Publikuar nga:

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Përgatitur nga:

Avokatura Ibrahimaga - Osmani - Tigani (I.O.T),

Kontribuesit:

Flakron Sylejmani, në emër të Projektit për Reformë Ligjore – GIZ

© **2014** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe Avokatura Ibrahimaga Osmani Tigani (I.O.T)

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH nuk e merr asnjë përgjegjësi për përmbajtjen e paraqitur dhe nuk është përgjegjës për aktualitetin, saktësinë, plotësinë ose kualitetin e informatave të paraqitura. Prandaj, të gjitha pretendimet për dëmin e shkaktuar nga përdorimi i informatave të paraqitura, duke përfshirë edhe informatat që janë jo të plota ose të pasakta, do të refuzohen.

Nuk lejohet shumëzimi ose përdorimi i pjesëve të publikimit si fotografitë, etj. në publikimet tjera, pa lejen e veçantë të GIZ-it dhe autorëve.

Nëse ndonjë pjesë ose shprehje individuale në tekst nuk është e ligjshme ose e saktë, përmbajtja ose vlefshmëria e pjesëve tjera mbetet e pandikuar nga ky fakt.

Mars 2014

Publikuar në Prishtinë

Hartimi dhe publikimi i përmbledhjes së ligjeve u mundësua nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Projekti për Reformë Ligjore në Kosovë, në emër të Ministrisë Federale Gjermane për zhvillim ekonomik dhe bashkëpunim (BMZ).

PARATHËNIE

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ), në bashkëpunim me autorët e këtij publikimi, duke synuar përmirësimin e gjendjes me literaturën ligjore në Kosovë, ka kënaqësinë që t'ju ofrojë Komentarin e Ligjit për Familjen në Kosovë.

Nisur nga fakti se ka probleme të ndryshme rreth zbatimit të ligjeve në Kosovë, të interpretimit të dispozitave- ndonjëherë edhe për përmbajtjen e dispozitave të caktuara, është parë si më se e domosdoshme që nga ekspertët të bëhet komentimi i ligjit dhe nxjerrja e kuptimit të duhur dhe të drejtë.

Komentari ofron sqarime dhe shtjellime të neneve të ligjit si dhe jep udhëzime për zbatimin e drejtë dhe adekuat të tij, sipas teorisë dhe praktikës vendore dhe ndërkombëtar, duke mos lënë anash edhe të arriturat juridike në këtë drejtim.

Gjithashtu, ky komentar do të ndihmojë profesionistët e fushës juridike në institucionet e Kosovës, që nga Ministria, Gjykatat, Prokuroritë, Fakultetin juridik si dhe të gjithë bashkëpunëtorët profesionalë në kryerjen e detyrave të tyre gjatë zbatimit dhe kuptimit të drejtë të këtij ligji. Kjo do t'i kontribojë krijimit të sigurisë juridike, mbrojtjes së interesave të palëve në procedurë si dhe ngritjen e besueshmërisë së qytetarëve në institucionin e Drejtësisë.

Presim që Komentari të bëhet një mjet i çmueshëm për komunitetin e profesionistëve juridikë, duke qenë i pari i këtij lloji, madje edhe si një kontribut i vlershëm për drejtësinë në Kosovë.

GIZ - Projekti për reformën ligjore në Kosovë- falënderon autorët e këtij komentari dhe personelin akademikë, ekspertët juridikë dhe bashkëpunëtorët e tyre të cilët ndihmuan në këtë punë, që ky publikim dhe të tjerat në të ardhmen do të jenë të dobishme për profesionistët e fushës së drejtësisë, shkencat juridike, gjithashtu do të jenë të dobishme edhe për popullin e Kosovës në përgjithësi.

Aktiviteti legjislativ në Kosovë në vitet e fundit ka rezultuar me miratimin e ligjeve të shumta nga Parlamenti i Kosovës, si legjislacion primar, që kanë pasur ndikim në shumë fusha të jetës sonë të përditshme. Vënia në dispozicion e legjislacionit primar është një nga parakushtet e vendosjes së sundimit të ligjit në Kosovë.

Për më tepër, mungesa e literaturës juridike ka nxitur Projektin e GIZ-it për Reformë Juridike dhe të ndërmarr iniciativën për përgatitjen e edicionit të parë të përmbledhjes së ligjeve në vitin 2009 i cili u botua përfundimisht në vitin 2012.

Përgjigjet e dhëna në pyetësorin e shpërndarë për komunitetin juridik treguan se rezultatet ishin shumë pozitive. Të gjithë të anketuarit vlerësuan punën e Projektit të GIZ-it për Reformë Juridike në botimin e përmbledhjeve të ligjeve. Përveç kësaj, për

shkak të zhvillimit dinamik të legjislacionit, të anketuarit sugjeruan botimin e edicionit të ri të pakos së përditësuar të përmbledhjes së ligjeve.

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, në emër të Ministrisë Federale të Gjermanisë për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ) në bashkëpunim me Firmën Juridike Ibrahimaga - Osmani - Tigani (I.O.T), me kënaqësi prezanton edicionin e dytë të Përmbledhjes së Ligjeve të Aplikueshme në Kosovë me synim të përmirësimit të situatës në fushën e botimeve juridike në Kosovë dhe me qëllim që komunitetit juridik t'i sigurohen mjetet efektive të punës.

Në këtë përmbledhje mund t'i gjeni të gjitha ligjet me ndryshime dhe plotësime gjer në datën e botimit të përmbledhjes.

Përdoruesit mund të shfrytëzojnë tekstin e ligjeve nga përmbledhja, si versione të aplikueshme pa pasur nevojë të kërkojnë gjetiu tekstet e ligjeve. Legjislacioni i përfshirë në këtë përmbledhje i referohet burimit origjinal të ligjit, titullit dhe numrit të ligjit si dhe datës së botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Përmbledhja është e ndarë në katër fusha kryesore: E drejta Civile, Penale, Administrative dhe Komerciale - Administrative. Me qëllim të lehtësisë në gjetjen e tekstit përkatës, secila fushë është e ndarë në nënfusha të fushës përkatëse.

Ligjet janë përmbledhur në 7 libra të organizuara sipas fushave:

Përmbledhja e ligjeve në fushën administrative ndahet në tri vëllime, me këtë përmbajtje:

Vëllimi I Legjislacioni: Interesat shtetërore, rendi publik dhe siguria, të drejtat e njeriut, statusi civil, mjedisi dhe ndërtimtaria;

Vëllimi II Legjislacioni: Kujdesi shëndetësor, puna dhe shoqëria, ekonomia dhe industria, administrata publike, drejtësia, pushteti lokal;

Vëllimi III Legjislacioni: Mediet dhe publikimi, punët e jashtme dhe humanitare, kultura dhe sporti, komunikimi, arsimi dhe shkenca, inspektoratet dhe konventat ndërkombëtare.

Përmbledhja e ligjeve në fushën civile ka një vëllim me këtë përmbajtje: E drejta civile sistemike, ligjet procedurale dhe ligjet e procedurës jokontestimore.

Përmbledhja e ligjeve penale ka një vëllim me këtë përmbajtje: ligjet materiale dhe procedurale.

Përmbledhja e ligjeve ekonomike është e ndarë në dy vëllime:

Vëllimi I Legjislacioni: Sektori i tregtisë dhe industrisë, kompanitë, privatizimi, koncesionet dhe format tjera të investimit, sektori i pronësisë industriale, aktivitetet në fushën e botimeve, bujqësia, blegtoria, ujërat, pylltaria, peshkataria, bletaria dhe gjuetia;

Vëllimi II Legjislacioni: Sektori i energjisë dhe minierave, sektori i bankave dhe financave, legjislacioni për tatime dhe dogana, marrëveshjet ndërkombëtare për zhvillim ekonomik, financat publike dhe auditimi.

Këto përmbledhje janë në dispozicion në versionin e shtypur në gjuhën shqipe, kurse versionet në anglisht dhe në serbisht janë në dispozicion në CD-ROM.

GIZ – Projekti për Reformë Juridike në Kosovë falënderon Firmën Juridike Ibrahimaga - Osmani -Tigani dhe të gjithë bashkëpunëtorët e tyre të cilët ndihmuan në realizimin e kësaj pune, me shpresë se ky botim dhe botimet e ardhshme të përmbledhjeve do t'i ndihmojnë profesionistëve në fushën juridike në shfrytëzimin e ligjeve të aplikueshme (në fushat e tyre përkatëse), dhe do t'ua lehtësojnë qytetarëve gjetjen e ligjeve që u interesojnë.

Volkmar Theobald

Menaxher i projektit
Projekti për Reformë Juridike - GIZ
Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

PËRMBAJTJA

E DREJTA ADMINISTRATIVE – PJESA SHTETËRORE

I. INTERESAT SHTETËRORE

Kushtetuta e Kosovës 3
Amandamenti i Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të Pavarësisë së Kosovës 58
Amendamentimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Amendamenti nr. 23) 61
Ligji Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës 62
Ligji Nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës 126
Ligji Nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve 130
Ligji Nr. 03/L-094 për presidentin e Republikës së Kosovës 141
Ligji Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës 150
Ligji Nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës 158
Ligji Nr. 03/L-108 për ndryshimin e ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës Nr. 03/L-046, të datës 15.06.2008 170
Ligji Nr. 03/L-050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës 171
Ligji Nr. 03/L-063 Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë 179
Ligji Nr. 03/L-089 Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për kufijtë administrativ komunal, ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, ligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, ligjit për azil dhe ligjit për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror 200
Ligji Nr. 03/L-132 për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës 202
Ligji Nr. 03/L-235 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-132 për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës 223
Ligji Nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës 230
Ligji Nr. 03/L-089 Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për kufijtë administrativ komunal, ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, ligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, ligjit për azil dhe ligjit për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror 233
Ligji Nr. 03/L-054 për vula në institucionet e Republikës së Kosovës 235
Ligji Nr. 03/L-190 për Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës 242
Ligji Nr. 03/L-176 për hetim parlamentar 249
Ligji Nr. 03/L-111 për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit 259
Ligji Nr. 03/L-038 për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës 279
Ligji Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike 288
Ligji Nr. 04/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike 296

Ligji Nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme 299
Ligji Nr. 2003/13 mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 2002/5 mbi themelimin e regjistrit të të drejtave në pronën e paluajtshme 303
Ligji Nr. 04/L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme 305
Ligji Nr. 03/L-075 për themelimin e zyrës së auditorit të përgjithshëm dhe zyrës së auditimit të Kosovës 307
Ligji Nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës 314
Ligji Nr. 04/-L-025 për nisma legjislative 326

II. RENDI PUBLIK DHE SIGURIA

Ligji Nr. 04/L-57 lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare 335
Ligji Nr. 04/L-076 për policinë 349
Ligji Nr. 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale 374
Ligji Nr. 03/L-142 Ligji për rendin dhe qetësinë publike 411
Ligji Nr. 03/L-118 për tubimet publike 417
Ligji Nr. 03/L-178 për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë 427
Ligji Nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit 449
Ligji Nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror 457
Ligji Nr. 04/L-217 për azil 481
Ligji Nr. 04/L-219 për të huajt 516
Ligji Nr. 04/L-088 për arkivat shtetërore 578
Ligji Nr. 04/L-071 për sistemin e adresave 586
Ligji Nr. 04/L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës 595
Ligji Nr. 03/L-143 për armët 614
Ligji Nr. 03/L-246 për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri 655
Ligji Nr. 04/L-022 për përdorim civil të eksplozivëve 676
Ligji Nr. 04/L-012 për mbrojtje nga zjarri 709
Ligji Nr. 04/L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera 724

III. DREJTËSIA

Ligji Nr. 03/L-202 për konfliktet administrative 775
Ligji Nr. 03/L-199 për gjykatat 792
Ligji Nr. 04/L-171 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-199 për gjykatat 809
Ligji Nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës 811
Ligji Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës 823
Ligji Nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës 843
Ligji Nr. 03/L-053 mbi kompetencat, për zgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë 855

Ligji Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës 872
Ligji Nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës 896
Ligji Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës 908
Ligji Nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës 925
Ligji Nr. 03/L-052 për Prokurorin Speciale të Republikës së Kosovës 937
Ligji Nr. 03/L-225 për prokurorin e shtetit 955
Ligji Nr. 04/L-193 për avokatinë 967
Ligji Nr. 02/L-25 për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës 987
Ligji Nr. 04/L-017 për ndihmë juridike falas 993
Ligji Nr. 03/L-101 Ligj për faljen 1006
Ligji Nr. 03/L-141 për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar 1010
Ligji Nr. 03/L-187 për mjekësinë ligjore 1015
Ligji Nr. 03/L-137 për Departamentin e Mjekësisë Ligjore 1022
Ligji Nr. 04/L-157 për avokaturën shtetërore 1028
Ligji Nr. 04/L-141 për provimin e jurisprudencës 1037
Ligji Nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë 1046

IV. TË DREJTAT E NJERIUT

Ligji Nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë 1057
Ligji Nr. 2004/3 kundër diskriminimit 1062
Ligji Nr. 03/L-215 për qasje në dokumente publike 1068
Ligji Nr. 2004/2 për barazi gjinore 1079
Ligji Nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës 1090
Ligji Nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës 1103
Ligji Nr. 04/L-020 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës 1115
Ligji Nr. 03/L-95 për të drejtat e ish të denuarve dhe të përndjekurve politikë 1117
Ligji Nr. 03/L-195 për avokatin e popullit 1125

V. MARRËDHËNIET ME JASHTË

Ligji Nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe shërbimin diplomatik të Kosovës 1141
Ligji Nr. 03/L-207 Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe shërbimin diplomatik të Republikës së Kosovës 1147
Ligji Nr. 03/L-125 për shërbimin konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës 1149
Ligji Nr. 03/L-122 për shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës 1157

Ligji Nr. 03/L-033 për statusin, imunitetet dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin e kosovës dhe praninë ndërkombëtare ushtarake si dhe personelin e saj.....1170
Ligji Nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës 1177
Ligji Nr. 04/L-052 për marrëveshjet ndërkombëtare 1189
Ligji Nr. 03/L-183 për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare.....1199
Ligji Nr. 04/L-122 për ratifikimin e këmbimit të notave diplomatike për statusin e forcave të huaja mes Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës 1206
Ligji Nr. 04/L-148 për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë.....1210

VI. KONVENTAT NDËRKOMBËTARE

Ligji Nr. 04/L-207 për ratifikimin e marrëveshjes kornizë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime që rregullon aktivitetet e Bankës Evropiane për investime në Kosovë.....1219
Ligji Nr. 04/L-134 për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi 1231
Ligji Nr. 04/L-199 për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.....1255

E DREJTA ADMINISTRATIVE – PJESA SHTETËRORE

INTERESAT SHTETËRORE

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Përmbajtja

Kapitulli I: Dispozitat themelore 4
Kapitulli II: Të drejtat dhe liritë themelore 8
Kapitulli III: Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre 17
Kapitulli IV: Kuvendi i Republikës së Kosovës 21
Kapitulli V: Presidenti i Republikës së Kosovës 28
Kapitulli VI: Qeveria e Republikës së Kosovës 31
Kapitulli VII: Sistemi i drejtësisë 34
Kapitulli VIII: Gjykata Kushtetuese 39
Kapitulli IX: Marrëdhëniet ekonomike 41
Kapitulli X: Qeverisja lokale dhe organizimi territorial 43
Kapitulli XI: Sektori i sigurisë 44
Kapitulli XII: Institucionet e pavarura 47
Kapitulli XIII: Dispozitat përfundimtare 51
Kapitulli XIV: Dispozitat kalimtare 52

Ne, Populli i Kosovës,

Të vendosur për të ndërtuar një ardhmëri të Kosovës si një vend i lirë, demokratik dhe paqedashës, i cili do të jetë atdhe i të gjithë qytetarëve të vet;

Të përkushtuar për krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit;

Të zotuar që Kosova të jetë shtet i mirëqenies ekonomike dhe i prosperitetit social;

Të sigurt që shteti i Kosovës do të kontribuojë në stabilitetin e rajonit dhe të mbarë Evropës, duke krijuar marrëdhënie të fqinjësisë dhe të bashkëpunimit të mirë me të gjitha shtetet fqinje;

Të bindur që shteti i Kosovës do të jetë anëtar i denjë i familjes së shteteve paqedashëse në Botë;

Me synimin që shteti i Kosovës të përfshihet në proceset integruese Euro-Atlantike; Në mënyrë solemne, miratojmë Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Kapitulli I
Dispozitat Themelore

Neni 1
[Përkufizimi i Shtetit]

1. Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik, dhe i pandashëm.
2. Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet. Republika e Kosovës ushtron autoritetin e saj bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj.
3. Republika e Kosovës nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjë shteti ose pjese të ndonjë shteti dhe nuk do të kërkojë të bashkohet me asnjë shtet ose pjesë të ndonjë shteti.

Neni 2
[Sovraniteti]

1. Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet, në pajtim me Kushtetutën, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, me referendum, si dhe në forma të tjera, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.
2. Sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj.
3. Republika e Kosovës, me qëllim të ruajtjes së paqes dhe mbrojtjes së interesave shtetërore, mund të marrë pjesë në sisteme të sigurisë ndërkombëtare.

Neni 3
[Barazia para Ligjit]

1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.
2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

Neni 4
[Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]

1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.

3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.
4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.
5. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.
6. Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.
7. Republika e Kosovës ka institucionet e veta për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe të integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës.

Neni 5
[Gjuhët]

1. Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe.
2. Gjuha Turke, Boshnjake dhe ajo Rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj.

Neni 6
[Simbolet]

1. Flamuri, stema dhe himni janë simbolet shtetërore të Republikës së Kosovës të cilat pasqyrojnë karakterin shumetnik të saj.
2. Pamja, mënyra e përdorimit dhe mbrojtja e flamurit dhe të simboleve të tjera shtetërore rregullohen me ligj. Mënyra e përdorimit dhe e mbrojtjes së simboleve kombëtare rregullohet me ligj.

Neni 7
[Vlerat]

1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.
2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.

Neni 8
[Shteti Laik]

Republika e Kosovës është shtet laik dhe neutral në çështje të besimeve fetare.

Neni 9
[Trashëgimia Kulturore dhe Fetare]

Republika e Kosovës siguron ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë së vet kulturore dhe fetare.

Neni 10
[Ekonomia]

Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës.

Neni 11
[Valuta]

1. Në Republikën e Kosovës si mjet i vlefshëm pagese përdoret një valutë e vetme.
2. Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës është i pavarur dhe quhet Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Neni 12
[Pushteti Lokal]

1. Njësi themelore territoriale të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës janë komunat.
2. Organizimi dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes lokale rregullohen me ligj.

Neni 13
[Kryeqyteti]

1. Kryeqyteti i Republikës së Kosovës është Prishtina.
2. Statusi dhe organizimi i kryeqytetit rregullohet me ligj.

Neni 14
[Shtetësia]

Fitimi dhe humbja e së drejtës së shtetësisë së Republikës së Kosovës rregullohet me ligj.

Neni 15
[Shtetasit jashtë Vendit]

Republika e Kosovës mbron interesat e shtetasve të saj jashtë vendit, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 16
[Epërsia e Kushtetutës]

1. Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë.
2. Pushteti qeverisës buron nga Kushtetuta.
3. Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare.
4. Secili person dhe organ në Republikën e Kosovës u nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës.

Neni 17
[Marrëveshjet Ndërkombëtare]

1. Republika e Kosovës lidh marrëveshje ndërkombëtare dhe anëtarësohet në organizata ndërkombëtare.
2. Republika e Kosovës merr pjesë në bashkëpunim ndërkombëtar për promovimin dhe mbrojtjen e paqes, sigurisë dhe të drejtave të njeriut.

Neni 18
[Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare]

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje:
   (1) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;
   (2) të drejtat dhe liritë themelore;
   (3) anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare;
   (4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës.
2. Marrëveshjet ndërkombëtare me përjashtim të atyre në pikën 1, ratifikohen pas nënshkrimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës.
3. Presidenti i Republikës së Kosovës ose Kryeministri njoftojnë Kuvendin sa herë që të nënshkruhet një marrëveshje ndërkombëtare.
4. Amendamentimi ose tërheqja nga marrëveshjet ndërkombëtare do të kenë të njejtën procedurë të vendim marrjes sikur ajo e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare.
5. Parimet dhe procedurat për ratifikimin dhe kontestimin e marrëveshjeve ndërkombëtare rregullohen me ligj.

Neni 19
[Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare]

1. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji.
2. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.

Neni 2
[Bartja e Sovranitetit]

1. Republika e Kosovës, në bazë të marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, për çështje të caktuara mund të kalojë kompetenca shtetërore organizatave ndërkombëtare.
2. Nëse një marrëveshje anëtarësimi e ratifikuar nga Republika e Kosovës për pjesëmarrje në një organizatë ndërkombëtare në mënyrë eksplicite kërkon zbatim të drejtpërdrejtë të normave të kësaj organizate, ligji me të cilin ratifikohet marrëveshja e anëtarësisë miratohet me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe ato norma kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.

Kapitulli II
Të Drejtat dhe Liritë Themelore

Neni 21
[Parimet e Përgjithshme]

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.
2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.
3. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.
4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

Neni 22
[Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve dërkombëtare]

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
(3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
(4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
(5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
(6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
(7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
(8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

Neni 23
[Dinjiteti i Njeriut]

Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Neni 24
[Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 25
[E Drejta për Jetën]

1. Secili individ gëzon të drejtën për jetën.
2. Dënimi me vdekje është i ndaluar.

Neni 26
[E Drejta e Integritetit Personal]

Secili person gëzon të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj, që përfshin:
1. të drejtën që të marrë vendime lidhur me reprodukimin, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me ligj;
2. të drejtën që të ketë kontroll mbi trupin e saj/tij në pajtim me ligjin;
3. të drejtën që të mos i nënshtrohet trajtimit mjekësor kundër vullnetit të tij/saj në pajtim me ligjin;
4. të drejtën që të mos marrë pjesë në eksperimente mjekësore ose shkencore, pa pëlqimin paraprak të saj/tij.

Neni 27
[Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues]

Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.

Neni 28
[Ndalimi i Skllavërisë dhe i Punës së Detyruar]

1. Askush nuk mund të mbahet në skllavëri ose në pozitë të ngjashme me skllavërinë.
2. Askush nuk mund të shtrëngohet për të kryer punë të detyruar. Punë e detyruar nuk konsiderohet puna ose shërbimi i përcaktuar me ligj për personat e dënuar me vendim të formës së prerë gjatë vuajtjes së dënimit ose në raste të Gjendjes së Jashtëzakonshme, të shpallur sipas rregullave të përcaktuara me këtë Kushtetutë.
3. Trafikimi i qenieve njerëzore është i ndaluar.

Neni 29
[E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë]

1. Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:
   (1) pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale;
   (2) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;
   (3) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij/saj në një institucion kompetent, sipas një urdhri të ligjshëm;
   (4) për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë;
   (5) për hyrje të paligjshme në Republikën e Kosovës ose pas urdhrit të ligjshëm për largim ose ekstradim.
2. Çdokush që privohet nga liria, duhet të vihet në dijeni menjëherë, për arsyet e privimit, në gjuhën që ajo/ai e kupton. Njoftimi me shkrim mbi arsyet e privimit duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundshme. Çdokush që privohet nga liria pa urdhër të gjykatës, brenda dyzet e tetë (48) orësh duhet të dërgohet përpara gjyqtarit, i cili vendos për paraburgimin ose lirimin e tij/saj, jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga momenti kur personi i privuar është sjellë para gjykatës. Çdokush që arrestohet, ka të drejtën që të nxirret në gjykim brenda një periudhe të arsyeshme, ose të lirohet në pritje të gjykimit, me përjashtim kur gjyqtari konstaton se personi përbën rrezik për komunitetin ose ka rrezik për ikjen e saj/tij para gjykimit.
3. Çdokush që privohet nga liria, duhet të njoftohet menjëherë se ka të drejtë të mos japë asnjë deklaratë dhe se ka të drejtë për mbrojtës sipas zgjedhjes së tij/saj dhe ka të drejtë që pa vonesë të informojë për këtë personin sipas zgjedhjes së vet.
4. Çdokush që i hiqet liria me arrest ose ndalim, gëzon të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit ose të ndalimit. Rasti do të vendoset nga gjykata brenda një afati sa më të shkurtër dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, do të urdhërohet lirimi i personit.
5. Çdokush që është ndaluar ose arrestuar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, gëzon të drejtën e kompensimit në mënyrën e parashikuar me ligj.

6. Personi që vuan dënimin, ka të drejtë të ankohet për kushtet e privimit nga liria, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 30
[Të Drejat e të Akuzuarit]

Çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale në vijim:

(1) të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër saj/ tij;
(2) të njoftohet për të drejtat e tij/saj sipas ligjit;
(3) të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;
(4) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi;
(5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas;
(6) të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet.

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.
6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.
7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.

Neni 32
[E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 33
[Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale]

1. Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit.
2. Dënimi i shqiptuar për një vepër penale nuk mund të jetë më i ashpër sesa ka qenë i përcaktuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës.
3. Ashpërsia e dënimit nuk mund të jetë në disproporcion me veprën penale.
4. Dënimet përcaktohen në bazë të ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, me përjashtim të veprave për të cilat ligji i mëvonshëm i aplikueshëm është më i favorshëm për kryesin e veprës.

Neni 34
[E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër]

Askush nuk mund të gjykohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale.

Neni 35
[Liria e Lëvizjes]

1. Shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Kosovës, kanë të drejtë të lëvizin lirisht në Republikën e Kosovës dhe të zgjedhin vendbanimin.
2. Secili person ka të drejtë të largohet nga vendi. Kufizimet e kësaj të drejte rregullohen me ligj, nëse ato janë të nevojshme për procedurën ligjore, zbatimin e vendimit të gjykatës ose për të përmbushur obligimin për mbrojtjen e shtetit.
3. Shtetasve të Republikës së Kosovës nuk do t'u ndalohet hyrja në Republikën e Kosovës.
4. Shtetasit e Republikës së Kosovës nuk mund të ekstradohen nga Kosova kundër vullnetit të tyre, me përjashtim të rasteve kur me ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare është përcaktuar ndryshe.
5. E drejta e të huajve për të hyrë në Republikën e Kosovës dhe për t'u vendosur në vend, rregullohet me ligj.

Neni 36
[E Drejta e Privatësisë]

1. Çdokush gëzon të drejtën që t'i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera.

2. Kontrollet e cilësdo banese ose cilitdo objekti privat, që mendohet se janë të domosdoshme për hetimin e krimit, mund të bëhen vetëm deri në shkallën e domosdoshme dhe vetëm pas miratimit nga ana e gjykatës, pas shpjegimit të arsyeve pse një kontroll i tillë është i domosdoshëm. Shmangia nga kjo rregull lejohet, nëse është e domosdoshme për arrestim të ligjshëm, për mbledhjen e provave që ka rrezik të humbasin ose për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerëzit dhe për pasuri, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Gjykata duhet që të miratoj veprimet e tilla në mënyrë retroaktive.
3. Fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimit tjetër, është e drejtë e pacenueshme. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm përkohësisht, në bazë të vendimit gjyqësor, nëse është e domosdoshme për ecurinë e procedurës penale ose për mbrojtjen e vendit, në mënyrën e parashikuar me ligj.
4. Secili person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Mbledhja, ruajtja, qasja, korrigjimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligj.

Neni 37
[E Drejta e Martesës dhe Familjes]

1. Në bazë të pëlqimit të lirë, çdokush gëzon të drejtën të martohet dhe të drejtën që të krijojë familje në pajtim me ligjin.
2. Martesa dhe zgjidhja e saj rregullohen me ligj dhe bazohen në barazinë e bashkëshortëve.
3. Familja gëzon mbrojtje të veçantë të shtetit, në mënyrën e rregulluar me ligj.

Neni 38
[Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë]

1. Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë, është e garantuar.
2. Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë ngërthen të drejtën për të pranuar dhe për të manifestuar fenë, të drejtën për të shfaqur bindjet personale dhe të drejtën për të pranuar ose refuzuar për të qenë anëtarë i një bashkësie ose grupi fetar.
3. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohet, në kundërshtim me ndërgjegjen e vet, që të marrë pjesë në praktikimin e fesë si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij/saj.
4. Liria e manifestimit të fesë, e besimit dhe e ndërgjegjes mund të kufizohet me ligj, nëse një gjë e tillë është e domosdoshme për mbrojtjen e sigurisë dhe rendit publik, të shëndetit, ose të të drejtave të personave të tjerë.

Neni 39
[Konfesionet Fetare]

1. Republika e Kosovës siguron dhe mbron autonominë fetare dhe monumentet fetare brenda territorit të saj.
2. Konfesionet fetare janë të lira që të rregullojnë pavarësisht organizimin e vet të brendshëm, veprimtaritë fetare, si dhe ritet fetare.
3. Konfesionet fetare kanë të drejtë të themelojnë shkolla fetare dhe institucione bamirëse në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligj.

Neni 40
[Liria e Shprehjes]

1. Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush.
2. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.

Neni 41
[E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike]

1. Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike.
2. Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.

Neni 42
[Liria e Medieve]

1. Garantohet liria dhe pluralizmi i medieve.
2. Censura është e ndaluar. Askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose të ideve nëpërmjet medieve, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.
3. Çdokush ka të drejtë të korrigjojë informacionin e pavërtetë, jo të plotë ose të pasaktë të publikuar, nëse cenon të drejtat ose interesat e saj/tij, në pajtim me ligjin.

Neni 43
[Liria e Tubimit]

Liria e tubimit paqësor është e garantuar. Secili person gëzon të drejtën për të organizuar tubime, protesta dhe demonstrata, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në to. Këto të drejta mund të kufizohen me ligj, nëse është e domosdoshme për të siguruar rendin publik, shëndetin publik, sigurinë kombëtare, ose mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve.

Neni 44
[Liria e Asociimit]

1. Liria e asociimit është e garantuar. Liria e asociimit ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate.

2. Liria për të themeluar sindikata dhe për t'u organizuar, me qëllim që të mbrohen interesat, është e garantuar. Kufizimi i kësaj të drejte mund të bëhet me ligj për kategori të veçanta të punonjësve.
3. Organizatat ose aktivitetet që kanë për qëllim cenimin e rendit kushtetues, shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut, ose nxitjen e urrejtjes racore, kombëtare, etnike a fetare, mund të ndalohen me vendim gjyqësor të gjykatës kompetente.

Neni 45
[Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]

1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.
2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.
3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.

Neni 46
[Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.
4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.
5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.

Neni 47
[E Drejta për Arsimin]

1. Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohen me ligj dhe financohet nga fondet publike.
2. Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t'u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.

Neni 48
[Liria e Artit dhe e Shkencës]

1. Liria e krijimtarisë artistike dhe shkencore është e garantuar.
2. Liria akademike është e garantuar.

Neni 49
[E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

1. E drejta e punës garantohet.
2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.

Neni 50
[Të Drejtat e Fëmijës]

1. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre.
2. Fëmijët e lindur jashtë martese, kanë të drejta të barabarta me të lindurit në martesë.
3. Secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi.
4. Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.
5. Secili fëmijë gëzon të drejtën për raporte të rregullta personale dhe kontakte të drejtpërdrejta me prindërit e vet, me përjashtim kur institucioni kompetent përcakton se një gjë e tillë është në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës.

Neni 51
[Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale]

1. Kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj.
2. Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj.

Neni 52
[Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor]

1. Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin.
2. Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton.
3. Ndikimi në mjedisin jetësor merret parasysh nga institucionet publike në procesin e marrjes së vendimeve.

Neni 53
[Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]

Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 54
[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Neni 55
[Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]

1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.
2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.
3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.
4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.
5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar.

Neni 56
[Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme]

1. Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore që mbrohen me Kushtetutë, mund të bëhet vetëm pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme sipas kësaj Kushtetute dhe vetëm deri në masën sa është e domosdoshme nën rrethanat e dhëna.
2. Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 23, 24, 25, 27, 28, 29, 31, 33, 34, 37 dhe 38, të Kushtetutës nuk është e lejuar në kurrfarë rrethanash.

Kapitulli III
Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre

Neni 57
[Parimet e Përgjithshme]

1. Banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (Komunitetet), gëzojnë të drejta të veçanta, të përcaktuara me këtë Kushtetutë, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II të kësaj Kushtetute.

2. Çdo pjesëtar i komunitetit do të ketë të drejtën që të zgjedhë lirisht nëse do të trajtohet ose të mos trajtohet si pjesëtar i komunitetit dhe nga kjo zgjedhje ose nga ushtrimi i të drejtave që ndërlidhen me këtë zgjedhje, nuk do të rezultojë asnjë diskriminim.
3. Pjesëtarët e komuniteteve do të kenë të drejtë që të shprehin, të avancojnë dhe të zhvillojnë lirisht identitetin dhe atributet e tyre si komunitet.
4. Ushtrimi i këtyre të drejtave do të bartë me vete detyrimet dhe përgjegjësitë për të vepruar në pajtim me ligjin e Republikës së Kosovës, dhe nuk i cenon të drejtat e të tjerëve.

Neni 58[*]
[Përgjegjësitë e Shtetit]

1. Republika e Kosovës siguron kushtet e duhura, të cilat u mundësojnë komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre që të ruajnë, të mbrojnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre. Qeveria do të përkrahë veçanërisht nismat kulturore të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, përfshirë këtu edhe nëpërmjet ndihmës financiare.
2. Republika e Kosovës do të promovoj frymën e tolerancës, dialogut dhe do të mbështesë pajtimin ndërmjet komuniteteve dhe do të respektoj standardet e përcaktuara me Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe me Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave.
3. Republika e Kosovës do të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur personat të cilët mund t'u nënshtrohen kërcënimeve ose veprimeve diskriminuese, armiqësisë a dhunës, si rrjedhojë e identitetit të tyre kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar.
4. Republika e Kosovës, sipas nevojës, do të miratojë masa adekuate për të promovuar një barazi të plotë dhe efektive ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore. Masat e tilla nuk do të konsiderohen të jenë vepër e diskriminimit.
5. Republika e Kosovës do të promovoj ruajtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore të të gjitha komuniteteve, si pjesë përbërëse e trashëgimisë së Kosovës. Republika e Kosovës do të ketë detyrë të posaçme për të siguruar mbrojtjen efektive të tërësisë së objekteve dhe monumenteve të rëndësisë kulturore dhe fetare për komunitetet.
6. Republika e Kosovës ndërmerr veprime efektive kundër të gjithë atyre që pengojnë gëzimin e të drejtave të pjesëtarëve të komuniteteve. Republika e Kosovës do të përmbahet nga politikat ose praktikat që kanë për qëllim asimilimin, kundër vullnetit të tyre, të personave që u përkasin komuniteteve, dhe do t'i mbrojë ata persona nga çfarëdo veprimi që ka për qëllim një asimilim të tillë.
7. Republika e Kosovës siguron, në baza jodiskriminuese, që të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre të mund të ushtrojnë të drejtat e tyre, të specifikuara me këtë Kushtetutë.

[*] Neni 58, paragrafi 4 është riformuluar me amendamentin 1.

Neni 59
[Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre]

Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që, në mënyrë individuale ose si komunitet:

1. të shprehin, mbajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre dhe të ruajnë elementet thelbësore të identitetit të tyre, përkatësisht fenë, gjuhën, traditat dhe kulturën e tyre;
2. të marrin arsimim publik në të gjitha nivelet, në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës se Kosovës, sipas zgjidhjes së tyre;
3. të marrin arsimim publik parafillor, fillor dhe të mesëm, në gjuhën e tyre, deri në masën e përcaktuar me ligj, ku pragu për themelimin e paraleleve a shkollave të veçanta për këtë qëllim, do të jetë më i ulët sesa ai që përcaktohet rëndom për institucionet arsimore;
4. të themelojnë dhe të menaxhojnë institucionet private të arsimit dhe trajnimit, për të cilat mund të jepet ndihma financiare publike, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;
5. të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre lirisht në jetën private dhe publike;
6. të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre në marrëdhëniet e tyre me autoritetet komunale ose me zyrat lokale të autoriteteve qendrore në fushat në të cilat ata përfaqësojnë një pjesë të mjaftueshme të popullatës, në pajtim me ligjin. Shpenzimet e bëra për interpretuesit ose përkthyesit, do të mbulohen nga autoritetet kompetente;
7. të përdorin dhe të shfaqin simbolet e komunitetit, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;
8. të regjistrojnë emrat personal në formën e tyre origjinale dhe në shkrimin e gjuhës së tyre, si dhe emrat e tyre t'i kthejnë në formën origjinale, nëse u janë ndryshuar me dhunë;
9. të kenë emërtime lokale, emërtime të rrugëve dhe tregues të tjerë topografikë, që pasqyrojnë dhe janë të ndjeshëm ndaj karakterit shumetnik dhe shumëgjuhësor të zonës përkatëse;
10. të kenë qasje të garantuar dhe përfaqësim të veçantë në mediet transmetuese publike si dhe programet në gjuhën e tyre, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;
11. të krijojnë dhe të përdorin mediet e tyre vetjake, përfshirë këtu ofrimin e informacioneve në gjuhën e tyre, ndër të tjera, përmes gazetave ditore e shërbimeve kabllore, dhe përdorimin e një numri të rezervuar të frekuencave për mediet elektronike, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare. Republika e Kosovës do të marrë të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e një plani ndërkombëtar të frekuencave, për t'i mundësuar komunitetit Serb në Kosovë qasje në një kanal televiziv të pavarur, të licencuar në gjuhën Serbe, në mbarë Republikën e Kosovës;
12. të gëzojnë kontakte të papenguara ndërmjet tyre përbrenda Republikës së Kosovës, dhe të themelojnë e të mbajnë kontakte të lira dhe paqësore me personat në cilindo shtet, sidomos me ata që kanë të përbashkët identitetin etnik, kulturor, gjuhësor a fetar, ose trashëgiminë e përbashkët kulturore, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;

13. të gëzojnë kontakte të papenguara me dhe të marrin pjesë, pa diskriminim, në aktivitetet e organizatave joqeveritare lokale, rajonale dhe ndërkombëtare;
14. të themelojnë shoqata të kulturës, artit, shkencës dhe arsimit, si dhe shoqata të studiuesve e shoqata të tjera për shprehjen, avancimin dhe zhvillimin e identitetit të tyre.

Neni 60
[Këshilli Konsultativ për Komunitete]

1. Një Këshill Konsultativ për Komunitete vepron nën autoritetin e Presidentit të Republikës së Kosovës, në të të cilin përfaqësohen të gjitha komunitetet.
2. Këshilli Konsultativ për Komunitete përbëhet, përveç të tjerësh, nga përfaqësues të asociacioneve të komuniteteve.
3. Mandati i Këshillit Konsultativ për Komunitete përfshin:
   (1) ofrimin e një mekanizmi për shkëmbimin e rregullt ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë së Kosovës;
   (2) mundësinë e komuniteteve për të komentuar në një fazë të hershme nismat legjislative dhe politike, të cilat mund të përgatiten nga Qeveria, për të sugjeruar nisma të tilla dhe për të kërkuar që pikëpamjet e tyre të përfshihen në projektet dhe programet përkatëse;
   (3) çdo përgjegjësi a funksion tjetër, në pajtim me ligjin.

Neni 61
[Përfaqësimi në Punësim në Institucionet Publike]

Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre do të kenë të drejtë për përfaqësim të barabartë në punësim në organet publike dhe ndërmarrjet publike në të gjitha nivelet, përfshirë këtu veçanërisht në shërbimin policor në zonat e banuara me komunitetin përkatës, duke respektuar në të njëjtën kohë rregullat që kanë të bëjnë me kompetencën dhe integritetin e qeverisjes së administratës publike.

Neni 62
[Përfaqësimi në Organet e Pushtetit Lokal]

1. Në komunat në të cilat së paku dhjetë për qind (10%) të banorëve u përkasin komuniteteve, të cilat në ato komuna nuk janë shumicë, posti i zëvendëskryetarit për komunitete të kuvendit të komunës do të rezervohet për një përfaqësues nga radhët e këtyre komuniteteve.
2. Postin e zëvendëskryetarit do ta mbajë kandidati që i përket popullatës që nuk është shumicë, që ka marrë shumicën e votave në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje për kuvendin e komunës.
3. Zëvendëskryetari për komunitetet, do të promovojë dialog ndërmjet komuniteteve dhe shërben si pikë formale e kontaktit për adresimin e brengave dhe interesave të komuniteteve që nuk janë shumicë në takimet e kuvendit të komunës dhe në punët e saj. Zëvendëskryetari gjithashtu është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave që parashtrohen nga komunitetet ose pjesëtarët e tyre, nëse aktet a vendimet e

kuvendit të komunës shkelin të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë. Zëvendëskryetari këto çështje i'a referon kuvendit të komunës, për rishqyrtimin e aktit a të vendimit të marrë.

4. Në rast se kuvendi i komunës vendos që të mos rishqyrtojë aktin a vendimin e vet, ose nëse zëvendëskryetari vlerëson se, edhe pas rishqyrtimit rezultati përbën shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, ai/ajo mund të parashtrojë çështjen drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, e cila mund të vendosë nëse do të pranojë ta shqyrtojë rastin përkatës.
5. Në këto komuna përfaqësimi në organin ekzekutiv për komunitetet që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës është i garantuar.

Kapitulli IV
Kuvendi i Republikës së Kosovës

Neni 63
[Parimet e Përgjithshme]

Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli.

Neni 64
[Struktura e Kuvendit]

1. Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin.
2. Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej njëqind e njëzet (120) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovës, si vijon:
   (1) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin Serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10);
   (2) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti Rom një (1) vend; komuniteti Ashkali një (1) vend; komuniteti Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali, ose Egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti Boshnjak tri (3) vende, komuniteti Turk dy (2) vende dhe komuniteti Goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.

Neni 65*
[Kompetencat e Kuvendit]

Kuvendi i Republikës së Kosovës:

(1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme;
(2) vendos të ndryshojë Kushtetutën me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve që mbajnë vendet e rezervuara dhe të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë;
(3) shpall referendum, në pajtim me ligjin;
(4) ratifikon traktatet ndërkombëtare;
(5) miraton Buxhetin e Republikës së Kosovës;
(6) zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit;
(7) zgjedh dhe mund të shkarkojë Presidentin e Republikës së Kosovës në pajtim me këtë Kushtetutë;
(8) zgjedh Qeverinë dhe shpreh mosbesimin ndaj saj;
(9) mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit;
(10) zgjedh anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë;
(11) propozon gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese;
(12) mbikëqyr politikën e jashtme dhe të sigurisë;
(13) jep pëlqimin për dekretin e Presidentit mbi shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme;
(14) vendos për çështjet me interes të përgjithshëm, të përcaktuara me ligj.

Neni 66
[Zgjedhja dhe Mandati]

1. Kuvendi i Kosovës zgjidhet me mandat katërvjeçar, duke filluar nga dita e seancës konstituive, që mbahet brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve.
2. Zgjedhjet e rregullta për Kuvend mbahen më së voni tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit, kurse në raste të shpërndarjes së Kuvendit, jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas shpërndarjes.
3. Presidenti i Republikës së Kosovës e thërret seancën e parë të Kuvendit. Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës nuk është në gjendje të thërrasë seancën e parë, Kuvendi mblidhet pa pjesëmarrjen e Presidentit.
4. Mandati i Kuvendit të Kosovës mund të vazhdohet vetëm në raste të Gjendjes së Jashtëzakonshme për masa emergjente të mbrojtjes ose në rast të rrezikut ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike të Republikës së Kosovës, dhe vetëm për aq sa zgjat Gjendja e Jashtëzakonshme, siç është përcaktuar me këtë Kushtetutë.
5. Kushtet, zonat dhe procedurat zgjedhore, rregullohen me ligj.

* Ne nenin 65 pas pikes (14) shtohet pika (15) sipas amendamnetit nr. 23.

Neni 67
[Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve]

1. Kuvendi i Kosovës nga radhët e veta zgjedh Kryetarin dhe pesë (5) nënkryetarë.
2. Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar dhe zgjedhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.
3. Tre (3) nënkryetarët të propozuar nga tri grupet më të mëdha parlamentare, zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.
4. Dy (2) nënkryetarë përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kuvend dhe ata zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve. Njëri nënkryetar do të jetë nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet të rezervuara ose të garantuara të komunitetit Serb, dhe tjetri nënkryetar nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara nga komunitetet tjera që nuk janë shumicë.
5. Kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit shkarkohen me votën e shumicës prej dy të tretave (2/3) të numrit të përgjithshëm të deputetëve.
6. Kryetari dhe nënkryetarët formojnë Kryesinë e Kuvendit. Kryesia është përgjegjëse për funksionimin administrativ të Kuvendit në mënyrën e përcaktuar me Rregulloren e Punës të Kuvendit.
7. Kryetari i Kuvendit:
   (1) përfaqëson Kuvendin;
   (2) përcakton rendin e ditës, thërret dhe kryeson seancat;
   (3) nënshkruan aktet e miratuara nga Kuvendi;
   (4) ushtron edhe funksione të tjera, në bazë të kësaj Kushtetute dhe Rregullores së Punës të Kuvendit.
8. Në rast mungese ose pamundësie për të ushtruar funksionin, Kryetarin e Kuvendit e zëvendëson njëri nga nënkryetarët.

Neni 68
[Seancat]

1. Mbledhjet e Kuvendit të Kosovës janë publike.
2. Mbledhjet e Kuvendit të Kosovës mund të jenë të mbyllura me kërkesën e Presidentit të Republikës së Kosovës, të Kryeministrit ose të një të tretës (1/3) së deputetëve, në rastet e përcaktuara me Rregulloren e Punës të Kuvendit. Vendimi miratohet në mënyrë të hapur e transparente dhe kërkon votën e dy të tretave (2/3) të deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë.

Neni 69
[Orari i Seancave dhe Kuorumi]

1. Kuvendi i Kosovës punimet vjetore i zhvillon në dy sesione.
2. Sesioni pranveror fillon të hënën e tretë të muajit janar, kurse sesioni vjeshtor fillon të hënën e dytë të muajit shtator.
3. Kuvendi ka kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e të gjithë deputetëve të Kuvendit.

4. Kuvendi i Kosovës mblidhet në seancë të jashtëzakonshme me kërkesë të Presidentit të Republikës, të Kryeministrit ose të një të tretës (1/3) të deputetëve.

Neni 70
[Mandati i Deputetëve]

1. Deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit dhe nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues.
2. Mandati i deputetit të Kuvendit të Kosovës fillon ditën e certifikimit të rezultatit të zgjedhjes.
3. Mandati i deputetit mbaron ose bëhet i pavlefshëm, nëse:
   (1) nuk bën betimin;
   (2) jep dorëheqjen;
   (3) emërohet anëtar i Qeverisë së Kosovës;
   (4) përfundon mandati i Kuvendit;
   (5) mungon gjashtë (6) muaj rresht në seancat e Kuvendit. Në raste të veçanta, Kuvendi i Kosovës mund të vendosë ndryshe;
   (6) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale me një ose më shumë vjet burgim;
   (7) ajo/ai vdes.
4. Vendet e liruara të deputetëve në Kuvend, plotësohen menjëherë, në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligjin.

Neni 71
[Kualifikimet dhe Barazia Gjinore]

1. Secili shtetas i Republikës së Kosovës i cili është tetëmbëdhjetë (18) vjeç ose më i madh dhe përmbush kriteret ligjore, mund të jetë kandidat për deputet.
2. Përbërja e Kuvendit të Kosovës do të respektoj parimet e barazisë gjinore të cilat janë të pranuara në pajtim me parimet ndërkombëtare.

Neni 72
[Papajtueshmëria]

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nuk mund të mbajë ndonjë post ekzekutiv në administratën publike ose në ndonjë ndërmarrje në pronësi publike, dhe as të ushtrojë ndonjë funksion tjetër ekzekutiv, sikurse është përcaktuar me ligj.

Neni 73
[Pamundësia e Kandidimit]

1. Nuk mund të kandidohen dhe as të zgjidhen deputetë të Kuvendit, pa hequr dorë paraprakisht nga detyra e tyre:
   (1) gjyqtarët dhe prokurorët;
   (2) pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës;
   (3) pjesëtarët e Policisë së Kosovës;

(4) pjesëtarët e Doganave të Kosovës;
(5) pjesëtarët e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;
(6) udhëheqësit e agjencive të pavarura;
(7) përfaqësuesit diplomatikë;
(8) kryetarët dhe anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

2. Nuk mund të kandidohen për deputetë personat e privuar nga zotësia juridike për të vepruar, me vendim përfundimtar të gjykatës.
3. Kryetarët dhe zyrtarët e tjerë, të cilët mbajnë përgjegjësi ekzekutive në nivel komune, nuk mund të zgjidhen si deputetë të Kuvendit pa hequr dorë paraprakisht nga detyra e tyre.

Neni 74
[Ushtrimi i Funksionit]

Deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit.

Neni 75 [Imuniteti]

1. Deputetët e Kuvendit gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet e tyre brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë të Kuvendit. Imuniteti nuk pengon ndjekjen penale të deputetëve të Kuvendit për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive së tyre si deputetë të Kuvendit.
2. Deputeti i Kuvendit nuk mund të arrestohet dhe as ndalohet përderisa është duke kryer detyrat e tij/saj si deputet i Kuvendit, pa pëlqimin e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit.

Neni 76
[Rregullorja e Punës]

Rregullat e Punës së Kuvendit miratohen me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij dhe përcaktojnë organizimin e brendshëm dhe mënyrën e punës së Kuvendit.

Neni 77
[Komisionet]

1. Kuvendi i Kosovës emëron komisione të përhershme, komisione funksionale dhe komisione ad hoc, që pasqyrojnë përbërjen politike të Kuvendit.
2. Kuvendi, me kërkesën e një të tretës (1/3) së të gjithë deputetëve të tij, cakton komisione për një çështje të veçantë, duke përfshirë edhe çështje hetimore.
3. Së paku një zëvendëskryesues i secilit komision parlamentar, do të jetë nga radhët e komunitetit tjetër nga ai i kryesuesit.
4. Pushtetet dhe procedurat e komisioneve përkufizohen me Rregulloren e Punës të Kuvendit.

Neni 78
[Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve]

1. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve është komision i përhershëm i Kuvendit. Ky komision përbëhet nga një e treta (1/3) e anëtarëve që përfaqësojnë grupin e deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin Serb, nga një e treta (1/3) e anëtarëve që përfaqësojnë grupin e deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë, dhe një e treta (1/3) e anëtarëve nga komuniteti shumicë, të përfaqësuar në Kuvend.
2. Me kërkesën e cilitdo anëtar të Kryesisë së Kuvendit, çdo ligj i propozuar do të dorëzohet në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. Komisioni, me shumicën e votave të anëtarëve të tij, do të vendosë nëse do të bëjë rekomandime në lidhje me ligjin e propozuar brenda dy javësh.
3. Për të siguruar që të drejtat dhe interesat e komuniteteve janë adresuar si duhet, Komisioni mund t'i bëjë rekomandime komisionit tjetër përkatës ose Kuvendit.
4. Komisioni, me nismën e vet, mund të propozojë ligje dhe masa të tilla të tjera brenda përgjegjësive të Kuvendit, të cilat i konsideron se janë të duhura për të adresuar interesat e komuniteteve. Anëtarët e Komisionit mund të japin mendime individuale.
5. Një çështje mund t'i referohet komisionit për mendim këshillimor nga Kryesia e Kuvendit, një komisioni tjetër, ose një grupi të përbërë nga të paktën dhjetë (10) deputetë të Kuvendit.

Neni 79
[Nisma Legjislative]

Nismën për të propozuar ligje, mund ta marrë Presidenti i Republikës së Kosovës nga fushëveprimtaria e saj/tij, Qeveria, deputetët e Kuvendit, ose më së paku dhjetëmijë qytetarë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Neni 80
[Miratimi i Ligjeve]

1. Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë.
2. Ligji i miratuar nga Kuvendi nënshkruhet nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe shpallet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pasi ta ketë nënshkruar brenda tetë (8) ditësh pasi të ketë marrë ligjin.
3. Nëse Presidenti i Republikës e kthen ligjin në Kuvend, ai/ajo duhet të theksojë arsyet e kthimit të ligjit. Presidenti i Republikës së Kosovës të drejtën e kthimit të një ligji në Kuvend, mund ta ushtrojë vetëm një herë.
4. Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, vendos për miratimin e ligjit të rikthyer nga Presidenti i Republikës, dhe ligji përkatës konsiderohet i shpallur.

5. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda tetë (8) ditësh pas marrjes së ligjit, nuk merr asnjë vendim për shpalljen ose kthimin e tij, ligji konsiderohet i shpallur, pa nënshkrimin e saj/tij dhe publikohet në Gazetën Zyrtare.
6. Ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, përveç nëse, me vetë ligj nuk përcaktohet ndryshe.

Neni 81[*]
[Legjislacioni me Interes Vital]

1. Për miratimin, ndryshimin ose shfuqizimin e ligjeve në vijim, kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë, si dhe të shumicës së deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë, të cilët mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e Komuniteteve që nuk janë shumicë:
   (1) ligjet të cilat ndryshojnë kufijtë e komunave, themelojnë ose shuajnë komuna, përkufizojnë shtrirjen e pushteteve të komunave dhe pjesëmarrjen e tyre në marrëdhëniet ndërkomunale dhe tejkufitare;
   (2) ligjet të cilat zbatojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, me përjashtim të atyre të përcaktuara me Kushtetutë;
   (3) ligjet për përdorimin e gjuhëve;
   (4) ligjet për zgjedhjet lokale;
   (5) ligjet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;[*]
   (6) ligjet për liritë fetare ose për marrëveshjet me komunitetet fetare;
   (7) ligjet për arsimin;
   (8) ligjet për përdorimin e simboleve, përfshirë simbolet e komuniteteve dhe për festat publike.
2. Asnjëri nga ligjet me interes vital, nuk mund t'i nënshtrohet referendumit.

Neni 82
[Shpërndarja e Kuvendit]

1. Kuvendi shpërndahet në këto raste:
   (1) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e caktimit të mandatarit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nuk mund të formohet Qeveria;
   (2) nëse për shpërndarjen e Kuvendit votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve, shpërndarja bëhet me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës;
   (3) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjes, nuk zgjedhet Presidenti i Republikës së Kosovës.
2. Kuvendi mund të shpërndahet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pas votimit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë.

[*] Neni 81, paragrafi 1 është riformuluar me amendamentin 2.
[*] Neni 81, paragrafi 1, pika (5) është riformuluar me amenda-mentin 3.

Kapitulli V
Presidenti i Republikës së Kosovës

Neni 83
[Statusi i Presidentit]

Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikë së Kosovës.

Neni 84
[Kompetencat e Presidentit]

Presidenti i Republikës së Kosovës:

(1) përfaqëson Republikën e Kosovës brenda dhe jashtë;
(2) garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë;
(3) shpall zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe thërret mbledhjen e parë te tij;
(4) nxjerr dekrete në pajtim me këtë Kushtetutë;
(5) shpall ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
(6) ka të drejtën e kthimit për rishqyrtim të ligjeve të miratuara, nëse konsideron se janë të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë komuniteteve të saj. Të drejtën e rikthimit të një ligji mund ta shfrytëzojë vetëm një herë;
(7) nënshkruan marrëveshjet ndërkombëtare në pajtim me këtë Kushtetutë;
(8) propozon amendamente për këtë Kushtetutë;
(9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;
(10) udhëheq politikën e jashtme të vendit;
(11) pranon letrat kredenciale të shefave të misioneve diplomatike të akredituar në Republikën e Kosovës;
(12) është Komandant Suprem i Forcave të Sigurisë të Kosovës;
(13) udhëheq Këshillin Konsultativ për Komunitete;
(14) cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën e Kuvendit;
(15) emëron dhe shkarkon Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
(16) emëron dhe shkarkon gjyqtarët e Republikës së Kosovës me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
(17) emëron dhe shkarkon Kryeprokurorin e Shtetit të Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Prokuroial të Kosovës;
(18) emëron dhe shkarkon prokurorët e Republikës së Kosovës, me propozimin të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
(19) emëron gjyqtarët për Gjykatën Kushtetuese, me propozimin e Kuvendit;
(20) emëron Komandantin e Forcave të Sigurisë të Kosovës, pas rekomandimit të Kryeministrit;
(21) së bashku me Kryeministrin, emëron Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Intelegjencë;

(22) vendos për shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, në konsultim me Kryeministrin;
(23) mund të kërkojë mbledhje të Këshillit të Sigurisë të Kosovës dhe i kryeson ato në kohën e Gjendjes së Jashtëzakonshme;
(24) vendos për formimin e misioneve diplomatike e konsullare të Republikës së Kosovës, në bazë të konsultimit me Kryeministrin;
(25) emëron dhe shkarkon shefat e misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës, me propozimin e Qeverisë;
(26) emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
(27) emëron Guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës i cili shërben edhe si Drejtor Menaxhues dhe emëron anëtarët e tjerë të Bordit të Bankës;
(28) jep medalje, mirënjohje dhe çmime, në pajtim me ligjin;
(29) shpall falje individuale, në pajtim me ligjin;
(30) së paku një herë në vit i drejtohet Kuvendit të Kosovës përkitazi me fushëveprimtarinë e tij/saj.

Neni 85
[Kualifikimi për Zgjedhjen e Presidentit]

President i Republikës së Kosovës mund të zgjedhet çdo shtetas i Republikës së Kosovës, i cili e ka mbushur moshën tridhjetë e pesë (35) vjeçare.

Neni 86
[Zgjedhja e Presidentit]

1. Presidenti i Republikës së Kosovës zgjedhet nga Kuvendi, me votim të fshehtë.
2. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës duhet të bëhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual.
3. Secili shtetas i Republikës së Kosovës mund të nominohet si kandidatë për President të Republikës së Kosovës, nëse ajo/ai siguron nënshkrimet e të paktën tridhjetë (30) deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Deputetët e Kuvendit mund të nënshkruajnë vetëm për një kandidatë për President të Republikës së Kosovës.
4. Zgjedhja e Presidentit bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.
5. Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve, zgjedhet President i Republikës së Kosovës.
6. Nëse në votimin e tretë, asnjëri kandidat nuk zgjidhet President i Republikës së Kosovës, shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda dyzet e pesë (45) ditësh.

Neni 87
[Mandati dhe Betimi]

1. Presidenti i Republikës së Kosovës fillon mandatin pasi të ketë dhënë betimin para Kuvendit të Kosovës. Teksti i betimit rregullohet me ligjin.
2. Mandati i Presidentit është pesë (5) vjet.
3. Pas përfundimit të mandatit të parë, Presidenti mund të rizgjedhet vetëm edhe një herë.

Neni 88
[Papajtueshmëria]

1. Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër publik.
2. Pas zgjedhjes, Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion në parti politike.

Neni 89
[Imuniteti]

Presidenti i Republikës së Kosovës gëzon imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet brenda fushëveprimit të përgjegjësive të Presidentit të Republikës së Kosovës.

Neni 90
[Mungesa e Përkohshme e Presidentit]

1. Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës përkohësisht nuk është i aftë për të përmbushur përgjegjësitë e tij/saj, ajo/ai mund t'ia kalojë vullnetarisht detyrat e postit të tij/saj, Kryetarit të Kuvendit, i cili do të jetë ushtrues i detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës. Urdhri i Presidentit për kalimin e përgjegjësive duhet të përmbajë veçanërisht arsyet dhe kohëzgjatjen e kalimit të përgjegjësive, nëse ka njohuri për to. Presidenti i Republikës së Kosovës do të rifillojë ushtrimin e përgjegjësive kur të jetë në gjendje t'i ushtrojë përgjegjësitë, dhe kështu Kryetarit të Kuvendit i pushon posti i ushtruesit të detyrës së Presidentit.
2. Në rast se nuk ka ndodhur kalimi vullnetar i përgjegjësive, Kuvendi i Republikës së Kosovës, pas konsultimit me konsiliumin mjekësor, me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve vendos nëse Presidenti i Republikës së Kosovës është përkohësisht i paaftë për të ushtruar përgjegjësitë e veta. Kryetari i Kuvendit të Kosovës do të shërbejë si ushtrues i detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës derisa ajo/ai të bëhet i aftë që të rifillojë ushtrimin e përgjegjësive të Presidentit.
3. Posti i ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, nuk mund të ushtrohet për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj.

Neni 91
[Shkarkimi i Presidentit]

1. Presidenti i Republikës së Kosovës mund të shkarkohet nga Kuvendi nëse ai/ajo është dënuar për kryerjen e krimit të rëndë ose nëse ajo/ai nuk është i/e aftë për të ushtruar përgjegjësitë e këtij posti për shkak të sëmundjes së rëndë ose nëse Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se ajo/ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës.
2. Procedura për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Kosovës mund të iniciohet nga një e treta (1/3) e deputetëve të Kuvendit, të cilët nënshkruajnë një peticion, i cili shpjegon arsyet për shkarkim. Në rast se peticioni supozon sëmundjen e rëndë, Kuvendi do të kërkojë mendimin e konsiliumit mjekësor për gjendjen shëndetësore të Presidentit. Në rast se peticioni supozon ndonjë shkelje të rëndë të Kushtetutës, peticioni duhet t'i dorëzohet menjëherë Gjykatës Kushtetuese, e cila vendosë për këtë çështje brenda shtatë (7) ditësh nga marrja e peticionit.
3. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës është dënuar për ndonjë krim të rëndë ose kur nëse Kuvendi, në pajtim me këtë nen, konstaton që Presidenti nuk është i aftë të ushtrojë përgjegjësitë e tij/saj për shkak të sëmundjes së rëndë ose nëse Gjykata Kushtetuese konstaton se ajo/ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës, Kuvendi mund të shkarkojë Presidentin me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij.

Kapitulli VI
Qeveria e Republikës së Kosovës

Neni 92
[Parimet e Përgjithshme]

1. Qeverinë e Kosovës e përbëjnë Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat.
2. Qeveria e Kosovës ushtron pushtetin ekzekutiv në pajtim me Kushtetutën dhe ligj.
3. Qeveria zbaton ligjet dhe aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe ushtron veprimtari tjera brenda përgjegjësive të përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj.
4. Qeveria merr vendime në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligje, propozon projektligje dhe amendamentimin e ligjeve ekzistuese e akteve të tjera, si dhe mund të japë mendimin rreth projektligjeve të cilat nuk janë të propozuara nga ajo.

Neni 93
[Kompetencat e Qeverisë]

Qeveria ka këto kompetenca:

(1) propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit;
(2) mundëson zhvillimin ekonomik të vendit;
(3) propozon Kuvendit projektligje dhe akte të tjera;
(4) merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve;
(5) propozon Buxhetin e Republikës së Kosovës;

(6) udhëzon dhe mbikëqyr punën e organeve të administratës;
(7) udhëzon veprimtarinë dhe zhvillimin e shërbimeve publike;
(8) i propozon Presidentit të Republikës së Kosovës emërimet dhe shkarkimet për shefa të misioneve diplomatike të Kosovës;
(9) propozon amendamentimin e Kushtetutës;
(10) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;
(11) ushtron edhe funksione të tjera ekzekutive, të cilat nuk u janë caktuar organeve të tjera qendrore ose vendore.

Neni 94
[Kompetencat e Kryeministrit]

Kryeministri ka këto kompetenca:
(1) përfaqëson dhe udhëheq Qeverinë;
(2) siguron që të gjitha Ministritë të veprojnë në pajtim me politikat qeveritare;
(3) siguron zbatimin e ligjeve dhe të politikave të përcaktuara të Qeverisë;
(4) ndërron anëtarët e Qeverisë, pa pëlqimin e Kuvendit;
(5) kryeson Këshillin e Sigurisë të Kosovës;
(6) emëron Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
(7) këshillohet me Presidentin e Republikës së Kosovës mbi çështjet e Inteligjencës;
(8) së bashku me Presidentin, emëron Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;
(9) këshillohet me Presidentin për zbatimin e politikës së jashtme të vendit;
(10) kryen edhe punë të tjera, të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.

Neni 95
[Zgjedhja e Qeverisë]

1. Pas zgjedhjeve, Presidenti i Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë.
2. Kandidati për Kryeministër, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit.
3. Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.
4. Nëse përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme, Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda dhjetë (10) ditësh emëron kandidatin tjetër sipas së njëjtës procedurë. Nëse as herën e dytë nuk zgjidhet Qeveria, atëherë Presidenti i Kosovës i shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre.
5. Nëse Kryeministri jep dorëheqjen ose për arsye të tjera, posti i tij/saj mbetet i lirë, Qeveria bie, dhe Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me partitë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, mandaton kandidatin e ri, për të formuar Qeverinë.
6. Anëtarët e Qeverisë pas zgjedhjes, japin betimin para Kuvendit. Teksti i betimit rregullohet me ligj.

Neni 96
[Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve]

1. Ministritë dhe organet e tjera ekzekutive themelohen, sipas nevojës, për kryerjen e funksioneve brenda kompetencave të Qeverisë.
2. Numri i anëtarëve të Qeverisë përcaktohet me aktin e brendshëm të saj.
3. Në Qeveri do të jenë së paku një (1) Ministër nga komuniteti Serb dhe një (1) Ministër nga ndonjë komunitet tjetër joshumicë në Kosovë. Nëse janë më shumë se dymbëdhjetë ministra, Qeveria do të ketë edhe një ministër të tretë, i cili përfaqëson një nga komunitetet joshumicë në Kosovë.
4. Do të jenë së paku dy (2) zëvendësministra nga komuniteti Serb i Kosovës dhe dy (2) zëvendësministra nga komunitete të tjera joshumicë në Kosovë. Nëse janë më shumë se dymbëdhjetë (12) ministra, Qeveria do të ketë edhe një zëvendësministër të tretë, i cili përfaqëson komunitetin Serb, dhe një (1) tjetër zëvendësministër, i cili përfaqëson një nga komunitetet e tjera joshumicë në Kosovë.
5. Zgjedhja e këtyre ministrave dhe zëvendësministrave do të vendoset pas konsultimit me partitë, me koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë. Nëse caktohen kandidatë jashtë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, për këta ministra e zëvendësministra kërkohet miratimi formal i shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët u përkasin partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin në fjalë.
6. Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat e Qeverisë mund të zgjidhen nga deputetë të Kuvendit të Kosovës ose nga persona të kualifikuar, që nuk janë deputetë të Kuvendit.
7. Papajtueshmëria e anëtarëve të Qeverisë lidhur me funksionet e tyre rregullohet me ligj.

Neni 97
[Përgjegjësia]

1. Qeveria, për punën e vet, i përgjigjet Kuvendit të Kosovës.
2. Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat mbajnë bashkëpërgjegjësinë për vendimet që merr Qeveria, dhe përgjegjësinë individuale për vendimet që marrin në fushat e përgjegjësive të tyre.

Neni 98
[Imuniteti]

Anëtarët e Qeverisë së Kosovës gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi për veprimet dhe vendimet brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si anëtarë të Qeverisë.

Neni 99
[Procedurat]

Mënyra e punës dhe procedurat e vendimmarrjes në Qeveri rregullohen me ligj dhe me rregullore.

Neni 100
[Mocioni i Votëbesimit]

1. Mocioni i mosbesimit ndaj Qeverisë mund të ngrihet me propozimin e një të tretës (1/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit.
2. Votëbesimin e Qeverisë mund ta kërkojë Kryeministri.
3. Mocioni i mosbesimit vihet në rendin e ditë të Kuvendit, jo më vonë se pesë (5) ditë e as më herët se dy (2) ditë nga data e parashtrimit të tij.
4. Konsiderohet se mocioni i mosbesimit është pranuar, nëse për të kanë votuar shumica e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.
5. Nëse mocioni i mosbesimit dështon, mocioni tjetër i mosbesimit nuk mund të ringrihet gjatë nëntëdhjetë (90) ditëve të ardhshme.
6. Nëse mocioni i mosbesimit votohet për Qeverinë në tërësi, Qeveria konsiderohet në dorëheqje.

Neni 101
[Shërbimi Civil]

1. Përbërja e shërbimit civil do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës, duke marrë në konsideratë parimet e barazisë gjinore, të njohura ndërkombëtarisht.
2. Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës.

Kapitulli VII
Sistemi i Drejtësisë

Neni 102
[Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]

1. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovë ushtrohet nga gjykatat.
2. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.
3. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.
4. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.
5. Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. E drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankese.

Neni 103
[Organizimi dhe Jurisdiksioni i Gjykatave]

1. Organizimi, funksionimi dhe jurisdiksioni i Gjykatës Supreme dhe i gjykatave të tjera, rregullohen me ligj.
2. Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti më i lartë gjyqësor.
3. Të paktën pesëmbëdhjetë përqind (15%) e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, por jo më pak se tre (3) gjyqtarë, do të jenë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.
4. Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës e emëron dhe shkarkon Presidenti i Kosovës, nga radhët e gjyqtarëve te Gjykatës Supreme, për mandat shtatëvjeçar, pa mundësi të riemërimit, pas propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin ose shkarkimin e saj/tij.
5. Kryetarët e të gjitha gjykatave të tjera emërohen në mënyrën e përcaktuar me ligj.
6. Të paktën pesëmbëdhjetë përqind (15%) e gjyqtarëve nga cilado gjykatë tjetër, e themeluar me jurisdiksionin e apelit, por jo më pak se dy (2) gjyqtarë do të jenë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.
7. Gjykata të specializuara mund të themelohen me ligj kur kjo të jetë e nevojshme, por në asnjë mënyrë nuk mund të themelohen gjykata të jashtëzakonshme.

Neni 104
[Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve]

1. Gjyqtarët i emëron, riemëron dhe shkarkon Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
2. Përbërja e gjyqësorit pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Kosovës dhe parimet e pranuara ndërkombëtarisht të barazisë gjinore.
3. Përbërja e gjykatave pasqyron përbërjen etnike të jurisdiksionit territorial të gjykatës përkatëse. Para dhënies së propozimit për emërim ose riemërim, Këshilli Gjyqësor i Kosovës këshillohet me gjykatën përkatëse.
4. Gjyqtarët mund të shkarkohen nga funksioni për shkak të dënimit për një vepër të rëndë penale ose për mosrespektimin e rëndë të detyrave.
5. Gjyqtarët kanë të drejtë të ankohen ndaj vendimit mbi shkarkimin drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës.
6. Gjyqtarët nuk mund të transferohen kundër vullnetit të tyre, përveç nëse është parashikuar ndryshe me ligj, për shkak të funksionimit efikas të gjyqësorit ose masave disiplinore.

Neni 105
[Mandati dhe Riemërimi]

1. Mandati fillestar për gjyqtarët është trevjeçar. Në raste të riemërimit, mandati është i përhershëm deri në moshën e pensionimit, sikurse është përcaktuar më ligj, përveç nëse shkarkohet në pajtim me ligjin.
2. Kriteret dhe procedurat për riemërimin e një gjyqtari, përcaktohen nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe ato mund të dallojnë në shkallë nga kriteret e përdorura për shkarkimin e gjyqtarëve.

Neni 106
[Papajtueshmëria]

1. Gjyqtari nuk mund të ushtrojë ndonjë funksion në institucionet shtetërore jashtë gjyqësorit, të jetë i përfshirë në ndonjë aktivitet politik ose ndonjë aktivitet tjetër të ndaluar me ligj.
2. Gjyqtarëve nuk u lejohet të marrin përgjegjësi ose të jenë bartës të funksioneve, të cilat në çfarëdo mënyre, do të ishin në kundërshtim me parimet e pavarësisë dhe paanësisë së rolit të gjyqtarit.

Neni 107
[Imuniteti]

1. Gjyqtarët, përfshirë edhe gjyqtarët porotë, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si gjyqtarë.
2. Gjyqtarët, përfshirë edhe gjyqtarët porotë, nuk gëzojnë imunitet dhe mund të shkarkohen nga funksioni, kur të kenë shkelur ligjin me qëllim.
3. Kur një gjyqtar akuzohet ose arrestohet, duhet të njoftohet pa vonesë Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Neni 108
[Këshilli Gjyqësor i Kosovës]

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor.
2. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij. Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale e të paanshme, dhe të pasqyrojnë plotësisht natyrën shumetnike të Republikës së Kosovës e të ndjekin parimet e barazisë gjinore. Këshilli do t'u japë përparësi për emërim si gjyqtarë, anëtarëve të komuniteteve të nën përfaqësuara në mënyrën e përcaktuar me ligj.
3. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është përgjegjës për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërim dhe riemërim për pozita gjyqësore. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është po ashtu përgjegjës për transferimin dhe për procedurën disiplinore kundër gjyqtarëve.
4. Propozimet për emërimin e gjyqtarëve duhet të bëhen në bazë të procesit të hapur për emërime, në bazë të meritave të kandidatëve, dhe ky propozim pasqyron parimin e barazisë gjinore dhe përbërjen etnike të jurisdiksionit territorial të gjykatës përkatëse. Të gjithë kandidatët duhet t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj.
5. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është përgjegjës për inspektimin gjyqësor, administrimin gjyqësor, përpilimin e rregullave për gjykatat në pajtim me ligjin, punësimin dhe mbikëqyrjen e administratorëve të gjykatave, hartimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit për gjyqësorin, përcaktimin e numrit të gjyqtarëve në secilin jurisdiksion dhe bën rekomandime për themelimin e gjykatave të reja.

Themelimi i gjykatave të reja bëhet me ligj.

6. Këshilli Gjyqësor i Kosovës përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë, me kualifikime dhe ekspertizë profesionale. Anëtarët emërohen për një mandat pesëvjeçar dhe zgjedhën në këtë mënyrë:
   (1) Pesë (5) anëtarë do të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga anëtarët e gjyqësorit;
   (2) Katër (4) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve. Të paktën dy (2) nga katër (4) anëtarët duhet të jenë gjyqtarë, dhe një (1) do të jetë anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës;
   (3) Dy (2) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komunitetit Serb në Kosovë, dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar;
   (4) Dy (2) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve të tjera, dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar;
   (5) Papajtueshmëria e të qenit anëtar i Këshillit Gjyqësor rregullohet me ligj.
7. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, nga radhët e anëtarëve të vet, zgjedh kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin me mandat trevjeçar. Zgjedhja në këto funksione nuk e zgjat mandatin e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
8. Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës i drejtohet Kuvendit të Republikës së Kosovës së paku një herë në vit lidhur me Sistemin Gjyqësor.
9. Kandidatët për pozita gjyqësore, të cilat janë të rezervuara për pjesëtarët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, mund të rekomandohen për emërim vetëm nga anëtarët e Këshillit të zgjedhur nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për pjesëtarët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë. Nëse ky grup i anëtarëve të Këshillit nuk e propozon kandidatin për këtë pozitë gjyqësore pas dy seancave të njëpasnjëshme të Këshillit, atëherë cilido anëtar i Këshillit ka të drejtë të rekomandojë kandidatin për atë pozitë gjyqësore.
10. Kandidatët për pozita gjyqësore të gjykatave themelore, nën jurisdiksionin e të cilave përfshihet ekskluzivisht territori i një a më shumë komunave, ku shumica e popullsisë i takon komunitetit Serb të Kosovës, mund të rekomandohen për emërim vetëm nga dy (2) anëtarët e Këshillit që i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për komunitetin Serb në Republikën e Kosovës të cilët veprojnë bashkërisht dhe në mënyrë unanime. Nëse këta dy (2) anëtarë nuk rekomandojnë kandidat gjyqësor për këtë pozitë, gjatë dy seancave të njëpasnjëshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, atëherë cilido anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka të drejtë të propozojë kandidat për atë pozitë.

Neni 109
[Prokurori i Shtetit]

1. Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër, sikurse është rregulluar me ligj.
2. Prokurori i Shtetit është institucion i paanshëm, dhe vepron në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit.

3. Organizimi, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit rregullohen me ligj.
4. Prokurori i Shtetit pasqyron përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe respekton parimet e barazisë gjinore.
5. Mandati fillestar për prokuror është trevjeçar. Në rast të riemërimit, mandati është i përhershëm deri në moshën e pensionimit, sikurse është përcaktuar me ligj, përveç nëse shkarkohet në pajtim me ligjin.
6. Prokurorët mund të shkarkohen nga funksioni për shkak të dënimit për një vepër të rëndë penale ose për mosrespektimin e rëndë të detyrave.
7. Kryeprokurori i Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Mandati i Kryeprokurorit të Shtetit është shtatëvjeçarë, pa mundësi riemërimi.

Neni 110
[Këshilli Prokurorial i Kosovës]

1. Këshilli Prokurorial i Kosovës është institucion plotësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij, në pajtim me ligjin. Këshilli Prokurorial i Kosovës siguron qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë personat në Kosovë. Këshilli Prokurorial i Kosovës siguron që Prokurori i Shtetit të jetë i pavarur, profesional, i paanshëm dhe pasqyron natyrën shumetnike të Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore.
2. Këshilli Prokurorial i Kosovës do të rekrutojë, propozojë, avancojë, transferojë, disiplinojë prokurorët në mënyrën e rregulluar me ligj. Këshilli do t'i japë përparësi emërimit për prokurorë të anëtarëve të komuniteteve të nën përfaqësuara në mënyrën e përcaktuar me ligj. Të gjithë kandidatët duhet t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj.
3. Propozimet për emërimin e prokurorëve duhet të bëhen në bazë të procesit të hapur për emërime, në bazë të meritave të kandidatëve, dhe ky propozim pasqyron parimin e barazisë gjinore dhe përbërjen etnike të jurisdiksionit territorial përkatës.
4. Përbërja e Këshillit Prokurorial të Kosovës, si dhe dispozitat për emërimin, shkarkimin, mandatin, strukturën organizative dhe rregullat e procedurës, rregullohen me ligj.

Neni 111
[Avokatura]

1. Avokatura është profesion i pavarur, e cila ofron shërbime sikur është e rregulluar me ligj.
2. Mënyra e fitimit të së drejtës për të ushtruar profesionin e avokatit, si dhe marrja e kësaj të drejte, rregullohen me ligj.

Kapitulli VIII
Gjykata Kushtetuese

Neni 112
[Parimet e Përgjithshme]

1. Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.
2. Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësive të saj.

Neni 113
[Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara]

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:
   (1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;
   (2) përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën.
3. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë çështjet në vijim:
   (1) konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;
   (2) përputhshmëria e referendumit të propozuar me Kushtetutën;
   (3) përputhshmëria e shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme me Kushtetutën;
   (4) përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur;
   (5) nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit.
4. Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt.
5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.
6. Tridhjetë (30) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, janë të autorizuar të ngrenë çështjen nëse Presidenti i Republikës së Kosovës ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës.
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
8. Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë

procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë.

9. Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës.
10. Jurisdiksioni shtesë mund të rregullohet me ligj.

Neni 114
[Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese]

1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë (9) gjyqtarë, të cilët do të jenë juristë të shquar dhe personalitete me moralin më të lartë, jo me më pak se dhjetë (10) vjet përvojë profesionale përkatëse. Kualifikimet e tjera përkatëse rregullohen me ligj. Parimet e barazisë gjinore do të respektohen.
2. Gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit, për një mandat nëntëvjeçar, pa mundësi vazhdimi.
3. Vendimi për të propozuar shtatë (7) nga gjyqtarët, varet nga miratimi i dy të tretave (2/3) të deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë. Vendimi për të propozuar dy (2) gjyqtarët e tjerë, merret me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit, të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë, por që mund të bëhet vetëm pas pëlqimit të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet që janë rezervuar ose garantuar për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.
4. Nëse mandati i gjyqtarit përfundon para mbarimit të mandatit të rregullt, emërimi i gjyqtarit të ri bëhet në pajtim me këtë nen, me mandat të plotë, pa të drejtë rizgjedhjeje.
5. Zgjedhja e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Gjykatës Kushtetuese, bëhet nga gjyqtarët të Gjykatës Kushtetuese me votim të fshehtë të gjyqtarëve të Gjykatës, për mandat trevjeçar. Zgjedhja në këto funksione nuk e zgjat mandatin e gjyqtarit.

Neni 115
[Organizimi i Gjykatës Kushtetuese]

1. Gjykata Kushtetuese përcakton organizimin e vet të brendshëm, rregulloren e punës, proceset e vendimmarrjes dhe çështje të tjera organizative në pajtim me ligjin.
2. Gjykata Kushtetuese publikon raportin vjetor.

Neni 116
[Efekti Juridik i Vendimeve]

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.
2. Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të

suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të pariparueshme.
3. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe me vendim të Gjykatës Kushtetuese, shfuqizimi i ligjit, i aktit ose i veprimit hyn në fuqi në ditën e publikimit të vendimit të Gjykatës.
4. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese shpallet në Gazetën Zyrtare.

Neni 117
[Imuniteti]

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga detyra për vendimet e marra, mendimet e shprehura dhe veprimet e marra brenda fushës së përgjegjësive si gjykatës të Gjykatës Kushtetuese.

Neni 118
[Shkarkimi]

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese mund të shkarkohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës me propozimin e dy të tretave (2/3) të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, vetëm për kryerjen e krimeve të rënda ose për mospërfillje të rëndë të detyrave.

Kapitulli IX
Marrëdhëniet Ekonomike

Neni 119
[Parimet e Përgjithshme]

1. Republika e Kosovës siguron një mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut, lirinë e aktivitetit ekonomik dhe sigurinë e pronës publike e private.
2. Republika e Kosovës siguron të drejta ligjore të barabarta për të gjithë investitorët dhe të gjitha ndërmarrjet vendore dhe të jashtme.
3. Veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese, ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj.
4. Republika e Kosovës promovon mirëqenie për të gjithë qytetarët e saj duke inkurajuar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.
5. Republika e Kosovës do të themelojë organe të pavarura për rregullimin e tregut atëherë kur vetë tregu nuk mundet që në masë të mjaftueshme të mbrojë interesin publik.
6. Investitorit të jashtëm i garantohet nxjerrja e lirshme e fitimit dhe kapitalit të investuar jashtë vendit, në pajtim me ligjin.
7. Garantohet mbrojtja e konsumatorëve, në pajtim me ligjin.
8. Secili person është i obliguar të paguajë tatimet dhe kontributet e tjera të parapara me ligj.
9. Republika e Kosovës ushtron të drejtën e pronësisë mbi çdo ndërmarrje që ajo

kontrollon në pajtim me interesin publik, me qëllim që të maksimalizojë vlerën afatgjate të ndërmarrjes.

10. Shërbimet publike të detyrueshme mund të imponohen mbi këto ndërmarrje në pajtim me ligjin, i cili duhet të përcaktojë edhe kompensimin e drejtë.

Neni 120
[Financat Publike]

1. Shpenzimet publike dhe mbledhja e të hyrave publike duhet të bazohen në parimet e llogaridhënies, efektshmërisë, efikasitetit dhe transparencës.
2. Administrimi i politikës fiskale në të gjitha nivelet e qeverisë do të jetë në pajtim me kushtet për inflacion të ulët dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe për krijimin e vendeve të punës.
3. Huat publike rregullohen me ligj dhe duhet të jenë në pajtim më stabilitetin ekonomik dhe qëndrueshmërinë fiskale.

Neni 121
[Prona]

1. Llojet e pronës rregullohen me ligj.
2. Personat fizikë të huaj dhe organizatat e huaja mund të sigurojnë të drejta të pronësisë mbi pronën e paluajtshme në pajtim me kushtet e arsyeshme të përcaktuara me ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare.
3. Personat fizikë të huaj dhe organizatat e huaja në pajtim me kushtet e arsyeshme të përcaktuara me ligj, mund të sigurojnë të drejta të koncesionit dhe të drejta të tjera për shfrytëzim dhe/ose eksploatim të resurseve në pronësi publike, përfshirë këtu resurset natyrore, dhe të infrastrukturës në pronësi publike.

Neni 122
[Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore]

1. Populli i Republikës së Kosovës në pajtim me kushtet e arsyeshme të përcaktuara me ligj, mund të gëzojë resurset natyrore të Republikës së Kosovës, por nuk mund të shkel obligimet që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare për bashkëpunim ekonomik.
2. Pasuritë natyrore, si ujërat, hapësira ajrore, pasuritë minerare dhe pasuritë e tjera natyrore, si dhe trualli, pyjet, bota bimore e shtazore, pjesët e tjera të natyrës, paluejtshmëria dhe të mirat e tjera me rëndësi të veçantë kulturore, historike, ekonomike dhe ekologjike, të cilat përcaktuar me ligj se janë përcaktuar me interes për Republikën e Kosovës, gëzojnë mbrojtjen e tyre të veçantë, në pajtim me ligjin.
3. Kufizimet e të drejtave të pronarëve dhe të drejtave të tjera mbi eksploatimin e të mirave me interes të veçantë për Republikën e Kosovës dhe kompensimi për kufizimet e tilla rregullohen me ligj.

Kapitulli X
Qeverisja Lokale dhe Organizimi Territorial

Neni 123
[Parimet e Përgjithshme]

1. E drejta e vetëqeverisjes lokale garantohet dhe rregullohet me ligj.
2. Vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.
3. Veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në këtë Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Republika e Kosovës merr parasysh dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në masën e kërkuar nga vendi nënshkrues.
4. Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.

Neni 124
[Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale]

1. Njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është komuna. Komunat gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.
2. Themelimi i komunave, kufijtë, kompetencat dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre, rregullohen me ligj.
3. Komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin. Autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushtrimin e delegimit.
4. Komunat kanë të drejtë për bashkëpunimin ndërkomunal dhe për bashkëpunimin ndërkufitar, në pajtim me ligjin.
5. Komunat kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta si dhe të marrin fonde nga Qeveria qendrore, në pajtim me ligjin.
6. Komunat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet, dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore.
7. Rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre, kufizohet në sigurimin e përputhjes me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjin.

Kapitulli XI
Sektori i Sigurisë

Neni 125
[Parimet e Përgjithshme]

1. Republika e Kosovës ka pushtet mbi zbatimin e ligjit, sigurinë, drejtësinë, sigurinë publike, inteligjencën, organet civile emergjente dhe mbi kontrollin e kufijve në territorin e vet.
2. Institucionet e sigurisë në Republikën e Kosovës mbrojnë sigurinë publike dhe të drejtat e të gjithëve në Republikën e Kosovës. Institucionet veprojnë me transparencë të plotë dhe në pajtim me standardet demokratike e me të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht. Institucionet e Sigurisë duhet të pasqyrojnë shumëllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës.
3. Republika e Kosovës respekton plotësisht të gjitha marrëveshjet e aplikueshme ndërkombëtare dhe ligjin përkatës ndërkombëtar dhe bashkëpunon me organet ndërkombëtare të sigurisë e me homologët rajonalë.
4. Kontrolli civil dhe demokratik mbi institucionet e sigurisë garantohet.
5. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbikëqyr buxhetin dhe politikat e institucioneve të sigurisë, sikur rregullohet me ligj.

Neni 126
[Forca e Sigurisë e Kosovës]

1. Forca e Sigurisë e Kosovës është forcë kombëtare e sigurisë për Republikën e Kosovës, dhe mund të dërgoj pjesëtarët e saj jashtë vendit në përputhje të plotë me përgjegjësitë e saj ndërkombëtare.
2. Forca e Sigurisë e Kosovës mbron qytetarët dhe komunitetet e Republikës së Kosovës në bazë të kompetencave të përcaktuara me ligj.
3. Presidenti i Republikës së Kosovës është Komandant i Përgjithshëm i Forcës së Sigurisë të Kosovës, e cila gjithmonë i nënshtrohet kontrollit të autoriteteve civile të zgjedhura në mënyrë demokratike.
4. Forca e Sigurisë e Kosovës është profesioniste, pasqyron shumëllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës dhe rekrutohet nga shtetasit e Republikës së Kosovës.
5. Komandantin e Forcës së Sigurisë të Kosovës e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të rekomandimit të Qeverisë. Organizimi i brendshëm i Forcës së Sigurisë të Kosovës rregullohet me ligj.

Neni 127
[Këshilli i Sigurisë i Kosovës]

1. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Presidentin e Republikës së Kosovës dhe Qeverinë, përgatit strategjinë e sigurisë për Republikën e Kosovës. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës ka edhe rol këshillues në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë në Republikën e Kosovës.

2. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës kryesohet nga Kryeministri me mbështetje nga Qeveria, përveç gjatë periudhës së Gjendjes së Jashtëzakonshme, sikurse është parashikuar me këtë Kushtetutë.
3. Presidenti i Republikës së Kosovës mund të kërkojë takime të Këshillit të Sigurisë të Republikës së Kosovës, dhe Këshilli është i obliguar të bashkërendojë punën e tij ngushtësisht me Presidentin. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës do të bashkëpunojë ngushtësisht me autoritetet ndërkombëtare.
4. Anëtarët e Këshillit të Sigurisë të Republikës së Kosovës emërohen dhe shkarkohen në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 128
[Policia e Kosovës]

1. Policia e Republikës së Kosovës mban përgjegjësinë për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
2. Policia e Republikës së Kosovës është profesioniste dhe pasqyron shumëllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës.
3. Kryeministri emëron Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Republikës së Kosovës me rekomandimin e Qeverisë dhe në pajtim me ligjin. Organizimi i brendshëm i Policisë së Kosovës, rregullohet me ligj.
4. Policia e Republikës së Kosovës ka zinxhir të unifikuar komandues në tërë Republikën e Kosovës, me stacione policore të cilat korrespondojnë me kufijtë komunalë. Policia e Kosovës lehtëson bashkëpunimin me autoritetet komunale dhe udhëheqësit e bashkësive përmes themelimit të Këshillave Lokale, sikur është rregulluar me ligj. Përbërja etnike e policisë brenda një komune duhet të pasqyron, deri në shkallën më lartë të mundshme, përbërjen etnike të popullsisë brenda komunës përkatëse.
5. Policia e Republikës së Kosovës mban përgjegjësinë për kontrollin e kufirit në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me autoritetet vendore dhe ndërkombëtare.

Neni 129
[Agjencia e Kosovës për Inteligjencë]

1. Agjencia e Kosovës për Inteligjencë zbulon, heton dhe mbikqyr kërcënimet ndaj sigurisë në Republikën e Kosovës.
2. Agjencia e Kosovës për Inteligjencë është profesioniste, politikisht e paanshme, shumetnike dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes nga Kuvendi në mënyrën e përcaktuar me ligj.
3. Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri, pas konsultimit me Qeverinë, së bashku emërojnë Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Kualifikimi dhe mandati, rregullohen me ligj.
4. Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri marrin të njëjtat informacione në lidhje me inteligjencën.

Neni 130
[Autoriteti Civil i Aviacionit]

1. Autoriteti Civil i Aviacionit të Republikës së Kosovës rregullon veprimtarinë e aviacionit civil në Republikën e Kosovës dhe është ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror, sikur është përcaktuar me ligj.
2. Autoriteti Civil i Aviacionit bashkëpunon plotësisht me autoritetet relevante ndërkombëtare dhe vendore, të përcaktuara me ligj.

Neni 131
[Gjendja e Jashtëzakonshme]

1. Presidenti i Republikës mund të shpallë Gjendjen e Jashtëzakonshme, kur:
   (1) ka nevojë për masa emergjente të mbrojtjes;
   (2) ka rrezik të brendshëm ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike;
   (3) ka fatkeqësi natyrore, e cila prek tërë territorin e Republikës së Kosovës ose një pjesë të tij.
2. Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk suspendohet. Kufizimet mbi të drejtat dhe liritë e garantuara me këtë Kushtetutë, bëhen vetëm deri në shkallën e nevojshme, për sa më pak kohë që të jetë e nevojshme dhe në përputhje të plotë me këtë Kushtetutë. Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, ligji për zgjedhjet e Kuvendit dhe të Komunave nuk mund të ndryshohet. Parimet e tjera për veprimet e institucioneve publike gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme rregullohen me ligj, por ato nuk duhet të jenë në shpërputhje me këtë nen.
3. Nëse paraqitet nevoja për marrjen e masave emergjente të mbrojtjes, Presidenti i Republikës së Kosovës, pas konsultimit me Kryeministrin, shpall Gjendjen e Jashtëzakonshme. Me shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, Presidenti i Republikës së Kosovës shpallë menjëherë dekretin, i cili përcakton natyrën e kërcënimit dhe çfarëdo kufizimi për të drejtat dhe liritë. Brenda dyzet e tetë (48) orësh, Kuvendi mund të japë pëlqimin me dy të tretat (2/3) e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Nëse nuk jepet pëlqimi, dekreti i Presidentit nuk ka forcë as efekt.
4. Nëse ka rrezik ndaj rendit kushtetues dhe sigurisë publike në Republikën e Kosovës, ose ekziston një fatkeqësi natyrore në tërë territorin e Republikës së Kosovës ose një pjesë të tij, Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me Kryeministrin, mund të shpallë Gjendjen e Jashtëzakonshme. Me shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, Presidenti i Republikës së Kosovës shpallë menjëherë një dekret, i cili përcakton natyrën e gjendjes së emergjencës dhe çfarëdo kufizimi mbi të drejtat dhe liritë. Brenda dyzet e tetë (48) orësh, Kuvendi mund të japë pëlqimin e tij me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Nëse nuk jepet pëlqimi, dekreti i Presidentit nuk ka forcë as efekt.
5. Gjendja e Jashtëzakonshme zgjat për aq kohë sa vazhdon të kërcënojë rreziku dhe nuk mund të zgjatë më shumë se për një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditësh. Me pëlqimin e shumicës së deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë,

Gjendja e Jashtëzakonshme, nëse është e nevojshme, mund të zgjatet për periudha pasuese prej tridhjetë (30) ditësh, por jo më shumë se për nëntëdhjetë (90) ditë shtesë gjithsej.

6. Kuvendi mund të vendosë kufizime të tilla, sipas nevojës, për sa i përket kohëzgjatjes dhe shkallës së Gjendjes së Jashtëzakonshme. Kur Presidenti konstaton se rreziku ndaj Republikës së Kosovës është i natyrës së jashtëzakonshme, Kuvendi mund të vendosë që Gjendja e Jashtëzakonshme të zgjasë më shumë se njëqind e pesëdhjetë (150) ditë, vetëm nëse për të votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit.
7. Presidenti i Republikës së Kosovës, pas konsultimit me Qeverinë dhe Kuvendin, mund të urdhërojë mobilizimin e Forcës së Sigurisë të Kosovës, për të ndihmuar në Gjendjen e Jashtëzakonshme.
8. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës, vetëm gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, ushtron funksione ekzekutive që kufizohen në funksionet që ndërlidhen në veçanti me Gjendjen e Jashtëzakonshme. Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës do të drejtohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, sikur rregullohet me ligj. Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës do të bashkëpunojë ngushtësisht me Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet ndërkombëtare.
9. Ligji përcakton parimet, lëmit dhe mënyrën e kompensimit të dëmeve të shkaktuara si pasojë e kufizimeve të vendosura gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme.

Kapitulli XII
Institucionet e Pavarura

Neni 132
[Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit]

1. Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.
2. Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës.
3. Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.

Neni 133
[Zyra e Avokatit të Popullit]

1. Zyra e Avokatit të Popullit është e pavarur, dhe propozon e administron buxhetin e vet, në pajtim me ligj.
2. Avokati i Popullit ka një (1) ose më shumë zëvendës. Numri, mënyra e përzgjedhjes dhe mandati i tyre, rregullohen me ligjin për Avokatin e Popullit. Të paktën një (1) nga zëvendësit e Avokatit të Popullit është pjesëtar i komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

Neni 134
[Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit]

1. Avokatin e Popullit e zgjedh Kuvendi i Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të tij, për një mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.
2. Avokat i Popullit ka të drejtë të zgjidhet çdo shtetas i Republikës së Kosovës, me arsim të lartë, me karakter e moral të lartë, i ndershëm, me eksperiencë dhe njohuri të dalluara në fushën e të drejtave të njeriut.
3. Avokati i Popullit dhe zëvendësit e saj/tij nuk mund të jenë anëtarë të asnjë partie politike, as të ushtrojnë veprimtari politike, shtetërore a private profesionale dhe as të marrin pjesë në organizmat drejtues të organizatave civile, ekonomike dhe tregtare.
4. Avokati i Popullit gëzon imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet ose vendimet që janë brenda fushës së përgjegjësive të Avokatit të Popullit.
5. Avokati i Popullit mund të shkarkohet vetëm me kërkesën e më shumë se një të tretës (1/3) së të gjithë deputetëve, dhe në këtë rast Kuvendi vendos me shumicën e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të tij.

Neni 135
[Raportimi i Avokatit të Popullit]

1. Avokati i Popullit paraqet raport vjetor para Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Me kërkesën e Kuvendit, Avokati i Popullit duhet të dorëzojë raporte periodike ose tjera Kuvendit. Me kërkesën e Avokatit të Popullit, Kuvendi duhet t'ia lejojë që të dëgjohet.
3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.
4. Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.

Neni 136
[Auditori i Përgjithshëm i Kosovës]

1. Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar.
2. Organizimi, funksionimi dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, përcaktohen me Kushtetutën dhe me ligj.
3. Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës zgjidhet nga Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, në bazë të propozimit të Presidentit të Republikës së Kosovës.
4. Kuvendi vendos për shkarkimin e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës me shumicën e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të tij, në bazë të propozimit të Presidentit ose me nismën e një të tretës (1/3) së deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

5. Mandati i Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës është pesë (5) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm edhe për një mandat.

Neni 137
[Kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës]

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës kontrollon:
(1) veprimtarinë ekonomike të institucioneve publike dhe të personave të tjerë juridikë shtetërorë;
(2) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve publike nga organet e pushtetit qendror dhe lokal;
(3) veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve publike dhe personave juridikë të tjerë, tek të cilët Shteti ka një pjesë të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga Shteti.

Neni 138
[Raportimi i Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës]

1. Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës, Kuvendit i paraqet:
   (1) raport për zbatimin e Buxhetit të Shtetit;
   (2) mendimin për raportin e Qeverisë për shpenzimet e vitit financiar të shkuar, para se të miratohet nga Kuvendi;
   (3) informacione për rezultatet e kontrolleve, sa herë që kërkohet nga Kuvendi.
2. Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës i paraqet Kuvendit raportin vjetor për veprimtarinë e vet.

Neni 139
[Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve e referendumet dhe shpall rezultatet e tyre.
2. Komisioni përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë.
3. Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me jurisdiksion apeli.
4. Gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Nëse në Kuvend janë të përfaqësuara më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë. Një (1) anëtarë emërohet nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin Serb të Kosovës dhe tre (3) anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë.

Neni 140
[Banka Qendrore e Kosovës]

1. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, është institucion i pavarur i cili i përgjigjet vetëm Kuvendit të Kosovës.
2. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ushtron kompetencat dhe pushtetin e vet vetëm në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me instrumentet e tjera ligjore të zbatueshme.
3. Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ushtron edhe detyrën e Kryeshefit Ekzekutiv të saj.
4. Qeverisja e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe procedurat e zgjedhjes dhe të nominimit të anëtarëve të Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës rregullohen me ligjin, cili duhet të sigurojë pavarësinë dhe autonominë e saj.

Neni 141
[Komisioni i Pavarur i Medieve]

1. Komisioni i Pavarur i Medieve është organ i pavarur që rregullon spektrin e Frekuencave Transmetuese në Republikën e Kosovës, licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj.
2. Anëtarët e Komisionit të Pavarur të Medieve zgjedhen sipas ligjit, përmes një procesi transparent.

Neni 142
[Agjencitë e Pavarura]

1. Agjencitë e pavarura të Republikës së Kosovës janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Agjencitë e pavarura funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës.
2. Agjencitë e pavarura kanë buxhetin e tyre, i cili administrohet në mënyrë të pavarur, në pajtim me ligj.
3. Secili organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe t'u përgjigjet kërkesave të agjencive të pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore, në pajtim me ligj.

Kapitulli XIII
Dispozitat Përfundimtare

Neni 143*
[Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës]

Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj Kushtetute:

1. Të gjitha autoritetet në Republikën e Kosovës veprojnë në pajtim me të gjitha detyrimet e Republikës së Kosovës sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007. Ato do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e tyre.
2. Dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007 kanë epërsi ndaj të gjitha dispozitave të tjera ligjore në Kosovë.
3. Kushtetuta, ligjet dhe aktet tjera ligjore të Republikës së Kosovës interpretohen në pajtueshmëri me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007. Në rast se ka papajtueshmëri midis dispozitave të kësaj Kushtetute, ligjeve dhe akteve të tjera ligjore të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të marrëveshjes, kjo e fundit do të mbizotërojë.

Neni 144*
[Amendamentimi]

1. Qeveria, Presidenti ose një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit, sipas Rregullores së Punës të Kuvendit, mund të propozojnë ndryshime dhe amendamentime të kësaj Kushtetute.
2. Çdo ndryshim do të kërkojë miratimin e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës.
3. Ndryshimet në këtë Kushtetutë mund të miratohen nga Kuvendi vetëm pasi të ketë adresuar Kryetari i Kuvendit të Kosovës amendamentin e propozuar në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar paraprakisht nëse ndryshimi i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
4. Ndryshimet e Kushtetutës hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Neni 145*
[Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe e Legjislacionit të Aplikueshëm]

1. Marrëveshjet ndërkombëtare dhe aktet e tjera për bashkëpunimin ndërkombëtarë, që janë në fuqi ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, do të vazhdojnë të

* Neni 143 është fshirë me amendamentin 4.
* Neni 144 është bartur në Kapitullin I – Dispozitat themelore me amendamentin 5.
* Neni 145, është bartur në Kapitullin I – Dispozitat themelore me amendamentin 6.

respektohen deri atëherë kur ato marrëveshje ose akte të rinegociohen ose kur të bëhet tërheqja nga to në pajtueshmëri me kushtet e tyre ose deri atëherë kur ato të zëvendësohen nga marrëveshje ose akte të reja ndërkombëtare me të cilat mbulohen fushat e njëjta dhe që janë miratuar në pajtim me këtë Kushtetutë.

2. Legjislacioni i aplikueshëm në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute vazhdon të zbatohet për aq sa të jetë në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë, derisa të mos shfuqizohet, zëvendësohet ose amendamentohet në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë.

Kapitulli XIV
Dispozitat Kalimtare

Neni 146*
[Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil]

Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj Kushtetute:

1. Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil dhe organizatat e akterët e tjerë ndërkombëtarë të mandatuar sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, kanë mandatin dhe kompetencat e përcaktuara me Propozimit Gjithëpërfshirës duke përfshirë zotësinë juridike si dhe privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara me të.
2. Të gjitha autoritetet në Republikën e Kosovës bashkëpunojnë plotësisht me Përfaqësuesin Ndërkombëtarë Civil, organizatat dhe akterët tjerë ndërkombëtarë të mandatuar sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007 dhe ndër të tjera i'u japin fuqi ligjore vendimeve ose akteve të tyre.

Neni 147*
[Autoriteti Përfundimtarë i Përfaqësuesit Ndërkombëtarë Civil]

Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Kushtetute, Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, është autoriteti përfundimtarë në Kosovë lidhur me interpretimin e aspekteve civile të Propozimit Gjithëpërfshirës. Asnjë autoritet i Republikës së Kosovës nuk ka jurisdiksion të rishikojë, të pakësojë ose në ndonjë mënyrë të kufizojë mandatin, kompetencat dhe detyrimet e përcaktuara në nenin 146 dhe në këtë nen.

Neni 148*
[Dispozitat Transicionale për Kuvendin e Kosovës]

1. Për dy (2) mandatet e para zgjedhore, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të ketë njëzet (20) vende të rezervuara për përfaqësim të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë në mënyrën si vijon: Dhjetë (10) vende do t'u ndahen partive,

* Neni 146, është fshirë me amendamentin 7.
* Neni 147 është fshirë me amendamentin 8.
* Neni 148 është fshirë me amendamentin 9.

koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, që janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin Serb të Kosovë, dhe dhjetë (10) vende do t'u ndahen komuniteteve të tjera si vijon: komunitetit Rom një (1) vend; komunitetit Ashkali një (1) vend; komunitetit Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali ose Egjiptian, i cili ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komunitetit Boshnjak tri (3) vende, komunitetit Turk dy (2) vende dhe komuniteti Goran një (1) vend. Çdo vend i fituar përmes zgjedhjeve, do të jetë vend shtesë, përveç dhjetë (10) vendeve të rezervuara që u ndahen përkatësisht komunitetit Serb të Kosovës dhe komuniteteve të tjera.

2. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, mandati ekzistues në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute do të konsiderohet si mandati i parë zgjedhor i Kuvendit, në rast se ky mandat zgjat për së paku dy vite nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute.

Neni 149[*]
[Miratimi Fillestar i Ligjeve me Interes Vital]

Pavarësisht nga dispozitat e Nenit 81 të kësaj Kushtetute, ligjet me interes vital të radhitura në atë nen, do të miratohen fillimisht me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm të Kuvendit dhe që votojnë.

Neni 150[*]
[Procesi i Emërimit të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve]

1. Shqyrtimi gjithëpërfshirës mbarëkosovar për përshtatshmërinë e të gjithë kandidatëve për emërime të përhershme për gjyqtarë dhe prokurorë në Kosovë, deri në moshën e pensionimit të përcaktuar me ligj, do të vazhdojë të bëhet në pajtim me Urdhëresën Administrative 2008/2 dhe nuk do të ndikohet nga përfundimi i mandatit të UNMIK-ut, ose nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute.
2. Të gjithë kandidatët e suksesshëm, të cilët janë emëruar ose riemëruar për gjyqtarë dhe prokurorë nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, si pjesë e procesit të emërimit, do të vazhdojnë të shërbejnë në postet e tyre deri në skadimin e natyrshëm të mandatit të tyre, ose deri atëherë kur ata të shkarkohen në pajtim me ligjin.
3. Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial do t'i paraqesë me shkrim Këshillit Gjyqësor të Kosovës rekomandimet për kandidatët për emërimin dhe riemërimin e tyre si gjyqtarë dhe prokurorë, i cili ushtron pushtetin përfundimtar, që t'ia propozojë Presidentit të Kosovës kandidatët për emërim dhe riemërim si gjyqtarë dhe prokurorë.
4. Të gjithë kandidatët e suksesshëm, të cilët janë emëruar ose riemëruar nga Presidenti i Kosovës si gjyqtarë dhe prokurorë, sipas propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si pjesë e procesit të emërimit, do të vazhdojnë të shërbejnë në këto poste deri në skadimin e natyrshëm të mandatit të tyre, ose deri atëherë kur ata të shkarkohen në pajtim me ligjin.
5. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 105 të kësaj Kushtetute, mandati i të gjithë gjyqtarëve

[*] Neni 149 është fshirë me amendamentin 10.
[*] Neni 150 është fshirë me amendamentin 11.

dhe prokurorëve që në mënyrë të suksesshme e kalojnë procesin e emërimit siç është përcaktuar në këtë nen dhe të cilët kanë ushtruar funksionin së paku dy vjet para emërimit, sipas këtij neni, është i përhershëm deri në moshën e pensionimit sikurse është përcaktuar më ligj, përveç nëse shkarkohen në pajtim me ligjin.

Neni 151*
[Përbërja e Përkohshme e Këshillit Gjyqësor të Kosovës]

Deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare të zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të përbëhet siç vijon:

1. Pesë (5) anëtarë janë anëtarë kosovarë të Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, që janë verifikuar nga Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, si pjesë e fazës së parë dhe të dytë të procesit të emërimit, në pajtim me Urdhëresën Administrative 2008/02. Prej këtyre pesë (5) anëtarëve, një (1) gjyqtar dhe një (1) prokuror të zgjedhur sipas metodës së rastësisë, do të shërbejnë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës deri në skadimin e natyrshëm të mandateve të tyre ekzistuese, kur do të zëvendësohen me një (1) gjyqtar dhe një (1) prokuror të verifikuar nga Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial dhe që janë zgjedhur nga ana e kolegëve të tyre, duke iu përmbajtur metodave që kanë për qëllim sigurimin e përfaqësimit sa më të gjerë të shërbimit të Gjyqësorit dhe Prokurorisë. Dy (2) gjyqtarët e mbetur dhe një (1) prokuror nga radhët e pesë (5) anëtarëve kosovarë të Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, do të shërbejnë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës për një mandat plotësues njëvjeçar pas skadimit të natyrshëm të mandatit të tyre, kur ata do të zëvendësohen me procedurë të njëjtë sikur edhe ishkolegët e tyre të Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial. Në rast të themelimit të një subjekti përgjegjës për çështjet e emërimit, disiplinës dhe shkarkimit të prokurorëve, të gjithë anëtarët e tjerë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës do të jenë gjyqtarë.
2. Tetë (8) anëtarët e tjerë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës do të zgjedhen nga Kuvendi i Kosovës në mënyrën e përcaktuar me këtë Kushtetutë, përveç dy (2) nga katër (4) anëtarët e zgjedhur nga deputetët e Kuvendit që mbajnë vende të fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve, duhet të jenë ndërkombëtarë, të përzgjedhur nga Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil, sipas propozimit të Misionit Evropian për Politika të Sigurisë dhe Mbrojtes. Njëri nga anëtarët ndërkombëtarë duhet të jetë gjyqtar.

Neni 152*
[Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese]

Deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare të zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, Gjykata kushtetuese do të përbëhet si në vijim:

1. Gjashtë (6) nga nëntë (9) gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së

* Neni 151 është fshirë me amendamentin 12.
* Neni 152 është fshirë me amendamentin 13.

Kosovës, me propozimin e Kuvendit.

2. Nga gjashtë (6) gjyqtarët, dy (2) do të shërbejnë për një mandat trevjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes, dy (2) do të shërbejnë për një periudhë gjashtëvjeçare, pa mundësi të rizgjedhjes, dhe dy (2) do të shërbejnë për një periudhë nëntëvjeçare, pa mundësi të rizgjedhjes. Mandatet e gjyqtarëve fillestarë do të zgjidhen me short, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, menjëherë pas emërimit të tyre.
3. Nga gjashtë (6) gjyqtarët, katër (4) do të zgjidhen votat e dy të tretave (2/3) të deputetëve të Kuvendit, të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë. Dy (2) do të zgjidhen me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit, pas pëlqimit të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vendet që janë rezervuar ose garantuar për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.
4. Tre (3) gjyqtarë ndërkombëtarë do të emërohen nga Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Tre (3) gjyqtarët nuk do të jenë qytetarë të Kosovës dhe as të ndonjë vendi fqinj.
5. Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil do të përcaktojë se kur skadon mandati i gjyqtarëve ndërkombëtarë, dhe gjyqtarët do të ndërrohen sikur është e parashikuar me Kushtetutë.

Neni 153[*]
[Prania Ndërkombëtare Ushtarake]

Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj Kushtetute, Prania Ndërkombëtare Ushtarake ka mandatin dhe kompetencat e përcaktuara nga instrumentet relevante ndërkombëtare, përfshirë Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007. Kryesuesi i Pranisë Ndërkombëtare Ushtarake, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, është autoriteti final në zonën operative për sa i përket interpretimit të atyre aspekteve të marrëveshjes së përmendur që i referohen Pranisë Ndërkombëtare Ushtarake. Asnjë autoritet i Republikës së Kosovës nuk ka jurisdikcion të rishikojë, të pakësoj ose përndryshe të kufizoj mandatin, kompetencat dhe detyrimet e referuara në këtë nen.

Neni 154[*]
[Trupat e Mbrojtjes të Kosovës]

Trupat e Mbrojtjes të Kosovës do të shpërbëhen brenda një viti pas hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute. Deri në shpërbërje, Prania Ndërkombëtare Ushtarake, në konsultim me Përfaqësuesin Ndërkombëtarë Civil dhe Republikën e Kosovës do të ketë autoritet ekzekutiv mbi Trupat e Mbrojtjes të Kosovës dhe vendos për dinamikën kohore të shpërndarjes.

[*] Neni 153 është fshirë me amendamentin 14.
[*] Neni 154 është fshirë me amendamentin 15.

Neni 155*
[Shtetësia]

1. Të gjithë banorët e ligjshëm të Kosovës në datën e miratimit të kësaj Kushtetute, gëzojnë të drejtën e shtetësisë së Republikës së Kosovës.
2. Republika e Kosovës ua njeh të drejtën në shtetësinë e Republikës së Kosovës, pavarësisht nga vendbanimi i tyre i tanishëm dhe shtetësia që ata kanë, të gjithë qytetarëve të ish Republikës Federative të Jugosllavisë, të cilët kanë qenë banorë të përhershëm të Kosovës me datën 1 janar 1998, dhe pasardhësve të tyre të drejtpërdrejtë.

Neni 156*
[Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit]

Republika e Kosovës promovon dhe lehtëson kthimin e sigurt dhe me dinjitet të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit, dhe u ndihmon atyre për kthimin e pronave dhe posedimeve të tyre.

Neni 157*
[Auditori i Përgjithshëm i Kosovës]

Deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare dhe zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, Revizori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës do të jetë një ndërkombëtar i emëruar nga Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil.

Neni 158*
[Autoriteti Qendror Bankar]

Deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare dhe zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës do të emërohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pas marrjes së pëlqimit nga Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil.

Neni 159*
[Pronat dhe Ndërmarrjet në Pronësi Shoqërore]

1. Të gjitha ndërmarrjet që ishin në tërësi ose pjesërisht në pronësi shoqërore, para hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, do të privatizohen në pajtim me ligj.
2. Të gjitha interesat në pronësi shoqërore në prona dhe ndërmarrje në Kosovë do të jenë në pronësi të Republikës së Kosovës.

* Neni 155 është bartur në Kapitullin I – Dispozitat themelore me amendamentin 16.
* Neni 156 është bartur në Kapitullin II me amendamentin 17.
* Neni 157 është fshirë me amendamentin 18.
* Neni 158 është fshirë me amendamentin 19.
* Neni 159 është fshirë me amendamentin 20.

Neni 160*
[Ndërmarrjet në Pronësi Publike]

1. Republika e Kosovës do t'i ketë në pronësi të vet të gjitha ndërmarrjet në Republikën e Kosovës që janë ndërmarrje në pronësi publike. Të gjitha obligimet që kanë të bëjnë me këto të drejta pronësore do të jenë obligime të Republikës së Kosovës. Qeveria e Kosovës mund të privatizojë, të japë me koncesion ose të japë me qira ndërmarrjet në pronësi publike në mënyrën e rregulluar me ligj.
2. Të drejtat e pronësisë, që kanë të bëjnë me një ndërmarrje në pronësi publike e cila ofron shërbime vetëm në një komunë specifike ose në një numër të kufizuar të komunave, do të jenë të drejta pronësore të komunës ose komunave përkatëse. Obligimet në lidhje me të drejtat e tilla pronësore do të jenë obligime të komunës ose komunave përkatëse. Kuvendi mundet me ligj të identifikojë një ndërmarrje të tillë dhe komunën a komunat, që kanë të drejta pronësore dhe obligimet lidhur me to. Nëse përcaktohet me ligj, komuna a komunat përkatëse, ndërmarrjet në pronësi shoqërore mund t'i privatizojnë, t'i japin me koncesion ose t'i lëshojnë me qira.

Neni 161*
[Transicioni i Institucioneve]

1. Me përjashtim të rastet kur Kushtetuta përcakton një transicion tjetër, të gjitha kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrimet e institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë, do t'u kalojnë menjëherë atyre institucioneve në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute. Kohëzgjatja e mandatit të secilit institucion para hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, do të mbetet e paprekur dhe e pandryshuar deri në skadimin e rregullt, ose deri në zgjedhjet e reja.
2. Deri ne zgjedhjet e para parlamentare pas hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, Kryesia e Kuvendit mbetet me kompetencat e parapara në mandatin e saj ekzistues. Pas seancës konstituive të Kuvendit të parë pas hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, Kryesia e Kuvendit ristrukturohet në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.
3. Dispozitat e nenit 70.3.(3) nuk do të aplikohen deri në seancën konstituive të Kuvendit pas zgjedhjeve të para parlamentare pas hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute.
4. Deri në formimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, funksionet dhe përgjegjësitë e tij do të i kryejë Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Neni 162
[Hyrja në Fuqi]

Kushtetuta e Republikës së Kosovës hyn në fuqi më 15 qershor 2008.

Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. V-027 të datës 9 prill 2008.

* Neni 160 është fshirë me amendamentin 21.
* Neni 161 është fshirë dhe është shtuar një nen i ri si dispozitë kalimtare me amendamentin 22.

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

AMANDAMENTIMIN E KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS LIDHUR ME PËRFUNDIMIN E MBIKËQYRJES NDËRKOMBËTARE TË PAVARËSISË KOSOVËS

Amendamenti 1:

Neni 58 paragrafi 4., riformulohet me tekstin si në vijim:

4. Republika e Kosovës, sipas nevojës, do të miratoj masa adekuate për të promovuar barazi të plotë dhe efektive të pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore dhe pjesëmarrjen efektive të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në jetën publike dhe në vendimmarrje. Masat e tilla nuk do të konsiderohen të jenë vepër e diskriminimit.

Amendamenti 2:

Nenit 81 paragrafi 1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Për miratimin, ndryshimin ose shfuqizimin e ligjeve në vijim, kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit dhe të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë në shumicë.

Amendamenti 3:

Nenit 81 paragrafi 1. pika (5), fshihet dhe riformulohet si vijon:

(5) Ligjet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe zonave të veçanta të mbrojtura.

Amendamenti 4:

Neni 143 fshihet.

Amendamenti 5:

Neni 144 (Amendamentimi), bartet tek Kapitulli I - Dispozitat Themelore.

Amendamenti 6:

Neni 145, (Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe e Legjislacionit të Aplikueshëm), të bartet tek Kapitulli I - Dispozitat Themelore.

Amendamenti 7:

Neni 146 fshihet.

Amendamenti 8:

Neni 147 fshihet.

Amendamenti 9:

Neni 148 fshihet.

Amendamenti 10:

Neni 149 fshihet.

Amendamenti 11:

Neni 150 fshihet.

Amendamenti 12:

Neni 151 fshihet.

Amendamenti 13:

Neni 152 fshihet.

Amendamenti 14:

Neni 153 fshihet.

Amendamenti 15:

Neni 154 fshihet.

Amendamenti 16:

Neni 155 (Shtetësia), bartet tek Kapitulli I - Dispozitat Themelore.

Amendamenti 17:

Neni 156 (Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit) bartet në kapitullin II të Kushtetutës**.**

Amendamenti 18:

Neni 157 fshihet.

Amendamenti 19:

Neni 158 fshihet.

Amendamenti 20:

Neni 159 fshihet.

Amendamenti 21:

Neni 160 fshihet.

Amendamenti 22:

Neni 161 fshihet dhe shtohet një nen i ri si dispozitë kalimtare me tekstin si në vijim:

Neni 161
Dispozitë kalimtare

Individët e emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtarë, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, mandati i të cilëve nuk ka përfunduar para deklarimit të përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur do të vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre në institucionet ku janë deri në fund të mandatit të specifikuar. Kosova do t'ua japë këtyre individëve të njëjtat privilegje dhe imunitete që i gëzojnë diplomatët dhe familjet e tyre sipas Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike.

Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.04-V-436 më 7 shtator 2012

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 25 / 07 SHTATOR 2012, PRISHTINË

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratoi

AMENDAMENTIMIN E KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

I.
Amendamenti nr. 23

Në nenin 65, pas pikës (14) shtohet pika (15), me tekstin si vijon:
"(15) jep amnisti me ligj përkatës, i cili miratohet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit".

II.

Ndryshimet kushtetuese hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.04-V-553, 14 mars 2013.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 7 / 26 MARS 2013, PRISHTINË

LIGJI Nr. 03/L-073
PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 63
Kreu II: E drejta për të votuar, lista e votuesve dhe periudha e kundërshtimit dhe konfirmimit për listën së votuesve 68
Kreu III: Regjistrimi i partive politike dhe certifikimi i subjekteve politike 71
Kreu IV: Certifikimi i kandidatëve 78
Kreu V: Kodi i mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët 81
Kreu VI: Kufizimi i shpenzimeve të fushatës dhe deklarimi financiar 84
Kreu VII: Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike 88
Kreu VIII: Mediat gjatë fushatës së zgjedhjeve 89
Kreu IX: Vëzhguesit e zgjedhjeve 92
Kreu X: KQZ 94
Kreu XI: Komisionet komunale të zgjedhjeve 99
Kreu XII: Këshillat e vendvotimeve 102
Kreu XIII: Qendrat e votimit dhe votimi 106
Kreu XIV: Votimi jashtë Kosovës 111
Kreu XV: Votimi i personave me nevoja të veçanta 112
Kreu XVI: Procesi i numërimit të fletëvotimeve dhe shpallja e rezultateve të zgjedhjeve 113
Kreu XVII: Informimi i votuesve dhe media 115
Kreu XVIII: Sistemi zgjedhor për kuvendin e kosovës 116
Kreu XIX: Shpenzimet/kostoja e zgjedhjeve 119
Kreu XX: Komisioni zgjedhor për ankesa dhe parashtresa 120
Kreu XXI: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 124

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Me qëllim të organizimit të zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike për Kuvendin e Kosovës, dhe me qëllim të fuqizimit të qeverisjes demokratike në Kosovë,

Miraton:

LIGJ PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË KOSOVË

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i Ligjit

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë:

a) sistemin zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës;
b) financimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës;
c) njohjen dhe mbrojtjen e të drejtës për të votuar dhe kriteret për pranueshmërinë e votës;
d) mirëmbajtjen e listës së votuesve;
e) regjistrimin e partive politike dhe certifikimin e subjekteve politike;
f) përgjegjësitë dhe funksionimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
g) krijimin dhe funksionimin e Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa;
h) organizimin dhe funksionimin e komisioneve dhe këshillave të zgjedhjeve;
i) rregullat për akreditimin e vëzhguesve të zgjedhjeve, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre;
j) kufizimet e shpenzimeve për fushatë dhe obligimet për publikim financiar;
k) mbulimin e fushatave zgjedhore nga mediat;
l) kodin e mirësjelljes së subjekteve politike, kandidatëve të tyre dhe mbështetësve;
m) procedurat e votimit, numërimit dhe shpalljes së rezultateve;
n) sanksionet dhe gjobat e ngarkuara për shkeljen e dispozitave të këtij ligji.

Neni 2
Parimet Themelore

Mbajtja dhe administrimi i zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës dhe legjislacioni përkatës zgjedhor udhëhiqen nga parimet në vijim:

- Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës mbahen në bazë të votës së lirë, të përgjithshme, të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë në përputhje me këtë ligj dhe rregullat e KQZ-së.
- Votuesit me të drejtë vote janë të barabartë në ushtrimin e të drejtës së tyre për të votuar dhe për të hedhur numër të barabartë të votave në zgjedhjet e njëjta.

- Çdo qytetar i Kosovës ka të drejtën për të votuar dhe për t'u zgjedhur pa diskriminim në bazë të racës, etnisë, ngjyrës, gjuhës, gjinisë, besimit fetar apo bindjes politike, arsimit, përkatësisë sociale apo ndonjë kriteri tjetër të ngjashëm në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
- Organet e administrimit të zgjedhjeve ndërmarrin aktivitete për edukimin e votuesve me qëllim të rritjes së aftësive të votuesve për procedurat e votimit dhe procedurat e mbrojtjes së të drejtave zgjedhore. Për këtë qëllim, organet e administrimit të zgjedhjeve vejnë në dispozicion materialin edukues në gjuhët e komuniteteve në ato zona gjeografike ku ato komunitete ndodhen dhe përmes mediave që veprojnë në gjuhët e pakicave.
- Liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka të drejtë të pengojë ndonjë qytetar për të votuar, të detyrojë atë të votojë në një mënyrë të caktuar, të mbajë atë përgjegjës për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës së tij/saj që të zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mos votim.
- Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës reflektojnë përfaqësimin gjeografik të të gjitha rajoneve të Kosovës.
- Të gjitha subjektet politike janë të lira të bëjnë fushatë dhe të bëjnë propagandë zgjedhore në media, përmes organizimit të ngjarjeve politike dhe botimit e shpërndarjes së materialeve për fushatë në çfarëdo mënyre ligjore në përputhje me rregullat dhe legjislacionin në fuqi.
- Subjektet politike kanë mundësi të barabartë për emisione në radio dhe televizion, fonde publike dhe forma të tjera të mbështetjes.
- Përdorimi i zyrave publike, burimeve ose personelit të cilitdo institucion në nivel qendror ose lokal me qëllim të mbështetjes së një subjekti politik në zgjedhje është rreptësishtë i ndaluar.
- Subjektet politike nuk mund të shfrytëzojnë nëpunësit civil që përdorin pozitën, burimet, ose personelin për fushatë gjatë zgjedhjeve.
- Të gjitha subjektet politike dhe organet zgjedhore janë të obliguara t'i respektojnë kërkesat për kuotën e gjinisë siç përcaktohet me këtë ligj.
- Të gjitha subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe të gjitha institucionet tjera janë të obliguara të respektojnë parimet themelore të përcaktuara në këtë nen dhe të ndërmarrin të gjitha masat për të siguruar mbajtjen e zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të mirë-informuara në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Neni 3
Përkufizimet

Për qëllim të këtij ligji,

"Aktiviteti i Fushatës Politike" do të thotë çfarëdo tubimi ose fjalimi politik, mbledhje, prezantim publik, ose ndonjë aktivitet i përgatitur për të propaganduar mesazh politik në lidhje me zgjedhjet;

"Borxhi" do të thotë të gjitha shumat monetare të cilat subjekti politik është i detyruar t'ua paguajë personave të tjerë;

"**Burime**" përfshijnë artikujt e prekshëm dhe të paprekshëm siç janë përcaktuar në rregullat e një institucioni, sikurse janë automjetet, materialet shpenzuese, fotokopja,

telefoni, telefoni celular, pajisjet e zyrës, objektet;
"Fletë bilanci" do të thotë deklarimi financiar i subjekteve politike i pasurive, detyrimeve dhe kapitalit siç është e përkufizuar në këtë nen;
"Formulari i Përputhjes së Rezultateve" (FPR) do të thotë formulari i miratuar nga KQZ-ja para çdo zgjedhjeve për qëllim të përputhjes së votave në një vendvotim;
"**Kandidati**" do të thotë kandidati për deputet të Kuvendit të Kosovës, i cili garon në emër të një partie politike apo nisme qytetare;
"Kandidati i pavarur" do të thotë kandidati për deputet të Kuvendit të Kosovës, i cili nuk i takon asnjë partie politike ose nisme qytetare dhe nuk garon në emër të asnjë subjekti tjetër politik;
"Kapitali" do të thotë ndryshimi ndërmjet pasurive dhe borxheve;
"Koalicioni" do të thotë koalicioni i dy ose më shumë subjekteve politike;
"Komisioni Komunal i Zgjedhjeve" (KKZ) është organ përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve zgjedhore brenda territorit të komunës;
"KZAP" do të thotë **Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**, një organ i pavarur përgjegjës për vendosjen për parashtresat dhe ankesat në lidhje me procesin zgjedhor; **"Komuna"** ka kuptimin e termit sipas nenit 124 të Kushtetutës së Kosovës;
"Komuniteti" do të thotë banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar, etnik, gjuhësor ose fetar,
tradicionalisht të pranishëm në territorin e Kosovës;
"Kontributi" do të thotë dhurata, ndihma ose donacioni i cilitdo lloj që i jepet subjektit politik, qoftë në para të gatshme apo në të mira materiale, dhe përfshinë pagesën e borxheve të subjektit dhe sigurimin jo në baza komerciale, të pasurisë, të huas, të shërbimeve dhe të objekteve për shfrytëzim ose përfitim të subjektit. Shërbimet që i ofrohen subjektit politik nga individë në mënyrë vullnetare jashtë orarit të tyre të punës dhe pa pagesë nuk konsiderohen kontribute. Kontributi realizohet atëherë kur subjekti politik përfiton nga kontributi;
"KQZ" do të thotë **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, organ i pavarur i ekspertëve përgjegjës për administrimin e zgjedhjeve;
"Kushtetuta" do të thotë Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
"Kuvendi" do të thotë Kuvendi i Kosovës;
"Lista përfundimtare e votuesve" (LPV) do të thotë lista e votuesve ashtu siç përcaktohet në nenin 8.6 të këtij ligji;
"Lista Përfundimtare e Votuesve të Vendvotimit" (LPV VV) do të thotë lista e votuesve të cilët janë caktuar të votojnë në një VV të rregullt, e cila mban nënshkrimin e atyre anëtarëve të cilët kanë hedhur votat e rregullta në atë VV;
"Lista e votuesve me kusht" (LVK) do të thotë lista e zbrazët e votuesve që do të përdoret në VV-të ku hidhen fletëvotimet me kusht;
"Lista e Votuesve" (LV) do të thotë lista e të gjithë votuesve me të drejtë vote për zgjedhje siç përcaktohet në nenin 7.1 të këtij ligji;
"Media" do të thotë të gjitha televizionet dhe radiostacionet që transmetojnë në territorin e Kosovës dhe të cilët janë të licencuara nga Komisioni i Pavarur për Mediave, duke përfshirë edhe mediat e shkruara;
"Ngjarje" do të thotë tubim politik në mjedis të mbyllur ose të hapur, mbledhje, marsh ose vargan, fjalim ose ndonjë aktivitet tjetër i ngjashëm i caktuar për të shpërndarë mesazh politik në mënyrë që të fitohet mbështetje nga votuesit;

“Nisma Qytetare” do të thotë grupi i personave të cilët bashkohen vullnetarisht mbi bazën e një ideje, interesi ose pikëpamje të përbashkët, me qëllim zgjedhjen e kandidatëve të tyre, por që nuk dëshirojnë të formojnë parti politike;
“Organizata Jo-Qeveritare” (OJQ) do të thotë çdo organizatë jo-qeveritare e regjistruar në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi;
“Pagesa” do të thotë transferimi i pagesës me vlerë, përfshirë dhe pagesën në formë të mallrave dhe shërbimeve. Pagesa bëhet në kohën kur merret përfitimi nga pagesa;
“Parti politike” do të thotë një organizim i individëve të cilët janë bashkuar vullnetarisht mbi bazën e ideve, interesit dhe pikëpamjeve të përbashkëta, me qëllim të ushtrimit të ndikimit dhe pasjes së përfaqësuesve të tyre të zgjedhur në zyrë publike, ose siç e përcaktuar ndryshe me legjislacionin në fuqi;
“Pasuria” do të thotë e tërë pasuria e paluajtshme ose e luajtshme në pronë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, përfshirë paratë e gatshme në dorë ose depozitat bankare, si dhe të ardhurat që burojnë prej tyre nga shitja, kalimi në posedim të një personi të tretë apo marrëveshje tjetër, vlera e bizneseve në pronësi dhe çdo send në zotërim që ka vlerë më të madhe se pesëqind euro (500 €) dhe me jetëgjatësi ekonomike më të gjatë se tri (3) vjet;
“Periudha e kundërshtimit dhe e konfirmimit” do të thotë periudha kohore pas shpalljes së ditës së zgjedhjeve nga Presidenti i Kosovës, gjatë së cilës votuesit me të drejtë vote mund të kundërshtojnë pasaktësitë ose lëshimet në Listën e Votuesve në vendet e caktuara nga KQZ-ja dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat e themeluara nga KQZ-ja;
“Periudha e fushatës” do të thotë periudha prej tridhjetë (30) ditëve për fushatën zgjedhore të subjekteve politike e cila përfundon një (1) ditë para ditës së zgjedhjeve;
“Personi kontaktues” do të thotë personi i cili është i autorizuar të komunikoj në emër të subjektit politik me zyrën për çështje jo-financiare;
“Përfaqësuesi financiar” do të thotë personi që është personalisht përgjegjës për mbajtjen e shënimeve financiare të subjektit politik, duke siguruar pajtueshmërinë e subjektit me këtë ligj dhe duke komunikuar me Sekretariatin e KQZ-së lidhur me raportet për deklarimin e financave të fushatës së subjektit;
“Pikë publicitare politike” do të thotë një reklamë e vetme e natyrës politike që përfaqëson pikëpamjet e subjektit politik të certifikuar që transmetohet nga transmetuesi medial;
“Nëpunësi publik” përfshinë, por nuk kufizohet në, personin në marrëdhënie pune me departamentin e administratës qeveritare, administratës komunale apo ndonjë organi të ngjashëm, paga e të cilit bëhet nga fondet e siguruara nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës;
“Qasja e drejtë” do të thotë qasje e drejtë dhe e përpjesshme në media të shkruara dhe elektronike në kuptim të periudhave kohore të mbulimit nga mediat, vendosjes së numrit të rreshtave në mediat e shkruara, pa diskriminim për ose kundër cilitdo subjekt të veçantë të certifikuar;
“Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve” (QNR) do të thotë lokacioni ku numërohen fletëvotimet me kusht (FK-të), fletëvotimet jashtë Kosovës, dhe çdo fletëvotim i rregullt siç kërkohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) apo Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, FPR-të nga secili VV auditohen dhe tabelohen, dhe rezultati përfundimtar përpilohet;

"Qendra e Votimit" (QV) do të thotë ndërtesa ku ndodhen një apo më shumë vendvotime për qëllim të votimit në zgjedhje dhe përfshinë një hapësirë publike brenda rrezes 25 metra nga dera e hyrjes në ndërtesë;
"Regjistri Qendror Civil" do të thotë regjistri i banorëve të përhershëm, sipas Ligjit për Shtetësinë dhe sipas këtij ligji;
"SKQZ" do të thotë Sekretariati i KQZ-së;
"Subjekti politik" do të thotë parti politike, koalicion, nismë qytetare ose kandidat i pavarur;
"Subjekti(et) i certifikuar politik" do të thotë subjekti politik, që është partia politike, koalicioni i partive politike, nisma qytetare ose kandidati i pavarur, i cili është i certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përputhje me këtë ligj dhe me rregullat e KQZ-së;
"Shpenzimi" do të thotë pagesa e bërë për mallra ose për blerje të mallrave, materialeve, punës, ose shërbimeve, qofshin ato të prekshme ose të paprekshme. Shpenzimi bëhet në datën kur bëhet pagesa ose blerja ose në datën kur sigurohen mallrat, materialet, puna ose shërbimet, cilado që bëhet më parë;
"Shpenzimi për fushatë" do të thotë çdo pagesë e bërë për mallra ose blerje te mallrave, materialeve, punës, shërbimeve, qofshin ato të prekshme ose të paprekshme, me qëllim të ndikimit të drejtpërdrejtë në zgjedhje, pavarësisht nëse bëhen për mbështetje të kandidatit të posaçëm, partisë politike, koalicionit ose nismës qytetare, siç janë shpenzimet për reklamim në mediat e shtypura; prodhimin e spoteve transmetuese; materialet e fushatës, përfshirë pamfletet, posterët, butonat; ekspozim të reklamave, përfshirë stendat e afishimit dhe prodhimin e tyre; kontributet bamirëse. Këto nuk përfshijnë shpenzimet e bëra në mbështetje të veprimtarive të rregullta të subjektit politik. Mallrat ose shërbimet për të cilat pagesat janë bërë para ose pas periudhës së fushatës, për përdorim gjatë periudhës së fushatës, po ashtu konsiderohen si shpenzime për fushatë;
"Shtetasi i Kosovës"/banor i përhershëm i Kosovës është ai individ që i plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 28 të Ligjit për Shtetësinë;
"Të ardhura" do të thotë çdo shumë monetare e pranuar si kuotë anëtarësie ose tarifë; qiraja; kontributet nga jashtë nga individët, bizneset ose organizatat e çfarëdo lloji; donacionet; vlera e kontributeve në formë të mallrave dhe shërbimeve (bamirëse) kontributet dhe çfarëdo pagese për subjektin politik;
"Transmetuesi në shërbim publik" do të thotë organizata e transmetuesit publik jofitimprurës të Kosovës, siç përcaktohet me Ligjin për Radio-Televizionin e Kosovës;
"Transmetuesi privat" do të thotë transmetuesi i cili nuk është në pronësi publike;
"**Tribunali**" do të thotë Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ);
"Vendvotimi" (VV) do të thotë një dhomë, sallë ose objekt i ngjashëm për qëllim të votimit në Ditën e Zgjedhjeve dhe që, po ashtu, përfshinë hapësirën publike me rreze prej 25 metra të hyrjes në ndërtesë në të cilën ndodhet vendvotimi;
"Vëzhguesi i akredituar" do të thotë përfaqësuesi i një subjekti të certifikuar politik, organizate joqeveritare, qeveritare ose ndërqeveritare, organizate ndërkombëtare të specializuar dhe të përfshirë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, vendi të huaj, ose media, që ka dorëzuar kërkesën për vëzhgim të zgjedhjeve dhe ka marrë miratimin nga KQZ-ja në pajtim me këtë ligj dhe me rregullat e KQZ-së;
"Votimi i Personave me Nevoja të Veçanta" (VPNV) do të thotë marrëveshjet e bëra

dhe procedurat e ndjekura për ata votues me të drejtë vote në Kosovë të cilët nuk mund të votojnë personalisht në VV-në në të cilën janë caktuar për Ditën e Zgjedhjeve;
"Votuesi jashtë Kosovës" do të thotë aplikuesi i suksesshëm nga jashtë Kosovës që përdor një nga mënyrat e votimit jashtë territorit të Kosovës, siç është e saktësuar në rregullat e KQZ-së;
"Zgjedhje" do të thotë zgjedhje për Kuvendin e Kosovës;
"Zyra" do të thotë Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim në kuadër të KQZ-së që vepron ashtu siç është e saktësuar me legjislacionin në fuqi.

Neni 4
Data e Shpalljes së Zgjedhjeve

4.1. Pas konsultimit me partitë politike, Presidenti i Kosovës cakton dhe shpall datën e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës.
4.2. Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës mbahen në ditën e diel çdo katër (4) vjet. Zgjedhjet nuk mbahen më herët se gjashtëdhjetë (60) ditë dhe mbahen në jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit.
4.3. Sipas kompetencave të Presidentit të përcaktuara me Kushtetutë, vendimi i Presidentit për të caktuar datën e zgjedhjeve bëhet jo më herët se gjashtë (6) dhe jo më vonë se katër (4) muaj para datës së zgjedhjeve. Vendimi përmban datën e zgjedhjeve.
4.4. Kuvendi i Kosovës zgjidhet për një mandat katër (4) vjeçar, i cili fillon që nga dita e seancës konstitutive e cila mbahet brenda tridhjetë (30) ditësh nga shpallja zyrtare e rezultateve të zgjedhjeve.
4.5. Pas shpërndarjes së Kuvendit të Kosovës zgjedhjet e parakohshme caktohen nga Presidenti jo me vonë se dhjetë (10) ditë pas shpërndarjes. Zgjedhjet e parakohshme nuk mund të mbahen më herët se tridhjetë (30) ditë dhe me vonë se dyzetë e pesë (45) ditë pas shpërndarjes. Zgjedhjet e parakohshme rregullohen nga ligjet dhe rregullat e njëjta të KQZ-së sikurse edhe zgjedhjet tjera, përveç se KQZ-ja mund të ndryshojë afatet kohore sipas nevojës në pajtim me rrethanat.
4.6. Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve bëhet publik në 'Gazetën Zyrtare të Kosovës'.

KREU II
E DREJTA PËR TË VOTUAR, LISTA E VOTUESVE DHE PERIUDHA E KUNDËRSHTIMIT DHE KONFIRMIMIT PËR LISTËN SË VOTUESVE

Neni 5
E drejta për të votuar

5.1. Çdo person ka të drejtë për të votuar në zgjedhje në përputhje me këtë ligj nëse i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet në ditën kur mbahen zgjedhjet dhe e plotëson njërin prej kritereve vijuese:
   a) është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil;
   b) banon jashtë Kosovës ose ka lëshuar Kosovën në apo pas 1 janarit 1998, me

kusht që t'i plotësojë kriteret e parapara sipas ligjit në fuqi për të qenë qytetar i Kosovës; apo

c) ka fituar statusin e refugjatit, siç është përkufizuar në Konventën Lidhur me Statusin e Refugjatëve të 28 korrikut 1951 dhe Protokollin e saj të 16 dhjetorit 1966, në apo pas 1 janarit 1995, dhe ka të drejtë për t'u regjistruar në Regjistrin Qendror Civil si banor i Kosovës;

5.2. Asnjë person nuk mund të votojë nëse:

a) është duke vuajtur dënimin e shqiptuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ("Tribunali");

b) është i akuzuar nga Tribunali dhe ka dështuar t'i bindet urdhrit për t'u paraqitur para Tribunalit; ose

c) është shpallur mentalisht i paaftë me vendim të prerë gjyqësor.

Neni 6
Votimi brenda dhe jashtë Kosovës

6.1. Çdo person me të drejtë vote ka të drejtë të votojë në Kosovë në ditën e zgjedhjeve dhe në zonën zgjedhore ku ai apo ajo është i regjistruar, me kusht që emri i tij apo saj paraqitet në Regjistrin Qendror Civil ose është regjistruar si qytetar i Kosovës në një datë të caktuar nga KQZ-ja.

6.2. Votuesi me të drejtë vote i cili përkohësisht banon jashtë, ose është zhvendosur nga, Kosova ka të drejtë të votojë në zgjedhje sipas procedurave dhe afateve kohore të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 7
Lista e Votuesve

7.1. KQZ-ja mban Listën e Votuesve dhe siguron që Lista e Votuesve është e saktë dhe e azhuruar, dhe e njëjta përmban:

a) ekstraktin më të vonë në dispozicion nga Regjistri Qendror Civil i të gjithë votuesve me të drejtë vote të cilët janë regjistruar si qytetar të Kosovës sipas Ligjit për Shtetësinë;

b) të gjithë votuesit me të drejtë vote jashtë Kosovës të cilët në mënyrë të suksesshme kanë aplikuar për votim jashtë Kosovës.

7.2. Të gjithë votuesit me të drejtë vote, të shënuar në mënyrë të kërkuar nga KQZ-ja. Informatat personale të ofruara për secilin votues janë: emri, mbiemri, data e lindjes, adresa dhe Qendra e Votimit ku ai/ajo është caktuar për të votuar.

7.3. Për konfirmimin e të drejtës për votim, KQZ-ja ka qasje në regjistra, të dhëna për vendbanim dhe të dhëna të tjera zyrtare.

7.4. Lista e Votuesve është në dispozicion për të pasur qasje në të ashtu siç parashihet me rregullat e KQZ-së.

7.5. Të gjitha aktivitetet dhe dokumentet e organeve shtetërore, të gjitha paraqitjet dhe të dhënat lidhura me qytetarët e regjistruar në Listën e Votuesve lirohen nga pagesa e tarifave dhe taksave.

7.6. Të dhënat personale të qytetarëve në Listën e Votuesve shënohen në gjuhët dhe alfabetet në të cilat shënimet origjinale mbahen në pajtim me Ligjin për

Përdorimin e Gjuhëve në Kosovë.

7.7. Gjykata kompetente duhet të dorëzoj të dhënat në KQZ për personat të cilëve u është marrë zotësia e veprimit me vendim gjyqësor të formës së prerë. Këto të dhëna dorëzohen ashtu siç kërkohet nga KQZ-ja.

7.8. Regjistri Qendror Civil pajis KQZ-në me të gjitha informatat përkatëse që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kërkon për të mirëmbajtur Listën e Votuesve në pajtim më afatet kohore të caktuara nga KQZ-ja.

7.9. KQZ-ja u ofron Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve (këtu e tutje: KKZ) një kopje elektronike të të gjithë LV-së dhe një kopje të shtypur të LV-së për komunën e tyre.

Neni 8
Shqyrtimi i Listës së Votuesve dhe Periudha e Kundërshtimit

8.1. Votuesit me të drejtë vote mund të kundërshtojnë, siç është e përcaktuar në nenin 9, pasaktësitë apo lëshimet në Listën e Votuesve gjatë periudhës së vendosur për atë qëllim nga KQZ-ja.

8.2. Para fillimit të Periudhës së Kundërshtimit dhe Konfirmimit, pas shpalljes së datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Kosovës, Sekretariati i KQZ-së e bën LV-në të disponueshme në zyrat e KKZ-së në secilën komunë, sikurse është përcaktuar me rregullat e KQZ-së dhe në pajtim me rregullat për mbrojtjen e të dhënave. Përveç kësaj, KKZ-ja mund të përcaktojë lokacione shtesë për të publikuar LV-të kur kjo është e nevojshme për të siguruar qasje në të brenda komunës së saj.

8.3. Vendimet për ndryshimet në LV merren nga gjykata e shkallës së parë.

8.4. Para fillimit të periudhës së kundërshtimit KQZ-ja pajis me LV Personin Kontaktues të secilit subjekt politik të certifikuar. Çdo përdorim i LV-së nga subjektet politike të certifikuara që është në kundërshtim me Kapitullin V për Kodin e Mirësjelljes të Subjekteve Politike dhe Mbështetësve të Tyre dhe Kandidatëve, paraqet shkelje të këtij ligji. Ndryshimet në LV mund të bëhen në përputhje me rregullat e KQZ-së.

8.5. KQZ-ja pajis me LV gjatë periudhës së zgjedhjeve vëzhguesit e akreditуar të zgjedhjeve sipas kërkesave të tyre individuale. Vëzhguesit e akreditуar të zgjedhjeve mund të vëzhgojnë Periudhën e kundërshtimit dhe konfirmimit në të gjitha lokacionet ku LV-ja është në dispozicion për tu shikuar.

8.6. Pasi që publiku të ketë pasur mundësinë të sfidojë pasaktësitë dhe mangësitë ne Listën e Votuesve, mirëpo para ditës së zgjedhjeve, KQZ-ja vërteton se Lista e Votuesve është në përputhje me ligjin në fuqi.

Neni 9
Procedura e kundërshtimit

9.1. Çdo votues me të drejtë vote siç përcaktohet me nenin 5 mund të rishikojë LV-në po qe se:

a) identifikon veten saktësisht tek KKZ si person me të drejtë vote në Kosovë që paraqitet në LV dhe ofron një prej dokumenteve identifikuese në vijim:
   (i) letërnjoftim të vlefshëm;

(ii) dokument udhëtimi të vlefshëm;
(iii) pasaportë të vlefshme;
(iv) leje të vozitjes të vlefshme; ose

b) identifikon plotësisht veten para KKZ-së si kandidat i suksesshëm për votues nga jashtë Kosovës me dokument të vlefshëm identifikues me fotografi, dhe dëftesë të regjistrimit jashtë Kosovës.

9.2. Personi që dëshiron të kundërshtojë një emër që mendon se nuk duhet të jetë në LV duhet të dorëzojë ankesë në gjykatën e shkallës së parë duke theksuar qartë faktet që mbështesin kundërshtimin, duke përfshirë provat tjera relevante.

9.3. Personi mund të ngritë ankesë në gjykatën e shkallës së parë nëse zbulon që emri i tij/saj nuk gjendet në LV. Një ankesë e tillë përfshinë çfarëdo prove relevante.

Neni 10
Procesi i Vendosjes

10.1. Të gjitha vendimet e gjykatës së shkallës së parë janë përfundimtare, përfshirë vendimet që kanë të bëjnë me përfshirjen apo përjashtimin e emrit nga LV-ja.

10.2. Gjykata e shkallës së parë e njofton KQZ-në dhe çdo palë tjetër ndaj së cilës është ngritur ankesa, dhe u ofron këtyre palëve mundësinë për t'u përgjigjur. Çdo përgjigje ndaj ankesës duhet të pranohet brenda dy (2) ditëve të punës prej njoftimit nga gjykata e shkallës së parë që ankesa është pranuar.

10.3. Gjykata e shkallës së parë brenda pesë (5) ditëve u komunikon vendimet lidhur me ankesat palëve të cilat kanë paraqitur ankesën dhe çfarëdo pale tjetër të cilës i është lëshuar njoftimi në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni.

10.4. Ankesa lidhur me përjashtim të padrejtë nga Lista e Votuesve, e rregullt apo përmes postës, duhet të pranohet nga gjykata e shkallës së parë brenda dyzet (40) ditëve para ditës së zgjedhjeve.

10.5. Gjykata e shkallës së parë nuk do të veprojë ndaj ankesave të cilat nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara në Rregullat e saj të Procedurës. Gjykata e shkallës së parë mund në përgjithësi të refuzojë një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë.

10.6. Gjykata e shkallës së parë ka autoritetin për të urdhëruar KQZ-në për të marrë masa riparuese për çështje në lidhje me kërkesat që kanë të bëjnë me LV-të.

KREU III
REGJISTRIMI I PARTIVE POLITIKE DHE CERTIFIKIMI I SUBJEKTEVE POLITIKE

Neni 11
Dispozitat e Përgjithshme

11.1. KQZ-ja themelon, brenda SKQZ-së, Zyrën për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim ("Zyra"). Zyra është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrit të partive politike, certifikimin e të gjitha subjekteve politike që do të përfshihen

në fletëvotim dhe kufizimin e shpenzimeve të fushatave dhe dispozitave për deklarim financiar të këtij ligji.

11.2. Zyra udhëhiqet nga drejtori ekzekutiv i cili i raporton drejtpërdrejtë KQZ-së.

11.3. Të gjitha regjistrimet e mbajtura nga Zyra për regjistrimin e partive politike e formuar brenda Shtyllës së III-të të UNMIK-ut (OSBE) në kohën e hyrjes së këtij ligji në fuqi konsiderohen të jenë të regjistruara nga ky ligj duke iu nënshtruar nenit 18.1 të këtij ligji.

11.4. Partia politike konsiderohet automatikisht e certifikuar në kohën e zgjedhjeve dhe pasi që të plotësojë kërkesën e nenit 15.3 të këtij ligji, përveç nëse e informon Zyrën ndryshe në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

11.5. Partia politike e regjistruar ose cilido aplikues tjetër për certifikim në përputhje me këtë ligj konsiderohet si subjekt politik. Zyra krijon dhe mban kuti postare për secilin subjekt politik të certifikuar nga KQZ-ja. E gjithë korrespondenca zyrtare në të shkruar me subjektet politike bëhet përmes Personit Kontaktues dhe kutisë postare përkatëse. Subjektet janë të obliguara që rregullisht të kontrollojnë kutitë postare të tyre që gjenden në KQZ.

Neni 12
Regjistrimi i Partive Politike

12.1. Aplikimet për regjistrimin e partive politike mund të dorëzohen në Zyrë në çdo kohë gjatë orëve të rregullta të punës.

12.2. Aplikimet e dorëzuara për regjistrim në Zyrë ndërmjet ditës se deklarimit të datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Kosovës dhe datës së vendosur për tërheqjen e fletëvotimit do të shqyrtohen vetëm nëse aplikimet për certifikim si subjekt politik janë bërë në përputhje me këtë ligj.

12.3. Aplikimet për regjistrimin e partive politike dorëzohen në formën e vendosur nga rregullat e KQZ-së siç e kërkuar nga Zyra, dhe duhet të përfshijnë me sa vijon:

a) emrin, mbiemrin, adresën dhe numrin e telefonit të kryetarit të partisë;
b) emrin, mbiemrin, adresën dhe numrin e telefonit të përfaqësuesit të autorizuar financiar të partisë;
c) emrin, mbiemrin, adresën dhe numrin e telefonit të personit të autorizuar për të komunikuar në emër të partisë me KQZ-në;
d) numrin e telefonit dhe adresën postare të zyrës qendrore të partisë;
e) deklaratën e nënshkruar nga kryetari i partisë për të respektuar dhe për t'iu përmbajtur Kodit të Mirësjelljes së Partive Politike;
f) statutin e partisë;
g) çfarëdo shkurtese apo shenje të partisë;
h) deklaratën e fundit financiare të partisë;
i) datën e konventës më të fundit të partisë;
j) emrin dhe adresën e së paku 500 anëtarëve të partisë të cilët banojnë në Kosovë dhe të cilët gjenden në Listën e Votuesve të Kosovës.

12.4. Zyra i shqyrton aplikimet brenda dhjetë (10) ditëve nga pranimi i tyre dhe brenda pesë (5) ditëve nga përfundimi i rishikimit të çfarëdo çështjeje që kërkon sqarim apo ndryshim në formën e aplikimit.

12.5. Brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i aplikimit, Zyra e njofton KQZ-në për statusin e aplikimit, duke rekomanduar regjistrimin, duke rekomanduar mos regjistrimin, ose duke saktësuar fusha të tjera që mund të kërkojnë sqarime shtesë.
12.6. Secila parti politike e regjistruar e dorëzon formularin siç përshkruhet nga rregullat e KQZ-së për të vazhduar regjistrimin e saj jo më vonë se 31 marsi i vitit kalendarik.
12.7. Dështimi për t'u riregjistruar në përputhje me këtë ligj do të thotë se partia largohet nga regjistri i partive politike.
12.8. Për çfarëdo ndryshimesh sa i përket kryetarit apo zyrtarit për financa të partisë politike, Zyra njoftohet brenda pesë (5) ditëve të punës pas bërjes së ndryshimeve.

Neni 13
Auditimi i deklaratave financiare

Deklaratat financiare të partisë politike të regjistruar auditohen në baza vjetore në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 14
Sanksionimi penal i subjekteve politike

14.1. Sanksioni penal kundër subjektit politik të regjistruar do të thotë çregjistrim i atij subjekti politik, siç përcaktohet nga gjykata.
14.2. Zyrtari i autorizuar financiar i partisë dhe kryetari i partisë janë ligjërisht përgjegjës për saktësinë e të gjitha informatave të dorëzuara në Zyrë, ashtu siç kërkohet me këtë ligj.

Neni 15
Certifikimi i subjekteve politike

15.1. Me qëllim të pjesëmarrjes në zgjedhje, subjekti politik duhet të certifikohet për atë qëllim nga KQZ-ja.
15.2. Aplikimet për certifikim mund të dorëzohen në çdo kohë gjatë orëve të rregullta të punës deri gjashtëdhjetë (60) ditë para zgjedhjeve. Asnjë aplikim nuk mund të merret në konsideratë nga Zyra në mes gjashtëdhjetë (60) ditë para zgjedhjeve dhe ditës së zgjedhjeve.
15.3. Partia politike e regjistruar është automatikisht e certifikuar, por duhet të njoftojë Zyrën brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga deklarimi i datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Kosovës për çfarëdo ndryshimi për kryetar të partisë, përfaqësues të autorizuar të partisë, ose përfaqësues financiar të partisë dhe çfarëdo informata të nevojshme lidhur më këso lloj ndryshimesh.
15.4. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga shpallja e datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Kosovës, partia politike e regjistruar e cila nuk dëshiron të certifikohet për zgjedhje duhet të njoftojë Zyrën që nuk garon në zgjedhje, apo që partia politike do të kërkojë certifikim përmes koalicionit në përputhje me

këtë ligj.

15.5. KQZ-ja e certifikon subjektin politik me të drejtë pjesëmarrjeje nëse i njëjti e dorëzon aplikimin e plotësuar, në formën e përshkruar dhe në datën e vendosur nga rregullat e KQZ-së. Këto aplikime shoqërohen me të gjithë dokumentacionin e mbështetur të kërkuar nga ky nen si në vijim:

a) Certifikata e Regjistrimit (numri personal në rastin e kandidatëve individual);
b) emri, mbiemri, adresa dhe numri i telefonit të kryetarit të subjektit ku kjo është e zbatueshme, dhe përfaqësuesit të autorizuar dhe numri i telefonit të zyrës qendrore të subjektit politik;
c) kopja e shenjës së partisë, apo në rast koalicionesh, kopja e shenjës e të gjitha partive politike që janë në koalicion dhe çfarëdo shenje të vetë koalicionit;
d) emri, mbiemri, adresa dhe numri i telefonit i zyrtarit financiar të subjektit;
e) emri, mbiemri, adresa dhe numri i telefonit i personit të ngarkuar me procesin zgjedhor në emër të subjektit;
f) deklarata e nënshkruar nga kryetari i partisë, apo bartësi i listës për subjekte të tjera që zotohen për të respektuar dhe vepruar në përputhje me Kodin e Mirësjelljes siç është përcaktuar më tutje në këtë ligj;
g) deklarata politike, e cila nuk tejkalon 150 fjalë, dhe në gjuhën apo gjuhët e zgjedhjes së saj, për qëllim të shpërndarjes së votuesve me qëllim të pjesëmarrjes në zgjedhje si votues jashtë Kosovës. Deklarata politike është në përputhje me Kodin e Mirësjelljes të përcaktuar në këtë ligj dhe të nënshkruar nga kryetari apo nënshkruesi i autorizuar për subjektin politik;
h) në rast të koalicionit, një deklaratë e nënshkruar nga kryetari i secilës parti politike të regjistruar e cila merr pjesë në koalicion përmes së cilës jepet pëlqimi për të marrë pjesë, duke bërë me dije mënyrën përmes së cilës kandidatët do të radhiten në fletëvotim në mesin e anëtarëve të koalicionit, dhe që zotohen për të respektuar dhe vepruar në pajtim me Kodin e Mirësjelljes së këtij ligji;
i) në rastin e nismës qytetare, numrin e letërnjoftimit të udhëheqësit të nismës, përfaqësuesin e autorizuar dhe përfaqësuesin financiar të autorizuar. Në rast të kandidatit të pavarur apo nismës qytetare, kandidati apo udhëheqësi i nismës po ashtu mund të shërbejë si përfaqësues i autorizuar dhe përfaqësues financiar;
j) emri, mbiemri, adresa dhe numri i telefonit të udhëheqësit të listës së koalicionit, përfaqësuesit dhe përfaqësuesit financiar;
k) në rast të koalicionit, një kopje e çfarëdo shenje të koalicionit;
l) Zyra njoftohet për çfarëdo ndryshimi të kryetarit të partisë politike apo zyrtarit për financa brenda pesë (5) ditëve të punës pas bërjes së ndryshimeve.

15.6. Subjekti politik dorëzon me aplikimin e tij certifikatën e pagesës siç është përcaktuar më tutje në nenin 23 të këtij ligji.

15.7. Përveç përjashtimeve të përcaktuara në paragrafin 8 të këtij neni, secili aplikim për certifikim përfshinë numrin e nevojshëm të nënshkrimeve siç parashihet me rregullën e KQZ-së.

15.8. Partia politike që ka marr së paku një (1) ulëse në Kuvendin e Kosovës në zgjedhjet e fundit të llojit të njëjtë nuk kërkohet të dorëzojë nënshkrimet në mbështetje të aplikimit të saj për certifikim në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.
15.9. Personi mund të japë nënshkrimin e tij/saj në mbështetje të vetëm një subjekti politik për zgjedhje.
15.10. Çdo subjekt politik është i obliguar që në aplikimin e tij për certifikim, të zotohet me shkrim dhe të nënshkruajë për të respektuar Kodin e Mirësjelljes për Subjekte Politike siç përcaktohet në Kapitullin VI të këtij ligji.
15.11. Çdo subjekt politik në kërkesën e tij tregon nëse dëshiron të hyjë në garë për të fituar ndonjërin prej vendeve të garantuara për përfaqësim të serbëve dhe komuniteteve tjera jo-shumicë të Kosovës, sipas nenit 64 të Kushtetutës.
15.12. Çdo dështim në përmbushjen e kërkesave të këtij neni i jep të drejtë KQZ-së të pezullojë procesin e aplikimit. Përveç kërkesave të certifikimit të këtij Kapitulli, më lartë, KQZ-ja, me pranimin e aplikimit për certifikim nga subjekti politik, përfshirë edhe partinë politike të regjistruar, kërkon nga KZAP-ja të japë konfirmim me shkrim se subjekti politik që aplikon ka paguar plotësisht gjobat në lidhje me cilat do zgjedhje të mëparshme dhe të konfirmojë se nuk ka borxhe tjera të papaguara.
15.13. Të gjitha kërkesat për të tërhequr një subjekt të certifikuar politik nga zgjedhjet i dorëzohen KQZ-së.

Neni 16
Shqyrtimi i Aplikimeve për Certifikim

16.1. Zyra shqyrton të gjitha aplikimet për certifikim dhe nëse përcakton se subjekti politik nuk ka plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në nenin 15, atëherë Zyra brenda dhjetë (10) ditëve pas pranimit të aplikimit për certifikim dërgon një njoftim me të cilin e informon subjektin politik për arsyen ose arsyet pse aplikimi i tij nuk është i mjaftueshëm.
16.2. Aplikuesi i cili pranon njoftimin sipas nenit 12.4 të këtij ligji, ka pesë (5) ditë punë për të dorëzuar aplikimin e korrigjuar apo një shpjegim që adreson brengat e identifikuar në njoftim.
16.3. Zyra i bën rekomandim me shkrim KQZ-së për apo kundër miratimit të secilit aplikim që pranon brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i dokumentacionit të plotë. Rekomandimet përmbajnë shpjegim të shkruar për secilin kriter. Asnjë parti nuk certifikohet nëse nuk i plotëson kriteret e përcaktuara më tutje.
16.4. Pas pranimit të rekomandimit nga Zyra, KQZ-ja e miraton ose refuzon aplikimin për certifikim brenda shtatë (7) ditëve të punës.
16.5. Pas vendimit të KQZ-së, Zyra e njofton menjëherë aplikuesin me shkrim rreth statusit të aplikimit dhe në rast të refuzimit, ofron arsyetimin për refuzim dhe e këshillon aplikuesin për të drejtën e tij për t'u ankuar në KZAP brenda pesë (5) ditëve.

Neni 17
Partitë Politike

17.1. Partia politike mund të certifikohet për pjesëmarrje në zgjedhje nëse dëshmon se regjistrimi në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2004/11 nuk është nën pezullim.
17.2. Zyra e informon KQZ-në rreth statusit të regjistrimit të secilës parti politike aplikuese para përfundimit të procedurës së certifikimit.

Neni 18
Koalicionet

18.1. Koalicioni mund të certifikohet për të garuar në zgjedhje nën një emër, me kusht që përbëhet vetëm nga partitë politike që kanë të drejtë për t'u certifikuar sipas nenit 15.4 të këtij ligji.
18.2. KQZ-ja e trajton koalicionin si një subjekt politik të vetëm nga dita kur koalicioni është certifikuar nga ajo e deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve. Partia politike nuk mund të tërhiqet nga koalicioni pasi që të jetë certifikuar, derisa rezultatet e zgjedhjeve të certifikohen.
18.3. Pas shpërbërjes së koalicionit, secila nga partitë politike të regjistruara të cilat kanë qenë anëtare të koalicionit janë përgjegjëse për një ndarje të të gjitha borxheve të shkaktuara nga koalicioni në përpjesëtim me marrëveshjen për koalicionin, përfshirë gjobat e papaguara të ngarkuara nga KQZ-ja apo KZAP-i.
18.4. Partia politike që është anëtare e koalicionit nuk mund të marrë pjesë si anëtare në një koalicion tjetër apo si parti politike e veçantë në të njëjtat zgjedhje.

Neni 19
Nisma qytetare

19.1. KQZ–ja e trajton nismën qytetare si subjekt politik nga dita e certifikimit të saj deri sa nisma qytetare të dorëzojë raportin përfundimtar të Publikimit Financiar të Fushatës sipas nenit 40.2 (b) të këtij ligji.
19.2. Secili kandidat i certifikuar i listës së nismës qytetare është personalisht përgjegjës për ndarje të barabartë të gjobave të ngarkuara mbi nismën qytetare nga KQZ-ja apo KZAP-i.

Neni 20
Kandidatët e Pavarur

20.1. Kandidati i pavarur mund të certifikohet për pjesëmarrje në zgjedhje, me kusht që ai ose ajo ka të drejtë të jetë kandidat sipas nenit 29 dhe është i/e regjistruar për të votuar.
20.2. Kandidati pavarur nuk mund, që në të njëjtat zgjedhje, të kërkojë certifikim si kandidat për një parti politike, koalicion apo nismë qytetare.
20.3. Një kandidat i pavarur nuk mund të tërheqë kandidaturën e tij apo saj para certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

Neni 21
Emrat Identik apo të Ngjashëm

21.1. KQZ–ja nuk e certifikon subjektin politik me emër apo akronim që është i njëjtë si, apo sipas gjykimit të KQZ-së, është i ngatërrueshëm, mashtrues ose i ngjashëm me, emrin apo akronimin me të cilin një subjekt tjetër politik është certifikuar më herët.

21.2. Nëse dy apo më shumë subjekte politike aplikojnë për certifikim me emra apo akronime që janë të njëjta, apo aq të ngjashme sa që me siguri se do të shkaktojnë ngatërrim apo çorientojnë votuesit, KQZ–ja vendos se cili subjekt ka të drejtën për t'u certifikuar me emrin dhe akronimin. Në vendimin se cili subjekt politik ka të drejtën për t'u certifikuar nën cilin emër dhe akronim, KQZ–ja ka parasysh datën kur secili subjekt ka dorëzuar aplikimin e tij në KQZ dhe përdorimin paraprak të emrave dhe akronimeve.

21.3. Për qëllim të këtij neni, koalicioni konsiderohet të jetë një subjekt politik tjetër nga një palë zgjedhje në tjerat në të ardhmen përveç nëse anëtarësia përfshinë të gjitha partitë politike që më parë kanë qenë pjesë e koalicionit.

21.4. Asgjë në këtë nen nuk e pamundëson certifikimin e kandidatëve të pavarur me emrin ligjor të tij apo saj. Në rast se emrat janë të njëjtë, KQZ-ja mund të përfshijë informata për të bërë dallimin e tyre dhe për t'i ikur ngatërrimit në fletëvotim.

Neni 22
Nënshkrimet

22.1. Si pjesë e shqyrtimit sipas nenit 16.1 të këtij ligji, Zyra e rishikon secilën broshurë me nënshkrime të dorëzuar në mbështetje të aplikimit për certifikim për të siguruar se nënshkrimet janë të vlefshme.

22.2. Në vërtetimin e nënshkrimeve të mbështetjes, Zyra e rishikon secilën broshurë të nënshkrimeve të dorëzuar nga aplikuesit siç përcaktohet me rregullat e KQZ-së.

22.3. Llojet e nënshkrimeve në vijim konsiderohen si të pavlefshme dhe nuk llogariten ndaj kërkesës së nënshkrimeve:

a) nënshkrimet e personave të cilët nuk janë votues të regjistruar;
b) nënshkrimet e mbështetjes për të cilat çfarëdo informate e kërkuar mungon apo është e pa lexueshme;
c) nënshkrimet të cilat janë me të njëjtin dorëshkrim si nënshkrimet tjera, përfshirë nënshkrimet nga udhëheqësi i familjes për anëtarët e tjerë të familjes; dhe
d) nënshkrimet të cilat përfshijnë informata të cilat nuk përputhen me informatat e regjistruara në variantin më të fundit të listës së votuesve.

Neni 23
Pagesa për Certifikim

Pagesat për certifikim vendosen ashtu siç përcaktohet me rregullat e KQZ-së.

Neni 24
Renditja në Fletëvotim

24.1. Shorti i fletëvotimit mbahet në një datë të caktuar nga KQZ-ja.
24.2. Kryesuesi i KQZ-së vendos për procedurat që duhen respektuar gjatë tërheqjes së shortit, duke siguruar se tërheqja është e drejtë dhe transparente. Kryesuesi i KQZ-së e kryeson tërheqjen e shortit.
24.3. Zyra i njofton subjektet politike për vendndodhjen, datën, dhe kohën në të cilën shorti i fletëvotimit do të mbahet. Secili subjekt politik dërgon një përfaqësues për të tërhequr shortin dhe vëzhguar mbajtjen e shortit të fletëvotimit. Kryesuesi i KQZ-së e kryeson lotarinë e fletëvotimit dhe nëse subjekti politik nuk e dërgon përfaqësuesin në shortin e fletëvotimit, një anëtar i Sekretariatit të KQZ-së e tërheq shortin për atë subjekt.

KREU IV
CERTIFIKIMI I KANDIDATËVE

Neni 25
Dispozitat e Përgjithshme

25.1. Një subjekt politik, koalicion i subjekteve politike, ose nismë qytetare që ka aplikuar për certifikim për pjesëmarrje në zgjedhje i dorëzon Zyrës me kohë dhe në mënyrën e përcaktuar sipas rregullave të KQZ-së listën e kandidatëve.
25.2. KQZ-ja e tërheq vendimin për certifikimin e subjektit politik, nismës qytetare ose koalicionit të certifikuar në rast të dështimit të dorëzimit të listës së kandidatëve në Zyre në periudhën kohore të përcaktuar nga KQZ-ja.

Neni 26
Shqyrtimi i Listës së Kandidatëve

26.1. Zyra i bën një rekomandim të shkruar KQZ-së për ose kundër certifikimit të secilës listë të kandidatëve të pranuar jo më vonë se pesë (5) ditë pune pas afatit për dorëzim të listave.
26.2. Zyra i shqyrton të gjitha listat e kandidatëve dhe, në rast të përfundimit se subjekti politik i është përgjigjur kërkesave të Kapitullit III dhe IV të këtij ligji, atëherë i rekomandon KQZ-së certifikimin e listës brenda dhjetë (10) ditëve pas pranimit të listës.
26.3. Nëse Zyra vendos që lista e kandidatëve nuk përmbush dispozitën e mësipërme, në atë rast e njofton subjektin politik në fjalë që të korrigjojë listën e kandidatëve në periudhën brenda pesë (5) ditëve të punës, duke dhënë arsyetimin/et/ se përse lista e tyre duhet korrigjuar.
26.4. Subjekti politik i cili e pranon njoftimin e përcaktuar sipas paragrafit 3 të këtij neni i ka tre (3) ditë pune pas pranimit të njoftimit për të dorëzuar aplikimin e korrigjuar ose një arsyetim që adreson shqetësimet në çështjet e identifikuara në njoftim, ose të dyja bashkë.

26.5. Zyra i paraqet rekomandimin me shkrim KQZ-së për ose kundër certifikimit të listës së kandidatëve brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas dorëzimit të njoftimit sipas nenit 26.3.
26.6. Ankesa e cilitdo subjekt politik ndaj vendimit të KQZ–së për të refuzuar certifikimin e listës së kandidatëve tek KZAP-i bëhet brenda afatit prej pesë (5) ditë pune pas njoftimit të atij subjekti politik me vendimin.

Neni 27
Kuotat Gjinore

27.1. Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30 %) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30 %) për qind janë femra; me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë.
27.2. Kjo dispozitë nuk aplikohet te listat e përbëra nga një apo dy kandidatë.

Neni 28
Tërheqja apo Zëvendësimi i Kandidatëve dhe Subjekteve Politike

28.1. Subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar KQZ-së një njoftim me shkrim me të cilin shpreh qartazi qëllimin për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit për zgjedhje, të përcaktuar sipas nenit 24.1 të këtij ligji.
28.2. Në rast se KZAP-i largon një kandidat nga lista e kandidatëve pas përcaktimit se kandidati nuk ka dhënë pëlqimin e tij apo saj për t'u emëruar si kandidat, subjekti politik nuk mund të zëvendësojë atë kandidat në listën e kandidatëve, por siguron që lista të jetë në përputhje me nenin 27 të këtij ligji.
28.3. Duke mos paragjykuar dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni, një subjekt politik, nismë qytetare apo koalicion mund që katër (4) ditë pas largimit të kandidatit, ta zëvendësojë atë nëse ai kandidat në të njëjtën kohë paraqitet në listën e kandidatëve të një tjetër subjekti politik, nisme qytetare ose koalicioni dhe shfaq synim të qartë me shkrim se do të mbetet në listën e subjektit tjetër politik.
28.4. Në rast të vdekjes së kandidatit para mbajtjes së zgjedhjeve, një subjekt politik, nismë qytetare apo koalicion mund të zëvendësojë kandidatin e vdekur brenda një date të caktuar nga KQZ-ja.
28.5. Të gjitha kërkesat për të tërhequr një kandidat të ceritikuar nga zgjedhjet i dorëzohen KQZ-së.

Neni 29
Përshtatshmëria/Aftësia e Kandidatit

29.1. 29.1 Cilido person emri i të cilit paraqitet në Listën e Votuesve është i aftë për certifikim si kandidat përveç nëse ai apo ajo është:
a) gjykatës apo prokuror në Kosovë ose gjetkë;
b) pjesëtar i Forcës së Sigurisë së Kosovës;
c) pjesëtar i Policisë së Kosovës;

d) pjesëtar i Shërbimit Doganor të Kosovës;
e) pjesëtar i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;
f) kryesues i një agjencie të pavarur;
g) përfaqësues diplomatik;
h) kryesues apo anëtar i KQZ-së;
i) pjesëtar i KZAP-it;
j) anëtar i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve;
k) pjesëtar i forcave të armatosura të ndonjë shteti;
l) pjesëtar i ndonjë force policore apo të një trupi të ngjashëm;
m) duke vuajtur dënimin e shqiptuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë;
n) nën akuzë nga Tribunali dhe ka dështuar të veprojë në përputhje me urdhrin për t'u paraqitur para Tribunalit;
o) me anë të vendimit të gjykatës, përfshirë edhe vendimin e KZAP-it i është hequr e drejta për të qenë kandidat;
p) me anë të vendimit të gjykatës, i është hequr e drejta për të qenë kandidat;
q) i shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit;
r) ka dështuar të paguajë gjobën e vënë nga KZAP-i apo KQZ-ja; ose
s) ka dështuar t'i përmbahet ndonjë urdhëri të KZAP-it.

29.2. Numri i emrave të dorëzuar të kandidatëve nuk mund të jetë më shumë se dhjetë për qind (10 %) e maksimumit të numrit të ulëseve të caktuara.

29.3. Në rast të paraqitjes së më shumë kandidatëve sesa maksimumi i caktuar, KQZ-ja e redukton listën e kandidatëve deri në numrin që është në pajtim me dispozitat e këtij neni.

29.4. Nëse kandidati i cili është certifikuar nga KQZ-ja është apo ka arritur statusin sipas të cilit ai apo ajo humb aftësinë për të qenë kandidat sipas dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, ai person decertifikohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe largohet nga lista e kandidatëve të subjektit politik në fjalë.

29.5. Asnjë person i zgjedhur anëtar i një organi tjetër legjislativ, nuk mund të ketë ulëse në Kuvendin e Kosovës. Anëtari i Kuvendit i cili pas marrjes së ulëses së tij apo saj në Kuvend është apo bëhet anëtar i një trupi tjetër të zgjedhur legjislativ, humb mandatin e tij apo saj në Kuvend.

29.6. Një punëtor publik i cili përpiqet të fitojë një ulëse në Kuvend duhet të marrë pushim të lejuar mungese me efekt nga data e fillimit të periudhës së fushatës.

29.7. KQZ-ja i publikon listat e certifikuara të kandidatëve në afat brenda pesë (5) ditëve pas certifikimit dhe secilin ndryshim në të brenda pesë (5) ditëve tjera shtesë.

29.8. Kandidati nuk mund të garojë për pozitë në më shumë se një listë kandidatësh të një subjekti politik, koalicioni, nisme qytetare, apo të garojë si kandidat i pavarur në të njëjtën kohë.

29.9. Paraqitja e qëllimshme e të dhënave të pavërteta që lidhen me paragrafin 1 ose 5 të këtij neni konsiderohen shkelje të dënueshme në pajtim me rregullat e KZAP-it.

Neni 30
Ruajtja dhe Verifikimi i të Dhënave të Kandidatëve

30.1. Sekretariati i KQZ-së, në përputhje me këtë ligj dhe rregullat e KQZ-së, do të mbajë në konfidencë të gjitha informacionet rreth kandidatëve të dorëzuara tek KQZ-ja, deri pas certifikimit të kandidatit nga ana e KQZ-së, përveç rasteve kur Sekretariati i KQZ-së do t'u ofrojë të gjitha agjencive për zbatimin e ligjit secilin informacion të nevojshëm për këto organizata me qëllim të sigurisë gjatë procesit të zgjedhjeve.
30.2. Pasi kandidati të jetë certifikuar, KQZ-ja mund të publikojë të dhënat personale të atij personi vetëm siç lejohet me ligjin e aplikueshëm.
30.3. Në rast se KQZ-ja nuk certifikon një kandidat, Sekretariati i KQZ-së nuk i zbulon të dhënat personale të atij kandidati.

KREU V
KODI I MIRËSJELLJES PËR SUBJEKTET POLITIKE, MBËSHTETËSIT E TYRE DHE KANDIDATËT

Neni 31
Qëllimi i Kodit të Sjelljes

Kodi i Sjelljes për subjektet politike dhe mbështetësit e tyre dhe kandidatët ka për qëllim krijimin e kushteve në të cilat populli i Kosovës mund të zgjedhë përfaqësuesit e tij përmes zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të mirë-informuara në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Neni 32
Përgjegjësitë e Subjekteve Politike, Mbështetësve të tyre dhe Kandidatëve

32.1. Këtij Kodi i detyrohen të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre.
32.2. KZAP-i ka autoritet ligjor të marrë vendim në pretendimet se janë shkelur dispozitat e këtij Kodi si dhe të shpallë sanksione dhe kompensime në përputhje me procedurat e saj.
32.3. Subjektet politike informojnë në mënyrë të duhur anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre rreth dispozitave të këtij Kodi.
32.4. Subjektet politike ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të parandaluar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre nga shkelja e këtij Kodi.
32.5. Subjektet politike mbahen përgjegjëse për shkeljet e këtij Kodi të kryera nga anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre.
32.6. Subjekti politik mund të paraqesë prova pranë KZAP-it që tregojnë se ka bërë përpjekje serioze për të parandaluar dhe/ose dekurajuar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tij nga shkelja e këtij Kodi. Këto dëshmi mund të përdoren në përcaktimin e duhur të masave të mëtejshme dhe mund të përfshijë dëshmi se:
    a) Subjekti politik ka informuar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tij për dispozitat e këtij Kodi dhe nevojat për të zbatuar dispozitat e tij;

b) Subjekti politik dhe kandidatët e tij publikisht janë shprehur për dënimin e dhunës, kërcënimeve me dhunë, apo frikësim gjatë procesit zgjedhor;
c) Subjekti politik në mënyrë publike dhe aktive ka bërë qortimin e anëtarëve, mbështetësve dhe kandidatëve të tij për çdo shkelje të ligjeve të aplikueshme që kanë të bëjnë me zgjedhjet;
d) Subjekti politik nuk ka nxitur, shtytur apo përkrahur anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tij në shkeljen e Rregullave të Zgjedhjeve në ndonjë rast të veçantë apo në raste tjera; dhe
e) Çdo provë tjetër në lidhje me përpjekjet e subjektit politik për të parandaluar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tij nga shkelja e Rregullave të Zgjedhjeve.

32.7. Secili kandidat nënshkruan një deklaratë me të cilën konfirmohet se ai ose ajo do i bindet të gjitha ligjeve të aplikueshme dhe mbështet zbatimin e plotë të rezultateve zgjedhore të certifikuara.

Neni 33
Veprimet e Ndaluara të Subjekteve Politike

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërës si në vijim:

a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;
b) vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve;
c) mbajtja ose ekspozimi i armëve të secilit lloj gjatë tubimeve politike ose gjatë çfarëdo lloj ngjarjeje që ka lidhje me aktivitetet e subjekteve politike. Mbajtja e armëve nga personat e tjerë gjatë tubimeve politike/manifestimeve lejohet vetëm në rast se personat që mbajnë armë të tilla janë të autorizuar për një gjë të tillë nga autoritetet përkatëse dhe që Policia e Kosovës është njoftuar paraprakisht se të tilla armë do të mbahen në tubimet e caktuara;
d) çrregullimi i tubimeve të subjekteve tjera politike ose nxitja e të tjerëve për një veprim të tillë;
e) pengimi ose tentimi për pengimin e gazetarëve për të përmbushur detyrat e tyre profesionale;
f) premtimi i ndonjë shpërblimi financiar me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve;
g) kërcënimi ose tentimi për të kërcënuar subjektet tjera politike, përkrahësit ose kandidatët e tyre;
h) nxitja e cilitdo person për të votuar në zgjedhje, i cili nuk ka të drejtë vote;
i) nxitja e personit për të votuar më shumë se një herë në të njëjtat zgjedhje ose të votojë në emër të një personi tjetër;

j) abuzimi me të drejtën e ankesës, ose duke bërë ankesa ose paraqitje të rrejshme, të pavlera dhe irrituese në KZAP;
k) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë; ose
l) për qëllime të promovimit të subjektit politik ose kandidatëve të tij duke përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali i cili i referohet personit i cili:
   (i) është në vuajtje të dënimit të shqiptuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë; ose
   (ii) ka padi të ngritur nga Tribunali dhe i cili nuk i është përmbajtur urdhrit për t'u paraqitur para Tribunalit.

Neni 34
Frikësimi dhe Dhuna Gjatë Procesit Zgjedhor

34.1. Përdorimi ose kërcënimi me përdorim të dhunës së çfarëdo lloji nga subjekti politik, anëtarët, mbështetësit ose kandidatët e tyre, ndalohet rreptësisht.
34.2. Asnjë subjekt politik ose kandidatët nuk inkurajojnë, mbështesin ose miratojnë dhunën, kërcënimet me dhunë ose kanosje, gjatë procesit zgjedhor. Secili subjekt politik i informon anëtarët dhe mbështetësit e tij për nevojën për të shmangur një sjellje të tillë.
34.3. Fushata zgjedhore organizohet në atë mënyrë që një atmosferë e pëlqyeshme dhe paqësore të mbizotërojë gjatë fushatës zgjedhore.

Neni 35
Veprimet e Ndaluara Nga Shërbyesit Publik

35.1. Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, qoftë të nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonjë ndërmarrjeje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale, nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje.
35.2. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore asnjë subjekt politik nuk inkurajon ose përfiton nga shërbyesi publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik.

Neni 36
Veprimet e Ndaluara Para Procesit të Votimit

36.1. Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të

tyre u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë:

a) shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërën nga Qendrat e Votimit, ose 100 metra brenda hapësirës së të njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi tek votuesit;
b) bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Neni 37
Pranimi i Rezultateve të Zgjedhjeve

Të gjitha subjektet politike, mbështetësit dhe kandidatët e tyre, obligohen t'u përmbahen rezultateve të zgjedhjeve si dhe të mbështesin zbatimin e plotë të rezultateve zgjedhore të certifikuara.

Neni 38
Sanksionimi për Shkeljet e Parimeve të këtij Kodi

38.1. Shkelja e njërit nga këto nene të Kodit të Sjelljes të paraqitur në këtë Kapitull, në rastet kur këto shkelje nuk kanë ndikuar në rezultatet e zgjedhjeve, konsiderohet shkelje administrative dhe e dënueshme me gjobë sikurse është përcaktuar nga KZAP-i.
38.2. Shuma e gjobës përcaktohet në bazë të nenit 146 të këtij ligji.
38.3. Shkeljet e Kodit të Sjelljes të përcaktuara nga KZAP-i të cilat kanë tentuar të ndikojnë rezultatet e zgjedhjeve paraqesin vepër penale sipas Kodit Penal të Kosovës.

KREU VI
KUFIZIMI I SHPENZIMEVE TË FUSHATËS DHE DEKLARIMI FINANCIAR

Neni 39
Kufizimi i Shpenzimeve të Fushatës dhe Kontributet

39.1. Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të bëjë tejkalime në shpenzime të fushatës mbi shumën që do të caktohet nga rregulla e KQZ-së jo më vonë se (5) ditë pas ditës së shpalljes së zgjedhjeve.
39.2. KQZ-ja përcakton maksimumin e shpenzimeve të fushatës mbështetur në numrin e përgjithshëm të votuesve të regjistruar në listën e votuesve në kohën e freskimit të fundit të listës së votuesve në dispozicion të KQZ-së.
39.3. Shpenzimet maksimale për fushatë zbatohen për çdo mall dhe shërbim të shpenzuar për qëllime të fushatës pa marrë parasysh kohën e blerjes apo të pajisjes me shërbime.
39.4. Subjekti politik nuk pranon çfarëdo kontributi, përveç në mënyrën e rregulluar me legjislacionin në fuqi.

Neni 40
Kërkesat për Deklarim Financiar

40.1. Çdo subjekt politik i certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje, dorëzon Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës së Subjektit, duke i përfshirë të gjitha degët dhe pjesët përbërëse të tij, për periudhën që fillon nëntëdhjetë (90) ditë para zgjedhjeve dhe me mbarim në ditën e zgjedhjeve. Raporti i Publikimit Financiar për Fushatën dorëzohet jo më vonë se dyzetë e pesë (45) ditë kalendarike pas ditës së zgjedhjeve.

40.2. Secili Raport i Publikimit Financiar të Fushatës, i secilit subjekt politik, duke i përfshirë të gjitha degët e tyre dhe pjesët përbërëse, përfshinë publikimin komplet dhe të saktë të:
   a) të ardhurave të subjektit politik për periudhën raportuese, përfshirë burimin dhe datën e të gjitha kontributeve me para të gatshme;
   b) të gjitha shpenzimet, përfshirë shpenzimet e fushatës, të bëra nga subjekti gjatë periudhës raportuese; dhe
   c) një fletë bilanci që i paraqet pasuritë, detyrimet dhe barazimin e subjektit prej ditës së parë deri te dita e fundit e periudhës së raportimit.

40.3. Subjektet politike i sigurojnë Zyrës kopjet e dëftesave për secilën pagesë administrative të paguar.

40.4. Zyra do i raporton KQZ-së për secilën pagesë administrative të mbledhur dhe të transferuar në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

40.5. Nëse një subjekt politik nuk e dorëzon Raportin e Publikimit Financiar të Fushatës deri në afatin përfundimtar ose, nëse e dorëzon raport jo të plotë ose të pasaktë, Zyra mund t'ia paraqesë ankesën KZAP-it në pajtim me procedurat e atij organi.

40.6. Secili subjekt politik i certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje i mban dhe ruan në arkivat e tyre, për një periudhë shtatë (7) vjeçare, shënimet e sakta dhe të detajuara të gjendjes financiare të subjektit dhe të gjitha degëve për periudhën e mbuluar me Raportet e Publikimit Financiar të Fushatës, përfshirë:
   a) librat e mbajtjes së llogarive me shënime, në pajtueshmëri me parimet llogaritëse të pranuara në përgjithësi:
      (i) të gjitha të ardhurat sipas burimit, shumës, duke e identifikuar mënyrën se si është kryer pagesa (d.m.th., para të gatshme, çek, draft bankier, etj.); dhe
      (ii) të gjitha pagesat të cilat i ka kryer subjekti ndaj personit tjetër, qëllimi i pagesës dhe mënyra se si është kryer pagesa;
   b) dëftesat për të gjitha shpenzimet që tejkalojnë shumën prej njëqind euro (100 €);
   c) shënimet bankiere për të gjitha llogaritë të cilat i mban subjekti politik ose që janë në emër të tij;
   d) dokumentet të cilat e ndërtojnë bazën ligjore për pronësi ose posedim të tërë pasurisë së patundshme të subjektit politik;
   e) kontratat, partner i të cilave është subjekti, përfshirë kontratat lidhur me qiranë ose blerjen e pasurisë së tundshme apo të patundshme;
   f) një regjistrim i të gjitha kontributeve të subjektit, pa marrë parasysh se kur

janë bërë, përfshirë:
(i) vlerën e secilit kontribut;
(ii) datën kur secili kontribut është dhënë;
(iii) emrin e plotë, adresën dhe Regjistrimin Civil, numrin e pasaportës ose të lejes së vozitjes të secilit kontribuues; dhe
(iv) emrin e plotë të personit i cili e ka pranuar kontributin në emër të subjektit.

40.7. Të gjithë zyrtarët për financa ndjekin një trajnim për llogaritjen dhe auditimin, të organizuar nga Zyra menjëherë pas emërimit të tyre, nëse ata nuk i ofrojnë Zyrës një shkallë të pranueshme të ekspertizës dhe përvojës që tregon se një trajnim i tillë nuk është i domosdoshëm.

Neni 41
Auditimi

41.1. Për qëllime të këtij neni, me "Auditor për Fushatë" nënkuptohet organizata e cila është e ngarkuar nga Zyra me detyrë specifike të auditojë shpenzimet e fushatës.

41.2. Zyra auditon cilindo Raport të Publikimit Financiar të Fushatës apo Formular të Publikimit Financiar të Kandidatit.

41.3. Shfrytëzimi i një auditori të jashtëm, si auditor fushate, është çështje e vendimit të KQZ-së.

41.4. Të gjitha subjektet politike bashkëpunojnë plotësisht me Auditorin e Fushatës dhe i ofrojnë auditorëve qasje të plotë e pa pengesa në regjistrat financiar të subjektit, përfshirë pa kufizim, të gjithë regjistrat të cilët i referohen paragrafit 3 të këtij neni.

41.5. Auditori i Fushatës ia paraqet rezultatet paraprake të auditimit, përfshirë listën e të gjitha gabimeve ose lëshimeve të dukshme, organit më të lartë ekzekutiv të subjektit politik brenda katërdhjetepesë (45) ditëve prej fillimit të auditimit dhe jo më vonë se katër (4) muaj pas zgjedhjeve.

41.6. Subjekti politik mundet, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës prej ditës kur i ka pranuar rezultatet paraprake, të paraqesë raport të korrigjuar financiar dhe një sqarim që i adreson gabimet ose lëshimet e mundshme të identifikuara nga Auditori i Fushatës.

41.7. Auditori i Fushatës ia dorëzon raportin përfundimtar të auditimit KQZ-së dhe organit më të lartë ekzekutiv të subjektit politik jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë të punës nga dita e dorëzimit të raportit paraprak të auditimit sipas nenit 46.5 të këtij ligji. Raporti përfundimtar identifikon çdo gabim ose lëshim të raportit financiar, duke pasur parasysh çdo sqarim dhe inspektim të paraqitur në paragrafin 5 të këtij neni.

41.8. Asnjë nga dispozitat e këtij ligji nuk e parandalon Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës ose ndonjë institucion relevant nga auditimi i shpenzimeve të subjekteve politike në çdo kohë, përfshirë edhe shpenzimet e fushatës.

Neni 42
Sanksionet

42.1. KQZ-ja mund ta ngarkojë subjektin politik, i cili e bënë Publikimin e Raportit Financiar të Fushatës pas afatit përfundimtar, me pagesa administrative në pajtim me rregullat. KQZ-ja i transferon të gjitha pagesat administrative në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

42.2. Ngarkimi i ndonjë gjobe ose sanksionimi tjetër nga KQZ-ja nuk paragjykon ndonjë sanksionim penal që mund të jetë i aplikueshëm.

42.3. Subjekti politik mund ta apelojë në gjykatën e shkallës së parë vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili e përcakton gjobën sipas këtij neni brenda (5) ditëve të punës pas njoftimit mbi vendimin.

42.4. Gjykata e shkallës së parë nuk shqipton sanksione lidhur me çështjen e cila është subjekt i pagesës administrative të paragrafit 1 të këtij neni.

42.5. Subjektet politike ia paraqesin Zyrës një kopje të dëshmisë së pagesës së tarifës administrative të cilën e kanë paguar.

Neni 43
Informimi Publik

43.1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke vepruar përmes Zyrës, krijon dhe ruan një Dosje të Informimit Publik e cila përmban kopjet e fundit si më poshtë:

a) Regjistrin e Donatorëve i cili tregon:
   (i) emrin e plotë dhe Regjistrimin Civil, numrin e pasaportës apo lejes së vozitjes për secilin person i cili ka kontribuar për subjektin politik, vlerën e kombinuar e cila i tejkalon njëqind euro (100 €) për çdo vit kalendarik;
   (ii) identitetin e subjektit politik i cili e bënë pranimin;
   (iii) vlerën e kontributit; dhe
   (iv) datat në të cilat është dhënë kontributi;
b) kopjet e të gjitha Raporteve të Publikimit Financiar të Fushatës, të dorëzuara tek Zyra;
c) kopjet e të gjithë Formularëve të Publikimit Financiar për Kandidatë për kandidatët e certifikuar që janë dorëzuar në Zyrë; dhe
d) kopjet e raporteve përfundimtare të kandidatëve të certifikuar lidhur me auditimin e bërë nga Zyra.

43.2. Zyra harton përbërjen e Dosjes së Informimit Publik e cila do i vihet në dispozicion për shikim anëtarëve të publikut në një lokacion qendror i cili caktohet nga Zyra gjatë orarit të rregullt të punës, në faqen elektronike të KQZ-së si dhe në vende e kohë tjera siç mund të urdhërohen nga KQZ-ja.

KREU VII
FUSHATA E ZGJEDHJEVE DHE NJOFTIMI PËR NGJARJET POLITIKE

Neni 44
Dispozitat e Përgjithshme

44.1. Sipas kushteve të saktësuara më lartë në Kodin e Sjelljes, gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, subjektet politike kanë të drejtë:
   a) të organizojnë dhe mbajnë tubime/ngjarje politike, tryeza të rrumbullakëta, konferenca për shtyp, fjalime, ose ndonjë aktivitet tjetër të ngjashëm, përmes të cilave ata mund t'i shprehin lirisht mendimet e tyre me qëllim të fitimit të përkrahjes nga votuesit e tyre;
   b) të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore; dhe
   c) të bëjnë fushatë përmes cilitdo operator televiziv, të radios apo kabllor, gjithashtu edhe përmes revistave, shtypit, rrjetit telefonik, sistemit postar ose çdo lloj mjeti tjetër reklamues, në pajtim me rregullat e KQZ-së dhe ligjet tjera në fuqi.

44.2. Mosmarrëveshjet në lidhje me mbajtjen e ndonjë ngjarje politike në vendet publike mund të shqyrtohen dhe zgjidhen nga Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Raportet e policisë në lidhje me trazirat në ndonjë ngjarje politike i vihen në dispozicion Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa dhe KQZ-së.

Neni 45
Pjesëtarët e Armatosur të Njësisë për Mbrojtje nga Afërsia në Tubimet Politike

Anëtarët e njësisë për mbrojtje nga afërsia, të autorizuar nga autoriteti i ligjit në fuqi për bartjen e armëve, të cilët janë në detyrë, identifikohen paraprakisht në çdo tubim dhe pas kërkesës së zyrtarit të pranishëm të SHPK-së. Të gjitha armët që mbahen duhet të mbahen të fshehura.

Neni 46
Sanksionet

Përveç përgjegjësisë individuale për cenimin e cilësdo dispozitë të këtij Kapitulli, që është e ndëshkueshme me Kodin Penal të Kosovës, cenimet gjithashtu mund t'i referohen Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa mund t'i shqiptojë sanksione subjektit politik që ka shkelur këtë dispozitë të këtij Kapitulli.

KREU VIII
MEDIAT GJATË FUSHATËS SË ZGJEDHJEVE

Neni 47
Dispozitat e Përgjithshme

47.1. Kodi i Sjelljes për Mediat Transmetuese dhe Kodi i Sjelljes (KS) për Mediat e Shkruara, siç janë nxjerrë nga Komisioni i Pavarur për Media, zbatohet ndaj të gjitha aspekteve të prezantimit të fushatës dhe transmetimit të reklamave. Ky Kod i Sjelljes zbatohet për të gjithë gazetarët, redaktorët, udhëheqësit e transmetimit dhe botuesit.

47.2. Të gjitha mediat transmetuese publike emetojnë pa pagesë material për edukimin e votuesve, ashtu siç kërkohet dhe u sigurohet nga KQZ-ja.

47.3. Gazetarët, redaktorët, udhëheqësit e transmetimeve, botuesit dhe pronarët e mediave që kandidohen në zgjedhje për një post publik, nuk kontribuojnë ose përndryshe ndikojnë në përmbajtjen e mediave të tyre përkatëse.

47.4. Të gjitha mediat pranojnë reklamimin me pagesë në gjuhën(t) në të cilën ato normalisht transmetojnë ose publikojnë.

47.5. Publikimi ose përfshirja në transmetim të hulumtimeve të opinionit dhe të anketave gjatë periudhës së fushatës dhe që kanë të bëjnë me zgjedhjet përcillet me numrin e gjithëmbarshëm të respondentëve, emrin e kompanisë realizuese, emrin e partisë përgjegjëse për atë hulumtim, dhe margjinën e gabimit.

Neni 48
Qasja e Drejtë dhe e Paanshme nga Mediat gjatë Fushatës së Zgjedhjeve

Të gjitha mediat sigurojnë se të gjitha subjektet politike të certifikuara përfaqësohen në mënyrë të drejtë dhe të paanshme në emisionet gjatë fushatës së zgjedhjeve, dhe të gjitha mediat transmetuese u sigurojnë të gjitha subjekteve politike të certifikuara qasje të drejtë dhe të paanshme në programet me diskutime politike dhe debate.

Neni 49
Rregullat e Përgjithshme për Reklamim Politik në Radio dhe Televizion

49.1. Pikat reklamuese politike nuk janë më të gjata se dy (2) minuta (120 sekonda).

49.2. Nga transmetuesit të cilët vendosin të emetojnë reklamim politik me pagesë kërkohet që gjatë periudhës së fushatës t'i ofrojnë një sasi minimale minutash të kohës për emetim pa pagesë secilit subjekt politik të certifikuar:
   a) 20 minuta për transmetues televiziv privat që transmetojnë në tërë Kosovën;
   b) 40 minuta për Transmetuesin Televiziv të Shërbimit Publik;
   c) 15 minuta për secilin radio stacion privat që transmeton në tërë Kosovën;
   d) 30 minuta për secilin nga kanalet e dy radiove publike;
   e) 15 minuta për të gjitha stacionet tjera televizive;
   f) 10 minuta për të gjitha radio stacionet tjera.

49.3. Kjo kohë e emetimit pa pagesë mund të sigurohet sipas vlerësimit të transmetuesve individual, në formë të pjesëmarrjes në debate, programe

diskutimi, intervista jashtë programeve të rregullta informative të parapara, ose si pika reklamuese politike pa pagesë.

49.4. Përfshirja në programet e rregullta informative të parapara nuk llogaritet si kohë emetimi pa pagesë.

49.5. Në kuadër të programeve informative nuk emetohet asnjë pikë reklamuese politik. Për qëllim të këtij neni, programet informative përkufizohen si programe që përfshijnë komponentët e sportit dhe të motit në transmetimet e lajmeve.

49.6. Transmetuesit përkujdesen që çdo pikë reklamuese politike të identifikohet qartë si e tillë dhe të tregojë qartë organizatën ose individin përgjegjës për të.

49.7. Nga transmetuesit kërkohet të mbajnë ditarë të veçantë ditorë, të siguruar nga KPM-ja, për qasjet e siguruara pa pagesë dhe kohët për reklamim që i janë shitur çdo subjekti politik të certifikuar. Këta ditarë përgatiten dhe i dorëzohen KPM-së për çdo javë në përputhje me udhëzimet e dhëna. Pasi të merren, ditarët janë të hapur për t'u shikuar nga publiku.

49.8. Transmetuesit të cilët zgjedhin të transmetojnë reklama të paguara politike ofrojnë, një javë para fillimit të periudhës së fushatës, një orar me shkrim të kohëve të paanshme dhe të drejta të emetimit pa pagesë për pikat reklamuese politike për të gjitha subjektet politike të certifikuara.

49.9. Transmetuesit nuk ndëshkohen nëse një subjekt politik i certifikuar nuk e shfrytëzon kohën e ofruar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

49.10. Koha e gjithëmbarshme e pikave reklamuese politike të emetuara pa pagesë në një transmetues është më së shumti 20 minuta për një subjekt politik të certifikuar.

49.11. Transmetuesit që vendosin të transmetojnë reklamimet politike me pagesë, por që gjatë rrjedhës së periudhës së fushatës nuk ofrojnë minimumin e kohëve të kërkuara për emetim pa pagesë për subjektet politike të certifikuara konsiderohet se e kanë shkelur këtë ligj.

49.12. Nga transmetuesit privat të cilët vendosin të mos transmetojnë reklamim politik me pagesë për asnjë subjekt politik të certifikuar, nuk kërkohet të ofrojnë minimumin e kohës së emetimit pa pagesë, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni.

49.13. Transmetuesit privat të cilët vendosin të mos emetojnë reklamime politike me pagesë, por që ofrojnë kohë për emetim pa pagesë për cilindo subjekt politik të certifikuar, duhet që kohë të ngjashme për emetim pa pagesë t'u sigurojnë të gjitha subjekteve politike të certifikuara.

49.14. Çmimi për një sekondë me të cilin ngarkohen për pika reklamuese politike me pagesë nuk është më i lartë sesa shkalla më e ulët e ngarkuar për atë kohë dhe ditë të javës gjatë gjashtë (6) muajve të fundit.

Neni 50
Reklamimi Politik me Pagesë në Mediat e Shkruara

50.1. Mediat e shkruara u sigurojnë qasje të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjekteve politike të certifikuara që kërkojnë hapësirë reklamuese.

50.2. Një medium i shkruar aplikon çmime të njëjta pa diskriminim ndaj të gjitha subjekteve politike të certifikuara.

50.3. Çdo reklamim politik me pagesë e tregon organizatën ose individin përgjegjës për të.
50.4. Hapësira për reklamim pa pagesë, e siguruar për subjektin politik të certifikuar, identifikohet qartë si e tillë. Hapësira e ngjashme pa pagesë u sigurohet menjëherë të gjitha subjekteve politike të tjera të certifikuara që e kërkojnë këtë.
50.5. Mediat e shkruara i ngarkojnë subjektet politike të certifikuara me norma të reklamimit që nuk janë më të larta se normat më të ulëta të reklamimit të publikuara zyrtarisht dhe të ofruara për të gjithë reklamuesit e tjerë për hapësirë dhe numër të ngjashëm të rreshtave në faqe, e që janë në përdorim tridhjetë (30) ditë para periudhës së fushatës.

Neni 51
Rregullimi i Regjimit dhe Procedurat e Ankimit

51.1. Të gjitha ankesat përkitazi me shkeljen e këtij Kapitulli nga subjektet politike i përcillen Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP), ndërsa shkeljet nga mediat i referohen Komisionit të Pavarur për Media (KPM) në pajtim me dispozitat e Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave.
51.2. Të gjitha ankesat të cilat pretendojnë shkeljen e këtij Kapitulli përcillen nga KZAP-i për shqyrtim dhe vendosje nga KPM-ja.
51.3. Cenimi i detyrave dhe përgjegjësive të mediave, siç është shpallur në këtë Kapitull, mund të përfundojë me sanksione nga KPM-ja.
51.4. KZAP-i e ka autoritetin t'u shqiptojë sanksione subjekteve politike të certifikuara lidhur me shkeljen e këtij Kapitulli në pajtim me dispozitat e Kapitullit XX. Shkeljet tjera të këtij neni i referohen KZAP-it.

Neni 52
Ndalimi i Përfshirjes në Media

52.1. Asnjë person ose medium nuk transmeton ose publikon çfarëdo materiali që i takon aktivitetit të fushatës gjatë periudhës që fillon njëzetekatër (24) orë para hapjes së vendvotimeve deri në mbylljen zyrtare të vendvotimeve.
52.2. Në Kosovë nuk bëhet asnjë publikim ose transmetim i rezultateve të hulumtimit të opinionit publik që ka të bëjë me fushatën e zgjedhjeve, duke përshirë daljen në votime, gjatë periudhës që fillon 24 orë para mbylljes zyrtare të vendvotimeve dhe deri në përmbylljen e procesit zgjedhor.

Neni 53
Mirëmbajta e Ditarit të Mbulimit të Mediave

Komisioni i Pavarur për Media siguron se mediat mirëmbajnë një ditar për të regjistruar kohën e emetimit, dhe ekspozimeve tjera të mediave, për reklamim me pagesë dhe pa pagesë, të aktiviteteve të fushatës për secilën parti. Ditari i vlerëson të gjithë treguesit relevant të ekspozimeve, ndaras për secilin subjekt politik, sipas mënyrës së përcaktuar me rregullat e KPM-së.

KREU IX
VËZHGUESIT E ZGJEDHJEVE

Neni 54
Dispozitat e Përgjithshme

54.1. Subjektet politike të certifikuara, OJQ-të dhe organizatat qeveritare e ndër-qeveritare, sikurse edhe organizatat ndërkombëtare të specializuara të cilat merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe përfaqësuesit e vendeve të huaja, kanë të drejtë të kërkojnë akreditim të vëzhguesve për zgjedhje.

54.2. Një person nuk mund të jetë vëzhgues vendor nëse ai/ajo nuk i përmbushë kriteret e së drejtës për të votuar në zgjedhje.

54.3. Kërkesën për akreditim të vëzhguesve çdo organizatë mund ta parashtrojë pranë KQZ-së në çdo kohë deri në ditën e njëzetepesë (25) para Ditës së Zgjedhjeve.

54.4. Kërkesat për akreditim për vëzhgimin e Ditës së Zgjedhjeve mund të parashtrohen vetëm nga organizatat, në çfarëdo kohe njëzet (20) ditë para Ditës së Zgjedhjeve.

54.5. Akreditimi i individëve për vëzhgim të zgjedhjeve në emër të ndonjë organizate duhet të parashtrohet në KQZ jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para Ditës së Zgjedhjeve.

54.6. KQZ-ja e miraton ose e refuzon kërkesën jo më vonë se dhjetë (10) ditë pas parashtrimit të saj.

54.7. Çdo individ ose organizatë që ka aplikuar për certifikim për vëzhgues të procesit zgjedhor e që i është mohuar akreditimi nga KQZ-ja, mund të parashtrojë ankesë në KZAP për rishqyrtim të vendimit në pajtim me procedurat e KZAP-it.

54.8. KQZ-ja mund të anulojë akreditimin e një vëzhguesi të procesit zgjedhor që i ka cenuar ligjet në fuqi, Rregulloret, Urdhëresat Administrative, Rregullat e Zgjedhjeve ose Procedurat Administrative lidhur me procesin zgjedhor.

Neni 55
Kualifikimi i Vëzhguesve

55.1. Të gjithë vëzhguesit e akredituar, përveç atyre të emëruar nga ndonjë organizatë ndërqeveritare, qeveri e huaj ose OJQ-të jo të regjistruar në Kosovë, janë persona të regjistruar për votim në zgjedhje.

55.2. Asnjë person nuk mund të shërbejë si vëzhgues zgjedhor nëse është:
   a) kandidat për post zgjedhor në Kosovë; ose
   b) pjesëtar i policisë, ushtarak oso i njësitit të inteligjencës së Kosovës ose i një shteti tjetër.

55.3. Organizata e akredituar për vëzhgim e shënon emrin e plotë, adresën dhe numrin e telefonit për kontaktim për secilin vëzhgues të saj dhe informatat e tilla i vë në dispozicion menjëherë pas kërkesës së KQZ-së ose të Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

55.4. Përgjegjësia për të raportuar çdo papajtueshmëri të përshkruar më lartë, bie mbi secilin vëzhgues të emëruar dhe mbi organizatën që e parashtron kërkesën për

akreditim të vëzhgimit të procesit zgjedhor. Nëse zbulohet se vëzhguesi mban ndonjërën nga pozitat e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, KQZ-ja e tërheq akreditimin e vëzhguesit.

Neni 56
Të Drejtat dhe Detyrat e Vëzhguesve

56.1. Vëzhguesi ka të drejtë të:
   a) vëzhgojë, pa u penguar, përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve, përfshirë takimet pas ditës së zgjedhjeve, dëgjimet dhe aktivitetet lidhur me zgjedhjet, ankesat dhe parashtresat lidhur me rezultatet e zgjedhjeve dhe përcaktimin e kandidatëve fitues;
   b) parashtrojë komente me shkrim komisioneve zgjedhore dhe këshillave të vendvotimeve;
   c) vëzhgojë paketimin, transferimin, dorëzimin, trajtimin, numërimin, ruajtjen e sigurt dhe shkatërrimin e fletëvotimeve;
   d) pajiset me kopjet e vendimeve, protokollet, tabelat, procesverbalet dhe dokumentacionin tjetër gjatë gjithë procesit zgjedhor, përfshirë proceset para dhe pas ditës së zgjedhjeve; dhe

56.2. Gjatë procesit zgjedhor, përfshirë edhe procesin e regjistrimit të votuesve, vëzhguesi i akredituar mund të parashtrojë ankesë për çfarëdo shkelje të Rregulloreve në fuqi, Urdhëresave Administrative, Rregullave Zgjedhore ose Procedurave Administrative pranë KQZ-së në pajtim me procedurat e saj.

56.3. Vëzhguesi ka për detyrë të:
   a) respektojë kërkesat e këtij ligji dhe rregullat e KQZ-së;
   b) mbajë distinktivin e identitetit të vëzhguesit në mënyrë të dukshme kur është i angazhuar në aktivitete të vëzhgimit;
   c) përmbahet nga bartja e shenjave dalluese të cilat shërbejnë si mjete propaganduese ose që mund të ndikojnë në dëshirën e votuesit ose e identifikon atë me një parti të caktuar politike ose kandidat; dhe
   d) përmbahet nga shkelja e të drejtës së votuesit për fshehtësi të fletëvotimit dhe nga pengimi i procesit të të votuarit dhe administrimit të zgjedhjeve.

56.4. Një organizatë e akredituar vëzhguese mund të dërgojë një vëzhgues në takimet e KQZ-së dhe KKZ-së.

Neni 57
Paanshmëria dhe Neutraliteti

57.1. Vëzhguesit zgjedhorë janë të paanshëm dhe politikisht neutral gjatë vëzhgimit të procesit zgjedhor.

57.2. Vëzhguesit zgjedhorë në asnjë mënyrë nuk ndërhyjnë në mbajtjen e zgjedhjeve dhe e respektojnë fshehtësinë e votimit.

57.3. Numri i vëzhguesve nga po e njëjta organizatë që mund të jenë të pranishëm në të njëjtën kohë në vendvotim, në qendër të numërimit, në qendër për informim të votuesve, nuk mund të kalojë mbi dy (2).

57.4. Gjatë vëzhgimit të procesit zgjedhor, vëzhguesit e akredituar i tregojnë simbolet

e akreditimit në mënyrë të dukshme dhe i mbajnë dokumentet e nevojshme sipas Rregullave Zgjedhore që i kërkon KQZ-ja.

Neni 58
Akreditimi i Organizatave Vëzhguese

KQZ-ja krijon rregulla për organizatat vëzhguese dhe vëzhguesit.

KREU X
KQZ

Neni 59
KQZ

59.1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (këtu e tutje "KQZ") i themeluar në pajtim me nenin 139 të Kushtetutës, është një organ i përhershëm dhe i pavarur në kuptim të këtij ligji.
59.2. KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji.
59.3. Gjatë zbatimit të mandatit të vet KQZ-ja, inter alia:
   a) ndërmerr aktivitete për edukimin e votuesve të përgatitura për ngritjen e vetëdijesimit të votuesit për, dhe pjesëmarrjen në zgjedhje;
   b) ndërmerr projekte ose kërkime lidhur me sistemin zgjedhor dhe çështjet lidhur me të;
   c) krijon procedura të përshtatshme dhe ndërmerr aktivitete për të garantuar se të gjithë personat me aftësi të kufizuara mund ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votimit dhe të marrin pjesë tërësisht në procesin zgjedhor në Kosovë; dhe
   d) kryen çdo funksion tjetër ndihmës për mbajtjen e zgjedhjeve në Kosovë që i përcaktohet me Rregulloret relevante dhe instrumentet ndihmëse, përfshirë veprimet e domosdoshme për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor në rast shfaqjeje të një force madhore.
59.4. Selia e KQZ-së ndodhet në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë.
59.5. Komisioni mund të lidhë marrëveshje teknike dhe mirëkuptimi të cilat mund të kërkohen për funksionimin dhe përgjegjësinë e tij.
59.6. KQZ-ja krijon dhe mban një llogari të ndarë bankare në emër të KQZ-së, që përdorët vetëm për grumbullimin dhe kthimin e depozitave siç kërkohet me ligj.
59.7. KQZ-ja i konsideron konfidenciale të gjitha të dhënat personale të mbledhura për kandidatët dhe votuesit, përveç asaj që kërkohet me këtë ligj, dhe i ndërmerr të gjitha masat për ruajtjen e këtyre të dhënave, përveç kur kërkohen nergut nga agjencitë e zbatimit të ligjit.

Neni 60
Përbërja e Komisionit dhe Pagesa

KQZ-ja përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë në pajtim me Kushtetutën.

Neni 61
Mandati dhe Emërimi i Anëtarëve të KQZ-së

61.1. Kryesuesi i KQZ-së emërohet në pajtueshmëri me nenin 139(3) të Kushtetutës së Kosovës.

61.2. Mandati i Kryetarit të KQZ-së është shtatë (7) vjet duke filluar nga data e caktuar për njoftim të emërimit nga Presidenti i Kosovës.

61.3. Neni 139 (4) i Kushtetutës së Kosovës parasheh se caktimi i anëtarëve të KQZ-së duhet të bëhet sipas procedurave në vijim:

a) Brenda dhjetë (10) ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, grupet parlamentare me të drejtë të caktimit të anëtarit(ve) në KQZ e njoftojnë Presidentin e Kosovës për nominimin e tyre. Pas sigurimit se individi i caktuar nga grupi parlamentar i përshtatet kërkesave të këtij ligji, Presidenti i Kosovës, brenda pesë (5) ditëve e konfirmon me shkrim emërimin. Emërimi hyn në fuqi në ditën e shënuar në emërimin zyrtar nga Presidenti i Kosovës;

b) Kryesuesi i KQZ-së nuk shërben në më shumë se dy (2) mandate të njëpasnjëshme;

c) Anëtarët e KQZ-së nuk shërbejnë në më shumë se tri (3) mandate të njëpasnjëshme;

d) Përfundimi i mandatit bëhet në ditën e fundit të muajit kalendarik, në të njëjtin muaj në të cilin ka filluar mandati;

e) Pavarësisht nga pika (d) e këtij paragrafi mandati që përfundon nëntëdhjetë (90) ditë ose më pak para zgjedhjeve ose deri 90 ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, automatikisht zgjatet për 90 ditë pas certifikimit të rezultateve zgjedhore.

61.4. Mandati i anëtarëve të KQZ-së fillon jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve për Kuvend.

61.5. Mandati i Kryesuesit të KQZ-së apo cilitdo anëtarë të KQZ-së mund të ndërpritet përmes dorëheqjes ose nga Presidenti i Kosovës me efekt të menjëhershëm, në rrethanat e mëposhtme:

a) Anëtari dështon në plotësimin e kushteve dhe kritereve që dalin nga ky ligj;

b) Anëtari nuk merr pjesë, pa ndonjë arsyetim të arsyeshëm, në tri mbledhje të njëpasnjëshme të KQZ-së dhe ndërprerja e mandatit miratohet nga dy të tretat (2/3) e votave të shumicës së KQZ-së;

c) Anëtari është i dënuar për vepër penale;

d) Anëtari sillet ose vepron në atë mënyrë që e dëmton seriozisht statusin dhe integritetin e KQZ-së;

e) Anëtari nuk është në gjendje t'i kryej detyrat e veta për më shumë se gjashtë muaj me radhë.

61.6. Nëse mandati ndërpritet nga Presidenti i Kosovës, emërimi i ri bëhet në pajtim me këtë nen. Emërimi i ri për zëvendësim bëhet në pajtim me procedurat e këtij neni dhe anëtari i ri shërben vetëm për kohëzgjatjen e mandatit të mbetur të anëtarit të zëvendësuar por do të jetë subjekt i riemërimit në pajtim me këtë nen.

61.7. Anëtari i KQZ-së duhet të ketë përvojë pune prej jo më pak se pesë (5) vite dhe diplomë universiteti në lëmin e drejtësisë, administratës publike, shkencave politike, të drejtave të njeriut, matematikë, administrim të zgjedhjeve, shkenca

sociale, marrëdhënie publike ose në statistikë.

61.8. Personi nuk ka të drejtë të jetë anëtar i KQZ-së nëse është:
   a) deputet i Kuvendit të Kosovës;
   b) këshilltar i ndonjë kuvendi komunal në Kosovë;
   c) kandidat për ndonjë post të zgjedhur publik në Kosovë;
   d) deputet përfaqësues i ndonjë kuvendi të zgjedhur publikisht jashtë Kosovës;
   e) zotërues i një posti të lartë publik ose i një posti të lartë në parti politike;
   f) anëtar i komisionit publik zgjedhor brenda ose jashtë Kosovës;
   g) anëtar i Trupave Mbrojtëse të Kosovës;
   h) pjesëtar i ndonjë force policore ose ndonjë organi të ngjashëm;
   i) person pa të drejtë vote në Kosovë;
   j) person që është duke e vuajtur dënimin e shqiptuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ose person që është paditur nga Tribunali dhe nuk e ka respektuar urdhrin që të paraqitet para tribunalit;
   k) anëtar i organizatës jo-qeveritare që i monitoron zgjedhjet;
   l) është dënuar për një krim të kryer me vendim përfundimtar gjyqësor;
   m) ka qenë pjesëtar i shërbimit të inteligjencës apo sigurisë në Kosovë ose jashtë saj gjatë pesë (5) viteve të fundit; dhe
   n) është larguar nga puna nga administrata publike për shkelje të ligjit.

61.9. Nëse një grup parlamentar ose komunitet nuk e cakton personin që do të jetë anëtar i KQZ-së brenda njëzetenjë (21) ditëve prej kohës kur kërkohet që ta bëjë këtë, Presidenti ka liri veprimi që të zgjedhë dhe emërojë një person të përshtatshëm për ta plotësuar postin e lirë, me person nga kategoria e përshkruar me Kushtetutë.

61.10. Nëse Presidenti mendon që një i emëruar nuk është i përshtatshëm të jetë anëtar i KQZ-së sipas këtij ligji, ai mban konsultime me, dhe kërkon nga organizata emëruese që të nominojë një kandidat të ri. Nëse organizata emëruese në fjalë nuk e cakton një person të përshtatshëm për të qenë anëtar i KQZ-së brenda katërmbëdhjetë (14) ditëve prej kërkesës së tillë, Presidenti ka liri veprimi që ta zgjedhë dhe emërojë një person të përshtatshëm për ta plotësuar postin e lirë.

Neni 62
Betimi dhe Emërimi

62.1. Presidenti i lëshon një shkresë emërimi secilit anëtar të KQZ-së, të cilët paraqiten personalisht para Presidentit ose përfaqësuesit të tij të caktuar në datën e shpallur nga Presidenti për ta dhënë deklaratën vijuese në gjuhën të cilën ai ose ajo e zgjedh vetë: "Deklaroj solemnisht se do t'i kryejë detyrat e mia si anëtar i KQZ-së në mënyrë të ndershme, besnike, të paanshme, profesionale dhe të ndërgjegjshme."

62.2. Nëse personi i emëruar si anëtar i KQZ-së pa arsye nuk e jep betimin në pajtim me nenin 67.1, Presidenti kërkon nga autoritetet që e kanë caktuar atë person që ta caktojnë një person tjetër. Nëse autoritetet nuk e caktojnë një person të pranueshëm për të qenë anëtar i KQZ-së brenda katërmbëdhjetë (14) ditëve prej kohës kur bëhet një kërkesë e tillë, Presidenti ka liri veprimi ta zgjedhë dhe emërojë një person të pranueshëm për ta plotësuar postin e lirë.

Neni 63
Marrja e Vendimeve

63.1. Takimet e KQZ-së i thërret Kryesuesi ose së paku katër (4) anëtarë. Njoftimi për takim përfshinë edhe agjendën e takimit.
63.2. Përgjatë periudhës së fushatës dhe deri pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, KQZ-ja mban takime sipas orarit të paracaktuar dhe publikuar.
63.3. Takimet e KQZ-së vlejnë vetëm nëse në to marrin pjesë jo më pak se shtatë (7) anëtarë të KQZ-së.
63.4. Për Rregullat Zgjedhore, regjistrimin e partive politike dhe certifikimin e partive politike, shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve, si dhe për vendimet lidhur me ankesat që kanë të bëjnë me shpalljen e rezultateve, KQZ-ja provon të vendosë me konsensus, e kur kjo është e pamundur, atëherë vendoset me dy të tretat (2/3) e votave. Çdo vendim tjetër merret me shumicën e thjeshtë të votave.
63.5. Takimet i kryeson Kryesuesi i KQZ-së.
63.6. Vendimi i Komisionit nuk i nënshtrohet ankesës, përveç nëse nuk parashihet qartë me këtë ligj.
63.7. KQZ-ja i krijon rregullat e punës në pajtim me këtë ligj.
63.8. Anëtari nuk merr pjesë në marrjen e vendimit nga KQZ-ja lidhur me çështjen në të cilën ai ose ajo ose anëtari i tij ose i saj i familjes ka interes të natyrës personale ose financiare, e që mund ta vë në dyshim aftësinë e anëtarit për të vepruar në mënyrë të paanshme.
63.9. Takimet e KQZ-së janë të hapura për publikun, përveç kur diskutohet për çështje lidhur me personelin e KQZ-së dhe SKQZ-së.
63.10. KQZ-ja i përgatit Kuvendit të Kosovës një raport vjetor dhe atë në muajin prill. Raporti përmban informata lidhur me aktivitetet e KQZ-së dhe rekomandimet që KQZ-ja i sheh si të përshtatshme që të trajtohen në Kuvend.
63.11. Të gjitha vendimet e KQZ-së janë dokumente publike.

Neni 64
Përgjegjësitë dhe Funksionet e KQZ-së

64.1. KQZ-ja është përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji.
64.2. KQZ-ja i:
a) përgatitë dhe shpallë rregullat, format dhe procedurat zgjedhore që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji dhe me çdo çështje tjetër që ka të bëjë me drejtimin e zgjedhjeve në kuadër të kompetencës së saj;
b) publikon të gjitha rregullat e miratuara, rregullat, udhëzimet dhe procedurat zgjedhore dhe i bën ato të arritshme për opinionin;
c) krijon dhe mban listën e personave që kanë të dejtë të votojnë në zgjedhje të veçanta;
d) mban Zyrën për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikimin e Partive Politike në mënyrën e paraparë me këtë ligj;
e) përpilon dhe miraton fletëvotimet dhe materialet tjera zgjedhore;
f) akreditonvëzhguesit zyrtarë të zgjedhjeve;
g) certifikon listën votuese lidhur me zgjedhjet;

h) certifikon rezultatet e zgjedhjeve;
i) publikon rezultatet e zgjedhjeve;
j) themelon komisionet komunale të zgjedhjeve dhe këshillat e vendvotimeve;
k) cakton ekipet e numërimit për çdo këshill të vendvotimit për aq sa garantojnë rrethanat.

Neni 65
Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

65.1. Në kryerjen e përgjegjësive dhe funksioneve të tij, Komisionit i ndihmon Sekretariati (këtu e tutje: "Sekretariati i KQZ-së") i cili vepron në pajtim me këtë ligj.
65.2. Zyra e ngarkuar me përgjegjësi rreth Regjistrimit të Partive Politike funksionon si pjesë e Sekretariatit të KQZ-së. Sekretariati KQZ-së i zbaton vendimet e KQZ-së, përgatitë raporte, rekomandime për vendime të KQZ-së dhe siguron ndihmë tjetër të nevojshme administrative për KQZ-në. Sekretariati, gjithashtu, e asiston KQZ-në në zbatimin e funksioneve dhe përgjegjësive të cilat i janë caktuar në pajtueshmëri me këtë ligj, dhe me instrumentet ndihmëse të përmendura më poshtë.
65.3. Pas miratimit nga KQZ-ja, Sekretariati lidhë marrëveshje me palën e tretë, në emër të KQZ-së duke u mbështetur në procedurat e themeluara nga KQZ-ja.

Neni 66
Menaxhimi i Sekretariatit të KQZ-së

66.1. Sekretariati drejtohet nga Kryeshefi Ekzekutiv (këtu e tutje: "KE"), dhe Zëvendësi i Kryeshefit Ekzekutiv (këtu e tutje: "Zëvendësi i KE-së"). KE-ja i përgjigjet drejtpërdrejt KQZ-së.
66.2. Koha e qëndrimit në post për KE-në, zëvendësin e KE-së dhe Drejtorin Ekzekutiv të Zyrës është në pajtim me Ligjin për Shërbyes Civil dhe mund të zgjatet. KQZ-ja mund ta largojë KE-në, zëvendësin e KE-së ose Drejtorin Ekzekutiv të Zyrës në çdo kohë në pajtim me procedurat në fuqi.
66.3. Asnjë person nuk mund të shërbejë si KE, Zëvendës i KE-së të Sekretariatit ose si Drejtor Ekzekutiv i Zyrës nëse ai/ajo:
a) mban ose kërkon post publik;
b) mban ndonjë post publik ose pozitë zyrtare në parti politike; ose
c) është dënuar për vepër penale.
66.4. Kryeshefi Ekzekutiv ose Zëvendësi i Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të KQZ-së merr pjesë në të gjitha takimet e KQZ-së.
66.5. KE-ja është përgjegjës për:
a) organizimin e agjendës së takimeve të KQZ-së nën udhëheqjen e Kryesuesit dhe sigurimin e tërë materialit të nevojshëm para çdo takimi;
b) raportim në KQZ për të gjitha detyrat e SKQZ-së, me përjashtim të Drejtorit Ekzekutiv të Zyrës;
c) administrimin dhe udhëheqjen e gjithëmbarshme të Sekretariatit dhe sigurimin për zbatimin e të gjitha funksioneve të besuara;

d) sigurimin e udhëzimeve të duhura për KQZ-në, dhe këshillave të paanshme e të kualifikuara nga Sekretariati;
e) organizimin e Sekretariatit dhe nxjerrjen e procedurave administrative lidhur me çështjet të cilat i përkasin;
f) menaxhimin efektiv dhe efikas të burimeve njerëzore dhe financiare të Sekretariatit; dhe
g) zbatimin e politikave jo-diskriminuese ndaj personelit të Sekretariatit, përfshirë përfaqësimin e drejtë gjinor në të gjitha fushat dhe nivelet dhe garantimin që përbërja e stafit të Sekretariatit e reflekton karakterin shumetnik të Kosovës.

66.6. KE-ja cakton një zyrtar të autorizuar financiar të Sekretariatit dhe garanton pajtueshmëri me vendime të tilla, udhëzime administrative dhe rregulla financiare të cilat mund të nxirren në lidhje me këtë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ose autoritetet tjera të përshtatshme.

66.7. Stafi i Sekretariatit përzgjidhet dhe punësohet nga KE-ja e SKQZ-së në pajtim me procedurat e Qeverisë së Kosovës.

66.8. KQZ-ja ka një shumë të caktuar vjetore nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për t'i mbuluar shpenzimet e funksionimit të duhur të Sekretariatit, të mbështetur në propozimin buxhetor të KQZ-së. KQZ-ja i përgatitë kërkesë për buxhet të veçantë Qeverisë së Kosovës për çdo vit zgjedhor.

66.9. Anëtarët e komisionit zgjedhor dhe të punësuarit në administratën publike në shërbim të këtyre komisioneve, japin përgjegjësi penale dhe administrative sipas legjislacionit në fuqi, nëse i shkelin dispozitat e këtij Kodi.

KREU XI
KOMISIONET KOMUNALE TË ZGJEDHJEVE

Neni 67
Përbërja e KKZ-ve dhe Kualifikimi i Anëtarëve

67.1. Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) në përgjithësi ka shtatë (7) anëtarë, ky numër mund të rritet nëse numri i subjekteve politike që kualifikohen për të qenë pjesë e komisionit është më i madh. Secili Komision Komunal i Zgjedhjeve është i përbërë nga:
a) Zyrtari Ekzekutiv i KKZ-së i punësuar nga KQZ-ja dhe i cili do të jetë kryesues i KKZ-së; dhe
b) nga një anëtar i nominuar nga subjektet politike që kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet nacionale, nëse i nënshtrohen pragut zgjedhor;

67.2. Anëtarët e KKZ-së janë persona me të drejtë vote në komunë dhe me qëndrime të larta profesionale e morale, me përvojë administrative ose zgjedhore dhe njohuri të mjaftueshme që i mundëson KKZ-së të kryejë me efektivitet detyrën e vet.

67.3. KQZ-ja duhet të përpiqet ta garantojë përfaqësimin e drejtë në KKZ për të gjitha komunitetet, me numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune.

67.4. KQZ-ja emëron KKZ-të brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas shpalljes së zgjedhjeve. Emërimet përfundojnë 15 ditë pas certifikimit të rezultateve të

zgjedhjeve, përveç nëse mandati i KKZ-së ndërpritet para përfundimit të afatit ose zgjatet.

67.5. Asnjë person nuk mund të caktohet të shërbejë si anëtar i KKZ-së, ose të vazhdojë të shërbejë pasi që është caktuar, po qe se ai/ajo:
   a) është kandidat për ndonjë post të zgjedhur publik;
   b) është zotërues i një posti të lartë publik;
   c) nuk ka të drejtë të qëndrojë si kandidat në zgjedhje;
   d) është zotërues i një posti të lartë publik ose i një posti të lartë në partinë politike të certifikuar;
   e) është shpallur mendërisht i paaftë me vendim përfundimtar gjyqësor; ose
   f) paraprakisht ka qenë i anuluar nga anëtarësia në KKZ nga KQZ-ja; ose
   g) i është ndaluar shërbimi në cilësinë e anëtarit të KKZ-së nga Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

67.6. Asnjë person nuk mund të shërbej, në të njëjtën kohë, në më shumë se në një KKZ.

67.7. Anëtari i Administratës Komunale i caktuar të shërbejë si anëtar i Komisionit Komunal Zgjedhor shërben me respekt ndaj detyrave të tij/saj si anëtar i Komisionit Komunal Zgjedhor, nën autoritetin e KQZ-së dhe Zyrtarit Ekzekutiv të KKZ-së gjatë periudhës derisa është i emëruar.

67.8. Emërimi i një anëtari të KKZ-së i nënshtrohet betimit dhe nënshkrimit të Kodit të Sjelljes së KQZ-së të miratuar nga KQZ-ja, para fillimit të punës.

67.9. Pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KKZ-së të cilët nuk i përmbushin kushtet sipas këtij neni.

Neni 68
Përgjegjësitë e Komisionit Komunal Zgjedhor

68.1. Të gjitha KKZ-të i administrojnë zgjedhjet përbrenda komunës, nën mbikëqyrjen ekskluzive dhe udhëzimet e KQZ-së që vepron përmes Sekretariatit, duke garantuar ligjshmëri, legjitimitet dhe efikasitet të procesit zgjedhor. Pa e kufizuar parimin e përgjithshëm të përgjegjësive të tyre, secili nga KKZ duhet të:
   a) themelojë një zyrë brenda godinës së administratës komunale për kryerjen e detyrave të veta;
   b) sigurojë informata të gjithë votuesve, për të gjitha komunitetet dhe të përhapë informata të nevojshme për administrimin e zgjedhjeve;
   c) sigurojë informata të paanshme për partitë politike, nismat qytetare, koalicionet dhe kandidatët e pavarur lidhur me të drejtat dhe obligimet e tyre ndaj zgjedhjeve;
   d) merr pjesë në çfarëdo seance trajnimi të kërkuar nga KQZ-ja;
   e) ndihmojë në caktimin dhe trajnimin e cilitdo person i cili ndihmon në administrimin e zgjedhjeve përfshirë edhe këshillave të vendvotimeve;
   f) ndihmojë marrëveshjet teknike në Vendvotime dhe çdo përgatitje tjetër teknike për zgjedhje përfshirë pranimin e të gjithë materialit jo të ndjeshëm;
   g) sigurojë mbajtjen e përshtatshme të votimit dhe të numërimit dhe

përmbledhjen e rezultateve të zgjedhjeve brenda juridiksionit të tyre;
h) grumbullojë dhe ruajë materiale zgjedhore pas zgjedhjeve; dhe
i) kryejë detyra tjera të cilat kërkohen nga legjislacioni në fuqi ose Rregullat e KQZ-së.

68.2. Secili ZKZ i dërgon raporte Sekretariatit të KQZ-së, çdo javë, lidhur me punën e KKZ-ve siç është e caktuar nga SKQZ-ja. Nëse Sekretariati i KQZ-së kërkon nga një ZKZ të shkruajë raport të menjëhershëm, ai duhet ta bëjë atë. ZKZ kryen detyra tjera të caktuara nga KQZ-ja.

68.3. Komisioni Komunal Zgjedhor mban shënime të rregullta për punën, përfshirë procesverbalet e mbledhjeve, vendimet e bëra, dhe raportet javore të KQZ-së dhe informatat tjera relevante.

Neni 69
Procesi i Emërimit

69.1. Sekretariati i KQZ-së ia siguron KQZ-së listën e kandidatëve për secilin KKZ. Secila nga listat mund të përfshijë emrat e disave, të gjithëve ose të asnjërit nga të punësuarit në Administratën komunale të propozuar nga Zyrtari Ekzekutiv i Administratës Komunale, me liri veprimi të Sekretariatit të KQZ-së.

69.2. SKQZ-ja mund t'i konsultojë organizatat joqeveritare, institucionet akademike dhe organizmat tjerë të ngjashëm me qëllim të identifikimit të kandidatëve të kualifikuar dhe të përshtatshëm.

69.3. Kur KQZ-ja refuzon një person të nominuar, ajo duhet të njoftojë ZKZ-në përkatëse lidhur me refuzimin dhe të kërkojë nga ai/ajo të paraqesë një kandidat tjetër. ZKZ-ja ka në dispozicion dhjetë (10) ditë për të propozuar kandidatin tjetër dhe KQZ-ja vendos për kandidatin tjetër pa u vonuar.

69.4. Çdo person ose persona tjerë të cilët Sekretariati i KQZ-së i konsideron të përshtatshëm për anëtarësim në KKZ, duke i kushtuar kujdes të veçantë kërkesës për përfaqësim të drejtë gjinor dhe etnik.

69.5. Sekretariati i KQZ-së i lëshon Certifikatë të Emërimit secilit anëtarë të KKZ-së.

69.6. Anëtarët e emëruar në Komisione Komunale Zgjedhore e fillojnë punën e tyre menjëherë pas emërimit nga KQZ-ja.

Neni 70
Përfundimi i Anëtarësisë në KKZ

70.1. KQZ-ja mund ta revokojë në çdo kohë emërimin e secilit anëtar të KKZ-së nëse anëtari:
a) nuk i kryen detyrat e tij/saj sipas rregullave të KQZ-së;
b) vepron në mënyrë të anshme dhe joprofesionale;
c) nuk merr pjesë në dy takime të njëpasnjëshme të KKZ-së pa ndonjë arsye të bazuar;
d) merr pjesë në një fushatë zgjedhore në emër të një subjekti politik ose ndërhyn në procesin zgjedhor;
e) nuk lajmërohet në punë dy (2) ditë me radhë gjatë fushatës zgjedhore pa ndonjë arsye të bazuar.

70.2. Anëtari i KKZ-së, të cilit iu ka revokuar emërimi, menjëherë e ndërprenë përfshirjen në punët e KKZ-së dhe ia kthen Shefit Ekzekutiv të KKZ-së pajisjet e KKZ-së.

Neni 71
Kompensimi i Anëtarëve të KKZ-së

71.1. Anëtarët e KKZ-ve dhe Kryesuesi paguhen për kryerjen e detyrave të tyre nga burimet e KQZ-së në pajtim me rregullat e miratuara për këtë qëllim.
71.2. Anëtarët e KKZ-së aktualisht të punësuar në Administratën Komunale marrin shpërblime që janë të barabarta me gjysmën e pagës së tyre të dhënë nga komuna, si shtesë e pagës së tyre të zakonshme, në vend të kompensimit për punë jashtë orarit të tyre. Anëtarët e tjerë të KKZ-ve, përveç ZKZ-së, nuk punësohen me orar të plotë jashtë periudhës zgjedhore.

Neni 72
Procesi i Vendimmarrjes

72.1. Komisioni Komunal i Zgjedhjeve i merr vendimet me shumicën e të gjithë anëtarëve të pranishëm.
72.2. Asnjë nga anëtarët e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve nuk merr pjesë në vendimin lidhur me çështjet për të cilat një anëtar i familjes së tij/saj mund të ketë interes personal, financiar ose të natyrës tjetër, ose që mund të sjellë dyshime rreth aftësisë së tij për veprim të paanshëm.

Neni 73
Qasja në Takimet dhe Dokumentacionin e Komisionit Komunal Zgjedhor

Një vëzhgues i akredituar ka qasje në të gjitha takimet dhe në dokumentacionin e KKZ-së. Nëse Komisioni Komunal i Zgjedhjeve nuk e lejon pjesëmarrjen në takim ose qasjen në një dokument, mund të parashtrohet ankesë në KQZ. KQZ-ja merr një vendim lidhur me ankesën brenda dyzetetetë (48) orëve dhe ndërmerr veprime të duhura, ti cilat ajo i konsideron të përshtatshme.

KREU XII
KËSHILLAT E VENDVOTIMEVE

Neni 74
Dispozitat e Përgjithshme

74.1. Përbërja e Këshillit të Vendvotimit reflekton strukturën e anëtarëve të KKZ-së. Komisioni Komunal i Zgjedhjeve mundet, në raste të veçanta, ta shtojë numrin e anëtarëve në Këshillin e Vendvotimit dhe për këtë menjëherë ta njoftojë KQZ-në.
74.2. Duke u mbështetur në vendimin e KQZ-së, mund të formohet një KVV i dytë përgjegjës për numërimin e rezultateve.

74.3. Të gjithë personat e emëruar si anëtarë të Këshillave të Vendvotimit (KVV) duhet t'i plotësojnë kriteret për emërim të saktësuara në këtë ligj.
74.4. Secili Komision Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) i paraqet SKQZ-së propozimet e atyre personave të cilët i plotësojnë kriteret relevante të emërimit. SKQZ-ja ia paraqet listën e siguruar nga KKZ-ja, KQZ-së për miratim, së bashku me rekomandimet ose vërejtjet.
74.5. KQZ-ja e shqyrton listën e paraqitur me persona nga Sekretariati i KQZ-së dhe vendosë me shumicën e thjeshtë që t'i emërojë ose jo personat e paraqitur, varësisht prej rastit.
74.6. Çdo anëtar i KVV-ve i cili nuk merr pjesë në trajnime të organizuara nga KKZ-ja pa ndonjë arsye të bazuar parandalohet të punojë Ditën e Zgjedhjeve dhe e humbë të drejtën mbi një pjesë ose tërë pagesën, siç vendoset nga KQZ-ja.
74.7. Çdo anëtar i KVV-së i cili nuk është i pranishëm në vendvotim ku është caktuar të ndodhet në Ditën e Zgjedhjeve e humbë të drejtën për pagesë dhe zëvendësohet menjëherë nga KKZ-ja me një anëtar rezervë të trajnuar dhe të emëruar.
74.8. Në kohën e emërimit, çdo anëtar i KVV-së e nënshkruan Kodin e Sjelljes, siç parashihet nga KQZ-ja.
74.9. Çdo anëtar i KVV-së, pavarësisht nga përkatësia e partisë politike ose pikëpamja politike, vepron në mënyrë të paanshme në shërbim të gjithë votuesve.
74.10. KVV-ja është përgjegjëse për sigurimin e integritetit, sigurisë dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në Vendvotim nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë nga KKZ-ja.

Neni 75
Kualifikimi dhe Kriteret e Emërimit të Anëtarëve të KVV-ve dhe Kryesuesit

75.1. Për t'u emëruar anëtar në KVV, një person duhet:
a) të jetë votues i regjistruar në të njëjtën komunë ku ndodhet Vendvotimi/Qendra e Votimit;
b) të ketë aftësi të lexojë dhe shkruajë në gjuhën e cila zyrtarisht përdoret në atë komunë.
75.2. Për t'u emëruar Kryesues i KVV-së, personi duhet të caktohet anëtar i KVV-së në pajtim me dispozitat e këtij neni dhe si shtesë duhet të ketë të përfunduar së paku shkollimin e mesëm; dhe
75.3. Asnjë person nuk mund të shërbejë si anëtar i KVV-së nëse ai/ajo është:
a) kandidat për funksion të zgjedhur në Kosovë;
b) anëtar i cilitdo Kuvend në Kosovë dhe jashtë saj;
c) anëtar i ndonjë KKZ-je, SKQZ-je ose KQZ-je;
d) pjesëtar i Shërbimit Policor të Kosovës, i ndonjë force policore ose pjesëtar i Trupave Mbrojtëse të Kosovës ose pjesëtar i ndonjë shërbimi tjetër ushtarak, të sigurisë ose inteligjencës;
e) shpallur i paaftë mendërisht me një vendim përfundimtar gjyqësor; ose
f) është shpallur fajtor për vepër penale gjatë tri (3) viteve të shkuara me një vendim përfundimtar gjyqësor.

Neni 76
Metoda e Përzgjedhjes së Këshillave të Vendvotimeve

76.1. Çdo KVV miratohet nga KQZ-ja dhe udhëhiqet nga Kryesuesi.
76.2. Në kohën e përcaktuar nga KQZ-ja, SKQZ-ja i fton të gjitha subjektet politike të certifikuara, të përfaqësuara në kuvendin komunal, të cilat garojnë në zgjedhjet shtetërore, t'i dorëzojnë në KKZ propozimet për personat që ata dëshirojnë t'i emërojnë anëtarë të KVV-ve të formuara në kuadër të komunës së tyre.
76.3. SKQZ-ja kërkon nga subjektet politike të reja, OJQ-të dhe organizatat tjera qytetare t'i dorëzojnë nominimet plotësuese për KVV.
76.4. Të gjitha nominimet në kuadër të nenit 74.2 dhe 74.3 të këtij ligji i dorëzohen KKZ-së përkatëse jo më vonë se pesë (5) ditë pasi që kërkesa për nominim i është bërë nga Sekretariati i KQZ-së.
76.5. Lista e nominimeve të KVV-e duhet të përfshijë:
   a) emrin e subjektit politik ose të OJQ-së të cilët e bëjnë kërkesën, emrin e personit kontaktues dhe detajet kontaktuese të tij/saj;
   b) emrin, mbiemrin, numrin personal, datën e lindjes të çdo të emëruari;
   c) përshkrimin e hollësishëm për çdo të emëruar nëse ai/ajo ka përvojë paraprake në zgjedhje dhe diplomë të shkollës së mesme; dhe
   d) datën dhe vendin e dorëzimit të listës së nominimeve, nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit politik ose OJQ-së, sikurse edhe nënshkrimin e pranimit të listës nga përfaqësuesi i KKZ-së.

Neni 77
Emërimi i Anëtarëve dhe Kryesuesve të KVV-ve

77.1. Menjëherë pas pranimit të të gjitha nominimeve, KKZ-të i caktojnë të emëruarit në VV-të e propozuara për ta duke e zbatuar grupin e rregullave në vijim:
   a) jo më shumë se një person prej një liste të nominimeve në KVV, të dorëzuar sipas nenit 76.2 të emërohet anëtar i KVV-së në të njëjtin VV;
   b) gjatë përzgjedhjes së kandidatëve nga lista e nominimeve të KVV-së të dorëzuar sipas nenit 76.3, përparësi u jepet kandidatëve me cilësi më të mira dhe veçanërisht atyre me përvojë paraprake në zgjedhje;
   c) jo më shumë se një person nga familja e ngushtë mund të emërohet në të njëjtin KVV. Për qëllime të këtij neni, familja e ngushtë përfshinë bashkëshortin/ën, fëmijët, prindërit dhe vëllezërit e motrat;
   d) në komunat e reja ose aty ku nuk janë certifikuar rezultatet nga zgjedhjet e kaluara, anëtarësia e KVV-ve përzgjidhet me short ndërmjet atyre subjekteve politike të certifikuara për pjesëmarrje në zgjedhjet e ardhshme në atë komunë.
77.2. KKZ-ja ia dorëzon këto nominime Sekretariatit të KQZ-së për rekomandim të KQZ-së jo më vonë se pesë (5) ditë pune pas pranimit të nominimeve. KQZ-ja i emëron të gjithë anëtarët e KVV-ve, përfshirë anëtarët rezervë të KVV-ve, jo më vonë se katër (4) ditë pas pranimit të nominimeve.
77.3. Kryesuesit e këshillave të vendvotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë në mesin e katër subjekteve politike të certifikuara që kanë fituar numrin më të

madh të votave për Parlamentin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë.

77.4. Pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KKV-ve të cilët nuk përmbushin kushtet sipas këtij neni.

Neni 78
Pagesat e Anëtarëve dhe Kryesuesve të KVV-ve

Anëtarët e KVV-ve dhe Kryesuesit e tyre paguhen për kryerjen e detyrave të tyre me mjetet e siguruara nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. KQZ-ja do të nxjerrë një vendim të veçantë, me të cilin do të rregullohet kjo çështje.

Neni 79
Emërimi i Rezervave të KVV-ve

79.1. Procedurat e saktësuara në nenin 77 zbatohen për emërimin e një numri shtesë prej dhjetë për qind (10 %) nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të KVV-ve si anëtarë rezervë në kuadër të secilës komunë.

79.2. Një anëtar i emëruar zëvendësohet me një anëtarë rezervë nga KKZ-ja nëse, për çfarëdo arsye, anëtari i emëruar nuk është në dispozicion për të shërbyer para ose në Ditën e Zgjedhjeve. Nëse nuk ka numër të mjaftueshëm të anëtarëve rezervë në dispozicion, një KKZ mund t'i plotësojë vendet e zbrazëta me persona për të cilët ajo mendon se janë të përshtatshëm dhe i plotësojnë kriteret e vendosura në nenin 80 të këtij ligji. Një KKZ duhet të:

a) sigurojë që jo më shumë se një person nga subjekti politik i përcaktuar në nenin 77.2 të këtij ligji të emërohet anëtar i KVV-së në të njëjtin VV;
b) sigurojë që zëvendësimi ta nënshkruajë Kodin e Sjelljes; dhe
c) organizojë trajnim të duhur për zëvendësimin.

Neni 80
Gjobat dhe Masat Tjera

80.1. Subjektet politike të certifikuara ose OJQ-të që kanë nominuar persona për të qenë anëtarë të KVV-ve janë përgjegjës për të siguruar që personat e tillë marrin pjesë në të gjitha seancat e trajnimit të organizuara nga KQZ-ja.

80.2. Subjektet politike të certifikuara ose OJQ-të që kanë nominuar persona për të qenë anëtarë të KVV-ve janë përgjegjës për të siguruar që personat e tillë janë të përpiktë në vijimin dhe kryerjen e detyrave në vendvotimin e tyre në terminët dhe periudhat kohore siç udhëzohen nga KKZ-ja.

80.3. Kur personi, ose personat, që emërohen nga një subjekt politik i certifikuar ose OJQ dështojnë në përmbushjen e obligimeve pa ndonjë arsye të fortë të saktësuar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, çështja raportohet nga KKZ-ja në Komisionin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa mund të shqiptojë gjobë ose sanksionim, nëse gjen se çështja është provuar.

80.4. Aty ku, sipas mendimit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve, një anëtar i këshillit të vendvotimit nuk është, për cilëndo arsye, i gatshëm ose është i paaftë t'i përmbushë obligimet e veta, KKZ-ja i jep fund emërimit të atij anëtari. Vendi vakant që del si rezultat i një vendimi i tillë duhet, deri sa është e mundur, të plotësohet në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 81
Kodi i Sjelljes për Anëtarët e KVV-ve

Emërimi i secilit anëtar në KVV është i kushtëzuar me dhënien e betimit dhe nënshkrimin e Kodit të Sjelljes siç parashihet me rregull të KQZ-së.

KREU XIII
QENDRAT E VOTIMIT DHE VOTIMI

Neni 82
Dispozitat e Përgjithshme

82.1. LPV-ja e votuesve të caktuar në të njëjtën QV përgatitet në mënyrën e përshkruar nga KQZ-ja në mënyrë që asnjë VV brenda QV-së nuk tejkalon 750 votues. Përjashtimet nga kjo rregull mund të autorizohen nga KQZ-ja.

82.2. Një VV duhet të jetë mjaft i madh për të siguruar mbajtjen e drejtë të votimit duke vendosur të gjitha stacionet e punës siç janë përkufizuar në këtë ligj dhe duke siguruar fshehtësinë e votës, pamjen e lirë dhe kontrollin e kutisë së votimit, dhe qasje të papenguar për vëzhgues.

82.3. Personat në vijim janë të autorizuar të jenë të pranishëm në vendvotim ose Qendër të Votimit:

a) personat e pranishëm me qëllim të votimit;
b) anëtarët e Këshillit të Vendvotimit dhe stafi i Qendrës së Votimit;
c) anëtarët e KQZ-së dhe personeli i SKQZ-së;
d) anëtarët e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve;
e) vëzhguesit e akreditуar të procesit zgjedhor;
f) policia, kur thirren për të vendosur rregull; dhe
g) përkthyesit për personat e shënuar në pikat (c) (e) dhe (f) të këtij nën-paragrafi.

Neni 83
Lokacionet e Vendvotimeve dhe Qendrave të Votimit

83.1. Mbështetur në rekomandimet e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), KQZ-ja, përmes Sekretariatit të KQZ-së, jo më vonë se dyzet (40) ditë para zgjedhjeve, i publikon lokacionet e sakta te të gjitha QV-ve.

83.2. Secilit votues të regjistruar i caktohet Qendra e Votimit që është lokacioni ku emri i tij/saj shfaqet në Listën Përfundimtare të Votuesve të përdorur gjatë mbajtjes së votimit në ditën e zgjedhjeve.

83.3. Sa më shumë që të jetë e mundur asnjë votues nuk duhet të udhëtoj më tepër se 3 km deri në vendin e tij apo saj të votimit.

83.4. Ndryshimet pasuese të lokacioneve të QV-ve lejohen në rastet e force majeure, ose arsye tjera objektive dhe të paparashikueshme që do të bënin QV-në të papërshtatshme për qëllime të votimit. Sekretariati i KQZ-së e informon menjëherë KQZ-në për këto ndryshime.

83.5. Nëse lokacioni i QV-së është ndryshuar, KKZ-ja i njofton votuesit për ndryshimin përmes burimeve në dispozicion të mediave lokale. Si shtesë, KKZ-ja vendos lajmërim në lokacionin origjinal të QV-së duke këshilluar votuesit për lokacionin e ri të QV-së.

83.6. VV-të janë në vend të qasshëm për të mundësuar votuesit të formojnë dhe të qëndrojnë në rresht dhe duhet, kur është e mundshme, të kenë qasje të niveluar që personat me aftësi të kufizuara të kenë hyrje dhe dalje të papenguar. VV-të kanë ndriçim adekuat dhe mbrojtje nga aksidentet elementare.

83.7. Një QV ose VV nuk duhet të jetë në një vend të kultit, ndërtesë e cila është pronë apo seli e subjektit politik, ose hapësira në të cilat shërbehet apo konsumohet alkooli.

Neni 84
Siguria e Vendvotimit

84.1. Kryesuesi i KVV-së, me ndihmën e të gjithë anëtarëve të KVV, siguron qetësinë dhe sigurinë e procesit të votimit brenda VV-së. Rendi në rresht para VV-së mbahet nga anëtari i KVV-së i caktuar Kontrollues i Rreshtit.

84.2. Në rast të çrregullimit serioz brenda ose në afërsi të drejtpërdrejtë të VV-së, Kryesuesi i KVV-së kërkon ndihmë të menjëhershme nga policia. Incidenti shënohet menjëherë në Librin e Votimit.

84.3. Në rast se çrregullimi kthehet në kërcënim serioz të integritetit të procesit të votimit ose kundër njerëzve brenda VV-së, Kryesuesi i KVV-së mund të vendosë të ndërpresë votimin dhe të mbyllë VV-në deri sa të ri-vendoset rregulli. Kryesuesi i KVV-së e informon menjëherë KKZ-në dhe e regjistron ngjarjen në Librin e Votimit, përfshirë periudhën gjatë së cilës votimi është ndërprerë.

84.4. Asnjë person që mban armë ose emblemë nuk lejohet brenda VV-së, përveç Policit të Kosovës në detyrë i cili është në uniformë. Policët e Kosovës në detyrë nuk bën të sillen brenda VV-së pas hedhjes së votës së tyre.

Neni 85
Materiali për Fushatën Zgjedhore dhe Materiali për Informim të Votuesve në VV dhe QV

85.1. Të gjitha subjektet politike të cilat nuk kanë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilitdo VV ose QV në rreze prej 100 metra, çfarëdo materiali i tillë i mbetur 24 orë para fillimit të votimit duhet të largohet nga anëtarët e KVV-ve ose Menaxheri i QV-së. Subjektet politike të cilat nuk kanë larguar dhe/ose janë gjetur duke postuar material të fushatës

zgjedhore pas afatit kohor të vendosur duhet të raportohen në KZAP për shkelje të këtij ligji.

85.2. Materiali i shtypur, i prodhuar nga Sekretariati i KQZ-së në emër të KQZ-së, duke shënuar emrat e të gjithë kandidatëve të të gjitha subjekteve të certifikuara politike dhe procedurat e votimit duhet të paraqiten në VV për përfitim nga votuesit. Këto lista duhet, po ashtu, të paraqiten në derën kryesore të hyrjes të secilës QV.

85.3. Shenjat informuese në ndërtesë duhet të paraqesin në mënyrë të qartë numrin e QV-së. Brenda QV-së, veçanërisht kur ka më tepër se një VV, shenjat për të drejtuar votuesit në VV-në e duhur duhet të paraqiten dukshëm. Secila VV duhet të shënjohet qartë me shenja që tregojnë numrin e VV-së dhe shkronjat nga LPV-ja të atyre votuesve të caktuar në atë VV.

85.4. Asnjë informatë e fushatës zgjedhore nuk duhet të emetohet në çfarëdo pajisje komunikuese në Qendër të Votimit, dhe as brenda distancës së dëgjimit.

Neni 86
Procedurat Para Fillimit të Votimit

86.1. KQZ-ja vendos një rregull e cila qeverisë rregullat e procedurës, shpërndarjet dhe pranimin e materialeve për zgjedhje të cilat i dërgohen KKZ-së dhe KVV-së.

86.2. Në Ditën e Zgjedhjeve, Kryesuesi i KVV-së, dhe/ose Zëvendësi i tij/saj duhet, në përcjellje të policisë, t'i dërgoj materialet e shënuara në nenin 103.1 nga KKZ-ja në QV.

86.3. Të gjithë anëtarët e KVV-së duhet të jenë të pranishëm në VV së paku një orë para fillimit të votimit.

86.4. Kryesuesi i KVV-së i kryen të gjitha detyrat e përcaktuara nga rregullat e KQZ-së të nevojshme për të hapur VV-të sikurse është përcaktuar me rregullat e KQZ-së.

86.5. Nëse VV-ja hapet me vonesë, Kryesuesi i KVV-së e informon menjëherë KKZ-në, e cila e informon Sekretariatin e KQZ-së dhe regjistron kohën e hapjes në Librin e vendvotimit.

Neni 87
Përshkrimi i Fletëvotimit dhe materialit në lidhje me Fletëvotimin

87.1. Emri i subjektit politik dhe kandidatëve të tyre paraqiten në fletëvotim siç paraqiten në origjinalin e aplikimit për certifikim, subjekt i modifikimeve – nëse ka – dhe në fund të miratuara nga KQZ-ja.

87.2. Votuesi udhëzohet për të shënuar zgjedhjen e tij/saj aq qartë që të mos ketë paqartësi mbi preferencat.

87.3. Emrat e të gjithë kandidatëve në materialin e shtypur të ekspozuara në vendvotime ose Qendra të Votimeve shfaqen drejtpërdrejtë nën emrin e partisë politike, koalicionit ose nismës qytetare që ka dorëzuar listën e kandidatëve.

87.4. KQZ-ja përcakton numrin e fletëvotimeve të cilat shtypen dhe shpërndahen. Numri i fletëvotimeve nuk tejkalon për më shumë se pesë për qind (5 %) numrin

e votuesve në listën e votuesve.

87.5. Fletëvotimi duhet të përmbajë:
   a) treguesin e qarkut elektoral;
   b) organin publik që do të zgjidhet;
   c) numrin rendor të vendosur para secilit subjekt politik individual zgjedhor;
   d) emrin dhe akronimin e secilit subjekt politik sipas radhës së përcaktuar me shortin për fletëvotim;
   e) tiparet e sigurisë, sikurse janë përcaktuar nga KQZ-ja;
   f) çfarëdo informate tjetër të kërkuar me këtë ligj dhe me rregullat e miratuara në përputhje me të.

87.6. KQZ-ja më tutje përcakton me anë të rregullës detajet e fletëvotimeve:
   a) përmbajtjen;
   b) formatin dhe ekspozimin/dukjen;
   c) mënyrën dhe kontrollin e printimit;
   d) verifikimin, shpërndarjen dhe trajtimin e fletëve të votimit;
   e) veçoritë e sigurisë; dhe
   f) çfarëdo çështje tjera të lidhura që nuk mbulohen me këtë ligj.

87.7. Fletëvotimet shtypen nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejt të KQZ-së.

87.8. Fletëvotimet shtypen në të gjitha gjuhët zyrtare në nivel kombëtar dhe në nivel lokal, sipas Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve. Subjekti politik i certifikuar mund të zgjedhë gjuhën dhe shkrimin në të cilën emri i tij/saj është i shkruar në fletëvotim.

Neni 88
Orari i Votimit

88.1. Qendrat e votimit hapen në orën 7:00 dhe mbyllen në orën 19:00.

88.2. Askush nuk mund të votojë pas kohës së mbylljes së qendrave të votimit, përveç votuesve të cilët presin në radhë në VV në kohën e mbylljes.

Neni 89
E Drejta e Votës dhe Fshehtësia e Votës

89.1. Votuesi më të drejtë për të votuar ka të drejtë vote nëse ai/ajo është i regjistruar në Kosovë ose ka aplikuar suksesshëm për votim jashtë Kosovës siç përcaktohet në nenet 5 dhe 6 të këtij ligji.

89.2. Askush nuk e parandalon ose orvatet të parandalojë një votues me të drejtë për të votuar nga ushtrimi i së drejtës së tij/saj për të votuar.

89.3. Askush nuk lejohet të votojë në emër të një votuesi tjetër, përveç në përputhje me dispozitat e nenit 89.5 të këtij ligji.

89.4. Secili votues e plotëson fletëvotimin e vet në fshehtësi mbrapa kabinës së votimit. Vetëm një person lejohet mbrapa kabinës së votimit gjatë një intervali të caktuar kohor përveç nëse votuesi ka kërkuar ndihmë nga personi tjetër, siç përcaktohet në paragrafin 5 të këtij neni.

89.5. Votuesi i cili është me aftësi të kufizuar në atë mënyrë që nuk është në gjendje të shënojë ose hedh fletëvotimin dhe/ose është analfabet mund të ndihmohet nga

një person tjetër i zgjedhur nga votuesi nëse ai kërkon një ndihmë të tillë. Personi i tillë e ndihmon vetëm një votues dhe nuk është anëtar i KVV-së ose vëzhgues i akredituar.

89.6. Personi i miratuar për të ndihmuar votuesin shkruan dhe nënshkruan emrin e tij/saj në Listën e duhur të Votuesve ose Zarfin për Fletëvotim me Kusht, afër emrit ose një hapësire tjetër të ofruar nga votuesi i cili është ndihmuar.

89.7. Anëtarët e KVV-së nuk mund në asnjë mënyrë të ndikojnë në vendimin e votuesit.

89.8. Anëtarët e Këshillit të Vendvotimit dhe/ose stafi i Vendvotimit shpjegojnë procedurën e votimit vetëm nëse u kërkohet nga zgjedhësi.

89.9. Anëtarët e KVV-së kujdesen veçanërisht për të siguruar që zgjedhësi nuk shqetësohet nga askush përderisa shënjon fletën e tij të votimit, dhe se fshehtësia e votimit është plotësisht e siguruar.

Neni 90
Dokumentet e Pranueshme të Identifikimit

Për qëllim të këtyre zgjedhjeve në vijim janë dokumentet e pranueshme të identifikimit:

a) letërnjoftimi i vlefshëm;
b) pasaporta valide;
c) dokumenti i vlefshëm i udhëtimit;
d) leja e vozitjes e vlefshëm e Kosovës;
e) kartela e vlefshme e PZHBV-ve; ose
f) kartela e vlefshme e refugjatit.

Neni 91
Votimi i Rregullt

91.1. Procedurat për votim të rregullt vendosen përmes rregullës së KQZ-së.

91.2. Votimi në zgjedhjet e njëjta më shumë se një herë përbën vepër penale dhe është i dënueshëm në përputhje me Kodin Penal të Kosovës.

Neni 92
Votimi i Anëtarëve të Këshillit të Vendvotimit

Anëtarët e KVV-ve dhe Kryesuesi votojnë të parët kur hapet vendvotimi.

Neni 93
Mbyllja e Vendvotimit

93.1. Çdo person në rresht në orën e mbylljes së VV-së, lejohet të votojë nëse ka të drejtë për të votuar. Kontrolluesi i rreshtit e informon personin e fundit në rresht se ai/ajo është personi i fundit që voton. Çdo person tjetër që i bashkohet rreshtit pas atij personi, nuk lejohet të hyjë në VV, dhe informohet për pamundësinë e tij/saj për të votuar.

93.2. Pasi të votojë personi i fundit në rresht në kohën e përfundimit të votimit, kryesuesi i KVV-së e mbyll VV-në, e mbyll kutinë e votimit në atë mënyrë që kjo të mund të shikohet nga vëzhguesit e pranishëm, dhe në librin e votimit e shënon kohën e saktë të mbylljes.

Neni 94
Libri i Votimit

94.1. Secili VV e ka Librin e Votimit në të cilin shënohen të gjitha ngjarjet domethënëse në lidhje me mbajtjen e votimeve të cilat ndodhin në vendvotim gjatë ditës së zgjedhjeve.
94.2. Vetëm Kryesuesi i KVV-së, anëtarët e KVV-së, dhe vëzhguesit e akredituar të pranishëm lejohen të bëjnë shënime në Librin e Votimit. Nëse votuesi ka ankesë në lidhje me ndonjë aktivitet brenda VV-së, ai/ajo mund të kërkojë nga Kryesuesi i KVV-së regjistrimin e ankesës së tij/saj në Librin e Votimit dhe/ose të dorëzojë një ankesë në Komision Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në përputhje me procedurat e përcaktuara.

Neni 95
Votimi me Kusht

Votuesi në Kosovë, emri dhe mbiemri i të cilit nuk mund të gjendet në LPV, ose që emri i tij/saj gjendet në LPV me një shenjë ose shënim që tregon se ai/ajo duhet të votojë me kusht, lejohet të votojë me kusht në VV-në që lëshon fletëvotime me kusht në pajtim me rregullat e KQZ-së.

KREU XIV
VOTIMI JASHTË KOSOVËS

Neni 96
Dispozitat e Përgjithshme

96.1. Votuesi me të drejtë vote i cili përkohësisht mungon në Kosovë mund të votojë për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës nëse ai ose ajo ka aplikuar suksesshëm për Votim Jashtë Kosovës dhe ka votuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e KQZ-së.
96.2. Vota përmes Votimit Jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja para ditës së zgjedhjeve, sikurse përcaktohet me anë të rregullave të KQZ- së.

Neni 97
Aplikimi për Fletëvotim

97.1. Votuesi me të drejtë vote mund të aplikojë për të marrë një fletëvotim për Votim Jashtë Kosovës duke dorëzuar të plotësuar Aplikimin për Votim Jashtë Kosovës/Formularin e Regjistrimit të Votuesit (“Aplikimi Përmes-Postës”)në formën në dispozicion nga faqja elektronike e KQZ-së:

a) përmes postës në një nga Kutitë Z.P të KQZ-së; ose
b) përmes faksit në KQZ në numrin e shënuar në Aplikimin për Votim Jashtë Kosovës.

97.2. Votuesi me të drejtë vote i cili nuk është regjistruar paraprakisht për të votuar në zgjedhje nën autoritetin e KQZ-së duhet të dorëzojë, bashkë më Aplikimin për Votim Jashtë Kosovës të plotësuar, dokumentacion provë që ai ose ajo plotëson kriterin juridik të përcaktuar me nenin 5 të këtij ligji.

97.3. Për qëllimet e paragrafit 2 të këtij neni, dokumentet e regjistruara në nenin 90 mund të përdoren për të disa apo të gjitha kriteret juridike nën nenin 5 të këtij ligji.

Neni 98
Konfirmimi dhe Procesi i Ankesave

98.1. KQZ-ja e njofton secilin kandidat nëse aplikimi i tij/saj është pranuar apo refuzuar.

98.2. Çdo aplikues i cili është refuzuar ka të drejtë ankese ndaj këtij vendimi në KZAP.

KREU XV
VOTIMI I PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Neni 99
Dispozitat e Përgjithshme

99.1. KQZ-ja përcakton rregullat për votim për personat me nevoja të veçanta:
a) votuesit me të drejtë vote të cilët nuk mund të dalin nga shtëpitë e tyre për të votuar personalisht në vendvotimin e zakonshëm për shkak të paaftësisë fizike, mjekësore ose çfarëdo paaftësie tjetër;
b) votuesit me të drejtë vote me lëvizje të kufizuar në ndonjë institucion: votuesit në hospitalizim, njerëzit e moshuar në shtëpitë e caktuara veçanërisht për të moshuarit, personat me aftësi të zvogëluar mendore në institucionet e kujdesit shëndetësor, të burgosurit në burgje dhe të paraburgosurit në qendrat e paraburgimit; ose
c) votimi në rrethana të veçanta: votuesit që jetojnë në bashkësitë, të cilat, për shkak të zhvendosjes nga vendi afër vendvotimit të tyre të rregullt ose për shkaqe sigurie, nuk mund të votojnë në vendvotimin e tyre të caktuar. Për këtë lloj votimi kërkohet miratimi nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve.

Neni 100
Procesi i Vendosjes

100.1. KKZ-ja lëshon një njoftim me shkrim të dhënë nga KQZ-ja duke informuar kështu çdo votues me të drejtë vote ose grup të votuesve të cilëve u është mohuar kërkesa për VPNV, duke i informuar për të drejtën e tyre për të ushtruar ankesë pranë gjykatës së shkallës së parë deri në datën e caktuar në njoftim.

100.2. Gjykata e shkallës së parë shqyrton secilën parashtresë që e merr në përputhje me Rregullat e Procedurës dhe afatet e përcaktuara me këtë ligj dhe rregullat e KQZ-së.
100.3. Gjykata e shkallës së parë mund të urdhërojë KKZ-në që të përfshijë ose të përjashtojë votuesit me të drejtë vote nga lista e votuesve e VPNV-së, në bazë të autoritetit të saj.

KREU XVI
PROCESI I NUMËRIMIT TË FLETËVOTIMEVE DHE SHPALLJA E REZULTATEVE TË ZGJEDHJEVE

Neni 101
Dispozitat e përgjithshme

101.1. Procedurat e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërimin dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës.
101.2. Fletëvotimet e rregullta nga vendvotimet përbrenda Kosovës numërohen në po ato vendvotime, menjëherë pas mbylljes së procesit votues.
101.3. Procedurat e numërimit janë në pajtim me rregullat e KQZ-së.

Neni 102
Raportimi i numërimit preliminar në vendvotim

102.1. Çdo anëtar i komisionit të vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistrojë mospajtimin e tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe mund të dërgojë një vërejtje te Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në përputhje me këtë ligj.
102.2. Kryesuesi i komisionit të vendvotimit dhe mbikëqyrësi i KQZ-së, nëse i pranishëm, është përgjegjës për përmbledhjen dhe saktësinë e rezultateve të votimit të marra nga shënimet e vendvotimit të bëra në format e kërkuara dhe e dërgon formën e kompletuar të FPR-së në vendin e caktuar.
102.3. Rezultatet e numërimit në VV vendosen në vendvotim nga Kryesuesi i vendvotimit.

Neni 103
Ruajtja e fletëvotimeve dhe transportimi i materialit zgjedhor

103.1. Pas përfundimit të numërimit, të gjitha fletëvotimet e përdorura dhe ato të papërdorura, lista përfundimtare e votuesve, lista e votuesve me kusht, libri i zgjedhjeve, zarfet me fletëvotime me kusht që përmbajnë fletëvotimet e shënjuara dhe materialet tjera zyrtare zgjedhore në vendvotim duhet të:
   a) paketohen dhe transportohen në përputhshmëri me rregullat KQZ-së;
   b) transportohen në kushte të sigurta deri në vendin e saktësuar nga KQZ-ja.
103.2. Kryesuesi i KVV-së e shoqëron transportin e fletëvotimeve dhe materialit zgjedhor deri në pikën e caktuar të grumbullimit, e nëse kërkohet, shoqërohet

nga një anëtar i opozitës, i një niveli të respektueshëm, i zgjedhur me konsensus, ose në mungesë të konsensusit, i zgjedhur me short nga kryesuesi.

103.3. Fletëvotimet, format dhe materialet tjera zgjedhore të transportuara në një vend të caktuar në Kosovë ruhen në kushte të sigurta derisa të zgjidhen të gjitha ankesat dhe derisa të certifikohen rezultatet nga KQZ-ja.

103.4. KQZ-ja me një vendim, pas certifikimit zyrtar të rezultatit të zgjedhjeve, shkatërron materialet e përmendura në kohën e përshtatshme brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve, përveç nëse udhëzohet ndryshe nga KZAP-ja.

Neni 104
Vëzhguesit

104.1. Të gjitha aktivitetet e zhvilluara nga QNR-ja mund të vëzhgohen nga anëtarët e KQZ-së dhe stafit të Sekretariatit të KQZ-së, anëtarët e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) dhe vëzhguesit zgjedhor të akreditуar nga KQZ-ja.

104.2. Jo më tepër se katër (4) vëzhgues të akreditуar nga i njëjti etnitet politik, siç është definuar në nenin 3 të këtij ligji, apo të organizatave tjera të akredituara mund të jenë të pranishëm brenda QNR-së njëkohësisht.

104.3. Pa marrë parasysh kushtet e këtij ligji, nëse drejtori ekzekutiv i sekretariatit të KQZ-së vlerëson se numri i vëzhguesve të akreditуar zgjedhor ose të vëzhguesve të akreditуar të mediave, të pranishëm brenda QNR-së paraqet pengesë për procesin e numërimit, ai/ajo i udhëzon vëzhguesit e akreditуar zgjedhor ose vëzhguesit e mediave të zvogëlojnë numrin e tyre.

Neni 105
Ankesat për procesin e QNR

105.1. Ankesat në lidhje me administrimin e numërimit në QNR dorëzohen me shkrim pranë KZAP-it brenda afatit prej 24 orësh nga momenti i të kuptuarit për shkeljen e supozuar dhe në asnjë rast më vonë se dy (2) ditë pune prej ndodhjes së shkeljes së supozuar.

105.2. Paraqitja e ankesës nuk e pengon ose ndërpret procesin e numërimit.

105.3. Për të gjitha ankesat e marra nga KZAP-i, vendoset jo më vonë se pesë (5) ditë nga momenti i pranimit të ankesës në zyrat qendrore të KZAP-it.

Neni 106
Rezultatet zgjedhore

106.1. KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe në qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha vërejtjet e dala që u përkasin votimit dhe numërimit janë vendosur nga Komisioni Zgjedhor për Parashtresat dhe Ankesat dhe nga Gjykata Kushtetuese.

106.2. Para certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave në cilindo vendvotim, qendër të numërimit ose edhe përsëritjen e votimit në një qendër votimi apo në një komunë.

106.3. Rezultatet e zgjedhjeve janë përfundimtare dhe detyruese atëherë kur janë

certifikuar nga KQZ-ja.

106.4. KQZ-ja i publikon rezultatet e zgjedhjeve pasi që ato të jenë certifikuar. Sekretariati i KQZ-së i publikon këto rezultate përfundimtare në formë tabelare duke përfshirë edhe publikimin në faqen e vetë të internetit:
a) numri i zgjedhësve të regjistruar;
b) numri zgjedhësve të cilët kanë votuar në secilin vendvotim;
c) numri i zgjedhësve të cilët kanë votuar jashtë vendvotimit;
d) numri i zgjedhësve që kanë votuar (numri përfundimtar i votimeve të bëra);
e) numri i pranuar i fletëvotimeve të vlefshme;
f) numri i papërdorur i fletëvotimeve;
g) numri i fletëvotimeve të përdorura;
h) numri i fletëvotimeve të pavlefshme;
i) numri i fletëvotimeve të zbrazëta;
j) numri i fletëvotimeve të dëmtuara;
k) numri i votave për secilin subjekt politik;
l) numri i votave të fituara për secilin kandidat individual, kur kjo është e zbatueshme;
m) numri i ulëseve të fituara për secilin etnitet;
n) emrat e kandidatëve të zgjedhur.

KREU XVII
INFORMIMI I VOTUESVE DHE MEDIA

Neni 107
Dispozitat e përgjithshme

107.1. KQZ-ja, në kohë të duhur, organizon dhe sponsorizon fushatën për edukimin e votuesve. Ajo shpërndan nëpër të gjithë vendin, sipas Ligjit për përdorim të gjuhëve, informatat për:
a) procedurat e votimit; dhe
b) të drejtat e votuesve dhe procedurat për mbrojtjen e tyre, përfshire edhe mekanizmat për ankesë.

107.2. Në secilin vendvotim, ne ditën e zgjedhjeve, materiali i shtypur, i dizajnuar dhe i përgatitur në emër të KQZ-së, me emra të numëruar të subjekteve politike dhe emrave të kandidatëve, e po ashtu edhe të procedurave të votimit, nxirret, ekspozohet ose publikohet nga Sekretariati i KQZ-së në dobi të votuesve. Emrat e kandidatëve në materiale të tilla të shtypura ose të ekspozuara renditen në të njëjtën mënyrë siç paraqiten në listën e regjistrimit të kandidatëve, të certifikuar nga KQZ-ja në lidhje me subjektet politike të cilat i kanë paraqitur.

107.3. Gjatë bërjes së fushatës për edukimin e votuesve, SKQZ-ja i kushton vëmendje të veçantë votuesve në viset rurale, me aftësi të kufizuara dhe analfabet.

Neni 108
Transmetimi i informatave për votuesit

108.1. KQZ-ja përgatit material të përshtatshëm për transmetim ne radio dhe televizion për informimin e publikut për procesin zgjedhor në Kosovë.
108.2. Materiali informues i përgatitur nga KQZ-ja për emetim në televizion përmban mënyrë për transmetimin simultan për njerëzit me dëgjim të dëmtuar ne gjuhën adekuate për nevojat e grupeve gjuhësore të cilat shërbehen nga transmetuesi.

Neni 109
Shkeljet

Nëse transmetuesi televiziv ose i radios dështon t'i përmbahet dispozitave të këtij ligji ose legjislacionit në zbatim, KQZ-ja e njofton menjëherë KPM-në.

KREU XVIII
SISTEMI ZGJEDHOR PËR KUVENDIN E KOSOVËS

Neni 110
Dispozitat e përgjithshme

110.1. Kosova konsiderohet një zonë zgjedhore me shumë kandidatë.
110.2. Subjekti politik paraqet listën e kandidatëve në bazë të procedurave të caktuara nga KQZ-ja dhe ky ligj. Secila listë e kandidatëve do të ketë së paku tridhjetë për qind (30%) të kandidatëve të gjinisë tjetër sipas tabelës së bashkëngjitur si Shtojca 1.
110.3. Secili subjekt politik i certifikuar paraqitet në votim me "listë të hapur".
110.4. Duke ushtruar të drejtën e tij/saj të votës, votuesi voton për një (1) subjekt politik të certifikuar dhe mund të votoj për një (1) kandidat nga lista e kandidatëve të këtij subjekti politik. Nëse në fletëvotim janë shënuar më shumë se një (1) kandidat, vetëm vota për subjektin politik llogaritet.
110.5. Vota e hedhur për subjektin politik konsiderohet si votë për kandidatin e parë në listën e kandidatëve të subjektit politik. KQZ-ja siguron që fletëvotimi nuk e lejon votuesin të votojë njëkohësisht për subjektin politik dhe për kandidatin e parë në listën e kandidatëve të këtij subjekti politik.

Neni 111
Ndarja e vendeve

111.1. Vendet në Kuvend ndahen sipas sistemit të përfaqësimit të caktuar nga neni 64 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke ndarë:
a) njëqind (100) vende midis të gjitha subjekteve politike të certifikuara në raport me numrin e votave të vlefshme që kanë marrë ato; dhe
b) njëzet (20) vende janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, si vijon:
(i) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët

janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10);

(ii) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti rom një (1) vend; komuniteti ashkali një (1) vend; komuniteti egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë i jepet komunitetit rom, ashkali, ose egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti boshnjak tri (3) vende, komuniteti turk dy (2) vende dhe komuniteti goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.

111.2. Njëqind (100) vendet e Kuvendit të përshkruara në nenin 111.1 (a) ndahen sipas mënyrës në vijim dhe në bazë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme që i ka fituar secili subjekt politik:

a) në mesin e subjekteve politike që përfaqësojnë komunitetin serb dhe komunitetet tjera joshumicë dhe në mesin e subjekteve politike të cilat nuk përfaqësojnë komunitetin serb dhe komunitetet joshumicë të cilat kanë fituar së paku pesë përqind (5%) nga numri i përgjithshëm i votave të vlefshme në zgjedhjet për Kuvend;

b) numri i përgjithshëm i votave të vlefshme të fituara nga secili subjekt politik në zgjedhjet për Kuvend pjesëtohet me 1, 3, 5, 7, 9, 11, 13, 15, e kështu me radhë derisa numri i pjesëtuesve të shfrytëzuar t'i përgjigjet numrit të plotë të vendeve;

c) koeficientët që rezultojnë nga vargu i pjesëtimeve rregullohen në renditje zbritëse. Vendet u ndahen subjekteve politike sipas koeficientëve në mënyrë që vendi i parë i takon subjektit që e ka koeficientin më të madh, vendi i dytë subjektit që e ka koeficientin e radhës më të madh, e kështu me radhë derisa të ndahen të gjitha vendet;

d) nëse një subjekti politik i ndahen vende që janë baraz me numrin e kandidatëve në listën e tij dhe ka ende vende për të ndarë, atëherë pjesa e mbetur e koeficientit të atij subjekti nuk merret parasysh gjatë ndarjes së vendeve të mbetura. Koeficientët pasues me renditje zbritëse përdoren derisa të ndahen të gjitha vendet;

e) nëse ndodh barazimi për shkak se dy ose më shumë koeficintë janë të njëjtë, vendi ndahet me hedhje të shortit nga kryesuesi i KQZ-së, në praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve politike në fjalë.

111.3. Njëzet (20) vendet e rezervuara në Kuvend të përshkruara në pikën (b) të paragrafit 1 të këtij neni u ndahen subjekteve politike që përfaqësojnë komunitetin serb dhe komunitetet tjera joshumicë në Kosovë sipas mënyrës së njëjtë të përshkruar në nenin 112.2 të këtij ligji, në bazë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme të fituara nga secili subjekt politik, pavarësisht nga numri i vendeve tashmë të ndara prej njëqind (100) vendeve.

111.4. Të gjitha votat e fituara nga kandidatët që janë në listën e hapur të subjektit

politik numërohen ndaras. Vota e hedhur për subjektin politik konsiderohet si votë për kandidatin e parë në listën e kandidatëve të subjektit politik. Listat me kandidatë rirenditen sipas mënyrës zbritëse në bazë të numrit të votave të fituara për secilin kandidat.

111.5. Vendet që i ndahen subjektit politik në paragrafin 2 të këtij neni u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur të kandidatëve të subjektit politik në paragrafin 4 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listë sipas një renditje zbritëse, deri në mbarim të vendeve që i ndahen subjektit politik. Vendet shtesë që u ndahen subjekteve politike që përfaqësojnë komunitetin serb dhe komunitetet tjera joshumicë në Kosovë sikurse në paragrafin 3 të këtij neni u ndahen kandidatëve pasues nga lista e rirenditur nga paragrafi 4 i këtij neni e kandidatëve të subjektit politik.

111.6. Nëse pas ndarjes së vendeve të përcaktuara në paragrafin 5 të këtij neni kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i radhës i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%.

111.7. Asnjë person që është anëtar i ndonjë organi tjetër ligjvënës të zgjedhur nuk mund të ketë vend në Kuvend. Një anëtar i Kuvendit që është ose bëhet anëtar i ndonjë organi tjetër ligjvënës të zgjedhur pas marrjes së vendit në Kuvend, humb mandatin e tij në Kuvend.

111.8. Një person që humb mandatin sipas këtij neni zëvendësohet në pajtim me dispozitat nga neni 112 i këtij ligji.

Neni 112
Zëvendësimi i Anëtarëve të Kuvendit

112.1. Vendet e shpërndara ne përputhje me ketë Ligj mbahen personalisht nga kandidatet e zgjedhur dhe jo nga subjekti politik. Mandati i anëtarit nuk do të ndryshohet apo ndërpritet para se të përfundoj mandati përveç ne rastet vijuese:

a) dënimi i anëtarit për vepër penale për të cilën ai apo ajo është dënuar me burgim sikurse parashikohet me anë të nenit 69.3 (6) të Kushtetutës;
b) dështimi i anëtarit që të marrë pjesë në seancat e Kuvendit apo të Komiteteve për gjashtë (6) muaj radhazi, anëtar i të cilave ai apo ajo janë, përveç nëse jepet ndonjë arsye bindëse në pajtim me Rregullat e Kuvendit;
c) humbja e mandatit të anëtarit, sipas nenit 29 të këtij ligji;
d) vdekja e anëtarit;
e) paaftësia mendore ose fizike e anëtarit, e përcaktuar me anë të vendimit përfundimtar gjyqësor, apo
f) dorëheqja e anëtarit.

112.2. Një anëtar i Kuvendit të Kosovës mandati i të cilit përfundon në pajtim me nenin 112.1 zëvendësohet si vijon:

a) nga kandidati i ligjshëm në radhë i të njëjtës gjini i cili ka fituar numrin më të mash të votave të listës së riorganizuar të kandidatëve të Subjektit Politik në emër të së cilës garoi anëtari;

b) nëse nuk ka ndonjë kandidat tjetër të ligjshëm me gjini të njëjtë nga lista e kandidatëve, nga kandidati i radhës i cili ka fituar numrin më të lartë të votave në listën e kandidatëve;
c) nëse nuk ka kandidat tjerë të ligjshëm në listën e kandidatëve, shkon kandidati i ardhshëm legjitim nga lista e kandidatëve të etnitetit politik që ka pasur koeficientin më të madh të votave sipas formulës së përcaktuar në nenin 111.4 të këtij ligji nga zgjedhjet e fundit të të njëjtit lloj; dhe
d) nëse anëtari është kandidat i pavarur, shkon kandidati i ardhshëm legjitim nga lista e kandidatëve të etnitetit politik që ka pasur koeficientin më të madh të votave sipas formulës së përcaktuar në nenin 111.4 të këtij ligji.

112.3. Pasi që një ulëse të mbetet e zbrazët, Kryetari i Kuvendit i bën kërkesë me shkrim Presidentit për mbushjen e ulëses së zbrazët. Një kërkesë e tillë duhet të përfshij edhe sqarimin se pse u lirua kjo ulëse.
112.4. Pas pranimit të kërkesës sipas paragrafit 3 të këtij neni, nëse sqarimi i dhënë është i mjaftueshëm, Presidenti duhet të kërkojë nga KQZ-ja të rekomandojë emrin e personit për ta mbushur vendin e lirë. KQZ-ja duhet që në afatin prej pesë (5) ditëve të punës nga momenti i marrjes së kërkesës, t'ia ofrojë Presidentit emrin radhës së personit të ligjshëm sipas paragrafit 2 të këtij neni

KREU XIX
SHPENZIMET/KOSTOJA E ZGJEDHJEVE

Neni 113
Financimi i zgjedhjeve

113.1. Qeveria e Kosovës financon mbajtjen e zgjedhjeve.
113.2. KQZ-ja administron fondet e ndara për mbajtjen e zgjedhjeve sipas normave të caktuara në këtë ligj.
113.3. Buxheti i KQZ-së përbën një vijë të veçantë në buxhetin shtetëror.
113.4. KQZ-ja i cakton rregullat për distribuimin dhe përdorimin e fondeve të nevojshme për mbajtjen e zgjedhjeve nga komisionet zgjedhore dhe funksionimit adekuat të sekretariatit të KQZ-së në përputhshmëri me përgjegjësit e saj, duke marrë parasysh ligjet e aplikueshme mbi menaxhimin e financave publike.
113.5. KQZ-ja mund të pranoj donacione, përveç parave të cilat janë në shërbim të procesit zgjedhor, duke mos ndërhyrë në pavarësinë dhe autoritetin e tij.
113.6. Brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve prej ditës së shpalljes të rezultateve zyrtare të zgjedhjeve, KQZ-ja do të publikoj një raport të plotë për shpenzimet zgjedhore dhe mënyrën e shpenzimit.
113.7. Përdorimi i drejtë i fondeve të caktuara për zgjedhje si dhe donacionet, kontrollohen nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës.

Neni 114
Përkrahja publike për fushatat zgjedhore

Institucionet publike, duhet t'u mundësojnë në baza të barabarta të gjitha subjekteve politike të certifikuara dhe KQZ-së qasje në godinat, pajisjet, si dhe tu ofrohen lehtësira tjera për të zhvilluar një fushatë zgjedhore në përputhshmëri me rregullat e tyre të zakonshme.

KREU XX
KOMISIONI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Neni 115
Emërimi i Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

115.1. KZAP është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar me këtë ligj dhe rregullat zgjedhore.
115.2. Kryetari i Gjykatës Supreme emëron anëtarët e KZAP-it nga mesi i gjykatësve të Gjykatës Supreme dhe gjykatave të qarkut. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Kryetari i Gjykatës Supreme emëron anëtarët e KZAP-it brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve.
115.3. Anëtarët e KZAP-it shërbejnë për një mandat të ripërtërishëm prej katër (4) viteve.
115.4. Në rast se një pozitë mbetet e zbrazët, Kryetari i Gjykatës Supreme ka kompetenca për të zëvendësuar cilindo anëtar të KZAP-it sipas zgjedhjes së tij, pas konsultimeve me KQZ-në.

Neni 116
Përbërja e KZAP-it

116.1. KZAP-i përbëhet nga pesë (5) anëtar, përfshirë edhe kryesuesin. KZAP-i mund të mblidhet në panele prej së paku tre (3) anëtarëve.
116.2. Anëtarët e emëruar të KZAP-it në periudhën duke filluar prej gjashtëdhjetë (60) ditë para ditës së zgjedhjeve deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve i japin përparësi të plotë obligimeve të tyre si anëtar të KZAP-it. Kërkohet nga të gjitha autoritetet kosovare t'i ofrojnë tërë ndihmën e nevojshme KZAP-it gjatë periudhës së lartpërmendur.

Neni 117
Procedurat e KZAP-it

117.1. KZAP-i vendos rregullat dhe procedurat e tij.
117.2. Gjatë vendosjes për një ankesë ose apel KZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se e konsideron këtë të nevojshme.
117.3. Vendosja për apelet dhe ankesat nga KZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.

117.4. KZAP-i mund të urdhërojë rinumërimin e fletëvotimeve në një vendvotim apo qendër votimi si dhe shqyrtimin e materialit votues si pjesë të hetimeve për ankesën ose apelin.

Neni 118
Vendimet

118.1. KZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.
118.2. KZAP-i ofron bazat ligjore dhe faktike për vendimet e tij me shkrim. KZAP-i u ofron kopjet e vendimeve të tij me shkrim, palëve të përfshira, brenda afatit prej dy (2) ditëve nga momenti i lëshimit të vendimit, në rast se ai ndikon në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve. Për vendimet tjera KZAP-i ofron kopjet e vendimeve të tij me shkrim palëve të përfshira në çështje, brenda pesë (5) ditëve të punës.
118.3. 18.3 Vendimet e KZAP-it publikohen në përputhshmëri me rregullat dhe procedurat e KZAP-it.
118.4. Mund të apelohet vendimi i KZAP-it, sikurse që KZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar apo edhe për shkak të vullnetit të mirë të treguar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës pranohet në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa 5,000 euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore. Gjykata Supreme u jep përparësi këtyre apeleve.
118.5. Vendimi i KZAP-it është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga KQZ-ja, përveç në rast se apeli i lejuar sipas këtij ligji ose Kushtetutës parashtrohet brenda kohës së paraparë dhe gjykata më e lartë përcakton ndryshe.

Neni 119
Ankesat

119.1. Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të KZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqesë një ankesë pranë KZAP-it.
119.2. Zyra mund të parashtrojë ankesë në KZAP sa i përket dështimit të subjektit politik për të vepruar në pajtim me këtë ligj ose rregullat e KQZ-së të cilat prekin procesin zgjedhor ose procesin e regjistrimit.
119.3. KZAP-i nuk merr parasysh një ankesë që ka të bëjë me vendim nga ana e KQZ-së, por do të mund të shqyrtojë një apel ndaj një vendimi të KQZ-s siç është saktësuar në nenin 122 të këtij ligji.
119.4. KZAP-i mund të vejë sanksione ndaj një Subjekti Politik për shkeljen e këtij ligji apo rregullave të KQZ-së të bëra nga anëtarët, përkrahësit dhe kandidatët e subjektit. Një subjekt politik mund t'i ofrojë fakte KZAP-it për të treguar se ka bërë përpjekje të arsyeshme për të parandaluar dhe dekurajuar anëtarët, përkrahësit dhe kandidatët për të mos shkelur këtë ligj ose rregullat zgjedhore. KZAP-i i shqyrton këto fakte për të vendosur për sanksionet përkatëse, në rast se

ka, për t'iu shqiptuar subjektit politik.

119.5. KZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtojë çështje të cilat përndryshe janë nën jurisdiskionin e tij kur kjo është rreptësishtë e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.

119.6. Ofrimi i informatave të rrejshme KZAP-it paraqet shkelje të këtij ligji të cilën gjë KZAP-i mund ta sanksionoj sipas nenit 12.1 të këtij ligji.

Neni 120
Përmirësimet dhe sanksionimet ndaj shkeljeve

120.1. Në rast se KZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të:
   a) urdhërojë një subjekt politik ose një organizatë vëzhguese të ndërmarrë masa përmirësuese;
   b) para certifikimit të rezultateve zgjedhore, dhe në rrethana të jashtëzakonshme është në zgjedhjen e vetë KZAP-it, për të anuluar rezultatet në një vendvotim apo të udhëzoj KQZ-në të urdhëroj përsëritjen e votimit në një qendër votimi; dhe
   c) të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik ose një organizate vëzhguese në një vlerë deri në dyqindmijë euro (€200,000).

120.2. Dështimi për të paguar dënimin apo për t'ju bindur një urdhërese të KZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e KZAP-it është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga KZAP-i.

120.3. Në rast se ka ndodhur një shkelje e këtij ligji ose rregullave zgjedhore, e cila e minon integritetin e zgjedhjeve, KZAP-i mund të:
   a) largojë një kandidat nga lista e kandidatëve, kur të dëshmohet se kandidati ishte përgjegjës për këtë shkelje;
   b) largojë një apo disa kandidatë nga lista e kandidatëve të një subjekti politik dhe të mos e lejoj subjektin politik t'i zëvendësojë kandidatët e larguar, nëse KZAP-i përcakton se subjekti ishte përgjegjës për këtë shkelje;
   c) decertifikojë një subjekt politik nga pjesëmarrja në zgjedhje; dhe
   d) ndalojë një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk i kalon gjashtë (6) vite.

120.4. KZAP-i ia drejton çfarëdo fonde të mbledhura nga gjobat Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.

120.5. Çdo vendosje e një gjobe ose ndonjë sanksionimi tjetër nga KZAP-i është pa paragjykim ndaj ndonjë sanksionimi penal që mund të pasojë.

Neni 121
Vëzhguesit Zgjedhor

121.1. KZAP-i mund të revokojë akreditimin e një organizate vëzhguese nëse ajo organizatë vëzhguese në mënyrë sistematike ose në mënyrë të organizuar ka shkelur këtë ligj ose rregullat zgjedhore.

121.2. KZAP-i mund të ndalojë një person të shërbejë ose të vazhdojë të shërbejë si një

vëzhgues zgjedhor nëse ai person ka shkelur këtë ligj, rregullat ose rregullat zgjedhore që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor.

Neni 122
Apelimet zgjedhore

122.1. Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të mëposhtme, vendime këto të marra nga KQZ-ja, mund të apelojë atë vendim në KZAP:
   a) përfshirjen ose largimin e një personi për të marrë pjesë në programin votues brenda dhe jashtë Kosovës;
   b) certifikimin ose kundërshtimin për të certifikuar një subjekt politik ose kandidat për të marrë pjesë në zgjedhje;
   c) kandidatin i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje;
   d) akreditimin ose refuzimin për akreditim të një vëzhguesi zgjedhor;
   e) vendosjen e një gjobe administrative ndaj një subjekti politik sipas nenit 42 të këtij ligji; dhe
   f) refuzimin për të regjistruar një parti politike brenda Zyrës.

122.2. KZAP-i do të mbështesë apelin ndaj vendimit të KQZ-së nëse vlerëson se KQZ-ja nuk ishte e arsyeshme në marrjen parasysh të të gjitha rrethanave.

122.3. Nëse KZAP-i mbështet apelin ndaj vendimit të KQZ-së, mundet të:
   a) udhëzojë KQZ-n ta rishqyrtojë vendimin e vet; dhe
   b) udhëzojë KQZ-në të marrë masa kompensimi.

Neni 123
Sekretariati i KZAP-it

123.1. KZAP-i ndihmohet në ushtrimin e përgjegjësive dhe funksioneve të tij nga Sekretariati i cili punon në pajtim me këtë ligj.

123.2. Asnjë person nuk mund të shërbejë në KZAP nëse ai ose ajo:
   a) mban ose kërkon zyrë publike;
   b) mban ndonjë post zyrtar ose post ekzekutiv në parti politike; ose
   c) ka qenë penalisht i/e dënuar.

123.3. Sekretariati i KZAP-it:
   a) pranon ankesa dhe apele;
   b) arkivon, përkthen dhe heton rastet;
   c) mirëmban adresë zyrtare dhe qasje në informatat në çdo kohë rreth vendimeve të KZAP-it në të gjitha gjuhët zyrtare sipas Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

123.4. Sekretariati i KZAP-it ka një udhëheqës zyre i cili, nën drejtimin e Kryesuesit të KZAP-it, është përgjegjës për:
   a) të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e KZAP-it;
   b) përgatitjen e paneleve të KZAP-it duke siguruar se i tërë materiali i nevojshëm është në dispozicion;
   c) organizimin e Sekretariatit dhe nxjerrjen e procedurave administrative për çfarëdo çështje që ka të bëjë me funksionet e KZAP-it.

123.5. Sekretariati i KZAP-it ka buxhetin vjetor të ndarë nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për të mbuluar shpenzimet për funksionimin e duhur të Sekretariatit, duke u bazuar në propozim buxhetin e dorëzuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme.

KREU XXI
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 124
Interpretimi ligjor dhe zbatushmëria

Ky ligji e zëvendëson çdo dispozitë në ligjet e aplikueshme.

Neni 125
Të gjitha rregullat dhe format

Të gjitha rregullat e referuara në këtë ligj përgatiten nga Sekretariati i KQZ-së dhe miratohen nga KQZ-ja me shumicën e thjeshtë. Të gjitha këto rregulla janë në dispozicion me kohë, në faqen e internetit të Sekretariatit të KQZ-së.

Neni 126
Sanksionet dhe dënimet

126.1. KQZ-ja ose gjykata e shkallës së parë mund të shqiptojë dënime për shkeljen e dispozitave të këtij ligji, kur ato nuk përbëjnë vepër penale dhe nuk janë shqyrtuar nga KZAP-i, dhe janë të dënueshme me një gjobë prej 200 deri në 2,000 euro.
126.2. KQZ-ja miraton rregulla zgjedhore ku i përcakton sanksionet dhe gjobat për secilin lloj të shkeljes së rregullave.

Neni 127
Dispozitat kalimtare

Organet administrative përgjegjëse për organizimin e zgjedhjeve vazhdojnë të shërbejnë në pozitat e tyre deri në caktimin e organeve të reja.

Neni 128
Zbatimi

128.1. KQZ-ja nxjerr legjislacion dytësor për zbatimin e këtij ligji. Brenda nëntë (9) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, KQZ-ja i miraton rregullat e referuara në këtë ligj;
128.2. KQZ-ja nxjerr rregulla të nevojshme për zbatimin e këtij ligji.

Neni 129
Hyrja në fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-073
5 qershor 2008

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III / Nr. 31 / 15 QERSHOR 2008

LIGJI Nr. 03/L-256
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-073 PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-073 PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Neni 1

Neni 3 i ligjit në fuqi, përkufizimi "KZAP" riformulohet si vijon:
"PZAP" do të thotë Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, një organ i pavarur përgjegjës për vendosjen për parashtresat dhe ankesat në lidhje me procesin zgjedhor.

Neni 2

Në tërë tekstin e ligjit në fuqi **"KZAP" -** Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, zëvendësohet me **"PZAP"** - Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

Neni 3

Neni 4 i ligjit në fuqi, paragrafi 3. riformulohet si në vijon:

4.3. Sipas kompetencave të Presidentit të përcaktuara me Kushtetutë, vendimi i Presidentit për të caktuar datën e zgjedhjeve bëhet jo më herët se katër (4) muaj dhe jo më vonë gjashtë (6) muaj para datës së zgjedhjeve. Vendimi përmban datën e zgjedhjeve.

Neni 4

Neni 105 i ligjit në fuqi, paragrafi 1. riformulohet si në vijon:

105.1. Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QNR dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

Neni 5

Neni 105 i ligjit në fuqi, paragrafi 3. riformulohet si në vijon:

105.3. Për të gjitha ankesat e marra nga PZAP-i vendoset jo më vonë se shtatëdhjetedy (72) orë nga momenti i pranimit të ankesave në zyrat qendrore të PZAP-it.

Neni 6

Neni 106 i ligjit në fuqi, paragrafi 1. riformulohet si në vijon:

106.1. KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha ankesat që u përkasin votimit dhe numërimit të vendosura nga PZAP-i dhe çdo apel ndaj vendimeve të PZAP-it lidhur me to të jetë vendosur nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Neni 7

Neni 110 i ligjit në fuqi riformulohet si në vijon:

110.1. Kosova konsiderohet një zonë e vetme zgjedhore.

110.2. Subjekti politik që nuk është kandidat i pavarur e paraqet listën e kandidatëve në përputhje me nenin 27, nenin 29 dhe rregullat e KQZ-së.

110.3. Secili subjekt politik i certifikuar paraqitet në votim me "listë të hapur".

110.4. Votuesi pajiset më një fletëvotim të vetëm për zgjedhje dhe

a) e shënjon atë me votën për një (1) subjekt politik, dhe
b) mund që po ashtu të shënojë atë me vota për deri në pesë (5) kandidatë nga lista e subjektit politik për të cilin ka votuar votuesi.

110.5. Nëse një fletëvotim shënjohet për më shumë se pesë (5) kandidatë, atëherë numërohet vetëm vota e hedhur për subjektin politik.

Neni 8

1. Neni 111 i ligjit në fuqi, paragrafi 4. riformulohet si në vijon:

111.1. Të gjitha votat e fituara nga kandidatët që janë në listën e hapur të subjektit politik numërohen ndaras. Listat me kandidatë rirenditen sipas mënyrës zbritëse në bazë të numrit të votave të fituara për secilin kandidat.

2. Neni 111 i ligjit në fuqi, paragrafi 6. riformulohet si në vijon:

111.6. Nëse pas ndarjes së vendeve të përcaktuara për kandidatët në listën e një subjekti politik, ashtu siç është përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të ndarë për atë subjekt politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga kandidati i radhës i gjinisë pakicë në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%. Ky paragraf nuk zbatohet ndaj ndarjes së vendeve nga lista që përbëhet prej një (1) apo dy (2) kandidatëve.

Neni 9

Neni 115 i ligjit në fuqi, paragrafi 2. riformulohet si në vijon:

115.2. Kryetari i Gjykatës Supreme emëron kryesuesin e PZAP-it nga mesi i gjykatësve të Gjykatës Supreme dhe emëron anëtarët nga mesi i gjykatësve të gjykatave të qarkut. Pas hyrjes në fuqi të këtij paragrafi, Kryetari i Gjykatës Supreme emëron kryesuesin dhe anëtarët e PZAP-it brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

Neni 10

Neni 115 i ligjit në fuqi, paragrafi 4. riformulohet si në vijon:

115.4. Në rast se pozita e kryesuesit apo një anëtari mbetet e zbrazët, Kryetari i Gjykatës Supreme emëron një person në atë pozitë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve në pajtim me nenin 115.2.

Neni 11

1. Neni 116 i ligjit në fuqi, paragrafi 1. riformulohet si në vijon:

116.1. PZAP-i përbëhet nga dhjetë (10) anëtar, përfshirë edhe kryesuesin. PZAP-i mund të mblidhet në seanca të ndara me nga së paku tre (3) anëtar.

Neni 12

1. Neni 118 i ligjit në fuqi, paragrafi 2. riformulohet si në vijon:

118.2. PZAP-i ofron bazat ligjore dhe faktike për vendimet e tij me shkrim. PZAP-i u ofron kopjet e vendimeve të tij me shkrim, palëve të përfshira, brenda afatit prej s h t a t ë d h j e t e d y (72) orëve nga momenti i lëshimit të vendimit, në rast se ai ndikon në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve. Për vendimet tjera KZAP-i ofron kopjet e vendimeve të tij me shkrim palëve të përfshira në çështje, brenda pesë (5) ditëve kalendarike.

2. Neni 118 i ligjit në fuqi, paragrafi 4. riformulohet si në vijon:

118.4. Mund të apelohet vendimi i PZAP-it, sikurse që PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore. Gjykata Supreme vendos në afatin prej shtatëdhjetedy (72) orëve pas paraqitjes së apelit.

3. Neni 118 i ligjit në fuqi, paragrafi 5. riformulohet si në vijon:

118.5. Vendimi i PZAP-it është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga KQZ-ja, përveç në rast se apeli i lejuar parashtrohet brenda kohës së paraparë dhe Gjykata Supreme përcakton ndryshe.

Neni 13

Neni 119 i ligjit në fuqi, paragrafi 1. riformulohet si në vijon:

119.1. Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të P ZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore,, mund të paraqesë ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP-i do të vendos për ankesën brenda 72 orëve nga koha kur është pranuar ankesa.

Neni 14

Neni 120 i ligjit në fuqi, paragrafi 1. pikat b) dhe c) riformulohen si në vijon:

b) para certifikimit të rezultateve zgjedhore, është në kompetencë të PZAP-it, në raste të jashtëzakonshme të anulojë rezultatet në një vendvotim apo qendër votimi, dhe ta urdhërojë KQZ-ën ti përsërisë votimin në një qendër votimi apo vendvotim, nëse konsideron se ka ndikim në rezultatet finale; dhe

c) të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri në pesëdhjetëmijë euro (50,000) Euro.

Neni 15

Neni 122 i ligjit në fuqi, paragrafi 1. riformulohet si në vijon:

122.1. Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të mëposhtme, vendime këto të marra nga KQZ-ja, mund të apelojë atë vendim në PZAP brenda njëzetekatër (24) orëve pasi që vendimi i apeluar shpallet nga KQZ-ja dhe apeli duhet të vendoset nga PZAP-i brenda shtatëdhjetedy (72) orëve pasi të jetë parashtruar apeli:

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi ditën e dekretimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-256
29 tetor 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-067-2010, datë 01.11.2010 nga u.d. Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 87 / 16 NËNTOR 2010

LIGJI Nr. 02/L-37
PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE

Përmbajtja

Pjesa e parë: Dispozitat e përgjithshme 130
Pjesa e dytë: Dispozitat e veçanta 132
Pjesa e tretë: Zbatimi 139
Pjesa e katërt: Dispozitat kalimtare dhe të fundit 140

Kuvendi i Kosovës

Në bazë Kreut 5.4 (a), 5.7, 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001, dhe

me qëllim të respektimit të identitetit gjuhësor të të gjithë personave dhe me qëllim të krijimit të një mjedisi për të gjitha komunitetet që të shprehin dhe të ruajnë identitetin e tyre gjuhësor,

duke u bazuar në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore dhe në Protokollet e saj, Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare, dhe

dhe duke pasur parasysh Rekomandimet e Hagës lidhur me të drejtat e shkollimit të pakicave kombëtare dhe Rekomandimet e Oslos lidhur me të drejtat gjuhësore të pakicave kombëtare, Udhëzimet mbi përdorimin e gjuhëve minoritare në mediat transmetuese, si dhe me qëllim që të rregullojë përdorimin e gjuhëve,

Miraton:

LIGJIN PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE

PJESA E PARË
Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

1.1. Qëllimi i këtij ligji është që të sigurojë:
   i. Përdorimin e gjuhëve zyrtare, si dhe të gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare, në institucionet e Kosovës, në ndërmarrje dhe organizata të tjera që realizojnë funksione dhe shërbime publike;
   ii. Status të barabartë të gjuhës shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare në Kosovë, të

drejta të barabarta sa i përket përdorimit të tyre në të gjitha institucionet e Kosovës;

iii. Të drejtën e të gjitha komuniteteve të Kosovës për të ruajtur, mbrojtur dhe promovuar identitetin e tyre gjuhësor;

iv. Karakterin shumë gjuhësor të shoqërisë kosovare, që paraqet vlerat e saj unike shpirtërore, intelektuale, historike dhe kulturore.

1.2. Në nivelin komunal, gjuhët e tjera të bashkësive, si gjuha turke, boshnjake dhe rome, do të jenë gjuhë në përdorim zyrtar, sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 2

2.1. Gjuha shqipe dhe gjuha serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhë zyrtare në Kosovë dhe kanë status të barabartë në institucionet e Kosovës.

2.2. Të gjithë personat kanë të drejta të barabarta në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare në institucionet e Kosovës.

2.3. Në komunat e banuara nga një bashkësi, gjuha amtare e të cilës nuk është gjuhë zyrtare dhe e cila përbën së paku 5 përqind të popullsisë së përgjithshme të asaj komune, gjuha e asaj bashkësie do t ketë statusin e gjuhës zyrtare në at komunë dhe do përdoret barabartë me gjuhët zyrtare. Pavarësisht kësaj që u tha m lartë, në mënyrë të veçantë, në komunën e Prizrenit gjuha Turke do të ketë statusin e gjuhës zyrtare.

2.4. Në ato komuna ku jeton një bashkësi, gjuha amtare e së cilës nuk është njëra nga gjuhët zyrtare në Kosovë dhe e cila përfaqëson më shumë se tre (3) përqind të popullatës së përgjithshme të komunës, gjuha e asaj bashkësie do të ketë statusin e gjuhës në përdorim zyrtar në atë komunë dhe do të jetë në përdorim të barabartë në pajtim me dispozitat e përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji. Përveç kësaj, një bashkësi, gjuha e së cilës me traditë është folur në një komunë, do të ketë statusin e gjuhës në përdorim zyrtar në atë komunë. Lidhur me këtë çështje, komunat do të miratojnë rregullore të hollësishme brenda 6 muajve pas hyrjes së këtij ligji në fuqi, në pajtim me nenin 35 të këtij ligji.

2.5. Institucionet e Kosovës do të sigurojnë të drejtat gjuhësore të personave që iu takojnë komuniteteve gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare, në pajtueshmëri me dispozitat e këtij ligji.

Neni 3

3.1. Çdo person ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pranuar, kërkuar dhe për të dhënë informata dhe ide në gjuhën e zgjedhur, pa ndërhyrje. Pranimi i lirë i transmetimit tejkufitar, qoftë i drejtpërdrejtë apo nëpërmjet të ritransmetimit apo riemetimit nuk ndalohet në baza të gjuhës. Ushtrimi i kësaj lirie mund t'u nënshtrohet kufizimeve të tilla, që janë në pajtueshmëri me traktatet ndërkombëtare obliguese të të drejtave të njeriut.

3.2. Çdo person ka të drejtën për barazi para ligjit dhe të mbrojtjes së barabartë nga ligji. Ndalohet çdo diskriminim në baza gjuhësore.

PJESA E DYTË
Dispozitat e veçanta

Përdorimi i gjuhëve në institucionet qendrore
Neni 4

4.1. Në institucionet qendrore të Kosovës zbatohet barazia e gjuhëve zyrtare.
4.2. Çdo person ka të drejtë të komunikojë dhe të pranojë shërbimet në dispozicion dhe dokumentet publike nga institucionet qendrore të Kosovës në cilëndo gjuhë zyrtare. Të gjitha institucionet qendrore kanë për detyrë të sigurojnë që çdo person mund të komunikojë dhe mund të pranojë shërbimet në dispozicion dhe dokumentet publike nga organet dhe institucionet e tyre në cilëndo gjuhë zyrtare.
4.3. Gjuhët zyrtare përdoren në baza të barabarta në takime dhe në punën e institucioneve qendrore. Institucionet qendrore do të mundësojnë përkthimin nga një gjuhë zyrtare në tjetrën, nëse kërkohet një përkthim i tillë, për takimet e institucioneve qendrore, si dhe në takimet publike të organizuara nga këto institucione.
4.4. Anëtarët e Qeverisë, gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare, kanë të drejtë të përdorin gjuhën e tyre amtare në takimet e institucioneve qendrore dhe në takimet publike të organizuara nga këto institucione. Nëse kërkohet, institucionet qendrore sigurojnë përkthimin.
4.5. Shënimet dhe dokumentet zyrtare do të mbahen dhe nxirren në gjuhët zyrtare.
4.6. Emrat zyrtarë të institucioneve qendrore paraqiten në gjuhët zyrtare si dhe në gjuhët zyrtare të komunës.
4.7. Institucionet qendrore duhet të sigurojnë që mjedisi i tyre i punës të kontribuojë në përdorimin efektiv të gjuhëve zyrtare si dhe të mundësojë përdorimin e cilësdo gjuhë zyrtare nga zyrtarët dhe punëtorët e tyre.

Neni 5

5.1. Gjuhët zyrtare përdoren në baza të barabarta në punë, në debate dhe në procedurat e tjera të Kuvendit të Kosovës dhe të komisioneve të tij. Mjetet duhet të ofrohen në dispozicion për përkthim simultan nga një gjuhë zyrtare në tjetrën për debatet dhe procedurat e tjera të Kuvendit të Kosovës dhe të komisioneve të tij.
5.2. Anëtarët e Kuvendit të Kosovës, gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare kanë të drejtë të përdorin gjuhën e tyre amtare në punën dhe në takimet e Kuvendit të Kosovës dhe të komisioneve të tij, si dhe në takimet publike të organizuara nga Kuvendi i Kosovës. Mjetet duhet të sigurohen për të mundësuar përkthimin nga dhe në gjuhën e anëtarit, nëse kërkohet një shërbim i tillë. Çdo dokument i dorëzuar nga anëtari i tillë përkthehet në gjuhët zyrtare dhe të gjitha përgjigjet e kërkuara të kthehen në gjuhën e përdorur nga ana e tij.
5.3. Dokumentet zyrtare si dhe të dhënat zyrtare të debateve dhe të procedurave të tjera të Kuvendit të Kosovës dhe të komisioneve të tij, mbahen dhe nxirren në gjuhët zyrtare.
5.4. Të gjitha ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës, nxirren dhe publikohen në

gjuhët zyrtare. Versionet në gjuhët zyrtare janë të barasvlershme. Të gjitha ligjet e shpallura publikohen në gjuhën boshnjake dhe turke.

Neni 6

Personat që i takojnë një komuniteti, gjuha amtare e të cilit nuk është gjuhë zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin shkresat në mënyrë të shkruar dhe gojore, në institucionin e Ombudspersonit si dhe të pranojnë përgjigjen në gjuhën e tyre amtare nga institucioni përkatës.

Përdorimi i gjuhëve në institucionet komunale
Neni 7

7.1. Në institucionet komunale zbatohet barazia e gjuhëve zyrtare të komunës.
7.2. Çdo person ka të drejtë të komunikoj dhe të pranojë shërbimet e mundshme dhe dokumentet publike nga institucionet komunale dhe nga zyrtarët në cilëndo gjuhë zyrtare. Çdo organ përfaqësues dhe ekzekutiv komunal ka për detyrë të sigurojë se çdo person mund të komunikojë dhe të pranojë shërbimet në dispozicion dhe dokumentet publike nga çdo institucion dhe organ komunal ne cilëndo gjuhë zyrtare.
7.3. Gjuhët zyrtare përdoren në baza të barabarta në takimet dhe në punën e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive komunale. Institucionet komunale do të mundësojnë përkthimin nga një gjuhë zyrtare në tjetrën, nëse kjo kërkohet, në takimet e këtyre organeve përfaqësuese dhe ekzekutive komunale, po ashtu edhe në takimet publike të organizuara nga komuna.
7.4. Shënimet e takimeve dhe shënimet zyrtare të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive komunale, regjistrat publikë dhe dokumente të tjera zyrtare, mbahen dhe lëshohen në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës.
7.5. Institucionet komunale duhet të sigurojnë që mjedisi i tyre i punës të kontribuojë në përdorimin efektiv të gjuhëve zyrtare si dhe të mundësojë përdorimin e cilësdo gjuhë zyrtare nga zyrtarët dhe punëtorët e tyre.
7.6. Rregulloret dhe aktet plotësuese të miratuara nga institucionet komunale nxirren dhe publikohen në gjuhët zyrtare të komunës. Versionet në gjuhët zyrtare janë të barasvlershme.

Neni 8

8.1. Në komunat, personat të cilët iu takojnë komuniteteve, gjuha e të cilëve është në përdorim zyrtar, në pajtueshmëri me nenin 2.4, kanë të drejtën të paraqesin të gjitha kërkesat dhe dokumentet në formë të shkruar apo gojore si dhe të pranojnë përgjigjet në gjuhën e tyre nga institucionet dhe nga zyrtarët komunalë, nëse ata kërkojnë kështu.
8.2. Çdo organ përfaqësues dhe ekzekutiv komunal ka për detyrë të sigurojë që personat e tillë të mund të paraqesin kërkesat dhe dokumentet në formë të shkruar apo gojore si dhe të marrin përgjigjet në gjuhën e tyre.
8.3. Rregulloret komunale si dhe aktet ndihmëse duhet të nxirren dhe të publikohen në gjuhët e komuniteteve të tilla, nëse atë e kërkojnë.

8.4. Në punën dhe në takimet e organeve përfaqësuese komunale dhe komiteteve të tyre, si dhe në takimet publike të organizuara nga komuna, anëtarët e të cilave iu takojnë komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare, kanë të drejtë të përdorin gjuhën e tyre në punë dhe në takimet e organeve përfaqësuese të komunës, dhe komiteteve të tyre si dhe në takimet publike të organizuara nga komuna. Mjetet duhet të sigurohen për të mundësuar përkthimin nga dhe në gjuhën e anëtarit, nëse kërkohet një shërbim i tillë. Çdo dokument i dorëzuar nga anëtari i tillë përkthehet në gjuhët zyrtare dhe të gjitha përgjigjet e kërkuara do të kthehen në gjuhën e përdorur nga ana e tij.

Neni 9

9.1. Emrat zyrtarë të institucioneve dhe të organeve komunale paraqiten në gjuhët zyrtare dhe në gjuhët që kanë statusin e gjuhës zyrtare sipas nenit 2.3.

9.2. Shenjat zyrtare që shënojnë apo përfshijnë emrat e komunave, fshatrave, rrugëve, rrugicave dhe të vendeve të tjera publike, paraqiten në gjuhët zyrtare dhe në gjuhët e komuniteteve, gjuha e të cilave ka statusin e gjuhës zyrtare në komunë, në pajtueshmëri me nenin 2.3.

Neni 10

Ministria për Administrim të Qeverisjes Lokale nxjerr udhëzim administrativ, që përcakton procedurat sipas të cilave komunitetet mund të shprehin kërkesat e tyre në pajtueshmëri me nenet 8.1, 8.2, 8.3 dhe 9.1 të këtij ligji 90 ditë pas shpalljes së këtij ligji.

Përdorimi i gjuhëve në ndërmarrjet publike
Neni 11

11.1. Në ndërmarrjet që janë në pronësi publike dhe në ndërmarrjet në pronësi shoqërore aplikohet barazia e gjuhëve zyrtare.

11.2. Çdo person ka të drejtë të komunikojë dhe të pranojë shërbimet dhe dokumentet nga ndërmarrjet në pronësi publike dhe nga ndërmarrjet në pronësi shoqërore në cilëndo nga gjuhët zyrtare.

11.3. Çdo ndërmarrje e tillë ka për detyrë të sigurojë që çdo person të mund të komunikojë dhe të pranojë shërbimet dhe dokumentet në cilëndo gjuhë zyrtare.

Përdorimi i gjuhëve në procedurat gjyqësore
Neni 12

12.1. Gjuhët zyrtare përdoren në mënyrë të barabartë në procedurat gjyqësore.

12.2. Gjykatat dhe organet për ndjekje penale, si dhe autoritetet e tjera të përfshira në procedurë penale dhe në procedurat e tjera gjyqësore, sigurojnë që çdo person që merr pjesë në procedurat penale si dhe në procedura të tjera gjyqësore mund të përdorë gjuhën zyrtare të cilën ai/ajo e zgjedh.

Neni 13

13.1. Gjykatat zhvillojnë procedurat në gjuhën zyrtare apo në gjuhët zyrtare të zgjedhura nga palët në procedura. Me kërkesën e palës në procedura, pajisjet duhet të sigurohen për përkthim simultan, duke përfshirë dëshmitë e dhëna, nga njëra gjuhë zyrtare në tjetrën.
13.2. Gjykatat mund të sigurojnë pajisjet për përkthim simultan të procedurave, duke përfshirë dëshmitë e dhëna, nga një gjuhë zyrtare në tjetrën, atëherë kur konsiderojnë se procedurat të jenë në interesin e përgjithshëm publik.

Neni 14

Gjykatat kanë për detyrë të lëshojnë dokumente të cilat kanë të bëjnë me procedurat në gjuhën(t) zyrtare të zgjedhur për procedurë dhe në gjuhë të tjera zyrtare nëse kërkohet nga cilado palë në procedurë apo nëse sipas pikëpamjes së gjykatës kjo do t'i shërbente interesit të përgjithshëm publik.

Neni 15

15.1. Çdo person që është i arrestuar apo i akuzuar për vepër penale dhe që nuk flet ose nuk kupton gjuhën(t) e procedurave ka të drejtën të njoftohet me kohë rreth arsyeve të arrestimit dhe për çdo akuzë kundër tij apo saj në gjuhën të cilën e kupton personi.
15.2. Personat që i takojnë komunitetit, gjuha amtare e të cilit nuk është gjuhë zyrtare, ka të drejtën të informohet me kohë rreth arsyeve për arrestimin e tyre dhe për çdo akuzë kundër tyre në gjuhën amtare të tyre.

Neni 16

16.1. Çdo person që merr pjesë në procedurat penale dhe në procedura të tjera gjyqësore, i cili nuk flet ose nuk kupton gjuhën (t) e procedurave, ka të drejtë të përdorë gjuhën e tij apo të saj në procedura.
16.2. Personat që i takojnë komunitetit, gjuha amtare e të cilit nuk është gjuhë zyrtare dhe që marrin pjesë në procedura penale dhe procedurë penale dhe ne procedurat tjera gjyqësore, kanë të drejtë të përdorin gjuhën e tyre amtare në procedura.
16.3. Gjykata dhe organet për ndjekje penale si dhe autoritetet e tjera të përfshira në procedurë penale, duhet të ofrojnë ndihmën me përkthyes pa pagesë për personat e cekur në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 17

17.1. Çdo person që merr pjesë në procedura penale, i cili nuk flet ose nuk kupton gjuhën(t) e procedurave, ka të drejtë të paraqesë shkresat, të dëshmojë dhe të dëgjojë faktet e rastit dhe të çdo dëshmie kundër tij apo saj, në gjuhën e folur nga ai apo ajo.
17.2. Personat që i takojnë komunitetit, gjuha amtare e të cilit nuk është gjuhë zyrtare

dhe që marrin pjesë në procedura penale, kanë të drejtën të paraqesin shkresat, të dëshmojnë dhe të dëgjojnë faktet për rastin dhe çdo dëshmie kundër tyre, në gjuhën e tyre amtare.

17.3. Gjykatat apo organet për ndjekje penale, si dhe autoritetet e tjera të përfshira në procedurën penale, duhet të ofrojnë ndihmën me përkthyes pa pagesë për personat e cekur në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 18

Institucionet penale dhe të burgut duhet të sigurojnë që personeli i tyre të flasë gjuhën(t) e numrit më të madh të të burgosurve, apo gjuhën(t) të cilën e kuptojnë ata. Përkthimi në gjuhën që është e kuptueshme nga një person i burgosur duhet të ofrohet atëherë kur ka nevojë.

Përdorimi i gjuhëve në arsim
Neni 19

19.1. Gjuhët e ligjërimit në arsimin publik duhet të jenë në pajtim me dispozitat e Kornizës Kushtetuese dhe të ligjeve nga lëmi i arsimit.

19.2. Çdo person ka të drejtë të zgjedhë, si dhe të zgjedhë për fëmijën e vet, gjuhën e vet të preferuar zyrtare për mësim.

19.3. Çdo person ka të drejtë të regjistrohet, si dhe të regjistrojë fëmijën e vet, në shkollën ku gjuha e tij e zgjedhur zyrtare është gjuhë e mësimit.

19.4. Në komunat ku gjuha e zgjedhur zyrtare e personit nuk përdoret nga asnjë shkollë në mësim, do të përcaktohen dispozita përkatëse për të siguruar mësimin e duhur në gjuhën e tyre të zgjedhur zyrtare. Hollësitë për implementim përcaktohen nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Neni 20

20.1. Në zonat e banuara me persona që i takojnë komunitetit, gjuha amtare e të cilit nuk është gjuhë zyrtare, personat që i takojnë këtij komuniteti kanë të drejtë të mësojnë në gjuhën e tyre amtare në shkollat publike arsimore.

20.2. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë përmes një udhëzimi administrativ do të përcakton detajet për zbatimin e së drejtës së përcaktuar sipas paragrafit 20.1.

Neni 21

21.1. Në shkollat fillore dhe të mesme, ku gjuha e mësimit nuk është gjuhë zyrtare nxënësit gjithashtu mësojnë një gjuhë zyrtare të cilën e zgjedhin.

21.2. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë përmes një udhëzimi administrativ përcakton procedurat sipas të cilave personat mund të deklarojnë se cilën gjuhë zyrtare dëshirojnë ta mësojnë gjatë shkollimit të mesëm.

Neni 22

22.1. E drejta e personave për të themeluar institucione arsimore private me mësim në gjuhën amtare është e garantuar në Kosovë.
22.2. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë vendos procedurën për regjistrim të institucioneve arsimore private të tilla.

Neni 23

23.1. Gjuhët zyrtare të Kosovës janë gjuhë parësore të mësimit në universitetet publike.
23.2. Rregullat detaje të përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe të çdo gjuhe tjetër, në programet arsimore, përcaktohen nga universitetet përmes akteve të tyre.
23.3. Në trajnimin e arsimtarëve, interpretuesve dhe të përkthyesve në gjuhët e komuniteteve, universitetet përshtatin përdorimin e gjuhëve të komuniteteve si gjuhë të mësimit.
23.4. Përdorimi i gjuhës në administratën universitare përcaktohet nga universitetet përmes rregulloreve të tyre, që duhet t'iu përshtaten dispozitave të këtij ligji.

Neni 24

24.1. Nxënësi së bashku me prindin e tij apo të saj vendos se në cilën gjuhë zyrtare do të mbahen shënimet shkollore dhe lëshohen raportet e tij apo të saj, nga ana e institucionit arsimor në të cilin ata vijojnë. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë përmes udhëzimit administrativ vendos procedurën sipas së cilës personat deklarojnë se në cilën gjuhë zyrtare dëshirojnë të mbahen shënimet e tyre.
24.2. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë përcakton procedurat për lëshimin e certifikatave shkollore në gjuhët zyrtare të Kosovës nëpërmjet një udhëzimi administrativ 90 ditë pas shpalljes së këtij Ligji.
24.3. Nxënësi i cili arsimohet sipas nenit 20.1 ka të drejtë t'i ketë shënimet e tyre shkollore të mbajtura si dhe raportet dhe certifikatat të lëshuara, në gjuhën amtare të tij/saj, përpos gjuhëve zyrtare.

Përdorimi i gjuhëve në Media
Neni 25

Çdo person ka të drejtë të themelojë medie në gjuhën të cilën ai/ajo e zgjedh në përputhje me ligjin në fuqi.

Neni 26

26.1. Transmetuesit publik avancojnë diversitetin kulturor dhe karakterin shumë gjuhësor në Kosovë në përputhje me ligjin në fuqi.
26.2. Komunitetet kanë të drejtë të kenë kohën për transmetim të programeve në gjuhën e tyre në Transmetues publik, në pajtim me ligjin në fuqi.

26.3. Përdorimi i gjuhëve gjatë transmetimit në Transmetues publik, koha e transmetimit dhe programet në nenin 26.2 përcaktohen me një ligj tjetër, duke marrë plotësisht në konsideratë të drejtat dhe intereset e anëtarëve të komunitetit për të patur mundësi dhe qasje të barabartë në informatë.

Emrat personal
Neni 27

27.1. Emri dhe mbiemri i personit regjistrohet në regjistrat publikë, në dokumentet për identifikim personal dhe në dokumente të tjera zyrtare në sistemin me shkrim në gjuhët zyrtare të zgjedhur nga ai person.
27.2. Personat që i takojnë komunitetit, gjuha amtare e të cilit nuk është gjuhë zyrtare, do të kenë të drejtën të regjistrojnë formën origjinale të emrit dhe mbiemrit të tyre në shkrimin dhe në pajtueshmëri me traditat dhe sistemin linguistik të gjuhës së tyre, si në regjistrat publikë, në dokumente për identifikim personal dhe në dokumente të tjera zyrtare, si dhe kjo formë do të përdoret nga zyrtarët publikë.

Liria linguistike
Neni 28

Të gjithë personat kanë të drejtë të themelojnë dhe mbajnë subjekte juridike siç janë shoqatat kulturore dhe ndërmarrjet e biznesit në gjuhën e tyre, përfshirë këtu edhe shfaqjen e këtyre emrave në bazë të traditës së tyre dhe sistemit gjuhësor.

Përdorimi i gjuhëve zyrtare në sferën private
Neni 29

29.1. Çdo person ka të drejtë të veprojë në ndërmarrjet private, institucionet private, shoqatat, organizatat apo aktivitetet e vetëpunësimit në gjuhën apo gjuhët sipas zgjidhjes së tyre.
29.2. Kur gjuha në rastet e numëruara në paragrafin 1 nuk është njëra nga gjuhët zyrtare, institucionet e Kosovës kërkojnë një përdorim shtesë të gjuhëve zyrtare, kur aktivitetet e tyre ndikojnë në interesin legjitim publik siç është rendi publik, siguria publike, shëndeti, apo mbrojtja e të drejtave të personave të tjerë si dhe për qëllime të mbikëqyrjes së administratës publike.

Neni 30

30.1. Në ndërmarrjet që kryejnë shërbime publike aplikohet barazia e gjuhëve zyrtare në kryerjen e këtyre shërbimeve.
30.2. Çdo person ka të drejtë të komunikojë dhe të pranojë shërbimet dhe dokumentet nga ndërmarrjet që kryejnë shërbime publike në cilëndo gjuhë zyrtare. Çdo ndërmarrje e tillë ka për detyrë të sigurojë që çdo person të mund të komunikojë dhe të pranojë shërbimet dhe dokumentet në cilëndo gjuhë zyrtare.
30.3. Në komunat e banuara nga komunitetet, gjuha e të cilave gëzon statusin e gjuhës që flitet në komunë, vlejnë dispozitat e neneve 30.1 dhe 30.2.

PJESA E TRETË
Zbatimi

Neni 31

Qeveria e Kosovës dhe institucionet e tjera do të miratojnë masat për promovimin e përdorimit dhe statusit të barabartë të gjuhëve zyrtare si dhe për të siguruar mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare.

Komisioni i gjuhëve
Neni 32

32.1. Me qëllim të ruajtjes, promovimit, apo mbrojtjes së gjuhëve zyrtare dhe statusit të barabartë të tyre në Kosovë, si dhe për të siguruar mbrojtjen e gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare, Qeveria e Kosovës do të themelojë Komisionin e Gjuhëve për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji.

32.2. Komisioni i gjuhëve do të marrë masa dhe veprime brenda kompetencave të tij për të siguruar njohjen e statusit të barabartë të gjuhëve zyrtare në përputhshmëri me këtë ligj.

32.3. Komisioni i gjuhëve do të zhvillojë dhe realizojë hetimet sipas ankesave që i janë drejtuar, duke vepruar apo mos vepruar kur:
   i. Statusi i barabartë i gjuhëve zyrtare nuk është njohur apo nuk njihet.
   ii. Çdo dispozitë e çdo ligji apo rregullore në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare apo gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare, nuk është respektuar apo nuk respektohet.

32.4. Komisioni i Gjuhëve mund gjithashtu të kryejë hetime me iniciativë të vet.

32.5. Komisioni i Gjuhëve mund të ndërmjetësojë në situatat kur ndërmjetësimi i tillë kërkohet për të siguruar zbatimin e këtij ligji.

32.6. Në konkludim të hetimit, Komisioni i Gjuhëve mund të nxjerrë rekomandime mbi korrigjimet e kërkuara dhe rekomandon përmirësimet.

32.7. Aty ku rekomandimet e Komisionit të Gjuhës nuk janë zbatuar brenda një periudhe të arsyeshme, ashtu siç është përcaktuar nga Komisioni, Komisioni mund të lëshojë vërejtje me shkrim.

32.8. Aty ku rekomandimet e Komisionit të gjuhëve nuk janë zbatuar brenda një periudhe të arsyeshme, pasi Komisioni të ketë lëshuar vërejtjen me shkrim, kjo duhet të citohet në raportin vjetor të Komisionit për Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës.

32.9. Komisioni i Gjuhëve mund të shqyrtoj dhe të bëjë rekomandime në lidhje me:
   i. çdo rregullore apo udhëzim administrativ të nxjerrë për zbatimin e këtij ligji dhe
   ii. çdo rregullore apo udhëzim administrativ tjetër që ndikon apo mund të ndikojë në statusin apo përdorimin e gjuhëve zyrtare apo gjuhëve të komuniteteve gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare.

32.10. Kompetencat detaje dhe përbërja e Komisionit do të përcaktohen me një udhëzim administrativ të lëshuar nga Zyra e Kryeministrit, duke marrë parasysh të drejtat dhe interesat e të gjitha komuniteteve gjuhësore në Kosovë, dhe duke marrë parasysh nevojën për të pasqyruar dallimet gjuhësore të komuniteteve në Kosovë, 90 ditë pas shpalljes së këtij Ligji..

32.11. Brenda periudhës njëvjeçare pas miratimit të këtij ligji dhe më pastaj në baza vjetore, Komisioni i Gjuhëve do të informojë Qeverinë dhe Parlamentin e Kosovës rreth masave ligjore dhe masave të tjera të ndërmarra për zbatimin e këtij ligji.

Sanksionet administrative
Neni 33

Sanksionet administrative në rast të shkeljes së dispozitave të këtij Ligji përcaktohen me udhëzim administrativ të lëshuar nga Ministria e Shërbimeve Publike.

PJESA E KATËRT
Dispozitat kalimtare dhe të fundit

Neni 34

Institucionet e Kosovës përdorin gjuhën angleze ne punën e tyre, në kontakte dhe në dokumente zyrtare gjatë mandatit të Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

Neni 35

Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes janë të obliguara që në aktet e tyre të miratojnë rregullore të hollësishme për përdorimin e gjuhëve, në pajtueshmëri me këtë ligj.

Neni 36

36.1. Brenda afatit prej gjashtë (6) muajsh pas shpalljes së këtij Ligji nga PSSP-ja, Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes do të nxjerrin udhëzime administrative me qëllim të zbatimit të këtij Ligji.
36.2. Qeveria e Kosovës do të zhvillojë programin për ngritje të vetëdijes publike lidhur me këtë ligj, menjëherë pas shpalljes së tij.

Neni 37

Ky ligj shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi, që është në kundërshtim me të.

Neni 38

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit të tij nga Kuvendi i Kosovës dhe pas shpalljes së tij nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji Nr. 02/L-37
27 korrik 2006

GAZETA ZYRTARE E INSTITUCIONEVE TË PËRKOHSHME TË VETË-QEVERISJES NË KOSOVË / PRISHTINË :VITI II / NR. 10 / 01 MARS 2007

LIGJI Nr. 03/L-094
PËR PRESIDENTIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 141
Kreu II: Të drejtat e Presidentit të Republikës së Kosovës pas përfundimit të mandatit 146
Të drejtat e familjes së presidentit të Republikës së Kosovës pas përfundimit të mandatit të presidentit 147
Të drejtat e familjes së presidentit të Republikës së Kosovës në rast të vdekjes së presidentit gjatë ushtrimit të mandatit 148
Dispozitat përfundimtare 148

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Me qëllim te vendosjes se rregullave ligjore për Presidentin e Kosovës

Miraton

LIGJ PËR PRESIDENTIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Statusi dhe simbolet e Presidentit

1. Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës.
2. Presidenti i Republikës së Kosovës ka simbolet e veta të cilat përdoren krahas Simboleve të Republikës së Kosovës.

Neni 2
Rezidenca e Presidentit të Republikës

Rezidenca e presidentit të Republikës së Kosovës është në kryeqytetin e Republikës së Kosovës, në Prishtinë. Presidenti i Republikës pasi ta marrë detyrën vendoset, bashkë me familjen, në rezidencë shtetërore të Republikës së Kosovës.

Neni 3
Kualifikimi për Zgjedhjen e Presidentit

President i Republikës së Kosovës mund të zgjidhen vetëm shtetasit e Republikës së Kosovës që kanë mbushur moshën tridhjetepesë (35) vjeçare dhe që kanë pasur banim të përhershëm në Kosovë për së paku dhjetë (10) vite.

Neni 4
Zgjedhja e Presidentit

1. Presidenti i Republikës së Kosovës zgjidhet nga Kuvendi me votim të fshehtë, sipas procedurës së paraparë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
2. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës duhet të bëhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual.
3. Secili shtetas i Republikës së Kosovës, që plotëson kriteret e parapara në nenin 3 të këtij ligji, mund të nominohet si kandidat për President të Republikës së Kosovës, nëse ai/ajo siguron nënshkrimet e të paktën tridhjetë (30) deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Deputetët e Kuvendit mund të nënshkruajnë vetëm për një kandidat për President të Republikës së Kosovës.

Neni 5
Mandati dhe Betimi

1. Presidenti i Republikës së Kosovës fillon mandatin pasi të ketë dhënë betimin para Kuvendit të Kosovës. Teksti i betimit:
   "Betohem se tërë fuqinë time do t'ia kushtoj ruajtjes së pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës, sigurimit të lirive dhe të të drejtave njerëzore e qytetare, respektimit dhe mbrojtjes së Kushtetutës dhe ligjeve, ruajtjes së paqes dhe mirëqenies së të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe me ndërgjegje e përgjegjësi do t'i kryej të gjitha detyrimet e mia."
2. Mandati i Presidentit është pesë (5) vjet. Ky mandat nuk ndërlidhet dhe nuk është i përputhshëm me mandatin e institucioneve të tjera.
3. Pas përfundimit të mandatit të parë, Presidenti mund të rizgjidhet vetëm edhe për një mandat.

Neni 6
Kompetencat e Presidentit

Presidenti i Republikës së Kosovës ushtron kompetencat që i janë akorduar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjet në fuqi.

Neni 7
Papajtueshmëria

1. Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër publik.
2. Pas zgjedhjes, Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion në parti politike.

Neni 8
Imuniteti

1. Presidenti i Republikës së Kosovës gëzon imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet brenda fushëveprimit të përgjegjësive të Presidentit të Republikës së Kosovës.
2. Presidenti i Republikës së Kosovës, gjatë dhënies së dëshmisë, nuk është i detyruar të zbuloj asnjë informatë për të cilën ka ardhur në dijeni gjatë ushtrimit të mandatit të tij/saj.
3. Presidenti i Republikës së Kosovës, gjatë dhënies së dëshmisë, nuk është i detyruar të zbulojë asnjë informatë që mund ta inkriminojë atë në çfarëdo mënyre, penale apo civile, që ka ndodhur gjatë veprimeve dhe vendimeve brenda fushëveprimit të përgjegjësive të Presidentit të Republikës së Kosovës.
4. Imuniteti i Presidentit sipas këtij neni vazhdon edhe pasi Presidenti të ketë përfunduar mandatin e tij/saj.

Neni 9
Mungesa e Përkohshme e Presidentit

1. Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës përkohësisht nuk është i aftë për të përmbushur përgjegjësitë e tij/saj, ai/ajo mund t'ia kalojë vullnetarisht detyrat e postit të tij/saj, Kryetarit të Kuvendit, i cili do të jetë ushtrues i detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës. Urdhëri i Presidentit për kalimin e përgjegjësive duhet të përmbajë veçanërisht arsyet dhe kohëzgjatjen e bartjes së përgjegjësive, nëse ka njohuri për to. Presidenti i Republikës së Kosovës do të rifillojë ushtrimin e përgjegjësive kur të jetë në gjendje t'i ushtrojë përgjegjësitë, me ç'rast Kryetarit të Kuvendit i pushon posti i ushtruesit të detyrës së Presidentit. Presidenti mund të rifillojë ushtrimin e përgjegjësive edhe para skadimit të afatit të cilin e ka dhënë për bartjen e përgjegjësive tek Kryetari i Kuvendit, kur ai/ajo konsideron se arsyet që kanë shkaktuar mungesën e përkohshme kanë pushuar së ekzistuari.
2. Në rast se kalimi i përgjegjësive nuk ka ndodhur në mënyrë vullnetare sipas paragrafit 1 të këtij Neni, mirëpo për shkak të sëmundjes së rëndë, Kuvendi i Republikës së Kosovës, pas konsultimit me konsiliumin mjekësor, me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve vendos nëse Presidenti i Republikës së Kosovës është përkohësisht i paaftë për të ushtruar përgjegjësitë e veta. Kryetari i Kuvendit të Kosovës do të shërbejë si ushtrues i detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës derisa ai/ajo të bëhet i aftë që të rifillojë ushtrimin e përgjegjësive të Presidentit.
3. Posti i ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, nuk mund të ushtrohet për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj.

Neni 10
Shkarkimi i Presidentit

1. Presidenti i Republikës së Kosovës mund të shkarkohet nga Kuvendi nëse:
   1.1. ai/ajo është dënuar për kryerjen e krimit të rëndë,

1.2. gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se ai/ajo ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës;
1.3. ai/ajo nuk është e/i aftë për të ushtruar përgjegjësitë e këtij posti për shkak të sëmundjes së rëndë.

2. Presidenti i Republikës së Kosovës shkarkohet sipas procedurës së paraparë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Neni 11
Paga e Presidentit të Republikës

1. Paga e Presidentit të Republikës së Kosovës është paga më e lartë në kuadër të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës.
2. Paga e Presidentit të Republikës gjithmonë duhet të jetë së paku njëzet e pesë përqind (25%) më e lartë se të ardhurat e përgjithshme të Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe udhëheqësve të tjerë institucional.

Neni 12
Statusi Diplomatik i Presidentit të Republikës

Presidenti i Republikës së Kosovës pajiset me pasaportë diplomatike të Republikës së Kosovës. Të drejtë të pajisen me pasaportë diplomatike kanë edhe bashkëshorti/ja e Presidentit dhe fëmijët e tyre.

Neni 13
Zonja e Parë

1. Zonja e Parë e Republikës së Kosovës është bashkëshortja e Presidentit të Republikës.
2. Funksionet ceremoniale dhe protokollare të Zonjës së Parë përcaktohen me Ligjin mbi Protokollin Shtetëror.

Neni 14
Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës

1. Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës është institucion i veçantë në kuadër të Shërbimit Civil të Kosovës.
2. Stafi Civil i Zyrës së Presidentit do të zgjidhet në përputhje me ligjet e aplikueshme për Shërbimin Civil.
3. Përgjegjësia e administrimit të stafit civil është e Sekretarit në Zyrën e Presidentit, sipas dispozitave të këtij ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme në Kosovë.
4. Presidenti i Republikës së Kosovës emëron stafin e tij/saj mbështetës dhe anëtarët e Kabinetit të Presidentit.
5. Presidenti i Republikës së Kosovës e emëron dhe e shkarkon Sekretarin e Zyrës së Presidentit të Republikës sipas procedurës së paraparë në nenin 16 të këtij ligji.
6. Presidenti i Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Sekretarin e Zyrës i emëron dhe i shkarkon Drejtorët e Departamenteve Profesionale në Zyrën e Presidentit të Republikës.

7. Organizimi i brendshëm i Zyrës së Presidentit përcaktohet me akte të brendshme të Zyrës, të propozuara nga Sekretari i Zyrës dhe të aprovuara nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

Neni 15
Sekretari i Zyrës së Presidentit të Kosovës

1. Sekretari është zyrtari kryesor administrativ dhe udhëheqës i stafit civil në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës.
2. Sekretari duhet të ketë kualifikim të duhur, kompetencë, përvojë dhe ndershmëri të lartë profesionale për të menaxhuar me resurset e Zyrës së Presidentit të Kosovës.

Neni 16
Procedura e emërimit të Sekretarit të Zyrës së Presidentit

1. Për zgjedhjen e Sekretarit të Zyrës së Presidentit shpallet konkurs sipas Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës.
2. Presidenti i Republikës cakton një komision përzgjedhës i cili i propozon Presidentit kandidatët e mundshëm për pozitën e Sekretarit.
3. Presidenti emëron Sekretarin nga lista e propozuar nga Komisioni përzgjedhës.

Neni 17
Përgjegjësitë e Sekretarit

1. Sekretari drejtpërdrejt i përgjigjet Presidentit të Republikës së Kosovës dhe detyrat e tij/saj i kryen në bashkëpunim të ngushtë me Presidentin.
2. Sekretari është përgjegjës për këto çështje:
   2.1. për administrimin dhe menaxhimin e gjithmbarshëm të Zyrës dhe për sigurimin e zbatimit të funksioneve të besuara të Zyrës;
   2.2. për sigurimin e informatave të sakta dhe për këshilla të paanshme e profesionale për Presidentin;
   2.3. për gjetjen e stafit dhe organizimin e Zyrës dhe nxjerrjen e akteve nënligjore për çfarëdo çështje lidhur me funksionin e saj;
   2.4. për menaxhimin efektiv dhe efikas të resurseve që i sigurohen Zyrës;
   2.5. për zbatimin e politikës jo diskriminuese ndaj personelit të Zyrës, duke përfshirë përfaqësimin e barabartë gjinor në të gjitha fushat dhe nivelet, dhe sigurimin që struktura e personelit të pasqyrojë karakterin shumë etnik të Kosovës dhe
   2.6. për sigurimin që punësimi i personelit të Zyrës të bazohet në kualifikime profesionale, kompetenca dhe merita dhe kjo të bëhet përmes konkurrimit të drejtë dhe të hapur.
   2.7. për nxjerrjen e akteve të brendshme nënligjore në mbështetje të kryerjes së funksioneve të Presidentit të Republikës të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.

KREU II
TË DREJTAT E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PAS PËRFUNDIMIT TË MANDATIT

Neni 18

1. Presidenti i Republikës së Kosovës fiton të drejtat e përcaktuara me këtë ligj pas përfundimit të mandatit për të cilin është zgjedhur.
2. Të drejtat e përcaktuara me këtë ligj nuk i njihen Presidentit të Republikës së Kosovës, mandati i të cilit ka përfunduar për shkaqet e parapara në nën-paragrafët 1.1. dhe 1.2. paragrafi 1. i nenit 10 të këtij ligji.
3. Pas përfundimit të mandatit për të cilin është zgjedhur, thirrja "President" vazhdon të vlejë për Presidentin e Republikës të cilit i ka përfunduar mandati në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 19

1. Presidenti i Republikës së Kosovës pas përfundimit të mandatit në pajtim me paragrafin 1. të nenit 18 të këtij ligji ka të drejtë në pension, shuma e të cilit është shtatëdhjetë përqind (70%) e pagës të cilën e merr Presidenti i Republikës së Kosovës.
2. Presidenti i Republikës së Kosovës dhe familja e tij/saj pas përfundimit të mandatit në pajtim me paragrafin 1. të nenit 18 të këtij ligji kanë të drejtë në sigurim të plotë shëndetësor dhe shërbime mjekësore në spitalet ushtarake dhe publike gjatë tërë jetës.
3. Presidenti i Republikës së Kosovës pas përfundimit të mandatit në pajtim me paragrafin 1. të nenit 18 të këtij ligji ka të drejtë në kompensim monetar kalimtar për një periudhë shtatë mujore të tranzicionit në jetën private. Fondet mund të përdoren për zyre, kompensim të stafit, shërbime të telekomunikacionit, shtypje dhe shërbime postare të ndërlidhura me periudhën tranzitore.

Neni 20

1. Presidenti i Republikës së Kosovës të cilit i ka përfunduar mandati në pajtim me paragrafin 1. të nenit 18 të këtij ligji ka të drejtë për periudhën pesë vjeçare pas përfundimit të mandatit të tij/saj, në hapësirë zyreje, në pajisje për zyre, dhe në personel profesional të zyrës që nuk mund të jenë më shumë se tre (3) persona. Presidenti angazhohet nga Qeveria e Kosovës në aktivitete shtetërore, atëherë periudha pesë vjeçare fillon nga përfundimi i angazhimit të Presidentit.
2. Personeli profesional nga paragrafi 1 i këtij neni, të drejtat e marrëdhënies së punës i realizojnë në Kabinetin e Presidentit të Republikës së Kosovës, kurse emërohen nga Presidenti të cilit i ka përfunduar mandati.

Neni 21

Presidenti i Republikës së Kosovës të cilit i ka përfunduar mandati në pajtim me paragrafin 1. të nenit 18 të këtij ligji ka të drejtë në përcjellje zyrtare për tri vjet pas

përfundimit të mandatit të tij/saj, në pajtim me aktet e veçanta që i sjell Ministri i Punëve të Brendshme në bashkëpunim me Zyrën e Presidentit te Republikës së Kosovës.

Neni 22

1. Presidenti i Republikës së Kosovës, të cilit i ka përfunduar mandati në pajtim me paragrafin 1. të nenit 18 të këtij ligji, merr pjesë në solemnitetet dhe manifestimet shtetërore sipas radhës protokollare që bëhet në pajtim me rregullat mbi shërbimin e protokollit shtetëror të Kosovës.
2. Presidenti i Republikës së Kosovës, të cilit i ka përfunduar mandati në pajtim me paragrafin 1. të nenit 18 të këtij ligji, dhe bashkëshorti/ja i/e saj/tij, vazhdojnë ta përdorin pasaportën diplomatike të Republikës së Kosovës gjatë tërë jetës. Fëmijët e tij e kanë këtë të drejtë deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare.

Neni 23

Presidenti i Republikës së Kosovës, të cilit i përfundon mandati mund t'i pushojnë me kërkesën e tij/saj të drejtat e caktuara me këtë ligj.

Neni 24

Me rastin e vdekjes, Presidenti i Republikës së Kosovës, të cilit i ka përfunduar mandate, ai/ajo varroset me shpenzimet shtetërore dhe me nderime shtetërore, përderisa nuk ka shprehur dëshirë tjetër.

Neni 25

1. Presidenti i Republikës së Kosovës, të cilit i ka përfunduar mandati, në pajtim me paragrafin 1. të nenit 18 të këtij ligji, ka të drejtë në shpenzimet materiale për aktivitetet e tij/saj, në rastet kur këto aktivitete ushtrohen në cilësinë e ish Presidentit.
2. Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni sigurohen nga Buxheti i përcaktuar për Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës.

TË DREJTAT E FAMILJES SË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PAS PËRFUNDIMIT TË MANDATIT TË PRESIDENTIT

Neni 26

1. Me familje të Presidentit të Republikës së Kosovës, me këtë ligj, nënkuptohet bashkëshortja/bashkëshorti i/e Presidentit dhe fëmijët e tyre.
2. Familja e Presidentit të Republikës së Kosovës fiton të drejta të përcaktuara me këtë ligj në rast të vdekjes së Presidentit.
3. Në rast të vdekjes së Presidentit të Republikës së Kosovës pas përfundimit të mandatit, të drejtat nga neni 19 i këtij ligji i takojnë bashkëshortes/it gjatë tërë jetës

dhe fëmijëve të tij/saj deri në përfundimin e shkollimit të rregullt, përkatësisht deri në moshën njëzet e gjashtë (26) vjeçare.

4. Familja e Presidentit të Republikës së Kosovës të cilit i ka përfunduar mandati në pajtim me paragrafin 1. të nenit 18 të këtij ligji, ka të drejtë në përcjellje zyrtare për tri vjet pas përfundimit të mandatit të tij/saj, në pajtim me aktet e veçanta që i sjell Ministri i Punëve të Brendshme në bashkëpunim me Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës.

TË DREJTAT E FAMILJES SË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË RAST TË VDEKJES SË PRESIDENTIT GJATË USHTRIMIT TË MANDATIT

Neni 27

1. Në rast të vdekjes së Presidentit të Republikës së Kosovës gjatë ushtrimit të mandatit, familja e Presidentit gëzon të drejtat ashtu siç janë përcaktuar në nenin 19 të këtij ligji.
2. Nëse Presidenti në momentin e vdekjes ka pasur fëmijë të mitur, të drejtën e paragrafit 1 të këtij neni fëmijët e tij/saj të mitur e përdorin deri në përfundim të shkollimit të tyre të rregullt, përkatësisht deri në moshën njëzet e gjashtë (26) vjeçare.
3. Në rast të vdekjes së Presidentit të Republikës së Kosovës gjatë ushtrimit të mandatit të tij/saj, fëmijët e tij/saj kanë të drejtë në bursë nga Qeveria e Kosovës për shkollim në vend deri në moshën njëzet e gjashtë (26) vjeçare.
4. Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës e humb jetën në rrethana jo të natyrshme, gjatë ushtrimit të mandatit, familja e Presidentit ka të drejtë në pagesën e kompensimit me të holla në bazë të dëmit jo material lartësia e së cilit përcaktohet nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
5. Në rast të vdekjes së Presidentit të Republikës së Kosovës gjatë ushtrimit të mandatit, familja e Presidentit mund të përdorë edhe disa të drejta të tjera për të cilat merr vendim Qeveria e Republikës së Kosovës.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 28

Të drejtat e përcaktuara me këtë ligj ju takojnë edhe familjes së Presidentit të Republikës së Kosovës të cilit i ka përfunduar mandati si President para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 29

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji pushojnë së vepruari të gjitha vendimet, udhëzimet, dhe urdhëresat e nxjerra nga Qeveria e Kosovës dhe/apo UNMIK-u që kanë të bëjnë me funksionet dhe të drejtat e Presidentit të Republikës së Kosovës gjatë dhe pas përfundimit të mandatit.

Neni 30

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-094
19 dhjetor 2008

Shpallur me dekretin Nr. DL-082-2008, datë 07.01.2009 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI IV / Nr. 47 / 25 JANAR 2009

LIGJI Nr. 03/L-046
PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 150
Kreu II: Komanda dhe kontrolli 151
Kreu III: Forca e sigurisë së Kosovës 153

Në mbështetje të Kapitullit IV neni 65 pika 1, Kapitulli XI neni 126 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me qëllim të rregullimit me ligj të përgjegjësisë dhe kompetencave të institucioneve të Republikës së Kosovës në fushën e sigurisë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Miraton:

LIGJIN PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Aplikimi i Ligjit

Ky Ligj është i aplikueshëm për Forcën e Sigurisë së Kosovës, përfshirë pjesëtarët e saj (aktiv dhe rezervë) të uniformuar, pjesëtarët civilë dhe rekrutët e saj.

Neni 2
Territori i fushëveprimit

2.1. Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës janë të autorizuar të shërbejnë brenda territorit të Republikës së Kosovës dhe dërgohen jashtë vendit në operacione vetëm kur t'u jepet mandati nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe në marrëveshje me shtetin pranues, në bazë të ftesës së një organizate ndërkombëtare në të cilën Republika e Kosovës është anëtare ose aspiron të jetë, apo në bazë të një Rezolute të Këshillit të Sigurimit të KB-së.

2.2. Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës mund të marrin pjesë në shkollim, stërvitje dhe ushtrime jashtë kufijve territorial të Republikës së Kosovës pa miratimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës vetëm atëherë kur janë të ftuar nga organizatat ndërkombëtare anëtare e të cilave është apo aspiron të bëhet Republika e Kosovës, apo në baza bilaterale me pjesëtarët e këtyre organizatave dhe pas autorizimit ministror.

KREU II
KOMANDA DHE KONTROLLI

Neni 3
Parimet e përgjithshme

3.1. Kuvendi i Republikës së Kosovës, Presidenti, Kryeministri dhe Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës përbëjnë zinxhirin e mbikëqyrjes civile të Forcës së Sigurisë së Kosovës, siç përcaktohet me Kushtetutë, këtë ligj dhe ligjet tjera relevante.

3.2. Qeveria e Republikës së Kosovës ushtron kontroll transparent, demokratik dhe civil të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Neni 4
Kuvendi i Kosovës

4.1. Në pajtim me ligjin, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka kompetenca për të:
- a) ushtruar kontroll demokratik parlamentar mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës;
- b) mbikëqyrur dhe hetuar të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me organizimin, financimin, personelin, pajisjet dhe dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës;
- c) përcaktuar me ligj të gjitha çështjet e ndërlidhura me organizimin, financimin, personelin, pajisjet dhe dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës;
- d) miratuar buxhetin vjetor dhe planin dhjetë vjeçar rotativ për Forcën e Sigurisë së Kosovës;
- e) miratuar dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës gjatë periudhave të jashtëzakonshme apo në operacione në mbështetje të paqes jashtë vendit.

4.2. Kuvendi i Republikës së Kosovës themelon një Komision Parlamentar, i cili ka kompetencë që:
- a) t'i kërkojë Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës të dorëzojë një raport vjetor dhe t'u përgjigjet pyetjeve personalisht, sipas nevojës. Raporti i dërgohet Presidentit dhe Kryeministrit;
- b) të kërkojë praninë e Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në takimet e tyre dhe t'iu përgjigjet pyetjeve;
- c) të shqyrtojë buxhetin e Forcës së Sigurisë së Kosovës para dorëzimit të tij për miratim në Kuvendin e Kosovës;
- d) të shqyrtojë të gjitha projektet për pajisje që janë të vlerës më shumë se një milion Euro, si të atyre që financohen nga Qeveria e Kosovës ashtu edhe të atyre që financohen nga donatorët, para dorëzimit të tyre për miratim në Kuvendin e Kosovës;
- e) t'i vë në dispozicion të Pranisë Ndërkombëtare Ushtarake të gjitha informatat e nevojshme për t'i identifikuar të gjitha burimet e fondeve dhe pajisjeve që i janë dhënë Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Neni 5
Presidenti

5.1. Presidenti është Komandant Suprem i Forcës së Sigurisë së Kosovës.
5.2. Presidenti ka pushtet të autorizoj dërgimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës në veprime gjatë gjendjes emergjente ose gjatë veprimeve në mbështetje të paqes jashtë vendit, pas aprovimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
5.3. Në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet tjera përkatëse, Presidenti ka kompetencë që:
   a) të emërojë Komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës pas rekomandimit nga Qeveria;
   b) t'i miratoj të gjitha promovimet në gradën e Gjeneralit mbi rekomandimin e përbashkët të Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ministrit për Forcën e Sigurisë së Kosovës;
   c) t'i miratojë të gjitha ndryshimet e emërimit të Gjeneralëve sipas rekomandimit të përbashkët të Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ministrit për Forcën e Sigurisë së Kosovës;
   d) të ndajë dekorata, medalje, çmime dhe shpërblime.

Neni 6
Kryeministri

6.1. Kryeministri ka kompetencë që në mënyrë efektive ta mbikëqyrë dhe të ushtroj kontroll mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës, përmes Ministrit të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës.
6.2. Në zbatim të autoritetit nga Kuvendi i Kosovës, Kryeministri ka kompetencë që:
   a) të autorizoj Ministrin për Forcën e Sigurisë së Kosovës që të urdhërojë angazhimin dhe dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës;
   b) të angazhoj Forcën e Sigurisë së Kosovës për t'i ndihmuar autoritetet civile në përgjigje të fatkeqësive apo aksidenteve natyrore dhe fatkeqësive apo aksidenteve tjera;
   c) të përcaktoj dhe të modifikoj strukturën e Forcës së Sigurisë së Kosovës (shih nenin 14 të këtij ligji) sipas nevojës, në konsultim me Presidentin dhe t'i nënshtrohet konfirmimit nga ana e Kuvendit,
   d) të përcaktoj minimumin e përfaqësimit të të gjitha komuniteteve brenda Forcës së Sigurisë së Kosovës, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë.

Neni 7
Këshilli i Sigurisë së Kosovës

7.1. Këshilli i Sigurisë së Kosovës, në zbatim të Ligjit për Këshillin e Sigurisë së Kosovës, merr në shqyrtim dhe këshillon në lidhje me të gjitha çështjet e ndërlidhura me sigurinë e Republikës së Kosovës, përfshirë përdorimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës.
7.2. Gjatë shqyrtimit të çështjeve që kanë të bëjnë me sigurinë, Këshilli i Sigurisë së Kosovës mund të kërkojë asistencën e personelit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, sipas nevojës.

Neni 8
Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Në pajtim me Ligjin për Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës:

a) Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës caktohet nga Kryeministri dhe do t'i nënshtrohet miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës;
b) Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës ka kompetencë për të ushtruar kontroll dhe administrim të përgjithshëm të Forcës së Sigurisë së Kosovës, përfshirë edhe çfarëdo kompetenca, të cilat me ligj i janë caktuar Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës;
c) Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës vepron si përfaqësues ndërkombëtar i Kosovës në çështjet lidhur me forcën e sigurisë së Kosovës në nivelin ministror, por ai mundet ta delegojë këtë funksion për aktivitete të caktuara.

KREU III
FORCA E SIGURISË SË KOSOVËS

Neni 9
Të përgjithshme

9.1. Forca e Sigurisë së Kosovës, sipas këtij ligji, është forcë krejtësisht vullnetare e ndërtuar nga të gjitha shtresat e shoqërisë.
9.2. Gjuhët zyrtare të Forcës së Sigurisë së Kosovës janë gjuha shqipe dhe ajo serbe, në komunikim me organizatat ndërkombëtare do të përdoret edhe gjuha angleze.
9.3. Forca e Sigurisë së Kosovës do të jetë e dizajnuar dhe e përgatitur për të përmbushur funksionet e sigurisë që nuk i përkasin policisë apo organizatave tjera për zbatim të ligjit, të cilat funksione do të autorizohen përmes një procesi monitorues sipas standardeve të përcaktuara, i cili do të vendoset nga Prania Ushtarake Ndërkombëtare, në bashkërendim me Përfaqësuesin Ndërkombëtar Civil.

Neni 10
Misionet dhe detyrat

10.1. Misioni i Forcës së Sigurisë së Kosovës, si instrument i sigurisë, është që ta mbështesë Qeverinë e Republikës së Kosovës.
10.2. Forca e Sigurisë së Kosovës është e armatosur lehtë dhe nuk do të ketë armë të rënda, siç janë tanket, artileria e rëndë apo kapacitete sulmuese ajrore. Çdo ndryshim në armatim do të përcaktohet nga Prania Ushtarake Ndërkombëtare, në bashkërendim me Përfaqësuesin Ndërkombëtar Civil. Një rishikim i plotë i këtyre kufizimeve, do të bëhet jo më herët se pesë vite nga koha e hyrjes në fuqi e këtij Ligji. Detyrat fillestare të Forcës së Sigurisë së Kosovës janë:
   a) të marrë pjesë në operacionet për reagim ndaj krizave, përfshirë operacionet në mbështetje të paqes. Kjo do të përfshijë operacionet jashtë territorit të Republikës së Kosovës, ku do të ftohet për këtë qëllim;

b) të ndihmojë autoritetet civile në përgjigje ndaj fatkeqësive natyrore, fatkeqësive dhe emergjencave tjera, madje edhe si pjesë e një përpjekjeje reaguese regjionale apo ndërkombëtare;
c) të kryejë shkatërrimin e mjeteve shpërthyes;
d) të ndihmojë autoritetet civile përmes operacioneve të mbrojtjes civile.

Neni 11
Paanshmëria politike, integriteti dhe standardet

11.1. Forca e Sigurisë së Kosovës nuk mund të përdoret për qëllime politike apo për veprimtari partiake.
11.2. Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës nuk mund të jenë anëtarë të partive politike e as nuk mund të shfaqin haptazi shenja të përkrahjes së cilësdo parti politike, edhe pse ky nen nuk e mohon realizimin e të drejtës së pjesëtarëve për të votuar.
11.3. Pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës u kërkohet që të zbatojnë kodin e mirësjelljes për Forcën e Sigurisë së Kosovës të përcaktuar nga Ministri.

Neni 12
Ligji i aplikueshëm

12.1. Të gjithë pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës u nënshtrohen ligjeve të aplikueshme në Kosovë.
12.2. Gjatë shërbimit jashtë kufijve territorial të Republikës së Kosovës, pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës u nënshtrohen ligjeve të Republikës së Kosovës dhe të vendit nikoqir, përveç nëse është vendosur ndryshe me Marrëveshjen e Statusit të Forcës.

Neni 13
Anëtarësia

13.1. Të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës, të cilët kanë mbushur moshën 18 vjet, kanë të drejtë për të aplikuar për anëtarësim në Forcën e Sigurisë së Kosovës.
13.2. Shtetasit mund të hyjnë në Forcën e Sigurisë së Kosovës pasi të kenë plotësuar kriteret e përzgjedhjes. Përzgjedhja do të bazohet në gjendjen shëndetësore dhe fizike, merita dhe në nevojat dhe prioritetet e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe në përfundimin me sukses të procedurës së miratuar të kontrollit të sigurisë. Ky punësim do të konfirmohet pas përfundimit të stërvitjeve të nevojshme elementare, gjatë së cilës kohë, shtetasit do të cilësohen si rekrutë.
13.3. Forca e Sigurisë së Kosovës përbëhet nga personeli profesional i sigurisë, personeli rezervë, personeli civil dhe rekrutët.

Neni 14
Organizimi

14.1. Forca e Sigurisë së Kosovë fillimisht përbëhet nga një komponentë aktive prej më së shumti 2500 pjesëtarë dhe nga një komponentë rezervë prej më së shumti 800 pjesëtarë.
14.2. Forca e Sigurisë së Kosovës fillimisht përbëhet nga Komanda e Forcave Tokësore, Brigada për Reagim të Shpejtë, Brigada e Mbështetjes së Operacioneve dhe Komanda e Trajnimit dhe Doktrinës. Pjesëtarëve të përzgjedhur të uniformuar të Forcës së Sigurisë së Kosovës gjithashtu do t'u kërkohet të shërbejnë periudha detyre në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës.
14.3. Komponentja për reagim emergjent e Forcës së Sigurisë së Kosovës përfshin kërkim-shpëtimin, deminimin, trajtimin e materialeve të rrezikshme, zjarrfikjen dhe shkathtësitë e tjera për asistencë humanitare.

Neni 15
Struktura e gradave

15.1. Shërbimi i oficerëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës përbëhet nga nëntë grada, prej më të ultës te më e larta në këtë renditje: Nëntoger, Toger, Kapiten, Major, Nënkolonel, Kolonel, Gjeneral brigade, Gjeneral major dhe Gjeneral lejtnant. Nuk është e thënë që duhet të përdoren të gjitha këto grada.
15.2. Shërbimi i nënoficerëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës përbëhet nga gjashtë grada, prej më të ultës te më e larta në këtë renditje: Ushtar, Tetar, Rreshter, Rreshter i klasit të parë, Kapter dhe Flamurtar.
15.3. Në çdo kohë, në Forcën e Sigurisë së Kosovës do të jetë më së shumti një Gjeneral lejtnant dhe dy Gjeneralë major.

Neni 16
Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës

16.1. Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës, rekomandon një kandidat të përshtatshëm për t'u emëruar Komandant i parë i Forcës së Sigurisë së Kosovës nga Presidenti. Që të jetë i përshtatshëm për t'u marrë në shqyrtim, kandidati duhet të ketë mbajtur gradën e Gjeneral majorit së paku dymbëdhjetë muaj.
16.2. Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës i përgjigjet Ministrit për Forcën e Sigurisë së Kosovës.
16.3. Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës ushtron komandë të plotë mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe elementit të saj rezervë dhe është përgjegjës:
   a) për drejtimin, stërvitjen, mbikëqyrjen dhe aktivitetet e Forcës së Sigurisë së Kosovës;
   b) për dorëzimin e raportit vjetor të Komisioni përkatës parlamentar dhe t'u përgjigjet personalisht pyetjeve të Komisionit kur të ketë kërkuar një gjë të tillë;
   c) për mbikëqyrjen dhe sigurimin e ekzekutimit të të gjithë urdhrave të ligjshëm sipas udhëzimeve të Ministrit për Forcën e Sigurisë së Kosovës;
   d) për planifikimin dhe zbatimin e angazhimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës;

e) t'i propozojë Ministrit për Forcën e Sigurisë së Kosovës personelin dhe strukturën e Forcës së Sigurisë së Kosovës;
f) të veprojë si këshilltar kryesor i Presidentit, Kryeministrit dhe Këshillit të Sigurisë së Kosovës, anëtar i të cilit duhet të jetë ai, mbi çështjet që kanë të bëjnë me Forcën e Sigurisë së Kosovës;
g) të sigurojë gatishmërinë operacionale të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe të miratojë të gjitha planet operacionale;
h) të rekomandojë gradimin e personelit në gradën e Gjeneralit dhe të konfirmojë gradimet tjera në pajtueshmëri me Ligjin mbi Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës;
i) të veprojë si përfaqësues ndërkombëtar i Kosovës në çështjet forcës së sigurisë së Kosovës në nivel të Shefit të Shtabit të Mbrojtjes.

16.4. Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës më së shumti ka gradën e Gjeneral lejtnantit dhe do të jetë oficeri me gradën më të lartë në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Neni 17
Betimi

Personi i cili për herë të parë hyn në Forcën e Sigurisë së Kosovës jep betimin si në vijim:
"Betohem (apo deklarohem) solemnisht se do të jem i përkushtuar dhe do t'i qëndroj plotësisht besnik Republikës së Kosovës; se do t'iu bindem urdhrave të Presidentit të Kosovës dhe oficerëve tjerë mbi mua në pajtim me ligjin; dhe se do t'i kryej detyrat e mia me zell, nder dhe dinjitet. Gjatë gjithë kohës do të jem mbrojtës i të drejtave dhe lirive të njeriut dhe nuk do të lejojë diskriminim të asnjë lloji, përfshirë gjuhën, etnicitetin apo besim fetare. Betohem (apo deklarohem) solemnisht se unë kurrë nuk do të keqpërdori pozitën time, gradën apo ndikimin tim për përfitimin material apo personal."

Neni 18
Flamuri, himni dhe stema

18.1. Flamuri dhe himni i Forcës së Sigurisë së Kosovës është flamuri dhe himni i Republikës së Kosovës.
18.2. Stema e Forcës së Sigurisë së Kosovës është flamuri i Republikës së Kosovës dhe bartet nga të gjithë pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës.
18.3. Stema e njësiteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës miratohet nga Presidenti mbi bazën e rekomandimit të përbashkët të Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ministrit për Forcën e Sigurisë së Kosovës.
18.4. Askush nuk është i autorizuar të riprodhojë apo përdorë stemën e Forcës së Sigurisë së Kosovës pa autorizim me shkrim të Ministrit për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Neni 19
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës
Me datën: 13.03.2008

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III / Nr. 27 / 03 QERSHOR 2008

LIGJI Nr. 04/L-115
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË KANË TË BËJNË ME PËRFUNDIMIN E MBIKËQYRJES NDËRKOMBËTARE TË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË KANË TË BËJNË ME PËRFUNDIMIN E MBIKËQYRJES NDËRKOMBËTARE TË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Neni 1
Qëllimi

1. Ky ligj ka për qëllim të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve në vijim për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës:
   1.1. Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
   1.2. Ligjit Nr. 03/L-075 për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës;
   1.3. Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
   1.4. Ligjit Nr. 03/L-079 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale;
   1.5. Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
   1.6. Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04 L 101 për Fondet Pensionale të Kosovës;
   1.7. Kodit Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë;
   1.8. Ligji Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat;
   1.9. Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat;
   1.10. Ligji Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
   1.11. Ligji Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
   1.12. Ligji Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë;
   1.13. Ligji Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme;
   1.14. Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës;
   1.15. Ligji Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativ të Komunave;

1.16. Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës;
1.17. Ligji Nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës;
1.18. Ligji Nr. 03/L-237 për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave;
1.19. Ligji Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës;
1.20. Ligji Nr. 03/L-082 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës.
1.21. Ligji Nr. 03/L-033 për Statusin, imunitetet dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin e Kosovës dhe praninë ndërkombëtare ushtarake, si dhe personelin e saj.

Neni 2
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Ligji)

1. Neni 15 i ligjit bazik pas paragrafit 1. shtohet paragraf i ri 2. me tekstin si në vijim:
   2. Gjykatësit ndërkombëtarë, të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë ligj, vazhdojnë të marrin pagën e tyre të specifikuar sipas vendimit për emërim. Qeveria e Kosoves merr pjesë në pagesën e gjykatësve ndërkombëtarë, në periudhën e përcaktuar në vlerë të pagave të gjyqtarëve vendorë.
2. Neni 55 i ligjit bazik, paragrafi 1. dhe paragrafi 2 fshihen nga teksti i ligjit dhe shtohet një paragraf i ri me tekstin si në vijim:
   Mandati i gjykatësve ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim.

Neni 3
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-075 për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës (Ligji)

1. Neni 8 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 8

Auditori i përgjithshëm, i emëruar në përputhje me Kushtetutën dhe me këtë ligj, vazhdon të qëndrojë në post deri në përfundim të mandatit, me kompensimin e cekur në kushtet specifike të emërimit të tij. Qeveria e Kosovës siguron fonde në vlerën e përcaktuar me marrëveshjen në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Zyrës se Auditorit të përgjithshëm.

Neni 4
Ndryshimet dhe plotësimet Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji)

1. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1.12, që përkufizon Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar, fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Kuvendi pas propozimit nga qeveria zgjedh tre (3) anëtarë ndërkombëtarë drejtorë të bordit. Bordi, po ashtu, emëron një shtetas të Kosovës drejtor të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit, i cili nuk do të jetë anëtar i Bordit. Bordi, përveç kryesuesit, po ashtu, emëron zëvendëskryesues njërin prej anëtarëve të tij. Për emërimin, shkarkimin ose ndryshimin e kushteve të referimit të Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit kërkohet vota afirmative e shumicës së Bordit të Drejtorëve. Anëtarët ndërkombëtarë zgjedhën më mandat deri më 31 gusht 2014.

3. Neni 14 i ligjit bazik, paragrafët 7., dhe 9., vlejnë deri në përfundimin e mandatit të anëtarëve ndërkombëtarë të bordit.
4. Neni 31 i ligjit bazik, pas paragrafit 5. shtohet një paragraf i ri 6. me tekstin si në vijim:
   6. Nëse një anëtar ndërkombëtar i bordit i emëruar në pajtim me nenin 31 (5) jep dorëheqje nga Bordi dhe nëse kjo dorëheqje ose largim nga posti ndodh deri më 31 gusht 2014 atëherë ai/ajo do të zëvendësohet me një ndërkombëtar tjetër.

Neni 5
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-079 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale (Ligji)

1. Neni 4 i ligjit bazik që ndryshon nenin 5.2 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   5.2. Bordi mbikëqyrës përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve të cilët emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryeministri.
2. Neni 8 i ligjit bazik që ndryshon nenin 6.1 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   6.1. Sekretaria Ekzekutive ka drejtorin dhe zëvendësdrejtorin të cilët emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryeministri.
3. Neni 10 i ligjit bazik që ndryshon nenin 7.1 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   7.1. Komisioni përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të cilët emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.
4. Neni 13 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 13

Kuvendi, në konsultim me Komisionin, mund të themelojë panele shtesë të Komisionit, anëtarët e të cilëve do të emërohen në bazë të neneve 7.1 dhe 7.2.

5. Neni 16 i ligjit bazik që ndryshon nenin 12.8 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   12.8. Gjykata Supreme e Kosovës vendos lidhur me ankesat në trupin gjykues prej tre (3) gjyqtarëve të cilët emërohen nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës.
6. Pas nenit 27 të ligjit bazik, shtohet një nen i ri 27.A me tekstin si në vijim:

Neni 27.A

1. Mandati i tre (3) anëtarëve ndërkombëtarë të Bordit mbikëqyrës (përfshi edhe kryesuesin), i drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive, i dy (2) anëtarëve ndërkombëtarë të Komisionit (përfshi edhe kryesuesin), si dhe i dy gjykatësve ndërkombëtarë në panelet e ankimit të Gjykatës Supreme të cilët janë emëruar në pajtim me Kushtetutën do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim.
2. Anëtarët dhe gjykatësit ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë Ligj vazhdojnë të marrin pagën e tyre të specifikuar sipas kushteve të emërimit të tyre.
3. Qeveria e Kosoves do të sigurojë fonde për drejtorin e Sekretariatit Ekzekutive të barabartë me pagën e një anëtari vendor të Bordit Mbikëqyrës.
4. Nëse një anëtar ndërkombëtar i emëruar ne pajtim me Kushtetutën jep dorëheqje ose largohet nga pozita e tij/saj dhe nëse ky largim ose dorëheqja ndodh para datës 31 gusht 2014, atëherë ai/ajo do të zëvendësohet me një ndërkombëtar, të dominuar nga Kryeministri për pozitat e anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë së Pronës dhe drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive, si dhe të nominuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme për pozitën e anëtarëve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Anëtareve të Panelit të Ankesave të Gjykatës Supreme, pas konsultimeve me PSBE.

Neni 6
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.3. fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.7, riformulohet me tekstin si në vijim:
   1.7. **Gjykatës Ndërkombëtar** - çdo gjykatës i Misionit Evropian për Politika të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, i cili është emëruar në pajtim me këtë ligj.
3. Neni 11 i ligjit bazik, paragrafi 2. riformulohet me tekstin si në vijim:
   2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Dhoma e Posaçme do të vazhdojë të respektojë dhe zbatojë parimin e kompensimit në vend të kthimit fizik. Kur vendoset për mjetin juridik që do të jepet në një rast të caktuar, Dhoma e Posaçme do të marrë parasysh edhe dispozitat në fuqi të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, duke përfshirë qëllimet publike që përcaktohen në preambulën e atij ligji.

Neni 7
Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04 L-101 për fondet pensionale të Kosovës

1. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 4.6, riformulohet me tekstin si në vijim:
   4.6. Komisioni për përzgjedhje, i propozon kandidatët Kuvendit për vendet e lira në anëtarësim ose për riemërim të anëtarëve të Bordit Drejtues. Komisioni për Përzgjedhje do të përbëhet nga guvernatori i BQK-së - kryesues, Auditori i

Përgjithshëm dhe Ministri i Financave. Mandati i secilit anëtar të emëruar në Bordin Drejtues zgjat tre vjet, me mundësi të rizgjedhjes, nëse mandati i anëtarëve të Bordit skadon dhe asnjë anëtar i ri nuk është emëruar, atëherë anëtarët e Bordit ekzistues do të vazhdojnë mandatin për nëntëdhjetë (90) ditë.

Neni 8
Ndryshimet dhe plotësimet e Kodit Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë (Kodi)

1. Neni 309 i ligjit bazik që rregullon emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave me pëlqimin e PCN-së, fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 1 i Aneksit D, i Kodit, fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 1

Ky Aneks ofron përjashtimet e posaçme të përkufizuara në këtë Aneks që do t'i jepen bashkësive fetare sipas përkufizimit në legjislacionin e aplikueshëm, duke përfshirë edhe legjislacionin për liritë fetare në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Neni 9
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat (Ligji)

1. Neni 1 i ligjit bazik, paragrafi 1.32, që përkufizon PCN-në fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 8 i ligjit bazik paragrafi 2. në rreshtin e tretë fshihet fjala “dhe PCN”.
3. Neni 88 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 10
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-199 për gjykatat (ligji)

1. Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 11, riformulohet me tekstin si në vijim:
   11. Nëse në njërën nga komunat e reja dhe të themeluara mbi bazën e Ligjit për Kufijtë Administrativë Komunal nuk ka gjykatë themelore, komuna me vendim të Kuvendit Komunal mund ta parqet kërkesën para Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK) për të vendosur mbi themelimin e gjykatës themelore në territorin e saj, ose që një nga gjykatat ekzistuese themelore në territorin e komunës tjetër të ketë juridiksion mbi territorin e komunës së re. Të njëjtën të drejtë e ka edhe komuna ekzistuese, ku shumica e popullatës i takon komunitetit jo shumicë në Kosovës, dhe në të cilën nuk ka gjykatë themelore.
      11.1. KGjK do të aprovojë kërkesat e tilla, përveç nëse vlerësohet se ngarkesat e lëndëve për atë juridiksion është e pamjaftueshme për ta arsyetuar ekzistimin e gjykatës së ndarë.
      11.2. Kur KGjK e aprovon kërkesën për themelimin e gjykatës së re

themelore, autoritetet kompetente do t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se cilado gjykatë e re, është themeluar dhe funksionale brenda periudhës gjashtë mujore prej datës së vendimit.

11.3. Nëse KGjK nuk aprovon kërkesën për themelimin e gjykatës së re themelore, ose kur komuna i kërkon gjykatës ekzistuese që të ketë juridiksion për territorin e vet, autoritetet kompetente do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për përmirësimin e qasjes në drejtësi për komunitetet lokale, e cila është vështirësuar për shkak të izolimit gjeografik, mungesës së sigurisë, ose për shkak të faktorëve të tjerë relevant. Këto masa mund të përfshijnë krijimin në kuadër të territorit të komunës së re, të një departamenti të gjykatës themelore ekzistuese prej së cilës komuna e re ka kërkuar të ketë kompetencë për territorin e vet, ose që gjykata themelore të mundësojë mbajtjen e seancave në territorin e komunës së re.

2. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Përbërja e Gjykatës së Apelit pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Republikës së Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore. Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin përkatës në fuqi, si dhe për të siguruar pjesëmarrjen e komunitetit në gjyqësor, pesëmbëdhjetë (15) për qind e numrit të tërësishëm të ulëseve në Gjykatën e Apelit, por jo më pak se dhjetë ulëse, garantohen për gjyqtarët nga radha e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

Neni 11
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.2. fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 1.3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   1.3. Për të siguruar se gjykatat pasqyrojnë përbërjen etnike të zonës së tyre të juridiksionit në përputhje me nenin 104(3) të Kushtetutës dhe me legjislacionin përkatës në fuqi, Këshilli do të marrë parasysh që të plotësojë vendet e lira të punës ose të ulëseve të rezervuara me anëtarë të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.
3. Neni 7 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 7
Mandati i anëtarëve të Këshillit

Anëtarët e Këshillit zgjidhen me mandat 5 (pesë) vjeçar, siç ceket në nenin 108 (6) të Kushtetutës dhe në këtë ligj. Një anëtar i këtij Këshilli mund të zgjidhet për një mandat shtesë jo-vijues pesë (5) vjeçar.

4. Neni 16 i ligjit bazik, paragrafi 3., riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Në përputhje me nenin 104(3) të Kushtetutës, Këshilli zbaton masa dhe veprimet tjera me qëllim rekrutimi, të cilat i konsideron të nevojshme dhe të përshtatshme për të siguruar se një gjykatë ose degë e gjykatës pasqyron përbërjen etnike në zonën e tyre të juridiksionit.

5. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 1., riformulohet si në vijim:
   1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ndërmerr masa të nevojshme për të rritur numrin e gjyqtarëve nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë, prej radhëve të atyre gjyqtarëve që shërbejnë në Kosovë. Për të përmbushur përgjegjësitë e veta, Këshilli, ndër të tjera, nga aplikantët njëlloj të kualifikuar për të shërbyer si gjyqtarë u jep përparësi anëtarëve nga komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovës, ashtu siç është paraparë me nenin 108 të Kushtetutës.
6. Neni 17 i ligjit bazik, pas paragrafit 5., shtohen tre paragraf të rinjë 6, 7 dhe 8, me tekstin si në vijim:
   6. Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të hartojë një rregullore të veçantë për të përshkruar procesin e emërimit dhe të riemërimit të gjykatësve nga komunitetet e nën-përfaqësuara në mesin e gjykatësve që shërbejnë në Kosovë.
   7. Dhënia e përparësisë për kandidatët me kualifikime të barabarta nga komunitetet e nën-përfaqësuara, do të zbatohet përderisa përqindja e gjyqtarëve pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë në Kosovë të jetë nën pesëmbëdhjetë përqind (15%) dhe / përderisa përqindja e gjyqtarëve të cilët janë pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, të jetë nën tetë (8%).
   8. Mandati i dy anëtarëve ndërkombëtarë të Këshillit të emëruar në pajtim me Kushtetutën do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim. Anëtarët ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë ligj vazhdojnë të marrin pagën e tyre.
   9. Neni 52 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 12
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.7, fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 1.3 riformulohet me tekstin si në vijim:
   1.3. Siguron se prokuroritë pasqyrojnë përbërjen etnike të zonës së tyre të juridiksionit në përputhje me nenin 109 (4) dhe 110(3) të Kushtetutës.
3. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Këshilli zbaton masa dhe veprime rekrutimi, si dhe masa të tjera të cilat i konsideron të nevojshme për të siguruar që një zyrë prokuroriale pasqyron përbërjen etnike të zonës së juridiksionit përkatës.
4. Neni 17 i ligjit bazik, pas paragrafit 3. shtohet një paragraf i ri 4. me tekstin si në vijim:
   4. Këshilli harton rregullore të veçantë për të përshkruar procesin e emërimit dhe të riemërimit të prokurorëve nga komunitetet e nën-përfaqësuara në mesin e prokurorëve që shërbejnë në Kosovë.
5. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 1., riformulohet me tekstin si në vijim:
   1. Këshilli ndërmerr masa të nevojshme për të rritur numrin e prokurorëve nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë. Kur ka aplikantë njëlloj të kualifikuar për të shërbyer si prokurorë, Këshilli u jep përparësi anëtarëve nga komunitetet që janë të nënpërfaqësuara në Kosovë siç është paraparë edhe me nenin 109 (4) dhe 110 (3) të Kushtetutës.

6. Neni 18 i ligjit bazik, pas paragrafit 5, shtohet paragrafi i ri 6, me tekstin si në vijim:
   6. Dhënia e përparësisë për kandidatët me kualifikime të barabarta nga komunitetet e nën-përfaqësuara, do të zbatohet përderisa përqindja e prokuroreve pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë në Kosovë të jetë nën pesëmbdhjetë përqind (15%) dhe / ose përderisa përqindja e prokurorëve të cilët janë pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, të jetë nën tetë përqind (8%).

Neni 13
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë (Ligji)

1. Pjesa e parë e preambulës se ligjit, riformulohet me tekstin si në vijim:
   Në bazë të nenit 65 (1) dhe ne pajtim me dispozitat kalimtare dhe përfundimtare nga kreu XIII dhe XIV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Pas nenit 7 të ligjit bazik shtohet një nen i ri 7.A me tekstin si në vijim:

Neni 7.A
Statusi i Kishës Ortodokse Serbe

1. Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë konsiderohet pjesë përbërëse e Kishës Ortodokse Serbe (KOS).
2. Emri dhe organizimi i brendshëm i Kishës Ortodokse Serbe, duke përfshirë edhe hierarkinë dhe veprimtaritë e saj, do të respektohen.
3. Nuk do të ketë ndalim arbitrar për hyrje në Kosovë ose qëndrim brenda Kosovës për priftërinjtë, kandidatët për prift, murgjve, murgeshave dhe vizitorëve.
4. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 7.3, fjalët "**themelojnë dhe**", fshihen nga teksti i ligjit.
5. Neni 8 i ligjit bazik, paragrafi 1, riformulohet me tekstin si në vijim:
   1. Ndërtesat dhe objektet që u takojnë bashkësive fetare, që janë të dedikuara për kryerjen e ceremonive fetare konsiderohen të pacenueshme për sa i përket ndërhyrjes së autoriteteve qeveritare dhe në to mund të hyhet vetëm me pëlqimin e institucionit përkatës fetar, përveç nëse është lëshuar ndonjë urdhër gjyqësor për shkak të aktiviteteve ilegale dhe në rast të rrezikut për jetën ose shëndetin.
6. Neni 12 i ligjit bazik, pas paragrafit 12.4 shtohet një paragraf i ri 12.5 me tekstin si në vijim:
   12.5. Përveç përjashtimeve të përmendura më lart, bashkësitë fetare gëzojnë privilegje doganore dhe tatimore për veprimtari ekonomike, që janë specifike për vetë-qëndrueshmërinë e tyre financiare, siç do të definohet me një akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e financave. Këto privilegje përfshijnë importimin dhe blerjen e produkteve qenësore për prodhim, të materialeve, pajisjeve dhe bagëtisë; dhe eksportimin e produkteve që dalin nga aktivitetet e lartpërmendura.

Neni 14
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1. përkufizimi "**Propozimin Gjithëpërfshirës**", fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Objekt i shpronësimit sipas këtij ligji mund të jenë të drejtat private pronësore dhe të drejtat tjera private për ose ndaj një prone të paluajtshme, me përjashtim të asaj prone të paluajtshme që bën pjesë në atë kategori të pronës, për të cilën Kushtetuta në mënyrë specifike thotë se nuk do të jetë objekt i shpronësimit.
3. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3, shtohet nën-paragraf i ri 3.1. me tekstin si në vijim:
   3.1 Prona e luajtshme dhe e paluajtshme, si dhe asetet tjera të Kishës Ortodokse Serbe do të jenë të pacenueshme dhe nuk do të jenë objekt i shpronësimit.

Neni 15
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (ligji)

1. Pas nenit 3 shtohet nen i ri 3.A me tekstin si në vijim:

Neni 3.A
Të drejtat e refugjatëve dhe personave të zhvendosur

1. Të gjithë refugjatët nga Kosova dhe personat e zhvendosur brenda vendit do të kenë të drejtën e kthimit dhe kërkimit të pronës së tyre dhe posedimeve personale, në pajtim me ligjet vendore dhe ndërkombëtare. Çdo person do të ketë të drejtë të marrë vendim të lirë dhe të jetë i informuar për vendin ku ai kthehet.
2. Institucionet e Republikës së Kosovës ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të krijuar kushte te favorshme për kthim të sigurt dhe të denjë të refugjatëve dhe personave të zhvendosur, bazuar në vendimet e tyre të lira dhe të bazuara në informata të sakta, përfshirë përpjekjet për të promovuar dhe mbrojtur lirinë e tyre të lëvizjes dhe mbrojtjen nga kërcënimi
3. Kushtet e kthimit të personave të zhvendosur dhe mekanizmat e bashkëpunimit me institucionet relevante ndërkombëtare do të përcaktohen nga institucionet e Republikës së Kosovës në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e aplikueshme."

Neni 16
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativë të Komunave (ligji)

1. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Bordi do të përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë, me nga pesë (5) përfaqësues të zgjedhur nga secila komunë dhe një (1) përfaqësues i zgjedhur nga Kryeministri.

2. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 4. riformulohet me tekstin si në vijim:
   4. Kryesuesi i Bordit përzgjidhet nga Kryeministri.
3. Neni 14 i ligjit bazik, fshihet termi **"dhe PCN do të ndërmarrin"** dhe zëvendësohet me termin: "**ndërrmer**".
4. Në Shtojcën 1 (Zonat Kadastrale) të ligjit bazik, emërtimi i komunës "**Hani i Elezit**" në gjuhën serbe dhe angleze ndryshohet në "**Elez Han**"

Neni 17
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës (ligji)

1. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi (c) riformulohet me tekstin si në vijim:
   (c) Një (1) anëtar, i përzgjedhur nga Kryeministri.
2. Neni 14 i ligjit bazik, paragrafi (b), nënparagrafi (iv) riformulohet me tekstin si në vijim:
   iv. Një (1) anëtar, i përzgjedhur nga Kryeministri.

Neni 18
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës (ligji)

1. Titulli i nenit 29 të ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 29
Regjistrimi dhe përcaktimi i shtetësisë

Neni 19
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-237 për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave (Ligji)

1. Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 4.12., riformulohet me tekstin si në vijim:
   4.12 Një (1) përfaqësues nga një prej Universiteteve publike, anëtar;

Neni 20
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës (ligji)

1. Neni 9 i ligjit bazik, paragrafi 3., riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Forca e Sigurisë së Kosovës është e strukturuar dhe e përgatitur për të përmbushur funksionet e sigurisë që nuk i përkasin policisë ose organizatave tjera për zbatim të ligjit.
2. Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 2., riformulohet me tekstin si në vijim:
   2. Forca e Sigurisë së Kosovës është e armatosur lehtë dhe nuk ka armë të rënda, siç janë tanket, artileria e rëndë ose kapacitete sulmuese ajrore. Një rishikim i plotë i këtyre kufizimeve, do të bëhet jo më herët se pesë vjet nga koha e hyrjes në fuqi e Ligjit Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Detyrat fillestare të Forcës së Sigurisë së Kosovës janë:

3. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 2, pika (e) fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 21
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-082 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës (ligji)

1. Neni 5 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 22
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-033 për Statusin, imunitetet dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin e Kosovës dhe praninë ndërkombëtare ushtarake, si dhe personelin e saj

1. Neni 3 i ligjit bazik paragrafi 2. pika (a) riformulohet me tekstin si në vijim:
   (a) Zyra Civile Ndërkombëtare dhe Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian.
2. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3.3. Individët e emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtarë, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, mandati i të cilëve nuk ka përfunduar para deklarimit të përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur gëzojnë statusin, privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara në ligjin bazik.
3. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 6., riformulohet me tekstin si në vijim:
   4.6. Ministri i Punëve të Jashtme nuk mund t'i shpallë PSBE-në ose një anëtar të personelit të tij, anëtarët e personelit të ICO-së, përfshirë individët e përcaktuar në nenin 3.3. të ligjit bazik ose anëtarët e misionit EULEX, si persona non grata.
4. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 7. fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 23

1. Të gjithë anëtarët ndërkombëtarë të emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, në pajtim me Kushtetutën e Republikës se Kosovës, me përjashtim të atyre të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Agjencisë Kosovare të Pronës gjyqtarët ndërkombëtarë të Panelit të Ankesave të Gjykatës Supreme, dhe dy gjyqtarë në Komisionin për Kërkesa Pronësore, nëse për çfarëdo arsye largohen nga pozita para datës 31 gusht 2014 ai/ajo do të zëvendësohet me një anëtar vendor.
2. Nëse në cilindo ligj të aplikueshëm në Republikën e Kosovës përdoren termet ICO ose PCN, të njëjtat shfuqizohen dhe zëvendësohen me institucionet vendore përkatëse.

II. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 24
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të amendamenteve kushtetuese për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë.

Ligji Nr. 04/L-115
31 gusht 2012

Shpallur me dekretin Nr.DL-036-2012, datë 04.09.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr.25 / 7 SHTATOR 2012, PRISHTINË

LIGJI Nr. 03/L-108
PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS NR. 03/L-046, TË DATËS 15.06.2008

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Miraton

LIGJ PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS NR. 03/L-046, TË DATËS 15.06.2008

Neni 1

Pika a) e nenit 8 të Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës ndryshohet si vijon:

a) "Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës emërohet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 95 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe mund të ndërrohet në pajtim me nenin 94 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Zëvendës Ministri-at emërohen sipas ligjit në fuqi."

Neni 2

Pas nenit 18 të Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës, shtohet një nen i ri 18. A.

Neni 18.A
Dispozita kalimtare

Ministri dhe Zëvendës Ministri(rat) i/e parë i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës emërohet nga Kryeministri pas miratimit të Ligjit për Ministrinë e FSK Nr. 03/L-045 të datës 15.06.2008 dhe Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës Nr. 03/L-046 të datës 15.06.2008 siç janë ndryshuar më pas."

Neni 3

Ky Ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-108
10 Nëntor 2008

Shpallur me dekretin Nr. DL-057-2008, datë 17.11.2008 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III / Nr. 42 / 25 NËNTOR 2008

LIGJI Nr. 03/L-050
PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT TË SIGURISË SË KOSOVËS

Përmbajtja

Kreu I: Gjendja e zakonshme 171
Kreu II: Gjendja e jashtëzakonshme 175
Kreu III: Organet mbështetëse 176
Kreu IV: Dispozitat përfundimtare dhe kalimtare 177

Në mbështetje të Kapitullit IV neni 65 pika 1, si dhe kapitulli i IX neni 127 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me qëllim të themelimit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJIN PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT TË SIGURISË SË KOSOVËS

KREU I
GJENDJA E ZAKONSHME

Neni 1
Misioni

1.1. Këshilli i Sigurisë së Kosovës ka rol këshillues në të gjitha çështjet që lidhen me sigurinë e Kosovës dhe kontributin e tij për stabilitetin rajonal.
1.2. Këshilli i Sigurisë i Kosovës rekomandon politika dhe strategji për sigurinë.
1.3. Këshilli i Sigurisë i Kosovës duhet të ofroj informata dhe vlerësime të gjendjes së sigurisë në Kosovë, që t'i mundësojnë Qeverisë së Republikës së Kosovës marrjen e vendimeve përkatëse lidhur me çështjet e sigurisë.

Neni 2
Kompetencat

2.1. Këshilli i Sigurisë së Kosovës, në koordinim me Presidentin e Republikës së Kosovës, përgatitë dhe shqyrton Strategjinë e Sigurisë së Kosovës. Strategjia e Sigurisë së Kosovës miratohet nga Qeveria dhe i dorëzohet Kuvendit të Kosovës për miratim përfundimtar.
2.2. Këshilli i Sigurisë së Kosovës ofron komente me shkrim për të gjitha projektligjet që kanë të bëjnë me sektorin e sigurisë dhe institucionet e tij.

Këshillat dhe komentet e Këshillit të Sigurisë së Kosovës merren parasysh nga Qeveria e Republikës së Kosovës para miratimit të projektligjit nga ana e Qeverisë dhe dorëzimit të tij Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim përfundimtar.

2.3. Këshilli i Sigurisë së Kosovës shqyrton planin qeverisës dhjetëvjeçar për Forcën e Sigurisë së Kosovës para se ai të miratohet nga Qeveria dhe pastaj t'i dorëzohet Kuvendit të Kosovës për miratim përfundimtar.

2.4. Këshilli i Sigurisë së Kosovës shqyrton platformën vjetore të inteligjencës dhe prioritetet strategjike për Agjencinë e Inteligjencës së Kosovës para se ajo të miratohet nga Qeveria e Kosovës.

2.5. Këshilli i Sigurisë së Kosovës rishikon politikat dhe planet strategjike të paraqitura nga Ministri i Punëve të Brendshme që kanë të bëjnë me Policinë e Kosovës para miratimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

2.6. Këshilli i Sigurisë së Kosovës shqyrton politikat dhe planet strategjike të paraqitura nga Ministri i Punëve të Brendshme që kanë të bëjnë me Shërbimin e Doganave para miratimit nga Qeveria e Kosovës.

2.7. Këshilli i Sigurisë së Kosovës shqyrton politikën për siguri të jashtme, draftet e të gjitha traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare që janë të rëndësishme për sigurinë dhe vendosjen e marrëdhënieve në mes të agjencive kombëtare për siguri dhe agjencive, apo organizatave homologe ndërkombëtare.

2.8. Këshilli i Sigurisë së Kosovës këshillon Presidentin dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës mbi propozimin për përfshirjen e propozuar të institucioneve dhe agjencive të sigurisë së Kosovës në operacione jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Institucionet dhe agjencitë qeveritare të sigurisë në Kosovë kanë të drejtë të shërbejnë jashtë vetëm në bazë të marrëveshjes me vendin pranues ose në bazë të ftesës së organizatës ndërkombëtare në të cilën Kosova është anëtare apo aspiron të anëtarësohet, ose në bazë të një Rezolute të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të japë pëlqimin paraprak për dërgimin e personelit në operacione jashtë vendit.

2.9. Presidenti i Republikës së Kosovës ka të drejtë të kërkojë këshilla nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës. Këshilli i Sigurisë së Kosovës me kohë do t'i përgatisë dhe japë këshillën e kërkuar Presidentit të Republikës së Kosovës.

Neni 3
Përbërja

3.1. Këshilli i Sigurisë së Kosovës përbëhet prej anëtarëve të mëposhtëm në cilësinë e anëtarëve të përhershëm me autoritet ekzekutiv:

a) Kryeministri;
b) Zëvendës Kryeministri(at);
c) Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës, ose në mungesë të tij apo saj, Zëvendës Ministri(at);
d) Ministri i Punëve të Jashtme, ose në mungesë të tij apo saj Zëvendës Ministri;
e) Ministri i Punëve të Brendshme, ose në mungesë të tij apo saj Zëvendës Ministri;

f) Ministri i Drejtësisë, ose në mungesë të tij apo saj Zëvendës Ministri;
g) Ministri i Ekonomisë dhe Financave, ose në mungesë të tij apo saj Zëvendës Ministri;
h) Ministri për Kthim dhe Komunitete, ose në mungesë të tij apo saj Zëvendës Ministri.

3.2. Nëse asnjëri nga anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurisë së Kosovës me autoritet ekzekutiv nuk i takon komunitetit serb, Kryeministri emëron një anëtar shtesë nga radhët e ministrave serbë si anëtar shtesë i Këshillit të Sigurisë së Kosovës me autoritet ekzekutiv.

3.3. Anëtarë tjerë jo të përhershëm ekzekutiv ministror mund të emërohen nga Kryesuesi i Këshillit të Sigurisë së Kosovës me status të përkohshëm.

3.4. Këshilli i Sigurisë së Kosovës, si anëtar të përhershëm po ashtu përfshin anëtarët e mëposhtëm në rolin këshillëdhënës:
a) një përfaqësues i Presidentit të Republikës së Kosovës;
b) drejtorin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;
c) këshilltarin e lartë të Kryeministrit;
d) këshilltarin e Kryeministrit për Siguri,
e) drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
f) komandantin e Forcës së Sigurisë të Kosovës;
g) sekretarin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës;
h) drejtorin e Departamentit për Menaxhimin e Emergjencave në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
i) drejtori i Doganave të Republikës së Kosovës

3.5. Anëtarë shtesë në cilësinë e këshilltarëve me status të përkohshëm mund të emërohen nga Kryesuesi i Këshillit të Sigurisë së Kosovës sipas nevojës.

3.6. Në cilësinë e vëzhguesit mund të marrin pjesë Kryetari i Komisionit parlamentar për siguri dhe kryetari i komisionit parlamentar për të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Neni 4
Kryesimi i takimeve

4.1. Këshilli i Sigurisë së Kosovës punon nën përgjegjësinë e Kryeministrit, i cili kryeson takimet e tij.

4.2. Kryeministri në pamundësi të kryesimit të takimit, këtë autoritet mund ta delegojë tek njëri nga Zëvendës Kryeministrat, ose në mungesë të tyre një anëtari tjetër të Këshillit të Sigurisë së Kosovës sipas rendit të prioritetit.

Neni 5
Thirrja e takimeve të Këshillit të Sigurisë së Kosovës

5.1. Këshilli i Sigurisë së Kosovës harton planin vjetor dhe cakton të mbajë jo më pak se një takim çdo tre muaj.

5.2. Prioritetet për planin vjetor përcaktohen nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës.

5.3. Takimet e Këshillit të Sigurisë së Kosovës thirren formalisht nga Kryeministri.

5.4. Kryeministri është i obliguar të thërras takimin e Këshillit të Sigurisë së

Kosovës në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës apo shumica e anëtarëve të përhershëm Këshillit të Sigurisë së Kosovës formalisht kërkojnë takim. Takimet mbahen pas njoftimit paraprak, siç është e përcaktuar me rregulloret në fuqi.

Neni 6
Rendi i ditës për takime

Rendi i ditës për takimet e Këshillit të Sigurisë së Kosovës do të caktohet nga Kryesuesi i Këshillit.

Neni 7
Vendimmarrja

Procesi i vendimmarrjes do të rregullohet me Rregullore te brendshme të Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

Neni 8
Raportimi i Këshillit të Sigurisë së Kosovës

Kryesuesi është përgjegjës për të raportuar për shqyrtimet dhe/ose rekomandimet e Këshillit të Sigurisë së Kosovës para Qeverisë.

Neni 9
Mbikëqyrja parlamentare e Këshillit të Sigurisë së Kosovës

9.1. Kryesuesi dorëzon Raportin Vjetor të Aktiviteteve për diskutim dhe miratim nga komisioni përkatës i Kuvendit, jo më vonë se muaji mars për vitin e kaluar. Komisioni mund të kërkojë raporte rreth aktiviteteve specifike të Këshillit të Sigurisë së Kosovës kurdo që konstatohet e nevojshme.

9.2. Komisioni përkatës i Kuvendit të Republikës së Kosovës mund të organizojë seanca për çështje lidhur me punën e Këshillit të Sigurisë së Kosovës të cilat Kuvendi dëshiron t'i parashtrojë.

Neni 10
Obligimi për konfidencialitet i anëtarëve të organit parlamentar për mbikëqyrje

10.1. Anëtarët e komisionit mbikëqyrës parlamentar janë të obliguar të mbajnë konfidenciale informatat e marra në çfarëdo forme nga Këshilli i Sigurisë e Kosovës, apo nga përfaqësuesit e saj të autorizuar, të cilat konsiderohen konfidenciale në pajtim me legjislacionin në fuqi. Obligimi për konfidencialitet mbetet në fuqi edhe pas përfundimit të anëtarësisë së tyre në komisionin parlamentar për mbikëqyrje. Çfarëdo shkelje e obligimit për sekret mund të dënohet deri në shkallën më të lartë që parasheh ligji.

10.2. Komisioni mbikëqyrës parlamentar do të përpilojë procedura të shkruara, në pajtim me ligjet e aplikueshme, për të mbrojtur zbulimin e paautorizuar e të

gjitha informatave të klasifikuara të cilat i ofrohen komisionit mbikëqyrës parlamentar, apo anëtarëve të tij individualë, nga ana e Këshillit të Sigurisë së Kosovës apo përfaqësuesit e tij të autorizuar.

Neni 11
Publikimi i vendimeve të Këshillit të Sigurisë së Kosovës

11.1. Çështjet e diskutuara nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës klasifikohen në pajtim me ligjin e aplikueshëm.
11.2. Të gjitha vendimet të cilat sipas ligjit të aplikueshëm nuk konsiderohen konfidenciale publikohen dhe vihen në dispozicion të publikut.
11.3. Të gjithë anëtarët dhe ish anëtarët e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, përfshirë anëtarët e Sekretariatit dhe Qendrës për Komunikim, bartin përgjegjësi individuale ligjore për zbulimin dhe mos zbulimin e informatave, në pajtim me ligjin e aplikueshëm.

KREU II
GJENDJA E JASHTËZAKONSHME

Neni 12
Misionet

Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, Këshilli i Sigurisë së Kosovës ushtron autoritet dhe përgjegjësi ekzekutive në emër të Qeverisë dhe sikurse është përcaktuar në nenin 13 të këtij ligji, të kufizuar në kohë dhe në ato veprime të cilat konsiderohen të nevojshme për të tejkaluar atë situatë emergjente.

Neni 13
Autoriteti ekzekutiv gjatë gjendjes së jashtëzakonshme

13.1. Këshillit të Sigurisë së Kosovës i besohet autoriteti ekzekutiv pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin në fuqi.
13.2. Autoriteti i Këshillit të Sigurisë së Kosovës gjatë gjendjes emergjente do të kufizohet në veprime, të cilat në pajtim me ligjet në fuqi janë të domosdoshme për t'u ballafaquar me gjendjen e emergjencës.
13.3. Këshilli i Sigurisë së Kosovës mund t'i delegojë autoritetin organeve të ndryshme për t'u ballafaquar me situata të caktuara gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, siç është përcaktuar me ligjet në fuqi.
13.4. Këshilli i Sigurisë së Kosovës informon Kuvendin e Kosovës për veprimet e tij, në pajtim me ligjet në fuqi.

Neni 14
Mbledhjet e Këshillit të Sigurisë së Kosovës gjatë gjendjes së jashtëzakonshme

14.1. Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme të shpallur, Presidenti i Republikës së Kosovës kryeson Këshillin e Sigurisë së Kosovës.

14.2. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës nuk ka mundësi të thirr mbledhjen, mbledhjet e Këshillit të Sigurisë së Kosovës mund të thirren në çfarëdo kohe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme me anë të një kërkese të veçantë nga Qeveria ose Kuvendi i Kosovës me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm.

Neni 15
Përbërja

15.1. Gjatë kohës së gjendjes së shpallur të emergjencës, Këshilli i Sigurisë së Kosovës përbëhet nga Presidenti i Republikës, Kryeministri dhe Ministrat e Qeverisë, në të cilët duhet të bartet pushteti ekzekutiv. Nëse ndonjëri nga ministrat nuk është në gjendje të marrë pjesë, në mungesë të tij duhet t'i lejohet pjesëmarrja zëvendës ministrit.

15.2. Këshilli i Sigurisë së Kosovës do të përfshijë këta anëtarë në cilësi këshillëdhënëse:

a) drejtorin e Agjencisë së Kosovës për Siguri;
b) këshilltarin e lartë për siguri të Presidentit;
c) këshilltarin e Kryeministrit për Siguri,
d) drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
e) komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës;
f) sekretarin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës;
g) drejtorin e departamentit për menaxhimin e emergjencave të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

KREU III
ORGANET MBËSHTETËSE

Neni 16
Roli i Sekretariatit

16.1. Këshilli i Sigurisë së Kosovës ka Sekretariatin e tij i cili rregullohet me legjislacion sekondar.

16.2. Sekretariati do të udhëhiqet nga Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, i cili emërohet nga Komisioni për Emërime të Larta Publike, në pajtim me ligjin në fuqi.

16.3. Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës i raporton drejtpërdrejtë Kryesuesit.

16.4. Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës është përgjegjës për:

a) përgatitjen e raporteve periodike dhe analizave për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Këshillin e Sigurisë së Kosovës që kanë të bëjnë me çështjet politike të sigurisë;
b) koordinimin e hartimit të strategjisë dhe politikave të sigurisë në Kosovë, përfshirë edhe ndërtimin e kapaciteteve, instrumentet e politikave dhe hulumtimit; dhe
c) ofrimin e mbështetjes administrative dhe funksionale Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

Neni 17
Qendra e Situatave

17.1. Këshilli i Sigurisë së Kosovës mbështetet nga një Qendër e Situatave e cila i ofron informata të shpejta rreth gjendjes dhe koordinon aktivitetet operacionale në tërë Kosovën. Shërben si qendër operacionale për mbledhjen e informatave, analizave themelore dhe mbështetjes për menaxhim të krizave.
17.2. Të gjitha ministritë relevante, institucionet e sigurisë dhe agjencitë i ofrojnë informata Qendrës te Situatave.
17.3. Qendra e Situatave po ashtu mbështetet nga përfaqësuesit e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Policisë së Kosovës, dhe Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë e cila është përgjegjëse për ndërlidhje me agjencitë e tyre përkatëse.

Neni 18
Komisionet Koordinuese

18.1. Kryeministri themelon Komisionin për Inteligjencë. Komisioni për Inteligjencë përbëhet nga Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës dhe përfaqësuesit e lartë të Policisë së Kosovës, Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Forcës së Sigurisë së Kosovës, Shërbimit Doganor, dhe çfarëdo agjencie apo organizate e autorizuar sipas ligjit ka mandat për kryerjen e aktiviteteve të inteligjencës. Komisioni i raporton Këshillit të Sigurisë së Kosovës dhe kryesohet nga Kryeministri apo personi i caktuar nga ai/ajo.
18.2. Komisioni koordinon aktivitetet e inteligjencës të organizatave dhe agjencive të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni për qëllim të:
   a) sigurimit që politikat e qeverisë në sektorin e inteligjencës janë duke u zbatuar sipas prioriteteve të përcaktuara;
   b) sigurimit të bashkëpunimit efikas në mes të agjencive dhe këmbimi i informacionit:
18.3. Këshilli i Sigurisë së Kosovës mund të themelojë edhe komisione sipas nevojës, të cilat i raportojnë Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

KREU IV
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 19
Kualifikimet për punësim në Qendrën e Situatave dhe Sekretariatin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës

Përveç kërkesave të zakonshme për punësim në Shërbimin Civil të Kosovës, punëtorët e Qendrës së Situatave ose Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës duhet të posedojnë edhe leje përkatëse për siguri, të përcaktuara me ligjin në fuqi.

Neni 20
Dispozitat kalimtare

20.1. Këshilli i Sigurisë së Kosovës ushtron funksionet e tij pa paragjykime ndaj mandateve specifike të organizatave ndërkombëtare sikurse është përcaktuar me anë të zgjidhjes së statusit dhe Kushtetutës.
20.2. Deri në miratimin e procedurës për dhënien e lejeve përkatëse për siguri të përmendura në nenin 19 të këtij ligji, punëtorëve të Qendrës së Situatave dhe Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës mund t'u lëshohen leje të përkohshme për siguri, të cilat vlejnë për 6 muaj, në rast se ata punëtor i kanë dorëzuar të plotësuar pyetësorët për leje të sigurisë. Lejet e përkohshme për siguri mund të zgjaten një herë për një periudhë e cila nuk kalon gjashtë muaj të tjerë.
20.3. Paragrafi 2 i këtij neni vlen vetëm për individët e punësuar në Qendrën e Situatave apo në Sekretariatin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës para zbatimit të procedurës për dhënien e lejeve për siguri.

Neni 21
Dispozitat përfundimtare

Buxheti i Këshillit të Sigurisë së Kosovës paraqitet nga ana e Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës dhe miratohet nga Kuvendi i Kosovës, në pajtim me ligjin në fuqi.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës
Me datën: 13.03.2008

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III / Nr. 26 / 02 QERSHOR 2008

LIGJI Nr. 03/L-063
LIGJI PËR AGJENCINË E KOSOVËS PËR INTELIGJENCË

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjitshme 180
Kreu II: Organizimi i administrimi i AKI-së 182
Kreu III: Inspektori i përgjithshëm 185
Kreu IV: Punonjësit e Agjencisë së Intelegjencës së Kosovës 187
Kreu V: Mbledhja, ndarja dhe mbrojtja e informacionit 191
Kreu VI: Fshehtësia 195
Kreu VII: Mbikëqyrja parlamentare 196
Kreu VIII: Mekanizmat e ankesës 198
Kreu IX: Financimi 198
Kreu X: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 199

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të neneve 65(1) dhe 129 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Duke njohur se nevoja për informacion me kohë dhe të saktë për inteligjencë, kundërinteligjencë, kërcënime nga brenda dhe jashtë, terrorizmin ndërkombëtar apo vendor, prodhimin dhe trafikimin e narkotikëve, krimin e organizuar, krimin ekonomik, sabotazhin dhe të gjitha çështjet tjera të inteligjencës të lidhura me sigurinë e Kosovës është esenciale për popullin e Kosovës;

Duke njohur se të gjitha mjetet e arsyeshme dhe ligjshme duhet të përdoren për të siguruar që Kosova do të pranojë informatat më cilësore të inteligjencës që janë në dispozicion;

Për këtë qëllim, do të themelohet Agjencia e Kosovës për Inteligjencë për të mbledhur, analizuar dhe shpërndarë këto informata në mënyrë të shpejtë dhe përgjegjshme. Parimet e parashtruara në këtë ligj janë hartuar për të arritur një baraspeshë të duhur ndërmjet marrjes së informacionit esencial dhe mbrojtjes së interesave individuale,

Miraton këtë

LIGJIN PËR AGJENCINË E KOSOVËS PËR INTELIGJENCË

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITSHME

Neni 1
Themelimi i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë

1.1. Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (në vijim AKI) themelohet si agjenci për siguri dhe inteligjencë në Kosovë.
1.2. AKI qeveriset në bazë të këtij ligji në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe të gjitha ligjet tjera në fuqi në Kosovë.
1.3. AKI është person juridik.
1.4. AKI ka mandat të veproj në tërë territorin e Kosovës.
1.5. Ndalohet çdo përdorim i teknikave të fshehta në Kosovë pa autorizim të posaçëm në bazë të ligjit.
1.6. Mjetet financiare për veprimtarinë e AKI-së sigurohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës në pajtim me ligjin në fuqi për të.
1.7. Në varësi të nevojave specifike operative të AKI-së, AKI, po ashtu, mund të krijoj prani në terren brenda Kosovës për kryerjen e detyrave brenda mandatit të AKI-së.

Neni 2
Fusha e veprimit

2.1. AKI mbledhë informacion në lidhje me kërcënimet ndaj sigurisë së Kosovës. Në çdo rast kërcënim ndaj sigurisë së Kosovës konsiderohet kërcënimi ndaj integritetit territorial, integritetit të institucioneve, rendit kushtetues, stabilitetit dhe zhvillimit ekonomik, si dhe kërcënimet ndaj sigurisë globale në dëm të Kosovës, duke përfshirë:
(i) terrorizmin;
(ii) nxitjen, ndihmën dhe shtytjen ose përkrahjen e terrorizmit;
(iii) spiunazhin kundër Kosovës apo në dëm të sigurisë së Kosovës;
(iv) sabotazhin drejtuar kundër infrastrukturës vitale të Kosovës;
(v) krimin e organizuar kundër Kosovës apo në dëm të sigurisë së Kosovës në cilëndo mënyrë, duke përfshirë larjen e parave;
(vi) nxitjen e pakënaqësisë në strukturat e sigurisë;
(vii) trafikimin e substancave ilegale, armëve apo qenieve njerëzore;
(viii) prodhimin ilegal apo transportin e armëve të shkatërrimit në masë, ose të komponentëve të tyre, si dhe materialeve dhe pajisjeve të nevojshme për prodhimin e tyre;
(ix) trafikimin ilegal të prodhimeve dhe teknologjive nën Kontrollin Ndërkombëtar;
(x) aktivitetet që bien ndesh me të drejtën humanitare ndërkombëtare;
(xi) aktet e dhunës së organizuar apo të frikësimit kundër grupeve etnike apo fetare në Kosovë, dhe

(xii) çështjet që kanë të bëjnë me kërcënime serioze ndaj shëndetit apo sigurisë publike.

2.2. Për të avancuar aktivitetet e AKI-së të paraqitura në Nenin 2.1 më lartë, dhe në pajtim me nenet 28 dhe 30 të këtij ligji, AKI ka mundësitë e veta për mbledhjen e informacionit, që përfshijnë:
(i) përgjimin mobil dhe statik;
(ii) personelin e fshehtë për mbledhjen e informacioneve;
(iii) përgjimin teknik, siç janë pajisjet për dëgjim, përgjim dhe përcjellje;
(iv) agjentët e fshehtë;
(v) mbledhjen e të dhënave konfidenciale, si nga bankat, portet dhe telefonin.

2.3. Prioritetet strategjike të AKI-së parashtrohen në Platformën Vjetore të Politikës së Inteligjencës dhe Sigurisë (në vijim PVPIS), e cila përmban udhëzimet e përgjithshme për punën e AKI-së. Drejtori i AKI-së propozon një version të Platformës Vjetore të Politikës së Inteligjencës dhe Sigurisë Këshillit të Sigurisë të Kosovës (në vijim KSK) për shqyrtim nga ana e tyre. Pas konsultimit me Presidentin e Republikës së Kosovës, PVPIS i dorëzohet për miratim Qeverisë. Pas miratimit, PVPIS i dorëzohet Organit Mbikëqyrës Parlamentar për informim, dhe Drejtorit të AKI-së, për veprim.

2.4. AKI-ja nuk vepron kundër të drejtave dhe interesave të asnjë komuniteti e as diskriminon ndonjë person mbi çfarëdo baze siç është gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimi politik apo ndonjë tjetër, prejardhja kombëtare apo shoqërore, lidhja me një pakicë kombëtare, prona, lindja apo ndonjë status tjetër.

2.5. AKI-ja respekton parimet e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, dhe parimet tjera relevante të pasqyruara në instrumentet ligjore të njohura ndërkombëtarishtë dhe kryen aktivitetet e veta në pajtueshmëri me to.

Neni 3
Funksionet e ndaluara të AKI-së

3.1. AKI nuk ka funksione ekzekutive. Në këtë mënyrë, AKI nuk ka:
(i) të drejtën të përdorë forcë direkte apo indirekte;
(ii) çfarëdo autoriteti për arrest;
(iii) mundësinë të iniciojë procedura penale, dhe
(iv) autorizimin të detyrojë persona apo kompani të bashkëpunojnë për aktivitetet e saj, ndonëse persona apo kompani mund të bashkëpunojnë me AKI-në mbi baza vullnetare.

3.2. AKI nuk do të mbledhë informata duke përdorë mekanizma dhe metoda të fshehta në lidhje me palët e treta që gëzojnë imunitetet dhe privilegjet diplomatike, që janë në përputhje me Ligjin për Statusin, Imunitetet dhe Privilegjet e Misioneve Diplomatike, Konsullore dhe Personelin e tyre në Republikën e Kosovën dhe Praninë Ndërkombëtare Ushtarake dhe Personelin e saj, si dhe Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike, me përjashtim të rasteve kur synohet parandalimi i kërcënimeve ndaj këtyre organizatave dhe organeve. Drejtori i AKI-së është i obliguar të informojë krerët e këtyre organizatave dhe organeve për të gjitha kërcënimet e tilla.

3.3. Të gjitha veprimet apo mosveprimet e AKI-se dhe të punonjësve të saj janë në pajtim më ligjin në fuqi, duke përfshirë instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të përshkruara mes tjerash në nenin 2.5 më lartë.

3.4. Qeveria e Kosovës mban përgjegjësi për dëmet e shkaktuara ndaj personave juridik apo fizik si rezultat i veprimeve të punonjësve të AKI-së të ndërmarrura gjatë kryerjes së detyrave apo në lidhje me kryerjen e detyrave të AKI-së sipas këtij ligj.

3.5. Qeveria e Kosovës ka të drejtë nëpërmjet rrugës gjyqësore të rikthejë çfarëdo shume të paguar në emër të kompensimit palës së tretë, nëse punonjësi i AKI-së shpallet përgjegjës për dëmet të përmendura në nenin 3.4 më lartë, dhe nëse dëmet rezultojnë nga pakujdesia e madhe apo veprimi i qëllimshëm apo i paautorizuar i punonjësit.

Neni 4
Verifikimi dhe aktivitetet tjera të sigurimit

4.1. AKI-ja do të mbrojë sigurinë e aktiviteteve, informacionit, punonjësve dhe pronës së vet nëpërmjet mjeteve përkatëse, duke përfshirë verifikimin e kandidatëve, të punonjësve dhe të të kontraktuarve sipas nevojës.

4.2. Të gjitha veprimet në lidhje me procedurat e verifikimit të përshkruara më lartë, dhe në Nenin 14 më poshtë, do të kryhen me konfidencialitet dhe për të vetmin qëllim, mbrojtjen e sigurisë së Kosovës dhe të popullit të saj.

4.3. Asnjë aplikant, punonjës apo i kontraktuar nuk do të diskriminohet mbi bazë të përkatësisë së vet në një komunitet apo në ndonjë mënyrë tjetër, e cila shkel nenin 2.4 të këtij ligji.

KREU II
ORGANIZIMI E ADMINSTRIMI I AKI-së

Neni 5
Drejtori i AKI-së

5.1. Drejtori i AKI-së, në pajtueshmëri me këtë Ligj, Rregulloren mbi Organizimin e Brendshëm dhe ligjet tjera në fuqi, është përgjegjës për të gjitha aspektet e menaxhimit të AKI-së. Drejtori i AKI-së do t'i përgjigjet drejtpërdrejt Kryeministrit.

5.2. Në kryerjen e përgjegjësive të veta, drejtori i AKI-së ndihmohet nga një zëvendësdrejtor, udhëheqësit e njësive organizative, këshilltarët, dhe personeli me kualifikim të duhur sipas nevojës, në pajtueshmëri me rregullat dhe procedurat e parashtruara me këtë Ligj dhe Rregulloren e Organizimit të Brendshëm.

5.3. Presidenti i Republikës së Kosovës së bashku me Kryeministrin, emërojnë së bashku Drejtorin e AKI brenda njëzet (20) ditësh pune nga dita kur pozita mbetet e lirë.

5.4. Drejtori i AKI-se shkarkohet nëpërmjet procesit të njëjtë me të cilin është emëruar.

5.5. Drejtori i AKI-së emërohet për një mandat pesë (5) vjeçar, i cili mund të vazhdohet edhe njëherë.

5.6. Drejtori i AKI-së duhet të ketë arsimim universitar dhe duhet të emërohet mbi baza të profesionalizmit dhe përvojës së dëshmuar.

5.7. Drejtori i AKI-së:

(i) shërben si këshilltar i Presidentit dhe Kryeministrit të Republikës së Kosovës për çështje të inteligjencës që kanë të bëjnë me sigurinë e Kosovës;

(ii) njofton Presidentin dhe Kryeministrin e Republikës së Kosovës për aktivitetet e AKI-së;

(iii) ofron informata për Presidentin dhe Kryeministrit e Republikës së Kosovës sa i përket sigurisë;

(iv) është përgjegjës për mbledhjen, analizën, prodhimin dhe shpërndarjen e informatave dhe siguron se kjo bëhet me kohë dhe në mënyrë objektive dhe të pandikuar nga arsyet politike;

(v) mbron burimet e inteligjencës dhe metodat e veprimit si dhe informacionin tjetër të klasifikuar nga shpalosja e pa autorizuar;

(vi) ka pushtet ekskluziv të emërojë Punonjësit në AKI, që do të bëhet sipas parimeve të parashtruara në Kapitullin IV të këtij Ligji, dhe në Rregulloren e Organizimit të Brendshëm;

(vii) vendosë dhe koordinon marrëdhëniet me agjencitë e inteligjencës dhe sigurisë të qeverive të huaja për çështje që kanë të bëjnë me inteligjencën;

(viii) siguron se AKI-ja nuk ndërmerr asnjë veprim që mund të krijojë dyshim të arsyeshëm se AKI-ja është e angazhuar në avancimin, mbrojtjen apo dëmtimin e interesave të cilido komunitet apo cilësdo parti apo organizatë politike;

(ix) siguron se AKI-ja nuk ndërmerr asnjë veprim me qëllim të ndikimit në procese politike, opinion publik, politika dhe media në Kosovë;

(x) propozon buxhetin vjetor të bazuar në udhëzimet nga Platforma e Politikës së Inteligjencës dhe Sigurisë dhe dorëzon propozimin bashkë me mendimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë për përfshirje në buxhetin vjetor të Kosovës;

(xi) përgatitë raporte dhe propozojë plane dhe programe të AKI-së, duke përfshirë mes tjerash, Programin Vjetor të Aktivitetit dhe Raportin Vjetor të Aktivitetit;

(xii) përgatitë propozimin e Platformës Vjetore të Politikës së Inteligjencës dhe Sigurisë;

(xiii) inicion dhe nënshkruan Memorandume të Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit me institucione dhe organe tjera;

(xiv) raporton para Komisionit parlamentar mbikëqyrës sipas kërkesës; dhe,

(xv) përgjigjet ndaj ankesave të individëve që besojnë se të drejtat e tyre janë shkelur nga ana e AKI-së.

Neni 6
Zëvendësdrejtori i AKI-së

6.1. Zëvendësdrejtori i AKI-së ndihmon drejtorin e AKI-së dhe drejton aktivitetet operacionale të njësive organizative të AKI-së nën mbikëqyrjen e drejtorit të AKI-së.

6.2. Zëvendësdrejtori i AKI-së duhet të ketë arsimim universitar dhe emërohet mbi baza të profesionalizmit dhe përvojës së dëshmuar dhe pa marr parasysh përkatësinë politike, për një mandat pesëvjeçar (5), cili mund të përtërihet dhe do të rrjedhë pavarësisht nga mandati i drejtorit të AKI-së.

6.3. Presidenti i Republikës së Kosovës së bashku me Kryeministrin, emërojnë zëvendës Drejtorin e AKI-së brenda njëzet (20) ditësh pune nga dita kur pozita mbetet e lirë.

6.4. Zëvendësdrejtori i AKI-së shkarkohet nëpërmjet procesit të njëjtë me të cilin është emëruar.

6.5. Zëvendësdrejtori i AKI-së përkohësisht kryen dhe ushtron përgjegjësitë e drejtorit të AKI-së gjatë mungesës apo paaftësisë të drejtorit. Në rast të paaftësisë të përhershme, zëvendësdrejtori i AKI-së kryen dhe ushtron përgjegjësitë e drejtorit të AKI-së deri në kohën kur zëvendësimi i Drejtorit të KIA-s emërohet në mënyrë formale.

Neni 7
Rregullorja dhe Organizimi i Brendshëm

7.1. Organizimi i brendshëm i AKI-së përcaktohet me Rregulloren e Organizimit të Brendshëm.

7.2. Rregullorja e Organizimit të Brendshëm do t'i dorëzohet për miratim Kryeministrit.

7.3. Në pajtim me këtë Ligj dhe legjislacionin tjetër në fuqi, Drejtori i AKI-së është përgjegjës për shpalljen, mes tjerash, rregullat, rregulloret dhe udhëzimeve me sa vijon:

(i) kodi i etikës;
(ii) plani për sigurinë e të dhënave;
(iii) rregullorja e klasifikimit dhe deklasifikimit të të dhënave;
(iv) rregullorja e procedurës për lejen e sigurisë;
(v) rregullorja për sigurimin e të dhënave sekrete dhe ruajtjen e të dhënave;
(vi) rregulloret mbi shpërndarjen e të dhënave;
(vii) rregullorja mbi rekrutimin, menaxhimin dhe pagimin e informatorëve;
(viii) rregullorja mbi zbatimin, përdorimin dhe angazhimin e mjeteve operacionale speciale dhe teknike;
(ix) rregullorja mbi mbajtjen dhe përdorimin e armëve;
(x) rregullorja e punës;
(xi) rregullorja për pagat;
(xii) rregullorja e sigurisë së brendshme;
(xiii) rregullorja e procedurës disiplinore;
(xiv) rregullorja mbi thirrjet bazike dhe të përgjithshme të punonjësve të AKI;
(xv) rregullorja mbi bashkëpunimin me organe dhe institucione;
(xvi) rregullorja mbi nënshkrimin e memorandumeve të mirëkuptimit me organe dhe institucione ne Kosovë;
(xvii) rregullorja mbi bashkëpunimin me organe ndërkombëtarë dhe shkëmbimin e inteligjencës;
(xviii) rregullorja e kartelat identifikuese;

(xix) rregulloren mbi mekanizmin e ankesave, që do të zhvillohet në konsultim me institucionin e Ombudspersonit në Kosovë dhe do të vendoset në domenin publik.

7.4. Përmbledhjet e rregullave, rregulloret, dhe udhëzimet të parashtruara në Nenin 7.3 të këtij Ligji do të jenë të klasifikuara në atë mënyrë që të jenë në interes të sigurisë së Kosovës.

7.5. Drejtori i AKI siguron që të punësuarit në AKI të jenë të njohur me Përmbledhjet e Rregullave, rregulloret dhe udhëzimet e nxjerra në bazë të nenit 7.3 dhe dispozitave tjera të këtij ligji.

Neni 8
Bashkëpunimi brenda qeveritar

8.1. Bashkëpunimi ndërmjet AKI-së dhe Policisë së Kosovës, Ministrisë për Punë të Brendshme, si dhe me institucionet tjera të sigurisë publike do të jetë i rëndësisë primare. AKI-ja bashkëpunon me institucionet tjera qeveritare në Kosovë me qëllim të mbrojtjes së zyrtarëve, objekteve dhe informacionit të AKI-së.

8.2. Pas emërimit të drejtorit të AKI-së, nënshkruhet një memorandum për bashkëpunim, ndihmë dhe koordinim të ndërsjellë të aktiviteteve ndërmjet AKI-së dhe Policisë së Kosovës, Ministrisë për Punë të Brendshme dhe institucioneve tjera relevante qeveritare. Qeveria definon parimet e përgjithshme të koordinimit dhe asistencës ndërmjet dhe brenda AKI-së dhe organeve dhe institucioneve në Kosovë.

8.3. AKI-ja dhe organet dhe institucionet tjera në Kosovë janë të obliguara të bashkëpunojnë dhe ndihmojnë njëra-tjetrën në kryerjen e detyrave të tyre dhe të koordinojnë aktivitetet brenda kompetencave të veta, në harmoni me ligjet dhe rregulloret në fuqi në lidhje me mbrojtjen e burimeve, metodave dhe informacionit tjetër të klasifikuar.

8.4. Drejtori i AKI-së, me miratim të kryeministrit, bënë marrëveshje me institucionet në Kosovë për ofrimin e mbështetjes për inteligjencën e fshehtë.

KREU III
INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

Neni 9
Emërimi dhe mandati i inspektorit të përgjithshëm

9.1. Presidenti i Republikës së Kosovës së bashku me Kryeministrin, emëron Inspektorin e Përgjithshëm të AKI-së brenda njëzet (20) ditësh pune nga dita kur pozita mbetet e lirë.

9.2. Inspektori i përgjithshëm shërben për një mandat (4) katërvjeçar, që mund të përtërihet edhe për një mandat katërvjeçar.

9.3. Inspektori përgjithshëm shkarkohet nëpërmjet procesit të njëjtë me të cilin është emëruar.

9.4. Emërimi i inspektorit të përgjithshëm bëhet mbi baza të integritetit, përputhjes ndaj standardeve të sigurisë së AKI-së, dhe përvojës në lëmi të sigurisë apo administrimit qeveritar në Kosovë.

9.5. Inspektori i përgjithshëm i raporton drejtpërdrejt kryeministrit.
9.6. Inspektori i përgjithshëm i raporton organit mbikëqyrës parlamentar të paktën çdo gjashtë (6) muaj dhe me kërkesë specifike me shkrim të Komisionit Mbikëqyrës Parlamentar.

Neni 10
Përgjegjësia e inspektorit të përgjithshëm

10.1. Inspektori i përgjithshëm inspekton aktivitetet e AKI-së.
10.2. Është përgjegjësi e inspektorit të përgjithshëm të ndihmojë drejtorin të jetë informuar në mënyrë të plotë dhe të vazhdueshme për problemet potenciale në aktivitetet e AKI-së, me qëllim të promovimit të ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit, dhe evitimit të çfarëdo shkeljeje ligjore.
10.3. Inspektori i përgjithshëm i rekomandon Drejtorit të AKI-së veprime korrektuese dhe monitoron progresin e secilit veprim korrektuese të urdhëruar nga drejtori i AKI-së.
10.4. Përgjegjësia e inspektorit të përgjithshëm përfshin auditimet financiare të aktiviteteve të AKI-së. Përveç drejtorit të AKI-së, rezultatet e këtyre auditimeve do t'i vihen në dispozicion edhe kryeministrit.
10.5. Pas njoftimit të drejtorit të AKI-së, inspektori i përgjithshëm ka të drejtë të marrë në pyetje Punonjësit e AKI-së dhe të ketë qasje në objektet dhe të dhënat e AKI-së sipas nevojës, me qëllim të hetimit, inspektimit apo auditimit të brendshëm.
10.6. Drejtori i AKI-së mund t'i ndalojë inspektorit të përgjithshëm të iniciojë, kryejë apo përfundojë cilindo inspektim apo auditim nëse drejtori përcakton se është e nevojshme të mbrohen interesat vitale të sigurisë së Kosovës. Nëse drejtori ushtron këtë të drejtë, ai apo ajo do t'ia raportojë këtë veprim kryeministrit dhe Presidentit të Republikës së Kosovës brenda shtatë (7) ditëve kalendarike.
10.7. Inspektori i përgjithshëm është përgjegjës për ofrimin e funksionit të kontrollit të brendshëm në AKI duke shqyrtuar aktivitetet e AKI-së, iniciuar inspektime, auditime dhe hetime, hetuar ankesat në lidhje me aktivitetet e AKI-së apo të bëra nga personat në Kosovë.
10.8. Inspektori i përgjithshëm është përgjegjës për të mbështetur hetimet e Ombudspersonit të Kosovës.

Neni 11
Ndihma inspektorit të përgjithshëm

Nëse e miraton drejtori i AKI-së, inspektori i përgjithshëm bënë zgjedhjen e individëve për ta ndihmuar atë në kryerjen e funksioneve të veta, duke përfshirë individë të kualifikuar për të kryer auditime financiare.

KREU IV
PUNONJËSIT E AGJENCISË SË INTELEGJENCËS SË KOSOVËS

Neni 12
Zbatueshmëria e legjislacionit të punësimit për punonjësit e AKI-së

12.1. Punonjësit e AKI-së nuk janë shërbyes civilë. Megjithatë, legjislacioni që rregullon çështjet e shërbimit civil zbatohet ndaj AKI-së, përveç rasteve kur rregullohet ndryshe me këtë ligj.
12.2. Shpalljet e vendeve të lira të punës në AKI i nënshtrohen konkurrencës së hapur dhe publikohen në shumë gazeta ditore që shpërndahen në Kosovë, me përshkrim të kërkesave të përgjithshme për pozitat në pajtim me ligjin në fuqi.
12.3. Procesi i brendshëm i zgjedhjes të punonjësve të AKI-së do të jetë i klasifikuar.

Neni 13
Kushtet specifike për punonjësit e AKI-së

13.1. Përveç kërkesave të përgjithshme për punësim që zbatohen ndaj punonjësve të tjerë të qeverisë, drejtori i AKI-së mund të vë kushte speciale për punonjës të AKI-së në lidhje me ekspertizën, shëndetin, detyrat e punës, dhe kërkesat e sigurisë që janë në përputhje me interesat e sigurisë së Kosovës.
13.2. Rregullorja e Organizimit të Brendshëm, e hartuar nga drejtori i AKI-së, përcakton kërkesat për secilën pozitë në AKI, si dhe do të parashtrojë kërkesat specifike për punësim në AKI.
13.3. Në përputhje me rregullat e brendshme dhe kur është e nevojshme, AKI mund të kontraktojë palë të treta për shërbime ndihmëse.

Neni 14
Leja e sigurisë

14.1. Personat e zgjedhur për punësim në AKI duhet të plotësojnë standardet strikte të sigurisë, të cilat përcaktohen në pajtim me ligjin në fuqi dhe në harmoni me procedurat e përcaktuara në rregulloret e shpallura nga drejtori i AKI-së dhe të miratuara nga Qeveria. Kandidati duhet të vlerësohet stabil, i besueshëm dhe me karakter, vlerësim dhe diskrecion të shkëlqyeshëm. Çfarëdo dyshimi në lidhje me cilindo nga faktorët e sipërpërmendur zgjidhet në favor të sigurisë së Kosovës dhe leja e sigurisë do të refuzohet.
14.2. Kandidatët nuk punësohen nga AKI-ja nëse nuk i nënshtrohet procedurës së lejes së sigurisë ose dështojnë të plotësojnë kërkesat e parashtruara në nenin 15.
14.3. Kandidatët të cilët qëllimisht paraqesin informata të rreme eliminihohen automatikisht.
14.4. Nëse personi nuk punësohet në AKI pasi që ai apo ajo dështon të plotësojë kërkesat e sipërpërmendura ose nëse ka pengesa për këtë punësim, AKI-ja i shpjegon arsyet për të cilat personi nuk është punësuar, përveç nëse shpalosja e informacionit të tillë rezulton në kompromet imin e informacionit të klasifikuar.

Neni 15
Kualifikimet për punësim në AKI

AKI nuk mund të rekrutojë kandidatët nëse nuk i plotësojnë kushtet në vijim:

(i) të jenë shtetas të Kosovës;
(ii) të jenë mbi 18 vjeç;
(iii) të kenë kualifikime të duhura arsimore dhe profesionale ashtu siç përcaktohet me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm;
(iv) të kryejnë ekzaminimin mjekësor të kërkuar për pozitë;
(v) të jenë të liruar nga shërbimi ushtarak, nëse është e zbatueshme; dhe
(vi) të jenë të aftë të plotësojnë kërkesat e sigurisë që do të përcaktohen me anë të procedurës për lejen e sigurimit.

Neni 16
Të drejtat e punonjësve të AKI-së

16.1. Punonjësit e AKI-së kanë të drejtë për:
(i) për punësim të përhershëm deri në plotësimin e kushteve për pensionim, me përjashtim të individëve të cilët janë të punësuar në bazë të kontratës për shërbim për një periudhë fikse, si dhe atyre që shkarkohen me arsye, në bazë të legjislacionit në fuqi;
(ii) të merr pushim në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe mundësinë për të vazhduar punën e njëjtë apo të ngjashme kur të mbarojë pushimi;
(iii) për shpërblim për detyrat dhe kryerjen e detyrave siç përcaktohet me këtë ligj;
(iv) të merr rrogë dhe pagesa në pajtim me legjislacionin në fuqi;
(v) për avancim të karrierës dhe zhvillim profesional nëpërmjet trajnimit dhe mjeteve tjera;
(vi) për mbrojtje të integritetit fizik dhe moral gjatë kryerjes së detyrave të tyre zyrtare.

16.2. Kur një Punonjës i AKI-së beson se shpalosja në gjyq e informacionit, të cilin e ka mësuar për shkak të punësimit të tij në AKI mund të dëmtojë sigurinë e Kosovës, ai do t'ia referojë çështjen gjyqtarit kryesor. Gjyqtari kryesor konsultohet me inspektorin e përgjithshëm dhe ai mban autoritetin final mbi përdorimin e informacionit në gjyq dhe vendosjes nëse procedura in camera është e nevojshme për procesin.

16.3. Nëse iniciohen procedura gjyqësore kundër një Punonjësi të AKI-së për shkak të veprimeve të kryera gjatë kryerjes së detyrave të AKI-së, AKI-ja siguron avokat apo ndihmë tjetër juridike për Punonjësin, përveç nëse Punonjësi ka vepruar jashtë autorizimeve të veta apo ka keqpërdorur autorizimet e veta.

16.4. Sipas të njëjtave kushte nga neni 16.3 më lartë, AKI-ja, po ashtu, siguron ndihmë juridike për një Punonjës pas përfundimit të punësimit të tij/saj, përveç nëse Punonjësi ka të drejtë tjetër për ndihmë juridike ekuivalente.

Neni 17
Sjelljet e ndaluara të Punonjësit

17.1. Punonjësit e AKI-së nuk mund të jenë anëtarë të partive politike apo marrin udhëzime prej partive, organizatave apo lëvizjeve politike, apo individëve jashtë AKI-së, e as nuk mund të kryejnë çfarëdo aktiviteti apo detyra tjera publike apo profesionale me pagesë, të cilat nuk janë në përputhje me punën e AKI-së. Punonjësit e AKI-së kërkojnë miratimin paraprak të drejtorit të AKI-së para së t'i bashkohen cilësdo organizate apo grupi; dështimi për të raportuar këtë mund të ofrojë bazë për suspendim apo përjashtim të Punonjësit të AKI-së.

17.2. Punonjësit e AKI-së nuk mund të kenë punësim tjetër gjatë kohës sa janë të punësuar të AKI-së.

17.3. Punonjësit e AKI-së nuk kanë të drejtën për veprime që kanë për qëllim ndërprerjen e aktivitetit apo ndonjë formë tjetër të ndalesës kolektive të punës.

17.4. Punonjësit e AKI-së, pa pajtimin paraprak të drejtorit të AKI-së, nuk mund të japin deklarata publike apo përndryshe komentojnë punën e AKI-së, apo ofrojnë informacion personave të paautorizuar mbi të dhënat, dokumentet, kontaktet, qëllimet, dijen apo personelin e AKI-së.

17.5. Punonjësit e AKI-së nuk do të ndjekin apo pranojnë asnjë fitim, beneficion, avancim monetar, apo shërbim për vete apo të tjerët përveç atyre të ofruara me këtë Ligj.

17.6. Shkelja e cilësdo dispozitë të këtij neni apo këtij Ligji konsiderohet bazë për suspendim dhe/apo ndërprerje të punësimit sipas këtij Ligji.

Neni 18
Detyrimet ligjore personale të punonjësit

18.1. Secili punonjës i AKI-së do t'i kryej detyrat që i jepen në pajtim me këtë ligj dhe ligjet tjera relevante dhe është personalisht përgjegjës për zbatimin e ligjshëm të detyrave të AKI-së, ashtu siç është përcaktuar me këtë Ligj, dhe që janë në kuadër të detyrave të dhëna punonjësit të caktuar.

18.2. Nëse një punonjës beson se ai apo ajo ka pranuar një urdhër ilegal, ai apo ajo duhet të informojë urdhërdhënësin në lidhje me shqetësimin e tij apo të saj.

18.3. Në rastet kur urdhërdhënësi përsërit urdhrin, Punonjësi do të kërkojë një konfirmim me shkrim të urdhrit të tillë. Nëse Punonjësi vazhdon të ketë rezervime, ai apo ajo do t'ia përcjellë urdhrin eprorit të parë të urdhërdhënësit dhe do t'ia raportojë çështjen inspektorit të përgjithshëm.

18.4. Punonjësi duhet të refuzojë të kryejë një urdhër për të cilin ai apo ajo beson me arsye se shkel ligjin e zbatueshëm të Kosovës.

18.5. Nëse një Punonjës beson se AKI-ja apo një Punonjës i AKI-së mund të ketë shkelur apo po shkel ndonjë ligj, rregullore apo politikë relevante, ai apo ajo duhet t'ia raportojë këtë inspektorit të përgjithshëm.

18.6. Punonjësi nuk mund t'u nënshtrohet procedurave disiplinore për kryerjen e veprimeve sipas neneve 18.2, 18.3, 18.4 ose 18.5 të këtij Ligji përveç nëse Inspektori i përgjithshëm vendosë ndryshe.

Neni 19
Pagat dhe kompensimi për punonjësit e AKI-së

19.1. Krijimi i një pakoje kompensimi për Punonjësit e AKI-së njeh kushtet e veçanta nën të cilat ata kryejnë detyrat e veta. Rroga bazë e punonjësve të AKI-së ndryshon bazuar në faktorë që përfshijnë, por nuk kufizohen në, gradën dhe kohëzgjatjen e shërbimit.

19.2. Përveç rrogës bazë, Punonjësit e AKI-së mund të pranojnë ligjërisht lloje të ndryshme të shtesave të rrogës, mëditjeve dhe beneficioneve. Këto pagesa shtesë mund të bazohen në faktorë që përfshijnë, por nuk kufizohen në, detyrën me rrezik, punën pas orarit, ndryshimin për punën me ndërrime, punën gjatë festave dhe ditëve tjera që zakonisht do të ishin ditë pushimi, detyrat speciale dhe shkathtësitë speciale.

19.3. Pagesat shtesë mund të përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në, shtesën për rrezik, shtesën për ndërrim, pagesën për ditë festash, pagesën për punën pas orarit dhe pagesën për detyra speciale. Beneficionet mund të përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në, shpenzimet mjekësore dhe shëndetësore, shpenzimet për trajnim profesional dhe teknik, shpenzimet e jetesës për transfer të përkohshëm apo detyrë speciale, pushim të paguar, beneficione të vdekjes dhe beneficione të pensionit.

19.4. Rrogat bazë dhe cilado pagesa të autorizuara shtesë përcaktohen dhe paguhen në pajtim me procedurat e definuara me ligjin përkatës në fuqi dhe aktet nënligjore të Qeverisë. Nëse e miraton Kryeministri, Drejtori i AKI-së mund të përfshijë në propozimin për buxhetin vjetor për Punonjësit e AKI-së, shumat që do të përdoren për pagesën e cilësdo pagesë shtesë të autorizuar me ligj.

19.5. Mbahet evidencë e të gjitha rritjeve të rrogave sipas këtij Neni dhe ajo shqyrtohet periodikisht nga inspektori i përgjithshëm i AKI-së.

Neni 20
Dispozitat disiplinore dhe ndërprerja e punësimit

20.1. Punonjësit mund të shpallen përgjegjës për shkelje të detyrës zyrtare ashtu si parashtrohet me këtë Ligj.

20.2. Procedurat për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore brenda AKI-së udhëhiqen nga procedurat e brendshme.

20.3. Punësimi i punonjësve të AKI-së ndërpritet në këto raste:

(i) dorëheqja vullnetare nga AKI-ja;
(ii) përfundim i kontratës;
(iii) arritja e moshës së pensionimit;
(iv) paaftësia e përhershme për kryerjen e detyrave zyrtare për shkak të kushteve shëndetësore, me kusht që Punonjësi nuk ka të drejtë të transferohet në një pozitë tjetër të përshtatshme brenda AKI-së;
(v) humbja e shtetësisë së Kosovës;
(vi) marrja vullnetare e shtetësisë së një vendi tjetër pas fitimit të punësimit në AKI;
(vii) shkurtimet e vendeve të punës;

(viii) dënimi për vepër penale që bart ndëshkim me burg; dhe
(ix) përjashtimi nga shërbimi si rezultat i procedurës disiplinore.

Neni 21
Kartelat e identifikimit

Punonjësve të AKI-së ju lëshohen kartelat e identifikimit. Lloji, forma dhe përmbajtja e kartelës së identifikimit të Punonjësit të AKI-së përcaktohet me rregullore të lëshuar nga drejtori i AKI-së pas konsultimit me kryeministrin.

Neni 22
E drejta për armëmbajtje

22.1. Punonjësit e AKI-së zakonisht nuk mbajnë armë.
22.2. Punonjësit e AKI-së autorizohen të mbajnë armë vetëm nëse drejtori i AKI-së beson me arsye se është e nevojshme për mbrojtjen personale të personelit të AKI-së.
22.3. Autorizimet e armëve do të:
(i) regjistrohen në formë të shkruar;
(ii) lëshohen për një periudhë të kufizuar kohore; dhe
(iii) nënshtrohen shqyrtimit të inspektorit të përgjithshëm.
22.4. Drejtori i AKI-së harton udhëzime të qarta për mbajtjen dhe përdorimin e armëve që përfshijnë trajnimin dhe testimin e nevojshëm për t'u kualifikuar për autorizim për armëmbajtje. Të gjithë Punonjësit e autorizuar për armëmbajtje duhet së pari të jenë të kualifikuar për mbajtjen e asaj arme.

KREU V
MBLEDHJA, NDARJA DHE MBROJTJA E INFORMACIONIT

Neni 23
Mbledhja e informacionit

23.1. AKI është e autorizuar të mbledhë, mbajë dhe shpërndajë për qëllime të ligjshme qeveritare informacion sipas nenit 2 të këtij Ligji. Këto aktivitete rregullohen me procedura strikte në pajtueshmëri me parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe nevojës, dhe vetëm për avancim të sigurisë kombëtare. I gjithë informacioni i mbledhur në këtë mënyrë klasifikohet në një mënyrë që përcaktohet si e përshtatshme nga drejtori i AKI-së dhe në pajtueshmëri me legjislacionin përkatës në fuqi për mbrojtjen dhe klasifikimin e informacionit.
23.2. Procedura e përmendur më lartë lejon mbledhjen e informacionit i cili përfshinë, por nuk kufizohet në informacionin e mbledhur gjatë aktivitetit të ligjshëm të inteligjencës; informacionin që del nga hetimi i ligjshëm i personelit ose sigurimit fizik; ose informacioni që ka të bëjë me personat për të cilët ka arsye të besohet se janë burime apo kontakte potenciale me qëllimin e vetëm të përcaktimit të përshtatshmërisë ose besueshmërisë të tyre.

Neni 24
Burimet e informacionit

Në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive të veta, AKI-ja mund:

(i) të mbledhë informacion duke fshehur arsyet për mbledhjen e tij për shkak të natyrës sekrete të tij;
(ii) të krijojë kontakte të fshehta me individë privatë;
(iii) të krijojë dhe përdorë sisteme informacioni për avancimin e mbledhjes së inteligjencës;
(iv) të përdorë forma të mashtrimit operativ që nuk shkaktojnë lëndime fizike apo dëmtojnë shëndetin;
(v) të përgatisë dhe përdorë dokumente mbulesë për mbrojtjen e punonjësve të AKI-së dhe personave fizikë që bashkëpunojnë me ta, si dhe fshehjen e qëllimit të sigurisë së tyre;
(vi) të krijojë dhe mbajë organizata të përkohshme për qëllime të mbledhjes së fshehtë të të dhënave; dhe
(vii) të caktojë punonjës të AKI-së të punojnë në fshehtësi në institucione apo organe të Kosovës "në pajtim me nenin 8.4 të këtij ligji".

Neni 25
Shpërndarja e informacionit

25.1. Drejtori i AKI-së ose i emëruari i tij/saj, sipas nevojës aprovojnë shpërndarjen rezultateve të analizave të tij tek institucionet tjera qeveritare në periudha të caktuara dhe në pajtueshmëri me mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.
25.2. Nëse gjatë kryerjes së funksioneve të veta, AKI-ja bindet se ekziston bazë për dyshim se një person apo subjekt i caktuar ka kryer apo po kryen një vepër penale, apo po përgatitë apo organizon një vepër penale që i nënshtrohet ndjekjes publike, ajo është e obliguar të njoftojë drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës dhe prokurorin publik kompetent.
25.3. Nëse një rast që del nga Neni 25.2 më lartë, përfshinë dyshimin për një vepër penale kundër sigurisë së Qeverisë së Kosovës dhe rendit të saj kushtetues, drejtori i AKI-së mund t'i paraqesë një kërkesë prokurorit publik kompetent që policia të suspendojë përkohësisht ekzekutimin e akteve dhe masave në procedimet parapenale kur kjo është në interes të sigurisë kombëtare dhe kur jetët dhe shëndeti i personave të tretë me këtë nuk vihen në rrezik.

Neni 26
Përkrahja nga institucionet tjera qeveritare

Institucionet qeveritare bashkëpunojnë dhe ndihmojnë AKI, përveç nëse ligji përjashton këtë mundësi, nën mbikëqyrjen e kryeministrit.

Neni 27
Përkrahja institucioneve tjera qeveritare

AKI mund të ofrojë përkrahje në fushë të inteligjencës, duke përfshirë edhe ndihmë të ekspertëve, institucioneve tjera qeveritare sipas nevojës për sigurinë e Kosovës.

Neni 28
Urdhri gjyqësor për përgjim apo hyrje në objekte

28.1. Përgjimi në vende jopublike, apo ku palët mund të presin me arsye të kenë privatësi, përgjimi i telekomunikacioneve, dhe të gjitha format tjera të përgjimit elektronik, si dhe hyrja në pronë pa pajtimin e pronarit apo banuesit të përkohshëm, mund të bëhet vetëm në rastet kur ka pasur autorizim paraprak nga një gjyqtar i Gjykatës Supreme që do të jepet vetëm pas shqyrtimit të kërkesës më shkrim të bërë nën betim dhe të aprovuar nga drejtori i AKI-së apo zëvendësdrejtori i AKI-së.

28.2. Gjyqtari i Gjykatës Supreme është i detyruar të ruaj fshehtësinë në lidhje me informacionin e fituar sipas dispozitave të këtij Ligji.

28.3. Drejtori i AKI-së paraqet kërkesë me shkrim gjyqtarit të Gjykatës Supreme kur ai apo ajo beson me arsye se nevojitet përgjimi apo hyrja për të mundësuar AKI-në të hetojë çështje brenda brezit të veprimeve të veta.

28.4. Zbatimi dhe urdhri për përgjim të fshehtë ofrojnë:

(i) emrin dhe adresën apo përshkrimin preciz fizik të cakut apo caqeve;

(ii) llojin e komunikimit që duhet përgjuar, llojin e informacionit, shënimet, dokumentet apo gjërat që propozohen të merren; dhe mjetet që duhen ushtruar për atë qëllim;

(iii) një përshkrim të përgjithshëm të vendit apo vendeve kur përgjimi apo kërkimi propozohet të kryhet, nëse mund të jepet një përshkrim i përgjithshëm i atij vendi;

(iv) arsyetimin për pohimin se teknika që kërkohet të përdoret nevojitet që t'i mundësojë AKI-së të mbledhë inteligjencë lidhur me një kërcënim ndaj sigurisë së Kosovës;

(v) informacionin që arsyeton se përgjimi apo kërkimi kërkohet mbi baza të arsyeshme për t'i mundësuar AKI-së të hetojë një kërcënim ndaj sigurisë së Kosovës;

(vi) një deklaratë se informacioni i kërkuar nuk mund të merret në mënyrë të arsyeshme nëpërmjet një teknike më pak ndërhyrëse brenda kohës së nevojshme;

(vii) periudhën, jo më të gjatë se gjashtëdhjetë (60) ditë, për të cilën kërkohet që urdhri të jetë në fuqi; dhe

(viii) informacionin për cilëndo kërkesë të mëparshme të bërë në lidhje me personin apo vendin që i nënshtrohen përgjimit apo kërkimit, datën në të cilën një kërkesë e tillë është bërë, emrin e gjyqtarit të cilit i është paraqitur kërkesa; dhe vendimin e gjyqtarit në atë rast.

28.5. Teknikat e përgjimit do të përdoren në pajtueshmëri me standardet të parapara për të minimizuar marrjen, mbajtjen dhe shpërndarjen e informacionit jo relevant për qëllimin e deklaruar të urdhrit për përgjim.

28.6. Gjyqtari merr një vendim brenda dyzetetetë (48) orësh prej paraqitjes së kërkesës.
28.7. Urdhri për përgjim i gjyqtarit përcakton periudhën kohore gjatë së cilës aprovohet teknika, e cila nuk do të zgjasë me tepër se gjashtëdhjetë (60) ditë. Zgjatjet e një urdhri mund të jepen pas një kërkese për zgjatje të bërë në mënyrën e njëjtë si ajo e përshkruar në Nenin 28.2, duke paraqitur arsyetimin për zgjatjen e propozuar.
28.8. Përdorimi i një teknike përgjimi ndërpritet menjëherë nëse objektivat e parashtruara në urdhrin e gjyqtarit janë arritur apo nëse nuk mund të priten rezultate të mëtejme nga përdorimi i vazhduar i saj.

Neni 29
Urdhri për përgjim emergjent

Në një situatë emergjente, kur koha nuk lejon përgatitjen e një kërkese me shkrim nga ana e drejtorit të AKI-së apo zëvendësdrejtorit të AKI-së apo dhënien e një urdhri me shkrim nga ana e një gjyqtari të Gjykatës Supreme, kërkesa mund të bëhet dhe urdhri për përgjim të fshehtë mund të jepet gojarisht, për t'u konfirmuar më shkrim brenda dyzetetetë (48) orësh.

Neni 30
Qasja në të dhënat personale të mbajtura nga një palë e tretë

30.1. Sipas këtij neni, AKI-ja mund marr të dhëna personale të mbajtura nga pala e tretë.
30.2. Pas kërkesës së një pjesëtari të AKI-së, drejtori mund të autorizojë kërkesat që një palë e tretë të ofrojë informacion të atillë siç përshkruhet në shkresën ligjore, nëse ai konsideron se ka nevojë të arsyeshme për të avancuar përgjegjësitë e AKI-së të parapara në nenin 2.1.
30.3. Pala e tretë mund të pajtohet me kërkesat e shkresës ligjore por nuk është nën asnjë obligim të bëjë këtë. Kur pala e tretë nuk pajtohet apo nuk ka gatishmëri të pajtohet me tërë shkresën ligjore, ata mund të pajtohen me një përgjigje të pjesshme.
30.4. Një palë e tretë mund të kërkojë kompensim përkatës për plotësimin e kërkesave të shkresës ligjore. Zbatimi i kërkesave të shkresës ligjore nuk mund të vonohet për të fituar kompensimin përkatës.
30.5. Kërkesa e përmendur në nenin 30.2 duhet të përfshijë:
    (i) emrin dhe adresën ose përshkrimin preciz fizik të cakut apo caqeve;
    (ii) informacionin që kërkohet;
    (iii) kohën kur kërkohet informacioni;
    (iv) formatin në të cilin kërkohet informacioni;
    (v) emrin dhe adresën e palës së tretë e cila ka informacionin që kërkohet;
    (vi) informacion që arsyeton se informacioni kërkohet mbi baza të arsyeshme për t'i mundësuar AKI-së të hetojë një kërcënim ndaj sigurisë së Kosovës;
    (vii) një deklaratë se informacioni i kërkuar nuk mund të sigurohet më mënyrë të arsyeshme nëpërmjet një teknike më pak ndërhyrëse brenda kohës së nevojshme; dhe

(viii) informacion mbi cilëndo kërkesë të mëparshme të bërë në lidhje më cakun e shkresës ligjore, datën në të cilën një kërkesë e tillë është bërë, dhe vendimin në atë rast.

30.6. Shkresa ligjore në këtë nen 30.2 duhet të jetë në format të përcaktuar dhe përmbajë informacionin vijues:
(i) faktin se është një shkresë ligjore sipas Nenit 30 të këtij ligji;
(ii) faktin se pala e tretë ka të drejtë për kompensim përkatës;
(iii) si mund të kërkojë pala e tretë pagesën e kompensimit përkatës;
(iv) faktin se pajtueshmëria me shkresën ligjore është vullnetare.

30.7. Autoritetet nuk i kërkojnë palës së tretë të mbledhë informacion të cilin ata përndryshe do të mblidhnin gjatë aktiviteteve të tyre normale dhe ligjore.

30.8. Pala e tretë nuk do të shpalosë ekzistencën e autorizimit me shkrim, ose cilindo informacion që mund të zbulojë ekzistencën e autorizimit me shkrim asnjë personi të paautorizuar, përveç personave nga të cilët kërkohet përmbushja e kërkesave të autorizimit me shkrim.

Neni 31
Trajtimi i të dhënave të mbledhura dhe ruajtura

31.1. Të dhënat personale të mbledhura nga AKI-ja duhet të ruhen për qëllime të specifikuara dhe legjitime dhe nuk përdoren në cilëndo mënyrë që nuk është në pajtim me ato qëllime, dhe duhet te mbahen nga AKI-ja vetëm gjatë kohës sa është e nevojshme për kryerjen e detyrave të saj. Në momentin kur është e panevojshme që të dhënat personale të mbahen nga AKI-ja, ato duhet të asgjësohen nga AKI-ja sipas mënyrës së përcaktuar me rregulla të brendshme.

31.2. Merren masat përkatëse të sigurisë për mbrojtjen e këtij informacioni të ruajtur në skeda të automatizuara të të dhënave nga shkatërrimit aksidental apo i joautorizuar, nga humbja aksidentale, si dhe nga qasja, ndryshimi dhe shpërndarja aksidentale.

KREU VI
FSHEHTËSIA

Neni 32
Raportimi i përjashtimit

Në avancim të autorizimeve dhe përgjegjësisë së drejtorit të AKI-së për mbrojtjen e burimeve dhe metodave të inteligjencës dhe informacionin tjetër të klasifikuar, AKI do të jetë e përjashtuar nga dispozitat e cilado ligjeve që kërkojnë shpalosjen e organizimit, funksioneve, emrave, titujve zyrtarë.

Neni 33
Obligimi i Punonjësve për Ruajtjen e Fshehtësisë

Punonjësit e AKI-së duhet të mbrojnë informacionin e klasifikuar dhe, si kusht punësimi, nënshkruajnë një marrëveshje ruajtjen e fshehtësisë. Obligimi për të mbrojtur këto fshehtësi nuk pushon kur Punonjësi nuk është më i punësuar në AKI.

Neni 34
Ndjekja penale për zbulimin e paautorizuar të informatave të klasifikuara

Zbulimi i informatave të klasifikuara të AKI-së cilitdo individ të pa autorizuar për ta pranuar ato, paraqet shkelje të Kodit Penal të Kosovës, dhe kryesi do t'i nënshtrohet dënimit siç parashihet në dispozitën përkatëse të kodit.

KREU VII
MBIKËQYRJA PARLAMENTARE

Neni 35
Mbikëqyrja parlamentare

Mbikëqyrja e KIA-s kryhet nga komisioni mbikëqyrës parlamentar, mandati i të cilit përshkruhet me këtë ligj. Përbërja e tij përcaktohet me Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës.

Neni 36
Veprimi dhe përgjegjësitë e organit mbikëqyrës parlamentar

36.1. Komisioni mbikëqyrës parlamentar mban mbledhjet e veta të paktën dy herë në vit.
36.2. Kryetari i komisionit mbikëqyrës parlamentar nuk duhet të jetë anëtar i partisë politike apo koalicionit qeverisës që është në pushtet.
36.3. Kryetari i komisionit mbikëqyrës parlamentar thirr mbledhjet me iniciativën e vet.
36.4. Kryetari i komisionit mbikëqyrës parlamentar është i obliguar të thirr mbledhjet e organit mbikëqyrës parlamentar pas marrjes së kërkesës me shkrim të një të tretës të anëtarëve të organit mbikëqyrës parlamentar sipas rregullores së punës në fuqi të Kuvendit të Kosovës.
36.5. Ndërveprimi ndërmjet AKI-së dhe komisionit mbikëqyrës parlamentar do të jetë i mbyllur për publik përveç nëse specifikohet ndryshe nga kryesuesi i komisioni mbikëqyrës parlamentar, sipas diskrecionit të tij apo saj, apo pas rekomandimit dhe votimit të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të komisionit mbikëqyrës parlamentar.
36.6. Komisioni mbikëqyrës parlamentar është përgjegjës të:
   (i) mbikëqyrë ligjshmërinë e punës së AKI-së;
   (ii) shqyrtojë raportet e kryeministrit në lidhje me çështjet brenda kompetencave, të cilat përfshijnë veprime të ndërmarra për të korrigjuar çfarëdo problemesh në AKI të bëra të ditura nëpërmjet inspektimit, auditimit apo hetimit;
   (iii) shqyrtojë raportet e drejtorit të AKI-së në lidhje me operacionet dhe shpenzimet e AKI-së;
   (iv) shqyrtojë raportet e inspektorit të përgjithshëm;
   (v) ofrojë një mendim për propozimin e detajizuar të buxhetit për AKI-në; dhe
   (vi) kryejë hetime në lidhje me punën e AKI-së.

Neni 37
Hetimet parlamentare

37.1. Nëse komisioni mbikëqyrës parlamentar ka bazë të besojë se AKI-ja po kryen detyrat e veta në mënyrë të paligjshme, të papërshtatshme apo joprofesionale, ai mund të kryejë një hetim gjatë të cilit komisioni mbikëqyrës parlamentar mund të marrë në pyetje Punonjësit e AKI-së dhe të ketë qasje në dokumentet relevante të AKI-së.

37.2. Hetimet parlamentare janë të mbyllura për opinionin përveç nëse caktohet ndryshe nga kryesuesi i organit mbikëqyrës parlamentar, në bazë të diskrecionit të tij apo saj, ose pas rekomandimit dhe votimit të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të komisioni mbikëqyrës parlamentar.

37.3. Nëse komisioni mbikëqyrës parlamentar konstaton se operacioni i AKI-së është i paligjshëm, ai mund të ftojë kryeministrin të ndërmarrë masat e nevojshme dhe të iniciojë shqyrtimin e përgjegjësisë.

37.4. Kryeministri është i obliguar të informojë komisionin mbikëqyrës parlamentar për rezultatet e çdo shqyrtimi të kryer sipas dispozitave të këtij Neni.

37.5. Gjatë kryerjes së funksionit të vet, komisioni mbikëqyrës parlamentar mund të kërkojë informacion nga kryeministri, drejtori i AKI-së, ose cilido Punonjës i AKI-së. Në avancim të këtij funksioni, komisioni mbikëqyrës parlamentar mund të urdhërojë drejtorin e AKI-së të paraqitet para tij në mënyrë që drejtori i AKI-së të japë raport gojor në lidhje me aktivitetet e AKI-së.

37.6. Gjatë mbikëqyrjes parlamentare të ushtruar nga komisioni mbikëqyrës parlamentar, do të vihet në dispozicion informacion i klasifikuar përveç nëse shpalosja e tij do të kërcënonte interesat vitale të sigurisë kombëtare të lidhura me mbrojtjen e burimeve dhe metodave në një rast specifik.

37.7. Nëse Kryeministri apo drejtori i AKI-së vendosin të mos i ofrojnë informacion komisionit mbikëqyrës parlamentar në bazë të Nenit 36.5 më lartë, ai do të informojë menjëherë me shkrim komisionin mbikëqyrës parlamentar me shpjegimin për mosofrimin e atij informacioni.

Neni 38
Obligimi i ruajtjes së fshehtësisë nga komisioni mbikëqyrës parlamentar

38.1. Anëtarët e komisionit mbikëqyrës parlamentar janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë në me lidhje me informacionin që ka të bëjë me sekretet zyrtare në të cilat kanë pasur qasje në cilësinë e tyre, dhe e cila do të mbetet në fuqi pas përfundimit të anëtarësisë së tyre në komisionin mbikëqyrës parlamentar. Cilado shkelje e obligimit për ruajtjen e fshehtësisë është e dënueshme siç përcaktohet në nenin 34 të këtij ligji.

38.2. Komisioni mbikëqyrës parlamentar krijojnë procedura me shkrim për të mbrojtur zbulimin e jo autorizuar të të gjithë informacionit të klasifikuar që i ofrohet organit mbikëqyrës parlamentar.

KREU VIII
MEKANIZMAT E ANKESËS

Neni 39

39.1. Individët, institucionet dhe palët e treta kanë të drejtën e ankesës ndaj AKI-së.
39.2. Ankesat mund t'i drejtohen Institucionit të Ombudspersonit të Kosovës (IOK).
39.3. Cilado ankesë paraqitur IOK-së nuk cenon të drejtën e një individi, institucioni apo pale të tretë të kërkojë shqyrtim nga një gjykatë.

KREU IX
FINANCIMI

Neni 40
Përgatitja dhe ofrimi i buxhetit

40.1. Drejtori i AKI-së harton dhe paraqet kryeministrit, për aprovim dhe dorëzim tek komisioni mbikëqyrës parlamentar, projekt buxhetin vjetor për AKI-në, detajet e të cilit konsiderohen informacion i klasifikuar.
40.2. Kuvendi i Kosovës i vë në dispozicion AKI-së buxhetin vjetor të mjaftueshëm për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë për të mbrojtur sigurinë e Kosovës.

Neni 41
Përgjegjësia e shpenzimeve

41.1. Drejtori i AKI-se është përgjegjës për shpenzimin e ligjshëm të fondeve të dhëna AKI-së.
41.2. Shumat të cilat i vihen në dispozicion AKI-së shpenzohen nga drejtori i AKI-së apo ata të cilëve drejtori i AKI-së ia ka deleguar këtë përgjegjësi në pajtueshmëri me ligjet e Kosovës, për cilindo qëllim të nevojshëm për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë e AKI-së.

Neni 42
Shpenzimet emergjente

42.1. Në rrethana të jashtëzakonshme relevante për punën e AKI-së, drejtori i AKI-së mund të shpenzojë fonde pavarësisht dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me shpenzimet e fondeve qeveritare, përveç nëse përndryshe ndalohet në mënyrë të veçantë me ligj.
42.2. Nëse drejtori i AKI-së ushtron autorizimin të bëjë shpenzime emergjente ashtu siç është paraparë më lart, ai apo ajo i raporton menjëherë gojarisht kryeministrit për shpenzimin dhe e arsyeton me shkrim brenda dyzetetetë (48) orësh pas shpenzimit.

KREU X
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 43
Ndarja kalimtare e resurseve

43.1. Përkundër dispozitave të nenit 1.6 dhe Kapitullit VII të këtij Ligji, Qeveria krijon dispozitë speciale për të ofruar objekte dhe resurse financiare përkatëse AKI-së pas formimit të saj deri në kohën kur financimi i AKI-së mund të kryhet sipas procedurave normale.

43.2. Qeveria vë në dispozicion fonde të tilla të nevojshme për emërimin dhe veprimin fillestar të drejtorit të AKI-së dhe zëvendësdrejtorit të AKI-së deri sa fondet e tilla të ndahen në mënyrë specifike nga ana e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.

Neni 44
Veprimi kalimtar

44.1. Me miratim paraprak të kryeministrit, drejtori i AKI-së mund të zbatojë ligje dhe rregullore të zbatueshme ndaj institucionet qeveritare të Kosovës në atë masë që zbatimi i ligjit nuk është në mospërputhje me dispozitat e këtij Ligji. Një zbatim i tillë nuk do të bëhet për një periudhë me të gjatë se gjashtë (6) muaj pas themelimit të AKI-së.

44.2. Në pritje të miratimit dhe zbatimit të legjislacionit relevant për mbrojtjen e informative të klasifikuara, drejtori i AKI-së lëshon rregullore që përkohësisht krijon një sistem për klasifikimin e informacionit, masat për mbrojtjen e këtij informacioni, dhe përgjegjësitë e punonjësve për mbrojtjen e këtij informacioni të sigurisë.

44.3. Krijimi i vendeve të lira të punës që dalin nga ky ligj bëhet nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas nenit 45.

44.4. Në pritje të miratimit të procedurës për lejen e sigurisë, Punonjësit e AKI-së mund të marrin leje të përkohshme sigurie, valide deri në gjashtë (6) muaj, nën kushtin që këta punonjëse të dorëzojnë pyetësorin për lejen e sigurisë, përmbajtja e të cilit nuk zbulon bazat e qarta të refuzimit të lejes së sigurisë. Leja e përkohshme e sigurisë mund të ripërtërihet vetëm njëherë, për një periudhë që nuk mund jetë më shumë se gjashtë muaj.

44.5. Neni 44.4 i këtij Ligji zbatohet vetëm ndaj individëve të cilët i bashkohen AKI-së para zbatimit të procedurës për lejen e sigurisë.

Neni 45
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-063
21 Maj 2008

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III / Nr. 30 / 15 QERSHOR 2008

LIGJI Nr. 03/L-089
LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR KUFIJTË ADMINISTRATIV KOMUNAL, LIGJIT PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT, LIGJIT PËR ARSIMIN NË KOMUNAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, LIGJIT PËR FESTAT ZYRTARE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, LIGJIT PËR AGJENCINË E KOSOVËS PËR INTELIGJENCË, LIGJIT PËR AZIL DHE LIGJIT PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR DHE KONTROLLIN E KUFIRIT SHTETËROR

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton këtë

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR KUFIJTË ADMINISTRATIV KOMUNAL, LIGJIT PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT, LIGJIT PËR ARSIMIN NË KOMUNAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, LIGJIT PËR FESTAT ZYRTARE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, LIGJIT PËR AGJENCINË E KOSOVËS PËR INTELIGJENCË, LIGJIT PËR AZIL DHE LIGJIT PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR DHE KONTROLLIN E KUFIRIT SHTETËROR

Neni 1
Qëllimi

Nenet në vijim,

a) Neni 19 i Ligjit për kufijtë administrativ komunal, nr. 03/L-041,
b) Neni 32 i Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit 03/L-067,
c) Neni 17 i Ligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës 03/L-068,
d) Neni 9 i Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës 03/L-064,
e) Neni 45 i Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë 03/L-063,
f) Neni 73.1 i Ligjit për Azil 03/L-066, dhe
g) Neni 38 i Ligjit për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror ndryshohen si në poshtë:

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-089
13 qershor 2008

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III / Nr. 31 / 15 QERSHOR 2008

LIGJI Nr. 03/L-132
PËR PROTOKOLLIN E SHTETIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Përmbajtja

Kreu I 203
Kreu II 204
Kreu III 207
Kreu IV: Ceremoniali zyrtar i autoriteteve më të larta të shtetit 208
Kreu V 214
Kreu VII: Ceremonitë kryesore zyrtare 220

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Me qëllim të vendosjes së rregullave ligjore për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR PROTOKOLLIN E SHTETIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 1

1. Me këtë ligj në Ministrinë e Punëve të Jashtme themelohet Zyra e Protokollit të Shtetit, e cila ka për detyrë:
   1.1. organizimin dhe realizimin e të gjitha angazhimeve protokollare të Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, për të gjithë veprimtarinë e tyre brenda dhe jashtë vendit.
   1.2. bashkërendimin e veprimtarisë protokollare të Qeverisë dhe titullarëve të institucioneve të larta qendrore;
   1.3. bashkërendimin dhe zbatimin e programit të vizitave të delegacioneve të huaja të nivelit të lartë.
2. Veprimtaria e Zyrës së Protokollit të Shtetit rregullohet me akte të veçanta ligjore ose nënligjore.”

KREU I

Neni 2
PROTOKOLLI I SHTETIT

1. Protokolli i Shtetit përfaqëson përmbledhjen institucionale të kritereve që rregullojnë çdo aspekt të natyrës formale dhe joformale të marrëdhënieve zyrtare. Për zbatimin e këtyre kritereve është kompetent Protokolli i Shtetit. Protokolli i Shtetit është zyra kompetente që përcakton dhe trajton në Republikën e Kosovës protokollin dhe ceremonialin zyrtar.
2. Protokolli i Shtetit kryen detyrën e zbatimit të ceremonialit zyrtar dhe veprimtarisë protokollare të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme për veprimtaritë e tyre brenda dhe jashtë vendit.

Neni 3
Kompetencat e Protokollit të Shtetit

1. Protokolli i Shtetit kryen këto funksione:
   1.1. zbaton me saktësi radhën e përparësisë të rangjeve zyrtare të Republikës së Kosovës, Misioneve Diplomatike si dhe e përcakton atë në rastet e veçanta të paparashikuara në këtë ligj. Kriteri themelor i funksionimit të kësaj strukture është respektimi i rangut zyrtar.
   1.2. organizon dhe ndjek ceremonitë e pritjes e të përcjelljes së delegacioneve të huaja të rangut: President, Kryetar i Kuvendit, Kryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme; harton në bashkëpunim me kabinetet e Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme programin e vizitës së tyre dhe përgjigjet për zbatimin e tij.
   1.3. përgatit anën protokollare për vizitat zyrtare jashtë shtetit të Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe të Ministrit të Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës. Protokolli i Shtetit, në bashkëpunim me përfaqësitë Diplomatike të Republikës së Kosovës dhe me institucionin homolog të shtetit pritës, përpunon programin e vizitës së personaliteteve të mësipërme.
   1.4. përgjigjet për organizimin e ceremonive për festat zyrtare, memorialë, shtetërorë dhe lokale, në rastet kur ato janë jubilare dhe kur për organizimin e të cilave formohet me vendim të Qeverisë të Republikës së Kosovës një komision shtetëror.
   1.5. përcakton mënyrën e përdorimit të simboleve shtetërore, flamurit, himnit, stemës dhe shenjave të tjera zyrtare sipas Ligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Republikës së Kosovës.
   1.6. bashkërendon takimet e Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Ministrit të Punëve të Jashtme dhe të Ministrave tjerë me përfaqësuesit diplomatikë të akredituar në Republikën e Kosovës.
2. Institucionet qendrore apo lokale, si dhe përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës janë të detyruara t'i ofrojnë Protokollit të Shtetit informacionin e kërkuar kur ai lidhet drejtpërdrejt ose jo me aktivitetin e tij, me normativat e Protokollit të Shtetit, të konventave të Vjenës "Për marrëdhëniet diplomatike" dhe "Për marrëdhëniet konsullore", si dhe për zbatimin e reciprocitetit.

Neni 4
Zyra të tjera protokolli

1. Institucionet qendrore dhe lokale të Republikës së Kosovës kanë veçoritë dhe specifikat e tyre në zbatimin e protokollit zyrtar. Pranë tyre funksionojnë zyrat përkatëse të protokollit që trajtojnë drejtpërsëdrejti praktikat protokollare dhe ceremoniale të titullarëve të tyre.
2. Zyra e protokollit të shtetit mbanë lidhje të ngushta me zyrat e protokolleve të institucioneve qendrore e lokale, komunikon praktikat protokollare, shkëmben informacione, organizon takime konsultative dhe shërben si strukturë qendrore e unifikimit të praktikave protokollare në Republikën e Kosovës.
3. Zyrat përkatëse pranë institucioneve të shtetit, përgjigjen për aktivitetin zyrtar të titullarëve përkatës, jetën e përditshme me karakter formal ose jo të tyre, lëvizjet brenda territorit të Kosovës, inaugurime, pritje dhe vizita, takime dhe evenimente të ndryshme publike.
4. Protokolli i Kuvendit përgjigjet për zbatimin e ceremonialit të brendshëm të këtij institucioni, aktivitetit parlamentar dhe rregullimin e aspekteve të ndryshme të marrëdhënieve me trupin diplomatik, marrëdhënieve publike të institucionit dhe takimet e parlamentarëve me delegacionet e huaja.
5. Protokolli i Ministrisë së Forcës së Sigurisë ka kompetencën e organizimit të ceremonive respektive ushtarake në kuadër të këtij institucioni dhe reparteve ushtarake, në përputhje me normat themelore të Protokollit të Republikës së Kosovës dhe rregulloret ushtarake në fuqi.

KREU II

Neni 5
CEREMONIALI DIPLOMATIK

1. Ceremoniali diplomatik përcakton:
   1.1. raportet protokollare midis Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera;
   1.2. rregullat, praktikat administrative dhe përparësitë që gëzojnë përfaqësitë diplomatike në Kosovë në përputhje me Ligjin për statusin, imunitetin dhe privilegjet e misioneve diplomatike dhe në përputhje me konventat e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike dhe marrëdhëniet konsullore;
   1.3. marrëveshjet dy dhe shumëpalëshe mbi bazën e reciprocitetit.
2. Ceremoniali diplomatik përmbledh formalitetet që respektohen për ardhjen dhe largimin nga Republika e Kosovës të funksionarëve diplomatikë, veçoritë e statusit të tyre, imunitetet, privilegjet e trupit diplomatik, modalitetet e sigurimit të tyre. Është detyrë ekskluzive e Protokollit të Shtetit të drejtojë dhe t'i respektojë këto procedura.

Neni 6
Paraqitja e kredencialeve Presidentit të Republikës

1. Protokolli i Shtetit njofton ambasadën përkatëse për datën, orën dhe vendin e paraqitjes së kredencialeve Presidentit të Republikës nga ana e ambasadorit të ri.

2. Ai e shoqëron ambasadorin në një dhomë pritjeje të veçantë, ku ambasadori nënshkruan Librin e Miqve dhe qëndrojnë për disa çaste për një bisedë të shkurtër. Më pas Drejtori i Protokollit e drejton atë në sallën kryesore të ceremonisë.

Neni 7
Lidhjet me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe institucionet qendrore

1. Përfaqësitë diplomatike mbajnë lidhje me administratën shtetërore të Republikës së Kosovës nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme. Për takimet që dëshirojnë të mbajnë me administratën shtetërore dhe që kanë të bëjnë me marrëdhëniet dypalëshe ose çështje me interes të përbashkët, duhet që paraprakisht të vënë në dijeni Protokollin e Shtetit dhe drejtorinë përkatëse në Ministrinë e Punëve të Jashtme.
2. Diplomatët, specialistët dhe ekspertët e huaj mund të komunikojnë drejtpërdrejt me homologët e tyre Kosovar në administratën shtetërore, kur bëhet fjalë për marrëdhënie shoqërore, kortezie ose probleme të veçanta midis ekspertësh.
3. Përfaqësitë diplomatike të akredituara në Republikën e Kosovës, për pritjet zyrtare me rastin e festës zyrtare dhe memoriale si dhe për çdo veprimtari tjetër festive, politike, shkencore e sociale që organizojnë, ftesat drejtuar Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Ministrit të Punëve të Jashtme duhet t'i dorëzojnë pranë Protokollit të Shtetit. Është ky institucion që përgjigjet për shpërndarjen e tyre në destinacion. Protokolli i Shtetit sugjeron nivelin e përfaqësimit. Ministrat si rregull nuk marrin pjesë në pritje pa njoftimin e Protokollit të Shtetit.

Neni 8
Hapja e një përfaqësie të re diplomatike

Zyrtari i huaj që vjen në Kosovë për të hapur një përfaqësi diplomatike mund të jetë diplomat i saj ose një diplomat tjetër i ngarkuar me ketë detyrë. Me të mbërritur, ai merr takim në Ministrinë e Punëve të Jashtme me drejtorinë përkatëse dhe Protokollin e Shtetit, të cilët i informon për qëllimin e misionit të tij.

Neni 9
Ndihma për diplomatët

1. Protokolli i Shtetit ndihmon Misionin Diplomatik për çështje të ndryshme. Brenda kuadrit të lejuar, ai ndihmon diplomatët dhe familjet e tyre nga dita e ardhjes deri në ditën e largimit të tyre.
2. Zyra përkatëse e protokollit i informon diplomatët për vendet më të përshtatshme për banim, për treg, mësimin e gjuhës, udhëtimet, aktivitetet artistike, shërbimin shëndetësor, shkollat për arsimimin e fëmijëve dhe rekomandime të tjera sipas kërkesës së tyre.
3. Protokolli i Shtetit shërben si mbështetje për çështje që përfaqësitë e huaja kanë me institucionet e tjera të Republikës së Kosovës, publike ose private dhe me individë të veçantë.

Neni 10
Pjesëmarrja në ceremonitë zyrtare dhe memoriale

1. Shefi i përfaqësisë njoftohet që në fillim të ardhjes së tij me një notë verbale, ku pasqyrohen festat zyrtare dhe memoriale të Republikës së Kosovës dhe orari i punës së zyrave të administratës publike.
2. Misioni Diplomatik ftohet të marrë pjesë në këto ceremoni kryesore zyrtare dhe memoriale që janë të përcaktuar në ligjin për festat zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 11
Përfundimi i detyrës dhe largimi i shefit të misionit

1. Kur shefi i një përfaqësie largohet përfundimisht nga Republika e Kosovës, ai/ajo njofton paraprakisht me notë verbale Ministrinë e Punëve të Jashtme për largimin e tij/saj, si dhe për emrin e diplomatit që do ta zëvendësojë në drejtimin e misionit si i ngarkuar me punë.
2. Protokolli i Shtetit i jep atij/asaj ndihmën e duhur për të realizuar takimet e lamtumirës me Presidentin e Republikës, Kryeministrin, Ministrin e Punëve të Jashtme dhe personalitete të tjera që ai shpreh dëshirën për t'i takuar.

Neni 12
Vdekja e një diplomati

1. Sapo Ministria e Punëve të Jashtme vihet në dijeni nga përfaqësia diplomatike për vdekjen e shefit të përfaqësisë ose të ndonjë diplomati tjetër ofron ndihmën dhe bashkëpunimin e saj në formë asistence dhe orientimi.
2. Drejtoria përkatëse përgatit një letër ngushëllimi që Ministri i Punëve të Jashtme do t'i dërgojë familjes së diplomatit të ndjerë dhe telegramin e ngushëllimit që do t'i dërgohet Ministrit të Punëve të Jashtme të shtetit të të ndjerit.
3. Në rastin e vdekjes së një diplomati të Republikës së Kosovës në detyrë, arkivoli i tij/saj pritet në aeroport nga Protokolli i Shtetit dhe përfaqësues të tjerë të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Funerali niset nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe shpenzimet e tij mbulohen nga institucioni.

Neni 13
Flamuri shtetërorë në përfaqësitë diplomatike

1. Përfaqësitë e huaja diplomatike të akredituara në Kosovë mund të mbajnë të shpalosur në ndërtesën ose territorin e selisë flamurin e tyre shtetërorë.
2. Ato duhet të ngrenë flamurin shtetërorë të Republikës së Kosovës krahas flamurit të tyre vetëm në rastin kur atje shkon për vizitë Presidenti i Republikës së Kosovës. Flamuri mbetet i ngritur deri në largimin e kreut të shtetit.

KREU III

Neni 14
SIMBOLET E REPUBLIKËS

Simbolet kryesore përfaqësuese të Republikës së Kosovës janë flamuri, himni dhe stema e Republikës së Kosovës. Përdorimi i simboleve në Kosovë rregullohet me anë të Ligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Republikës së Kosovës.

Neni 15
Flamuri shtetërorë

1. Shpalosja e flamurit shtetërorë është një e drejtë e përgjithshme në Republikën e Kosovës. Dimensionet e tij janë orientative dhe shprehen të fiksuara në raportin 1:1,4. Kur flamuri shpaloset në lartësi mbi 10m nga toka, rekomandohen përmasa jo më tepër se 350cm x 490cm. Për rastet kur shpaloset në ballkon ose deri në 10m lartësi, sugjerohet përmasa 200cm x 280cm. Në mjedise të brendshme (salla, zyra) rekomandohen përmasa 1.07 x 1.50 ose 150cm x 210cm në një shtizë 2.5 m të gjatë, në varësi nga hapësira e mjedisit. Flamuri i tavolinës duhet të ketë përmasat 16 x 23cm.
2. Në mjediset e jashtme flamuri shtetëror i Republikës së Kosovës qëndron i ngritur mbi ose pranë selive të institucioneve qendrore dhe lokale qeveritare, në pikat kufitare si dhe përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës, njëzetekatër (24) orë dhe i ndriçuar drejtpërdrejtë gjatë natës. Në rastet e festave zyrtare dhe memoriale flamuri ngritët edhe në vende të tjera me autorizimin e Kryeministrit, për evenimente shtetërorë ose të kryetarit të Komunës, për evenimente lokale.

Neni 16
Ceremonia e ngritjes ose uljes së flamurit

1. Gjatë ceremonisë së uljes ose ngritjes së flamurit, apo parakalimit të tij, të pranishmit marrin drejtqëndrim duke ndjekur me shikim lëvizjen e flamurit.
2. Ushtarakët nderojnë ushtarakisht të drejtuar nga flamuri. Kur flamuri nuk duket, drejtqëndrimi mbahet nga banda. Të huajt prezent marrin drejtqëndrim. Kjo ceremoni nuk zbatohet vetëm në rastet kur transmetohet në televizion ose në radio.

Neni 17
Himni shtetërorë

Himni shtetërorë intonohet kurdoherë në prezencën e flamurit shtetërorë. Intonimi i himnit në ceremonitë zyrtare dhe memoriale përcaktohet me Ligjin për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës.

Neni 18
Stema e Republikës

1. Përdorimi i stemës së Republikës është e drejtë ekskluzive e organeve shtetërore. Dimensionet e stemës së Republikës janë orientative dhe shprehen në raportin 1:1,5.
2. Zyrtarisht njihen edhe stemat e niveleve të ndryshme të pushtetit lokal, të enteve publike, shenjat dalluese të armëve të ndryshme të ushtrisë, të policisë dhe të universiteteve të miratuara nga Protokolli i Shtetit.
3. Përdorimi dhe vendosja e stemës së Republikës së Kosovës përcaktohet me Ligjin për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës.

KREU IV
CEREMONIALI ZYRTAR I AUTORITETEVE MË TË LARTA TË SHTETIT

Neni 19
Rregulla të përgjithshme

1. Rangjet e Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, për shkak të funksioneve që kanë, rolit që luajnë dhe detyrave që zgjidhin, dallohen në radhën e përparësisë dhe të privilegjeve ceremoniale.
2. Ceremonitë ku marrin pjesë këto autoritete organizohen sipas specifikave të aktivitetit nga Protokolli i Shtetit, zyrat e protokollit të brendshëm të tyre, institucione të ndryshme, ministri, organe komunale.
3. Përgatitja e aktivitetit bëhet paraprakisht. Organizatorët kanë për detyrë të njoftojnë Protokollin e Shtetit kur në ceremoni marrin pjesë edhe personalitete të huaja, të paktën 1-2 javë para datës së caktuar. Ata janë të detyruar të informojnë për qëllimin, programin e plotë të aktivitetit, mënyrën e organizimit, masat e marra, listën e të ftuarve, kohën dhe vendin e caktuar.
4. Protokolli i Shtetit vihet ne dijeni paraprakisht për çdo lëvizje të personaliteteve kryesore, Presidentit, Kryetarit të Kuvendit dhe Kryeministrit jashtë shtetit. Vizitat bashkërendohen në mënyrë që të mos jenë të tre njëkohësisht jashtë vendit.
5. Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri kryejnë vizita të nivelit të lartë jashtë shtetit. Protokolli i Shtetit merret me procedurat zyrtare të organizimit të vizitave, nga përgatitja deri në përfundimin e tyre. Në funksion të këtij programi bashkëpunohet me kabinetet përkatëse.
6. Ceremonia e pritjes së homologut të huaj bëhet në aeroport ose në selinë e personalitetit të lartë. Kjo përcaktohet paraprakisht në bisedimet e Protokollit të Shtetit me protokollin e palës së huaj. Ceremonia kryhet sipas skemave të miratuara të Protokollit të Shtetit.

Neni 20
Presidenti/ja i/e Republikës

1. Presidenti/ja i/e Republikës përfaqëson autoritetin më të lartë të shtetit në Kosovë, që është shprehje e unitetit të popullit. Ushtrimi i mandatit të tij shoqërohet gjatë gjithë periudhës nga një ceremonial i veçantë për të gjitha aspektet zyrtare dhe jozyrtare të jetës dhe aktivitetit të tij.
2. Në pritje të ndryshme dhe festa shtetërorë të dhëna nga përfaqësitë diplomatike të akredituara në Kosovë, Presidenti i Republikës merr pjesë vetëm në rastet kur e konsideron tepër të arsyeshme dhe të rëndësishme prezencën e tij. Pjesëmarrja e Presidentit sinjalizohet nga Protokolli i Shtetit.
3. Obligohen të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës që në mjediset e tyre ta vendosin fotografinë e Presidentit. Përmasat minimale duhet të jenë 40 – 60 cm.

Neni 21
Ceremonia e fillimit të detyrës së Presidentit të Republikës

1. Ceremonia e fillimit të detyrës së Presidentit të Republikës zhvillohet si një e tërë, e ndarë në dy momente kryesore, në sallën e Kuvendit dhe në Rezidencën e Presidentit.
2. Ditën e caktuar në seancën e Kuvendit të Kosovës, përveç deputetëve, mund të marrin pjesë edhe të ftuar të tjerë të huaj dhe titullarët e përfaqësive diplomatike. Protokolli i Kuvendit drejton ceremoninë në sallën e Kuvendit.
3. Intonohet himni shtetërorë i Kosovës. Kryetari i Kuvendit fton Presidentin për të marrë fjalën përshëndetëse para Kuvendit.
4. Mbas Kuvendit të Kosovës, ceremonia presidenciale vijon në Rezidencën e Presidentit.

Neni 22
Zonja e Parë

1. Bashkëshortja e Presidentit të Republikës gëzon statusin Zonja e Parë e vendit.
2. Në ceremonitë ku merr pjesë vetëm me Presidentin, Zonja e Parë qëndron në të djathtë të tij. Në ceremonitë e nderit ku intonohen himnet shtetërorë qëndron së bashku me zonjën e parë mike, tre hapa pas të dy presidentëve. Në mjedise pritjesh formale, në rastet kur ka një të ftuar nderi, Presidenti ecën i pari, së bashku me bashkëshorten e të ftuarit të nderit, ndërsa Zonja e Parë shoqëron të ftuarin e nderit dhe hyn e dyta pas Presidentit
3. Pjesëtarët madhorë të familjes së Presidentit që jetojnë me të gëzojnë një status protokollar të barabartë me këshilltar presidenti, kurse ata që nuk bashkëjetojnë me të, të barabartë me këshilltar ministri. Ky status është i vlefshëm vetëm kur marrin pjesë të ftuar në aktivitete formale, së bashku me Presidentin. Në raste të tjera, si dhe të afërmit e mitur, nuk gëzojnë status protokollar.
4. Nëse Presidenti është i pamartuar, asnjë nga familjarët e tij nuk mund të përfaqësojë apo të luajë rolin e zonjës së parë. Në veprimtarinë zyrtare, Presidenti i Republikës paraqitet i pashoqëruar. Në ceremonitë festive kur udhëton jashtë

kryeqytetit ose jashtë shtetit, Presidenti i Republikës mund të shoqërohet nga një person tjetër i familjes sipas dëshirës, por jo në rangun e zonjës së parë. Shoqëruesi i Presidentit gëzon në të gjitha rastet të drejtën e një protokolli të veçantë.

Neni 23
Presidenca

1. Presidenca është selia e aktivitetit zyrtar të Presidentit të Republikës së Kosovës. Në hyrjen të Presidencës qëndrojnë në pozicion nderi dy truprojë nderi me uniformë ceremoniale.
2. Kur kalon Presidenti, të pranishmit qofshin të ftuar ose bashkëpunëtorë ngrihen në këmbë dhe i përgjigjen përshëndetjes së tij. Edhe ata që kanë njohje personale me Presidentin nuk duhet ta ndalojnë ose ta përshëndesin të parët. Presidentit gjithsecili i drejtohet "Z. President". Bashkëshortes së Presidentit i drejtohet Znj. (vijon mbiemri).
3. Presidenti i Republikës ka të drejtë të mbajë flamur dallues si shenjë e veçantë që identifikon shkallën e hierarkisë dhe autoritetin e këtij rangu për të drejtuar e komanduar. Në zyrën e Presidentit, pas ulëses së tij qëndrojnë dy flamurë, në të djathtë flamuri shtetërorë dhe në të majtë flamuri dallues i Presidentit.
4. Protokolli i brendshëm i Presidencës drejtohet nga shefi i protokollit të Presidentit. Ai është përgjegjës për takimet e përditshme që bëhen në zyrën e Presidentit, lëvizjet dhe aktivitetet brenda territorit të Kosovës, në përputhje me Protokollin e Shtetit.
5. Nëse është i domosdoshëm shoqërimi i Presidentit të Republikës nga Ministrat, kjo kryhet vetëm pas kërkesës që Presidenca i paraqet Kabinetit të Kryeministrit.
6. Për pritjen dhe përcjelljen e Presidentit të Republikës shtrohet tapeti i kuq në hyrje të sallës së personave të rëndësisë së veçantë të aeroporti dhe në hyrje të aeroplanit. Protokolli i Presidencës kryen të gjitha formalitetet dokumentare të nevojshme para largimit dhe për ardhjen e tij.

Neni 24
Pritje në Presidencë

1. Në rastin e vizitës së një President shteti, Kryeministër ose vizitor tjetër i lartë, Presidenti i Republikës e pret atë në selinë e Presidencës ose në një seli tjetër qeveritare.
2. Presidenti i Republikës pret miq të nivelit të lartë edhe në mjedise të tjera si në Rezidencën e Presidentit. Në to mund të zhvillohet e njëjta ceremoni nderi. Për homologun Presidenti shtron, sipas rastit, pritje kortezie, drekë ose darkë shteti.
3. Në rastet kur Presidenti i Republikës takohet me vizitorë të nivelit Kryeministër, pritja bëhet në hollin e Presidencës, kurse për nivelet ministër, sekretar shteti ose autoritete të tjera me të njëjtin rang, pritja bëhet brenda në sallën e takimit.

Neni 25
Ceremoniali i Kuvendit

1. Kuvendi është organi legjislativ i Republikës së Kosovës. Si i tillë ai gëzon të drejtën e një ceremoniali të veçantë në aktivitetin e tij zyrtar. Kompetencat për trajtimin dhe për zbatimin e këtij ceremoniali në hapësirën e Kuvendit i ka zyra e protokollit të Kuvendit.
2. Protokolli i Kuvendit drejton ceremonialin në Kuvend. Detyrat e tij parashikohen në rregulloren e brendshme të Kuvendit.
3. Protokolli i Kuvendit organizon, ndjek dhe programon ceremonitë e pritjes e të përcjelljes, si dhe të gjitha praktikat protokollare gjatë vizitave të delegacioneve të huaja të institucioneve parlamentare ndërshtetërorë.
4. Protokolli i Shtetit në bashkëpunim me protokollin e Kuvendit bashkërendon takimet e Kryetarit të Kuvendit me delegacionet e nivelit President, Kryeministër, Ministër të Punëve të Jashtme që vizitojnë vendin tonë dhe të ambasadorëve të rinj që paraqesin letërkredencialet. Takimet e nënkryetarëve të Kuvendit, kryetareve të grupeve parlamentare, kryetarëve të Komisioneve të Kuvendit dhe deputetëve bashkërendohen nga protokolli i Kuvendit.
5. Protokolli i Kuvendit harton ftesa dhe telegrame zyrtare të Kryetarit të Kuvendit për homologë dhe titullarë të organizatave e institucioneve të ndryshme ndërshtetërorë dhe ia përcjell ato Protokollit të Shtetit.
6. Ndjek praktikat konsullore me përfaqësitë diplomatike të akredituara në Republikën e Kosovës për vizitat e delegacioneve të Kuvendit, për dërgim të ftesave dhe të telegrameve të urimit dhe harton listën e pjesëmarrësve në takimet zyrtare dhe pritjet e Kryetarit të Kuvendit.

Neni 26
Kryetari i Kuvendit

1. Kryetari i Kuvendit është autoriteti i dytë në radhën e përparësisë në Republikën e Kosovës. Kryetari i Kuvendit ka të drejtën e një ceremoniali të veçantë në veprimtarinë e tij zyrtare dhe jozyrtare. Në hyrje të zyrës së Kryetarit të Kuvendit qëndrojnë dy truproja nderi. Gjithkush i drejtohet atij "z. Kryetar i Kuvendit".
2. Bashkëshorti/ja e Kryetarit të Kuvendit gëzon status protokollar gjatë pritjeve dhe aktiviteteve ku është ftuar së bashku me bashkëshortin, brenda ose jashtë shtetit ose vetëm, gjatë organizimit të aktiviteteve të ndryshme shoqërore, humanitare, si dhe me Misionin Diplomatik. Bashkëshortes së Kryetarit të Kuvendit, gjithsecili i drejtohet Znj. (vijon mbiemri).
3. Kur Kryetari i Kuvendit merr pjesë në aktivitetet publike së bashku me Presidentin e Republikës, qëndron në të djathtë të tij, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe.

Neni 27
Kryeministri

1. Kryeministri, si rangu më i lartë i pushtetit ekzekutiv në Kosovë, ka të drejtën e një ceremoniali të veçantë në të gjitha aspektet zyrtare dhe jozyrtare të jetës dhe aktivitetit të tij. Kryeministrit gjithsecili i drejtohet, "Z. Kryeministër".

2. Bashkëshortja/i e Kryeministrit është personalitet publik dhe ka të drejtë të japë pritje dhe të organizojë aktivitete të ndryshme shoqërore, humanitare dhe me përfaqësues nga Misioni Diplomatik. Bashkëshortes së Kryeministrit gjithsecili i drejtohet Znj. (vijon mbiemri).
3. Në rastet kur Presidenti i Republikës është i pamartuar ose i ve, bashkëshortja e Kryeministrit fiton të gjitha privilegjet e Zonjës së Parë të vendit deri në ndryshimin e statusit familjar të Presidentit, por emërtimi i saj zyrtar nuk është Zonjë e Parë.
4. Bashkëshortja e Kryeministrit e shoqëron bashkëshortin në vizitat që kryen, merr pjesë, sipas dëshirës, në aktivitetet dhe ceremonitë që zhvillohen, por jo në takimet zyrtare. Gjatë këtyre ajo gëzon të drejtën e një programi të veçantë protokollar.
5. Fëmijët në moshë madhore të Kryeministrit, që jetojnë me të, kur marrin pjesë të ftuar në ceremoni të ndryshme formale, barazohen me rangun këshilltar i kryeministrit. Në raste të tjera ose kur janë në moshë të vogël, nuk gëzojnë status protokollar.

Neni 28
Betimi i Qeverisë

1. Ceremonia e betimit të Qeverisë së re zhvillohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Përveç Deputetëve marrim pjesë të ftuar nga institucionet kryesore të shtetit, trupi diplomatik i akreditуar në Kosovë, përfaqësues të shquar të shkencës, kulturës dhe artit, Kryetarët e Bashkësive Fetare: Islame, Katolike dhe Ortodokse dhe përfaqësues të tjerë të shquar të shoqërisë në Republikën e Kosovës.
2. Qeveria e kryesuar nga Kryeministri ulet në vendin e caktuar sipas renditjes në listën Qeveritare. Ceremoninë e hap Kryetari i Kuvendit. Hyn Presidenti i Republikës dhe zë vendin e caktuar. Të gjithë të pranishmit ngrihen në këmbë. Intonohet himni shtetëror.
3. Pas betimit, Qeveria e re mblidhet në selinë e Kryeministrisë në takimin e parë inagurativ dhe Kryeministri përshëndet çdo ministër për fillimin me sukses të detyrës.
4. Me rastin e fillimit të detyrës, Kryeministri jep në një nga selitë Qeveritare një pritje për Misionin Diplomatik. Ftohen të gjithë shefat e përfaqësive të akreditуar në Kosovë dhe personalitete të tjera. Lista përpilohet nga zyra e Kryeministrit. Organizimi i aktivitetit bëhet nga Protokolli i Shtetit.

Neni 29
Kryeministria

1. Në hyrjet të selisë së Kryeministrisë qëndrojnë dy truproja nderi me uniformë ceremoniale të ndryshme nga të Presidencës.
2. Rangu i Kryeministrit ka të drejtë të mbajë flamur dallues si shenjë e veçantë që identifikon shkallën e hierarkisë dhe autoritetin e këtij rangu për të drejtuar e komanduar. Në zyrën e Kryeministrit, mbrapa ulëses së tij qëndrojnë dy flamurë, në të djathtë flamuri shtetërorë dhe në të majtë flamuri dallues i Kryeministrit.

3. Kryeministri merr pjesë në pritje të ndryshme që jepen nga Misionet Diplomatike të akredituara në Kosovë. Në pamundësi të pjesëmarrjes, Kryeministri dërgon në këto aktivitete një nga përfaqësuesit e tij kryesor.
4. Protokolli i zyrës së Kryeministrit drejtohet nga Shefi i Protokollit të Kryeministrit. Ai është përgjegjës për pritjet dhe përcjelljet që bëhen në zyrën e Kryeministrit, lëvizjet dhe aktivitetet që bëhen brenda territorit të Kosovës, në përputhje me protokollin e shtetit.

Neni 30
Pritje në Kryeministri

1. Në selinë e tij Kryeministri i Republikës së Kosovës pret dhe përcjell vizitorë sipas një programi të miratuar që më parë. Kreun e shtetit të huaj e pret dhe e përcjell deri pranë automjetit, ndërsa homologun deri në hyrje të selisë. Ceremonitë zyrtare me vizitorë të huaj drejtohen nga Protokolli i Shtetit.
2. Dy orë para mbërritjes, ngrihet në vendin e caktuar mbi hyrje flamuri i shtetit mik, në krah të majtë të flamurit të Republikës së Kosovës. Flamujt e të dy vendeve vendosen në sallën e takimit ose me përmasa të vogla, në tavolinën e bisedimeve zyrtare.
3. Në vizitat zyrtare zhvillohet ceremonia e nderit. Ajo mund të zhvillohet në aeroport, në selinë e Kryeministrit ose në një seli tjetër qeveritare sipas skemës së përcaktuar.
4. Në vizita jozyrtare nuk zhvillohet ceremonia e nderit. Kryeministri e pret vizitorin mik në hyrjen e selisë së Kryeministrisë. Sipas rastit, së bashku me Kryeministrin presin 2-3 shoqërues zyrtarë të tij, personat e ngarkuar me protokollin, shtypin dhe përkthyesi.
5. Kryeministri i Republikës së Kosovës pret miq të nivelit të lartë si President shteti dhe Kryeministër të huaj edhe në ambientet e Rezidencës së Presidentit dhe me seli të tjera qeveritare. Në to mund të zhvillohet e njëjta ceremoni nderi. Për miqtë, Kryeministri shtron, sipas rastit, drekë ose darkë zyrtare.
6. Në rastet kur Kryeministri takohet me vizitorë të huaj të nivelit ministër, sekretar shteti ose autoritete të të njëjtit nivel me ta, pritja e tyre bëhet në sallën e takimit.

Neni 31
Pritje në Ministrinë e Punëve të Jashtme

1. Ministria e Punëve të Jashtme organizon me Misionin Diplomatik pritje të ndryshme, duke përfshirë në to, sipas rastit, edhe personalitete të Republikës së Kosovës të jetës politike e sociale.
2. Drejtuesit e saj kryesorë marrin pjesë, për shkak të detyrës, në shumë pritje ose aktivitete shtetërore, zyrtare dhe private, kur janë të ftuar nga autoritetet organizatore dhe kur në to marrin pjesë përfaqësues të Misionit Diplomatik apo delegacione të huaja të ndodhura për vizitë në Kosovë.
3. Ministri i Punëve të Jashtme, së bashku me bashkëshorten, ka të drejtën të organizojë pritje dhe aktivitete diplomatike, sipas momentit dhe qëllimeve që kërkon të realizojë nëpërmjet tyre. Kjo përcaktohet në përputhje me synimet politike që ai vetë ka miratuar.

4. Pritja e parë e Ministrit të Punëve të Jashtme jepet sapo fillon detyrën zyrtare. Pritja jepet brenda orarit zyrtar, vetëm për shefat e përfaqësive diplomatike ose jashtë orarit zyrtar, nëse ftohen së bashku me bashkëshortet.

KREU V

Neni 32
VIZITA DHE TAKIME

1. Protokolli i Shtetit të Republikës së Kosovës parashikon këto lloj vizitash:
   1.1. Shtetërore (vetëm nga President shteti);
   1.2. Zyrtare;
   1.3. Pune;
   1.4. Kortezie, Private.
2. Vizitat dhe takimet ndërshtetërore të Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme në Republikën e Kosovës organizohen nëpërmjet kanaleve diplomatike dhe asistohen nga Protokolli i Shtetit.
3. Ftesat duhet të bëhen nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Ministri i Punëve të Jashtme, homologëve të tyre të huaj gjatë takimeve që mund të kenë me ta ose edhe zyrtarisht, nëpërmjet përfaqësuesve diplomatikë.
4. Ftesat dërgohen nëpërmjet Protokollit të Shtetit.
5. Palët bien dakord nëpërmjet kanaleve diplomatike për kohën e vizitës, si dhe për kohëzgjatjen e saj.
6. Kur kryetari i delegacionit është President Shteti, Kryetar Parlamenti, Kryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme, në mjete te komunikimit jepet një biografi e shkurtër e jetës dhe e veprimtarisë së tij, e shoqëruar me një përmbledhje të shkurtër të historikut të marrëdhënieve midis dy vendeve.
7. Disa ditë përpara datës së caktuar të mbërritjes së delegacionit, hartohet programi përfundimtar i vizitës. Në program parashikohen, mënyra e pritjes dhe e përcjelljes, përbërja e delegacioneve, zhvillimi dhe formati i bisedimeve, marrëveshjet, nëse ka të tilla, takimet me personalitetet e vendit, vizita në qendra të ndryshme kulturore-turistike, të dhëna mbi vendin dhe klimën e tij etj.
8. Hartimi i programit bëhet duke bashkëpunuar ngushtë me përfaqësinë diplomatike të vendit nga vjen delegacioni. Përfaqësisë diplomatike i jepet një kopje e programit përfundimtar disa ditë përpara mbërritjes së delegacionit.

Neni 33
Pritja e delegacioneve të huaja të nivelit të lartë

1. Në raste vizitash shtetërore dhe zyrtare zhvillohet gjithmonë ceremonia e plotë e pritjes me truprojën e nderit dhe ekzekutimin e himneve shtetërorë.
2. Delegacioni i huaj i nivelit President Shteti, Kryetar Parlamenti, Kryeministër, Sekretar i Përgjithshëm i OKB-së dhe i NATO-s, President i KE-së dhe i një rangu me ta, pritet me ceremoninë përkatëse në Aeroportin e Prishtinës ose në selinë e autoritetit që e ka ftuar. Kjo fiksohet në programin e vizitës dhe miratohet paraprakisht nga personaliteti pritës i Republikës së Kosovës.

3. Personalitetet e Republikës së Kosovës prezantohen nga autoriteti i Republikës së Kosovës, kurse personeli diplomatik prezantohet nga ambasadori përkatës.
4. Kur delegacioni kryesohet nga Ministri i Mbrojtjes, ceremonia zhvillohet në ambientet e Ministrisë së Forcës se Sigurisë ose në repartin ushtarak të përcaktuar që më parë sipas programit.
5. Kur kryetari i delegacionit është Kryeministër dhe takohet me Presidentin, ky i fundit shoqërohet nga Ministri i Punëve të Jashtme dhe në mungesë të tij nga zëvendësministri i Punëve të Jashtme.
6. Në të gjitha rastet e vizitave të delegacioneve në nivel President Shteti, Kryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme, thirret ambasadori i Republikës së Kosovës i akreditуar në vendin nga vjen delegacioni dhe renditet i dyti në listën e delegacionit të Republikës së Kosovës, përveç rastit kur në të marrin pjesë dy nga personalitetet e mësipërme.
7. Gjatë kohës që miku i lartë qëndron në Kosovë, në selinë ku ai vendoset, ngrihet flamuri i tij shtetërorë, i cili qëndron i shpalosur deri në largimin e mysafirit.
8. Delegacioni i huaj, në vizitat që mund të bëjë në qytetet e tjera të Kosovës shoqërohet nga një personalitet i lartë i përcaktuar që më parë nga Protokolli i Shtetit. Në këto raste delegacionit i uron mirëseardhjen Kryetari i Komunës dhe autoritete të tjera të pushtetit lokal. Përcjellja e delegacionit bëhet në të njëjtën mënyrë dhe nga të njëjtët persona që e presin.

Neni 34
Përdorimi i sallës për personat e rëndësisë së veçantë të aeroportit

1. Salla për personat e rëndësisë së veçantë në Aeroportin e Prishtinës është e formuar nga dy ose më shumë mjedise. Shfrytëzimi i mjediseve të sallës (për personat e rëndësisë së veçantë) të aeroportit rregullohet me akt të veçantë nënligjor nga Ministria e Punëve të Jashtme.
2. Përdorimi i sallave për personat e rëndësisë së veçantë bëhet pa anashkaluar kontrollin e sigurisë së bagazheve dhe të personave. Ky kontroll përjashtohet vetëm për nivelin President, Kryetar Kuvendi, Kryeministër, Ministër i Jashtëm, Ministra dhe homologët e tyre të huaj. Çdo person tjetër që përdor sallën për personat e rëndësisë së veçantë dhe çdo delegacion në përgjithësi, u nënshtrohet procedurave të kontrollit.

Neni 35
Bisedimet

1. Bisedimet zyrtare ndërmjet dy delegacioneve zhvillohen në tavolinë, e cila përgatitet që me parë. Delegacionet zënë vend përballë njëri-tjetrit sipas rangut. Në qendër qëndron kryetari i delegacionit. Në tavolinë vendosen flamuj të vegjël shtetërorë. Vendasit zënë vend me shpinë nga dritarja ose përballë hyrjes, kurse miqtë, përballë tyre. Mund të vendosen edhe flamuj të mëdhenj shtetërorë.
2. Nëse takimi është i karakterit formal ose kortezie dhe në rang jo të barabartë, zhvillohet në një sallon pritje.

3. Takimet homologe dypalëshe zhvillohen në tavolina drejtkëndëshe, ato trepalëshe në tavolinë në formë U, me delegacionin pritës në qendër dhe, nëse janë katër delegacione, përdoret një tavolinë katrore.
4. Nëse delegacionet janë pesë ose më shumë, përdoret tavolinë vezake ose drejtkëndëshe, ku delegacioni pritës qëndron në pjesën e ngushtë të saj. Në rastet kur është e nevojshme që të evidentohet barazia formale e pjesëmarrësve dhe të evitohet pozicioni hierarkik i kryesimit të takimit, atëherë përdoret tavolinë katrore ose e rrumbullakët.
5. Në të gjitha llojet e bisedimeve lejohet pjesëmarrja fillestare e medias dhe bëhen fotografi zyrtare të delegacioneve ose të kryetarëve të tyre. Lejohen sekretarët e stenografisë.

Neni 36
Nënshkrimi i marrëveshjeve

1. Nënshkrimi i marrëveshjeve dy ose më shumë palësh është një moment solemn, i cili kërkon një protokoll të veçantë dhe të kujdesshëm. Ceremonia duhet të respektojë këto rregulla bazë:
   1.1. Tavolina e nënshkrimeve duhet të ketë madhësi të përshtatshme me numrin e nënshkruesve, të cilët ulen të gjithë nga e njëjta anë e saj.
   1.2. Autoriteti pritës e vendos mikun në krah të djathtë. Nëse janë më shumë se dy, vendasi qëndron në mes.
   1.3. Në tavolinë vendosen që më parë dosjet e marrëveshjes dhe penat.
   1.4. Pas nënshkruesve vendosen flamujt shtetërorë dhe përfaqësues, të cilët duhet të jenë të të njëjtës madhësi. Mundet që përveç flamujve të mëdhenj të vendosen edhe flamuj të vegjël tavoline.
   1.5. Të paktën dy vetë ndihmojnë nënshkruesit gjatë procedurës së nënshkruarjes.
   1.6. Media sistemohet përballë tavolinës së nënshkrimeve, jo më pak se 2-3m distancë.
   1.7. Delegacionet përkatëse zënë vend në krah të kryetarit të tyre ose pas tij.
   1.8. Nëse marrëveshja nuk nënshkruhet nga autoritetet më të larta prezent në ceremoni, këta të fundit zënë vend pas nënshkruesve ose ulur në tavolinë në mes të tyre.

Neni 37
Shkëmbimi i dhuratave

1. Në rastet e vizitave, takimeve dhe në përgjithësi gjatë ushtrimit të detyrës shtetërore, personaliteteve të larta të shtetit u jepen dhurata nga njerëz dhe institucione. Presidenti, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme, shkëmbejnë dhurata në shenjë kortezie.
2. Vlera e dhuratës nuk duhet të kapërcejë kufijtë e mirësjelljes, rregullat apo limitet ligjore që shtete të ndryshme mund të kenë vendosur, si dhe reciprocitetin. Për çdo dhuratë të dhënë hartohet dokumentacioni përkatës përshkrues. Institucionet rekomandohen të bëjnë personalizimin e dhuratave.

3. Autoritetet kryesore nuk i shkëmbejnë vetë dhuratat në takimet zyrtare, përveç rasteve të veçanta kur bihet dakord që më parë për këtë. Në çdo rast tjetër, dhuratat shkëmbehen nëpërmjet protokolleve përkatëse.

Neni 38
Pritja e delegacioneve jo të nivelit të lartë

1. Kur delegacionet e huaja që vijnë në Republikën e Kosovës kryesohen nga personalitete të nivelit ministër dhe më ulët, priten dhe përcillen nga përfaqësues të Republikës së Kosovës të të njëjtit rang me ta.
2. Këto delegacione priten pa ceremoni zyrtare dhe ngritje flamuri. Flamurët e të dy vendeve ngrihen në ministritë përkatëse vetëm kur delegacioni kryesohet nga Ministri i Punëve të Jashtme ose Ministri i Mbrojtjes.
3. Delegacionet e huaja të kryesuara nga nivel ministri mund të priten në takime të veçanta nga Presidenti i Republikës dhe Kryeministri, bazuar në kërkesën e tyre pranë Protokollit të Shtetit. Delegacionet legjislative të të njëjtit rang priten nga Kryetari i Kuvendit. Në çdo rast merret mendimi paraprak i drejtorisë përkatëse të Ministrisë së Punëve të Jashtme.
4. Në të gjitha rastet e vizitave të nivelit ministër ose të barabartë me të, vihet në dijeni për programin e vizitës Policia e Kosovës jo më vonë se dyzetetetë (48) orë përpara mbërritjes së personalitetit të huaj.
5. Ceremonia e pritjes së një Ministri Mbrojtje ose ushtaraku të lartë, kur bëhet në Ministrinë e Forcës së Sigurisë ose në një objekt ushtarak, zhvillohet në prani të truprojës ushtarake të nderit dhe drejtohet nga protokolli i Ministrisë së Forcës se Sigurisë.

Neni 39
Përcjellja e delegacioneve të Republikës së Kosovës të nivelit të lartë

1. Kur Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe Ministri i Jashtëm udhëtojnë jashtë shtetit për vizitë shteti ose zyrtare, mundet që 1 ditë më parë udhëton për në vendin pritës një punonjës i protokollit të institucionit përkatës ose Protokollit të Shtetit, i cili njihet me përgatitjet, vendin dhe programin e vizitës ose këtë aktivitet e kryen përfaqësia diplomatike e Republikës së Kosovës e akreditуar në vendin përkatës.
2. Delegacioni i lartë përcillet në aeroport nga Drejtori i Protokollit të Shtetit ose zëvendësi. Në përcjelljen e Presidentit të Republikës si rregull marrin pjesë, gjithashtu Sekretari i Presidencës ose shefi i Kabinetit dhe anëtarë të stafit të tij. Merr pjesë edhe ambasadori i vendit përkatës.
3. Në përcjelljen e Kryeministrit marrin pjesë Sekretari i Përhershëm i Kryeministrisë, Shefi i Kabinetit të Kryeministrit dhe Drejtori i Protokollit të Shtetit ose zëvendësi.
4. Në përcjelljen e Ministrit të Punëve të Jashtme merr pjesë Shefi i Kabinetit dhe Drejtori i Protokollit të Shtetit ose zëvendësi i tij. Në rastet e vizitave zyrtare asiston edhe ambasadori i vendit përkatës.

5. Autoritetet e mësipërme vijnë në aeroport vetëm disa çaste përpara ngritjes së aeroplanit. Anëtarët e tjerë të delegacionit kryejnë të gjitha formalitetet përpara mbërritjes së autoritetit dhe hipin të parët në aeroplan. Personi i ngarkuar me protokollin e personalitetit kryen të gjitha formalitetet përpara mbërritjes së tij në aeroport.

Neni 40
Pritja e personaliteteve të rëndësishëm pa rang zyrtar

1. Nëse në Republikën e Kosovës vijnë për vizitë të ftuar nga autoritetet e larta të vendit, personalitete të veçanta pa rang zyrtar, por të rëndësishëm dhe të nivelit të lartë në vendin e tyre si, princ jotrashëgimtar, drejtues fondacionesh të rëndësishme, përfaqësues të mëdhenj të artit, kulturës, të familjeve të mëdha botërore ose të tjerë të barabartë me këtë nivel, ndaj tyre zbatohet një protokoll i veçantë.
2. Nëse ardhja e tyre është negociuar në rrugë diplomatike, priten nga zyrtarë të Protokollit të Shtetit, përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe trajtohen si vizitorë me status diplomatik. Nivelin e pritjes e përcakton Protokolli i Shtetit.

Neni 41
Radha e përparësisë së rangjeve zyrtare

1. Në Republikën e Kosovës, përparësia e rangjeve zyrtare ndahet në tre grupe kryesore:
   1.1. **Grupi I:** Presidenti, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese dhe ish Presidentët.
   1.2. **Grupi II:** Nënkryetarët e Kuvendit, Zëvendëskryeministrat, Ministrat e Qeverisë sipas listës së dekretimit, Ambasadorët e huaj, Kryetarët e Grupeve Parlamentare, Kryetarët e Komisioneve Parlamentare, Deputetët, Ambasadorët e Republikës së Kosovës në detyrë, Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Gjykatës Supreme, Kryetari i Kryeqytetit, Avokati i Popullit, Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Guvernatori i Bankës Qendrore, Prokurori i përgjithshëm i Republikës së Kosovës, Komandanti i Përgjithshëm i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Drejtori i Policisë së Kosovës, Drejtori i AIK, Kryetarët e Bashkësive Fetare: Islame, Katolike dhe Ortodokse, të ngarkuarit me Punë në Republikën e Kosovës, Kryetarët e Komunave, Këshilltarët e parë Politik të Presidentit dhe të Kryeministrit, Rektori i Universitetit Publik, Ushtarak me gradën Gjeneral, Sekretari i Përhershëm i Presidencës, Kuvendit dhe Zyrës së Kryeministrit dhe këshilltarët e parë të Ministrave.
   1.3. **Grupi III:** Kryesuesit e Kuvendeve Komunale, Sekretarët e Përhershëm të Ministrive, Drejtorët e Agjencioneve dhe Instituteve në nivel vendi, Kryetarët e Gjykatave të Qarkut, Prokurorët Publik të Qarkut, Drejtori i Muzeut, Drejtori i Arkivit, Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës, Kryetari i Odës Ekonomike, Drejtorët e Drejtorive në Kuvendet Komunale, Kryetarët e Partive joparlamentare, Këshilltarët e Kuvendeve Komunal dhe drejtuesit e Organizatave Joqeveritare.

Neni 42
Përparësia në Republikën e Kosovës

1. Ndër të kualifikuarit me të njëjtin rang përparësinë e ka më i vjetri në detyrë dhe më tej më i vjetri në moshë.
2. Ndër të kualifikuarit me rang të barabartë prioritetin e ka një i huaj.
3. Krerët e Shteteve kanë të gjithë rang të barabartë, presidentë apo mbretër qofshin, prandaj përparësia vendoset mbi bazën se kush është më i vjetër në detyrë dhe më tej në moshë.
4. Personat "ish" dhe të dalë në pension radhiten më poshtë se ata që kanë zënë vendet e tyre në detyrë.
5. Në raste ceremonish të një natyre specifike, e cila lidhet me ngjarje dhe manifestime të një karakteri të përcaktuar, mund të ndodhë që të bëhen përjashtime në radhën e përparësisë së rangjeve. Në këto raste është natyra e ceremonisë që kushtëzon edhe radhën e vendosjes ndryshe të personaliteteve. Kjo bëhet brenda limiteve të caktuara dhe sipas një programi të miratuar që më parë. p.sh. Në një manifestim të armës së Policisë së Shtetit, vendi i drejtorit të përgjithshëm të policisë duhet të jetë pranë Ministrit të Punëve të Brendshme. Në inaugurime objektesh apo festa lokale, rangu drejtues përkatës qëndron pranë personalitetit më të lartë të pranishëm. Në takime pune, funksionarë të ndryshëm, sekretarë të përhershëm të Presidencës, Qeverisë, Kuvendit, vendosen pas personaliteteve të tyre.
6. Në manifestimet publike, shënimin e festave zyrtare, memoriale, festave lokale, përkujtimeve, ceremonive komemorative renditja behët konform përparësisë së rangjeve zyrtare të këtij Ligji.

Neni 43
Përparësia e organeve të pushtetit lokal

Për përcaktimin e radhës së përparësisë së organeve të pushtetit lokal, Protokolli i Shtetit vendos në konsultim me Ministrinë e Pushtetit Lokal.

Neni 44
Elemente të ceremonive zyrtare

1. Ecja zyrtare, organizohet duke respektuar radhën e parë të saj, e cila si rregull duhet të jetë me numër tek. Vendi i nderit është në mes sipas renditjes: 4-2-1-3-5. Kur numri i personave të caktuar në radhën e parë është çift, vendi i nderit është në të djathtë: 1-2-3-4.
2. Kur personalitetet nisen për të zënë vend në një tribunë, ata ecin në mënyrë të tillë: 2-1-3 dhe në fund të lëvizjes personalitetet zënë vendet e caktuara nga protokolli.
3. Vendi i nderit, konsiderohet ai në krah të djathtë nëse kemi dy vende ose i mesit, nëse janë tre. I dyti për nga rëndësia vjen vendi në të djathtë të vendit të mesit, i treti ai në të majtë dhe kështu me radhë. Nëse janë dy personalitete të të njëjtit rang, atëherë vendosen të dy në mes duke pasur në të dy krahët një numër të barabartë shoqëruesish.

4. Përcaktimi i vendeve në salla ndjek radhën e përparësisë së rangjeve të pjesëmarrësve. Pika e referimit është kolltuku e mesit në radhën e parë ose kolltuku e parë në të djathtë të rrugëkalimit në të cilën ulet personi më i rëndësishëm.
5. Për të respektuar ceremonialin duhet të përpilohet një hartë e qartë me mënyrën e ndarjes së vendeve sipas emrave të pjesëmarrësve në ceremoni dhe që ju shpërndahet pjesëmarrësve bashkë me ftesat.

Neni 45
Ceremoni inaugurimi

Nëse autoritetet më të larta të shtetit marrin pjesë në inaugurime të objekteve, veprave dhe prodhimeve të reja, kjo përbën një ceremoni solemne, e cila organizohet me kujdesin e duhur.
Të ftuarit përcillen në të njëjtën mënyrë si priten.

Neni 46
Ceremoni emërimi në detyrë

1. Çdo institucion ka detyrimin moral të bëjë të njohur zyrtarët që fillojnë punë në të. Në funksion të kësaj zhvillohet një ceremoni e thjeshtë, gjatë së cilës bëhet prezantimi i personit, i aftësive dhe aktivitetit të tij dhe më pas bëhet betimi. Nëse objekti është një grup të emëruarish të rinj, prezantimin mund ta bëjë edhe titullari i institucionit.
2. Ministria e Punëve të Jashtme zhvillon ceremoninë e përcjelljes së ambasadorëve të akredituar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës në vendet e tjera. Në ceremoni, përveç zyrtarëve të institucionit, ftohen të marrin pjesë edhe ambasadorët e vendeve përkatëse.

KREU VII
CEREMONITË KRYESORE ZYRTARE

Neni 47
Festat zyrtare dhe publike

1. Festat zyrtare dhe memoriale dhe ceremonitë e tyre ne Republikën e Kosovës janë te përcaktuara me ligj dhe me Komisionin Republikan për përcaktimin e festave memoriale dhe festave te shënuar.
2. Mënyra e shënimit të festave zyrtare dhe memoriale rregullohet me akt nënligjor të Qeverisë.

Neni 48
Zija shtetërorë

1. Zija është një ceremoni solemne e respektit shtetëror e qytetar që zhvillohet në frymën e vlerave më të larta njerëzore dhe parimeve universale të të drejtave të njeriut, demokracisë dhe lirisë të përcaktuar më Kushtetutë.
2. Zi shtetërorë mbahet për:
   2.1. personalitete të larta shtetërore e publike;

2.2. personalitete të shquara të komunitetit ndërshtetërorë me origjinë Kosovare;
2.3. njerëz që sakrifikojnë jetën e tyre në krye të detyrës;
2.4. fatkeqësi të rënda njerëzore që prekin thellë ndërgjegjen e kolektivitetit;

3. Zija shtetërorë shpallet me vendim të Presidentit dhe i komunikohet Misionit Diplomatik nëpërmjet Protokollit të Shtetit.
4. Kohëzgjatja e zisë përcaktohet nga Presidenti.

Neni 49
Ceremonitë mortore

1. Sipas rastit përcaktohet formimi i një komisioni të veçantë për organizimin e ceremonisë mortore.
2. Ceremonitë mortore në Republikën e Kosovës janë shtetërore, zyrtare, ushtarake dhe jo të plota zyrtare e ushtarake. Të gjitha llojet e ceremonive janë të rëndësishme, të cilat programohen deri në imtësitë më të vogla për të ruajtur solemnitetin dhe manifestuar respektin e merituar. Ceremonitë ushtarake organizohen nga protokolli i Ministrisë e Forcës së Sigurisë.
3. Rangjet të cilave u takon t'u bëhet funeral shteti janë:
   3.1. Presidenti i Republikës në detyrë;
   3.2. Ish Presidentët;
   3.3. Kryetari i Kuvendit në detyrë;
   3.4. Kryeministri;
   3.5. Çdo personalitet tjetër që përcaktohet me vendim të Qeverisë.
4. Në rastin e ceremonisë mortore që organizohet për një President, Kryetar Kuvendi ose Kryeministër, arkivoli vendoset në shtratin e topit i mbuluar me flamur shtetërorë dhe shoqërohet nga truproja e nderit të Republikës.
5. Lëshimin e arkivolit në varr shoqërohet me të shtëna nga truproja e nderit. Të gjitha personalitetet zyrtare pjesëmarrëse në ceremoni duhet të vendosin një shirit të zi në krahun e majtë. Ushtarakët marrin drejtqëndrim. Nderimi me të shtëna arme u rezervohet:

5.1.	Presidentit të Republikës	21 të shtëna
5.2.	Kryetarit të Kuvendit	19 të shtëna
5.3.	Kryeministrit	19 të shtëna
5.4.	Ministrave	15 të shtëna
5.5.	Komandantit të FSK-së	15 të shtëna

Neni 50
Ceremoni mortore shtetërore

1. Kur Qeveria vendos për kryerjen e një ceremonie shtetërore mortore dhe familja e të ndjerit e pranon këtë lloj funerali, formohet një komision, ku bën pjesë edhe Protokolli i Shtetit.
2. Protokolli i Shtetit bashkërendon punën me Institucionet tjera.
3. Pranë arkivolit krijohet një vend i posaçëm për familjen dhe të afërmit e të ndjerit. Në hyrje vendoset tavolina me Librin e Ngushëllimeve. Mbi të vendoset portreti i të ndjerit dhe në të djathtë flamuri shtetërorë. Në të dy krahët mbajnë drejtqëndrim dy truproja nderi.

4. Arkivoli vendoset në mbajtësen e posaçme. Truproja e nderit merr drejtqëndrim "për nder armë" gjatë lëvizjes së arkivolit. Personaliteti i caktuar bën përshëndetjen e rastit (3) minuta. Nga arkivoli hiqet flamuri me palosje dhe arkivoli vendoset pranë varrit.
5. Lëshimi në varr e arkivolit paraprihet nga të shtënat e nderit. Skuadra përbëhet nga pesë (5) deri shtatë (7) ushtarë dhe komandohet nga një oficer. Armët mbahen dyzetepesë (45) gradë nga horizontalja, me drejtim mbi varr. Të shtënat komandohen nga oficeri i truprojës. Mbas të shtënave skuadra merr drejtqëndrim "për nder armë".
6. Personalitetet e pranishme ngushëllojnë familjen e të ndjerit dhe largohen. Shpenzimet e funeralit shtetëror mbulohen nga Qeveria.

Neni 51
Ceremoni mortore zyrtare

1. Ceremonia e homazheve organizohet me lejen e familjes, në institucionin përkatës, ku vendoset arkivoli dhe hapet Libri i Ngushëllimeve. Në orën e caktuar, kortezhi i përmortshëm niset drejt varrezave i eskortuar vetëm nga patrulla policore.
2. Organizimi i ceremonisë dhe shpenzimet e funeralit mbulohen nga institucioni përkatës.

Neni 52
Vdekja e një personaliteti të huaj

Nëse ndërron jetë një: President Shteti, Kryeministër, Ministri Punëve të Jashtme apo një personalitet i lartë, homologët nga Republika e Kosovës vizitojnë personalisht ambasadorin e vendit përkatës. Homologu Kosovar bënë ngushëllime personalisht dhe nënshkruan në Librin e Ngushëllimeve. Autoritetet e tjera mund të dërgojnë sipas dëshirës një përfaqësues.

Neni 53
Dispozitat përfundimtare

Ministria e Punëve të Jashtme nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 54
Hyrja në fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-132
16 prill 2009

Ligji shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI IV / Nr. 53 / 01 QERSHOR 2009

LIGJI Nr. 03/L-235
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-132 PËR PROTOKOLLIN E SHTETIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-132 PËR PROTOKOLLIN E SHTETIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 1

Pas nenit 5 të ligjit në fuqi shtohet nen i ri 5A si vijon:

Neni 5A
Akreditimi i Shefit të Misionit Diplomatik

1. Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me instrumentet dhe praktikat ndërkombëtare, Ambasadorët e huaj akreditohen tek Presidenti i Republikës së Kosovës si përfaqësues të Kreut të Shtetit të tyre.
2. Procedura fillon me marrjen e kërkesës, në formën e një note diplomatike për agrement. Pas kësaj, përgatitet nga Protokolli i Shtetit një informacion vlerësues, i cili së bashku me *Curriculum Vitae* përkatëse i dorëzohet Presidentit të Republikës.
3. Pas dhënies së agrementit, nga Zyra e Presidentit, Protokolli i Shtetit ka për detyrë të informojë ambasadën e vendit, nga i cili është paraqitur kërkesa, për qëndrimin e Institucioneve të Republikës se Kosovës, si dhe përfaqësinë tonë në atë vend, nëse ka të tillë. Në përgjithësi, kjo procedurë kërkon deri tridhjetë (30) ditë punë, ose zbatohet parimi i reciprocitetit.
4. Mbërritja e Ambasadorit të ri është objekt i rregullave të veçanta që zbatohen nga ceremoniali diplomatik i Protokollit të shtetit.
5. Data dhe ora e mbërritjes së Ambasadorit regjistrohet nga protokolli sepse përcakton edhe radhën e paraqitjes së Kredencialeve. Nëse protokolli nuk njoftohet për ardhjen e tij, atëherë si datë e mbërritjes konsiderohet koha kur ambasada përkatëse lajmëron me notë verbale për mbërritjen e shefit të saj. Që prej këtij momenti ai konsiderohet si Ambasador i emëruar dhe brenda disa ditëve (jo më shumë se dhjetë (10) ditë), Drejtori i Protokollit të Shtetit (ose zëvendësi) e pret për të marrë kopjet e Letër Kredencialeve dhe të thirrjes së paraardhësit. Gjatë kësaj kohe Ambasadori i ri mund të takojë anëtarë të Trupit Diplomatik, zyrtarë të

Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe persona të tjerë jo zyrtarë, por i sugjerohet që të mos kërkojë takim me anëtarët e Qeverisë, Kuvendit dhe Presidencës.

6. Sapo Presidenca përcakton datën e ceremonisë së akreditimit, Protokolli i Shtetit informon Ambasadorin. Shkresa përkatëse përcakton përveç ceremonisë, gjuhën e përdorur dhe vendin nga ku Ambasadori do të merret në ceremoni dhe emrat e një deri dy bashkëpunëtorëve të tij që janë paracaktuar për ta shoqëruar.
7. Veshja e rekomanduar është kostum i zi ose gri i errët, këmishë e bardhë, kravatë e errët, këpucë të zeza, ose veshje kombëtare.
8. Që nga momenti i paraqitjes së kredencialeve Ambasadori i ri gëzon statusin e tij diplomatik.
9. Lajmi i akreditimit të Ambasadorit të ri publikohet menjëherë në botimin e radhës së Gazetës Zyrtare. Për këtë kujdeset Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës.
10. Brenda një periudhe kohe prej një deri në dy muaj nga paraqitja e kredencialeve, Ambasadori i ri thirret së bashku me një ose dy (2) ambasadorë të tjerë për drekë ose darkë kortezie nga Ministri i Punëve të Jashtme.
11. Kur Shefi i Përfaqësisë largohet për periudha të shkurtra, ose kur posti i tij mbetet vakant, misioni duhet të informojë për këtë Protokollin e Shtetit me anë të një note verbale, ku do të tregohet data e nisjes së tij/saj dhe emri i të Ngarkuarit me Punë që e zëvendëson. Menjëherë pas kthimit të Shefit të Misionit, Protokolli i Shtetit duhet informuar përsëri për datën e rimarrjes së funksioneve të tij.

Neni 2

Titulli dhe neni 6 i ligjit në fuqi riformulohet si vijon:

Neni 6
Paraqitja e kredencialeve Presidentit të Republikës

1. Protokolli i shtetit njofton ambasadën përkatëse lidhur me vendimin e Presidentit për datën, orën dhe vendin e paraqitjes se kredencialeve Presidentit te Republikës nga ana e ambasadorit te ri.
2. Drejtori i Protokollit të Shtetit e shoqëron ambasadorin në një dhomë pritjeje të veçantë, ku ambasadori nënshkruan Librin e Miqve dhe qëndrojnë për disa qaste për një bisedë të shkurtër. Më pas Drejtori i Protokollit e drejton atë në sallën kryesore të ceremonisë.

Neni 3

Pas nenit 6 të ligjit në fuqi shtohet neni i ri 6A si vijon:

Neni 6A
Takimet zyrtare të Shefit të Misionit

1. Pas paraqitjes së kredencialeve Ambasadori i ri njofton Dekanin e Trupit Diplomatik dhe gjithë përfaqësitë e huaja për datën e paraqitjes së Kredencialeve dhe fillimin e kryerjes së funksioneve të tij.
2. Ambasadori i ri bën kërkesë zyrtare për takim me Kryetarin e Kuvendit,

Kryeministrin, anëtarët e Kabinetit Qeveritar dhe Kryetarin e Prishtinës. Asnjë nga personalitetet e larta të mësipërme nuk e viziton me këtë rast Ambasadorin e ri në selinë e tij.

3. Bashkëshortja e Ambasadorit të ri, nga ana e saj i kërkon një takim Zonjës së parë ose në mungesë të saj bashkëshortes së Kryeministrit, ose bashkëshortes së Ministrit të Jashtëm. Zonja e parë (në mungesë të saj bashkëshortja e Kryeministrit), në disa raste brenda vitit i thërret për takim kortezie në grupe nga dy ose tre, bashkëshortet e ambasadorëve të rinj.

Neni 4

Pas nenit 7 të ligjit në fuqi shtohet neni i ri 7A si vijon:

Neni 7A
Fillimi i detyrës së diplomatit, atasheut ushtarak, konsullit dhe funksionarit të organizatave ndërkombëtare

1. Fillimi i detyrës së një diplomati njoftohet nga përfaqësia përkatëse me anë të një note verbale drejtuar zyrës së Protokollit të Shtetit, ne të cilën shënohet pozicioni qe zë diplomati i sapo ardhur, personin që zëvendëson apo nëse është pozicion i ri. Notes Verbale i bashkëngjitet formulari përkatës i përgatitur nga Ministria e Punëve të Jashtme.
2. Akreditimi i Atasheut Ushtarak ndjek të njëjtën procedure për sa i përket kërkesës se agrementit, ndërsa konsultimet protokollare bëhen me strukturat përkatëse të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës. Njoftimi për pranimin mund të bëhet vetëm pas miratimit në përfundim të këtyre konsultimeve.
3. Njoftimi për ardhjen e atasheut ushtarak bëhet nga misioni përpara mbërritjes, me anë të një note verbale ku do të specifikohet emri i plotë, kualifikimi i saktë, personi qe zëvendësohet dhe CV e tij. Misioni përkatës duhet të presë miratimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme para se të fillojë të ushtrojë funksionet e tij.
4. Njoftimi për fillimin e funksionit të shefit të konsullatës bëhet me anë të një note verbale drejtuar Protokollit të Shtetit dhe njësisë përkatëse për çështje konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme, ku specifikohet territori, vendndodhja dhe adresa e qytetit ku do të ushtroje funksionet posti konsullor.
5. Konsujt e Nderit, të cilët janë shtetas të Kosovës, ose me dyshtetësi, kanë një status specifik. Ata e kryejnë mbi baza vullnetare misionin e tyre diplomatik dhe ndërkohë janë të lejuar të vazhdojnë të kryejnë aktivitetin e tyre privat.
6. Propozimi për konsull nderi duhet bërë nëpërmjet një kërkesë zyrtare të ardhur nga përfaqësia diplomatike e akredituar në Kosovë ose drejtpërdrejtë nga Ministria e Punëve të Jashtme e vendit qe e kërkon, dhe duhet miratuar nga autoritetet kompetente të Republikës së Kosovës.
7. Përjashtohen nga mundësia për të qenë konsull nderi:
   7.1. personat me shtetësi të Kosovës që janë të zgjedhur në organet përfaqësues t Republikës së Kosovës;
   7.2. personat që punojnë ne institucionet shtetërore, me funksione të papajtueshme ne bazë të ligjit me këtë detyre;

7.3. personat qe ushtrojnë profesionin e gjykatësit apo të prokurorit dhe të shërbimeve të inteligjencës.

8. Organizatat Ndërkombëtare duhet të bëjnë të njohur funksionaret e tyre të kategorisë së parë ne te njëjtën mënyrë si edhe misionet diplomatike, duke plotësuar të njëjtat procedura, përveç rasteve kur me ndonjë ligj tjetër te Republikës së Kosovës është përcaktuar ndryshe.

Neni 5

Nenit 8 të ligjit në fuqi i shtohet një paragraf i ri si vijon:

2. Diplomati duhet të jete i pajisur nga Ministria e Punëve te Jashtme e shtetit dërgues me letrën përkatëse drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, ku shënohet misioni i ngarkuar. Dorëzimi i saj bëhet ne Protokollin e Shtetit. Presidenti i Republikës së Kosovës aprovon hapjen e misionit dhe bënë dekretimin e akreditimit te tij.

Neni 6

Neni 20 i ligjit në fuqi fjalët Presidenti/ja i/e Republikës në titullin e nenit dhe në paragrafin e parë zëvendësohen me fjalët Presidenti i Republikës.

Neni 7

Neni 20 i ligjit në fuqi pas paragrafit 3. shtohet një paragraf i ri 4. si vijon:

4. Qeveria sipas propozimit të Protokollit të Shtetit miraton akt nënligjor për përcaktimin e kritereve për vendosjen e fotografisë së Presidentit.

Neni 8

1. Neni 22 i ligjit në fuqi pas paragrafit 2. shtohet një paragraf i ri 3. si vijon:
   3. Zonja e Parë shoqëron Presidentin e Republikës në vizita shtetërore jashtë vendit, bën vetë vizita në cilësinë e Zonjës së Parë, jep pritje, organizon publikisht dhe privatisht ceremoni të ndryshme me karakter shoqëror, humanitar e patriotik, mban lidhje me zonjat e para të vendeve te tjera, por nuk mund të marrë pjesë në punët dhe takimet zyrtare të Presidentit të Republikës.
2. Paragrafët e tjerë të këtij neni në ligjin në fuqi ndryshojnë radhitjen për një numër.

Neni 9

Neni 24 i ligjit në fuqi, paragrafi 2. riformulohet si vijon:

2. Presidenti i Republikës pret miq të nivelit të lartë edhe ne mjedise të tjera si në Rezidencën e Presidentit. Në to mund të zhvillohet e njëjta ceremoni nderi e cila organizohet nga protokolli i Presidencës në bashkëpunim me Protokollin e Shtetit.

Neni 10

Neni 24 i ligjit në fuqi pas paragrafit 3. shtohen katër paragrafë të ri 4., 5., 6. dhe 7. si vijon:

4. Nëse vizitori është Kryetar Shteti ne vizitë shtetërore, organizohet për nder të tij ceremonia e nderit ne aeroport ose ne Selinë e Presidentit, sipas skemës së miratuar më parë nga Protokolli i Shtetit dhe Protokolli i Presidencës.
5. Dy (2) orë para mbërritjes së Kreut të Shtetit mik, në vendin e caktuar ngrihet flamuri i tij kombëtar në krah të majtë të flamurit të Kosovës. Flamuj te të dy vendeve vendosën në sallën e takimit ose me përmasa të vogla në tavolinën e bisedimeve zyrtare.
6. Nëse Kreu i Shtetit mik nuk është në vizitë shtetërore (kalimtare, private, shumëpalëshe) atëherë nuk zhvillohet ceremoni nderi. Presidenti i vendit i del përpara, e pret ne hyrje të selisë dhe e shoqëron për në brendësi të ndërtesës. Vizitori i huaj nderohet ne hyrje nga truproja e nderit. Edhe përcjellja behet ne te njëjtën mënyrë si pritja.
7. Në rastet kur nuk zhvillohen bisedime zyrtare, takimi bëhet në sallën e pritjeve ulur në poltrona. Në këto takime formati i pjesëmarrjes përcaktohet qe me parë nga protokolli i Presidentit. Ceremonitë shtetërore drejtohen nga Protokolli i Shtetit.

Neni 11

Neni 34 i ligjit në fuqi paragrafi 1. riformulohet si vijon:
Salla për personat e rëndësisë së veçantë në Aeroportin e Prishtinës është e formuar nga dy (2) ose më shumë mjedise. Qeveria sipas propozimit të Protokollit të Shtetit miraton akt nënligjor për procedurën e shfrytëzimit të sallës së aeroportit për persona të rëndësisë së veçantë (PRV).

Neni 12

Neni 41 i ligjit në fuqi riformulohet si vijon:

1. Në Republikën e Kosovës, përparësia e rangjeve zyrtare ndahet në tre grupe kryesore:
   - 1.1. **Grupi i I**
     - 1.1.1. Presidenti i Republikës së Kosovës;
     - 1.1.2. Kryetari i Kuvendit;
     - 1.1.3. Kryeministri;
     - 1.1.4. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese;
     - 1.1.5. Ish Presidentet e Republikës.
   - 1.2. **Grupi II**
     - 1.2.1. Nënkryetarët e Kuvendit;
     - 1.2.2. Zëvendëskryeministrat;
     - 1.2.3. Ministrat;
     - 1.2.4. Kryetari i Kryeqytetit;
     - 1.2.5. Deputetët;
     - 1.2.6. Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës;

1.2.7. Kryetari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
1.2.8. Kryetari i Këshillit Prokurorial të Kosovës;
1.2.9. Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës;
1.2.10. Komandanti i Gardës së Republikës;
1.2.11. Kryeprokurori i shtetit;
1.2.12. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës;
1.2.13. Drejtori i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;
1.2.14. Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës;
1.2.15. Kryetari i Akademisë se Shkencave dhe Arteve të Kosovës;
1.2.16. Rektori i universitetit publik;
1.2.17. Kryetarët e komunave;
1.2.18. Udhëheqësit e misioneve ndërkombëtare në Kosovë;
1.2.19. Kryetaret e Partive Parlamentare;
1.2.20. Ambasadorët e vendeve të huaja të akredituar në Kosovë;
1.2.21. Ambasadoret e Kosovës në krye të detyrës;
1.2.22. Ish Kryeministri;
1.2.23. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese;
1.2.24. Kryetarët e komisioneve parlamentare;
1.2.25. Kryetaret e grupeve parlamentare;
1.2.26. Gjyqtarët e Gjykatës Supreme;
1.2.27. Avokati i popullit;
1.2.28. Auditori i Përgjithshëm i Kosovës;
1.2.29. Shefat e Kabinetit të Presidentit, Kryeministrit dhe Kryetarit të Kuvendit;
1.2.30. Këshilltarët e lartë politikë të Presidentit, Kryeministrit dhe Kryetarit të Kuvendit;
1.2.31. Udhëheqësit e bashkësive fetare në Kosovë;
1.2.32. Zëvendësministrat;
1.2.33. Sekretarët e Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit, Presidencës dhe Kuvendit;
1.2.34. Të ngarkuarit me Punë të vendeve të huaja të akredituara në Kosovë;

1.3. **Grupi III**

1.3.1. Kryetaret e partive jo parlamentare;
1.3.2. Zv. Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës;
1.3.3. Gjeneralët e Forcës së Sigurisë së Kosovës;
1.3.4. Gjeneralët e Policisë së Kosovës;
1.3.5. Zëvendësdrejtori dhe Inspektori i përgjithshëm i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;
1.3.6. Këshilltarët e lartë politikë të Ministrave;
1.3.7. Udhëheqësit e Agjencive të Pavarura;
1.3.8. Udhëheqësit e Institucioneve të Pavarura;
1.3.9. Sekretaret e përgjithshëm të Ministrive dhe pozicionet e barasvlershme me ta;
1.3.10. Drejtoret e Zyrës së Kryeministrit, Presidencës dhe Kuvendit;
1.3.11. Përfaqësues të familjeve të heronjve të Kosovës;

1.3.12. Përfaqësues të shquar të letërsisë, artit, shkencës dhe shoqërisë civile;
1.3.13. Kryetari i shoqatës se veteraneve te luftës,
1.3.14. Kryetarë të Gjykatave;
1.3.15. Drejtori i Zyrës së Protokollit të Shtetit.

Neni 13

Nenit 43 të ligjit në fuqi i shtohet një paragraf i ri si vijon:
2. Kryeqyteti ka status special nga qytetet tjera.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-235
28 tetor 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-065-2010, datë 09.11.2010 nga u.d. Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 89 / 30 NËNTOR 2010

LIGJI Nr. 03/L-064
PËR FESTAT ZYRTARE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe me qëllim të përcaktimit të festave zyrtare në Republikën e Kosovës,

Miraton këtë

LIGJ PËR FESTAT ZYRTARE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Neni 1
Qëllimi

Me këtë ligj përcaktohen festat zyrtare në Republikën e Kosovës.

Neni 2
Festat zyrtare në Republikën e Kosovës

2.1. Duke pasur parasysh respektimin e historisë, kulturës dhe të traditave, të popullit të Kosovës dhe të shtetasve të saj, festa zyrtare në Republikën e Kosovës janë:
   a) Viti i Ri-1 dhe 2 janari;
   b) Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, 17 Shkurti;
   c) Dita e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, 9 Prilli;
   d) Dita Ndërkombëtare e Punës, 1 Maji;
   e) Dita e Evropës, 9 Maji;
   f) Bajrami i Madh, dita e parë;
   g) Bajrami i Vogël, dita e parë;
   h) Krishtlindjet Katolike, 25 dhjetor;
   i) Krishtlindjet Ortodokse, 7 janar;
   j) Pashkët Katolike, E hëna e Pashkëve;
   k) Pashkët Ortodokse, E hëna e Pashkëve.

Neni 3

3.1. Ditët e festave zyrtare të cekura në nenin 2 të këtij ligji janë ditë të lira me pagesë për të gjithë punëtorët e Kosovës, përveç kur është e rregulluar ndryshe me ligje tjera.
3.2. Një ditë pune gjatë festave zyrtare kompensohet me një ditë e gjysmë pushimi ose në kundërvlerë në para.

Neni 4

Kur ditët e festave zyrtare të cekura në nenin 2 të këtij ligji bien ditën e shtunë ose të diel, ditë pushimi do të jenë ditët pasardhëse të punës.

Neni 5
Komisioni Republikan i Festave

5.1. Qeveria e Republikës së Kosovës, themelon Komisionin Republikan të Festave, përbërja e të cilit pasqyron diversitetin e shoqërisë kosovare.
5.2. Komisioni Republikan i Festave do të përgatitë rregullat dhe mënyrat e festimit të festave zyrtare si dhe ditët memoriale.
5.3. Komisioni Republikan i Festave Zyrtare, më së largu gjer në fundin e muajit tetor të vitit vijues, nxjerr Kalendarin e festave zyrtare dhe ditët memoriale, për vitin që vjen, duke u bazuar në këtë ligj.
5.4. Festat e reja zyrtare mund të përcaktohen me plotësimin dhe ndryshimin e këtij ligji.
5.5. "Ditët memoriale janë:
   a) 28 Nëntori, dita e shqiptareve;
   b) 12 Qershori, dita e paqes;
   c) 6 Marsi, dita e Përkujtimit dhe e Respektit për Veteranet;
   d) 23 Prilli, dita e turqve;
   e) 8 Prilli, dita e romeve;
   f) 15 Shkurti, dita e ashkalinjëve;
   g) 28 Shtatori, dita e boshnjakeve;
   h) 6 Maji, dita e goranëve.

Ditët tjera memoriale përcaktohen nga Qeveria e Republikës se Kosovës në konsultim me Presidentin e Republikës së Kosovës, nga të cilat dy ditë në konsultim me komunitetin serb të Kosovës.

Neni 6

Qeveria e Republikës së Kosovës përcakton institucionet publike dhe ato private si dhe shërbimet e tjera publike, që janë të obliguara të punojnë në ditët e festave zyrtare të Kosovës.

Neni 7

Kuvendet komunale mund të përcaktojnë ditët e komunave të tyre si dhe ditët memoriale të komunave në harmoni me këtë ligj.

Neni 8

Qeveria e Republikës së Kosovës nxjerr aktet përkatëse nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-064
23 Maj 2008

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III / Nr. 30 / 15 QERSHOR 2008

LIGJI Nr. 03/L-089
LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR KUFIJTË ADMINISTRATIV KOMUNAL, LIGJIT PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT, LIGJIT PËR ARSIMIN NË KOMUNAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, LIGJIT PËR FESTAT ZYRTARE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, LIGJIT PËR AGJENCINË E KOSOVËS PËR INTELIGJENCË, LIGJIT PËR AZIL DHE LIGJIT PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR DHE KONTROLLIN E KUFIRIT SHTETËROR

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton këtë

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR KUFIJTË ADMINISTRATIV KOMUNAL, LIGJIT PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT, LIGJIT PËR ARSIMIN NË KOMUNAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, LIGJIT PËR FESTAT ZYRTARE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, LIGJIT PËR AGJENCINË E KOSOVËS PËR INTELIGJENCË, LIGJIT PËR AZIL DHE LIGJIT PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR DHE KONTROLLIN E KUFIRIT SHTETËROR

Neni 1
Qëllimi

Nenet në vijim,

a) Neni 19 i Ligjit për kufijtë administrativ komunal, nr. 03/L-041,
b) Neni 32 i Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit 03/L-067,
c) Neni 17 i Ligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës 03/L-068,
d) Neni 9 i Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës 03/L-064,
e) Neni 45 i Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë 03/L-063,
f) Neni 73.1 i Ligjit për Azil 03/L-066, dhe
g) Neni 38 i Ligjit për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror ndryshohen si në poshtë:

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-089
13 qershor 2008

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III / Nr. 31 / 15 QERSHOR 2008

LIGJI Nr. 03/L-054
PËR VULA NË INSTITUCIONET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 235
Kreu II: Dispozitat e veçanta 236
Kreu III: Punimi i vulës 238
Kreu IV: Përdorimi dhe përgjegjësia 239
Kreu V: Sanksionet kundërvajtëse 240
Kreu VI: Dispozitat kalimtare 241

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Duke u bazuar në Nenin 65 pika (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJIN PËR VULA NË INSTITUCIONET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është rregullimi dhe përcaktimi i formës dhe përmbajtjes së vulës, procedurës për mënyrën e punimit, përdorimit, ruajtjes si dhe përgjegjësia për përdorimin e vulës në institucionet e Republikës së Kosovës.

Neni 2
Përkufizimet

Për qëllimet të këtij ligji, shprehjet dhe shkurtesat e përdorura më poshtë kanë kuptimet si në vijim:
"Institucion"- nënkupton organet e pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor të nivelit qendror dhe të nivelit lokal dhe organet në varësi të tyre;
"Ministria"- nënkupton Ministrinë e Shërbimeve Publike, apo Ministrinë kompetente për administratë publike.
"Komisioni" - nënkupton komisionin e emëruar nga udhëheqësi i institucionit i cili zhvillon procedurën për marrjen e lejes për vulë, porositjen e vulës te vulëpunuesi, mbikëqyrjen e punës së vulëpunuesit, arkivimin e vulës, shpalljen e pavlefshme të vulës dhe veprime të tjera të parapara me dispozitat e këtij ligji.

Neni 3

3.1. Sipas kërkesës së institucionit përkatës, Ministria lejon pajisjen me vulë.
3.2. Leja ose refuzimi i kërkesës për pajisjen me vulë jepet në afat prej tri ditë pune.
3.3. Ministria mban evidencën për lejet e dhëna.
3.4. Institucioni duhet të ketë vetëm një vulë dhe në rastet të veçanta mund të ketë edhe një vulë të vogël.
3.5. Institucionit i lejohet të ketë më shumë ekzemplarë të vulave, nëse ushtron veprimtarinë e tij në më shumë se në një ndërtesë dhe nëse është e arsyeshme sipas kërkesave të punës.
3.6. Nëse ka më shumë ekzemplarë të vulës, atëherë secili ekzemplar shënohet me numrin rendor romak, i cili vihet në mes të stemës së Kosovës dhe emërtimit të selisë së institucionit.

Neni 4

4.1. Vula e institucionit shërben për të vërtetuar aktin autentik zyrtar, të cilin e lëshojnë institucionet.
4.2. Me vulë vulosen vetëm ato akte, dokumente dhe shkresa, që janë nënshkruar nga personi i autorizuar.
4.3. Vula vihet në anën e majtë të nënshkrimit të personit të autorizuar për nënshkrim, ashtu që do të mbulojë afërsisht një të katërtën (1/4) e nënshkrimit.

KREU II
DISPOZITAT E VEÇANTA

Neni 5

5.1. Vula e institucionit ka këtë formë dhe madhësi:
a) vula ka formë rrethore,
b) madhësia e vulës është me diametër prej 40 mm, 50 mm dhe 60 mm.
5.2. Madhësia e vulës përcaktohet sipas gjatësisë së tekstit dhe numrit të gjuhëve, të cilat duhet t'i përmbajë vula.
5.3. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, në se me dispozitat e veçanta ligjore në fuqi është paraparë përdorimi i vulës me formë, madhësi dhe përmbajtje tjetër nga ajo e përcaktuar me këtë ligj, institucioni apo njësia organizative mund të pajiset edhe me atë vulë duke respektuar dispozitat e tjera të këtij ligji.

Neni 6

6.1. Vula e institucionit ka më shumë rrathë koncentrikë dhe përmban këto të dhëna:
a) në rrethin e parë të jashtëm shkruhet: Republika e Kosovës,
b) në rrathët e tjerë shkruhet emërtimi i institucionit dhe selia e tij dhe
c) në sipërfaqen e mbetur brenda rrethit më të vogël të vulës vendoset stema e Republikës së Kosovës.
6.2. Teksti i vulës së institucionit shkruhet me shkronja të mëdha të shtypit në madhësi dhe formë të njëjtë në gjuhët zyrtare të Kosovës.

6.3. Teksti i vulës së institucioneve komunale shkruhet me shkronja të mëdha të shtypit në madhësi dhe formë të njëjtë në gjuhët zyrtare të komunave.
6.4. Qeveria e Republikës së Kosovës, në afat prej tre muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerrë aktin nënligjor për zbatimin e këtij neni.

Neni 7

7.1. Institucionet mund të kenë vulë të vogël për rastet, në të cilat përdorimi i saj do të ishte më i përshtatshëm për vërtetimin e dokumenteve të një madhësie të vogël, por diametri i saj nuk mund të jetë më i vogël se 20 mm.
7.2. Përmbajtja dhe forma e vulës së vogël është e njëjtë me vulën e paraparë në nenin 5 dhe 6 të këtij ligji, mirëpo emërtimi i institucionit mund të jetë i shkurtuar, por vetëm në atë masë që të shihet se e kujt është vula.

Neni 8

8.1. Institucionet kanë vulë katrore, e cila përdoret për protokollimin e shkresave.
8.2. Si rregull vula katrore ka dimensionin 35 mm. me 70mm., por sipas nevojës mund të ketë edhe dimensione tjera.
8.3. Vula katrore përmban këto të dhëna sipas renditjes:
a) në pjesën e epërme të vulës vihet stema e Republikës së Kosovës,
b) Republika e Kosovës,
c) emërtimi i institucionit, i shkruar me shkronja të mëdha të shtypit,
d) emërtimi i njësisë organizative të institucionit,
e) numri i protokollit i njësisë organizative, në vazhdim lehet hapësira për shënimin e numrit të protokollit të shkresës,
f) hapësira ku do të shënohet numri i faqeve të bashkangjitura,
g) hapësira ku do të shënohet dita, muaji dhe viti dhe
h) vendi i selisë së institucionit.
8.4. Me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria, në afat prej tre muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, caktohen forma e vulës katrore dhe parametrat teknikë të ngjyrës.

Neni 9

9.1. Komunat e Kosovës përdorin vulën me stemën e tyre në ato akte për të cilat nuk janë të obliguara të vendosin stemën e Kosovës, sipas dispozitave të Ligjit për përdorimin e Simboleve Shtetërore të Kosovës.
9.2. Vulat e komunave duhet të jenë në pajtim me dispozitat e këtij ligji, përjashtimisht përdorimit të stemës së tyre sipas paragrafit një të këtij neni.

Neni 10

10.1. Vula është prej gome, metali apo plastike.
10.2. Ngjyra e vulës është e kaltër.
10.3. Me akt nënligjor, të nxjerrë nga Ministria, në afat prej tre muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, caktohen lloji, nuanca dhe parametrat teknikë të ngjyrës.

Neni 11

11.1. Udhëheqësi i institucionit emëron, me vendim, komisionin prej tre anëtarëve, i cili zhvillon procedurën për marrjen e lejes për vulë, porositjen e vulës te vulëpunuesi, mbikëqyrjen e punës së vulëpunuesit, arkivimin e vulës, shpalljen e pavlefshme të vulës dhe veprime të tjera të parapara me dispozitat e këtij ligji.
11.2. Për çdo veprim, komisioni harton procesverbal.

Neni 12

12.1. Në rastet kur ndryshohet emërtimi i institucionit apo për arsye të tjera vula nuk është për përdorim, ajo dërgohet në arkivin kompetent për ruajtje, në pajtim me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në Ligjin Nr. 2003/7 për lëndën arkivore dhe arkivat (shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/20.
12.2. Arkivi është përgjegjës për sigurinë dhe ruajtjen e vulës së pranuar.
12.3. Komisioni për vulë lidhur me arkivimin e vulës përpilon procesverbalin në tri kopje identike, prej të cilave nga një kopje iu dërgohet Ministrisë dhe arkivit, ndërsa një kopje e mban në arkivin e institucionit.

Neni 13

13.1. Institucioni përdorues i vulës është përgjegjës për autorësinë dhe vërtetësinë e dokumenteve, në të cilat vihet vula.
13.2. Çdo institucion përdorues i vulës është i detyruar të mbajë evidencë për vulat që i ka në përdorim.
13.3. Ministria e Punëve të Jashtme ndërmerr të gjitha veprimet për njoftimin e subjekteve të jashtme të rëndësishme, lidhur me vulat zyrtare në komunikim me jashtë.

KREU III
PUNIMI I VULËS

Neni 14

14.1. Vula e institucionit, punohet nga vulëpunuesi i caktuar nga institucioni.
14.2. Vulëpunuesi duhet të ketë të regjistruar veprimtarinë e tij, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi për regjistrimin e bizneseve.

Neni 15

15.1. Vulëpunuesi i vulës obligohet që pas përfundimit të punimit të vulës, nën mbikëqyrjen e komisionit t'i kthejë ose t'i asgjësojë të gjitha modelet, kallëpet si dhe të gjitha gjurmët e tjera, të cilat kanë mbetur gjatë procesit të punimit të vulës.
15.2. Komisioni, për veprimet e parapara me paragrafin një të këtij neni, mban procesverbal në tri kopje identike, të cilin e nënshkruan edhe vulëpunuesi, prej

të cilave një kopje i dërgohet Ministrisë, një kopje vulëpunuesit, ndërsa një kopje e mban institucioni në arkivin e tij.

Neni 16

Vulëpunuesi i autorizuar për punimin e vulës mban përgjegjësi të plotë juridike për vulën, nga momenti i pranimit të porosisë së punimit të vulës e deri në momentin e dorëzimit të saj komisionit të institucionit.

Neni 17

Vulëpunuesi është i detyruar të mbajë evidencë me shkrim për vulat e punuara.

Neni 18

Vulëpunuesi është i detyruar të punojë vulën, vetëm sipas porosisë së dhënë, në të kundërtën i merret autorizimi.

KREU IV
PËRDORIMI DHE PËRGJEGJËSIA

Neni 19

19.1. Udhëheqësi i institucionit, pas pranimit të vulës nga komisioni, nxjerr vendim për datën e fillimit të përdorimit të vulës.
19.2. Udhëheqësi i institucionit autorizon me shkrim personin përgjegjës, i cili do të përdorë vulën.
19.3. Personi përgjegjës për përdorimin e vulës është i detyruar të mbajë evidencë të plotë dhe të saktë, si dhe një kopje të dokumentit të vulosur.
19.4. Vula e institucionit përdoret vetëm brenda selisë së institucionit, përjashtimisht edhe jashtë selisë, por me leje të veçantë të udhëheqësit më të lartë të institucionit.

Neni 20

Personi përgjegjës mban përgjegjësi për përdorimin e vulës dhe është i detyruar të ruajë vulën, nga shfrytëzimi i paautorizuar i saj.

Neni 21

21.1. Me rastin e humbjes së vulës apo kur vula bëhet e papërdorshme, lajmërohet menjëherë udhëheqësi i institucionit dhe dhënësi i lejes për pajisje me vulë, në afatin më të shkurtër të mundshëm e jo më larg se 24 orë.
21.2. Menjëherë pas konstatimit të humbjes së vulës ose kur vula nuk është më e përdorshme, me vendim të udhëheqësit të institucionit vula shpallet e pavlefshme.

21.3. Punimi i vulës së re bëhet sipas procedurës së paraparë me këtë ligj dhe përmban numrin rendor romak pasues të vulës së humbur ose të vulës që nuk është në përdorim.

Neni 22

Jashtë orarit të punës dhe kur vula nuk përdoret, ajo ruhet në kasafortë.

Neni 23

Ministria bën mbikëqyrjen e institucioneve për zbatimin e këtij ligji dhe obligon institucionin të veprojë në bazë të dispozitave të këtij ligji.

Neni 24

24.1. Mbikëqyrjen e punës së vulëpunuesit të caktuar për punimin e vulës së institucioneve e bën Ministria e Punëve të Brendshme.
24.2. Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes, Ministria e Punëve të Brendshme mund t'i urdhërojë vulëpunuesit t'i kthejë ose t'i asgjësojë të gjitha modelet, kallëpet si dhe të gjitha gjurmët tjera, të cilat kanë mbetur gjatë procesit të punimit të vulës dhe të përshtatë punën e tij me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat e tjera në fuqi.

KREU V
SANKSIONET KUNDËRVAJTËSE

Neni 25

25.1. Institucioni ndëshkohet me gjobë prej pesëqind (500) deri në pesëmijë (5.000) euro, në këto raste:
   a) nëse e porosit vulën pa marrjen e lejes nga Ministria,
   b) nëse nuk e njofton Ministrinë për humbjen e vulës,
   c) nëse personi i autorizuar për përdorimin e vulës nuk ka vendim me shkrim për përdorimin e saj,
   d) nëse vula nuk ruhet në kasafortë kur nuk është në përdorim,
   e) nëse nuk e shpall të pavlefshme vulën e humbur apo të papërdorshme dhe
   f) nëse vulën e papërdorshme nuk e dërgon në arkiv.
25.2. Personi përgjegjës i institucionit ndëshkohet me gjobë prej dyqind e pesëdhjetë (250) deri në dymijë e pesëqind (2.500) euro për shkeljet e parapara me paragrafin 25.1 të këtij neni.

Neni 26

Vulëpunuesi ndëshkohet, me gjobë në shumën prej pesëqind (500) deri në pesëmijë (5.000) euro, në këto raste:
   a) nëse pa autorizim të institucionit e punon vulën të paraparë me dispozitat e këtij ligji,

b) nëse nuk i kthen ose nuk i asgjëson të gjitha modelet, kallëpet ose mbetjet e tjera gjatë procesit të punimit të vulës dhe
c) nëse vulën ua jep personave të paautorizuar.

Neni 27

Dispozitat ndëshkuese të parapara sipas këtij ligji nuk i eliminon përgjegjësitë të tjera të parapara me dispozita ligjore në fuqi.

Neni 28

Gjobat e parapara sipas dispozitave të këtij ligji derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

KREU VI
DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 29

Institucionet janë të detyruara të përgatitin vulat e tyre sipas dispozitave të këtij ligji në afat prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 30

Ky ligj shfuqizon çdo dispozitë ligjore që rregullon këtë materie.

Neni 31

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-054
30 korrik 2008

Shpallur me dekretin nr. DL-047-2008, datë 07.08.2008 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III / Nr. 38 / 20 SHTATOR 2008

LIGJI Nr. 03/L-190
PËR GAZETËN ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR GAZETËN ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 1
Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Ky ligj rregullon procedurat për publikimin e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës si dhe të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës për Publikimin e Gazetës Zyrtare.
2. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës është i vetmi publikim zyrtar në Republikën e Kosovës ku publikohen ligjet dhe aktet tjera të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:
   1.1. **Gazeta Zyrtare -** Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
   1.2. **Zyra -** Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës që vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.
   1.3. **Publikimi i Gazetës Zyrtare -** publikimi i Gazetës Zyrtare në formë të shtypur (në letër) dhe në formë elektronike (në ueb-faqen e Gazetës Zyrtare).
   1.4. **Ueb-faqja e Gazetës Zyrtare -** faqja elektronike në internet, në të cilën faqe janë të publikuara të gjitha ligjet dhe aktet e tjera juridike të nxjerra nga institucionet e Republikës së Kosovës.
   1.5. **Indeksi i Gazetës Zyrtare -** lista e të gjitha ligjeve dhe akteve nënligjore të publikuara në Gazetën Zyrtare.

Neni 3
Përmbajtja e Gazetës Zyrtare

1. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës përmban:

1.1. Stemën e Republikës së Kosovës;
1.2. emërtimin/ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës;
1.3. numrin rendor;
1.4. vitin e botimit (ditën, muajin dhe vitin);
1.5. vendin e botimit.

2. Emërtimi, viti i botimit, dhe numri i Gazetës Zyrtare duhet të shënohen qartë në të gjitha faqet e Gazetës Zyrtare.

Neni 4
Publikimi i Gazetës Zyrtare

1. Publikimi i Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare) bëhet në formë të shtypur dhe në formë elektronike.
2. Në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, publikohen këto akte:
   2.1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
   2.2. ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe të shpallura nga Presidenti i Republikës së Kosovës;
   2.3. ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në përputhje me paragrafin 4 dhe 5 të nenit 80 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
   2.4. marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
   2.5. vendimet e Gjykatës Kushtetuese;
   2.6. dekretet e Presidentit të Republikës së Kosovës në rastet kur kërkohet nga Presidenti;
   2.7. deklaratat dhe rezolutat e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në rastet kur kërkohet nga Kryetari i Kuvendit.
   2.8. aktet nënligjore të Qeverisë dhe të ministrive në rastet kur kërkohet nga Kryeministri.
   2.9. aktet tjera të përcaktuara me ligje të veçanta.
   2.10. INDEKSI-i vjetor i Gazetës Zyrtare
3. Versionet e publikuara në formë të shtypur në Gazetën Zyrtare dhe ato të publikuara në formë elektronike janë të njëjta.

Neni 5
Gjuha

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës publikohet në gjuhën shqipe, në gjuhën serbe, në gjuhën turke, në gjuhën boshnjake dhe në atë angleze.

Neni 6
Dërgimi i akteve juridike në Zyrën për publikimin e Gazetës Zyrtare

1. Aktet juridike të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji, publikohen në Gazetën Zyrtare, vetëm atëherë kur akti i tillë, versioni përfundimtar në origjinal, i nënshkruar, vjen në Zyrën për publikimin e Gazetës Zyrtare me kërkesën e organit, i cili e ka nxjerrë aktin e tillë juridik.

2. Të gjitha institucionet janë të detyruara që aktet juridike, të cilat duhet t'i publikojnë në Gazetën Zyrtare, t'i dërgojnë në Zyrën për publikimin e Gazetës Zyrtare në formë të shtypur dhe në formë elektronike.

Neni 7
Detyrimet e institucioneve të cilat i publikojnë aktet e tyre në Gazetën Zyrtare

1. Dërgimi i akteve juridike, të nxjerra nga Presidenti i Republikës së Kosovës, për publikim në Gazetën Zyrtare, bëhet nga Sekretari i Zyrës së Presidentit apo personi i autorizuar nga ai.
2. Dërgimi i ligjeve dhe akteve të tjera juridike të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për publikim në Gazetën Zyrtare, bëhet nga Sekretari i Kuvendit apo personi i autorizuar nga ai.
3. Dërgimi i akteve juridike të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për publikim në Gazetën Zyrtare, bëhet nga Sekretari i Përhershëm apo personi i autorizuar nga ai.
4. Dërgimi i akteve juridike të ministrive, për publikim në Gazetën Zyrtare, bëhet nga Sekretari i Përhershëm apo personi i autorizuar nga ai.
5. Dërgimi i marrëveshjeve të ndryshme, për publikim në Gazetën Zyrtare, bëhet nga organi apo institucioni që është i autorizuar për të lidh atë marrëveshje.
6. Dërgimin e akteve tjera juridike për publikim në Gazetën Zyrtare, e bënë titullari i institucionit, organit apo organizatës që ka nxjerrë aktin.
7. Titullari i Institucionit është përgjegjës për dërgimin e aktit përfundimtar për publikim në Gazetën Zyrtare.
8. Të gjitha institucionet janë të detyruara që aktet juridike brenda afatit kohor 5 (pesë) ditor, nga dita e nxjerrjes, t'i dërgojnë në Zyrën për publikimin e gazetës zyrtare.
9. Organi apo institucioni, i cili ka dërguar aktin juridik ose dokumentin për publikim, mban përgjegjësi për pasaktësi, parregullsi, gabime në përmbajtjen e aktit juridik, mospërputhshmëri në përkthimin e akteve apo dokumentit, ose pengesë ligjore për publikim.

Neni 8
Publikimi i akteve juridike të institucioneve ndërkombëtare

1. Aktet juridike të institucioneve ndërkombëtare që veprojnë në Republikën e Kosovës publikohen në Gazetën Zyrtare përmes Kryeministrit.
2. Institucionet ndërkombëtare sigurojnë që aktin juridik të cilin e procedojnë për publikim në Gazetën Zyrtare të jetë versioni përfundimtar, ashtu siç përcaktohet më dispozitat e këtij ligji.
3. Kryeministri nxjerrë vendim lidhur me procedurat e publikimit të akteve juridike të institucioneve ndërkombëtare.

Neni 9
Të drejtat e institucioneve të cilat i publikojnë aktet e tyre në Gazetën Zyrtare

1. Institucionet vendore kanë të drejtë të kërkojnë nga Zyra për publikimin e gazetës zyrtare që aktet e tyre juridike, versionet përfundimtare, të publikohen me kohë në

Gazetën Zyrtare, në përputhshmëri të plotë më dispozitat e përcaktuara me këtë ligj.

2. Institucionet vendore kanë të drejtë të kërkojnë sqarime nga Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare lidhur më vonesën eventuale të publikimit të aktit juridik në Gazetën Zyrtare.

Neni 10
Përgjegjësitë e Zyrës për Publikimin e Gazetës Zyrtare

1. Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare është përgjegjëse për:
   1.1. publikimin e akteve juridike, të cilat dërgohen në Zyrën për Publikimin e Gazetës Zyrtare, në formë të shtypur dhe në formë elektronike, e të cilat akte i plotësojnë kushtet e përcaktuara më këtë ligj;
   1.2. mbajtjen apo ruajtjen e fshehtësisë apo sekretit zyrtar, të të dhënave të ligjeve dhe akteve tjera deri sa ato nuk publikohen në Gazetën Zyrtare në formë të shtypur dhe në formë elektronike.
   1.3. redaktimin teknik të versioneve përfundimtare të cilat publikohen në Gazetën Zyrtare në formë të shtypur dhe elektronike;
   1.4. publikimin e saktë dhe më kohë të akteve juridike në Gazetën Zyrtare në formë të shtypur dhe në formë elektronike;
   1.5. mbikëqyrjen e punëve në mënyrë të vazhdueshme, të cilat kanë të bëjnë më publikimin e saktë dhe me kohë të akteve në Gazetën Zyrtare, në formë të shtypur dhe në formë elektronike;
   1.6. koordinimin e punëve me operatorin ekonomik i cili e bën botimin e Gazetës Zyrtare;
   1.7. koordinimin e punëve me operatorin ekonomik i cili e bën shpërndarjen e Gazetës Zyrtare;
   1.8. koordinimin e punëve me palët tjera me interes dhe donatorët e ndryshëm në bashkëpunim me Kryeministrin;
   1.9. bashkëpunimin me institucionet kompetente shtetërore në sigurimin e ueb-faqes së Gazetës Zyrtare nga keqpërdoruesit e mundshëm dhe mirëmbajtjen e kësaj ueb-faqe;
   1.10. hartimin e planit afatgjatë strategjik të punës dhe aktiviteteve të zyrës;
   1.11. përgatitjen e raportit vjetor të punës dhe prezantimin e këtij raporti Kryeministrit.
2. Formati, kriteret teknike, procedurat e përgatitjes, autorizimi i botimit, tirazhi i kopjeve në gjuhët e ndryshme të gazetës zyrtare, mënyra e vënies në qarkullim dhe shpërndarja e ekzemplarëve të Gazetës Zyrtare, si dhe rregullat për përgatitjen dhe publikimin e akteve në Zyrën për Publikim, përcaktohen me udhëzim administrativ të nxjerrë nga Kryeministri dhe të propozuar nga Drejtori i Zyrës për Publikim të Gazetës Zyrtare.
3. Gazeta Zyrtare dërgohet për publikim me miratimin dhe nën përgjegjësinë e Drejtorit të Zyrës për Publikimin e Gazetës Zyrtare, e në mungesë të tij, nga i autorizuari i tij.
4. Drejtori i Zyrës për Publikimin e Gazetës Zyrtare, kujdeset për pranimin e akteve nga institucionet dhe për publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare në formë të shtypur dhe elektronike.

Neni 11
Të drejtat e Zyrës për Publikimin e Gazetës Zyrtare

1. Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare ka këto të drejta:
   1.1. të publikojë Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në formë të shtypur dhe në formë elektronike.
   1.2. të ripublikojë Gazetën Zyrtare në formë të shtypur sipas kërkesave dhe nevojave të institucioneve dhe të qytetarëve;
   1.3. të lidh Memorandum Mirëkuptimi me institucione të ndryshme për parapagimin e Gazetës Zyrtare me pëlqimin e institucionit mbikëqyrës;
   1.4. të lidh marrëveshje të ndryshme më të gjitha institucionet vendore e ndërkombëtare, që kanë për qëllim përmbushjen e detyrave dhe misionit të Zyrës për publikim me pëlqimin e institucionit mbikëqyrës;
   1.5. të kërkojë nga operatoret ekonomik ti kryejnë shërbimet e caktuara më kohë dhe në cilësi ashtu siç e parasheh kontrata.
   1.6. të bëjë padi ndaj të gjitha palëve kontraktuese të cilat nuk i përmbushin obligimet e tyre ndaj Gazetës Zyrtare.
   1.7. Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare do ta ketë vulën e vet zyrtare, vulën e rrumbullakët dhe vulën e protokollit në pajtim me ligjin.

Neni 12
Publikimi

1. Gazeta Zyrtare publikohet rregullisht sipas nevojës në formë të shtypur dhe në formë elektronike, në gjuhët e përcaktuara me këtë ligj, por jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga paraqitja për publikimin e akteve të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji.
2. Gazeta Zyrtare publikohet në formë të shtypur dhe elektronike, sipas nevojave urgjente të institucioneve të Republikës së Kosovës.
3. Publikimet e veçanta të Gazetës Zyrtare në formë të shtypur dhe në formë elektronike bëhen sipas kërkesës nga ana e Kryeministrit.
4. Gazeta Zyrtare botohet nga shtypshkronja e kualifikuar dhe e zgjedhur në pajtim me rregullat për prokurim publik të Republikës së Kosovës.
5. Ripublikimi i Gazetës Zyrtare në formë të shtypur dhe në formë elektronike nga kushdo tjetër, është i ndaluar.
6. Të gjithë shfrytëzuesit e materialeve të Gazetës Zyrtare duhet të cekin emrin, numrin dhe vitin e botimit të Gazetës Zyrtare.

Neni 13
Çmimi dhe shpërndarja e Gazetës Zyrtare

1. Çmimi i Gazetës Zyrtare përcaktohet me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me propozimin e Zyrës për Publikimin e Gazetës Zyrtare.
2. Me propozim të Zyrës për Publikimin e Gazetës Zyrtare, Qeveria e Republikës së Kosovës nxjerr vendim për përcaktimin e subjekteve përfituese dhe numrin e ekzemplarëve të Gazetës Zyrtare që do të shpërndahen falas.

3. Gazeta Zyrtare në formë elektronike publikohet në të njëjtën ditë kur këto akte juridike publikohen edhe në formën e shtypur në Gazetën Zyrtare.
4. Gazeta Zyrtare në formë elektronike do të jetë në dispozicion falas për qytetarët.
5. Shpërndarjen e ekzemplarëve të Gazetës Zyrtare e bën operatori ekonomik i kualifikuar dhe i zgjedhur në pajtim me rregullat e prokurimit publik të Republikës së Kosovës.

Neni 14
Financimi

1. Financimi i Gazetës Zyrtare bëhet nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe nga donatorët.
2. Të gjitha institucionet të cilat lidhin Memorandum Mirëkuptimi me Zyrën për Publikimin e Gazetës Zyrtare janë të obliguara, të bëjnë pagesën e ekzemplarëve të Gazetës Zyrtare, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga momenti i pranimit të faturës ashtu siç e përcakton Ligji për Menaxhimin e Financave Publike.
3. Mjetet e realizuara nga Zyra për Publikim, do të derdhen në Buxhetin e Kosovës.

Neni 15
Ankesat

1. Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare pranon ankesat lidhur me gabimet dhe defektet që kanë të bëjnë me publikimin e akteve juridike në Gazetën Zyrtare, qoftë në formë të shtypur apo në formë elektronike.
2. Afatet dhe masat adekuate në lidhje me ankesat për Gazetën Zyrtare do të rregullohen me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Qeveria.

Neni 16
Zbatimi

Me propozim të Zyrës për Publikimin e Gazetës Zyrtare, Qeveria e Kosovës nxjerr akte përkatëse juridike për zbatimin e këtij ligji, brenda gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 17
Shndërrimi

Zyra për Menaxhimin dhe Administrimin e Gazetës Zyrtare të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, shndërrohet në Zyrën për Publikimin e Gazetës Zyrtare dhe merr të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë e kësaj zyre.

Neni 18
Shfuqizimi i akteve ligjore

Ky ligj shfuqizon Ligjin nr. 2004/47 për Gazetën Zyrtare të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë dhe të gjitha aktet tjera juridike, që rregullojnë çështjen e publikimit të Gazetës Zyrtare.

Neni 19
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-190
4 qershor 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-023-2010, datë 28.06.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 74 / 20 KORRIK 2010

LIGJI Nr. 03/L-176
PËR HETIM PARLAMENTAR

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 249
Kreu II: Dispozitat themelore 250
Kreu III: Organizimi dhe funksionimi i komisionit hetimor 252
Kreu IV: Kryerja e hetimeve parlamentare 253
Kreu V: Raporti për kuvendin 257
Kreu VI: Dispozitat e tjera 257

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR HETIM PARLAMENTAR

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është të rregulloj funksionimin e Komisionit hetimor duke përcaktuar strukturën organizative, veprimtarinë, kompetencat dhe përgjegjësit e Komisionit hetimor.

Neni 2
Fusha e veprimit

1. Fusha e veprimit të Komisionit duhet të jetë në pajtim me kushtetutën dhe dispozitat ligjore të së drejtës ndërkombëtare, duke mos e cenuar pavarësinë dhe duke mos e penguar veprimtarinë e organeve të tjera.
2. Komisioni i themelohet për të hetuar probleme çështje ku janë drejt për së drejti të përfshira përgjegjësit qeveritare apo shtetërore.
3. Komisioni themelohet me qëllim të konstatimit, përshkrimit të rrjedhës së ngjarjeve me qëllim të qartësimit të asaj se çfarë ka ndodhur dhe të përcaktimit të përgjegjësisë së atyre që kanë qenë të involvuar.
4. Komisioni themelohet me qëllim të informimit, rekomandimit, ushtrimit të mbikëqyrjes parlamentare dhe të arritjes së një përfundimi.

5. Komisioni themelohet dhe funksionon mbi bazën e parimeve kushtetuese dhe rregullave të përcaktuara me këtë ligj.
6. Komisioni përgatitë raportin përfundimtar lidhur me hetimet brenda afatit të caktuar nga Kuvendi dhe në pajtim me ligjin.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:
   1.1. **Ditë** – ditët kalendarike.
   1.2. **Komisioni**- Komisioni parlamentar hetimor që themelohet nga Kuvendi i Kosovës.
   1.3. **KPPK** - Kodi i Procedurës Penale të Kosovës.
   1.4. **KPK** – Kodi Penal i Kosovës.
   1.5. **Personeli i Kuvendit** - stafi civil i Kuvendit të Kosovës.
   1.6. **Hetimi parlamentar** - veprime procedurale që ndërmerren nga Komisioni për të ndriçuar një rast apo një çështje të caktuar, pa pasur të pandehur dhe pa ngritur aktakuzë.
   1.7. **Provë** - çdo e dhënë, dëshmi, dokument apo fakt që i kontribuon nxjerrjes së konkluzioneve të hetimit.
   1.8. **Pyetje të palejueshme** - pyetje të cilat sipas KPP-se nuk janë të lejuara të shtrohen ose në të cilat mund të refuzohet përgjigjja.
   1.9. **Propozuesi -** Komisioni ose grupi i deputeteve qe propozojnë inicimin e Komisionit hetimor.

KREU II
DISPOZITAT THEMELORE

THEMELIMI I KOMISIONEVE HETIMORE

Neni 4
Procedura për ngritjen e Komisionit hetimor parlamentar

1. Të drejtën për të iniciuar procedurën për themelimin e Komisionit e kanë gjashtë (6) deputet, një Komision i përhershëm parlamentar dhe një e treta (1/3) e anëtarëve të Kuvendit.
2. Propozimi për themelimin e Komisionit i dorëzohet Kryesisë se Kuvendit me shkrim dhe duhet të përmbaj çështjen e cila do të hetohet, arsyetimin, nënshkrimin e grupit nismëtar, propozimin për numrin e anëtarëve të Komisionit dhe afatin kohorë brenda të cilit duhet të mbaroj mandati i Komisionit i cili nuk mund të jetë me i gjatë se gjashtë (6) muaj.
3. Në rastet kur kërkesa për themelimin e Komisionit parashtrohet nga një e treta (1/3) e deputetëve, Kuvendi detyrimisht në seancë plenare themelon Komisionin për çështjen e kërkuar.
4. Në rastet e iniciativës nga një Komision i përhershëm parlamentar ose grup deputetesh qe përbejnë me pak se një e treta (1/3) e anëtareve te Kuvendit,

Kuvendi mund të vendose me shumicë të thjeshtë të votave për ngritjen e Komisionit.

5. Komisioni nuk mund të themelohet gjatë gjashtë (6) muajve të fundit të një mandati të Kuvendit.

Neni 5
Pushimi i punës së Komisionit

1. Kuvendi vendose për pushimin e punës se Komisionit para përfundimit të mandatit të tij vetëm me kërkesën e propozuesit dhe me shumicë të votave të të gjithë deputetëve.
2. Ne rastet kur Kuvendi shpërndahet para përfundimit të mandatit të rregullt, Komisioni gjithashtu do të pushoj se ekzistuari.
3. Çështjet qe kane qenë një herë objekt i hetimit parlamentar në njërën nga legjislaturat e Kuvendit, nuk mund të jenë objekt i hetimit parlamentar, përveç rastit të paraparë në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 6
Mandati i Komisionit

1. Çështja e cila është përcaktuar për hetim parlamentar me vendim nga Kuvendi mund të ndryshohet ose zgjerohet me vendim të Kuvendit me vone, nëse propozuesi për inicimin e Komisionit është pajtuar me ndryshimin.
2. Komisioni është i obliguar ti përmbahet mandatit të tij të dhënë nga Kuvendi. Ndryshimi ose zgjerimi i mëvonshëm i mandatit mund të behet vetëm në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni.
3. Mandati për hetimin e një çështje është gjashtë (6) muaj brenda të cilit Komisioni duhet të paraqet raport përfundimtar.

Neni 7
Detyrimet e organeve të Kuvendit

1. Kryetari i Kuvendit, jo më vone se shtatë (7) ditë nga data e marrjes së kërkesës për ngritjen e Komisionit thërret Kryesinë e Kuvendit për ta diskutuar nismën.
2. Pavarësisht nga propozimi i nismëtarëve lidhur me numrin e anëtarëve të Komisionit, Kryesia e Kuvendit para themelimit te Komisionit mund t'i propozojë Kuvendit zgjerimin ose zvogëlimin e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Komisionit.
3. Kryesia i propozon Kuvendit përbërjen e Komisionit në bazë të nominimeve të grupeve parlamentare për anëtarë të Komisionit. Në rast se një Grup Parlamentar nuk i përgjigjet kërkesës së Kryesisë me kohë, kryesia i propozon Kuvendit përbërjen nga nominimet e bëra nga grupet parlamentare dhe pozitat e pa nominuara mbeten të zbrazta.
4. Kryesia e Kuvendit radhitë kërkesën për ngritjen e Komisionit në rend te ditës jo me vonë se tri (3) javë kalendarike pas datës së paraqitjes se kërkesës nga propozuesi. Ne rast se kryesia nuk arrin ta radhitë kërkesën ne afatin e

lartpërmendur, kërkesa e inicuesit shqyrtohet pa propozimin e kryesisë ne mbledhjen e parë të radhës se Kuvendit.

KREU III
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT HETIMOR

Neni 8
Përbërja e Komisionit

1. Anëtarë të Komisionit mund të jenë vetëm deputetët e Kuvendit të Kosovës.
2. Komisioni përbehet nga jo me pak se shtatë (7) dhe jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) anëtarë. Numri i anëtarëve të Komisionit duhet të jetë gjithnjë tek.
3. Çdo Grup Parlamentar i Kuvendit përfaqësohet në Komision me se paku një (1) anëtar.
4. Në parim, gjatë përcaktimit të përbërjes së Komisionit duhet të merret parasysh proporcioni i përfaqësimit të grupeve parlamentare në Kuvend. Megjithatë Komisioni duhet te përbëhet nga deputetët e partive të pozitës dhe opozitës, në raporte sa më të përafërta përfaqësimi. Diferenca e anëtarëve te përgjithshëm në raport pozitë opozitë në Kuvend nuk mund të jetë me shume se një (1) anëtar i Komisionit.

Neni 9
Largimi nga Komisioni Hetimor

1. Anëtari i Komisionit mund të largohet nga Komisioni vetëm me iniciativën e tij në çdo kohë, përveç në periudhën pas përfundimit të procedurës së hetimeve dhe fillimit të shqyrtimit të rezultateve nga Komisioni.
2. Komisioni vendosë detyrimisht për largimin e një anëtari të Komisionit, nëse ai mungon tri (3) herë radhazi në punimet e Komisionit pa arsye të përligjshme.
3. Ne rast largimi të një anëtari të Komisionit, kryetari i Komisionit informon menjëherë Kryesinë e Kuvendit për largimin e anëtarit të Komisionit.
4. Anëtarët e larguar të Komisionit duhen të zëvendësohen nga grupimi politik që ata përfaqësojnë, përveç rasteve kur konstatohet se anëtari pa arsye pengon punën e Komisionit.
5. Kuvendi në seancën e ardhshme vendosë për emërimin e anëtarit të ri të Komisionit.

Neni 10
Kryesuesi i Komisionit

1. Kryesuesi i Komisionit emërohet nga Kuvendi me rastin e themelimit te Komisionit. Kryesuesi zgjidhet nga radhët e njërit grup parlamentar i cili nuk është iniciator i Komisionit hetimor dhe nuk i përket partisë së koalicionit qeverisës. Zëvendës kryesuesi emërohet nga Kuvendi me propozim te iniciatorit ose grupit iniciator te Komisionit.
2. Kryesuesi i Komisionit udhëheq punën e Komisionit në përputhje me këtë ligj dhe

vendimin e Kuvendit për themelimin e Komisionit. Ne mungesë të kryesuesit, detyrat e tij kryhen nga zëvendëskryesuesi.

Neni 11
Mbledhjet e Komisionit

1. Mbledhja e parë Komisionit thirret nga kryesuesi i Komisionit, jo më vonë se katërmbëdhjetë (14) ditë nga data e marrjes së vendimit të Kuvendit për themelimin e Komisionit.
2. Kryesuesi thërret mbledhjet e Komisionit konform planit të punës i cili miratohet nga Komisioni në njërën nga mbledhjet e para të Komisionit.
3. Me kërkesë të një të tretës (1/3) së anëtarëve të Komisionit, kryesuesi detyrimisht thërret mbledhjen e Komisionit për datën e kërkuar nga grupi propozues.
4. Anëtarët e Komisionit dhe stafi mbështetës obligohet të ruajë sekretin lidhur me informata dhe ecurinë e punës së Komisionit.
5. Dispozitat për punën e Komisioneve të përhershme të përcaktuara me Rregulloren e Punës të Kuvendit janë të zbatueshme përshtatshmërish edhe për Komisionin hetimor, përveç rasteve kur ky ligj rregullon ndryshe.

Neni 12
Vendimmarrja

1. Mbledhjet dhe seancat e Komisionit mbahen nëse më shumë se gjysma e anëtarëve të tij është prezent (kuorumi).
2. Komisioni merr vendime me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm.
3. Në rastet kur gjatë mbledhjes konstatohet mungesa së kuorumit kryesuesi ndërpret mbledhjen për një kohë të caktuar. Ne rast se brenda kësaj kohe nuk arrihet kuorumi, kryetari përfundon mbledhjen dhe thërret një mbledhje tjetër për një afat jo më të gjatë se shtatë (7) ditë.
4. Nëse një anëtar i një grupi parlamentar nuk merr pjesë tri (3) herë radhazi pa arsye atëherë Komisioni nga Kuvendi kërkon që anëtari të zëvendësohet, jo detyrimisht nga grupi i njëjtë parlamentar.

KREU IV
KRYERJA E HETIMEVE PARLAMENTARE

Neni 13
Të drejtat e dhe detyrat e Komisionit gjatë fazës së hetimeve

1. Me qëllim të ushtrimit të hetimeve, Komisioni ka të drejtë:
   1.1. ti thërras bartësit e funksioneve publike të dëgjohen para Komisionit;
   1.2. të thërras persona të tjerë fizik dhe juridik të dëgjohen para Komisionit;
   1.3. të thërras persona nga pika a dhe b te japin dëshmi nën betim;
   1.4. te ketë qasje të pakufizuar në të gjitha dokumentet zyrtare;
   1.5. të kërkoj dhe të ngritë prova;
   1.6. të urdhëroj sjelljen e detyrueshme të personave nga nën-paragrafët 1.1., 1.2. dhe 1.3. të këtij paragrafi të thirrur për të jap dëshmi para Komisionit;

1.7. të krijoj një grup hetues nga anëtarët e Komisionit për të zhvilluar hetime të caktuara nga radhët e anëtarëve të Komisionit.

2. Komisioni ka të drejtë të kërkojë ekspertizën e ekspertëve të pavarur gjatë kryerjes së detyrës. Mjetet financiare për këtë ekspertizë sigurohen nga Kuvendi.
3. Puna e Komisionit mbështetet nga personeli i Kuvendit.

Neni 14
Fazat e punës së Komisionit

1. Puna e Komisionit ndahet në tri faza kryesore:
   1.1. faza e hetimeve;
   1.2. vlerësimi i hetimeve;
   1.3. përgatitja e raportit final.

Neni 15
Faza e Hetimeve

1. Komisioni e përpilon dhe e miraton planin e veprimit për çështjen e cila është objekt hetimi.
2. Plani i veprimit përmban veprime procedurale, hetimore dhe afatet kohore që do të ndiqen nga Komisioni për hetimin të çështjes, si dhe rrethin e personave që do dëgjohen dhe që merren si dëshmitarë ose ekspertë.
3. Plani i veprimit mund të ndryshoj gjatë zhvillimit të hetimeve, ne rastet kur ndodhin ngjarje të reja ose dalin prova të reja që lidhen me çështjen që hetohet.
4. Çdo anëtarë i Komisionit mund të propozojë veprime procedurale, ngritje të provave dhe veprime hetimore lidhur me çështjen.

Neni 16
Publiciteti i mbledhjeve të Komisionit

1. Mbledhjet e Komisionit janë publike, përveç rasteve kur parashihet ndryshe me ligj ose me rastet kur Komisioni vendos për seance te mbyllur.
2. Mbledhjet e Komisionit janë detyrimisht te mbyllura kur Komisioni bene vlerësimin e provave te mbledhura dhe me rastin e vendimmarrjes lidhur me to.
3. Komisioni vendos për seance te mbyllur në rastet kur kjo është e nevojshme për:
   3.1. ruajtjen e fshehtësisë zyrtare;
   3.2. ruajtjen e informacionit të fshehtë i cili do të rrezikohej nga shqyrtimi i hapur;
   3.3. ruajtjen e rendit dhe respektimin e ligjit;
   3.4. mbrojtjen e jetës personale ose familjare të një personi që është i prekur nga proceduara;
   3.5. mbrojtjen e te dëmtuarve ose dëshmitarëve; dhe
   3.6. mbrojtjen e sekretit të ndërmarrjes.
4. Komisioni mund të vendos për mbledhje mbyllur ose me pjesëmarrje të kufizuar të publikut me shumicë të thjeshtë votash. Ne ketë rast Komisioni vendosë për rrethin e personave qe janë të autorizuar të jenë prezent në mbledhjen e Komisionit.

5. Kërkesën për seancë të mbyllur ose pjesëmarrje te kufizuar mund ta bëjë;
   5.1. një (1) anëtarë i pranishëm Komisionit;
   5.2. dëshmitari;
   5.3. eksperti;
   5.4. personi qe dëgjohet nga Komisioni.
6. Vendimin për mbledhje të mbyllur ose të kufizuar e benë publik kryesuesi i Komisionit në mbledhjen e hapur.
7. Seancat e Komisionit incizohen vetëm përmes mjeteve elektronike zyrtare të Kuvendit dhe ruhen si sekret zyrtar përveç nëse Komisioni vendos ndryshe.
8. Ne mbledhjen e ardhshme të Komisionit aprovohet procesverbali i mbledhjes, i cili pas aprovimit nënshkruhet nga kryesuesi.

Neni 17
Mbajtja e rendit ne mbledhjet e Komisionit

1. Për mbajtjen e rendit në mbledhjet e Komisionit përkujdesët kryesuesi.
2. Çdo pjesëmarrës prezent, përveç anëtarëve të Komisionit i cili nuk i përmbahen rendit në mbledhjet e Komisionit mund të largohet nga salla e mbledhjes. Nëse ata refuzojnë largimin, mund të urdhërohet largimi me dhunë nga organet e rendit.
3. Kundër personave nga paragrafi 2 i këtij neni mund të kërkohet nga prokuroria inicimi i procedurës gjyqësore.
4. Komisioni gjithashtu mund të vendos t'u mohoj personave nga paragrafi 2 i këtij neni të drejtën për pjesëmarrje në mbledhjet e Komisionit.

Neni 18
Provat

1. Komisioni vendos për marrjen dhe shqyrtimin e provave.
2. Dispozitat e KPPK lidhur me provat dhe dëshmitarët janë të zbatueshme përshtatshmërisht.
3. Me kërkesë të së paku 1/3 të anëtarëve të Komisionit duhet të ngritët çdo provë, përveç rasteve kur kjo nuk është konform procedurave ligjore.
4. Të gjithë personat fizik dhe juridik privat ose publik janë të obliguar ti dorëzojnë Komisionit të gjitha dokumentet ose provat tjera materiale qe kërkohen nga ata.
5. Në rast të refuzimit ose vonesës së paarsyeshme të dorëzimit të provave nga subjektet e paragrafit 4 të këtij neni, Komisioni kërkon nga gjykata kompetente qe ajo të siguroj provën përkatëse të kërkuar.
6. Gjykatat janë të obliguara t'i dorëzojnë Komisionit provat e kërkuara nga paragrafi 5 i këtij neni.

Neni 19
Dëshmitarët

1. Komisioni harton listën e dëshmitarëve.
2. Lista mund të azhurnohet deri në fazën e mbylljes së hetimeve.
3. Komisioni edhe gjatë fazës së mbylljes së hetimeve kur konsideron që dëshmia e

dëshmitarit mund ta ndryshoi esencialisht rrjedhën e procesit mund të vendos që ta dëgjoi edhe në fazën e përfundimit.
4. Komisioni thërret dëshmitarë për ti sqaruar rrethanat e ndryshme që lidhen me çështjen qe hetohet.
5. Radhitja e dëshmive para Komisionit vendoset me konsensus. Nëse Komisioni nuk arrin konsensus radhitja vendoset me shumicën e thjeshtë të votave.
6. Dëshmitarët janë të obliguar ti përgjigjën letërthirrjes se Komisionit për të dhënë dëshmi. Letërthirrja duhet të përmbaj datën dhe orën, vendin, çështjen për të cilën është ngritur prova, të drejtat e dëshmitarit në procedurë si dhe pasojat ligjore në rast të mos përgjigjes së dëshmitarit letërthirrjes se Komisionit.
7. Ne rast se dëshmitari nuk i përgjigjet letërthirrjes së Komisionit, Komisioni mund të kërkoi që ndaj dëshmitarëve të merren masa konform ligjeve në fuqi.
8. Dispozitat e KPPK lidhur me dëshmitarët janë përshtatshmërisht edhe për procedurën hetimore të Komisionit.
9. Organet publike janë të obliguara tu lejojnë nëpunësve ose punonjësve publik dëshminë para Komisionit, përveç rasteve kur ligji e parasheh ndryshe.
10. Dëshmitari është i detyruar të dëshmoj konform procedurave të këtij ligji dhe KPPK. Në të kundërtën dëshmitari mund ti nënshtrohet sanksioneve ligjore të parapara me ketë ligj. Komisioni mund të kërkoj gjithashtu ngritjen e procedurës penale kundër dëshmitarit i cili nuk dëshmon konform detyrimeve të tij me ketë ligj ose me dispozitat e KPPK.

Neni 20
Intervistimi i dëshmitarit

1. Dëshmitarët intervistohen nga anëtarët e Komisionit.
2. Kryesuesi i Komisionit e informon dëshmitarin para fillimit të marrjes së dëshmisë lidhur me të drejtat dhe përgjegjësitë e tij në procedurë.
3. Dëshmitari është i obliguar ti përgjigjet pyetjeve të Komisionit, përveç rasteve kur parashihet ndryshe me dispozitat e KPPK.
4. Dëshmitari mund të refuzoj përgjigjen në pyetjet e palejueshme. Kryesuesi i Komisionit ka për detyrë të intervenoj ndaj një pyetje të palejueshme.

Neni 21
Ekspertiza

1. Ekspertet propozohen dhe caktohen nga anëtarët e Komisionit.
2. Ekspertët thirren dhe kanë detyrime, sipas dispozitave të parashikuara në KPPK.
3. Personi i cili thirret si ekspert ka për detyrë ti përgjigjet thirrjes dhe të jap ekspertizën e tij, përveç rasteve të parapara me nenin 178 KPPK.
4. Komisioni dhe eksperti merren vesh lidhur me afatin kohor për dhënien ose dorëzimin e ekspertizës. Afati kohore është i detyrueshëm për ekspertin. Ne qoftë se eksperti e vonon ekspertizën për arsye të pajustifikueshme, Komisioni mund të kërkoi që ndaj dëshmitarit të merren masa konform ligjeve në fuqi.
5. Ekspertët japin ekspertizën e tyre duke u bazuar ne parimin e profesionalizimit dhe paanësisë.

Neni 22
Përfundimi i hetimit

1. Hetimet përfundojnë me vendim të Komisionit, kur përmbushen pikat e planit të hetimeve dhe kur Komisioni krijon bindje të qartë për çështjen e objektit të hetimit.
2. Komisioni vendos për përfundimin e fazës së hetimit me konsensus. Ne rast se nuk arrihet konsensusi Komisioni vendos me shumicë të thjeshtë votash.

KREU V
RAPORTI PËR KUVENDIN

Neni 23
Raporti përfundimtar

1. Pas përfundimit të hetimeve dhe vlerësimit të tyre përgatitet raporti përfundimtar i Komisionit. Raporti duhet të pasqyroj në mënyrë objektive rrjedhën e procedurës, konkluzionet e hetimeve, provat që kane quar Komisionin në konkluzione dhe propozime për Kuvendin lidhur me çështjen e trajtuar.
2. Detajet mbi burimet e provave nuk publikohen në raportin përfundimtarë.
3. Raporti përfundimtar miratohet nga Komisioni me konsensus. Në rast se Komisioni nuk arrin konsensus vendoset me shumicë të thjeshtë votash.
4. Anëtarët e Komisionit të cilët nuk pajtohen me konkluzionet ose përmbajtjen e raportit përfundimtar kanë të drejt, ti paraqesin pikëpamjet e tyre lidhur me raportin më një mendim të veçantë me shkrim. Ky mendim duhet të përmbajë arsyetimin dhe duhet ti bashkëngjitet detyrimisht raportit përfundimtar.
5. Kryetari i Komisionit ia dorëzon raportin përfundimtar të Komisionit Kuvendit brenda dhjetë (10) ditëve nga dita e aprovimit të tij nga Komisioni. Kryesia e Kuvendit duhet ta radhisë në rend dite shqyrtimin e raportit në mbledhjen e Kuvendit brenda një afati pasues prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit.
6. Raportit përfundimtar gjithashtu i bashkëngjitet vendimi i Kuvendit për themelimin e Komisionit dhe plani i hetimeve të Komisioni.
7. Provat materiale, dëshmitë e hetimit dhe ekspertiza arkivohen dhe ruhen në pajtim me ligjin.
8. Nëse është evidente se Komisioni nuk mund të arrijë të përgatisë raportin përfundimtar para përfundimit të legjislaturës përkatëse, Kuvendi mund të kërkoj raport të Komisionit mbi gjendjen aktuale të hetimit.
9. Me vendim të Kuvendit mund të kërkohet edhe raport i përkohshëm nga Komisioni.

KREU VI
DISPOZITAT E TJERA

Neni 24
Buxheti i Komisionit

1. Për veprimtarinë e tij, Komisioni e ka fondin e veçantë të miratuar nga Kuvendi me propozim të Komisionit.

2. Komisioni menaxhon në mënyrë autonome me buxhetin e caktuar nga Kuvendi dhe paraqet raport sipas nevojave të Kuvendit.
3. Dispozitat përgjithshme ligjore të zbatuara nga gjykatat lidhur me kompensimin dhe shpenzimet lidhur me ekspertët dhe dëshmitarët janë të aplikueshme edhe për Komisionin.

Neni 25
Dispozitat përfundimtare

Komisioni mund të nxjerr rregulla të brendshme sipas nevojës, të cilat nuk mund të jenë në kundërshtim me ketë ligj dhe me Rregulloren e Kuvendit të Kosovës.

Neni 26
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-176
4 qershor 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-024-2010, datë 28.06.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 74 / 20 KORRIK 2010

LIGJI Nr. 03/L-111
PËR TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E DEPUTETIT

Përmbajtja

Kreu I: Dispozita të përgjithshme 259
Kreu II: Kandidimi dhe përfundimi i mandatit të deputetit 260
Kreu III: Imuniteti 261
Kreu IV: Marrëdhëniet me organet qendrore dhe lokale 262
Kreu V: Kompensimi, shpenzimet dhe përfitimet e tjera të deputetit 263
Kreu VI: Të drejtat e tjera të deputetëve 266
Kreu VII: Kodi i mirësjelljes dhe konflikti i ineteresave 268
Kreu VIII: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 271

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E DEPUTETIT

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Me këtë ligj rregullohen të drejtat, përgjegjësitë, imuniteti dhe kompensimi i deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë deputeti) para, gjatë dhe pas mandatit të tij.

Neni 2
Statusi i deputetit

1. Deputeti gëzon status të veçantë gjatë periudhës së ushtrimit të mandatit të deputetit në pajtim me dispozitat kushtetuese, me Ligjin për zgjedhjet dhe me këtë ligj.
2. Me status të veçantë të deputetit kuptohet pozicioni që ka ai në marrëdhëniet me organet shtetërore, me organet e qeverisjes lokale, si dhe të drejtat dhe detyrimet materiale dhe protokollare.

Neni 3
Mandati i lirë

1. Deputeti është përfaqësues i qytetarëve dhe gjatë mandatit të tij i nënshtrohet vetëm ndërgjegjes së tij.
2. Deputeti i ushtron detyrat e tij në pajtim me dispozitat kushtetuese, ligjin dhe me Rregulloren e punës së Kuvendit.

KREU II
KANDIDIMI DHE PËRFUNDIMI I MANDATIT TË DEPUTETIT

Neni 4
Kandidimi për mandat të deputetit

Askush nuk mund të pengohet që të kandidohet ose të ushtrojë mandatin e deputetit, përveç në rastet e parapara me ligj.

Neni 5
Mandati i deputetit

1. Mandati i deputetit buron nga vota e lirë e qytetarëve dhe fillon nga momenti i certifikimit të mandatit në pajtim me ligjin në fuqi.
2. Mandati i deputetit fillon që nga momenti i certifikimit të mandatit nga ana e autoritetit kompetent në përputhje me ligjin. Mandati i deputetëve të përbërjes paraprake të Kuvendit përfundon po të njëjtën ditë.
3. Deputeti i cili ushtron marrëdhënie pune të rregullt në sektorin publik, obligohet të deklarojë me shkrim pagën primare dhe atë sekondare brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh prej ditës së certifikimit të mandatit.

Neni 6
Mospërputhshmëria me funksionin e ekzekutivit

1. Deputeti njëkohësisht nuk mund të jetë kryeministër, zëvendëskryeministër, ministër ose zëvendësministër.
2. Me rastin e emërimit të një deputeti në funksionet e parapara në paragrafin 1 të këtij neni, mandati i tij përfundon në ditën e emërimit të tij si anëtar i qeverisë nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 7
Mospërputhshmëria me Aktivitetet ekonomike

1. Deputeti nuk mund të jetë anëtar i Bordit në ndonjë kompani private ose publike.
2. Deputeti, gjatë mandatit të tij, nuk mund të veprojë në cilësinë e këshilltarit apo përfaqësuesit ligjor i asnjë kompanie ose biznesit.
3. Deputeti nuk mund të jetë kryeredaktor apo zëvendëskryeredaktor në media të shkruara apo elektronike, me përjashtim të atyre partiake.

4. Deputeti, gjatë mandatit të tij, nuk mund të ushtrojë veprimtarinë e avokatit.
5. Deputeti nuk mund të kryejë aktivitete ekonomike që krijojnë konflikt të interesit.

Neni 8
Përfundimi i Mandatit

1. Mandati i Deputetit/es përfundon para kohe:
   1.1. nëse deputeti/ja nuk e bën betimin në seancën inauguruese ose në seancën e radhës, në të cilën ai/ ajo fizikisht është në gjendje ta bëjë betimin;
   1.2. pas dorëheqjes së tij/saj;
   1.3. nëse deputeti/ja bëhet anëtar/e i Qeverisë së Kosovës;
   1.4. nëse deputeti/ja bëhet i/e paaftë për ta ushtruar funksionin e tij/saj;
   1.5. nëse deputeti/ja për 6 muaj nuk merr pjesë në sesionet plenare të Kuvendit ose në mbledhjet e komisioneve, ku është anëtar/e. Në raste të veçanta, Kuvendi mund të vendosë ndryshe;
   1.6. nëse me vendimin e formës së prerë të gjykatës dënohet për vepër penale me vuajtje të dënimit për një ose më shumë vjet burg;
   1.7. me vdekjen e tij/saj..
2. Për rastet nga nën-paragrafët 1.4 dhe 1.5. të paragrafit 1 të këtij neni vendimin për përfundimin e mandatit të deputetit e nxjerr Kuvendi, me dy te tretat (2/3) e votave të deputeteve të pranishëm, të cilët votojnë sipas propozimit të Komisionit për Mandate dhe Imunitet.

KREU III
IMUNITETI

Neni 9
Imuniteti i deputetit

1. Deputetët e Kuvendit gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, nga paditë civile ose nga shkarkimi për veprimet e tyre brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë të Kuvendit. Imuniteti nuk e pengon ndjekjen penale të deputetëve të Kuvendit për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë të Kuvendi.
2. Deputeti i Kuvendit nuk mund të arrestohet dhe as të ndalohet përderisa është duke i kryer detyrat e tij/saj si deputet i Kuvendit, pa pëlqimin e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit.
3. Kërkesën për heqjen e imunitetit të deputetit e bën vetëm Prokurori i Përgjithshëm i Kosovës. Vetëm në rastet kur ndaj deputetit është ngritur padia private sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, kërkesën për suspendimin e imunitetit të deputetit mund ta paraqet gjykata e cila e ka rastin në hetim.
4. Kërkesa për heqjen e imuniteti i drejtohet kryetarit të Kuvendit i cili menjëherë ia dërgon Komisionit për Mandate dhe Imunitete, i cili e shqyrton dhe përgatit rekomandimin për seancën e radhës të Kuvendit.
5. Komisioni për Mandate dhe Imunitete, brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga kryetari i Kuvendit, e përgatit rekomandimin për Kuvendin.

6. Kuvendi pa debat do të vendosë lidhur me heqjen e imunitetit, mirëpo deputeti mund t'i parashtrojë pikëpamjet e tij lidhur me rastin.
7. Për heqjen e imunitetit të deputetit janë të nevojshme shumica e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
8. Deputetit të cilit i është hequr imuniteti ka të drejtë ankimi në gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Ankesa e deputetit nuk e suspendon vendimin e Kuvendit.
9. Përjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, masa e paraburgimit mund të ndërmerret ndaj deputetit pa pëlqimin paraprak të Kuvendit, në rastin kur ai ose ajo kapet në kryerje e sipër (*in flagranti)* të një vepre të rëndë penale, që është e dënueshme me pesë (5) ose më shumë vjet burgim.

Neni 10
Fillimi dhe respektimi i imunitetit

1. Deputeti gëzon imunitet parlamentar që nga data e certifikimit të mandatit të tij.
2. Imuniteti i deputetit duhet të respektohet nga të gjithë, pa dallim funksioni.
3. Deputeti mund ta njoftojë kryetarin e Kuvendit për çdo shkelje të imunitetit të tij. Kryetari i Kuvendit është i obliguar të ndërmarrë masa të nevojshme pa asnjë vonesë.

Neni 11
Qasja në institucionet publike

1. Kartela e identitetit e lëshuar për deputet garanton hyrje të lirë në të gjitha organet e shtetërore dhe të administratës publike. Në përputhje me rregulloret e lëshuara nga ministritë kompetente të Qeverisë, deputeti mund të jetë, gjithashtu, i autorizuar të hyjë në zonat e shërbimit të forcave të armatosura vendore, shërbimet e sigurisë, policisë dhe forcave të policisë të Kosovës.
2. Organet e administratës publike janë të obliguara që të sigurojnë ndihmë për deputetin në përmbushjen e mandatit dhe të japin informacionin e duhur që kërkohet për punën e tyre.

KREU IV
MARRËDHËNIET ME ORGANET QENDRORE DHE LOKALE

Neni 12
Pjesëmarrja e deputetit në politikat e qeverisjes lokale

1. Deputeti ka të drejtë pranie në mbledhjet që organizohen nga organet e qeverisjes lokale.
2. Organet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, në fillim të çdo muaji vënë në dispozicion deputetëve pranë zyrave të tyre kalendarin e mbledhjeve, duke përfshirë ndryshimet e mundshme që mund t'i bëhen atij.

Neni 13
Të drejtat në relacion me organet qendrore ekzekutive

1. Drejtuesit kryesorë të ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore janë të obliguar të presin me përparësi deputetin sa herë që ky kërkon takim për problemet që lidhen me ushtrimin e detyrës së tyre.
2. Deputeti ka të drejtë të kërkojë shpjegime për çdo çështje që ka të bëjë me përmbushjen e detyrës së tij, të ministrave ose të drejtuesve të institucioneve të tjera qendrore, si dhe të çdo institucioni tjetër në administratën shtetërore të qeverisjes lokale. Drejtuesit ose stafet e tyre janë të detyruar t'i përgjigjen deputetit brenda shtatë ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.
3. Për shkeljet procedurave nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni njoftohet me shkrim Kabineti i Kryeministrit dhe Komisioni për mandate dhe imunitete për të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse.
4. Deputetit i bëhet ftesë dhe mund të marrë pjesë në mbledhjet e Qeverisë, në ministri ose në institucione të tjera qendrore, kur në to shqyrtohen probleme të ngritura prej tij.
5. Organet dhe institucionet publike janë të obliguara të marrin në shqyrtim kërkesat, ankesat dhe propozimet e bëra nga zgjedhësit nëpërmjet deputetit dhe brenda tridhjetë (30) ditësh, nga data e paraqitjes së tyre, detyrohen të njoftojnë deputetin për mënyrën e trajtimit të tyre.
6. Kur deputeti vlerëson se një akt nënligjor i nxjerrë nga Qeveria, institucionet qendrore, organet e qeverisjes lokale, është i kontestueshëm, propozon me shkrim pranë organit përkatës rishikimin ose shfuqizimin e tij, duke njoftuar për këtë Kabinetin e Kryeministrit ose komunën. Organet drejtuese përkatëse janë të obliguara të shqyrtojnë propozimin e bërë nga deputeti në mbledhjen më të afërt të radhës dhe brenda shtatë ditëve ta njoftojnë me shkrim për përfundimin e shqyrtimit.
7. Deputeti, kur konstaton se nëpunës të emëruar të administratës publike shkelin ligjet, ka të drejtë të kërkojë pranë organit përkatës të merren masa në përputhje me legjislacionin përkatës. Bartësit e këtyre organeve janë të detyruar t'i shqyrtojnë menjëherë propozimet e bëra dhe brenda tridhjetë (30) ditëve të marrin vendimin përkatës duke njoftuar deputetin.

KREU V
KOMPENSIMI, SHPENZIMET DHE PËRFITIMET E TJERA TË DEPUTETIT

Neni 14
Përfitimet financiare dhe materiale të deputetit

1. Deputeti gjatë ushtrimit të mandatit të tij ka të drejtë kompensimi për:
   1.1. pagë bazë;
   1.2. pagë kalimtare pas përfundimit të mandatit;
   1.3. kompensimi për pjesëmarrje në seanca dhe në takime të komisioneve;
   1.4. kompensim për funksionet parlamentare;
   1.5. kompensimi i shpenzimeve mujore;

1.6. pensionet suplementare; dhe
1.7. të drejtat e tjera të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 15
Kompensimi i deputetit

Paga bazë e deputetit do të përcaktohet me dispozitat e Ligjit për pagat e funksionarëve publikë.

Neni 16
Kompensimi kalimtar

Deri në fillimin e realizimit të të hyrave financiare nga ndonjë burim tjetër, ose nga realizimi i pensionit, që nga dita e përfundimit të mandatit deputeti/ja ka të drejtë në pagë bazë për dymbëdhjetë (12) muaj.

Neni 17
Shpenzimet mujore

Deputeti ka të drejtë në kompensim të shpenzimeve mujore lidhur me punën në Kuvend.

Neni 18
Kompensimi për funksion

1. Deputeti që mban funksion parlamentar, me propozim të Komisionit për Buxhet dhe Financa merr kompensim, shtesë mujore, që përcaktohet me vendimin e Kuvendit.
2. Kompensimi për funksion i nënshtrohet tatimit dhe kontributit pensional.
3. Deputeti nga paragrafi 1 i këtij neni ka të drejtë kompensimin shtesë vetëm për një funksion udhëheqës.

Neni 19
Ndalesa e kompensimit

Për mospjesëmarrje, për shkaqe të paarsyeshme, të deputetit në seancë plenare, në komisione ose në funksione të tjera parlamentare, në të cilat është emëruar, pason ndalesa e kompensimit nga nën-paragrafët 1.3. dhe 1.5. paragrafi 1 i nenit 14 të këtij ligj, sipas një akti të veçantë të Kryesisë së Kuvendit.

Neni 20
Përcaktimi i lartësisë së kompensimeve

Lartësia e kompensimit për funksione dhe shpenzime mujore, përcaktohet me propozim të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe vendim të Kryetarit të Kuvendit.

Neni 21
Mëditjet për udhëtime zyrtare

1. Deputeti që shkon në shërbim jashtë Kosovës nga Kuvendi përfiton mëditje ditore dhe kompensim të transportit, sipas akteve të miratuara nga Kuvendi.
2. Deputeti në rastet kur caktohet të marrë pjesë në delegacionet e Qeverisë ose të institucioneve të tjera, shpenzimet përballohen nga institucioni që e ka ftuar, duke përfituar mëditjen sipas akteve të miratuara nga Qeveria.
3. Deputeti, për ushtrimin e funksionit të tij parlamentar, ka të drejtë në shërbim adekuat transporti ose kompensim adekuat për shpenzimet e udhëtimit, sipas kuotave dhe procedurave të përcaktuara me akt të veçanta të Kuvendit.

Neni 22
Pensioni suplementar

1. Deputeti, pas përfundimit të mandatit, ka të drejtë për pension suplementar, nëse detyrën e deputetit e ka ushtruar së paku një mandat dhe e ka mbushur moshën pesëdhjetepesë (55) vjeç.
2. Deputeti që i plotëson kushtet e caktuara me paragrafin 1 të këtij neni, e realizon pensionin suplementar në lartësi prej pesëdhjetë perqind (50 %) të pagës bazë të deputetit. Deputeti që ka shërbyer në dy (2) mandate në kushtet e përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni e realizon pensionin suplementar në vlerë prej gjashtëdhjetë perqind (60 %) të pagës bazë dhe ai që ka shërbyer në tri (3) e më shumë mandate në lartësi prej shtatëdhjetë perqind (70 %) të pagës bazë.

Neni 23

1. Të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, të përcaktuara me këtë ligj, fillojnë të rrjedhin nga viti 2001, me certifikimin e mandatit të deputetit.
2. Statusi i deputetit të legjislaturës 1990 - 2000 rregullohet me ligj të veçantë.

Neni 24
Baza e pensionit

1. Si bazë për përcaktimin e pensionit suplementar shërben paga bazë aktuale e deputetit që realizohet në Kuvend.
2. Shuma e përgjithshme e pensionit suplementar nuk mund të jetë më e madhe se shtatëdhjetë përqind (70 %) e pagës bazë të deputetit.

Neni 25
Pensionimi për shkak të paaftësisë

1. Deputeti, të cilit për shkak të lëndimit gjatë ushtrimit të detyrës së tij, iu ka shkaktuar paaftësia e përgjithshme për punë, ka të drejtë për pension suplementar pa marrë parasysh stazhin pensional, moshën dhe kohën e kryerjes së detyrave të deputetit.

2. Pensioni nga paragrafi 1 i këtij neni caktohet në shumën prej shtatëdhjetë përqind (70 %) të pagës bazë.

Neni 26
Rrethanat e veçanta

Kriter për realizimin dhe përcaktimin e lartësisë së pensionit, është stazhi i përgjithshëm pensional i realizuar në vend dhe jashtë vendit.

Neni 27
Pensioni familjar

1. Anëtarëve të familjes së shfrytëzuesit të pensionit suplementar që ka vdekur, pensioni familjar u përcaktohet në shumën prej shtatëdhjetë përqind (70 %) të atij pensioni në ditën e vdekjes.
2. E drejta për pension familjar nga paragrafi 1 i këtij neni vlen për të gjitha rastet, duke filluar nga legjislatura e vitit 2001.
3. Procedurat e parapara për realizimin e të drejtave të pensionit të rregullt janë të aplikueshme edhe për realizimin e pensionit suplementar.
4. Të drejtë për pensionin familjar e kanë bashkëshorti/ja dhe fëmijët deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, përkatësisht deri në moshën njëzetedy (22) vjeçare, nëse vazhdojnë shkollimin e lartë.

Neni 28
Sigurimi i mjeteve

Mjetet financiare për kompensim të përcaktuar në nenin 14 të këtij ligji, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

KREU VI
TË DREJTAT E TJERA TË DEPUTETËVE

Neni 29
Pushimi vjetor

Deputetit i njihet e drejta e pushimit vjetor jo me shumë së tridhjetë (30) ditë kalendarike brenda sesionit vjetor të punimeve të Kuvendit.

Neni 30
Kompensimi për pushim vjetor

Deputeti ka të drejtën e kompensimit në pagën bazë për periudhën kur Kuvendi përcakton pushimin vjetor.

Neni 31
Statusi diplomatik

1. Deputetit i njihet e drejta e pajisjes me pasaportë diplomatike gjatë kohës së kryerjes së mandatit, si dhe një (1) vjet pas mbarimit të tij.
2. Bashkëshortit/es së deputetit, për realizimin e vizitës së përbashkët zyrtare i mundësohen lehtësira lidhur me pajisje me viza udhëtimi.
3. Imuniteti diplomatik i deputetit garantohet me marrëveshje në mes shteteve dhe sipas detyrimeve që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare.

Neni 32
Stazhi i punës

1. Periudha e ushtrimit të mandatit të deputetit llogaritet në stazhin e punësimit aktiv.
2. Gjatë ushtrimit të mandatit të tij, deputeti duhet të pajiset me sigurim shëndetësor dhe pensional në pajtim me ligjin.

Neni 33
Mjetet e punës

1. Komisioneve dhe grupeve parlamentare u sigurohen zyrat në Kuvend dhe stafi ndihmës.
2. Deputetët pajisen me zyrat e tyre në Kuvend.
3. Gjithashtu, pranë çdo zonë elektorale, organet e qeverisjes lokale hapin zyra të veçanta pune për deputetët. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, me pëlqimin e deputetëve, emëron në shërbim të deputetëve në këto zyra një sekretar, si rregull me arsim të lartë juridik, i cili pajiset me mjetet e nevojshme të punës.
4. Fondet për nevojat e mësipërme përballohen nga buxheti i Kuvendit.

Neni 34
Përfitime e tjera

Deputeti përfiton falas "Fletoren Zyrtare", Buletinin e Kuvendit ose të institucioneve të tjera qendrore, aktet nënligjore të Qeverisë si dhe të organeve të komunës, ku është zgjedhur.

Neni 35
Siguria e deputetit

1. Deputetit i sigurohet mbrojtje e veçantë nga organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, në pajtim me procedurën për mbrojtje të veçantë me rastet kur ai e kërkon këtë.
2. Përkitazi me kërkesën e deputetit, për sigurimin e mbrojtjes së veçantë vendos Ministria e Punëve të Brendshme në procedurë të përshpejtuar.

Neni 36
Dokumenti identifikues

1. Deputeti pajiset nga Kuvendi me dokument identifikues, që është i vlefshëm deri në mbarimin e mandatit të tij. Ky dokument zëvendëson çdo leje tjetër lëshuar nga organet publike, civile ose ushtarake, për të hyrë në vende dhe objekte të ndryshme, me përjashtim të atyre vendeve dhe objekteve, hyrja në të cilat ndalohet me ligj.
2. Pas përfundimit të mandatit, deputetit i lëshohet dokumenti identifikues në të cilin shënohet data e fillimit dhe e përfundimit të mandatit të deputetit.

Neni 37
Kontributet jo tatimore

1. Rregullat e sigurimit shëndetësor dhe të sigurimit pensional të aplikueshme për nëpunës civilë janë të aplikueshme edhe për deputet.
2. Deputeti, për qëllim të paragrafit 1 të këtij neni, do të konsiderohet si i punësuar për periudhën e kohëzgjatjes se mandatit të tij, pas pushimit të mandatit, në pajtim me nenin 16 të këtij ligji.

Neni 38
Kthimi në vendin e punës

Deputeti që para fitimit të mandatit ka qenë i punësuar në sektorin publik ose në institucionin që financohet me mjete publike, ka të drejtë vazhdimin e funksionit në pozitën e tij të njëjtë ose në pozitë të rangut të njëjtë pas përfundimit të mandatit të deputetit. Për këtë qëllim deputeti duhet t'ia parashtrojë kërkesën e tij punëdhënësit brenda gjashtë (6) muajve pas përfundimit të mandatit.

KREU VII
KODI I MIRËSJELLJES DHE KONFLIKTI I INETERESAVE

Neni 39
Parimet

1. Deputeti është i obliguar t'u përmbahet dispozitave kushtetuese dhe ligjit dhe në të gjitha rastet të veprojë në pajtim me besimin që i është i dhënë si dhe tu përmbahet këtyre parimeve:
   1.1. **Vetëmohimi -** Deputeti merr qëndrim apo voton për çështjet që janë vetëm me interes publik. Ai nuk mund të marrë pjese në marrjen e vendimeve për përfitime financiare apo përfitime të tjera materiale për vete, për familjen e tij apo për miqtë.
   1.2. **Integriteti moral -** Deputeti nuk mund të ketë detyrime financiare ndaj individëve apo organizatave që mund të ndikojnë në ushtrimin e detyrave të tij zyrtare.
   1.3. **Objektiviteti -** Deputeti duhet të vendosë vetëm në bazë të meritave dhe të

interesit publik gjatë ushtrimit së funksioneve publike, duke përfshirë edhe emërimet publike, shpalljen e fituesit të kontratave ose rekomandimin e individëve për shpërblime dhe subvencione.

1.4. **Përgjegjësia** - Deputeti mbanë përgjegjësi për vendimin e tij dhe i nënshtrohet një vetëkontrolli të kujdesshëm që i përgjigjet funksionit të tij.

1.5. **Sinqeriteti** - Deputeti duhet të jetë i sinqertë për të gjitha vendimet dhe veprimet që i ndërmerr.

1.6. **Ndershmëria** - Deputeti është i detyruar të deklarojë interesin privat që mund të jetë relevant për detyrat e tij publike dhe duhet të ndërmarrë veprime për zgjidhjen e konflikteve eventuale për të mbrojtur interesin publik.

1.7. **Aftësia udhëheqëse -** Deputeti me udhëheqje dhe shembuj konkretë duhet të sigurojë mbështetjen e këtyre parimeve.

Neni 40
Detyrimet

1. Deputeti është i detyruar të marrë pjesë në seancat plenare dhe në mbledhjet e organeve ndihmëse të Kuvendit, në të cilat ai është anëtar.
2. Organet ndihmëse të Kuvendit nga paragrafi 1 i këtij neni janë të gjitha organet e përhershme ose *ad hoc* që formohen me vendim të Kuvendit.
3. Deputeti, që nuk mund të marrë pjesë në seancat e Kuvendit ose në mbledhjet e organeve ndihmëse të Kuvendit në të cilat ai është anëtar duhet ta njoftojë më kohë kryetarin e Kuvendit, përkatësisht kryetarin, zëvendëskryetarin e atij organi ndihmës, duke prezantuar edhe arsyet për mungesën e tij.

Neni 41
Mos përmbushja e detyrimeve

1. Nëse deputeti nuk merr pjesë në punimet e seancës plenare ose të organeve ndihmese të Kuvendit, ku ai është anëtar, paga bazë dhe kompensimi shtesë reduktohen. Nga ky reduktim përjashtohen rastet kur deputeti gjendet në detyrë zyrtare në funksionin e tij parlamentar.
2. Rregullat e tjera për pjesëmarrjen e deputetit në punime dhe sanksionet e tjera përcaktohen me Rregulloren e Kuvendit ose me një Rregullore të brendshme të Kuvendit.

Neni 42
Obligimet parlamentare

Deputeti nuk mund të refuzojë anëtarësinë apo pjesëmarrjen në trupat punuese të Kuvendit pa arsye objektive të pranueshme.

Neni 43
Konfidencialiteti

Deputeti është i detyruar ta ruajë konfidencialitetin e informatave dhe të dokumenteve zyrtare në pajtim me ligjin.

Neni 44
Konflikti i interesave

Deputeti nuk ka të drejtë të votojë për një çështje për të cilën vendimi mund të rezultojë me përfitim financiar për të dhe i njëjti as që do të pranohej nga një kategori e gjerë e njerëzve që nuk janë deputetë të Kuvendit ose nga të afërmit e deputetëve të Kuvendit.

Neni 45
Regjistri i interesave

Deputetët duhet të regjistrojnë në Regjistrin e Interesave të gjitha interesat relevante të përcaktuara me aneksin e këtij ligji.

Neni 46
Dhuratat

1. Deputeti gjatë mandatit të tij mund të pranojë dhurata, në pajtim me ligjin përkatës në fuqi.
2. Kufizimet e parapara me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të bëjnë me shumën e mjeteve apo të gjërave të pranuara nga deputeti për përdorimin e mjeteve gratis të siguruara nga Kuvendi, partia e tij, grupi i deputetëve dhe nga ndonjë fondacion që mbështet legjislativin ose që është në lidhje të ngushtë me këtë. Shuma të këtilla dhe gjëra për përdorim gratis, duhet të regjistrohen nga deputeti si pjesë e deklaratës së tyre mbi pasurinë, të ardhurat dhe interesat e ekonomike sipas shtojcës nr. 1 të këtij ligji. Deputeti, në përfundim të mandatit, gjërat e pranuara për përdorim gratis, nuk duhet t'i mbajë në pronësi ose në përdorim të mëtejshëm të tij apo të ndonjë person i afërt i tij.

Neni 47
Deklarimi i pasurisë

1. Deputeti është i obliguar, që brenda tridhjetë ditëve tridhjetë (30) nga certifikimi i mandatit të deputetit dhe pas 1 janarit të çdo viti, si dhe pas tridhjetë ditëve nga pushimi i detyrës së tij, të bëjë një deklaratë rreth pasurisë, të ardhurave dhe interesave ekonomike të tij, të kryetari i Kuvendit, në përputhje me Shtojcën e këtij ligji.
2. Deputeti duhet t'ia bashkëngjisë deklaratës së tij personale edhe deklaratën e pasurisë të bashkëshortit/es ose partnerit të jetës, si edhe fëmijës që jeton në të njëjtën familje në përputhje me shtojcën e këtij ligji.

KREU VIII
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 48

Kuvendi, brenda gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, do ta nxjerrë Ligjin për pagat e funksionarëve publik.

Neni 49
Aktet nënligjore

Ngarkohen Qeveria dhe Kuvendi, që në afat prej gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, t'i nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 50
Pacenueshmëria e të drejtave

Të drejtat që përfitojnë deputetët nga ky ligj, nuk mund të cenohen.

Neni 51
Hyrja ne fuqi

Ky ligj publikohet në Gazetën Zyrtare dhe fillon të zbatohet më 1 janar të vitit 2011.

Ligji Nr. 03/L-111
4 qershor 2010

Shpallur me Dekretin DL-029-2010, datë 05.07.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 74 / 20 KORRIK 2010

Shtojcë

Deklarata për pasurinë, të ardhurat dhe interesat ekonomik të Deputetit, për bashkëshortin/en e tij/saj në jetë dhe fëmijën (ët) që jetojnë bashkë me të

Personi deklarues
1. Deklaruesi:
   a. Deputeti
   b. Bashkëshorti/ja e jetës, i/e cili/a jeton së bashku me Deputetin (prej këtu e tutje: bashkëshorti/ja e jetës)
   c. Fëmija/ët që jetojnë bashkë me Deputetin (prej këtu e tutje: fëmija)
2. Emri i Deputetit: . . . . . .
3. Emri i bashkëshortit/es të jetës: . . . . . .
4. Emri i fëmijës/jëve: . . . . . .

Pjesa A)
DEKLARIMI I PRONËS

I.
Patundshmëria

1.
   a. Emri i vendbanimit ku gjendet patundshmëria: . . . . . .
   b. Hapësira ku gjendet ajo patundshmëri: . . . . . .
   c. Sektori i punësimit (apo emri i sektorit nga i cili është larguar): . . . . . .
   d. Karakteri i ndërtesës sipas qëllimit të saj kryesor që ka (ndërtesë banimi, ndërtesë pushimi, objekt afarizmi, etj.), hapësira qendrore e ndërtesës: . . . . . .
   e. Karakteri ligjor i patundshmërisë: . . . . . .
   f. Statusi ligjor i deklaruesit (pronar, qiramarrës, etj.): . . . . . .
   g. Në rast të një bashkëpronësie, tregoni pjesën tuaj në pronë: . . . . . .
   h. Titulli dhe data e përvetësimit (fillimi i statusit ligjor): . . . . . .
2.
   a. Emri i vendbanimit ku gjendet patundshmëria:. . . . . .
   b. Hapësira ku gjendet ajo patundshmëri: . . . . . .
   c. Sektori i punësimit (apo emri i sektorit nga i cili është larguar): . . . . . .
   d. Karakteri i ndërtesës sipas qëllimit të saj kryesor që ka (ndërtesë banimi, ndërtesë pushimi, objekt afarizmi, etj.), hapësira qendrore e ndërtesës: . . . . . .
   e. Karakteri ligjor i patundshmërisë: . . . . . .
   f. Statusi ligjor i deklaruesit (pronar, qiramarrës, etj.): . . . . . .
   g. Në rast të një bashkëpronësie, tregoni pjesën tuaj në pronë: . . . . . .
   h. Titulli dhe data e përvetësimit (fillimi i statusit ligjor): . . . . . .
3.
   a. Emri i vendbanimit ku gjendet patundshmëria: . . . . . .
   b. Hapësira ku gjendet ajo patundshmëri: . . . . . .
   c. Sektori i punësimit (apo emri i sektorit nga i cili është larguar):. . . . . .
   d. Karakteri i ndërtesës sipas qëllimit të saj kryesor që ka (ndërtesë banimi, ndërtesë pushimi, objekt afarizmi, etj.), hapësira qendrore e ndërtesës: . . . . . .

e. Karakteri ligjor i patundshmërisë: . . . . . .
f. Statusi ligjor i deklaruesit (pronar, qiramarrës, etj.): . . . . . .
g. Në rast të një bashkëpronësie, tregoni pjesën tuaj në pronë: . . . . . .
h. Titulli dhe data e përvetësimit (fillimi i statusit ligjor): . . . . . .

4.

a. Emri i vendbanimit ku gjendet patundshmëria: . . . . . .
b. Hapësira ku gjendet ajo patundshmëri: . . . . . .
c. Sektori i punësimit (apo emri i sektorit nga i cili është larguar): . . . . . .
d. Karakteri i ndërtesës sipas qëllimit të saj kryesor që ka (ndërtesë banimi, ndërtesë pushimi, objekt afarizmi, etj.), hapësira qendrore e ndërtesës: . . . . . .
e. Karakteri ligjor i patundshmërisë: . . . . . .
f. Statusi ligjor i deklaruesit (pronar, qiramarrës, etj.): . . . . . .
g. Në rast të një bashkëpronësie, tregoni pjesën tuaj në pronë: . . . . . .
h. Titulli dhe data e përvetësimit (fillimi i statusit ligjor): . . . . . .

II.
Pronë personale të nivelit të lartë

1. Vetura
   a. Mjet udhëtarësh:. . . . . lloji
      data dhe titulli ligjor i përvetësimit : . . . . . lloji
      data dhe titulli ligjor i përvetësimit: . . . . . .lloji
      data dhe titulli ligjor i përvetësimit: . . . . . .
   b. Furgon, autobus: . . . . . lloji
      data dhe titulli ligjor i përvetësimit: . . . . . .lloji
      data dhe titulli ligjor i përvetësimit: . . . . . .lloji
      data dhe titulli ligjor i përvetësimit: . . . . . .
   c. Motoçikletë: . . . . . lloji data dhe titulli ligjor i përvetësimit: . . . . . .lloji
      data dhe titulli ligjor i përvetësimit: . . . . . .lloji
      data dhe titulli ligjor i përvetësimit: . . . . . .
2. Mjeti i cili qarkullon në det apo ajër:
   a. karakteri: . . . . . .
      lloji: . . . . . .
      data dhe titulli ligjor i përvetësimit: . . . . . .
      karakteri: . . . . . .
      lloji: . . . . . .
      data dhe titulli ligjor i përvetësimit: . . . . . .
3. Punimet artistike, koleksionet e caktuara:
   a. Punime individuale artistike: . . . . . .
      përshkrimi . . . . . veprat
      data dhe titulli ligjor i përvetësimit . . . . . .
      përshkrimi . . . . . veprat
      data dhe titulli ligjor i përvetësimit . . . . . .
      përshkrimi . . . . . veprat
      data dhe titulli ligjor i përvetësimit. . . . . .

b. koleksioni: . . . . . .
përshkrimi . . . . . veprat
data dhe titulli ligjor i përvetësimit . . . . . .
përshkrimi . . . . . veprat
data dhe titulli ligjor i përvetësimit . . . . . .
përshkrimi . . . . . veprat
data dhe titulli ligjor i përvetësimit . . . . . .

4. Pronë tjetër personale vlera e të cilës (vepër, koleksione) e kalon pagesën themelore aktuale gjashtë mujore të Deputetit:
   a. përshkrimi: . . . . . .
   data dhe titulli ligjor i përvetësimit . . . . . .
   b. përshkrimi: . . . . . .
   data dhe titulli ligjor i përvetësimit . . . . . .
   c. përshkrimi: . . . . . .
   data dhe titulli ligjor i përvetësimit . . . . . .
   d. përshkrimi: . . . . . .
   data dhe titulli ligjor i përvetësimit . . . . . .
   e. përshkrimi: . . . . . .
   data dhe titulli ligjor i përvetësimit . . . . . .
5. Kursimet e depozituara në fonde (aksione, obligacione, njësi investimi, sigurimi me një shumë të madhe të siguruar etj.):
   përshkrimi: . . . . . .
   vlera normale, shuma e siguruar:. . . . . .
   përshkrimi: . . . . . .
   vlera normale, shuma e siguruar:. . . . . .
   përshkrimi: . . . . . .
   vlera normale, shuma e siguruar:. . . . . .
   përshkrimi: . . . . . .
   vlera normale, shuma e siguruar:. . . . . .
   përshkrimi: . . . . . .
   vlera normale, shuma e siguruar:. . . . . .
6. Kursimet në depozitat e kursimeve: . . . . . .
7. Parat e gatshme që kalojnë shumën e kompensimit aktuale gjashtë mujor të deputetit: . . . . . .
8. Bilanci përkatës i llogarisë bankare apo ndonjë kërkese tjetër për përfitime në bazë të ndonjë kontrate tjetër e cila e kalon në tërësi shumën e kompensimit gjashtë mujorë të Deputetit:
   a. bilanci i llogarisë përkatëse bankare
   në Forintë: . . . . . .
   në këmbimin ndërkombëtarë (kundër vlera e forintit): . . . . . .
   b. shumë përkatëse parash në bazë të një kontrate tjetër: . . . . . .
9. Pronat tjera të një vlere të konsiderueshme nëse shuma e tyre e përbashkët e tejkalon shumën e kompensimit gjashtë mujorë të Deputetit:
   përshkrimi: . . . . . .
   përshkrimi: . . . . . .
   përshkrimi: . . . . . .

përshkrimi: . . . . . .
përshkrimi: . . . . . .

III.
Borxhet

Luteni që në këtë pjesë të shënoni çfarëdo borxhi përkatës si borxh publik apo të institutive financiare apo personave privat.

1. Borxhe publike (tatime, dogana, obligimet, Kontributi për SS (Sigurim Social, etj.): . . . . . .
2. Borxhe ndaj instituteve financiare (kreditë, hua, etj.): . . . . . .
3. Borxhe ndaj personave privat: . . . . . .

IV.
Informacione tjera

. . . . . .

. . . . . .

. . . . . .

. . . . . .

. . . . . .

. . . . . .

Pjesa B)*
DEKLARATA MBI BURIMET E TË ARDHURAVE
(burime të ardhurash të tatueshëm të tjera këto nga kompensimi i Deputetit)

1. Profesioni: . . . . . .
   Pozita: . . . . . .
   Profesioni i ndërprerë: *po*
   jo
   Të ardhura mujore (bruto) nga profesioni: . . . . . .
2. Të gjitha aktivitetet tjera përveç në profesionin e përmendur në pikën 1 të cilat sigurojnë të ardhura të tatueshme:
   a. Përshkrimi i aktivitetit: . . . . . .
   b. Personi pagues (përveç aktivitetet nën fushën e obligimeve të fshehta të theksuara nga rregullat ligjore): . . . . . .
   c. Shpeshtësia e fitimit të të ardhurave (mujore, intervale tjera, sipas rastit, kalimtare):. . . . . .
   d. Shuma e të ardhurave (bruto): . . . . . .
   a. Përshkrimi i aktivitetit: . . . . . .

b. Personi pagues (përveç aktivitetet nën fushën e obligimeve të fshehta të theksuara nga rregullat ligjore): . . . . . .
c. Shpeshtësia e fitimit të të ardhurave (mujore, intervale tjera, sipas rastit, kalimtare):. . . . . .
d. Shuma e të ardhurave (bruto): . . . . . .
a. Përshkrimi i aktivitetit: . . . . . .
b. Personi pagues (përveç aktivitetet nën fushën e obligimeve të fshehta të theksuara nga rregullat ligjore): . . . . . .
c. Shpeshtësia e fitimit të të ardhurave (mujore, intervale tjera, sipas rastit, kalimtare):. . . . . .
d. Shuma e të ardhurave (bruto): . . . . . .

Pjesa C)
DEKLARIMET E INTERESAVE EKONOMIK
Pozita apo interesi në një ndërmarrje ekonomike:

I

1. Emri i ndërmarrjes ekonomike: . . . . . .
2. Forma e korporatës: . . . . . .
3. Forma e interesit (pronarë, palë në interes, në rast se është anëtarë i brendshëm apo i jashtëm i kompanisë së bashkëpunëtorëve, etj.): . . . . . .
4. Palë në interes (aksionist) në një ndërmarrje me interes pronësorë: . . . . . %
5. Aksionet e mbajtura për momentin: . . . . . %
6. Pozita në ndërmarrjen ekonomike: . . . . . .

II

1. Emri i ndërmarrjes ekonomike: . . . . . .
2. Forma e korporatës: . . . . . .
3. Forma e interesit (pronarë, palë në interes, në rast se është anëtarë i brendshëm apo i jashtëm i kompanisë së bashkëpunëtorëve, etj.): . . . . . .
4. Palë në interes (aksionist) në një ndërmarrje me interes pronësorë: . . . . . %
5. Aksionet e mbajtura për momentin: . . . . . %
6. Pozita në ndërmarrjen ekonomike: . . . . . .

III

1. Emri i ndërmarrjes ekonomike: . . . . . .
2. Forma e korporatës: . . . . . .
3. Forma e interesit (pronarë, palë në interes, në rast se është anëtarë i brendshëm apo i jashtëm i kompanisë së bashkëpunëtorëve, etj.): . . . . . .
4. Palë në interes (aksionist) në një ndërmarrje me interes pronësorë: . . . . . %
5. Aksionet e mbajtura për momentin: . . . . . %
6. Pozita në ndërmarrjen ekonomike: . . . . . .

IV

1. Emri i ndërmarrjes ekonomike: . . . . . .
2. Forma e korporatës: . . . . . .
3. Forma e interesit (pronarë, palë në interes, në rast se është anëtarë i brendshëm apo i jashtëm i kompanisë së bashkëpunëtorëve, etj.): . . . . . .
4. Palë në interes (aksionist) në një ndërmarrje me interes pronësorë: . . . . . %
5. Aksionet e mbajtura për momentin: . . . . . %
6. Pozita në ndërmarrjen ekonomike: . . . . . .

V

1. Emri i ndërmarrjes ekonomike: . . . . . .
2. Forma e korporatës: . . . . . .
3. Forma e interesit (pronarë, palë në interes, në rast se është anëtarë i brendshëm apo i jashtëm i kompanisë së bashkëpunëtorëve, etj.): . . . . . .
4. Palë në interes (aksionist) në një ndërmarrje me interes pronësorë: . . . . . %
5. Aksionet e mbajtura për momentin: . . . . . %
6. Pozita në ndërmarrjen ekonomike: . . . . . .

Pjesa D)[*]
DEKLARIMI

rreth ndihmës financiare dhe gjërave të dhuruara për shfrytëzim të pranuara nga Deputeti nga Parlamenti, partisë të cilës i përket apo Grupit të Deputetit dhe/apo fondacionit i cili mbështetë aktivitetin legjislativ, i nevojshëm ky për të kryer punën e Deputetit apo në lidhje të ngushtë me këtë (prej këtu e tutje ndihma financiare)

Data e caktimit (ndarjes)	*Emërtimi i ndihmës financiare*	*Vlera e ndihmës financiare*

Pjesa E)*
DEKLARIMI

për dhuratat e pranuar nga Deputetët në lidhje me mandatin e tij si Deputet dhe ndihma e dhuruar financiare tjetër nga ajo e përshkruar në pikën (D) të këtij deklarimi (prej këtu e tutje: dhurata)

Data e pranimit të dhuratës	*Emërtimi i dhuratës*	*Vlera e dhuratës*

***

Me datën: . . . . . ., (muaji) . . . . . (dita) (viti)
Me këtë deklaratë, e kam përmbyllur deklarimin (et) për bashkëshortin/en tim/e të jetës . . . . . .
si dhe për fëmijë (ët) e mi i/të cili/ët jetojnë bashkë me mua: . . . . . .
Ky deklarim është bërë nga bashkëshorti/ja e jetës dhe prindi i fëmijës/ve i/të cili/ët jeton/jnë së bashku me. . . . . Deputet.

Nënshkrimi

LIGJI Nr. 03/L-038
PËR PËRDORIMIN E SIMBOLEVE SHTETËRORE TË KOSOVËS

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 279
Kreu II: Përdorimi, vendosja dhe renditja e flamurit të Republikës së Kosovës..... 280
Kreu III: Stema e Republikës së Kosovës 283
Kreu IV: Himni i Republikës së Kosovës 285
Kreu V: Dispozitat kalimtare 287

Në mbështetje të Kapitullit IV neni 65 pika 1 si dhe neni 81 pika 1 paragrafi 8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me qëllim të përdorimit të simboleve shtetërore të Republikes së Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJIN PËR PËRDORIMIN E SIMBOLEVE SHTETËRORE TË KOSOVËS

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Me këtë ligj rregullohet përdorimi i simboleve shtetërore të Republikës së Kosovës.

Neni 2
Simbolet shtetërore të Republikës së Kosovës

2.1. Simbolet shtetërore të Republikës së Kosovës janë: flamuri, stema dhe himni.
2.2. Me flamurin, stemën dhe himnin përfaqësohet Republika e Kosovës dhe identiteti shtetëror i saj.
2.3. Flamuri, stema dhe himni i Republikës së Kosovës, përdoren në pajtim me këtë ligj dhe me aktet nënligjore, që do të nxirren për zbatimin e këtij ligji.

Neni 3
Forma dhe përmbajtja e simboleve shtetërore të Republikës së Kosovës

3.1. Forma, përmasa e flamurit dhe stemës, përmbajtja e tekstit dhe partitura e himnit, përcaktohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

3.2. Rregullat gjeometrike të pamjes dhe të ngjyrave për formësimin e flamurit, stemës, si dhe të tekstit dhe të shënimit të notave të melodisë së himnit të përcaktuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës do të jenë pjesë përbërëse e këtij ligji.

3.3. Origjinali i simboleve të Republikës së Kosovës ruhet në arkivin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në pajtim me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në Ligjin Nr. 2003/7 për lëndën arkivore dhe arkivat (shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/20, të datës 23 qershor 2003, për shpalljen e Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës mbi materialin arkivor dhe arkivin.

KREU II
PËRDORIMI, VENDOSJA DHE RENDITJA E FLAMURIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 4
Përdorimi i flamurit të Republikës së Kosovës nga institucionet shtetërore

4.1. Flamuri shtetëror vendoset në mjediset e brendshme dhe të jashtme të institucioneve shtetërore dhe publike. Për përdorimin e flamurit shtetëror në mjediset e brendshme dhe të jashtme të institucioneve publike, Qeveria e Republikës së Kosovës mund të nxjerr akte nënligjore.

4.2. Flamuri shtetëror mund të vendoset në mjedise të brendshme të zyrave publike, në universitete, në selitë e partive politike, në institucione shkencore e kulturore, në objekte të kultit dhe në organizata të ndryshme. Në këto raste, flamuri qëndron në të djathtë të vendit kryesor apo në tavolinën e punës.

4.3. Flamuri shtetëror i Republikës së Kosovës përdoret në rastet e takimeve ceremoniale të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore me përfaqësues të shteteve të huaja:

a) në mënyrë të lirë në tryezat e zyrtarëve dhe nga personat juridikë;
b) në ndërtesat dhe automjetet e përfaqësuesve të Republikës së Kosovës, në shtetet e tjera; dhe
c) në të gjitha rastet kur përfaqësohet Republika e Kosovës.

Neni 5
Përdorimi i flamurit shtetëror të Republikës së Kosovës nga qytetarët

Çdo qytetar i Republikës së Kosovës ka të drejtë ta përdorë flamurin shtetëror të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: flamurin shtetëror) në pajtim me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 6
Përdorimi i flamujve kombëtarë

6.1. Çdo qytetar i Republikës së Kosovës ka të drejtë të përdorë flamujt kombëtarë në pajtim me këtë ligj dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.

6.2. Qytetarët e të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës kanë të drejtën, në mënyrë individuale apo si komunitet, të përdorin flamujt kombëtarë në pajtim me këtë ligj dhe me standardet ndërkombëtare.

6.3. Për mënyrën e përdorimit të flamujve kombëtarë në mjedise të brendshme dhe të jashtme në institucionet publike, Qeveria e Republikës së Kosovës nxjerr akte përkatëse nënligjore.

6.4. Ndalohet vendosja publike e flamujve kombëtarë nëse janë të vjetruar apo të dëmtuar.

Neni 7
Vendosja e flamurit shtetëror

7.1. Flamuri shtetëror gjithmonë vendoset:
   a) në ndërtesa, në të cilat është selia e Kryetarit të Republikës së Kosovës, selia e Kuvendit të Republikës së Kosovës, selia e Qeverisë së Republikës së Kosovës;
   b) në pikat e kalimeve kufitare;
   c) në ndërtesat e përfaqësive të Republikës së Kosovës jashtë shtetit dhe në mjetet e transportit, të cilat i përdorë udhëheqësi i përfaqësisë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, në përputhje me dispozitat ndërkombëtare, në të cilin është përfaqësia, përkatësisht në përputhje me rregullat dhe praktikat e organizatës ndërkombëtare, pranë të cilës është përfaqësia; dhe
   d) gjatë festave zyrtare të Republikës së Kosovës.

7.2. Flamuri shtetëror vendoset:
   a) me rastin e solemnitetit zyrtar të përcjelljes së Kryetarit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kryeministrit kur shkojnë nga Republika e Kosovës në vizitë në shtetet e huaja dhe në pritjen e tyre kur kthehen në Republikën e Kosovës;
   b) me rastin e arritjes zyrtare të udhëheqësit të shtetit të huaj ose të përfaqësuesit të autorizuar të organizatës ndërkombëtare në Republikën e Kosovës, përkatësisht me rastin e solemnitetit të ndarjes kur shkojnë nga Republika e Kosovës;
   c) rregullat më të hollësishme të përdorimit të flamurit shtetëror të përcaktuara në pikën 1 dhe 2, parashihen në ceremonialin e protokollit të shtetit.

7.3. Flamuri shtetëror vendoset po ashtu:
   a) me rastin e takimeve vendore dhe ndërkombëtare, tubimeve publike, garave sportive, kulturore dhe garave tjera, shfaqjeve humanitare, ushtarake, dhe tjera si dhe në të cilat Republika e Kosovës paraqitet, përkatësisht në të cilat merr pjesë;
   b) me rastin e festave zyrtare.

7.4. Flamuri shtetëror mund të vendoset:
   a) me rastin e ditëve përkujtimore;
   b) të manifestimeve publike që janë të rëndësishme për Republikën e Kosovës, dhe të cilat i përcakton Qeveria;
   c) në rastet tjera, nëse përdorimi i flamurit nuk është në kundërshtim me këtë ligj.

7.5. Në të gjitha rastet e vendosjes së flamurit shtetëror, krahas flamujve tjerë, flamuri shtetëror i Republikës së Kosovës nuk mund të jetë në përmasa më të vogla se flamujt e tjerë.
7.6. Ndalohet vendosja publike e flamujve nëse janë të vjetruar apo të dëmtuar.

Neni 8
Vendosja e flamurit shtetëror në raste të veçanta

8.1. Në rastet e ditëve të zisë të shpallura në Republikën e Kosovës, flamuri shtetëror ngrihet në gjysmështizë. Mënyra e vendosjes dhe heqjes së flamurit shtetëror përcaktohet me akt përkatës nënligjor të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
8.2. Flamuri i mbajtur në dorë nga njësitë e Forcave të Sigurisë së Republikës së Kosovës (FSK) nuk vendoset asnjëherë në gjysmështizë.
8.3. Ngritja e flamurit në FSK, policore, kufitare apo të ngjashme, bëhet me respekt dhe solemnitet të veçantë, sipas rregulloreve të propozuara nga ministritë përkatëse dhe të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
8.4. Në ceremoni shtetërore funebre, flamuri përdoret për të mbuluar arkivolin. Në asnjë mënyrë nuk lejohet që flamuri të futet në varr apo të prekë tokën gjatë ceremonisë.
8.5. Flamuri ngritët dhe zbritet, vendoset dhe hiqet, përkatësisht bartet me rastin e ngjarjeve zyrtare me nderime të zakonshme, në përputhje me dispozitat për nderimin e flamurit.

Neni 9
Renditja e flamujve

9.1. Nëse flamuri shtetëror i Republikës së Kosovës është i vendosur krahas ndonjë flamuri tjetër, shikuar përpara, duhet të jetë gjithmonë në të majtë.
9.2. Nëse flamuri shtetëror i Republikës së Kosovës është i vendosur bashkë me dy ose me më shumë flamuj tjerë në shtiza të kryqëzuara, shikuar nga përpara, duhet të jetë shtiza me flamurin e Republikës së Kosovës e vendosur para shtizave të atyre flamujve.
9.3. Kur flamuri shtetëror shpaloset bashkë me ndonjë flamur tjetër, flamuri shtetëror qëndron në vendin e nderit në anën e djathtë. Flamuri tjetër ose të tjerët, vendosen në të majtë të tij, me të njëjtat përmasa dhe largësi shtize.
9.4. Vendosja në zyrat publike e një ose më shumë flamujve të huaj krahas flamurit shtetëror të Republikës së Kosovës bëhet vetëm në rastet e ceremonive zyrtare ose takimeve dy ose më shumëpalëshe me delegacione të huaja të nivelit të lartë dhe në raste kur nënshkruhen marrëveshje zyrtare.
9.5. Kur flamuri shtetëror vendoset pranë një foltoreje, duhet të qëndrojë lart, pas vendit të folësit, ose kur është në shtizë, në të djathtë të tij. Flamurët e tjerë vendosen në të majtë të folësit.
9.6. Nëse në ndërtesa të ndryshme, flamuri shtetëror shpaloset bashkë me flamuj të tjerë në institucione qendrore apo lokale, ata duhet vendosur në pikën më të lartë ose me shtizën më të lartë, në krahasim me flamuj tjerë. Asnjë flamur tjetër nuk duhet të vendoset më lart se flamuri shtetëror apo në të djathtë të tij.

9.7. Në takime ndërkombëtare shumëpalëshe, flamujt e këtyre vendeve vendosen në të majtë të flamurit shtetëror dhe radha e tyre përcaktohet sipas rendit alfabetik.

9.8. Nëse flamuri është i vendosur bashkë me më shumë flamuj të tjerë, flamuri shtetëror është:

a) në mesin e rrethit, ashtu që mund të shihet qartë nëse flamujt janë të renditur në rreth;
b) në mesin e gjysmërrethit nëse flamujt janë të renditur në gjysmërreth;
c) në krye të kolonës nëse flamujt janë të renditur në kolonë;
d) në vendin e parë të rreshtit, përkatësisht, shikuar përpara, në të majtë nëse flamujt janë renditur në rresht;
e) në krye të grupit nëse flamujt janë renditur në grup.

Neni 10
Flamujt dallues të institucioneve

10.1. Për të vënë në pah dallimin dhe identifikimin e tyre, të drejtë në flamur dallues kanë institucionet në vijim:

a) Kryetari i Republikës së Kosovës;
b) Qeveria e Republikës së Kosovës;
c) Ministria për FSK;
d) Ministria e Punëve të Brendshme;
e) Ministria e Punëve të Jashtme;
f) Forcave të Sigurisë së Republikës së Kosovës;
g) Trupat Mbrojtëse të Republikës së Kosovës;
h) Policia e Republikës së Kosovës;dhe
i) Komunat e Republikës së Kosovës.

10.2. Flamuri dallues i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni përfshin në vetvete të gjithë të tjerët. Flamuri i Kryetarit të Republikës së Kosovës është flamur i parë.

10.3. Flamujt dallues të institucioneve vendosen në selitë e institucioneve që i përkasin, krahas flamurit shtetëror.

KREU III
STEMA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 11
Vendosja e stemës

11.1. Stema e Republikës së Kosovës vendoset:

a) në hyrje të institucioneve shtetërore, së bashku me emërtesën e tyre;
b) në të gjitha aktet zyrtare;
c) në vulat e institucioneve shtetërore;
d) në dokumentet dhe marrëveshjet ndërshtetërore të Republikës së Kosovës në bazë të reciprocitetit.

Neni 12
Përdorimi i stemës

12.1. Përdorimi i stemës së Republikës së Kosovës është e drejtë ekskluzive e organeve shtetërore.

12.2. Stema e Republikës së Kosovës përdoret si shenjë identifikimi:

a) në vula, stampila, shenjëzime të dokumenteve dhe në shenjat e organeve shtetërore;
b) në dokumentet e statusit civil dhe në dokumentet personale;
c) në diplomat dhe në dëftesat për shkollimin e përfunduar;
d) për shenjëzimin e kufirit shtetëror, në rajonet e kalimeve kufitare dhe në objektet e organeve shtetërore si dhe në hapësirat e këtyre organeve;
e) në hapësirat dhe ndërtesat, ku është selia e organeve shtetërore si dhe në hapësirat e këtyre organeve;
f) në hapësirat dhe ndërtesat e përfaqësive diplomatike e konsullore të Republikës së Kosovës jashtë shtetit dhe në mjetet transportuese, që i përdorë udhëheqja e përfaqësive, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, me dispozitat e shtetit, në të cilin është përfaqësia, përkatësisht me rregullat dhe praktikën e organizatës ndërkombëtare, në të cilat është akreditуar misioni;
g) në vulën, stampilat si dhe te shenjëzimet e dokumenteve të organeve lokale kur kryejnë detyra të veçanta, përkatësisht detyra nga kompetencat shtetërore;
h) në vulën, stampilat si dhe në shenjëzimet e dokumenteve, të ndërmarrjeve dhe të organizatave tjera private, që kanë autorizime publike kur kryejnë detyra të veçanta, përkatësisht detyra të caktuara nga kompetencat shtetërore;
i) në ftesa, urime, vizitë-karta, kartat zyrtare të identifikimit të cilat i përdorin Presidenti i Republikës së Kosovës, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kryeministri, ministrat dhe udhëheqësit e përfaqësive të Republikës së Kosovës jashtë vendit;
j) në ftesa, urime, vizitëkarta, kartat e ngjashme zyrtare të identifikimit, të cilat i përdorin deputetët, funksionarët si dhe nëpunësit e organeve shtetërore;
k) me rastin e takimeve ndërkombëtare sportive, kulturore dhe garave tjera, tubimeve humanitare dhe shfaqjeve e tubimeve të tjera, në të cilat Republika e Kosovës paraqitet, përkatësisht në të cilat merr pjesë, në përputhje me rregullat dhe zakonet e tubimeve të tilla;
l) me stemë shenjëzohen edhe fluturaket dhe mjetet tjera të transportit publik, sipas kushteve dhe në mënyrën, që i përcaktojnë dispozitat e akteve të përgjithshme juridike;
m) në raste të tjera dhe në kushte, të cilat i përcakton ligji;
n) në rastet tjera, nëse përdorimi i stemës nuk është në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 13
Renditja e stemave

13.1. Stema e Republikës së Kosovës kur paraqitet me stema shtetesh të tjera vendoset në vendin më të dukshëm ose në të njëjtin vend me to.
13.2. Nëse stema e Republikës së Kosovës përdoret krahas stemës tjetër, shikuar përpara, duhet të jetë gjithmonë në të majtë. Përjashtimisht, guxon të jetë në anën e djathtë të stemës së shtetit të huaj ose të shenjës adekuate të organizatës ndërkombëtare, kur kjo stemë, përkatësisht kjo shenjë përdoret me rastin e vizitës zyrtare të udhëheqësit të shtetit të huaj, përkatësisht përfaqësuesit të autorizuar të organizatës ndërkombëtare.
13.3. Nëse stema e Republikës së Kosovës përdoret bashkë me dy stemat tjera, përkatësisht shenja tjera, stema e Republikës së Kosovës është në mes.
13.4. Nëse stema e Republikës së Kosovës përdoret me më shumë stema të huaja dhe vendore, përkatësisht shenja adekuate të organizatave ndërkombëtare ose me shenjëzime të ngjashme të ndryshme, stema e Republikës së Kosovës është:
   a) në mes të rrethit dhe mund të shihet qartë, në rast se stemat dhe shenjat janë të renditura në rreth;
   b) në mes të gjysmërrethit, dhe mund të shihet qartë, nëse stemat dhe shenjat janë të renditura në gjysmërreth;
   c) në krye të kolonës, nëse stemat dhe shenjat janë të renditura në kolonë;
   d) në vendin e parë, përkatësisht shikuar përpara, në anën e majtë, nëse stemat dhe shenjat janë renditur në rresht;
   e) në krye të grupit, nëse stemat dhe shenjat janë të renditura në grupe.

KREU IV
HIMNI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 14
Intonimi/ekzekutimi i himnit shtetëror të Republikës së Kosovës

14.1. Himni shtetëror i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: himni) intonohet/ekzekutohet, në ceremonitë zyrtare, në çdo veprimtari ndërkombëtare, ku vendi ynë është palë, si dhe në raste të tjera të përcaktuara me ligjet përkatëse.
14.2. Kur intonohet/ekzekutohet himni, merret drejtqëndrim.
14.3. Himni nuk intonohet/ekzekutohet asnjëherë në mjediset publike pa prezencën e flamurit, me përjashtim, kur ekzekutohet në televizion ose në radio.
14.4. Në ceremonitë solemne, festive dhe të përfaqësimit, intonohet/ekzekutohet vetëm strofa e parë dhe refreni i himnit.
14.5. Himni mund të intonohet/ekzekutohet:
   a) me rastin e solemnitetit zyrtar kur Kryetari i Republikës së Kosovës shkon nga Republika e Kosovës në shtetet e huaja dhe në rastin e pritjes kur kthehet në Republikën e Kosovës;
   b) me rastin e arritjes dhe përcjelljes së kryetarëve të shteteve të huaja ose të zyrtarëve të lartë apo përfaqësueseve të autorizuar të organizatave ndërkombëtare;

c) me rastin e vënies së kurorave, të cilat i vënë përfaqësuesit zyrtar të Republikës së Kosovës, përkatësisht përfaqësuesit e shteteve të huaja ose të organizatave ndërkombëtare pranë përmendoreve, në varreza të dëshmoreve apo të ngjashme;

14.6. Çdo banor i Republikës së Kosovës ka të drejtë të këndojë himnin.

Neni 15
Renditja e intonimit/ekzekutimit të himneve

15.1. Kur himni shtetëror i Republikës së Kosovës intonohet/ekzekutohet së bashku me himnin e një vendi tjetër, përparësi ka himni i vendit tjetër.

15.2. Vizita zyrtare e një presidenti ose kryeministri të huaj shoqërohet me intonimin/ekzekutimin e himneve shtetërore të të dy vendeve. Himni interpretohet pas himnit mik.

15.3. Gjatë intonimit/ekzekutimit të himnit, FSK mbajnë drejtqëndrim ose sipas rastit nderojnë me armë. Ushtarakët nderojnë flamurin sipas rregullave ushtarake, kurse autoritetet civile dhe të gjithë sa janë prezentë ngrihen në këmbë dhe mbajnë drejtqëndrim.

15.4. Nëse ndodh të intonohen/ekzekutohen më shumë se dy himne, radha e tyre caktohet sipas rendit alfabetik të vendeve pjesëmarrëse në takim, por mund të caktohen edhe kritere të tjera.

15.5. Nëse intonohen/ekzekutohen më shumë se dy himne, himni i Republikës së Kosovës interpretohet i fundit për arsye mikpritje.

15.6. Himni nuk duhet të intonohen/ekzekutohet në atë mënyrë që do ta cenonte nderin dhe prestigjin e Republikës së Kosovës.

15.7. Himni nuk lejohet të intonohet/ekzekutohet për qëllime marketingu, përkatësisht të reklamimit të shërbimeve.

Neni 16
Përdorimi i simboleve shtetërore të Republikës së Kosovës nga personat tjerë juridikë

16.1. Pjesë të simboleve shtetërore mund të përdoren si pjesë përbërëse e emblemave dhe shenjave tjera të personave juridikë (publikë dhe privatë), me kusht që me këtë nuk është cenuar prestigji i Republikës së Kosovës.

16.2. Përdorimi i simboleve shtetërore të Republikës së Kosovës lejohet në krijimtarinë artistike dhe muzikore dhe për qëllime edukativo-arsimore, me kusht që të mos cenohet prestigji dhe nderi i Republikës së Kosovës.

16.3. Simbolet shtetërore të Republikës së Kosovës ose pjesët përbërëse të tyre, ndalohet të bëhen shenjë mbrojtëse ose të përdoren si shenjëzim, model, përkatësisht mostër (ekzemplarë) si dhe të shenjëzimit të mallit ose të prodhimit.

16.4. Qeveria e Republikës së Kosovës mund të nxjerr aktet përkatëse nënligjore për zbatimin e paragrafëve paraprak.

KREU V
DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 17
Sanksionet kundërvajtëse

17.1. Me gjobë prej 500 – 1000 euro do të ndëshkohet personi juridik në rast se:
   a) e përdor stemën apo flamurin në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 2 të këtij ligji;
   b) e përdor stemën apo flamurin në formë apo përmbajtje, e cila nuk është përcaktuar me këtë ligj si dhe me dispozitat ligjore në fuqi;
   c) në vend publik shpalos stemën apo flamurin të vjetruara, në formë të parregullt, të dëmtuara apo në ndonjë mënyrë tjetër të dëmtuar;
   d) nuk përdor stemën apo flamurin kur përdorimi është i detyrueshëm;
   e) ekzekutimin e himnit të Republikës së Kosovës në kundërshtim me paragrafin 6 të nenit 15 të këtij ligji dhe dispozitave ligjore në fuqi.

17.2. Për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni do të shqiptohet gjoba nga 250-500 euro zyrtarit përgjegjës të personit juridik.

17.3. Për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni do të shqiptohet gjoba nga 250-500 euro personit përgjegjës në organet shtetërore.

17.4. Me gjobë prej 150 - 300 euro do të ndëshkohet personi fizik për shkeljet nga pikat a, b, c, d dhe e të këtij neni.

Neni 18
Aktet përkatëse nënligjore

Qeveria e Republikës së Kosovës, sipas nevojës nxjerr aktet përkatëse nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 19
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës
Me datën: 20.02.2008

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III / Nr. 26 / 02 QERSHOR 2008

LIGJI Nr. 03/L-174
PËR FINANCIMIN E SUBJEKTEVE POLITIKE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR FINANCIMIN E SUBJEKTEVE POLITIKE

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj rregullon mënyrën, kushtet e financimit, administrimin, mbikëqyrjen, transparencën dhe raportimin për shpenzimin e pasurisë dhe të ardhurave të subjekteve politike në Republikën e Kosovës.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **Administrim** - organizimi, drejtimi, përdorimi, kujdesi dhe shpenzimi me mirëbesim i pasurisë nga subjektet politike;
   1.2. **Fletë bilanci** - deklarimi financiar i pasurisë, të ardhurave dhe detyrimeve të subjekteve politike;
   1.3. **Fondi për mbështetjen e subjekteve politike-Fondi -** fondi për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës i cili funksionon në kuadër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
   1.4. **KQZ** - Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;
   1.5. **Kontributet -** dhuratat (donacionet) ose ndihma e cilitdo lloj që i jepet subjektit politik, qoftë në para të gatshme apo në të mira tjera materiale;
   1.6. **Kuotë anëtarësie** - shumë e caktuar e të hollave, që paguhet çdo muaj ose çdo vit për anëtarësinë në një organizatë;
   1.7. **Parti politike -** çdo parti politike e regjistruar dhe e certifikuar nga organi kompetent për regjistrim dhe certifikim;
   1.8. **Pasuri -** tërësia e sendeve, e mjeteve materiale, parave dhe e vlerave tjera që ka një subjekt politik**;**
   1.9. **Përfaqësuesi financiar -** personi përgjegjës për mbajtjen e shënimeve financiare të subjektit politik;
   1.10. **Subjekti politik -** parti politike, koalicion, nismë qytetare ose kandidat i pavarur;

1.11. **Subjekt i certifikuar politik -** subjekti i certifikuar politike nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përputhje me ligjin në fuqi dhe me rregullat e KQZ-së;
1.12. **Shpenzimet për fushatë -** të gjitha shpenzimet dhe pagesat e bëra për mallra dhe shërbime në pajtim me ligjin për zgjedhjet e përgjithshme;
1.13. **Të ardhura -** çdo shumë monetare që subjekti politik ka pranuar nga personat fizik dhe juridik, kuota e anëtarësisë dhe Buxheti i Republikës së Kosovës.

Neni 3
Statusi i subjektit politik

Subjekti politik është person juridik jo fitimprurës.

Neni 4
Burimet financiare dhe materiale

1. Burimet financiare dhe materiale të subjekteve politike përbëhen nga:
   1.1. kuota (pagesat) e anëtarësisë;
   1.2. kontributet
   1.3. financimi nga Buxheti i Republikës së Kosovës;
   1.4. çdo pasuri e fituar në mënyrë të paraparë me këtë ligj;
   1.5. të ardhurat nga aktivitetet e subjektit politik të përcaktuara me nenin 6 të këtij ligji.

Neni 5
Kontributet për subjektet politike

1. Subjektet Politike lejohen të marrin kontribute nga:
   1.1. personat fizikë, në vlerë prej, jo më shumë se dy mijë (2.000) Euro për një (1) vit kalendarik.
   1.2. personat juridikë në vlerë prej - jo më shumë se dhjetëmijë (10.000) Euro për një (1) vit kalendarik.
2. Subjekti politik i cila pranon një kontribut, origjinën dhe prejardhjen e të cilit, kontributdhënësi, nuk mund ta dëshmojë, detyrohet, që brenda dy (2) javë, t'i njoftojë organet kompetente për vërtetimin e prejardhjes së këtij kontributi.
3. Nëse nuk mund të dëshmohet prejardhja e kontributit, kjo vlerë mbetet në Buxhetin e Republikës së Kosovës.
4. Ndalohen harxhimet e burimeve financiare, të referuara në paragrafët e mësipërm për përfitime personale.

Neni 6
Të ardhurat nga aktivitetet e subjekteve politike

1. Subjekti politik nuk mund të ushtrojë veprimtari financiare fitimprurëse, përveç shitjes së të mirave siç janë: publikimet, botimet, shitja e materialeve reklamuese,

posterëve me emblemën ose akronimin e subjektit politik dhe burimeve të tjera të lejuara me ligj.
2. Të gjitha të hyrat dhe të dalat nga aktivitetet financiare të subjekteve politike duhet të regjistrohen në regjistrat financiare.

Neni 7
Fondi për mbështetjen e subjekteve politike

1. Financimi publik i subjekteve politike bëhet përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës, nga Fondit për mbështetjen e subjekteve politike.
2. Fondi për mbështetjen e subjekteve politike funksionon në kuadër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Shuma e mjeteve buxhetore dedikuar Fondit për mbështetjen e subjekteve politike nuk mund të kalojë (0.17%) të Buxhetit të Kosovës.
4. Burimet financiare publike, nga buxheti i Republikës së Kosovës, shfrytëzohen për financimin e aktiviteteve parazgjedhore e zgjedhore, financimin dhe punën e Grupeve Parlamentare dhe financimin e aktiviteteve të rregullta të subjekteve politike.
5. Ndarja e mjeteve të Fondit bëhet në bazë të kritereve të parapara në nenin 9 të këtij ligji.

Neni 8
Qëllimi i përdorimit të mjeteve nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike

1. Mjetet nga Fondi mund të përdoren për këto qëllime:
   1.1. financimi i aktiviteteve të subjekteve politike;
   1.2. financimi i degëve të subjekteve politike;
   1.3. për shpenzime materiale vjetore të deputetëve dhe punën e Grupeve Parlamentare për aktivitete partiake;
   1.4. për shpenzime për zgjedhjet lokale dhe qendrore, dhe zgjedhjet e jashtëzakonshme të subjekteve politike.

Neni 9
Ndarja e mjeteve financiare publike

1. Për financimin e aktiviteteve të rregullta të subjektit politik, mjetet nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike, ndahen në mes të subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend në bazë të numrit të ulëseve për atë mandat.
2. Nëse një deputet vendos të largohet nga subjekti politik, ku ka fituar mandatin, nuk do të bartë mjetet financiare të ndara nga Fondi për atë mandat në subjektin e ri politik.
3. Subjekti politik për të përfituar nga ky fond duhet që kërkesës së tij t'ia bashkëngjes një deklaratë financiare për vitin paraprak.

Neni 10
Ndarja e mjeteve financiare për fushatat zgjedhore

1. Për financimin e fushatës zgjedhore qendrore dhe lokale, për zgjedhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme, Kuvendi, nga Fondi, ndan mjete me propozim të Qeverisë por jo më shumë së 0.05% të buxhetit të Kosovës.
2. Mjetet për financimin e fushatës para zgjedhore ndahen për subjektet politike të cilat marrin pjesë në zgjedhje sipas këtyre kritereve:
   2.1. 90% e mjeteve financiare ndahen në bazë të numrit të vendeve në Kuvend:
      2.1.1. për zgjedhjet qendrore në bazë të vendeve në zgjedhjet e fundit qendrore;
      2.1.2. për zgjedhjet lokale në bazë të vendeve në Kuvendet Komunale në zgjedhjet e fundit lokale;
   2.2. 10% e mjeteve financiare ndahen proporcionalisht për subjektet politike të posa regjistruara dhe të certifikuara për zgjedhjet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 11
Ndalimi i ndihmave financiare

1. Ndalohet ndihma financiare dhe materiale nga:
   1.1. institucionet qeveritare dhe joqeveritare të huaja, si dhe personat fizikë dhe juridik të huaj;
   1.2. personat anonim fizik dhe juridik;
   1.3. dhuruesit (donatorët) anonim;
   1.4. institucionet dhe ndërmarrjet me kapital të fituar nga bixhozi, bastoret e ndryshme apo lojërat e fatit, si dhe nga;
   1.5. entet vendase publike ose me pjesëmarrje të kapitalit shtetërorë.
2. Ndërmarrjet publike nuk mund t'i përkrahin financiarisht subjektet politike.

Neni 12
Ndalimi i ushtrimit të presionit

1. Ndalohet ushtrimi i çfarëdo forme të presionit politik në personat fizik dhe juridik për mbledhjen e kontributeve për subjektet politike.
2. Ndalohet premtimi i privilegjeve apo përfitimeve personale kundërligjore ndaj dhuruesit (donatorit) të ndonjë subjekti politik.

Neni 13
Mbledhja e mjeteve

1. Subjekti politik, përveç pagesës nga kuota e anëtarësisë, ka të drejtë të fillojë të mbledh mjete për shpenzimet e saj zgjedhore, jo më shumë se gjashtë (6) muaj, para fillimit të fushatës zgjedhore.
2. Subjekti Politik, për qëllimet e parapara me paragrafin 1. të këtij neni, e hapë një llogari bankare të veçantë, në njërën nga bankat komerciale të regjistruara në Republikën e Kosovës,

3. Subjekti Politik është i detyruar të mbajë shënime të sakta për prejardhjen, strukturimin dhe qarkullimin e shumave të mjeteve të mbledhura.

Neni 14
Përgjegjësia për shfrytëzimin e mjeteve

1. Subjekti Politik cakton një zyrtar të autorizuar financiar i cili mban përgjegjësinë:
   1.1. për regjistrimin e të ardhurave;
   1.2. për shpenzimet e mjeteve;
   1.3. për dorëzimin e raportit final të mjeteve të harxhuara;
   1.4. për dorëzimin e Raportit të Deklarimit Financiar të Fushatës; dhe
   1.5. për detyrimet tjera lidhur me të ardhurat, shpenzimet, paraqitjen e qëllimeve dhe ndarjen e shumës së mjeteve të subjektit.
2. Zyrtari i autorizuar financiar i subjektit politik dhe kryetari i subjektit politik janë ligjërisht përgjegjës për saktësinë e të gjitha informatave të dorëzuara në KQZ-së dhe Institucionet tjera ashtu siç kërkohet me ligj.

Neni 15
Raportimi financiar

1. Subjektet e regjistruara politike ia dorëzojnë KQZ-së për çdo vit raportin vjetor financiar për, më së largu deri më 1 mars të vitit vijues në mënyrën e paraparë nga KQZ – ja.
2. Secili raport financiar vjetor përmban:
   2.1. bilancin e gjendjes, i cili tregon pasurinë, detyrimet dhe kapitalin e partisë, duke përfshirë të gjitha degët e saj në ditët e para dhe të fundit të periudhës së përfshirë në raport.
   2.2. pasqyrën e fitimit dhe të humbjeve, e cila tregon të hyrat dhe shpenzimet e partisë, duke përfshirë të gjitha degët e saj gjatë periudhës së përfshirë në raport, dhe
   2.3. pasqyrën e cila tregon çdo pagesë që i është bërë personit tjetër gjatë periudhës së përfshirë në raport, nëse vlera e përgjithshme e të gjitha pagesave që i janë bërë atij personi gjatë kësaj periudhe tejkalon pesëmijë (5.000) Euro, duke shënuar edhe qëllimin e pagesës.
3. Çdo raport financiar vjetor përmban kopjet e dokumentacionit vijues:
   3.1. pasqyrën financiare të subjektit politik të regjistruar për periudhën e përfshirë në raport;
   3.2. faturat për të gjitha shpenzimet që tejkalojnë shumën prej njëqind (100) Eurosh;
   3.3. bilancet bankare për çdo llogari bankare të subjektit politik të regjistruar ose llogarive në emër të saj, dhe
   3.4. regjistrin e të gjitha kontributeve për subjektin e regjistruar politike të dhëna nga një burim i vetëm, nëse vlera e përgjithshme e kontributeve nga ai burim ka tejkaluar shumën prej njëqind (100) Eurosh gjatë periudhës së përfshirë në raport, i cili tregon:
      3.4.1. vlerën e secilit kontribut të dhënë subjektit politik;

3.4.2. datën kur është dhënë secili kontribut, dhe
3.4.3. emrin e plotë, adresën dhe numrin personal, të pasaportës ose të patentë shoferit të kontribuesit.

3.5. subjektet politike që pranojnë kontribute nga Ndërmarrjet Private, të cilat, përmes kontratave me Institucionet e shtetit, kryejnë shërbime, duhet të përgatisin një listë të veçantë të kontributeve të pranuara.

4. KQZ-ja duhet ti publikoj të gjitha raportet vjetore financiare së bashku me deklaratën e auditimit të subjekteve politike në faqen zyrtare të saj.

Neni 16
Tatimi i të ardhurave të subjekteve politike

1. Të ardhurat nga kuota e anëtarësisë dhe të ardhurat e përcaktuara në nenin 6, nuk tatohen.
2. Të ardhurat tjera të subjekteve politike tatohen.

Neni 17
Kontrolli i brendshëm

1. Subjektet Politike janë të detyruara të definojnë në Statut mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj.
2. Subjektet Politike duhet të definoje qartë, me Statut, të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare.

Neni 18
Mospagimi i detyrimeve

Në rastet kur një subjekt politik nuk paguan detyrimet si gjoba, dënime gjyqësore, fatura etj., atëherë shuma përkatëse i zbritet nga buxheti që i ndahet nga Fondi për mbështetje subjekteve politike.

Neni 19
Kontrolli financiar

1. KQZ-ja e bënë kontrollin e secilit raport financiar vjetor.
2. KQZ-ja e kryen kontrollin në përputhje me standardet e kontabilitetit të zbatueshëm në Kosovë.
3. Subjekti i regjistruar politik bashkëpunon ngushtë me revizorët e KQZ - së dhe u ofron atyre qasje të plotë dhe të papenguar në shënimet financiare të partisë, duke përfshirë të gjitha shënimet pa kufizime.
4. KQZ - ja ia paraqet rezultatet paraprake të kontrollimit të raportit vjetor financiar organit më të lartë ekzekutiv të subjektit politik, duke përfshirë edhe listën e gabimeve ose lëshimeve brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga fillimi i kontrollimit.
5. Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e rezultateve paraprake të kontrollimit mund ta dorëzojë raportin e rishikuar

financiar dhe shpjegimin lidhur me çdo gabim të dukshëm ose lëshim të identifikuar nga KQZ - ja.

6. KQZ - ja përgatit raportin përfundimtar të revizionit partisë së regjistruar politike brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga dorëzimi i raportit paraprak të revizionit. Raporti përfundimtar identifikon çdo gabim ose lëshim në raportin financiar, duke marrë parasysh çdo shpjegim ose rishikim të dorëzuar.
7. Pas kryerjes së raportit përfundimtar të kontrollimit, KQZ - ja ia dorëzon një kopje të organit më të lartë të partisë së regjistruar politike.
8. KQZ-ja përgatit një raport vjetor për Kuvendin e Republikës së Kosovës për shpërndarjen dhe shpenzimin e mjeteve nga Fondi.

Neni 20
Ndarja e pasurisë

1. Në rastin e ndarjes së subjekteve politike, ndarja e pasurisë bëhet me marrëveshje.
2. Kur nuk ka marrëveshje të subjekteve politike, ndarja e pasurisë bëhet përmes gjykatës kompetente.

Neni 21
Dispozitat ndëshkimore

1. Subjekti politik do të gjobitet prej tremijë (3.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro, ndërsa, Kandidatët për deputet dhe këshilltarë si dhe kandidatët e pavarur do të gjobitet prej pesëqind (500) deri në tremijë (3.000) Euro, për cenim të dispozitave të këtij ligji, në qoftë se:
   1.1. pranon mjete financiare në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;
   1.2. mban shënimet në regjistrat e veta në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;
   1.3. nuk i përmbahen dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave tjera të ligjeve tjera në fuqi, për zgjedhjet e përgjithshme dhe zgjedhjet lokale.
2. Një subjekt politik, i cili nuk e paraqet raportin vjetor financiar KQZ - së brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, humb të drejtën për të përfituar nga fondi në vitin e ardhshëm.
3. Personi përgjegjës brenda subjektit politik, dënohet në shumë prej treqind (300) deri në njëmijë (1.000) Euro për cenim e dispozitave të këtij ligji.
4. Të hyrat nga gjobat sipas këtij ligji derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Neni 22
Paraqitja e pasurisë

Subjekti politik detyrohet të paraqesë në KQZ të gjitha të dhënat për pasuritë e tij, të kategorizuara sipas vlerës, llojit dhe origjinës.

Neni 23
Organi përgjegjës për nxjerrjen e akteve nënligjore

APK, KQZ dhe Qeveria, sipas nevojës nxjerrin akte të veçanta për zbatimin e këtij ligji.

Neni 24
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen të gjitha dispozitat që rregullojnë çështjet e financimit të subjekteve politike, të cilat janë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 25
Hyrja në fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-174
16 shtator 2010

Ligji shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 82 / 21 TETOR 2010

LIGJI Nr. 04/L-058
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-174 PËR FINANCIMIN E SUBJEKTEVE POLITIKE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-174 PËR FINANCIMIN E SUBJEKTEVE POLITIKE

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010).

Neni 2

1. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 3. ndryshohet dhe riformulohet si vijon:
   3. Shuma e mjeteve buxhetore dedikuar Fondit për mbështetjen e subjekteve politike nuk mund të kalojë 0.34% të Buxhetit të Republikës së Kosovës.
2. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 4.fshihet nga teksti i ligjit

Neni 3

Neni 8 i ligjit bazik, paragrafi 1. ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

1. Mjetet nga fondi mund të përdoren për këto qëllime:
   1.1. financimin e aktiviteteve të rregullta të subjekteve politike;
   1.2. financimin e degëve të subjekteve politike;
   1.3. financimin e njësive përkatëse të organizimit të grave dhe të rinjve të subjekteve politike;
   1.4. financimin e aktiviteteve parazgjedhore e zgjedhore të subjekteve politike;
   1.5. financimin e aktiviteteve të grupeve parlamentare.

Neni 4

1. Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 2. nën-paragrafi 2.2. ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:
   2.1. 10% e mjeteve financiare ndahen proporcionalisht për subjektet e tjera politike të regjistruara dhe të certifikuara nga Komisioni qendror i zgjedhjeve, për zgjedhjet përkatëse.
2. Neni 10 i ligjit bazik, pas paragrafit 2. shtohet një paragraf i ri 3. me tekstin si në vijim:
   3. Subjekti politik i cili përfiton mjete financiare në pajtim me paragrafin 2. të nenit 10 të këtij ligji, nëse nuk merr pjesë në zgjedhjet përkatëse, është i obliguar ti kthejë mjetet në buxhetin e Kosovës.

Neni 5

Neni 11 i ligjit bazik, pas paragrafit 2. shtohet një paragraf i ri 3. me tekstin si vijon:

3. Ndalohet dhënia e donacioneve nga të cilat dhuruesi në mënyrë të qartë mund të përfitoj ndonjë avantazh ekonomik. Donacionet e personave fizik dhe juridik për subjekte politike duhet të bëhen në mënyrë transparente në llogari bankare dhe duhet të përfshihen në raportet financiare të subjekteve politike përfituese. Raporti financiar i subjekteve politike duhet të përmbajë emrin dhe numrin e regjistrimit për personat juridike apo emrin, mbiemrin dhe adresën për personat fizikë.

Neni 6

Neni 15 i ligjit bazik, pas paragrafit 4. shtohet një paragraf i ri 5. me tekstin si në vijim:

5. KQZ-ja përgatit raport vjetor për Kuvendin e Republikës së Kosovës për shpërndarjen dhe shpenzimin mjeteve nga Fondi, më sa largu deri me datën 30 qershor të vitit pasardhës.

Neni 7

Neni 21 i ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

1. Subjekti politik gjobitet në shumën prej pesëmijë (5.000) deri në pesëdhjetëmijë (50.000) Euro, ndërsa kandidati për kryetar komune, kandidati për deputet, këshilltar komunal dhe kandidati i pavarur, gjobitet prej njëmijë (1.000) deri në pesëmijë (5.000) Euro, për shkelje të dispozitave të këtij ligji në qoftë se:
   1.1. pranon mjete financiare në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;
   1.2. mban shënimet në regjistrat e veta në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;
   1.3. nuk i përmbahen dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave tjera të ligjeve tjera në fuqi, për zgjedhjet e përgjithshme dhe zgjedhjet lokale.

2. Një subjekt politik, i cili nuk e paraqet raportin vjetor financiar KQZ-së brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, humb të drejtën për të përfituar nga fondi në vitin e ardhshëm.
3. Personat përgjegjës brenda subjektit politik dënohet me gjobë prej njëmijë (1.000) deri në pesë mijë (5.000) Euro.
4. Subjektet politike të cilat nuk mund të dëshmojnë origjinën e të hyrave mbi njëzetmijë (20.000) Euro do të gjobiten me trefishin e asaj shume.
5. Nëse në keqpërdorim të fondeve është i përfshirë kandidati apo subjekti politik dhe mund të vërtetohet se fitimi i mandatit/mandateve është si rezultat i keqpërdorimit të fondeve në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, kandidatit apo subjektit politik mund edhe t'i merret mandati.
6. Subjektet Politike kanë të drejtë ankese ndaj dispozitave ndëshkimore. Ankesat i drejtohen Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në bazë të legjislacionit në fuqi.
7. Të hyrat nga gjobat sipas këtij ligji derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Neni 8

Neni 23 i ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

KQZ sipas nevojës nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 9

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-058
21 dhjetor 2011

Shpallur me dekretin Nr. DL-055-2011, datë 30.12.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 01 / 12 JANAR 2012, PRISHTINË

LIGJI Nr. 2002/5
PËR THEMELIMIN E REGJISTRIT TË TË DREJTAVE TË PRONËS SË PALUAJTSHME

Kuvendi i Kosovës,

Në mbeshtetje të Kreut 9. Pjesa 9.1.26 /a/ te Rregullores nr.2001/9 te dt.25 maj 2001 për Kornizën Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë,

Miraton Ligjin si vijon:

Neni 1
Regjistri i të drejtave mbi pronën e paluajtshme

1.1. Regjistri i të drejtave të pronës së paluajtshme (në tekstin e mëtejmë: Regjistri), themelohet si mekanizem që njeh dhe zbaton vlefshmërinë e të drejtave të pronës së paluajtshme në Kosovë sipas ligjeve në fuqi.

1.2. Autorizohet Agjencia Kadastrale e Kosovës (ne tekstin e mëtejmë: ”AKK”) që të bëjë administrimin e gjithmbarshëm të Regjistrit në pajtim me dispozitat e ligjeve në fuqi. Zyrat Kadastrale të Komunave (në tekstin e mëtejmë:”ZKK”) do të regjistrojnë të drejtat e pronave të paluajtshme në Regjistër sipas autorizimit të AKK-së dhe në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe udhëzimeve administrative të nxjerra nga AKK-ja.

1.3. AKK-ja bën përcaktimin e nivelit të pagesave për shërbimet e bëra për regjistrimin e të të drejtave të pronave të paluajtshme të cilat inkasohen në ZKK.

Neni 2
Të drejtat e pronave të paluajtshme

2.1. Të drejtat e pronave të paluajtshme, ashtu siç rregullohen me dispozitat e ligjeve ne fuqi, që i takojnë tokës, ndërtesave dhe banesave (në tekstin e mëtejmë:”pronat e paluajtshme”) do të regjistrohen në Regjistër.

2.2. Të drejtat e pronave të paluajtshme përfshijnë:

a) pronësinë;
b) hipotekat;
c) servitutet;
d) të drejtat e shfrytëzimit të pronave shoqërore dhe pronave shtetërore.

Neni 3
Regjistrimi i të drejtave të pronave të paluajtshme

3.1. Kërkesat për regjistrimin e të drejtave të pronave të paluajtshme i parashtrohen me shkrim ZKK-së në territorin ku ndodhet prona e paluajtshme. ZKK-ja do të konfirmojë datën dhe kohën e pranimit të kërkesës për regjistrim.

3.2. Parashtruesi që kërkon regjistrimin e të drejtave të pronave të paluajtshme, kërkesës duhet t'ja bashkangjes dokumentacionin përkatës për të mbështetur të drejtën e pronës së paluajtshme siç kërkohet me ligjin në fuqi të përcaktuar me nenin 3.7 të këtij ligji.

3.3. ZKK-ja do të shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur dhe nëse ky dokumentacion nuk është i mjaftueshëm sipas ligjit në fuqi, ZKK-ja cakton afatin për parashtruesin për ta kompletuar dokumentacionin.

3.4. ZKK-ja e refuzon regjistrimin nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i mjaftueshëm të provojë se parashtruesi i kërkesës është bartës i:
   (i) të drejtës së pronës së paluajtshme, të kërkuar për regjistrim;
   (ii) nëse kërkesa dhe dokumentet mbështetëse përmbajnë parregullsi të dukshme;
   (iii) nëse validiteti i kërkesës ose ndonjë nga dokumentet mbështetës është në pyetje; dhe
   (iv) nëse dokumentacioni nuk është i kompletuar dhe nuk paraqet bazë për regjistrim.

3.5. ZKK-ja do të marrë vendim me shkrim në pajtim me nenet 3.3 deri 3.4.

3.6. Pa prejudikuar nenet 3.3 dhe 3.4, ZKK-ja bën regjistrimin e të drejtës mbi pronën e paluajtshme, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve, prej ditës së pranimit të kërkesës për regjistrim dhe lidhur me të do ta njoftojë parashtruesin e kërkesës. Regjistrimi hyn në fuqi kur vendimi për regjistrim i ZKK-së futet në Regjistër.

3.7. Pa prejudikuar nenin 1.2 (b) të Rregullores Nr. 1999/23, të UNMIK-ut (mbi Themelimin e Drejtorisë për Çështje pronësore-banesore dhe Komisionit për kërkesa pronësore-banesore) ZKK-ja do të regjistrojë të drejtën e pronës së paluajtshme në Regjistër vetëm nëse gjykata kompetente i ka dhënë dokumentin përkatës me shkrim ZKK-së për regjistrimin e të drejtës së pronës së paluajtshme në Regjistër.

Neni 4
Rishqyrtimi

4.1. Parashtruesi i kërkesës mundet që brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita qe është informuar me shkrim nga ZKK-ja, për refuzimin e regjistrimit te te drejtës se pronës se paluajtshme, të kërkojë nga ZKK-ja rishqyrtimin e vendimit.

4.2. ZKK-ja do të marrë vendim se a do të regjistrojë ose jo të drejtën e pronës së paluajtshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për rishqyrtim.

4.3. Kur ZKK-ja konstaton se parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për regjistrim, do të bëjë regjistrimin e këtij vendimi dhe do ta regjistroj të drejtën e pronës së paluajtshme në pajtim me të.

Neni 5
Korrigjimi i Regjistrit

5.1. Cilido person që pretendon se regjistrimi i të drejtës mbi pronën e paluajtshme nuk është i ligjshëm dhe se i cënon të drejtat e tij/saj mbi pronën e paluajtshme (në tekstin e mëtejmë: ”Kundërshtuesi”), mund të kërkojë nga ZKK-ja që ta plotësojë Regjistrin në bazë të kërkesës së tij. Regjistri do të plotësohet me futjen e vërejtjes në Regjistrin mbi të drejtat e pronës së paluajtshme të regjistruara.

5.2. Parashtrimi i vërejtjes nuk do të krijojë dhe as nuk do të zvogëlojë të drejtat ligjore të asnjë personi. Aq më tepër, vërejtja nuk mund të shërbejë si ndalesë për shitje apo qarkullim të pronës së paluajtshme, por çdo blerës do të njoftohet për vërejtjen apo interesin e Kundërshtuesit mbi pronën e paluajtshme të regjistruar.

5.3. Kërkesa e Kundërshtuesit do të shoqërohet me dokumentet e përcaktuara me nenin 3.2 më sipër. Procedura e paraparë me nenin 3.3 e deri më 3.5 do të zbatojë parimin *mutatis mutandis* për futjen e vërejtjes.

5.4. Pas zgjidhjes së kërkesës nga gjykata kompetente ose vendimit të Drejtorisë për Çështje Pronësore-Banesore, përkatësisht Komisionit për Çështje Pronësore-Banesore ose të ndonjë organi tjetër kompetent i cili mund të themelohet me ligje të mëvonshme, ZKK-ja do ta bëjë korrigjimin e Regjistrit.

Neni 6
Rishqyrtimi i vendimeve të ZKK-ve

6.1. Brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e marrjes së vendimit me shkrim të ZKK-së mbi refuzimin e regjistrimit të tëdrejtës së pronës së paluajtshme, parashtruesi i kërkesës mund të kërkojë nga AKK-ja të bëjë rishikimin e vendimit të ZKK-së.

6.2. Vendimi i AKK-së në pajtim me nenin 6.1 më lartë i nënshtrohet rishqyrtimit gjyqësor në pajtim me ligjet në fuqi.

Neni 7
Hyrja në fuqi e regjistrimit

7.1. Në momentin kur themelohet Regjistri, asnjë regjistrim mbi transferin e të drejtave të pronës të paluajtshme nuk do të jetë valid, përpos nëse është regjistruar më pajtim me ligjin aktual.

7.2. Futjet e të dhënave në Regjistrin e të drejtave të pronave të paluajtshme, supozohet të jenë të sakta, të vërteta dhe të ligjshme deri dhe nëse korrigjohen në bazë të procedurave të themeluara me këtë ligj. Të dhënat e futura në Regjistër do të jenë në dispozicion për të gjithë qytetarët.

Neni 8
Zbatimi

Ministria e Shëbimeve Publike do të nxjerrë urdhëresa administrative për zbatimin e këtij ligji.

Neni 9
Ligji ne fuqi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore që më parë kanë rregulluar këte çështje.

Nerni 10
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi I Kosovës dhe shpalljes se tij nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

UNMIK/REG/2002/22
20.12.2002

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III / Nr. 34 / 01 GUSHT 2008

LIGJI Nr. 2003/13
MBI NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E LIGJIT NR. 2002/5 MBI THEMELIMIN E REGJISTRIT TË TË DREJTAVE NË PRONËN E PALUAJTSHME

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të autoritetit të dhënë sipas neneve 9.1.26, 9.1.44 dhe 9.1.45 te Kornizës Kushtetuese mbi Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/19), Duke marrë parasysh se Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/22 mbi Shpalljen e Ligjit të Miratuar nga Kuvendi i Kosovës mbi Themelimin e Regjistrit të të Drejtave në Pronën e Paluajtshme, shpalli Ligjin Nr. 2002/5, me kusht që Ligji Nr. 2002/5 do të hyjë në fuqi pas shpalljes së legjislacionit plotësues të paraparë për njoftimin e vërtetë publik dhe masat tjera ruajtëse për mbrojtjen e personave të drejtat e të cilëve mund të ndikohen me regjistrim,

Me këtë miratohet ky Ligj, si vijon:

Neni 1

Në Ligjin nr. 2002/5, për themelimin e regjistrit të të drejtave në pronën e paluajtshme pikat 3.3.a, 3.3.b dhe 3.3.c do te shtohen ne fund te paragrafit 3.3:

3.3.a Çdo ZKK do të mbaj tabelën e shpalljeve publike ku do të afishohen kërkesat për regjistrim. Tabela e shpalljeve do të vendoset në vend të sigurt që është e arritshme dhe e dukshme për publikun gjatë orarit zyrtar të punës.

3.3.b Të paktën pesë (5) ditë pune para nxjerrjes së vendimit që lejon regjistrimin, ZKK do të afishoj njoftimin e kërkesës për regjistrim në tabelën e shpalljeve publike. Njoftimi do të përmbaj:

i. adresën e pronës, dhe nëse është e mundur, numrin e ngastrës kadastrale;
ii. të dhënat për personin prej të cilit bëhet bartja e të drejtës mbi pronën;
iii. të dhënat për personin që me regjistrim e fiton të drejten mbi pronën;
iv. e drejta që duhet të regjitrohet; dhe
v. datën deri kur çdo palë e interesuar mund të paraqet kundërshtimin te ZKK (qe do të jetë data e së paku pesë (5) ditë pune pas datës së afishimit në tabelën e shpalljeve publike).

3.3.c Para regjistrimit të çdo të drejte në ndërtesë apo banesë, ZKK do të bëjë një hetim te organi i duhur i Drejtorisë për Çështje Banesore dhe të Strehimit për të vërtetuar nëse është bërë kërkesë kundër ndërtesës apo banesës sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60 ose Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 dhe ZKK do të vendosë:

i. Të regjistroj të drejtën mbi pronën nëse nuk është bërë asnjë kërkesë, dhe afati i fundit për paraqitjen e kërkesave ka kaluar;
ii. Nëse kërkesa është bërë, ZKK do të refuzoj regjistrimin derisa të zgjidhet kërkesa nga komisioni i kërkesave pronësore dhe banesore; dhe
iii. Nëse nuk është bërë kërkesa dhe afati i fundit për paraqitjen e kërkesave nuk ka kaluar, ZKK do të fut në regjistrim vërejtjen vijuese:

Me këtë njoftim bëhet me dije se afati i fundit për paraqitjen e kërkesave sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 ose 2000/60 nuk ka kaluar që nga regjistrimi i kësaj të drejte. Megjithatë është e mundur që regjistrimi t'i nënshtrohet kërkesës në të ardhmen. Sugjerohet që çdo palë e interesuar të kërkoj ndihmë juridike profesionale për të vlerësuar rrezikun e kërkesës së bërë.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj do të hyjë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe të shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

UNMIK/REG/2003/27
18.08.2003

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III / Nr. 34 / 01 GUSHT 2008

LIGJI Nr. 04/L-009
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2002/5 PËR THEMELIMIN E REGJISTRIT TË TË DREJTAVE TË PRONËS SË PALUAJTSHME

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2002/5 PËR THEMELIMIN E REGJISTRIT TË TË DREJTAVE TË PRONËS SË PALUAJTSHME

Neni 1

Ky ligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme.

Neni 2

Neni 1. i ligjit bazik, paragrafi 1.3. ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

1.3. AKK-ja me akt nënligjor përcakton nivelin e pagesave për shërbimet e ofruara për regjistrimin e të drejtave në pronën e paluajtshme në përputhje me koston e kryerjes së shërbimeve.

Neni 3

1. Neni 2. i ligjit bazik, paragrafi 2.2 pika d) ndryshohet dhe riformulohet si vijon:
   e) të drejtat e shfrytëzimit të pronave komunale, publike, shoqërore dhe pronave shtetërore.
2. Neni 2. i ligjit bazik, paragrafi 2.2 pas pikës d) shtohet pikë e re e) si vijon:
   e) barrat dhe ngarkesat pronësore.

Neni 4

Neni 3. i ligjit bazik, paragrafi 3.7. ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

3.7. Të drejat mbi pronën e paluajtshme që parashihen sipas nenit 2 të ligjit regjistrohen në bazë të:
   a) vendimit të plotëfuqishëm të gjykatës;

b) vendimit të organit administrativ shtetëror;
c) kontratës për bartjen e së drejtës së pronës së paluajtshme të vërtetuar nga organi kompetent;
d) vendimit apo kontratës për privatizim të lëshuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit;
e) vendimit të Komisionit për rindërtimin e kadastrit;
f) vendimit të Komisionit për rregullimin e tokave; dhe
g) dokumentit tjetër që me ligje të veçanta parashihet regjistrimi i të drejtave pronësore.

Neni 5
Zbatimi

Neni 8 i ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si vijon:
Ministria kompetente e planifikimit hapësinor, në afat prej gjashtë (6) muajsh nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-009
21 korrik 2011

Shpallur me dekretin Nr. DL-011-2011, datë 03.08.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 7 / 10 GUSHT 2011, PRISHTINË

LIGJI Nr. 03/L-075
PËR THEMELIMIN E ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM DHE ZYRËS SË AUDITIMIT TË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65(1) dhe nenit 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Me qëllim të promovimit të standardeve më të larta të transparencës, përgjegjësisë dhe ndershmërisë në menaxhimin financiar dhe mbarëvajtjen e administratës publike në Kosovë,

Miraton këtë

LIGJ PËR THEMELIMIN E ZYRËS SË SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM TË KOSOVËS DHE ZYRËS SË AUDITORIT TË KOSOVËS

Neni 1
Përkufizimet

Për qëllime të këtij ligji:
"Kuvend" e ka të njëjtin kuptim siç është përkufizuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
"Funksion i auditorit të përgjithshëm" do të thotë një funksion që kryhet në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e auditorit të përgjithshëm të përshkruara në nenin 3 të këtij Ligji.
"Zyrtar i autorizuar" do të thotë zyrtari i cili është autorizuar nga Auditori i përgjithshëm i Kosovës për t'i kryer të gjitha funksionet e parapara sipas këtij Ligji.
"ONISR" do të thotë Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
"BKSFR" do të thotë Bordi i Kosovës mbi Standardet Financiare të Raportimit.
"Auditor mbarëvajtjes" do të thotë auditimi i mënyrës ekonomike, i efikasitetit dhe efektshmërisë, me të cilat institucioni apo subjekti që kontrollohet i përdorë dhe i menaxhon mjetet e veta financiare gjatë kryerjes së detyrave të tij.
"Sektor publik" do të thotë sektori i përgjithshëm i Qeverisë, duke përfshirë ndërmarrjet financiare dhe jo financiare siç janë përkufizuar në statistikën financiare të Qeverisë të nxjerra nga Fondi Ndërkombëtar Monetar.
"Auditor i rregullsisë" do të thotë verifikimi i përgjegjësisë financiare, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e deklaratave financiare dhe të dhënave të tjera financiare si dhe shprehjen e mendimeve:

(i) nëse pasqyrat financiare japin pasqyrë të drejtë dhe korrekte të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e kontrollit;

(ii) nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet i përmbahen statuteve dhe rregulloreve në fuqi;
(iii) për përshtatshmërinë e kontrollit të brendshëm dhe funksionet interne të auditimit;
(iv) për korrektësinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative të marra nga institucioni apo subjekti i kontrolluar dhe
(v) për të gjitha çështjet që rezultojnë apo lidhen me auditimin.

Neni 2
Auditori i Përgjithshëm i Kosovës

2.1. Auditori i përgjithshëm do t'i kryejë detyrat e tij apo të saj në mënyrë të pavarur dhe nuk i nënshtrohet urdhrit ose kontrollit nga cilido person ose institucion tjetër.
2.2. Varësisht nga kufizimet e përcaktuara në dispozitat e tjera të këtij ligji, auditori i përgjithshëm ka liri të plotë veprimi në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tij apo të saj. Në veçanti auditori i përgjithshëm nuk mund t'i nënshtrohet kurrfarë urdhri:
a) se a duhet apo nuk duhet të bëhet një auditim i caktuar;
b) për mënyrën si duhet të bëhet një auditim i caktuar;
c) për përparësinë që duhet dhënë ndonjë çështjeje të caktuar.
2.3. Kuvendi e emëron Auditorin e Përgjithshëm me mandat për pesë (5) vite. Auditor i përgjithshëm duhet të jetë person i cili posedon kualifikimet e kërkuara, moral të lartë, i paanshëm dhe i ndershëm që janë të domosdoshme për kryerjen e funksionit të tij, si dhe:
a) duhet të posedojë diplomë universitare dhe përvojë përkatëse prej jo më pak se 10 viteve në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, financa publike ose administratë publike; dhe
b) nuk është subjekt i një hetimi për kryerje të një vepre penale dhe nuk është dënuar nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale;
2.4. Funksioni i auditorit të përgjithshëm është punë me orar të plotë dhe nuk mund të jetë i punësuar me pagesë gjetiu derisa të shërbejë si auditor i përgjithshëm.
2.5. Kurdo që pozita auditorit të përgjithshëm mbetet vakante, Kuvendi në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh e plotëson atë.
2.6. Auditori i përgjithshëm do të paguhet dhe shpërblehet sipas mënyrës që e përcakton Kuvendi.
2.7. Auditori i përgjithshëm mund të jep dorëheqje, duke e njoftuar me shkrim Kuvendin 30 (tridhjetë) ditë më parë.
2.8. Kuvendi mund ta caktojë njërin nga zëvendësit e auditorit e përgjithshëm për ushtrues të detyrës së auditorit të përgjithshëm në rastin kur auditori i përgjithshëm mungon më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga detyra, për shkak se gjendet jashtë Kosovës apo për ndonjë arsyeje tjetër se nuk është në gjendje t'i ushtrojë detyrat e postit të tij.
2.9. Personi i caktuar për të shërbyer si ushtrues i auditorit të përgjithshëm në bazë të paragrafit 8 të këtij neni duhet të ketë të njëjtat kompetenca dhe përgjegjësi të cilat vlejnë për postin e auditorit të përgjithshëm.

2.10. Kuvendi mund ta largojë nga detyra auditorin e përgjithshëm vetëm nëse ai:
   a) nuk është në gjendje t'i kryejë detyrat e tij apo të saj për shkak të ndonjë sëmundjeje fizike apo mendore, që mund të ndikojnë në aftësinë e tij për t'i kryer detyrat e tilla;
   b) gjatë kryerjes së detyrës është marrë me punë të pahijshme dhe të pasjellshme ose është gjetur në rrethana të cilat mund ta kompromentojnë për të ushtruar detyrën e tij apo të saj;
   c) është jokompetent;
   d) është shpallur fajtor me ndonjë aktgjykim të formës së prerë të Gjykatës për ndonjë vepër penale dhe është dënuar me burg;
   e) falimenton ose kërkon të përfitojë nga çfarëdo ligji ose rregulle për lirimin e debitorëve që kanë falimentuar ose janë josolventë.
   f) nuk është në gjendje t'i paguajë detyrimet e tij apo të saj dhe hyn në ndonjë marrëveshje formale me huadhënësit;
   g) i jep shpërblimet e veta në dobi të huadhënësëve të tij apo të saj.

Neni 3
Kompetencat dhe përgjegjësitë e auditorit të përgjithshëm

3.1. Auditori i përgjithshëm i raporton Kuvendit.

3.2. Auditori i përgjithshëm në bazë vjetore kryen auditim të Rregullsisë të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, organizatave buxhetore, duke përfshirë por pa u kufizuar, Kuvendin e Republikës së Kosovës, Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës, çdo ministri dhe agjenci ekzekutive, komunat, organet e pavarura, Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) dhe subjektet e tjera të cilat janë më shumë se 50% në pronësi publike ose marrin mjete financiare nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës, sigurojnë dividendët apo të ardhura të tjera të pataksueshme për të, duke përfshirë por pa u kufizuar, Shërbimin Doganor të Kosovës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Ombudspersonin.

3.3. Auditori i përgjithshëm duhet të raportojë për të gjitha auditimet e rregullsisë dhe në këtë kontekst do të zbatohen kërkesat dhe procedurat vijuese:
   a) auditori i përgjithshëm i siguron një raport Kuvendit mbi auditimin e rregullsisë së Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe të çdo institucioni apo subjekti të referuar në nenin 3.2 jo më vonë se deri më 31 gusht të vitit pas periudhës së kontrollit;
   b) auditori i përgjithshëm ia dërgon raportin e tij apo të saj institucionit ose subjektit që i është nënshtruar auditimit;
   c) drejtuesit e institucionit apo të subjektit të referuar në paragrafin 2 të këtij neni i kanë katërmbëdhjetë (14) ditë afat pas pranimit të raportit të auditorit të përgjithshëm që t'i ofrojnë auditorit të përgjithshëm çfarëdo përgjigjesh lidhur me këtë raport, dhe këto përgjigje (nëse ka) i bashkëngjiten raportit të auditimit dhe janë pjesë përbërëse e raportit;
   d) kopje të raportit të Auditorit të Përgjithshëm do të vendosen në dispozicion të publikut;
   e) brenda 30 ditëve pas publikimit të raportit përkatës të auditimit, institucioni ose subjekti i revizionuar në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, duhet

t'i dorëzojë Auditorit të Përgjithshëm një raport i cili i përcakton masat të cilat institucioni ose subjekti ka për qëllim t'i ndërmarrë për zbatimin e rekomandimeve të bëra në raportin e auditimit.

3.4. Auditori i përgjithshëm në çdo kohë mund të kryejë auditimin e mbarëvajtjes së institucionit apo subjektit të referuar në paragrafin 2 të këtij neni. Dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni mbi Auditimin e Rregullsisë vlejnë njësoj edhe për Auditimin e Mbarëvajtjes.

3.5. Auditori i përgjithshëm në çdo kohë mund të konsultojë cilindo nga institucionet apo subjektet e referuara në paragrafin 2 të këtij neni, me qëllim të koordinimit të përgjegjësive të auditimit ndërmjet auditorit të përgjithshëm dhe kërkesave për auditime të brendshme për çfarëdo institucioni apo për çfarëdo subjekti.

3.6. Përveç kërkesave për auditim të detyrueshëm të referuara në paragrafin 2 të këtij neni, auditori i përgjithshëm mund të bëjë marrëveshje me cilindo institucion apo subjekt të referuar të njëjtin paragraf për:
   a) kryerjen e auditimit të rregullsisë;
   b) kryerjen e auditimit të mbarëvajtjes; ose
   c) ofrimin e shërbimeve të zakonshme plotësuese që i kryen një auditor.

3.7. Pas pranimit të kërkesës me shkrim nga Kuvendi ose Qeveria, auditori i përgjithshëm e kryen auditimin e rregullsisë financiare ose auditimin e mbarëvajtjes në cilindo institucion apo subjekt të shënuar në paragrafin 2 të këtij neni.

3.8. Sipas këtij neni, auditori i përgjithshëm nuk mund t'i kryejë detyrat e auditimit që janë jashtë fushëveprimit të përgjegjësive që lidhen me institucionet apo subjektet e referuara në paragrafin 2 të këtij neni.

3.9. Auditori i përgjithshëm mund të angazhojë çdo person apo subjekt, duke përfshirë edhe ndonjë organizatë ndërkombëtare, për të ndihmuar në përmbushjen e detyrave të auditorit të përgjithshëm.

3.10. Përmes një akti me shkrim, auditori i përgjithshëm mund ta bartë pjesërisht apo tërësisht auditimin sipas këtij Ligji, me kusht që personi, organizata ose subjekti të cilit i bartet ky funksion të jetë në përputhje me të gjitha udhëzimet ligjore të auditorit të përgjithshëm.

3.11. Me rastin e paraqitjes së kërkesës me shkrim nga një shtet donator apo organizatë, auditori i përgjithshëm e kryen auditimin e fondeve të dhuruara nga shteti donator apo organizata, institucioni apo subjekti i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni nëse fondet e tilla janë përfshirë në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës pas marrëveshjes për mbulimin e shpenzimeve të një auditimi të tillë nga shteti ose organizata donatore e cila ka kërkuar këtë auditim.

3.12. Përveç rasteve kur është njoftuar ndryshe nga auditori i përgjithshëm, institucioni ose subjekti i referuar në paragrafin 2 të këtij neni duhet të përfshijë në raportet e tij vjetore të gjitha raportet e auditimit të lëshuara nga auditori i përgjithshëm, që i janë dhënë institucionit apo subjektit përkatës për periudhën të cilën e mbulon ai raport vjetor.

3.13. Auditori i përgjithshëm i publikon me shkrim standardet e auditimit të sektorit publik, të cilat duhet të respektohen nga personat që kryejnë auditimet e rregullsisë dhe të mbarëvajtjes. Këto standarde duhet të jenë në përputhje me ONISR, me standardet e auditimit të Unionit Evropian (UE) dhe me Standardet

Ndërkombëtare të Auditimit (SNR) të shpallura nga Komisioni Ndërkombëtar për Praktikat e Auditimit (KNPA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK). Këto standarde duhet të jenë gjithashtu në përputhje me kërkesat përkatëse të BKSFR-së.

3.14. Derisa të publikohen standardet e aplikueshme të referuara në këtë dokument, auditori i përgjithshëm fillimisht do të publikojë një numër standardesh të auditimit para fillimit të punës së auditimit.

3.15. Një herë në vit, brenda afatit prej tre (3) muajve pas përfundimit të vitit të llogarisë, auditori i përgjithëm i dërgon Kuvendit një raport vjetor mbi auditimet e bëra nga ana e tij. Ky raport duhet të përmbajë edhe një raport mbi auditimin e pavarur të llogarive të Zyrës së Auditimit të Kosovës.

Neni 4
Kompetencat për mbledhjen e informatave, mirëbesimin dhe fshehtësinë

4.1. Auditori i përgjithshëm mund të udhëzojë një person me shkrim, duke ia caktuar një kohë të arsyeshme për përmbushjen e të gjitha detyrave, ose cilëndo nga detyrat vijuese:
   a) që t'i sigurojë auditorit të përgjithshëm çfarëdo informate që ai e kërkon;
   b) të paraqitet dhe të sigurojë dëshmi para auditorit të përgjithshëm apo zyrtarit të autorizuar dhe
   c) t'i sigurojë dokumente auditorit të përgjithshëm lidhur me kryerjen e detyrave të tyre që janë nën kujdestarinë apo kontrollin e personit përkatës.

4.2. Auditori i përgjithshëm mund të urdhërojë që:
   a) informatat apo përgjigjet të jepen me gojë ose me shkrim dhe
   b) informatat apo përgjigjet e pyetjeve të jepen nën betim ose pas pohimit se informatat përkatëse janë të vërteta. Një betim apo konfirmim i tillë do të bëhet nën mbikëqyrjen e auditorit të përgjithshëm apo zyrtarit të autorizuar.

4.3. Personi i cili nuk u përmbahet udhëzimeve të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni kryen vepër penale për të cilën parashihet dënimi me gjobitje deri në pesë mijë (5000) euro ose dënimi me burgim deri në tri (3) vjet.

4.4. Auditori i përgjithshëm ose personi i autorizuar:
   a) në çdo kohë të arsyeshme mund të hyjë dhe të qëndrojë në çdo lokal të institucionit apo subjektit të përshkruar në paragrafin 2 të këtij neni;
   b) ka të drejtë të plotë që lirisht të kontrollojë në çdo kohë të arsyeshme, pasurinë apo dokumentet qofshin në letër apo në formën elektronike dhe
   c) mund t'i kontrollojë, të bëjë kopje ose të nxjerrë kopje nga ato të dhëna.

4.5. Nëse një zyrtar i autorizuar hyn, ose propozon të hyjë, në lokalet të cilat punojnë nën autoritetin e auditorit të përgjithshëm, titullari duhet t'i ofrojë zyrtarit në fjalë të gjitha lehtësirat e nevojshme për ushtrimin efektiv të kompetencave të Zyrës së auditorit të përgjithshëm. Çdo person që nuk vepron në përputhje me këtë dispozitë kryen vepër penale të dënueshme me gjobë deri në pesë mijë (5000) euro ose me burgim deri në tri (3) vjet.

4.6. Zyrtari i autorizuar nuk ka të drejtë të hyjë apo të qëndrojë në lokale nëse ai ose ajo nuk ka siguruar autorizim me shkrim nga auditori i përgjithshëm dhe nëse titullari kërkon që ai të ofrojë dëshmi për autoritetin e tij apo të saj.

4.7. Personi nuk lirohet nga obligimi për të dhënë një dokument ose për t'u përgjigjur në pyetje të caktuara konform paragrafit 2 të këtij neni, me arsyetimin se dhënia e dokumentit ose e përgjigjes, mund ta fajësojë personin apo ta bëjë atë penalisht të përgjegjshëm. Megjithatë, asnjë përgjigje apo dokument i tillë, ose çka do tjetër që merret në mënyrë direkte ose indirekte nga një përgjigje ose dokument i tillë nuk do të pranohet si dëshmi kundër personit në asnjë procedurë penale me përjashtim të procedurave gjyqësore për ndonjë kundërvajtje të paraparë sipas paragrafit 3 të këtij neni..

4.8. Nëse një person ka marrë informata gjatë kryerjes së detyrës së auditorit të përgjithshëm, personi në fjalë nuk duhet t'i zbulojë ato informata, përveç gjatë kohës së kryerjes së detyrës së auditorit të përgjithshëm ose për qëllimet e cilësdo dispozite të ligjit në fuqi e cila i cakton funksionet auditorit të përgjithshëm. Çdo person i cili nuk vepron në përputhje me këtë dispozitë kryen vepër penale të dënueshme me gjobë deri në pesë mijë (5000) euro ose me burgim deri në tri (3) vjet.

4.9. Auditori i Përgjithshëm nuk do të publikojë ose zbulojë në një raport publik, çfarëdo informata të cilat janë klasifikuar me ligj si informata sekrete (konfidenciale).

4.10. Nëse, në përputhje me paragrafin 9 të këtij neni, Auditori i Përgjithshëm nuk i përfshin disa informata në një raport publik, atëherë Auditori i Përgjithshëm, pas kërkesës nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës, duhet të përgatisë dhe t'i dorëzojë Kryesisë së Kuvendit një raport sekret i cili i identifikon informatat e pa-përfshira në raport si dhe i ep arsyetimet për mos-përfshirjen e tyre.

Neni 5
Themelimi i Zyrës së Auditimit të Kosovës

5.1. Me këtë themelohet Zyra e Auditimit të Kosovës.

5.2. Zyra e Auditorit përbëhet nga auditori i përgjithshëm dhe personeli i zyrës së auditimit. Auditori i përgjithshëm mund të emërojë më së shumti dy zëvendësauditorë të përgjithshëm, të cilët:

a) duhet të posedojnë diplomë universitare dhe përvojë përkatëse prej jo më pak se 8 viteve në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, financa publike ose administratë publike;

b) nuk është subjekt i një hetimi për kryerje të një vepre penale dhe nuk është dënuar nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale;

5.3. Funksioni i zyrës së auditimit është që të ndihmojë auditorin e përgjithshëm në kryerjen e funksioneve të tij.

5.4. Urdhëresat për personelin e zyrës së auditimit lidhur me kryerjen e funksioneve të auditorit të përgjithshëm mund të jepen vetëm nga:

a) auditori i përgjithshëm; ose

b) anëtari i personelit të zyrës së auditimit, i cili është autorizuar nga auditori i përgjithshëm për të dhënë urdhëresa të tilla.

5.5. Zyra e auditimit, për aq sa nuk financohet nga burimet e tjera, do të financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Buxheti i zyrës i nënshtrohet miratimit nga Kuvendi. Auditori i përgjithshëm përgatit në baza vjetore dhe i dorëzon

Kuvendit buxhetin e propozuar për zyrën e auditimit në pajtim me kushtet, udhëzimet dhe aranzhimet e caktuara nga Kuvendi. Kuvendi e shqyrton propozim-buxhetin e sipër cekur brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të tij. Gjatë shqyrtimit dhe vendosjes mbi buxhetin, Kuvendi duhet të sigurojë që Zyrës së Auditorit t'i ndahen mjete të mjaftueshme për t'i lejuar asaj ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësive të saj në mënyrë të plotë dhe të pavarur.

Neni 6
Kontrolli i Zyrës së Auditimit të Kosovës

6.1. Llogaritë, dokumentet dhe deklaratat financiare të Zyrës së Auditimit të Kosovës do të auditohen nga auditorë të jashtëm të pavarur të cilët janë të mirënjohur ndërkombëtarisht dhe të cilët zgjedhen dhe emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës mund t'i shkarkojë këta auditorë të jashtëm nëse ka arsye të mira për ta bërë këtë. Një auditor i jashtëm nuk mund të shfrytëzohet më shumë se pesë vite të njëpasnjëshme.

6.2. Pa i paragjykuar kushtet për raportim të përcaktuara në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Zyra e Auditimit të Kosovës, brenda katër muajve pas përfundimit të secilit vit fiskal duhet t'i dorëzojë Kuvendit të Republikës së Kosovës:
   a) deklaratat financiare të certifikuara nga auditorët e saj të jashtëm;
   b) një raport mbi veprimtarinë e saj gjatë vitit.

Neni 7
Zbatimi

Auditori i Përgjithshëm është i autorizuar që të nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e këtij Ligji.

Neni 8
Dispozitat kalimtare

Deri në përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të zbatimit të Propozimit gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, Auditori i Përgjithshëm do të jetë një ndërkombëtar i emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-075
5 qershor 2008

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III / Nr. 32 / 15 QERSHOR 2008

LIGJI Nr. 04/L-115
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË KANË TË BËJNË ME PËRFUNDIMIN E MBIKËQYRJES NDËRKOMBËTARE TË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË KANË TË BËJNË ME PËRFUNDIMIN E MBIKËQYRJES NDËRKOMBËTARE TË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Neni 1
Qëllimi

1. Ky ligj ka për qëllim të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve në vijim për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës:
   1.1. Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
   1.2. Ligjit Nr. 03/L-075 për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës;
   1.3. Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
   1.4. Ligjit Nr. 03/L-079 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale;
   1.5. Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
   1.6. Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04 L 101 për Fondet Pensionale të Kosovës;
   1.7. Kodit Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë;
   1.8. Ligji Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat;
   1.9. Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat;
   1.10. Ligji Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
   1.11. Ligji Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
   1.12. Ligji Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë;
   1.13. Ligji Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme;
   1.14. Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës;
   1.15. Ligji Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativ të Komunave;

1.16. Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës;
1.17. Ligji Nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës;
1.18. Ligji Nr. 03/L-237 për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave;
1.19. Ligji Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës;
1.20. Ligji Nr. 03/L-082 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës.
1.21. Ligji Nr. 03/L-033 për Statusin, imunitetet dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin e Kosovës dhe praninë ndërkombëtare ushtarake, si dhe personelin e saj.

Neni 2
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Ligji)

1. Neni 15 i ligjit bazik pas paragrafit 1. shtohet paragraf i ri 2. me tekstin si në vijim:
   2. Gjykatësit ndërkombëtarë, të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë ligj, vazhdojnë të marrin pagën e tyre të specifikuar sipas vendimit për emërim. Qeveria e Kosoves merr pjesë në pagesën e gjykatësve ndërkombëtarë, në periudhën e përcaktuar në vlerë të pagave të gjyqtarëve vendorë.
2. Neni 55 i ligjit bazik, paragrafi 1. dhe paragrafi 2 fshihen nga teksti i ligjit dhe shtohet një paragraf i ri me tekstin si në vijim:
   Mandati i gjykatësve ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim.

Neni 3
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-075 për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës (Ligji)

1. Neni 8 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 8

Auditori i përgjithshëm, i emëruar në përputhje me Kushtetutën dhe me këtë ligj, vazhdon të qëndrojë në post deri në përfundim të mandatit, me kompensimin e cekur në kushtet specifike të emërimit të tij. Qeveria e Kosovës siguron fonde në vlerën e përcaktuar me marrëveshjen në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Zyrës se Auditorit të përgjithshëm.

Neni 4
Ndryshimet dhe plotësimet Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji)

1. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1.12, që përkufizon Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar, fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Kuvendi pas propozimit nga qeveria zgjedh tre (3) anëtarë ndërkombëtarë drejtorë të bordit. Bordi, po ashtu, emëron një shtetas të Kosovës drejtor të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit, i cili nuk do të jetë anëtar i Bordit. Bordi, përveç kryesuesit, po ashtu, emëron zëvendëskryesues njërin prej anëtarëve të tij. Për emërimin, shkarkimin ose ndryshimin e kushteve të referimit të Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit kërkohet vota afirmative e shumicës së Bordit të Drejtorëve. Anëtarët ndërkombëtarë zgjedhën më mandat deri më 31 gusht 2014.

3. Neni 14 i ligjit bazik, paragrafët 7., dhe 9., vlejnë deri në përfundimin e mandatit të anëtarëve ndërkombëtarë të bordit.
4. Neni 31 i ligjit bazik, pas paragrafit 5. shtohet një paragraf i ri 6. me tekstin si në vijim:
   6. Nëse një anëtar ndërkombëtar i bordit i emëruar në pajtim me nenin 31 (5) jep dorëheqje nga Bordi dhe nëse kjo dorëheqje ose largim nga posti ndodh deri më 31 gusht 2014 atëherë ai/ajo do të zëvendësohet me një ndërkombëtar tjetër.

Neni 5
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-079 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale (Ligji)

1. Neni 4 i ligjit bazik që ndryshon nenin 5.2 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   5.2. Bordi mbikëqyrës përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve të cilët emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryeministri.
2. Neni 8 i ligjit bazik që ndryshon nenin 6.1 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   6.1. Sekretaria Ekzekutive ka drejtorin dhe zëvendësdrejtorin të cilët emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryeministri.
3. Neni 10 i ligjit bazik që ndryshon nenin 7.1 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   7.1. Komisioni përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të cilët emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.
4. Neni 13 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 13

Kuvendi, në konsultim me Komisionin, mund të themelojë panele shtesë të Komisionit, anëtarët e të cilëve do të emërohen në bazë të neneve 7.1 dhe 7.2.

5. Neni 16 i ligjit bazik që ndryshon nenin 12.8 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   12.8. Gjykata Supreme e Kosovës vendos lidhur me ankesat në trupin gjykues prej tre (3) gjyqtarëve të cilët emërohen nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës.
6. Pas nenit 27 të ligjit bazik, shtohet një nen i ri 27.A me tekstin si në vijim:

Neni 27.A

1. Mandati i tre (3) anëtarëve ndërkombëtarë të Bordit mbikëqyrës (përfshi edhe kryesuesin), i drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive, i dy (2) anëtarëve ndërkombëtarë të Komisionit (përfshi edhe kryesuesin), si dhe i dy gjykatësve ndërkombëtarë në panelet e ankimit të Gjykatës Supreme të cilët janë emëruar në pajtim me Kushtetutën do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim.
2. Anëtarët dhe gjykatësit ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë Ligj vazhdojnë të marrin pagën e tyre të specifikuar sipas kushteve të emërimit të tyre.
3. Qeveria e Kosoves do të sigurojë fonde për drejtorin e Sekretariatit Ekzekutive të barabartë me pagën e një anëtari vendor të Bordit Mbikëqyrës.
4. Nëse një anëtar ndërkombëtar i emëruar ne pajtim me Kushtetutën jep dorëheqje ose largohet nga pozita e tij/saj dhe nëse ky largim ose dorëheqja ndodh para datës 31 gusht 2014, atëherë ai/ajo do të zëvendësohet me një ndërkombëtar, të dominuar nga Kryeministri për pozitat e anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë së Pronës dhe drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive, si dhe të nominuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme për pozitën e anëtarëve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Anëtareve të Panelit të Ankesave të Gjykatës Supreme, pas konsultimeve me PSBE.

Neni 6
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.3. fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.7, riformulohet me tekstin si në vijim:
   1.7. **Gjykatës Ndërkombëtar** - çdo gjykatës i Misionit Evropian për Politika të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, i cili është emëruar në pajtim me këtë ligj.
3. Neni 11 i ligjit bazik, paragrafi 2. riformulohet me tekstin si në vijim:
   2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Dhoma e Posaçme do të vazhdojë të respektojë dhe zbatojë parimin e kompensimit në vend të kthimit fizik. Kur vendoset për mjetin juridik që do të jepet në një rast të caktuar, Dhoma e Posaçme do të marrë parasysh edhe dispozitat në fuqi të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, duke përfshirë qëllimet publike që përcaktohen në preambulën e atij ligji.

Neni 7
Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04 L-101 për fondet pensionale të Kosovës

1. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 4.6, riformulohet me tekstin si në vijim:
   4.6. Komisioni për përzgjedhje, i propozon kandidatët Kuvendit për vendet e lira në anëtarësim ose për riemërim të anëtarëve të Bordit Drejtues. Komisioni për Përzgjedhje do të përbëhet nga guvernatori i BQK-së - kryesues, Auditori i

Përgjithshëm dhe Ministri i Financave. Mandati i secilit anëtar të emëruar në Bordin Drejtues zgjat tre vjet, me mundësi të rizgjedhjes, nëse mandati i anëtarëve të Bordit skadon dhe asnjë anëtar i ri nuk është emëruar, atëherë anëtarët e Bordit ekzistues do të vazhdojnë mandatin për nëntëdhjetë (90) ditë.

Neni 8
Ndryshimet dhe plotësimet e Kodit Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë (Kodi)

1. Neni 309 i ligjit bazik që rregullon emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave me pëlqimin e PCN-së, fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 1 i Aneksit D, i Kodit, fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 1

Ky Aneks ofron përjashtimet e posaçme të përkufizuara në këtë Aneks që do t'i jepen bashkësive fetare sipas përkufizimit në legjislacionin e aplikueshëm, duke përfshirë edhe legjislacionin për liritë fetare në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Neni 9
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat (Ligji)

1. Neni 1 i ligjit bazik, paragrafi 1.32, që përkufizon PCN-në fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 8 i ligjit bazik paragrafi 2. në rreshtin e tretë fshihet fjala “dhe PCN”.
3. Neni 88 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 10
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-199 për gjykatat (ligji)

1. Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 11, riformulohet me tekstin si në vijim:
   11. Nëse në njërën nga komunat e reja dhe të themeluara mbi bazën e Ligjit për Kufijtë Administrativë Komunal nuk ka gjykatë themelore, komuna me vendim të Kuvendit Komunal mund ta parqet kërkesën para Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK) për të vendosur mbi themelimin e gjykatës themelore në territorin e saj, ose që një nga gjykatat ekzistuese themelore në territorin e komunës tjetër të ketë juridiksion mbi territorin e komunës së re. Të njëjtën të drejtë e ka edhe komuna ekzistuese, ku shumica e popullatës i takon komunitetit jo shumicë në Kosovës, dhe në të cilën nuk ka gjykatë themelore.
      11.1. KGjK do të aprovojë kërkesat e tilla, përveç nëse vlerësohet se ngarkesat e lëndëve për atë juridiksion është e pamjaftueshme për ta arsyetuar ekzistimin e gjykatës së ndarë.
      11.2. Kur KGjK e aprovon kërkesën për themelimin e gjykatës së re

themelore, autoritetet kompetente do t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se cilado gjykatë e re, është themeluar dhe funksionale brenda periudhës gjashtë mujore prej datës së vendimit.

11.3. Nëse KGjK nuk aprovon kërkesën për themelimin e gjykatës së re themelore, ose kur komuna i kërkon gjykatës ekzistuese që të ketë juridiksion për territorin e vet, autoritetet kompetente do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për përmirësimin e qasjes në drejtësi për komunitetet lokale, e cila është vështirësuar për shkak të izolimit gjeografik, mungesës së sigurisë, ose për shkak të faktorëve të tjerë relevant. Këto masa mund të përfshijnë krijimin në kuadër të territorit të komunës së re, të një departamenti të gjykatës themelore ekzistuese prej së cilës komuna e re ka kërkuar të ketë kompetencë për territorin e vet, ose që gjykata themelore të mundësojë mbajtjen e seancave në territorin e komunës së re.

2. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Përbërja e Gjykatës së Apelit pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Republikës së Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore. Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin përkatës në fuqi, si dhe për të siguruar pjesëmarrjen e komunitetit në gjyqësor, pesëmbëdhjetë (15) për qind e numrit të tërësishëm të ulëseve në Gjykatën e Apelit, por jo më pak se dhjetë ulëse, garantohen për gjyqtarët nga radha e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

Neni 11
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.2. fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 1.3, riformulohet me tekstin si në vijim:

1.3. Për të siguruar se gjykatat pasqyrojnë përbërjen etnike të zonës së tyre të juridiksionit në përputhje me nenin 104(3) të Kushtetutës dhe me legjislacionin përkatës në fuqi, Këshilli do të marrë parasysh që të plotësojë vendet e lira të punës ose të ulëseve të rezervuara me anëtarë të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

3. Neni 7 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 7
Mandati i anëtarëve të Këshillit

Anëtarët e Këshillit zgjidhen me mandat 5 (pesë) vjeçar, siç ceket në nenin 108 (6) të Kushtetutës dhe në këtë ligj. Një anëtar i këtij Këshilli mund të zgjidhet për një mandat shtesë jo-vijues pesë (5) vjeçar.

4. Neni 16 i ligjit bazik, paragrafi 3., riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Në përputhje me nenin 104(3) të Kushtetutës, Këshilli zbaton masa dhe veprimet tjera me qëllim rekrutimi, të cilat i konsideron të nevojshme dhe të përshtatshme për të siguruar se një gjykatë ose degë e gjykatës pasqyron përbërjen etnike në zonën e tyre të juridiksionit.

5. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 1., riformulohet si në vijim:
   1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ndërmerr masa të nevojshme për të rritur numrin e gjyqtarëve nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë, prej radhëve të atyre gjyqtarëve që shërbejnë në Kosovë. Për të përmbushur përgjegjësitë e veta, Këshilli, ndër të tjera, nga aplikantët njëlloj të kualifikuar për të shërbyer si gjyqtarë u jep përparësi anëtarëve nga komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovës, ashtu siç është paraparë me nenin 108 të Kushtetutës.
6. Neni 17 i ligjit bazik, pas paragrafit 5., shtohen tre paragraf të rinjë 6, 7 dhe 8, me tekstin si në vijim:
   6. Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të hartojë një rregullore të veçantë për të përshkruar procesin e emërimit dhe të riemërimit të gjykatësve nga komunitetet e nën-përfaqësuara në mesin e gjykatësve që shërbejnë në Kosovë.
   7. Dhënia e përparësisë për kandidatët me kualifikime të barabarta nga komunitetet e nën-përfaqësuara, do të zbatohet përderisa përqindja e gjyqtarëve pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë në Kosovë të jetë nën pesëmbëdhjetë përqind (15%) dhe / përderisa përqindja e gjyqtarëve të cilët janë pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, të jetë nën tetë (8%).
   8. Mandati i dy anëtarëve ndërkombëtarë të Këshillit të emëruar në pajtim me Kushtetutën do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim. Anëtarët ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë ligj vazhdojnë të marrin pagën e tyre.
   9. Neni 52 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 12
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.7, fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 1.3 riformulohet me tekstin si në vijim:
   1.3. Siguron se prokuroritë pasqyrojnë përbërjen etnike të zonës së tyre të juridiksionit në përputhje me nenin 109 (4) dhe 110(3) të Kushtetutës.
3. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Këshilli zbaton masa dhe veprime rekrutimi, si dhe masa të tjera të cilat i konsideron të nevojshme për të siguruar që një zyrë prokuroriale pasqyron përbërjen etnike të zonës së juridiksionit përkatës.
4. Neni 17 i ligjit bazik, pas paragrafit 3. shtohet një paragraf i ri 4. me tekstin si në vijim:
   4. Këshilli harton rregullore të veçantë për të përshkruar procesin e emërimit dhe të riemërimit të prokurorëve nga komunitetet e nën-përfaqësuara në mesin e prokurorëve që shërbejnë në Kosovë.
5. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 1., riformulohet me tekstin si në vijim:
   1. Këshilli ndërmerr masa të nevojshme për të rritur numrin e prokurorëve nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë. Kur ka aplikantë njëlloj të kualifikuar për të shërbyer si prokurorë, Këshilli u jep përparësi anëtarëve nga komunitetet që janë të nënpërfaqësuara në Kosovë siç është paraparë edhe me nenin 109 (4) dhe 110 (3) të Kushtetutës.

6. Neni 18 i ligjit bazik, pas paragrafit 5, shtohet paragrafi i ri 6, me tekstin si në vijim:
   6. Dhënia e përparësisë për kandidatët me kualifikime të barabarta nga komunitetet e nën-përfaqësuara, do të zbatohet përderisa përqindja e prokuroreve pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë në Kosovë të jetë nën pesëmbdhjetë përqind (15%) dhe / ose përderisa përqindja e prokurorëve të cilët janë pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, të jetë nën tetë përqind (8%).

Neni 13
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë (Ligji)

1. Pjesa e parë e preambulës se ligjit, riformulohet me tekstin si në vijim:
   Në bazë të nenit 65 (1) dhe ne pajtim me dispozitat kalimtare dhe përfundimtare nga kreu XIII dhe XIV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Pas nenit 7 të ligjit bazik shtohet një nen i ri 7.A me tekstin si në vijim:

Neni 7.A
Statusi i Kishës Ortodokse Serbe

1. Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë konsiderohet pjesë përbërëse e Kishës Ortodokse Serbe (KOS).
2. Emri dhe organizimi i brendshëm i Kishës Ortodokse Serbe, duke përfshirë edhe hierarkinë dhe veprimtaritë e saj, do të respektohen.
3. Nuk do të ketë ndalim arbitrar për hyrje në Kosovë ose qëndrim brenda Kosovës për priftërinjtë, kandidatët për prift, murgjve, murgeshave dhe vizitorëve.
4. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 7.3, fjalët "**themelojnë dhe**", fshihen nga teksti i ligjit.
5. Neni 8 i ligjit bazik, paragrafi 1, riformulohet me tekstin si në vijim:
   1. Ndërtesat dhe objektet që u takojnë bashkësive fetare, që janë të dedikuara për kryerjen e ceremonive fetare konsiderohen të pacenueshme për sa i përket ndërhyrjes së autoriteteve qeveritare dhe në to mund të hyhet vetëm me pëlqimin e institucionit përkatës fetar, përveç nëse është lëshuar ndonjë urdhër gjyqësor për shkak të aktiviteteve ilegale dhe në rast të rrezikut për jetën ose shëndetin.
6. Neni 12 i ligjit bazik, pas paragrafit 12.4 shtohet një paragraf i ri 12.5 me tekstin si në vijim:
   12.5. Përveç përjashtimeve të përmendura më lart, bashkësitë fetare gëzojnë privilegje doganore dhe tatimore për veprimtari ekonomike, që janë specifike për vetë-qëndrueshmërinë e tyre financiare, siç do të definohet me një akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e financave. Këto privilegje përfshijnë importimin dhe blerjen e produkteve qenësore për prodhim, të materialeve, pajisjeve dhe bagëtisë; dhe eksportimin e produkteve që dalin nga aktivitetet e lartpërmendura.

Neni 14
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1. përkufizimi "**Propozimin Gjithëpërfshirës**", fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Objekt i shpronësimit sipas këtij ligji mund të jenë të drejtat private pronësore dhe të drejtat tjera private për ose ndaj një prone të paluajtshme, me përjashtim të asaj prone të paluajtshme që bën pjesë në atë kategori të pronës, për të cilën Kushtetuta në mënyrë specifike thotë se nuk do të jetë objekt i shpronësimit.
3. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3, shtohet nën-paragraf i ri 3.1. me tekstin si në vijim:
   3.1 Prona e luajtshme dhe e paluajtshme, si dhe asetet tjera të Kishës Ortodokse Serbe do të jenë të pacenueshme dhe nuk do të jenë objekt i shpronësimit.

Neni 15
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (ligji)

1. Pas nenit 3 shtohet nen i ri 3.A me tekstin si në vijim:

Neni 3.A
Të drejtat e refugjatëve dhe personave të zhvendosur

1. Të gjithë refugjatët nga Kosova dhe personat e zhvendosur brenda vendit do të kenë të drejtën e kthimit dhe kërkimit të pronës së tyre dhe posedimeve personale, në pajtim me ligjet vendore dhe ndërkombëtare. Çdo person do të ketë të drejtë të marrë vendim të lirë dhe të jetë i informuar për vendin ku ai kthehet.
2. Institucionet e Republikës së Kosovës ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të krijuar kushte te favorshme për kthim të sigurt dhe të denjë të refugjatëve dhe personave të zhvendosur, bazuar në vendimet e tyre të lira dhe të bazuara në informata të sakta, përfshirë përpjekjet për të promovuar dhe mbrojtur lirinë e tyre të lëvizjes dhe mbrojtjen nga kërcënimi
3. Kushtet e kthimit të personave të zhvendosur dhe mekanizmat e bashkëpunimit me institucionet relevante ndërkombëtare do të përcaktohen nga institucionet e Republikës së Kosovës në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e aplikueshme."

Neni 16
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativë të Komunave (ligji)

1. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Bordi do të përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë, me nga pesë (5) përfaqësues të zgjedhur nga secila komunë dhe një (1) përfaqësues i zgjedhur nga Kryeministri.

2. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 4. riformulohet me tekstin si në vijim:
   4. Kryesuesi i Bordit përzgjidhet nga Kryeministri.
3. Neni 14 i ligjit bazik, fshihet termi **"dhe PCN do të ndërmarrin"** dhe zëvendësohet me termin: "**ndërrmer**".
4. Në Shtojcën 1 (Zonat Kadastrale) të ligjit bazik, emërtimi i komunës "**Hani i Elezit**" në gjuhën serbe dhe angleze ndryshohet në "**Elez Han**"

Neni 17
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës (ligji)

1. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi (c) riformulohet me tekstin si në vijim:
   (c) Një (1) anëtar, i përzgjedhur nga Kryeministri.
2. Neni 14 i ligjit bazik, paragrafi (b), nënparagrafi (iv) riformulohet me tekstin si në vijim:
   iv. Një (1) anëtar, i përzgjedhur nga Kryeministri.

Neni 18
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës (ligji)

1. Titulli i nenit 29 të ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 29
Regjistrimi dhe përcaktimi i shtetësisë

Neni 19
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-237 për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave (Ligji)

1. Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 4.12., riformulohet me tekstin si në vijim:
   4.12 Një (1) përfaqësues nga një prej Universiteteve publike, anëtar;

Neni 20
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës (ligji)

1. Neni 9 i ligjit bazik, paragrafi 3., riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Forca e Sigurisë së Kosovës është e strukturuar dhe e përgatitur për të përmbushur funksionet e sigurisë që nuk i përkasin policisë ose organizatave tjera për zbatim të ligjit.
2. Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 2., riformulohet me tekstin si në vijim:
   2. Forca e Sigurisë së Kosovës është e armatosur lehtë dhe nuk ka armë të rënda, siç janë tanket, artileria e rëndë ose kapacitete sulmuese ajrore. Një rishikim i plotë i këtyre kufizimeve, do të bëhet jo më herët se pesë vjet nga koha e hyrjes në fuqi e Ligjit Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Detyrat fillestare të Forcës së Sigurisë së Kosovës janë:

3. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 2, pika (e) fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 21
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-082 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës (ligji)

1. Neni 5 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 22
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-033 për Statusin, imunitetet dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin e Kosovës dhe praninë ndërkombëtare ushtarake, si dhe personelin e saj

1. Neni 3 i ligjit bazik paragrafi 2. pika (a) riformulohet me tekstin si në vijim:
   (a) Zyra Civile Ndërkombëtare dhe Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian.
2. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3.3. Individët e emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtarë, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, mandati i të cilëve nuk ka përfunduar para deklarimit të përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur gëzojnë statusin, privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara në ligjin bazik.
3. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 6., riformulohet me tekstin si në vijim:
   4.6. Ministri i Punëve të Jashtme nuk mund t'i shpallë PSBE-në ose një anëtar të personelit të tij, anëtarët e personelit të ICO-së, përfshirë individët e përcaktuar në nenin 3.3. të ligjit bazik ose anëtarët e misionit EULEX, si persona non grata.
4. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 7. fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 23

1. Të gjithë anëtarët ndërkombëtarë të emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, në pajtim me Kushtetutën e Republikës se Kosovës, me përjashtim të atyre të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Agjencisë Kosovare të Pronës gjyqtarët ndërkombëtarë të Panelit të Ankesave të Gjykatës Supreme, dhe dy gjyqtarë në Komisionin për Kërkesa Pronësore, nëse për çfarëdo arsye largohen nga pozita para datës 31 gusht 2014 ai/ajo do të zëvendësohet me një anëtar vendor.
2. Nëse në cilindo ligj të aplikueshëm në Republikën e Kosovës përdoren termet ICO ose PCN, të njëjtat shfuqizohen dhe zëvendësohen me institucionet vendore përkatëse.

II. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 24
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të amendamenteve kushtetuese për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë.

Ligji Nr. 04/L-115
31 gusht 2012

Shpallur me dekretin Nr.DL-036-2012, datë 04.09.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr.25 / 7 SHTATOR 2012, PRISHTINË

LIGJI Nr. 04/-L-025
PËR NISMA LEGJISLATIVE

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 326
Kreu II: Nisma legjislative nga institucionet e Republikës së Kosovës 327
Kreu III: Nisma legjislative nga qytetarët 328
Kreu IV: Procedurat dhe kriteret për nismën legjislative nga qytetarët 328
Kreu V: Shqyrtimi i projektligjit dhe propozimit për hartimin e projektligjit të inicuar nga qytetarët 330
Kreu VI: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 331

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Miraton

LIGJ PËR NISMA LEGJISLATIVE

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të përcaktoj rregullat dhe procedurat për nismat legjislative.

Neni 2
Fushëveprimi

Fushëveprimi i këtij ligji përfshin nismën për të propozuar ligje, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria, deputetët e Kuvendit, dhe nga më së paku dhjetëmijë (10.000) qytetarë.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **Qytetarë** – çdo qytetarë i Republikës së Kosovës me të drejtë vote.
   1.2. **Nismë legjislative** – një propozim që ka për qëllim rregullimin e një fushe me ligj apo me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit në fuqi.

1.3. **Përfaqësuesi i nismës** -qytetari/ët apo organizimet e qytetarëve që marrin pjesë në nismë legjislative, me qëllim të përfaqësimit të tyre para Kuvendit dhe institucioneve përkatëse si dhe para qytetarëve.

Neni 4
Nisma legjislative

1. Të gjitha aktivitetet për paraqitjen e nismës legjislative duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi.
2. Të gjitha projektligjet të cilat i paraqiten Kuvendit duhet t'i përmbajnë kushtet e parashtrimit të një projektligji të përcaktuara në Rregulloren e Punës së Kuvendit nëse nuk parashihet ndryshe me këtë ligj.
3. Të gjitha nismat legjislative duhet t'i përmbahen standardeve për hartimin e legjislacionit të përcaktuara nga Qeveria nëse nuk parashihet ndryshe me këtë ligj.

Neni 5
E drejta e nismës legjislative

1. Nismë legjislative, mund të marrë:
   1.1. Presidenti i Republikës së Kosovës nga fushë veprimtaria e vet;
   1.2. deputetët e Kuvendit;
   1.3. Qeveria; ose
   1.4. më së paku dhjetëmijë (10.000) qytetarë me të drejtë vote.

Neni 6
Refuzimi i nismës legjislative

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës, refuzon nismën legjislative në rastet kur nisma:
   1.1. është kundër parimeve themelore të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; dhe
   1.2. nuk i përmban kushtet dhe kriteret e përcaktuar me këtë ligj.

KREU II
NISMA LEGJISLATIVE NGA INSTITUCIONET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 7
Nisma legjislative nga Presidenti

1. Presidenti i Republikës së Kosovës, ka të drejtë për të propozuar nismë legjislative nga fushë veprimtaria e tij/saj.
2. Presidenti nismën legjislative ia adreson Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Neni 8
Nisma legjislative nga deputetët e Kuvendit

Së paku gjashtë (6) deputetë të Kuvendit kanë të drejtë të nismës për të propozuar ligje sipas mënyrës së përcaktuar me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Neni 9
Nisma legjislative nga Qeveria

Qeveria e Republikës së Kosovës ka të drejtë të nismës për të propozuar ligje, nga fushë veprimtaria e saj, sipas mënyrës së përcaktuar me Rregulloren e Punës së Qeverisë dhe me Rregullat e Punës së Kuvendit.

KREU III
NISMA LEGJISLATIVE NGA QYTETARËT

Neni 10
E drejta e nismës legjislative nga qytetarët

1. Çdo qytetarë mund të iniciojë nismën legjislative.
2. Çdo qytetarë gëzon të drejta të barabarta për sa i përket nismës legjislative.
3. Ndalohet çdo formë e diskriminimit apo kufizimit për të propozuar ligje në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

KREU IV
PROCEDURAT DHE KRITERET PËR NISMËN LEGJISLATIVE NGA QYTETARËT

Neni 11
Përfaqësuesi i nismës legjislative

1. Çdo nismë legjislative duhet të ketë përfaqësuesin.
2. Përfaqësuesi i nismës është pika e kontaktit dhe komunikimit me institucionet përkatëse.

Neni 12
Forma e nismës legjislative

1. Qytetari/ët kanë të drejtë të nismës për të propozuar ligje duke:
   1.1. hartuar projektligjin; apo
   1.2. propozuar Kuvendit hartimin e projektligjit.

Neni 13
Njoftimi i Kuvendit për fillimin e nismës

1. Përfaqësuesi i nismës legjislative, njoftimin për fillimin e nismës e dërgon në njësinë përkatëse për Parashtresa dhe Ankesa në Kuvendin e Kosovës dhe ia ofron Kuvendit informacionin se a do të fillon nisma legjislative për hartimin e një projektligji apo për propozimin e hartimit të një projektligji të caktuar duke dhënë shpjegimet e detajuara në shkresën shpjeguese për objektivat që synojnë t'i realizojnë.
2. Njësia përkatëse për Parashtresa dhe Ankesa ne Kuvend vërteton pranimin e njoftimit për nismën legjislative.

Neni 14
Afati kohor për mbledhjen e nënshkrimeve

Brenda gjashtë (6) muajve nga data kur përfaqësuesi për nismën legjislative njofton Kuvendin e Kosovës për fillimin e nismës duhet të përfundojë procesi i mbledhjes së nënshkrimeve dhe të dërgohet nisma legjislative në Kuvendin e Kosovës.

Neni 15
Financimi i nismës legjislative

1. Shpenzimet që dalin nga përgatitjet për mbledhjen e nënshkrimeve për nismën legjislative mbulohen nga përfaqësuesi nismës.
2. Përfaqësuesi për nismën legjislative njofton Kuvendin e Kosovës për mënyrën e financimit të nismës dhe i bën transparente burimet dhe shumën e financimit.

Neni 16
Lista me nënshkrime nga qytetarët

1. Lista që përfshinë të paktën dhjetëmijë (10.000) nënshkrime, duhet përfshijë:
   1.1. formën e nismës legjislative dhe emërtimin e saj;
   1.2. emrin dhe mbiemrin;
   1.3. numrin personal;
   1.4. komunën e lindjes;
   1.5. nënshkrimin dhe datën e nënshkrimit.
2. Përfaqësuesi përkujdeset që në listë qytetarët të nënshkruhen vetëm nga një herë dhe t'i përmbajnë të gjitha të dhënat e kërkuara në paragrafin 1. të këtij neni.
3. Çdo faqe e listës duhet ti përmbajë të dhënat e përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni.

Neni 17
Verifikimi i listës

1. Lista që përfshinë të paktën dhjetëmijë (10.000) nënshkrime verifikohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve.
2. Në rast të ndonjë mangësie të gjetur në kuptim të nenit 16 të këtij ligji gjatë

procesit të verifikimit të listës Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e njofton përfaqësuesin e nismës që në afat kohor jo më shumë se tridhjetë (30) ditë të përmirësojë listën e nënshkrimeve.

3. Në rast se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve konstaton se nisma është në pajtim me kushtet e përcaktuara me këtë ligj, brenda tri (3) ditëve e njofton përfaqësuesin e nismës legjislative.

Neni 18
Dërgimi i nismës në Kuvend

1. Projektligji apo propozimi i hartimit të një projektligji të caktuar së bashku me shkresën shpjeguese për objektivat që synojnë t'i realizojnë të nënshkruar nga të paktën dhjetëmijë (10.000) qytetarë i paraqitet Kuvendit nga përfaqësuesi i nismës.
2. Përfaqësuesi i nismës Projektligjin e dorëzon te Kryetari apo Kryesia e Kuvendit, në mënyrë solemne.

Neni 19
E drejta e ankesës

Në rast se nisma legjislative e ndërmarr nga qytetarët do të refuzohet nga njësia përkatëse e Kuvendit me arsyetimin që nisma legjislative nuk i përmban kushtet e përcaktuara me këtë ligj, qytetarët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës kompetente për konteste administrative.

KREU V
SHQYRTIMI I PROJEKTLIGJIT DHE PROPOZIMIT PËR HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT TË INICUAR NGA QYTETARËT

Neni 20
Shqyrtimi i Projektligjit

1. Në rastin kur nisma legjislative nga qytetaret është në formë të Projektligjit, Kuvendi është përgjegjës për shqyrtimin e tij konform Rregullores së Punës të Kuvendit për Shqyrtimin e Projektligjeve.
2. Kuvendi, Projektligjin ia dërgon Qeverisë për marrjen e opinioneve dhe deklaratave përkatëse.
3. Pas marrjes së opinioneve dhe deklaratave përkatëse nga Qeveria, fillon shqyrtimi i Projektligjit sipas procedurave të përcaktuara me Rregulloren e Punës së Kuvendit.
4. Përfaqësuesi i nismës legjislative ftohet që gjatë gjithë kohës të merr pjesë në punën e komisioneve përkatëse të Kuvendit.
5. Kryesia e Kuvendit mund të lejoj përfaqësuesin të prezantoj nismën në seancë plenare ose cakton një deputet me propozimin e përfaqësuesit që të bëjë prezantimin e nismës në seancë plenare.

Neni 21
Shqyrtimi i propozimit për hartimin e Projektligjit

1. Në rastin kur nisma legjislative nga qytetaret është në formën e propozimit për hartimin e Projektligjit, Kuvendi është përgjegjës për hartimin e tij konform Rregullores se Punës te Kuvendit për Shqyrtimin e Projektligjeve.
2. Kuvendi, bazuar në propozimin për hartimin e Projektligjit mund te kërkojë nga Qeveria hartimin e Projektligjit përkatës.
3. Qeveria, cakton njërën nga Ministritë si bartëse për hartimin e Projektligjit.
4. Përfaqësuesi i nismës legjislative ftohet që gjatë gjithë kohës të merr pjesë në Grupet Punuese përkatëse.

KREU VI
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 22
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Qeveria ka autoritetin të miratojë udhëzues dhe akte tjera përkatëse me qëllim të zbatimit të këtij ligji.
2. Njësia përkatëse që merret me çështje ligjore e Zyrës së Kryeministrit, sipas nevojës edhe në bashkëpunim me institucionet dhe me shoqërinë civile, ndërmarrin masat e nevojshme për të promovuar dhe përkrahur të drejtat e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 23

Dispozitat e këtij ligji do të vlejnë në mënyrë analoge edhe për nismat për amendamentimin e ligjeve.

Neni 24
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-025
6 tetor 2011

Shpallur me dekretin Nr. DL-040-2011, datë 13.10.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 23 / 26 TETOR 2011, PRISHTINË

RENDI PUBLIK DHE SIGURIA

LIGJI Nr. 04/L-57
LIRINË E ASOCIIMIT NË ORGANIZATAT JOQEVERITARE

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 335
Kreu II: Themelimi i OJQ-së 336
Kreu III: Organizimi dhe funksionimi i brendshëm i OJQ-së 341
Kreu IV: Statusi për përfitim publik i OJQ-së, raportimi financiar dhe pezullimi i tij 342
Kreu V: Shuarja dhe çregjistrimi i OJQ-së 346
Kreu VI: Bashkëpunimi dhe përkrahja e OJQ-ve 347
Kreu VII: Dispozitat kalimtare dhe të fundit 347

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR LIRINË E ASOCIIMIT NË ORGANIZATAT JOQEVERITARE

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimet dhe fushëveprimi i këtij ligji

1. Ky ligj rregullon themelimin, regjistrimin, udhëheqjen e brendshme, veprimtarinë, shuarjen dhe çregjistrimin e personave juridik të organizuar si organizata joqeveritare në Kosovë.
2. Ky ligj nuk vlen për parti politike, sindikata dhe organizata sindikale, e as për qendra të besimit fetar, apo faltore dhe fusha tjera që rregullohen me ligje të veçanta.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **Organizatë Joqeveritare (OJQ)** - çdo shoqatë dhe fondacion të vendit, siç përkufizohet me nenin 5 të këtij ligji, si dhe çdo organizatë të huaj dhe ndërkombëtare, siç përkufizohet me nenin 7 të këtij ligji.
   1.2. **Ministria -** Ministria e Administratës Publike.

1.3. **Ministër -** Ministri i Ministrisë së Administratës Publike.
1.4. **Organ kompetent** - organi kompetent për regjistrim dhe çregjistrim.
1.5. **Person -** çdo person juridik apo fizik të vendit, ose të huaj.
1.6. **Përfaqësues i Autorizuar** - individi që banon në Kosovë, që ka moshë madhore dhe zotësi të veprimit, që është i autorizuar për ta përfaqësuar një OJQ dhe për të pranuar njoftime dhe hetime zyrtare.
1.7. **Anëtar i familjes** – Bashkëshorti/ja, fëmijët, prindërit, gjyshërit, nipat, mbesat, vëllezërit dhe motrat, fëmijët e tyre dhe bashkëshortët si dhe anëtarët e familjes së ngushtë të bashkëshortit/es (vjehërrinë, kunetët dhe fëmijët e tyre);
1.8. **Situatat e jashtëzakonshme** duke përfshirë fatkeqësitë natyrore, që janë përtej kontrollit të OJQ-së dhe në të vërtetë pamundësojnë OJQ-në nga kompletimi dhe dorëzimi i raportit siç, parashihet me nenin 18 të këtij ligji.

Neni 3
Liria e Asociimit

1. Çdo person në Kosovë gëzon të drejtën e plotë për t'u asociiuar dhe themeluar OJQ-në.
2. Asnjë person nuk obligohet që të asociiohet kundër vullnetit të tij dhe asnjë person nuk diskriminohet në asnjë mënyrë për shkak të vendimit për t'u asociiuar apo për të mos u asociiuar.

Neni 4
Mos shpërndarja e të ardhurave

1. OJQ-ja nuk shpërndan të ardhura neto ose fitime për asnjë person.
2. Pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e një OJQ-je përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të përcaktuara për organizatën.
3. Pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e një OJQ-je nuk mund të përdoren për të sjellë drejtpërdrejtë ose tërthorazi përfitime, për ndonjë themelues, drejtor, zyrtar, anëtar, punonjës ose donatorë të OJQ-së, përveç pagesës apo kompensimit të arsyeshëm për personat që kryejnë punë për organizatën.

KREU II
THEMELIMI I OJQ-SË

Neni 5
Nocioni i OJQ-së në Kosovë

1. OJQ-ja vendore është shoqatë ose fondacion e themeluar në Kosovë për realizimin e qëllimit bazuar në ligj, për përfitim publik ose për interes të ndërsjellë.
2. Shoqata është një organizatë e anëtarësisë. Shoqatën mund ta themelojnë të paktën tre (3) ose më shumë persona, ku të paktën njëri prej tyre ka vendbanimin ose zyrën në Kosovë.
3. Fondacioni është organizatë pa anëtarësi, i krijuar për menaxhimin e pronave dhe

pasurive. Një fondacion mund të krijohet nga një ose më shumë persona, në rast se të paktën njëri prej tyre ka vendbanimin ose zyrën në Kosovë.

Neni 6
Themelimi i Shoqatave dhe Fondacioneve në Kosovë

1. Shoqata ose fondacioni themelohet nëpërmjet aktit themelues që përmban të dhënat e mëposhtme:
   1.1. emrin zyrtar, shkurtesën zyrtare si dhe simbolin zyrtar të organizatës;
   1.2. formën organizative (shoqatë, fondacion);
   1.3. adresën e organizatës;
   1.4. qëllimet e organizatës dhe aktivitetet;
   1.5. emrat dhe adresat e themeluesve;
   1.6. emrin, adresën dhe informata tjera kontaktimi të përfaqësuesit të autorizuar, dhe
   1.7. afatin kohor për të cilin organizata themelohet, nëse ka një të tillë.
2. Fondacioni mund të themelohet edhe me testament, apo me lënie të trashëgimisë, në qoftë se ai përmban informatat e përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni.
3. Shoqata ose fondacioni ka statutin, i cili duhet t'i përmbajë të dhënat në vijim:
   3.1. emrin e organizatës, selinë dhe simbolin e saj;
   3.2. qëllimet e organizatës;
   3.3. emrin e organit më të lartë udhëheqës;
   3.4. nëse OJQ-ja është shoqatë, procedurat për zgjedhjen dhe largimin e anëtarëve, kushtet për anëtarësim si dhe nëse organizata vendos të ketë një bord, procedurat për zgjedhjen dhe largimin e anëtarëve të bordit dhe ndarjen e kompetencave dhe përgjegjësive ndërmjet Kuvendit të Përgjithshëm të anëtarëve dhe Bordit;
   3.5. nëse OJQ-ja është fondacion, procedurat për zgjedhjen dhe largimin e anëtarëve të Bordit;
   3.6. kompetencat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve, nëse ka;
   3.7. mënyrën e marrjes së vendimeve;
   3.8. rregullat dhe procedurat për:
      3.8.1. ndryshimin e aktit themelues dhe statutit;
      3.8.2. bashkimin, ndarjen ose shuarjen e organizatës dhe
      3.8.3. shpërndarjen e mjeteve që mbesin pas shuarjes.
4. Statuti mund të përmbajë çdo rregull, dispozitë apo procedure tjetër, që nuk është në kundërshtim me kushtet e parapara me këtë ligj.
5. Rregullat dhe procedurat për udhëheqje të brendshme që i përmban statuti i OJQ-së, duhet të jenë në pajtim me parimet demokratike.
6. Shoqata apo fondacioni ka vetëm ato kompetenca dhe ka të drejtë angazhimi vetëm në ato aktivitete dhe qëllime, që janë në përputhje me aktin themelues dhe statutin dhe që lejohen me ligj.

Neni 7
OJQ-të e vendit të huaj dhe ato ndërkombëtare

OJQ-ja e vendit te huaj dhe ajo ndërkombëtare janë persona juridik të themeluar jashtë Kosovës, sipas legjislacionit që përmbush në thelb kushtet e parapara me nenin 4 të këtij ligji.

Neni 8
Asociimi i Personave Juridik

Personat Juridik, duke përfshirë edhe OJQ-të, mund të themelojnë shoqata, fondacione për të përparuar qëllimin e tyre të ligjshëm, qoftë për përfitim publik apo të ndërsjellë, në përputhje me nenin 5 dhe 6 të këtij ligji.

Neni 9
Regjistrimi

1. Çdo person, pavarësisht nga përkatësia, në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal, ka të drejtë të regjistrojë OJQ, në pajtim me kushtet dhe rrethanat e përcaktuara me këtë ligj. Asnjë person nuk ka nevojë të regjistrojë OJQ-në për të ushtruar të drejtën e lirisë në asociim.
2. OJQ-ja regjistrohet pranë departamentit përkatës në Ministrinë e Administratës Publike.
3. OJQ-ja, kërkesës për regjistrim duhet t'ia bashkëngjes një kërkesë-formular, aktin e themelimit dhe statutin e saj.
4. OJQ-ja cakton me shkrim Përfaqësuesin e Autorizuar. Të gjitha fletëkërkesat për regjistrim duhet t'i nënshkruajë Përfaqësuesi i Autorizuar i OJQ-së. Aktin e themelimit e nënshkruajnë të tre themeluesit.
5. OJQ-ja e vendit të huaj dhe ajo ndërkombëtare regjistrohen duke i dorëzuar dokumentet e mëposhtme:
   5.1. një kërkesë-formular;
   5.2. dëshminë që është person juridik në një vend tjetër;
   5.3. adresën e organizatës në Kosovë; dhe
   5.4. një deklaratë me shkrim nga një përfaqësues i autorizuar i OJQ-së, me autorizim për të dhënë një deklaratë të këtillë, dhe që tregon:
      5.4.1. qëllimet e OJQ-së;
      5.4.2. një përshkrim të përgjithshëm të aktiviteteve që OJQ-ja planifikon t'i kryejë në Kosovë, dhe
      5.4.3. emrin, adresën dhe kontakt-informata tjera të përfaqësuesit të autorizuar.
6. Fletëkërkesat për regjistrimin e OJQ-ve i dorëzohen dhe pranohen nga organi kompetent. Vendimet në lidhje me regjistrim si dhe numrat e regjistrimit i cakton organi kompetent.

7. Dokumentet që i dorëzon OJQ-ja në mbështetje të kërkesës për regjistrim duhet të jenë në gjuhët përkatëse në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
8. Pavarësisht nga paragrafi 7. i këtij neni, dokumentet që i dorëzon OJQ-ja e huaj dhe ajo ndërkombëtare për të dëshmuar se është person juridik në një shtet tjetër, duhet të jenë në gjuhën origjinale të atij vendi, së bashku me përkthimin e dokumentacionit në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Përkthimi duhet të jetë nga përkthyesi i autorizuar – licencuar. Çdo dallim përmbajtësor apo mashtrues ndërmjet gjuhës së origjinalit dhe dokumentit të përkthyer është arsye për tërheqjen e regjistrimit të organizatës.
9. Organi kompetent i lëshon OJQ-së certifikatën për regjistrim, ose një vendim me shkrim me të cilin refuzohet regjistrimi brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh, nga dita e pranimit të kërkesës për regjistrim, përpos, nëse organi kompetent bën kërkesë me shkrim gjatë rrjedhës së afatit, për informata të mëtutjeshme, ose për qartësim. Nëse regjistrimi refuzohet, organi kompetent përfshinë në vendimin për refuzim një arsyetim të bazave ligjore në bazë të të cilave regjistrimi refuzohet dhe të drejtën e ankesës.
10. Nëse organi kompetent bën kërkesë me shkrim për informacione plotësuese, ose për qartësim lidhur me kërkesën për regjistrim, afati gjashtëdhjetë (60) ditor brenda të cilit organi kompetent duhet të lëshojë Certifikatën për regjistrim, ose vendimin me shkrim me të cilin refuzohet regjistrimi ndalet së rrjedhuri nga data e kërkesës me shkrim. Me pranimin e informacioneve plotësuese, ose të qartësimeve të kërkuara, organi kompetent lëshon Certifikatën për Regjistrim, ose vendimin për refuzim të regjistrimit brenda afatit prej:
    10.1. numrit të ditëve të mbetura nga afati gjashtëdhjetë (60) ditësh për lëshimin e vendimit;
    10.2. katërmbëdhjetë (14) ditësh nga pranimi i informatave plotësuese, ose qartësimit, cilido nga këto afate të jetë më i gjatë.
11. OJQ-ja informon organin kompetent brenda tridhjetë (30) ditësh lidhur me çdo ndryshim që pësojnë informatat që kërkohen sipas paragrafëve 1. dhe 3. të nenit 6 dhe paragrafit 5. të këtij neni. Ndryshimet në regjistrim u nënshtrohen procedurave, standardeve dhe afateve të njëjta kohore, sikur ato që janë zbatuar me rastin e regjistrimit fillestar. Ndryshimet që i pranon organi kompetent mbahen, regjistrohen dhe vihen në dispozicion të publikut sipas nenit 12 të këtij ligji.

Neni 10
Refuzimi i regjistrimit

1. Organi kompetent refuzon një kërkesë në qoftë së:
    1.1. dokumentet e regjistrimit janë në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji;
    1.2. në qoftë se statuti i OJQ-së shkel dispozitat e ligjit në fuqi;
    1.3. organizata që kërkon regjistrimin ka të njëjtin emër apo shkurtesë ose një emër shumë të ngjashëm me OJQ-në e regjistruar ose të themeluar më parë, saqë mund të shkaktonte konfuzion;
    1.4. nëse me statut dhe me program të OJQ-së promovohen pabarazia në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës,

gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

Neni 11
Statusi ligjor

1. OJQ-ja vendore ka statusin e personit juridik me regjistrim në përputhje me këtë ligj.
2. Me regjistrim, OJQ-të e vendit të huaj dhe ato ndërkombëtare janë të autorizuara të veprojnë si persona juridik në Kosovë.
3. OJQ-të vendore, të vendit të huaj, dhe ato ndërkombëtare u nënshtrohen të gjitha ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës.
4. Çdo njoftim, letër, ftesë, apo akt tjetër ligjor konsiderohet se i është dorëzuar në mënyrë valide OJQ-së, nëse i dorëzohet personalisht, ose me postë përfaqësuesit të autorizuar, ose në adresën e theksuar sipas nën-paragrafit 1.3. paragrafi 1. i nenit 6 dhe nën-paragrafit 5.3. paragrafi 5. i nenit 9 të këtij ligji.
5. Zyrtarët, drejtorët dhe punëtorët e OJQ-së së regjistruar nuk janë personalisht përgjegjës për borxhet apo obligimet e OJQ-së, por janë personalisht përgjegjës për shkeljet që shkaktohen me dashje, me pakujdesi ose me moskryerje të detyrës.

Neni 12
Regjistri i OJQ-ve

1. Organi kompetent mbanë një regjistër të OJQ-ve.
2. Regjistri përmban: emrin, adresën, formën e organizimit dhe qëllimet, themeluesit e çdo OJQ-je, emrin dhe informacionin tjetër të kontaktit të përfaqësuesit të autorizuar si dhe të dhënën nëse OJQ-ja ka status të përfituesit publik.
3. Organi kompetent është përgjegjës për përditësimin e të dhënave të regjistrit publik.
4. OJQ-të vendore, të vendit të huaj dhe ato ndërkombëtare janë të obliguara që një herë në vit të dorëzojnë në organin kompetent një deklaratë, e cila konfirmon se informatat që kërkohen sipas paragrafit 2. të këtij neni janë ende të vlefshme, ose kanë ndryshuar.
5. Dështimi për të dorëzuar këtë deklaratë për dy (2) vite me radhë obligon organin kompetent që të ndërmarrë procedurat e çregjistrimit të OJQ-së. Organi kompetent obligohet që gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të afatit tre (3) vjeçar për të dorëzuar këtë deklaratë, të njoftojë me shkrim OJQ-në për pasojat e dështimit për të plotësuar këtë obligim.
6. Regjistri i vihet në dispozicion publikut në pajtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU III
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I BRENDSHËM I OJQ-së

Neni 13
Udhëheqja e brendshme e Shoqatave dhe Fondacioneve

1. Organi më i lartë drejtues i shoqatës është Kuvendi, i cili përbëhet nga të gjithë anëtarët e shoqatës. Të gjithë anëtarët e shoqatës kanë të drejtë pjesëmarrjeje në takimet e Kuvendit.
2. Organi më i lartë drejtues i një fondacioni është Bordi i Drejtorëve. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga të paktën tre anëtarë.
3. Organi më i lartë drejtues ka përgjegjësi të plota për çështje të politikës dhe financave të organizatës dhe takohet të paktën një herë në vit, në mbledhjen ku shqyrtohet dhe miratohet raporti për mjetet, detyrimet, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e kaluar, si dhe plani për mjetet e detyrimet e parapara, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e ardhshëm.
4. Organi më i lartë drejtues i OJQ-së, nuk delegon:
   4.1. detyrat sipas paragrafit 3. të këtij neni;
   4.2. zgjedhjet e zyrtarëve në pozita udhëheqëse të OJQ-së;
   4.3. ndryshimet në aktin themelues apo Statut dhe
   4.4. vendimet për bashkimin, ndarjen apo shuarjen e OJQ-së.

Neni 14
Konflikti i interesave dhe detyrimi në lojalitet

1. Asnjë anëtari të organit drejtues nuk i lejohet të marrë pjesë në diskutim apo në marrjen e vendimit për çështje ku ai ka interes direkt apo indirekt ekonomik. Anëtari i organit drejtues konsiderohet se ka interes ekonomik nëse ai/ajo, ose cilido anëtar i familjes së tij ka interes direkt apo indirekt ekonomik.
2. Çdo transaksion ndërmjet OJQ-së dhe një organizate tjetër të ndërlidhur, apo ndërmjet OJQ-së dhe anëtarëve, zyrtarëve, anëtarëve të bordit ose punonjësve të saj ndalohet, përveç, nëse organi drejtues vendos, pas hetimeve të arsyeshme, se transaksioni është në interes, i drejtë dhe i arsyeshëm për OJQ-në, dhe se OJQ-ja nuk kishte mundur të sigurojë marrëveshje më të favorshme me përpjekje të arsyeshme dhe brenda rrethanave ekzistuese.
3. Zyrtarët dhe anëtarët e bordit të një OJQ-je e kanë detyrë që të tregojnë lojalitet ndaj OJQ-së, të mbrojnë fshehtësinë e informatave jopublike të OJQ-së dhe interesat e OJQ-së, si dhe të ushtrojnë përgjegjësitë e OJQ-së me mirëbesim dhe kujdes.

Neni 15
Ndalimi i mbledhjes së fondeve, fushatave dhe mbështetjes së kandidatëve dhe partive politike

OJQ-të nuk mund të angazhohen në mbledhje fondesh ose në fushata për të mbështetur partitë politike ose kandidatët për funksione politike, dhe as nuk mund të propozojnë,

regjistrojnë ose në ndonjë mënyrë të mbështesin kandidatët për poste publike.

Neni 16
Pasuria dhe mjetet

1. Të ardhurat e OJQ-së përfshijnë: donacionet në të holla, letrat me vlerë, kontributet në mall, trashëgimitë, anëtarësinë, dhuratat, grantet, pasurinë e tundshme dhe e patundshme si dhe të ardhurat e fituara përmes çfarëdo aktivitetesh të ligjshme të OJQ-së me pasurinë dhe mjetet e saja.
2. OJQ-ja mund të angazhohet në aktivitete ekonomike me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të saja jofitimprurëse, në pajtim me nenin 4, dhe me kusht që të ardhurat e realizuara nëpërmjet të aktiviteteve ekonomike të shfrytëzohen ekskluzivisht për të arritur qëllimet e theksuara në statutin e OJQ-së.
3. OJQ-ja mund të ketë dhe të menaxhojë pronë dhe pasuri për të realizuar qëllimet e veta jofitimprurëse.
4. Me ligj ndalohet financimi i organizatave, veprimtaria e të cilave nuk përkon me rendin juridik në Republikën e Kosovës dhe të drejtën ndërkombëtare.

KREU IV
STATUSI PËR PËRFITIM PUBLIK I OJQ-së, RAPORTIMI FINANCIAR DHE PEZULLIMI I TIJ

Neni 17
Statusi për Përfitim Publik

1. OJQ-ja e regjistruar sipas këtij ligji mund të paraqesë kërkesë për status për përfitim publik, nëse OJQ-ja është e organizuar dhe vepron për të ndërmarrë një apo më shumë aktivitete si aktivitete parësore si: ndihmë dhe përkrahje humanitare, përkrahje personave me aftësi të kufizuara, aktivitete bamirëse, arsim, shëndetësi, kulturë, rini, sport, ruajtje dhe përparim të mjedisit, rindërtim dhe zhvillim ekonomik, mbrojtje dhe përparim të të drejtave të njeriut, mbështetje të praktikave demokratike dhe shoqërisë civile, apo çfarëdo veprimtarie tjetër që është në funksion të së mirës së publikut.
2. Veprimtaria e OJQ-së arsimore dhe shëndetësore përfshinë veprimtari për të mirën e publikut, vetëm në rast se përfitime të konsiderueshme sigurohen falas ose më lirë se vlera reale e tregut për grupe ose individë në kushte të pavolitshme. Veprimtaria e OJQ-së për zhvillim ekonomik përfshinë veprimtari për të mirën e publikut, vetëm nëse ndërmerret, në radhë të parë për të mirën e individëve dhe grupeve në kushte të pavolitshme.
3. OJQ-ja mund të paraqesë kërkesë për status për përfitim publik me rastin e regjistrimit fillestar të OJQ-së ose më vonë. Organi kompetent i lejon OJQ-së statusin për përfitim publik, nëse dokumentet e regjistrimit dëshmojnë se qëllimet dhe veprimtaria e OJQ-së i plotëson kërkesat e paragrafit 1. dhe paragrafit 2. të këtij neni.
4. OJQ-të me status të përfituesit publik gëzojnë të drejtën për lirim nga tatimi dhe lehtësi tatimore dhe fiskale sipas legjislacionit ne fuqi me përjashtim të atyre që në esencë janë detyrime për shërbimet publike komunale.

5. Për zbatimin e këtij neni, Ministria propozon aktin nënligjor, i cili aprovohet nga Qeveria.

Neni 18
Obligimet për raportim financiar dhe të aktivitetit për OJQ-të me status për përfitim publik

1. OJQ-ja, të cilës i është lejuar statusi për përfitim publik, duhet t'i paraqesë organit kompetent çdo vit një raport vjetor për veprimet dhe aktivitetet e saj në Kosovë. Raportet duhet të dorëzohen deri në fund të muajit mars të secilit vit për vitin raportues që përfundon me 31 dhjetor të vitit paraprak.
2. Raporti vjetor duhet nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i OJQ-së. Përfaqësuesi i autorizuar është përgjegjës për saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave që i përmban raporti.
3. Raporti vjetor domosdo përbëhet nga tri pjesët në vijim:
   3.1. pjesa për menaxhment dhe administratë;
   3.2. raporti për aktivitete dhe të arritura;
   3.3. raporti financiar.
4. Pjesa për menaxhment dhe Administratë duhet të përmbajë:
   4.1. emrin, shkurtesën (emërtimin me iniciale), adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresën elektronike (e-mail) të OJQ-së;
   4.2. emrin e zyrtarit kryesor ekzekutiv (p.sh. përgjegjës apo drejtor ekzekutiv);
   4.3. emrat e anëtarëve të organit udhëheqës, si dhe emrat e titujt e të gjithë zyrtarëve në pozita udhëheqëse.
5. Raporti i aktiviteteve dhe të arriturave duhet të përmbaj:
   5.1. një deklaratë për misionin dhe qëllimin mirëbërës shoqëror të OJQ-së;
   5.2. identifikimin e programeve kryesore dhe aktiviteteve që kanë për qëllim realizimin e atyre programeve. Deklarata duhet të jetë e mjaftueshme për të dëshmuar mënyrën si organizata i realizon qëllimet e veta mirëbërëse shoqërore përmes aktiviteteve të veta;
   5.3. një deklaratë për arritjet kryesore të programeve;
   5.4. nëse OJQ-ja merr përsipër aktivitete të tjera, përveç atyre që shkojnë në dobi të shoqërisë, siç është përcaktuar me paragrafin 1. të nenit 17 të këtij ligji, një deklaratë, e cila i përshkruan ato aktivitete;
   5.5. një deklaratë se OJQ-ja nuk ka mbledhur fonde dhe nuk ka bërë fushatë për përkrahjen e partive politike apo për emërimin dhe zgjedhjen e kandidatëve në detyra të ndryshme publike, apo për regjistrimin dhe përkrahjen e kandidatëve të emëruar apo të zgjedhur në funksione publike gjatë periudhës për të cilën raportohet;
   5.6. OJQ-ja që është e angazhuar në aktivitete mirëbërëse shoqërore, në lëmin e arsimit apo të shëndetësisë, dorëzon edhe një deklaratë për:
      5.6.1. llojin e grupeve ose individëve në kushte të pavolitshme, të cilët i shërben;
      5.6.2. llojin e dobive që organizata u ofron grupeve ose individëve në kushte të pavolitshme;
      5.6.3. një deklaratë se ato dobi ofrohen falas, apo, së paku më lirë se vlera e tyre në treg;

5.7. OJQ-ja, e cila angazhohet në aktivitete mirëbërëse shoqërore në sferën e zhvillimit ekonomik, dorëzon edhe një deklaratë për llojin e individëve dhe grupeve në kushte të pavolitshme që u shërben.

6. Raportet financiare përgatiten në formularë, të cilët i siguron organi kompetent, dhe të cilët përmbajnë, së paku:
   6.1. një fletë-bilanc, ku shihen pasuria dhe përgjegjësitë financiare të organizatës;
   6.2. raportin financiar mbi burimin e të hyrave, ku të hyrat dhe të dalat e OJQ-së paraqiten ndarazi për pjesën për menaxhment dhe administratë, dhe atë programore.
7. Organi kompetent me kërkesën e OJQ-së mund ta caktojë një afat shtesë për dorëzimin e raportit vjetor, nëse këtë e kanë imponuar situatat e jashtëzakonshme, por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga dita e kalimit të këtyre rrethanave.
8. Deklaratat financiare përgatitën deri më ditën e fundit të muajit mars për periudhën prej një viti, që përfundon me datën 31 dhjetor të vitit paraprak.
9. Raportet financiare të përgatitura dhe të dorëzuara nga OJQ-të vendore, me të hyra vjetore ose me shpenzime mbi njëqindmijë (100.000) euro, nga OJQ-të e huaja dhe ndërkombëtare me të hyra ose shpenzime vjetore për veprimtarinë dhe aktivitetin e tyre brenda Republikës së Kosovës mbi njëqindmijë (100.000) euro, duhet të prezantojnë pasqyrën financiare të vitit fiskal si në Republikën e Kosovës, duke përfshirë edhe raportin e auditimit për vitin paraprak, të nënshkruar nga auditori i licencuar në Republikën e Kosovës, në mënyrë që aspektet materiale dhe pozita financiare e organizatës për atë periudhë raportimi të jetë e drejtë.
10. Raporti vjetor duhet të përfshijë:
    10.1. një deklaratë, e cila i përfshinë të gjithë veprimtarinë si dhe pagesën e pagave të punonjësve të OJQ-së, duke përfshirë përshkrimin e punës së të angazhuarve dhe marrëdhënieve kontraktuale ndërmjet OJQ-së dhe palës tjetër në kryerjen e asaj pune; ose
    10.2. një vërtetim se OJQ-ja nuk ka zhvilluar veprimet e parapara sipas nën-paragrafit 10.1. të këtij paragrafi, gjatë periudhës për të cilën raportohet.
11. Raportet e dorëzuara në pajtim me këtë nen, vihen në dispozicion publikut. OJQ-ja ka mundësi t'i veçojë informatat apo pasurinë, të cilën ajo e konsideron konfidenciale në raportin e saj dhe të kërkojë që organi kompetent t'ia fshijë ato të dhëna para se raporti të bëhet publik. Informatat apo pasuria, e cila mund të konsiderohet konfidenciale për qëllime të këtij neni përfshinë informatat personale ose financiare të punonjësve të organizatës. OJQ-ja duhet të paraqesë një kërkesë për mos publikim të informatave të këtilla atëherë kur ia dorëzon raportin organit kompetent, si dhe duhet të paraqesë arsyet për trajtim konfidencial të informacioneve. Përveç kësaj, OJQ-ja duhet të paraqesë informatën konfidenciale në mënyrë të ndarë nga pjesa tjetër e raportit, dhe domosdo duhet që në mënyrë të qartë të theksojë se raporti përfshinë kërkesën për mospublikim të informacionit. Organi kompetent i përgjigjet me shkrim kërkesës për mospublikim brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas dorëzimit të kërkesës.
12. Publikimi i paautorizuar dhe kundër ligjor, nga organi kompetent, i cili disponon të dhënat përkatëse ndëshkohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.
13. Organi kompetent, pas plotësimit me sukses të obligimit për raportim të OJQ-së

me status për përfitim publik, siç parashihet me këtë nen, OJQ-së i lëshon certifikatën e re të statusit për përfitim publik në afat një (1) vjeçar.

Neni 19
Pezullimi, revokimi dhe tërheqja vullnetare e Statusit për Përfitim Publik

1. Organi kompetent pezullon statusin e përfituesit publik të një OJQ-je, e cila nuk paraqet raport të plotë vjetor, ashtu siç kërkohet me nenin 18. OJQ-ja që dështon të paraqesë raportin e kërkuar me këtë ligj brenda afatit të paraparë me paragrafin 1. të nenit 18 të këtij ligji, ose paraqet raport jo të plotë, njoftohet me shkrim për dështimin nga ana e organit kompetent. Njoftimi me shkrim udhëzon OJQ-në që të paraqesë raportin që mungon, ose atë jo të plotë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga data e njoftimit, si dhe e informon OJQ-në, që dështimi në përmbushjen e kësaj kërkese ka për pasojë pezullimin e statusit të përfituesit publik dhe të gjitha përfitimeve që rrjedhin nga ai.
2. OJQ-ja që dështon të paraqesë raport të plotë, siç kërkohet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga data e njoftimit me shkrim, në bazë të paragrafit 1. të këtij neni, njoftohet me shkrim nga organi kompetent se statusi i saj i përfituesit publik, së bashku me të gjitha përfitimet që rrjedhin nga ai status janë pezulluar, dhe se, nëse OJQ-ja dështon të sigurojë raportin brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh, pas njoftimit, organi kompetent nxjerr vendim për revokimin e statusit për përfitim publik. OJQ-ja është e detyruar që në mënyrë retroaktive t'i kryejë të gjitha detyrimet tatimore dhe doganore të papaguara që kanë rrjedhur nga lehtësitë tatimore dhe doganore të Statusit për Përfitim Publik, për periudhën për të cilën ka dështuar të raportojë në afat prej gjashtë (6) muajsh nga dita e pranimit të vendimit.
3. Organi kompetent pezullon statusin për përfitim publik të një OJQ-je, nëse pas shqyrtimit të raportit vjetor të dorëzuar nga OJQ-ja, verifikon se OJQ-ja nuk plotëson më tutje kërkesat për status për përfitim publik të parapara me nenin 17 të Ligjit. Pas një verifikimi të këtillë, organi kompetent e njofton me shkrim OJQ-në për arsyet e pezullimit të statusit për përfitim publik dhe përfitimeve që rrjedhin nga ai status. OJQ-ja ka mundësi që brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, që nga dita e pranimit të njoftimit, t'i sigurojë organit kompetent informata me shkrim, që e mbështesin të drejtën e saj për status për përfitim publik. Nëse OJQ-ja nuk siguron informata të bazuara brenda afatit të paraparë, organi kompetent nxjerr vendim për revokimin e statusit për përfitim publik. OJQ-ja është e detyruar që në mënyrë retroaktive t'i kryejë të gjitha detyrimet tatimore dhe doganore të papaguara që kanë rrjedhur nga lehtësitë tatimore dhe doganore të Statusit për Përfitim Publik, për periudhën për të cilën janë konstatuar shkeljet në afat prej gjashtë (6) muajsh nga dita e pranimit të vendimit. Organi kompetent i njofton me shkrim organet tatimore dhe doganore për vendimin e marrë.
4. OJQ-ja së cilës i është revokuar statusi për përfitim publik, ka të drejtë të kërkojë përsëri të njëjtin pas kalimit të afatit trevjeçar nga data e revokimit.
5. OJQ-ja me status për përfitim publik mund të bëjë kërkesë për tërheqjen nga ky status pas përfundimit të vitit financiar për të cilin i ka gëzuar lehtësirat që i ka garantuar statusi për përfitim publik. Kërkesa për tërheqje nga ky status për vitin e

ardhshëm duhet të bëhet të paktën dyzet e pesë (45) ditë para përfundimit të vitit kalendarik gjatë të cilit OJQ-ja është duke e gëzuar statusin për përfitim publik. Organi kompetent është i obliguar që për tërheqjen nga statusi për përfitim publik të vendosë jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas pranimit të kërkesës, duke i njoftuar për vendimin të gjitha organet tatimore dhe doganore. OJQ-ja që tërheq vullnetarisht statusin për përfitim publik, ka të drejtë që të kërkojë përsëri këtë status, sipas procedurave të parapara me ligj.

KREU V
SHUARJA DHE ÇREGJISTRIMI I OJQ-së

Neni 20
Shuarja e OJQ-së

1. OJQ-ja shuhet:
   1.1. me vendim vullnetar për shuarjen e OJQ-së të marrë nga organi më i lartë udhëheqës në pajtim me statutin e saj;
   1.2. kur OJQ-ja bëhet josolvente sipas ligjit në fuqi;
   1.3. me kalimin e afatit për të cilin është themeluar, nëse një afat i tillë është i përcaktuar në aktin themelues;
   1.4. në bazë të vendimit të plotfuqishëm gjyqësor.

Neni 21
Çregjistrimi i OJQ-së

1. Organi kompetent çregjistron OJQ-në:
   1.1. në njërën nga rastet e përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 20 të këtij ligji;
   1.2. nëse OJQ-ja për tri (3) vite me radhë dështon të paraqesë deklaratën vjetore të paraparë në paragrafin 5. të nenit 12 të këtij ligji.
2. Organi kompetent i jep OJQ-së njoftim me shkrim për arsyet e çregjistrimit si dhe mundësinë që të përgjigjet para se të merret vendimi për çregjistrimin e OJQ-së.
3. Në rast të shuarjes ose çregjistrimit të OJQ-së, e cila ka shfrytëzuar lehtësi tatimore ose fiskale, donacione publike, ose grante nga qeveria, e gjithë pasuria e mbetur pas shlyerjes së borxheve të OJQ-së i jepet OJQ-së tjetër me qëllime të njëjta apo të ngjashme. Kjo OJQ identifikohet në bazë të statutit të OJQ-së, ose me propozim të organit më të lartë udhëheqës të OJQ-së. Ministria themelon Komisionin për Shpërndarjen e Pasurisë së mbetur të OJQ-së së shuar dhe të çregjistruar, me përfaqësues edhe të OJQ-ve, duke u bazuar në aktin nënligjor të nxjerrë nga Qeveria.
4. Në të gjitha rastet tjera, çdo pasuri e mbetur pas pagesës së borxheve shpërndahet në bazë të statutit apo të vendimit të organit më të lartë udhëheqës, dhe në të gjitha rastet në përputhshmëri me nenin 4 të këtij ligji.
5. OJQ-ja me status të përfituesit publik që është shpërbërë, është çregjistruar, ose pushon së vepruari në Kosovë brenda afatit të raportimit paraqet raport për atë periudhë, në përputhshmëri me nenin 4 dhe 18 të këtij ligji. Në raportin e saj, OJQ-ja thekson datën e shpërndarjes, shuarjes, çregjistrimit, dispozitat për përfundimin

e punës së saj, si dhe shumën e mjeteve të mbetura pas përmbushjes së obligimeve, mënyrën e planifikuar të disponimit me mjete, si dhe mënyrën në të cilën është marrë vendimi për disponim me mjete (konkretisht, me dispozitë të përcaktuar në Statutin e organizatës, me vendim të organit më të lartë udhëheqës, apo me vendim të organit kompetent).

6. Përfaqësuesi i autorizuar i OJQ-së ka përgjegjësi juridike para organit kompetent për regjistrim dhe organeve tjera.
7. Pas shterjes së të gjitha të drejtave për ankesë, dhe në bazë të vendimit për çregjistrim, organi kompetent e heq OJQ-në nga regjistri i OJQ-ve.

KREU VI
BASHKËPUNIMI DHE PËRKRAHJA E OJQ-ve

Neni 22
Institucionet e Republikës së Kosovës dhe OJQ-të

Institucionet e Republikës së Kosovës përkrahin, por nuk ndërhyjnë në veprimtaritë e OJQ-ve, dhe bëjnë publike të gjitha format e bashkëpunimit dhe përkrahjes. Dhënia e çfarëdo fondi publik për OJQ nga institucionet e Republikës së Kosovës bëhet në bazë të kritereve të paracaktuara dhe publike.

Neni 23
Ankesat

1. Nëse OJQ-ja është e pakënaqur me vendimin e organit të shkallës së parë ka të drejtë t'i drejtohet me ankesë organit të shkallës së dytë.
2. Ankesa i drejtohet organit të shkallës së dytë përmes organit të shkallës së parë.
3. Ministria përkatëse themelon organin e shkallës së dytë, i cili duhet të jetë i pavarur.
4. Mënyra e krijimit dhe funksionimit të këtij organi rregullohet me rregullore të veçantë që e nxjerr Ministria përkatëse.

KREU VII
DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 24
Aktet nënligjore

1. Ministria propozon aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, në afat prej gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të ligjit.
2. Qeveria nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji më së largu nëntë (9) muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit.

Neni 25
Shfuqizimi

Ky ligj shfuqizon Ligjin Nr. 03/ L-134 për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare dhe çdo dispozitë të legjislacionit që bie në kundërshtim me këtë ligj që ka të bëjë me lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.

Neni 26
OJQ-të e regjistruara sipas Ligjit 03/L134 për Lirinë e Asociimit në OJQ në Kosovë

Çdo OJQ e regjistruar sipas Ligjit 03/L134 për Lirinë e Asociimit në OJQ në Kosovë konsiderohet e regjistruar në Kosovë sipas këtij ligji.

Neni 27
Hyrja në Fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-057
29 gusht 2011

Shpallur me dekretin Nr. DL-034-2011, datë 31.08.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 14 / 9 SHTATOR 2011, PRISHTINË

LIGJI Nr. 04/L-076
PËR POLICINË

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 349
Kreu II: Detyrat dhe autorizimet e policisë 353
Kreu III: Organizimi i policisë së Republikës së Kosovës 362
Kreu IV: Menaxhmenti i lartë i policisë 365
Kreu V: Marrëdhënia e punës 368
Kreu VI: Financimi 371
Kreu VII: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 372

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR POLICINË

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj rregullon autorizimet dhe detyrat e Policisë së Republikës së Kosovës, organizimin e saj dhe çështje të tjera lidhur me aktivitetet dhe veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës.

Neni 2
Parimet udhëzuese

1. Veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës udhëhiqen nga parimet e mëposhtme:
   1.1. trajtimi i barabartë dhe i drejtë i të gjithë personave;
   1.2. respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;
   1.3. paanshmëria dhe neutraliteti lidhur me bindjet dhe pikëpamjet politike të personave;
   1.4. integriteti, ndershmëria dhe përgjegjësia në shërbimin publik;
   1.5. transparenca - ofrimi i informatave për qytetarët dhe të qenit të hapur ndaj publikut;

1.6. legjitimiteti, përshtatshmëria dhe proporcionaliteti;
1.7. përkushtimi ndaj punësimit, avancimit dhe caktimit të detyrave në mënyrë gjithëpërfshirëse, meritore dhe pa diskriminim, duke reflektuar karakterin shumetnik në Republikën e Kosovës dhe duke i njohur parimet e barazisë gjinore dhe të drejtat e njeriut të parapara në Kushtetutë.

2. Zyrtarët policorë ushtrojnë autorizimet e tyre dhe kryejnë detyrat në mënyrë të ligjshme, të bazuara në Kushtetutë, në ligjet e tjera në fuqi dhe në Kodin e Etikës të hartuar nga Policia e Republikës së Kosovës dhe të miratuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.
3. Kodi i Etikës duhet të jetë në përputhje me parimet e lartpërmendura dhe me Kodin Evropian të Etikës Policore.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
1.1. **Komision** - Komisioni i themeluar nga Ministri i Punëve të Brendshme për përzgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe Zëvendësdrejtorëve të Përgjithshëm të Policisë;
1.2. **Stafi Civil -** personeli i policisë të cilët janë të punësuar për të kryer shërbime administrative apo mbështetëse por të cilët nuk kanë autorizime policore;
1.3. **Drejtorët e Departamenteve -** Drejtorët e Departamenteve të cilët udhëheqin njërën nga fushat e caktuara te nivelit qendror në Policinë e Republikës së Kosovës;
1.4. **Zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm**- Zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm të Policisë së Republikës së Kosovës;
1.5. **Drejtori i përgjithshëm-** Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Republikës së Kosovës;
1.6. **Inspektorati –** Inspektorati Policor të Republikës së Kosovës të themeluar me Ligjin për Inspektoratin Policor;
1.7. **Objektivi i ligjshëm i Policisë -** synimi të cilin e ndjek policia gjatë ushtrimit të funksioneve të saj, që është në pajtim me kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
1.8. **Ministri -** Ministrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme;
1.9. **Ministria -** Ministrinë e Punëve të Brendshme;
1.10. **Policia -** Policia e Republikës së Kosovës;
1.11. **Zyrtari Policor -** zyrtari nën betim i Policisë së Republikës së Kosovës, të cilit i është dhënë autoriteti për të ushtruar autorizime policore në kryerjen e detyrave të tij/saj;
1.12. **Autorizimet Policore -** autorizimet e zyrtarit policor që të imponoj kontroll të arsyeshëm ndaj njerëzve dhe pronës brenda juridiksionit të tij/saj për mbrojtjen e rendit dhe sigurisë publike;
1.13. **Drejtori rajonal -** çdo drejtor rajonal i Policisë së Republikës së Kosovës, përfshirë edhe drejtorin rajonal të policisë kufitare;
1.14. **Këshilli Komunal për Siguri** - Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi të themeluar në secilën komunë të Republikës së Kosovës; dhe

1.15. **Komiteti Lokal për Siguri -** Komiteti Lokal i Sigurisë në Bashkësi të themeluar nga drejtori i përgjithshëm në komunitetin lokal në kuadër të një komune të Republikës së Kosovës.

Neni 4
Statusi i Policisë

1. Me këtë ligj, Policia e Republikës së Kosovës është shërbim publik në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
2. Policia është person juridik.
3. Policia vepron nëpërmjet zinxhirit të unifikuar komandues në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
4. Policia ka uniformën, flamurin dhe emblemën e vet të cilat aprovohen nga qeveria me propozimin e ministrit.

Neni 5
Marrëdhëniet ndërmjet Policisë dhe Ministrisë

1. Policia funksionon nën autoritetin e Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë. Autoriteti i ministrit nuk përfshinë menaxhimin operacional të policisë. Drejtori i përgjithshëm i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt ministrit për administrimin dhe menaxhimin e policisë. Drejtori i përgjithshëm bashkëpunon me ministrin dhe i ofron informata dhe raporte atij sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
2. Në fushën e rendit dhe të sigurisë publike, ministri ka këto të drejta:
   2.1. t'i zhvilloj politikat dhe ta mbështesë përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit;
   2.2. ta mbikëqyrë koordinimin ndërmjet policisë dhe autoriteteve të tjera publike lidhur me kontrollin e kalimit kufitar;
   2.3. ta mbikëqyrë bashkëpunimin ndërmjet policisë dhe agjencive të tjera, organizatave ndërkombëtare përgjegjëse në fushën e rendit dhe të sigurisë publike;
   2.4. t'i zhvilloj dhe t'i zbatoj strategjitë për marrëdhëniet me publikun dhe marrëdhëniet me organet e tjera përgjegjëse në fushën e rendit dhe të sigurisë publike;
   2.5. të mbledh, të mbaj dhe të analizoj të dhëna statistikore dhe informata; dhe
   2.6. të kryej funksione që lidhen me përgatitjet për raste emergjente, siç është përcaktuar me këtë ligj dhe ligjet e aplikueshme.

Neni 6
Marrëdhëniet ndërmjet Policisë, Prokurorit Publik dhe Gjykatës

1. Policia zbaton urdhrat dhe udhëzimet e lëshuara në mënyrë të ligjshme nga prokurori publik ose gjyqtari kompetent.
2. Policia bashkëpunon dhe i raporton Zyrës së Prokurorit Publik kompetent për informatat lidhur me akuzat për aktivitete të dyshimta kriminale, për të cilat policia është njoftuar në pajtim me ligjin e aplikueshëm.

Neni 7
Bashkëpunimi me komunitetin

1. Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit dhe për shtimin e sigurisë për të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës, policia komunikon dhe bashkëpunon me autoritetet e qeverisë lokale, organizatat civile dhe me komunitetet lokale.
2. Policia bashkëpunon me komunitetin, ndërkaq komandanti i stacionit dhe përfaqësues të tjerë policorë marrin pjesë në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, të themeluar në secilën komunë.
3. Këshilli për Siguri është një organ këshillues i kryesuar nga kryetari i komunës dhe anëtarë që janë përfaqësues të të gjitha komuniteteve përbrenda komunës.
4. Qëllimi i Këshillit të Sigurisë është që ta zhvilloj vetëdijesimin lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal, t'i identifikoj brengat lidhur me sigurinë publike dhe t'i rekomandoj planet e veprimit, për t'i adresuar këto brenga me përpjekje bashkëpunuese të autoriteteve komunale, komuniteteve lokale dhe policisë.
5. Drejtori i përgjithshëm është i autorizuar të themelojë Komitetin për Siguri Publike, si një organ këshillues, në kuadër të ndonjë zone të caktuar në çdo komunë që është në interesin më të mirë për një punë efektive të policisë në bashkësi.

Neni 8
Bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe me ato lokale të qeverisjes

1. Policia bashkëpunon me institucione të qeverisjes qendrore të Republikës së Kosovës që janë përgjegjëse në fushën e sigurisë. Bashkëpunimi i tillë rregullohet me akte nënligjore të qeverisë dhe me memorandume të mirëkuptimit, të miratuara nga ministri.
2. Me kërkesë të institucioneve të qeverisjes qendrore ose lokale, policia është e autorizuar t'ju ofroj ndihmë në kryerjen e detyrave publike, kur ka arsye për të besuar se siguria e personit ose e personave që kryejnë detyra publike mund të rrezikohet për shkak të rezistimit të mundshëm ndaj veprimeve të tyre.

Neni 9

Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Policia bashkëpunon me organizatat policore ndërkombëtare dhe me institucionet e tjera të huaja, në bazë të ligjit në fuqi ose sipas marrëveshjes ndërkombëtare.
2. Policia mund të dërgoj zyrtarë policorë në shërbim të përkohshëm në një organizatë tjetër policore ndërkombëtare me qëllim të kryerjes së detyrave policore jashtë vendit, në përputhje me ligjin në fuqi ose në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare.

KREU II
DETYRAT DHE AUTORIZIMET E POLICISË

Neni 10
Detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të policisë

1. Detyrat e përgjithshme të policisë janë të:
   1.1. mbroj jetën, pronën dhe të ofroj siguri për të gjithë personat;
   1.2. mbroj të drejtat dhe liritë themelore të të gjithë personave;
   1.3. parandaloj rrezikun ndaj qytetarëve dhe ta mbajë rendin dhe sigurinë publike;
   1.4. parandaloj dhe t'i zbuloj veprat penale dhe kryesit e tyre;
   1.5. hetoj veprat penale dhe kryesit e tyre;
   1.6. mbikëqyrë dhe kontrolloj sigurinë në komunikacion;
   1.7. menaxhoj dhe kontrolloj kufirin shtetëror;
   1.8. ofroj ndihmë gjatë fatkeqësive natyrore dhe në raste të tjera emergjente; dhe
   1.9. kryej detyra të tjera të parapara me ligjin në fuqi.

Neni 11
Autorizimet policore

1. Gjatë kryerjes së detyrave policore, zyrtari policor ka autorizim të ushtrojë kontroll të arsyeshëm mbi njerëzit dhe pronën në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve të tij apo të saj, të jap dhe të zbatoj urdhra dhe instruksione të ligjshme për anëtarët e shoqërisë në përgjithësi, për t'i arritur objektivat ligjore të policisë.
2. Autorizimet e cekura në këtë ligj përcaktojnë autorizimet e përgjithshme dhe kufizimet e zyrtarit policor në kryerjen e detyrave të tij lidhur me parandalimin e rrezikut dhe mbajtjen e rendit dhe të sigurisë publike. Autorizimet dhe kufizimet e zyrtarit policor gjatë ushtrimit të detyrave përkitazi me hetimet penale, në mënyrë të përgjithshme, janë përcaktuar në ligjet e tjera, duke i përfshirë, por jo duke u kufizuar, në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.
3. Gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, zyrtarët policorë, kanë autorizim të patrullojnë kufirin, ta kontrollojnë trafikun ndërkufitarë, t'i ekzaminojnë dokumentet për kalimin e kufirit, të hyjnë në pronën private në zonën kufitare, përjashtimisht ata nuk mund të hyjnë në banesa private, por mund të hyjnë në stacione hekurudhore, aeroporte, trena dhe në aeroplanë. Policia ka të drejtë të njihet me pronarin e pronës përgjatë kufirit, të ketë rrugë apo shteg përgjatë vijës kufitare dhe porta në murin rrethues për t'iu mundësuar qasje zyrtarëve policorë gjatë patrullimit.
4. Policia ofron siguri dhe mbrojtje për vendet e trashëgimisë fetare dhe kulturore në Republikën e Kosovës.
5. Zyrtari policor ushtron autorizimet policore edhe jashtë orarit të punës në pajtim me ligjin.

Neni 12
Përshtatshmëria dhe proporcionaliteti

1. Zyrtari policor zbaton parimet e përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit si një kufizim në ushtrimin e autorizimeve policore.
2. Kur ndërmerr masa parandaluese për ta kufizuar lirinë e personit, zyrtari policor duhet ta ketë parasysh maturinë, shkallën e rrezikut dhe seriozitetin e kryerjes së veprës penale në atë situatë, për ta përcaktuar shkallën e kufizimit të lirisë së personit në pajtim me ligjin.
3. Autorizimet e policisë ushtrohen vetëm atëherë kur është e domosdoshme, dhe vetëm deri në atë nivel që nevojitet për t'i arritur objektivat ligjore të policisë me pasoja sa më pak të dëmshme dhe për kohë sa më të shkurtër të mundshme.

Neni 13
Detyra e zyrtarit policor për t'i zbatuar urdhrat e ligjshëm dhe për t'i refuzuar urdhrat e paligjshëm

1. Zyrtari policor ka për detyrë t'i zbatoj urdhrat e ligjshëm të dhëna nga mbikëqyrësi.
2. Zyrtari policor ka për detyrë t'i refuzoj urdhrat të cilët janë të paligjshëm dhe të raportoj për këtë menjëherë në pajtim me aktet nënligjore.
3. Zyrtari policor nuk do të shkaktoj, nxis, mbështes ose toleroj asnjë akt të torturës, degradimit ose trajtimit çnjerëzor në çfarëdo rrethanash, ndërsa asnjë rrethanë e jashtëzakonshme apo urdhër i lëshuar nuk do ta arsyetojë veprimin e tillë.

Neni 14
Prezantimi i zyrtarit policor

1. Para se t'i ushtroj autorizimet policore, zyrtari policor do t'i njoftoj personat lidhur me statusin e tij/saj si zyrtar policor dhe, nëse nuk është në uniformë, duhet të prezantojë veten duke treguar kartelën e identifikimit ose shenjën e policisë.
2. Zyrtari policor do të prezantohet më vonë në rastet kur vihet në rrezik jeta, prona ose arritja e objektivave legjitime të policisë.

Neni 15
Pranimi i informatave për veprat penale dhe shkeljet e tjera të ligjit

1. Zyrtari policor ka për detyrë t'i pranojë informatat e ofruara nga personat lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale ose me shkeljet e tjera të ligjit që janë relevante për punën dhe kompetencat e policisë.
2. Kur policia konstaton se vepra e raportuar nuk është vepër penale apo është vepër penale e cila ndiqet në bazë të padisë private, zyrtari policor duhet ta informojë personin që ka raportuar dhe palën e dëmtuar nëse ekziston ajo.
3. Informatat për vepra penale përcillen në Zyrën e Prokurorit Publik kompetent ne pajtim me Kodin e Procedurës Penale.

Neni 16
Identifikimi i personave dhe i sendeve

1. Zyrtari policor ka autorizim ta identifikoj personin tjetër atëherë kur:
   1.1. ekziston dyshimi i arsyeshëm se personi ka kryer, është duke kryer, ose do të kryejë vepër penale;
   1.2. ekziston dyshimi i arsyeshëm se personi paraqet rrezik për personat ose pronën, ose është duke shkaktuar shqetësim;
   1.3. gjendet në zonën në të cilën është kryer, është duke u kryer ose ku do të kryhet vepra penale, apo zonën ku është duke u fshehur i dyshuari;
   1.4. gjendet në vend të ndaluar sipas ligjit në fuqi;
   1.5. personi gjendet në vend të ngjarjes, në zonë të kufizuar ose në kufi;
   1.6. duhet të arrestohet ose të paraburgoset;
   1.7. është i autorizuar të ndërmarrë një veprim të tillë në bazë të cilitdo ligj tjetër në fuqi.
2. Në pajtim paragrafin 1. të këtij neni, zyrtari policor është i autorizuar ta ndalë personin, ta pyes për identitetin e tij dhe të kërkojë ndonjë dokument valid identifikimi me fotografi. Zyrtari policor do t'ia tregojë personit shkakun e identifikimit. Kur personi nuk bashkëpunon dhe masat e tjera dështojnë për ta përcaktuar identitetin e tij, zyrtari policor mund ta ndaloj personin, duke i zbatuar procedurat e parapara me ligjin në fuqi, për ta vërtetuar identitetin e tij.
3. Ndalimi zgjatë vetëm aq kohë sa është e domosdoshme për t'u kryer identifikimi, por jo më gjatë se gjashtë (6) orë. Zyrtari policor do ta përpilojë raportin për procedurën e identifikimit dhe një kopje të tij do t'ia japë personit që është në mbajtje nëse kërkohet nga ai/ajo.
4. Zyrtari policor është i autorizuar ta vërtetojë ose ta përcaktojë identitetin e një sendi. Ky autorizim do të ushtrohet kur është e domosdoshme të përcaktohet vlera e një sendi, karakteristikat, pronësia ose për ta përcaktuar lidhjen e sendit me personin, ngjarjen ose me veprimin. Policia është e autorizuar ta publikoj fotografinë, skicën, regjistrimin ose përshkrimin e sendit, nëse ekziston bindje e arsyeshme se ky veprim do të ndihmoj në përcaktimin e identifikimit të sendit.

Neni 17
Thirrjet e policisë

1. Zyrtari policor mund ta thërrasë personin për të dhënë informacione nëse ka arsye të bazuar se personi i caktuar ka informacione të rëndësishme për arritjen e objektivave legjitimë të policisë. Përgjigjja ndaj një ftese të tillë është vullnetare nga personi që e pranon ftesën.
2. Zyrtari policor është i autorizuar që ta thërrasë gojarisht personin e caktuar për intervistë në polici, nëse ekziston arsye e bazuar se ai ka informacione të rëndësishme për arritjen e objektivave legjitime të policisë.
3. Zyrtari policor duhet ta njoftoj personin lidhur me arsyen e thirrjes, dhe nëse personi pajtohet, zyrtari policor e shoqëron atë për në lokalet e policisë. Në raste urgjente, kur vonesa shkakton rrezik ose janë thirrur shumë njerëz, atëherë thirrja mund të publikohet në mediat publike.

4. Zyrtari policor është i autorizuar që me shkrim ta thërrasë personin e caktuar për intervistë në polici, nëse ekziston arsyeja e bazuar se personi ka informacione të rëndësishme për arritjen e objektivave legjitime të policisë. Fletëthirrja do të përmbajë titullin, adresën dhe vendin e organit policor që bën kërkesë për prezencën e personit, arsyen për thirrje, vendin dhe kohën ku duhet të paraqitet personi i thirrur.
5. Intervista policore për të miturit zhvillohet vetëm atëherë kur prindi ose kujdestari ka nënshkruar fletëthirrjen dhe e ka miratuar atë dhe vetëm në praninë e prindit ose të kujdestarit. Përgjigjja ndaj fletëthirrjes është vullnetare nga personi i thirrur.
6. Zyrtari policor lëshon fletëthirrje që personi i kërkuar të paraqitet për intervistë policore vetëm gjatë orarit ditor të punës, me përjashtim kur vonesa e thirrjes paraqet rrezik për personin, pronën, ose për arritjen e objektivave legjitime të policisë.
7. Vetëm sipas urdhrit të gjykatës dhe vetëm në pajtim me ligjin e aplikueshëm, zyrtari policor mund ta përdorë forcën për ta mbajtur personin e thirrur dhe për ta sjellë në stacionin policor ose në ndonjë vend tjetër. Nëse përdoret forca gjatë procesit të thirrjes, personi i thirrur informohet në gjuhën të cilën ai/ajo e kupton, se ka të drejtë të hesht, ta konsultoj mbrojtësin dhe ta kontaktoj një person familjar apo ndonjë person tjetër të besueshëm, siç parashihet në Kodin e Procedurës Penale.

Neni 18
Kufizimi i përkohshëm i lirisë së lëvizjes

1. Zyrtari policor është i autorizuar që përkohësisht t'ia kufizojë lirinë e lëvizjes personit në një zonë të caktuar ose ta orientojë lëvizjen e tij në një zonë tjetër, me qëllim që të sigurohet zona e caktuar për t'i arritur objektivat legjitime të policisë apo për t'i mbrojtur personat nga rreziku i përkohshëm.
2. Objektivat legjitime të policisë përfshijnë, por nuk kufizohen në mbrojtjen e personave nga fatkeqësitë, epidemitë, dhe rastet e tjera të rrezikut të pashmangshëm.
3. Kufizimi i përkohshëm i lirisë së lëvizjes të personit përfundon menjëherë pasi të arrihen objektivat legjitime të policisë lidhur me kufizimin e përkohshëm.

Neni 19
Vërejtjet dhe urdhrat

1. Zyrtari policor është i autorizuar të jap vërejtje gojore, me shkrim, vizuale ose vërejtje të tjera ndaj çdo personi që paraqet rrezik për sigurinë personale apo publike, paraqet rrezik për pronën private apo publike, prish rendin dhe qetësinë publike, paraqet rrezik për sigurinë në komunikacion ose ekziston dyshimi i bazuar se është duke kryer apo duke u përgatitur për të kryer një vepër penale ose është duke e detyruar personin tjetër të kryejë vepër penale.
2. Zyrtari policor është i autorizuar t'u jap urdhra personave të tillë në mënyrë që t'i ndalojë veprimet e tyre ose të ndërmarrë veprime të tjera të cilat zyrtari policor i konsideron të arsyeshme.

3. Vërejtjet dhe urdhrat mund të jepen me qëllim të arritjes së objektivave legjitime të policisë duke përfshirë por jo duke u kufizuar vetëm në kushtet e parapara në nenin 11 të këtij ligji.

Neni 20
Ndalimi i përkohshëm policor

1. Zyrtari policor është i autorizuar ta ndalojë përkohësisht personin atëherë kur është e nevojshme:
   1.1. ta mbroj personin nga rreziku dhe dëmi, veçanërisht kur personi s'ka mundësi për t'u mbrojtur; apo
   1.2. ta identifikoj personin ose t'i kufizoj lëvizjet e tij, siç autorizohet me ligj, kur personi është jo bashkëpunues ndaj masave më të lehta.
2. Ndalimi i përkohshëm policor zgjatë aq sa është e nevojshme që të arrihen objektivat legjitime të policisë, por jo më gjatë se gjashtë (6) orë, përjashtimisht në rastet kur personi është ende në gjendje të pamundësisë për t'u mbrojtur, por jo edhe më gjatë se gjashtë (6) orë të tjera.
3. Ndalimi i përkohshëm policor në pajtim me nën-paragrafin 1.2. të paragrafit 1. të këtij neni mund të zgjasë deri njëzetekatër (24) orë, brenda këtij afati policia obligohet ta informojë prokurorin publik kompetent në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.
4. Personi nën ndalim të përkohshëm policor në pajtim me këtë nen nuk mbahet së bashku me të burgosurit, personat e arrestuar dhe të paraburgosurit e tjerë, me personat e gjinisë së kundërt dhe me persona të mitur përveç nëse vetë janë të mitur.
5. Personi nën ndalim të përkohshëm informohet lidhur me arsyet e mbajtjes, dhe i jepet mundësia ta lajmëroj ndonjë anëtar të familjes, mbrojtësin, institucionin përkatës ose personin tjetër të besueshëm.
6. Nëse personi në mbajtje është i paaftë për të vepruar, zyrtari policor përpiqet që ta njoftojë një anëtar të familjes ose ndonjë person tjetër të besueshëm, përveç nëse një gjë e tillë do të ishte në dëm të personit në mbajtje.

Neni 21
Sekuestrimi i përkohshëm i sendeve

1. Zyrtari policor është i autorizuar që përkohësisht ta sekuestroj një send me qëllim që ta parandalojë rrezikun e menjëhershëm ndaj personave apo pronës, për ta mbrojtur pronarin apo poseduesin e ligjshëm nga humbja ose dëmtimi i sendit, apo në përputhje me ligjin në fuqi, ta mbajë në vend të sigurt, përderisa personi të mbahet në paraburgim. Nëse dihet, pronari ose poseduesi i ligjshëm i sendit, do të informohet për arsyen e sekuestrimit të përkohshëm dhe do t'i jepet vërtetimi përkatës.
2. Sendin e sekuestruar policia e mban vetëm aq kohë sa është e nevojshme për t'i arritur objektivat ligjor të saj, por jo më gjatë se dhjetë (10) ditë, të cilin pastaj ia kthen pronarit ose poseduesit të ligjshëm sa më shpejtë që të jetë e mundshme.
3. Kufizimet e parapara në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, zbatohen përshtatshmërish për sekuestrim të përkohshëm në pajtim me këtë nen.

Neni 22
Kontrolli parandalues

1. Zyrtari policor është i autorizuar të kryej me iniciativë të tij/saj kontroll me qëllim të parandalimit të rrezikut të menjëhershëm ndaj sigurisë publike, jetës dhe pronës, kontroll parandalues të personave, objekteve, hapësirave dhe vendeve të caktuara, kur ekziston dyshimi i arsyeshëm që veprat e kryera mund të rrezikojnë jetën apo pronën në pajtim me kufizimet e parapara në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.
2. Kontrolli parandalues, në kuptimin e këtij neni, zbatohet me qëllim të largimit të armëve, apo sendeve tjera që paraqesin rrezik të pashmangshëm për jetën ose pasurinë, apo të parandaloj aktivitetet të cilat paraqesin rrezik të pashmangshëm për jetën dhe pasurinë. Kontrolli mund të përfshijë përdorimin e mjeteve teknike dhe të tjera për të zbuluar eksploziv, materie kimike, biologjike apo materiale radioaktive.
3. Pas ushtrimit të kontrollit, zyrtari policor harton procesverbal përkatës dhe brenda dyzetetetë (48) orëve, duke përjashtuar rrethanat e jashtëzakonshme të njëjtin ia dërgon prokurorit publik kompetent për vendin ku është kryer kontrolli. Një kopje e procesverbalit duhet t'i jepet pronarit ose poseduesit të objektit apo personit të kontrolluar. Personat e kontrolluar nga policia, kanë të drejtë të bëjnë ankesë në gjykatën kompetente, nëse e konsiderojnë kontrollimin e tyre nga policia si të padrejtë apo në kundërshtim me ligjin.

Neni 23
Ndalimi dhe kontrolli i mjetit motorik

1. Zyrtari policor gjatë ushtrimit të detyrave të tij të parapara me ligjet në fuqi është i autorizuar të jap urdhra, ndaloj dhe të kontrolloj mjetin motorik, në pajtueshmëri me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.
2. Bazuar në dyshimin e arsyeshëm, zyrtari policor është i autorizuar të kontrolloj mjetin motorik në rast se:
   2.1. mjeti motorik është përdorur për të kryer vepra penale apo mjeti është i ndërlidhur me veprën penale;
   2.2. të kërkimit të personave, armëve, municionit, materialit eksploziv, drogave ose përbërësve, materieve tjera të rrezikshme ose sendeve që ndërlidhen me veprën penale.

Neni 24
Sigurimi dhe këqyrja e vendit të ngjarjes së veprës penale apo aksidentit

1. Zyrtari policor është i autorizuar ta sigurojë dhe ta shikoj vendin e ngjarjes të veprës penale ose aksidentit, derisa të vij organi përgjegjës, që të gjejë dhe të siguroj dëshmi, të zbuloj kryesin e veprës penale dhe të mbledh informacione lidhur me veprën penale ose aksidentet.
2. Më qëllim të mbrojtjes së viktimave të veprës penale apo të aksidentit, zyrtari policor është i autorizuar ta pengojë incizimin video-akustik në perimetrin e sigurisë të vendit të ngjarjes të veprës penale apo aksidentet.

Neni 25
Vëzhgimi parandalues i vendit publik

1. Policia është e autorizuar të bëjë vëzhgim parandalues të vendit publik, duke përdorë pajisje për incizime video-akustike dhe pajisje fotografike për t'i vëzhguar vendet publike ku në të kaluarën shpesh janë kryer vepra penale, apo ku ka arsye të bazuar të besohet se vëzhgimi publik do ta zvogëlonte rrezikun nga kryerja e veprave penale dhe do ta përmirësonte sigurinë publike në të ardhmen, në pajtim me Kodin e Procedurës Penale.
2. Policia është e autorizuar t'i përdorë incizimet video-akustike dhe fotografitë për të vëzhguar dhe mbledhur informacione në një tubim publik atëherë kur ka arsye të bazuar se tubimi publik mund t'i rrezikoj personat apo pronën.
3. Para se të ndërmerret vëzhgimi parandalues, në përputhje me këtë nen, policia do ta informoj publikun për qëllimin dhe arsyen e ndërmarrjes së këtij aktiviteti, përveç nëse kjo mund ta pengoj qëllimin apo rezultatin e vëzhgimit.
4. Incizimet video dhe audio nga vëzhgimi parandalues do të mbahen jo me gjatë se tridhjetë (30) ditë nga dita e incizimit, përveç kur pas kontrollimit, verifikohet se incizimi përmban të dhëna për veprimtari kriminale. Mbajtja e këtyre të dhënave më gjatë se kjo periudhë bëhet vetëm në rastet e parapara me ligjin në fuqi.

Neni 26
Përdorimi i forcës

1. Zyrtari policor është i autorizuar ta përdorë forcën, vetëm atëherë kur është e domosdoshme dhe vetëm deri në atë nivel që kërkohet për t'i arritur objektivat legjitime të policisë.
2. Zyrtari policor mund ta përdorë forcën për ta mbrojtur jetën e personit, për ta parandaluar sulmin, kryerjen e veprës penale, arratisjen e kryesit të veprës apo atëherë kur masat e tjera nuk janë të suksesshme për arritjen e një objektivi tjetër legjitim të policisë.
3. Zyrtari policor vepron me maturinë e tij/saj për ta përcaktuar llojin e forcës më të përshtatshme dhe kufizimet në përdorimin e forcës. Zyrtari policor merr parasysh rrethanat specifike, natyrën e veprës penale, shkallën e rrezikut ndaj personave të tjerë që janë të pranishëm dhe gjendjen fizike, mentale dhe emocionale të personit ndaj të cilit përdoret forca.
4. Në rastet e përdorimit të forcës, zyrtari policor duhet të përpiqet ta minimizoj ndërhyrjen në të drejtat dhe liritë e personit dhe të minimizoj çfarëdo pasoje të dëmshme.
5. Përdorimi i forcës, si term që përdoret në këtë ligj, përfshin por nuk kufizohet vetëm në përdorimin e forcës fizike, shufrës zyrtare, sprejit, mjeteve pranguese, mjeteve për ndalimin e automjeteve, qenit të policisë, mjeteve kimike për paaftësim të përkohshëm, kalit të policisë, armëve të zjarrit, topave të ujit, automjeteve dhe llojeve të veçanta të armëve dhe mjeteve shpërthyese.

Neni 27
Përdorimi i armëve të zjarrit

1. Zyrtari policor është i autorizuar të posedoj dhe ta bartë armën zyrtare të zjarrit të lejuar nga policia. Zyrtari policor është i autorizuar ta përdorë armën e zjarrit vetëm atëherë kur është absolutisht e domosdoshme dhe vetëm deri në atë nivel që kërkohet për ta arritur objektivin ligjor të policisë, kur përdorimi i saj është në proporcion me shkallën e rrezikut dhe seriozitetin e veprës penale në atë situatë, dhe vetëm nëse konsiderohet se me përdorimin e mjeteve më të vogla të forcës nuk do të arrihen objektivat legjitime të policisë.
2. Zyrtari policor është i autorizuar ta përdorë armën e zjarrit kundër personit tjetër vetëm kur mjetet më pak ekstreme janë të pamjaftueshme që ta:
   2.1. mbroj jetën e vet ose jetën e të tjerëve nga sulmet e pashmangshme;
   2.2. parandaloj kryerjen e pashmangshme apo vazhdimësinë e veprës penale që shkakton rrezik të lartë për jetën;
   2.3. arrestoj personin i cili paraqet rrezik për jetën e të tjerëve dhe që u reziston urdhrave ligjor të dhënë nga zyrtari policor; dhe
   2.4. parandaloj arratisjen e personit i cili paraqet rrezik të pashmangshëm për jetën e personave të tjerë dhe që u reziston urdhrave ligjorë të dhënë nga zyrtari policor.
3. Para se ta përdorë armën e zjarrit, zyrtari policor jep vërejtje gojore, prezanton vetën si zyrtar policor, duke urdhëruar personin që të ndalet, por edhe duke e paralajmëruar se do të shtie nëse ai/ajo nuk ndalet.
4. Si masë e veçantë në rrethana urgjente, zyrtari policor mund të mos e bëjë paralajmërimin në rast se një veprim i tillë e rrezikon zyrtarin policor ose personat e tjerë nga një rrezik serioz i pashmangshëm.
5. Zyrtari policor është i autorizuar ta përdorë armën e zjarrit kundër kafshëve, kur ato paraqesin rrezik për shëndetin dhe sigurinë e cilitdo person, ose për shkak të rrezikut nga sulmi.

Neni 28
Përdorimi i pronës së personave të tretë në rrethana urgjente

1. Zyrtari policor është i autorizuar që përkohësisht ta marrë apo ta përdorë çfarëdo prone, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në mjetet e transportit, të komunikimit ose të mbrojtjes, që janë në posedim të cilitdo qytetar, mirëpo vetëm atëherë kur është e domosdoshme që të parandalohet rreziku i pashmangshëm për personat ose pronën apo për të arritur një objektiv tjetër policor urgjent, që kërkon veprim të menjëhershëm.
2. Prona që merret në përdorim duhet t'i kthehet personit nga i cili është marrë menjëherë pasi të mos jetë më e nevojshme që të arrihen objektivat urgjent policor për çka edhe është marrë, por në asnjë rast jo më gjatë se njëzetekatër (24) orë pas marrjes. Policia do ta kompensoj pronarin apo poseduesin për çdo shpenzim apo dëm që i është shkaktuar pronës gjatë përdorimit të saj.

Neni 29
Burimet e besueshme të informatave

1. Zyrtari policor do t'i pranoj dhe vlerësoj të gjitha informatat e marra nga individët anonimë që janë relevante për kryerjen e detyrave policore dhe arritjen e objektivave legjitime të policisë.
2. Zyrtari policor mund të krijoj marrëdhënie bashkëpunuese të besueshme me personat më qëllim që të marrë informata relevante që kanë të bëjnë me kryerjen e detyrave policore dhe arritjen e objektivave legjitime të policisë.
3. Zyrtari policor do ta mbroj besueshmërinë e marrëdhënieve të tilla bashkëpunuese dhe të informacioneve të marra përderisa obligimi ligjor për ta ruajtur besueshmërinë të jetë përmbushur.

Neni 30
Njoftimi publik për shpërblimin

1. Policia është e autorizuar të ofrojë shpërblime për dhënien e informatave relevante që shkojnë në dobi të kryerjes së detyrave policore dhe për arritjen e objektivave legjitime të policisë. Ofertat e tilla për shpërblime do të shpallen publikisht në gazeta, radio, televizione ose në media të tjera përkatëse apo në mënyra të tjera.
2. Shpërblimi i tillë jepet vetëm nëse informatat e marra ende nuk janë në duart e policisë dhe vetëm atëherë kur marrja e këtyre informatave shpie në arritjen e objektivave legjitime të policisë, për çka edhe është marrë informata.

Neni 31
Mbledhja, ruajtja, procedimi, analizimi, përdorimi dhe fshirja e të dhënave

1. Policia është e autorizuar t'i mbledh dhe t'i ruaj të dhënat personale, të dhënat mbi krimin dhe të dhënat e tjera. Të dhënat personale janë të dhënat që kanë të bëjnë me një person të identifikuar apo të identifikueshëm që përfshijnë, por nuk kufizohen në emër, datëlindje, vendin e lindjes dhe në vendbanimin. Të dhënat e krimit janë të dhëna që kanë të bëjnë me vepra të caktuara penale që përfshijnë, por nuk kufizohen në llojin e veprës penale, kohën dhe vendin e kryerjes së veprës, metodat dhe mënyrat e përdorura për kryerjen e veprës, çfarëdo lëndime të personave apo dëmin e pasurisë që është pasojë e veprës penale dhe motivin e saj.
2. Mbledhja, ruajtja, përdorimi dhe transferimi i të dhënave personale bëhet në pajtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Policia mbledh dhe ruan të dhënat personale dhe të dhënat e veprave penale vetëm për analiza dhe përdorim në mbrojtjen e rendit dhe të sigurisë publike, zbulimin dhe parandalimin e veprave penale, në identifikimin, vendndodhjen dhe në kapjen e kryesve të veprave penale dhe për arritjen e objektivave të tjera legjitime të policisë.
4. Policia ruan të dhënat personale vetëm deri në atë masë kur ekziston arsyetimi i bazuar se ruajtja e informatave do të ndihmoj në arritjen e objektivave legjitime të policisë. Kufizimet e arsyeshme në llojin e informatave të ruajtura, në kohëzgjatjen e ruajtjes së të dhënave personale në regjistrat e policisë dhe çështjet e tjera që

kanë të bëjnë me mbledhjen, ruajtjen dhe përdorimin e të dhënave do të rregullohen me akte nënligjore të nxjerra në bazë të ligjit në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

5. Policia nuk duhet të mbledh dhe të ruaj informata dhe të dhëna personale për personat me qëllim të mirëmbajtjes së regjistrave që kanë të bëjnë me bindjet apo anëtarësimet politike, religjioze apo filozofike.
6. Zyrtari policor ka për detyrë ta ruaj besueshmërinë e të gjitha të dhënave personale dhe të dhënave të krimit të cilat ai apo ajo i ka marrë gjatë kryerjes së detyrave policore, përveç në ato raste kur lirimi i të dhënave autorizohet me ligj dhe është e nevojshme për të arritur objektivin legjitim të policisë.
7. Policia siguron mbikëqyrje kompetente për sistemin e informatave ku regjistrat policor mbahen më qëllim të mbrojtjes së të dhënave personale në pajtim me ligjin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
8. Të dhënat numerike që kanë të bëjnë me veprat penale, kryesit e veprave, viktimat apo me kategori të tjera që lidhen me veprën penale apo me sigurinë, mund të përdoren për qëllime statistikore apo analitike nga policia apo ministria. Të dhënat e tilla do të jenë të mundshme për përdorim edhe nga autoritetet hulumtuese profesionale apo akademike.
9. Të dhënat personale mund t'u jepen edhe organizatave të huaja dhe atyre ndërkombëtare policore në bazë të ligjit në fuqi.
10. Policia siguron me kërkesën e ndonjë personi, çfarëdo të dhëne personale të ruajtur nga policia lidhur me personin që bën kërkesën, përveç nëse në ato raste dhënia e të dhënave mund t'i dëmtoj hetimet ose kur interesi i besueshmërisë nga personi tjetër ose publiku është më i rëndësishëm se interesi i zbulimit të personit që ka bërë kërkesën. Pas zbulimit se të dhënat personale të ruajtura në regjistër janë jo të sakta, policia do t'i korrigjoj apo largoj ato të dhëna personale.

KREU III
ORGANIZIMI I POLICISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 32
Organizimi i Policisë së Republikës së Kosovës

1. Policia organizohet në nivel qendror dhe lokal. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, është niveli qendror përgjegjës për tërë Republikën e Kosovës. Niveli lokal përfshin Drejtoritë Rajonale të Policisë, përgjegjëse për rajonet e përbëra me komunat e caktuara, stacionet policore që janë përgjegjëse për policinë lokale në secilën komunë dhe nënstacionet policore, përgjegjëse për policinë lokale brenda zonave të caktuara të një komune.
2. Juridiksioni territorial i secilës drejtori rajonale përcaktohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Juridiksioni territorial i secilit stacion policor do të jetë brenda kufijve të komunës, ku është vendosur. Juridiksioni territorial i secilit nënstacion policor përcaktohet nga Drejtori i Përgjithshëm.
3. Struktura e brendshme organizative e Policisë së Republikës së Kosovës propozohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe aprovohet nga ministri. Drejtori i Përgjithshëm, me miratimin e ministrit, mund të themeloj njësitë policore të përkohshme për të kryer detyra të veçanta.

4. Më qëllim të menaxhimit dhe kontrollit të kufijve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, përveç stacioneve policore që gjenden në secilën komunë, themelon edhe stacionet policore kufitare nën autoritetin dhe juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Policisë Kufitare.

Neni 33
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe përbëhet nga departamente, sipas fushave përkatëse.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë ka këto detyra dhe përgjegjësi të:
   2.1. përkrahë Drejtorin e Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij/saj;
   2.2. mbikëqyrë efektivitetin e Drejtorive Rajonale të Policisë;
   2.3. menaxhoj, vëzhgoj, analizoj dhe vlerësoj situatën e tërësishme të sigurisë;
   2.4. udhëheqë veprimet policore në rrethana të jashtëzakonshme ose urgjente;
   2.5. koordinoj zhvillimin dhe implementimin e strategjive për parandalimin dhe zvogëlimin e krimit, rivendosjen dhe mbajtjen e rendit dhe të sigurisë publike dhe për sigurimin dhe kontrollin e kufijve;
   2.6. koordinoj funksionet administrative të policisë, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në mirëmbajtjen e të dhënave të policisë dhe sistemin e telekomunikimit, rekrutimit, trajnimit dhe të edukimit të personelit policor, menaxhimin e buxhetit dhe të çështjeve financiare, prokurimin dhe në menaxhimin e rasteve dhe objekteve policore;
   2.7. bashkëpunoj me organizata ndërkombëtare dhe ta koordinoj implementimin e marrëveshjeve ndërkombëtare lidhur me aktivitetet policore; dhe të
   2.8. kryej punë të tjera të parapara me ligj, rregulla ligjore, me instruksione apo urdhra.
3. Selia e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Republikës së Kosovës do të jetë e vendosur në Prishtinë.

Neni 34
Drejtoritë Rajonale të Policisë

1. Në mënyrë që veprimet policore të menaxhohen me efektivitet, Policia e Republikës së Kosovës ndahet në rajone të cilat, kurdo që të jetë e mundshme, do të jenë të njëjta me kufijtë rajonal të gjyqësisë.
2. Në përcaktimin e juridiksionit territorial të drejtorive rajonale, konsideratë do t'ju jepet faktorëve ashtu siç janë, mirëpo jo të kufizuar në madhësinë e rajonit, numrin e banorëve, nivelin e krimit, pozitën gjeografike, ndërtesat e rëndësishme, rrugët dhe në infrastrukturën tjetër.
3. Funksionet e Drejtorisë Rajonale përfshijnë por nuk do të kufizohen vetëm si në vijim të:
   3.1. kryej detyra dhe funksione të përcaktuara me ligj, udhëzime ose urdhra të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë;
   3.2. përkrahë dhe mbikëqyrë efektshmërinë policore përbrenda rajonit ku shërben; dhe

3.3. koordinoj detyra të ndryshme që mund të caktohen nga Drejtoria e Përgjithshme, siç janë edukimi profesional dhe trajnimi për zyrtarët policorë dhe stafin ose punët administrative lidhur me financat, objektet dhe pajisjet.

Neni 35
Stacionet Policore Lokale

1. Stacionet Policore themelohen në secilën komunë, ndërsa juridiksioni territorial i stacionit policor është i njëjtë me kufijtë e komunës të përcaktuar me ligj.
2. Stacionet Policore kryejnë detyra policore në kuadër të juridiksionit të tyre brenda territorit komunal. Secilin stacion policor e udhëheq komandanti i stacionit.
3. Drejtori Rajonal mund t'ia propozojë për miratim Drejtorit të Përgjithshëm, themelimin e nënstacioneve policore, njësive të tjera organizative në kuadër të stacioneve policore.
4. Përbërja etnike e policisë në kuadër të komunës, deri në nivelin e mundshëm, do ta përfaqësojë përbërjen etnike të popullatës të asaj komune.
5. Para ndërmarrjes së çdo veprimi nga forcat policore qendrore apo speciale në kuadër të juridiksionit territorial të stacionit policor, komandanti i stacionit do të informohet nga drejtori i përgjithshëm, drejtori rajonal i policisë, apo nga zyrtarët e tjerë policorë që kryejnë veprime të veçanta, përveç nëse rrethanat operacionale kërkojnë ndryshe.

Neni 36
Themelimi i Policisë Rezervë

1. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, me aprovimin e ministrit, themelon policinë rezervë në mënyrë që ta ndihmojë policinë në veprimet e veçanta të sigurisë. Policia rezervë përbëhet nga vullnetarët të cilët e nënshkruajnë kontratën me policinë që të jenë anëtarë rezervë, dhe janë të kualifikuar dhe të trajnuar të kryejnë detyra policore.
2. Anëtarët e policisë rezervë mund të angazhohen nga Drejtori i Përgjithshëm me aprovimin e ministrit. Menaxhimi operacional i Policisë rezervë është e drejtë vetëm e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë. Zyrtarët e policisë rezervë mund të angazhohen në kombinim me zyrtarët e rregullt policorë në rrethana të jashtëzakonshme ose urgjente, siç janë: rastet emergjente publike të rëndësishme, reagimi emergjent ndaj sulmeve terroriste, çrregullimet ose trazirat e mëdha të qytetarëve, reagimet emergjente ndaj rrezikut të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

KREU IV
MENAXHMENTI I LARTË I POLICISË

Neni 37
Komisioni për përzgjedhjen e Drejtorit te Përgjithshëm dhe Zëvendësdrejtorëve të Përgjithshëm të Policisë

1. Kandidatët për pozitat e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendësdrejtorëve të Përgjithshëm të Policisë, përzgjidhen dhe propozohen nga komisioni, i cili themelohet nga ministri.
2. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe Zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm të Policisë, emërohen për një periudhë kohore prej pesë (5) vjetësh, me mundësi vazhdimi pas çdo pesë (5) vjet, nga autoriteti që i ka emëruar.
3. Nëse Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendësdrejtorëve të Përgjithshëm të Policisë iu përfundon mandati në vitin kalendarik të zgjedhjeve të përgjithshme, atëherë qëndrimi i tyre në detyrë do të zgjatet në mënyrë automatike për një (1) vit pas certifikimit të zgjedhjeve.
4. Komisioni i propozon ministrit kandidatët për emërim në pozitën Drejtor i Përgjithshëm i Policisë, ministri në njërën nga mbledhjet e Qeverisë i propozon kandidatin Qeverisë për këtë pozitë, ndërkaq Qeveria i rekomandon kryeministrit kandidatin për Drejtor të Përgjithshëm të Policisë. Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë e emëron Kryeministri.
5. Komisioni i propozon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, kandidatët për emërim në pozitat e Zëvendësdrejtorëve të Përgjithshëm të Policisë, ndërsa Drejtori i Përgjithshëm i Policisë i rekomandon ministrit kandidatët për Zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm të Policisë. Zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm të Policisë i emëron ministri.
6. Drejtorët e Departamenteve duhet të zgjidhen nga Drejtori i Përgjithshëm në bazë të procedurave të brendshme të Policisë së Republikës së Kosovës.
7. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë është përgjegjës që të udhëheqë, kontrolloj, dhe mbikëqyrë policinë, të menaxhoj dhe shpërndaj buxhetin e policisë në përputhje me objektivat dhe qëllimet strategjike të përcaktuara nga ministri.
8. Themelimi, përbërja dhe procedura e komisionit rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga ministri.

Neni 38
Kriteret për përzgjedhjen dhe emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendësdrejtorëve të Përgjithshëm

1. Kriteret për përzgjedhje dhe emërim të Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendësdrejtorëve të Përgjithshëm janë:
   1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
   1.2. të jetë i diplomuar në një nga universitetet e akredituara ose të ketë diplomë të nostrifikuar.
   1.3. të ketë gradën policore kolonel, nënkolonel ose major, se paku pesë (5) vite;
   1.4. të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale, me vendim të formës së prerë;

1.5. të mos jetë ndëshkuar për shkelje të rënda disiplinore sipas rregullores disiplinore të policisë apo rregullores së institucioneve të tjera shtetërore brenda dhjetë (10) viteve të fundit që është ekuivalente me shkeljet që përcaktohen në rregulloren e disiplinës së Policisë së Kosovës;
1.6. të mos ketë konflikt interesi me detyrën apo siç parashihet në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

2. Secili kandidat për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendësdrejtorëve të Përgjithshëm, duhet t'i nënshtrohet verifikimit të sigurisë sipas ligjit të aplikueshëm.

Neni 39
Lirimi apo shkarkimi nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendësdrejtorëve të Përgjithshëm

1. Drejtori i Përgjithshëm apo Zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm, lirohen apo shkarkohen nga detyra nga autoriteti i cili i ka emëruar, për njërën nga arsyet e mëposhtme:
   1.1. është dënuar për vepër penale,
   1.2. arrin moshën për pension;
   1.3. jep dorëheqje;
   1.4. për shkak të pamundësisë së ushtrimit të detyrës për një periudhë kohore jo më të gjatë se gjashtë (6) muaj;
   1.5. me mbarimin e mandatit;
   1.6. për shkak të performancës jo të mirë të dokumentuar.
2. Kur ekziston dyshim i arsyeshëm për të besuar se Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, ka kryer vepër penale apo për ndonjërën nga arsyet e parapara në paragrafin 1. të këtij neni, ministri mund të suspendojë menjëherë Drejtorin e Përgjithshëm dhe ia paraqet kryeministrit të gjitha faktet për dhënien e suspendimit. Kryeministri vendos lidhur me vazhdimin apo ndërprerjen e suspendimit.
3. Në rastet e lirimit, shkarkimit apo suspendimit të Drejtorit të Përgjithshëm, kryeministri menjëherë emëron njërin nga Zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm si ushtrues detyre të Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 40
Drejtori Rajonal i Policisë

Drejtorët Rajonalë të Policisë caktohen nga Drejtori i Përgjithshëm bazuar në standardin e gradave, pozitave dhe përshkrimit të vendeve të punës në polici.

Neni 41
Komandantët e Stacioneve Policore

Komandantët e Stacioneve të Policisë caktohen nga Drejtori i Përgjithshëm bazuar në procedurat e brendshme të Policisë.

Neni 42
Përzgjedhja e veçantë e Komandantëve të Stacionit

1. Në komunat ku komuniteti serb është komuniteti më i madh etnik, komandantët e stacioneve policore dhe komandantët e nënstacioneve i emëron Ministria e Punëve të Brendshme me propozimin e Kuvendit Komunal dhe Drejtorit të Përgjithshëm, në pajtim me dispozitat e këtij neni.
2. Kur pozita e komandantit të stacionit ose komandantit të nënstacionit lirohet, Drejtori i Përgjithshëm do t'ia dërgojë një kërkesë me shkrim Kuvendit Komunal të komunës në të cilën gjendet stacioni ose nënstacioni policor në fjalë. Bashkë me kërkesën, Drejtori i Përgjithshëm do të dërgojë edhe një listë me të gjithë kandidatët e përshtatshëm për pozitën. Drejtori i Përgjithshëm do të kërkojë nga Kuvendi Komunal të rekomandoj së paku dy (2) kandidatë të cilët i plotësojnë kriteret minimale për pozitë nga lista. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të kërkesës, Kuvendi Komunal do t'ia rekomandoj
3. Drejtorit të Përgjithshëm së paku dy (2) kandidatë të cilët i plotësojnë kriteret minimale nga kjo listë dhe mund t'i renditë ata sipas preferencës. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të rekomandimeve, Drejtori i Përgjithshëm do t'ia përcjellë Ministrisë së Punëve të Brendshme emrat e të gjithë kandidatëve të rekomanduar nga Kuvendi Komunal. Drejtori i Përgjithshëm mund ta shpreh preferencën e tij për emrat e rekomanduar nga Kuvendi Komunal. Ministria e Punëve të Brendshme do ta emëroj një kandidat nga emrat e rekomanduar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të listës, përveç nëse aplikohet paragrafi 3. i këtij neni.
4. Nëse asnjëri nga kandidatët e rekomanduar nuk është i pranueshëm për Ministrinë e Punëve të Brendshme, ajo do ta njoftojë Drejtorin e Përgjithshëm pa vonesë. Brenda shtatë (7) ditëve pas njoftimit për këtë refuzim Drejtori i Përgjithshëm do ta njoftoj Kuvendin Komunal me shkrim dhe do të kërkoj nga ata së paku dy rekomandime shtesë për pozitën. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të kësaj kërkese, Kuvendi Komunal do t'ia rekomandoj Drejtorit të Përgjithshëm së paku dy (2) emra të rinj të cilët i plotësojnë kriteret minimale nga lista e të gjithë kandidatëve të përshtatshëm të siguruar nga
5. Drejtori i Përgjithshëm. Kuvendi Komunal mund t'i radhitë kandidatët e rekomanduar sipas preferencës. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të rekomandimeve, Drejtori i Përgjithshëm do t'ia përcjellë Ministrisë së Punëve të Brendshme emrat e të gjithë kandidatëve të rekomanduar nga Kuvendi Komunal. Drejtori i Përgjithshëm mund ta shpreh preferencën e tij për emrat e rekomanduar nga Kuvendi Komunal. Ministria e Punëve të Brendshme duhet ta emëroj një kandidat nga emrat e rekomanduar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të listës.
6. Nëse brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të kërkesës me shkrim të Drejtorit të Përgjithshëm, Kuvendi Komunal nuk i jep rekomandimet e kërkuara sipas këtij neni, Drejtori i Përgjithshëm është i autorizuar ta përcjell tek ministria listën me të gjithë kandidatët e përshtatshëm për pozitën e Komandantit të stacionit ose Komandantit të nënstacionit pa rekomandimin e Kuvendit Komunal. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e dërgimit të listës te ministria, Drejtori i

Përgjithshëm do ta njoftoj Kuvendin Komunal se e tërë lista është përcjellë te ministria për emërim të kandidatit. Ministria do të emëroj ndonjërin kandidat nga kjo listë. Gjatë procesit të emërimit, ministria duhet t'i ketë parasysh nevojat dhe brengat e komunitetit lokal lidhur me shërbimet policore.

7. Përjashtimisht procedurës së emërimit të komandantëve të stacionit ose nënstacioneve të parapara në këtë nen, për të gjitha çështjet tjera duhet të aplikohen dispozitat e parapara me këtë ligj dhe akte tjera nënligjore.

Neni 43
Procedurat disiplinore për personelin policor

1. Të gjitha shkeljet disiplinore, ku përfshihet punonjësi i Policisë së Kosovës, përveç rasteve të parapara në Ligjin për Inspektoratin Policor hetohen dhe vendoset nga Policia e Kosovës.
2. Shkeljet, masat dhe procedura disiplinore rregullohen me akt nënligjor.

KREU V
MARRËDHËNIA E PUNËS

Neni 44
Punësimi i personelit policor

1. Policia e Republikës së Kosovës punëson tri kategori të personelit policor:
   1.1. zyrtarë policorë që bëjnë betimin dhe kanë autoritet t'i ushtrojnë dhe t'i kryejnë autorizimet dhe detyrat policore;
   1.2. staf civil që punësohet për të kryer shërbime mbështetëse dhe administrative, por që nuk ka autoritet të ushtroj autorizime policore;
   1.3. kadet policor.
2. Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor.

Neni 45
Gradat dhe funksionet e zyrtarëve policorë

1. Sistemi i gradimit për zyrtarët policorë, është në përputhje me gradat vijuese:
   1.1. polic i ri;
   1.2. polic;
   1.3. polic i lartë;
   1.4. rreshter;
   1.5. toger;
   1.6. kapiten;
   1.7. major;
   1.8. nënkolonel;
   1.9. kolonel.
2. Zyrtarët policor të emëruar në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm ose të Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm pas përfundimit të mandatit rimarrin gradën e mëparshme të cilën e kanë pasur para emërimit në këto pozita.

Neni 46
Të drejtat dhe kufizimet e personelit policor

1. Personeli policor, gëzon të drejta të njëjta civile dhe politike sikurse qytetarët e tjerë, duke iu nënshtruar vetëm kufizimeve në këtë ligj që janë të nevojshme për ushtrimin efektiv të autorizimeve dhe detyrave policore në shoqërinë demokratike.
2. Personeli policor gëzon të drejta të njëjta sociale dhe ekonomike sikurse shërbyesit e tjerë publikë, siç janë e drejta për të organizuar apo për të marrë pjesë në organizata përfaqësuese dhe t'i pranojnë shpërblimet e duhura, sigurimin social, ndihmën juridike, benificione shëndetësore dhe benificione të tjera për punën e tyre.
3. Personeli policor nuk ka të drejtë të bëj grevë, por ka të drejtë t'i shprehë pakënaqësitë e tij nëpërmjet protestave të organizuara dhe të udhëhequra nga organet përfaqësuese.

Neni 47
Paga dhe kompensimi për personelin policor

1. Kompensimi për zyrtarët policor ka parasysh kushtet e veçanta nën të cilat ata i kryejnë detyrat e tyre. Paga themelore e zyrtarëve policor ndryshon duke u bazuar në faktorët përfshirës, por jo të kufizohet vetëm me gradën dhe kohëzgjatjen e shërbimit.
2. Si shtesë e pagës themelore, zyrtarët policor në mënyrë të ligjshme marrin lloje të shtesave, kompensime dhe benificione. Pagesat e tilla shtesë bazohen në faktorët duke përfshirë, por jo të kufizohen vetëm në detyrat e rrezikshme, punën nën stres, punën jashtë orarit, orarin e punës me ndërrime, punën gjatë festave ose ditëve të tjera që janë ditë pushimi, caktimin në punë të veçanta dhe për shkathtësi të veçanta.
3. Shtesat përfshijnë, por nuk kufizohen në kompensime për punë të rrezikshme, punën nën stres, kompensime për orar të punës me ndërrime, pagesa gjatë festave, pagesa për punë jashtë orarit, dhe pagesa për caktim në punë të veçantë. Benificionet mund të përfshijnë, por jo të kufizohen në, shpenzimet mjekësore dhe shëndetësore, shpenzimet për trajnimet profesionale dhe teknike, shpenzimet jetësore për transferim të përkohshëm, pushim me pagesë, kompensimet në rastet e vdekjes, dhe benificionet e pensionit.
4. Pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore. Drejtori i Përgjithshëm, me miratim të ministrit mund të përfshijë në buxhetin vjetor të policisë propozimin për shumat që nevojiten të përdoren për pagimin e çfarëdo pagese shtesë të autorizuar me ligj.
5. Përveç pensionit invalidor që e gëzojnë në bazë të ligjit në fuqi, zyrtarët policor të cilët bëhen invalid në kryerje të detyrës apo në detyrë kanë të drejtë në pension invalidor 20% të pagës bruto.

Neni 48
Kompensimi për vdekje në detyrë apo në kryerje të detyrës

1. Policia paguan shpenzimet e ceremonisë së varrimit për zyrtarin policor që vdes në detyrë apo në kryerje të detyrës. Vendvarrimi do të caktohet nga anëtarët e familjes së zyrtarit policor. Policia do t'i paguajë shpenzimet në vijim:
   1.1. transportin për bartjen e kufomës;
   1.2. shpenzimet e udhëtimit për dy (2) persona shoqërues;
   1.3. shpenzimet e funeralit që nuk janë paguar në forma të tjera;
   1.4. shpenzimet e tjera me aprovimin e ministrit.
2. Policia do të paguaj bashkëshortin apo fëmijët nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare të zyrtarit policor i cili vdes në detyrë apo në kryerje të detyrës me një ndihmë financiare të menjëhershme në një shumë që është e barabartë me pagën mujore bruto të shumëzuar me gjashtë. Një pagesë e tillë do të bëhet vetëm pasi të përcaktohet se bashkëshorti apo fëmijët kanë qenë të përkrahur nga zyrtari policor para vdekjes së tij ose saj. Në raste të caktuara sipas vlerësimit, Qeveria mund të ndaj shumë më të lartë financiare të menjëhershme për zyrtarin policor i cili ka vdekur në kryerje të detyrës.
3. Bashkëshorti i/e cili/a përcaktohet që ka qenë e përkrahur nga zyrtari policor dhe fëmijët nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare të zyrtarit policor i cili vdes në kryerje të detyrës kanë të drejtë në pension familjar, por vetëm deri në vlerën 80% të pagës bruto.
4. Bashkëshorti i/e cili/a përcaktohet që kanë qenë e përkrahur nga zyrtari policor dhe fëmijët nën moshën tetëmbëdhjete (18) vjeçare të zyrtarit policor i cili vdes në detyrë kanë të drejtë në pension familjar, por vetëm deri në vlerën 60% të pagës bruto.
5. Me propozimin e Ministrisë përkatëse për Punë të Brendshme, Qeveria nxjerr akt nënligjor për përcaktimin e rasteve të zyrtarëve policor të cilët vdesin në detyrë apo në kryerje të detyrës.

Neni 49
Konflikti i interesave

1. Personeli policor nuk do të pranojë një pozitë apo obligim, dhe nuk do të jetë pjesëmarrës në çfarëdo funksioni apo aktiviteti, i cili krijon konflikt të interesave me detyrat zyrtare të policisë. Pozitat dhe aktivitetet që formojnë konflikt të interesave përfshijnë por nuk kufizohen me:
   1.1. emërimi apo zgjedhja në detyrë publike apo pozitë tjetër qeveritare;
   1.2. pjesëmarrja në fushata elektorale për zgjedhje në detyrë publike;
   1.3. punësimi, apo pjesëmarrja në çfarëdo aktivitet biznesi për kompensim, përveç me leje të dhënë nga Drejtori i Përgjithshëm;
   1.4. pjesëmarrja aktive në cilëndo parti politike, ndjekja e udhëzimeve nga cilado parti politike në kryerjen e detyrave policore; paraqitja me uniformë policore në çfarëdo tubimi politik, përveç kur është në detyrë zyrtare policore (anëtarësimi i thjeshtë në një parti politike nuk është konflikt i interesave), dhe

1.5. dhënia e deklaratave publike apo komenteve lidhur me punën e policisë, përveç në raste kur lejohet nga eprori me autorizim të duhur.

Neni 50
Caktimi i zyrtarit policor në detyrë jashtë shtetit

1. Zyrtari policor mund të caktohet jashtë shtetit në detyrë si pjesë e punës së tij ose saj të rregullt në mënyrë që të mbështes bashkëpunimin me autoritetet ndërkombëtare kompetente ose organizatat ndërkombëtare.
2. Caktimi në detyrë jashtë shtetit mund të bëhet vetëm me pëlqimin e zyrtarit policor.
3. Caktimi jashtë shtetit zbatohet siç parashihet në marrëveshjen ndërkombëtare, nënshkruese e së cilës është Republika e Kosovës.

KREU VI
FINANCIMI

Neni 51
Buxheti i policisë dhe menaxhimi financiar

1. Policia do të ketë buxhetin e saj, i cili është buxhet i ndarë në kuadër të ministrisë, të miratuar në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.
2. Drejtori i Përgjithshëm përgatit buxhetin e policisë, të cilin pastaj ia përcjell ministrit për shqyrtim dhe procedim të mëtutjeshëm në përputhshmëri me procedurat e parapara me ligj.
3. Policia është përgjegjëse për implementimin dhe menaxhimin e buxhetit.

Neni 52
Fondet e veçanta të policisë

1. Buxheti i policisë duhet ta ketë një shumë të caktuar për fonde të veçanta për tu përdorur për pagesën e shpërblimeve, pagesën e informatorëve, pagesën për mbrojtjen e dëshmitarëve, dhe pagesën e operacioneve tjera të veçanta policore.
2. Fondet e përshkruara në paragrafin 1. të këtij neni do të administrohen nga Drejtori i Përgjithshëm në pajtim me aktet nënligjore të nxjerra nga ministri për udhëheqjen, menaxhimin dhe shpenzimin e fondeve të tilla.

Neni 53
Përgjegjësia për dëmin ose lëndimin

1. Zyrtari policor raporton tek mbikëqyrësi i tij apo saj çdo dëm apo lëndim që ai apo ajo ka shkaktuar gjatë kryerjes së detyrave policore të tij/saj.
2. Në përputhje me ligjin në fuqi, Qeveria e Republikës së Kosovës do të jetë përgjegjëse për dëmet apo lëndimet e shkaktuara personave fizik ose juridik si rezultat i veprimeve të zyrtarëve policorë në kryerjen apo në ndërlidhje me kryerjen e detyrave policore.

Neni 54
Medaljet, lëvdatat, shpërblimet dhe mirënjohjet

1. Kryeministri, Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm janë të autorizuar t'u japin medalje, lëvdata, shpërblime dhe mirënjohje, zyrtarëve policorë, punëtorëve të tjerë të policisë, personave fizik dhe juridik të vendit dhe të huaj që e kanë dalluar vetën me meritat e tyre.
2. Kryeministri jep medaljen në vijim:
   2.1. medaljen e nderit.
3. Ministri jep medaljet në vijim:
   3.1. medaljen për merita;
   3.2. medaljen për trimëri; dhe
   3.3. medaljen e shpëtimit të jetës.
4. Drejtori i Përgjithshëm jep medaljet në vijim:
   4.1. medaljen për mburojë të policisë;
   4.2. medaljen për shërbim të dalluar;
   4.3. medaljen policore për lëvdim; dhe,
   4.4. medaljen për shërbim të besnikërisë.

KREU VII
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 55
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore, për:
   1.1. mënyrën e kryerjes së detyrave dhe autorizimeve policore, siç përshkruhet në nenet 10 dhe 11 të këtij ligji;
   1.2. përdorimin e forcës nga zyrtarët policorë, siç përshkruhet në nenin 26 të këtij ligji;
   1.3. përdorimin e armëve të zjarrit nga zyrtarët policorë, siç përshkruhet në nenin 27 të këtij ligji;
   1.4. standardet dhe metodat për mbledhjen, ruajtjen, përdorimin dhe fshirjen e të dhënave personale të mbajtura nga policia, siç përshkruhet në nenin 31 të këtij ligji;
   1.5. kualifikimet e nevojshme dhe angazhimi i policisë rezervë siç përshkruhet në nenin 36 të këtij ligji;
   1.6. shkeljet, masat dhe procedurën disiplinore, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 43 të këtij ligji;
   1.7. marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji;
   1.8. procedurën e gradimit për personelin policor;
   1.9. llojet e lëvdatave, shpërblimeve dhe mirënjohjeve, siç përshkruhet në paragrafin 3. të nenit 54 të këtij ligji; dhe
   1.10. drejtori i përgjithshëm do të nxjerr akte nënligjore më qëllim përkrahjes së bashkëpunimit në mes të kuvendit komunal dhe komunitetit në pajtim me

këtë nen, dhe do të përkrahë funksionalitetin e plotë të Komiteteve për Siguri dhe Bordeve.

2. Ministri nxjerr aktet nënligjore, për:
   2.1. themelimin, përbërjen dhe procedurën e komisionit, sipas paragrafit 8. të nenit 37 të këtij ligji;
   2.2. menaxhimin dhe shpenzimin e fondeve të veçanta policore; dhe
   2.3. kriteret dhe procedurat e dhënies së medaljeve shpërblyese, sipas paragrafit 2. të nenit 54 të këtij ligji.
3. Qeveria me propozimin e Ministrisë përkatëse për Punë të Brendshme nxjerr akt nënligjor për mënyrën e ofrimit të ndihmës organeve qeveritare, siç përshkruhet në nenet 7, 8 dhe 9 të këtij ligji.

Neni 56
Dispozitat e aplikueshme

Të gjitha çështjet të cilat nuk janë të rregulluara me këtë ligj dhe aktet nënligjore që janë në fuqi, vazhdojnë të mbeten në fuqi deri në nxjerrjen e akteve nënligjore që burojnë nga ky ligj.

Neni 57
Afati për nxjerrjen e akteve nënligjore

Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, nxirren gjashtë (6) muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 58
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji nr.03/L-035 për Policinë dhe të gjitha aktet nënligjore që burojnë prej tij, përveç nëse është thënë ndryshe me këtë ligj.

Neni 59
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-076
2 mars 2012

Ligji shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 04 / 19 MARS 2012, PRISHTINË

LIGJI Nr. 03/L-172
PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Përmbajtja

Kreu I: Dispozita të përgjithshme 374
Kreu II: Legjitimiteti i përpunimit të të dhënave 377
Kreu III: Të drejtat e subjektit të të dhënave 385
Kreu IV: Mbrojtja institucionale e të dhënave personale 388
Kreu V: Transferimi i të dhënave personale 394
Kreu VI: Të drejtat dhe mbikëqyrja 397
Kreu VII: Dispozitat ndëshkuese 404
Kreu VIII: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 409

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i Ligjit

Ky Ligj përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe themelon institucionin që është përgjegjës për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:
   1.1. **Të dhëna personale** - çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (subjekt i të dhënave); person i identifikueshëm është personi i cili mund të identifikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në veçanti në bazë të një numri të identifikimit ose të një e më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij ose saj fizik, psikologjik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror;
   1.2. **Përpunim i të dhënave personale** - çdo veprim ose një sërë veprimesh të

cilat kryhen në të dhënat personale, qoftë me ose pa ndihmën e mjeteve automatike, siç janë: grumbullimi, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatshmëria ose ndryshimi, korrigjimi, konsultimi, përdorimi, zbulimi përmes transferimit, shpërndarjes ose mënyrave tjera të vënies në dispozicion, bashkimi ose kombinimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi;

1.3. **Përpunim automatik i të dhënave** - përpunimin e të dhënave personale duke përdorur mjetet e teknologjisë informative;

1.4. **Kontrollues i të dhënave -** çdo person fizik ose juridik nga sektori publik ose privat që individualisht ose së bashku me të tjerët përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave, ose një person i caktuar me ligj që po ashtu përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit;

1.5. **Përpunues i të dhënave** - çdo person fizik ose juridik nga sektori publik ose privat i cili përpunon të dhënat personale për dhe në llogari të kontrolluesit të të dhënave;

1.6. **Marrës i të dhënave -** çdo person fizik, juridik ose çdo person tjetër nga sektori publik ose privat të cilit i zbulohen të dhënat personale;

1.7. **Sistem i dosjeve -** çdo strukturë të caktuar të të dhënave personale të cilat janë të qasshme në varësi të kritereve specifike, pavarësisht nëse struktura është e centralizuar, e decentralizuar ose e shpërndarë në baza funksionale ose gjeografike;

1.8. **Katalog i sistemit të dosjeve -** përshkrimin në detaje të strukturës dhe përmbajtjes së sistemeve të dosjeve;

1.9. **Regjistër i sistemeve të dosjeve -** regjistrin i cili mundëson një pasqyrim të detajuar të sistemeve të dosjeve;

1.10. **Pëlqim i subjektit të të dhënave –** çdo shprehje të lirë të vullnetit, të dhënë në mënyrë të qartë nga subjekti i të dhënave me të cilin ai ose ajo jep pajtimin për përpunimin e të dhënave personale;

1.11. **Pëlqim me shkrim i subjektit të të dhënave –** pëlqimin e dhënë sipas nën-paragrafit 1.10 te paragrafit 1 të këtij neni, ku përveç kësaj subjekti i të dhënave duhet të vë nënshkrimin ose shenjën në pëlqimin me shkrim për përpunimin e të dhënave të tij ose saj.

1.12. **Pëlqim gojor ose pëlqim tjetër i përshtatshëm i subjektit të të dhënave -** pëlqimin nga nën-paragrafi 1.10 e dhënë gojarisht, me anë të mjeteve të telekomunikimit ose me ndonjë mjet tjetër të përshtatshëm, përmes të cilit mund të konkludohet në mënyrë të qartë se subjekti i të dhënave e ka dhënë pëlqimin e tij ose saj;

1.13. **Bllokim -** ndalimin e përpunimit të mëtutjeshëm të të dhënave. Vendimi për bllokimin e të dhënave duhet të tregohet në mënyrë të saktë dhe duhet të mbetet i bashkëngjitur me të dhënat personale për aq kohë sa ekzistojnë arsyet për bllokim;

1.14. **Klasifikim i të dhënave personale –** shënjimin e të dhënave personale për të treguar natyrën e tyre të ndjeshme. Për të dhënat e klasifikuara duhet përcaktuar kushtet nën të cilat përdoruesi mund të bëjë përpunimin e tyre. Klasifikimi duhet të mbetet i bashkëngjitur me të dhënat personale të ndjeshme deri në fshirjen, asgjësimin, shkatërrimin ose anonimizimin e tyre;

1.15. **Anonimizim** – ndryshimin e të dhënave personale në mënyrë të atillë që ato

të mos mund të ndërlidhen më me subjektin e të dhënave ose ku ndërlidhja e tillë mund të bëhet vetëm me përpjekje, shpenzime ose me kohë shtesë;

1.16. **Të dhëna personale të ndjeshme -** të dhënat personale që zbulojnë origjinën etnike ose racore, pikëpamjet politike ose filozofike, përkatësitë fetare, anëtarësimin në sindikatë ose çdo të dhënë për gjendjen shëndetësore ose jetën seksuale, çfarëdo përfshirje në ose heqje nga evidencat penale ose të kundërvajtjeve që ruhen në pajtim me ligjin. Karakteristikat biometrike gjithashtu konsiderohen si të dhëna personale të ndjeshme nëse këto të fundit mundësojnë identifikimin e një subjekti të të dhënave në lidhje me cilëndo nga rrethanat e lartpërmendura në këtë nën-paragraf;

1.17. **Kod lidhës -** numrin personal të identifikimit ose çfarëdo numri tjetër të veçantë të identifikimit të përcaktuar me ligj, lidhur me personin, i cili numër mund të përdoret për zbulimin ose rikthimin e të dhënave personale nga sistemet e dosjeve në të cilat gjithashtu përpunohet kodi lidhës;

1.18. **Karakteristikat biometrike -** të gjitha karakteristikat fizike, psikologjike dhe të sjelljes që i kanë të gjithë individët, por që janë të veçanta dhe të përhershme për secilin individ, nëse në veçanti mund të përdoren për identifikimin e një individi siç janë: gjurmët e gishtërinjve, vijat papilare të gishtit, irida, retina, tiparet e fytyrës dhe ADN-ja.

1.19. **Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejmë Agjencia) -** agjencion i pavarur, përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 3
Parimet e përpunimit të të dhënave

1. Të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme dhe të ligjshme pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave.
2. Të dhënat personale duhet të jenë adekuate, relevante dhe nuk duhet t'i tejkalojnë qëllimet për të cilat ato janë grumbulluar dhe/ose përpunuar më tutje.
3. Të dhënat personale grumbullohen vetëm për qëllime të caktuara, të qarta dhe legjitime dhe nuk mund të përpunohen më tutje në kundërshtim me këto qëllime, përveç nëse nuk është e paraparë ndryshe me ligj.
4. Të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe të përditësuara. Para grumbullimit të të dhënave personale, kontrolluesi i të dhënave verifikon saktësinë e të dhënave personale duke e kontrolluar ndonjë dokument të identifikimit ose çfarëdo dokumenti tjetër publik të përshtatshëm të subjektit të të dhënave.
5. Të dhënat personale mund të ruhen vetëm për aq kohë sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit për të cilin janë grumbulluar ose përpunuar më tutje. Me rastin e përmbushjes së qëllimit të përpunimit, të dhënat personale do të asgjësohen, fshihen, shkatërrohen, bllokohen ose bëhen anonime, përveç nëse është paraparë ndryshe me Ligjin për Lëndën Arkivore dhe Arkivat ose me ndonjë ligj tjetër përkatës.

Neni 4
Fushëveprimi

1. Ky ligj zbatohet për përpunimin e të dhënave personale nga organet publike dhe private. Ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave personale nëse përpunimi është kryer për qëllime krejtësisht personale.
2. Ky ligj zbatohet edhe në zyrat diplomatike dhe konsullore, si dhe në të gjitha përfaqësitë e tjera zyrtare të Republikës së Kosovës jashtë shtetit.
3. Ky ligj zbatohet edhe për kontrolluesin e të dhënave i cili nuk është i themeluar në Republikën e Kosovës, por që për qëllime të përpunimit të të dhënave personale përdor pajisje automatike ose të tjera, në Republikën e Kosovës, përveç nëse pajisjet e këtilla përdoren vetëm për qëllime të transitit nëpër territorin e Kosovës. Në këto rrethana, kontrolluesi duhet të caktojë një përfaqësues të themeluar në Kosovë.
4. Paragrafi 2 i nenit 16, nenet 17, 18 dhe 20 si dhe Kreu V (pesë) i këtij ligji nuk zbatohen për të dhënat personale të cilat mediat i përpunojnë me qëllim të informimit të publikut dhe për qëllime të shprehjeve artistike ose letrare.
5. Nenet 17, 18 dhe 20 të këtij ligji nuk zbatohen për të dhënat personale që përpunohen nga partitë politike, sindikatat, shoqatat ose bashkësitë fetare në lidhje me anëtarët e tyre.

KREU II
LEGJITIMITETI I PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE

Nën-kreu A
Bazat ligjore dhe qëllimet

Neni 5
Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale

1. Të dhënat personale mund të përpunohen vetëm nëse:
   1.1. subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij ose saj;
   1.2. përpunimi është i domosdoshëm për përmbushjen e një kontrate në të cilën subjekti i të dhënave është palë kontraktuese ose për të ndërmarrë veprimet lidhur me kërkesën e subjektit të të dhënave para lidhjes së kontratës;
   1.3. përpunimi është i domosdoshëm për respektimin e obligimit ligjor të cilit i nënshtrohet kontrolluesi;
   1.4. përpunimi është i domosdoshëm për mbrojtjen e interesave jetike të subjektit të të dhënave;
   1.5. përpunimi është i domosdoshëm për kryerjen e një detyre me interes publik ose në ushtrimin e autoritetit zyrtar që i është dhënë kontrolluesit apo një pale të tretë të cilës i zbulohen të dhënat;
   1.6. përpunimi është i domosdoshëm për qëllime të interesave legjitime të ushtruara nga kontrolluesi ose pala e tretë apo palëve të cilave u janë zbuluar të dhënat, me përjashtim të rasteve kur interesat e tilla janë në kundërshtim me të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave.

Neni 6
Përpunimi i të dhënave personale të ndjeshme

1. Të dhënat personale të ndjeshme mund të përpunohen vetëm në rastet në vijim:
   1.1. nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin;
   1.2. nëse përpunimi është i domosdoshëm për qëllime të realizimit të detyrimeve dhe të drejtave specifike të kontrolluesit të të dhënave në fushën e punësimit, në pajtim me ligjet përkatëse të cilat po ashtu ofrojnë masa mbrojtëse të përshtatshme për të drejtat e subjektit të të dhënave;
   1.3. nëse përpunimi është i domosdoshëm për mbrojtjen e interesave jetike të subjektit të të dhënave kur subjekti i të dhënave është fizikisht ose ligjërisht i paaftë për të dhënë pëlqimin e tij ose saj sipas nën-paragrafit 1.1 të këtij paragrafi;
   1.4. nëse ato përpunohen për qëllime të veprimtarive legjitime nga institucionet, shoqatat, asociacionet, bashkësitë fetare, sindikatat ose organizatat tjera jo-fitimprurëse me qëllime politike, filozofike, fetare ose sindikaliste, por vetëm nëse përpunimi ka të bëjë me anëtarët e tyre ose subjektet e të dhënave që janë në kontakt të rregullt me ato e në lidhje me qëllimet e tilla dhe nëse ata nuk i zbulojnë të dhënat e tilla të tjerëve pa pëlqimin me shkrim të subjektit të të dhënave;
   1.5. nëse subjekti i të dhënave i ka bërë ato publike pa e kufizuar përdorimin e tyre në mënyrë të dëshmuar ose të qartë;
   1.6. nëse ato përpunohen nga punonjësit shëndetësorë ose personeli shëndetësor në pajtim me ligjet përkatëse për qëllimet e mbrojtjes së shëndetit së shoqërisë, individëve dhe menaxhimit ose funksionimit të shërbimeve shëndetësore;
   1.7. nëse përpunimi është i nevojshëm për pohimin ose mohimin e kërkesës ligjore;
   1.8. nëse ato përpunohen në pajtim me ligjin përkatës për arsye të interesit thelbësor publik.

Neni 7
Mbrojtja e të dhënave personale të ndjeshme

1. Të dhënat personale të ndjeshme duhet të mbrohen në mënyrë të veçantë dhe të klasifikohen me qëllim të parandalimit të qasjes dhe përdorimit të paautorizuar, me përjashtim të rasteve nga nën-paragrafi 1.5, paragrafit 1 të nenit 6 të këtij ligji.
2. Kur të dhënat personale të ndjeshme transferohen përmes rrjeteve të telekomunikimit konsiderohen si të mbrojtura në mënyrë të përshtatshme, nëse ato janë të koduara për të siguruar palexueshmërinë dhe mosnjohjen e tyre.

Neni 8
Vendimmarrja automatike

1. Vendimmarrja automatike e cila mund të prodhojë efekte ligjore ose të ketë ndikim të rëndësishëm tek subjekti i të dhënave dhe e cila bazohet vetëm në përpunimin automatik të dhënave me qëllim të vlerësimit të aspekteve të caktuara personale, veçanërisht përmbushjes së detyrave të subjektit të të dhënave në vendin e punës,

aftësisë së tij ose saj, besueshmërisë, sjelljes ose respektimit të rregullave të caktuara, lejohet vetëm nëse vendimi:

2. është marrë gjatë lidhjes ose përmbushjes së kontratës, me kusht që kërkesa për lidhjen ose zbatimin e kontratës, e parashtruar nga subjekti i të dhënave është përmbushur ose ekzistojnë masa të duhura për të mbrojtur interesat e tij ose saj legjitime, siç janë marrëveshjet që i mundësojnë subjektit të të dhënave të kundërshtojë vendimet e tilla ose të shpreh qëndrimin e tij ose saj;
3. parashihet me ligjin i cili po ashtu siguron masat për mbrojtjen e interesave legjitime të subjektit të të dhënave, në veçanti mundësinë e mjetit juridik kundër vendimeve të tilla.

Neni 9
Përpunimi për qëllime të kërkimeve historike, statistikore dhe shkencore

1. Pavarësisht nga qëllimi fillestar i grumbullimit, të dhënat personale mund të përpunohen më tutje për qëllime të kërkimeve historike, statistikore dhe shkencore.
2. Nëse të dhënat personale përpunohen më tutje për qëllimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, ato do të bëhen anonime, përveç nëse ligji e parashikon ndryshe ose nëse subjekti i të dhënave e ka dhënë paraprakisht pëlqimin e tij ose saj me shkrim.
3. Të dhënat personale, të cilat i janë zbuluar marrësve të të dhënave në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, do të shkatërrohen ose fshihen me rastin e përfundimit të përpunimit të tyre, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj. Pas shkatërrimit ose fshirjes, marrësi i të dhënave pa vonesë do ta njoftojë me shkrim kontrolluesin e të dhënave, i cili ka zbuluar të dhënat, për mënyrën dhe kohën e shkatërrimit dhe fshirjes së të dhënave.
4. Rezultatet e përpunimit nga paragrafi 1 i këtij neni, do të publikohen në formë anonime, përveç nëse me ligj është paraparë ndryshe, nëse subjekti i të dhënave ka dhënë paraprakisht pëlqimin e tij ose saj me shkrim për publikim në formë jo-anonime ose nëse pëlqimi paraprak me shkrim për një publikim të tillë është dhënë nga trashëgimtarët e personit të vdekur, sipas këtij ligji.

Neni 10
Informacionet që i jepen subjektit të të dhënave

1. Nëse të dhënat personale janë marrë drejtpërdrejt nga subjekti i të dhënave, kontrolluesi i të dhënave ose përfaqësuesi i tij duhet t'i ofrojë subjektit të të dhënave në momentin e grumbullimit të të dhënave së paku informacionet në vijim, përveç në rastet kur ai ose ajo është në dijeni për këto informacione:
   1.1. identitetin e kontrolluesit të të dhënave dhe të përfaqësuesit të tij ose saj të mundshëm si emrin(at) personal, titullin respektivisht pozitën zyrtare, adresën ose vendqëndrimin dhe kur është e mundur edhe adresën elektronike dhe numrin e telefonit;
   1.2. qëllimin e përpunimit;
   1.3. informacionet që kanë të bëjnë me atë se përgjigjet a janë të detyrueshme ose vullnetare, si dhe pasojat në rast të dështimit për të dhënë përgjigje;

1.4. informacionet lidhur me të drejtën për qasje, transkriptim, kopjim, plotësim, korrigjim, bllokim dhe asgjësim të të dhënave personale.

2. Nëse në rrethana të veçanta për grumbullimin e të dhënave personale të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, nevojitet të sigurohet përpunim i ligjshëm dhe i paanshëm i të dhënave personale të subjektit të të dhënave, kontrolluesi i të dhënave, në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, duhet po ashtu t'i ofrojë subjektit të të dhënave informacionin shtesë, nëse subjekti i të dhënave nuk është në dijeni për këto informacione, si vijon:
   2.1. informacionet lidhur me marrësit ose kategoritë e marrësve të të dhënave personale;
   2.2. bazën ligjore të veprimeve të përpunimit;
3. Nëse të dhënat personale nuk janë grumbulluar drejtpërdrejt nga subjekti i të dhënave, kontrolluesi i të dhënave ose përfaqësuesi i tij duhet t'i ofrojë subjektit të dhënave informacionet në vijim, përveç nëse subjekti i të dhënave është në dijeni për këto informacione:
   3.1. identitetin e kontrolluesit dhe të përfaqësuesit të tij të mundshëm, si: emrin personal, titullin respektivisht pozitën zyrtare, adresën ose selinë dhe ku është e mundur adresën elektronike dhe numrin e telefonit;
   3.2. qëllimin e përpunimit;
   3.3. informacionet lidhur me të drejtën për qasje, transkriptim, kopjim, plotësim, korrigjim, bllokim dhe asgjësim të të dhënave personale;
   3.4. origjinën e të dhënave.
4. Nëse në rrethana të veçanta për grumbullimin e të dhënave personale të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, nevojitet të sigurohet përpunim i ligjshëm dhe i paanshëm i të dhënave personale, kontrolluesi i të dhënave, në bazë të paragrafit 3 të këtij neni, duhet po ashtu t'i ofrojë subjektit të të dhënave informacionet shtesë si në vijim, e në veçanti:
   4.1. informacionin për kategoritë e të dhënave personale të grumbulluara;
   4.2. informacionin lidhur me marrësin ose kategoritë e marrësve të të dhënave personale;
   4.3. bazën ligjore të veprimeve të përpunimit.
5. Informacionet nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni nuk jepen nëse për qëllime historike, statistikore ose shkencore-kërkimore vërtetohet se është e pamundur, shkaktojnë shpenzime të mëdha ose përpjekje të shtuara apo nevojitet një kohë shumë gjatë, ose nëse përpunimi apo zbulimi i të dhënave personale parashihet në mënyrë të qartë me ligj.

Neni 11
Përdorimi i kodeve lidhëse

1. Të dhënat personale që mbahen në një sistem të dosjeve nga fusha e shëndetësisë, nuk duhet të grumbullohen dhe të përpunohen duke përdorur vetëm kodin lidhës.
2. Kodi lidhës përjashtimisht mund të përdoret për të marrë të dhënat personale në rast se është i vetmi element i të dhënave në një rast të veçantë për të mbrojtur jetën dhe trupin e subjekteve të të dhënave. Pas përdorimit të kodit lidhës, një shënim zyrtar ose një dokument tjetër i shkruar i bashkëngjitur me të dhënat personale duhet të bëhet pa vonesë

3. Të dhënat personale në regjistrin kadastral dhe regjistrin afarist mund të grumbullohen dhe përpunohen duke përdorur vetëm kodin lidhës

Neni 12
Zbulimi i të dhënave personale

1. Marrësi i të dhënave bartë shpenzimet e çdo zbulimi ligjor të të dhënave nga ana e kontrolluesit të dhënave, nëse me ligj nuk është paraparë ndryshe.
2. Informacionet nga regjistri qendror i shtetasve dhe regjistri i të dhënave të banorëve të përhershëm dhe të përkohshëm zbulohen për marrësit që shprehin interes legjitim. Këto informacione përmbajnë: emrin personal dhe adresën e përhershme ose të përkohshme të subjektit të të dhënave.
3. Kur zbulohen të dhënat e tilla kontrolluesi i të dhënave duhet të sigurojë që të evidentohet informacioni në vijim: cilat të dhëna personale janë zbuluar, kujt, kur dhe me çfarë baze ligjore. Informacioni i tillë që ka të bëjë me zbulimin duhet të mbahet me të dhënat e subjektit të të dhënave për aq kohë sa ruhen ato të dhëna.

Neni 13
Mbrojtja e të dhënave personale të personave të vdekur

1. Të dhënat personale të personave të vdekur mund tu zbulohen vetëm marrësve të autorizuar me ligj.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1 të këtij neni, të dhënat personale të personave të vdekur mund tu zbulohen trashëgimtarëve ligjorë të tyre, nëse ata tregojnë interes legjitim dhe personat e vdekur nuk e kanë ndaluar me shkrim zbulimin e të dhënave personale të tilla.
3. Të dhënat personale të personit të vdekur mund të zbulohen për qëllime historike, statistikore ose për kërkime shkencore në qoftë se personi i vdekur, paraprakisht e ka lejuar me shkrim zbulimin e të dhënave personale të tilla, përveç nëse me ligj është paraparë ndryshe.
4. Nëse personi i vdekur, paraprakisht nuk e ka lejuar zbulimin e të dhënave të tij ose saj, trashëgimtarët ligjorë mund ta lejojnë me shkrim zbulimin e të dhënave të tilla, përveç nëse me ligj është paraparë ndryshe.

Nën-kreu B
Detyrimet e përpunuesit dhe kontrolluesit të të dhënave

Neni 14
Sigurimi i përpunimit të të dhënave

1. Sigurimi i të dhënave personale përfshinë procedurat dhe masat e duhura organizative, teknike dhe logjiko-teknike për mbrojtjen e tyre dhe parandalimin e çfarëdo shkatërrimi të paqëllimshëm ose të qëllimshëm të paautorizuar, zbulimin, ndryshimin, qasjen ose përdorimin e të dhënave apo humbjen e papritur ose të qëllimshme të tyre si:
   1.1. duke i mbrojtur lokalet, pajisjet dhe sistemet aplikative (softuerët), përfshirë edhe kontrollin e qasjes;

1.2. duke i mbrojtur programet aplikative (softuerike) që përdoren për përpunimin e të dhënave;
1.3. duke parandaluar çfarëdo qasje të paautorizuar në ose leximin e të dhënave personale gjatë ruajtjes dhe transmetimit të tyre, përfshirë transmetimin nëpërmjet mjeteve të telekomunikimit dhe rrjeteve;
1.4. duke siguruar metodat efikase për bllokimin, shkatërrimin, fshirjen ose anonimizimin e të dhënave personale;
1.5. duke mundësuar përcaktimin pasues se kur janë futur të dhënat personale në sistemin e dosjeve, kur janë qasur, ndryshuar, zbuluar, shkatërruar, përdorur ose kur janë përpunuar ndryshe, dhe kush e ka bërë atë, për kohën sa janë ruajtur ato.

2. Nëse të dhënat personale janë përpunuar me anë të rrjeteve të telekomunikimit duhet të sigurohet që përpunimi të kryhet brenda kufijve të paraparë me ligj. Gjithashtu pajisjet e prekshme (hardueri), programi sistemor (softueri) dhe aplikacionet programore (softuerike) duhet të sigurojnë një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes së të dhënave.
3. Procedurat dhe masat për të mbrojtur të dhënat personale duhet të jenë të përshtatshme dhe të mbahen të përditësuara, duke pasur parasysh natyrën e të dhënave personale që duhet mbrojtur dhe rrezikun që paraqitet gjatë përpunimit të të dhënave të tilla.
4. Zyrtarët, të punësuarit dhe personat tjerë që kryejnë punë lidhur me përpunimin e të dhënave përfshirë kontrolluesin e të dhënave janë të obliguar, që gjatë dhe pas kryerjes së punëve të kontraktuara, të mbrojnë fshehtësinë e të dhënave personale me të cilat ata njihen.

Neni 15
Përpunimi i kontraktuar

1. Përpunuesit të të dhënave mund t'i besohet përpunimi i të dhënave personale me një kontratë të shkruar nëse ai ose ajo është i/e regjistruar në Republikën e Kosovës për të kryer veprimtari të tilla në pajtim me procedurat dhe masat e parapara me nenin 14 të këtij ligji.
2. Përpunuesi i të dhënave mund të veprojë vetëm brenda kufijve të autorizimeve të kontrolluesit të të dhënave dhe nuk mund të përpunojë të dhënat personale për qëllime tjera. Të drejtat dhe detyrimet reciproke duhet të caktohen me kontratë të shkruar, e cila po ashtu duhet të përmbajë edhe një përshkrim të detajuar të procedurave dhe masave në pajtim me nenin 14 të këtij ligji.
3. Kontrolluesi i të dhënave duhet të mbikëqyrë zbatimin e procedurave dhe masave në pajtim me nenin 14 të këtij ligji. Po ashtu, duhet të përfshijë edhe vizitat e përkohshme në lokalet ku bëhet përpunimi i të dhënave personale.
4. Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet kontrolluesit të të dhënave dhe përpunuesit të të dhënave, përpunuesi i të dhënave duhet menjëherë në kërkesë të kontrolluesit të të dhënave t'i kthejë të gjitha të dhënat që ai ose ajo i posedon. Përpunuesit të të dhënave nuk i lejohet t'i mbajë kopjet dhe t'i përpunojë ato më tutje.
5. Në rast të ndërprerjes së veprimtarive të përpunuesit të të dhënave, të dhënat personale duhet të kthehen menjëherë te kontrolluesi i të dhënave.

Neni 16
Obligimi për sigurimin e të dhënave personale

1. Kontrolluesit e të dhënave dhe përpunuesit e të dhënave duhet të kujdesen në çdo kohë që të dhënat personale janë të mbrojtura sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 14 të këtij ligji.
2. Kontrolluesit e të dhënave dhe përpunuesit e të dhënave duhet të përshkruajnë në aktet e tyre të brendshme procedurat dhe masat e vendosura për sigurinë e të dhënave personale dhe duhet të emërojnë në formë të shkruar personat kompetent që janë përgjegjës për sistemin e dosjeve dhe personat të cilët, për shkak të natyrës së punës së tyre, duhet të përpunojnë të dhënat personale.

Nën-kreu C
Sistemi i dosjeve

Neni 17
Katalogu i sistemit të dosjeve

1. Kontrolluesi i të dhënave duhet të krijojë për secilin sistem të dosjeve një përshkrim të detajuar i quajtur katalogu i sistemit të dosjeve e që përmban:
   1.1. titullin e sistemit të dosjeve;
   1.2. identitetin e kontrolluesit të të dhënave dhe përfaqësuesit të tij ose saj. Për personat fizik: emrin (at) personal, adresën e përhershme ose të përkohshme ku janë kryer veprimet ose adresën e përhershme ose të përkohshme të banimit, dhe ku është e mundur numrin e telefonit dhe adresën elektronike. Për tregtarët e pavarur: emrin (at) e tyre zyrtar, zyrat e regjistruara, selinë dhe numrin e regjistrimit dhe ku është e mundur, numrin e telefonit dhe adresën elektronike. Për personat juridikë: emri i themeluesit, titullin ose zyrën e regjistruar, adresën ose selinë, numrin e regjistrimit dhe ku është e mundur, numrin e telefonit dhe adresën elektronike;
   1.3. bazën ligjore për përpunimin e të dhënave;
   1.4. kategoritë e subjekteve të të dhënave;
   1.5. kategoritë e të dhënave personale në sistemin e dosjeve;
   1.6. qëllimin e përpunimit;
   1.7. kohëzgjatjen e paraparë për ruajtjen e të dhënave personale;
   1.8. kufizimet e të drejtave të subjekteve dhe bazën ligjore për kufizimet e tilla;
   1.9. marrësit e të dhënave ose kategoritë e marrësve të të dhënave të përfshirë në sistemin e dosjeve;
   1.10. informacionet nëse të dhënat personale janë ose do të transferohen në shtetin tjetër, ku, kur dhe kujt i transferohen dhe bazën ligjore për transferimet e tilla;
   1.11. përshkrimin e përgjithshëm të procedurave dhe masave në pajtim me nenin 14 të këtij ligji;
   1.12. të dhënat ose sistemet e ndërlidhura të dosjeve nga evidenca zyrtare ose librat publikë.
2. Kontrolluesi i të dhënave duhet të sigurojë që përmbajtja e katalogut të sistemit të dosjeve të jetë e saktë dhe të mbahet e përditësuar.

Neni 18
Lajmërimi i Agjencisë

1. Së paku njëzet (20) ditë para krijimit të një sistemi të dosjes ose para futjes së kategorive të reja të të dhënave personale, kontrolluesi i të dhënave i ofron Agjencisë, në formë të shkruar apo me mjete elektronike informacionet nga nën-paragrafët e paragrafit 1 të nenit 17 të këtij ligji.
2. Kontrolluesit e të dhënave duhet ta informojnë Agjencinë për çdo ndryshim rreth informacioneve nga paragrafi 1 të këtij neni jo më larg se tetë (8) ditë nga dita e ndryshimit.

Neni 19
Kontrolli paraprak

1. Pas pranimit të njoftimit, Agjencia kontrollon nëse operacioni i përpunimit mund të paraqesë rrezik të veçantë për të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave për shkak të natyrës së të dhënave personale që përpunohen dhe fushëveprimit ose qëllimit të përpunimit të të dhënave.
2. Brenda tri (3) javësh pas marrjes së njoftimit Agjencia duhet të jep mendimin e saj. Kjo periudhë mund të pezullohet derisa Agjencia të merr informacionin tjetër që konsiderohet i domosdoshëm. Varësisht nga ndërlikueshmëria e çështjes, kjo periudhë kohore mund të zgjatet deri në tre (3) muaj me vendim të Agjencisë i cili duhet t'i komunikohet kontrolluesit të të dhënave para kalimit të periudhës tre (3) mujore.
3. Nëse komunikimi nuk bëhet brenda afatit prej tre (3) muajsh, ose nëse ky afat nuk zgjatet, atëherë komunikimi konsiderohet sikur ai të jetë kryer.
4. Nëse Agjencia konsideron se përpunimi i komunikuar mund të përmbajë shkelje të rregullave për mbrojtjen e të dhënave, ajo bën sugjerim të duhur për t'i shmangë shkeljet e tilla.
5. Kontrolluesi i të dhënave duhet ta respektojë çdo sugjerim dhe vendim që është nxjerrë nga Agjencia për të siguruar përpunimin ligjor të të dhënave.

Neni 20
Regjistri

1. Agjencia duhet ta themelojë dhe ta mbajë një regjistër të sistemit të dosjeve që përmban informacionet nga neni 18 i këtij ligji, në pajtim me procedurat e saj të brendshme.
2. Regjistri duhet të menaxhohet duke përdorur mjetet e teknologjisë informative dhe do të publikohet në faqen publike të Agjencisë.
3. Përcaktimi i procedurave të brendshme nga paragrafi 1 i këtij neni bëhet me akt nënligjor.

KREU III
TË DREJTAT E SUBJEKTIT TË TË DHËNAVE

Neni 21
Konsultimi i regjistrit

Çdo person ka të drejtë që pa pagesë ta konsultojë regjistrin e sistemeve të dosjeve që mbahet nga Agjencia dhe t'i kopjojë ose t'i transkriptojë detajet.

Neni 22
E drejta për qasje

1. Çdo subjekt i të dhënave mund ta konsultojë katalogun e sistemit të dosjeve që mbahet nga kontrolluesi i të dhënave. Kontrolluesi i të dhënave duhet t'i sigurojë subjektit të të dhënave, me kërkesën e tij, informacionet në vijim:
   1.1. të dhënat personale të ruajtura të tij ose saj;
   1.2. qëllimet e përpunimit dhe kategoritë e të dhënave që përpunohen;
   1.3. bazën ligjore për përpunim;
   1.4. origjinën e të dhënave;
   1.5. marrësit e të dhënave ose kategoritë e marrësve të të dhënave dhe kur dhe në çfarë baze dhe për çfarë qëllimi të dhënat e subjektit të të dhënave janë zbuluar duke përfshirë marrësit e të dhënave në shtetet tjera;
   1.6. nëse është e zbatueshme, procedurat teknike dhe informacionin lidhur me logjikën e përfshirë në vendimmarrje.
2. Ekstrakti i lëshuar nga kontrolluesi i të dhënave për të dhënat personale të ruajtura nga ai ose ajo nuk zëvendëson dokumentin ose certifikatën, dhe kjo shënohet në ekstrakt.

Neni 23
Procedura për qasje

1. Subjektet e të dhënave mund të kërkojnë nga kontrolluesit e të dhënave në periudha të rregullta kohore të konsultojnë, transkriptojnë dhe kopjojnë informacionet që kanë të bëjnë më ta, sipas nenit 22 të këtij ligji dhe mund të kërkojnë një ekstrakt ose kopje të këtyre informacioneve. Kjo kërkesë mund të parashtrohet gojarisht, me shkrim ose me mjete elektronike.
2. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kontrolluesit e të dhënave duhet ta konfirmojnë me shkrim pranimin e kërkesës së subjektit të të dhënave, ose brenda afatit të njëjtë kohor ata duhet ta informojnë me shkrim subjektin e të dhënave për arsyet pse kërkesa nuk mund të realizohet.
3. Kontrolluesit e të dhënave duhet që brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të kërkesës t'i ofrojnë subjektit të të dhënave një ekstrakt ose kopje apo çfarëdo informacioni të kërkuar në pajtim me paragrafin 1 të nenit 22 të këtij ligji.
4. Nëse kontrolluesi i të dhënave nuk vepron sipas paragrafit 1, 2 dhe 3 të këtij neni, subjekti i të dhënave mund ta konsultojë Agjencinë.
5. Shpenzimet lidhur me cilëndo kërkesë të parashtruar nga subjekti i të dhënave sipas këtij neni, mbulohen nga kontrolluesi i të dhënave.

Neni 24
E drejta për shtim, korrigjim, bllokim, shkatërrim, asgjësim, fshirje dhe kundërshtim

1. Me kërkesën e subjektit të të dhënave, kontrolluesi i të dhënave duhet të shtojë, të korrigjojë, të bllokojë, shkatërrojë, fshijë ose asgjësojë të dhënat personale për të cilat subjekti i të dhënave vërteton se janë jo të plota, jo të sakta ose jo të përditësuara, apo nëse janë grumbulluar ose përpunuar në kundërshtim me ligjin.
2. Me kërkesën e subjektit të të dhënave, kontrolluesi i të dhënave duhet që menjëherë t'i informojë të gjithë marrësit e të dhënave dhe përpunuesit e të dhënave, të cilëve u janë zbuluar të dhënat personale lidhur me masat e ndërmarra në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni. Kontrolluesi i të dhënave nuk është i obliguar të bëjë këtë nëse kjo do të shkaktonte shpenzime të mëdha.
3. Subjektet e të dhënave, të dhënat personale të të cilëve janë përpunuar në përputhje me nën-paragrafët 1.5 dhe 1.6 të nenit 5 të këtij ligji, kanë të drejtë të kundërshtojnë në çdo kohë përpunimin e të dhënave të tyre. Kontrolluesi i të dhënave duhet ta pranojë kundërshtimin nëse subjekti i të dhënave demonstron se kushtet për përpunim nuk janë plotësuar në pajtim me nën-paragrafët 1.5 dhe 1.6 të nenit 5 të këtij ligji. Në rastin e tillë të dhënat personale të subjektit të të dhënave nuk përpunohen.
4. Nëse kontrolluesi i të dhënave nuk e pranon kundërshtimin nga paragrafi 3 të këtij neni, subjekti i të dhënave mund të kërkojë që Agjencia të vendosë nëse përpunimi është në përputhje me nën-paragrafët 1.5 dhe 1.6 të nenit 5 të këtij ligji. Subjekti i të dhënave mund të parashtrojë kërkesë të tillë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i kundërshtimit të kontrolluesit të të dhënave.
5. Agjencia lidhur me kërkesat nga paragrafi 4 i këtij neni duhet të vendosë brenda dy (2) muajsh pas pranimit të tyre. Parashtrimi i kërkesës pezullon përpunimin e të dhënave personale.
6. Shpenzimet për masat nga paragrafi 5 i këtij neni mbulohen nga kontrolluesi i të dhënave.

Neni 25
Procedura e shtimit, korrigjimit, bllokimit, asgjësimit, shkatërrimit, fshirjes dhe kundërshtimit

1. Çdo kërkesë apo kundërshtim sipas nenit 24 të këtij ligji mund të parashtrohet gojarisht, me shkrim ose me mjete elektronike.
2. Kontrolluesit e të dhënave shtojnë, bllokojnë, korrigjojnë, asgjësojnë, shkatërrojnë apo fshijnë të dhënat personale në fjalë, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas pranimit të kërkesës. Ata duhet ta informojnë me shkrim subjektin e të dhënave brenda afatit të njëjtë kohor për arsyet e refuzimit. Kontrolluesit e të dhënave duhet brenda afatit të njëjtë kohor të vendosin për kundërshtimin e parashtruar nga subjekti i të dhënave lidhur me përpunimin e të dhënave të tij ose saj.
3. Nëse kontrolluesit e të dhënave nuk veprojnë në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, subjekti i të dhënave mund ta konsultojë Agjencinë.
4. Nëse kontrolluesi i të dhënave konkludon se të dhënat personale nuk janë të

kompletuara, të sakta dhe nuk janë të përditësuara, ai duhet t'i shtojë ose korrigjojë ato dhe ta informojë subjektin e të dhënave, përveç nëse me ligj nuk është paraparë ndryshe.

5. Mbulimi i shpenzimeve që kanë të bëjnë me kompletimin, korrigjimin, bllokimin, shkatërrimin, asgjësimin dhe fshirjen, e të dhënave personale, dhe të njoftimit apo vendimit lidhur me kundërshtimin, barten nga kontrolluesi i të dhënave.

Neni 26
Mbrojtja ligjore e të drejtave të subjektit të të dhënave

1. Subjektet e të dhënave të cilët kuptojnë se të drejtat e tyre të garantuara me këtë ligj janë shkelur, mund të kërkojnë mbrojtje ligjore për aq kohe sa zgjatë shkelja e tillë, pavarësisht të drejtës së subjektit të të dhënave për konsultim dhe kundërshtim tek Agjencia në pajtim me këtë ligj.
2. Nëse shkelja sipas paragrafit 1 të këtij neni pushon, subjekti i të dhënave mund të paraqesë padi në gjykatën kompetente për të vërtetuar se shkelja ka ekzistuar, nëse atij ose asaj nuk i është siguruar mbrojtje tjetër ligjore në lidhje me shkeljen.

Neni 27
Ndalimi i përkohshëm i përpunimit të të dhënave personale

Në padinë e dorëzuar, lidhur me shkeljet e të drejtave nga neni 24 të këtij ligji, subjekti i të dhënave mund të kërkojë nga gjykata deri sa të lëshohet vendimi përfundimtar, që ta detyrojë kontrolluesin e të dhënave, për të ndaluar çfarëdo përpunimi të dhënave personale në shqyrtim, nëse përpunimi i tyre do t'i shkaktonte subjektit të dhënave dëme të paripareshme, ndërsa shtyrja e përpunimit nuk është në kundërshtim me interesin publik e as nuk ka rrezik që palës kundërshtare do t'i bëhej dëm i madh i paripareshëm.

Neni 28
Kufizimi dhe përjashtimet

1. Të drejtat e subjektit të të dhënave nga neni 10, nenet 22 dhe 24 të këtij ligji dhe obligimin për publikim të regjistrit të sistemit të dosjeve nga paragrafi 2 i nenit 20 të këtij ligji, në mënyrë të veçantë mund të kufizohen me ligj për arsye të:
   1.1. sigurisë kombëtare;
   1.2. mbrojtjes kombëtare;
   1.3. sigurisë publike;
   1.4. parandalimit, hetimit, zbulimit dhe ndjekjes së veprave penale, ose shkeljes së etikës për profesionet e caktuara;
   1.5. interesit të rëndësishëm ekonomik ose financiar të Republikës së Kosovës përfshirë çështjet monetare, buxhetore dhe të taksave;
   1.6. mbikëqyrjes, inspektimit ose funksionimit të rregullt i ndërlidhur qoftë edhe rastësisht me ushtrimin e autoritetit zyrtar në rastet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.3, 1.4 dhe 1.5 të këtij paragrafi;
   1.7. mbrojtjes së subjektit të të dhënave ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

2. Masat nga paragrafi 1 i këtij neni mund të merren vetëm për aq sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit për të cilin kufizimi është dhënë.

KREU IV
MBROJTJA INSTITUCIONALE E TË DHËNAVE PERSONALE

Nën-kreu D
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Neni 29
Statusi i Agjencisë

1. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është agjenci e pavarur, e ngarkuar për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave për mbrojtjen e të dhënave. Anëtarët e saj veprojnë të pavarur në pajtim me këtë ligj dhe nuk duhet të pranojnë asnjë udhëzim nga palët e treta. Ajo i përgjigjet Kuvendit të Kosovës.
2. Agjencia në veçanti:
   2.1. jep këshilla organeve publike dhe private për çështjet lidhur me mbrojtjen e të dhënave;
   2.2. vendos lidhur me ankesat e subjektit të të dhënave;
   2.3. bën inspektime dhe kontrolle;
   2.4. informon publikun për çështjet dhe zhvillimet në fushën e mbrojtjes së të dhënave; dhe
   2.5. promovon dhe përkrah të drejtat themelore për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 30
Organizimi i Agjencisë

1. Agjencia kryesohet nga Këshilli, i cili përbëhet nga Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror dhe katër Mbikëqyrës Shtetëror (tani e tutje: Mbikëqyrësit). Së paku njëri nga anëtarët e Këshillit, duhet të jetë jurist i diplomuar. Vendimet e Këshillit merren me shumicë të thjeshtë.
2. Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror përfaqëson Agjencinë, organizon dhe koordinon punën e saj.

Neni 31
Emërimi i Mbikëqyrësit Kryesor Shtetëror

1. Mbikëqyrës Kryesor Shtetëror, mund të caktohet personi i cili ka diplomë universitare dhe pesë (5) vjet përvojë pune profesionale.
2. Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror emërohet nga Kuvendi i Kosovës me propozimin e Qeverisë së Kosovës për një periudhë pesë (5) vjeçare me mundësi të emërimit edhe për një mandat.

Neni 32
Emërimi i Mbikëqyrësit Shtetëror

1. Personat të cilët kanë diplomë universitare dhe tri (3) vjet përvojë pune profesionale, mund të caktohen si Mbikëqyrës Shtetëror.
2. Mbikëqyrësit Shtetëror emërohen nga Kuvendi i Kosovës me propozimin e Qeverisë së Kosovës për një periudhë pesë (5) vjeçare me mundësi të emërimit edhe për një mandat.

Neni 33
Zëvendësi i Mbikëqyrësit Kryesor Shtetëror

Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror cakton Zëvendësin e tij ose saj nga radhët e Mbikëqyrësve, i cili do ta zëvendësojë gjatë mungesës ose paaftësisë së përkohshme.

Neni 34
Shkarkimi i Mbikëqyrësve

1. Anëtarët e Këshillit mund të shkarkohen nga detyra e tyre vetëm në rastet si në vijim:
   1.1. nëse paraqesin dorëheqje para Kuvendit të Kosovës;
   1.2. nëse është dënuar me vendim te formës së prerë për vepër penale me dënim me burgim mbi gjashtë (6) muaj;
   1.3. për mospërfillje të detyrës zyrtare;
   1.4. nëse nuk mund të kryejnë detyrat e tyre për arsye shëndetësore ose për arsye të tjera të rëndësishme për më shumë se gjashtë (6)muaj;
   1.5. nëse bëhen përherë të paaftë për kryerjen e detyrave të tyre.
2. Anëtarët e Këshillit shkarkohen më herët nga detyrat e tyre dhe pozita e tyre përfundon ditën kur Kuvendi i Kosovës konstaton arsyet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 35
Pavarësia e Mbikëqyrësve

1. Në kryerjen e detyrave të tyre anëtarët e Këshillit veprojnë plotësisht të pavarur në pajtim me këtë ligj, Kushtetutën dhe ligjet tjera relevante. Ata duhet t'i shmangen çfarëdo veprimi të papajtueshëm me detyrat e tyre dhe nuk mund të ushtrojnë asnjë profesion tjetër, qoftë fitimprurës apo jo.
2. Anëtarët e Këshillit duhet të punojnë ngushtë me njëri tjetrin dhe duhet ta ndihmojnë njëri tjetrin në kryerjen e detyrave të tyre.

Neni 36
Organizimi i brendshëm i Agjencisë

1. Në pajtim me ligjin përkatës në fuqi, Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror nxjerr akt nënligjor për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të agjencionit.

2. Në Agjenci mund të caktohen për kryerjen e detyrave ligjore ose punëve ndihmëse, nëpunësit civil të organeve shtetërore në bazë të propozimit të Mbikëqyrësit Kryesor Shtetëror. Gjykatësit apo prokurorët mund të caktohen për kryerjen e detyrave të tilla në pajtim me dispozitat e ligjit për gjykatat dhe prokuroritë.
3. Nëpunësit civil dhe zyrtarët tjerë sipas paragrafit 2 të këtij neni nuk kryejnë inspektime, por ndihmojnë Mbikëqyrësit në përgatitjen dhe kryerjen e inspektimeve të tilla.

Neni 37
Fondet për punën e Agjencisë

1. Agjencia ka buxhetin e saj, i cili administrohet në mënyrë të pavarur, në pajtim me ligj.
2. Fondet për punën e Agjencisë sigurohen nga Buxheti i Kosovës. Buxheti i Agjencisë përcaktohet nga Kuvendi i Kosovës me propozimin e Mbikëqyrësit Kryesor Shtetëror.

Nën-kreu E
Detyrat e Agjencisë

Neni 38
Ofrimi i këshillave për institucionet publike dhe private

1. Agjencia këshillon Kuvendin e Kosovës, Qeverinë, organet e pushtetit lokal, organet e tjera shtetërore dhe ushtruesit e pushtetit publik për të gjitha çështjet lidhur me mbrojtjen e të dhënave duke përfshirë interpretimin dhe zbatimin e ligjeve përkatëse.
2. Agjencia po ashtu këshillon institucionet private për të gjitha çështjet lidhur me mbrojtjen e të dhënave kur kjo kërkohet, duke përfshirë edhe interpretimin dhe zbatimin e ligjeve përkatëse.

Neni 39
Detyrimi për konsultim

Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës duhet ta informojnë Agjencinë me rastin e hartimit të masave legjislative dhe administrative që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale. Agjencia duhet të konsultohet para miratimit të masave të tilla.

Neni 40
E drejta për inicim të procedurave ligjore

1. Agjencia parashtron kërkesë tek Gjykata Kushtetuese e Kosovës për të vlerësuar kushtetutshmërinë e ligjeve, rregulloreve dhe akteve tjera kur konsideron se ato nuk janë në harmoni me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave siç parashihet në nenin 36 të Kushtetutës së Kosovës.
2. Agjencia parashtron padi në gjykatën kompetente, kur konsideron se e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale është shkelur.

Neni 41
E drejta për ankesë

1. Çdo person ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë Agjencisë nëse ai ose ajo konsideron se e drejta e tij ose e saj për mbrojtjen e të dhënave është shkelur.
2. Ankesat mund të parashtrohen gojarisht, me shkrim ose me mjete elektronike.

Neni 42
Shqyrtimi i ankesave

1. Agjencia duhet ta informojë ankuesin menjëherë pas shqyrtimit të ankesës lidhur me rezultatin dhe veprimin e ndërmarrë.
2. Procedura lidhur me ankesat do të rregullohet me akt nënligjor nga Agjencia.

Neni 43
Bashkëpunimi me organet tjera

Agjencia bashkëpunon me organet shtetërore, ndërkombëtare dhe organet e Bashkimit Evropian lidhur me çështjet që konsiderohen të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale.

Nën-kreu F
Publiciteti i punës

Neni 44
Raporti vjetor i punës

1. Agjencia duhet t'i paraqesë Kuvendit të Kosovës raport vjetorë të punës dhe duhet ta publikojë atë, jo më vonë se më 31 mars, të vitit vijues.
2. Raporti vjetor i aktiviteteve jep një pasqyrë të punës së Agjencisë dhe të zhvillimeve në fushën e mbrojtjes së të dhënave në vitin paraprak dhe do të shkoqisë vlerësimet dhe rekomandimet lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 45
Publiciteti lidhur me punën

1. Agjencia mund të publikojë në faqen e saj publike ose në një mënyrë tjetër të duhur:
   1.1. një gazetë të brendshme dhe literaturë profesionale;
   1.2. çdo këshillë të dhënë sipas paragrafit 1 të nenit 38 të këtij ligji, në veçanti nëse ligjet ose rregulloret tjera që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale janë miratuar dhe publikuar në Gazetën Zyrtare;
   1.3. çdo kërkesë nga neni 40 i këtij ligji, pasi që Gjykata Kushtetuese t'i ketë pranuar ato;
   1.4. të gjitha vendimet e Gjykatës Kushtetuese sipas kërkesave nga neni 40 i këtij ligji;

1.5. çdo vendim të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale. Në raste të tilla të dhënat personale lidhur me palët, palët e dëmtuara, dëshmitarët ose ekspertët e përfshirë nuk do të publikohen;
1.6. opinionet rreth pajtueshmërisë së kodeve të etikës profesionale, kushteve të përgjithshme të biznesit ose draft-rregulloreve në fushën e mbrojtjes së të dhënave;
1.7. opinionet, sqarimet dhe qëndrimet për çështjet në fushë të mbrojtjes së të dhënave;
1.8. të gjitha udhëzimet dhe rekomandimet lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale në fushat individuale;
1.9. deklaratat publike për inspektimet e ndërmarra për rastet individuale;
1.10. çdo njoftim tjetër i rëndësishëm.

2. Agjencia mban konferenca të rregullta për media lidhur me punën e saj dhe publikon në faqen publike të tij transkriptet e deklaratave ose regjistrimet e deklaratave apo në ndonjë mënyrë tjetër të duhur. Ajo po ashtu mund të mbajë seminare dhe të organizojë fushata për ngritje të vetëdijes kur kjo konsiderohet si e nevojshme.
3. Agjencia për kryerjen e detyrave të saj mund të inkurajojë bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes së të dhënave me përfaqësues të shoqatave dhe organizatave tjera joqeveritare në fushën e mbrojtjes së të dhënave, privatësisë dhe mbrojtjes së konsumatorit.

Nën-kreu G
Inspektimet dhe Kontrollet

Neni 46
Fushëveprimi i inspektimeve

1. Agjencia me iniciativën e vet mund të kryejë inspektime dhe kontrolle, për të mbikëqyrur pajtueshmërinë me rregullat e mbrojtjes së të dhënave. Në kuadër të kompetencave të inspektimit, Agjencia:
1.1. mbikëqyrë ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale;
1.2. mbikëqyrë përshtatshmërinë e procedurave dhe masave të ndërmarra për sigurinë e të dhënave personale në pajtim me këtë ligj;
1.3. mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të këtij ligji që rregullojnë katalogun e sistemit të dosjeve, regjistrin e sistemit të dosjeve dhe regjistrimet e zbulimit të të dhënave personale tek marrësit;
1.4. mbikëqyrë zbatimin e dispozitave lidhur me transferimin e të dhënave personale tek shtetet tjera dhe organizatat ndërkombëtare.

Neni 47
Kryerja e drejtpërdrejtë e inspektimit

1. Inspektimet dhe kontrollet duhet të kryhen drejtpërdrejt nga Mbikëqyrësit, brenda kufijve të kompetencave të tyre.

2. Mbikëqyrësit gjatë kryerjes së inspektimit dhe kontrollit, duhet të identifikohen me kartelë zyrtare të identifikimit, e cila përmban fotografinë, emrin personal, titullin profesional ose shkencor dhe të dhënat tjera të nevojshme.
3. Me propozim të Agjencisë, Qeveria e Kosovës me akt nënligjor lëshon kartelat zyrtare të identifikimit të Mbikëqyrësve si dhe përcakton në mënyrë të detajuar formën dhe përmbajtjen e tyre.

Neni 48
Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit

1. Gjatë kryerjes së inspektimit dhe kontrollit, mbikëqyrësit kanë të drejtë të:
   1.1. kontrollojnë dhe konfiskojnë çdo dokumentacion që ka të bëjë me përpunimin e të dhënave personale, pavarësisht nga besueshmëria ose fshehtësia e tij, transferimin e të dhënave personale tek shtetet tjera dhe organizatat ndërkombëtare si dhe me zbulimin për marrësit e jashtëm;
   1.2. kontrollojnë përmbajtjen e sistemeve të dosjeve, pavarësisht nga besueshmëria ose fshehtësia e tyre dhe katalogët e sistemit të dosjeve;
   1.3. kontrollojnë dhe konfiskojnë çdo dokumentacion dhe udhëzime që rregullojnë sigurinë e të dhënave personale;
   1.4. kontrollojnë ndërtesën në të cilën të dhënat personale përpunohen dhe kanë të drejtë të kontrollojnë dhe konfiskojnë kompjuterët dhe çfarëdo pajisje tjetër, si dhe dokumentacionin teknik;
   1.5. verifikojnë masat dhe procedurat që kanë për qëllim të sigurojnë të dhënat personale dhe zbatimin e tyre;
   1.6. kryejnë çdo detyrë tjetër që konsiderohet e rëndësishme për kryerjen e inspektimeve dhe kontrolleve të parapara me këtë ligj.

Neni 49
Masat e inspektimit

1. Nëse Mbikëqyrësi vëren shkelje të këtij ligji ose të cilido ligj apo rregulloreje që rregullon përpunimin e të dhënave personale, ai ose ajo kanë të drejtë që menjëherë:
   1.1. të urdhërojë eliminimin e parregullsive ose mangësive që ai ose ajo i vëren, në mënyrën dhe brenda afatit të caktuar më parë nga ai ose ajo. Kjo mund të përfshijë asgjësimin, bllokimin, shkatërrimin, fshirjen ose anonimizimin e të dhënave personale në pajtim me ligjin;
   1.2. të ndalojë përkohësisht dhe në mënyrë të caktuar përpunimin e të dhënave personale nga kontrolluesit dhe përpunuesit në sektorët publik ose privat, të cilët kanë dështuar në zbatimin e masave dhe procedurave të nevojshme për sigurimin e të dhënave personale;
   1.3. të ndalojë përkohësisht dhe në mënyrë të caktuar përpunimin e të dhënave personale, anonimizimin e tyre, klasifikimin dhe bllokimin e të dhënave personale sa herë që ai ose ajo konkludon se të dhënat personale janë duke u përpunuar në kundërshtim me dispozitat ligjore;
   1.4. të ndalojë përkohësisht dhe në mënyrë të caktuar përpunimin e të dhënave

personale në vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare, ose zbulimin e tyre marrësve të huaj nëse ato janë transferuar ose zbuluar në kundërshtim me dispozitat ligjore ose me marrëveshjet ndërkombëtare;

1.5. të paralajmërojë ose këshillojë me shkrim kontrolluesin e të dhënave ose përpunuesin e të dhënave në rastet e shkeljeve të vogla.

2. Në rast të parregullsive ose mangësive kontrolluesi i të dhënave ose përpunuesi i të dhënave duhet që menjëherë t'i korrigjojë ato pas marrjes së udhëzimeve me shkrim ose këshillimit nga Mbikëqyrësi për të siguruar përpunim të ligjshëm të të dhënave.
3. Kundër vendimit përfundimtar të Mbikëqyrësit nga paragrafi 1 të këtij neni, nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikti administrativ në Gjykatën kompetente.

Neni 50
Mbrojtja e fshehtësisë

1. Mbikëqyrësit janë të obliguar që të mbrojnë fshehtësinë e të dhënave personale që hasin gjatë kryerjes së detyrave së tyre, si dhe pas ndërprerjes së ushtrimit të detyrave të tyre.
2. Obligimi nga paragrafi 1 i këtij neni zbatohet ndaj të gjithë punëtorëve që punojnë në Agjenci.

KREU V
TRANSFERIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Nën-kreu H
Transferimi i të dhënave personale tek shtetet tjera dhe organizatat ndërkombëtare

Neni 51
Dispozitat e përgjithshme

Transferimi të dhënave personale të cilat janë përpunuar ose ato që do të përpunohen në vende të tjera dhe tek organizatat ndërkombëtare, mund të bëhet vetëm në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe në qoftë se vendi ose organizata ndërkombëtare në fjalë sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave.

Neni 52
Procedura për përcaktimin e nivelit të duhur për mbrojtjen e të dhënave personale

Vendet dhe organizatat ndërkombëtare konsiderohen se sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave, nëse Agjencia ka marrë një vendim formal, dhe ato vende apo organizata janë përfshirë në listën përkatëse të nxjerrë nga Agjencia në pajtim me këtë ligj.

Neni 53
Lista e vendeve dhe organizatave ndërkombëtare me nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave

1. Agjencia mban një listë të vendeve dhe të organizatave ndërkombëtare për të cilat ajo konstaton se ato sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave, në pajtim me këtë ligj.
2. Lista mund të përmbajë Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian dhe Zonës Ekonomike Evropiane. Ndërsa sa i përket vendeve të tjera Agjencia mund të zbatojë vendimet e marra nga organi kompetent i Bashkimit Evropian nëse vendet e tilla dhe organizatat ndërkombëtare sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave, ose mund të merr një vendim formal sipas nenit 54 të këtij ligji.
3. Agjencia publikon listën nga paragrafi 1 i këtij neni në Gazetën zyrtare dhe faqen publike të saj.

Neni 54
Vendimet për nivelin e duhur të mbrojtjes së të dhënave nga vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare

1. Gjatë marrjes së vendimit të tij lidhur me nivelin e duhur të mbrojtjes së të dhënave personale të një vendi tjetër ose organizate ndërkombëtare, Agjencia detyrohet t'i përcaktojë të gjitha rrethanat që kanë të bëjnë me transferimin e të dhënave personale. Në veçanti, ajo merr parasysh llojin e të dhënave personale, qëllimin dhe kohëzgjatjen e përpunimit të propozuar, rregullimin ligjor në vendin e origjinës dhe në vendin e marrësit, duke përfshirë rregullimin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve të huaj, si dhe masat për sigurimin e të dhënave personale të përdorura në vendet e tilla dhe organizatat ndërkombëtare.
2. Gjatë marrjes së vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni, Agjencia në veçanti merr parasysh:
   2.1. nëse të dhënat personale të transferuara janë përdorur vetëm për qëllimin për të cilin ato janë transferuar, ose nëse qëllimi mund të ndryshojë vetëm në bazë të lejes së kontrolluesit të të dhënave që i siguron të dhënat apo në bazë të pëlqimit personal të subjektit të të dhënave;
   2.2. nëse subjekti i të dhënave ka mundësi të përcaktojë qëllimin për të cilin të dhënat personale të tij ose saj janë përdorur, kujt i janë dërguar ato dhe mundësinë e korrigjimit ose asgjësimit së të dhënave personale të pasakta apo te vjetërsuara, përveç në rastet kur kjo është e ndaluar me marrëveshje ndërkombëtare detyruese për shkak të fshehtësisë së procedurës;
   2.3. nëse kontrolluesi ose përpunuesi i huaj i të dhënave përmbush procedurat dhe masat e duhura organizative dhe teknike për mbrojtjen e të dhënave personale;
   2.4. nëse është caktuar personi kontaktues i autorizuar për ofrimin e informatave subjektit të të dhënave ose Agjencisë për përpunimin e të dhënave personale të transferuara;
   2.5. nëse marrësi i huaj i të dhënave mund të transferojë të dhënat personale vetëm me kusht që marrësi tjetër i huaj i të dhënave të cilit i zbulohen të

dhënat siguron një mbrojtje të duhur të të dhënave personale edhe për shtetasit e huaj;

2.6. nëse është siguruar mbrojtje ligjore efektive për subjektet e të dhënave të dhënat personale të të cilëve janë transferuar apo do të transferohen.

Neni 55
Kriteret për Vendimmarrje

Agjencia përcakton në mënyrë të detajuar se cili informacion është i domosdoshëm për të vendosur nëse shteti tjetër ose organizata ndërkombëtare siguron nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale, siç është paraparë me këtë ligj.

Neni 56
Dispozitat e veçanta

1. Pavarësisht nga neni 51 i këtij ligji, të dhënat personale mund t'i transferohen dhe zbulohen vendit ose organizatës ndërkombëtare që nuk e siguron nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave, nëse:
   1.1. është paraparë me ligj tjetër ose me marrëveshje ndërkombëtare detyruese;
   1.2. subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij ose të saj dhe është i vetëdijshëm për pasojat e transferimit;
   1.3. transferimi është i nevojshme për përmbushjen e kontratës ndërmjet subjektit të të dhënave dhe kontrolluesit të të dhënave ose për zbatimin e masave para-kontraktuese të ndërmarra si përgjigje të kërkesës së subjektit të të dhënave;
   1.4. transferimi është i domosdoshëm për lidhjen ose përmbushjen e një kontrate, të lidhur për interes të subjektit të të dhënave ndërmjet kontrolluesit të të dhënave dhe një pale të tretë;
   1.5. transferimi është i domosdoshëm dhe ligjërisht kërkohet në bazë të rëndësisë së interesit publik;
   1.6. transferimi është i domosdoshëm për të mbrojtur jetën dhe trupin e subjektit të të dhënave;
   1.7. transferimi është i domosdoshëm për themelimin, ushtrimin ose mbrojtjen e kërkesave ligjore;
   1.8. transferimi është kryer nga një regjistër i cili në sipas ligjeve apo rregulloreve ka për qëllim të informojë publikun dhe i cili është i hapur për konsultime qoftë nga publiku në përgjithësi ose nga çdo person i cili mund të shprehë një interes legjitim, për aq sa kushtet e përcaktuara për konsultim në këtë rast të veçantë janë përmbushur.

Neni 57
Autorizimi për transferimin e të dhënave

1. Pavarësisht nga neni 51 i këtij ligji Agjencia mund të autorizojë një transferim ose një sërë transferimesh të të dhënave personale në shtetin tjetër ose një organizate ndërkombëtare e cila nuk siguron një nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave

sipas këtij ligji, në rastet ku kontrolluesi i të dhënave paraqet masat e duhura mbrojtëse për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtave dhe lirive themelore të individëve, sa i përket ushtrimit të të drejtave përkatëse. Masat e tilla mbrojtëse mund të rezultojnë nga dispozitat e kontratës ose nga kushtet e përgjithshme të aktiviteteve biznesore që administrojnë transferimin e të dhënave personale.

2. Kontrolluesi i të dhënave mund të transferojë të dhënat personale vetëm pas marrjes së autorizimit sipas paragrafit 1 të këtij neni. Me kërkesën e tij ose saj për autorizim, kontrolluesi i të dhënave i siguron Agjencisë informacionet e domosdoshme lidhur me transferimin e kërkuar të të dhënave personale. Kjo në veçanti përfshin kategoritë e të dhënave, qëllimin e transferimit dhe masat mbrojtëse në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale në vendin tjetër apo organizatën ndërkombëtare.
3. Agjencia vendosë për kërkesën nga paragrafi 2 i këtij neni pa vonesë dhe përcakton me një akt nënligjor detajet dhe procedurat e brendshme për paraqitjen e kërkesave të tilla. Vendimi i lartë cekur është përfundimtar në procedurën administrative por mund të hapet konflikti administrativ në gjykatën kompetente.

Neni 58
Regjistrimi i autorizimeve

Autorizimet lidhur me transferimin e të dhënave personale në vendin tjetër apo organizatën ndërkombëtare, të dhëna nga Agjencia duhet të regjistrohen në pajtim me nën-paragrafin 1.10 të paragrafit 1 të nenit 17 të këtij ligji.

KREU VI
TË DREJTAT DHE MBIKËQYRJA

Nën-kreu I
Marketingu i drejtpërdrejt

Neni 59
Të drejtat dhe përgjegjësitë e kontrolluesve të të dhënave

1. Kontrolluesit e të dhënave mund të përdorin të dhënat personale që ata i kanë siguruar nga burimet publike të qasshme ose brenda kufijve të kryerjes së ligjshme të aktiviteteve për qëllime të ofrimit të mallrave, shërbimeve, punësimit ose kryerjes së përkohshme të punës përmes përdorimit të shërbimeve postare, thirrjeve telefonike, postës elektronike ose mënyrave tjera të telekomunikimit (më tutje në tekst: marketingu i drejtpërdrejtë) në pajtim me dispozitat e këtij kreu, përveç nëse me ligjin përkatës është paraparë ndryshe.
2. Për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, kontrolluesit e të dhënave mund të përdorin vetëm të dhënat personale të grumbulluara në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni: emrin(at) personal, adresën e vendbanimit të përhershëm ose të përkohshëm, numrin e telefonit, adresën e postës elektronike (e-mail) dhe numrin e faksit. Në bazë të pëlqimit paraprak të subjektit të të dhënave, kontrolluesit e të dhënave mund të përpunojnë të dhëna personale tjera, por të dhënat personale të

ndjeshme mund t'i përpunojnë vetëm nëse ata e posedojnë pëlqimin me shkrim.

3. Kur kontrolluesit e të dhënave kryejnë marketing të drejtpërdrejtë, duhet t'i informojnë subjektet e të dhënave për të drejtat e tyre sipas nenit 60 të këtij ligji.
4. Nëse kontrolluesit e të dhënave kanë për qëllim të zbulojnë të dhëna personale nga paragrafi 2 i këtij neni, tek marrësit e tjerë të të dhënave, për qëllim të marketingut të drejtpërdrejtë, ose tek përpunuesit e të dhënave, ata janë të detyruar që të informojnë subjektin e të dhënave dhe të marrin pëlqimin me shkrim të tij ose të saj para se të zbulohen të dhënat e tilla. Njoftimi për subjektin e të dhënave lidhur me zbulimin në fjalë duhet të përmbajë të gjitha informacionet që synohen të zbulohen si dhe, kujt dhe për çfarë qëllimi. Shpenzimet e njoftimit mbulohen nga kontrolluesi i të dhënave.

Neni 60
E drejta për kundërshtim

1. Subjekti i të dhënave në çdo kohë mund të kërkojë me shkrim që kontrolluesit e të dhënave të ndërpresin në mënyrë të përhershme ose të përkohshme përdorimin e të dhënave personale të tij ose të saj për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë. Brenda tetë (8) ditëve pas pranimit të kundërshtimit nga subjekti i të dhënave, kontrolluesit e të dhënave duhen të ndalojnë përdorimin e të dhënave personale për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë dhe brenda pesë (5) ditëve pasuese ata duhet të informojnë me shkrim subjektin e të dhënave për aprovimin e kërkesës së tyre.
2. Shpenzimet për veprimet e kontrolluesit të të dhënave në lidhje me kërkesën nga paragrafi 1 i këtij neni i bartë kontrolluesi i të dhënave.

Nën-kreu J
Vëzhgimi me kamerë

Neni 61
Dispozitat e përgjithshme

1. Dispozitat e këtij Nën-kreu zbatohen për vëzhgimin me kamerë, përveç kur është paraparë ndryshe me ligj përkatës.
2. Personat në sektorin publik ose privat që kanë për qëllim të instalojnë sistemet e vëzhgimit me kamerë duhet të vendosin njoftimin për këtë. Njoftimi i tillë duhet të jetë i dukshëm dhe të bëhet publik në mënyrë që t'i mundësojë subjekteve të të dhënave që pa vështirësi të njoftohen me masat, më së voni kur vëzhgimi me kamerë fillon.
3. Përmes njoftimit të rregullt nga paragrafi 2 i këtij neni, konsiderohet se subjekti i të dhënave është i informuar lidhur me përpunimin e të dhënave personale në pajtim me nenin 10 të këtij ligji.
4. Sistemi i vëzhgimit me kamerë dhe regjistrimet e vëzhgimit duhet të mbrohen në mënyrë të duhur nga qasja dhe përdorimi i paautorizuar.

Neni 62
Vëzhgimi i ndërtesave zyrtare dhe të biznesit

1. Personat në sektorin publik dhe privat mund të instalojnë sistemet e vëzhgimit me kamerë për vëzhgimin e ndërtesave të tyre nëse konsiderohet e nevojshme për sigurinë e njerëzve dhe sigurimin e pasurisë. Vëzhgimi me kamerë në veçanti mund të jetë i nevojshëm për të vëzhguar hyrjet e ndërtesave, ose ku për shkak të natyrës së punës së tyre ekziston kërcënim potencial ndaj të punësuarve.
2. Vendimet e nevojshme merren nga nëpunësi kompetent, drejtori ose ndonjë person tjetër i autorizuar nga sektori publik ose privat.
3. Vendimi duhet të përmbajë arsyet për vendosjen e sistemeve të vëzhgimit me kamerë.
4. Sistemet e vëzhgimit me kamerë mund të mbikëqyrin pjesën e jashtme dhe hyrjen e ndërtesës, por jo edhe hyrjen dhe brendinë e apartamenteve.
5. Personat që punojnë në ndërtesat publike dhe private nën vëzhgimin me kamerë informohen në mënyrë te duhur në formë të shkruar për instalimin e sistemeve të tilla dhe të drejtat e tyre.
6. Secili kontrollues i të dhënave duhet ta krijojë sistemin e dosjeve për regjistrimin e sistemeve të vëzhgimit me kamerë. Sistemi i dosjeve, veçmas nga regjistrimet (pamjet dhe/ose zëri), përmban datën, vendin, kohën e regjistrimit dhe ku ruhen regjistrimet.
7. Regjistrimet nga paragrafi 6 të këtij neni mund të ruhen deri në gjashtë (6) muaj përveç nëse nuk kërkohet ndryshe për qëllime legjitime.

Neni 63
Mbikëqyrja e ndërtesave me apartamente

1. Për instalimin e sistemeve të vëzhgimit me kamerë në ndërtesën me apartamente, kërkohet pajtimi me shkrim i së paku 70% të pronarëve.
2. Vëzhgimi me kamerë mund të instalohet vetëm nëse kjo është e domosdoshme për sigurinë e njerëzve dhe sigurimin e pronës.
3. Vëzhgimi me kamerë në ndërtesën me apartamente mund të mbikëqyrë vetëm hyrjen dhe hapësirat e përbashkëta. Ndalohet mbikëqyrja me kamerë e apartamentit të shtëpiakut të ndërtesës dhe punëtorisë së tij ose saj.
4. Ndalohet transmetimi i regjistrimeve të vëzhgimeve me kamerë përmes televizionit kabllor të brendshëm, televizionit publik kabllor, internetit ose mjeteve tjera të telekomunikimeve,pa marrë parasysh se a bëhet në kohën e transmetimit apo më vonë.
5. Hyrjet në apartamentet individuale mund të mbikëqyren me sistem të vëzhgimit me kamerë vetëm nëse pronari vendos kështu. Pronari mund t'i mbajë regjistrimet vetëm për nevoja të tij ose të saj.

Neni 64
Vëzhgimi me kamerë në sektorin e punësimit

1. Vëzhgimi me kamerë në hapësirat e punës mund të bëhet vetëm në rastet kur domosdoshmërish kërkohet për sigurinë e njerëzve, sigurimin e pronës dhe ruajtjen e informacioneve konfidenciale nëse ky qëllim nuk mund të arrihet me mjete më të lehta.

2. Vëzhgimi me kamerë duhet të kufizohet rreptësishtë në hapësirat ku interesat nga paragrafi 1 i këtij neni janë të rrezikuara.
3. Vëzhgimi me kamerë ndalohet në hapësirat jashtë vendit të punës, veçanërisht në dhoma të ndërrimit, ashensorë dhe hapësira sanitare.
4. Para instalimit të sistemit të vëzhgimit me kamerë punëdhënësi duhet t'i informojë me shkrim subjektet e të dhënave për të drejtat e tyre dhe arsyet për vëzhgim. Hapësirat e mbikëqyrura duhet të shënohen nga punëdhënësit përmes shenjave të përshtatshme.
5. Para fillimit të instalimit të sistemeve të vëzhgimit me kamerë në sektorët publik ose privat, punëdhënësi i informon përfaqësuesit të sindikatës, nëse është e zbatueshme.
6. Paragrafët 4 dhe 5 të këtij neni nuk zbatohen në hapësirat e mbrojtjes kombëtare, në aktivitetet e sigurisë kombëtare të inteligjencës në vendet ku ruhen të dhënat sekrete.

Nën-kreu K
Përdorimi i karakteristikave biometrike

Neni 65
Përpunimi i karakteristikave biometrike

Përcaktimi dhe përdorimi i karakteristikave biometrike të subjektit të të dhënave dhe krahasimi i tyre për të mundësuar identifikimin e tij ose të saj rregullohet me dispozitat e këtij ligji.

Neni 66
Përdorimi i karakteristikave biometrike në sektorin publik

1. Sektori publik mund të përdor karakteristikat biometrike, vetëm nëse domosdoshmërish kërkohet për sigurinë e njerëzve, sigurimin e pronës ose mbrojtjen e të dhënave konfidenciale dhe sekreteve të biznesit, nëse kjo nuk mund të arrihet me mjete më të lehta.
2. Pavarësisht nga paragrafi1 i këtij neni, përdorimi i karakteristikave biometrike mund të lejohet në pajtim me obligimet që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare detyruese ose për identifikimin e personave që kalojnë kufirin shtetëror.

Neni 67
Kontrolli i qasjes

Karakteristikat biometrike mund të përdoren në sektorin publik për arsyet e kontrollit të qasjes. Në këtë rast dispozitat e paragrafëve 2, 3 dhe 4 të nenit 68 të këtij ligji duhet të zbatohen përshtatshmërish (mutatis mutandis).

Neni 68
Përdorimi i karakteristikave biometrike në sektorin privat

1. Sektori privat mund të përdorë karakteristikat biometrike vetëm nëse kjo është e domosdoshme për kryerjen e aktiviteteve për sigurinë e njerëzve, për sigurimin e pronës ose për mbrojtje të të dhënave konfidenciale ose sekreteve të biznesit. Të punësuarit duhet të informohen paraprakisht në formë të shkruar për përdorimin e karakteristikave të tyre biometrike, rreth masave që do të merren dhe të drejtat e tyre.
2. Nëse nuk është paraparë ndryshe me ligj përkatës, kontrolluesi i të dhënave duhet që para marrjes së masave për përdorimin e karakteristikave biometrike t'i ofrojë Agjencisë përshkrimin e detajuar për masat që do të merren duke përfshirë informacionet që do t'i jepen subjektit të të dhënave, arsyet për marrjen e masave dhe masat mbrojtëse për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Pas marrjes së informacionit nga paragrafi 2 i këtij neni, Agjencia brenda tridhjetë (30) ditësh duhet të vendosë nëse informacioni i marrë lidhur me masat është në pajtim me dispozitat e këtij ligji.
4. Kontrolluesit e të dhënave mund të zbatojnë masat për përdorimin e karakteristikave biometrike, pas marrjes së autorizimit nga Agjencia.
5. Kundër vendimit nga paragrafi 3 i këtij neni nuk lejohet ankesa, por mund të hapet konflikti administrativ në gjykatën kompetente.

Nën-kreu L
Regjistrimet e hyrjes dhe daljes nga ndërtesat

Neni 69
Regjistrimi

1. Organet e sektorit publik dhe privat për arsye të mbrojtjes së sigurisë së njerëzve dhe sigurimit të pronës mund të kërkojnë nga personat që hyjnë ose dalin nga ndërtesat tu japin të dhënat nga paragrafi 2 i këtij neni. Nëse konsiderohet e domosdoshme të dhënat personale mund të verifikohen duke i ekzaminuar dokumentet e identifikimit.
2. Të dhënat e regjistrimit të personave që hyjnë ose dalin nga ndërtesat mund të përmbajnë vetëm këto të dhëna personale: emrin(at) personal, numrin dhe llojin e dokumentit të identifikimit, adresën e përhershme ose të përkohshme, datën dhe kohën si dhe arsyen për hyrje në ndërtesë.
3. Të dhënat nga paragrafi 2 i këtij neni konsiderohen si dokumente zyrtare, nëse grumbullimi i të dhënave kërkohet për qëllime të policisë dhe aktiviteteve të shërbimeve të inteligjencës.
4. Të dhënat personale nga regjistrimet sipas paragrafit 2 të këtij neni mund të ruhen deri në tri (3) vjet nga dita e regjistrimit të tyre dhe pastaj duhet të fshihen ose shkatërrohen, përveç nëse me ligj nuk është paraparë ndryshe.

Nën-kreu M
Librat publikë dhe mbrojtja e të dhënave personale

Neni 70
Librat publikë

Të dhënat personale nga librat publikë të rregulluara me ligjin përkatës mund të përdoren vetëm në pajtim me qëllimin për të cilin janë grumbulluar ose janë përpunuar, nëse qëllimi ligjor për grumbullimin ose përpunimin e tyre është përcaktuar ose është i përcaktueshëm.

Nën-kreu N
Ndërlidhja e sistemeve të dosjeve

Neni 71
Dokumentet zyrtare dhe librat publikë

1. Sistemet e dosjeve nga dokumentet zyrtare dhe librat publikë mund të bashkohen nëse kjo është e paraparë me ligj.
2. Kontrolluesi ose kontrolluesit e të dhënave që synojnë të ndërlidhin dy ose më shumë sisteme të dosjeve që mbahen për qëllime të ndryshme duhet përpara se ta bëjnë këtë ta njoftojnë me shkrim Agjencinë.
3. Nëse të paktën njëri nga sistemet e dosjeve që ndërlidhen përmban të dhëna të ndjeshme ose nëse ndërlidhja do të rezultonte në zbulimin e të dhënave të ndjeshme ose zbatimi i ndërlidhjes kërkon përdorim të kodit ndërlidhës, ndërlidhja nuk do të lejohet pa autorizimin paraprak të Agjencisë.
4. Agjencia mund të autorizojë me vendim ndërlidhjen sipas paragrafit 3 të këtij neni, nëse përcakton se kontrolluesi i të dhënave siguron nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave.
5. Kundër vendimit nga paragrafi 4 i këtij neni, nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikti administrativ në gjykatën kompetente.

Neni 72
Ndalimi i ndërlidhjes së sistemeve të dosjeve

Ndalohet ndërlidhja e sistemeve të dosjeve penale dhe kundërvajtjeve me sistemet e dosjeve të tjera si dhe ndërlidhja e sistemeve në mes të dosjeve penale dhe atyre të kundërvajtjeve.

Neni 73
Dispozitat e posaçme

Të dhënat personale nga sistemet e dosjeve të dokumenteve zyrtare dhe librave publikë duhet të mbahen ndaras në regjistrin e sistemeve të dosjeve.

Nën-kreu O
Zyrtari i Mbrojtjes së të Dhënave

Neni 74
Zyrtari i Mbrojtjes së të Dhënave

1. Të gjitha organet publike që përpunojnë të dhëna personale zgjedhin dhe caktojnë me shkrim një zyrtari të brendshëm të mbrojtjes së të dhënave.
2. Vetëm personat të cilët posedojnë njohuri të specializuara dhe që janë të besueshëm për kryerjen e detyrës në fjalë mund të emërohen si zyrtar për mbrojtjen e të dhënave.
3. Zyrtari i mbrojtjes së të dhënave është në vartësi të kryesuesit të organit publik. Ai ose ajo nuk do të pësojë asnjë dëm gjatë kryerjes së detyrave të tij ose të saj.
4. Zyrtari i mbrojtjes së të dhënave është i detyruar të mbajë fshehtësinë e të dhënave personale, me të cilat ai ose ajo njoftohet gjatë kryerjes së detyrave të tij ose të saj.
5. Organi publik ndihmon zyrtarin e mbrojtjes së të dhënave në kryerjen e detyrës së tij ose të saj dhe duhet në veçanti në masë të nevojshme t'i vejë në dispozicion pajisjet dhe kapacitet tjera.
6. Nëse zyrtari i mbrojtjes së të dhënave nuk i përmbush më tutje kushtet e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, ai ose ajo shkarkohet nga detyra e tij ose e saj.

Neni 75
Detyrat e zyrtarit të mbrojtjes së të dhënave

1. Zyrtari i mbrojtjes së të dhënave ndihmon organin publik në sigurimin se rregullat përkatëse për mbrojtjen e të dhënave janë në mbikëqyrje dhe zbatohen në mënyrën e duhur. Për këtë qëllim ai ose ajo mund ta konsultojë në çdo kohë Agjencia.
2. Zyrtari i mbrojtjes së të dhënave në mënyrë të rregullt mbikëqyrë përdorimin e duhur të programeve për përpunimin e të dhënave dhe masave e procedurave të vendosura për të garantuar përpunim të sigurt të të dhënave.
3. Zyrtari i mbrojtjes së të dhënave rregullisht i informon të gjithë personat e punësuar nga organin publik në përpunimin e të dhënave personale, me rregullat dhe dispozitat përkatëse. Ai ose ajo po ashtu rregullisht i informon të gjithë punonjësit për të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas këtij ligji dhe rreth zhvillimeve në fushën e mbrojtjes së të dhënave.

Neni 76
Kontrolli

1. Zyrtari i mbrojtjes së të dhënave mund të kryejë kontrolle me vetiniciativë.
2. Zyrtari i mbrojtjes së të dhënave ka të drejtë të konsultojë, të heq, të transkriptojë ose të kopjojë të dhënat personale të cilat i ndesh gjatë kontrolleve. Ai ose ajo është i/e detyruar të respektojë fshehtësinë e të dhënave personale.
3. Zyrtari i mbrojtjes së të dhënave duhet t'i raportojë me shkrim kryesuesit të organit publik për rezultatet e kontrollit.

Neni 77
Informimi i subjektit të të dhënave

1. Gjatë kryerjes së kontrolleve, zyrtari i mbrojtjes së të dhënave mund ta lajmërojë me shkrim subjektin e të dhënave lidhur me kryerjen e detyrave të tij ose të saj. Ai ose ajo po ashtu mund ta informojë subjektin e të dhënave se do t'i ofrojë organit publik opinionin lidhur me kontrollin.
2. Subjekti i të dhënave nga paragrafi 1 i këtij neni mund t'i zbulojë zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave, informacione shtesë që mund të jenë të nevojshme për kryerjen e kontrollit.

Neni 78
Të dhënat personal të ndjeshme

Nëse gjatë kryerjes së kontrollit janë përpunuar të dhënat personale të ndjeshme, zyrtari i mbrojtjes së të dhënave bën një shënim zyrtar në dosjen e subjektit të të dhënave.

KREU VII
DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 79
Shkeljet e përgjithshme të dispozitave të këtij ligji

1. Personi juridik ose personi që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej katërmijë (4.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro, nëse:
   1.1. përpunon të dhëna personale pa bazë ligjore ose pëlqimin personal të subjektit të të dhënave sipas paragrafit 1 të nenit 3 dhe paragrafit 1 të nenit 5 të këtij ligji;
   1.2. ia beson një detyrë individuale që ka të bëjë me përpunimin e të dhënave personale një person tjetër pa lidhur kontratë me shkrim në pajtim me paragrafin 2 të nenit 15 të këtij ligji;
   1.3. përpunon të dhëna personale të ndjeshme në kundërshtim me nenin 6 të këtij ligji, ose nuk i mbron ato në pajtim me nenin 7 të këtij ligji;
   1.4. përpunon të dhënat personale në kundërshtim me nenin 10 të këtij ligji;
   1.5. grumbullon të dhënat personale për qëllime që nuk janë të definuara në mënyrë të qartë dhe të paligjshme, ose nëse vazhdon ti përpunojë ato në kundërshtim me nenin 5 të këtij ligji;
   1.6. e pajisë marrësin e të dhënave me të dhëna personale, në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 9, nëse nuk i asgjëson të dhënat personale në pajtim me paragrafin 3 të nenit 9 ose nuk i publikon rezultatet e përpunimit në pajtim me paragrafin 4 të nenit 9 të këtij ligji;
   1.7. nuk informon subjektin e të dhënave për përpunimin e të dhënave personale në pajtim me nenin 10 të këtij ligji;
   1.8. përdor kodin e njëjtë lidhës në kundërshtim me nenin 11 të këtij ligji;
   1.9. nuk i asgjëson, shkatërron, bllokon ose nuk i bën anonime të dhënat

personale atëherë kur qëllimi për të cilin janë mbledhur dhe/ose përpunuar është arritur në pajtim me paragrafin 5 të nenit 3 të këtij ligji;

1.10. vepron në kundërshtim me nenin 12 të këtij ligji;
1.11. dështon të sigurojë se katalogu i sistemit të dosjeve përmban informacione të garantuara me nenin 17 të këtij ligji;
1.12. dështon të njoftojë Agjencinë për informacionet lidhur me regjistrin të sistemeve të dosjeve sipas nenit 18 të këtij ligji;
1.13. vepron në kundërshtim me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 22 ose paragrafët 2, 3 ose 5 të nenit 23 të këtij ligji;
1.14. vepron në kundërshtim me nenin 24 ose paragrafin 2 ose 5 të nenit 25 të këtij ligji;
1.15. vepron në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 52 ose në kundërshtim me nenin 56 të këtij ligji transferon të dhënat personale tek vendet tjera apo organizatat ndërkombëtare.

2. Personi përgjegjës i personit juridik ose i personit që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej pesëqind (500) deri në dymijë (2.000) Euro, për shkeljet nga nën-paragrafi 1.15, paragrafi 1 i këtij neni.
3. Personi përgjegjës i organit shtetëror dënohet për kundërvajtje me gjobë prej pesëqind (500) deri në dymijë (2.000) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.
4. Individi dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dyqind (200) deri në tetëqind (800) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 80
Shkelja e dispozitave për përpunimin kontraktues

1. Personi juridik ose personi që ushtron veprimtari të pavarur, dënohet për kundërvajtje me gjobë prej katërmijë (4.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro, nëse tejkalon autorizimin e shprehur në kontratë nga paragrafi 2 i nenit 15 të këtij ligji ose nuk i kthen të dhënat personale në pajtim me paragrafin 4 të nenit 15 të këtij ligji.
2. Personi përgjegjës i personit juridik ose i personit që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej pesëqind (500) deri në dymijë (2.000) Euro për shkeljet nga paragrafi 1 i këtij neni.
3. Personi përgjegjës i organit shtetëror dënohet për kundërvajtje me gjobë prej pesëqind (500) deri në dymijë (2.000) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.
4. Individi dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dyqind (200) deri në tetëqind (800) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 81
Shkelja e dispozitave për sigurinë e të dhënave personale

1. Personi juridik ose personi që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej katërmijë (4.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro, nëse gjatë përpunimit të të dhënave personale dështon të garantojë nivel duhur për sigurimin e mbrojtjes së të dhënave personale sipas neneve 14 dhe 16 të këtij ligji.
2. Personi përgjegjës i personit juridik ose i personit që ushtron veprimtari të pavarur

dënohet për kundërvajtje me gjobë prej pesëqind (500) deri në dymijë (2.000) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.
3. Personi përgjegjës i organit shtetëror dënohet për kundërvajtje me gjobë prej pesëqind (500) deri në dymijë (2.000) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.
4. Individi dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dyqind (200) deri në tetëqind (800) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 82
Shkelja e dispozitave për marketingun e drejtpërdrejtë

1. Personi juridik ose personi që ushtron veprimtari të pavarur dënohet, për kundërvajtje me gjobë prej dymijë (2.000) deri në katërmijë (4.000) Euro nëse në pajtim me këtë ligj përpunon të dhënat personale për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë dhe nuk vepron në pajtim me nenet 59 ose 60 të këtij ligji.
2. Personi përgjegjës i personit juridik ose i personit që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej katërqind (400) deri në njëmijë (1.000) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.
3. Individi dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dyqind (200) deri në tetëqind (800) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 83
Shkelja e dispozitave të përgjithshme për vëzhgimin me kamerë

1. Personi juridik ose personi që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej katërmijë (4.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro nëse:
   1.1. nuk publikon njoftimin në mënyrën e paraparë në paragrafin 2 të nenit 61 të këtij ligji;
   1.2. njoftimi nuk përmban informacionet e domosdoshme nga paragrafi 3 i nenit 61 të këtij ligji;
   1.3. nuk mbron sistemin e vëzhgimit me kamerë dhe regjistrimet që përdoren për të kryer vëzhgimin me kamerë në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 61 të këtij ligji.
2. Personi përgjegjës i personit juridik ose personit që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej tetëqind (800) deri në njëmijë (1.000) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.
3. Personi përgjegjës i organit shtetëror dënohet për kundërvajtje me gjobë prej pesëqind (500) deri në dymijë (2.000) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.
4. Individi dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dyqind (200) deri në tetëqind (800) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 84
Shkelja e dispozitave për vëzhgimin me kamerë lidhur me qasjen në ndërtesat zyrtare dhe të biznesit

1. Personi juridik ose personi që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej katërmijë (4.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro nëse:

1.1. i zbaton sistemet e vëzhgimit me kamerë pa një vendim të nevojshëm me shkrim ose pa ndonjë bazë ligjore nga neni 62 të këtij ligji;
1.2. i zbaton sistemet e vëzhgimit me kamerë me qëllim të vëzhgimit të brendësisë së ndërtesave në kundërshtim me paragrafi 4 i nenit 62;
1.3. nuk ka informuar të punësuarit me shkrim nga paragrafi 5 i nenit 62;
1.4. ruan të dhënat personale në kundërshtim me paragrafin 7 të nenit 62 të këtij ligji.

2. Personi përgjegjës i personit juridik ose personit që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej pesëqind (500) deri në dymijë (2.000) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.
3. Personi përgjegjës i organit shtetëror dënohet për kundërvajtje me gjobë prej pesëqind (500) deri në dymijë (2.000) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni..
4. Individi dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dyqind (200) deri në tetëqind (800) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 85
Shkelja e dispozitave për vëzhgimin me kamerë në ndërtesat me apartamente

1. Personi juridik ose personi që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dymijë (2.000) deri në tetëmijë (8.000) Euro nëse zbaton sistemet për vëzhgimin me kamerë në kundërshtim me nenin 63 të këtij ligji.
2. Personi përgjegjës i personit juridik ose personit që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej katërqind (400) deri në njëmijë (1.000) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.
3. Personi përgjegjës i organit shtetëror dënohet për kundërvajtje me gjobë prej tetëqind (800) deri në njëmijë (1.000) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.
4. Individi dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dyqind (200) deri në katërqind (400) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 86
Shkelja e dispozitave për vëzhgimin me kamerë në hapësirat e punës

1. Personi juridik ose personi që ushtron veprimtari të pavarur dënohet me gjobë prej katërmijë (4.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro nëse zbaton sistemet e vëzhgimit me kamerë në hapësirat e punës në kundërshtim me nenin 64 të këtij ligji.
2. Personi përgjegjës i personit juridik ose personit që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej njëmijë (1.000) deri në dymijë (2.000) Euro nga paragrafi 1 i këtij neni.
3. Personi përgjegjës i organit shtetëror dënohet për kundërvajtje me gjobë prej njëmijë (1.000) deri në dymijë (2.000) Euro nga paragrafi 1 i këtij neni.
4. Individi dënohet me gjobë prej tetëqind (800) deri në njëmijë (1.000) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 87
Shkelja e dispozitave për karakteristikat biometrike në sektorin publik

1. Personi juridik ose personi që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej katërmijë (4.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro nëse zbaton masat biometrike në kundërshtim me nenin 66 të këtij ligji.
2. Personi përgjegjës i personit juridik ose personit që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej njëmijë (1.000) deri në dymijë (2.000) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.
3. Personi përgjegjës i organit shtetëror dënohet me gjobë prej njëmijë (1.000) deri në dymijë (2.000) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 88
Shkelja e dispozitave për karakteristikat biometrike në sektorin privat

1. Personi juridik ose personi që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej katërmijë (4.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro nëse zbaton masat biometrike në kundërshtim me nenin 68 të këtij ligji.
2. Personi përgjegjës i personit juridik ose personit që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej njëmijë (1.000) deri në dymijë (2.000) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 89
Shkelja e dispozitave për regjistrimet e hyrjes dhe daljes nga ndërtesa

1. Personi juridik ose personi që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dymijë (2.000) deri në katërmijë (4.000) Euro:
   1.1. nëse shfrytëzon regjistrimet e hyrjes dhe daljes nga ndërtesa si dokumente zyrtare në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 69 të këtij ligji;
   1.2. nëse vepron në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 69 të këtij ligji.
2. Personi përgjegjës i personit juridik ose personit që ushtron veprimtari të pavarur dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dyqind (200) deri në tetëqind (800) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.
3. Personi përgjegjës i organit shtetëror dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dyqind (200) deri në tetëqind (800) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.
4. Individi dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dyqind (200) deri në tetëqind (800) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 90
Shkelja e dispozitave për ndërlidhjen e sistemeve të dosjeve

1. Personi përgjegjës i organit shtetëror dënohet për kundërvajtje me gjobë prej tetëqind (800) deri në dymijë (2.000) Euro i cili ndërlidh sistemet e dosjeve në kundërshtim me nenin 71 të këtij ligji.
2. Personi përgjegjës i organit shtetëror dënohet për kundërvajtje me gjobë prej tetëqind (800) deri në dymijë (2.000) Euro nëse ndërlidhë sistemet e dosjeve nga

evidenca penale ose evidencat e kundërvajtjeve me sistemet e dosjeve tjera, ose ndërlidh sistemet e dosjeve nga evidencat penale me sistemin e dosjeve nga evidenca e kundërvajtjeve sipas nenit 72 të këtij ligji.

Neni 91
Shkelja e dispozitave për mbikëqyrjen nga eksperti

1. Personi juridik dënohet për kundërvajtje me gjobë prej katërmijë (4.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro:
   1.1. nëse kryen kontrollin në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 76 të këtij ligji;
   1.2. nëse nuk mban një shënim ose regjistrime tjera sipas nenit 78 të këtij ligji.
2. Personi përgjegjës i personit juridik dënohet për kundërvajtje me gjobë prej tetëqind (800) deri njëmijë (1.000) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.
3. Personi përgjegjës i organit shtetëror dënohet për kundërvajtje me gjobë prej njëmijë (1.000) deri në dymijë (2.000) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.
4. Individi dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dyqind (200) deri tetëqind (800) Euro për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni.

KREU VIII
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 92
Përgjegjësitë tjera

Shqiptimi i dispozitave ndëshkuese, sipas këtij ligji, nuk përjashton përgjegjësitë tjera në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, në veçanti përgjegjësinë e kontrolluesve dhe përpunuesve të të dhënave për dëmet që rrjedhin nga përpunimi i paligjshëm.

Neni 93
Tarifat

Tarifat për njoftimet dhe autorizimet sipas këtij ligji do të rregullohen me akt nënligjor nga Agjencia.

Neni 94
Aktet nënligjore

Për zbatimin e këtij ligji, Agjencia mund të nxjerr edhe akte të tjera nënligjore.

Neni 95
Shfuqizimi

Ky ligj shfuqizon pjesën shtatë të Ligjit nr. 02/L-23 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike.

Neni 96
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-172
29 prill 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-020-2010, datë 13.05.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 70 / 31 MAJ 2010

LIGJI Nr. 03/L-142
LIGJI PËR RENDIN DHE QETËSINË PUBLIKE

Përmbajtja

Kreu I: Dispozita të përgjithshme 411
Kreu II: Kundërvajtjet kundër rendit dhe qetësisë publike 412
Kreu III: Sekuestrimi i mjeteve 416
Kreu IV: Dispozitat përfundimtare 416

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65.1 te Kushtetutës së Republikës se Kosovës,

Më qëllim te vendosjes se rregullave ligjore për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike.

Miraton

LIGJI PËR RENDIN DHE QETËSINË PUBLIKE

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllim i këtij ligji është rregullimi i sjelljes personale në mënyrë që të ruhet rendi dhe qetësia publike.

Neni 2
Fushëveprimi

Fushëveprimi i këtij ligji është ruajtja e rendit dhe qetësisë publike, duke përcaktuar kundërvajtjet kundër rendit dhe qetësisë publike, si dhe duke paraparë ndëshkimet për kryerjen e kundërvajtjeve.

Neni 3
Përkufizimet

1. Termat e përdorur në këtë ligj kanë këtë domethënie:
   "Rendi dhe qetësia publike" nënkupton respektimin e sistemit ligjor dhe të institucioneve publike nga ana e qytetarëve, si dhe mbrojtjen e interesit ligjor dhe

të lirive të personit.
"Vendi publik" nënkupton çdo hapësirë të mbyllur apo të hapur, qoftë private apo publike, ku qytetarët kanë qasje nga e drejta apo në bazë të ndonjë ftese, të shprehur apo që nënkuptohet, qoftë me apo pa pagesë në të holla, por jo edhe vendet që përdoren vetëm nga një apo më shumë persona për tubime private ose për qëllime tjera personale.
"Hapësira private" nënkupton pronën me mundësi për të hyrë me lejen e pronarit, poseduesit apo personit tjetër të autorizuar.
"Rrahja" nënkupton konfrontimin fizik në mes të dy apo më shumë personave, në përpjekje për t'i shkaktuar lëndime njëri tjetrit.
"Prostitucioni" nënkupton kryerjen e akteve seksuale për përfitime materiale, me të holla ose me ndonjë vlerë tjetër ekuivalente;
"Person zyrtar" nënkupton personin e zgjedhur ose të caktuar në një organ publik apo personin e autorizuar në një organizatë afariste ose në ndonjë tjetër person juridik, i cili në saje të ligjit apo të ndonjë dispozite tjetër të nxjerrë në përputhje me ligjin, ushtron funksione publike dhe i cili brenda këtyre funksioneve ushtron detyra të veçanta, bazuar në autorizimet që ka në bazë të ligjit.
"Zhurma" është tingulli (zëri) i lartë dhe i padëshirueshëm.
"Organi Kompetent" nënkupton Ministria e Punëve te Brendshme.

KREU II
KUNDËRVAJTJET KUNDËR RENDIT DHE QETËSISË PUBLIKE

Neni 4
Sjellja arrogante

1. Kushdo që ne vend publik, nxitë ose merr pjesë në përleshje dënohet për kundërvajtje, përveç atëherë kur paraqet vepër penale.
2. Kryesi i kundërvajtjes nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me gjobë prej pesëdhjetë (50) Euro deri shtatëqind (700) Euro apo me dënimin me burg deri në pesëdhjetë (50) ditë.
3. Nëse kundërvajtja e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, kryhet ndaj personave zyrtar ose personave tjerë që mbrojnë rendin dhe qetësinë publike sipas ligjit në fuqi për tubimet publike, ai/ajo do të dënohet me gjobë prej njëqindepesëdhjetë (150) deri nëntëqind (900) Euro apo me dënimin me deri në gjashtëdhjetë (60) ditë.

Neni 5
Sulmi verbal

1. Kushdo që ne vend publik përdorë fjalë ofenduese, me qëllim që të provokoj prishjen e rendit dhe qetësisë publike, dënohet për kundërvajtje.
2. Kryesi i kundërvajtjes nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me gjobë prej tridhjetë (30) deri pesëqind (500) Euro apo me dënimin me burg deri në dyzet (40) ditë.
3. Nëse kundërvajtja e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, kryhet ndaj personave zyrtar ose personave që mbrojnë rendin dhe qetësinë publike sipas ligjit të në fuqi për tubimet publike, ai/ajo do te dënohet me gjobë prej njëqind (100) deri shtatëqind (700) Euro apo me dënimin me burg deri në pesëdhjetë (50) ditë.

Neni 6
Sjelljet e pa hijshme seksuale

1. Kushdo që në vend publik kryen ndonjë akt seksual, ose ekspozon ndonjë pjesë intime te trupit apo bën ndonjë sjellje të pahijshme seksuale që shkakton shqetësim te qytetarët, dënohet për kundërvajtje.
2. Kryesi i kundërvajtjes nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me gjobë prej njëqind (100) deri shtatëqind (700) Euro apo me dënimin me burg deri në pesëdhjetë (50) ditë.

Neni 7
Marrja me Prostitucion

1. Kushdo që përfshihet në një akt seksual të prostitucionit, dënohet për kundërvajtje.
2. Kryesi i kundërvajtjes nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me gjobë prej njëqind (100) deri nëntëqind (900) Euro apo me dënimin me burg deri në gjashtëdhjetë (60) ditë.

Neni 8
Bezdisjet Publike - Shkeljet që kanë të bëjnë me zhurmën

1. Kushdo që shkakton zhurmë të pa nevojshme dhe të padurueshme që dëgjohet të banorët për rreth apo në rrugë dhe që shqetësojnë personat tjerë nga ora 22:00 e deri në orën 07:00 gjatë ditëve të javës dhe prej orës 23:00 e deri ne orën 07:00 të shtunave dhe të dielave, dënohet për kundërvajtje.
2. Nëse kundërvajtjet nga paragrafët 1 të këtij neni janë kryer nga personi fizik, ai /ajo dënohet me gjobë prej tridhjetë (30) deri pesëqind (500) Euro.
3. Nëse kundërvajtjet e parapara në paragrafin 1 të këtij neni janë kryer nga pronari ose personi përgjegjës i një subjekti juridik, ai/ajo dënohet me gjobë prej njëqindepesëdhjetë (150) deri shtatëqind (700) Euro.

Neni 9
Dehja në vend publik

1. Kushdo që shfaqet në vend publik dukshëm i dehur ose nën ndikim të substancave të kontrolluara (narkotike), jo te përdorura sipas terapisë dhe vë në rrezik veten, personat tjerë ose pasurinë dënohet për kundërvajtje.
2. Kryesi i kundërvajtjes nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me gjobë prej tridhjetë (30) deri pesëqind (500) Euro apo me dënimin me burg deri në tridhjetë (30) ditë.

Neni 10
Kërkimi i lëmoshës në vend publik

1. Kushdo që në vend publik kërkon lëmoshë në mënyrë të bezdisshme dënohet për kundërvajtje.
2. Kryesi i kundërvajtjes nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me gjobë prej tridhjetë (30) deri pesëqind (500) Euro.

Neni 11
Ekspozimi i materialit të turpshëm dhe ofendues

1. Kushdo që shpërndan ose ekspozon ndonjë shkrim, shenje, ose paraqitjeje tjetër të dukshme e cila ofendon ose turpëron dikë, me qëllim që të nxis prishjen e qetësisë dënohet për kundërvajtje.
2. Kryesi i kundërvajtjes nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me gjobë prej njëqind (100) deri tetëqind (800) Euro apo me dënimin me burg deri në dyzet (40) ditë.

Neni 12
Mbikëqyrja e shkujdesur e shtazëve

1. Kushdo që në vend publik mbanë ose ka shtazë pa mbikëqyrje ose pa mjetet e duhura mbrojtëse, dënohet për kundërvajtje.
2. Kryesi i kundërvajtjes të paraparë në paragrafin 1 të këtij neni dënohet me gjobë prej pesëdhjetë (50) deri pesëqind (500) Euro.

Neni 13
Mbrojtja e të miturve

1. Pronari ose personi përgjegjës i një veprimtarie afariste, i cili lejon të miturin nën moshën 16 vjeçare, që pa shoqërimin e prindërve ose kujdestarit, të hyjë dhe/ose qëndrojë ne një lokal afarist, në të cilin prej orës 22:00 deri në ora 07:00 shërbehen pije alkoolike, do të dënohet për kundërvajtje:
2. Kryesi i kundërvajtjes se paraparë në paragrafin 1 të këtij Neni, do të dënohet me gjobë prej pesëdhjetë (50) deri shtatëqind (700) Euro apo me dënimin me burg deri në dyzet (40) ditë.

Neni 14
Lajmërimi i rrejshëm

1. Kushdo qe me dashje shkakton alarmim të rrejshëm lidhur me zjarrin apo ndonjë emergjencë tjetër tek ndonjë organ i emergjencave dënohet për kundërvajtje.
2. Kushdo që me dashje shkakton panik në tubime publike, duke lajmëruar rrejshëm për alarm nga zjarri dhe për kërcenim me bombë, do të dënohet për kundërvajtje.
3. Kryerësi i kundërvajtjes të paraparë në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, dënohet me gjobë prej tridhjetë (30) deri pesëqind (500) Euro apo me dënimin me burg deri në tridhjetë (30) ditë.

Neni 15
Krijimi i rrethanave te rrezikshme

1. Kushdo që vendos ndonjë send apo pajisje përpara ndërtesës, murit mbrojtës apo murit të jashtëm me të cilën mund të shkaktoj lëndime fizike tek këmbësorët dënohet për kundërvajtje.
2. Kushdo që hedh në rrugë sendin ose mjetin ose vendos sende tjera në vend të pasigurt në ballkonin ose në pjesën e jashtme(prag) të dritares të cilat mund të lëndojnë kalimtarin ose i shkakton ndonjë dëm material personit tjetër, dënohet për kundërvajtje.

3. Personi fizik, pronari i biznesit apo personi përgjegjës i tij i cili nuk ndërmerr masat e nevojshme për ta mbyllur apo siguruar pusin(bunarin), gropën, kanalin, instalimet elektrike dhe pajisjet tjera të cilat paraqesin rrezik për këmbësorët dënohet për kundërvajtje.
4. Nëse kundërvajtjet nga paragrafët 1 deri 3 të këtij neni janë kryer nga personi fizik, ai /ajo dënohen me gjobë prej tridhjetë (30) deri pesëqind (500) Euro apo me dënimin me burg deri në tridhjetë (30) ditë.
5. Nëse kundërvajtja nga paragrafi 1 deri në paragrafin 3 të këtij neni është bërë nga pronari i një subjekti juridik apo i autorizuari i tij, ai/ajo dënohet me gjobë prej njëqindepesëdhjetë (150) deri tetëqind (800) Euro apo me dënimin me burg deri në dyzet (40) ditë.

Neni 16
Mospërfillja e urdhrave te ligjshëm

1. Kushdo që me dashje nuk përfill urdhrin e ligjshëm të zyrtarit lidhur me rendin dhe qetësinë publike dënohet për kundërvajtje.
2. Individi, pronari ose ndonjë person përgjegjës i një veprimtarie ekonomike, i cili nuk e zbaton urdhrin e ligjshëm te ndonjë përfaqësuesi zyrtar nga kompania për ujë, rrymë elektrike apo nxehje, për ta ç'kyqur përkohësisht nga rrjeti elektrik, i ujit apo i nxehjes, duke rrezikuar kështu qytetaret, apo nuk e zbaton urdhrin e ligjshëm te përfaqësuesit zyrtar te kompanisë elektrike, te ujit apo nxehjes, për ta rikyçur në shërbimet e përmendura më sipër, do të gjobitet për kundërvajtje.
3. Nëse kundërvajtja nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer nga personi fizik, ai /ajo dënohen me gjobë prej njëqind (100) deri shtatëqind (700) Euro apo me dënimin me burg deri në dyzet (40) ditë.
4. Nëse kundërvajtjet e parapara në paragrafin 1 të këtij neni janë kryer nga pronari ose personi përgjegjës në kuadër të një subjekti juridik, ai/ajo dënohet me gjobë prej njëqindepesëdhjetë (150) deri tetëqind (800) Euro apo me dënimin me burg deri në gjashtëdhjetë (60) ditë.

Neni 17
Vandalizmi

1. Kushdo që me dashje, paramendim, apo me qëllim të keq shkakton dëm apo shkatërron strukturën apo përmbajtjen (brendinë) e pronës publike ose private dënohet për kundërvajtje.
2. Kryesi i kundërvajtjeve të parapara në paragrafin 1 te këtij neni dënohet me gjobë prej njëqind (100) deri nëntëqind (900) Euro apo me dënimin me burg deri në gjashtëdhjetë (60) ditë.

Neni 18
Mos mbikëqyrja e të miturit

1. Nëse kundërvajtja është kryer si pasojë e dështimit të mbikëqyrjes së fëmiut nga ana e prindit apo kujdestarit të fëmiut që ka kryer veprën e kundërvajtjes, sipas këtij ligji prindi apo kujdestari dënohet për kundërvajtje.

2. Kryesi i kundërvajtjes nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me gjobë prej pesëdhjetë (50) deri katërqindepesëdhjetë (450) Euro.

KREU III
SEKUESTRIMI I MJETEVE

Neni 19
Sekuestrimi i mjeteve dhe sendeve

1. Organi kompetent mundet menjëherë ta sekuestroj mjetin ose sendin e përdorur, të përfituar ose mjetin përkatësisht sendin që do të përdoret për kryerjen e kundërvajtjes edhe në rast se kryesi i kundërvajtjes nuk është pronari i pasurisë së sekuestruar.
2. Organi kompetent mund të sekuestroj mjetet ose sendet deri në marrjen e vendimit të plotfuqishëm nga ana e gjykatës kompetente.

KREU IV
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 20
Mbikëqyrja

Për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, përgjegjëse është Ministria e Punëve të Brendshme.

Neni 21
Shfuqizimi

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji mbi Rendin dhe Qetësinë Publike (“Gazeta Zyrtare”) e KSAK Nr. 23/81.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-142
17 shtator 2009

Shpallur me dekretin Nr. DL-027-2009, datë 13.10.2009 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI IV / Nr. 59 / 29 TETOR 2009

LIGJI Nr. 03/L-118
PËR TUBIMET PUBLIKE

Përmbajtja

Kreu I..... 417
Kreu II 424

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Më qëllim të vendosjes se rregullave ligjore për organizimin e tubimeve publike, respektimit të fjalës së lirë dhe procedurën e lajmërimit, kufizimit apo ndalimin e tubimeve publike,

Miraton

LIGJIN PËR TUBIMET PUBLIKE

KREU I

Neni 1
Dispozitat e përgjithshme

Me këtë ligj rregullohet e drejta për tubime publike, e fjalës së lirë në tubime publike, protestave, manifestimeve publike, koha dhe mënyra e lajmërimit, detyrat dhe përgjegjësitë e organizatorëve.

Neni 2
Përkufizimet

Përkufizimet e përdora në këtë ligj kanë kuptimin si vijon:
“Tubimet publike” janë tubime te hapura te qytetarëve të organizuara nga grupe, entitete, OJQ, subjekte politike etj, në te cilat festohet, jepen shfaqje apo shprehet brenga dhe pakënaqësia për çështje të ndryshme.
"Vende publike" konsiderohen sheshet, bulevardet, rrugët dhe çdo mjedis tjetër që shfrytëzohet lirisht për lëvizjet e qytetarëve dhe të automjeteve.
“Vende të hapura për publikun” janë vende në dispozicion për qytetarët që nën kushte të caktuara mund të marrin lejen për të hyrë.
“Organizator" është personi juridik ose fizik që organizon tubimin dhe persona të tjerë që japin ndihmesë në zhvillimin e tij.

“Kujdestarët” janë persona që caktohen nga organizatori i tubimit publik për mbajtjen e rendit dhe të qetësisë, gjatë kohës sa zgjatë tubimi publik dhe kanë shenja dalluese.
“Dhunë” është dhuna e ushtruar nga një grup i konsiderueshëm pjesëmarrësish e jo nga individët e veçantë, kundër njerëzve ose objekteve tjera.
“Protesta” nënkupton kundërshtimin e vendosur për një padrejtësi a për një veprim te paligjshëm, shprehje e mospajtimit në diçka në mënyrë të prerë.
“**Demonstrata**” nënkupton manifestimin e masave popullore nëpër rrugë e sheshe për të shprehur haptas një kërkesë politike, ekonomike a shoqërore, për të kundërshtuar diçka.

Neni 3
E drejta dhe llojet e tubimeve publike

1. Çdo qytetar i Republikës se Kosovës pa asnjë dallim gjinie, race, ngjyre, gjuhe, besimi, përkatësisë nacionale, gjendjes ekonomike e financiare, arsimore e sociale, të bindjeve politike, ose të çdo lloj rrethane tjetër vetjake, ka të drejtë të organizoj dhe të marr pjesë në tubimet publike**,** sipas rregullave të përcaktuara me këtë ligj.
2. “Llojet e tubimeve publike sipas këtij ligji konsiderohen të gjitha ato tubime të qeta si në vijim”.
   2.1. tubimet;
   2.2. manifestimet;
   2.3. parakalimet;
   2.4. protesta;
   2.5. kremtime publike;
   2.6. përkujtime të qeta;
   2.7. manifestime dhe organizime të natyrave të ngjashme në të cilat pjesëmarrësit shprehin lirisht dhe në mënyrë paqësore pikëpamjet e tyre për çështjet që u interesojnë;
   2.8. demonstrata.

3. Tubimet publike konsiderohen edhe ato të shfaqjeve kulturore, humanitare, sportive, fetare, the argëtuese.

Neni 4
Kufizimet dhe ndalimet e tubimeve publike

1. Me këtë ligj rregullohen tubimet publike, caktohen kufizime apo ndalohen tubimet publike kur ato rrezikojnë rendin, qetësinë dhe sigurinë publike, sa i përket lirisë, dhe të drejtave të njerëzve të tjerë, moralit dhe shëndetit publik.
2. E drejta e pjesëmarrjes dhe e fjalimit në tubimet publike ndalohet në rastet kur tubimet publike shërbejnë për të thirr apo nxitur, dhunën, urrejtjen ndërnacionale, religjioze, apo nxitje të tjera të ndaluara me ligj.
3. Asnjë tubim publik nuk mund të mbahet kur ndalohet nga organet e policisë përveç kur me këtë ligj nuk është paraparë ndryshe.

Neni 5
Tubimet e qeta publike

1. Tubime të qeta publike konsiderohen të gjitha ato tubime të organizuara dhe ku janë tubuar më shumë se njëzet (20) persona për qëllime të shprehjes publike të brengës politike, sociale, nacionale, racore etj.
2. Organet kompetente për mbajtjen e rendit dhe të qetësisë e sigurisë janë përgjegjëse për sigurimin e lirisë për organizimin, pjesëmarrjen dhe fjalën e lirë të qytetarëve në tubimet e qeta publike.
3. Organet kompetente për mbajtjen e rendit dhe të qetësisë e sigurisë mund të ndërmarrin masa të përdorimit të dhunës vetëm atëherë kur tubimi publik përkatësisht protesta rrezikon të prish ose shkatërroj të mirat e përgjithshme.
4. Çdo tubim publik duhet detyrimisht të lajmërohet nga organizatori apo përfaqësuesi i tij nën kushtet dhe afatin e paraparë nga organet e policisë.
5. Organizatori është përgjegjës që me rastin e pjesëmarrjes së qytetarëve në tubimin publik të mbaj dhe organizoj rendin.
6. Organizatori i tubimit publik në pajtim me këtë ligj është përgjegjës për ndërmarrjen e të gjitha masave rreth organizimit të tubimit publik.

Neni 6
Lajmërimi i tubimit të qetë publik

1. Lajmërimi për organizimin e tubimit të qetë publik për qëllimin, vendin dhe kohën e organizimit bëhet para policisë së Kosovës në vendin ku mbahet tubimi.
2. Lajmërimi bëhet më së voni shtatëdhjetë e dy (72) orë para se të mbahet tubimi i qetë publik.
3. Policia e Kosovës duhet që më së voni dyzet e tetë (48) orë para mbajtjes së tubimit publik të lajmëroj organizatorin për lejimin apo ndalimin e tubimit publik. Nëse në afatin e paraparë nuk shpallet vendimi i ndalimit, tubimi konsiderohet i lejuar.
4. Lajmërimi për tubimin publik duhet të përmbaj:
   4.1. qëllimin, vendin ditën dhe kohën e mbajtjes së tubimit publik;
   4.2. kohëzgjatjen e tubimit të qetë publik;
   4.3. të dhënat e organizatorit apo të përfaqësuesit të tij;
   4.4. të dhënat mbi udhëheqësin e tubimit publik;
   4.5. numrin e kujdestarëve dhe
   4.6. numrin e përafërt të pjesëmarrësve.
5. Për vendin dhe kohën e mbajtjes së tubimit vendos organizatori. Tubimet publike brenda hapësirës së një institucioni publik nuk janë të lejuara.

Neni 7

1. Tubimet që mund të mbahen pa u lajmëruar janë ato që mbahen në lokale të mbyllura apo lokale të parapara për qëllime të tilla si: mbledhjet, tribunat, tryezat e rrumbullakëta të subjekteve të ndryshme.
2. Gjithashtu nuk lajmërohen ato tubime nëse mbahen në: stadiume, salla kinemaje, teatro etj dhe të cilat nuk kërkojnë masa shtesë të sigurisë.

3. Tubimet publike mund të mbahen në çdo vend të përshtatshëm për to.
4. Përjashtim nga paragrafi 3 i këtij neni, bëjnë pjesë vendet në:
   4.1. afërsi të spitaleve, dhe vendeve ku mund të pengohen automjetet e ndihmës së parë dhe të prishet qetësia e të shtrirëve në spital.
   4.2. në afërsi të çerdheve për fëmijë dhe shkollave fillore gjatë kohës së mësimit.
   4.3. në parqet nacionale dhe parqet e mbrojtura natyrore përveç rasteve kur tubimi publik ka për qëllim mbrojtjen e natyrës dhe të mjedisit.
   4.4. në afërsi të përmendoreve apo objekteve me vlerë të lartë kulturore dhe historike me qëllim të mbrojtjes nga dëmtimi përveç rasteve të kremtimeve dhe të përkujtimeve të qeta.
   4.5. në udhëkryqe dhe magjistrale, për të mos penguar qarkullimin e automjeteve.
   4.6. në vende të tjera duke marr parasysh kohën e mbajtjes së tubimit numrin e pjesëmarrësve, dhe qëllimin e tubimit mund seriozisht të shqetësoj një numër të madh të qytetarëve.

Neni 8

1. Policia e Kosovës mund të ndalojnë një tubim të qetë publik kur konsiderojnë se:
   1.1. tubimi publik nuk është lajmëruar në mënyrë të rregullt;
   1.2. është paraparë të mbahet në vendin që është ndaluar me këtë ligj;
   1.3. kur qëllimet e tubimit nxisin ose thërrasin për përdorimin e dhunës, urrejtës ndërnacionale, fetare racore, politike;
   1.4. se ekzistojnë arsye të konsiderueshme se tubimi do të mund të përdorej për dhunë.
2. Tubimi publik sipas paragrafit 1. të këtij neni mund të ndalohet së paku njëzetekatër (24) orë para se të mbahet.
3. Organizatori apo lajmëruesi i tubimit publik i pakënaqur me vendimin e organit që ka ndaluar tubimin publik mund brenda tri (3) ditëve të ankohet para gjykatës kompetente për shqyrtim të rastit.
4. Gjykata në këtë rast vendos me procedurë të shpejtuar.
5. Tubimi spontan pa organizator të njohur i cili rrezikon të eskaloj në tubim të dhunshëm është i ndaluar.

Neni 9
Përgjegjësitë e organizatorit për organizimin e tubimit të qetë publik

1. Organizatori duhet që të ndërmerr të gjitha masat për mbajtjen e rendit dhe qetësisë në tubimin publik.
2. Organizatori duhet të siguroj numër të mjaftueshëm të mbajtësve te rendit në tubimin publik.
3. Organizatori mbajtën e rendit mund t'ia besoj kompanive private të sigurimit të licencuara në pajtim me ligjin.
4. Organizatori duhet që ti ndërmerr të gjitha masat që pjesëmarrësit të mos jenë të armatosur dhe të mos shkaktojnë dëme.
5. Me kërkesën e organizatorit, Policia e Kosovës mund të bashkëpunoj për mbajtjen e rendit dhe të marrin masat për ndalimin e personave të cilët veprojnë në kundërshtim me ligjin.

6. Organizatori gjatë zhvillimit të tubimit publik, duhet të krijoj hapësirë për kalimin e automjeteve të Policisë së Kosovës, të ndihmës së shpejt dhe zjarrfikësve.

Neni 10

Policia do ta mban rendin dhe qetësinë publike përreth vendit ku mbahet tubimi publik.

Neni 11

1. Pjesëmarrësve në tubimin apo protestën e qetë publike u ndalohet të mbajnë armë apo gjësende të ndaluara dhe gjithashtu të mbajnë apo shesin alkool.
2. Pjesëmarrësve të tubimit publik u ndalohet që të mbajnë apo bartin: shenja, mbishkrime, apo gjësende të tjera dalluese me të cilat, fyhet, nxitet apo ftohet për dhunë, urrejtje ndërnacionale, politike, fetare, racore, sociale, apo të ngjashme.

Neni 12
Kujdestarët

1. Kujdestarët janë persona të moshës madhore që caktohen nga organizatori i tubimit publik për mbajtjen e rendit dhe të qetësisë në tubimin publik.
2. Gjatë kohës së mbajtjes së tubimit publik, kujdestarët kujdesen që pjesëmarrësit mos të dëmtojnë të mirat materiale që ekzistojnë në vendin e mbajtjes së tubimit.
3. Kujdestari menjëherë duhet që të kap dhe dorëzoj tek policët pjesëmarrësin apo personin tjetër që qarkullon pranë vendit të tubimit publik nëse prishë rendin, qetësinë, mban armë apo objekte të rrezikshme apo shenja të ndaluara.
4. Kujdestari gjatë tubimit publik për punët e mbajtjes së rendit dhe qetësisë ka të drejtë:
   4.1. të kontrolloj personat që hyjnë në vendin ku mbahet tubimi;
   4.2. tu ndaloj hyrjen personave për të cilët konsideron se mund të prishin rendin dhe sigurinë e sidomos personat e dehur;
   4.3. të ndalë qarkullimin e pjesëmarrësve jashtë vendit të mbajtjes së tubimit;
   4.4. izoloj (dorëzoj policisë) personat që prishin rendin dhe qetësinë.
5. Kujdestari gjatë kohës sa zgjatë tubimi duhet të mbaj në krah një shirit dallues dhe duhet ti përmbahet udhëzimeve të udhëheqësit të tubimit.
6. Gjithashtu kujdestari nuk duhet të mbaj armë, objekte, simbole apo shenja të ndaluara sipas paragrafit 2. të nenit 11 të këtij ligji.

Neni 13

1. Udhëheqësi i tubimit të qetë publik është personi që caktohet nga organizatori për të caktuar mbajtësin e rendit dhe i cili kujdeset që tubimi të jetë mirë i organizuar.
2. Udhëheqësi mund të ndërmarr masa shtesë sa i përket sigurisë dhe rendit për tubimin publik.
3. Udhëheqësi mund të ndërpres tubimin e qetë para kohe nëse konsideron se vazhdimi i mëtejmë i tubimit mund të ketë për pasojë dhunën,
4. Udhëheqësi pasi të jetë qetësuar situata mund të vendos që të vazhdoj tubimin.

5. Udhëheqësi mund të largoj personat që nuk i përmbahen rregullit nga tubimi publik. Personat e larguar nga udhëheqësi duhen ta lëshojnë menjëherë vendin e tubimit.
6. Policia, përkatësisht organet më të larta kompetente të policisë, mund ta shtyjnë apo ndërprejnë tubimin nëse tubimi:
   6.1. nuk është lajmëruar apo lejuar;
   6.2. nëse mbahet në vendin që nuk është paraparë për tubim në lajmërim;
   6.3. nëse ka pjesëmarrës të armatosur në tubim;
   6.4. nëse pjesëmarrësit thërrasin apo nxisin për dhunë apo urrejtje;
   6.5. nëse kujdestarët nuk mund të mbajnë rendin dhe qetësinë; dhe
   6.6. nëse me tubimin publik apo protestën është rrezikuar seriozisht rendi, siguria dhe qetësia.
7. Personi zyrtar i cili vendos që të ndërpritet tubimi publik kërkon nga udhëheqësi i tubimit që të kërkoj nga pjesëmarrësit të qetë të shpërndahen nga tubimi,
8. Nëse udhëheqësi përkatësisht pjesëmarrësit nuk veprojnë sipas paragrafit 7. të këtij neni zyrtari kompetent do të ndërmarr masa të duhura që të shpërndahen pjesëmarrësit nga tubimi.

Neni 14
Tubimet urgjente

1. Kur ka rrethana urgjente, tubimi mund të zhvillohet pa respektuar afatin e parashikuar në të këtë ligj, prej shtatëdhjetë e dy (72) orësh por detyrimisht duhet të bëhet njoftimi me shkrim i cili përmban elementet e përcaktuara në paragrafin 4. të nenit 6 të këtij ligji, si dhe arsyen e urgjencës.
2. Njoftimi duhet të bëhet menjëherë, por jo më vonë së tri (3) orë përpara kohës së mbajtjes së tubimit.

Neni 15
Tubimet në zona private

1. Në zona apo prona private mund të mbahen tubime publike pa lajmëruar policinë.
2. Policia nuk mund të hyjë në zona private ku zhvillohen tubime pa pëlqimin e organizatorit të tubimit ose pronarit të saj, me përjashtim të rasteve flagrante për të ndaluar një rrezik të çastit për jetën dhe shëndetin e pjesëmarrësve në tubim.

Neni 16
Protestat publike

1. Protestat publike mund të mbahen në mjedise të hapura apo të mbyllura të parapara apo të përshtatshme për protesta.
2. Protestat publike nuk mund të mbahen në vendet e parapara në paragrafin 4. neni 7 të këtij ligji.
3. Organizatori i protestës duhet t'a lajmëroj mbajtjen e saj.
4. Përgjegjësitë e organizatorit për protestën publike janë të njëjta sikur ato të parapara në nenin 9 të këtij ligji.

5. Gjithashtu përgjegjësitë e parapara për kujdestarët në nenin 12 vlejnë edhe për protestat publike.
6. Protestat publike duhet të lajmërohen më së paku shtatëdhjetedy (72) orë para mbajtjes së saj.
7. Lajmërimi i bëhet policisë sipas nenit 6 të këtij ligji dhe ky lajmërim duhet të përmbaj:
   7.1. emrin, mbiemrin, numrin personal të Kartelës Identifikuese adresën si dhe përgjegjësinë e tij në organizatën apo subjektin që organizon protestën;
   7.2. të dhënat e udhëheqësit të protestës kujdestarët e angazhuar dhe numrin e tyre;
   7.3. qëllimin e protestës, vendin datën dhe kohën e mbajtjes së protestës publike;
   7.4. masat e marra për sigurinë dhe rendin;
   7.5. numrin e kujdestarëve; dhe
   7.6. numrin e përafërt të pjesëmarrësve.

Neni 17

1. Policia në bazë të kërkesës për mbajtjen e protestës publike vlerëson se a ekzistojnë kushte dhe rrethana të arsyeshme për mbajtjen e protestës në aspektin e sigurisë.
2. Policia mund ta refuzoj kërkesën për mbajtjen e protestës publike në rast kur konstaton se protesta:
   2.1. nuk është lajmëruar në mënyrë të rregullt;
   2.2. është lajmëruar se do të mbahet në vendet që me këtë ligj është e ndaluar;
   2.3. se qëllimi i kësaj proteste është të thirret apo nxitet në: dhunë, urrejtje ndërnacionale, fetare, racore apo të ngjashme;
   2.4. kur vlerësohet se protesta do të shkaktoj dhunën në prishjen e rendit, qetësisë, apo shkatërrimin e objekteve me rëndësi të përgjithshme;
   2.5. kur në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë apo kohë të përafërm është lejuar që të mbahet një protestë apo tubim tjetër.
3. Policia kur konstaton se nuk ekzistojnë kushtet dhe rrethanat e arsyeshme në aspektin e sigurisë për mbajtjen e protestës mund ta ndaloj njëzet e katër (24) orë para mbajtjes së protestës.
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankesë brenda dyzet e tetë (48) orëve në organet më të larta të policisë.
5. Këto organe janë të obliguara që brenda dyzetetetë (48) orëve të vendosin mbi ankesën dhe të lajmërojnë organizatorin.
6. Në rast se ushtruesi i ankesës nuk është i kënaqur me vendimin nga paragrafi 5. i këtij neni mund ti drejtohet Gjykatës. Në këtë rast Gjykata vendos me procedurë të shpejtë.

KREU II

Neni 18
Manifestimet publike

1. Manifestimet publike mund të mbahen në vende të hapura apo në ambiente të mbyllura të destinuara apo të përshtatshme për mbajtjen e tyre.
2. Organizatori i manifestimit publik mund të jetë personi fizik apo juridik sipas rregullave të parapara me këtë ligj.
3. Manifestimi publik duhet të lajmërohet nëntëdhjetë e gjashtë (96) orë para mbajtjes së saj.
4. Lajmërimi për mbajtjen e manifestimit publik bëhet para organeve të policisë së vendit ku do të mbahet manifestimi publik.
5. Lajmërimi i manifestimit publik duhet të përmbaj:
   5.1. emrin mbiemrin, numrin personal, vendlindjen dhe vendbanimin dhe të dhënat tjera të organizatorit;
   5.2. të dhënat mbi udhëheqësin e manifestimit publik;
   5.3. organizimin për mbajtjen e rendit, qetësisë dhe të sigurisë së bashku me numrin e kujdestarëve;
   5.4. natyrën e manifestimit;
   5.5. datën, kohën dhe vendin e mbajtjes; dhe
   5.6. numrin e përafërt të pjesëmarrësve.
6. Organizatori i manifestimit publik në vendet e hapura është përgjegjës që së bashku me të dhënat e parapara në paragrafin 5. të këtij neni, të bashkangjes edhe masat e ndërmarra në pajtim me dispozitat nga fusha e sigurisë në trafik dhe me rrethanat me rastin kur manifestimi mund të pengoj sigurinë në trafik.
7. Organet e policisë në bazë të lajmërimit vlerësojnë se a ekzistojnë kushtet për mbajtjen e manifestimit publik në aspektin e sigurisë.
8. Në pajtim me paragrafin 6. të këtij neni policia mund të kërkoj nga organizatori të shtoj masat shtesë për mbajtjen e rendit përkatësisht shtimin e numrin të kujdestarëve.
9. Organet e policisë duke vlerësuar se organizatori nuk ka arritur që të rris masat shtesë dhe se mbajtja e manifestimit publik mund të sjell deri te prishja e rendit dhe sigurisë publike mund më së voni njëzet e katër (24) orë para mbajtjes së manifestimit ta ndaloj atë.
10. Për ndalimin e manifestimit publik policia duhet të ketë për bazë nëse shfaqja publike:
    10.1. nuk është lajmëruar sipas rregullave të parapara;
    10.2. nuk janë marr parasysh kërkesat nga paragrafi 8 i këtij neni;
    10.3. është paraparë të mbahet në vendet që janë të ndaluara përkatësisht nuk janë të destinuara apo të përshtatshme të mbahen manifestimet publike;
    10.4. se ekzistojnë arsyet bazë se mbajtja e manifestimit publik do të cenoj sigurinë e përgjithshme, rendin dhe qetësinë, do të dëmtoj moralin publik, shëndetin e përgjithshëm apo do të ndotë ambientin.
11. Kundër vendimit të organit të policisë brenda dyzet e tetë (48) orëve mund të bëhet ankesë në organet më të larta të policisë.

12. Organet më të larta të policisë brenda dyzet e tetë (48) orëve do të marrin vendimin përfundimtar lidhur me ankesën dhe ta informoj organizatorin.
13. Në rast se ushtruesi i ankesës nuk është i kënaqur me vendimin nga paragrafi 12. i këtij neni mund ti drejtohet Gjykatës. Në këtë rast Gjykata vendos me procedure të shpejtë.

Neni 19

1. Me rastin e angazhimit të policisë me masa shtesë të sigurisë gjatë shfaqjes sportive, kulturore apo argëtuese organizatori është përgjegjës për kompensimin e këtyre shpenzimeve që ka shkaktuar ai angazhim.
2. Për kompensimin e këtyre shpenzimeve nga organizatori, arrihet marrëveshja së bashku me policinë dyzet e tetë (48) orë para fillimit të manifestimit publik.
3. Organizatori ka përgjegjësi objektive për kompensimin e dëmeve të bëra nga pjesëmarrësit në manifestimin publik në objektet apo ambientet të parapara në paragrafin 1. të nenit 18 të këtij ligji.

Neni 20
Tubimet e tjera të ngjashme

1. Tubimet si: ritet fetare, dasmat, varrimet si dhe tubimet e tjera të ngjashme nuk lajmërohen.
2. Përjashtim nga paragrafi 1. i këtij neni duhet të lajmërohen tubimet që pavarësisht nga numri i pjesëmarrësve apo natyra e tubimit kërkojnë të ndërmerren masa shtesë të sigurisë jashtë angazhimit normal nga ana e policisë.
3. Lajmërimi nga paragrafi 2. i këtij neni bëhet më së voni dymbëdhjetë (12) orë para mbajtjes së tubimit.
4. Lajmërimi për këtë lloj të tubimit bëhet siç është paraparë në paragrafin 2. të nenit 6 të këtij ligji.

Neni 21
Masat ndëshkuese

1. Me një shumë prej njëqind (100) deri në dyqind (200) euro do të dënohet:
   1.1. organizatori i tubimit publik apo protestës që nuk e ka lajmëruar atë në pajtim me paragrafin 4. të nenit 5 të këtij ligji;
   1.2. organizatori që mban tubimin apo protestën e qetë publike me gjithë ndalimin nga organet e policisë (neni 8 i këtij ligji);
   1.3. organizatori i cili nuk ka ndërmarr masa shtesë së sigurisë (paragrafi 8. i nenit 18 të këtij ligji);
   1.4. organizatori i cili nuk ka lajmëruar tubimet e ngjashme publike por që ka qenë i obliguar ti lajmëroj (neni 20 i këtij ligji).
2. Me një shumë prej dyqind (200) deri në pesëqind (500) euro do të dënohet:
   2.1. kur nuk e ndërprenë tubimin apo protestën publike (paragrafi 3. i neni 13 të këtij ligji);
   2.2. kur sipas kërkesës së policisë organizatori nuk e ndërprenë tubimin apo protestën publike (paragrafi 7. i neni 13 të këtij ligji).

3. Në shumën prej pesëqind (500) deri në shtatëqind (700) euro do të dënohet:
   3.1. organizatori që mban protestën publike pa dhënien e lejes nga organet e policisë (paragrafi 2. i nenit 17 të këtij ligji);
   3.2. organizatori që mban tubimin apo protestën publike në vendet e ndaluara sipas këtij paragrafi 4. nenit 7 të këtij ligji).
4. Në shumën prej shtatëqind (700) deri në njëmijë (1000) euro do të dënohet:
   4.1. personi i cili mban armë apo shet alkool në vendin e tubimit (paragrafi 1. i neni 11 të këtij ligji);
   4.2. personi i cili në tubimin e qetë publik mbanë apo bartë mbishkrime, apo gjësende të tjera me të cilat nxitet apo ftohet për dhunë apo urrejtje ndërnacionale, politike, fetare, racore apo të ngjashme (paragrafi 2. i neni 11 të këtij ligji).

Neni 22
Hyrja në fuqi

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushojnë të vlejnë të gjitha ligjet tjera apo akte që rregullojnë këtë fushë.
2. Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-118
4 dhjetor 2008

Shpallur më vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 03-V-101, datë 26 mars 2009.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI IV / Nr. 51 / 15 PRILL 2009

LIGJI Nr. 03/L-178
PËR KLASIFIKIMIN E INFORMACIONEVE DHE VERIFIKIMIN E SIGURISË

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 427
Kreu II: Klasifikimi i informacioneve 429
Kreu III: Siguria e personelit 436
Kreu IV: Mbrojtja e dosjeve dhe të dhënave 445
Kreu V: Siguria industriale 446
Kreu VI: Administrimi i sistemit të klasifikimit dhe verifikimit të sigurisë 447
Kreu VII: Dispozitat përfundimtare 448

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR KLASIFIKIMIN E INFORMACIONEVE DHE VERIFIKIMIN E SIGURISË

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është themelimi i një sistemi unik për klasifikimin dhe ruajtjen e informacioneve që kanë të bëjnë me interesat e sigurisë së Kosovës si dhe për verifikimin e sigurisë së personave që kanë qasje në këto informacione.

Neni 2
Fushëveprimi

1. Ky ligj zbatohet ndaj të gjitha institucioneve publike që ushtrojnë kompetenca ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore dhe ndaj Presidencës se Kosovës.
2. Ky ligj zbatohet edhe ndaj personave fizik dhe juridik të cilët në çfarëdo forme mund të kenë qasje në informacionet e klasifikuara.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:
   1.1. **Qasje -** aftësinë apo mundësinë për të marrë njohuri rreth informacioneve të klasifikuara.
   1.2. **Shoqëri Tregtare -** e ka kuptimin siç është definuar në Ligjin për Shoqëritë Tregtare nr. 02/L-123.
   1.3. **Klasifikim** - aktin apo procesin përmes të cilit informacionet përcaktohen si informacione të klasifikuara.
   1.4. **Autoritet i Klasifikimit** - çdo person i përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji që ka kompetencë origjinere apo të deleguar për të klasifikuar informacione.
   1.5. **Informacion i klasifikuar -** çdo informacion dhe material, publikimi i paautorizuar i të cilave do të cenonte në shkallë të ndryshme interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës.
   1.6. **Kontratë e klasifikuar -** çdo kontratë të lidhur nga një institucion publik që përmban informacione të klasifikuara sipas këtij ligji.
   1.7. **Deklasifikim -** ndryshimin e autorizuar të statusit të informacioneve nga informacioni i klasifikuar në informacion të paklasifikuar.
   1.8. **Dokument -** çdo mjet fizik apo elektronik mbi të cilin është regjistruar informacioni.
   1.9. **Degradim -** vendimin që informacioni i klasifikuar dhe i ruajtur në një nivel të përcaktuar klasifikohet dhe ruhet në nivel më të ulët klasifikimi.
   1.10. **Informacion i Qeverisë së huaj** nënkupton:
      1.10.1. informacioni i dhënë Republikës së Kosovës nga një qeveri e huaj apo organizatë qeveritare ndërkombëtare;
      1.10.2. informacioni i prodhuar nga Republika e Kosovës në pajtim me, apo si rezultat i një marrëveshje të përbashkët me një qeveri të huaj apo organizatë qeveritare ndërkombëtare me pritjen apo kërkesën që një informacion, marrëveshje e tillë apo të dyja të mbahen sekret.
   1.11. **Informacion -** njohurinë që mund të komunikohet në çfarëdo forme.
   1.12. **Material -** dokumente si dhe çdo makineri, pajisje ose armatim që është prodhuar apo që është në prodhim e sipër.
   1.13. **Përpunim -** çdo veprim apo sërë veprimesh që bëhen ndaj të dhënave personale, me apo pa mjete automatike, siç është mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, adaptimi apo ndryshimi, kërkimi, konsultimi, shfrytëzimi, publikimi me transmetim, përhapja apo çdo formë tjetër e vënies në dispozicion, rreshtimit apo kombinimit, bllokimit, shlyerjes apo asgjësimit.
   1.14. **Institucion publik -** të gjitha institucionet dhe organet e përcaktuara në nenin 2.1 të këtij ligji.
   1.15. **Interesat e sigurisë -** i referohet mbrojtjes, veprimtarive të zbatimit te ligjit dhe zbulimit, marrëdhënieve me jashtë apo të sigurisë të Republikës së Kosovës, përfshirë integritetin e saj territorial, integritetin e institucioneve të saja, rregullin kushtetues si dhe stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik.
   1.16. **Bashkëshort/e -** çdo marrëdhënie të krijuar përmes martesës së ligjshme

dhe për nevojat e këtij ligji përfshinë edhe çdo marrëdhënie jashtëmartesore midis dy personave fizikë.

1.17. **Agjenci -** Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë.

1.18. **Drejtues i institucionit publik -** zyrtarin më të lartë të Shërbimit Civil të një organi publik në nivelin e Sekretarit të Përhershëm, Shefit Ekzekutiv apo cilësdo pozitë tjetër të barazvlefshme me këto.

1.19. **Nevoja për njohuri -** vendimin i marrë nga një bartës i autorizuar i informacionit të klasifikuar se pranuesit të ardhshëm i duhet qasje në informacionin specifik të klasifikuar për të punuar ose ndihmuar në një funksion të ligjshëm dhe të autorizuar qeveritar, detyrë zyrtare ose funksion publik.

1.20. **Bartësit e autorizuar të informacioneve të klasifikuara -** personi i cili ka në posedim informacionin e klasifikuar, ka leje të vlefshme të sigurisë dhe i plotëson kushtet tjera që lejojnë qasjen në informacionin e klasifikuar, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj.

KREU II
KLASIFIKIMI I INFORMACIONEVE

Neni 4
Kriteret e Klasifikimit

1. Informacionet klasifikohen vetëm nëse është e nevojshme dhe nëse
   1.1. klasifikimi bëhet nga autoriteti kompetent i klasifikimit siç është përcaktuar me këtë ligj;
   1.2. informacionet zotërohen, prodhohen nga apo për, ose janë nën kontroll të Republikës së Kosovës;
   1.3. informacionet bien brenda një apo më shumë prej këtyre kategorive:
      1.3.1. siguri publike;
      1.3.2. mbrojtje, plane ushtarake, sisteme armësh, apo operacione;
      1.3.3. informacione për marrëdhëniet me jashtë dhe qeveritë e jashtme, përfshirë burimet konfidenciale;
      1.3.4. veprimtari zbulimi dhe të zbatimit të ligjit, përfshirë metoda dhe burime të zbulimit;
      1.3.5. sisteme, instalime, infrastruktura, projekte, plane apo shërbime të mbrojtjes që lidhen me interesat e sigurisë të Republikës së Kosovës;
      1.3.6. veprimtari shkencore, teknologjike, ekonomike, financiare që lidhen me interesat thelbësore të sigurisë së Republikës së Kosovës;
   1.4. Autoriteti i Klasifikimit vendosë për nivelin e klasifikimit të informacionit varësisht prej shkallës së dëmit që do të kishte publikimi i paautorizuar i tij në interesat e sigurisë në Republikën e Kosovës.

Neni 5
Ndalimi i Klasifikimit

1. Ndalohet klasifikimi i informacioneve për të:
   1.1. fshehur shkeljet e ligjit, abuzimin e autoritetit, mos efikasitetin apo gabimin administrativ;
   1.2. parandaluar turpërimin e një personi, autoriteti publik apo organizate;
   1.3. ndaluar konkurrencën; apo
   1.4. parandaluar apo vonuar publikimin e një informacioni, e cila qartazi nuk ka të bëjë me çështje të sigurisë.

Neni 6
Nivelet e Klasifikimit

1. Informacioni mund të klasifikohet në njërin nga këto nivele:
   1.1. "TEPËR SEKRET", zbatohet për informacionet, hapja e paautorizuar e të cilave sipas vlerësimit të arsyeshëm do të shkaktonte dëm jashtëzakonisht të rëndë për interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës;
   1.2. "SEKRET", zbatohet për informacionet, hapja e paautorizuar e të cilave do t'i dëmtonte seriozisht interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës;
   1.3. "KONFIDENCIALE", zbatohet për informacionet, hapja e paautorizuar e të cilave do të mund t'i dëmtonte interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës;
   1.4. "E KUFIZUAR", zbatohet për informacionet, hapja e paautorizuar e të cilave do të ishte e pafavorshme për interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës.

Neni 7
Kompetenca për Klasifikim

1. Pavarësisht nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, kompetencën për klasifikim e ka vetëm institucioni publik i cili e ka prodhuar informacionin.
2. Kompetencën origjinale për klasifikim në nivelin "TEPËR SEKRET" e kanë:
   2.1. Presidenti i Kosovës,
   2.2. Kryetari i Kuvendit të Kosovës,
   2.3. Kryeministri,
   2.4. Kryesuesi i Këshillit të Sigurisë së Kosovës;
   2.5. Drejtori i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;
   2.6. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës;
   2.7. Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës;
3. Personat e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni kanë të drejtë që t'ia delegojnë kompetencën për klasifikim vartësve të tyre të drejtpërdrejt.
4. Kompetencën origjinale të klasifikimit në nivelin "SEKRET", "KONFIDENCIALE" dhe "E KUFIZUAR" e kanë sekretarët e përhershëm, kryeshefat ekzekutivë apo drejtorët ekzekutivë të institucioneve publike dhe pozicionet e barasvlershme me ta, përveç nëse ata ia delegojnë këtë kompetencë zyrtarëve të lartë vartës.

5. Zyrtarët e autorizuar për klasifikimin e informacioneve në një nivel të përcaktuar kanë të drejtë t'i klasifikojnë informacionet edhe në nivel më të ulët.
6. Delegimi i kompetencës për klasifikim kufizohen në minimumin e kërkuar për ta zbatuar këtë ligj. Institucionet publike të përcaktuara në paragrafët 2. dhe 4. të këtij neni, janë përgjegjës që të sigurojnë se çdo delegim i kompetencës për klasifikim te zyrtarët vartës revokohet nëse nuk ka nevojë të qartë dhe të vazhdueshme që zyrtarët të ushtrojnë kompetencë të tillë klasifikimi. Kompetenca për klasifikim e deleguar te zyrtarët në pajtim me paragrafët 2. dhe 4. të këtij neni, nuk i delegohet më tutje ndonjë personi tjetër.
7. Çdo delegim i kompetencës për klasifikim bëhet me shkrim dhe e identifikon qartë zyrtarin me emër dhe titull të pozitës si dhe nivelin e klasifikimit.
8. Agjencia harton, mirë mbanë dhe rregullisht e azhurnon një regjistër me emrat e zyrtarëve që kanë kompetencë klasifikimi në nivelet "TEPËR SEKRET", "SEKRET" dhe "KONFIDENCIAL".
9. Kur një zyrtar, punonjës apo kontraktues i një institucioni publik, që nuk ka kompetencë origjinere apo të deleguar për klasifikim, prodhon një informacion, e cila sipas mendimit të atij personi kërkon klasifikim, ai/ajo e mbron atë informacion në mënyrën e paraparë me këtë ligj dhe menjëherë ia transmeton informacionin zyrtarit, i cili e ka kompetencën e duhur për klasifikim dhe që është përgjegjës për çështjen. Personi me kompetencë për klasifikim dhe përgjegjësi vendosë brenda tetë (8) ditësh nëse ky informacion duhet klasifikuar.

Neni 8
Vendimi për Klasifikim

1. Autoriteti i Klasifikimit vendosë nëse informacioni duhet klasifikuar dhe përcakton nivelin e klasifikimit të informacionit që në momentin kur prodhohet informacioni.
2. Vendimi nëse duhet klasifikuar informacioni dhe përcaktimi i nivelit të klasifikimit bazohet në një vlerësim të pasojave të dëmshme që mund të rezultojnë për interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës nga hapja e paautorizuar e informacionit të tillë. Vlerësimi bëhet me shkrim dhe i bashkëngjitet si shtojcë dokumentit që përmban informacionin e klasifikuar.
3. Autoriteti i Klasifikimit i shmanget klasifikimit të tepërt të informacioneve dhe atyre u cakton vetëm nivel të tillë të klasifikimit që është i nevojshëm për ta ruajtur interesat e Republikës së Kosovës.

Neni 9
Klasifikimi i Pjesëve të Dokumenteve dhe të Dokumenteve të Ndara

1. Faqe të caktuara, paragrafë, pjesë, shtojca, bashkëngjitje dhe materiale të bashkë mbyllura të një dokumenti të caktuar, që kërkojnë klasifikime të ndryshme, shënjohen sipas klasifikimit të vet. Klasifikimi i dokumentit si tërësi bëhet në nivelin më të lartë të klasifikimit që e kanë pjesët e tij.
2. Klasifikimi i një shkrese apo shënimi që mbulon materialet e bashkëngjitura është aq i lartë sa niveli më i lartë i klasifikimit të materialit të tij të bashkëngjitur. Autoriteti i Klasifikimit tregon qartë se në çfarë niveli duhet klasifikuar shkresa apo shënimi nëse shkëputet nga materiali i bashkëmbyllur.

3. Autoriteti i Klasifikimit mund t'i klasifikojë informacionet që gjenden në dokumente të ndara, që në mënyrë të ndarë nuk konsiderohen se kërkojnë klasifikim, por që kur kombinohen si tërësi kërkojnë mbrojtje nga hapja e paautorizuar.

Neni 10
Shënjimi

1. Të gjitha dokumentet që përmbajnë informacione të klasifikuara, në ballinë mbajnë këtë shënjim:
   1.1. nivelin e klasifikimit;
   1.2. datën e klasifikimit
   1.3. emrin dhe titullin e pozitës së autoritetit të klasifikimit;
   1.4. institucionin publik të prejardhjes;
   1.5. listën e shpërndarjes, nëse ka; dhe
   1.6. informacionin mbi deklasifikimin.
2. Shënjimet aplikohen si në vijim:
   2.1. mbi dokumentet "E KUFIZUARA", me mjete mekanike apo elektronike;
   2.2. mbi dokumentet "KONFIDENCIALE", me mjete mekanike dhe me dorë apo duke shtypur mbi letrën e regjistruar të vulosur që përpara;
   2.3. mbi dokumentet e "SEKRET" dhe "TEPËR SEKRET", me mjete mekanike dhe me dorë.
3. Nëse nuk është parashikuar ndryshe me traktat, në të cilin Republika e Kosovës është palë, apo me ndonjë instrument tjetër ndërkombëtar të detyrueshëm, shënjimi i një dokumenti të një qeverie të huaj apo organizate ndërkombëtare që përmban informacione të klasifikuara mbanë shënjimet origjinere të klasifikimit apo mund t'i caktohet klasifikim sipas legjislacionit të Kosovës që parasheh shkallën e mbrojtjes të paktën të barabartë me atë që kërkohet nga institucioni që ka sjellë informacione.

Neni 11
Kohëzgjatja e Klasifikimit

1. Informacioni qëndron i klasifikuar vetëm gjersa kërkon mbrojtje. Përveç nëse Autoriteti i Klasifikimit e ka caktuar një datë ose ngjarje të veçantë për deklasifikim duke marrë parasysh kohëzgjatjen e ndjeshmërisë së informacionit afatet në vijim vlejnë për deklasifikim automatik:
   1.1. informacionet e klasifikuara si "TË KUFIZUARA" deklasifikohen një (1) vit pas datës së vendimit për klasifikim;
   1.2. informacionet e klasifikuara si "KONFIDENCIALE" deklasifikohen pesë (5) vite pas datës së vendimit për klasifikim;
   1.3. informacionet e klasifikuara si "SEKRET" deklasifikohen pesëmbëdhjetë (15) vite pas datës së vendimit për klasifikim; dhe
   1.4. informacionet e klasifikuara si "TEPËR SEKRET" deklasifikohen njëzetepesë (25) vite pas datës së vendimit për klasifikim.
2. Në rast se Autoriteti Klasifikues konsideron se informacioni duhet të mbrohet më

gjatë se sa që është paraparë në paragrafin 1., ai nxjerr vendim të ri për klasifikim në pajtim me nenin 8 të këtij ligji. Vendimi i tillë nuk guxon të merret më herët se gjashtë (6) muaj para datës së paraparë për deklasifikim sipas paragrafit 1. të këtij neni.

Neni 12
Deklasifikimi

1. Informacioni deklasifikohet atëherë kur nuk ka më nevojë për mbrojtje dhe nuk i përmbushë kriteret për klasifikim të informacionit në pajtim me këtë ligj.
2. Autoriteti i Klasifikimit, nga i cili informacioni i klasifikuar e ka origjinën, e bën deklasifikimin e saj.
3. Vendimi për deklasifikimin e informacionit bëhet me shkrim dhe jepen arsyet për deklasifikim. Vendimi u komunikohet menjëherë nga institucioni i klasifikimit të gjitha institucioneve publike dhe të adresuarve të tjerë, të cilëve iu është dërguar dokumenti apo një kopje e tij.
4. Autoriteti i Klasifikimit që ka prodhuar informacione të klasifikuara e bën një rishikim çdo pesë (5) vite për të verifikuar nëse informacionet e klasifikuara vazhdojnë të kërkojë mbrojtje në pajtim me kriteret e klasifikimit të përcaktuara me këtë ligj. Nëse autoriteti i klasifikimit vjen në përfundim se informacioni i klasifikuar nuk i përmbush kërkesat e klasifikimit, ajo menjëherë lëshon vendimin për deklasifikim.
5. Pavarësisht kërkesës për rishikim të detyrueshëm në pajtim me paragrafin 4. të këtij neni, autoriteti i klasifikimit i përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni, menjëherë e deklasifikon informacionin nëse njoftohet me fakte që tregojnë qartë se informacioni nuk kërkon mbrojtje sipas kritereve të klasifikimit të përcaktuara me këtë ligj.
6. Informacionet e klasifikuara të qeverive së huaja mund të deklasifikohen nga institucionet e Kosovës vetëm nëse informacionet e tilla janë deklasifikuar nga autoriteti i huaj i klasifikimit që i ka klasifikuar informacionet.

Neni 13
Degradimi dhe Ngritja e Nivelit të Klasifikimit

1. Autoriteti i klasifikimit, nga i cili e ka origjinën informacioni i klasifikuar, është përgjegjës për degradimin e nivelit të klasifikimit të një informacioni të tillë.
2. Autoriteti kompetent i klasifikimit e degradon nivelin e klasifikimit nëse njoftohet për fakte që tregojnë qartë që informacioni i klasifikuar nuk kërkon nivelin e mbrojtjes i cili akordohet në nivelin ekzistues të klasifikimit.
3. Paragrafët 3. dhe 4. të nenit 12 të këtij ligji zbatohen përshtashmërisht ndaj degradimit të niveleve të klasifikimit të informacionit të klasifikuar.
4. Informacionet e klasifikuara të qeverive të huaja mund të degradohen nga institucionet e Kosovës vetëm nëse dhe deri në atë masë që autoriteti i jashtëm i klasifikimit, që ka kompetencën për ta degraduar informacionet në fjalë, e ka degraduar nivelin e klasifikimit të informacioneve të tilla.
5. Autoriteti i Klasifikimit, i cili e ka prodhuar informacionin e klasifikuar, mund ta

ngrit nivelin e klasifikimit të informacionit të klasifikuar nëse një ngritje e tillë e klasifikimit është e nevojshme për të mbrojtur interesat e sigurisë të Republikës së Kosovës dhe nëse i përmbushë kriteret e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji për nivelin përkatës të klasifikimit, në nivelin e të cilit do të ngritët klasifikimi.

Neni 14
Kontestimi i Klasifikimit

1. Bartësit e autorizuar të informacioneve të klasifikuara, të cilët,në mirëbesim, besojnë se statusi i tyre i klasifikimit nuk është i duhur apo nuk është i justifikuar sipas ligjit, mund ti propozojnë autoritetit të klasifikimit që e ka prodhuar informacionin e klasifikuar, që të rishikojë statusin e klasifikimit dhe sipas nevojës ta deklasifikojë informacionin apo ta degradojë nivelin e klasifikimit.
2. Autoriteti i klasifikimit e shqyrton propozimin dhe brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i propozimit dhe e informon me shkrim bartësin e tillë të autorizuar për vendimin.
3. Personat, të cilëve u është mohuar qasja në informacione të klasifikuara, mund ta kontestojnë vendimin e klasifikimit duke paraqitur kërkesë për rishikim pranë autoritetit të klasifikimit që e ka prodhuar informacionin e klasifikuar. Një kërkesë e tillë për rishikim paraqitet brenda tre (3) ditëve nga data e pranimit të vendimit të qasjes në informacionet e klasifikuara. Në këtë rast zbatohen dispozitat mbi rishikimin administrativ sipas Ligjit për Procedurën Administrative dhe nuk ka efekt suspenziv.

Neni 15
Klasifikimi Derivativ

1. Bartësit e autorizuar të informacioneve të klasifikuara të cilët riprodhojnë, nxjerrin pjesë të shkëputura, përmbledhin, inkorporojnë, parafrazojnë, rishpallin apo krijojnë në formë të re informacioneve të klasifikuara, zbatojnë shënjimet e klasifikimit në përputhje me shënjimet e klasifikimit që zbatohen ndaj informacionit origjiner.
2. Bartësit e autorizuar të informacioneve të klasifikuara të cilët përdorin shënjime të klasifikimit derivativ kanë për detyrë të
   2.1. respektojnë vendimet origjinere të klasifikimit; dhe
   2.2. të bartin shënjimet përkatëse të klasifikimit te cilido dokument të sapo krijuar.
3. Për informacionet e klasifikuara në mënyrë derivative të bazuara në burime të shumëfishta, klasifikuesi derivativ bartë
   3.1. nivelin më të lartë të klasifikimit të cilitdo nga burimet e shumëfishta;
   3.2. datën apo ngjarjen e deklasifikimit që korrespondon me periudhën më të gjatë të klasifikimit midis burimeve; dhe
   3.3. listën e këtyre burimeve mbi apo të bashkëngjitur me dosjen zyrtare apo kopje të regjistruar.

Neni 16
Përgatitja dhe Përkthimi i Informacioneve të Klasifikuara

Dokumentet që përmbajnë informacione të klasifikuara si "KONFIDENCIALE" apo në nivel më të lartë, shkruhen, përkthehen, ruhen, kopjohen apo në çfarëdo forme tjetër riprodhohen vetëm nga personat të cilët kanë leje të vlefshme mbi sigurinë për nivelin e klasifikimit të dokumentit përkatës.

Neni 17
Shpërndarja e Informacioneve të Klasifikuara

1. Dokumentet që përmbajnë informacione të klasifikuara si "KONFIDENCIALE" apo të nivelit më të lartë i shpërndahen vetëm personave të cilët kanë leje përkatës të sigurisë dhe kanë nevojë për njohuri rreth atyre informacioneve.
2. Shpërndarja fillestare e informacioneve të klasifikuara specifikohet nga institucioni që e ka krijuar informacionin.
3. Standardet e sigurisë që duhen zbatuar me qëllim të shpërndarjes së informacioneve të klasifikuara, përcaktohen përmes akteve nënligjore.

Neni 18
Transferimi i Informatave të Klasifikuara

1. Informacionet e Klasifikuara nuk largohen nga objektet zyrtare dhe në asnjë mënyrë tjetër nuk transferohen te institucionet tjera publike nëse autoriteti i klasifikimit origjiner nuk e autorizon një gjë të tillë. Institucioni publik që pranon informacione të klasifikuara nuk lejon hapjen e atyre informacioneve pa aprovimin e autoritetit që i ka krijuar ato.
2. Informacionet e klasifikuara i transferohen vetëm institucioneve publike
   2.1. që përmbushin standardet e sigurisë së informacioneve siç përcaktohet me këtë ligj apo me akte tjera nënligjore; dhe
   2.2. personeli i të cilave ka kaluar me sukses verifikimin e duhur të sigurisë, dhe ka nevojë për të marrë njohuri rreth atyre informacioneve.
3. Institucioni publik që transferon informacione të klasifikuara i regjistron të gjitha dokumentet e transferuara si dhe institucionet publike që i pranojnë ato dokumente.
4. Në rast të transferimit të informacioneve të klasifikuara bashkë me bartjen e funksioneve, institucioni publik që i pranon ato konsiderohet si institucioni që i ka krijuar ato informacione. Kjo nuk vlen në rast se informacionet e klasifikuara transferohen te një institucion tjetër publik vetëm për qëllime të ruajtjes.
5. Në rast se institucioni publik që i ka krijuar ato informacione nuk ekziston më dhe nuk është bërë transferimi te ndonjë institucion trashëgues në pajtim me paragrafin 4. të këtij neni, institucioni publik që i posedon ato informacione të klasifikuara konsiderohet si institucioni prej nga ato e kanë origjinën.
6. Standardet e sigurisë që zbatohen për qëllime të bartjes së informacioneve të klasifikuara, përcaktohen përmes akteve nënligjore.

Neni 19
Siguria Fizike dhe Siguria e Informacioneve

Të gjitha institucionet publike garantojnë sigurinë fizike dhe sigurinë e informacioneve lidhur me informacionet e klasifikuara në pajtim me standardet dhe procedurat e përcaktuara përmes akteve nënligjore, i cili është në përputhje me standardet relevante të përcaktuara nga Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe rregulloret mbi sigurinë të Bashkimit Evropian.

Neni 20
Humbja e Informacioneve të Klasifikuara

1. Për çfarëdo humbje, humbje të dyshuar, thyerje apo thyerje të dyshuar të sigurisë së informacioneve të klasifikuara, si dhe për çfarëdo qasje aktuale apo të dyshuar të paautorizuar në informacione të klasifikuara, të gjithë bartësit e autorizuar të informacioneve të klasifikuara menjëherë i raportojnë për këtë institucionit të tyre përkatës publik si dhe Agjencisë. Autoriteti përkatës publik menjëherë i merr të gjitha masat e nevojshme për të:
   1.1. hetuar rastin,
   1.2. identifikuar shkakun e humbjes,
   1.3. gjurmuar ndonjë hapje nga persona të paautorizuar për tu qasur në informacioneve të tilla,
   1.4. larguar ndonjë efekt të dëmshëm dhe për të parandaluar humbje të mëtejme të informacioneve të klasifikuara,
   1.5. iniciuar procedura disiplinore, penale dhe procedura tjera ligjore në dispozicion ndaj personave të cilët kanë shkaktuar humbjen e informacioneve të klasifikuara dhe të cilët kanë pranuar informacione të tilla pa autorizim.

KREU III
SIGURIA E PERSONELIT

Neni 21
Dispozita të Përgjithshme

1. Çdo person ka për detyrë të mbrojë informacionet e klasifikuara sipas këtij ligji, pavarësisht se si i është dhënë qasja në to apo se si e ka pranuar, apo në çfarëdo forme tjetër, ka arritur të posedojë informacione të klasifikuara.
2. Me rastin e largimit nga institucioni publik, shkëputjes së marrëdhënies së punës apo të ndonjë marrëdhënie tjetër kontraktore, zyrtarit apo personit të kontraktuar i ndalohet të largojë informacionet e klasifikuara nga kontrolli i institucionit publik.

Neni 22
Rregulla të Përgjithshme mbi Qasjen në Informacione të Klasifikuara

1. Një person mund të ketë qasje në informacione të klasifikuara si "KONFIDENCIALE", "SEKRET' ose "TEPËR SEKRET" me kusht që ai person:

1.1. të ketë leje të vlefshme mbi sigurinë;
1.2. të ketë nevojë për të qenë në dijeni të këtyre informacioneve që ta kryejë misionin apo detyrën e tij/saj zyrtare; dhe
1.3. të ketë nënshkruar deklaratën e konfidencialitetit.

2. Vetëm Presidenti i Republikës së Kosovës, Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe Kryeministri janë të autorizuar të kenë qasje në informacionet e klasifikuara me qëllim të kryerjes së detyrave zyrtare të tyre pa i përmbushur kërkesat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, me kusht që të kenë nevojë për të qenë në dijeni të këtyre informacioneve.
3. Të gjithë personat e autorizuar për të pasur qasje në informacionet e klasifikuara në pajtim me paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni nënshkruajnë deklaratën e konfidencialitetit që dëshmon se ata
   3.1. kanë qasje dhe shfrytëzojnë informacionet e klasifikuara vetëm me qëllim të kryerjes së detyrave të tyre zyrtare,
   3.2. i njohin dispozitat e këtij ligji dhe të legjislacionit tjetër relevant që ka të bëjë me qasjen në informacione dhe ruajtjen e informacioneve të klasifikuara si dhe sanksionet përkatëse ligjore për mosrespektimin e tyre,
   3.3. do të përdorin informacionet e klasifikuara që i kanë në posedim strikt në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe çdo legjislacioni tjetër relevant.
   3.4. Nuk do të publikojnë informacionet e klasifikuara që i kanë në posedim si dhe ndonjë njohuri tjetër që kanë lidhur me ato informacione gjatë dhe pas periudhës sa të jenë në detyrë para ndonjë personi të paautorizuar.
4. Qasja në informacionin e klasifikuar si "E KUFIZUAR" i lejohet pa leje të sigurisë të gjithë zyrtarëve dhe personave të kontraktuar të cilët
   4.1. kanë nevojë që të jenë në dijeni të këtyre informacioneve që të kryejnë misionin apo detyrën e tyre zyrtare; dhe
   4.2. kanë nënshkruar deklaratën e konfidencialitetit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni

Neni 23
Kërkesa për Qasje në Informacione të Klasifikuara

1. Drejtuesi i institucionit publik, ku krijohen, përpunohen, ruhen, pranohen apo transmetohen informacionet e klasifikuara, ka për detyrë që të sigurohet se të gjithë personat që kanë qasje në informacione të klasifikuara t'i përmbushin kushtet e përcaktuara në nenin 22 të këtij ligji sipas të cilave lejohet qasja në informacione të klasifikuara.
2. Drejtuesi i institucionit publik i përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni, ka për detyrë që të sigurohet se janë marrë të gjitha masat e sigurisë nga institucioni publik, siç kërkohet me këtë ligj dhe me çdo akt nënligjor që lejon apo ndalon qasjen ndaj informacioneve të klasifikuara në pajtim me këtë ligj.
3. Çdo institucion publik respekton vendimin e autoritetit verifikues dhe nuk lejon qasje në informacione të klasifikuara një person të cilit i është refuzuar certifikata e sigurisë.
4. Drejtuesi i institucionit publik, gjersa mbanë përgjegjësi përfundimtare, mund t'ia delegojë përgjegjësinë për të marrë vendim për lejimin e qasjes së informacione të

klasifikuara dhe për administrimin e informacioneve të klasifikuara sipas këtij ligji një zyrtari të lartë të institucionit publik i cili e ka verifikimin e nevojshëm të sigurisë dhe ka kualifikimin dhe përvojën adekuate për të ushtruar përgjegjësinë e deleguar.

Neni 24
Autoriteti Verifikues

1. Agjencia e Kosovës për Inteligjencë është Autoriteti Verifikues që ka përgjegjësi për të zhvilluar procedura të verifikimit të sigurisë, siç është përcaktuar me këtë ligj, për të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës dhe kontraktuesve të tyre.
2. Agjencia e Kosovës për Inteligjencë themelon një departament të veçantë verifikimi që është ekskluzivisht përgjegjës për të zbatuar procedurat e verifikimit të sigurisë. Departamenti i Verifikimit të Sigurisë dhe të gjithë të punësuarit dhe personeli i angazhuar në të duhet të jetë politikisht i paanshëm, profesional, pa paragjykime në gjykimin e tyre dhe të veprojnë vetëm në pajtim me ligjin dhe që nuk marrin udhëzime nga ndonjë person apo institucion.
3. Kërkesat për të kryer procedura verifikimi i paraqiten udhëheqësit të Departamentit të Verifikimit të Sigurisë me shkrim nga drejtuesi përkatës i institucionit publik, duke specifikuar nivelin e klasifikimit për të cilin kërkohet verifikimi i sigurisë.

Neni 25
Leja e Sigurisë

1. Autoriteti Verifikues ia lëshon lejen mbi sigurinë vetëm atij personi, i cili pas kryerjes të një procedure të verifikimit të sigurisë në pajtim me këtë ligj është përcaktuar si rrezik i pranueshëm për sigurinë.
2. Leja e sigurisë tregon qartë nivelin e informacionit të klasifikuar, në të cilën personi që e ka kaluar procedurën e verifikimit të sigurisë mund të ketë qasje. Leje e sigurisë për një nivel të caktuar të klasifikimit i jep bartësit qasje edhe në informacionet me nivel më të ulët të klasifikimit.
3. Çdo institucion publik i bindet vendimit të Autoritetit Verifikues dhe nuk i jep qasje në informacione të klasifikuara një personi të cilit i është refuzuar leja e sigurisë.

Neni 26
Rreziku i Papranueshëm për Sigurinë

1. Një person përbën rrezik të papranueshëm për sigurinë nëse ekzistojnë tregues të qartë se ai/ajo
   1.1. nuk është lojal ndaj Republikës së Kosovës dhe rendit dhe vlerave të saj kushtetuese;
   1.2. ka preferenca ose mund të manipulohet, nxitet ose shantazhohet për të ndihmuar një grup, ndonjë person, organizatë ose qeveri të huaj në mënyrë të dëmshme për interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës; ose

1.3. sillet në një mënyrë që tregon personalitet me çrregullime emocionale apo mendore, mungesë gjykimi ose dëshire, mos-sinqeriteti, vet-kontrolli ose mungesë të vullnetit për t'iu bindur rregullave në mënyrë që ngritë dyshime rreth përgjegjshmërisë së atij personi, besueshmërisë dhe aftësisë për t'i mbrojtur informacionet e klasifikuara.

2. Një person mund të konsiderohet si rrezik i papranueshëm për sigurinë nëse bashkëshorti/ja i/e tij/saj e përmbushë një ose më shumë nga kriteret e paraqitura në nën-paragrafët 1.1. deri 1.3. të këtij neni.

Neni 27
Rregulla të Përgjithshme mbi Procedurat e Verifikimit të Sigurisë

1. Qëllimi i procedurës së verifikimit të sigurisë është që të zbulojë nëse një person paraqet rrezik të papranueshëm për sigurinë siç është përcaktuar në nenin 26 të këtij ligji.
2. Refuzimi për të marrë pjesë në procedurën e verifikimit të sigurisë automatikisht përbën rrezik të papranueshëm për sigurinë.
3. Kur të zhvillohet procedura e verifikimit të sigurisë dhe kur të vendoset nëse një person përbën rrezik të papranueshëm për sigurinë, autoriteti verifikues i kushton vëmendjen e duhur atij personi në tërësi dhe i vlerëson informacionet mbi sjelljen e atij personi sipas këtyre faktorëve:
   3.1. natyrës, masës, dhe seriozitetit të sjelljes;
   3.2. rrethanat që e përcjellin atë sjellje;
   3.3. shpeshtësinë dhe rastet e fundit të asaj sjelljeje;
   3.4. moshën dhe pjekurinë e personit në kohën e asaj sjelljeje;
   3.5. deri në ç'masë ka qenë e vullnetshme pjesëmarrja në këtë sjellje;
   3.6. prania apo mungesa e rehabilitimit dhe ndryshimeve tjera të sjelljeve të përhershme;
   3.7. motivimi për atë sjellje;
   3.8. potenciali për presion, detyrim, shfrytëzimit ose kërcënimit; dhe
   3.9. mundësinë e vazhdimit apo shfaqjes së sërishme të kësaj sjellje.
4. Çdo dyshim, për sa i përket një personi që i nënshtrohet verifikimit, zgjidhet në dobi të interesave të sigurisë së Kosovës.
5. Çdo procedurë e verifikimit të sigurisë zhvillohet me pajtimin e personit përkatës, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me ligj. Pajtimi jepet me shkrim por jo në formë elektronike. Personat që i nënshtrohen procedurave të verifikimit të sigurisë duhet të jenë tetëmbëdhjetë (18) vjeç apo më të vjetër.
6. Procedura e verifikimit të sigurisë së bashkëshortit/es, siç mund të kërkohet nga paragrafi 3 i nenit 32 të këtij ligji, zhvillohet vetëm me pajtimin e bashkëshortit/es. Paragrafi 5. i këtij neni zbatohet përshtatshmërish. Refuzimi i bashkëshortit/es për të marrë pjesë në procedurën e verifikimit të sigurisë mund të rezultojë me mosdhënie të lejes së sigurisë.
7. Mos marrja e lejes së sigurisë rezulton me transferimin e personit zyrtarit në një pozitë tjetër të baras vlefshme për të cilën nuk nevojitet verifikimi i sigurisë. Nëse kjo nuk është e mundur atëherë mos marrja e lejes së sigurisë rezulton në largim nga puna apo me përfundim të kontratës mbi vepër ose shërbime në raport me

autoritetin publik nëse posedimi i lejes së vlefshme të sigurisë është kërkesë e domosdoshme për punësimin apo shërbimin përkatës.

Neni 28
Të Drejtat e Personit që i Nënshtrohet Verifikimit të Sigurisë

1. Në rast se procedura e verifikimit të sigurisë jep arsye të besohet që personi paraqet rrezik të papranueshëm për sigurinë, atij personi i jepet rasti të dëgjohet para se të merret vendimi. Ai person mund të ndihmohet nga një person i autorizuar gjatë dëgjimit të tillë.
2. Procedura dëgjimore zhvillohet në atë mënyrë që t'i mbrojë të drejtat dhe interesat e privatësisë legjitime të atij personi.
3. Procedurë dëgjimore nuk mbahet nëse mbajtja e një dëgjimi të tillë do të ishte e dëmshme për interesat legjitime politike apo të sigurisë së Republikës së Kosovës.
4. Një personi të konsideruar si rrezik të papranueshëm për sigurinë i lëshohet vendim me shkrim i cili ia mohon lëshimin e lejes së sigurisë. Ai person mund të paraqesë ankesë ndaj një vendimi të tillë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur ai/ajo është njoftuar për vendimin. Ankesa paraqitet dhe përpunohet në pajtim me Ligjin mbi Procedurën Administrative dhe nuk ka efekt suspenziv.

Neni 29
Pyetësori i Sigurisë

1. Të gjithë personat që i nënshtrohen verifikimit të sigurisë plotësojnë një pyetësor të verifikimit të sigurisë që në minimum përmban këto të dhëna:
   1.1. emrin, mbiemrin, përfshirë emrat dhe mbiemrat e mëparshëm;
   1.2. data dhe vendi i lindjes;
   1.3. shtetësia, përfshirë atë të mëparshmen dhe shtetësitë tjera;
   1.4. statusi civil;
   1.5. vendbanimi brenda dhe jashtë Kosovës;
   1.6. profesioni aktual;
   1.7. të dhënat e kontaktit të punëdhënësit dhe punëdhënësve të mëparshëm;
   1.8. numri i fëmijëve;
   1.9. emri, mbiemri, vendi dhe data e lindjes, shtetësia dhe vendi i banimit të personave që jetojnë në bashkësinë familjare;
   1.10. emri, mbiemri, vendi dhe data e lindjes, shtetësia dhe vendi i banimit të prindërve, njerkëve, prindërve birësues apo kujdestarëve;
   1.11. arsimimi dhe historiku i punësimit;
   1.12. shërbimi ushtarak;
   1.13. të gjitha dokumentet e identifikimit dhe dokumentet e udhëtimit si dhe numrat e tyre;
   1.14. informata rreth falimentimit apo procedurave të likuidimit ose zbatimit të masave ekzekutive që janë marrë në dhjetë (10) vjetët e fundit;
   1.15. informacione mbi gjendjen aktuale financiare, përfshirë borxhet dhe obligimet tjera financiare;
   1.16. kontaktet me shërbimet e jashtme të zbulimit, mediumet vendore dhe të jashtme dhe partitë politike;

1.17. kontaktet me organizatat që veprojnë në kundërshtim me rendin kushtetues të Republikës së Kosovës;
1.18. të dhëna mbi vepra penale, kundërvajtje dhe procedura penale në zhvillim e sipër;
1.19. masat e ndërmarra disiplinore;
1.20. përdorimi i alkoolit dhe drogës;
1.21. çrregullimet mendore apo emocionale, si dhe gjendja shëndetësore aktuale;
1.22. informacione mbi të afërmit e familjes jashtë shtetit apo lidhjet tjera me shtetet e huaja;
1.23. verifikimet e mëparshme të sigurisë;
1.24. dy referenca.

2. Pyetësori përmban një deklaratë që duhet nënshkruar nga personi që i nënshtrohet verifikimit të sigurisë që e autorizon Autoritetin Verifikues për tu qasur në të dhënat private të cilat i mbajnë institucionet financiare, shëndetësore dhe institucionet tjera që kanë të bëjnë me këtë person me qëllim të verifikimit të informatave të paraqitura në pyetësorin e sigurisë. Paragrafi 2 i nenit 27 të këtij ligji zbatohet përshtatshmërish në rast se personi refuzon të nënshkruajë një deklaratë të tillë.

Neni 30
Procedura e Thjeshtë e Verifikimit të Sigurisë

1. Procedura e thjeshtë e verifikimit të sigurisë zbatohet ndaj personave të cilët duhet të kenë qasje në informacionet e klasifikuara si "KONFIDENCIALE".
2. Autoriteti verifikues verifikon nëse informacionet e dhëna në pyetësorin e sigurisë janë të plota dhe të sakta. Për këtë qëllim, autoriteti verifikues inspekton regjistrat e statusit civil, dosjet mbi veprat penale dhe çfarëdo regjistri apo bazë të të dhënave tjetër zyrtare kombëtare apo ndërkombëtare.
3. Procedura e thjeshtë e verifikimit të sigurisë përfundon brenda tre (3) muajve nga dita e fillimit të kësaj procedure.

Neni 31
Procedura e Zgjatur e Verifikimit të Sigurisë

1. Procedura e zgjatur e verifikimit të sigurisë zbatohet ndaj personave të cilët duhet të kenë qasje në informacione të klasifikuara të nivelit jo më të lartë se "SEKRET".
2. Me qëllim të zhvillimit të procedurës së zgjatur të verifikimit të sigurisë, autoriteti verifikues merr të gjitha veprimet për të cilat është i autorizuar në pajtim me paragrafin 2. të nenit 30 të këtij ligji dhe përveç kësaj:
   2.1. urdhëron kontrollimin shëndetësor nëse kjo konsiderohet e nevojshme për të verifikuar informacionet lidhur me përdorimin, varësive të alkoolit dhe drogës, ose ndonjë çrregullimi mendor apo emocional;
   2.2. kërkon informacione nga institucionet e sigurisë të Kosovës nëse kjo konsiderohet e nevojshme për të verifikuar informacionet lidhur me kontaktet me qeveritë e huaja si dhe shërbimet e huaja të zbulimit dhe informacione të ngjashme;

2.3. hyn në bilancet e llogarive bankare dhe kërkon nga bankat dhe institucionet tjera bankare informacione lidhur me borxhet;
2.4. bën intervista me fqinjët në vendin e banimit dhe me punëdhënësit aktualë dhe të mëparshëm.

3. Procedura e zgjatur e verifikimit të sigurisë përfundon brenda gjashtë (6) muajve nga dita e fillimit të procedurës.

Neni 32
Procedura e Veçantë e Verifikimit të Sigurisë

1. Procedura e veçantë e verifikimit të sigurisë zbatohet ndaj personave të cilët duhet të kenë qasje në informacionet e klasifikuara si "TEPËR SEKRET".
2. Me qëllim të zhvillimit të procedurës së veçantë të verifikimit të sigurisë, autoriteti verifikues merr të gjitha veprimet për të cilat është i autorizuar sipas paragrafit 2 të nenit 30 dhe paragrafit 2 të nenit 31 të këtij ligji dhe kërkon nga bashkëshorti/ja të plotësojë një pyetësor të sigurisë. Përveç kësaj, ai zhvillon intervista me personin që i nënshtrohet verifikimit të sigurisë, me bashkëshortin/en dhe personat e paraqitur në listë si referencë.
3. Procedura e veçantë e verifikimit të sigurisë përfundon brenda nëntë muajsh nga dita e fillimit të procedurës.

Neni 33
Zgjatja e Afatit Kohor për Verifikime të Sigurisë

Në rast se Autoriteti Verifikues nuk ka mundësi të mbledhë dhe përpunojë të gjitha informacionet e kërkuara që të kryhet verifikimi i sigurisë brenda afateve kohore të përcaktuara në nenet 30, 31, dhe 32 të këtij ligji me vendim me shkrim që i dërgohet personit që i nënshtrohet verifikimit të sigurisë autoriteti verifikues mund të zgjasë afatin kohor për një periudhë jo më të gjatë se tre (3) muaj.

Neni 34
Bashkëpunimi Gjatë Verifikimit të Sigurisë

1. Gjatë zhvillimit të procedurës së verifikimit të sigurisë, autoriteti verifikues mund të bashkëpunojë me agjencitë e qeverive të huaja apo organizatat qeveritare ndërkombëtare që kanë përgjegjësi për verifikimin e sigurisë siç mund të jetë e përcaktuar me traktatet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Kosovës është palë nënshkruese, apo me instrumentet tjera relevante ndërkombëtare të detyrueshme. Në këtë rast, autoriteti verifikues respekton legjislacionin relevant mbi mbrojtjen e të dhënave.
2. Gjatë zhvillimit të procedurës së verifikimit të sigurisë, autoriteti verifikues mund të bashkëpunojë me institucionet tjera publike sipas nevojës. Institucionet tjera publike japin ndihmë sipas kërkesës.

Neni 35
Përsëritja e Verifikimit të Sigurisë

1. Personat të cilëve u është lëshuar leja e sigurisë i nënshtrohen një verifikimi të ri të sigurisë në intervalet e rregullta si në vijim:
   1.1. çdo dhjetë (10) vjet për personat me le të sigurisë që u lejon atyre qasje në informacionet e klasifikuara si "KONFIDENCIALE"; dhe
   1.2. çdo pesë (5) vjet për personat me leje të sigurisë që u lejon atyre qasje në informacionet e klasifikuara si "SEKRET" ose "TEPËR SEKRET".
2. Autoriteti Verifikues apo drejtuesi i institucionit publik, ku personi i verifikuar është i punësuar, mund t'i kërkojë këtij personi që t'i nënshtrohet një procedure të re të verifikimit të sigurisë madje edhe para skadimit të vlefshmërisë së lejes së sigurisë nëse ai/ajo ka indikacione që kanë ndodhur ngjarje apo janë paraqitur rrethana që ngrisin dyshim nëse personi i verifikuar ende përbën rrezik të pranueshëm për sigurinë.

Neni 36
Revokimi i Lejes së Sigurisë

1. Autoriteti Verifikues e revokon lejen e sigurisë para skadimit të vlefshmërisë së tij nëse:
   1.1. një procedurë e re e verifikimit të sigurisë ka rezultuar në vendimin se personi që i është nënshtruar verifikimit nuk përbën më rrezik të pranueshëm për sigurinë;
   1.2. personi që i është nënshtruar verifikimit ka dhënë dorëheqje apo është transferuar në një detyrë apo mision të ri ku ai/ajo nuk ka nevojë të ketë qasje në informacione të klasifikuara;
   1.3. personi që i është nënshtruar verifikimit është gjetur fajtor për vepër penale apo masë disiplinore, e cila është aq serioze sa që ai person duhet konsideruar rrezik i papranueshëm për sigurinë.
2. Në rast të fillimit të një procedure të verifikimit të sigurisë në pajtim me paragrafin 2. të nenit 35 të këtij ligji, Autoriteti Verifikues mund të pezullojë vlefshmërinë e lejes së sigurisë deri në përfundimin e procedurës së verifikimit të sigurisë.
3. Revokimi i lejes së sigurisë rezulton me largimin nga puna të personit apo me përfundimin e kontratës mbi vepër apo shërbime me autoritetin publik përkatës nëse posedimi i lejes së vlefshme të sigurisë është kërkesë e domosdoshme për punësimin apo shërbimin përkatës.

Neni 37
Qasja e Përkohshme në informacionet e Klasifikuara

1. Në rastet që përbëjnë përjashtim, kur ekziston nevojë detyruese zyrtare për të pasur qasje në informacionet e klasifikuara, drejtuesi i institucionit publik mund t'i japë leje një personi i cili nuk e ka verifikimin e sigurisë që kërkohet për qasje në nivelin e klasifikimit të informacionit, pasi që t'i ketë dhënë autoritetit verifikues njoftim paraprak me kusht që:

1.1. personi të ketë leje të vlefshme të sigurisë mirëpo jo për nivelin e klasifikimit për të cilin kërkohet qasja;
1.2. autoriteti verifikues të mos kundërshtojë me shkrim brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i njoftimit.
1.3. Leja për qasje të përkohshme në informacione të klasifikuara është e vlefshme për periudhë të pa ripërtërishme që nuk tejkalon gjashtë muaj.
1.4. Nuk lejohet qasje e përkohshme në informacionet e klasifikuara si "TEPËR SEKRET".
1.5. Drejtuesi i institucionit publik mbanë shënim mbi emrin, mbiemrin, titullin dhe rangun e të gjithë personave të cilëve u është dhënë leje për qasje të përkohshme në informacione të klasifikuara, përfshirë dokumentet që ata kanë inspektuar apo shfrytëzuar dhe për këtë menjëherë e informon Autoritetin Verifikues.

Neni 38
Qasja Urgjente në Informatat e Klasifikuara

1. Në gjendje urgjence ose gjatë operacioneve të jashtëzakonshme, drejtuesi i institucionit publik mund t'u lejojë me shkrim qasje në informacione të klasifikuara personave të cilët nuk kanë verifikim të sigurisë me kusht që
   1.1. të ekzistojë nevojë absolutisht zyrtare që ai person të ketë qasje në informacione të klasifikuara;
   1.2. të mos ketë dyshime të arsyeshme rreth lojalitetit, besnikërisë dhe përgjegjshmërisë së atij personi.
2. Drejtuesi i institucionit publik mbanë shënim mbi emrin, mbiemrin, titullin dhe rangun e të gjithë personave të cilëve u është dhënë leje për qasje të përkohshme ndaj informacioneve të klasifikuara, përfshirë dokumentet që ata kanë inspektuar apo shfrytëzuar dhe për këtë menjëherë e informon Autoritetin Verifikues.

Neni 39
Takimet dhe konferencat

Drejtuesi i institucionit publik garanton që të gjithë zyrtarët ose personat e kontraktuar që marrin pjesë në një mbledhje apo konferencë ku paraqiten apo shpërndahen informacionet e klasifikuara, të kenë verifikimin e duhur të sigurisë dhe të jenë të autorizuar për të marrë pjesë në një mbledhje apo konferencë të tillë.

Neni 40
Regjistri i sigurisë

1. Çdo drejtues i një institucioni publik krijon dhe përditëson rregullisht një regjistër të sigurisë, i cili përmban informacione rreth emrit, mbiemrit, pozitës dhe rangut të personave të autorizuar për të pasur qasje në informacionet e klasifikuara që mbahen në institucionin publik përkatës.
2. Autoriteti Verifikues mbanë një regjistër qendror të emrit, mbiemrit, pozitës dhe rangut të të gjithë personave në Kosovë të autorizuar për të pasur qasje në informacionet e klasifikuara si "KONFIDENCIALE", "SEKRET" apo "TEPËR SEKRET".

KREU IV
MBROJTJA E DOSJEVE DHE TË DHËNAVE

Neni 41
Dosja e Sigurisë

1. Leja e sigurisë, pyetësori i plotësuar i sigurisë dhe të gjitha dokumentet dhe materialet tjera relevante që kanë të bëjnë me verifikimin e sigurisë, mbahen nga Autoriteti Verifikues në dosjen e sigurisë.
2. Përveç të dhënave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, dosja e sigurisë përmban edhe informacione mbi ndryshimet e mëvonshme lidhur me informacionet e paraqitura në pyetësorin e sigurisë.
3. Drejtuesi i institucionit publik dhe personi i verifikuar kanë detyrë që ta informojnë menjëherë Autoritetin Verifikues për çdo zhvillim, ngjarje apo rrethanë të re që mund të rezultojnë në ndryshimin e informacioneve të dhëna në pyetësorin e sigurisë apo që në një mënyrë tjetër mund të ndikojnë negativisht në verifikimin e sigurisë të personit përkatës.
4. Autoriteti Verifikues klasifikon dhe mbanë dosjen e sigurisë në mënyrë që i jep dosjes së sigurisë nivelin e klasifikimit dhe të mbrojtjes të cilin Autoriteti Verifikues e konsideron të nevojshëm për t'i ruajtur interesat e sigurisë të Kosovës.

Neni 42
Fshirja e Dosjes së Sigurisë

Dosja e sigurisë fshihet dhjetë vjet pas ditës kur personit që i është nënshtruar verifikimit i ka skaduar leja e vlefshme e sigurisë, përveç nëse personi i verifikuar pajtohet me një periudhë më të gjatë kohore apo nëse një periudhë më e gjatë kohore e mbajtjes së dosjes është në interes të Republikës së Kosovës.

Neni 43
Përpunimi i të Dhënave

1. Autoriteti Verifikues mund të përpunojë të dhënat personale të personit të verifikuar që gjenden në dosjen e sigurisë vetëm me qëllim të ushtrimit të funksioneve dhe përgjegjësive të tij të përcaktuara me këtë ligj.
2. Autoriteti Verifikues nuk ia transferon institucioneve tjera publike të dhënat personale që gjenden në dosjen e sigurisë, përveç nëse ekziston një interes publik me prioritet pa i rrezikuar interesat e sigurisë të Republikës së Kosovës dhe vetëm për nevojat e:
   2.1. veprimtarive lidhur me zbatimin e ligjit;
   2.2. veprimtarive lidhur me zbulimin;
   2.3. hetimet parlamentare.
3. Institucioni publik që i pranon të dhënat e tilla mund ti shfrytëzojë dhe përpunojë ato vetëm nëse kjo është absolutisht e nevojshme dhe për qëllime të specifikuara në paragrafin 2. të këtij neni dhe duhet ti sigurojë mbrojtje nga publikimi i paautorizuar që kërkohet për nivelin përkatës të klasifikimit.

4. Agjencitë e zbatimit të ligjit mund ti shfrytëzojnë dhe përpunojnë të dhënat të përcaktuara në paragrafin 2. të këtij neni për nevojat e ndjekjes penale vetëm si mjetin e fundit kur të dhënat e tilla nuk mund të mblidhen në forma tjera apo nëse ndjekja penale do të pengohej seriozisht në mungesë të qasjes në të dhënat e tilla.

Neni 44
Informacionet mbi të Dhënat Personale

1. Personi i cili më parë apo aktualisht i nënshtrohet verifikimit ka të drejtë që të informohet nga autoriteti verifikues për të gjitha të dhënat personale të mbledhura dhe të ruajtura gjatë procedurës së verifikimit të sigurisë. Informacionet mbi të dhënat e tilla personale jepen nga autoriteti verifikues në bazë të një kërkese me shkrim të paraqitur nga personi i verifikuar.
2. Autoriteti verifikues e refuzon kërkesën nëse
   2.1. publikimi i informacionit të kërkuar do të dëmtonte sigurinë publike apo interesat e sigurisë të Republikës të Kosovës; ose
   2.2. informacioni duhet të mbahet konfidencial në mënyrë që të mbrohen të drejtat legjitime dhe interesat e personit të tretë apo burime të inteligjencës.
3. Në rast të refuzimit të kërkesës, personi që e kërkon informacionin mund të paraqesë kërkesë për rishikim administrativ pranë autoritetit verifikues në pajtim me Ligjin mbi Procedurën Administrative.

KREU V
SIGURIA INDUSTRIALE

Neni 45
Dispozitat e Përgjithshme mbi Qasjen në Informacione të Klasifikuara

1. Pronarët, menaxhuesit dhe punonjësit e shoqërive tregtare dhe nën-kontraktuesit e tyre, të cilët janë të ftuar për të bërë ofertë, për të negociuar apo përmbushur një kontratë të klasifikuar apo që në një formë tjetër mund të ju jepet qasje në informacione të klasifikuara, kanë qasje në informacione të tilla të klasifikuara me kusht që të kenë leje të vlefshme të sigurisë të lëshuar nga Autoriteti Verifikues dhe që të kenë nevojë që të jenë në dijeni për këto informacione.
2. Informacioni i klasifikuar i jepet një shoqërie tregtare vetëm me pëlqimin e institucionit publik nga i cili e ka origjinën ky informacion.

Neni 46
Siguria e Objekteve Afariste

1. Shoqëritë tregtare dhe nën-kontraktuesit e tyre, pronarëve, menaxhuesve apo punonjësve të të cilëve u është dhënë në mënyrë të ligjshme qasje në informacione të klasifikuara garantojnë që objektet e tyre afariste, ku përdoren informacionet e tilla, i përmbushin standardet e sigurisë siç është përcaktuar me këtë ligj dhe me aktet nënligjore. Autoriteti Verifikues i inspekton objektet e tilla dhe e ndalon qasjen në informacione të klasifikuara nëse objektet afariste nuk i përmbushin standardet e sigurisë të përcaktuara në këtë ligj dhe me aktet nënligjore përkatëse.

2. Autoriteti Verifikues, kohë pas kohe dhe pa njoftim paraprak inspekton objektet e shoqërive tregtare të cilat kanë qasje në informacione të klasifikuara.

Neni 47
Përfundimi i Negociatave apo Kontratave

1. Mosrespektimi i standardeve të sigurisë nga ana e një shoqërie tregtare është arsye që menjëherë të ndërpriten negociatat apo të shkëputet kontrata ekzistuese pa obligim kompensimi të çfarëdo dëmi apo fitimi të humbur të shoqërisë tregtare përkatëse.
2. Paragrafi 1 i nenit 46 të këtij ligji, nuk cenon kërkesat e institucionit publik ndaj shoqërisë tregtare përkatëse për kompensim të dëmit të shkaktuar nga ndërprerja e negociatave apo shkëputjes së kontratës.
3. Paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni zbatohen përshtatshmërisht nëse një pronar, menaxhues apo punonjës i shoqërisë tregtare përkatëse, i cili ka apo duhet të ketë qasje në informacione të klasifikuara, nuk posedon lejen e vlefshme të sigurisë për nivelin përkatës së klasifikimit.

Neni 48
Dosja e Sigurisë dhe Mbrojtja e të Dhënave

Autoriteti Verifikues ka për detyrë që të mbajë dosje të sigurisë për çdo pronar, menaxhues apo punonjës i cili ka qasje të ligjshme në informacione të klasifikuara. Dispozitat e Kapitullit IV zbatohen përshtatshmërisht ndaj të dhënave personale të pronarëve, menaxhuesve apo punonjësve të tillë.

KREU VI
ADMINISTRIMI I SISTEMIT TË KLASIFIKIMIT DHE VERIFIKIMIT TË SIGURISË

Neni 49
Përgjegjësitë e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë në fushën e Klasifikimit të Informacioneve dhe Verifikimit të Sigurisë

1. Me qëllim të zbatimit të këtij ligji Agjencia ka funksionet dhe përgjegjësitë vijuese:
   1.1. kryen procedurat e verifikimit të sigurisë dhe funksionet e tjera të përcaktuara me këtë ligj;
   1.2. monitoron dhe koordinon zhvillimet në fushën e ruajtjes së informacioneve të klasifikuara;
   1.3. propozon marrjen e masave, përfshirë përgatitjen e politikave dhe legjislacionit për të përmirësuar mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara;
   1.4. përgatit aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji për miratim nga Qeveria e Kosovës
   1.5. nxjerr udhëzime dhe instruksione me qëllim të zbatimit të çështjeve administrative dhe teknike të këtij ligji;
   1.6. siguron zhvillimin dhe zbatimin e standardeve fizike, organizative dhe teknike për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara;

1.7. mbikëqyrë zbatimin e traktateve apo instrumenteve ndërkombëtare mbi mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara dhe propozon marrjen e masave lidhur me këtë;
1.8. bashkëpunon dhe koordinon me institucionet përkatëse në shtetet tjera dhe organizata ndërkombëtare në çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara;
1.9. jep trajnime dhe ngritë kapacitete rregullisht në fushën e mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara.

KREU VII
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 50
Sanksionet Penale

1. Personi i cili pa autorizim publikon informacionin e klasifikuar sipas këtij ligji si ”KONFIDENCIALE” dhe cilido bartës i autorizuar i informacionit të tillë të klasifikuar i cili nuk e mbron informacionin e klasifikuar siç kërkohet me këtë ligj, kryen vepër penale dhe dënohet me burgim prej një deri pesë (5) vite.
2. Personi i cili publikon pa autorizim informacionin e klasifikuar sipas këtij ligji si “SEKRET”, dhe cilido bartës i autorizuar i informacionit të tillë të klasifikuar nuk e mbron informacionin e klasifikuar siç kërkohet me këtë ligj, kryen vepër penale dhe dënohet me burgim prej tri deri dhjetë vite.
3. Personi i cili publikon pa autorizim informacionin e klasifikuar sipas këtij ligji si “TEPËR SEKRET”, dhe cilido bartës i autorizuar i informacionit të tillë të klasifikuar i cili nuk e mbron informacionin e klasifikuar siç kërkohet me këtë ligj, kryen vepër penale dhe dënohet me burgim prej pesë (5) deri dymbëdhjetë (12) vite.

Neni 51
Aktet nënligjore

Qeveria miraton aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji brenda një (1) viti nga hyrja e tij në fuqi.

Neni 52
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-178
1 korrik 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-035-2010, datë 15.07.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 76 / 10 GUSHT 2010

LIGJI Nr. 03/L-159
PËR AGJENCINË KUNDËR KORRUPSIONIT

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 449
Kreu II: Agjencia Kundër Korrupsionit 450
Kreu III: Komisioni mbikëqyrës i agjencisë 453
Kreu IV: Strategjia dhe plani i veprimit kundër korrupsionit 453
Kreu V: Procedura e hetimeve paraprake 454
Kreu VI: Mbrojta e të dhënave, ruajtja e shënimeve dhe fshehtësia e informacionit 456
Kreu VII: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 456

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR AGJENCINË KUNDËR KORRUPSIONIT

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj përcakton statusin dhe përgjegjësitë e Agjencisë kundër Korrupsionit në fushën e luftimit dhe parandalimit të korrupsionit, veçanërisht në fushën e raportimit, zbulimit dhe hetimit të korrupsionit, zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit.

Neni 2
Përkufizimet

1. Për qëllime të këtij ligji termet e përdorura kanë këtë kuptim:
   1.1. **Agjencia -** Agjencia kundër Korrupsionit.
   1.2. **Komisioni -** Komisioni Parlamentar Mbikëqyrës.
   1.3. **Korrupsion –** çdo keqpërdorim të pushtetit apo çdo sjellje tjetër të personit zyrtar, personit përgjegjës apo personit tjetër me qëllim të arritjes së një përparësie apo përftimi të kundërligjshëm për veten apo për tjetrin.
   1.4. **Person zyrtar -** personi zyrtar të definuar në Kodin penal të Kosovës.

1.5. **Person përgjegjës** - personi përgjegjës të definuar në Kodin penal të Kosovës.

KREU II
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT

Neni 3
Statusi i Agjencisë

Agjencia është organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë.

Neni 4
Buxheti i Agjencisë

1. Me propozim të Agjencisë, Kuvendi i Kosovës aprovon buxhetin vjetor të Agjencisë.
2. Agjencia vendosë në mënyrë të pavarur për përdorimin të buxhetit.

Neni 5
Kompetencat e Agjencisë

1. Agjencia ka kompetencat e mëposhtme:
   1.1. inicion dhe zhvillon procedurën e zbulimit dhe hetimit paraprak të korrupsionit dhe përcjellë kallëzime penale për rastet e dyshimit për korrupsion në prokurorinë publike kompetente, nëse për të njëjtin rast nuk zhvillohet procedurë penale;
   1.2. bashkëpunon me institucionet vendore, të huaja dhe ndërkombëtare që kanë për mision parandalimin dhe luftimin e korrupsionit;
   1.3. në bashkëpunim me Komisionin, Qeverinë, institucionet e tjera dhe me organizatat joqeveritare, harton strategjinë kundër korrupsionit dhe planin e veprimit;
   1.4. monitoron dhe mbikëqyrë zbatimin e Strategjisë kundër Korrupsionit dhe planin e veprimit;
   1.5. mbikëqyr dhe parandalon rastet e konfliktit të interesit dhe ndërmerr masat e parapara me ligj të veçantë;
   1.6. mbikëqyr pasuritë e zyrtarëve të lartë publik dhe personave të tjerë, siç parashihet me ligj të veçantë;
   1.7. mbikëqyr pranimin e dhuratave që kanë të bëjnë me kryerjen e detyrës zyrtare dhe ndërmerr masat e parapara me ligj;
   1.8. bashkëpunon me autoritetet publike kompetente për hartimin, harmonizimin dhe zbatimin e legjislacionit në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit;
   1.9. përfaqësohet në takime ndërkombëtare që kanë të bëjnë me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit si dhe merr pjesë në procesin e negociatave për lidhjen e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale apo miratimin e instrumenteve ligjore ndërkombëtare kundër korrupsionit;

1.10. bashkëpunon me institucionet kompetente të Republikës së Kosovës për realizimin e detyrimeve që dalin nga aktet ndërkombëtare kundër korrupsionit dhe ofron rekomandime për përmbushjen e detyrimeve të tyre;
1.11. merr pjesë dhe ofron këshilla për hartimin e kodit të etikës në sektorin publik dhe privat;
1.12. ofron opinione në lidhje me konfliktin e interesit dhe mbikëqyrjen e dhuratave që kanë të bëjnë me kryerjen e detyrës zyrtare;
1.13. ofron sqarime në lidhje me mënyrën e deklarimit të pasurisë dhe çështje tjera nga fushëveprimi i Agjencisë;
1.14. mbledh, analizon dhe publikon të dhënat statistikore ose të dhëna të tjera në lidhje me gjendjen e korrupsionit në Kosovë;
1.15. bashkëpunon me institucionet shtetërore dhe shoqërinë civile për ngritjen e vetëdijes së publikut lidhur me korrupsionin;

2. i raporton Kuvendit një herë në vit dhe Komisionit çdo gjashtë (6) muaj për punën e Agjencisë. Komisioni mund të kërkojë raporte edhe më të shpeshta nga Agjencia.
3. përgatit dhe propozon buxhetin vjetor të Agjencisë.

Neni 6
Pagat dhe kompensimet

1. Pagat dhe shtesat për nëpunësit e Agjencisë bazohen në kushtet e veçanta nën të cilat ata i kryejnë detyrat dhe funksionet.
2. Pagat themelore dhe çdo shtesë për nëpunësit e Agjencisë përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 7
Drejtori i Agjencisë

1. Agjencia udhëhiqet nga Drejtori.
2. Drejtori i Agjencisë nuk mund ta ushtrojë asnjë funksion që paraqet konflikt interesi me funksionin e tij sipas ligjit në fuqi.

Neni 8
Procedura e zgjedhjes së drejtorit

1. Komisioni gjashtë (6) muaj para skadimit të mandatit të Drejtorit të Agjencisë informon Kuvendin e Kosovës në mënyrë që të fillojë procedurën për zgjedhjen e Drejtorit të ri.
2. Kuvendi i Kosovës, në pajtim me Rregulloren e punës, zgjedh Drejtorin e Agjencisë në bazë të konkursit të hapur.
3. Kandidati për Drejtor të Agjencisë duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:
   3.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës dhe të ketë vendbanim të përhershëm në Kosovë;
   3.2. të këtë së paku diplomë universiteti katërvjeçar ose master;
   3.3. të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale;
   3.4. të ketë integritet të lartë moral;

3.5. të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale.
4. Komisioni menaxhon procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve më të mirë, dy prej të cilëve ia propozon Kuvendit të Kosovës për votim.
5. Kuvendi i Kosovës me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të votave zgjedh njërin prej kandidatëve të propozuar.
6. Drejtori zgjidhet për mandat pesë (5) vjeçar dhe mund të rizgjidhet vetëm edhe për një mandat tjetër.

Neni 9
Paga e drejtorit

Drejtori i Agjencisë ka një pagë në lartësinë e pagës së Kryetarit të Komisionit Parlamentar të Kuvendit të Kosovës.

Neni 10
Përfundimi i Mandatit të drejtorit

1. Funksioni i Drejtorit të Agjencisë përfundon:
   1.1. me përfundimin e mandatit të paraparë me këtë ligj;
   1.2. me humbjen e përhershme të aftësisë për të kryer funksionin e tij;
   1.3. me dorëheqje;
   1.4. nëse me vendim të plotfuqishëm gjyqësor është dënuar për vepër penale, për të cilën ligji parasheh dënimin mbi 6 muaj burgim;
   1.5. nëse ushtron funksione që janë në papajtueshmëri me funksionin e tij sipas ligjit në fuqi;
   1.6. me shkarkim nga Kuvendi i Kosovës për shkak të dështimit në përmbushjen e mandatit ligjor;
   1.7. me vdekje.

Neni 11
Përgjegjësitë dhe kompetencat e drejtorit

1. Drejtori i Agjencisë ka përgjegjësitë e mëposhtme:
   1.1. udhëheq dhe organizon punën e Agjencisë;
   1.2. mbikëqyr punën e nëpunësve të Agjencisë;
   1.3. përfaqëson Agjencinë brenda dhe jashtë vendit;
   1.4. menaxhon buxhetin e Agjencisë dhe është përgjegjës për mënyrën e shpenzimit të tij;
   1.5. lidh marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare, në pajtim me ligjin në fuqi;
   1.6. vendos për angazhimin e ekspertëve jashtë Agjencisë;
   1.7. ushtron edhe detyra të tjera të përcaktuara me ligj.
2. Drejtori autorizon me shkrim njërin nga varësit e tij/saj të drejtpërdrejt për ta zëvendësuar në rast të mungesës së tij/saj të përkohshme.

Neni 12
Raportimi për punën e Agjencisë

Agjencia paraqet raport vjetor të punës për vitin paraprak në Kuvendin e Republikës së Kosovës më së voni deri me datën 31 mars.

KREU III
KOMISIONI MBIKËQYRËS I AGJENCISË

Neni 13
Komisioni

Kuvendi i Kosovës në bazë të këtij ligji dhe Rregullores së Punës së tij, themelon Komisionin Mbikëqyrës të Agjencisë.

Neni 14
Kompetencat e Komisionit

1. Komisioni:
   1.1. shqyrton raportet e Agjencisë;
   1.2. mbikëqyrë dhe vlerëson në mënyrë periodike punën e Drejtorit të Agjencisë.
   1.3. inicion procedurën për zgjedhjen dhe shkarkimin e Drejtorit të Agjencisë;
   1.4. pas dorëzimit të raportit të Agjencisë, Komisioni mund të kërkojë raport të veçantë në lidhje me lëndët në të cilat Agjencia ka pushuar hetimet;
   1.5. raporti duhet të përmbajë shpjegimet në lidhje me arsyet e mbylljes së rasteve të tilla pa përmendur identitetin apo të dhënat personale të personave të hetuar.
   1.6. kontrollon dhe mbikëqyr pasurinë e deklaruar nga zyrtarët e lartë të Agjencisë dhe rastet e konfliktit të interesit në pajtim me rregullat dhe procedurën e paraparë me ligje të veçanta.

Neni 15

Komisioni nuk ka të drejtë ndërhyrjeje në asnjë mënyre në rastet të cilat gjenden në procedurën e hetimeve paraprake të Agjencisë.

KREU IV
STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT KUNDËR KORRUPSIONIT

Neni 16
Strategjia kundër korrupsionit

1. Agjencia, në bashkëpunim me Qeverinë dhe institucionet e tjera qeveritare dhe joqeveritare harton Strategjinë kundër Korrupsionit.
2. Agjencia përmes Qeverisë paraqet për miratim Strategjinë kundër Korrupsionit në Kuvendin e Kosovës, dokument i cili përmban politikat kundër korrupsionit që

duhet të zbatohen nga institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal.

Neni 17
Plani i Veprimit kundër korrupsionit

1. Në zbatim të Strategjisë kundër Korrupsionit, Agjencia harton Planin e Veprimit kundër Korrupsionit në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, dokument i cili përmban masat konkrete kundër korrupsionit që duhet të zbatohen nga institucionet si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal.
2. Plani i veprimit kundër Korrupsionit mund të ndryshohet dhe plotësohet në bazë të propozimeve nga institucionet përgjegjëse ose me iniciativën e Agjencisë.
3. Agjencia monitoron zbatimin e Planit të veprimit kundër Korrupsionit nga institucionet e Kosovës si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Për zbatimin e masave kundër korrupsionit, institucionet përgjegjëse i raportojnë Agjencisë në mënyrë periodike një herë në gjashtë muaj si dhe kurdo që kjo kërkohet nga Agjencia.
4. Në raportin vjetor të Agjencisë në Kuvend të Kosovës raportohet edhe për ecurinë e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit.

KREU V
PROCEDURA E HETIMEVE PARAPRAKE

Neni 18
Hetimet paraprake

1. Agjencia zhvillon procedurën e hetimit paraprak në rastin e dyshimit për korrupsion sipas:
   1.1. detyrës zyrtare; apo
   1.2. sipas informacioneve të pranuara nga personat fizik apo juridik.
2. Për zbatimin e masave nga paragrafi 1 i këtij neni, Agjencia:
   2.1. kërkon, mbledh, hulumton dhe analizon dokumentacionin dhe informacionet tjera relevante për rastin;
   2.2. kërkon informacione nga personat e përfshirë në rast;
   2.3. ekzaminon rrethanat që kanë lidhje me rastin.
3. Hetimet paraprake duhet të përfundojnë brenda një periudhe kohore prej gjashtë (6) muajsh nga momenti i inicimit të hetimit, përjashtimisht në raste të veçanta Drejtori i Agjencisë mund të lejoj zgjatjen e afatit me së shumti edhe 6 muaj.
4. Zgjatja e afatit për përfundimin e hetimeve sipas paragrafit 3 të këtij neni duhet të arsyetohet me shkrim nga drejtori dhe arsyetimi të vendoset në dosjen e lëndës.
5. Agjencia në ushtrimin e funksionit të vet, nëse has në vështirësi kërkon ndihmë nga policia.
6. Nëse pas përfundimit të procedurave hetimore paraprake konstatohet se ka të dhëna të mjaftueshme apo/dhe dyshim të arsyeshëm se rasti mund të përbëjë vepër penale, Agjencia ia përcjellë rastin prokurorisë kompetente për procedim të mëtutjeshëm.

7. Prokuroria kompetente informon Agjencinë për procedimin e mëtejshëm dhe vendimin final në lidhje me rastin.
8. Në rast se nuk dyshohet për vepër penale por për shkelje administrative, Agjencia e përcjell rastin tek organi administrativ kompetent.
9. Organi administrativ kompetent duhet ta informojë Agjencinë për procedimin e mëtejshëm dhe vendimin final në lidhje me rastin.
10. Nëse pas përfundimit të procedurave hetimore paraprake Agjencia konstaton se nuk ka të dhëna të mjaftueshme apo/dhe dyshim të bazuar se rasti mund të përbëjë vepër penale apo shkelje administrative, Agjencia nxjerr vendim për mbylljen e rastit.
11. Rasti mund te rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana te reja.
12. Agjencia informon raportuesin e rastit në lidhje me vendimin final për rastin.

Neni 19
Raportimi i rasteve të korrupsionit

1. Kur një person dyshon për korrupsion, ai/ajo mund të raportojë rastin e tillë në Agjenci.
2. Në rast se një person zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare vjen në dijeni në lidhje me veprimin korruptiv, duhet të njoftojë Agjencinë dhe njëkohësisht të ndërmarr masat e nevojshme për të ruajtur të dhënat në lidhje me sjelljen korruptive.
3. Paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni nuk përjashton mundësinë e personit për t'i raportuar rastet drejtpërdrejt tek institucionet e tjera kompetente për zbatimin e ligjit.

Neni 20
Qasja në dokumentacion

1. Autoritet publike dhe private, autoritetet lokale dhe personat zyrtar janë të detyruar t'i ofrojnë Agjencisë me kërkesën e saj informacionin e duhur për kryerjen e punëve të tyre si dhe të ofrojnë dokumentacionin përkatës brenda afatit të arsyeshëm kohor të përcaktuar nga Agjencia.
2. Në rast se organet dhe institucionet e parapara në paragrafi 1 të këtij neni refuzojnë që të ofrojnë informacionet e kërkuara, Agjencia njofton prokurorinë e shtetit, i cila vepron në pajtim me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.

Neni 21
Pavarësia në ushtrimin e kompetencave

Zyrtarët e Agjencisë gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare gëzojnë pavarësi të plotë dhe nuk mund t'iu imponohet asnjë presioni nga jashtë për shkak të detyrës së tyre apo kur ndërmarrin veprime të caktuara konkrete në pajtim me këtë ligj apo me ligjet e tjera në fuqi.

KREU VI
MBROJTA E TË DHËNAVE, RUAJTJA E SHËNIMEVE DHE FSHEHTËSIA E INFORMACIONIT

Neni 22

1. Zyrtarët e Agjencisë, çdo person i punësuar nga Agjencia, si dhe të gjithë personat që vihen në dijeni për sekretin zyrtar gjatë bashkëpunimit me Agjencinë, janë të detyruar ta ruajnë si sekret çdo informacion që e kanë mësuar gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, që konsiderohet informacion sekret.
2. Në kuptim të këtij ligji informacion sekret konsiderohen:
   2.1. informacionet në lidhje me të dhënat personale të individëve që janë ose kanë qenë objekt i hetimit nga Agjencia,
   2.2. të dhënat personale të raportuesve të rasteve të korrupsionin nëse një gjë e tillë kërkohet nga raportuesit;
   2.3. si dhe informacionet e tjera publikimi i të cilave mund të dëmtojë procesin e hetimeve.

Neni 23

Agjencia është e detyruar të ruajë të dhënat, informacionin dhe dokumentacionin e marrë në bazë të këtij ligji dhe në pajtim me dispozitat e ligjit në fuqi.

KREU VII
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 24

Zgjedhja e Drejtorit sipas procedurës së paraparë me këtë ligj bëhet pas përfundimit të mandatit të drejtorit aktual të Agjencisë.

Neni 25
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore që janë në kundërshtim me të.

Neni 26
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-159
29 dhjetor 2009

Shpallur me dekretin Nr. DL-006-2010, datë 19.01.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

LIGJI Nr. 04/L-072
PËR KONTROLLIN DHE MBIKËQYRJEN E KUFIRIT SHTETËROR

Përmbajtja

Kreu I: Dispozita të përgjithshme 457
Kreu II: Kompetencat dhe autorizimet për kryerjen e kontrollit kufitar 459
Kreu III: Kalimi i kufirit shteteror 460
Kreu IV: Kontrolli kufitar 460
Kreu V: Pika e kalimit kufitar dhe zona e pikës se kalimit kufitar 467
Kreu VI: Mbikëqyrja e kufirit 469
Kreu VII: Vija kufitare 470
Kreu VIII: Masat e policisë ne brendi te shtetit 472
Kreu IX: Bashkëpunimi ndërmjet organeve shteterore që kanë kompetenca në menaxhimin kufitar 472
Kreu X: Bashkëpunimi policor nderkombëtar 473
Kreu XI: Grumbullimi i te dhënave personale 474
Kreu XII: Dispozita kundërvajtese 476
Kreu XIII: Dispozita kalimtare dhe përfundimtare 479

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR KONTROLLIN DHE MBIKËQYRJEN E KUFIRIT SHTETËROR

KREU I
DISPOZITA TË PERGJITHSHME

Neni l
Qëllimi

Me këtë ligj rregullohet kontrolli kufitar, kompetencat e policisë brenda shtetit, bashkëpunimi ndërmjet organeve shtetërore të cilat kanë kompetencë në menaxhimin kufitar.

Neni 2
Kontrolli kufitar

1. Kontrolli kufitar përfshin kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit, analizën e kërcënimeve dhe rreziqeve për sigurinë nacionale të cilat mund të ndikojnë në sigurinë e kufirit dhe kryhet me qellim të:
   1.1. parandalimit dhe zbulimit të veprave penale dhe kundërvajtjeve dhe të zbulimit dhe kapjes së kryerësve të tyre;

1.2. parandalimit dhe zbulimit të migracionit ilegal dhe trafikimit me qenie njerëzore;
1.3. mbrojtjes së jetës, shëndetit të njerëzve, sigurisë personale, pronës, mjedisit jetësor dhe natyrës; dhe
1.4. parandalimit dhe zbulimit të rreziqeve tjera për rendin publik, rendin juridik, sigurinë nacionale dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

Neni 3
Kuptimi i shprehjeve të veçanta

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
1.1. **Vijë kufitare -** varg pikash në sipërfaqen e tokës të përcaktuara me koordinata, në të cilën shtrihet kufiri shtetëror i cili e kufizon territorin e Republikës së Kosovës nga territori i shteteve fqinje;
1.2. **Kufiri shtetëror -** vija e cila e ndan territorin tokësor, ujor, nëntokësor, hapësirën ajrore te Republikës së Kosovës me shtete fqinj, si dhe kufiri shtetëror në zonën e pikave të kalimit kufitar në aeroporte, nëpërmjet të cilave zhvillohet komunikacioni ndërshtetëror dhe ndërkombëtar;
1.3. **Kontrolli kufitar -** kontrolli i kryer në pikat e kalimit kufitar për të siguruar që personat, mallrat dhe mjetet e tyre të transportit janë të autorizuar të hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës apo të lëshojnë Republikën e Kosovës;
1.4. **Mbikëqyrje kufitare -** mbikëqyrja e kufirit shtetëror ndërmjet pikave te kalimit kufitar dhe mbikëqyrja e pikave te kalimit kufitar jashtë orarit të caktuar të punës me qëllim që të pengohet anashkalimi, përkatësisht shmangia e kontrollit kufitar;
1.5. **Pikat e kalimit kufitar -** vendet e caktuara nga organet kompetente të pushtetit shtetëror për kalimin e kufirit shtetëror, në komunikacionin rrugor, hekurudhor dhe ajror;
1.6. **Zonë e pikës se kalimit kufitar -** hapësira e cila është e nevojshme për kryerjen e kontrollit kufitar dhe procedurave tjera kufitare, si dhe rrethina e drejtpërdrejtë me objektet të cilat nevojiten për zhvillim të papenguar dhe të sigurt të trafikut, kontrollit kufitar dhe procedurave tjera kufitare;
1.7. **Menaxhimi kufitar -** aktivitetet dhe masat të cilat i ndërmarrin organet shtetërorë të cilat janë te autorizuara për menaxhimin kufitar në pajtim me ligjet përkatëse ne fuqi;
1.8. **Kërcënimi për shëndetin publik -** çdo sëmundje me potencial për të kaluar në epidemi siç është definuar në rregullat shëndetësore ndërkombëtare të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe sëmundjet tjera infektuese ose sëmundjet e shkaktuara nga parazitë, nëse janë lëndë e dispozitave mbrojtëse të cilat zbatohen për qytetarët e Republikës së Kosovës;
1.9. **Operator -** personi fizik ose juridik, pronar ose përdorues i aeroportit apo i aerodromit (operatori i aeroportit) dhe personi fizik ose juridik, i cili furnizon përmes transportit hekurudhor (operatori hekurudhor);
1.10. **Kontrolli në vijën e dytë -** kontrolli i mëtejmë i cili mund të realizohet në vend të posaçëm jashtë vendit ku kontrollohen të gjithë udhëtarët;

1.11. **Aviotransportues -** çdo person fizik ose juridik puna e të cilit është sigurimi i transportit të udhëtarëve në trafikun ajror.

Neni 4
Fushëveprimi i ligjit

Ky ligj zbatohet për të gjithë personat të cilët e kalojnë kufirin shtetëror të Republikës së Kosovës, pa i cenuar të drejtat e refugjateve dhe personave të cilët kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare, posaçërisht në përputhje me parimin e moskthimit.

KREU II
KOMPETENCAT DHE AUTORIZIMET PËR KRYERJEN E KONTROLLIT KUFITAR

Neni 5
Organi i cili e kryen kontrollin kufitar

1. Kontrolli kufitar është në kompetencë të Ministrisë së Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejmë: Ministria).
2. Punët që kanë të bëjnë me kontrollin kufitar i kryen policia kufitare ne kuadër te policisë së Republikës se Kosovës, (ne tekstin e mëtejmë; policia kufitare).

Neni 6
Personeli, pajisja dhe mjetet për ushtrimin e kontrollit kufitar

Për ushtrimin e kontrollit kufitar efikas, të unifikuar dhe në nivel të lartë duhet të sistemohen numër i mjaftueshëm i zyrtarëve policor kufitar dhe të sigurohen mjete dhe pajisje të mjaftueshme.

Neni 7
Autorizimet

1. Gjatë kryerjes së kontrollit kufitar zyrtarët policor kufitar punojnë në pajtim me autorizimet e përcaktuara me këtë ligj dhe me legjislacionin ne fuqi.
2. Autorizimet nga paragrafi 1. i këtij neni zyrtarët policor kufitar i zbatojnë në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 8
Respektimi i dinjitetit njerëzor

1. Gjatë kryerjes së kontrollit kufitar zyrtarët policor kufitar detyrohen që të respektojnë dinjitetin njerëzor.
2. Autorizimet që i ndërmarrin zyrtarët policor kufitar gjatë kryerjes së kontrollit kufitar duhet të jenë në proporcion me qëllimin për të cilin ndërmerren.
3. Gjatë kryerjes së kontrollit kufitar zyrtarët policor kufitar nuk bëjnë diskriminim lidhur me gjininë, përkatësinë etnike ose racore, moshën, statusin sociale, bindjen fetare, paaftësinë ose përcaktimin seksual, pozitën pronësore dhe shoqërore.

KREU III
KALIMI I KUFIRIT SHTETEROR

Neni 9
Kalimi i kufirit shtetëror

1. Kufiri shtetëror, kalohet vetëm në pikat e kalimit kufitar, gjatë orarit zyrtar të punës. Orari i punës në pikat e kalimit kufitar të cilat nuk punojnë njëzetekatër (24) orë duhet të jetë i lexueshëm, i qartë, dhe i publikuar në vend të dukshëm.
2. Me përjashtim nga paragrafi 1. i këtij neni, kufiri shtetëror mund të kalohet jashtë pikave te kalimit kufitar dhe jashtë orarit të caktuar të punës:
   2.1. nga personat ose grupe personash kur ekziston kërkese e natyrës së veçantë dhe kur nuk është në kundërshtim me interesat e rendit publik dhe sigurisë nacionale të Republikës së Kosovës;
   2.2. nga personat ose grupe personash në rast të fatkeqësisë ose situatës urgjente të paparaparë.
3. Kalimi i kufirit shtetëror sipas paragrafit 2. te këtij neni behet me leje për kalimin e kufirit shtetëror, te cilën e lëshon Ministria, me afat të vlefshmërisë deri në një (1) vit.
4. Personi i cili synon ta kalojë kufirin shtetëror sipas paragrafit 2. të këtij neni detyrohet që pa vonesë ta njoftojë policinë.

KREU IV
KONTROLLI KUFITAR

Neni 10
Vendi i kryerjes së kontrollit kufitar

1. Kontrolli kufitar kryhen në zonën e pikës se kalimit kufitar.
2. Kontrolli kufitar mund të kryhet edhe jashtë zonës së pikës së kalimit kufitar, në tren, mjet fluturimi, ose në ndonjë vend tjetër.
3. Me përjashtim nga paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare, kontrolli kufitar mund të kryhet edhe në territorin e shtetit fqinj.

Neni 11
Mundësimi i kryerjes së kontrollit kufitar

1. Personi i cili ka për qëllim që ta kalojë kufirin shtetëror ose veç e ka kaluar kufirin shtetëror, detyrohet që të paraqes dokument të vlefshëm udhëtimi ose dokument tjetër të përcaktuar për kalimin e kufirit shtetëror, të mundësoj të kryhet kontrolli kufitar dhe nuk mund ta lëshoje zonën e pikës se kalimit kufitar deri sa nuk kryhen procedurat e nevojshme, duke i përfshirë edhe kontrollin e mjeteve transportuese dhe gjësendeve që i posedon personi i cili e kalon kufirin.
2. Personi nga paragrafi 1. i këtij neni detyrohet që me kërkese të zyrtarit policor kufitar i cili kryen kontrollin kufitar ta informoj për të gjitha rrethanat në lidhje me plotësimin e kushteve për kalimin e kufirit shtetëror dhe të veprojë sipas udhëzimeve dhe urdhrave te zyrtarit policor kufitar.

Neni 12
Kontrolli kufitar i personave

1. Zyrtari policor kufitar gjatë kryerjes së kontrollit kufitar të personave, është i autorizuar që:
   1.1. të kërkoj dokument të vlefshëm udhëtimi ose dokument tjetër të përcaktuar për kalimin e kufirit shtetëror, ta përcaktoj identitetin e personit i cili ka për qëllim ta kalojë kufirin shtetëror;
   1.2. të kontrolloj nëse janë plotësuar kushtet për hyrje dhe dalje nga Republika e Kosovës të përcaktuara me ligj, të jap udhëzime dhe urdhra me qëllim të kryerjes së shpejtë dhe të papenguar të kontrollit kufitar;
   1.3. nëse ekzistojnë, dyshime për vepër penale ose kundërvajtje të kryer, të kryejë kontroll kufitar në vijën e dytë që nënkupton edhe kontrollin ose bastisjen e personit, sendeve dhe mjetit të transportit që ai i posedon;
   1.4. ta kontrolloj vlefshmërinë e dokumentit të udhëtimit, përkatësisht dokumentit tjetër të përcaktuar për kalimin e kufirit shtetëror;
   1.5. të kryeje kontroll të gjurmëve të gishtave dhe pëllëmbëve dhe të dhënave tjera biometrike në evidencat përkatëse, të kryejë kontroll në evidencat operative dhe në evidencat tjera dhe bazat elektronike të dhënave për persona, sende dhe mjete transportuese.

Neni 13
Llojet e kontrollit kufitar

Kontrolli kufitar realizohet si kontroll minimal dhe i plotë kufitar.

Neni 14
Kontrolli kufitar minimal

1. Kontrolli kufitar minimal realizohet për të gjithë personat të cilët e kalojnë kufirin shtetëror me qëllim që të kontrollohet dhe përcaktohet identiteti i tyre në bazë të dokumentit të udhëtimit ose dokumentit tjetër të përcaktuar për kalimin e kufirit shtetëror.
2. Kontrolli kufitar minimal nga paragrafi 1. i këtij neni përbehet nga kontrolli i shpejtë dhe i rëndomte me ndihmën e aparateve teknike përkatëse dhe kontrolli në evidencat përkatëse dhe në bazat elektronike të dhënave. Ky kontroll kryhet me qëllim te vërtetimit nëse dokumenti i udhëtimit, përkatësisht dokumenti tjetër i përcaktuar për kalimin e kufirit shtetëror është i vjedhur, i keqpërdorur, i humbur ose i pavlefshëm si dhe verifikimit te vlefshmërisë se tij dhe të kontrollohet prania e shenjave të cilat dëshmojnë keqpërdorimin, falsifikimin ose ndryshimin e dokumentit.

Neni 15
Kontrolli kufitar i plotë

1. Kontrolli kufitar i plotë gjatë hyrjes përbehet nga kontrolli i plotësimit të kushteve për hyrje në territorin e Republikës së Kosovës, si dhe:

1.1. verifikimi i vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit, përkatësisht dokumentit tjetër të përcaktuar për kalimin e kufirit shtetëror dhe kontrolli i vlefshmërisë së tij, si dhe kontrolli nëse kërkohet, lidhur me posedimin e vizës së nevojshme ose lejen për qëndrim;
1.2. ekzaminimi i dokumentit të udhëtimit, përkatësisht dokumentit tjetër të përcaktuar për kalimin e kufirit shtetëror për zbulimin e shenjave të falsifikimit ose ndryshimit;
1.3. rishikimi i vulave katrore të cilat janë vendosur gjatë hyrjes dhe daljes në dokumentin e udhëtimit me qëllim që të përcaktohet, përmes krahasimit të datave për hyrje dhe dalje, se personi nuk e ka tejkaluar kohëzgjatjen e lejuar për qëndrim në territorin e Republikës së Kosovës;
1.4. konstatimi i vendit të prejardhjes, destinacionit dhe qëllimi i qëndrimit të personit dhe kur është e domosdoshme kontrolli i dokumenteve shtesë;
1.5. konstatimi nëse personi ka mjete të mjaftueshme për jetesë gjatë qëndrimit si dhe për qëllimin qëndrimit te tij, si dhe për kthimin e tij në vendin nga i cili ai vjen ose kalon transit në vendin në të cilin vërtetohet se do të pranohet;
1.6. konstatimi se shtetasi i huaj, mjeti i tij i transportit ose sendet të cilat i bart nuk e rrezikojnë rendin publik, sigurinë nacionale, shëndetin publik ose marrëdhëniet e Republikës së Kosovës me shtetet tjera.

2. Kontrolli kufitar i plotë gjatë daljes përbehet nga:
2.1. konstatimi nëse shtetasi i huaj posedon dokument të vlefshëm të udhëtimit ose dokument tjetër të përcaktuar për kalimin e kufirit shtetëror;
2.2. verifikimi i dokumentit të udhëtimit, përkatësisht i dokumentit tjetër të përcaktuar për kalimin e kufirit shtetëror për zbulimin e shenjave te falsifikimit ose ndryshimit; dhe
2.3. konstatimi se shtetasi i huaj nuk konsiderohet se është i rrezikshëm për rendin publik, sigurinë nacionale dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

3. Përveç kontrollit nga paragrafi 2. i këtij neni kontrolli kufitar i plotë gjatë daljes përmban edhe:
3.1. konstatimin nëse personi posedon vizë të vlefshme për udhëtim në shtet tjetër, përveç kur personi posedon leje të vlefshme për qëndrim;
3.2. konstatimin nëse personi nuk e ka tejkaluar kohëzgjatjen e qëndrimit të lejuar në territorin e Republikës së Kosovës; dhe
3.3. kontrolli në bazat elektronike të të dhënave.

4. Në pikat e kalimit kufitar aty ku është e mundshme dhe nëse personi e kërkon ketë, kontrolli kufitar i plotë mund te realizohen në objekt të veçantë.

5. Personat të cilët i nënshtrohen kontrollit kufitar të plotë në vije të dytë, informohen për qëllimin dhe procedurën e kryerjes së kontrollit, si dhe mundësinë qe te kërkoj emrin dhe mbiemrin, numrin identifikues të zyrtarëve policor kufitar te cilët e kryejnë kontrollin kufitar të plotë, emrin e pikës se kalimit kufitar dhe datën kur është kaluar kufiri.

Neni 16
Lehtësimi i kontrollit kufitar

1. Kontrolli kufitar mund të realizohet në shtrirje të zvogëluar për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme dhe të paparashikuara.
2. Si rrethana të jashtëzakonshme dhe të paparashikuara nga paragrafi 1. i këtij neni konsiderohen ato ngjarje të paparashikuara të cilat sjellin intensitet të tillë të trafikut, me ç'rast koha e pritjes në piken e kalimit kufitar zgjatet jashtë mase edhe përkundër përdorimit të gjitha mundësive dhe potencialit kadrovikë, teknik dhe organizativ.
3. Në rast të kontrollit kufitar nga paragrafi 1. i këtij neni, kontrolli kufitar gjatë hyrjes në Republikën e Kosovës, ka përparësi para kontrollit kufitar gjatë daljes nga Republika e Kosovës.
4. Për lehtësimin e kontrollit kufitar vendos zyrtari policor kufitar përgjegjës për piken e kalimit kufitar.
5. Lehtësimi i kontrollit kufitar është i përkohshëm, vendoset gradualisht dhe korrespondon me rrethanat e arsyeshme.
6. Gjatë kryerjes së kontrollit kufitar nga paragrafi 1. i këtij neni zyrtari policor kufitar vendos vulë katrore në dokumentin e udhëtimit të shtetasve të huaj gjatë hyrjes dhe daljes nga Republika e Kosovës.

Neni 17
Vënia e vulës katrore

1. Zyrtari policor kufitar gjatë kryerjes së kontrollit kufitar të shtetasve të huaj detyrimisht vendos vulë katrore në dokumentin e tyre të udhëtimit gjatë hyrjes dhe daljes nga territori i Republikës së Kosovës.
2. Zyrtari policor kufitar nuk vendos vulë katrore gjatë hyrjes dhe daljes nga territori i Republikës së Kosovës në:
   2.1. dokumentet e udhëtimit të shefave të shteteve si dhe anëtareve të delegacionit të tyre, ardhja e të cilëve është e paralajmëruar zyrtarisht në mënyre diplomatike;
   2.2. lejet e piloteve ose vërtetimet e anëtareve të ekuipazhit të tyre; dhe
   2.3. ne lejet për trafik lokal.
3. Me përjashtim nga paragrafi 1. i këtij neni, me kërkese të shtetasit të huaj mund të lirohet nga vendosja e vulës katrore gjatë hyrjes dhe daljes nga territori i Republikës së Kosovës, nëse vënia e saj mund të krijoje vështirësi serioze për personin. Në ketë rast hyrja ose dalja duhet të shënohen në fletë të veçantë në të cilën shkruhet emri dhe mbiemri i personit dhe numri i dokumentit të udhëtimit ose dokumentit tjetër të përcaktuar për kalimin e kufirit shtetëror, dhe një kopje e fletës i jepet personit.

Neni 18
Hyrja e pjesëtareve të organeve të huaja të sigurisë në Republikën e Kosovës

1. Në Republikën e Kosovës mund të hyjnë pjesëtare të organeve të huaja të sigurisë me uniformë, me armë zjarri, pajisje dhe me automjet që është shënuar me shenja të tyre në pajtim me marrëveshje ndërkombëtare.

2. Rastet nga paragrafi 1. i këtij neni nuk kanë të bëjnë me hyrjen, qëndrimin ose kalimin e forcave të huaja të armatosura në territorin e Republikës së Kosovës për aktivitete ushtruese, trajnim dhe pjesëmarrje në operacione paqeruajtëse dhe humanitare në pajtim me legjislacionin ne fuqi.
3. Pjesëtarët e organeve të huaja të sigurisë dhe ushtarake të cilët me ftesë të institucioneve shtetërore janë në vizitë zyrtare si anëtare të delegacionit mund të hyjnë në Republikën e Kosovës edhe pa leje të veçantë, të mbajnë uniforma dhe armë zjarri të shkurtër, nëse ajo është pjese përbërëse e uniformes së tyre, me njoftim me shkrim paraprakisht në Ministri.
4. Pjesëtarët e organeve të huaja të sigurisë të cilët drejtpërdrejt e sigurojnë përfaqësuesin e shtetit të huaj dhe organizatës ose institucionit ndërkombëtar gjatë vizitës zyrtare ose qëndrimit të ligjshëm në Republikën e Kosovës, mund të mbajnë armë zjarri, municion dhe pajisje në bazë të lejes me shkrim të lëshuar nga Ministria.
5. Në rast te kalimit transit nëpër territorin e Republikës së Kosovës të pjesëtareve të organeve të huaja të sigurisë, për bartjen e armëve, municionit dhe pajisjes nevojitet leja nga paragrafi 4. i këtij neni.

Neni 19
Mënyra e kryerjes së kontrollit kufitar në trafik rrugor

1. Gjatë kryerjes së kontrollit kufitar në trafik rrugor personat të cilët e kalojnë kufirin shtetëror me automjet, sipas rregullit, qëndrojnë në automjet deri sa të kryhet kontrolli.
2. Me përjashtim nga paragrafi 1. i këtij neni, nëse këtë e kërkojnë, rrethanat mund te kërkohet nga personat që të dalin nga automjeti dhe t'i tregojnë gjësendet të cilat i kanë më vete ose në mjetin transportues dhe të kryhet kontrolli i tyre, me qëllim të gjetjes së gjësendeve të ndaluara.
3. Zyrtarët policor kufitar janë të autorizuar të kryejnë kontroll të mjetit transportues, duke e përfshirë edhe çmontimin e pjesëve të tij të veçanta pa urdhër gjyqësor, nëse ekzistojnë baza për dyshim se personi i cili e drejton mjetin transportues bart lëndë të ndaluara, si edhe gjësende dhe dokumente të cilat ndihmojnë në përcaktimin e identitetit të tij ose identitetit te udhëtareve të tjerë në mjetin transportues, si dhe për shkak të pengimit të kalimit joligjor të kufirit shtetëror.

Neni 20
Prania gjatë kontrollit ose bastisjes

Pronari i mjetit transportues, pronari i gjësendeve, përkatësisht personi i cili i posedon ose i shfrytëzon ka të drejtë të jetë i pranishëm gjatë kontrollit ose bastisjes së mjetit transportues dhe të gjësendeve.

Neni 21
Veprimi në pajtim me ligjet tjera

Nëse zyrtari policor kufitar gjatë kontrollit ose bastisjes së personit, gjësendeve ose mjetit transportues gjen gjësende që sipas dispozitave të kodit te procedurës penale dhe

ligjit në fuqi për kundërvajtje duhet të konfiskohen, ose gjësende që janë të nevojshme për udhëheqjen e procedurës penale ose kundërvajtës, procedura do të vazhdohet në pajtim me legjislacionin ne fuqi.

Neni 22
Vendi i kryerjes së kontrollit kufitar ne trafik ajror

1. Kontrolli kufitar në trafik ajror, sipas rregullit, nuk kryhet në avion ose në dalje nga avioni, ose në hyrje, përkatësisht dalje nga terminali i udhëtareve, përveç nëse është e arsyeshme në bazë të vlerësimit të rrezikut lidhur me sigurinë nacionale dhe migrimit ilegal.
2. Me qëllim që të sigurohet se në aeroportet e përcaktuara si pika te kalimit kufitar, kontrolli kryhen në pajtim me legjislacionin ne fuqi, operatori i aeroportit do t'i ndërmarre të gjitha masat e nevojshme për orientimin e udhëtareve në hapësirat e dedikuara për kryerjen e kontrollit kufitar.
3. Operatori i aeroportit detyrohet që t'i ndërmarre të gjitha masat e nevojshme që të pengohet, që personat në mënyrë të paautorizuar të hyjnë ose të dalin nga zona e kufizuar e sigurisë.
4. Kontrolli kufitar, sipas rregullit, nuk kryhet në zonën e transitit, përveç nëse është e arsyeshme në bazë të vlerësimit të rrezikut lidhur me sigurinë nacionale dhe migracionin ilegal.
5. Kontrolli kufitar në zonën e transitit nga paragrafi 4. i këtij neni mund të kryhet për personat të cilët nevojitet të posedojnë vize transite ajrore me qëllim që të kontrollohet nëse ata e posedojnë vizën transite.

Neni 23
Kontrolli kufitar ne fluturimet private

Kapiteni ose udhëheqësi i mjetit fluturues që kryen fluturim privat, i cili fluturon nga shteti tjetër ose në shtetin tjetër, para fluturimit, duhet të dorëzoj deklaratë të përgjithshme të përbëre nga plani për fluturim në pajtim me Aneksin 2 të Konventës për Aviacion civil ndërkombëtar, si dhe informata të cilat kanë të bëjnë me identitetin e udhëtareve.

Neni 24
Obligimi i aviotransportuesve për dorëzimin e të dhënave për udhëtaret

1. Transportuesit ajror detyrohen që me kërkese të stacionit policor kompetent për kontrollin kufitar, me qëllim te lehtësimit te kryerjes së kontrollit kufitar, deri në fund të paraqitjes së udhëtareve të dorëzojnë informata të cilat kanë të bëjnë me udhëtarët që i bartin në pikën e përcaktuar kufitare nëpërmjet të cilës ata do të hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës.
2. Informata nga paragrafi 1. i këtij neni i përmban të dhënat si në vijim:
   2.1. numrin dhe llojin e dokumentit të udhëtimit ose dokumentit tjetër të vlefshëm të përcaktuar për kalimin e kufirit shtetëror;
   2.2. shtetësinë;

2.3. emrin dhe mbiemrin;
2.4. datëlindjen;
2.5. pikën e kalimit kufitar për hyrje në territorin e Republikës së Kosovës;
2.6. numrin e fluturimit;
2.7. kohën e nisjes dhe arritjes së transportit;
2.8. numrin e përgjithshëm të udhëtarëve;
2.9. dokumentin përcjellës te mallrave; dhe
2.10. pikën fillestare të nisjes.

3. Të dhënat nga paragrafi 2. i këtij neni dërgohen nëpërmjet mjeteve elektronike, ose në rast të dërgimit të pasuksesshëm, në mënyre tjetër përkatëse.

Neni 25
Kontrolli kufitar ne trafik hekurudhor

1. Kontrolli kufitar ne trafik hekurudhor kryhet në zonën e pikës së kalimit kufitar për trafikun hekurudhor.
2. Kontrolli i kalimit të kufirit bëhet për personat që udhëtojnë me tren dhe për personelin zyrtar hekurudhor.
3. Në rast se nuk është e mundur të kryhet kontrolli kufitar në pikën e kalimit kufitar për trafikun hekurudhor, kontrolli kufitar mund të kryhet brenda në tren, gjatë lëvizjes.
4. Zyrtari policor kufitar, nëse nevojitet, mund të urdhëroj që të inspektohen hapësirat e fshehta te vagonit, me ndihmën e inspektorit të trenit, për të siguruar se personat ose objektet që duhet t`i nënshtrohen kontrollit kufitar nuk janë fshehur në to.
5. Makinisti i trenit, në qarkullimin ndërkombëtar, nuk mund ta ndalë trenin ndërmjet kufirit dhe pikës së kalimit kufitar, përveç rasteve kur kjo bëhet e nevojshme, për shkak të rregullimit të qarkullimit hekurudhor ose në rast të ndonjë force madhore.
6. Në rast të qëndrimit në këtë zonë, makinisti njofton menjëherë stacionin me të afërt të policisë, si dhe merr masa emergjente për të penguar largimin e udhëtarëve nga treni.

Neni 26
Kategoritë e personave për të cilët vlejnë rregulla të posaçme gjatë kryerjes së kontrollit kufitar

1. Gjatë kryerjes së kontrollit kufitar, rregulla të veçanta vlejnë për kategoritë e personave, si vijojnë:
1.1. shefat e shteteve dhe anëtaret e delegacionit te tyre;
1.2. pilotet dhe anëtaret e ekuipazhit të tyre;
1.3. bartësit e pasaportave diplomatike, ose zyrtare dhe anëtaret e organizatave ndërkombëtare;
1.4. punëtoret ndërkufitar;
1.5. personat e mitur; dhe
1.6. poseduesit e lejeve për komunikacion kufitar lokal.

KREU V
PIKA E KALIMIT KUFITAR DHE ZONA E PIKËS SE KALIMIT KUFITAR

Neni 27
Përcaktimi dhe kategorizimi i pikës se kalimit kufitar

Pikat e kalimit kufitar, orarin e punës dhe kategorizimin e pikave te kalimit kufitar i përcakton Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 28
Pika e kalimit kufitare te përkohshme

1. Me përjashtim nga neni 27 i këtij ligji, Ministria në pajtim me Ministrinë e Financave dhe organin kompetent të shtetit fqinj, mund të përcaktoj pika te përkohshme te kalimit kufitar, nëse kjo është e nevojshme për kryerjen e veprimtarive afatshkurtra, siç janë:
   1.1. aktivitete dhe manifestime kulturore, shkencore, profesionale, sportive dhe turistike;
   1.2. masa për riorientim të trafikut;
   1.3. realizimi i aktiviteteve që dalin nga marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare;
   1.4. aktivitete bujqësorë dhe ekonomike; dhe
   1.5. punë tjera me interes publik.
2. Pika e përkohshme e kalimit kufitar mund të përcaktohet në kohëzgjatje deri në gjashtë (6) muaj gjatë një (1) viti kalendarik, ndërsa për rastet nga nën-paragrafi 1.4. dhe 1.5. të paragrafit 1. të këtij neni gjatë kohëzgjatjes së atyre aktiviteteve, përkatësisht në kohëzgjatje deri sa ekziston interesi publik.
3. Në vendimin nga paragrafi 1. i këtij neni përcaktohet orari i punës, vëllimi i shfrytëzimit të pikës se kalimit kufitar, mënyra e kalimit të kufirit shtetëror, kushtet e nevojshme për kalimin e kufirit shtetëror dhe shpenzimet për përcaktimin e pikës se përkohshme te kalimit kufitar.

Neni 29
Zona e pikës se kalimit kufitar

1. Zona e pikës se kalimit kufitar përcaktohet nga Ministria ne konsultim me Ministrinë e Financave.
2. Në pikat e kalimit kufitar të përbashkëta me shtetin fqinj, zona e pikës se kalimit kufitar përcaktohet në pajtim me marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 30
Shënimi i pikës se kalimit kufitar dhe zonës së saj

1. Pika e kalimit kufitar dhe zona e saj shënohen me tabela kufitare, shenja dhe sinjalizim tjetër.
2. Tabelat kufitare, shenjat dhe sinjalizimi tjetër nga paragrafi 1. i këtij neni, me propozim të Ministrisë i vendos dhe i mirëmban Ministria kompetente për infrastrukture.

3. Me përjashtim nga paragrafi 2. i këtij neni, tabelat kufitare, shenjat dhe sinjalizimin tjetër të pikës se kalimit kufitar dhe zonës së saj në aeroporte, dhe në komunikacionin hekurudhor, me propozim të Ministrisë i vendos dhe mirëmban operatori.

Neni 31
Kushtet për ndërtim dhe rregullim

1. Objektet të cilat i shfrytëzon Ministria në pikat e kalimit kufitar duhet të planifikohen, ndërtohen dhe rregullohen ne mënyrë që të mundësojnë kryerje të sigurt, të papenguar dhe ekonomike të kontrollit kufitar në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe aktet që i përcakton Qeveria e Republikës së Kosovës.
2. Operatori detyrohet që të siguroje kushte përkatëse për punë, hapësire dhe objekte që mundësojnë kryerje të papenguar të kontrollit kufitar, në pajtim me këtë ligj.
3. Operatori i aeroporteve në të cilat zhvillohet komunikacioni ajror ndërkombëtar detyrohet që të krijoje kushte për vendosje të të huajve të cilët nuk i plotësojnë kushtet për hyrje në Republikën e Kosovës, si dhe të udhëtareve të cilët kalojnë transit nëpër territorin e Republikës së Kosovës.
4. Shpenzimet për sigurimin e kushteve dhe standardeve nga paragrafët 1., 2. dhe 3. të këtij neni dhe nga neni 22 i këtij ligji, janë në ngarkim të operatorit.
5. Marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet operatoreve dhe organeve shtetërore kompetente lidhur me shfrytëzimin e lokaleve dhe objekteve të dedikuara për kryerjen e kontrollit kufitar rregullohen me marrëveshje.

Neni 32
Ndërtimi dhe vendosja e objekteve dhe ndryshimi i veprimtarisë në zonën e pikës se kalimit kufitar

1. Ndërtimi dhe vendosja e objekteve dhe ndryshimi i veprimtarisë në zonën e pikës se kalimit kufitar nuk mund te pengojnë kryerjen e detyrave dhe zbatimin e masave të sigurisë në kufirin shtetëror.
2. Kryerësi i veprimtarisë në zonën e pikës se kalimit kufitar detyrohet që veprimtarinë ta kryeje në lokale përkatëse të dedikuara për atë qellim.
3. Investuesi ose pronari i objektit, përkatësisht kryerësi i veprimtarisë detyrohet që para fillimit të aktiviteteve për ndërtim, vendosje të objekteve ose ndryshim te veprimtarisë të merr leje nga Ministria.
4. Leja nga paragrafi 3. i këtij neni nuk do të lëshohet, nëse me objektin ose veprimtarinë pengohet kryerja e pandërprere e kontrollit kufitar dhe zbatimi i masave të sigurisë në kufirin shtetëror si dhe nëse nuk është në pajtim me planin urbanistik për pikën e kalimit kufitar përkatëse.

Neni 33
Lëvizja dhe qëndrimi në zonën e pikës se kalimit kufitar

1. Në zonën e pikës së kalimit kufitar lejohet lëvizja dhe qëndrimi i personave, i mjeteve dhe i mallrave që kalojnë kufirin, me qellim te kontrollit kufitar, si dhe i personave apo i mjeteve që kanë autorizim nga organet shtetërore.

2. Udhëtarët dhe personat tjerë të cilët gjenden në zonën e pikës se kalimit kufitar, detyrohen që t'i respektojnë udhëzimet dhe urdhrat e zyrtarëve policor kufitar.

Neni 34
Obligimi i personave të cilët kryejnë veprimtari në zonën e pikës se kalimit kufitar

1. Operatori dhe personat tjerë juridike dhe fizik të cilët në zonën e pikës se kalimit kufitar kryejnë veprimtari, detyrohen qe stacionit policor kompetent t'i dorëzojnë të dhëna personale për të punësuarit para se të fillojnë punën në zonën e pikës se kalimit kufitar.
2. Për të punësuarit nga paragrafi 1. i këtij neni dorëzohen të dhënat personale në vijim: emri dhe mbiemri, numri personal i qytetarit, datëlindja, vendlindja, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi dhe shtetësia.
3. Të dhënat personale nga paragrafi 2. i këtij neni ruhen një vit nga dita e pushimit të marrëdhënies së punës të punësuarit në zonën e pikës se kalimit kufitar.
4. Të punësuarit nga paragrafi 1. i këtij neni, duhet te mbajnë kartelën e identifikimit ne vend te dukshëm e cila përmban të dhëna për emrin dhe mbiemrin, fotografi dhe të dhëna për emrin e operatorit, përkatësisht personit juridik ose fizik, tek i cili janë të punësuar.
5. Operatori, personi tjetër juridik ose fizik nga paragrafi 1. i këtij neni, detyrohen që të sigurojnë kartelë për të punësuarit para fillimit të punës në zonën e pikës se kalimit kufitar.

KREU VI
MBIKËQYRJA E KUFIRIT

Neni 35
Qëllimi i mbikëqyrjes se kufirit

Mbikëqyrja e kufirit kryhet me qëllim të parandalimit të kalimit ilegal të kufirit shtetëror, parandalimit të krimit tejkufitar dhe ndërmarrjes së masave kundër personave të cilët ne mënyrë te paligjshme e kanë kaluar kufirin.

Neni 36
Mënyra e kryerjes së mbikëqyrjes kufirit

1. Mbikëqyrja e kufirit kryhet me qëllim të parandalimit dhe dekurajimit te personave të cilët kanë për qëllim që ta evitojnë kontrollin kufitar në pikat e kalimit kufitar.
2. Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes se kufirit zyrtaret policor kufitar përdorin aparate statike ose mobile.

Neni 37
Metoda për kryerjen e mbikëqyrjes se kufirit

Mbikëqyrja e kufirit kryhet nga ana e zyrtarëve policore kufitar, numri i të cilëve dhe metodat e veprimit janë të përshtatura me rreziqet dhe kërcënimet ekzistuese.

Neni 38
Njësitë dhe mjetet policore për mbikëqyrjen e kufirit

1. Mbikëqyrja e kufirit kryhet me përdorimin e njësive policore statike dhe mobile nëpërmjet patrullimit ose vendosjes në vende të cilat konsiderohen si kalime ilegale, me qëllim të zbulimit dhe pengimit të personave të cilët ne mënyrë te paligjshme e kalojnë kufirin shtetëror.
2. Mbikëqyrja e kufirit mund të kryhet edhe me mjete teknike, duke përfshirë edhe mjetet elektronike.
3. Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes se kufirit, policia kufitare është e autorizuar që të shfrytëzojë qen kufiri dhe të vendos pengesa me të cilat pamundësohet kalimi ilegal i kufirit shtetëror.

Neni 39
Mundësimi i mbikëqyrjes kufirit

1. Pronarët, përkatësisht shfrytëzuesit e tokës bujqësorë detyrohen që t'u mundësojnë kalim të lirë zyrtarëve policor kufitar për kryerjen e papenguar të mbikëqyrjes kufitare dhe zyrtarëve tjerë të cilët janë kompetent për vendosjen dhe mirëmbajtjen e mjeteve dhe aparateve teknike si dhe mirëmbajtjen e tabelave kufitare dhe shenjave.
2. Zyrtarët policor kufitar, pavarësisht nga dispozitat e përcaktuara me ligj tjetër dhe vullneti i personave nga paragrafi 1. i këtij neni, mund të lëvizin nëpër pronë dhe t'i shfrytëzojnë të gjitha llojet e mjeteve transportuese, në rast kur kjo është e nevojshme për kryerjen e punëve nga paragrafi 1. i këtij neni.

KREU VII
VIJA KUFITARE

Neni 40
Përcaktimi dhe shënimi i vijës kufitare

Qeveria e Republikës së Kosovës, emëron anëtaret e komisionit shtetëror për shënjimin dhe mirëmbajtjen e kufirit shtetëror, te vendosur në bazë te marrëveshjes ndërkombëtare.

Neni 41
Tabela kufitare dhe sinjalizimi

1. Nëse vija kufitare nuk është mjaft e dukshme, në afërsi të saj, vendosen tabela kufitare, shenja dhe sinjalizim tjetër me të cilat paralajmërohet afrimi drejt vijës kufitare.
2. Tabelat kufitare, shenjat dhe sinjalizimin tjetër nga paragrafi 1. i këtij neni, me propozim të Ministrisë i vendos dhe i mirëmban Ministria e Infrastrukturës.
3. Në tabelat kufitare, shenjat dhe në sinjalizimin tjetër ndalohet vendosja e tabelave tjera, shenjave ose sinjalizimit me të cilin do te dobësohet dukshmëria e tabelave kufitare.

Neni 42
Ndalimi për kryerjen e aktiviteteve përgjatë vijës kufitare për shkaqe sigurie

1. Ministria, për shkaqe sigurie mund ta ndaloje gjuetinë, peshkimin, fluturimin e avionëve dhe mjeteve tjera për fluturim, lëvizjen, qëndrimin në thellësi deri në pesëqind (500) metra nga vija kufitare në tërë ose në një pjesë të kufirit shtetëror.
2. Ndalimi nga paragrafi 1. i këtij neni zgjatë deri sa zgjasin shkaqet e sigurisë.

Neni 43
Dukshmëria e vijës kufitare dhe masat për mirëmbajtjen e saj

1. Vija kufitare në pajtim me marrëveshje ndërkombëtare duhet të pastrohet nga trungjet, kaçubat të cilat e zvogëlojnë dukshmërinë e tabelave kufitare, shenjave dhe sinjalizimit si dhe zgjatimin e vijës kufitare. Përgjegjëse për mirëmbajtjen e vijës kufitare është Ministria kompetente për bujqësi dhe pylltari.
2. Për dukshmërinë e vijës kufitare Ministria mund ta ndalojë mbjelljen e llojeve të caktuara të kulturave bujqësorë, mbjelljen e drunjtëve dhe bimëve tjera përgjatë vijës kufitare.
3. Nëse për shkak të ndalimit nga paragrafi 2. i këtij neni personat juridik ose fizik pësojnë dëm, ata kane të drejtë në kompensim në pajtim me dispozitat e ligjit përkatës ne fuqi.

Neni 44
Rregullimi i hapësirës përgjatë vijës kufitare

1. Planet urbanistike me të cilat rregullohet hapësira deri në pesëqind (500) metra nga vija kufitare dhe nga zona e pikës kufitare miratohen me pëlqim paraprak të Ministrisë.
2. Në rast kur me planet urbanistike rregullohet hapësira e zonës së pikave te kalimit kufitar pëlqim e jep edhe Ministria e Financave.
3. Ministria nuk do të japë pëlqim për miratimin e planit urbanistik nga paragrafi 1. i këtij neni, nëse me të pengohet dukshmëria e kufirit shtetëror.
4. Ministria e Financave nuk do të japë pëlqim për miratimin e planit urbanistik nga paragrafi 2. i këtij neni, nëse me të pengohet zbatimi i kompetencave doganore në pajtim me ligj.

Neni 45
Incident kufitar

1. Sipas këtij ligji incidente kufitare, janë aktivitetet e organeve të huaja shtetërore në territorin e Republikës së Kosovës të kryera nga ana e zyrtarëve të organeve shtetërore te shteteve fqinje, të cilat nuk janë të lejuara me marrëveshje ndërkombëtare dhe me legjislacionin e Republikës së Kosovës.
2. Ministria e Punëve te Jashtme ne bashkëpunim me Ministrinë verifikon dhe zgjedh incidentet kufitare.

KREU VIII
MASAT E POLICISË NE BRENDI TE SHTETIT

Neni 46
Masat në brendi të shtetit

1. Në përputhje me këtë ligj, aktivitetet për kontrollin kufitar mund të kryhen në mbarë Republikën e Kosovës. Me qëllim të pengimit të trafikimit me qenie njerëzore, kontrabandës së emigrantëve, kalimeve të paligjshme të kufirit dhe për të siguruar kontrollin e të huajve, zyrtarët policor kufitar autorizohen të:
   1.1. kontrollojnë dhe zbatojnë masa adekuate me qëllim të zbulimit të hyrjes dhe qëndrimit të paligjshëm të shtetasve dhe të personave të huaj në Republikën e Kosovës;
   1.2. kontrollojnë personat, sendet dhe automjetet jashtë zonave të kalimit kufitar.

KREU IX
BASHKËPUNIMI NDËRMJET ORGANEVE SHTETERORE QË KANË KOMPETENCA NË MENAXHIMIN KUFITAR

Neni 47
Bashkëpunimi i organeve shtetërore në fushën e menaxhimit kufitar

1. Ne ushtrimin e kontrollit kufitar Ministria bashkëpunon me organet tjera shtetërore që kanë kompetenca në menaxhimin kufitar në pajtim me ligj.
2. Bashkëpunimi nga paragrafi 1. i këtij neni realizohet ndërmjet Ministrisë, Ministrisë së financave, Ministrisë së punëve të jashtme, Agjencisë së ushqimit dhe veterinës si dhe organeve tjera shtetërore që kanë kompetenca në menaxhimin kufitar.
3. Organet shtetërore nga paragrafi 2. i këtij neni bashkëpunojnë me qëllim të:
   3.1. mundësimit të qarkullimit më të shpejtë të personave,mallrave dhe mjeteve transportuese në pikat e kalimit kufitar;
   3.2. pengimit dhe zbulimit të krimit ndërkufitar, mbledhjes, analizës dhe shkëmbimit të të dhënave dhe informatave lidhur me menaxhimin kufitar; dhe
   3.3. realizimit të formave tjera të bashkëpunimit në pajtim me kompetencat e organeve shtetërore të përcaktuara me ligj.

Neni 48
Mënyra e bashkëpunimit ndërmjet organeve shtetërore në kufirin shtetërorë

1. Organet shtetërore te përfshira ne menaxhimin kufitar duhet te ndihmojnë njëra tjetrën dhe duhet te bashkëpunojnë ngushtë dhe ne vazhdimësi me qëllim te realizimit sa me efikas dhe efektiv te kontrolli kufitar.
2. Bashkëpunimi nga paragrafi 1. i këtij neni realizohet përmes Strategjisë për Menaxhimin e Integruar te Kufirit.

Neni 49
Qendra kombëtare për menaxhim kufitar

1. Për arritjen e bashkërendimit efikas, lehtësimit të shkëmbimit të të dhënave dhe informatave si dhe efikasitetit më të madh të sistemit për menaxhim të integruar te kufirit, themelohet Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit (ne testin e mëtejmë: Qendra).
2. Në punën e Qendrës kombëtare në pajtim me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare mund të marrin pjesë edhe oficeri për ndërlidhje i shtetit të huaj, organizata ndërkombëtare dhe institucionet tjera.
3. Funksionimi, detyrat dhe përgjegjësit e qendrës kombëtare për menaxhimin e kufirit përcaktohen me akt nënligjor te nxjerrë nga Qeveria.

KREU X
BASHKËPUNIMI POLICOR NDERKOMBËTAR

Neni 50
Bashkëpunimi policor ndërkombëtar

Bashkëpunimi policor ndërkombëtar në kryerjen e kontrollit kufitar përfshin aktivitete të shërbimeve të huaja policore në territorin e Republikës së Kosovës, përkatësisht të policisë se Kosovës në territorin e shteteve tjera, si dhe bashkëpunimin me organe të huaja të sigurisë dhe shkëmbim të oficereve për ndërlidhje.

Neni 51
Bashkëpunimi me zyrtaret e huaj policor

1. Në Republikën e Kosovës mund të hyjnë zyrtar policor të autorizuar të shteteve tjera dhe të kryejnë pune të parapara me marrëveshje ndërkombëtare.
2. Zyrtaret policor të Kosovës, në pajtim me marrëveshje ndërkombëtare, në shtete tjera mund të kryejnë punë siç është përcaktuar ne paragrafin 1. te këtij neni.
3. Zyrtarët e huaj policor në territorin e Republikës së Kosovës mund të shfrytëzojnë pajisje teknike dhe automjete me shenja të tyre, të mbajnë uniforme, armë dhe mjete tjera për detyrim, në kushte dhe në mënyre të përcaktuar me marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 52
Bashkëpunimi me organet e huaja të sigurisë

Ministria në pajtim me marrëveshje ndërkombëtare bashkëpunon me organet e huaja të sigurisë në kryerjen e kontrollit kufitar.

Neni 53
Oficerët për ndërlidhje

Ministria në pajtim me marrëveshjen ndërkombëtare mund të dërgoje jashtë vendit oficerët për ndërlidhje, për kryerjen e punëve të bashkëpunimit policor ndërkombëtar, si dhe u përcakton detyra konkrete dhe autorizime.

KREU XI
GRUMBULLIMI I TE DHËNAVE PERSONALE

Neni 54
Grumbullimi, përpunimi dhe shfrytëzimi i të dhënave

1. Gjatë kryerjes së kontrollit kufitar dhe punëve tjera të përcaktuara me këtë ligj policia kufitare është e autorizuar që nga personat ndaj të cilëve i aplikon autorizimet policore, drejtpërdrejt të grumbulloj të dhëna personale që përpunohen në evidenca, me aplikimin e aparateve teknike në pajtim me këtë ligj, si dhe të shfrytëzojë të dhëna personale dhe të dhëna tjera nga evidencat që themelohen dhe mbahen në bazë të ligjeve tjera.
2. Policia kufitare detyrohet që grumbullimin, përpunimin dhe shfrytëzimin e të dhënave personale nga paragrafi 1. i këtij neni ta bëjë në pajtim me dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 55
Aplikimi i mjeteve teknike

1. Policia kufitare është e autorizuar që gjatë kryerjes së kontrollit kufitar me qëllim të hetimit, përcaktimit të identitetit dhe gjetjes së kryerësve të veprave penale dhe kundërvajtjeve, të bëjë fotografim, incizim dhe video mbikëqyrje, si dhe të aplikojë mjetet tjera teknike.
2. Mjetet teknike nga paragrafi 1. i këtij neni, kur janë të vendosura në zonën e pikës kufitare, doemos duhet të jene të dukshme si edhe personat të cilët gjenden në zonën e tillë doemos duhet të paralajmërohen për ekzistimin e mjeteve të tilla.
3. Nëse me mjete teknike nga paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni incizohen të dhëna personale, nevojitet që ato incizime të asgjësohen në afat prej gjashte muajsh nga dita e incizimit, përveç nëse nuk janë të nevojshme për ndjekjen e kryerësve të veprave penale ose kundërvajtjeve, në pajtim me ligj.

Neni 56
Evidenca

1. Policia kufitare është e autorizuar që për nevojat e kontrollit kufitar dhe punët tjera në pajtim me këtë ligj, të mbajë:
   1.1. evidencë për personat dhe mjetet e transportit qe i nënshtrohen kontrollit kufitar;
   1.2. evidencë të personave të cilëve u është dhënë leje për kalimin e kufirit shtetëror jashtë pikave te kalimit kufitar dhe jashtë orarit të përcaktuar të punës në pikat e kalimit kufitar;
   1.3. evidencë të lejeve të dhëna për futjen dhe mbajtjen e armës, municionit dhe pajisjeve në Republikën e Kosovës nga ana e pjesëtarëve të organeve të huaja të sigurisë;
   1.4. evidencë të incidenteve të kryera kufitare;
   1.5. evidencë për të dhënat personale të të punësuarve te operatori dhe personat tjerë juridike ose fizike të cilët në zonën e pikës kufitare kryejnë veprimtari;

1.6. evidencë për vizat e lëshuara ne pikat e kalimit kufitar;
1.7. evidencë për lehtësimin e kontrollit kufitar; dhe
1.8. evidencë për refuzimin e hyrjes ne kufi.

Neni 57
Të dhëna personale

1. Në evidencat nga nën-paragrafi 1.1. paragrafi 1. i nenit 56 te këtij ligji, grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat personale në vijim: emri dhe mbiemri, datëlindja, të dhënat për dokumentin e udhëtimit ose dokumentin tjetër të përcaktuar për kalimin e kufirit shtetëror me të cilin personi e ka kaluar kufirin shtetëror, fotografia e personit që e ka kaluar kufirin shtetëror, vendqëndrimi, shtetësia, vendi, koha dhe drejtimi.
2. Në evidencën nga nën-paragrafi 1.2. paragrafi 1. i nenit 56 te këtij ligji grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat personale në vijim: emri dhe mbiemri, datëlindja, vendlindja, vendqëndrimi, shtetësia, lloji dhe numri i dokumentit në bazë të cilit është dhënë leja, shkaku për dhënien e lejes, vendi i kalimit të kufirit shtetëror dhe afati i vlefshmërisë së lejes.
3. Në evidencat nga nën-paragrafi 1.3. paragrafi 1. i nenit 56 te këtij ligji grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat personale në vijim: emri dhe mbiemri, datëlindja, vendlindja, vendqëndrimi, shtetësia, lloji dhe numri i dokumentit të udhëtimit dhe dokumentit tjetër të vlefshëm të përcaktuar për kalimin e kufirit shtetëror, lloji i armëve, pajisjes dhe numri i municionit.
4. Në evidencat nga nën-paragrafi 1.4. paragrafi 1. i nenit 56 te këtij ligji grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat personale në vijim: emri dhe mbiemri, datëlindja, vendlindja, vendqëndrimi, shtetësia, koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së incidentit kufitar, lloji, numri dhe afati i vlefshmërisë së dokumenteve në bazë të të cilave është përcaktuar identiteti.
5. Në evidencat nga nën-paragrafi 1.5. paragrafi 1. i nenit 56 te këtij ligji grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat personale në vijim: emri dhe mbiemri, datëlindja, vendlindja, vendbanimi ose vendqëndrimi, shtetësia, data e fillimit dhe e ndërprerjes së punës në zonën e pikës kufitare, emri i personit tjetër juridik ose fizik tek i cili personi është i punësuar.
6. Në evidencat nga nën-paragrafi 1.6. paragrafi 1. i nenit 56 te këtij ligji grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat personale në vijim: emri dhe mbiemri, datëlindja, vendlindja, vendbanimi ose vendqëndrimi, shtetësia, llojin dhe kohëzgjatjen e vizës.
7. Në evidencat nga nën-paragrafi 1.7. paragrafi 1. i nenit 56 te këtij ligji grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat personale në vijim: emri i pikës se kalimit kufitar e cila i nënshtrohet lehtësimit te kontrollit kufitar, koha kur ka filluar dhe kur ka mbaruar lehtësimi i kontrollit kufitar, arsyeja e zbatimit te lehtësimit te kontrollit kufitar dhe te dhënat e zyrtarit qe ka urdhëruar lehtësimin e kontrollit kufitar.
8. Në evidencat nga nën-paragrafi 1.8. paragrafi 1. i nenit 56 te këtij ligji grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat personale në vijim: emri dhe mbiemri, datëlindja, vendlindja, vendbanimi ose vendqëndrimi, shtetësia, llojin

dhe kohëzgjatjen e vizës (nëse për hyrje kërkohet viza), vendi i fundit prej ku është nisur ne drejtim te Republikës se Kosovës, arsyeja e refuzimit, pika e kalimit kufitar ku është bërë refuzimi, ndalesa për hyrje, nëse aplikohet, dhe te dhënat e zyrtarit i cili e bënë refuzimin e hyrjes.

9. Të dhënat personale nga evidenca nga paragrafi 1. i këtij neni ruhen pesë (5) vjet nga dita e shënimit.
10. Të dhënat personale nga evidenca nga paragrafi 2. i këtij neni ruhen dy (2) vjet pas kalimit të kohës për të cilën është dhënë leja.
11. Të dhënat personale nga evidenca nga paragrafi 3. i këtij neni ruhen tri (3) vjet nga dita e hyrjes së realizuar në territorin e Republikës së Kosovës.
12. Të dhënat personale nga evidenca nga paragrafi 4. i këtij neni ruhen pesë (5) vjet nga dita e kryerjes së incidentit kufitar.
13. Të dhënat personale nga evidenca nga paragrafi 5. i këtij neni ruhen dy (2) vjet nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës në zonën e pikës kufitare.
14. Të dhënat personale nga evidenca nga paragrafi 6. i këtij neni ruhen pesë (5) vjet nga dita e lëshimit te vizës në kufi.
15. Të dhënat personale nga evidencat nga paragrafi 7. dhe 8. te këtij neni ruhen dy (2) vjet nga dita e zbatimit te lehtësimit te kontrolli kufitar përkatësisht nga dita e refuzimit te hyrjes.

Neni 58
Mbikëqyrja e përpunimit e të dhënave personale

Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale kryen mbikëqyrjen, përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e tyre të përcaktuar me këtë ligj.

KREU XII
DISPOZITA KUNDERVAJTESE

Neni 59

1. Me gjobë prej pesëqind (500) deri tetëqind (800) Euro do t'i shqiptohet dënimi për kundërvajtje, personit fizik i cili:
   1.1. do ta kaloj ose do të tentojë që ta kaloj kufirin shtetëror jashtë pikës së kalimit kufitar dhe jashtë orarit të punës të pikës kufitare (paragrafi 1. i nenit 9 të këtij ligji);
   1.2. do ta kaloj ose do të tentojë që ta kaloje kufirin shtetëror në kundërshtim me dispozitën për kalimin e kufirit (paragrafi 3. i nenit 10 të këtij ligji);
   1.3. gjatë kontrollit kufitar nuk jep në shikim dokumentin e vlefshëm të udhëtimit ose dokumentin tjetër të përcaktuar për kalimin e kufirit shtetëror, nuk mundëson që të kryhen kontrolle kufitare dhe e lëshon zonën e pikës së kalimit kufitar para se të kryhen procedura te nevojshme, duke i përfshirë edhe kontrollin e mjetit transportues dhe sendeve që i posedon (paragrafi 1. i nenit 11 të këtij ligji);
   1.4. kapiteni i mjetit fluturues privat, përkatësisht mjetit fluturues që shfrytëzohet për transport për nevoja personale i cili fluturon nga shteti

tjetër ose në shtetin tjetër, e para fluturimit në stacionin policor për kontrollin kufitar nuk dorëzon deklaratë të përgjithshme të përbëre nga plani për fluturim në pajtim me Aneksin 2 të Konventës për Aviacion civil ndërkombëtar, si dhe informata të cilat kanë të bëjnë me identitetin e udhëtareve (neni 23 i këtij ligji); dhe

1.5. gjuan, peshkon, fluturon me mjete fluturuese dhe mjete tjera për fluturim, lëviz, qëndron dhe vendoset përgjatë vijës kufitare në tere ose në një pjesë të kufirit shtetëror, nëse kjo është e ndaluar (paragrafi 1. i nenit 42 të këtij ligji).

Neni 60

1. Me gjobe prej njëqind (100) deri pesëqind (500) Euro do t'i shqiptohet dënimi për kundërvajtje personit fizik:
   1.1. i cili do të veprojë në kundërshtim me paragrafi 4. të nenit 9 të këtij ligji;
   1.2. i cili nuk do të japë njoftim për të gjitha rrethanat lidhur me përmbushjen e kushteve për kalimin e kufirit shtetëror, nuk vepron sipas paralajmërimeve dhe urdhrave të zyrtarit policor i cili e kryen kontrollin kufitar (paragrafi 2. i nenit 11 të këtij ligji);
   1.3. makinistit që në komunikacionin ndërkombëtar do ta ndalojë trenin në pjesën e hekurudhës ndërmjet vijës kufitare dhe zonës së pikës se kalimit kufitar, përveç kur kjo është e nevojshme për rregullimin e komunikacionit hekurudhor ose në rast të fuqisë madhore (paragrafi 5. i nenit 25 të këtij ligji);
   1.4. .makinistit që nuk do t'i ndërmarr masat e nevojshme me qëllim të pamundësimit të udhëtareve që ta lëshojnë trenin, përkatësisht pamundësimit të hyrjes së personave në tren dhe për ndaljen e trenit nuk e njofton policinë (paragrafi 6. i nenit 25 të këtij ligji);
   1.5. i cili veprimtarinë në zonën e pikës kufitare nuk e kryen në lokale përkatëse të dedikuara për këtë qëllim (paragrafi 2. i nenit 32 të këtij ligji);
   1.6. i cili nuk ka siguruar leje nga Ministria para fillimit të aktiviteteve për ndërtim, vendosje të objekteve ose ndryshim të veprimtarisë në zonën e pikës së kalimit kufitar (paragrafi 3. i nenit 32 të këtij ligji);
   1.7. i cili lëviz ose qëndron në zonën e pikës se kalimit kufitar pa qëllim që ta kaloje kufirin shtetëror ose tanimë e ka kaluar dhe në piken e kalimit kufitar nuk mbahet për shkak të kontrollit kufitar ose nuk ka shkaqe të arsyeshme për këtë (paragrafi 1. nenit 33 të këtij ligji);
   1.8. i cili në zonën e pikës se kalimit kufitar nuk i respekton udhëzimet dhe urdhrat e zyrtarëve policor (paragrafi 2. i nenit 33 të këtij ligji);
   1.9. i cili në stacionin policor kompetent për kontrollin kufitar nuk do t'i dorëzoje të dhëna personale për të punësuarit, para se të punësuarit të fillojnë punën në zonën e pikës se kalimit kufitar (paragrafi 1. i nenit 34 të këtij ligji);
   1.10. të punësuarve tek operatori dhe personat tjerë juridike dhe fizike të cilët në zonën e pikës se kalimit kufitar kryejnë veprimtari, në vend të dukshëm nuk mbajnë kartelë e cila përmban të dhëna për emrin dhe mbiemrin, fotografi

dhe të dhëna për emrin e operatorit, përkatësisht personit juridik ose fizik tek i cili janë të punësuar (paragrafi 4. i nenit 34 të këtij ligji);

1.11. i cili në zonën e pikës se kalimit kufitar kryen veprimtari, e nuk siguron kartelë për të punësuarit para fillimit të tyre të punës në zonën e pikës se kalimit kufitar dhe nuk i bart shpenzimet për përpunimin e tyre (paragrafi 5. i nenit 34 të këtij ligji);

1.12. i cili nuk do t'u mundësojë kalim të lirë zyrtarëve policor për kryerje të papenguar të mbikëqyrjes kufitare dhe zyrtareve tjerë kompetente për vendosjen dhe mirëmbajtjen e mjeteve teknike dhe aparateve dhe mirëmbajtjen e tabelave kufitare dhe shenjave (paragrafi 1. i nenit 39 të këtij ligji);

1.13. i cili në tabelat kufitare, shenjat dhe në sinjalizimin tjetër vendos tabela tjera, shenja ose sinjalizim me të cilin do të zvogëlohej dukshmëria e tabelave kufitare, shenjave dhe sinjalizimit tjetër me të cilën paralajmërohet për vijën kufitare (paragrafi 3. i nenit 41 të këtij ligji);

1.14. i cili mbjellë lloje të caktuara të kulturave bujqësorë ose mbjell drunj ose bime përgjatë vijës kufitare kur kjo është e ndaluar (paragrafi 2. i nenit 43 të këtij ligji).

Neni 61

1. Me gjobe prej njëmijë (1.000) deri dymijepesëqind (2.500) Euro në do t'i shqiptohet dënimi për kundërvajtje personit juridik:

1.1. makinisti i të cilit në komunikacionin ndërkombëtar do ta ndaloje trenin në pjesën e hekurudhës ndërmjet vijës kufitare dhe zonës së pikës se kalimit kufitar, përveç kur kjo është e nevojshme për rregullimin e komunikacionit hekurudhor ose në rast të fuqisë madhore (paragrafi 5. i nenit 25 të këtij ligji);

1.2. makinisti i të cilit nuk do ta ndaloje trenin që e ka kaluar kufirin shtetëror, në hekurudhe të hapur jashtë zonës së pikës se kalimit kufitar, ose pas daljes nga zona e pikës se kalimit kufitar para kufirit shtetëror dhe nuk do t'i ndërmarre masat e nevojshme me qellim të pamundësimit të udhëtareve që ta lëshojnë trenin, përkatësisht pamundësimit të hyrjes së personave në tren dhe për ndaljen e trenit nuk e njofton policinë (paragrafi 6. i nenit 25 të këtij ligji);

1.3. i cili nuk vepron në pajtim me paragrafët. 2 dhe 3. të nenit 31 të këtij ligji;

1.4. i cili gjatë ndërtimit dhe vendosjes së objekteve, si dhe gjate ndryshimit të veprimtarisë në zonën e pikës se kalimit kufitar e pamundëson kryerjen e kontrollit kufitar dhe zbatimin e masave të sigurisë në kufirin shtetëror, pa leje të Ministrisë, fillon ndërtim, vendosje të objektit dhe ndryshim të veprimtarisë në zonën e pikës se kalimit kufitare (paragrafët 1. dhe 3. të nenit 32 të këtij ligji);

1.5. i cili veprimtarinë në zonën e pikës se kalimit kufitar nuk e kryen në lokalet përkatëse të dedikuara për këtë qëllim (paragrafi 2. i nenit 32 të këtij ligji);

1.6. i cili stacionit policor kompetent për kontrollin kufitar nuk do t'i dorëzoje të dhëna personale për të punësuarit, para se të punësuarit të fillojnë punën në zonën e pikës se kalimit kufitar (paragrafi 1. i nenit 34 të këtij ligji);

1.7. i cili në zonën e pikës se kalimit kufitar kryen veprimtari, ndërsa nuk siguron kartelë për të punësuarit para fillimit të tyre të punës në zonën e pikës se kalimit kufitar dhe nuk i bart shpenzimet për përpunimin e tyre (paragrafi 5. i nenit 34 të këtij ligji);
1.8. i cili nuk do t'u mundësoje kalim të detyrueshëm zyrtareve policor për kryerje të papenguar të mbikëqyrjes kufitare dhe zyrtarëve tjerë kompetente për vendosjen dhe mirëmbajtjen e mjeteve teknike dhe aparateve dhe mirëmbajtjen e tabelave kufitare dhe shenjave (paragrafi 1. i nenit 39 të këtij ligji);
1.9. punëtori i të cilit gjuan, peshkon, fluturon me mjete fluturuese dhe mjete tjera për fluturim, lëviz, qëndron dhe vendoset përgjatë vijës kufitare në tere ose më një pjese të kufirit shtetëror, nëse kjo është e ndaluar (paragrafi 1. i nenit 42 të këtij ligji);
1.10. i cili mbjellë lloje të caktuara të kulturave bujqësorë ose mbjelle drunj ose bime tjera përgjatë vijës kufitare kur kjo është e ndaluar (paragrafi 2. i nenit 43 të këtij ligji).

2. Gjobë prej pesëqind (500) deri tetëqind (800) Euro do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për veprimet nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 62

1. Me gjobë prej tremijë (3.000) deri pesëmijë (5.000) Euro, do t'i shqiptohet dënimi për kundërvajtje personit fizik dhe personit juridik i cili me fajin e tij me kërkesë të stacionit policor kompetent për kontrollin kufitar deri në fund të paraqitjes së udhëtareve nuk dorëzojnë informata të cilat kanë të bëjnë me udhëtaret të cilët i bartin deri te pika e përcaktuar e kalimit kufitar nëpërmjet së cilës ata do të hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës, ose dorëzojnë të dhëna të pakompletuara ose të rrejshme (neni 24 i këtij ligji).
2. Me gjobë prej tremijë (3.000) deri pesëmijë (5.000) Euro do t'i shqiptohet dënimi personit përgjegjës në personin juridik për veprimet nga paragrafi 1. i këtij neni.

KREU XIII
DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 63
Shfuqizimi, aplikimi dhe nxjerrja e akteve nënligjore

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet çdo dispozitë tjetër qe bien ne kundërshtim me te, si dhe:
   1.1. Ligji nr. 03/L-065 për Menaxhimin e Integruar dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror; dhe
   1.2. Udhëzimi Administrativ i Qeverisë nr. 06/2010 Për ushtrimin e kontrollit kufitar.
2. Me kusht qe te mos jenë në kundërshtim me ketë ligj, deri ne miratimin e akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji, vazhdojnë te zbatohen:
   2.1. Udhëzimi Administrativ i Qeverisë nr. 03/2010 Për shënjimin e vijës kufitare;

2.2. Udhëzimi Administrativ i Qeverisë nr. 04/2010 për Incidentet Kufitare;
2.3. Udhëzimi Administrativ i Qeverisë nr. 05/2010 Për ndërtimin e ndërtesave brenda zonës se kalimit te kufirit;
2.4. Udhëzimi Administrativ i Qeverisë nr. 07/2010 Për kategorizimin e pikave te kalimit kufirit;
2.5. Udhëzimi Administrativ i Qeverisë nr. 08/2010 Për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e vendosjes së shenjave paralajmëruese dhe shenjave te shkruara ne pikat e kalimit te kufirit dhe ne zonën e kalimit te kufirit;
2.6. Udhëzimi Administrativ i Qeverisë nr. 09/2010 Për ndalimin, kufizimin ose kushtëzimin e aktiviteteve përgjatë vijës se kufirit shtetëror.

3. Ministria ne bashkëpunim me organet tjera shtetërore nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 64
Hyrja në fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-072
21 dhjetor 2011

Shpallur me dekretin Nr. DL-001-2012, datë 06.01.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 02 / 20 JANAR 2012, PRISHTINË

LIGJI Nr. 04/L-217
PËR AZIL

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme dhe parimet themelore 481
Kreu II: Të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesëve, personave me status refugjati dhe personave nën mbrojtje plotësuese 493
Kreu III: Procedura e azilit 498
Kreu IV: Procedura e ankesës 506
Kreu V: Dhënia e mbrojtjes së përkohshme dhe statusi i personave me mbrojtje të përkohshme 508
Kreu VI 511
Kreu VII: Trajtimi i të dhënave personale 512
Kreu VIII: Dispozitat përfundimtare 515

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR AZIL

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME DHE PARIMET THEMELORE

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj rregullon kushtet dhe procedurat për njohjen e statusit të refugjatit, mbrojtjes plotësuese, mbrojtjes së përkohshme, statusin, të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesve, personave me status refugjati, si dhe personave të cilëve iu është lejuar mbrojtja plotësuese dhe mbrojtja e përkohshme.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **Ministria –** Ministria e Punëve të Brendshme;
   1.2. **DSHAM -** Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim në kuadër të MPB-së;
   1.3. **DMH –** Drejtoria për Migrim dhe të Huaj në Policinë e Kosovës;
   1.4. **UNHCR –** Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë;

1.5. **Azilkërkues –** çdo shtetas i huaj, apo person pa shtetësi, i cili paraqet kërkesë për azil dhe për të cilin nuk është marrë vendim i formës së prerë;

1.6. **Kërkesa për azil** – kërkesa e bërë nga shtetasi i huaj apo personi pa shtetësi e cila nënkupton kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare. Çdo kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare prezumohet si kërkesë për azil përveç nëse shtetasi i huaj apo personi pa shtetësi shprehimisht kërkon mbrojtje tjetër;

1.7. **I huaji** - çdo person fizik i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës;

1.8. **Shtetas i huaj** – çdo person i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës dhe i cili ka shtetësi të huaj;

1.9. **Person pa shtetësi** – personi i cili nuk konsiderohet shtetas i asnjë shteti në kuadër të fushëveprimit të ligjeve të tij;

1.10. **Statusi i refugjatit –** njohja e statusit të refugjatit për shtetasin e huaj apo personin pa shtetësi nga Republika e Kosovës;

1.11. **Refugjat** - personi i cili për shkak të frikës së mirë të bazuar për të qenë i persekutuar për arsye të racës, religjionit, kombësisë, mendimit politik apo përkatësisë së grupit të caktuar shoqëror, është jashtë vendit të shtetësisë dhe nuk ka mundësi apo për shkak të frikës së tillë nuk ka dëshirë të përfitoj mbrojtjen e atij vendi, apo personin pa shtetësi i cili duke qenë jashtë vendit të banimit të mëparshëm të rregullt për arsye të njëjta siç përmenden më lartë, nuk ka mundësi apo, për shkak të frikës së tillë nuk ka dëshirë të kthehet në atë vend.

1.11.1. koncepti i racës në veçanti do të përfshijë konsideratën ndaj ngjyrës, prejardhjes, apo përkatësisë së ndonjë grupi të veçantë etnik;

1.11.2. koncepti i religjionit në veçanti do të përfshijë mbajtjen e besimeve teiste, jo-teiste dhe ateiste, pjesëmarrjen në apo abstenimin nga ritualet religjioze në hapësira private apo publike, qoftë i vetëm apo në bashkësi me të tjerët, aktet e tjera religjioze apo shprehjen e pikëpamjeve, ose format personale apo kolektive të sjelljes të bazuara në besimin religjioz apo të urdhëruara nga çfarëdo besimi religjioz;

1.11.3. koncepti i kombësisë nuk do të kufizohet në shtetësi apo në mungesën e saj, po në veçanti do të përfshijë përkatësinë në një grup të përcaktuar nga identiteti kulturor, etnik apo linguistik, nga origjina gjeografike apo politike apo nga marrëdhënia e grupit të tillë me popullatën e shtetit tjetër;

1.11.4. grupi do të konsiderohet të krijojë grupin e veçantë shoqëror kur në veçanti:

11.4.1.1. pjesëtarët e atij grupi ndajnë një karakteristikë të lindur apo një prapavijë të përbashkët që nuk mund të ndërrohet, ose ndajnë ndonjë karakteristikë apo besim që është aq esencial për identitetin apo vetëdijen sa që personi nuk duhet të detyrohet të heq dorë nga e njëjta; dhe

11.4.1.2. ai grup ka identitet të dalluar në vendin relevant, për shkak se i njëjti është i perceptuar si i ndryshëm nga shoqëria që e rrethon. Varësisht nga rrethanat në vendin e origjinës, një grup i veçantë social mund të përfshijë një grup të bazuar

në karakteristikat e përbashkëta të orientimit seksual. Orientimi seksual nuk mund të kuptohet që duhet të përfshijë akte që konsiderohen të jenë kriminale në pajtim me ligjin kombëtar të Republikës së Kosovës. Aspektet e lidhura me moshën, përfshijnë identitetin gjinor, duhet të jepet konsideratë e theksuar me qëllim të përcaktimit të anëtarësisë së grupit të veçantë social ose identifikimit të një karakteristike të një grupi të tillë.

1.11.5. koncepti i pikëpamjes politike në veçanti do të përfshijë mbajtjen e opinionit, mendimit apo besimit në çështjen që ka të bëjë me akterët potencial të persekutimit të përmendur në nën-paragrafin 1.26. të këtij neni dhe me politikat apo metodat e tyre, pavarësisht nëse opinioni, mendimi apo besimi i tillë është shprehur nga azilkërkuesi;

1.11.6. gjatë vlerësimit nëse aplikuesi ka frikë të bazuar mirë nga të qenit i persekutuar, është e parëndësishme nëse azilkërkuesi posedon karakteristikat racore, religjioze, kombëtare, sociale apo politike të cilat e provokojnë persekutimin, duke siguruar që karakteristika e tillë i atribuohet azilkërkuesit nga akterët e persekutimit.

1.12. **Mbrojtja plotësuese** - është mbrojtje që i afrohet shtetasit të huaj apo personit pa shtetësi edhe pse nuk i përmbush kriteret e përcaktimit të statusit të refugjatit, ka arsye serioze dhe të bazuara të mendohet se në rast të kthimit të tij në vendin e origjinës apo të prejardhjes, apo në rastin e personit pa shtetësi në vendin e tij apo të saj të banimit të mëparshëm të rregullt, ai rrezikon realisht të përballet me cenime të rënda dhe nuk ka mundësi apo për shkak të rrezikut të tillë nuk dëshiron të përfitoj nga mbrojtja e atij vendi. Cenime të rënda konsiderohen:

1.12.1. dënimi me vdekje apo ekzekutimi;

1.12.2. tortura apo trajtimi ose dënimi ç'njerëzor apo degradues i aplikuesit në vendin e origjinës; apo

1.12.3. kërcënimi serioz dhe individual ndaj jetës së një civili apo personi për shkak të dhunës së pa selektuar në situata të konfliktit të armatosur ndërkombëtar apo të brendshëm.

1.13. **Mbrojtja e përkohshme** – mbrojtja e përkohshme dhe të menjëhershme sipas një procedure të veçantë që i jepet personave të zhvendosur nga vendet e treta në raste të flukseve masive dhe të menjëhershme të cilët nuk mund të kthehen në vendin e origjinës, në veçanti nëse ekziston rreziku se sistemi i azilit do ta ketë të pamundur të procedoj pa efekte të dëmshme për operimin efikas të tij, me interes të personave në fjalë dhe personave tjerë të cilët kërkojnë mbrojtje;

1.14. **Konventa e Gjenevës** - Konventa e Gjenevës së 28 Korrikut të vitit 1951 në lidhje me statusin e refugjatëve dhe protokollin e saj të vitit 1967 në lidhje me statusin e refugjatëve;

1.15. **Vendi i origjinës –** vendi i shtetësisë së shtetasit të huaj apo vendi në të cilin personi pa shtetësi kishte vendbanimin e fundit;

1.16. **Vendi i parë azilit** – një vend mund të konsiderohet si vend i parë i kërkesës së azilit për një azilkërkues nëse:

1.16.1. ai ose ajo në atë shtet është pranuar si refugjat dhe ai/ajo ende mund të përfitoj nga mbrojtja e atij vendi; ose

1.16.2. ai/ajo në mënyrë tjetër gëzon mbrojtje të vazhdueshme në atë shtet, duke përfshirë përfitimet nga parimi i moskthimit duke u siguruar që ai/ajo do të riatdhesohet në atë shtet.

1.17. **Vendi i tretë i sigurt-** koncepti i vendit të tretë të sigurt mund të zbatohet vetëm atëherë kur organi kompetent është i sigurt se azilkërkuesi do të trajtohet në vendin e tretë të caktuar në pajtim me parimet në vijim:

1.17.1. jeta dhe liria nuk janë të kërcënuara për arsye të racës, religjionit, kombit, përkatësisë në grupin e veçantë shoqëror apo të mendimit politik;

1.17.2. parimi i mos-dëbimit në pajtim me Konventën e Gjenevës respektohet;

1.17.3. ndalimi i largimit në kundërshtim me të drejtën e lirisë nga tortura, trajtimi çnjerëzor dhe poshtërues, siç janë përcaktuar në të drejtën ndërkombëtare, respektohet; dhe

1.17.4. ekziston mundësia për të kërkuar statusin e refugjatit dhe nëse cilësohet të jetë refugjat, të pranoj mbrojte në pajtim me Konventën e Gjenevës.

1.17.5. zbatimi i konceptit të vendit të tretë të sigurt do të jetë subjekt i rregullave të përcaktuara në legjislacionin vendor duke përfshirë:

1.17.5.1. rregullat të cilat kërkojnë lidhjen në mes të azilkërkuesit dhe vendit të tretë të caktuar në bazë të të cilave do të ishte e arsyeshme për atë person që të shkoj në atë shtet;

1.17.5.2. rregullat për metodologjinë sipas së cilës organi kompetent mund të jetë i kënaqur se koncepti i vendit të tretë të sigurt mund të zbatohet për një vend të veçantë ose për një kërkesë të veçantë. Një metodologji e tillë duhet të përfshij shqyrtimin rast për rast lidhur me sigurinë e atij vendi për azilkërkuesin e veçantë ose përcaktimi kombëtar të vendeve të konsideruara përgjithësisht të sigurta;

1.17.5.3. rregullat në pajtim me të drejtën ndërkombëtare të cilat lejojnë shqyrtimin individual për atë nëse vendi i tretë i caktuar është i sigurt për azilkërkuesin e veçantë që në minimum, do të lejojë azilkërkuesin të sfidojë zbatimin e konceptin të shtetit të tretë të sigurt mbi bazën se ai/ajo do të ishte subjekt i torturës, trajtimit dhe dënimit çnjerëzor dhe degradues.

1.17.6. kur zbatohet vendimi i cili bazohet vetëm në ketë nen, Republika e Kosovës:

1.17.6.1. do ta informojnë azilkërkuesin në përputhje me rrethanat; dhe

1.17.6.2. do t'i ofrojnë atij/asaj dokumentin me të cilin informojnë autoritetet e vendit të tretë, në gjuhën e atij vendi, se kërkesa nuk është shqyrtuar në përmbajtje.

1.17.7. kur vendi i tretë nuk e pranon azilkërkuesin për azil që të hyjë në

territorin e saj, Republika e Kosovës do të sigurojë që qasja në procedurë është ofruar në pajtim me parimet dhe garancitë themelore të përshkruara në këtë ligj.

1.18. **Vendi i sigurt i origjinës** – një vend konsiderohet si vend i sigurt i origjinës kur, në bazë të situatës ligjore, zbatimi i ligjit në një sistem demokratik dhe në rrethana politike të përgjithshme, mund të konstatohet se atje në përgjithësi dhe në mënyrë konsistente nuk ka persekutim siç është definuar në nenin 1 A të Konventës së përgjithshme, dhe nuk ka torturë ose trajtim ç'njerëzor ose ndëshkim, dhe nuk ka kërcënim me qëllim të dhunës diskriminuese në situatë të konfliktit të armatosur të brendshëm apo ndërkombëtar.

1.18.1. me rastin e konstatimit, vëmendje duhet t'i kushtohet, përveç tjerash, deri në masën në të cilën mbrojtja është siguruar kundër ndjekjes ose maltretimit përmes:

1.18.1.1. ligjeve dhe rregulloreve përkatëse të vendit dhe mënyra në të cilën ato aplikohen;

1.18.1.2. vështrimi i të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe/ose Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe/ose Konventën kundër Torturës, në veçanti të drejtat nga të cilat derogimi nuk mund të bëhet në bazë të nenit 15 (2) të Konventës Evropiane të thënë;

1.18.1.3. respektimi i parimit të moskthimit në pajtim me Konventën e Gjenevës;

1.18.1.4. dispozita për një sistem efektiv të mundësisë për ankesë kundër shkeljes së këtyre të drejtave dhe lirive.

1.19. **Anëtarë të familjes –** përfshijnë ashtu siç ekzistonte familja në vendin e origjinës, anëtarët vijues të familjes së përfituesit të statusit të refugjatit apo mbrojtjes plotësuese të cilët janë të pranishëm në të njëjtin shtet anëtarë në raport me kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare:

1.19.1. bashkëshorti/ja i/e përfituesit të statusit të refugjatit apo mbrojtjes plotësuese apo partneri i tij/saj i/e pa martuar në marrëdhënie të qëndrueshme, kur legjislacioni apo praktika e shtetit përkatës në fjalë i trajton qiftet e pamartuara në mënyrë të krahasueshme me çiftet e martuara sipas Ligjit për të Huaj;

1.19.2. fëmijët e çiftit të referuar në paragrafin 1.19.1 të përfituesit të statusit të refugjatit apo mbrojtjes plotësuese me kusht që ata të jenë të pamartuar dhe të varur, dhe pavarësisht nëse ata janë lindur në apo jashtë martesës apo janë të adoptuar siç definohet në ligjin kombëtar;

1.19.3. babai, nëna ose ndonjë i rritur tjetër përgjegjës për përfituesin e mbrojtjes ndërkombëtare qoftë nga ligji apo nga praktika e Republikës së Kosovës, kur ai përfitues është fëmijë i pamartuar.

1.20. **Fëmijë** –shtetasi i huaj apo personin pa shtetësi nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare.

1.21. **Fëmijë i pashoqëruar -** shtetasi i huaj apo personi pa shtetësi, nën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, që hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës pa qenë të shoqëruar nga një person madhor, përgjegjës për ta, sipas ligjit apo traditës zakonore, dhe përderisa ata nuk janë nën kujdesin efektiv të personit të tillë, fëmija i pashoqëruar përfshinë dhe fëmijën e lënë vetëm pas hyrjes në territorin e Kosovës.

1.22. **Leje qëndrimi** – çdo autorizim i lëshuar nga autoritetet e Republikës së Kosovës që lejojnë qëndrimin e ligjshëm të të huajit në territor, me përjashtim të:

1.22.1. vizave;

1.22.2. lejeve të lëshuara në pritje të shqyrtimit të kërkesave për leje qëndrim apo azil.

1.23. **Përfaqësues** – personi i cili vepron në emër të një organizate e cila përfaqëson fëmiun e pashoqëruar si mbrojtës juridik, personin që vepron në emër të organizatës (shtetërore) e cila është përgjegjëse për kujdesin dhe mirëqenien e fëmijës ose ndonjë përfaqësim tjetër për të siguruar interesin e tij/saj më të mirë.

1.24. **Organi kompetent** –DSHAM, Komisionin Kombëtar për Refugjatë dhe gjykatën kompetente në përputhje me Ligjin për Gjykatat.

1.25. **Aktet e persekutimit –** nënkupton:

1.25.1. aktet të cilat konsiderohen si përndjekje nga arsyet e përmendura në nën-paragrafin 1.10. të këtij neni, përveç tjerash nënkuptojmë:

1.25.1.1. akt serioz për nga natyra ose të përsëritshme, ose veprimi i cili paraqet shkelje serioze të të drejtave themelore të njeriut posaçërisht të të drejtave të cilat nuk mund të kufizohen sipas nenit 15, paragrafin 2. të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore;

1.25.1.2. ose të jenë akumulim i masave të ndryshme, përfshirë shkeljet e të drejtave të njeriut që janë aq të rënda sa që ndikojnë në individin në mënyrë të ngjashme siç parashihet në nën-paragrafin 1.25.1.1 të këtij neni.

1.25.2. Aktet e persekutimit nga nën-paragrafi 1.25.1. i këtij neni përfshijnë:

1.25.2.1. dhunën fizike apo mendore duke përfshirë edhe dhunën seksuale;

1.25.2.2. masat ligjore, administrative, policore ose gjyqësore të cilat janë diskriminuese ose të cilat zbatohen në mënyrë diskriminuese;

1.25.2.3. përndjekjet gjyqësore ose dënimet gjyqësore të cilat janë jo proporcionale ose diskriminuese;

1.25.2.4. kufizimin e ndihmës gjyqësore, duke rezultuar në një dënim diskriminues dhe shpërpjestues;

1.25.2.5. përndjekjet ose dënimet gjyqësore që ndërlidhen me refuzimin e kryerjes së obligimit ushtarak në rast të konflikteve, kur kryerja e shërbimeve ushtarake do të përfshinte krime apo akte që bien në fushë veprimtarinë e

arsyeve për përjashtim siç është e përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji;

1.25.2.6. veprimet të cilat për nga natyra në veçanti ndërlidhen me gjininë ose fëmijët.

1.26. **Akterët e persekutimit apo cenimit serioz janë:**

1.26.1. akterët e persekutimit apo cenimit në kuptim nenit 2, nën-paragrafi 1.10. të këtij neni përfshijnë:

1.26.1.1. shtetin;

1.26.1.2. palët apo organizatat të cilat kontrollojnë shtetin apo një pjesë të konsiderueshme të territorit të shtetit;

1.26.1.3. akterët jo shtetëror nëse mund të dëshmohet se aktorët në nën-paragrafët 1.26.1.1. dhe 1.26.1.2. përfshirë organizatat ndërkombëtare, nuk kanë mundësi apo nuk kanë vullnet që të ofrojnë mbrojtje nga persekutimi apo cenimi serioz.

1.27. **Akterët mbrojtës –** konsiderohen:

1.27.1. mbrojtja nga persekutimi në kuptim të nën-paragrafit 1.10. të këtij neni, mund të sigurohet nga:

1.27.1.1. shteti;

1.27.1.2. palët apo organizatat, përfshirë organizatat ndërkombëtare të cilat kontrollojnë shtetin apo një pjesë të konsiderueshme të territorit të shtetit;

1.27.1.3. mbrojtja kundër persekutimit ose dëmtimit të rëndë duhet të jetë efektive dhe jo e natyrës së përkohshme. Një mbrojtje e tillë përgjithësisht jepet kur akterët (personat) e përmendur në nën-pikat 1.27.1.1. dhe 1.27.1.2. të këtij neni, ndërmarrin hapa të arsyeshëm të parandalojnë nga persekutimi apo vuajtja nga dëmtimi i rëndë, inter alia, nga operimi i një sistemi ligjor efektiv për hetimin, ndjekjen dhe dënimin e akteve që konsiderohen persekutime ose dëmtime të rënda, dhe kur aplikuesi ka qasje në një mbrojtje të tillë.

1.28. **Ndalim/arrestim** - mbyllja/izolimi i një azilkërkuesi nga organi kompetent në një vend të veçantë, ku azilkërkuesi është i privuar nga liria e lëvizjes.

Neni 3
Mbrojtja e integritetit familjar

1. Në pajtim me këtë ligj, gjatë procedurës dhe pas përfundimit të shqyrtimit të kërkesës për azil ose mbrojtjes plotësuese, organet kompetente duhet të ndërmarrin të gjitha masat me qëllim të ruajtjes së unitetit të familjes.
2. Organi kompetent duhet të sigurohet se në rastet kur anëtarët e familjes së përfituesit të mbrojtjes nuk kualifikohen individualisht për një mbrojtje të tillë, ata përfitojnë nga statuset derivative të refugjatit në pajtim me Ligjin për të Huaj.
3. Përjashtimisht nga paragrafi 1. dhe 2. të këtij neni, anëtarët e familjes të cilëve iu është revokuar, përfunduar ose refuzuar statusi i refugjatit ose ekzistojnë rrethana për përjashtim nga statusi i refugjatit në pajtim me këtë ligj.

4. Përfitimet nga paragrafi 1. dhe 2. të këtij neni, mund të refuzohen, të zvogëlohen ose të merren për arsye që ndërlidhen me sigurinë kombëtare ose rendin publik.

Neni 4
Ndalimi i dëbimit ose i kthimit (refoulement)

1. Republika e Kosovës nuk duhet ta dëboj ose kthej refugjatin në asnjë mënyrë në kufijtë e territoreve, ku do të kërcënohet jeta apo liria e tij për arsye të racës, religjionit, përkatësisë kombëtare, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo bindjeve të tij politike.
2. Përfitimet nga paragrafi 1. i këtij neni nuk do të mund të kërkohen nga një refugjat për të cilin ka arsye të forta të mendohet se ai paraqet rrezik për sigurinë e Republikës së Kosovës apo i cili duke qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për një krim veçanërisht të rëndë, paraqet rrezik për sigurinë e Republikës së Kosovës.
3. Në raste nga paragrafi 2. i këtij neni, revokohet ose refuzohet leja e qëndrimit.

Neni 5
Nevoja e mbrojtjes ndërkombëtare që lind *sur place*

1. Frika e bazuar mirë për persekutim apo rreziku real i përjetimit të cenimit serioz mund të bazohet në ngjarjet të cilat kishin ndodhur që nga koha kur aplikuesi kishte lëshuar vendin e origjinës.
2. Frika e bazuar mirë për persekutim apo rreziku real i përjetimit të cenimit serioz mund të bazohet në aktivitetet në të cilat azilkërkuesi ishte angazhuar që nga koha e lëshimit të vendit të origjinës, në veçanti kur konstatohet që aktivitetet në fjalë paraqesin shprehje dhe vazhdimësi të dënimeve apo orientimeve që mbizotërojnë në vendin e origjinës.
3. Pa e cenuar Konventën e Gjenevës, Republika e Kosovës mund të përcaktojë se azilkërkuesi i cili parashtron një kërkesë pasuese zakonisht nuk do të akordohet me statusin e refugjatit, nëse rreziku i persekutimit është i bazuar në rrethanat të cilat aplikuesi i kishte krijuar me vendimin e vet që nga koha e lëshimit të vendit të origjinës.

Neni 6
Njohja e azilit

1. Republika e Kosovës iu jep azilin shtetasit të huaj apo personit pa shtetësi, me kërkesën e tij, i cili i plotëson kriteret e refugjatit të përcaktuara në nenin 2 paragrafi 1.10. të këtij ligji.
2. Personat të cilëve iu është dhënë azili në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, do t'iu lëshohet leje qëndrimi në pajtim me Ligjin për të Huajt.

Neni 7
Përjashtimi nga azili

1. E drejta për azil nuk do t'i njihet një personi, për të cilin ka arsye serioze të konsiderohet se ai/ajo:
   1.1. ka kryer krime kundër paqes, krime lufte ose krime kundër njerëzimit në siç definohet në aktet ndërkombëtare të hartuara për të paraparë dispozita për krime të tilla;
   1.2. ka kryer krim serioz jo-politik jashtë Republikës së Kosovës para pranimit tij apo saj si refugjat, në atë vend si refugjat;
   1.3. është fajtor për akte që janë në kundërshtim me qëllimet apo parimet e Kombeve të Bashkuara, siç parashihet në preambulë dhe nenin 1 dhe 2 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.
2. Paragrafi 1. i këtij neni, zbatohet ndaj personave të cilët nxisin apo në mënyrë tjetër marrin pjesë në kryerjen e krimeve ose akteve të lartcekura.
3. Azili nuk do t'iu lejohet personave të cilët tashmë gëzojnë ndihmën ose mbrojtjen e organeve dhe agjencive të Kombeve të Bashkuara, përveç mbrojtjes ose ndihmës së Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për refugjatë. Kur një mbrojtje ose ndihmë e tillë ka pushuar për çfarëdo arsye, pa u vendosur definitivisht pozita e këtyre personave në pajtim me rezolutat relevante të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, këta persona në bazë të fakteve (ipso facto) kanë të drejtë të përfitojnë nga ky ligj.
4. Azili nuk do t'u lejohet personave, për të cilët të drejtat dhe detyrimet e ngjashme si shtetas të Kosovës janë të njohura nga shteti i Kosovës.

Neni 8
Dhënia e mbrojtjes plotësuese

1. Republika e Kosovës ia ofron mbrojtjen plotësuese shtetasit, të huaj apo personit pa shtetësi i cili nuk i përmbush kriteret e përcaktimit të statusit të refugjatit, por i plotëson kriteret e përcaktuara në përkufizimin e mbrojtjes plotësuese të parapara në nenin 2, paragrafi 1.12. të këtij ligji.
2. Sa më parë që është e mundur pasi që statusi i tyre është akorduar, Ministria do t'u lëshojnë përfituesve të statusit të mbrojtjes plotësuese një leje banimi e cila duhet të jetë e vlefshme së paku një (1) vit dhe e përsëritshme, përveç nëse arsyet imponuese të sigurisë shtetërore apo të rendit publik kërkojnë ndryshe.

Neni 9
Përjashtimi nga mbrojtja plotësuese

1. E drejta për mbrojtje plotësuese nuk do t'i njihet personit, për të cilin ka arsye serioze të konsiderohet se ai/ajo:
   1.1. ka kryer krime kundër paqes, krime lufte ose krime kundër njerëzimit në kuptim të dispozitave ndërkombëtare që përcakton këto krime;
   1.2. ka kryer krime të rënda të dënueshme;
   1.3. është fajtor për akte që janë në kundërshtim me qëllimet apo parimet e

Kombeve të Bashkuara, siç parashihet në preambulë dhe nenin 1 dhe 2 të Kartës së Kombeve të Bashkuara;

1.4. paraqet rrezik për bashkësinë ose për sigurinë e Republikës së Kosovës.

2. Paragrafi 1. i këtij neni, zbatohet ndaj personave të cilët nxisin apo në mënyrë tjetër marrin pjesë në kryerjen e krimeve ose akteve të lartcekura.
3. Mbrojtja plotësuese nuk do t'i jepet një personi i cili ka kryer një apo më tepër vepra penale para se të hyjë në Republikën e Kosovës jashtë fushë veprimtarisë së paragrafit 1. të këtij neni, të cilat vepra penale do të ishin të dënueshme me burgim nëse do të kryheshin në Republikën e Kosovës dhe nëse ai apo ajo e lëshon vendin e tij apo saj të origjinës, vetëm për t'iu shmangur sanksioneve që rezultojnë nga këto krime.

Neni 10
Hyrja në Republikën e Kosovës

Shtetasit e huaj apo personat pa shtetësi të cilët deklarojnë qëllimet e tyre për parashtrimin e kërkesës për azil në Republikën e Kosovës, do të trajtohen si azilkërkues në pajtim me këtë ligj, pra do t'ju lejohet të hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 11
Ndihma për azilkërkuesit

1. Azilkërkuesi mund të kërkojë azil në një gjuhë të cilën ai ose ajo e kupton.
2. Azilkërkuesi në një afat pesëmbëdhjetë (15) ditor që nga paraqitja e kërkesës për azil do të informohet në një gjuhë të cilën e kupton lidhur me procedurën e azilit, të drejtat dhe detyrimet në procedurën e tillë, si dhe për të drejtën të kontaktoj UNHCR-në dhe ndonjë Organizatë Joqeveritare të cilat iu ofrojnë ndihmë azilkërkuesve.
3. Azilkërkuesi ka të drejtë të zgjedh një përfaqësues, i cili do ta ndihmoj dhe përfaqësoj atë gjatë procedurës për përcaktimin e azilit, me shpenzime të azilkërkuesit.
4. Përfaqësuesi i azilkërkuesit si dhe përfaqësuesi i Zyrës së UNHCR-së, kanë të drejtë të kontaktojnë azilkërkuesin në çdo kohë dhe në secilën fazë të procedurës për përcaktimin e azilit.
5. Azilkërkuesi ka të drejtë të flas me përfaqësuesin e tij ose përfaqësuesin e UNHCR-së në çdo kohë, si dhe të jetë i informuar për këtë të drejtë.
6. Përfaqësuesi gëzon qasje në informacion në dosjen e azilkërkuesit, siç i lejohet autoritetit të përcaktuar për të shqyrtuar kërkesën për azil, për aq sa është i rëndësishëm informacioni për shqyrtimin e kërkesës.
7. Përjashtimisht përfaqësuesi nuk do e gëzoj të drejtën në dosjen e azilkërkuesit kur zbulimi i informatave ose burimeve do të rrezikonte sigurinë kombëtare, sigurinë e organizatave apo personit/personave që ofrojnë informacionin, sigurinë e personit/personave të cilëve u referohet informacioni ose kur interesat e hetimeve në lidhje me shqyrtimin e kërkesave të azilit nga organi kompetent ose marrëdhëniet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, do të rrezikoheshin. Në

këto raste, qasja në informata ose burime në fjalë do të jetë në dispozicion të organit kompetent me përjashtim kur qasja e tillë është përjashtuar për shkak të sigurisë kombëtare.

Neni 12
Gjuha e procedurës dhe e drejta për përkthyes

1. Në rastet kur azilkërkuesi nuk e kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, organi kompetent i siguron shërbimet e përkthimit me qëllim që t'i sigurohet procedura në një gjuhë në të cilën konsiderohet se e kupton. Përkthyesi do të jetë i detyruar të mbaj sekretin profesional.
2. Në raste të veçanta, nëse është e mundur azilkërkuesit do t'i sigurohet një përkthyes i të njëjtës gjini.
3. Azilkërkuesi ka të drejtë të angazhoj një përkthyes sipas vullnetit të vet, me kusht që ky i fundit të mos jetë azilkërkues.

Neni 13
Femrat azilkërkuese

Azilkërkueset femra kanë të drejtë që procedurën e azilit ta zhvilloj zyrtarja, në pajtim me mundësitë.

Neni 14
Fëmijët e pashoqëruar

1. Azilkërkuesit fëmijë të pashoqëruar do t'i caktohet zyrtari për shërbimet sociale i caktuar nga Qendra për Punë Sociale në kohën sa më të shkurtë të mundur, si përfaqësues i fëmijës së pashoqëruar në mënyrë që të përfaqësoj ose ta ndihmoj fëmijën e pashoqëruar me qëllim të shqyrtimit të kërkesës për azil. Në asnjë rrethanë fëmija i pashoqëruar nuk mund të merret në pyetje pa qenë i shoqëruar nga zyrtari për shërbimet sociale.
2. Organi kompetent duhet të marrë në konsideratë interesin më të mirë të fëmijës me rastin e implementimit të këtij neni.
3. Zyrtarit për shërbimet sociale për fëmijë, do t'i ipet mundësia për ta informuar fëmijën e pa shoqëruar për kuptimin dhe pasojat eventuale të intervistës personale dhe, kur është e nevojshme si ta përgatis vetën për intervistë personale. Zyrtari për shërbimet sociale për fëmijë, do të lejohet të marrë pjesë në intervistë dhe ka të drejtë të parashtroj pyetje ose të paraqes komente brenda kornizës së përcaktuar nga zyrtari intervistues.
4. Në rastet kur fëmija i pashoqëruar do të intervistohet lidhur me kërkesën e tij për azil, kjo intervistë do të zhvillohet nga personi i cili ka njohuri të domosdoshme lidhur me nevojat e veçanta të fëmijës, dhe vendimi lidhur me kërkesën për azil po ashtu duhet të merret nga personi i cili i ka njohuritë e domosdoshme për nevojat e veçanta të fëmijës.
5. Pas njohjes së statusit të refugjatit, mbrojtjes plotësuese dhe mbrojtjes së përkohshme fëmijës të pashoqëruar i caktohet kujdestari për fëmijë.

6. Ministria është e obliguar të filloj përpjekjet për të gjetur sa më shpejt prindërit apo të afërmit e tjerë të ngushtë të fëmijës të pashoqëruar në bashkëpunim me organizatat relevante.
7. Ministria do të sigurohet që fëmijët e pashoqëruar të jenë të vendosur qoftë:
   7.1. me të afërmit e rritur; apo
   7.2. me ndonjë familje birësuese; apo
   7.3. në qendra të specializuara për akomodim të fëmijëve; apo
   7.4. në akomodim tjetër të përshtatshëm për fëmijë.
8. Në këtë kontekst, mendimi i fëmijës do të merret parasysh në pajtim me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij apo të saj.
9. Ata që punojnë me fëmijët e pashoqëruar duhet të kenë marrë ose duhet të marrin trajnim të përshtatshëm në lidhje me nevojat specifike të tyre, dhe duhet të respektojnë parimin e konfidencialitetit, në lidhje me ndonjë informacion që ata mund të marrin gjatë punës së tyre.

Neni 15
Azilkërkuesit me të meta mentale

Për azilkërkuesit me aftësi të zvogëluara mentale do t'i caktohet një përfaqësues para fillimit të procedurës.

Neni 16
Personat me nevoja të veçanta

1. Qeveria do t'iu kushtoj trajtim dhe kujdes të veçantë personave me nevoja të veçanta, veçanërisht fëmijëve, fëmijëve të pashoqëruar, personat e moshuar, personat e paaftë, gratë shtatzëna, prindërit e vetëm me fëmijë, personat të cilët kanë qenë viktima të torturës, dhunimit, apo ndonjë formë tjetër serioze të dhunës psikologjike, fizike dhe seksuale.
2. Nevoja të veçanta sipas këtij ligji do të përcaktohen në bazë të vlerësimit individual të secilit azilkërkues, refugjat, person nën mbrojtjen plotësuese apo personat nën mbrojtje të përkohshme.
3. Azilkërkuesit, refugjatët, personat nën mbrojtje plotësuese apo personat nën mbrojtje të përkohshme me nevoja të veçanta, do të kenë trajtim të veçantë në pajtim me nevojat e tyre specifike me rastin e akomodimit, ofrimit të kushteve të veçanta të pranimit, trajtimin e nevojshëm mjekësor, këshillimin e nevojshëm psikosocial.

Neni 17
Qëndrimi dhe liria e lëvizjes

1. Azilkërkuesit mund të lëvizin lirshëm në territorin e Republikës së Kosovës.
2. Republika e Kosovës mund të vendos lidhur me kufizimin e lëvizjes për arsye të interesit publik ose kur është e nevojshme për shqyrtim të shpejtë dhe vëzhgimin efektiv të kërkesës së tij ose saj.
3. Kur paraqitet e nevojshme, për shembull për arsye ligjore ose për arsye të rendit

publik, Republika e Kosovës mund t'ia kufizoj lirinë e lëvizjes në përputhje me legjislacionin kombëtar.

4. Azilkërkuesi nuk duhet të kërkoj leje për të kryer takimet me autoritetet ose gjykatat, kur paraqitja e tij/ saj është e nevojshme.

Neni 18
Roli i UNHCR- së

1. Organet shtetërore do ta lejojnë UNHCR - në:
   1.1. të ketë qasje tek azilkërkuesit, duke përfshirë edhe ata nën arrest, në aeroport;
   1.2. të ketë qasje në informata, te kërkesat individuale për azil, në zhvillimin e procedurave dhe në vendimet e marra duke siguruar që azilkërkuesi ka shprehur pajtimin;
   1.3. të paraqes pikëpamjet e veta, si zbatim i përgjegjësive mbikëqyrëse sipas nenit 35 të Konventës së Gjenevës ndaj cilitdo organ kompetent, lidhur me kërkesat individuale për azil në çdo fazë të procedurës.
2. Paragrafi 1. i këtij neni, do të zbatohet gjithashtu për organizatën e cila punon në emër të UNHCR-së në territorin e Republikës së Kosovës sipas një marrëveshjeje me Qeverinë e Kosovës.

KREU II
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E AZILKËRKUESËVE, PERSONAVE ME STATUS REFUGJATI DHE PERSONAVE NËN MBROJTJE PLOTËSUESE

Neni 19
Të drejtat e azilkërkueseve

1. Azilkërkuesi ka të drejtë:
   1.1. të qëndroj në Republikën e Kosovës;
   1.2. të ketë kushtet themelore të jetesës;
   1.3. kujdesin shëndetësor;
   1.4. ndihmën sociale themelore;
   1.5. ndihmën ligjore pa pagesë;
   1.6. të drejtën e arsimimit për azilkërkuesit fëmijë;
   1.7. të drejtën në lirinë e mendimit dhe besimit fetar;
   1.8. të drejtën për punësim dhe të drejtën në trajnime profesionale.

Neni 20
E drejta për qëndrim e azilkërkuesit

1. Azilkërkuesi ka të drejtë të qëndroj në Republikën e Kosovës deri në marrjen e vendimit të formës së prerë.
2. Anëtarët e familjes të cilët kanë arritur në Republikën e Kosovës së bashku me azilkërkuesin, kanë të drejtë të qëndrojnë në përputhje me paragrafin 1. të këtij neni.

3. Organi kompetent duhet të ndërmarr masat e nevojshme të mbaj aq sa është e mundur unitetin familjar, ashtu siç është brenda territorit të Republikës së Kosovës nëse azilkërkueseve iu është ofruar strehim.

Neni 21
E drejta për kushte themelore të jetesës dhe kushte sociale

Azilkërkuesit kanë të drejtë në ndihmë financiare që përfshinë strehimin, ushqimin dhe veshmbathjen të ofruar në mall ose në kupona, dhe një porcion të përditshëm shpenzimesh. Azilkërkuesit me nevoja të veçanta do t'iu sigurohen standardet e jetesës në pajtim me nevojat e tyre specifike.

Neni 22
Kujdesi shëndetësor

1. Azilkërkuesit kanë të drejtë në kujdes shëndetësor e cila përfshinë, kujdesin emergjent shëndetësor dhe trajtimin e sëmundjes.
2. Azilkërkuesit të cilët i janë nënshtruar përdhunimit, torturës ose formave të tjera të rënda të dhunës si dhe azilkërkueseve me nevoja të veçanta, do t'iu afrohet trajtim i nevojshëm mjekësor sipas nevojave specifike dhe pasojave të shkaktuara.

Neni 23
Ndihma ligjore pa pagesë

1. Azilkërkuesit i afrohet ndihma juridike falas si në vijim:
   1.1. informata lidhur me të drejtat dhe detyrimet e azilkërkueseve;
   1.2. ndihma në hartimin e ankesave;
   1.3. përfaqësimin në procedurë para organit kompetent.
2. Ndihma sipas paragrafit 1. të këtij neni, do t'i afrohet azilkërkuesit i cili nuk ka mjete të mjaftueshme apo gjëra me vlerë për t'i mbuluar shpenzimet përkatëse.
3. Ndihmën sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund ta afrojnë: avokatët apo organizatat për ndihmë të refugjatëve.

Neni 24
E drejta në arsim e fëmijëve azilkërkues

Azilkërkuesit fëmijë kanë të drejtë në arsimin fillor dhe të mesëm sipas të njëjtave kushte me qytetarët e Republikës së Kosovës.

Neni 25
E drejta në mendimit dhe besimit fetar lirinë e fesë

Qeveria e Kosovës do t'iu garantoj azilkërkueseve të drejtën e ushtrimit dhe lirinë e fesë sipas bindjeve të tyre.

Neni 26
E drejta për punësim dhe e drejta në trajnime profesionale

1. Azilkërkuesit kanë të drejtë të ushtrojnë aktivitet fitimprurës pas gjashtë (6) muajve që nga dita e paraqitjes së kërkesës deri në vendimin e formës së prerë.
2. Azilkërkuesit kanë të drejtë në trajnime profesionale pavarësisht nëse kanë qasje në tregun e punës.

Neni 27
Detyrimet e azilkërkuesit

1. Azilkërkuesi është i detyruar:
   1.1. gjatë gjithë kohës të veproj në pajtim me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore të Republikës së Kosovës, si dhe me masat e ndërmarra nga organet shtetërore;
   1.2. të bashkëpunojë me DSHAM-në dhe organet e tjera relevante qeveritare;
   1.3. t'i përgjigjet ftesave të organit kompetent dhe zyrave të tjera qeveritare dhe të bashkëpunojë në çdo fazë të procedurës së azilit;
   1.4. të dorëzojë dokumentet e udhëtimit, identitetit dhe prova të tjera që i ka në dispozicion;
   1.5. të njoftojë DSHAM-në dhe organet e tjera përkatëse të azilit për çfarëdo ndryshimi të adresës brenda tri (3) ditësh;
   1.6. të veprojë në pajtim me urdhrat që lëshohen nga organi kompetent, dhe të gjitha urdhrat e tjera qeveritare lidhur me kufizimet e lëvizjes;
   1.7. të mos lëshojë territorin e Kosovës pa lejen e organit kompetent derisa të mos përfundohet procedura e azilit;
   1.8. të bashkëpunojë me organin kompetent lidhur me marrjen e gjurmëve të gishtërinjve dhe fotografisë.
2. organi kompetent mund të kontrollojë azilkërkuesin dhe gjësendet të cilat ai i posedon.
3. organi kompetent mund të mbaj procesverbal lidhur me deklarimet e azilkërkuesit, nëse paraprakisht ai është informuar për këtë.

Neni 28
Të drejtat e personave me status të refugjatit dhe personit nën mbrojtje plotësuese

1. Personi me status refugjati dhe personi nën mbrojtje plotësuese ka të drejtat si në vijim:
   1.1. të drejtën për qëndrim në Republikën e Kosovës për kohën sa zgjatë azili ose mbrojtja plotësuese;
   1.2. ndihmën sociale elementare;
   1.3. strehimin elementar;
   1.4. kujdesin shëndetësor;
   1.5. arsimim;
   1.6. ndihmën për integrim në shoqëri;
   1.7. të drejtën në lirinë e mendimit dhe besimit fetar;

1.8. të drejtën për punësim dhe të drejtën për trajnime profesionale;
1.9. bashkimin me familjarë, siç parashihet në këtë ligj;
1.10. të drejtën në qasje në gjykata dhe ndihmë ligjore;
1.11. të drejtën për të poseduar pasuri të tundshme dhe të patundshme.

2. Personi me status refugjati dhe personi nën mbrojtje plotësuese, gëzojnë të drejtat nga paragrafi 1. i këtij neni, deri në nivelin e mbrojtjes të cilën e gëzojnë shtetasit e Republikës së Kosovës.
3. Organi kompetent do të informoj personin me status refugjati apo personin nën mbrojtje plotësuese në një afat pesëmbëdhjetë (15) ditësh, që nga dita e njohjes së azilit apo mbrojtjes plotësuese në një gjuhë të cilën ai ose ajo e kupton lidhur me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga njohja e statusit përkatës.

Neni 29
E drejta për qëndrim

Personi me status refugjati apo personi nën mbrojtje plotësuese ka të drejtë për qëndrim në Republikën e Kosovës për aq kohë sa i është dhënë azili apo mbrojtja plotësuese.

Neni 30
Mirëqenia sociale

Personi me status refugjati dhe personi nën mbrojtje plotësuese kanë të drejtë në ndihmë të domosdoshme sociale nën kushte të njëjta me shtetasit e Republikës së Kosovës.

Neni 31
Strehimi elementar

1. Personit me status refugjati apo personit nën mbrojtje plotësuese do t'i sigurohet strehimi deri në dy (2) vite, që nga dita e marrjes së vendimit për njohjen e azilit apo mbrojtjes plotësuese.
2. Personi me status refugjati ose personi nën mbrojtje plotësuese do ta humb të drejtën për akomodim nëse refuzon afrimin e strehimit elementar sipas paragrafit 1. të këtij neni.
3. Personi me status refugjati apo personi nën mbrojtje plotësuese i cili ka mjete të veta për mbulimin e shpenzimeve lidhur me strehimin, nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 32
Kujdesi shëndetësor

Personi me status refugjati apo personi nën mbrojtje plotësuese, ka të drejtën për kujdesin shëndetësor në nivel të njëjtë sikur edhe shtetasit e Kosovës.

Neni 33
Arsimimi

Personi me status refugjati apo personi nën mbrojtje plotësuese ka të drejtë në arsim fillor, të mesëm dhe të lartë nën kushte të njëjta sikurse edhe shtetasit e Republikës së Kosovës.

Neni 34
Integrimi në shoqëri

Me qëllim të integrimit në shoqërinë kosovare, personave me status refugjati dhe personave nën mbrojtje plotësuese do t'iu mundësohet mësimi i historisë, gjuhës dhe kulturës Kosovare.

Neni 35
Liria e mendimit dhe besimit fetar

Qeveria e Kosovës do t'i garantoj personave me status refugjati apo personit nën mbrojtje plotësuese të drejtën e ushtrimit, lirinë e mendimit dhe besimit fetar sipas bindjeve të tyre.

Neni 36
E drejta për punësim dhe e drejta në trajnime profesionale

1. Personi me status refugjati apo personi nën mbrojtje plotësuese ka të drejtë të punoj në Republikën e Kosovës pa leje të punës për shtetasit e huaj.
2. Personi me status refugjati dhe personi nën mbrojtje plotësuese, kanë të drejtë të trajnimit profesional, praktikës për përvojë pune nën të njëjtat kushte sikurse edhe shtetasit kosovar.

Neni 37
Bashkimi familjar

Personi me status refugjati dhe personi nën mbrojtje plotësuese ka të drejtë për bashkim familjar siç është parashikuar në nenin 2, paragrafi 1.19. të këtij ligji.

Neni 38
Ndihma ligjore falas

1. Personi me status refugjatit apo personit nën mbrojtje plotësuese i afrohet ndihma juridike falas si në vijim:
   1.1. informata lidhur me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga njohja e statusit të azilit apo personit nën mbrojtje plotësuese;
   1.2. ndihma në hartimin e ankesave dhe përfaqësimin para organit kompetent në rast të ndërprerjes, anulimit apo revokimit të statusit të refugjatit apo mbrojtjes plotësuese.

2. Ndihma sipas paragrafit 1. të këtij neni, do t'i afrohet personit me status refugjati apo personit i cili nuk ka mjete të mjaftueshme apo gjëra me vlerë për t'i mbuluar shpenzimet përkatëse.
3. ndihmën sipas paragrafit 1. të këtij neni mund ta afrojnë: avokatët apo organizatat për ndihmë të refugjatëve.

Neni 39
Të drejtën për të poseduar pasuri të tundshme dhe të patundshme

Personi me status refugjati apo personi nën mbrojtje plotësuese ka të drejtën e posedimit të pasurisë së tundshme dhe të patundshme nën kushte të njëjta sikurse personat e huaj.

Neni 40
Natyralizimi

Personi me status refugjati ka të drejtë për natyralizim në pajtim me Ligjin për Shtetësinë.

Neni 41
Detyrimet e personave me status refugjati dhe personave nën mbrojtje plotësuese

1. Personi me status refugjati apo personi nën mbrojtje plotësuese janë të detyruar:
   1.1. të respektojnë kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore të Republikës së Kosovës;
   1.2. në afatin shtatë (7) ditor ta njoftojnë organin kompetent për ndryshimin e adresës.

KREU III
PROCEDURA E AZILIT

Neni 42
Organet kompetente vendimmarrëse

1. DSHAM është përgjegjëse për vendosje në shkallën e parë lidhur me kërkesën për azil.
2. Komisioni Kombëtar për Refugjatë është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të drejtuara kundër vendimeve të shkallës së parë.
3. Gjykata kompetente në përputhje me Ligjin për Gjykatat, është përgjegjëse për shqyrtimin e vendimeve administrative.

Neni 43
Parimet e procedurës së azilit

1. Procedura e azilit fillon kur shtetasi i huaj apo personi pa shtetësi paraqet kërkesën për azil.

2. Organi kompetent i mundëson azilkërkuesit të paraqes, shpjegoj dhe dëshmoj të gjitha faktet dhe rrethanat të cilat janë relevante për kërkesën e tij/ saj për azil.
3. Azilkërkuesi duhet plotësisht të bashkëpunojë në mënyrë aktive me organin kompetent gjatë procedurës. Azilkërkuesi do të paraqes dhe të shpjegoj të gjitha faktet dhe rrethanat për të cilat është në dijeni me qëllim që ta ndihmoj organin kompetent në shqyrtimin e dëshmive të cilat i ka në dispozicion azilkërkuesi. Ai/ ajo do të paraqes të gjitha dokumentet përkatëse në posedim të tij / saj që mund të jenë relevante për përcaktimin e azilit.
4. Organi kompetent shqyrton kontekstin e informacionit lidhur me situatën aktuale në vendin prej të cilit ka ikur personi dhe përpiqet të verifikojë faktet dhe rrethanat e ndërlidhura me azilkërkuesin në lidhje me çfarëdo dëshmie të ofruar nga ai/ajo. Organi kompetent mund të marrë në konsideratë dëshmi shtesë që ka në dispozicion me qëllim të vendosjes për kërkesën e azilit.
5. Vendimet e organit kompetent për të njohur ose refuzuar azilin nuk merren vetëm në bazë të dokumenteve formale dhe dëshmive tjera të ngjashme. Vendimi merret duke u bazuar në vlerësimin e të gjitha dëshmive që janë në dispozicion, përfshirë edhe deklaratat e azilkërkuesit.
6. Gjatë procedurës së azilit, organi kompetent do të bëjë të gjitha përpjekjet për të siguruar që procedura të mos jetë e pafavorshme dhe për aq sa është e mundshme dhe kur të jetë e nevojshme, azilkërkuesi të ndihmohet në paraqitjen e kërkesës tij/saj. Zyrtarët përgjegjës për intervistimin e azilkërkuesit janë përgjegjës të parandalojnë që mungesa e dijes dhe e përvojës së azilkërkuesit të mos i dëmtojë të drejtat e tij.

Neni 44
Zbatimi i Ligjit mbi Procedurën Administrative

Nëse nuk është e rregulluar ndryshe me këtë ligj, procedura e azilit do të jetë në përputhje me Ligjin për Procedurën Administrative.

Neni 45
Paraqitja e kërkesës

1. Kërkesa e azilit paraqitet në momentin e hyrjes në Kosovë, në një pikë të kalimit kufitar, në një stacion policor ose në DSHAM.
2. Organet nga paragrafi 1. i këtij neni, janë të obliguara që t'ia mundësojnë azilkërkuesit që sa më parë që të jetë e mundur ta parashtroj kërkesën për azil. Kërkesat për azil nuk do të refuzohen ose përjashtohen prej shqyrtimit për të vetmen arsye se nuk janë parashtruar sa më shpejt që është e mundur.
3. Organi i cili e pranon kërkesën për azil sipas këtij neni, duhet që me rastin e pranimit të kërkesës ta plotësoj formularin fillestar duke përfshirë, marrjen e gjurmëve të gishtërinjve, fotografisë, dëshmive të tjera që ndërlidhen me kërkesën për azil dhe dokumenteve të udhëtimit.
4. Pas plotësimit të formularit fillestar, organi i cili e pranon kërkesën duhet që menjëherë ta kontaktoj zyrtarin kompetent të azilit në kuadër të DSHAM-së dhe ta transportoj azilkërkuesin në Qendrën për Azilkërkues.

Neni 46
Qendra për Azilkërkues

1. Qendrat për Azilkërkues (në tekstin e mëtejmë Qendra) administrohet nga DSHAM.
2. Funksionimi i qendrave dhe procedurat, rregullohen me procedurë të veçantë të miratuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Neni 47
Pranimi i azilkërkuesit në Qendër

1. Pas pranimit të azilkërkuesit në Qendër, zyrtari i Qendrës së Azilit duhet ta informoj azilkërkuesin lidhur me të drejtat dhe detyrimet si dhe procedurën e azilit, duke përfshirë mundësinë e përfitimit të ndihmës juridike pa pagesë dhe mundësinë e kontaktimit me përfaqësuesit e UNHCR-së ose organizatat tjera, të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të refugjatëve në gjuhën e tij ose në një gjuhë të cilën e kupton.
2. Pas informimit të azilkërkuesit për të drejtat detyrimet dhe mënyrën e procedurës azilkërkuesi i nënshtrohet ekzaminimit të nevojshëm mjekësor.

Neni 48
Akomodimi i azilkërkuesit

1. Azilkërkuesit mund të vendosen në Qendrën për Azilkërkues në ndonjë lokacion tjetër të përcaktuar nga DSHAM ose diku tjetër sipas dëshirës së tyre.
2. Në rastet e vendosjes së azilkërkuesve në një lokacion sipas zgjedhjes së tyre, shpenzimet e akomodimit mbulohen nga vet azilkërkuesit.

Neni 49
Pjesëmarrja e palëve të treta në procedurën e azilit

1. Procedura e azilit nuk do të jetë e hapur për publikun.
2. Individët e mëposhtëm mund të jenë prezentë në procedurën e azilit:
   2.1. përfaqësuesi i autorizuar;
   2.2. kujdestari ligjor për fëmijët e pashoqëruar;
   2.3. kujdestari për persona me aftësi të zvogëluar mendore;
   2.4. përfaqësuesi i UNHCR-së;
   2.5. përkthyesi.

Neni 50
Intervista me azilkërkuesin

1. Azilkërkuesi do të intervistohet personalisht pa prezencën e anëtarëve të tjerë të familjes, përveç kur organi kompetent konsideron të domosdoshme prezencën e anëtarëve të tjerë të familjes për një shqyrtim të duhur.
2. DSHAM do ta intervistoj azilkërkuesin në kohën sa më të shkurtë të mundur. Nëse është e nevojshme, azilkërkuesi do të intervistohet disa herë.

3. Azilkërkuesi është i obliguar të deklaroj të gjitha faktet dhe rrethanat që mbështesin kërkesën e tij/ saj për azil, të deklaroj të vërtetën në të gjitha përgjigjet, të paraqes të gjitha provat në dispozicion dhe të jep një shpjegim bindës dhe të besueshëm.
4. Intervista me azilkërkuesin duhet të zhvillohet nën kushtet të cilat e sigurojnë konfidencialitetin.
5. Intervista me azilkërkues mbahet në një procesverbal, procesverbali nënshkruhet nga azilkërkuesi për të konfirmuar vërtetësinë pasi që t'i jetë komunikuar në gjuhën të cilën e kupton.
6. Kur një azilkërkues refuzon të miratojë përmbajtjen e raportit, arsyet për këtë refuzim duhet të shënohen në dosjen e azilkërkuesit. Refuzimi për të miratuar përmbajtjen e raportit, nuk do të ndalojë organin kompetent nga nxjerrja e vendimit lidhur me kërkesën për azil.
7. Azilkërkuesi do të intervistohet nga personi i cili është mjaft kompetent për të marrë në konsideratë rrethanat personale ose të përgjithshme të kërkesës, duke përfshirë origjinën kulturore të aplikuesit ose cenueshmërinë e tij/saj, për aq sa është e mundur për të bërë këtë.

Neni 51
Vërtetimi i fakteve

1. DSHAM, sipas detyrës zyrtare vërteton të gjitha faktet relevante për marrjen e vendimit. Organi kompetent, nëse e konsideron të domosdoshme, do të zhvillojë intervistë plotësuese të azilkërkuesit, të shqyrtojë provat e nxjerra dhe nëse është e nevojshme të kërkojë edhe prova të tjera.
2. Në rastet kur DSHAM, ka nevojë për mendimin e ekspertit për të vërtetuar faktet e caktuara për marrjen e vendimit lidhur me një kërkesë të azilit, organi kompetent është i autorizuar të konsultojë një ekspert të asaj fushe. Eksperti udhëzohet lidhur me fshehtësinë e procedurës dhe do të pajtohet me kushtet e fshehtësisë, siç përcaktohet me këtë ligj.
3. DSHAM mund të këshillohet me ekspertin në çështjet e dëshmive për përcaktimin e azilit sipas kërkesës së azilkërkuesit, përfaqësuesit të tij ose të saj ose përfaqësuesit të Zyrës së UNHCR-së, nëse e vlerëson se mendimi i tillë mund të jetë i rëndësishëm për të vendosur për azilin.
4. Organi kompetent me rastin e shqyrtimit të kërkesës do të sigurohet se vendimi është marrë individualisht, objektivisht dhe në mënyrë të paanshme si dhe informacionet e sakta janë marrë nga burime të ndryshme si Komisariati i Lartë për Refugjatë (UNHCR) lidhur me gjendjen e përgjithshme që mbretëron në vendin e origjinës së azilkërkuesit dhe kur është e domosdoshme, edhe lidhur me vendet nëpër të cilat ata kanë kaluar dhe informatat e tilla të jenë të qasshme për personelin përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave dhe nxjerrjen e vendimeve.

Neni 52
Procedura e përshpejtuar

1. DSHAM mund të marrë vendim me procedurë të përshpejtuar në pajtim me parimet dhe garancitë themelore në shkallë të parë, lidhur me rastet kur:

1.1. vendimi pozitiv është i bazuar në dëshmitë në dispozicion, apo
1.2. vendimi negativ merret sipas nenit 54 të këtij ligji.

2. Kundër vendimit të marrë në procedurë të përshpejtuar, azilkërkuesi ka të drejtë të ushtroj ankesë pranë Komisionit Kombëtar për Refugjatë në afat prej shtatë (7) ditëve.
3. Nën-paragrafi 1.2. i këtij neni, nuk do të vlejë në rastet kur kërkesa është parashtruar nga fëmija i pashoqëruar apo persona me aftësi të kufizuara mendore.

Neni 53
Vendimi i shkallës së parë

1. DSHAM merr vendim përmes të cilit:
   1.1. e njeh azilin;
   1.2. refuzon azilin dhe njeh mbrojtjen plotësuese;
   1.3. refuzon kërkesën për azil;
   1.4. ndërprenë procedurën e azilit.
2. DSHAM do të marrë vendim në formë të shkruar dhe në rastet kur kërkesa për azil refuzohet, arsyet faktike dhe ligjore duhet të jenë cekur në vendimin përkatës si dhe informacionet lidhur me mundësinë e parashtrimit të ankesës.

Neni 54
Refuzimi i kërkesës për azil dhe mbrojtja plotësuese

1. DSHAM do të refuzoj kërkesën për azil në rastet:
   1.1. azilkërkuesi nuk i përmbush kriteret e refugjatit siç është përcaktuar në përkufizimin e refugjatit dhe të mbrojtjes plotësuese siç është paraparë në përkufizimin e mbrojtjes plotësuese;
   1.2. në rastet kur konsideron se azilkërkuesi nuk ka të drejtë për mbrojtje sipas nenit 7 dhe 9 të këtij ligji;
   1.3. në rastet kur kërkesa për azil është e pabazuar sipas nenit 55 të këtij ligji.

Neni 55
Kërkesa për azil e cila është e pabazuar

1. DSHAM-i do të refuzoj kërkesën për azil e cila konsiderohet e pabazuar në procedurë të përshpejtuar në pajtim me garancitë procedurale të parapara në këtë ligj në rastet kur:
   1.1. azilkërkuesi në parashtrimin e kërkesës se tij/saj dhe në paraqitjen e fakteve, ka ngritur vetëm çështje që nuk janë të rëndësishme ose janë të një rëndësie minimale për shqyrtimin nëse ai/ajo kualifikohet si refugjat në bazë të këtij ligji;
   1.2. azilkërkuesi vjen nga një vend i tretë sigurt i origjinës;
   1.3. azilkërkuesi vjen prej një vendi të sigurt me kushtin që vendi përkatës ripranon azilkërkuesin;
   1.4. azilkërkuesi me rastin e parashtrimit të kërkesës për azil, pa ndonjë arsye të justifikuar nuk ka deklaruar se të dhënat për identitetin e tij/saj, lidhjet familjare, vendqëndrimin e kaluar, itinerarin e udhëtimit, dokumentet

identifikuese, arsyet për të kërkuar mbrojtje, dhe kërkesës për azil;

1.5. azilkërkuesi ka parashtruar një tjetër kërkesë për azil duke paraqitur të dhëna tjera personale;

1.6. azilkërkuesi nuk ka paraqitur informata të cilat me një nivel të arsyeshëm të sigurisë do të krijonin identitetin apo shtetësinë e tij/saj, ose sipas të gjitha gjasave në keqbesim ai/ajo ka shkatërruar apo ka fshehur dokumentin e udhëtimit ose identitetit të cilat do të ndihmonin për të vërtetuar identitetin apo shtetësinë e tij/saj; ose

1.7. azilkërkuesi ka qenë subjekt i kërkesës për azil në Republikën e Kosovës për të cilën është marrë vendim negativ dhe rrethanat për këtë vendim nuk kanë ndryshuar;

1.8. azilkërkuesi ka dështuar pa shkaqe të arsyeshme për të bërë kërkesën e tij/saj për azil më herët, duke pasur mundësinë për të bërë një gjë të tillë;

1.9. azilkërkuesi përdor procesin e azilit thjeshtë për të penguar apo vonoj deportimin.

1.10. të dhëna të rrejshme janë dhënë në lidhje me identitetin apo dokumente të rrejshme janë paraqitur, të cilat me qëllim janë deklaruar si origjinale;

1.11. azilkërkuesi refuzon të bashkëpunoj në lidhje me marrjen e shenjave të gishtërinjve.

Neni 56
Pezullimi i procedurës

1. DSHAM do ta pezulloj procedurën e azilit në rastet kur plotësohet njëri nga kushtet si në vijim:
   1.1. azilkërkuesi heq dorë nga kërkesa për azil;
   1.2. kur azilkërkuesi largohet nga vendqëndrimi i fundit për më shumë se tri (3) ditë pa e njoftuar organin kompetent përveç rasteve kur azilkërkuesi dëshmon brenda një kohe të arsyeshme se largimi i azilkërkuesit dhe moslajmërimi kanë ndodhur nga rrethanat jashtë kontrollit të tij/saj;
   1.3. azilkërkuesi largohet nga Republika e Kosovës gjatë procedurës.
2. Azilkërkuesi mund të bëjë kërkesë për rihapje të procedurës së azilit vetëm nëse paraqet arsye të forta. Kërkesa për rihapje të procedurës së azilit do të ndalojë dëbimin e të huajit nga Kosova.

Neni 57
Parashtrimi i kërkesës së re për azil

1. Azilkërkuesi, kërkesa e të cilit është refuzuar dhe vendimi ka marrë formë të prerë, mund të parashtroj kërkesë të re për azil.
2. Kërkesa e re sipas paragrafit 1. të këtij neni, do të shqyrtohet sipas një shqyrtimi paraprak nëse azilkërkuesi paraqet fakte të reja lidhur me konstatimin nëse ai ka gjasa të mira të cilësohet si refugjatë. Nëse gjatë shqyrtimit paraprak sipas këtij paragrafi, konstatohen fakte të reja të cilat në masë të konsiderueshme ka gjasa që azilkërkuesi të cilësohet si refugjat, atëherë kërkesa e re do të shqyrtohet sipas një shqyrtimi të rregullt.

3. Kërkesa e azilit e cila është objekt e shqyrtimit paraprak në pajtim me paragrafin 2. të këtij neni do të shqyrtohet në pajtim me garancitë procedurale të parapara në këtë ligj.

Neni 58
Kthimi i azilkërkuesit

Nëse kërkesa për azil refuzohet apo ndërpritet me vendim të formës së prerë, DSHAM vendos, si rregull të përgjithshëm, kthimin nga Kosova dhe urdhëron ekzekutimin e vendimit. DSHAM merr parasysh parimin e unitetit të familjes.

Neni 59
Pushimi i azilit

1. Shtetasi i huaj apo personi pa shtetësi do të pushoj të jetë refugjatë, nëse ai apo ajo:
   1.1. në mënyrë vullnetare e kthen veten në mbrojtjen e vendit të shtetësisë; apo
   1.2. duke humbur shtetësinë e tij ose saj në mënyrë vullnetare e rikërkon atë; apo
   1.3. ka fituar një shtetësi të re dhe gëzon mbrojtjen e vendit të shtetësisë së tij ose saj të re; apo
   1.4. në mënyrë vullnetare rivendoset në vendin të cilin ai ose ajo e kishte lëshuar apo jashtë të cilit ai apo ajo mbetet me frikën e të qenit i/e persekutuar; apo
   1.5. për shkak se rrethanat në lidhje me të cilat ai apo ajo ishte njohur si refugjatë kishin pushuar së ekzistuari, nuk mundet me tutje të vazhdoj të refuzojë që të përfitoj nga mbrojtja e vendit të shtetësisë; apo
   1.6. duke qenë person i/e pa shtetësi, për shkak se rrethanat për të cilat ishte njohur si refugjatë kishin pushuar së ekzistuari, ai ose ajo mund të kthehen në vendin e mëparshëm të rregullt.
2. Me rastin e shqyrtimit të nën-paragrafëve 1.5. dhe 1.6. organi kompetent do të ketë parasysh faktin nëse ndryshimi i rrethanave është i natyrës aq të rëndësishme dhe jo të përkohshme, ashtu që frika e refugjatit për persekutim nuk mund të konsiderohet më tutje si e mirë bazuar.
3. Nën-paragrafi 1.5. dhe 1.6. i paragrafit 1. të këtij neni nuk do të aplikohet për refugjatin i cili mund të parashtroj arsye bindëse që dalin nga persekutimi i mëparshëm për refuzimin e përfitimit e tij apo saj nga mbrojtja e vendit të shtetësisë, apo duke qenë person pa shtetësi, të vendbanimit të mëparshëm.

Neni 60
Revokimi, anulimi apo refuzimi i ripërtëritjes së statusit të refugjatit

1. Organi kompetent do ta revokoj, ose refuzoj ripërtëritjen e statusit të refugjatit në rastet kur:
   1.1. ai apo ajo ka pushuar të jetë refugjat në pajtim me nenin 59 të këtij ligji;
   1.2. ai apo ajo ka qenë apo është përjashtuar nga të qenit refugjat në pajtim me nenin 7 të këtij ligji.
2. Organi kompetent do të anuloj ose refuzoj ripërtëritjen e statusit të refugjatit në rastet kur:

2.1. shtrembërimi apo mos prezantimi i fakteve nga ana e tij apo saj, përfshirë përdorimin e dokumenteve false, ka qenë vendimtare për njohjen e statusit të refugjatit;
2.2. ka bazë të arsyeshme që ai apo ajo të konsiderohen si të rrezikshëm për sigurinë e Republikës së Kosovës;
2.3. ai apo ajo duke qenë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për ndonjë krim veçanërisht serioz, paraqet rrezik për shoqërinë e Republikës së Kosovës.

3. Para se të revokohet, anulohet ose refuzohet te ripërtërihet statusi i refugjatit, organi kompetent do të informoj azilkërkuesin me shkrim lidhur me arsyet e rishqyrtimit të statusit të azilit, si dhe t'ia afroj mundësinë për të paraqitur arsyet me gojë apo me shkrim se përse statusi i tij nuk duhet të revokohet.
4. Personit të cilit i është revokuar statusi i refugjatit në bazë të nën-paragrafit 1.2. të këtij neni, dhe i cili është prezent në Republikën e Kosovës do t'iu garantohen të drejtat si në vijim: e drejta për mos diskriminim, e drejta për liri fetare, qasja në gjykata, edukim, mos dënimi për shkak të hyrjes apo qëndrimit ilegal, respektimin e parimit të moskthimit.

Neni 61
Pushimi i mbrojtjes plotësuese

1. Personat me mbrojtje plotësuese nuk konsiderohet si të tillë nga momenti kur rrethanat që justifikonin dhënien e kësaj mbrojtje, pushojnë së ekzistuari ose kur këto rrethana kanë ndryshuar në mënyrë të tillë që kjo mbrojtje nuk është më e nevojshme.
2. Me rastin e aplikimit të paragrafit 1. të këtij neni, organi kompetent do të marrë në konsideratë faktin nëse ndryshimi i rrethanave është i rëndësisë së tillë dhe i natyrës jo të përkohshme, ashtu që personi i cili gëzon mbrojtjen plotësuese nuk përballet më tutje me rrezik real të cenimit serioz.
3. Mbrojtja plotësuese pushon edhe në qoftë se:
   3.1. personi heq dorë nga mbrojtja plotësuese.

Neni 62
Revokimi, ndërprerja apo refuzimi i ripërtëritjes së mbrojtjes plotësuese

1. Organi kompetent do ta revokoj, ose refuzon ripërtëritjen e mbrojtjes plotësuese në rastet kur:
   1.1. ai apo ajo ka pushuar të jetë përfitues i mbrojtjes plotësuese sipas nenit 61 të këtij ligji;
   1.2. ai apo ajo është dashur të përjashtohet apo është përjashtuar nga dhënia e statusit të mbrojtjes plotësuese në pajtim me nenin 9 të këtij ligji;
   1.3. shtrembërimi apo mos prezantimi i fakteve nga ana e tij apo saj, përfshirë përdorimin e dokumenteve false, ka qenë vendimtare për dhënien e mbrojtjes plotësuese.
2. Para se të revokohet mbrojtja plotësuese organi kompetent do të informoj personin me mbrojtje plotësuese me shkrim, lidhur me arsyet e rishqyrtimit të statusit të

mbrojtjes plotësuese, si dhe t'ia ofroj mundësinë për të paraqitur arsyet me gojë apo me shkrim se përse statusi i tij nuk duhet të revokohet.

Neni 63
Afatet e procedurës në shkallën e parë

1. Procedura e azilit në shkallë të parë si rregull zgjatë gjashtë (6) muaj që nga dita e paraqitjes së kërkesës për azil.
2. Vendimet e marra në mbështetje të nenit 52 të këtij ligji, duhet si rregull i përgjithshëm të merret brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës.

KREU IV
PROCEDURA E ANKESËS

Neni 64
Ankesa

1. Azilkërkuesi, personi me status refugjati, personi nën mbrojtje plotësuese apo personi nën mbrojtje të përkohshme ka të drejtë të parashtrojë ankesë kundër vendimit të DSHAM-së pranë Komisionit Kombëtar për Refugjatë.
2. Ankesat kundër vendimit të shkallës së parë rregullohen nga Ligji për Procedurën Administrative, përveç rasteve kur Ligji për Azil parashikon ndryshe.
3. Ankesat kundër vendimeve të shkallës së dytë paraqiten pranë gjykatës kompetente. Ankesa kundër vendimit të shkallës së parë dhe të dytë e pezullon ekzekutimin e vendimit.

Neni 65
Afatet për parashtrimin e ankesës

1. Afati për parashtrimin e ankesës kundër vendimit të shkallës së parë është pesëmbëdhjetë (15) ditë që nga dita e njoftimit të vendimit përveç rasteve të përcaktuara ndryshe me këtë ligj.
2. Ankesa e transmetuar me fax, konsiderohet e vlefshme nëse dërgohet brenda afatit dhe origjinali dërgohet më pas.

Neni 66
Komisioni Kombëtar për Refugjatë

1. Qeveria e Kosovës themelon Komisionin Kombëtar për Refugjatë dhe anëtarët e tij, të cilët shërbejnë gjatë një afati prej tri (3) vitesh:
   1.1. komisioni përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe pesë anëtarë të rregullt;
   1.2. kryetari, zëvendëskryetari dhe anëtarët e Komisionit emërohen nga radhët e juristëve të diplomuar, të punësuar në organet shtetërore administrative dhe duhet të kenë së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale;

1.3. organi i shkallës së parë përjashtohet nga pjesëmarrja në Komisionin Kombëtar për Refugjatë;
1.4. përfaqësuesi i UNHCR-së merr pjesë me cilësinë e vëzhguesit dhe ka të drejtë të paraqes komente në kontekst të vendimit final.

2. Komisioni është i pavarur në punën e tij.
3. Në parim, Komisioni vendos për rastet në këshill prej tre (3) anëtarësh, të kryesuar nga kryetari ose zëvendëskryetari. Këshilli merr vendimet me shumicë të votave.
4. Qeveria nxjerr akt nënligjor për rregullimin e procedurës së Komisionit Kombëtar për Refugjatë.

Neni 67
Arsyet e ankesës

1. Arsyet e ankesës janë si në vijim:
1.1. shkelja e dispozitave të drejtës procedurale;
1.2. shkelja e dispozitave të drejtës materiale;
1.3. konstatimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike;
1.4. fakte të reja të rëndësishme në mbështetje të kërkesës.

Neni 68
Rivendosja në afat

1. Nëse azilkërkuesi i cili për shkaqe të arsyeshme nuk mund të dorëzoj ankesën brenda afatit ligjor, mund të kërkoj rivendosjen në afat të ankesës.
2. Kërkesa për rivendosje në afat paraqitet brenda dhjetë (10) ditëve nga dita e marrjes në dijeni për njoftimin e vendimit të marrë në ngarkim të tij.
3. Kërkesa për rivendosje në afat pezullon ekzekutimin e vendimit për dëbimin e azilkërkuesit nga Kosova.

Neni 69
Procedura në shkallën e dytë

1. Komisioni Kombëtar për Refugjatë vendos mbi bazën e provave të mbledhura gjatë procedurës së azilit në shkallën e parë si dhe mbi bazën e provave të tjera të paraqitura nga azilkërkuesi.
2. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioni vendos si në vijim:
2.1. miraton vendimin e shkallës së parë;
2.2. anulon vendimin e shkallës së parë dhe të njëjtin e kthen për rishqyrtim;
2.3. përmirëson mangësitë e konstatuara dhe merr vendimin;
2.4. bën ndryshimin e vendimit të shkallës së parë mbi bazën e të njëjtave prova.

Neni 70
Afatet për shqyrtimin e ankesës

1. Si rregull i përgjithshëm, Komisioni vendos brenda tridhjetë (30) ditësh për shqyrtimin e ankesës përveç rasteve të ankesave të paraqitura kundër vendimeve të marra në mbështetje të nenit 55 të këtij ligji.

2. Në rastet kur ankesa është parashtruar kundër vendimeve të marra në mbështetje të nenit 55, atëherë afati për të vendosur lidhur me ankesën është pesëmbëdhjetë (15) ditë që nga dita e parashtrimit të ankesës.

KREU V
DHËNIA E MBROJTJES SË PËRKOHSHME DHE STATUSI I PERSONAVE ME MBROJTJE TË PËRKOHSHME

Neni 71
Vendimi i Qeverisë

1. Republika e Kosovës mund t'iu japë mbrojtjen e përkohshme shtetasve të huaj apo personave pa shtetësi, të cilët vijnë në numër të madh nga vendet ku për arsye të luftës ose situatës së ngjashme, dhunës së përgjithshme ose konfliktit të brendshëm, të drejtat fundamentale të njeriut janë shkelur, me kusht që vendi i origjinës nuk dëshiron apo nuk ka mundësi për t'i mbrojtur.
2. Vendimin lidhur me nevojën e dhënies së mbrojtjes së përkohshme si dhe vendimin lidhur me pushimin e arsyeve për dhënien e mbrojtjes do ta marrë Qeveria e Kosovës.
3. Vendimi lidhur me nevojën e dhënies së mbrojtjes së përkohshme do të përcaktoj grupet e personave për të cilët do të aplikohet dhënia e mbrojtjes së përkohshme dhe datën për të cilën mbrojtja do të ketë efekt.
4. Vendimi lidhur me nevojën e dhënies së mbrojtjes së përkohshme sipas këtij neni, duhet të merret duke pasur parasysh kapacitetet ekonomike, sigurinë kombëtare, mbrojtjen e rendit dhe të qetësisë publike si dhe informatat përkatëse të dhëna nga UNHCR-ja dhe organizatat tjera për ndihmë refugjatëve.
5. Mbrojtja e përkohshme nuk do ta paragjykoj njohjen e statusit të refugjatit sipas Konventës së Gjenevës.
6. Republika e Kosovës do ta jep mbrojtjen e përkohshme duke i respektuar të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale si dhe obligimin lidhur me parimin e moskthimit.

Neni 72
Organi kompetent për dhënien e mbrojtjes së përkohshme

1. Ministria është organi kompetent për dhënien e mbrojtjes së përkohshme.
2. Mbrojtja e përkohshme jepet në një afat prej një (1) viti.
3. Mbrojtja e përkohshme mund të vazhdohet për gjashtë (6) muaj shtesë nëse vazhdojnë kushtet në vendin e prejardhjes së personit të mbrojtur të cilat përbënin bazë të vendimit për dhënien e mbrojtjes. Mbrojtja e përkohshme mund të zgjatet për një periudhë maksimale prej dy (2) vitesh.

Neni 73
Arsyet për përjashtim

Mbrojtja e përkohshme nuk iu jepet shtetasve të huaj apo personave pa shtetësi, në rastet kur konstatohet se nuk kanë të drejtë për mbrojtje siç është përcaktuar në nenin 7 dhe 9 të këtij ligji.

Neni 74
Parashtrimi i kërkesës për azil

1. Personat nën mbrojtje të përkohshme kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për azil në çdo kohë.
2. Kërkesa për azil sipas paragrafit 1. të këtij neni, do të shqyrtohet pas përfundimit të mbrojtjes së përkohshme.

Neni 75
Përfundimi i mbrojtjes së përkohshme

1. Mbrojtja e përkohshme do të përfundoj në këto raste:
   1.1. pas përfundimit të afatit për të cilin i është lejuar mbrojtja e përkohshme;
   1.2. pas vendimit të Qeverisë lidhur me pushimin e arsyeve për dhënien e mbrojtjes së përkohshme.

Neni 76
Kthimi

1. Republika e Kosovës do të ndërmarrë masat e nevojshme për t'ua bërë të mundur kthimin vullnetarë personave nën mbrojtje plotësuese ose atyre të cilëve mbrojtja e përkohshme iu ka përfunduar. Kosova do të sigurohet se dispozitat që rregullojnë kthimin vullnetarë të personave nën mbrojtje të përkohshme lehtësojnë kthimin e tyre duke respektuar dinjitetin njerëzor. Republika e Kosovës do të sigurohet se vendimi lidhur me kthimin e këtyre personave është marrë duke njohur plotësisht faktet.
2. Republika e Kosovës do të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që kthimi me forcë i personave të cilëve afati i mbrojtjes së përkohshme i'u ka përfunduar apo i'u është ndërprerë të jetë në pajtim me respektimin e dinjitetit njerëzor.

Neni 77
Të drejtat dhe detyrimet e personave nën mbrojtjen e përkohshme

1. Personi nën mbrojtje të përkohshme, ka të drejtë:
   1.1. të qëndrojë përkohësisht në Republikën e Kosovës në pajtim me kohëzgjatjen e mbrojtjes së përkohshme;
   1.2. të ketë kushte themelore për strehim dhe jetesë;
   1.3. kujdesin shëndetësor;
   1.4. të drejtën në bashkim familjar sipas këtij ligji;
   1.5. të drejtën në arsimim;
   1.6. të qasje për këshillim dhe mbrojtje juridike;
   1.7. të drejtën në lirinë e mendimit dhe besimit fetar;
   1.8. të drejtën për të ushtruar aktivitet fitimprurës;
   1.9. në ndihmën e domosdoshme, në kuptimin e mirëqenies sociale.
2. Detyrimet e përcaktuara në nenin 41 të këtij ligji, vlejnë po ashtu për personat, të cilëve iu është dhënë mbrojtja e përkohshme.

Neni 78
E drejta në kujdesin shëndetësor

1. Personat nën mbrojtje të përkohshme kanë të drejtë në kujdes shëndetësor e cila përfshinë, kujdesin emergjent shëndetësor dhe trajtimin e sëmundjes.
2. Personat nën mbrojtje të përkohshme të cilët i janë nënshtruar përdhunimit, torturës ose formave të tjera të rënda të dhunës si dhe azilkërkuesve me nevoja të veçanta do t'iu ofrohet trajtim i nevojshëm mjekësor sipas nevojave specifike dhe pasojave të shkaktuara.

Neni 79
E drejta për kushte themelore të jetesës

1. Personat nën mbrojtje të përkohshme kanë të drejtë në kushte themelore të jetesës e cila përfshinë por nuk kufizohet në: strehimin, ushqimin, veshmbathjet, pakot higjienike. Personave nën mbrojtje të përkohshme me nevoja të veçanta do t'iu sigurohen standardet e jetesës në pajtim me nevojat specifike të tyre.
2. Personat nën mbrojtje të përkohshme kanë të drejtë të përfitojnë nga ndihma sociale në përputhje me Ligjin për Skemat Sociale.

Neni 80
E drejta në arsimim

Personat nën mbrojtje të përkohshme kanë të drejtë në arsim fillor, të mesëm nën kushte të njëjta sikurse edhe shtetasit e Republikës së Kosovës.

Neni 81
E drejta për ribashkim familjar

Ribashkimi familjar me anëtarët e varur të familjes lejohet për personat të cilëve iu është dhënë mbrojtja e përkohshme, për anëtarët e familjes, siç është përcaktuar në nenin 2, nën-paragrafi 1.19. të këtij ligji.

Neni 82
E drejta për punësim

1. Personat nën mbrojtje të përkohshme kanë të drejtë në punësim në Republikën e Kosovës pa leje të punës për shtetasit e huaj.
2. Personat nën mbrojtje të përkohshme kanë të drejtë në trajnime profesionale, praktikë për përvojë pune nën të njëjtat kushte sikurse edhe shtetasit kosovarë.

Neni 83
Të drejtën në lirinë e mendimit dhe besimit fetar

Qeveria e Kosovës do t'i garantoj personit nën mbrojtje të përkohshme të drejtën e ushtrimit dhe lirisë së fesë sipas bindjeve të tyre.

Neni 84
Akomodimi i të huajve të cilëve iu është lejuar mbrojtja e përkohshme

Personave nën mbrojtje të përkohshme, do t'iu sigurohet akomodimi në pajtim me mundësitë ekonomike të Republikës së Kosovës.

KREU VI

Neni 85
Lëshimi i dokumenteve

1. Ministria i lëshon azilkërkuesve dokumentet si në vijim:
   1.1. vërtetimin për dorëzimin e kërkesës për azil;
   1.2. letërnjoftimin për azilkërkuesin.
2. Personit me status refugjati, do t'i lëshohen dokumentet si në vijim:
   2.1. leje qëndrim për refugjatë; dhe
   2.2. dokumenti i udhëtimit për refugjatë.
3. Personave nën mbrojtje plotësuese dhe personave nën mbrojtje të përkohshme do t'iu lëshohen dokumentet si në vijim:
   3.1. leje qëndrim; dhe
   3.2. fletë udhëtimi për të huaj.
4. Dokumentet sipas paragrafit 2. dhe 3. të këtij neni do të lëshohen në pajtim me Ligjin për të Huaj.

Neni 86
Letërnjoftimi për azilkërkues

1. Letërnjoftimi i azilkërkuesit shërben po ashtu si leje e përkohshme për qëndrim në Republikën e Kosovës.
2. Letërnjoftimi iu lëshohet të gjithë anëtarëve të familjes së azilkërkuesit.
3. Letërnjoftimi i azilkërkuesit është i vlefshëm deri në përfundimin e procedurës së azilit.

Neni 87
Leje qëndrimi i personit me status të refugjatit, personit nën mbrojtje plotësuese dhe personit nën mbrojtjen e përkohshme

1. Personit me status të refugjatit, personit nën mbrojtje plotësuese dhe personit nën mbrojtje të përkohshme do t'i lëshohet leje qëndrimi.
2. Sipas paragrafit 1. të këtij neni, leje qëndrimi do t'iu lëshohet edhe përfituesve të ribashkimit familjar.

Neni 88
Dokumentet e udhëtimit për personat me status refugjati

1. Dokumentet e udhëtimit do t'i lëshohen personit me status refugjati në pajtim me skemën e Konventës së Gjenevës dhe standardeve Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.

2. Kërkesa për dokumentet e udhëtimit duhet të parashtrohet personalisht nga personi me status refugjati nëse ai ose ajo është në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare dhe ka zotësinë e veprimit, apo përmes përfaqësuesit të tij/saj.
3. Kur personi me status refugjati është më i ri se tetëmbëdhjetë (18) vjet, kërkesa duhet të dorëzohet nga përfaqësuesi ligjor i tij/saj ose kujdestari.
4. DSHAM do të konfirmojë statusin e azilit për qëllimet e përfshira në këtë nen.
5. Në rast të tërheqjes të statusit të refugjatit nga personi do të kërkohet t'i kthejë dokumentin e udhëtimit DSHAM-së.

Neni 89
Dokumentet e udhëtimit për personin nën mbrojtje plotësuese dhe mbrojtje të përkohshme

Ministria duhet të lëshoj përfituesve të statusit të mbrojtjes plotësuese të cilët nuk janë në gjendje të pajisen me pasaportë kombëtare, dokumente të cilat iu mundësojnë të udhëtojnë jashtë shtetit, përveç nëse arsyet imponuese të sigurisë shtetërore apo publike kërkojnë ndryshe.

Neni 90
Kthimi i dokumenteve

Dokumentet e përmendura në nenin 85, nën-paragrafët 1.2., 2.1., 2.2., dhe 3.1., të këtij ligji i kthehen DSHAM-së pas përfundimit të procedurës, revokimit të statusit apo në rast të zëvendësimit të tij për shkak dëmtimi.

KREU VII
TRAJTIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 91
Trajtimi i të dhënave personale

Në përputhje me përmbushjen e funksionit të tyre ligjor, DSHAM, organet që shqyrtojnë ankesat dhe organizatat e tjera të ngarkuara me detyra në mbështetje të këtij ligji, mund të trajtojnë apo të japin për trajtim të dhënat personale të një azilkërkuesi, të një personi për tu mbrojtur dhe të të afërmve të tyre, përfshirë edhe të dhëna të ndjeshme, të përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave.

Neni 92
Komunikimi i të dhënave personale të shtetit të origjinës apo të prejardhjes

1. Të dhënat personale të aplikantëve duhen të mbrohen nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave;
2. Organi kompetent me rastin e shqyrtimit të kërkesave individuale nuk duhet të:
   2.1. përhap drejtpërdrejtë informata tek akterët e pohuar të persekutimit ndaj azilkërkuesit në lidhje me kërkesën individuale për azil, ose për faktin që një kërkesë për azil është parashtruar;

2.2. siguroj kurrfarë informacioni nga akterët e pohuar të persekutimit në mënyrën që do të rezultonte se akterët e tillë do të informoheshin drejtpërdrejtë për faktin se një kërkesë është parashtruar nga azilkërkuesi në fjalë dhe të rrezikonte integritetin fizik të azilkërkuesit dhe të vartësve të tij/saj ose lirinë dhe sigurinë e anëtarëve të familjes së tij/saj të cilit ende jetojnë në shtetin e origjinës.

3. DSHAM me rastin e organizimit të kthimit të azilkërkuesit mund të marrë kontakt me vendin e origjinës apo të prejardhjes me qëllim që të gjejë dokumentet e udhëtimit të nevojshme për ekzekutimin e vendimit, me kusht që cilësia e refugjatit nuk është njohur me vendim të formës së prerë.
4. Me qëllim të ekzekutimit të vendimit të kthimit në vendin e origjinës apo të prejardhjes, DSHAM me rastin e organizimit e kthimit, mund t'iu komunikojë autoriteteve të huaja të dhënat e mëposhtme:
   4.1. të dhënat personale (emrin, mbiemrin, datën dhe vendin e lindjes, gjininë, shtetësinë, adresën e fundit të njohur në vendin e origjinës apo të prejardhjes) të personit në fjalë, dhe nëse është e nevojshme të dhënat personale të të afërmve të tij;
   4.2. të dhënat lidhur me pasaportën apo dokument tjetër identiteti;
   4.3. gjurmët e gishtërinjve, fotografitë dhe ndoshta të dhënat biometrike;
   4.4. të dhënat lidhur me dokumente të tjera që mundësojnë identifikimin e personit;
   4.5. të dhënat lidhur me gjendjen shëndetësore të personit, me kusht që kjo të jetë në përputhje me interesin e tij;
   4.6. çdo të dhënë tjetër të domosdoshme për të garantuar hyrjen e personit në shtetin e destinuar dhe për të ruajtur sigurinë e personave që e shoqërojnë;
   4.7. të dhënat lidhur me procedurat penale të hapura për aq sa kjo është e rëndësishme për procedurën e kthimit të personit në fjalë, për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike në vendin e origjinës apo të prejardhjes dhe për aq sa personi në fjalë nuk rrezikohet.

Neni 93
Bashkëpunimi me organet e ndjekjes penale

DSHAM iu transmeton autoriteteve kompetente të ndjekjes penale të gjitha të dhënat dhe mjetet e provës për një azilkërkues i cili dyshohet se ka shkelur të drejtën ndërkombëtare publike, veçanërisht nëse ka kryer krim kundër paqes, krim lufte apo krim kundër njerëzimit, duke marrë pjesë në gjenocid apo duke praktikuar torturën.

Neni 94
Të dhënat biometrike

1. Organet kompetente mund të trajtojnë të dhënat biometrike të një azilkërkuesi apo të një personi për tu mbrojtur me qëllim që të përcaktojnë identitetin e tij.
2. Llojet e të dhënave biometrike që duhen të mblidhen dhe e drejta e qasjes, rregullohet me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave.

Neni 95
Gjurmët e gishtërinjve dhe fotografitë

1. Merren gjurmët e të gjithë gishtërinjve dhe fotografia e secilit azilkërkues dhe personi për tu mbrojtur. Qeveria përcakton përjashtime për fëmijët nën dymbëdhjetë (12) vjeç.
2. Gjurmët e gishtërinjve dhe fotografia regjistrohen në një bazë të dhënash të mbajtur nga DSHAM.
3. Gjurmët e gishtërinjve të marra nga DSHAM, krahasohen me gjurmët e gishtërinjve të regjistruara nga policia.
4. Nëse policia konstaton se gjurmët e reja të gishtërinjve janë të njëjta me ato të regjistruara paraprakisht, ajo informon DSHAM-në, duke shënuar të dhënat personale të personit (emri, mbiemri, datëlindja, gjinia, numri i referencës, numri personal, shtetësia, dhe vendi në të cilin ndodhet). Nëse bëhet fjalë për të dhënat e mbledhura nga policia, duhet të tregojë (me numër kodi) datën, vendin dhe arsyen e marrjes së gjurmëve të gishtërinjve.

Neni 96
Përdorimi i këtyre të dhënave

1. DSHAM i përdor këto të dhëna me qëllim që:
   1.1. të verifikojë identitetin e personit në fjalë;
   1.2. të verifikojë nëse personi ka paraqitur një kërkesë azili;
   1.3. të verifikojë nëse ka të dhëna që konfirmojnë apo kundërshtojnë deklaratat e personit;
   1.4. të verifikojë nëse ekzistojnë të dhëna që vënë në dyshim mundësinë e personit për të fituar statusin e azilit;
   1.5. të lehtësojë bashkëpunimin ndërmjet DSHAM-së dhe policisë.
2. Komunikimi jashtë vendit i të dhënave personale të mbledhura në përputhje me paragrafin 4. të nenit 96 të këtij ligji, pa pëlqimin e DSHAM-së është i ndaluar. Neni 6 i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave zbatohet në mënyrë analoge.

Neni 97
Shkatërrimi i të dhënave

1. Të dhënat shkatërrohen:
   1.1. nëse statusi i azili i jepet personit;
   1.2. dhjetë (10) vjet pas marrjes formë të prerë të vendimit për refuzimin e kërkesës për azil, pas heqjes dorë vullnetare nga kërkesa për azil, apo pas ndërprerjes së procedurës së azilit;
   1.3. dhjetë (10) vjet pas heqjes së mbrojtjes plotësuese për personat për tu mbrojtur.

Neni 98
Mbajtja e statistikave

1. DSHAM administron bazën e të dhënave që lejon regjistrimin e kërkesave për azil dhe të ankesave, dhe kontrollin e dosjeve.
2. Kjo bazë të dhënash mund të përmbajë të dhëna personale të ndjeshme, për aq sa kjo nevojitet për kryerjen e detyrave të përcaktuara në ligj.
3. Të dhënat e gabuara duhet të korrigjohen.

KREU VIII
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 99
Afatet për nxjerrjen e akteve nënligjore

1. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, në afat prej gjashtë (6) muajve, ministria do të nxjerrë aktet nënligjore të përcaktuara në këtë ligj.
2. Ministria në bashkëpunim me organet tjera mund të nxjerrë edhe akte tjera nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 100
Shfuqizimi

Shfuqizohet Ligji për Azil Nr. 04/L-073 dhe të gjitha aktet e tjera që bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 101
Dispozitat kalimtare

Kërkesat e filluara para se ky ligj të hyjë në fuqi, do të trajtohen sipas këtij ligji.

Neni 102
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-217
31 korrik 2013

Shpallur me dekretin Nr. DL-039-2013, datë 19.08.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 32 / 30 GUSHT 2013, PRISHTINË

LIGJI Nr. 04/L-219
PËR TË HUAJT

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 516
Kreu II: Vizat 523
Kreu III: Hyrja dhe dalja e të huajve 530
Kreu IV: Qëndrimi i të huajve 532
Kreu V: Qëndrimi i paligjshëm, kthimi dhe dëbimi i të huajve 556
Kreu VI: Mbikëqyrja dhe kontrolli 566
Kreu VII: Përpunimi i të dhënave personale 568
Kreu VIII: Adresa e qëndrimit të të huajit 570
Kreu IX: Integrimi i të huajve në jetën ekonomike, kulturore dhe shoqërore 571
Kreu X: Dispozitat ndëshkimore 572
Kreu XI: Dispozita kalimtare dhe përfundimtare 575

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR TË HUAJT

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj rregullon kushtet e hyrjes, lëvizjes, qëndrimit dhe punësimit të të huajve në territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 2
Fushëveprimi

1. Dispozitat e këtij ligji janë të zbatueshme për të huajt, për aq sa statusi i tyre nuk është i rregulluar me dispozita të tjera ligjore apo me marrëveshje ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Kosovës.
2. Dispozitat e këtij ligji nuk janë të zbatueshme për të huajt, aq kohë sa statusi i tyre rregullohet me Ligjin për statusin, imunitetin dhe privilegjet e misioneve diplomatike dhe konsullore, personelit të tyre, pranisë ndërkombëtare ushtarake dhe personelit të tyre në Republikën e Kosovës.

3. Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk do të jetë në kundërshtim me të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e autoriteteve dhe të individëve sipas të drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe të drejtat ndërkombëtare të njeriut, në veçanti, Konventën e vitit 1951 dhe Protokollit të vitit 1967 lidhur me Statusin e Refugjatëve, parimin e mos dëbimit (non-refoulement) dhe të drejtën për të kërkuar azil të përfshira në to.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **I huaji** - çdo person fizik i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës;
   1.2. **Personi pa-shtetësi -** personi i cili nuk konsiderohet shtetas i asnjë shteti në kuadër të fushëveprimit të ligjit të shtetit përkatës;
   1.3. **Dokument udhëtimi** –pasaporta ose ndonjë dokument i ngjashëm i cili i mundëson bartësit të tij të kaloj kufirin dhe në të cilin mund të vendoset viza;
   1.4. **Dokumenti i udhëtimit për të huaj** - dokument udhëtimi për të huaj, dokument udhëtimi për personat pa shtetësi, dokument udhëtimi për refugjatë, persona nën mbrojtje plotësuese dhe fletë udhëtimi për të huaj i lëshuar nga Republika e Kosovës;
   1.5. **Transportuesi** - personi fizik ose juridik profesioni i të cilit është të ofroj transportimin e personave;
   1.6. **Migrant ditor** – shtetasi i një shteti fqinj, ku ai banon dhe vjen çdo ditë në punë në Republikën e Kosovës dhe kthehet në vendin e tij të qëndrimit;
   1.7. **Person juridik** – entiteti i cili e ka atë status sipas ligjit të aplikueshëm, përveç për organet shtetërore ose publike që ushtrojnë autoritet shtetëror dhe për organizatat ndërkombëtare publike;
   1.8. **Viza** – autorizimi i dhënë nga Republika e Kosovës me qëllim të transitit përmes territorit të Republikës së Kosovës ose Aeroportit Ndërkombëtar, ose qëndrimit për një kohë të caktuar por jo më gjatë se tre muaj brenda një periudhe gjashtë mujore prej datës së hyrjes së parë në territorin e Republikës së Kosovës;
   1.9. **Leje qëndrimi** – çdo autorizim i lëshuar nga autoritetet e Republikës së Kosovës që lejojnë qëndrimin e ligjshëm të të huajit në territor, me përjashtim të:
      1.9.1. vizave;
      1.9.2. lejeve të lëshuara në pritje të shqyrtimit të kërkesave për leje qëndrim apo azil.
   1.10. **Qëndrimi i paligjshëm** –prezenca e të huajit në territorin e Republikës së Kosovës i cili nuk i plotëson, apo nuk i plotëson më kushtet për hyrje apo qëndrim në Republikën e Kosovës;
   1.11. **Refugjat** - personi i cili për shkak të frikës mirë të bazuar për të qenë i persekutuar për arsye të racës, religjionit, kombësisë, mendimit politik apo përkatësisë së grupit të caktuar shoqëror, është jashtë vendit të shtetësisë dhe nuk ka mundësi apo për shkak të frikës së tillë nuk ka dëshirë të përfitoj

mbrojtjen e atij vendi, apo personin pa shtetësi i cili duke qenë jashtë vendit të banimit të mëparshëm të rregullt për arsye të njëjta siç përmendën më lartë, nuk ka mundësi, apo për shkak të frikës së tillë nuk ka dëshirë të kthehet në atë vend.

1.11.1. Koncepti i racës në veçanti do të përfshijë konsideratën ndaj ngjyrës, prejardhjes, apo përkatësisë së ndonjë grupi të veçantë etnik;

1.11.2. Koncepti i religjionit në veçanti do të përfshijë mbajtjen e besimeve teiste, jo-teiste dhe ateiste, pjesëmarrjen në apo abstenimin nga ritualet religjioze në hapësira private apo publike, qoftë i vetëm apo në bashkësi me të tjerët, aktet e tjera religjioze apo shprehjen e pikëpamjeve, ose format personale apo kolektive të sjelljes të bazuara në besimin religjioz apo të urdhëruara nga çfarëdo besimi religjioz;

1.11.3. Koncepti i kombësisë nuk do të kufizohet në shtetësi apo në mungesën e saj, po në veçanti do të përfshijë përkatësinë në një grup të përcaktuar nga identiteti kulturor, etnik apo linguistik, nga origjina gjeografike apo politike apo nga marrëdhënia e grupit të tillë me popullatën e shtetit tjetër;

1.11.4. Grupi do të konsiderohet të krijojë grupin e veçantë shoqëror kur në veçanti:

1.11.4.1. pjesëtarët e atij grupi ndajnë një karakteristikë të lindur apo një prapavijë të përbashkët që nuk mund të ndërrohet, ose ndajnë ndonjë karakteristikë apo besim që është aq esencial për identitetin apo vetëdijen sa që personi nuk duhet të detyrohet të heq dorë nga e njëjta, dhe

1.11.4.2. ai grup ka identitet të dalluar në vendin relevant, për shkak se i njëjti është i perceptuar si i ndryshëm nga shoqëria që e rrethon. Varësisht nga rrethanat ne vendin e origjinës, një grup i veçante social mund të përfshij një grup bazuar ne karakteristikat e përbashkëta te orientimit seksual. Orientimi seksual nuk mund te kuptohet qe duhet të përfshij akte qe konsiderohen te jenë kriminale në pajtim me ligjin kombëtar të Republikës së Kosovës. Aspektet e lidhura me moshën, përfshirë identitetin gjinor, duhet t'i jepet konsideratë e theksuar me qëllim të përcaktimit të anëtarësisë se grupit të veçantë social ose identifikimit të karakteristikave të një grupi të tillë.

1.11.5. Koncepti i pikëpamjes politike në veçanti do të përfshijë mbajtjen e opinionit, mendimit apo besimit në çështjen që ka të bëjë me akterët potencial të persekutimit të përmendur në nen nën-paragrafin 1.11. të këtij neni dhe me politikat apo metodat e tyre, pavarësisht nëse opinioni, mendimi apo besimi i tillë është shprehur nga azilkërkuesi.

1.12. **Marrëdhënia e punës**– ushtrimi i aktiviteteve që mbulojnë çfarëdo forme të punës të rregulluar me ligjet e aplikueshme ose në përputhje me praktikën e përcaktuar, për/ose nën drejtimin dhe/ose mbikëqyrjen e një punëdhënësi;

1.13. **Punëdhënësi** – personi fizik ose juridik, duke përfshirë Agjencinë e Përkohshme të Punësimit, për/apo nën drejtimin dhe /ose mbikëqyrjen e të cilit puna është ndërmarrë;
1.14. **Punëmarrësi** – personi fizik i cili është punësuar për kryerjen e punës apo shërbimeve për punëdhënësin kundrejt një pagese;
1.15. **Leje pune** – autorizimi i bartësit të saj për të qëndruar dhe punuar në territorin e Republikës së Kosovës sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj;
1.16. **Punësimi ilegal** –punësimi i një të huaji i cili qëndron ilegalisht në Republikën e Kosovës;
1.17. **Nënkontraktor** – personi fizik ose juridik, të cilit i është caktuar kryerja e të gjitha ose një pjese të obligimeve të kontratës paraprake;
1.18. **Agjencia për Punësimin e Përkohshëm** - personi fizik ose juridik, i cili në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm lidh kontrata të punësimit me punëmarrësit e agjencisë së përkohshme, me qëllim të caktimit të tyre për të punuar përkohësisht për ndërmarrjet nën mbikëqyrjen dhe drejtimin e tyre;
1.19. **Punëtor sezonal** - i huaji që banon në shtetin e të cilit ai është shtetas ose në të cilin ai ka një leje qëndrimi të përhershme, është me një punëdhënës të bazuar në Republikën e Kosovës dhe ka nënshkruar një kontratë për një punë të caktuar në një periudhë të caktuar jo më të gjatë se gjashtë (6) muaj;
1.20. **Punëdhënësi i huaji** – personi fizik ose juridik që kryen punë në Republikën e Kosovës në bazë të një marrëveshjeje apo kontrate paraprake, dhe i cili ka një përfaqësi të regjistruar në Republikën e Kosovës;
1.21. **Punëtori i sistemuar** - punëtori, punëdhënësi i tij/saj i huaj në kuadër të ofrimit të shërbimeve ndërkufitare i cili e ka dërguar atë për një periudhë të kufizuar kohore për të punuar në Republikën e Kosovës, i cili nuk është shteti në të cilin ai/ajo normalisht punon;
1.22. **Punësimi i punëtorëve me kualifikim të lartë** –puna e një personi i cili:
    1.22.1. është i mbrojtur si një punëmarrës sipas Ligjit mbi Punën apo në pajtim me praktikën e brendshme, pa marrë parasysh marrëdhënien juridike, me qëllim të ushtrimit të punës efektive, apo nën drejtimin e dikujt tjetër;
    1.22.2. është paguar dhe
    1.22.3. e ka kompetencën adekuate dhe specifike, që dëshmohet me kualifikimet e larta profesionale.
1.23. **Kualifikime të larta profesionale** – kualifikimet që dëshmohen në bazë të kualifikimeve të larta profesionale;
1.24. **Kualifikime të arsimit të lartë** -- çdo diplomë, certifikatë apo dëshmi tjetër të kualifikimeve formale të lëshuara nga autoriteti kompetent për aftësimin e përfundimit të suksesshëm të një programi arsimimi pas shkollës së mesme, konkretisht një sërë kursesh të ofruara nga një institucion i arsimit të lartë i pranuar si institucion i arsimit të lartë nga Republika e Kosovës. Kualifikimet e arsimit të lartë duhet të merren parasysh, me kusht që studimet e nevojshme për arritjen e këtij kualifikimi zgjasin së paku tre (3) vjet;
1.25. **Kthimi** – procesi i kthimit prapa të një të huaji, qoftë në pajtim me një

obligim vullnetar apo të detyrueshëm për t'u kthyer, në vendin e tij të origjinës apo në vend tjetër;

1.26. **Largimi** – ekzekutimi i obligimit për t'u kthyer, përkatësisht transportimi fizik jashtë Republikës së Kosovës;

1.27. **Ribashkimi familjar** – hyrja dhe qëndrimi në territorin e Republikës së Kosovës të anëtarëve të familjes të të huajit që qëndron ligjshëm në Republikën e Kosovës në mënyrë që të ruhet njësia familjare, nëse marrëdhënia familjare ka lindur para ose pas hyrjes së të huajit;

1.28. **Fëmijë i pashoqëruar -** shtetasi i huaj apo personi pa shtetësi, nën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, që hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës pa qenë të shoqëruar nga një person madhor, përgjegjës për ta, sipas ligjit apo traditës zakonore, dhe përderisa ata nuk janë nën kujdesin efektiv të personit të tillë, fëmijë i pashoqëruar përfshinë dhe të miturit e lënë vetëm pas hyrjes në territorin e Kosovës;

1.29. **Sponsor** – i huaji i cili qëndron ligjërisht në Republikën e Kosovës dhe që parashtron kërkesë apo anëtarët e familjes të të cilit parashtrojnë kërkesë për ribashkimin familjar që të bashkohen me të.

Neni 4
I huaji me më shumë se një shtetësi

I huaji i cili ka më shumë se një shtetësi, obligohet që gjatë qëndrimit të tij në Republikën e Kosovës të shërbehet dhe të largohet nga Republika e Kosovës me dokumentin e rregullt të udhëtimit me të cilin ka hyrë në Republikën e Kosovës.

Neni 5
Legjislacioni i zbatueshëm

1. I huaji obligohet që gjatë lëvizjes dhe qëndrimit të tij në Republikën e Kosovës, t'i përmbahet legjislacionit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës.
2. Të huajit të cilit i është kufizuar lëvizja në një zonë të caktuar, ai mund të lëvizë vetëm brenda asaj zone.
3. I huaji, i cili shkel dispozitën e paragrafit 2. të këtij neni, mund t'i konfiskohet dokumenti që i mundëson lëvizjen në atë zonë të caktuar dhe për këtë i lëshohet një vërtetim.
4. Të drejtat e të huajve që kërkojnë ose është e arsyeshme të besohet se mund të kërkojnë çfarëdo formë të mbrojtjes në Kosovë, duhet të përcaktohen në përputhje me dispozitat e Ligjit për Azil.
5. Të huajit nuk i lejohet themelimi i partive politike, por mund të formoj asociacione në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
6. Nëse nuk është rregulluar ndryshe me këtë ligj, procedura për të huaj do të jetë në përputhje me Ligjin për Procedurën Administrative dhe ligjet tjera përkatëse.

Neni 6
Refuzimi apo revokimi i leje qëndrimit për rrethanat të sigurisë shtetërore

1. Kontrollet e sigurisë për të huajt për qëllime të përcaktimit të arsyeve që lidhen me sigurinë shtetërore kryhen nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (në tekstin e mëtejmë AKI), siç është përcaktuar në nenin 2 të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Inteligjencës.
2. Në raste të refuzimit apo revokimit të leje qëndrimit të të huajit për arsye që ndërlidhen me sigurinë shtetërore, lëshohet vendim pa arsyetim lidhur me rrethanat për të cilat është nxjerrë ky vendim.
3. I huaji subjekt i paragrafit 1. të këtij neni ka të drejtë ankese në gjykatën kompetente.
4. I huaji subjekt i paragrafit 1. të këtij neni që kanë status të refugjatit apo mbrojtje plotësuese do të procedohen bazuar në procedurat të përcaktuara në Ligjin për Azil.

Neni 7
Dokumentet e udhëtimit për të huajt

1. Republika e Kosovës lëshon dokumentet e udhëtimit për të huajt si në vijim, të cilët nuk posedojnë ndonjë dokument udhëtimi:
   1.1. dokument udhëtimi për të huaj, të vlefshëm për një të huaj i cili qëndron ligjërisht në Republikën e Kosovës por që nuk posedon dhe nuk është në gjendje të marrë një dokument udhëtimi nga shteti shtetas i të cilit ai/ajo është;
   1.2. dokument udhëtimi për refugjatë, i vlefshëm për një të huaj të cilit i është dhënë azili apo mbrojtje plotësuese në pajtim me Ligjin mbi Azilin;
   1.3. dokument udhëtimi për personat pa shtetësi, siç definohen në Konventën e vitit 1954 për Statusin e Personave Pa Shtetësi;
   1.4. fletudhëtimi për të huajin, i vlefshëm për një dalje apo hyrje te vetme për të huajin i cili nuk posedon një dokument te vlefshëm të udhëtimit, siç specifikohet në këtë ligj.
2. Dokumenti i udhëtimit për personat pa shtetësi lëshohet sipas kushteve të përcaktuara nga konventat ndërkombëtare.
3. Fletudhëtimi për të huajt lëshohet me afat vlefshmërie prej tridhjetë (30) ditësh.
4. Forma, përmbajtja dhe procedura për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit të parapara në këtë nen, caktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga MPB-ja.

Neni 8
Lëshimi i fletudhëtimi për të huajt

1. Fletudhëtimi për të huaj i lëshohet personit i cili nuk ka asnjë dokument të huaj udhëtimi nëse:
   1.1. lirohet nga shtetësia e Republikës së Kosovës për të shkuar jashtë vendit;
   1.2. ka humbur dokumentin e udhëtimit apo në ndonjë mënyrë tjetër ka mbetur pa të, ndërsa shteti, shtetasi i të cilit është, nuk ka mision diplomatik

gjegjësisht zyra konsullore në Republikën e Kosovës e as interesat e tij nuk ka kush t'i përfaqësoj nga një shtet tjetër për të dalë jashtë vendit;

1.3. i huaji ka humbur dokumentin e udhëtimit për refugjat jashtë vendit, dokumentin e udhëtimit për personat pa shtetësi apo personat nën mbrojtje plotësuese të lëshuara nga Republika e Kosovës;

1.4. është në procedurë të dëbimit të detyruar me qëllim të largimit nga Republika e Kosovës.

2. Me përjashtim të paragrafit 1. të këtij neni, fletudhëtimi për të huaj mund të lëshohet edhe në rastet kur ekzistojnë arsye tjera të ligjshme.
3. Fletudhëtimi për të huaj sipas arsyeve të nën-paragrafit 1.1. 1.2. dhe 1.4. të këtij neni lëshohet nga Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim (në tekstin e mëtejmë DSHAM) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
4. Fletudhëtimi për të huaj sipas arsyeve të nën-paragrafit 1.3. të këtij neni, lëshohet nga misionet diplomatike apo konsullore të Republikës së Kosovës, në bazë të pëlqimit paraprak nga DSHAM.

Neni 9
Refuzimi për lëshimin e dokumentit të udhëtimit për të huajt

1. Dokument udhëtimi për të huajt nuk do t'i lëshohet të huajit:
   1.1. kundër të cilit është duke u zhvilluar një procedurë për vepër penale apo kundërvajtëse, përveç nëse ekziston pëlqimi i organit shtetëror i cili zhvillon procedurën;
   1.2. i cili ishte dënuar me burgim ose me gjobë, përderisa nuk e vuan dënimin apo derisa ai nuk e paguan dënimin me gjobë;
   1.3. i cili nuk i ka kryer detyrimet pronësore–juridike të akumuluara për të cilat ekziston urdhri ekzekutiv;
   1.4. nëse kërkohet për shkaqe të sigurisë shtetërore, rendit publik apo shëndetit publik.
2. Një i huaj i cili është në proces të dëbimit mund t'i lëshohet një dokument udhëtimi për të huaj, pavarësisht ekzistencës së rrethanave sipas paragrafit 1. nën-paragrafi 1.1. 1.2. dhe 1.3. të këtij neni.
3. Në rastin e paragrafit 1. të këtij neni, i huaji ka të drejtë të ankohet për refuzimin e lëshimit të dokumentit të udhëtimit, për të cilën vendoset nga komisioni i ankesave i cili do të emërohet nga Qeveria (në tekstin e mëtejmë Komisioni i Ankesave).
4. Përbërja, detyrat, përgjegjësitë dhe procedura e vendimmarrjes së Komisionit të Ankesave rregullohet me akte nënligjore të nxjerra nga Qeveria.

Neni 10
Marrja e dokumenteve të udhëtimit për të huajt

1. Në rastet kur vërtetohet se ekziston njëra prej arsyeve të parapara në paragrafin 1. të nenit 9 të këtij ligji, DSHAM do të marrë dokumentin e udhëtimit për të huajt.
2. Në rastet kur merret dokumenti i udhëtimit për të huajin, DSHAM duhet të nxjerrë një vendim. Kundër këtij vendimi i huaji ka të drejtë ankese për të cilën vendos Komisioni i Ankesave.

KREU II
VIZAT

Neni 11
Regjimi i Vizave

1. I huaji i cili është shtetas i shtetit për të cilin kërkohet vizë për hyrje në Republikën e Kosovës, është i obliguar të siguroj vizën para hyrjes në Republikën e Kosovës.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës përcakton regjimin e vizave me vendim në bazë të propozimit të Ministrisë për Punë të Jashtme (në tekstin e mëtejmë MPJ).
3. Në bazë të vizës, një i huaj nuk mund të punojë në territorin e Republikës së Kosovës.
4. Vizat lëshohen nga misionet diplomatike apo konsullore të Republikës së Kosovës, ose organet e autorizuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
5. Viza e lëshuar nuk garanton hyrjen e të huajit në Republikën e Kosovës.

Neni 12
Llojet e vizave

1. Republika e Kosovës lëshon këto viza:
   1.1. viza transite-ajrore;
   1.2. viza hyrëse.

Neni 13
Viza transite-ajrore

1. I huaji i cili gjatë kohës së qëndrimit në Aeroportin e Republikës së Kosovës apo gjatë fluturimeve ndërkombëtare, nuk e lëshon zonën ndërkombëtare transitore, nuk ka nevojë për vizë.
2. Me përjashtim të paragrafit 1. të këtij neni, Qeveria e Republikës së Kosovës mund të përcaktojë që shtetasit e huaj të shteteve të caktuara si dhe mbajtësit e pasaportave të lëshuara nga organet kompetente të shtetit, duhet të kenë viza transite-ajrore.
3. Viza transite-ajrore lëshohet për një (1), dy (2) ose më shumë kalime transiti nëpër zonën ndërkombëtare të transitit ajror.
4. Vlefshmëria e vizës transite-ajrore përfshinë edhe një periudhë toleruese shtesë prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh.
5. Me përjashtim të paragrafit 4. të këtij neni, koha shtesë nuk zbatohet nëse për këtë ekzistojnë arsye që ndërlidhen me sigurinë shtetërore, rendin publik apo marrëdhëniet ndërkombëtare.
6. Viza transite-ajrore shumë hyrëse jepet për një periudhë kohore deri në gjashtë (6) muaj.

Neni 14
Viza hyrëse

1. Viza hyrëse lëshohet për qëllim të transitit nëpër Republikën e Kosovës ose të qëndrimit në territorin e Republikës së Kosovës.
2. Viza hyrëse lëshohet për një (1), dy (2) apo më shumë hyrje në Republikën e Kosovës.
3. Periudha e vlefshmërisë së vizave hyrëse nuk mund të jetë më e gjatë së pesë (5) vjet.
4. Vizat hyrëse për më shumë hyrje lëshohen për një periudhë të vlefshmërisë prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet, nëse i huaji ka dëshmuar:
   4.1. nevojën ose qëllimin për të udhëtuar shpesh dhe/ose rregullisht, sidomos për arsye të profesionit apo statusit familjar siç janë: qëllime biznesi, shërbyes civil të përfshirë në kontakte të rregullta zyrtare me institucione të Republikës së Kosovës, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që udhëtojnë për qëllime të edukimit, trajnimit, seminareve dhe konferencave, anëtarë të familjes të një shtetasi të Republikës së Kosovës, anëtar të familjes të shtetasit të huaj i cili qëndron në mënyrë të ligjshme në Republikën e Kosovës;
   4.2. integritetin dhe besueshmërinë, veçanërisht përmes përdorimit ligjor të vizave të lëshuara më parë, gjendjes së tij financiare në vendin e origjinës dhe qëllimit të vërtetë për tu larguar nga territori i Republikës së Kosovës para skadimit të afatit të vizës së kërkuar.
5. Në rast transiti kohëzgjatja e vizës duhet të jetë në përputhje me kohën e nevojshme për transit.
6. Periudha e vlefshmërisë përfshinë edhe një periudhë toleruese shtesë prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh.
7. Me përjashtim të paragrafit 6. të këtij neni, koha shtesë toleruese nuk zbatohet nëse për këtë ekzistojnë arsye që ndërlidhen me sigurinë shtetërore, rendin publik apo marrëdhëniet ndërkombëtare.

Neni 15
Bashkëpunimi me ndërmjetësuesin komercial si dhe ofruesit e jashtëm të shërbimeve

1. Gjatë mbledhjes së kërkesave për vizë mund të marrin pjesë edhe ndërmjetësuesit komercial dhe/ose ofruesit e jashtëm të shërbimeve.
2. Bazuar në paragrafin 1. të këtij neni, shqyrtimi i kërkesave, intervistimi, marrja e vendimit, shtypja dhe afishimi i vizës është përgjegjësi ekskluzive e misioneve diplomatike apo konsullore. Ndërmjetësuesit komercial dhe/ose ofruesit e jashtëm të shërbimeve nuk mund të kenë qasje në sistemin informativ të vizave të Kosovës.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e ndërmjetësuesit komercial dhe/ose ofruesit e jashtëm të shërbimeve rregullohen me akt nënligjor të nxjerra nga MPJ.

Neni 16
Obligimi për pajisje me vizë

1. Para lëshimit të vizës MPJ në raste të parapara me akt nënligjor duhet të marrë pëlqimin paraprak nga MPB dhe AKI.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1. i këtij neni, kërkesat për viza mund të shqyrtohen dhe të vendoset në kufi, në pajtim me nenin 25 dhe 26 të këtij ligji.

Neni 17
Parashtrimi i kërkesës për vizë

1. Kërkesa për vizë duhet të dorëzohet përmes formularit jo më vonë se tre (3) muaj para udhëtimit të planifikuar.
2. Në rastet kur në një dokument udhëtimi janë më shumë se një person kërkesa për vizë duhet të bëhet për secilin person që ka për qëllim të pajiset me vizë, sipas formularit të paraparë në paragrafin 1. të këtij neni.
3. Kërkesës për vizë duhet t'i bashkëngjitet edhe dokumentacioni që vërteton qëllimin e hyrjes ose të qëndrimit në Republikën e Kosovës si dhe kushtet e transitit. Taksat dhe dokumentet tjera të nevojshme për tu pajisur me vizë, formulari, mënyra dhe procedura e lëshimit përcaktohet me akte nënligjore të nxjerra nga MPJ.

Neni 18
Vendosja e afishes

1. Viza do të vendoset në dokument të vlefshëm të udhëtimit në formën e një afisheje.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, nëse dokumenti i udhëtimit i parashtruesit të kërkesës nuk njihet zyrtarisht nga Republika e Kosovës, afisha e vizës vendoset në një fletë të veçantë dhe kjo rrethanë duhet të regjistrohet në sistemin informativ të vizave të Republikës së Kosovës.

Neni 19
Sigurimi shëndetësor i udhëtimit

1. I huaji i cili aplikon për lëshimin e vizës hyrëse për një ose me shumë hyrje obligohet që të dëshmoj se ai ka sigurim adekuat dhe të vlefshëm mjekësor të udhëtimit, për të mbuluar shpenzimet që mund të shkaktohen në lidhje me kthimin në vendin e origjinës nga ka ardhur për arsye mjekësore, ndihmë urgjente mjekësore ose trajtimi spitalor urgjent ose vdekje gjatë qëndrimit të tij në Republikën e Kosovës.
2. I huaji i cili aplikon për lëshimin e vizës hyrëse për një ose me shumë hyrje, duhet të tregoj se ka sigurim adekuat dhe të vlefshëm mjekësor të udhëtimit për herë të parë të vizitës së tij të planifikuar. Përveç kësaj i huaji duhet të nënshkruaj një deklaratë, siç është paraparë në formularin e aplikimit, me të cilën deklaron se ai është i vetëdijshëm që duhet të jetë në posedim të një sigurimi shëndetësor të udhëtimit për hyrje të mëvonshme.

3. Pavarësisht nga paragrafi 1. dhe 2. të këtij neni, dëshminë e sigurimit shëndetësor të udhëtimit nuk janë të detyruar ta dorëzojnë:
   3.1. poseduesit e pasaportave diplomatike;
   3.2. grupet e tjera profesionale, të cilët tashmë kanë sigurim shëndetësor të udhëtimit për shkak të aktiviteteve të tyre profesionale.

Neni 20
Sistemi Informativ për Viza i Kosovës

1. Formulari për viza dhe të dhënat e mbledhura nga një i huaj, si dhe personat fizik ose juridik të përmendur në nenin 17 paragrafi 3. të këtij ligji, do të ruhen dhe përpunohen në Sistemin Informativ të Vizave të Kosovës (në tekstin e mëtejmë SIVK) në përputhje me aktet nënligjore të nxjerra nga MPJ-ja.
2. Të dhënat mbi lëshimin, vazhdimin, refuzimin dhe anulimin e vizës do të futen në SIVK në përputhje me aktet nënligjore të nxjerra nga MPJ.

Neni 21
Mbledhja e të dhënave biometrike

1. I huaji i cili së pari parashtron kërkesën për lëshimin e vizës hyrëse, duhet që personalisht të parashtroj kërkesë tek misioni diplomatik apo konsullor i Republikës së Kosovës për mbledhjen e të dhënave biometrike siç janë:
   1.1. fotografi të skanuar ose e marrë në kohën e paraqitjes së kërkesës në përputhje me aktet nënligjore me të cilat rregullohet lëshimi i vizave;
   1.2. shenjat e dhjetë (10) gishtërinjve të dorës, të merren në mënyrë digjitale në përputhje me aktin nënligjor me të cilin rregullohet në SIVK.
2. Të dhënat biometrike nga paragrafi 1. i këtij neni duhet të futen në SIVK.
3. Pavarësisht nga paragrafi 1. i këtij neni, shenjat e gishtërinjve nuk merren nga:
   3.1. fëmijët nën moshën dymbëdhjetë (12) vjeçare;
   3.2. personat tek të cilët marrja e shenjave të gishtërinjve fizikisht është e pamundur. Nëse ka mundësi të merren shenjat e më pak se dhjetë (10) gishtërinjve, atëherë duhet të merret numri maksimal i mundshëm i shenjave të gishtërinjve. Në rast të pamundësisë së përkohshme të marrjes së shenjave të gishtërinjve, paraqitësi i kërkesës obligohet të jap shenjat e gishtërinjve me rastin e paraqitjes së kërkesës tjetër;
   3.3. krerët e shtetit ose qeverisë, anëtarët e qeverisë së bashku me bashkëshortët dhe anëtarët e delegacionit të tyre zyrtar kur ata ftohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës ose ndonjë organizatë ndërkombëtare për qëllime zyrtare;
   3.4. sovranët dhe anëtarët tjerë të lartë të familjes mbretërore kur ata ftohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës ose ndonjë organizatë ndërkombëtare për qëllime zyrtare.

Neni 22
Pranimi i kërkesës për viza

1. Kërkesa për vizë është e pranueshme nëse:
   1.1. është paraqitur jo më herët se tre (3) muaj para datës së planifikuar të udhëtimit;
   1.2. është dërguar në formën e përcaktuar me nenin 17 të këtij ligji;
   1.3. kërkesës i është bashkëngjitur dokumenti i udhëtimit në përputhje me nenin 24 paragrafi 1. i këtij ligji;
   1.4. kërkesës i është bashkëngjitur fotografia;
   1.5. janë marrë të dhënat biometrike;
   1.6. është bërë pagesa administrative e paraparë me akt nënligjor për lëshimin e vizave.
2. Në rastet kur janë plotësuar kushtet e përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, konsullata kompetente e pranon kërkesën, bën shqyrtimin e kërkesës dhe ndjek procedurat e parapara me aktin nënligjor për lëshimin e vizave.
3. Në rastet kur nuk janë plotësuar kushtet e parapara nga paragrafi 1. i këtij neni, konsullata kompetente e shpall kërkesën të pavlefshme dhe vepron në përputhje me aktin nënligjor për lëshimin e vizave. Përjashtimisht nëse kushtet e parapara nga paragrafi 1. i këtij neni nuk janë plotësuar, kërkesa mund të konsiderohet e pranueshme për shkaqe humanitare ose për arsye të interesit shtetëror.

Neni 23
Afati i vendosjes për kërkesën për vizë

1. Në rastet kur kërkesa për vizë është e pranueshme në përputhje me nenin 22 të këtij ligji, konsullata kompetente vendos për kërkesën për vizë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike nga dita e parashtrimit të kërkesës.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, afati i vendosjes lidhur me kërkesën për vizë mund të zgjatet deri në tridhjetë (30) ditë kalendarike kur nevojitet shqyrtim shtesë i kërkesës, në rastet e përfaqësimit kur kërkohet konsultim shtesë nga autoritetet e Republikës së Kosovës ose deri në gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike në raste të veçanta kur kërkohet dokumentacion shtesë.

Neni 24
Lëshimi i vizës në dokument të udhëtimit

1. Viza lëshohet në dokument udhëtimi nëse:
   1.1. është i vlefshëm së paku tre (3) muaj nga data e synuar e largimit nga territori i Republikës së Kosovës ose në rastet e vizitave të shumëfishta pas datës së synuar të largimit nga territori i Republikës së Kosovës;
   1.2. përmban të paktën dy (2) faqe të zbrazëta;
   1.3. është i lëshuar brenda dhjetë (10) viteve të fundit.
2. Përjashtimisht nga nën-paragrafi 1.1. i këtij neni, në raste të emergjencës viza mund të lëshohet edhe në dokument të udhëtimit, vlefshmëria e të cilit është më e shkurtër.

Neni 25
Lëshimi i vizave në pikën e kalimit kufitar

Përjashtimisht viza hyrëse mund të lëshohet në pikën e caktuar të kalimit kufitar për qëndrim jo më të gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë, varësisht nga qëllimi dhe kushtet e qëndrimit.

Neni 26
Kushtet për lëshimin e vizës në pikën e kalimit kufitar

1. Viza në pikën e kalimit kufitar në pajtim me nenin 25 të këtij ligji mund të lëshohet përjashtimisht nga Policia Kufitare nëse të huajt plotësojnë kushtet si në vijim:
   1.1. janë në posedim të një dokumenti të vlefshëm udhëtimi ose dokumenteve tjera të nevojshme për kalimin e kufirit;
   1.2. arsyetojnë qëllimin dhe kushtet e qëndrimit, kanë mjete të mjaftueshme për jetesë, duke përfshirë kohëzgjatjen e qëndrimit në Republikën e Kosovës dhe për kthimin në vendin nga kanë ardhur apo të kalojnë transit në një vend në të cilën është e sigurtë se do të pranohen, apo janë në gjendje t'i fitojnë ato mjete në mënyrë të ligjshme;
   1.3. nuk ka ndalim të hyrjes dhe qëndrimit në Republikën e Kosovës;
   1.4. nuk paraqet kërcënim për sigurinë shtetërore, rendin publik, shëndetin publik, ose marrëdhëniet e Republikës së Kosovës me shtetet tjera;
   1.5. Parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesë për vizë paraprakisht dhe të dorëzojë, nëse kërkohet, dokumente shtesë qe mbështesin arsyet e paparashikueshme dhe të domosdoshme për hyrje;
   1.6. Kthimi i parashtruesit të kërkesës në vendin e tij të origjinës apo qëndrimit apo transitit vlerësohet si i sigurt.
2. Kushtet dhe procedura e lëshimit të vizës në pikën e kalimit kufitar rregullohet me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga MPB.

Neni 27
Vazhdimi i vizës

1. Vazhdimi i vizës dhe kohëzgjatja e qëndrimit bëhet nga DSHAM, kur konsiderohet se bartësi i vizës ka ofruar dëshmi të mjaftueshme të ekzistimit të fuqisë madhore ose arsyeve humanitare, të cilat e parandalojnë atë për të lëshuar territorin e Republikës së Kosovës para skadimit të afatit të vlefshmërisë ose kohëzgjatjes së qëndrimit të autorizuar me vizë. Vazhdimi i vizës nga ky paragraf bëhet pa pagesë.
2. Afati i vlefshmërisë së vizës dhe kohëzgjatja e qëndrimit, mund të vazhdohet edhe atëherë kur bartësi i vizës ofron dëshmi të arsyeve serioze personale të cilat arsyetojnë vazhdimin e vizës dhe kohëzgjatjen e qëndrimit. Shuma e pagesës për vazhdimin e vizës sipas këtij paragrafi përcaktohet me akt nënligjor.
3. Vazhdimi i vizës bëhet përmes afishes së veçantë dhe informatat për vazhdimin e vizës regjistrohen në SIVK.
4. Kushtet dhe procedura e vazhdimit të vizës rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga MPB.

Neni 28
Refuzimi i vizave

1. Viza refuzohet nëse parashtruesi i kërkesës:
   1.1. paraqet dokument të udhëtimit të falsifikuar, ndryshuar ose të dikujt tjetër;
   1.2. nuk ofron arsyetim për qëllimin dhe kushtet e qëndrimit;
   1.3. nuk ofron dëshmi të mjaftueshme për jetesë gjatë qëndrimit në Republikën e Kosovës, duke përfshirë kohëzgjatjen e qëndrimit në Republikën e Kosovës dhe kthimin në vendin nga i cili vjen, ose për të kaluar transit në vendin për të cilin vërtetohet se do të pranohet;
   1.4. ka qëndruar tre (3) muaj gjatë periudhës kohore prej gjashtë (6) muajve në Republikën e Kosovës;
   1.5. ka ndalim të hyrjes dhe qëndrimit në Republikën e Kosovës;
   1.6. paraqet kërcënim për sigurinë shtetërore, rendin publik, shëndetin publik, ose marrëdhëniet e Republikës së Kosovës me shtetet tjera;
   1.7. nuk posedon sigurim shëndetësor adekuat të udhëtimit.
2. Viza refuzohet edhe kur ekziston dyshim i arsyeshëm lidhur me vërtetësinë e dokumenteve mbështetëse të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës ose deklaratat e bëra nga parashtruesi i kërkesës, si dhe qëllimi për ta lëshuar territorin e Republikës së Kosovës nuk është i besueshëm.
3. Në rastet të refuzimit të vizës lëshohet vendimi me shkrim duke përfshirë edhe arsyet e refuzimit të vizës bazuar në formularin e paraparë me akt nënligjor.
4. Në rastet e refuzimit të vizës, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë ankese brenda tetë (8) dite nga data e pranimit të vendimit, në komisionin e ankesave.
5. Informatat mbi refuzimin e vizës regjistrohen në SIVK.

Neni 29
Anulimi dhe revokimi i vizës

1. Viza do të anulohet në rastet kur bëhet e qartë se kushtet për lëshimin e saj nuk ishin plotësuar në kohën kur ishte lëshuar, në veçanti kur ekziston dyshimi i bazuar për të besuar se ishte marrë përmes mashtrimit. Anulimi i vizës bëhet nga organi i cili e ka lëshuar.
2. Viza do të revokohet në rastet kur bëhet e qartë se kushtet për lëshimin e saj nuk plotësohen më tej. Revokimi i vizës bëhet nga organi i cili e ka lëshuar atë. Viza revokohet edhe me kërkesë të poseduesit të vizës.
3. Në rast të anulimit ose revokimit të vizës vendoset vula "ANNULLED" ose "REVOKED" në afishe dhe duhet të zhvlerësohet përmes vijëzimit.
4. Në rast të anulimit ose revokimit të vizës lëshohet vendimi me shkrim duke përfshirë edhe arsyet e anulimit ose revokimit.
5. Në rast të anulimit ose revokimit të vizës, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë ankese brenda tetë (8) dite nga data e pranimit të vendimit, në komisionin e ankesave.
6. Informata mbi anulimin ose revokimin e vizës regjistrohen në SIVK.

KREU III
HYRJA DHE DALJA E TË HUAJVE

Neni 30
Hyrja e të huajve në territorin e Republikës së Kosovës

1. Konsiderohet se i huaji ka hyrë në territorin e Republikës së Kosovës, kur ai ka kaluar në pikën kufitare të kontrollit dhe i është nënshtruar kontrollit kufitar dhe në raste të veçanta kur ai e kalon vijën kufitare.
2. I huaj i cili është i regjistruar në dokumentin e udhëtimit të personit tjetër mund të hyjë dhe të dalë nga territori i Republikës së Kosovës vetëm me personin në dokumentin e udhëtimit në të cilin ai është i regjistruar.
3. Kontrolli kufitar sipas paragrafit 1. të këtij neni, kryhet në përputhje me Ligjin për Kontrollin e Kufirit Shtetëror dhe përfshinë vërtetimin e kushteve për hyrje të parapara me nenin 31 të këtij ligji.

Neni 31
Kushtet për hyrjen e të huajit në Republikën e Kosovës

1. I huaji mund të lejohet të hyjë në Republikën e Kosovës për qëndrimet qe nuk i kalojnë tre (3) muaj brenda periudhës gjashtë (6) mujore dhe nëse ai ose ajo plotëson kushtet në vijim:
   1.1. posedon dokument të vlefshëm të udhëtimit ose dokument tjetër për kalimin e kufirit;
   1.2. posedon vizë të vlefshme ose leje qëndrimi të vlefshme, kur kjo kërkohet;
   1.3. ai/ajo arsyeton qëllimin, kushtet e hyrjes dhe qëndrimit dhe dëshmon se ka mjete të mjaftueshme për jetesë, qoftë gjatë kohëzgjatjes së qëllimit të qëndrimit në Republikën e Kosovës dhe për kthim në vendin e origjinës apo transit në vendin e tretë në të cilin është e sigurte së do të pranohen, apo janë në gjendje qe ato mjete t'i fitojnë ligjërisht;
   1.4. nuk ka ndalim të hyrjes dhe qëndrimit në Republikën e Kosovës;
   1.5. nuk përbën kërcënim për sigurinë shtetërore, rendin publik, shëndetit publik në Republikën e Kosovës.
2. I huaji i cili nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, mund t'i lejohet hyrja në Republikën e Kosovës në një pikë të caktuar të kalimit kufitar, nëse kjo kërkohet për arsye humanitare, interesat shtetërore ose detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës.
3. Shuma e mjeteve të mjaftueshme për jetesë përcaktohet me vendim të veçantë të ministrit të MPB-së dhe lartësia e kësaj shume vlerësohet në përputhje me kohëzgjatjen dhe qëllimin e qëndrimit duke u bazuar në çmimet mesatare për jetesë.
4. Vlerësimi i mjeteve të mjaftueshme për jetesë mund të bazohet në para të gatshme, çeqe të udhëtimit dhe kartela krediti në posedim të të huajit. Deklaratat e sponsorimit dhe letrat e garancionit nga nikoqiri të cilat do të miratohen nga DSHAM-i para hyrjes së tyre në Republikën e Kosovës, mund të konsiderohen, në raste të caktuara, si dëshmi për mjete të mjaftueshme për jetesë.

5. Qeveria e Republikës së Kosovës me vendim mund të përcaktojë që qytetarët e vendeve të caktuara mund të hyjnë dhe të lëshojnë Republikën e Kosovës me një dokument identiteti të vlefshëm ose dokumente tjera që vërtetojnë identitetin dhe shtetësinë. Gjithashtu Qeveria e Kosovës me vendim mund të përcaktojë që në rastet kur për qytetarët e huaj të vendeve për të cilët kërkohet viza, të hyjnë dhe qëndrojnë për një kohë të caktuar në Republikën e Kosovës me një vizë të vlefshme Schengen apo me leje qëndrim të ndonjë shteti të zonës Schengen, nëse ata i plotësojnë kushtet e tjera të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni.
6. Një listë jo-përfundimtare e dokumenteve shtesë të cilat Policia Kufitare mund t'i kërkojë nga i huaji në mënyrë qe të verifikojë plotësimin e kushteve të përcaktuara ne nën-paragrafin 1.3. të këtij neni do të përcaktohen detajisht në një akt nënligjor qe ndërlidhet me ndalimin e hyrjes së të huajve në Republikën e Kosovës.

Neni 32
Refuzimi i hyrjes së të huajit në Republikën e Kosovës

1. Të huajt i cili nuk i plotëson kushtet për hyrje të përcaktuara me nenin 31 të këtij ligji, i refuzohet hyrja në territorin e Republikës së Kosovës dhe i lëshohet vendimi me arsyetim për refuzimin e hyrjes.
2. I huaji ka të drejtë të parashtroj ankesë kundër vendimit nga paragrafi 1. i këtij neni. Ankesa bëhet në misionin diplomatik apo konsullor që ka kompetencë territoriale ose pranë Komisionit për Ankesa. Ankesa kundër vendimit nuk pezullon ekzekutimin e tij.

Neni 33
Hyrja e paligjshme në Republikën e Kosovës

1. Hyrja e paligjshme në Republikën e Kosovës konsiderohet kur i huaji:
   1.1. kalon kufirin jashtë vendit apo kohës së caktuar për kalimin e kufirit shtetëror;
   1.2. i shmanget kontrollit kufitar të përcaktuar me Ligjin për Kontrollin e Kufirit Shtetëror;
   1.3. hyn në territorin e Republikës së Kosovës përderisa ka ndalesë për hyrje dhe qëndrim në Republikën e Kosovës;
   1.4. ka konsumuar afatin tre (3) mujor të qëndrimit brenda gjashtë (6) muajve;
   1.5. ka hyrë në bazë të një dokumenti të udhëtimit, vizë apo lejeqëndrim të falsifikuar, ndryshuar apo të dikujt tjetër.

Neni 34
Dalja e të huajit nga Republika e Kosovës

1. I huaji mund të dalë lirshëm nga Republika e Kosovës, përveç nëse:
   1.1. i huaji posedon dokument të huaj të pavlefshëm, dokument të falsifikuar si dhe dokument udhëtimi autentik të personave të tjerë të përdorur në mënyrë abuzive;
   1.2. i huaji nuk i plotëson kushtet për hyrje në shtetin tjetër;

1.3. për të huajin ekziston dyshimi i bazuar se do t'i shmangen ndjekjes për vepra penale apo për kundërvajtje, fletarrestimit, apo shlyerjes së detyrimeve të përcaktuara me ligj;
1.4. këtë e kërkojnë shkaqet e mbrojtjes së sigurisë shtetërore, rendit kushtetues ose të shkaqeve publike, në mbështetje të vendimit të organit kompetent.

2. Të huajit i lejohet dalja nga Republika e Kosovës kur pushojnë së ekzistuari shkaqet nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 35
Detyrimet e transportuesit

1. Transportuesi mund të sjellë një të huaj në pikën e kalimit kufitar të Republikës së Kosovës, në qoftë se i huaji ka një dokument udhëtimi të vlefshëm ose dokument tjetër të nevojshëm për kalimin e kufirit, ka një vizë të vlefshme nëse është e nevojshme ose lejeqëndrim.
2. Transportuesi mund ta sjell të huajin në pikën e kalimit kufitar nëse i plotëson kushtet për hyrje në Republikën e Kosovës.
3. Nëse të huajit i është refuzuar hyrja në Republikën e Kosovës, transportuesi që e ka sjellë atë në pikën e kalimit kufitar, duhet që me kërkesën e organit për kontrollin e kufirit, ta kthejë në shtetin nga i cili ka hyrë, në shtetin ku dokumenti i të huajit është lëshuar, apo në ndonjë shtet tjetër që është i sigurt që do ta pranon atë.
4. Nëse transportuesi nuk mund ta kthej të huajin nga Republika e Kosovës në pajtim me paragrafin 3. të këtij neni, duhet që menjëherë dhe me shpenzimet e tij të siguroj transportues tjetër.
5. Transportuesi i cili e ka sjellë të huajin në kufirin shtetëror apo në territorin e Republikës së Kosovës në kundërshtim me paragrafin 2. të këtij neni, duhet të paguaj shpenzimet e akomodimit dhe kthimit prapa të të huajit.
6. Detyrimet që rrjedhin nga ky nen duhet të zbatohen edhe ndaj transportuesit që bartin të huajin në kufirin shtetëror ose brenda territorit të Republikës së Kosovës, i cili është duke kaluar transit ose të cilit i është refuzuar transporti i mëtutjeshëm nga transportuesi tjetër ose të cilit i është refuzuar hyrja në shtetin e destinacionit dhe është kthyer në Republikën e Kosovës.
7. Organizatori i udhëtimeve turistike apo atyre të punës në Republikën e Kosovës, është i obliguar që për të huajt të cilëve i është ofruar shërbimi përkatës, t'i mbulojë shpenzimet e largimit nga Republika e Kosovës, nëse të huajit i është ndaluar hyrja apo largohet me forcë nga Republika e Kosovës dhe nëse këto shpenzime i huaji nuk mund t'i mbulojë vetë.

Neni 36
Ndalimi për dhënien e ndihmës së jashtëligjshme për të huaj

Asnjë i huaj nuk duhet të ndihmohet në kalimin e paligjshëm të kufirit shtetëror, për transit nëpër territorin ku i huaji ka hyrë në mënyrë të paligjshme në Republikën e Kosovës dhe të qëndroj paligjshëm.

KREU IV
QËNDRIMI I TË HUAJVE

Neni 37
Llojet e qëndrimit

1. Llojet e qëndrimit në Republikën e Kosovës janë:
   1.1. qëndrim afatshkurtër;
   1.2. qëndrimi i përkohshëm dhe
   1.3. qëndrimi i përhershëm.

Neni 38
Qëndrimi afatshkurtër

1. Qëndrimi afatshkurtër nënkupton qëndrimin e një të huaji deri në tre (3) muaj brenda periudhës kohore prej gjashtë (6) muajve pa vizë ose me vizë kur kjo kërkohet.
2. Qëndrimi afatshkurtër mund të jetë më i shkurtër se tre (3) muaj kur kjo përcaktohet me vizë. Periudha e qëndrimit llogaritet prej ditës së hyrjes së parë në Republikën e Kosovës.
3. I huaji i cili tashmë e ka shfrytëzuar afatin e qëndrimit prej tre (3) muajve brenda periudhës kohore prej gjashtë (6) muajve, mund të hyjë prapë dhe qëndrojë në Republikën e Kosovës pas kalimit të periudhës kohore prej gjashtë (6) muajsh nga data e hyrjes së parë.

Neni 39
Ndërprerja e qëndrimit afatshkurtër

1. Qëndrimi afatshkurtër i ndërpritet të huajit nëse:
   1.1. nuk i plotëson më kushtet e parapara nga neni 31 paragrafi 1. i këtij ligji;
   1.2. i ka skaduar periudha e vlefshmërisë së vizës;
   1.3. ka shfrytëzuar afatin e paraparë në nenin 38 të këtij ligji;
   1.4. i është anuluar qëndrimi.

Neni 40
Anulimi i qëndrimit afatshkurtër

1. Qëndrimi afatshkurtër i anulohet të huajit nëse:
   1.1. nuk i plotëson më kushtet e parapara me nenin 31 të këtij ligji;
   1.2. qëndron në Republikën e Kosovës në kundërshtim me qëllimin e hyrjes;
   1.3. cenon sigurinë shtetërore, rendin publik apo shëndetin publik;
   1.4. nuk i kryen detyrimet financiare ndaj shtetit.
2. Anulimin nga paragrafi 1. të këtij neni e bën Policia Kufitare.
3. Kundër vendimit për anulim e qëndrimit afatshkurtër, i huaji ka të drejtë të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore.

Neni 41
Qëndrimi i përkohshëm

1. Qëndrimit i përkohshëm i jepet të huajit i cili qëndron ose ka për qëllim të qëndroj në territorin e Republikës së Kosovës me qëllim të:
   1.1. ribashkimit familjar;
   1.2. arsimit parauniversitar ose arsimit të lartë;
   1.3. kërkime shkencore;
   1.4. arsye humanitare duke përfshirë refugjatët, personat nën mbrojtje plotësuese dhe viktimat e trafikimit me njerëz ose viktimave të kontrabandës me migrant dhe të huajt të cilët kanë shprehur vullnet të bashkëpunimit me autoritete kompetente;
   1.5. punës; dhe
   1.6. punësimit të punëtorit të sistemuar.
2. Të huajit me lejeqëndrim të përkohshëm dhe të huajit me lejeqëndrim të përhershëm sipas nenit 84 të këtij ligji i lëshohet lejeqëndrim unik.
3. Qëndrimi i përkohshëm për punëtorin e sistemuar i jepet të huajit nëse i plotëson kushtet e parapara nga neni 48 dhe neni 77 paragrafi 1. i këtij ligji.
4. Pavarësisht nga paragrafi 1. i këtij neni, të huajit mund t'i jepet qëndrimi i përkohshëm edhe për qëllime të tjera. Qëndrimi për qëllime tjera nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtë (6) muaj brenda një (1) viti.
5. Forma, përmbajtja dhe procedura për lëshimin e lejeqëndrimit sipas paragrafit 2. të këtij neni rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga MPB-ja.

Neni 42
Parashtrimi i kërkesës për qëndrim të përkohshëm

1. Kërkesa për leje qëndrim të përkohshëm do të parashtrohet në misionin diplomatik apo konsullor të Republikës së Kosovës.
2. I huaji për të cilin për të hyrë në Republikën e Kosovës nuk kanë nevojë për vizë, mund të parashtroj kërkesën për lejeqëndrim të përkohshëm në DSHAM.
3. Pavarësisht nga paragrafi 1. i këtij neni, të huajit i cili posedon vizë hyrëse dhe nëse ai vjen për qëllime studimi të rregullt me kohë të plotë në nivelet universitare, parauniversitare dhe pasuniversitare, si dhe një i huaj nga neni 70 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.12. 1.13. dhe 1.14. të këtij ligji dhe anëtarët e ngushtë të familjes së tyre mund të paraqesin kërkesë për lejeqëndrim të përkohshëm në DSHAM.
4. I huaji sipas paragrafit 2. dhe 3. këtij neni, duhet të paraqes kërkesë për lejeqëndrim të përkohshëm para skadimit të qëndrimit afat-shkurtër dhe mund të qëndroj në Republikën e Kosovës deri në vendosjen lidhur me kërkesën.

Neni 43
Mënyra e parashtrimit të kërkesës për lejeqëndrim të përkohshëm nga i huaji

1. Kërkesën për lejeqëndrim të përkohshëm i huaji e parashtron personalisht apo në rast të fëmijëve të pashoqëruar apo personave të ndjeshëm kërkesa mund të parashtrohet nga prindi apo kujdestari ligjor.

2. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, kërkesën për lejeqëndrim të përkohshëm për qëllim pune mund ta parashtroj edhe punëdhënësi.

Neni 44
Vendimi mbi kërkesën për lejeqëndrim të përkohshëm

1. Lidhur me kërkesën për lejeqëndrim të përkohshëm vendos DSHAM, brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të kërkesës.
2. Kundër vendimit nga paragrafi 1. të këtij neni brenda tetë (8) ditëve mund të parashtrohet ankesa për të cilën vendos komisioni i ankesave, brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të ankesës. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit.
3. Kundër vendimit për refuzimin e lejeqëndrimit të përkohshëm për punë për shkak të plotësimit të kuotës vjetore për punësim, apo në qoftë se akoma nuk është vendosur kuota vjetore për vazhdimin e lejeve të vlefshme, punësimin e ri apo punësimin sezonal, i huaji nuk ka të drejtë ankese por mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore.

Neni 45
Rregullimi i qëndrimit të përkohshëm të fëmijëve të lindur në Republikën e Kosovës

1. Prindi ose kujdestari i një fëmije të lindur në Republikën e Kosovës është i obliguar të parashtrojë kërkesë për lejeqëndrim të përkohshëm për fëmijën, jo më vonë se tre (3) muaj nga data e lindjes.
2. Qëndrimi i përkohshëm sipas paragrafit 1. të këtij neni mund të jepet për kohën në të cilën është lejuar qëndrimi i përkohshëm për prindin ose kujdestarin e fëmijës, ose deri në një (1) vit, nëse njëri prej prindërve ose kujdestari kanë lejeqëndrim të përhershëm**.**

Neni 46
Periudha e vlefshmërisë së qëndrimit të përkohshëm

1. Lejeqëndrimi i përkohshëm lëshohet për një periudhë deri në një (1) vit përveç rasteve kur është paraparë ndryshe me këtë ligj.
2. Periudha e vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit duhet të jetë të paktën tre (3) muaj më gjatë se periudha për të cilën është lëshuar lejeqëndrimi i përkohshëm.
3. Lejeqëndrimi për personat që gëzojnë statusin e refugjatit do të lëshohet për një periudhë vlefshmërie prej së paku tre (3) vjet dhe e ripërtërishme, përveç nëse arsyet bindëse të sigurisë nacionale apo rendit publik kërkojnë ndryshe.

Neni 47
Vazhdimi i lejeqëndrimit të përkohshëm

1. Kërkesa për vazhdimin e lejes së qëndrimit të përkohshëm duhet të paraqitet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para skadimit të lejeqëndrimit të përkohshëm në DSHAM.

2. I huaji i cili ka paraqitë kërkesën për vazhdimin e lejes së qëndrimit të përkohshëm para skadimit të qëndrimit të përkohshëm ekzistues mund të qëndrojë në Republikën e Kosovës deri në vendosje lidhur me kërkesën.
3. Përjashtimisht nga neni 46, paragrafin 2. të këtij ligji, i huaj që nuk posedon një dokument udhëtimi të vlefshëm, dhe i cili parashtron kërkesë për vazhdimin e lejeqëndrimit të përkohshëm në Republikën e Kosovës, i lëshohet një vendim për miratimin e lejeqëndrimit të përkohshëm.
4. I huaji nga paragrafi 3. i këtij neni, i cili parashtron kërkesë për vazhdimin e lejeqëndrimit të përkohshëm duhet t'ia bashkëngjit dokumentin e huaj të udhëtimit.
5. I huaji me lejeqëndrim të përkohshëm mund të parashtrojë një kërkesë për një lejeqëndrim të radhës për një qëllim tjetër, para skadimit të periudhës për të cilën është lëshuar.

Neni 48
Kushtet për dhënien e lejeqëndrimit të përkohshëm

1. Të huajit do t'i jepet lejeqëndrimi i përkohshëm, nëse:
   1.1. dëshmon qëllimin e qëndrimit të përkohshëm;
   1.2. posedon dokument të vlefshëm udhëtimi;
   1.3. posedon mjete të mjaftueshme për jetesë;
   1.4. posedon sigurim shëndetësor;
   1.5. nuk ka ndalesë të hyrjes dhe qëndrimit në Republikën e Kosovës;
   1.6. nuk përbën kërcënim për sigurinë shtetërore, rendin publik ose shëndetin publik.

Neni 49
Qëndrimi i përkohshëm më qëllim të ribashkimit familjar

1. Lejeqëndrimi i përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar mund t'i jepet një të huaji i cili është anëtar i ngushtë i familjes:
   1.1. i shtetasit të Kosovës;
   1.2. i të huajit i cili ka lejeqëndrim të përhershëm;
   1.3. i të huajit i cili ka lejeqëndrim të përkohshëm;
   1.4. i të huajit të cilit i është dhënë mbrojtje në pajtim me Ligjin për Azil.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.3. i këtij neni, anëtarit të ngushtë të familjes së të huajit i cili qëndron në Republikën e Kosovës në bazë të lejeqëndrimit të përkohshëm për punë të lëshuar për një (1) vit, në përputhje me kuotat vjetore për punësimin e të huajve, mund t'i jepet lejeqëndrim i përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar, vetëm nëse i huaji kërkon bashkim familjar në Republikën e Kosovës dhe nëse i ka të paktën dy (2) vjet të qëndrimit të përkohshëm.
3. Qëndrimi i përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar nuk do t'i jepet për një anëtar të familjes së të huajit të cilit i është lëshuar lejeqëndrimi për punë sezonale, azilkërkuesve dhe të huajve nën mbrojtje të përkohshme.
4. Parashtrimi i kërkesës për qëndrim të përkohshëm më qëllim të ribashkimit familjar do të dorëzohet dhe shqyrtohet kur anëtarët e familjes janë duke qëndruar

jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Përjashtimisht, në rrethana të caktuara, kërkesa për qëndrim të përkohshëm më qëllim të ribashkimit familjar mund të dorëzohet dhe shqyrtohet kur anëtarët e familjes gjenden në territorin e Republikës së Kosovës.

5. Kur bëhet shqyrtimi i kërkesës, interesat më të mira te fëmijëve të mitur do të merren parasysh.

Neni 50
Anëtarët e familjes

1. Anëtarët e familjes në kuptimin të këtij ligji janë:
   1.1. bashkëshortët ose partnerët e sponsorit;
   1.2. fëmijët e mitur të sponsorit dhe të bashkëshortit të tij/saj, duke përfshirë fëmijët e adoptuar ne pajtim me vendimin e marrë nga autoriteti i Republikës së Kosovës, apo një vendim i cili është automatikisht i zbatueshëm për shkak te detyrimeve ndërkombëtare te Republikës së Kosovës, apo duhet të njihen në pajtim me detyrimet ndërkombëtare;
   1.3. fëmijët e mitur duke përfshirë fëmijët e sponsorit kur sponsori ka kujdestarinë dhe fëmijët janë te varur në të. Ribashkimi familjar mund te autorizohet për fëmijët kujdestaria e të cilëve është e ndarë, me kusht qe pala tjetër qe e ndan kujdestarinë ka dhënë pajtimin e tij apo saj;
   1.4. fëmijët e mitur duke përfshirë fëmijët e adoptuar te bashkëshortit kur bashkëshorti ka kujdestarinë dhe fëmijët janë të varur në të. Ribashkimi familjar mund te autorizohet për fëmijët kujdestaria e të cilëve është e ndarë, me kusht qe pala tjetër e cila ndanë kujdestarinë ka dhënë pajtimin e tij apo saj.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, autoriteti kompetent mund të konsiderojë gjithashtu anëtarin e familjes se shtetasit të Kosovës, të huajit të cilit i është dhënë lejeqëndrimi i përkohshëm apo i përhershëm, dhe të huajit i cili ka statusin e refugjatit, nëse ka arsye të veçanta personale apo serioze humanitare për ribashkim familjar në Republikën e Kosovës.
3. Në rastin e një martese poligame, kur sponsori tashme ka një bashkëshort që jeton me të në territorin e Republikës së Kosovës nuk do të autorizohet ribashkimi familjar me një bashkëshort të mëvonshëm.
4. Ribashkimi familjar nuk do të jepet nëse bashkëshorti ose nëse partneri jashtëmartesor është i martuar ose është në një marrëdhënie afatgjatë me një person tjetër.
5. Bashkëjetesa në kuptim të këtij ligji është bashkësia jetësore e një burri të pamartuar dhe një gruaje të pamartuar qe jetojnë se bashku dhe e cila zgjatë së paku tre (3) vjet ose më pak nëse në këtë bashkëjetesë ka lindur një fëmijë i përbashkët.
6. Fëmijët e mitur duhet të jenë në moshë me të vogël se mosha e madhorisë dhe nuk duhet të jenë te martuar.
7. Si përjashtim, nëse fëmija është në moshë mbi dymbëdhjetëvjeçare (12) vjeçare dhe arrin në mënyrë të pavarur nga pjesa tjetër e familjes së tij/saj, Republika e Kosovës mund, para se të autorizojë hyrjen dhe qëndrimin sipas këtij ligji, të verifikojë nëse ai ose ajo e plotëson kushtin për integrim.

Neni 51
Ndëshkimet dhe rishqyrtimi

1. DSHAM mund të refuzojë një kërkesë për hyrje dhe qëndrim për qëllim të ribashkimit familjar, apo, nëse është e duhur, revokon apo refuzon ta ripërtërije lejeqëndrimin e anëtarit të familjes, në rrethanat si në vijim:
   1.1. kur kushtet e përcaktuara me këtë ligj nuk janë plotësuar apo nuk plotësohen më tej. Kur ripërtërihet një leje qëndrim, në rast se sponsori nuk ka mjete te mjaftueshme pa pasur qasje ne sistemin e asistencës sociale të Republikës së Kosovës, do të merren parasysh kontributet e anëtareve të familjes në ekonominë familjare;
   1.2. kur sponsori dhe anëtari i familjes se tij/saj nuk jeton apo nuk jeton më ne një marrëdhënie të vërtetë martesore apo familjare;
   1.3. kur gjendet se sponsori apo partneri i pamartuar është i martuar apo është në një marrëdhënie stabile afatgjate me një person tjetër.
2. DSHAM mund gjithashtu të refuzoje një kërkesë për hyrje dhe qëndrim për qëllim të ribashkimit familjar, apo revokon apo refuzon të ripërtërijë lejeqëndrimin e anëtarit te familjes, kur shihet se:
   2.1. janë përdorur informacione te falsifikuara apo mashtruese, dokumente false apo te falsifikuara, mashtrimi ishte kryer apo mjete të tjera te kundërligjshme ishin përdorur;
   2.2. martesa, marrëdhënia jashtëmartesore apo adoptimi ishin kontraktuar me qëllim të vetëm te lejimit te personit të hyje apo qëndroje në territorin e Republikës së Kosovës. Kur e bënë vlerësimin në lidhje me këtë çështje, DSHAM mund të merr parasysh në veçanti faktin se martesa, bashkësia jashtëmartesore apo adoptimi ishin kontraktuar pas lëshimit të lejeqëndrimit për sponsorin.
3. DSHAM mund të revokojë apo refuzojë te ripërtërijë lejeqendrimin për anëtarin e familjes kur lejeqendrimi i sponsorit skadon dhe anëtari i familjes akoma nuk e gëzon lejeqendrimin autonom te qëndrimit sipas nenit 54 të këtij ligji.
4. DSHAM mund të kryejë kontrollime specifike dhe inspektime kur ka arsye për të dyshuar se ka mashtrim, apo martesa, marrëdhënie jashtëmartesore apo adoptimi është lidhur sipas interesit. Kontrollime specifike mund gjithashtu te ndërmerren në rast të ripërtëritjes se lejëqendrimit te anëtarëve të familjes.

Neni 52
Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm për anëtarët e familjes të të huajit që gëzojnë mbrojtje në pajtim me Ligjin për Azil

1. Definicioni i anëtarëve të familjes i paraparë në paragrafin 1. të nenit 50 të këtij ligji, duhet të zbatohet gjithashtu edhe për anëtaret e familjes së personave cilëve iu është dhënë mbrojtje në pajtim me Ligjin për Azilin.
2. Anëtari i familjes të cilit iu është dhënë mbrojtje në përputhje me Ligjin për Azil, për fitimin e lejeqëndrimit të përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar, nuk i kërkohet t'i përmbush kushtet e përcaktuara në nenin 48 paragrafi 1., nën paragrafi 1.3. dhe 1.4. të këtij ligji.

3. Nëse të huajit të cilit i lejohet mbrojtja në përputhje me Ligjin për Azil është fëmijë i pashoqëruar, atëherë Republika e Kosovës:
   3.1. do të autorizojë hyrjen dhe qëndrimin me qëllim të ribashkimit familjar të afërmeve te tij/saj të shkallës së parë në linjë direkte të ngjitjes.
   3.2. do të autorizojë hyrjen dhe qëndrimin me qëllim të ribashkimit familjar të kujdestarit ligjor te tij/saj apo ndonjë anëtari tjetër të familjes, kur refugjati nuk është në lidhje direkte të ngjitjes apo të afërm të tillë nuk mund të gjinden.
4. Kur refugjati nuk mund të ofrojë dëshmi zyrtare të marrëdhënies familjare, DSHAM do të marrë parasysh dëshmi tjera, që do të vlerësohen në pajtim me legjislacionin në fuqi, të ekzistimit të marrëdhënies së tij. Vendimi me të cilin refuzohet kërkesa nuk mund të bazohet vetëm në faktin se dëshmia dokumentuese mungon.
5. Personave të cilët parashtrojnë kërkesë për qëndrim të përkohshëm më qëllim të ribashkimit familjar do t'u krijohen lehtësira për pajisje më vizë të nevojshme.

Neni 53
Vlefshmëria e lejeqëndrimit të përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar

1. Lejeqëndrimi i përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar jepet për një afat vlefshmërie prej një (1) viti ose deri në skadimin e qëndrimit të përkohshëm të lejuar të huajit i cili kërkon ribashkimin familjar.
2. I huaj i cili më parë ka pasur lejeqëndrim të vazhdueshëm të qëndrimit të përkohshëm për qëllim të ribashkimit familjar për të paktën dy (2) vjet, lejeqëndrimi i përkohshëm për të njëjtin qëllim mund të jepet për një periudhë deri në dy (2) vjet, ose deri në skadimin e lejeqëndrimit të përkohshëm i të huajit me të cilin është kërkuar ribashkimi familjar.

Neni 54
Qëndrimi autonom

1. Bashkëshortit, bashkëshortit jashtëmartesor dhe fëmiut i cili ka arritur moshën madhore, mund t'i jepet lejeqëndrim autonom, nëse ai plotëson kushtet nga nenit 48 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2. 1.3. 1.4. 1.5. dhe 1.6. të këtij ligji, në qoftë se atij i është dhënë lejeqëndrim i përkohshëm për qëllime të ribashkimit familjar për një periudhë të vazhdueshme prej tre (3) vitesh.
2. Përjashtimisht, një të huaji nga paragrafi 1. i këtij neni mund t'i jepet një qëndrim autonom nëse ai plotëson kushtet nga nenit 48, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. 1.3. 1.4. 1.5. dhe 1.6 të këtij ligji dhe nëse atij/asaj i është dhënë lejeqëndrimi i përkohshëm për qëllim të ribashkimit familjar për një periudhë të vazhdueshme prej dy (2) vitesh dhe në rast se personi në bazë të së cilës atij i është dhënë lejeqëdrimi i përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar, ka vdekur.
3. Përjashtimisht, lejeqëndrimi autonom mund të lëshohet pas parashtrimit të kërkesës së personave që kanë hyrë në bazë të ribashkimit familjar, vejushisë, shkurorëzimit dhe ndarjes.

Neni 55
Të drejtat e të huajve me qëndrim të përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar dhe qëndrimit autonom

Të huajit të cilit i është dhënë lejeqëndrim i përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar dhe të huajit me qëndrim autonom nga neni 54 i këtij ligji, gëzon të drejtën për shkollim, aftësim profesional, punë dhe vetëpunësim.

Neni 56
Qëndrimi i përkohshëm me qëllim të arsimit parauniversitar

1. Lejeqëndrimi i përkohshëm për qëllim të arsimit parauniversitar, do t'i jepet një të huaji i cili krahas kushteve nga neni 48 i këtij ligji, përmbushë edhe kushtet e mëposhtme:
   1.1. është regjistruar në institucionin arsimor;
   1.2. merr pjesë në një program të shkëmbimit të nxënësve të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsim;
   1.3. paraqet pëlqimin e prindërve ose kujdestarit ligjor për qëndrimin e planifikuar, qëllimi i së cilës është arsimimi parauniversitar në Republikën e Kosovës;
   1.4. ofron dëshmi se organizata e cila udhëheq programin e shkëmbimit të nxënësve është përgjegjëse për atë gjatë qëndrimit të tij në Republikën e Kosovës, veçanërisht në lidhje me mjetet e jetesës, të mësuarit, kujdesin shëndetësor dhe shpenzimet e kthimit dhe
   1.5. familja tek e cila ai banon ligjshëm i përmbush kushtet në bazë të dispozitave të veçanta dhe është zgjedhur në bazë të programit të këmbimit të nxënësve.
2. Leje qëndrimi i përkohshëm për qëllime të arsimit parauniversitar lëshohet me afat vlefshmërie deri në një (1) vit.

Neni 57
Qëndrimi i përkohshëm me qëllim të arsimit të lartë

1. Lejeqëndrimi i përkohshëm me qëllim të arsimit të lartë do t'i jepet një të huaj i cili i plotëson kushtet nga nenit 48 i këtij ligji dhe plotëson kushtet e mëposhtme:
   1.1. studion në një institucion të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës;
   1.2. vjen në kuadër të shkëmbimit të studentëve dhe lëvizshmërisë së të rinjve;
   1.3. vjen në praktikë të autorizuar nga organizata apo në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare apo marrëveshjeve ndërmjet universiteteve.
2. Lejeqëndrimi i përkohshëm me qëllim arsimit të lartë lëshohet me afat vlefshmërie deri në një (1) vit, ose deri në fund të vitit akademik.
3. Kryerja e praktikës e të huajit nga paragrafi 1. i këtij neni nuk do të konsiderohet si punë në kuptim të dispozitave të këtij ligji.

Neni 58
Qëndrimi i përkohshëm me qëllim të kërkimit shkencor

1. Qëndrimi i përkohshëm me qëllim të kërkimit shkencor do t'i jepet të huajit i cili ka marrëveshje me një institucion të licencuar në Republikën e Kosovës për vizitë dhe plotëson kushtet e nenit 48 i këtij ligji.
2. Lejeqëndrimi i përkohshëm me qëllim të kërkimeve shkencore lëshohet me afat vlefshmërie deri në një (1) vit.
3. I huaji i cili ka marrëveshje me qëllim të kërkimeve shkencore me ndonjërin nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian apo shtetet të cilat janë pjesë e zonës Schengen, mund të qëndroj me qëllim të kërkimeve shkencore deri në nëntëdhjetë (90) ditë në Republikën e Kosovës pa marrëveshje sipas paragrafit 1. të këtij neni me kusht që t'i plotësojë kushtet nga neni 48 i këtij ligji.

Neni 59
Qëndrimi i përkohshëm për arsye humanitare

1. Qëndrimi i përkohshëm për arsye humanitare do t'i jepet një të huaji në rastet e mëposhtme:
   1.1. nëse ai/ajo është viktimë e trafikimit me njerëz (në tekstin e mëtejmë viktimë) dhe ka pranuar programin e ndihmës dhe mbrojtjes;
   1.2. nëse i mituri ka qenë i braktisur ose është viktimë e krimit të organizuar apo për ndonjë arsye tjetër, pa kujdes prindëror, kujdestari, apo pa përcjellje;
   1.3. ka bashkëpunuar apo pranon të bashkëpunojë me autoritetet e drejtësisë apo me propozimin e autoriteteve të sigurisë shtetërore;
   1.4. në qoftë se ai/ajo bashkëpunon me autoritetet dhe pjesëmarrja e tij është e nevojshme në procedurat penale kundër një punëdhënësi që e ka punësuar ilegalisht;
   1.5. është grua shtatzënë mbi gjashtë (6) muaj; dhe
   1.6. arsye tjera serioze humanitare.
2. I huaj nga paragrafi 1. i këtij neni përjashtohet nga përmbushja e kushteve nga neni 48 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.3. dhe 1.4. të këtij ligji.

Neni 60
Viktimat e trafikimit me njerëz

Pas identifikimit të viktimës nga autoritetet e përcaktuara me ligjin përkatës për trafikim me njerëz, viktimave të trafikuara u jepet lejeqëndrim i përkohshëm.

Neni 61
Periudha e reflektimit dhe lëshimi i lejeqëndrimit

1. Republika e Kosovës duhet të siguroj që të huajve në fjalë duhet t'u lejohet një periudhë reflektuese që i lejon ata të rimarrin vetën dhe t'i ikin ndikimit të kryesve të veprave në mënyre që ata të marrin një vendim të bazuar në informacion nëse do të bashkëpunojnë me autoritetet kompetente. Kohëzgjatja e periudhës reflektuese

duhet të jetë prej tridhjetë (30) deri në nëntëdhjetë (90) ditë dhe se pika filluese e kësaj periudhe do të llogaritet nga moment kur çështja iu është referuar njësisë përkatëse kundër trafikimit me njerëz.
2. Gjatë periudhës reflektuese dhe gjatë pritjes së vendimit nga autoriteti kompetent, i huaji do të ketë qasje në trajtimin e referuar në paragrafin 1. të nenit 62 të këtij ligji dhe kur është e përshtatshme qasje në asistencë psikologjike, shërbime të përkthimit dhe interpretimit, sigurisë, nevojën për mbrojtje, ndihme ligjore falas sipas ligjit në fuqi.
3. Republika e Kosovës mund që në çdo kohë të përfundojë periudhën e reflektimit nëse autoritetet kompetente kanë gjetur që personi në fjalë në mënyre aktive, vullnetarisht dhe me iniciativën e tij/saj i ka ripërtërirë kontaktin me kryerësit e veprave apo për arsyet të lidhura me politikat publike dhe mbrojtjen e sigurisë shtetërore.
4. Pasi të ketë përfunduar periudha e reflektimit, me kërkesë të autoriteteve kompetente do të lëshohet lejëqendrimi për së paku gjashtë (6) muaj dhe do të ripërtërihet nëse kushtet përkatëse vazhdojnë të përmbushen.

Neni 62
Të drejtat e viktimave të trafikimit me njerëz të cilëve iu është dhënë lejeqëndrimi i përkohshëm

1. Viktimës të cilës i është lejuar qëndrimi i përkohshëm, ka të drejtë për strehim të sigurt, kujdes shëndetësor, ndihmë financiare, arsim dhe punë sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
2. Kujdes i veçantë duhet pasur për gratë shtatzëna dhe njerëzit me aftësi të kufizuara si grupe të viktimave veçanërisht të ndjeshme.
3. Të huajit të cilit i është dhënë qëndrimi i përkohshëm për shkaqe humanitare në pajtim me nenin 59 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.4. dhe 1.5. do të ushtrojnë të drejtat e tyre sipas paragrafit 1. të këtij neni.

Neni 63
Interesi me i mirë i viktimave të mitur të trafikimit me njerëz

1. Autoritetet e përfshira në parandalimin, luftimin dhe mbrojtjen e viktimave të mitura, do të marrin parasysh interesat më të mira të të miturit.
2. Për viktimën e mitur sipas paragrafit 1. të këtij neni merren masat e nevojshme në interesin më të mirë të fëmijës, qasja në sistemin e arsimit dhe masat e nevojshme duhet të merren për të përcaktuar identitetin, shtetësinë dhe për të gjetur anëtarët e tjerë të familjes.

Neni 64
Kthimi i viktimës së trafikuar

1. Kthimin e sigurt të të huajit që e gëzon statusin e viktimës e bën MPB-ja, duke u kujdesur për të drejtat e tij, sigurinë dhe dinjitetin. Kthimi sipas mundësisë duhet të jetë vullnetar dhe parimi i moskthimit duhet të merret çdo herë në konsideratë.

2. Të miturit të cilët janë viktima të trafikimit me njerëz nuk do të kthehen në asnjë shtet tjetër, nëse pas vlerësimit të rrezikshmërisë dhe sigurisë dyshohet që kthimi i tillë nuk do të jetë në interesin më të mirë për të miturin.

Neni 65
Përfundimi i lejeqëndrimit të përkohshëm për viktimat e trafikuara

1. Qëndrimi i përkohshëm për arsye humanitare, i përfundon viktimës në qoftë se:
   1.1. e ka humbur statusin e viktimës;
   1.2. vërtetohet se ai/ajo abuzon me statusin e viktimës apo ai /ajo marrë atë me mashtrim, pushon bashkëpunimin me autoritete kompetente dhe kur autoritetet kompetente e përfundojnë procedurën;
   1.3. atë e kërkojnë arsyet për mbrojtjen e rendit publik, sigurisë shtetërore dhe shëndetit publik.
2. Me rastin e marrjes së vendimit përfundimtar për qëndrimin e përkohshëm të viktimës së mitur do të kërkohet mendimi i autoriteteve kompetente për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz.
3. Qëndrimi i përkohshëm për arsye humanitare në bazë të nenit 59 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2. 1.3. 1.4. 1.5. 1.6. dhe 1.7. të këtij ligji përfundon në qoftë se përfundon qëllimi për të cilin të huajit i është dhënë qëndrimi i përkohshëm ose atë e kërkon mbrojtja e rendit publik, sigurisë shtetërore dhe shëndetit publik.
4. Kundër vendimit nga paragrafi 1. dhe 3. të këtij neni mund të ushtrohet ankesë, për të cilën vendos Komisioni i Ankesave.

Neni 66
Revokimi i qëndrimit të përkohshëm

1. Qëndrimi i përkohshëm i revokohet të huajit nëse:
   1.1. pushojnë kushtet për dhënien e qëndrimit të përkohshëm sipas nenit 48 të këtij ligji;
   1.2. në qoftë se brenda tridhjetë (30) ditëve pas miratimit të qëndrimit të përkohshëm nuk e lajmëron vendbanimin;
   1.3. qëndron jashtë territorit të Republikës së Kosovës për më shumë se tridhjetë (30) ditë pandërprerë;
   1.4. nëse qëndrimi i tij në Republikën e Kosovës është në kundërshtim me qëllimin e qëndrimit të përkohshëm.
2. Vendimi sipas paragrafit 1. nën-paragrafin 1.2. dhe 1.3. të këtij neni mund të merret pa një dëgjim paraprak të të huajit, përderisa paraprakisht ai ka qenë i njoftuar se ndaj tij është duke u zhvilluar procedura për revokimin e qëndrimit të përkohshëm.
3. Kundër vendimit sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të parashtrohet ankesë në Komision të Ankesave.
4. Përjashtimisht nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.3. i këtij neni, i huaji i cili nëntëdhjetë (90) ditë për shkaqe të arsyeshme qëndron jashtë Republikës së Kosovës, qëndrimi i përkohshëm nuk do t'i revokohet vetëm nëse e njofton DSHAM-in ose Policinë Kufitare, jo më vonë se dhjetë (10) ditë nga data e kthimit në Republikën e Kosovës.

Neni 67
Puna e të huajve në Republikën e Kosovës

1. I huaji në Republikën e Kosovës mund të punojë në bazë të lejes së dhënë për qëndrim dhe punë ose vërtetimit për lajmërimin e punës, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.
2. Lejeqëndrimi për punë mund të lëshohet në bazë të kuotës vjetore ose jashtë saj.
3. Përjashtohen nga pajisja me leje pune dhe vërtetimi për lajmërimin e punës të huajit me:
   3.1. qëndrim të përhershëm;
   3.2. me status të refugjatit, apo mbrojtje të përkohshme ose plotësuese;
   3.3. me qëndrim të përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar me shtetas të Republikës së Kosovës, me të huaj me qëndrim të përhershëm, me të huaj me status të refugjatit, si dhe të huaj të cilëve iu është aprovuar mbrojtja plotësuese ose mbrojtja e përkohshme;
   3.4. qëndrim të përkohshëm për arsye humanitare;
   3.5. qëndrim autonom;
   3.6. status të nxënësit ose studentit të rregullt, kur i kryejnë punët përmes ndërmjetësuesit të autorizuar, pa themelim të marrëdhënies së punës;
   3.7. qëndrim të përkohshëm me qëllim të kërkimit shkencor nga neni 58 i këtij ligji.
4. Punë në kuptim të këtij ligji, nuk konsiderohet kryerja e veprimeve paraprake për themelimin dhe regjistrimin e shoqërisë ose qarkullimit tregtar.
5. I huaji mund të punojë në Republikën e Kosovës vetëm në ato punë për të cilat i është lëshuar lejeqëndrimi për punë ose vërtetimi për lajmërimin e punës dhe vetëm tek ai punëdhënës, me të cilin është themeluar marrëdhënia e punës.
6. Punëdhënësi mund ta punësojë të huajin vetëm në ato punë, për të cilat i është dhënë lejeqëndrimi për punë, respektivisht vërtetimi për lajmërimin e punës.
7. Punëdhënësi nuk mund ta punësojë të huajin, i cili në mënyrë të paligjshme qëndron në Republikën e Kosovës.
8. Nëse shtetasi i huaj e ka paraqitur lejen e pavlefshme nga paragrafi 7. i këtij neni, punëdhënësi nuk do të konsiderohet fajtor për punësimin e shtetasit të huaj, i cili në mënyrë të paligjshme qëndron në Republikën e Kosovës, përveç nëse punëdhënësi e ka ditur se dokumenti i paraqitur si lejeqëndrim dhe i punës nuk është në rregull dhe i vlefshëm.
9. Punëdhënësi, i cili e punëson të huajin nga paragrafi 3. i këtij neni, është i obliguar që në afatin prej tetë (8) ditësh nga dita e themelimit të marrëdhënies së punës ose fillimit të punës, për këtë ta informojë MPMS-në, e cila për këtë duhet ta njoftoj MPB-në.
10. Dispozitat e këtij neni që kanë të bëjnë me punëdhënësin në mënyrë adekuate zbatohen edhe tek nënkontraktori.

Neni 68
Kuota vjetore e punësimit të shtetasve të huaj

1. Me Vendim Qeveria e Republikës së Kosovës e përcakton kuotën vjetore të punësimit të të huajve jo më vonë se deri më 31 tetor për vitin e ardhshëm për vazhdimin e lejeve të lëshuara dhe punësimin e ri. Kuota vjetore e punësimit për të huajt duhet të bëhet publike.

2. Propozimin e kuotës vjetore për punësimin e të huajve e harton MPMS-ja në bazë të rekomandimit të Këshillit Ekonomiko-Social.
3. Kuota vjetore për punësimin e të huajve përcaktohet në harmoni me politikën e migracionit dhe gjendjen në tregun e punës, në përputhje me nevojat dhe mundësitë e punësimit të të huajve në Republikën e Kosovës.
4. Me kuotën vjetore për punësimin e të huajve përcaktohen veprimtaritë dhe profesionet, në të cilat lejohet punësimi i ri, si dhe numri i lejeve për secilën veprimtari dhe profesion.
5. Me kuotën vjetore për punësimin e të huajve mund të përcaktohet edhe kuota për punësim sezonal.

Neni 69
Lejeqëndrimi për punë në bazë të kuotës vjetore për punësimin e të huajve

1. Lejeqëndrimi për punë në bazë të kuotës vjetore nga neni 68 i këtij ligji, do t'i lejohet të huajit, i cili i plotëson kushtet nga neni 48 i këtij ligji dhe duhet t'ia bashkëngjis:
   1.1. kontratën e punës, respektivisht vërtetimin me shkrim për lidhjen e kontratës për punë ose dëshminë adekuate të punës;
   1.2. dëshminë mbi arsimimin, kualifikimin e fituar dhe aftësimin e të huajit;
   1.3. dëshminë mbi regjistrimin e shoqërisë tregtare, shoqatës, një filial, degë, biznes, përfaqësi dhe organizatë në Republikën e Kosovës.

Neni 70
Lejeqëndrimi për punë jashtë kuotës vjetore

1. Lejeqëndrimi për punë jashtë kuotës vjetore mund të lëshohet:
   1.1. emigrantëve ditor me kushte të reciprocitetit;
   1.2. personelit kyç, ofruesve të shërbimeve, punëtorëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre, statusi i të cilëve është i rregulluar me Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit dhe bashkëveprimit në mes të Bashkimit Evropian e shteteve të saj dhe të Republikës së Kosovës;
   1.3. të huajve që punojnë në kompanitë private të cilat janë nënkontraktorë të misioneve diplomatike që veprojnë në Republikën e Kosovës;
   1.4. të huajve që kryejnë punët kryesore në shoqëritë tregtare, shoqatave dhe përfaqësive;
   1.5. të huajve që janë transferuar në kuadër të transferit të brendshëm të personelit në kuadër të shoqërive tregtare dhe personelit tjetër të domosdoshëm të përcaktuar paraprakisht me kontratë;
   1.6. të huajve që vetëpunësohen në shoqërinë e vetë tregtare ose në shoqërinë tregtare, në të cilën ka pjesëmarrje të pasurisë së tij më të madhe se 51% ose qarkullim të vetin;
   1.7. mësimdhënësve të cilët japin mësim në institucionet shkollore në gjuhën dhe shkrimin e pakicave kombëtare;
   1.8. sportistëve profesionistë ose veprimtarëve-punëtorë sportiv, të cilët punojnë në Republikën e Kosovës;

1.9. artistëve që punojnë në institucionet e kulturës në Republikën e Kosovës;
1.10. të huajve, të cilët kanë themeluar marrëdhënie pune në korporatat, të cilat janë të regjistruara si korporata të huaja në Republikën e Kosovës dhe më së paku edhe në tri (3) shtete tjera;
1.11. të huajve që punojnë në bazë të programit të lëvizshmërisë së të rinjve, të cilat Republika e Kosovës i realizon në bashkëpunim me shtetet tjera;
1.12. kërkuesve shkencorë, të huajve që punësohen në vendet shkencore të punës, shkencorë-arsimore ose vendet tjera kërkimore të punës tek personat juridik shkencor;
1.13. profesorëve të gjuhëve të huaja, ligjëruesve dhe arsimtarëve të tjerë të cilët japin mësim në institucionet e larta arsimore në Republikën e Kosovës ose në shkollat e regjistruara të gjuhëve të huaja;
1.14. të huajve që punojnë në bazë të kontratave ndërkombëtare, përveç kontratës nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2. të këtij neni.

2. Personi, që kryen punët kyçe në shoqërinë tregtare, shoqatën ose përfaqësinë e shoqërisë së jashtme tregtare në kuptim të paragrafit 1. nën-paragrafi 1.4. të këtij neni, konsiderohet personi:
2.1. personi, i cili në shoqërinë tregtare, shoqatën ose përfaqësinë ka pozitë të lartë, personi që udhëheqë me afarizëm, personi që gjendet nën mbikëqyrjen e përgjithshme ose në udhëheqjen e drejtorisë ose aksionarit, respektivisht anëtari i shoqërisë tregtare si dhe personi i cili kryen përgjegjësi të barabartë, duke përfshirë:
2.1.1. udhëheqjen e punës së repartit ose nën-repartit të shoqërisë tregtare;
2.1.2. përcjelljen dhe mbikëqyrjen e punës të punëtorëve të tjerë, respektivisht kryerjen e punëve mbikëqyrëse ose udhëheqëse;
2.1.3. autorizimin për punësim dhe shkarkimin e punëtorëve, respektivisht dhënies së rekomandimeve që janë të lidhura me punësim, shkarkimin ose punëve të tjera kadrovike.
2.2. personi që punon në shoqërinë tregtare, shoqatën ose përfaqësinë, i cili posedon aftësi të posaçme profesionale ose aftësi të nevojshme për ofrimin e shërbimeve, përdorimin e mjeteve për kërkime, pranimin e teknikave ose udhëheqjen e afarizmit të shoqërisë tregtare, shoqatës ose përfaqësisë.

Neni 71
Kushtet për marrjen e lejeqëndrimit për punë jashtë kuotës vjetore

1. Lejeqëndrimi për punë nga neni 70 i këtij ligji, mund t'i jepet të huajit nëse i ka plotësuar kushtet e parapara në nenin 48 të këtij ligji, dhe duhet të bashkëngjis:
1.1. kontratën e punës, respektivisht vërtetimin me shkrim për lidhjen e kontratës për punë ose dëshminë adekuate të punës;
1.2. dëshminë mbi arsimimin, kualifikimin e fituar dhe aftësimin e të huajit;
1.3. dëshminë mbi regjistrimin e shoqërisë tregtare, shoqatës, një filial, degë, biznes, përfaqësi dhe organizatë në Republikën e Kosovës;
1.4. arsyetimin për punësimin e të huajit që përmban shënimet për aftësitë dhe kualifikimet profesionale dhe përvojën e punës së të huajit si dhe arsyetimin përse vendi i punës nuk mund të plotësohet nga fuqia punëtore prej tregut të punës në Republikën e Kosovës.

2. Me kërkesën për lëshimin e lejeqëndrimit për punë nga neni 70 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1. 1.2. 1.4. 1.5. dhe 1.6. i këtij ligji nuk është e nevojshme që t'i bashkëngjitet arsyetimi mbi arsyeshmërinë e punësimit të shtetasit të huaj.

Neni 72
Kushtet për marrjen e lejeqëndrimit për punë jashtë kuotës vjetore për të huajt qe kryejnë detyra madhore për kompanitë tregtare, asociacionet dhe përfaqësitë

1. Të huajit nga neni 70 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.4. i këtij ligji, lejeqëndrimi për punë mund t'i lëshohet, nëse i plotëson kushtet e parapara në nenin 71 të këtij ligji dhe nëse:
   1.1. paraqet dëshmi mbi regjistrimin e shoqërisë tregtare;
   1.2. në shoqërinë tregtare, shoqatën ose përfaqësinë e huaj ka të punësuar së paku tre (3) shtetas të Republikës së Kosovës në punët e ndryshme, duke filluar nga punët e përfaqësuesit, anëtar i drejtorisë ose i organit mbikëqyrës;
   1.3. pagesa është e njëjtë me vlerën e pagës minimale në Republikën e Kosovës, të përcaktuar në vitin e kaluar.
2. Nëse më shumë të huaj nga paragrafi 1. i këtij neni, i kryen punët kyçe për të njëjtin punëdhënës, lejeqëndrimi për punë mund t'i lëshohet, nëse:
   2.1. janë të punësuar për çdo shtetas të huaj më së paku pesë (5) shtetas të Republikës së Kosovës në punët e ndryshme, duke filluar nga përfaqësuesi, anëtari i drejtorisë ose organit mbikëqyrës;
   2.2. paraqet dëshmi mbi regjistrimin e shoqërisë tregtare;
   2.3. pagesa është e njëjtë me vlerën e pagës mesatare në Republikën e Kosovës, të përcaktuar në vitin e kaluar.
3. Të huajit nga neni 70 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.6. i këtij ligji, lejeqëndrimi për punë do t'i lëshohet nëse i plotëson kushtet nga neni 71 i këtij ligji dhe nëse:
   3.1. paraqet dëshmi mbi regjistrimin e shoqërisë tregtare;
   3.2. janë të punësuar së paku tre (3) shtetas të Republikës së Kosovës;
   3.3. pagesa është e njëjtë me vlerën e pagës minimale në Republikën e Kosovës, të përcaktuar në vitin e kaluar;
   3.4. dëshminë mbi kryerjen e obligimeve tatimore dhe kontributet në Republikën e Kosovës.

Neni 73
Kushtet për marrjen e lejeqëndrimit për punë jashtë kuotës vjetore për të huajt statusi i të cilëve është i rregulluar përmes Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asociimit si dhe ndërveprimit ndërmjet Bashkimit Evropian, shteteve të tij dhe Republikës së Kosovës

1. Lejeqëndrimi për punë jashtë kuotës vjetore mund t'i lëshohet shtetasit të huaj që i plotëson kushtet nga neni 48 i këtij ligji dhe:
   1.1. që kryen punët kyçe në pajtim me nenin 70 nën-paragrafi 1.2. i këtij ligji, në shoqërinë tregtare e cila është bartëse e masave nxitëse në pajtim me dispozitën për joshjen e investimeve, ose që e ka pjesën e pasurisë prej më së paku 51% ose;
   1.2. i cili në Republikën e Kosovës kryen punë ose udhëheq projekte në bazë të

kontratave ndërkombëtare mbi ndihmën profesionale dhe teknike, të cilat Republika e Kosovës i ka lidhur me Bashkimin Evropian, me një shtet tjetër ose me një organizatë ndërkombëtare.

Neni 74
Vendimi për dhënien e lejeqëndrimit për punë

1. Lidhur me kërkesën për lëshimin e lejeqëndimit për punë vendos DSHAM-i, pas konfirmimit për lejimin e punës nga MPMS-ja. Kundër vendimit mund të ushtrohet ankesë brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i vendimit, për të cilën vendos Komisioni i Ankesave.
2. Lejeqëndrimi për punë i lëshohet shtetasit të huaj për kohën sa është e nevojshme për kryerjen e punëve, respektivisht për kohën për të cilin është lidhur kontrata e punës ose kontrata tjetër përkatëse, e më së gjati deri një (1) vit.
3. Përjashtimisht nga paragrafi 2. i këtij neni, lejeqëndrimi për punë të huajit nga neni 70 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.5. të këtij ligji i lëshohet me afat të vlefshmërisë prej dy (2) vitesh, nëse nuk është kërkuar periudha më e shkurtër e lëshimit të lejeqëndrimit për punë.
4. Shtetasi i huaj, të cili i është lëshuar lejeqëndrimi për punë për shkak të kryerjes së punëve sezonale, mund të qëndrojë në Republikën e Kosovës më së gjati gjashtë (6) muaj, në periudhën kohore prej një (1) viti dhe patjetër duhet të qëndrojë jashtë Republikës së Kosovës më së paku gjashtë (6) muaj, para se t'i i bëhet përsëri e mundur hyrja dhe qëndrimi me qëllim të punës.
5. Punëdhënësi dhe Administrata Tatimore në bazë të selisë së personit juridik ose vendbanimit të personit fizik, i cili i shfrytëzon shërbimet e të huajit ose vendit ku puna e kontraktuar do të kryhet do të njoftohen nga DSHAM-i për dhënien e lejeqëndrimit për punë.

Neni 75
Refuzimi i lëshimit të lejeqëndrimit për punë

Të huajit mund t'i refuzohet lëshimi i lejeqëndrimit për punë, me qëllim të sigurisë shëndetësore, nëse punëdhënësi i shkelë dispozitat e punës dhe mbrojtës në punë, sigurimit shëndetësor dhe pensional ose në rast se i huaji ose punëdhënësi nuk e ka paguar dënimin e shqiptuar me para.

Neni 76
Vërtetimi për lajmërimin e punës

1. Në bazë të vërtetimit për lajmërimin e punës, deri në nëntëdhjetë (90) ditë brenda një (1) viti, mund të punojnë të huajt si vijon:
   1.1. përfaqësuesi tregtar, personeli kryesor dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës të shoqërisë tregtare, të cilët i kryejnë punët për shoqërinë tregtare, por nuk janë në marrëdhënie pune;
   1.2. ofruesit e shërbimeve në turizëm, përfaqësuesit turistik, respektivisht animatorët në pajtim me dispozitat e posaçme;

1.3. shkencëtarët në aftësimin shkencor dhe profesional, shkencëtarët – përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, shkencëtarët që do të marrin pjesë në realizimin e projekteve shkencore, të rëndësishëm për Republikën e Kosovës;

1.4. personeli udhëheqës, ekspertët, arsimtarët dhe ligjëruesit e institucioneve të jashtme kulturore, arsimore dhe shkencore, të cilët në Republikën e Kosovës i kryejnë punët në kuadër të programeve të bashkëpunimit kulturor dhe arsimor, si dhe personeli udhëheqës, ekspertët, arsimtarët dhe ligjëruesit e institucioneve të jashtme kulturore, arsimore dhe shkencore, të cilët në Republikën e Kosovës i kanë shoqatat e veta, nëse vijnë nga institucioni amë;

1.5. zyrtarët civil dhe ushtarak të qeverive të shteteve tjera, të cilët në Republikën e Kosovës vijnë të punojnë në bazë të kontratës së bashkëpunimit me Qeverinë e Republikës së Kosovës;

1.6. korrespondentët e jashtëm, të akredituar në Republikën e Kosovës ose reporterët e medieve të huaja;

1.7. përfaqësuesit dhe personeli i bashkësive fetare, të cilët i kryejnë punët ekskluzivisht të lidhura me shërbimin fetar mirëbërës;

1.8. studentët, të cilët në unionet ose institucionet e Kosovës vijnë për punë vullnetare në kampet punuese ose në programet arsimore dhe të punës, respektivisht, të cilët vijnë në praktikë në misionet diplomatike dhe konsullore, të akredituara në Republikën e Kosovës;

1.9. vullnetarët, të cilët punojnë në unionet dhe institucionet jo fitimprurëse në Republikën e Kosovës në pajtim me dispozitat e posaçme, respektivisht në bazë të programeve të shkëmbimit dhe bashkëpunimit vullnetar;

1.10. shtetasit e huaj, të cilët në Republikën e Kosovës vijnë ta kryejnë stazhin ushtrimor në shoqëritë tregtare, shoqatat ose përfaqësitë, të cilët janë pronarë të firmës tregtare të jashtme, nëse ata të huaj vijnë nga ajo firmë në seli, respektivisht nga përfaqësia ose shoqata e saj në një shtet tjetër;

1.11. të huajt që i kryejnë punët e mbikëqyrjes dhe inspeksionit të riparimit dhe ndërtimit të anijeve, respektivisht të huajt që i kryejnë punët e mbikëqyrjes ose inspeksionit të prodhimit, të pajisjeve montazhe, të makinerisë dhe instrumenteve tjera, në bazë të kontratës mbi eksportimin ose porosinë e porositësit të huaj;

1.12. të huajt që e kryejnë praktikën, aftësimin ose punën vullnetare në kuadër të Programit të Bashkëpunimit, Programit për mësim gjatë tërë jetës dhe Programit të Rinjve në Veprim, pastaj të programeve dhe iniciativave tjera, të cilat i zbaton organi i arsimit dhe shkencës;

1.13. ekspertët në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, të letërsisë dhe arkivave;

1.14. të huajt, që kryejnë mësimin profesional, aftësimin dhe shkollimin e të punësuarve të personat fizik dhe juridik në Republikën e Kosovës;

1.15. të huajt, të cilët i kryejnë punët e lidhura me porositë, montazhet ose servisimin e makinave ose pajisjeve, ndërsa puna e tyre është kusht për realizimin e të drejtave të tyre garantuese ose është e lidhur me porosinë e makinerisë ose pajisjeve;

1.16. të huajt, të cilët aftësohen profesionalisht te personi juridik me seli në Republikën e Kosovës, i cili është i lidhur me punëdhënësin e jashtëm;
1.17. nxënësit, të cilët përmes të organizatës së autorizuar ose përmes të programit të shkëmbimit të nxënësve vijnë në praktikë.

2. Shtetasve të huaj nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.3. 1.4. 1.5. 1.6. 1.7. 1.8. 1.9. 1.10. 1.11. 1.12. 1.13. 1.14. dhe 1.15. të këtij neni, të cilët kanë për qëllim të qëndrojnë për punë në Republikën e Kosovës më gjatë se nëntëdhjetë (90) ditë, mund t'iu lëshohet lejeqëndrimi për punë jashtë kuotës vjetore, nëse i plotësojnë kushtet nga neni 48 i këtij ligji.
3. Në bazë të vërtetimit për lajmërimin e punës, deri në gjashtëdhjetë (60) ditë brenda një (1) viti, mund të punojnë të huajt si vijon:
   3.1. ofruesit e shërbimeve të revizioneve dhe konsulencës;
   3.2. ligjëruesit që marrin pjesë në tubimet dhe seminaret e organizuar profesional;
   3.3. artistët dhe personeli teknik, për shfaqjet e operave, baletit, teatrit, koncerteve dhe shfaqjeve tjera kulturore, respektivisht autorët dhe ekzekutuesit në fushën e artit të filmit dhe televizionit;
   3.4. punëtorët në parqet e cirkut dhe ato zbavitëse.
4. Në bazë të vërtetimit mbi lajmërimin e punës, deri në tridhjetë (30) ditë gjatë vitit, mund të punojnë shtetasit e huaj siç vijon:
   4.1. autorët dhe ekzekutuesit në fushën e muzikës, muzikës së skenës dhe artit të vallëzimit si dhe ekzekutuesit përcjellës, personeli teknik;
   4.2. në shfaqjet e panairit dhe ekspozitës, në të cilat ekzekuton punëdhënësi i tyre.
5. Lajmërimi nga paragrafi 1. 3. dhe 4. i këtij neni bëhet në MPMS, e cila i lëshon një vërtetim për lajmërimin e punës dhe menjëherë e njofton Administratën Tatimore, DSHAM-in, dhe Policinë Kufitare.
6. Në bazë të vërtetimit për lajmërimin e punës, i huaji mund të punoj për të njëjtin punëdhënës ose marrësin e shërbimeve, në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
7. Personi juridik ose fizik, i cili punëson ose i shfrytëzon shërbimet e shtetasit të huaj nga ky nen, duhet të ketë të lidhur kontratën adekuate ose dëshminë tjetër për kryerjen e punëve me shtetasin e huaj ose punëdhënësin e jashtëm, i cili e dërgon shtetasin e huaj në punë në Republikën e Kosovës.
8. Nëse shtetasit e huaj, të cilët në Republikën e Kosovës paraqitën në shfaqjet dhe garat sportive, si përfaqësues të ekipeve, klubeve të jashtme ose reprezentacioneve shtetërore, nuk aplikohet paragrafi 5. dhe 7. i këtij neni.

Neni 77
Punëtori i sistemuar

1. Punëtori i sistemuar është punëtori, të cilin punëdhënësi i huaj e ka sistemuar në Republikën e Kosovës në kuadër të punës së përkohshme ose të kohëpaskohshme përmes ofrimit të shërbimeve ndërkufitare në periudhë të kufizuar kohore, sipas njërës prej rrethanave në vijim:
   1.1. e dërgon në punë në Republikën e Kosovës në llogari të vetë dhe në udhëheqje të vetën, në bazë të kontratës së lidhur në mes të punëdhënësit të jashtëm dhe punëtorit, ekziston marrëdhënia e punës ose;

1.2. e dërgon në Republikën e Kosovës në shoqatën e tij ose në shoqërinë që është pronë e të njëjtit grup, të cilës i përket edhe punëdhënësi i huaj, me kusht që në kohën e dërgimit në mes të punëdhënësit të huaj dhe punëtorit të ekzistojë marrëdhënia e punës;

1.3. të paraqitet si agjenci për punësim të përkohshëm, shfrytëzuesit që është themeluar ose vepron në Republikën e Kosovës, me kusht që me rastin e paraqitjes të ekzistoj marrëdhënia e punës në mes të agjencisë për punësim të përkohshëm dhe punëtorit.

2. Punëtori i sistemuar nga ky nen i cili qëndron më shumë se tre (3) muaj në Republikën e Kosovës duhet të pajiset me lejeqëndrim për punë në përputhje me nenin 41 nënparagrafin 1.6. të këtij ligji.
3. Puna dhe kushtet e punës të referuara në këtë ligj nuk do të zbatohen për punëtorin e aftësuar të dërguar nga ana e punëdhënësit të huaj në Republikën e Kosovës për një periudhë më të shkurtër se tetë (8) ditë, nëse punëdhënësi i huaj, i cili bën sistemimin për bërjen e vendosjes së parë, të nevojshme për marrjen e të mirave që janë në përdorim, dhe i cili është i kontraktuar, si një pjesë e rëndësishme e kontratës për furnizim me të mira.
4. Për punëtoret, të cilët punëdhënësi i huaj do t'i dërgoj në Republikën e Kosovës në punët e konstruksionit të lidhura me konstruksionin, riparimin, mirëmbajtjen, apo shkatërrimin e ndërtesave posaçërisht punët e mihjes, punët e tokës, punët e rënda të konstruksionit, montimit dhe demontimit të instalimeve, renovimeve, shkatërrimeve, mirëmbajtjes së rregullt, pastrimit dhe përparimit, nuk do të aplikohet paragrafi 3. i këtij neni.

Neni 78
Periudha referuese

1. Periudha kohore në të cilën punëtori është sistemuar sipas nenit 77 të këtij ligji në punë, në Republikën e Kosovës llogaritet në bazë të periudhës referuese prej një (1) viti, nga fillimi i dërgimit.
2. Me qëllim të llogaritjes së afatit kohor të dërgimit, merren parasysh të gjitha periudhat e mëhershme, në të cilat puna e njëjtë për punëdhënësin e huaj e ka kryer secili punëtor i sistemuar.

Neni 79
Mbrojtja ligjore dhe bashkëpunimi

1. Për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave dhe kushteve të përcaktuara nga neni 77 të këtij ligji, punëtori i sistemuar mundet kundër personit fizik ose juridik punëdhënës i huaj, respektivisht marrësit të shërbimeve në Republikën e Kosovës të inicioj procedurë gjyqësore në Gjykatën Themelore, në përputhje me legjislacionin përkatës në Republikën e Kosovës.
2. Me qëllim të informimit për realizimin dhe shtrirjen e të drejtave të përcaktuara në nenin 77 të këtij ligji dhe bashkëpunimit të duhur ndërkombëtar, MPMS do ta sigurojë bashkëpunimin administrativ dhe ndihmën e ndërsjellët, në mënyrë që kushtet e punës të jenë të kapshme për të gjithë të interesuarit.

Neni 80
Deklarata për dërgim

1. Punëdhënësi i huaj nga neni 77 i këtij ligji, është i obliguar që para fillimit të dërgimit ta paraqes deklaratën për dërgim, e cila duhet të përmbajë:
   1.1. emrin dhe selinë, respektivisht emrin dhe mbiemrin, adresën e punëdhënësit të huaj dhe shënimet kontaktuese;
   1.2. emrin dhe mbiemrin e punëtorit të sistemuar dhe shënimet për shtetin, në të cilin zakonisht punon;
   1.3. fillimin dhe periudhën kohore të paraparë për dërgim;
   1.4. emrin dhe selinë respektivisht emrin dhe mbiemrin, adresën e shfrytëzuesit të shërbimeve, vendin e ofrimit të shërbimeve dhe përshkrimin e shkurtër të shërbimeve;
   1.5. të dhënat e datës së lëshimit, afatin e vlefshmërisë, numrin dhe organin kompetent, i cili e ka lëshuar lejen e vlefshme të qëndrimit dhe lejen për punëtorin e sistemuar nga neni 76 paragrafi 4. i këtij ligji sipas legjislacionit përkatës në Republikën e Kosovës, në të cilin punëdhënësi i huaj e kryen veprimtarinë.
2. Punëdhënësi i huaj nga neni 77 i këtij ligji është i obliguar që me rastin e zgjatjes së afatit për dërgim ta paraqes çdo ndryshim nga paragrafi 1. i këtij neni.
3. Deklarata nga paragrafi 1. i këtij neni i paraqitet me shkrim ose në mënyrë elektronike organit, i cili me dispozitat e posaçme është caktuar si organ i autorizuar për koordinimin e sistemit të sigurimit social në Republikën e Kosovës.

Neni 81
Revokimi i lejeqëndrimit për punë

1. Lejeqëndrimi për punë revokohet nëse:
   1.1. janë plotësuar kushtet nga neni 66 paragrafi 1. i këtij ligji;
   1.2. pushojnë kushtet, në bazë të cilave është lëshuar;
   1.3. i huaji i kryen punët, për të cilat nuk i është lëshuar lejeqëndrimi për punë;
   1.4. i huaji punon për punëdhënësin, për të cilin nuk i është lëshuar lejeqëndrimi për punë;
   1.5. punëdhënësi apo i huaji nuk i respektojnë dispozitat nga marrëdhënia e punës, mbrojtjes dhe sigurisë në punë, të sigurimit shëndetësor dhe pensional, në bazë të cilave veprimtaria patjetër duhet të kryhet;
   1.6. punëdhënësi ka refuzuar të punësojë një punëkërkues të papunë, ofruar nga zyra e punësimit, i cili plotësonte kushtet e përcaktuara nga autoritetet shtetërore përgjegjëse, sipas dispozitave të këtij ligji;
   1.7. është lëshuar në bazë të të dhënave të pavërtetuara për punëtorin apo punëdhënësin;
   1.8. pagat e marra nga punëtorët kanë qenë nën nivelin e përcaktuar me aktet nënligjore të nxjerra nga Qeveria;
   1.9. punëdhënësi nuk ka shlyer detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve të detyrueshme;
   1.10. ka arsye të rëndësishme, që përbëjnë rrezik për rendin, sigurinë dhe

shëndetin publik të Republikës së Kosovës, me përjashtim të rasteve kur gjendja shëndetësore e të huajit nuk ka ndikim në punën, për të cilën ai rekrutohet;

1.11. i huaji largohet nga Republika e Kosovës për një periudhë më gjatë se gjashtë (6) muaj.

2. Revokimin e lejeqëndrimit për punë e bën DSHAM-i.
3. Kundër vendimit të DSHAM-it nga paragrafi 2. i këtij neni, mund të ushtrohet ankesë sipas nenit 44 paragrafi 2. të këtij ligji.

Neni 82
Qëndrimi në rast të ndërprerjes së kontratës

1. Të huajit, të cilit pa fajin e tij i është ndërprerë kontrata e punës ose kontrata tjetër përkatëse, ka të drejtë të qëndrojë në Republikën e Kosovës deri në skadimin e afatit të lejeqëndrimit për punë.
2. Në rast të ndërprerjes së kontratës së punës ose kontratës tjetër përkatëse, ndërprerjes së ekzistimit të kushteve të tjera, në bazë të cilave është lëshuar lejeqëndrimi për punë, punëdhënësi dhe i huaji janë të obliguar që ta lajmërojnë DSHAM-në, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e paraqitjes së atyre rrethanave.

Neni 83
E drejta në trajtim të barabartë

1. I huaji i cili punon në Republikën e Kosovës gëzon trajtim të barabartë sikurse shtetasit e Republikës së Kosovës në:
   1.1. kushtet e punës duke përfshirë pagën dhe largimin nga puna, si dhe sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës;
   1.2. të drejtat në asocim dhe afilijim dhe anëtarësim në një organizatë që përfaqëson punëtorët apo punëdhënësit ose në ndonjë organizatë tjetër, anëtarët e të cilës janë të përfshirë në një profesion specifik, duke përfshirë përfitimet që rrjedhin nga ato organizata duke mos paragjykuar dispozitat ligjore të Republikës së Kosovës që kanë të bëjnë me interesin publik dhe sigurinë shtetërore;
   1.3. arsimimin dhe trajnimin profesional;
   1.4. njohjen e diplomave, certifikatave dhe kualifikimeve tjera profesionale në përputhje me legjislacionin përkatës;
   1.5. dispozitat e legjislacionit përkatës lidhur me sigurimin social;
   1.6. qasjen në të mira dhe shërbime publike dhe furnizimi me këto të mira dhe shërbime që i ofrohen publikut duke përfshirë procedurat për sigurimin e banimit, po ashtu informimin dhe shërbimet e këshillimit që ofrohen nga zyrat e punësimit.
2. I huaji qoftë person fizik dhe juridik ka përgjegjësi dhe obligime të barabarta në punë si shtetasi i Republikës së Kosovës.

Neni 84
Qëndrimi i Përhershëm

1. Lejeqëndrimi i përhershëm mund t'i jepet të huajit i cili në kohën e parashtrimit të kërkesës posedon lejeqëndrim të përkohshëm pandërprerë prej pesë (5) viteve në Republikën e Kosovës.
2. Periudha e mungesës në territorin Republikës së Kosovës nuk e ndërpret llogaritjen e afatit sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse ajo është më e shkurtër se gjashtë (6) muaj pandërprerë dhe në tërësi nuk e kalon periudhën prej dhjetë (10) muaj.
3. Në kohën e marrjes së vendimit për lejeqëndrim të përhershëm duhet të jetë i vlefshëm qëndrimi i përkohshëm.

Neni 85
Llogaritja e kohës së nevojshme për lejeqëndrim të përhershëm

1. Si periudhë e nevojshme për dhënien e lejeqëndrimit të përhershëm sipas nenit 84 paragrafi 1. i këtij ligji, nuk do të llogaritet:
   1.1. lejeqëndrimi i lëshuar në bazë të punës së punëtorëve sezonal, emigrantëve ditor dhe ofruesit e shërbimeve në emër të një punëdhënësi të huaj dhe
   1.2. koha e kaluar gjatë vuajtjes së dënimit me burg.
2. Të huajit të cilit i është dhënë lejeqëndrimi i përkohshëm për qëllim të studimit, periudha e nevojshme për qëndrim nga neni 84 paragrafi 1. i këtij ligji, do të llogaritet vetëm gjysma e kohës së kaluar në bazë të lejeqëndrimit të përkohshëm për qëllime studimi.

Neni 86
Rrethanat e jashtëzakonshme për dhënien e lejeqëndrimit të përhershëm

1. Përjashtimisht nga neni 84 i këtij ligji, qëndrimi i përhershëm mund t'i jepet:
   1.1. i huaji i cili deri në ditën e parashtrimit të kërkesës ka së paku pesë (5) vite me status të refugjatit sipas Ligjit për Azil;
   1.2. të huajit i cili ka qëndruar në territorin e Republikës së Kosovës së paku pesë (5) vjet pa ndërprerë dhe i cili konsiderohet se ka lidhje të ngushta ekonomike dhe familjare me Republikën e Kosovës. Qëndrimi nga ky paragraf mund të dëshmohet me dokumente që dëshmojnë qëndrimin e tij të pandërprerë në territorin e Republikës së Kosovës dhe i cili plotëson kushtet sipas nenit 48 të këtij ligji;
   1.3. fëmija të cilit të dy prindërit në kohën e lindjes së tij iu është dhënë qëndrimi i përhershëm, ose një fëmijë që jeton me një prind vetushqyes i cili ka lejeqëndrimi të përhershme;
   1.4. personat të cilët lirohen nga shtetësia e Republikës së Kosovës.

Neni 87
Kushtet shtesë për dhënien e lejeqëndrimit të përhershëm

1. Lejeqëndrimi i përhershëm i jepet të huajit i cili i plotëson kushtet nga neni 84 i këtij ligji dhe duhet të:

1.1. posedojë dokument të udhëtimit për të huaj të vlefshëm;
1.2. posedojë mjete të mjaftueshme për jetesë;
1.3. posedojë sigurim shëndetësor;
1.4. ketë njohuri elementare të njërës prej gjuhëve zyrtare në shkrim dhe lexim në Republikën e Kosovës, njohja e kulturës dhe rregullimit shoqëror;
1.5. mos ketë kërcënim për sigurinë shtetërore, rendin publik ose shëndetin publik.

2. Të huajt nga neni 86 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1. dhe 1.3. të këtij ligji nuk kërkohet t'i plotësoj kushtet e parapara sipas paragrafit 1. nën-paragrafit 1.1. 1.2. dhe 1.3. të këtij neni.
3. Të huajit sipas nenit 86 paragrafit 1. nën-paragrafit 1.2. dhe 1.4. të këtij ligji nuk kërkohet t'i plotësojnë kushtet nga nën-paragrafi 1.4. të këtij neni.

Neni 88
Parashtrimi i kërkesës për lejeqëndrim të përhershëm

1. Kërkesa për lejeqëndrim të përhershëm parashtrohet në DSHAM.
2. Lidhur me kërkesën për lejeqëndrim të përhershëm vendos DSHAM-i, brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e parashtrimi të kërkesës.
3. Kundër vendimit nga paragrafi 2. i këtij neni, nuk lejohet ankesa, por mund të iniciohet konflikt administrativ në Gjykatën Themelore.

Neni 89
Ekzaminimi i gjuhës, kulturës dhe rregullimit shoqëror në Republikën e Kosovës

1. Provimin e njohurive të njërës nga gjuhët zyrtare dhe shkrimit në njërën nga gjuhët zyrtare mund ta kryejnë në institucionet e arsimit të lartë, shkollat e mesme dhe institucionet e arsimit të të rriturve të licencuara ose akredituara në Republikën e Kosovës.
2. Njohja e kulturës dhe organizimi shoqëror i Republikës së Kosovës mund të vërtetohet me plotësimin e pyetësorit në procesin e miratimit të qëndrimit të përhershëm.
3. Dispozitat nga paragrafi 1. i këtij neni nuk vlejnë për:
   3.1. fëmijët parashkollor;
   3.2. pjesëmarrës, ose personat që kanë përfunduar arsimin fillor, të mesëm apo të lartë në Republikën e Kosovës;
   3.3. personat më të vjetër se gjashtëdhjetepesë (65) vjet, nëse ata nuk janë të punësuar.
4. I huaj i cili me plotësimin e një pyetësori në mënyrë të pavarur nga paragrafi 2. i këtij neni, ka demonstruar njohuri të kulturës dhe të organizimit shoqëror në Republikën e Kosovës, nuk duhet të jap provimin në ndonjërën nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
5. I huaj i cili nuk është i aftë në gjuhën dhe në shkrimin zyrtar, është i detyruar të ndjekë një kurs të ndonjërës nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës të paktën njëqindepesëdhjetë (150) orë.
6. Shpenzimet e provimit sipas paragrafit 1. të këtij neni dhe marrjen pjesë në kurset e ndonjërës nga gjuhët zyrtare nga paragrafi 5. i këtij neni, do t'i bartë vetë i huaji.

Neni 90
Të drejtat e të huajve me lejeqëndrim të përhershëm

1. I huaji me qëndrim të përhershëm ka të drejtë në:
   1.1. punësim dhe vetë-punësim;
   1.2. aftësim profesional;
   1.3. arsimim dhe bursa studentore;
   1.4. mirëqenie sociale, të drejta për pension dhe sigurim shëndetësor;
   1.5. qasje në të mira dhe shërbime si dhe ofrimi i të mirave dhe shërbimeve;
   1.6. të drejta në asocim dhe afilijim apo anëtarësim në një organizatë që përfaqëson punëtorët apo punëdhënësit ose në ndonjë organizatë tjetër anëtarët e të cilës janë të përfshirë në një profesion specifik, duke përfshirë përfitimet që rrjedhin nga ato organizata.
2. I huaji do të ushtrojë të drejtat e tij të parapara në paragrafin 1. të këtij neni, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 91
Revokimi i lejeqëndrimit të përhershëm

1. Lejeqëndrimi i përhershëm i revokohet të huajit nëse:
   1.1. ka ndalesë për hyrje dhe qëndrim në Republikën e Kosovës;
   1.2. qëndron jashtë Republikës së Kosovës pa ndërprerë më shumë se një (1) vit;
   1.3. konstatohet se me vetëdije ka dhënë informacion të rremë ose i ka fshehur me vetëdije qëllimet dhe rrethanat që ishin me rëndësi për qëndrim të përhershëm;
   1.4. paraqet rrezik për rendin publik, sigurinë shtetërore apo shëndetin publik;
   1.5. nëse këtë e bën me kërkesën e tij.
2. Vendimi për revokimin e qëndrimit të përhershëm e nxjerr DSHAM.
3. Vendimi për revokimin e leje qëndrimit të përhershëm mund të lëshohet pa dëgjimin e të huajit.
4. Kundër vendimit për revokimin e lejeqëndrimit të përhershëm nuk lejohet ankesa, por mund të iniciohet konflikt administrativ në Gjykatën Themelore.

KREU V
QËNDRIMI I PALIGJSHËM, KTHIMI DHE DËBIMI I TË HUAJVE

Neni 92
Mos-kthimi, interesi me i mirë i fëmijës, jeta familjare dhe gjendja shëndetësore

1. Republika e Kosovës nuk duhet ta dëboj ose kthej refugjatin në asnjë mënyrë në kufijtë e territoreve, ku do të kërcënohet jeta apo liria e tij për arsye të racës, religjionit, përkatësisë kombëtare, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo bindjeve të tij politike.
2. Përfitimet nga paragrafi 1. i këtij neni, nuk do të mund të kërkohen nga një refugjat për të cilin ka arsye të forta të mendohet se ai paraqet rrezik për sigurinë e Republikës së Kosovës apo i cili duke qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për një krim veçanërisht të rëndë, paraqet rrezik për sigurinë e Republikës së Kosovës.

3. Me rastin e vendosjes për kthimin ose largimin e të huajit nga Republika e Kosovës, do të merren parasysh rrethanat e mëposhtme:
   3.1. interesi me i mirë i fëmijës;
   3.2. jeta familjare;
   3.3. gjendja shëndetësore e të huajit në fjalë; dhe
   3.4. parimi i mos-kthimit.

Neni 93
Qëndrimi i paligjshëm

1. Konsiderohet se i huaji qëndron në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikën e Kosovës atëherë kur:
   1.1. nuk posedon vizë të vlefshme kur kërkohet për hyrje dhe qëndrim në Republikën e Kosovës;
   1.2. ka hyrë në territorin e Republikës së Kosovës në mënyrë të kundërligjshme;
   1.3. nuk ka leje qëndrimi të vlefshme ose i është anuluar ose revokuar lejeqëndrimi;
   1.4. iu ka refuzuar kërkesa për azil, mbrojtje plotësuese ose të përkohshme dhe nuk i plotëson më kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të parapara me këtë ligj;
   1.5. gjendet duke punuar në kundërshtim me kushtet e parapara me këtë ligj ose ligjet tjera në fuqi.
2. I huaji i cili qëndron në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Kosovës duhet që menjëherë ta lëshoj territorin e Republikës së Kosovës, përveç të huajit i cili ka aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare dhe është në pritje të vendimit për statusin e tij/saj.

Neni 94
Urdhri i largimit dhe afati i ekzekutimit

1. DSHAM nxjerr urdhrin e largimit për të huajt që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Kosovës ose kur i huaji ka vuajtur një dënim të dhënë nga gjykatat kompetente për një vepër penale, për të cilën Kodi Penal i Republikës së Kosovës parashikon një dënim minimal një (1) vjet me burgim.
2. Urdhër largimi, sipas paragrafit 1. të këtij neni, lëshohet në formë vendimi dhe përmban të dhënat personale të të huajit i cili është subjekt largimi, shkakun e urdhrit të largimit nga territori, afatin brenda të cilit i huaji duhet të largohet nga territori i Republikës së Kosovës, pikën e kalimit kufitar nga duhet të kalojë, si dhe afatin e ndalimit të hyrjes në Republikën e Kosovës, nëse largimi i të huajit shoqërohet me një masë të tillë ndaluese.
3. Afati i ndalimit të hyrjes sipas paragrafit 2. të këtij neni, nuk mund të jetë më i shkurtër se një (1) muaj dhe as më i gjatë se pesë (5) vjet.
4. Afati për ekzekutimin vullnetar të urdhrit të largimit është jo më pak se shtatë (7) ditë dhe jo më gjatë se tridhjetë (30) ditë nga data e njoftimit.
5. Urdhri i largimit për kategoritë e ndryshme të të huajve me qëndrim të paligjshëm zbatohet si në vijim:

5.1. për të huajin, i cili ka hyrë në mënyrë të paligjshme në territorin Republikës së Kosovës, apo nuk plotëson, ose nuk plotëson më kushtet e hyrjes dhe qëndrimit në Republikën e Kosovës sipas kushteve të parapara me këtë ligj, ose kapet duke punuar në mënyrë të paligjshme, jo më gjatë se dhjetë (10) ditë nga data e njoftimit;

5.2. për të huajin, të cilit i është anuluar ose revokuar viza, ose i është refuzuar përtëritja e lejes së qëndrimit ose i është anuluar apo revokuar leja e qëndrimit jo më shumë se tridhjetë (30) ditë nga data e njoftimit.

6. Ekzekutimi vullnetar i urdhrit të largimit mund të shtyhet për një periudhë të përshtatshme jo më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë, duke marrë në konsideratë rrethanat specifike të çdo rasti të veçantë, për kategoritë e mëposhtme:

6.1. fëmijët të cilët ndjekin procesin mësimor dhe afati i përfundimit të vitit shkollor është më pak se tre (3) muaj deri në përfundimin e vitit shkollor të fëmijës/ve;

6.2. të huajit, që ka një detyrim financiar dhe duhet të likuidojë një investim tre (3) muaj nga data e njoftimit;

6.3. të huaj me probleme shëndetësore, deri në aftësimin shëndetësor të tyre për të udhëtuar apo të përfundimit të qëndrimit në izolim sipas një vendimi të autoriteteve të shëndetit publik.

7. I huaji me qëndrim të kundërligjshëm të cilit i është miratuar kohëzgjatja e afatit të zbatimit vullnetar të urdhrit të largimit, çdo dhjetë (10) ditë, duhet të paraqiten pranë Policisë Kufitare.

8. Të huajve të cilëve iu është miratuar zgjatja e periudhës së zbatimit të urdhrit vullnetar të largimit kanë të drejtë:

8.1. të qëndrojnë së bashku me familjarët e tyre të cilët janë prezent në territorin e Republikës së Kosovës;

8.2. të shfrytëzojnë shërbimet e emergjencës mjekësore, trajtimet për sëmundje specifike, si dhe shërbimet e shëndetit publik;

8.3. të miturit të kenë qasje të garantuar në sistemin arsimor bazuar në periudhën e tyre të qëndrimit;

8.4. për shërbime të veçanta për personat me aftësi të kufizuara.

9. Në kohën e zbatimit të largimit të të huajit nga territori i Republikës së Kosovës duhet të merret në konsideratë interesi më i mirë i fëmijës, personave të ndjeshëm, jeta familjare si dhe gjendja shëndetësore e të huajit që është subjekt i largimit nga territori.

10. Të huajit i komunikohet në formë të shkruar urdhri për largim, në njërën nga gjuhët zyrtare dhe në gjuhën angleze. Urdhër largimi duhet të përmbaj edhe këshillën juridike për ankesë dhe procedurën e ankimimit. Forma e urdhër largimit përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga MPB-ja.

Neni 95
Ankesa kundër urdhër largimit

1. I huaji i cili është subjekt i urdhër largimit, ka të drejtë ankese, brenda tetë (8) ditëve nga dita e marrjes së urdhër largimit pranë Komisionit për Ankesa. Komisioni duhet ta zgjidh çështjen brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të ankesës.

2. Në rastet kur i huaji është i pakënaqur me vendimin e komisionit të ankesave, atëherë ai mund të hap konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore, brenda tetë (8) ditëve nga marrja e vendimit. Gjykata duhet të zgjidh çështjen nga ky paragraf brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e pranimit të padisë.
3. Ankesa kundër urdhër largimit nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit.

Neni 96
Zbatimi vullnetar i urdhër largimit

1. Zbatimi vullnetar i urdhër largimit nga i huaji bëhet në rastet kur i huaji deklaron se do të largohet vullnetarisht nga territori i Republikës së Kosovës. Deklarimi i largimit vullnetar i të huajit merret parasysh kur vendoset për kohëzgjatjen e masës së ndalimit të hyrjes, përjashtuar rastet kur për interesa të rendit dhe sigurisë publike ky deklarim nuk mund të merret në konsideratë.
2. Gjatë zbatimit vullnetar të urdhër largimit i jepet përparësi kthimit si me poshtë:
   2.1. i huaji i gjetur duke qëndruar në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Kosovës por që nuk ka sjellë pasoja të dëmshme për rendin dhe sigurinë publike dhe që deklaron se do të largohet vullnetarisht nga territori i Republikës së Kosovës;
   2.2. fëmijës së pashoqëruar;
   2.3. personat e sëmurë, invalid ose me aftësi të kufizuara;
   2.4. prindërit me fëmijë të vegjël;
   2.5. viktimat e trafikimit me njerëz, që duan të kthehen në vendin e tyre të origjinës;
   2.6. azilkërkuesit, të cilëve iu është refuzuar kërkesa për azil ose që kanë tërhequr kërkesën për azil dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për kthim;
   2.7. të huajin e pajisur me dokumente të rregullta udhëtimi, por që nuk ka mjete financiare të nevojshme për qëndrim;
   2.8. i huaji i cili është gjetur duke punuar në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 97
Largimi me forcë nga Republika e Kosovës

1. Largimi me forcë i të huajit nga territori i Republikës së Kosovës bëhet nga Policia Kufitare atëherë kur i huaji:
   1.1. ka hyrë në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Kosovës dhe ekziston dyshimi i bazuar se do të përdorë territorin e saj për të kaluar ilegalisht drejt vendeve të tjera;
   1.2. nuk është larguar nga Republika e Kosovës brenda afateve kohore, të përcaktuara në urdhrin e largimit pa ndonjë arsye objektive, apo pas largimit nga territori dhe brenda afateve të ndalimit të hyrjes, ri-hyn në territorin e Republikës së Kosovës;
   1.3. nuk e ka lëshuar territorin e Republikës së Kosovës deri në gjashtëdhjetë (60) ditë pas përfundimit të afatit të vizës, të lejes së qëndrimit, ose afatit të qëndrimit të parashikuar në këtë ligj për të huajt që hyjnë pa vizë;
   1.4. është ripranuar nga një vend tjetër në kuadër të Marrëveshjeve të Ripranimit

në fuqi në Republikën e Kosovës;

1.5. është dënuar për një vepër penale për të cilën legjislacioni i Republikës së Kosovës parashikon një dënim minimal një (1) vit heqje lirie.

2. Në rast se i huaji bëhet subjekt i largimit me forcë sipas këtij neni, ai mbahet i ndaluar në Qendër të Mbajtjes, derisa të ekzekutohet urdhri i largimit me forcë. Në rast të gjetjes së mundësive të tjera alternative, të zbatimit të masave të përkohshme siç përcaktohen me këtë ligj, këto të fundit kanë prioritet ndaj ndalimit.
3. I huaji, i cili nuk disponon një dokument udhëtimi duhet të paraqitet vetë ose i shoqëruar nga autoritetet kompetente, pranë përfaqësive diplomatike dhe konsullore të akredituara në Republikën e Kosovës, për t'u pajisur me një dokument të tillë.
4. Nëse në Republikën e Kosovës nuk ka përfaqësi diplomatike dhe konsullore të vendit të shtetasit të huaj, autoriteti përgjegjës në kuadër të MPB-së kërkon pajisjen me dokument udhëtimi në vendin e origjinës ose në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të vendit të shtetasit të huaj në ndonjë vend tjetër, nëpërmjet Drejtorisë Konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme.
5. Në rast se përfaqësia diplomatike nuk mund të lëshojë dokument udhëtimi, MPB – ja e pajisë të huajin me dokument standard udhëtimi të përcaktuar me marrëveshje ripranimi, i cili ka për qëllim zbatimin e largimit me forcë të të huajit.
6. Në zbatim të këtij ligji, MPB-ja mund t'i lëshoj fletudhëtim të huajit, nëse i huaji nuk pajiset me dokument udhëtimi, sipas nenit 7 të këtij ligji.
7. MPB në bazë të marrëveshjeve në fuqi në Republikën së Kosovës mund të bashkëpunoj me vende të tjera në procedurën e kthimit, apo kthimeve të përbashkëta të të huajve.
8. Të huajit i komunikohet në formë të shkruar, në njërën nga gjuhët zyrtare dhe në gjuhën angleze, se ndaj tij do të ekzekutohet masa administrative e largimit me forcë, duke i shpjeguar arsyet e nxjerrjes së urdhrit, datën dhe vendin ku do të ekzekutohet, mënyrën e transportimit të tij për në vendin e destinacionit dhe afatin e ndalimit të hyrjes. Forma dhe procedura e urdhër largimit me forcë përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga MPB-ja.

Neni 98
Ankesa ndaj urdhrit të largimit me forcë

1. I huaji ka të drejtë ankese brenda tetë (8) ditëve, pas pranimit të urdhër largimit me forcë të Komisioni i Ankesave. Komisioni duhet ta zgjidh çështjen brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të ankesës. Ankesa kundër vendimit lidhur me urdhrin e largimit me forcë, nuk e pezullon ekzekutimin e urdhër largimit me forcë.
2. Në rastet kur i huaji është i pakënaqur me vendimin e Komisionit të ankesave atëherë ai mundet të hap konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore, brenda tetë (8) ditëve nga marrja e vendimit. Gjykata duhet të zgjidh çështjen nga ky paragraf brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e pranimit të padisë.

Neni 99
Procedurat e zbatimit të urdhrit të dëbimit

1. Urdhri i dëbimit jepet nga DSHAM dhe zbatohet nga Policia Kufitare, e cila:
   1.1. merr masa për ndalimin e të huajit në Qendrën e Mbajtjes, ose zbatimin e masave të përkohshme të përcaktuara në këtë ligj, derisa të zbatohet urdhër dëbimi;
   1.2. merr shenjat e gishtërinjve dhe të pëllëmbës së dorës të të huajit, fotografinë dhe shenjat biometrike;
   1.3. regjistron urdhrin për dëbim në bazat përkatëse të të dhënave, ku shënohet periudha e ndalimit të hyrjes në Republikën e Kosovës dhe pikën e kalimit kufitar të largimit të të huajit;
   1.4. inicion pranë institucioneve përgjegjëse marrjen e masave të parapara për pajisje me fletudhëtim, sigurimin e kthimit në vendin e origjinës dhe biletën e udhëtimit.
2. Urdhri i dëbimit zbatohet menjëherë, në rast se prania e të huajit përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë shtetërore.
3. Në rast se as i huaji e as ftuesi nuk kanë mundësi financiare për të përballuar shpenzimet e kthimit të të huajit në vendin e destinacionit, shpenzimet e udhëtimit do të jepen si hua në paradhënie nga MPB-ja dhe do të kthehen nga ftuesi në rast se i huaji kërkon të vij në Republikën e Kosovës pas përfundimit të afatit të ndalimit të hyrjes ose nga punëdhënësi i tij i ardhshëm.

Neni 100
Kategoria e të huajve që nuk dëbohen

1. I huaji nuk dëbohet nëse i plotëson njërën nga kushtet e mëposhtme:
   1.1. është i pajisur me leje qëndrim të përhershëm;
   1.2. ka lindur në Republikën e Kosovës;
   1.3. ka hyrë në Republikën e Kosovës si fëmijë i pashoqëruar dhe është pajisur me leje qëndrim të përhershëm;
   1.4. është i pajisur me leje të përkohshme qëndrimi dhe është martuar me një të huaj, i cili ka leje të përhershme qëndrimi ose me një shtetas të Kosovës;
   1.5. ekziston dyshimi i bazuar se i huaji, në vendin e origjinës apo në një vend tjetër, do të dënohet me vdekje, do t'i nënshtrohet torturës, trajtimit çnjerëzor e degradues apo dënimeve për shkaqe diskriminuese;
   1.6. fëmija i pashoqëruar, nëse nga vendi i origjinës, një vend tjetër ose nga institucione të tjera nuk garantohet ribashkimi familjar ose kujdesi i duhur shëndetësor;
   1.7. është anëtar i familjes së të huajit, të cilit i njihet statusi i refugjatit në Republikën e Kosovës.
2. Përjashtimisht, i huaji mund të dëbohet, edhe pse përmbushen kushtet e përmendura në paragrafin 1. të këtij neni, në qoftë se qëndrimi i tij rrezikon rendin dhe sigurinë publike, si dhe përbën kërcënim për sigurinë shtetërore.

Neni 101
Ankesa ndaj urdhër dëbimit

1. Ndaj urdhër dëbimit i huaji ka të drejtë të ankohet në Gjykatën Themelore, brenda tetë (8) ditëve nga data e marrjes së vendimit.
2. Vendimi i Gjykatës Themelore mund të ankimohet në Gjykatën e Apelit brenda tetë (8) ditëve, e cila e shqyrton çështjen me përparësi.

Neni 102
Ekzekutimi i masave të përkohshme

1. Masat e përkohshme ndërmerren nga Policia Kufitare për të përgatitur apo siguruar zbatimin e një urdhri për largimin e të huajit nga territori ose për të mbikëqyrë largimin e tij.
2. Masat e përkohshme ndërmerren si masa alternative të ndalimit në Qendër të Mbajtjes së të Huajve që janë subjekt i largimit me forcë, bazuar në shqyrtimin rast pas rasti, pa ndikuar në garantimin e ekzekutimit të urdhrit të largimit me forcë.
3. Masat e përkohshme mund të merren menjëherë pas nxjerrjes së urdhër largimit me forcë, por mund të zëvendësojnë nëse është e nevojshme, masën e ndalimit në Qendër të Mbajtjes pasi ajo është nxjerrë dhe është zbatuar.
4. Kriteret, procedurat dhe forma e urdhër dëbimit do të përcaktohen me akt nënligjor të nxjerr nga MPB.

Neni 103
Detyrimi për tu paraqitur pranë autoriteteve publike

1. I huaji mund të detyrohet të paraqitet në periudha të rregullta kohore pranë Policisë Kufitare kur:
   1.1. ndaj tij është nxjerrë një urdhër largimi nga territori dhe kërkohet siguri për zbatimin e këtij urdhri apo nevojitet të mbikëqyret largimi i të huajit nga territori;
   1.2. i huaji para largimit ka pasur një adresë të saktë dhe të njohur nga Policia Kufitare dhe nuk ka të dhëna se i huaji mund t'i shmanget zbatimit të largimit dhe nuk i ka respektuar afatet e largimit vullnetar;
   1.3. vlerësohet interesi më i mirë i familjes së të huajit.
2. I huaji i cili detyrohet të paraqitet pranë Policisë Kufitare, duhet të informohet për arsyet e këtij detyrimi.
3. Detyrimi për tu paraqitur mbetet në fuqi deri kur i huaji i përmbush kërkesat për largimin nga territori, apo kur shqyrtimi i çështjes ka përfunduar ndryshe. Detyrimi për tu paraqitur do të marrë fund menjëherë kur nuk është më e nevojshme për të kërkuar zbatimin e një mase të tillë.

Neni 104
Sekuestrimi i biletës ose i dokumentit të udhëtimit

1. Në rast se i huaji është subjekt i një urdhri largimi me forcë ose dëbimi, Policia Kufitare mund të sekuestrojë biletën e udhëtimit dhe të dokumentit të udhëtimit,

për garantimin e kthimit. Procedurat e sekuestrimit do të përcaktohen me akt nënligjor nga MPB-ja.

2. Policia Kufitare sekuestron dokumentet e udhëtimit të të huajit deri kur vendimi, nga një procedurë administrative, merr formë të prerë ose deri kur të paguhet gjoba, apo deri në përfundimin e afatit të vendosur nga gjykata apo nga prokuroria.
3. Gjatë kohës së sekuestrimit të dokumenteve të udhëtimit, të huajit i lëshohet një vërtetim.

Neni 105
Sekuestrimi i mjeteve financiare ose vendosja e garancisë

1. Policia Kufitare i sekuestron të huajit mjetet financiare nëse posedon, deri në shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet e kthimit të tij. Pjesa e mbetur nga garancia financiare i kthehet të huajit menjëherë.
2. Në vend të masave të tjera të përkohshme, ose paralelisht, sipas vlerësimit rast pas rasti, Policia Kufitare mund t'i kërkoj të huajit të vendos një garancion financiar me anë të cilit garanton kthimin e tij.
3. Garancia financiare i kthehet të huajit menjëherë kur kjo vlerësohet se nuk është më e nevojshme ose kur realizohet kthimi i të huajit.

Neni 106
Qëndrimi i detyrueshëm në një territor të caktuar

1. Policia Kufitare vendos kufizimin e lirisë së lëvizjes të të huajve, duke e urdhëruar atë të qëndrojë në një territor të caktuar, në rastin kur:
   1.1. rikthimi, ose dëbimi nuk mund të urdhërohet apo zbatohet, për arsye objektive ose për shkak të një detyrimi të marrë përsipër nga Republika e Kosovës në kuadër të një marrëveshjeje ndërkombëtare në fuqi;
   1.2. ka një leje qëndrimi për arsye humanitare;
   1.3. ka përfunduar afati i ndalimit në Qendër të Mbajtjes dhe nuk është i mundur largimi i të huajit ose për arsye humanitare i huaji nuk mund të mbahet i ndaluar në Qendër të Mbajtjes;
   1.4. në rastet kur autoritetet e shëndetit publik, në bazë të një vlerësimi dhe sipas Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit, rekomandojnë izolimin e personit apo personave për një periudhë kohore të vlefshme për izolimin e sëmundjes së dyshuar.
2. I huaji ka të drejtë të parashtroj padi në Gjykatën Themelore kundër urdhrit për qëndrim në një territor të caktuar, njëjtë si ndaj urdhrit të ndalimit të të huajit në Qendrën e Mbajtjes.
3. Policia Kufitare në urdhrin për qëndrim në një territor të caktuar, përcakton rregullat e përgjithshme të qëndrimit, vendin dhe kohëzgjatjen e qëndrimit, si dhe njofton të huajin të paraqitet pranë autoriteteve kompetente policore për çdo muaj. Forma e urdhrit të qëndrimit të detyrueshëm në një territor të caktuar përcaktohet me akt nënligjor nga MPB-ja.

Neni 107
Qendra e Mbajtjes

1. Qendra e Mbajtjes duhet të ketë nivel të caktuar të sigurisë dhe kufizim të lirisë, në të cilin mund të mbahen vetëm të huajt të cilët janë subjekt i largimit me forcë apo dëbimi nga territori i Republikës së Kosovës.
2. Qendra e Mbajtjes duhet të plotësojë të gjitha kushtet e një trajtimi njerëzor si dhe respektimin e të drejtave njerëzore të garantuara me Kushtetutën e Kosovës dhe të mundësojë ofrimin e shërbimeve shëndetësore.
3. DSHAM-i në rast të ndalimit të një të huaji në Qendër të Mbajtjes me kërkesën e këtij të fundit, merr masa të menjëhershme për kujdesin ndaj anëtarëve të familjes së të huajit të ndaluar, të cilët kanë mbetur pa mbikëqyrje.
4. Qendra e Mbajtjes është pjesë e strukturës organizative të MPB-së.

Neni 108
Ndalimi në Qendër të Mbajtjes

1. Ndalimi në Qendrën e Mbajtjes është masë e fundit administrative, që nxjerrët dhe ekzekutohet nga Policia Kufitare, ndaj të huajit, për të cilin është nxjerrë një urdhër largimi me forcë apo dëbimi, në bazë të vlerësimit rast pas rasti, kur janë zbatuar të gjitha masat e mundshme alternative apo kur nga vlerësimi konsiderohet se këto masa nuk mund të zbatohen për të huajin, ose për të huajin e i cili është në procedurë të ripranimit në bazë të marrëveshjeve të ripranimit në fuqi.
2. I huaji qëndron i ndaluar në Qendër të Mbajtjes, në afate sa më të shkurtra kohore, derisa të kryhen procedurat ligjore, për të mundësuar largimin e tij nga Republika e Kosovës, brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj.
3. Policia Kufitare mund të ndalojë të huajin në Qendër të Mbajtjes, për arsye të sigurisë publike, vërtetim të identitetit apo arsye tjera.
4. I huaji njoftohet në formë të shkruar, në njërën nga gjuhët zyrtare dhe në gjuhën angleze, për ndalimin në Qendër të Mbajtjes, i cili përmban arsyen e ndalimit, afatet e ndalimit, të drejtën të sigurojë mbrojtjen ligjore të tij, si dhe të kontaktoj me të afërmit e vet.

Neni 109
Ankesa ndaj urdhrit të ndalimit

1. I huaji, ka të drejtë të parashtrojë padi kundër urdhrit për ndalim, në Gjykatën Themelore, brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të urdhrit për ndalimin ose zgjatjen e ndalimit.
2. Padia ndaj vendimit të Gjykatës Themelore bëhet në Gjykatën e Apelit sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 110
Koha e ndalimit në Qendrën e Mbajtjes

1. I huaji ndalohet në Qendër të Mbajtjes për një periudhë maksimale deri në gjashtë (6) muaj.

2. Policia Kufitare në konsultim me DSHAM-in mund të zgjatë periudhën e ndalimit në Qendër të të huajit deri në gjashtë (6) muaj të tjerë, nëse brenda periudhës gjashtë (6) mujore të ndalimit, largimi i të huajit ka qenë i pamundur në rastet kur:
   2.1. i huaji refuzon të japë të dhëna apo informacione personale si dhe dokumente udhëtimi të nevojshme për kthimin e tij ose paraqet informacione të rreme;
   2.2. i huaji ka penguar kthimin e tij në forma të ndryshme;
   2.3. ka vonesa në lëshimin e dokumentit të udhëtimit apo ndonjë dokumenti tjetër të nevojshëm për kthim.
3. Shtyrja e afatit të qëndrimit në Qendrën për Mbajtje bëhet së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë përpara mbarimit të afatit gjashtë (6) mujor të ndalimit në qendër.
4. Gjatë kohës së ndalimit në Qendrën e Mbajtjes, Policia Kufitare në konsultim me DSHAM-in shqyrton ekzistencën e kushteve për të mbajtur të mbyllur në qendër të huajin e ndaluar. Në varësi të vlerësimit të rrethanave, Policia Kufitare mund të vendos për zëvendësimin e masës së ndalimit në qendër me masa tjera të përshtatshme të përcaktuara me këtë ligj.
5. Në rast se i huaji kryen një vepër penale gjatë kohës së qëndrimit në Qendrën e Mbajtjes, ndaj tij fillon ndjekja penale, sipas dispozitave të legjislacionit penal në fuqi.

Neni 111
Përfundimi i mbajtjes në Qendrën e Mbajtjes

1. Mbajtja e të huajit në Qendrën e Mbajtjes përfundon në rastet si me poshtë:
   1.1. me largimin e të huajit;
   1.2. me përfundimin e periudhës së mbajtjes të përcaktuar në urdhrin e ndalimit;
   1.3. nëse qëndrimi i të huajit bëhet i paligjshëm;
   1.4. me anulimin e vendimit të ndalimit në Qendrën e Mbajtjes;
   1.5. me zëvendësimin e masës së ndalimit në Qendrën e Mbajtjes me një masë tjetër të përkohshme të përcaktuar në këtë ligj;
   1.6. me lirimin nga qendra.
2. I huaji lirohet nga Qendra e Mbajtjes në raste kur:
   2.1. në bazë të rrethanave largimi i të huajit nuk mund të bëhet me forcë;
   2.2. gjykata urdhëron lirimin e tij nga Qendra e Mbajtjes.

Neni 112
Ndalimi i fëmijëve të pashoqëruar

1. Përjashtimisht, fëmija i pashoqëruar, ndaj të cilit është nxjerrë një urdhër ndalimi, mbahet në një qendër sociale shtetërore ose në një qendër tjetër në kuadër të bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare, që kryejnë misione për fëmijët, viktimat e trafikimit ose kategori të tjera individësh në nevojë.
2. Fëmija mund të mbahet në Qendër të Mbajtjes, vetëm në rast të interesit më të mirë të tij apo të familjes, në ambiente të posaçme të ndara nga ato për të rritur.
3. Para se një fëmijë të ndalohet në Qendër të Mbajtjes, kërkohet mendimi i një punonjësi social apo psikologu.

Neni 113
Njoftimi i përfaqësuesit diplomatik

1. Me kërkesën e të huajit, ose kur është përcaktuar me marrëveshje dypalëshe, Ministria e Punëve të Jashtme e njofton menjëherë përfaqësuesin diplomatik apo konsullor të vendit të të huajit në Republikën e Kosovës për ndalimin e të huajit në Qendrën e Mbajtjes, si dhe për zgjatjen e periudhës së ndalimit.
2. Në rast se i huaji ka kërkuar azil ose gëzon statusin e refugjatit apo të një mbrojtjeje tjetër në Republikën e Kosovës, informacioni nga paragrafi 1. i këtij neni nuk i bëhet i ditur përfaqësuesit diplomatik apo konsullor të vendit të tij.

Neni 114
Të drejtat e të huajit në Qendrën e Mbajtjes

1. I huaji, i cili qëndron në Qendrën e Mbajtjes, informohet kur është e mundur në gjuhën e tij ose së paku në gjuhën angleze me çdo veprim, i cili ndërmerret nga autoritetet kompetente për mbajtjen e tij në qendër.
2. I huaji gëzon të drejtën për një trajtim njerëzor, ushqim të mjaftueshëm, ndihmë juridike në çdo çast dhe përkujdesje shëndetësore.
3. I huaji gëzon të drejtën për të informuar përfaqësuesin diplomatik apo konsullor për ndalimin e tij. I huaji ka të drejtë të ankohet në Gjykatën Themelore për shkeljen e të drejtave të tij themelore në Qendrën e Mbajtjes.
4. Në rast se i huaji i nënshtrohet procedurës së ripranimit, ai informohet për të drejtat dhe detyrimet, që i ka në bazë të legjislacionit në fuqi, kur është e mundur në gjuhën që ai e kupton, apo së paku në gjuhën angleze.

Neni 115
Kompensimi i shpenzimeve të largimit apo kthimit me forcë

1. I huaji ngarkohet me shpenzimet e akomodimit në Qendrën e Mbajtjes dhe me shpenzimet tjera të shkaktuara gjatë largimit të tij apo kthimit me forcë.
2. Të gjitha mjetet financiare që i merren të huajit që është subjekt largimi apo kthimi me forcë bëhen kundrejt lëshimit të një vërtetimi.
3. Mjetet financiare që i merren të huajit përdoren vetëm për të mbuluar shpenzimet e përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni.
4. Nëse i huaji nuk ka mjete për mbulimin e shpenzimeve sipas paragrafit 1 të këtij neni, shpenzimet i ngarkohen personit fizik ose juridik, i cili ka mundësuar hyrjen ose qëndrimin, apo transitin e paligjshëm të të huajit në territorin e Republikës së Kosovës, ose personit fizik apo juridik i cili ka marrë përsipër mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit dhe kthimit të të huajit në dhe nga territori i Republikës së Kosovës, transportuesit dhe punëdhënësit i cili ka punësuar një të huaj në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.
5. Sekuestrimi i mjeteve financiare sipas këtij neni bëhet nga Policia Kufitare për mbulimin e shpenzimeve.

KREU VI
MBIKËQYRJA DHE KONTROLLI

Neni 116
Mbikëqyrja dhe kontrolli i të huajve

1. Policia Kufitare, në ushtrim të detyrave të parashikuara në ligj:
   1.1. mbikëqyrë zbatimin e rregullave të hyrjes dhe qëndrimit të të huajve të paraparë me këtë ligj;
   1.2. kryen kontroll dhe hyn në mjedise private, ku qëndron i huaji, në rast se ekzistojnë dyshime të bazuara, në përputhje me rregullat dhe kushtet e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale;
   1.3. kërkon dokumentet e udhëtimit, lejen e qëndrimit ose dokumentin e identifikimit;
   1.4. shoqëron të huajin, i cili nuk disponon dokument identifikimi, leje qëndrimi, dokument udhëtimi ose ndonjë dokument tjetër, që dëshmon identitetin e tij;
   1.5. shoqëron të huajin, për të cilin ka një urdhër largimi, largimi me forcë ose dëbimi, për në pikën e kalimit kufitar, apo në vendin e origjinës;
   1.6. transporton të huajin e ndaluar, kur është e nevojshme, në institucionin shëndetësor, për të marrë trajtim mjekësor, ose për arsye të shëndetit publik për të siguruar izolimin e tij;
   1.7. shoqëron dhe merr masa për kthimin e të huajve me qëndrim të paligjshëm në vendin e origjinës apo vendin transit të cilin i huaji e ka përdorur për të hyrë në Republikën e Kosovës;
   1.8. merr masa që i huaji i ndaluar të paraqitet pranë gjykatës;
   1.9. shoqëron të huajin në përfaqësinë diplomatike ose konsullore, me qëllim të zhvillimit të intervistës së kërkuar, për të siguruar dokumentet e udhëtimit dhe e kthen atë në institucionin ku zbatohet ndalimi;
   1.10. bashkëpunon me organet tjera për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë nga të huajt gjatë hyrjes dhe qëndrimit të tyre në territorin e Republikës së Kosovës;
   1.11. vendos gjoba ndaj të huajit dhe merr masa për ekzekutimin e tyre për të gjitha rastet e parapara me këtë ligj.
2. Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji sa i përket kushteve të punës, mbrojtjes në punë, ambientit të punës si dhe të drejtave tjera të punësuarve të huaj, i kryen Inspektorati i Punës sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 117
Detyrimi i të huajit për dëshmimin e identitetit të tij/saj

1. I huaji e dëshmon identitetin e tij me anë të një:
   1.1. dokumenti të udhëtimit;
   1.2. dokumenti të identitetit personal për të huaj;
   1.3. dokumenti tjetër zyrtar që përmban fotografi dhe në bazë të së cilës është e mundur të përcaktohet identiteti i tij/saj.

2. I huaji është i detyruar të mbaj dokumentin me anë të të cilit e dëshmon identitetin e tij dhe t'a paraqes atë në rast se i kërkohet nga një person zyrtar përgjegjës për kontrollin e tyre.
3. I huaji është i detyruar të paraqes dokumentin e tij të udhëtimit gjatë kalimit të kufirit kur kjo i kërkohet nga një person zyrtar.
4. I huaji i cili nuk disponon një dokument identifikimi është i detyruar të paraqes të dhënat e tij personale të sakta një zyrtar përgjegjës për kontrollin e të huajve në territor.
5. I huaji nuk mund t'u jep të tjerëve në përdorim dokumentet e tij/saj të udhëtimit, si dhe ndalohet përdorimi i dokumenteve të identifikimit të falsifikuara apo dokumentet e udhëtimit të personit tjetër.

Neni 118
Detyrimi i punëdhënësit në raste të punësimit të të huajve të cilët punojnë në mënyrë të paligjshme

1. Punëdhënësi, i cili punëson ose përdor punën e të huajve që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Kosovës, është obligues i pagimit të tatimit, gjobave dhe dënimeve tjera shtrënguese.
2. Detyrimet nga paragrafi 1. i këtij neni, konsiderohen të gjitha taksat dhe kontributet për sigurimet e detyrueshme të parapara me legjislacion në fuqi, të cilat i paguan punëdhënësi sikurse kur i huaji do të ishte i punësuar ligjërisht.

Neni 119
Kthimi i dokumentit të udhëtimit dhe lejeqëndrimit për të huajt

1. I huaji, është i detyruar të kthej dokumentin e udhëtimit dhe lejeqëndrimin për të huaj të lëshuara nga Republika e Kosovës, në rast se:
   1.1. largohet përfundimisht nga territori i Republikës së Kosovës;
   1.2. skadon afati i vlefshmërisë së dokumentit;
   1.3. fiton shtetësinë e Kosovës.

KREU VII
PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 120
Mbledhja e të dhënave dhe evidencat

1. Autoritetet kompetente shtetërore për trajtimin e të huajve mbledhin dhe administrojnë të dhënat personale për të huajt nga organet shtetërore, subjektet private, apo të huajt me qëndrim në Republikën e Kosovës, si dhe nga vetë i huaji, i regjistrojnë këto të dhëna në bazat e të dhënave për të huajt, si dhe në evidencat e posaçme kur kjo:
   1.1. është e parashikuar me ligj apo me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Kosovës;
   1.2. është në interes të të huajit dhe i njëjti nuk e kundërshton atë;

1.3. kërkohet me qëllim të mbrojtjes së rendit publik, sigurisë shtetërore dhe shëndetit publik.

2. Me qëllim të zbatimit të këtij ligji, në rastet e largimit apo depërtimit të huajve autoritetet përgjegjëse kanë të drejtë të komunikojnë të dhënat personale shteteve te origjinës dhe transitit, shteteve tjera dhe organizatave ndërkombëtare relevante, me kusht që shtetet apo organizatat ndërkombëtare në fjalë garantojnë një mbrojtje të ngjashme të të dhënave të transmetuara.
3. Komunikohen të dhënat personale të përcaktuara me poshtë:
   3.1. të dhënat personale (emrin, mbiemrin, datën dhe vendin e lindjes, gjininë, shtetësinë, adresën e fundit të njohur në vendin e origjinës apo të prejardhjes) të personit në fjalë dhe, nëse është e nevojshme, të dhënat personale të të afërmve të tij;
   3.2. të dhënat lidhur me pasaportën apo dokument tjetër identiteti;
   3.3. gjurmët e gishtërinjve, fotografitë dhe të dhënat e tjera biometrike;
   3.4. të dhënat lidhur me dokumente tjera që mundësojnë identifikimin e personit;
   3.5. të dhënat lidhur me gjendjen shëndetësore të personit, me kusht që kjo të jetë në përputhje me interesin e tij;
   3.6. çdo e dhënë tjetër e domosdoshme për të garantuar hyrjen e personit në shtetin e destinuar dhe për ruajtur sigurinë e personave që e shoqërojnë;
   3.7. të dhënat lidhur me itinerarin e ndjekur nga personi, si dhe vendqëndrimet e tij;
   3.8. të dhënat lidhur me lejet e qëndrimit dhe vizat që i janë lëshuar personit;
   3.9. të dhënat lidhur me procedurën penale për aq sa kjo është e rëndësishme për procedurën e kthimit, për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në vendin e origjinës apo vendin e qëndrimit dhe për aq sa i huaji nuk rrezikohet.
4. Më kërkesë të dhënat nga paragrafi 3. i këtij neni u komunikohen autoriteteve te ndjekjes penale.
5. Komunikimi, qasja, dhe informimi i të dhënave personale sipas këtij neni do të bëhet në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
6. Mbledhja, përpunimi, evidentimi, komunikimi, informimi, qasja dhe fshirja e të dhënave personale për të huajt pas përfundimit të afatit të paraparë në nenin 122 të këtij ligji rregullohet me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave personale.

Neni 121
Përdorimi i të dhënave

1. Autoritetet kompetente për trajtimin e të huajve administrojnë dhe përdorin të dhënat e grumbulluara për të huajt në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave, si dhe i vënë ato në dispozicion të organeve të drejtësisë, organeve të sigurisë shtetërore, institucioneve për refugjatët që merren me fushën e të huajve.
2. Të dhënat e mbledhura dhe të administruara, sipas këtij ligji dhe në zbatim të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ruhen dhe përdoren për një afat të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar.
3. Për arsye të ligjshme, kanë të drejtë të mbledhin, të administrojnë, të shkëmbejnë dhe të kërkojnë vënie në dispozicion të të dhënave për të huajt autoritetet e mëposhtme për çështjet e:

3.1. shtetësisë;
3.2. punësimit të të huajve;
3.3. financave dhe doganave;
3.4. gjendjes civile;
3.5. shëndetit publik;
3.6. arsimit dhe shkencës.

Neni 122
Ruajtja e të dhënave

1. Autoritetet kompetente për trajtimin e të huajve, të cilat mbledhin dhe administrojnë të dhënat për të huajt, sipas këtij ligji, i ruajnë ato për një periudhë pesë (5) vjeçare pas skadimit të vlefshmërisë së vizës ose të lejes së përkohshme të qëndrimit, apo dhjetë (10) vjeçare nga përfundimi i procedurës ndëshkuese administrative ose penale.
2. Autoritetet kompetente për trajtimin e të huajve, të cilët mbledhin dhe administrojnë të dhënat personale për të huajt, marrin masat e duhura organizative dhe teknike për mbrojtjen e të dhënave personale nga shkatërrimi i jashtëligjshëm ose aksidental, humbja aksidentale, qasja ose shpërndarja tek persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave kryhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër të përpunimit të jashtëligjshëm.
3. Kushdo që ka qasje në të dhënat personale të mbledhura, ruajtura dhe përpunuara nga autoritetet kompetente për trajtimin e të huajve, si gjatë ushtrimit të detyrave si dhe pas përfundimit, i nënshtrohet detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit dhe mos shpërndarjes së asnjë të dhëne personale, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj.

KREU VIII
ADRESA E QËNDRIMIT TË TË HUAJIT

Neni 123
Lajmërimi i adresës

1. I huaji është i detyruar ta lajmëroj adresën dhe ndryshimin e adresës në stacionin më të afërt të policisë në afat prej tri (3) ditësh nga dita e hyrjes në territorin e Republikës së Kosovës, gjegjësisht nga dita e ndryshimit të adresës së banimit.
2. I huaji me lejeqëndrim në Republikën e Kosovës është i obliguar që ta lajmëroj vendbanimin dhe ndryshimin e adresës së banimit në stacionin më të afërt të policisë ose DSHAM-in, në afat prej tetë (8) ditëve që nga dita e ndryshimit të adresës së banimit.
3. I huaji nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni, është i obliguar të ç'lajmëroje vendbanimin gjegjësisht vendqëndrimin para se ta lëshoj Republikën e Kosovës.

Neni 124
Lajmërimi i adresës nga institucionet publike dhe private

1. Institucionet shëndetësore publike apo private të cilët pranojnë të huajt për shërim, obligohen ta lajmërojnë stacionin më të afërt të policisë brenda njëzetekatër (24) orëve nga dita e pranimit të tij.
2. Personat fizik dhe juridik të cilët ofrojnë akomodim të të huajve, por edhe personat tek të cilët vijnë të huajt për vizitë në Republikën e Kosovës, janë të obliguar që të lajmërojnë stacionin më të afërt të policisë brenda dymbëdhjetë (12) orëve nga pranimi i të huajit.
3. Dispozitat nga paragrafi 1. dhe 2. të këtij neni kanë të bëjnë me të huajt të cilët qëndrojnë në Republikën e Kosovës deri në nëntëdhjetë (90) ditë.

Neni 125
Evidenca e të huajve

1. Personat fizik dhe juridik të cilët ofrojnë akomodim për të huajt, obligohen që të mbajnë evidencën për të huajt e akomoduar.
2. Personat nga paragrafi 1. i këtij neni, janë të obliguar ta ruajnë evidencën mbi të huajt më së paku tre (3) vite nga dita e përmbylljes së saj.
3. Personat nga paragrafit 1. i këtij neni, obligohen që me kërkesë zyrtare të zyrtarit të autorizuar të organit kompetent, t'i japin për shikim të dhënat nga evidenca e të huajve.

KREU IX
INTEGRIMI I TË HUAJVE NË JETËN EKONOMIKE, KULTURORE DHE SHOQËRORE

Neni 126
Ndihma për integrimin e të huajve

Institucionet përgjegjëse duhet të sigurojnë kushtet për integrim në jetën ekonomike, kulturore dhe shoqërore të të huajve, të cilët e gëzojnë të drejtën e qëndrimit në Republikën e Kosovës.

Neni 127
Institucionet dhe organizatat

1. Institucionet shtetërore në pajtim me kompetencat e tyre bashkëpunojnë me partnerët socialë, organizatat jofitimprurëse dhe organizatat ndërkombëtare, për promovimin dhe zbatimin e programeve të integrimit të të huajve në shoqëri.
2. Institucionet shtetërore dhe organizatat sipas paragrafit 1. të këtij neni, iu ofrojnë të huajve mbrojtje kundër çdo lloj forme diskriminimi.

KREU X
DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 128
Masat ndëshkimore dhe ekzekutimi

1. Gjoba në shumë prej njëqind (100) deri treqind (300) euro do t'i shqiptohet nga Policia të huajit i cili:
   1.1. shërbehet me një dokument udhëtimi të ndryshëm prej atij me të cilin ai ka hyrë në Republikën e Kosovës (neni 4 i këtij ligji);
   1.2. nuk parashtron kërkesë për qëndrim të përkohshëm për fëmijën brenda afatit të përcaktuar ligjor (neni 45, paragrafi 1. i këtij ligji);
   1.3. nuk parashtron kërkesë për zgjatjen dhe vazhdimin e qëndrimit të përkohshëm brenda tridhjetë (30) ditësh para skadimit të qëndrimit të përkohshëm ekzistues (neni 47 paragrafi 1. i këtij ligji);
   1.4. ka qëndruar në Republikën e Kosovës në kundërshtim me qëllimin për të cilin i është dhënë qëndrimi i përkohshëm (neni 66, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. i këtij ligji);
   1.5. nuk i paraqet urdhrin e largimit tek zyrtari policor në pikën e kalimit kufitar (neni 94, paragrafi 2. i këtij ligji);
   1.6. nuk informon DSHAM-në, për pushimin e kushteve për të cilat i është dhënë lejeqëndrimi i përkohshëm për punë (neni 81, paragrafi 1.2. i këtij ligji);
   1.7. nuk posedon vërtetim mbi lajmërimin e punës (neni 76 i këtij ligji);
   1.8. me kërkesën e personit zyrtar ai/ajo nuk e paraqet një dokument i cili dëshmon identitetin e tij/saj ose nuk bart me vete atë (neni 117, paragrafi 2. i këtij ligji);
   1.9. nuk e kthen dokumentin e udhëtimit për të huaj dhe lejeqëndrimin, (neni 119 i këtij ligji);
   1.10. nuk raporton humbjen, zhdukjen ose vjedhjen e dokumenteve;
   1.11. nuk e lajmëron apo nuk e ç'lajmëron adresën, (neni 123 dhe 124 i këtij ligji);
   1.12. qëndron në territorin e Republikës së Kosovës në kundërshtim me qëllimin e hyrjes (neni 40 paragrafi 1.2. i këtij ligji).
2. Nga Inspektorati i Punës me gjobë në shumë prej njëmijë (1.000) deri dymijë e pesëqind (2.500) euro dënohet punëdhënësi si person fizik, me gjobë në shumën prej pesëmijë (5.000) deri shtatëmijë (7.000) euro do të dënohet punëdhënësi si person juridik dhe personi përgjegjës, i cili:
   2.1. nuk nënshkruan një kontratë ose pa dokumente të tjera të përshtatshme për një të huaj shërbimet e të cilit ai shfrytëzon (neni 71 paragrafi 1. i këtij ligji);
   2.2. nuk informon DSHAM-in për ndërprerjen e kushteve për të cilat i është dhënë leja e qëndrimit për punë (neni 82, paragrafi 2. i këtij ligji);

Neni 129

1. Me gjobë prej dyqind (200) deri pesëqind (500) euro do të dënohet nga Policia një i huaj i cili:
   1.1. lëviz në zona në të cilat atij i është kufizuar lëvizja (neni 106 i këtij ligji);
   1.2. qëndron paligjshëm në Republikën e Kosovës (neni 93 i këtij ligji);
   1.3. e pengon largimin me forcë (neni 97, paragrafi 2. i këtij ligji);
   1.4. është larguar nga Qendra e Mbajtjes pa leje ose nuk i ka zbatuar rregullat e qëndrimit në Qendër të Mbajtjes (neni 108 i këtij ligji);
   1.5. me kërkesën e zyrtarëve nuk i dorëzon për kontrollim dokumentet e udhëtimit ose ndonjë dokument tjetër që përdoret për kalimin e kufirit (neni 117, paragrafi 3. i këtij ligji);
   1.6. nuk ka një dokument identiteti dhe me kërkesën e zyrtarit policor nuk jep të dhënat personale (neni 117, paragrafi 4. i këtij ligji);
   1.7. dokumentet e tij i jep për përdorim një personi tjetër, ose përdor një dokument të pavlefshëm, ose të dikujt tjetër sikur të ishin të tij/saj (neni 117, paragrafi 5. i këtij ligji).
2. Për shkeljet nga paragrafin 1. të këtij neni mund të shpallet urdhri për largimin e të huajit paralelisht ose në mënyrë të pavarur pa dënim.

Neni 130

1. Nga Inspektorati i Punës me gjobë në shumë prej pesëmijë (5.000) deri shtatëmijë (7.000) euro do të shqiptohet nëse i huaji:
   1.1. punon pa lejeqëndrimin e punës si dhe vërtetimin e regjistrimit të punës (neni 67, paragrafi 1. i këtij ligji);
   1.2. i cili punon dhe vepron në kundërshtim me nenin (67, paragrafi 5. i këtij ligji) këtij ligji.
2. Për shkeljet e referuara në paragrafin 1. këtij të këtij neni, mund të shqiptohet urdhri për largim në mënyrë të pavarur dhe pa dënim.

Neni 131

1. Me gjobë në shumë prej tremijë (3.000) deri gjashtëmijë (6.000) euro për çdo të huaj të transportuar, do të dënohet nga Policia transportuesi i të huajit të cilët nuk kanë pasaportë të vlefshme ose dokument tjetër që përdoret për kalimin e kufirit, vizë të vlefshme ose leje qëndrimi (neni 35 paragrafi 2. i këtij ligji).
2. Me gjobë në shumë prej katërmijë (4.000) deri gjashtëmijë (6.000) euro për çdo të huaj të transportuar, do të dënohet nga Policia transportuesi si person fizik i cili me shpenzimet e veta nuk e ka dërguar (larguar) të huajin deri te vendkalimi i kufirit ose nga Republika e Kosovës ose nuk i ka marrë përsipër shpenzimet për kthimin e të huajit (neni 35, paragrafi 3., 4. dhe 5. i këtij ligji).
3. Me gjobë në shumën e katërmijë (4.000) deri gjashtëmijë (6.000) euro për çdo të huaji të asistuar, do të dënohet nga Policia personi fizik i cili ndihmon një të huaj në mënyrë të paligjshme të kaloj kufirin, transit dhe qëndrimit të paligjshëm në Republikën e Kosovës (neni 36 i këtij ligji).

4. Me gjobë në shumën prej gjashtëmijë (6.000) euro do të dënohet nga Policia një person juridik në rastin e paragrafit 2. dhe 3. të këtij neni, me gjobë në shumën prej dymijë e pesëqind (2.500) euro personi përgjegjës në personin juridik, për çdo të huaj të transportuar, apo të ndihmuar.

Neni 132

1. Nga Inspektorati i Punës me gjobë në shumë prej pesëmijë (5.000) deri tetëmijë (8.000) euro për çdo të huaji do të dënohet punëdhënësi - një person fizik i cili e ka punësuar një të huaj ose e përdor punën e tij, dhe me gjobë në shumën prej njëzetmijë (20.000) në dyzetmijë (40.000) euro për çdo të huaj do të dënohet punëdhënësi - një person juridik i cili ka punësuar një të huaj ose e përdor punën e tij:
   1.1. nëse e punëson një të huaj i cili nuk posedon lejeqëndrim për punë ose certifikatë të regjistrimit të punës (neni 67, paragrafi 1. i këtij ligji);
   1.2. nëse e punëson një të huaj në kundërshtim me dispozitat e nenit 67 paragrafi 6. të këtij ligji.
2. Nga Inspektorati i Punës me gjobë në shumë prej pesëmijë (5.000) deri tetëmijë (8.000) euro për çdo të huaji do të dënohet punëdhënësi - personi fizik që punëson ose përdor punën e të huajve që banojnë ilegalisht në Republikën e Kosovës, dhe me gjobë në shumën prej shtatëdhjetëmijë (70.000) deri tetëdhjetëmijë (80.000) euro për çdo të huaj do të dënohet punëdhënësi - një person juridik që punëson ose përdor punën e të huajve që banojnë ilegalisht në Republikën e Kosovës (neni 67, paragrafi 7. i këtij ligji).
3. Për shkeljet e referuara në paragrafin 1. këtij neni, do të dënohet nga Inspektorati i Punës me një gjobë prej pesëmijë (5.000) deri tetëmijë (8.000) euro personi përgjegjës i personit juridik.
4. Për shkeljet e referuara në paragrafin 2. këtij neni me gjobë në shumën prej njëzetmijë (20.000) deri dyzetmijë (40.000) euro, do të dënohet nga Inspektorati i Punës personi përgjegjës në personin juridik.
5. Për shkeljet e referuara në paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni, mund të ndalohet kryerja e aktiviteteve.
6. Nga Inspektorati i Punës me gjobë prej dhjetëmijë (10.000) deri në pesëmbëdhjetëmijë (15.000) Euro do të dënohet punëdhënësi-personi fizik, me një gjobë prej tridhjetëmijë (30.000) deri në gjashtëdhjetëmijë (60.000) do të dënohet punëdhënësi- personi juridik i cili nuk ofron të dhëna apo pengon qasjen në hapësira të mbyllura apo të rrethuara të pronës komerciale.

Neni 133

1. Nga Inspektorati i Punës me gjobë në shumë prej pesëmijë (5.000) deri tetëmijë (8.000) euro do të dënohet punëdhënësi i huaj si person juridik, nëse para fillimit të dërgimit të punëtorit nuk e dorëzon deklaratën ose e dorëzon atë jo të plotë ose të gabuar (neni 80 i këtij ligji).
2. Nga Inspektorati i Punës me një gjobë prej pesëqind (500) deri njëmijepesëqind (1.500) euro për shkeljet e referuara nga paragrafin 1. të këtij neni, do të dënohet punëdhënësi i huaj si person fizik, dhe personi përgjegjës i personit juridik.

3. Inspektorati i Punës me gjobë prej pesëmbëdhjetëmijë (15.000) deri tridhjetëmijë (30.000) euro do ta dënoj çdo të huaji si marrës i shërbimit, nëse ai e di ose ka arsye për të ditur se për punën e përdor një punëtor të sistemuar i cili nuk është i punësuar ligjërisht nga një punëdhënës i huaj (neni 77 i këtij ligji);
4. Inspektorati i Punës me gjobë prej tremijë (3.000) deri pesëmijë (5.000) euro për çdo të huaji për shkeljet e referuara në paragrafin 3. të këtij neni, do të dënohet përfituesi, personin fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik.

Neni 134

1. Me gjobë në shumë prej dyqind (200) deri katërqind (400) euro do të dënohet një person fizik apo me gjobë në shumën prej katërqind (400) deri tetëqind (800) euro do të dënohet nga Policia personi juridik, nëse:
   1.1. nuk e lajmëron apo nuk e ç'lajmëron adresën, (neni 124 i këtij ligji);
   1.2. personit të autorizuar nuk i vë në dispozicion të dhënat nga regjistrat për të huajt që ofrojnë shërbime (neni 125 paragrafi 3. i këtij ligji).
2. Për shkeljet të referuar në paragrafin 1. këtij neni, me gjobë në shumën prej pesëqind (500) deri njëmijë (1.000) euro dënohet nga Policia personi përgjegjës i personit juridik.

KREU XI
DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 135
Dispozita përfundimtare për lejet e punës

Lejet e punës, të lëshuara për punëmarrësit dhe të punësuarit e huaj dhe përjashtimet nga detyrimi për pajisje me leje pune, në zbatim të dispozitave të legjislacionit në fuqi, para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në përfundim të vlefshmërisë së afatit, sa kohë që nuk anulohen nga autoritetet shtetërore përgjegjëse ose nuk bëhen të pavlefshme, në zbatim të dispozitave të këtij ligji.

Neni 136
Dispozita përfundimtare për lejeqëndrim

Lejet e qëndrimit lëshuar të huajve në zbatim të dispozitave të legjislacionit në fuqi, para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në përfundim të datës së përfundimit të tyre, sa kohë që nuk anulohen nga autoritetet shtetërore përgjegjëse ose nuk bëhen të pavlefshme, në zbatim të dispozitave të këtij ligji, apo akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Neni 137
Nxjerrja e akteve nënligjore dhe zbatimi i akteve nënligjore ne fuqi

1. Në zbatim të këtij ligji, MPB nxjerr aktet nënligjore për:
   1.1. forma, përmbajtja dhe procedura për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit, sipas paragrafit 4. të nenit 7 të këtij ligji;

1.2. përbërja, detyrat, përgjegjësitë dhe procedura e vendimmarrjes së Komisionit të Ankesave, sipas paragrafit 4. të nenit 9 të këtij ligji;
1.3. kushtet dhe procedura e lëshimit të vizës në pikën e kalimit kufitar, sipas paragrafit 3. të nenit 26 të këtij ligji;
1.4. kushtet dhe procedura e vazhdimit të vizës, sipas paragrafit 4. të nenit 27 të këtij ligji;
1.5. forma, përmbajtja dhe procedura për lëshimin e leje qëndrimit të përkohshëm, sipas paragrafit 5. të nenit 41 të këtij ligji;
1.6. forma e urdhër largimit, Forma e urdhër largimit me forcë dhe Forma e urdhrit të qëndrimit të detyrueshëm në një territor të caktuar, sipas paragrafit 10. të nenit 94, paragrafit 8. të nenit 97 dhe paragrafit 3. të nenit 106 të këtij ligji;
1.7. procedurat e sekuestrimit, sipas paragrafit 1. të nenit 104 të këtij ligji.

2. Në zbatim të këtij ligji, MPJ nxjerr aktet nënligjore për:
2.1. detyrat dhe përgjegjësitë e ndërmjetësuesit komercial dhe/ose ofruesit e jashtëm të shërbimeve, sipas paragrafit 3. të nenit 15 të këtij ligji;
2.2. formularin, mënyrën dhe procedurat e lëshimit të vizave, sipas paragrafit 3. të nenit 17 të këtij ligji;
2.3. Sistemin Informativ të Vizave të Kosovës SIVK, sipas paragrafit 2. të nenit 20 të këtij ligji.

3. Në zbatim të këtij ligji, MPMS në bashkëpunim me MPB nxjerr akte nënligjore për:
3.1. formën, përmbajtjen, kategoritë dhe procedurat e aplikimit për lejeqëndrim për punë.

4. Lartësia e taksave për lejeqëndrimin do të përcaktohet me akt nënligjor të veçantë të nxjerrë nga ministri i MPB-së.

5. Për zbatim të këtij ligji mund të nxirren edhe akte tjera nënligjore.

Neni 138
Shfuqizimi

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen:
1.1. Ligji Nr. 04/L-069 për të Huajit;
1.2. Ligji Nr.03/L-136, për Dhënien e Lejes për Punë dhe Punësimin e Shtetasve të Huaj;
1.3. të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë ligj.

2. Deri në nxjerrjen e Udhëzimeve Administrative, mbesin në fuqi udhëzimet Administrative siç janë:
2.1. Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2009 - MPB për Fletudhëtimin për të Huaj;
2.2. Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2010 - MPB për Themelimin e Komisionit Shqyrtues dhe të Komisionit për Ankesa;
2.3. Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2010 - MPB për Përmbajtjen, Formën, Mënyrën e Dhënies dhe Anulimin e Lejes së Qëndrimit;
2.4. Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2010-MPB për Ndalimin e Hyrjes në Republikën e Kosovës;
2.5. Udhëzim Administrativ Nr. 21/2010 - MPB për Lëshimin e Vizave në Pikat e Kalimit Kufitar;

2.6. Udhëzim Administrativ Nr. 22/2010 – MPB për Lëshimin e Dokumenteve të Udhëtimit për të Huajt;
2.7. Udhëzim Administrativ Nr. 23/2010 – MPB për Mirëmbajtjen dhe Menaxhimin e Regjistrave për të Huajt;
2.8. Udhëzim Administrativ Nr. 31/2010 – MPB për Letërnjoftim për tëHuajt;
2.9. Udhëzim Administrativ 07/2012 për Procedurat e Lëshimit të Vizave për të Huajt nga Misionet Konsullore të Republikës së Kosovës;
2.10. Udhëzim Administrativ 08/2012 për Rregullimin e Sistemit të Informatave për Viza të Kosovës (SIVK);
2.11. Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2010, për Rregullimin e Procedurave për Dhënien e Lejeve për Punë dhe Punësimin e Shtetaseve të Huaj në Republikën e Kosovës;
2.12. Udhëzimi Administrativ Nr.14/2012, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr.05/2010, për Rregullimi e Procedurave për Dhënien e Lejeve për Punë dhe Punësimin e Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës.

Neni 139
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-219
31 korrik 2013

Shpallur me dekretin Nr. DL-042-2013, datë 19.08.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 35 / 5 SHTATOR 2013, PRISHTINË

LIGJI Nr. 04/L-088
PËR ARKIVAT SHTETËRORE

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 578
Kreu II: Dispozitat themelore 579
Kreu III: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 584

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR ARKIVAT SHTETËRORE

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj përcakton rregullat bazë për organizimin dhe funksionimin e shërbimit arkivor në institucionet e Republikës së Kosovës.

Neni 2
Fushëveprimi

Për qëllim të këtij ligji, institucionet publike, që hyjnë në fushën e veprimit të këtij ligji përfshijnë: Qeverinë dhe administratën në nivelin qendror, dhe lokal, institucionet ligjvënëse dhe gjyqësore, zyrën e presidencës, prokurorinë, personat fizik dhe juridik, me kusht që të ushtrojnë autoritet administrativ, kryejnë detyra publike apo operojnë me fonde publike sipas ligjeve të Republikës së Kosovës (bartësit privat të kompetencave publike); si dhe detyrimet e tyre ligjore për krijimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **Agjencia -** Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës është organ

qeveritar, e cila organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë në të gjithë rrjetin arkivor të vendit (në tekstin e mëtejmë Agjencia).

1.2. **Lënda arkivore** - i tërë materiali burimor dhe i reproduktuar nga institucionet publike, personat juridik dhe fizik gjatë veprimtarisë së tyre siç janë: dorëshkrimet, të dhënat e shtypura, vizatimet, fotografitë, vulat, materialet audiovizuele, materialet elektronike dhe të gjitha mjetet tjera ndihmëse të cilat e mundësojnë kuptueshmërinë e qartë të përmbajtjes së informacioneve dhe të cilat lehtësojnë shfrytëzimin e tyre.

1.3. **Material dokumentar** – tërësia e dokumenteve ose të dhënave të krijuara gjatë veprimtarisë dhe punës së institucioneve publike, personave juridik dhe fizik si dhe evidencat ligjore lidhur me ato, pa marrë parasysh formën dhe formatin e shënimit.

1.4. **Fondi arkivor shtetëror** - tërësia e materialit arkivor, i cili është nën mbrojtje të shtetit të Republikës së Kosovës, dhe shërben si burim i informatave për shoqërinë, për realizimin e interesave dhe nevojave të saj dhe të shtetit.

1.5. **Fond krijuesit** - institucionet e përcaktuara në fushëveprimin e këtij ligji, të cilat gjatë kryerjes së detyrave të punës krijojnë materialin, i cili dërgohet për arkivim në arkivin kompetent pas kalimit të afatit të përcaktuar me ligj.

KREU II
DISPOZITAT THEMELORE

Neni 4
Organizimi i Agjencisë

1. Agjencia Shtetërore e Arkivave është organ qeveritar e cila kryen detyrat dhe përgjegjësitë të përcaktuara në këtë ligj.
2. Agjencia udhëhiqet nga Kryeshefi Ekzekutiv, i cili është përgjegjës për administrimin, funksionimin dhe menaxhimin e Agjencisë.
3. Emërimi, shkarkimi, funksionet dhe përgjegjësitë e Kryeshefit Ekzekutiv rregullohen me dispozitat përkatëse në fuqi në Republikën e Kosovës.
4. Struktura dhe organizimi i Agjencisë rregullohet me akt nënligjor të cilin e propozon Agjencia dhe e miraton Qeveria.

Neni 5
Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë

1. Agjencia është institucion, i cili pranon, evidenton, ruan dhe publikon materialin arkivor dhe mundëson shfrytëzimin e tij për hulumtime shkencore dhe punë profesionale si dhe për nevoja tjera të cilat janë në interes për institucionet, organizatat, personat juridik dhe fizik.
2. Agjencia ushtron veprimtarinë e vet në pajtim me ligjin dhe aktet tjera të mbështetura në të, si dhe standardet arkivore ndërkombëtare.
3. Këshillon dhe udhëzon sipas nevojës institucionet, të cilat hyjnë në fushëveprimin e këtij ligji lidhur me administrimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e materialit arkivor.
4. Organizon trajnime, kurse, ligjërata për aftësimin dhe perfeksionimin profesional

të kuadrit arkivor në Kosovë si dhe kryen punë dhe aktivitete tjera të përcaktuara me ligj dhe me aktet e përgjithshme juridike, që u referohen veprimtarisë arkivore.

Neni 6
Rrjeti i institucioneve arkivore

1. Më qëllim të ruajtjes, të mbrojtjes dhe të shfrytëzimit të përshtatshëm të materialit arkivor dhe të zhvillimit të mëtejshëm të veprimtarisë arkivore krijohet rrjeti arkivor i Kosovës.
2. Rrjeti arkivor i Kosovës krijohet nëpërmjet ndërlidhjes funksionale të të gjitha institucioneve arkivore të Kosovës.
3. Rrjeti arkivor i Kosovës krijohet, organizohet dhe funksionon sipas aktit nënligjor për rrjetin arkivor të Kosovës, të cilin e propozon Agjencia dhe e miraton Qeveria.

Neni 7
Fondi arkivor i nivelit qendror dhe lokal

Fondi arkivor i nivelit qendror dhe lokal përfshin tërësinë e materialit arkivor të krijuar gjatë veprimtarisë se institucioneve, që hyjnë në fushëveprimin e këtij ligji si dhe të personave fizik dhe juridik me vlerë historike, juridike, politike, ekonomike, sociale e kulturore, i cili shërben si burim i informatave për realizimin e nevojave dhe interesave të shtetit dhe shoqërisë në tërësi.

Neni 8
Regjistri arkivor publik

1. Agjencia, më qëllim të përmirësimit të mundësive për shfrytëzimin e lëndës arkivore krijon, mban dhe përditëson regjistrin arkivor publik.
2. Regjistri arkivor publik ndër të tjera përmban këto elemente:
   2.1. evidencën e të dhënave për të gjitha institucionet arkivore dhe fond krijuese të Kosovës. Këto të dhëna klasifikohen sipas nivelit qendror, komunal dhe privat;
   2.2. një pasqyrë të përgjithshme për të gjithë materialin e arkivuar në Agjenci;
   2.3. kushtet për shfrytëzimin dhe qasjen në materialin e arkivuar në Agjenci.
3. Të gjitha arkivat në nivel qendror, komunal dhe privat janë të obliguara që ti vënë në dispozicion Agjencisë të gjitha të dhënat dhe informacionet e nevojshme për përditësimin e regjistrit arkivor publik.
4. Agjencia bashkëpunon me arkivat tjera për ndërtimin dhe përditësimin e regjistrit arkivor publik.
5. Në regjistrin arkivor publik mund të ketë qasje çdo person fizik dhe juridik.
6. Regjistri duhet të menaxhohet duke përdorur sistemet më moderne të teknologjisë informative dhe të publikohet në ueb-faqen e Agjencisë.

Neni 9
Përgjegjësia për arkivim

1. Përgjegjës për arkivimin e materialeve të të gjitha institucioneve publike, që hyjnë në fushëveprimin e këtij ligji, të cilat nuk janë më të nevojshme për kryerjen e detyrave të punës dhe për të cilat ka kaluar afati i ruajtjes në institucionin përkatës është Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, institucionet e paraqitura në vijim, mund të zhvillojnë arkiv vetanak në kuadër të fushë veprimtarisë së tyre:
   2.1. Administrata e Kuvendit të Republikës së Kosovës;
   2.2. Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës;
   2.3. Universitetet e Republikës së Kosovës;
   2.4. Ministria e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës;
   2.5. Ministria e Punëve të Brendshme;
   2.6. Agjencia Kosovare e Inteligjencës.
3. Në rastin kur institucionet e paraqitura në paragrafin 2. të këtij neni nuk posedojnë kushtet dhe hapësirën e nevojshme për arkivimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e materialit arkivor nga dëmtimi apo asgjësimi, atëherë institucionet e lartcekura i ofrojnë materialin e tyre për arkivim Agjencisë, duke marrë parasysh kushtet dhe kriteret e parapara në këtë ligj.

Neni 10
Ofrimi dhe pranimi i materialit arkivor

1. Institucionet publike që hyjnë në fushëveprimin e këtij ligji obligohen që t'i ofrojnë për arkivim Agjencisë të gjitha materialet, të cilat nuk konsiderohen të nevojshme për kryerjen e mëtejshme të detyrave të punës dhe afati i të cilave për ruajtje ka kaluar.
2. Ofrimi i materialit për pranim në Agjenci bëhet më së voni pas kalimit të afatit prej tridhjetë (30) viteve nga momenti i krijimit të materialit, përjashtimisht rasteve kur përmbajtja e materialit është specifike dhe me legjislacionin përkatës në fuqi kërkohet një afat më i gjatë për ruajtje në institucionin përkatës.
3. Agjencisë i sigurohet qasja nga institucioni përkatës në të gjithë materialin dhe të dhënat përkatëse, i cili është propozuar për pranim në Agjenci në mënyrë që të bëhet vlerësimi nëse materiali i plotëson kushtet për arkivim. Materialit të ofruar për arkivim në Agjenci nga institucioni përkatës i bashkëngjiten të gjitha shënimet relevante, të cilat janë të nevojshme për kuptueshmërinë e qartë të informacioneve si dhe për shfrytëzimin efektiv të tyre.
4. Të gjitha materialet elektronike, të cilat i nënshtrohen aktualizimit të vazhdueshëm duhet të ofrohen për arkivim në Agjenci.
5. Komisioni përgjegjës në Agjenci bënë vlerësimin nëse materiali i ofruar nga institucioni përkatës i përmbush kushtet dhe kriteret për arkivim në Agjenci. Në rast se nuk përmbushen kushtet dhe kriteret e parapara me ligj dhe akt nënligjor, materiali i ofruar për ruajtje në Agjenci vazhdon të mbetet në institucionin përkatës, deri në përmbushjen e tyre.

6. Agjencia brenda një periudhe kohore deri në gjashtë (6) muaj pas ofrimit të materialit nga fond krijuesi duhet të vlerësoj se cili material është relevant për arkivim në Agjenci. Për të bërë këtë vlerësim Agjencisë i mundësohet qasja në të gjithë materialin e ofruar për arkivim.
7. Në rastin kur Agjencia nuk merr vendim për arkivimin e materialit të ofruar nga institucioni përkatës brenda afatit kohor prej gjashtë (6) muajve, vazhdon detyrimi i institucionit përkatës për ruajtjen e mëtejshme të materialit të ofruar për arkivim.

Neni 11
Administrimi dhe mbrojtja e materialit arkivor

1. Materiali arkivor ruhet në gjendjen në të cilën është pranuar në Agjenci.
2. Materiali arkivor ruhet si tërësi dhe nuk mund të tjetërsohet, dëmtohet apo asgjësohet.
3. Materiali arkivor përpunohet në bazë të kritereve dhe standardeve për arkivim dhe ruhet nga shfrytëzimi i paautorizuar dhe keqpërdorimi.

Neni 12
Shfrytëzimi i materialit arkivor

1. Materiali arkivor mbahet, ruhet dhe shfrytëzohet për nevoja arsimore, shkencore, kulturore, hulumtuese, informative, për punë profesionale dhe nevoja qytetare.
2. Ky ligj garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës në materialin e arkivuar në Agjenci, me përjashtim të kufizimeve të cilat parashihen me këtë ligj dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
3. Hulumtimi dhe shfrytëzimi i materialit arkivor bënë pjesë në të drejtat themelore të qytetarit për informim të lirshëm dhe të papenguar dhe si e tillë në parim nuk mund të kufizohet.
4. Shfrytëzimi i materialit të arkivuar në Agjenci në parim është i pa pagesë.
5. Përjashtimisht nga paragrafi 4. i këtij neni me akt nënligjor përkatës caktohen tarifat dhe taksat për shërbimet arkivore, të cilat krijohen nga shfrytëzimi i materialit arkivor dhe nga krijimi i kopjeve, të cilin e miraton Agjencia.
6. Shfrytëzimi i materialit arkivor mund të kufizohet në tërësi apo pjesërisht në këto raste:
   6.1. kur ekziston dyshimi se do të rrezikohet mirëqenia e Republikës së Kosovës;
   6.2. kur cenohet siguria kombëtare, mbrojtjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare;
   6.3. kur cenohet jeta private e individit;
   6.4. kur cenohen të drejtat themelore të personave të tretë të garantuara me legjislacionin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale;
   6.5. kur cenohet politika financiare, monetare ose tatimore e shtetit të Republikës së Kosovës;
   6.6. çfarëdo dokumenti në përkujdesje të arkivave të Kosovës që përmban informata ose të dhëna që mund t'i prekin të drejtat dhe liritë fundamentale njerëzore të garantuara me Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut.

7. Personeli kompetent në Agjenci me rastin e shfrytëzimit të materialit arkivor apo krijimit të kopjes lëshon dokumentin, i cili përmban faktet që përfshinë lënda arkivore. Dokumenti i lëshuar nga Agjencia ka vlerën e dokumentit zyrtar.

Neni 13
Afatet kohore për shfrytëzimin e materialit të arkivuar në Agjenci

1. Nëse nuk parashihet një afat tjetër me legjislacionin përkatës në fuqi, materiali i arkivuar në Agjenci në parim mund të jepet në shfrytëzim pas kalimit të afatit prej tridhjetë (30) viteve nga momenti i krijimit të materialit nga fond krijuesi nëse nuk parashihet ndryshe me këtë ligj.
2. Nëse me dhënien në shfrytëzim të materialit, siç parashihet në paragrafin 1. të këtij neni cenohet mbrojtja e interesave shtetërore të Republikës së Kosovës si dhe marrëdhëniet e shtetit me jashtë, atëherë materiali jepet në shfrytëzim vetëm pasi të kenë rënë këto arsye, ndërsa më së voni pas kalimit të afatit prej pesëdhjetë (50) viteve nga fillimi i afatit për ruajtje të materialit në Agjenci.
3. Afati për dhënien në shfrytëzim të materialit arkivor, në të cilin parashihen rregulla të caktuara për konfidencialitet është gjashtëdhjetë (60) vite nga momenti i krijimit të tij.
4. Materiali arkivor, i cili në bazë të qëllimit dhe përmbajtjes thelbësore është i lidhur më të dhënat personale të personave fizik, nuk mund të jepet në shfrytëzim para kalimit të afateve të mëposhtme:
   4.1. dhjetë (10) vite pas vdekjes së personit fizik;
   4.2. njëqind (100) vite nga viti i lindjes, në rastin kur nuk është i njohur viti i vdekjes së personit konkret;
   4.3. gjashtëdhjetë (60) vite nga momenti i krijimit të materialit arkivor, në rast se viti i lindjes dhe ai i vdekjes është i panjohur.
5. Afatet kohore të përcaktuara në paragrafin 4. të këtij neni nuk vlejnë për dokumentet, të cilat në momentin e krijimit kanë qenë publike dhe i janë dedikuar publikut.
6. Afatet kohore të përcaktuara në paragrafin 4. të këtij neni vlejnë edhe për shfrytëzimin e materialit të arkivuar në Agjenci nga institucionet publike.
7. Bashkëshorti/ja, fëmijët apo prindërit e personit, të dhënat personale të të cilit gjenden në Agjenci mund të kenë qasje dhe t'i shfrytëzojnë materialin e arkivuar në Agjenci edhe para kalimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 4. të këtij neni, përveç rastit kur personi konkret para vdekjes ka ndaluar qasjen në materialin përkatës për familjarët e tij/saj.
8. Shfrytëzimi i materialit arkivor sipas afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 4. të këtij neni mund të lejohet në bazë të paraqitjes së kërkesës edhe para skadimit të këtij afati vetëm në këto raste:
   8.1. kur personi përkatës ka miratuar shfrytëzimin e materialit arkivor;
   8.2. me rastin e vdekjes së personit përkatës, këtë të drejtë e ushtrojnë pasardhësit e tij të ligjshëm, përveç rastit kur personi përkatës derisa ishte në jetë ka ndaluar shprehimisht qasjen në të dhënat personale të tij/saj.

Neni 14
Detyrat dhe Përgjegjësitë e Fond krijuesit

1. Fond krijuesi obligohet që materialin, të cilin e posedon t'ia dorëzoj Agjencisë për evidentim dhe ta mirëmbaj sipas kritereve të parapara në këtë ligj dhe standardeve arkivore.
2. Fond krijuesi i materialit arkivor obligohet që të veprojë si në vijim:
   2.1. ruajtja e materialit arkivor në gjendje të rregullt dhe mbrojtja e tij nga dëmtimi deri në dorëzimin e tij në arkivin kompetent;
   2.2. dërgimi i materialeve arkivore me kërkesën e Agjencisë për regjistrim dhe ruajtje si dhe informimi i saj për çdo ndryshim apo zhvillim përkitazi me të;
   2.3. evidentimi dhe klasifikimi i materialit arkivor sipas sistemit të përcaktuar për menaxhimin zyrtar të materialeve;
   2.4. dërgimi i materialit arkivor në Agjenci pas kalimit të afatit të përcaktuar me këtë ligj.

Neni 15
Lista e kategorizimit për ruajtjen dhe shfrytëzimin e materialit arkivor

Agjencia miraton listën e kategorizimit për ruajtjen dhe shfrytëzimin e materialit arkivor më të cilën përcaktohet vlera dhe afatet e ruajtjes si dhe mënyra e shfrytëzimit të materialit.

Neni 16
Fondi Arkivor Lokal

1. Arkivat lokale administrojnë, ruajnë, mbrojnë, klasifikojnë dhe kategorizojnë materialet arkivore të institucioneve lokale dhe të organeve që veprojnë brenda njësive administrativo-territoriale përkatëse. Ato kontrollojnë dhe iu ofrojnë ndihmë profesionale fond krijuesit të institucioneve të pushtetit lokal.
2. Materiali arkivor dorëzohet në arkivin kompetent në kuadër të Agjencisë pas kalimit të afatit të përcaktuar me këtë ligj i regjistruar dhe i evidentuar në pajtim me rregullat dhe standardet e arkivistikës. Nëse lënda arkivore nuk është e rregulluar sipas metodologjisë së menaxhimit zyrtar të materialeve të përcaktuar nga Agjencia, atëherë organi kompetent në Agjenci e përcakton afatin në të cilin poseduesi obligohet të dorëzoj materialin e plotësuar sipas kërkesës.
3. Në rastin kur nuk plotësohet kushti i paraparë në paragrafin 1. të këtij neni, Agjencia rregullon materialin më shpenzimet e poseduesit.

KREU III
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 17
Aktet nënligjore

1. Çdo institucion arkivor obligohet që të nxjerr një rregullore për mënyrën e ruajtjes dhe shfrytëzimit të materialit arkivor, e cila ndër të tjera duhet të rregulloj këto fusha:

1.1. sistemi i menaxhimit zyrtar;
1.2. procedurën e shfrytëzimit të materialit arkivor;
1.3. kriteret dhe standardet për ruajtjen e materialit arkivor;
1.4. krijimi i kopjeve dhe reproduktimeve;
1.5. përgjegjësia e shfrytëzuesve të materialit arkivor në rast të dëmtimit të të mirës arkivore;
1.6. tarifat dhe taksat për përdorimin e materialit arkivor dhe kompensimi për shpenzimet e krijuara me rastin e krijimit të kopjeve dhe reproduktimeve;
1.7. kushtet dhe procedurat tjera për shfrytëzimin e materialit arkivor.

Neni 18
Afatet për nxjerrjen e akteve nënligjore

1. Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji nxirren në afat prej gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Digjitalizimi i regjistrit arkivor publik përfundon brenda tri (3) viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 19
Shfuqizimi

1. Pas hyrjes në fuqi, ky ligj shfuqizon:
   1.1. Ligjin për lëndën arkivore dhe arkivat (Ligji nr. 2003/7);
   1.2. Ligjin nr. 02/L-80 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2003/7; dhe
   1.3. Ligjin nr. 03/L-077 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit 2003/7 për lëndën arkivore dhe arkivat, datë 7 nëntor 2008.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-088
15 shkurt 2012

Shpallur me dekretin Nr.DL-007-2012, datë 01.03.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 04 / 19 MARS 2012, PRISHTINË

LIGJI Nr. 04/L-071
PËR SISTEMIN E ADRESAVE

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 586
Kreu II: Kriteret për emërtim 588
Kreu III: Kriteret për numërtime 590
Kreu IV: Regjistri i adresave 591
Kreu V: Kriteret për tabelat e adresave 591
Kreu VI: Përgjegjësitë e komunës 592
Kreu VII: Përgjegjësitë e ministrive kompetente 592
Kreu VIII: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 593

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR SISTEMIN E ADRESAVE

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë dhe rregulloj mënyrën e krijimit dhe të administrimit të Sistemit të Adresave, përcaktimin e kritereve dhe identifikimin e çdo ndërtese, objekti dhe çdo parcele kadastrale të lirë në territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 2
Fusha e Zbatimit

Ky ligj përcakton kompetencat, përgjegjësitë e Komunave dhe detyrat e Qeverisë në krijimin dhe administrimin e Sistemit të Adresave në territorin e Kosovës.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Adresa** - përpilimi i fjalëve, numrave, dhe shenjat drejtshkrimore të gjuhës, të renditura sipas një qëllimi të caktuar, duke treguar vendndodhjen e saktë të një ndërtesë dhe një parcele kadastrale të lirë. Ajo është e përbërë nga shkronjat në gjuhët zyrtare dhe numrat Arab.
1.2. **Ministria** - Ministria përgjegjëse për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.
1.3. **Komuna** - përcaktimi i komunës, siç parashikohet në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale Nr. 03/L-040.
1.4. **Regjistri Komunal i Adresave** - regjistri zyrtar që përmban të gjitha elementet e adresave për Komunën e caktuar dhe i cili regjistër mirëmbahet dhe përditësohet vazhdimisht nga Komuna.
1.5. **Regjistri Shtetëror i Adresave** - regjistri zyrtar i cili përmban të dhëna nga të gjitha Regjistrat Komunal të Adresave i cili regjistër mirëmbahet dhe përditësohet vazhdimisht nga Ministria përgjegjëse për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, përkatësisht Agjencia Kadastrale e Kosovës.
1.6. **Gjuhët Zyrtare** - gjuhët zyrtare të përcaktuara me Ligjin për përdorimin e gjuhëve (Ligji nr 02/L-37).
1.7. **Hapësirë e Lirë** - parcela kadastrale e lirë.
1.8. **Zona e Qarkullimit Publik** - emërtohet pjesa e territorit publik, të tilla si bulevardet, rrugët, rrugicat, sheshet, parqet dhe unazat rrugore të cilat do të shërbejë si një referencë për të përshkruar vendndodhjen e saktë të një objekti, ndërtese dhe një parcele kadastrale të lirë brenda Komunës apo fshatit të komunës së njëjtë në territorin e Republikës së Kosovës.
1.9. **Rrugët** - përcaktohen në pajtim me Ligjin mbi rrugët (ligji nr 2003/11)
1.10. **Tabela e Adresave** – emërtimet, numërtimet dhe shenjat e adresave të cilat vendosen në tabelë.
1.11. **Agjencia Kadastrale e Kosovës** - Agjencia qendrore përgjegjëse për Kadastrin në Kosovë, ashtu siç është e paraparë më Ligji nr. 2003/25 për Kadastrin.

Neni 4
Elementet e Adresave

1. Elementet e një adrese janë si më poshtë:
   1.1. emri i Komunës;
   1.2. emri i Fshatit;
   1.3. emri i Zonës së Qarkullimit Publik në të cilin objekti ka një dalje;
   1.4. numri i Ndërtesës;
   1.5. numri i Hyrjes;
   1.6. numri i Katit;
   1.7. numri i Banesës; dhe
   1.8. kodi postar.

Neni 5
Sistemi i Adresave

Sistemi i Adresave aplikohet për çdo lloj objekti, ndërtese apo parcele kadastrale të lirë, pavarësisht nga qëllimi i shfrytëzimit të saj në Republikën e Kosovës.

Neni 6
Gjuhët e përdorura për zbatimin e Sistemit të Adresës

Sistemi i Adresave duhet të zbatohet duke përdorur gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. Kjo dispozitë zbatohet për përcaktimin e emrave të zonave të qarkullimit publik për prodhimin dhe instalimin e shenjave emërtuese të adresave.

KREU II
KRITERET PËR EMËRTIM

Neni 7
Emërtimi i Zonave të Qarkullimit Publik

1. Vendimi për emrat e zonave të qarkullimit publik, merret nga Kuvendi i Komunës nën juridiksionin e të cilave ndodhen ato.
2. Emrat për zonat e qarkullimit publik propozohen nga drejtoria komunale përgjegjëse. Emrat vendosen me vendim të Kuvendit të Komunës. Emrat e zonave të qarkullimit publik synojnë të ruajnë vazhdimësinë dhe homogjenitetin në aspektin kulturor dhe historik që synojnë të jenë të propozuara duke marrë në konsideratë procesin konsultativ me komunitetet që jetojnë në zona të veçanta. Emrat e zonave të qarkullimit publik regjistrohen në Regjistrin Komunal të Adresave.
3. Drejtoria komunale përgjegjëse gjithashtu cakton një kod unik për çdo zonë të qarkullimit publik në kuadër të komunës. Kodi regjistrohet në Regjistrin Komunal të Adresave.
4. Drejtoria komunale përgjegjëse obligohet të krijoj, mbajë dhe të rifreskojë vazhdimisht një listë alfabetike të të gjithë emrave të zonave të qarkullimit publik. Lista konsultohet gjatë procesit të emërtimit për të shmangur dyfishimin e emrave në të njëjtin fshat apo Komunë dhe e njëjta bëhet publike.

Neni 8
Kriteret e Emërtimit

1. Çdo zonë e qarkullimit publik ka një emër të veçantë në kuadër të të njëjtit fshat apo Komunës së njëjtë.
2. Në rrugën me një dalje vendoset emër i veçantë nga emri i rrugës kryesore nëse kur në të ka mbi dhjetë (10) banesa-shtëpi ose kur në planin rregullues parashikohet dalje në një rrugë tjetër. E njëjta gjë zbatohet edhe në fshatra.
3. Për rrugicat me një dalje ose me më pak se dhjetë (10) banesa-shtëpi përdoret emri i njëjtë i rrugës ku ato kanë dalje.
4. Nëse ka arsye për të përcaktuar emra të ndryshëm për të njëjtën zonë të qarkullimit publik përgjatë përfshirjes së saj, emri mund të ndryshojë vetëm në një udhëkryq, urë, kryqëzimin hekurudhor ose në ndonjë vend të njohur historik. Kjo dispozitë nuk do të thotë se i njëjti segment i zonës së qarkullimit publik mund të ketë emra të ndryshëm.

Neni 9
Ndalimet e Emërtimeve

1. Emrat e mëposhtme nuk do të përdoren në lidhje me Zonat e Qarkullimit Publik:
   1.1. inicialet, shkurtesat dhe emrat e shkurtuara;
   1.2. emrat në gjuhët e huaja;
   1.3. emra që përmbajnë gabime gjuhësore;
   1.4. emrat e familjeve;
   1.5. emrat përshkrues;
   1.6. emrat që përdorin numra nuk duhet të përdorin numrat me fraksione.

Neni 10
Riemërtimi i Zonave të Qarkullimit Publik

1. Në rast të nevojës për të ndryshuar emrin ekzistues të një zone zbatohen dispozitat e caktuara në këtë ligj për përcaktimin e emrave të zonave të qarkullimit publik.
2. Kur për shkak të një ndryshimi të kufijve komunal të Republikës së Kosovës, një zonë e qarkullimit publik është caktuar në një tjetër Komunë dhe ka një konflikt me një emër ekzistues, procesi i riemërtimit do të bëhet në pajtim me këtë ligj.

Neni 11
Lista e Emrave Rezervë

Drejtoria komunale përgjegjëse harton dhe mbanë një listë të emrave rezervë për zonat e qarkullimit publik. Emrat rezervë në listë duhet të përputhen me kriteret e emërtimit të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 12
Zonat ndër-komunale të Qarkullimit Publik

1. Zonat e qarkullimit publik që kalojnë nëpër dy ose më shumë Komuna, ruajnë të njëjtin emër në të gjithë përfshirjen e tyre.
2. Kur një zonë e qarkullimit publik kalon nëpër dy ose më shumë Komuna, Komunat bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në mënyrë që të sigurohet një pajtueshmëri në emërtimin dhe numërtimin e të njëjtës zonë të qarkullimin publik në të gjithë përfshirjen e saj.

Neni 13
Njoftimi për vendosjen e Emrit të Ri dhe ndryshimin e Emrit ekzistues

1. Në rast të vendosjes së një emri të ri ose ndryshimit të një emri ekzistues të një zone të qarkullimit publik Komuna e informon Ministrinë për emërtim të ri të propozuar brenda pesë (5) ditëve.
2. Ministria shqyrton emrin e propozuar në lidhje me pajtueshmërinë e saj me këtë ligj dhe Udhëzimet Administrative përkatëse. Ministria njofton Komunën brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve për vlerësimet e saj.

3. Në rast se Ministria konstaton papajtueshmërinë e emërtimit me këtë ligj dhe Udhëzimet Administrative të këtij ligji, atëherë Ministria brenda afatit të lart cekur i kërkon Komunës që të rishqyrtoj emërtimin.
4. Nëse Komuna nuk i përgjigjet kërkesës për rishqyrtim brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh apo refuzon kërkesën dhe e mbështetë vendimin e kontestuar për emërtim, atëherë Ministria mund ta dërgoj çështjen kontestuese në Gjykatën e Qarkut që është kompetente për territorin e Komunës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh pas dështimit për t'iu përgjigjur njoftimit për refuzim apo mbështetjen e vendimit të kontestuar.

KREU III
KRITERET PËR NUMËRTIME

Neni 14
Caktimi i Numrave të Adresave në Zonat Urbane

1. Drejtoria komunale përgjegjëse është kompetente të bëjë caktimin e numërtimit të adresave në ndërtesa, objekte dhe parcela kadastrale të lira, për nevoja të Sistemit të Adresave në tërë territorin e Komunës, duke vepruar çdo herë në pajtim më këtë ligj.
2. Drejtoria komunale përgjegjëse, po ashtu cakton një kod të veçantë për secilën ndërtesë, objekt ose parcelë kadastrale të lirë.
3. Drejtoria komunale përgjegjëse vendosë numrat e adresave dhe kodin identifikues të ndërtesës në regjistrin komunal të adresave.
4. Për ndërtesat e reja që planifikohen të ndërtohen në territorin e Komunës, adresa caktohet gjatë procesit të lëshimit të lejes së ndërtimit. Përgjegjësinë për të caktuar numrin e adresës për ndërtesat e planifikuara e ka drejtoria komunale përgjegjëse. Kur ndërtesa të përfundohet dhe miratohet për përdorim, adresa konfirmohet në regjistrin e adresave. Ky rregull aplikohet ndaj të gjithëve për caktimin e numrave për ndërtesat në zonat rurale.

Neni 15
Caktimi i Numrave të Adresave brenda Ndërtesave

Çdo banesë brenda ndërtesës, duke përfshirë edhe zyre dhe lokale duhet të kenë një numër të caktuar. Drejtoria komunale përgjegjëse është kompetente për të caktuar dhe vendosur numrat e adresave për secilën banesë, zyre dhe lokal për nevoja të Sistemit të Adresave në tërë territorin e Komunës.

Neni 16
Caktimi i Numrave të Adresave në Zonat Rurale

Drejtoria komunale përgjegjëse është kompetente për caktimin dhe vendosjen e numrave për shtëpi, objekte dhe parcela kadastrale të lira për nevoja të Sistemit të Adresave brenda territorit të Komunës, duke vepruar çdo herë në pajtim më këtë ligj.

Neni 17
Emërtimi dhe Numërtimi i Urave dhe Tuneleve

Urat dhe tunelet emërtohen dhe numërtohen për qëllim të identifikimit. Në të shumtën e rasteve, masat janë bërë në mes të urës dhe numri vendoset në fund të urës nga të dyja anët. Kompetencat për vendosjen e tabelës i përkasin Komunës ku ndodhet zona.

KREU IV
REGJISTRI I ADRESAVE

Neni 18
Regjistri Komunal i Adresave

Komuna krijon, mirëmban dhe siguron vazhdimisht saktësinë e të dhënave në Regjistrin Komunal të Adresave.

Neni 19
Regjistri Shtetëror i Adresave

1. Ministria krijon dhe administron Regjistrin Shtetëror të Adresave.
2. Regjistri Shtetëror i Adresave zbatohet dhe mirëmbahet nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Neni 20
Shpërndarja e të dhënave nga Regjistri Shtetëror i Adresave

1. Të dhënat nga Regjistri Shtetëror i Adresave u shpërndahen falas Ministrive, institucioneve dhe agjencive qeveritare, komunave, kompanive private, entiteteve joqeveritare dhe personave fizik në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Regjistri Shtetëror i Adresave është pjesë e Infrastrukturës së të Dhënave Nacionale Hapësinore (IDhNH).

KREU V
KRITERET PËR TABELAT E ADRESAVE

Neni 21
Specifikimet teknike për Tabelat, Emrat dhe Numrat

1. Tabelat për emrat e zonave të qarkullimit publik si dhe numrat për ndërtesat dhe hyrjet, prodhohen dhe vendosen duke përdorur praktikat Evropiane më të mira dhe të përshtatshme.
2. Numrat duhet të jenë numra Arab.
3. Shkronjat në tabela duhet të jenë në pajtim me legjislacionin përkatës për përdorimin e gjuhëve në Republikën e Kosovës.
4. Në Komunat ku gjuhët tjera kanë statusin e gjuhës zyrtare, tabelat janë në gjuhët zyrtare të Komunës.

Neni 22
Vendosja e Tabelave të Adresave

Drejtoria komunale përgjegjëse vendosë tabelat e adresave në objekte, ndërtesa dhe në parcela kadastrale të lira brenda territorit të Komunës.

Neni 23
Shpenzimet për vendosjen e Tabelave të Adresave

1. Shpenzimet e vendosjes së tabelave të adresave në zonat e qarkullimit publik mbulohen nga buxheti komunal i Komunës në të cilën ndodhet zona.
2. Shpenzimet për vendosjen e tabelave të adresave në ndërtesa dhe brenda tyre për herë të parë, mbulohet nga buxheti Komunal i Komunës.

KREU VI
PËRGJEGJËSITË E KOMUNËS

Neni 24
Përgjegjësitë e Komunës

1. Komuna cakton emrat dhe numrat e veçantë për të gjitha objektet ndërtesat, banesat, dhe parcelat kadastrale të lira, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.
2. Të gjitha elementet e adresës në Komunë regjistrohen dhe mirëmbahen nga stafi ekzistues i drejtorisë përgjegjëse në regjistrat komunale të adresave në pajtim më dispozitat e këtij ligji.
3. Komuna nuk lëshon leje ndërtimi përveç nëse është caktuar adresa dhe është përfshirë në lejen e ndërtimit.
4. Komuna koordinon proceset e emërtimeve dhe numërtimeve me komunën fqinje në rast të zonave ndër-komunale të qarkullimit publik.
5. Komuna njofton pronarët e pronave dhe banorët për emrin dhe numrin e zonës së qarkullimit publik në të cilën ata banojnë.
6. Komuna është përgjegjëse për sigurimin dhe vendosjen e tabelave me emra dhe numra për të gjitha zonat ekzistuese të qarkullimit publik.
7. Komuna është përgjegjëse për sigurimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha tabelave me emra, brenda territorit të saj.
8. Komuna mirëmban të dhënat në Regjistrin Komunal të Adresave duke siguruar që të gjitha të dhënat janë të plota, korrekte dhe të përditësuara

KREU VII
PËRGJEGJËSITË E MINISTRIVE KOMPETENTE

Neni 25
Përgjegjësitë e Ministrive

1. Ministria në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për Qeverisje Lokale, Ministrinë përgjegjëse për Punë të Brendshme dhe Komunat janë përgjegjëse për zbatimin e tërë Sistemit të Adresave në Republikën e Kosovës.

2. Ministria siguron koordinim ndërmjet institucioneve qeveritare dhe komunale dhe siguron mundësi teknike dhe financiare për zbatimin uniform të sistemit të adresave.
3. Ministria është përgjegjëse për shqyrtimin e emërtimeve të vendosura nga Komunat për zonat e qarkullimit publik dhe t'i njoftojë komunat në rast të shkeljes së këtij ligji.
4. Ministria krijon dhe administron Regjistrin Shtetëror të Adresave.
5. Ministria shpërndanë të dhënat nga Regjistri Shtetëror i Adresave në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

KREU VIII
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 26
Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Ministria dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës sigurojnë harta, Udhëzime Administrative manuale dhe udhërrëfyes të përshtatshëm për Komunat në mënyrë që të fillojnë zbatimin e Sistemit të Adresave.
2. Brenda gjashtë (6) muajve nga miratimi i akteve nënligjore të parapara më këtë ligj, Komunat i identifikojnë të gjitha zonat e qarkullimit publik dhe vendosin emra për ato në pajtim me dispozitat e këtij ligji.
3. Brenda dymbëdhjetë (12) muajve nga miratimi i akteve nënligjore të parapara më këtë ligj, Komunat i caktojnë numrat për të gjitha ndërtesat, objektet dhe parcelat kadastrale të lira ekzistuese, për caktimin e numrave të saktë.
4. Brenda tetëmbëdhjetë (18) muajve nga miratimi i akteve nënligjore të parapara më këtë ligj, Komunat caktojnë numra për hyrjet e ndërtesave dhe banesave brenda ndërtesave ekzistuese, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.
5. Brenda njëzet e katër (24) muajve nga miratimi i akteve nënligjore të parapara më këtë ligj, Komuna regjistron, bënë emërtimet dhe numërtimet e zonave të qarkullimit publik, objekteve dhe ndërtesave dhe të njëjtat i regjistron në regjistrin komunal të adresave, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 27
Nxjerrja e Udhëzimeve Administrative

1. Ministria dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës janë përgjegjëse për nxjerrjen e këtyre Udhëzimeve Administrative:
   1.1. udhëzim Administrativ për renditjen e elementeve të adresave dhe caktimin e formatit të shkronjave, numrave dhe të tabelave të adresave;
   1.2. udhëzim Administrativ për caktimin e emërtimit dhe numërtimit të adresave për zona të qarkullimit publik, ndërtesa, shtëpi, objekte dhe parcela kadastrale të lira;
   1.3. udhëzim Administrativ për vendosjen fizike të tabelave të adresave në zona të qarkullimit publik, ndërtesa, shtëpi, objekte dhe parcela kadastrale të lira;
   1.4. udhëzim Administrativ për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtime, listës rezerve dhe vendosjen e tyre nga Regjistrin Komunal të Adresave;

1.5. udhëzim Administrativ për procedurat e krijimit dhe administrimit të Regjistrit Komunal të Adresave dhe Regjistrit Shtetëror të Adresave**;**

1.6. Ministria nxjerrë edhe Udhëzime tjera administrative për zbatimin e këtij ligji.

2. Ministria dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës janë përgjegjëse për nxjerrjen e këtyre Udhëzimeve Administrative, në afat prej gjashtë (6) muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 28
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-071
8 dhjetor 2011

Shpallur me dekretin Nr. DL-052-2011, datë 21.12.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 29 / 27 DHJETOR 2011, PRISHTINË

LIGJI Nr. 04/L-036
PËR STATISTIKAT ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Përmbajtja

Kreu I: Dispozita të përgjithshme 595
Kreu II: Parimet themelore të statistikave zyrtare 597
Kreu III: Organizimi, pozita, punët dhe koordinimi i sistemit të statistikave zyrtare 599
Kreu IV: Masat planifikuese, programuese dhe zbatuese 602
Kreu V: Grumbullimi i të dhënave 604
Kreu VI: Përpunimi dhe ruajtja e të dhënave statistikore 605
Kreu VII: Regjistrat statistikorë 606
Kreu VIII: Shpërndarja dhe përdorimi i statistikave zyrtare 607
Kreu IX: Fshehtësia dhe ruajtja e të dhënave statistikore 608
Kreu X: Bashkëpunimi statistikor ndërkombëtar 611
Kreu XI: Dispozitat ndëshkuese 611
Kreu XII: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 613

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Me qëllim të rregullimit të statistikave zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me standardet ndërkombëtare për statistikat,

Miraton

LIGJ PËR STATISTIKAT ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i Ligjit

1. Qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë parimet themelore dhe të krijojë bazën ligjore për organizimin, prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare të Kosovës.
2. Qëllimi i statistikave zyrtare është mbledhja, përpunimi dhe shpërndarja e të dhënave për qëllime statistikore për aktivitetet ekonomike, sociale dhe kushtet e përgjithshme në Kosovë, si dhe i sigurojnë Kosovës përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare në prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare.

Neni 2
Përkufizime

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **Statistikat -** informata përfundimtare të dala nga përpunimi dhe analizimi i të dhënave, të cilat karakterizojnë fenomene kolektive për një popullim të dhënë;
   1.2. **Statistika zyrtare -** informata të dala nga procedimi i të dhënave me qëllim të karakterizimit të fenomeneve kolektive në popullatë brenda kornizës së zbatimit të programit të statistikave zyrtare, që është nën autoritetin e Agjencisë të Statistikave të Kosovës (në tekstin në vijim si ASK-ja), Banka Qendrore e Kosovës dhe Ministria kompetente Financave;
   1.3. **Prodhim statistikor** - të gjitha veprimtaritë e nevojshme për përgatitjen, grumbullimin, përpunimin, analizimin, interpretimin, shpërndarjen dhe ruajtjen e të dhënave statistikore;
   1.4. **Hulumtim statistikor -** metodë përmbajtjesore e vjeljes dhe e grumbullimit të dhënave me të cilën bartësit e statistikave zyrtare i grumbullojnë të dhënat drejtpërdrejt nga njësia raportuese statistikore ekskluzivisht për qëllime statistikore;
   1.5. **Formulari statistikor -** çdo shënim-dokument i shkruar në letër ose në formë elektronike me të cilin grumbullohen të dhënat nga njësitë raportuese statistikore;
   1.6. **Grumbullimi i të dhënave** - aktivitete për zbatimin e hulumtimeve statistikore, shfrytëzimin nga bartësit e statistikave zyrtare të të dhënave administrative dhe të dhënave të grumbulluara përmes metodave të përcjelljes dhe vëzhgimit, për qëllime të statistikave zyrtare;
   1.7. **Njësia raportuese** - te gjitha njësitë që mund të nxjerrin të dhëna statistikore siç janë: institucionet e ndryshme qeveritare, joqeveritare, personat fizike, ekonomitë familjare, ndërmarrjet apo operatorët ekonomik ku, në rast se kërkohen të dhëna nga ASK-ja ato njësi do të bashkëpunojnë dhe do ti raportojnë ASK-së.
   1.8. **Njësia statistikore -** njësia themelore e mbikëqyrjes, respektivisht një person fizik, ekonomi shtëpiake, operator ekonomik dhe ndërmarrje të tjera, të referuara nga të dhënat;
   1.9. **Veprimtari tjetër statistikore** - veprimtaria statistikore, që nuk është përfshirë në Program;
   1.10. **Identifikuesit -** emrat, adresat ose ndonjë kod tjetër i përcaktuar qartë, që është në gjendje të zbulojë identitetin e një njësie raportuese statistikore;
   1.11. **Shpërndarje -** të gjitha aktivitetet për qasje në të dhëna statistikore për të gjithë shfrytëzuesit, përveç rasteve të ndaluara me dispozita ligjore;
   1.12. **Shfrytëzuesi i të dhënave -** çdo person fizik dhe juridik, institucionet shtetërore, ato shkencore dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare, të cilat i shfrytëzojnë të dhënat statistikore;
   1.13. **Regjistrat statistikorë -** listat nominale të njësive raportuese, të cilat në vazhdimësi përditësohen dhe shfrytëzohen ekskluzivisht për qëllime statistikore;

1.14. **Lënda statistikore -** grumbulli i dokumenteve, të cilat përmbajnë: bazat metodologjike, formularët statistikorë, udhëzuesit, raportet, studimet dhe analizat statistikore, pasqyrat përmbledhëse, rezultatet, publikimet dhe aktet e tjera, të cilat rezultojnë nga kryerja e punëve të statistikave zyrtare;
1.15. **Plani testues -** plani për një test gjatë një hulumtimi statistikor;
1.16. **Frekuenca -** afatet kohore për një veprim.

KREU II
PARIMET THEMELORE TË STATISTIKAVE ZYRTARE

Neni 3
Parimet e statistikave zyrtare

1. Për të siguruar cilësinë e statistikave zyrtare dhe për të ruajtur besimin e opinionit të gjerë, si dhe për organizimin dhe zbatimin e Programit, statistikat zyrtare, sipas këtij ligji, udhëhiqen nga parimet e mëposhtme:
   1.1. **Parimi i relevancës:** Të dhënat statistikore duhet patjetër t`i plotësojnë kërkesat e caktuara sa i përket informimit të qartë e që kanë të bëjnë me qëllimin e statistikave zyrtare. Kërkesat përcaktojnë fushat, afatet dhe përfshirjen e statistikave, të cilat duhet të përfshijnë ndryshimet e reja demografike, ekonomike, bujqësore, arsimore, sociale dhe ambientale në çdo kohë. Mbledhja e të dhënave duhet të kufizohet në nevojën për arritje të rezultateve të pritura. Të dhënat statistikore duhet të verifikohen në mënyrë periodike, ndërsa nevojat e rëndësishme për të dhënat statistikore duhet të identifikohen me kohë;
   1.2. **Parimi i paanshmërisë**, nënkupton se statistikat duhet të zhvillohen, prodhohen dhe shpërndahen në mënyrë të paanshme dhe se të gjithë shfrytëzuesit duhet të trajtohen njësoj;
   1.3. **Parimi i objektivitetit**, nënkupton se statistikat duhet të zhvillohen, prodhohen dhe shpërndahen në mënyrë sistematike, të besueshme dhe të paanshme; përfshin shfrytëzimin profesional dhe standardet etike, d.m.th se politikat dhe praktikat janë transparente për shfrytëzuesit dhe respondentët e anketave;
   1.4. **Parimi i besueshmërisë,** përfshin metodat dhe procedurat, të cilat kanë të bëjnë me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave statistikore. Ato caktohen në bazë të standardeve profesionale, metodave shkencore dhe parimeve të etikës profesionale;
   1.5. **Parimi i ekonomizimit të mjeteve financiare publike/Kosto-efektiviteti:** Shfrytëzimi optimal i të gjitha resurseve të disponueshme dhe minimizimi i barrës së njësive raportuese.
   1.6. **Parimi i pavarësisë profesionale:** Statistikat zyrtare zhvillohen, prodhohen dhe shpërndahen në mënyrë të pavarur, sidomos sa i përket zgjedhjes së teknikave, përkufizimeve, metodologjive, burimeve që do të shfrytëzohen, kohës dhe përmbajtjes së të gjitha formave të shpërndarjes, të lira nga çfarëdo presioni nga grupet e interesit apo grupet politike, nga autoritetet kombëtare, pa cenuar vendosjen institucionale ose buxhetore apo përkufizimet e nevojave statistikore;

1.7. **Parimi i transparencës:** E drejta e njësive raportuese statistikore që të jenë të njoftuara me detyrim ligjor, që të japin të dhëna, si dhe marrjen e masave për mbrojtjen e të dhënave statistikore. Po ashtu, transparenca nënkupton se rezultatet e statistikave zyrtare duhet të jenë në dispozicion të të gjithë shfrytëzuesve;

1.8. **Parimi i fshehtësisë statistikore,** nënkupton mbrojtjen e të dhënave statistikore, që janë mbledhur direkt ose indirekt. Fshehtësia statistikore përfshin edhe ndalim - shfrytëzimin e të dhënave statistikore të mbledhura për qëllime jostatistikore dhe publikimin kundërligjor të të dhënave statistikore;

1.9. **Parimi i koordinimit dhe harmonizimit:** ASK-ja koordinon sistemin shtetëror të statistikave dhe është përgjegjëse për harmonizimin e të dhënave zyrtare statistikore;

1.10. **Parimi i shfrytëzimit i të dhënave individuale ekskluzivisht për qëllime statistikore,** nënkupton se të dhënat individuale statistikore të grumbulluara me zbatimin e aktiviteteve statistikore mund të shfrytëzohen vetëm në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe të legjislacionit tjetër në fuqi lidhur me këtë çështje.

Neni 4
Cilësia e statistikave zyrtare

1. Në mënyrë që të garantohet cilësia e rezultateve, statistikat zyrtare duhet të zhvillohen, prodhohen dhe shpërndahen në bazë të standardeve të njëjta dhe metodave të harmonizuara. Në këtë aspekt, do të aplikohen kriteret e cilësisë si në vijim:
   1.1. **"relevanca"**, e cila i referohet shkallës deri në të cilën statistikat i plotësojnë nevojat e mundshme dhe aktuale të shfrytëzuesve;
   1.2. **"saktësia"**, e cila i referohet afërsisë së vlerësimeve për vlerën e drejtë të panjohur;
   1.3. **"afatet"**, i referohen periudhës ndërmjet disponueshmërisë së informatave dhe ngjarjes apo fenomenit që përshkruhet;
   1.4. **"përpikëria"**, e cila i referohet vonesës ndërmjet datës së lëshimit të të dhënave dhe datës së planifikuar (data kur duhet të dorëzohen të dhënat);
   1.5. **"qasja"** dhe **"qartësia"**, e cila iu referohet kushteve dhe modaliteteve, sipas të cilave shfrytëzuesit mund të marrin, të shfrytëzojnë apo të interpretojnë të dhënat;
   1.6. **"krahasueshmëria"**, e cila i referohet masës së ndikimit të diferencës në konceptet e aplikuara statistikore, mjeteve matëse dhe procedurave ku statistikat krahasohen ndërmjet zonave gjeografike, domeneve sektoriale dhe kalimit të kohës,
   1.7. **"koherenca"**, e cila i referohet përshtatshmërisë së të dhënave që do të kombinohen në mënyra të ndryshme dhe për përdorime të ndryshme.
2. ASK-ja dhe autoritetet të tjera, në rast se kërkohet, u japin raport mbi cilësinë e të dhënave të transmetuara organeve kompetente të BE-së.

KREU III
ORGANIZIMI, POZITA, PUNËT DHE KOORDINIMI I SISTEMIT TË STATISTIKAVE ZYRTARE

Neni 5
Bartësit e statistikave zyrtare

1. Punët e statistikave zyrtare i kryejnë bartësit e caktuar të statistikave zyrtare:
   1.1. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK-ja);
   1.2. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;
   1.3. Ministria kompetente e financave;
   1.4. Organet e tjera të autorizuara të Agjencisë së Statistikave të Kosovës të caktuara me Program.

Neni 6
Statusi dhe financimi i ASK-së

1. ASK-ja është institucion profesional, i pavarur, bartës dhe shpërndarës i statistikave zyrtare dhe koordinator i statistikave zyrtare të Kosovës, e cila vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM-ë).
2. Organizimi i ASK-së miratohet nga Kryeministri, pas propozimit të ASK-së.
3. Të punësuarit e ASK-së kanë statusin e paraparë me dispozitat ligjore për Shërbimin Civil.
4. Rekrutimi i punëtorëve të ASK-së bëhet sipas rregullave në fuqi për shërbimin civil të Kosovës.
5. ASK-ja, për raste të veçanta, ka të drejtë të angazhojë punëtorë me marrëveshje për shërbime të veçanta në pajtim me legjislacionin në fuqi.
6. ASK-ja financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe nga donatorët, sipas ligjit të aplikueshëm.
7. ASK-ja është organizatë buxhetore autonome me kod të vet buxhetor.
8. ASK-ja krijon të hyra vetanake nga shërbimet e parapara me ligj, të cilat menaxhohen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 7
Përgjegjësitë dhe të drejtat e ASK-së

1. ASK-ja ka përgjegjësi të përgjithshme në prodhimin e statistikave zyrtare dhe për çështje që parashihen në Programin e statistikave zyrtare.
2. Detyrat e ASK-së janë:
   2.1. të përgatisë Projekt programin dhe Planin vjetor të statistikave zyrtare, në konsultim me Këshillin e Agjencionit të Statistikave të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Këshilli);
   2.2. të përgatisë dhe të organizojë përmbushjen e aktivitetit zyrtar të caktuar me Program;
   2.3. të përcaktojë dhe të zhvillojë metodologjinë statistikore, klasifikimin dhe standardet për prodhimin e statistikave zyrtare;

2.4. të mbledhë të dhëna të nevojshme statistikore, të zbërthejë, të analizojë, të publikojë dhe të shpërndajë rezultatet statistikore;
2.5. të ofrojë ndihmë profesionale dhe shpjegime teknike të rezultateve për të evituar interpretimin e gabueshëm të të dhënave të ofruara nga statistikat zyrtare;
2.6. të ndërmarrë studime dhe hulumtime për zhvillimin e mëtejshëm të metodologjisë dhe teknologjisë statistikore;
2.7. të monitorojë zbatimin e detyrave statistikore të ngarkuara nga autoritete të tjera me Programin statistikor;
2.8. ti paraqesë, përmes Kryeministrit, për miratim Qeverisë dhe Kuvendit raportin mbi zbatimin e planit, programit dhe shfrytëzimin e mjeteve buxhetore. Raporti vjetor i miratuar publikohet;
2.9. të rrisë aftësinë dhe njohuritë statistikore dhe njohuritë e nëpunësve për fushën e statistikave zyrtare;
2.10. të bashkëpunojë me Universitete për promovimin e njohurive për statistikat;
2.11. të bashkëpunojë me organizatat vendore dhe ndërkombëtare kompetente për statistikat zyrtare, për të mundësuar krahasimin e statistikave zyrtare me statistikat e prodhuara në sisteme të tjera statistikore.

3. Gjatë kryerjes së detyrave ASK-ja ka të drejtë:
3.1. të kërkojë nga njësitë raportuese statistikore të japin të dhëna për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në Program;
3.2. të kërkojë të dhëna administrative dhe statistikore nga ministritë apo nga institucionet e tjera;
3.3. të ndërmarrë çfarëdo aktiviteti tjetër për të përmbushur përgjegjësitë dhe detyrat, siç parashihen me këtë ligj.
3.4. të dhënat statistikore, të parapara sipas këtij neni, janë të obliguara t'i ofrojnë të gjitha njësitë e institucioneve, përveç nëse parashihet ndryshe me ndonjë akt tjetër ligjor.

Neni 8
Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së

1. Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së emërohet sipas legjislacionit në fuqi për emërimin e zyrtarëve të lartë civilë.
2. Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së për punën e vet i përgjigjet drejtpërdrejt Kryeministrit.
3. Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së është përgjegjës për:
3.1. administrimin dhe kryerjen e detyrave të ASK-së;
3.2. propozimin e strukturës organizative të ASK-së;
3.3. përfaqësimin e ASK-së me palët e treta si në nivel kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar;
3.4. përgatitjen për çdo vit të propozimeve për ndryshime dhe plotësime të Programit, duke u bazuar në këshillat që i jep Këshilli;
3.5. udhëheqjen në mënyrë efikase dhe efektive me mjetet që i ofrohen ASK-së nga Buxheti i Kosovës ose nga çfarëdo burimesh të tjera;
3.6. pjesëmarrje dhe diskutim në të gjitha mbledhjet e Këshillit dhe

3.7. zbatimin e detyrave të tjera, që përcaktohen me Program, me Plan dhe me vendime Zyrës së Kryeministrit dhe të Qeverisë së Kosovës.

Neni 9
Përbërja e Këshillit Statistikor

1. Këshilli përbëhet nga kryetari dhe dymbëdhjetë (12) anëtarë. Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së është anëtar i Këshillit. Anëtarë të Këshillit janë nga një përfaqësues i:
   1.1. Ministrisë kompetente të Financave;
   1.2. Ministrisë kompetente të Tregtisë dhe të Industrisë;
   1.3. Ministrisë kompetente të Arsimit;
   1.4. Ministrisë kompetente të Shëndetësisë;
   1.5. Zyrës për Planifikim Strategjik;
   1.6. Bankës Qendrore të Kosovës;
   1.7. Administratës Tatimore;
   1.8. Ministrisë kompetente të Punës dhe Mirëqenies Sociale;
   1.9. Ministrisë kompetente të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
   1.10. Universiteti, ekspert i njohur për hulumtime në fushën e statistikave; dhe
   1.11. shoqërisë civile, që përfaqëson organizatat e qendrave kërkimore, dhe
   1.12. Komunitetit të Biznesit.
2. Anëtarët e Këshillit caktohen nga institucionet e cekura në paragrafin 1. të këtij neni. Eksperti i njohur për hulumtime në fushën e statistikave emërohet nga Universiteti, nga radhët e personelit akademik të institucionit përkatës, në bazë të kritereve të përcaktuara nga ASK-ja, ndërsa anëtarët që përfaqësojnë organizatat e qendrave kërkimore dhe komunitetin e biznesit emërohen nga vetë Këshilli.
3. Anëtarët e Këshillit nga institucionet emërohen nga radhët e shërbyesve civilë të institucionit përkatës, në bazë të kritereve të përcaktuara nga ASK-ja.
4. Anëtarët e Këshillit caktohen në bazë të kualifikimit profesional.
5. Të gjithë anëtarët e Këshillit emërohen për një periudhë pesë (5) vjeçare.

Neni 10
Funksionet dhe detyrat e Këshillit

1. Këshilli themelohet për të dhënë këshilla për përgatitjen dhe zbatimin e Programit të statistikave zyrtare dhe për zhvillimin e përgjithshëm dhe funksionimin e ASK-së.
2. Në përmbushje të mandatit, Këshilli kryen këto detyra:
   2.1. jep rekomandime për përgatitjen e Projekt programit të statistikave zyrtare, jep mendime dhe këshilla për ndryshimet, plotësimet e Programit dhe të Planit Vjetor;
   2.2. ofron mendime dhe këshilla për amendamentet, shtesat e Programit dhe të Planit Vjetor;
   2.3. krijon grupe punuese për zhvillimin e direktivave statistikore, për bashkimin e fushave statistikore në sistemin statistikor të Kosovës;
   2.4. thërret seanca në lidhje me progresin e arritur nga grupet punuese;
   2.5. monitoron, vlerëson dhe jep këshilla për zbatimin e Programit;

2.6. jep mendime për ligjet dhe akte të tjera ligjore, që kanë të bëjnë me aktivitetet apo prodhuesit e statistikave zyrtare;
2.7. jep mendime për zhvillimin e sistemit të statistikave zyrtare dhe bashkëpunimin ndërkombëtar;
2.8. jep mendime për çështje të tjera me rëndësi për punën e statistikave zyrtare;
2.9. komenton situatën buxhetore të zbatimit të Programit;
2.10. Këshilli paraqet raportin vjetor për punën e tij në Zyrën e Kryeministrit dhe në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Neni 11
Organizimi i Këshillit Statistikor

1. Në takimin e parë, Këshilli vendos për përfaqësuesin e shoqërisë civile dhe të komunitetit të biznesit.
2. Këshilli vepron në bazë të Rregullave Procedurale, të cilat miratohen brenda tre (3) muajve pas themelimit të Këshillit.
3. Këshilli emëron kryesuesin dhe një zëvendëskryesues nga radhët e anëtareve të tij.
4. ASK-ja mbështet teknikisht dhe përmes administratës veprimtarinë e Këshillit.
5. ASK-ja financon aktivitetet e Këshillit nga buxheti i vet.

Neni 12
Zbatimi i statistikave zyrtare nga autoritetet e tjera

1. Për të zbatuar statistika zyrtare, përveç ASK-së, Bankës Qendrore të Kosovës dhe Ministrisë kompetente të Financave me Programin e Statistikave Zyrtare, mund të ngarkohen edhe organe të tjera.
2. Metodat, klasifikimet dhe standardet e përdorura nga këto organe përcaktohen nga ASK-ja, në pajtim me Programin e Statistikave Zyrtare dhe me Planin Vjetor.
3. ASK-ja, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe Ministria kompetente e Financave i shpallin rezultatet në publikimet e veta.

KREU IV
MASAT PLANIFIKUESE, PROGRAMUESE DHE ZBATUESE

Neni 13
Programi i Statistikave Zyrtare

1. Programi i Statistikave Zyrtare siguron kornizën për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare në Kosovë.
2. Projekt programin e statistikave zyrtare e harton ASK-ja, me rekomandimin e Këshillit dhe në konsultim me shfrytëzuesit dhe me prodhuesit e statistikave zyrtare për një periudhë, e cila nuk mund të jetë më e shkurtër se pesë (5) vjet dhe në harmoni me Programin Statistikor të Bashkësisë Evropiane.
3. Programin e statistikave zyrtare e aprovon Qeveria dhe ai shpallet në "Gazetën Zyrtare".

4. Programi përfshin hulumtimet statistikore, të nevojshme për sigurimin e të dhënave mbi gjendjen demografike, sociale, ekonomike, bujqësore dhe mjedisore në Kosovë, duke u përqendruar në fenomene thelbësore për vendimmarrësit, si dhe duke respektuar të drejtën e qytetarëve për mbrojtjen e të dhënave personale.
5. ASK-ja harton Projekt propozimin e Programit për periudhat që janë të krahasueshme me periudhat e përcaktuara në Programin Statistikor të Bashkësisë Evropiane.

Neni 14
Përmbajtja e Programit

1. Programi, për secilin element të tij specifikon përfshirjen, llojin, frekuencën dhe temat e karakteristikave, që duhet të nxirren nga burime të rëndësishme.
2. Nëse nuk parashikohet ndryshe në Program, kërkimet dhe anketimet do të zbatohen drejtpërdrejt nga Programi dhe njësitë e ngarkuara obligohen të ofrojnë informatat e nevojshme për prodhimin e statistikave përkatëse.

Neni 15
Plani vjetor

1. Për të përmbushur Programin, ASK-ja harton për çdo vit propozimin e Planit Vjetor deri më 31 maj për vitin e ardhshëm.
2. Propozimin e Planit e harton ASK-ja, në konsultim me shfrytëzuesit dhe me prodhuesit e statistikave zyrtare.
3. Me Planin Vjetor caktohet skema e resurseve të përgjithshme, të nevojshme e të parapara me Buxhetin e Republikës së Kosovës.
4. Planin vjetor e aprovon Qeveria e Kosovës dhe ai shpallet në “Gazetën Zyrtare”.

Neni 16
Hulumtimet statistikore

1. Hulumtimet statistikore përfshijnë:
   1.1. bartësin e statistikave zyrtare,
   1.2. emërtimin e kërkimit statistikor,
   1.3. periudhën e kërkimit,
   1.4. njësitë raportuese statistikore,
   1.5. mënyrën e grumbullimit të të dhënave,
   1.6. afatet e grumbullimit të të dhënave,
   1.7. detyrimin e ofrimit të të dhënave,
   1.8. lidhjen me rezultatet ose aktivitetet përbrenda Programit,
   1.9. afatet dhe niveli i shpalljes së rezultateve, dhe
   1.10. standardet relevante ndërkombëtare.

Neni 17
Raportimi

Raportin mbi zbatimin e Planit Vjetor e harton ASK-ja në pajtim me kërkesat e Ministrisë dhe Qeverisë për përgatitjen e raporteve vjetore.

Neni 18
Aktivitetet e jashtëzakonshme statistikore

1. Në rastet e jashtëzakonshme, pas miratimit nga Qeveria, ASK-ja do të kryejë aktivitetet statistikore, të cilat nuk janë përcaktuar me Programin dhe Planin Vjetor.
2. Të dhënat e fituara nga zbatimi i aktiviteteve statistikore nga paragrafi 1. i këtij neni janë të dhëna statistikore zyrtare.

KREU V
GRUMBULLIMI I TË DHËNAVE

Neni 19
Burimet e të dhënave

1. ASK-ja ka të drejtë të nxjerrë të dhënat e nevojshme për statistikat zyrtare nga të gjitha burimet e kërkuara nga njësitë statistikore, prej dokumentacionit administrativ apo prej parashikimeve, bazuar në informacionin që disponon ASK-ja.
2. Burimet e të dhënave që kërkohen nga njësitë statistikore përcaktohen nga ASK-ja, duke u bazuar në cilësi, afate, kosto dhe në barrën e përgjegjësve.

Neni 20
E drejta në informim

Njësitë statistikore, të cilave u kërkohet informacion për statistikat zyrtare, kanë të drejtë të informohen për qëllimin dhe shtrirjen e kërkimit apo anketimit, bazën juridike, masat e marra për sigurimin e fshehtësisë statistikore të kërkimit si dhe për të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Neni 21
Obligimi i dhënies së informatave

1. Njësitë statistikore, personat fizikë dhe juridikë, pa marrë parasysh nëse janë apo jo persona juridikë, janë të obliguar t'u japin ASK-së dhe prodhuesve të statistikave zyrtare informata të sakta, të plota dhe të përditësuara, pa kompensim, me përmbajte dhe formë, të cilat i cakton bartësi i statistikave zyrtare.
2. Për kërkimet testuese, dhënia e informatave i obligon vetëm ato njësi që përfshihen në planin testues me qëllim të kontrollimit të cilësisë së testeve.
3. Plani testues përpunohet nga ASK-ja, duke marrë parasysh përfaqësimin dhe kufizimin e barrës së përgjegjësve.

4. Askush nuk është i detyruar të ofrojë të dhëna nëse kërkimet statistikore nuk janë përcaktuar me Planin Vjetor, me Program ose me vendimin e Qeverisë së Kosovës sipas këtij ligji, përkatësisht nëse obligimi i dhënies së të dhënave nuk është paraparë me këtë ligj ose me ligj tjetër.

Neni 22
Përmirësimi i informatave të dhëna

Nëse të dhënat pasqyruese të njësive statistikore nuk janë të sakta, të plota dhe të përditësuara, njësitë statistikore janë të detyruara t'i përmirësojnë ato, përkatësisht t'i plotësojnë, siç kërkohet me udhëzime dhe brenda afateve të parapara.

Neni 23
Qasja në të dhënat administrative

1. Të gjitha organet e administratës publike janë të detyruara t'i lejojnë ASK-ës qasje në burimet e të dhënave administrative nga sistemi i administratës publike si: informatat e mbledhura, të përpunuara dhe të ruajtura në regjistra dhe dosje të tjera të të dhënave nën fushëveprimin dhe kompetencën e tyre për nevoja të prodhimit të statistikave zyrtare, njëkohësisht duke evituar imponimin e barrës mbi njësitë në fjalë.
2. Të dhënat për qëllime statistikore mund të nxirren edhe nga regjistrat publikë dhe nga burimet administrative të të dhënave, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 24
Kërkimet testuese

1. Në rastet kur duhet të bëhet vlerësimi i metodologjisë dhe i cilësisë së burimeve të të dhënave, të cilat synohen të mblidhen me kërkime statistikore, ASK-ja dhe bartësit e tjerë të statistikave zyrtare, me autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv të ASK-së, mund të bëjnë kërkime, testuese edhe në ato raste kur kërkimet nuk janë paraparë me Planin Vjetor ose me ndonjë ligj tjetër të veçantë.
2. Të dhënat e grumbulluara nga kërkimet statistikore, që parashihen në paragrafin 1. të këtij neni, nuk janë të dhëna statistikore zyrtare dhe ato nuk kanë të bëjnë me dispozitat e këtij ligji mbi opinionin dhe shpërndarjen e të dhënave, por aplikohen dispozitat e besueshmërisë.

KREU VI
PËRPUNIMI DHE RUAJTJA E TË DHËNAVE STATISTIKORE

Neni 25
Përpunimi i të dhënave statistikore

Bartësit e statistikave zyrtare janë të detyruar që pas përfshirjes, rregullimit dhe kodimit të të dhënave të grumbulluara, ose të dhënave të marra nga burimet administrative dhe shfrytëzimit të atyre për përditësimin e regjistrave statistikorë, t'i veçojnë identifikuesit prej variabëlve të përmbajtjes.

Neni 26
Ruajtja e të dhënave statistikore

1. Bartësit e statistikave zyrtare janë të obliguar që formularët statistikorë prej letre, të cilët përmbajnë të dhëna të grumbulluara në kërkimet statistikore, ruhen dhe mbrohen në përputhje me Ligjin për qasje në dokumente zyrtare, pasi të ketë përfunduar faza e përfshirjes, rregullimit, koordinimit dhe e përpunimit të të dhënave.
2. Lëndën statistikore e dokumentojnë dhe e arkivojnë bartësit e statistikave zyrtare të Kosovës.
3. Materiali statistikor ruhet në mënyrë që të pengohet shkatërrimi, keqpërdorimi, tjetërsimi, keqinterpretimi dhe zbulimi i tij, bazuar në ligjin në fuqi mbi materialin arkivor dhe arkivat.
4. Zyra e Kryeministrit nxjerr akte nënligjore me të cilat rregullon mënyrën e ruajtjes, kohën, teknikën dhe organizimin e ruajtjes së lëndës statistikore bazuar në ligjin në fuqi mbi materialin arkivor dhe arkivat.

KREU VII
REGJISTRAT STATISTIKORË

Neni 27
Regjistrat statistikorë

1. ASK-ja është përgjegjëse për krijimin, ruajtjen dhe mbajtjen e këtyre regjistrave statistikorë:
   1.1. regjistrin e popullsisë,
   1.2. regjistrin e ekonomive familjare,
   1.3. regjistrin e shtëpive dhe të banesave,
   1.4. regjistrin e bizneseve,
   1.5. regjistrin e njësive hapësinore,
   1.6. regjistrin e ekonomive bujqësore dhe të regjistrave të tjerë në pajtim me planet dhe vendimet.
2. Krijimi, ruajtja, mbajtja dhe shfrytëzimi i të dhënave të regjistrave statistikorë sipas paragrafit 1. të këtij neni rregullohet me akte nënligjore, të cilat i nxjerr Institucioni kompetent për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 28
Shfrytëzimi i të dhënave nga regjistrat statistikorë

1. Të dhënat nga regjistrat statistikorë shfrytëzohen ekskluzivisht për qëllime statistikore, përkatësisht me qëllim të përgatitjes së të dhënave përmbledhëse.
2. Të dhënat nga regjistrat statistikorë nuk duhet t`u jepen shfrytëzuesve në formën dhe mënyrën e cila iu mundëson zbulimin e njësisë me të cilën kanë të bëjnë të dhënat.

Neni 29
Standardet e klasifikimit

1. ASK-ja i shfrytëzon të dhënat nga burimet administrative të të dhënave, nga regjistrimet, nga kërkimet statistikore dhe nga të dhënat të mbledhura me metodën e anketimit, vrojtimit dhe të përcjelljes për qëllime statistikore, siç është modeli dhe korniza e zgjeruar për hulumtime statistikore.
2. ASK-ja ka të drejtë të bëjë përshtatjen e të dhënave të fituara nga burimet administrative të të dhënave në mënyrë që ato t`i harmonizojë me përkufizimet dhe klasifikimet që përdoren për regjistrat statistikorë të cilët i mban.
3. Të dhënat e caktuara nga regjistrat statistikorë mund t'u jepen bartësve të tjerë të statistikave zyrtare, nëse ato përdoren vetëm për identifikimin e njësive përgjegjëse për përfshirje në hulumtime statistikore në përgjegjësinë e tyre. Format përkatëse të hulumtimeve duhet të aprovohen nga ASK-ja.
4. ASK-ja bën ndarjen e shifrës numerike si identifikues unik për çdo njësi në regjistrin statistikor, pavarësisht nga shifra e cila shfrytëzohet nga subjektet e tjera për të dhënat e tyre administrative.
5. Zyra e Kryeministrit nxjerr akte nënligjore me të cilat përcakton rregullat mbi standardet e klasifikimit për aktivitete ekonomike dhe prodhime, për njësitë statistikore për vrojtim dhe analiza të sistemit të prodhimit dhe për krijimin e regjistrave biznesor për qëllime statistikore.
6. Obligohen njësitë statistikore dhe të gjitha Institucionet e Republikës së Kosovës të implementojnë produktin e ri të klasifikuar ndërkombëtar në sistemin e brendshëm të të dhënave të kërkuar nga ASK-ja.

KREU VIII
SHPËRNDARJA DHE PËRDORIMI I STATISTIKAVE ZYRTARE

Neni 30
Masat e shpërndarjes

1. Shpërndarja e statistikave zyrtare bëhet në pajtim të plotë me parimet statistikore, sipas nenit 3 të këtij ligji, e në veçanti në lidhje me ruajtjen e fshehtësisë statistikore dhe sigurimin e qasjes së barabartë sipas parimit të paanësisë.
2. Autoritetet e statistikave zyrtare bëjnë shpërndarjen e statistikave brenda fushës përkatëse të kompetencave të tyre.

Neni 31
Qasja në të dhëna statistikore

1. ASK-ja dhe autoritet e tjera duhet të sigurojnë që statistikat zyrtare të shpërndahen në mënyrë të tillë që të gjithë shfrytëzuesit të kenë mbështetjen e nevojshme për sigurimin e cilësisë në qasjen e barabartë, në përputhje me rezultatet e specifikuara në Program, sipas llojit, formës dhe datës së publikimit.
2. Statistikat, për të cilat shpërndarja nuk specifikohet në Program, duhet t`u vihen në dispozicion të gjithë shfrytëzuesve menjëherë pas prodhimit.

3. Ndalohet shpërndarja e të dhënave zyrtare statistikore para shpërndarjes zyrtare të tyre.
4. Të dhënat statistikore duhet të përmbajnë shpjegime në mënyrë që të interpretohen më lehtë dhe të mund t`u ofrohet ndihma profesionale shfrytëzuesve në interpretimin dhe vlerësimin e tyre.
5. Shfrytëzuesit e të dhënave statistikore, gjatë shfrytëzimit të tyre, duhet të cekin burimin e të dhënave.
6. Format mediatike mund të shfrytëzohen në mënyrë që shfrytëzuesit të mund t`i sigurojnë ato të dhëna. Këto forma mund të jenë: publikimet e ASK-së apo të prodhuesve të tjerë të statistikave zyrtare, masmediat apo cilado formë tjetër e adresimit të grupeve individuale të shfrytëzuesve.

Neni 32
Kalendari i publikimit të të dhënave statistikore

1. Bartësit e statistikave zyrtare janë të detyruar ta hartojnë dhe ta bëjnë publike kalendarin e shpalljes së të dhënave statistikore, i cili përmban datën e shpalljes së të dhënave statistikore. Këtë duhet ta bëjnë më së paku tre muaj, para periudhës me të cilën ka të bëjë Plani Vjetor përkatës.
2. Çdo lëvizshmëri e afateve të dhëna në kalendar nga paragrafi 1. i këtij neni duhet të bëhet publike.

Neni 33
Përpunimi i veçantë i statistikave zyrtare

1. Me kërkesën e një shfrytëzuesi, bartësit e statistikave zyrtare mund të japin të dhëna të fituara me përpunime të veçanta, duke pasur parasysh kufizimet e fshehtësisë që parasheh ligji.
2. Shpenzimet e përpunimeve të veçanta nga paragrafi 1. i këtij neni i bartin shfrytëzuesit, të cilët kanë kërkuar përpunime të tilla.
3. Kushtet dhe mënyra e dhënies së të dhënave nga paragrafi 1. i këtij neni, si dhe lartësia e shpenzimeve të përpunimeve të veçanta, caktohen me udhëzim administrativ.

KREU IX
FSHEHTËSIA DHE RUAJTJA E TË DHËNAVE STATISTIKORE

Neni 34
Fshehtësia e të dhënave

1. Të dhënat e fshehta përdoren vetëm për qëllime statistikore dhe është e ndaluar zbulimi i tyre i kundërligjshëm.
2. Të dhënat e fshehta të marra vetëm për prodhimin e statistikave zyrtare përdoren nga autoritetet e statistikave zyrtare vetëm për qëllime statistikore, përveç nëse njësia statistikore jep pëlqimin e qartë të saj për përdorimin e tyre për qëllime të tjera.

3. Rezultatet statistikore, të cilat e bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore mund të shpërndahen në rastet e veçanta si në vijim:
   3.1. kur kushtet dhe modalitetet përcaktohen me një akt të veçantë dhe kur rezultatet statistikore janë ndryshuar në atë mënyrë që shpërndarja e tyre nuk dëmton fshehtësinë statistikore, kurdo që njësia statistikore e kërkon një gjë të tillë, ose
   3.2. kur njësia statistikore është pajtuar qartë për zbulimin e të dhënave.
4. ASK-ja dhe prodhuesit e tjerë të statistikave zyrtare, brenda fushëveprimit të tyre të kompetencave të tyre, ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme ligjore, administrative, teknike dhe organizative për të siguruar mbrojtjen fizike dhe elektronike të të dhënave të fshehta.

Neni 35
Të dhëna nga burimet publike

Të dhënat e nxjerra nga burimet publike nuk konsiderohen si të dhëna të fshehta.

Neni 36
Shfrytëzimi i të dhënave të fshehta

Të dhënat e fshehta shfrytëzohen ekskluzivisht për prodhimin e statistikave apo për qëllime shkencore në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 37
Qasja në të dhëna të fshehta

1. Qasja në të dhëna të fshehta iu lejohet vetëm personave që kanë për detyrë prodhimin e statistikave zyrtare deri në atë masë që këto të dhëna të jenë të nevojshme për prodhimin e statistikave.
2. Qasja në të dhënat e fshehta, të cilat lejojnë vetëm identifikimin e tërthortë të njësive statistikore, mund t'u jepen studiuesve të cilët kryejnë analiza statistikore, në sferat e tyre përkatëse të kompetencës në bazë të marrëveshjes së posaçme për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave.

Neni 38
Kërkimet shkencore

1. Pas kërkesës me shkrim, që përcakton qëllimin e shfrytëzimit të të dhënave, Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së mund t'ua japë lejen për shfrytëzimin e të dhënave, të cilat nuk lejojnë identifikim direkt të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare ose të personave që paraqesin projekte për qëllime shkencore, rezultatet e të cilave nuk iu referohen njësive të identifikueshme individuale.
2. Leja për shfrytëzimin e të dhënave, të cilat nuk lejojnë identifikim direkt, jepet vetëm nëse plotësimi i standardeve të mbrojtjes së të dhënave të fshehta brenda projektit kërkimor sigurohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Në rast të refuzimit të lejes për shfrytëzimin e të dhënave, të paraparë në paragrafin 1. të këtij neni, palët e interesuara kanë të drejtë ankese.

4. Ankesën e shqyrton një komision i pavarur, i cili themelohet me vendim të Kryeministrit.

Neni 39
Regjistrimi për shfrytëzimin shkencor të të dhënave

Prodhuesit e statistikave zyrtare duhet t'i regjistrojnë shfrytëzuesit si dhe të regjistrojnë qëllimin e shfrytëzimit të të dhënave statistikore.

Neni 40
Shpërndarja e të dhënave të fshehta

1. Statistikat zyrtare nuk duhet të shpërndahen, nëse ato përmbajnë apo zbulojnë të dhëna të fshehta. Për këtë qëllim, të dhënat e grumbulluara (agreguara) duhet të përmbledhin së paku tri (3) njësi dhe ndarja e një njësie në një agregat nuk mund të tejkalojë 85 % të tërë masës, të shumës së njësisë.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni informatat rreth situatës ekonomike të mbledhura nga personat juridikë dhe fizikë apo mbi gjendjen e ambientit, mund të shpërndahen edhe nëse rezultatet nuk i përmbushin kërkesat e grumbulluara të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, në rastet kur është e nevojshme të sigurohen informata të rëndësishme bazike dhe kur me programin statistikor parashihet shpërndarja e informatave të tilla.

Neni 41
Masat mbrojtëse

1. Të gjitha masat rregulluese, administrative, teknike dhe të natyrës organizative, të nevojshme për të mbrojtur të dhënat e fshehta nga qasjet joligjore, duhet të merren nga autoritetet kompetente për prodhimin e statistikave zyrtare.
2. Mbrojtja e të dhënave statistikore të grumbulluara në përputhje me Programin dhe Planin Vjetor përfshin veprimet e natyrës teknike dhe organizative, si dhe veprime të tjera logjistike-teknike përkatëse me të cilat sigurohen hapësira dhe pajisja informatike, shpërndarja e të dhënave statistikore dhe përcaktimi i mënyrës, kohës dhe i qëllimit të përpunimit.
3. Mënyrën e mbrojtjes së të dhënave statistikore në paragrafin 1. të këtij neni e propozon Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së dhe ajo aprovohet me vendim nga Zyra e Kryeministrit.

Neni 42
Shfrytëzimi i të dhënave të fshehta gjatë kryerjes së detyrave të statistikave zyrtare

1. Personat të cilët gjatë kryerjes së detyrave të statistikave zyrtare kanë qasje në të dhëna të fshehta, nuk mund t'i shfrytëzojnë të dhënat e tilla për nevoja personale ose për kryerjen e punëve për persona të tjerë.
2. Detyrimi i personave të cilët gjatë kryerjes së detyrave të statistikave zyrtare kanë

qasje në të dhëna të fshehta, sipas paragrafit 1. të këtij neni, vazhdon edhe pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

3. Personi, i cili vepron në kundërshtim me këtë nen, do të ndëshkohet sipas nenit 46 të këtij ligji.

KREU X
BASHKËPUNIMI STATISTIKOR NDËRKOMBËTAR

Neni 43
Aplikimi i standardeve ndërkombëtare

Në kryerjen e obligimeve ndërkombëtare bartësit e statistikave zyrtare duhet të sigurojnë krahasimin e statistikave me vendet e tjera evropiane, t`i respektojnë dhe aplikojnë standardet ndërkombëtare dhe në mënyrë aktive të marrin pjesë në zhvillimin e statistikave zyrtare të Kosovës në nivel ndërkombëtar.

Neni 44
Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. ASK-ja organizon shkëmbimin e rezultateve dhe të bazave metodologjike të statistikave zyrtare me vendet e tjera dhe me organizatat ndërkombëtare.
2. Bartësit të tjerë të statistikave zyrtare, bëjnë shkëmbimin e rezultateve dhe të bazave metodologjike të statistikave zyrtare me vendet e tjera dhe me organizatat ndërkombëtare, pas miratimit nga ASK-ja.
3. ASK-ja dhe bartësit e tjerë të statistikave zyrtare, sipas paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni, mund t'ua bartin të dhënat statistikore individuale pa identifikues, në pajtim me dispozitat e këtij ligji, për fshehtësinë dhe mbrojtjen e të dhënave statistikore.
4. Të dhënat statistikore individuale pa identifikues mund t`iu jepen shërbimeve statistikore të organizatave të ndryshme ndërkombëtare, nëse shfrytëzuesit e tillë garantojnë fshehtësinë statistikore, pas aprovimit të Kryeshefit të Agjencisë.
5. Çdo bartje e të dhënave statistikore të dhëna në paragrafin 1. të këtij neni duhet të evidencohet, duke shënuar vendin, përkatësisht organizatën ndërkombëtare së cilës i janë dërguar të dhënat.
6. ASK-ja dhe shërbimi statistikor i organizatës ndërkombëtare, i cili kërkon të dhëna statistikore të cekura në paragrafin 2. të këtij neni, duhet të japin deklaratë me shkrim me të cilën vërtetojnë se këto të dhëna statistikore do të shfrytëzohen ekskluzivisht për qëllime statistikore dhe do ta kenë besueshmërinë statistikore.

KREU XI
DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 45
Shkelja e fshehtësisë

1. Shkelja e fshehtësisë të të dhënave statistikore, e paraparë me këtë ligj, është e ndaluar.

2. Ndalohet bashkimi apo kombinimi i të dhënave statistikore individuale me informata të tjera me qëllim të referimit të personave, ndërmarrjeve apo institucioneve të ndryshme për qëllime të tjera, përveç atyre të parashikuara me këtë ligj.
3. Personat përgjegjës për shkelje të dispozitave sipas paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni do të dënohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 46
Shfrytëzimi i paligjshëm i të dhënave

Çdo person që shfrytëzon të dhëna statistikore për qëllime personale apo për përfitime materiale gjatë ushtrimit të deleguar të detyrës nga prodhuesi i statistikave zyrtare do të dënohet më gjobë apo me burgim sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 47
Sanksionet kundërvajtëse

1. Çdo person i obliguar me ligj, që refuzon të ofrojë të dhëna statistikore, që ofron të dhëna jo të sakta, apo nuk respekton afatin e dorëzimit të të dhënave, do të dënohet me gjobë në shumën prej pesëqind (500) deri pesëmijë (5.000) Euro, për rastet në vijim:
   1.1. nëse nuk i dërgon të dhënat e sakta, të plota dhe të përditësuara për nga përmbajtja dhe brenda afateve sipas nenit 21 të këtij ligji;
   1.2. nëse nuk lejon qasjen në të gjitha burimet administrative të të dhënave të parapara me ligj, përveç nëse me ligjin e veçantë nuk është paraparë ndryshe sipas nenit 23 të këtij ligji;
   1.3. nëse të dhënat statistikore të grumbulluara i shfrytëzon në kundërshtim me këtë ligj.
2. Për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni do të dënohet me të holla në shumë prej treqind (300) deri tremijë (3.000) Euro edhe personi përgjegjës i personit juridik.
3. Për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni do të dënohet personi fizik me të holla në shumë prej treqind (300) deri njëmijë (1.000) Euro.
4. Për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni do të dënohen subjektet e tjera të autorizuara nga subjektet përkatëse juridike prej pesëqind (500) deri njëmijepesëqind (1.500) Euro.
5. Me dënimin me të holla në shumë prej pesëqind (500) deri pesëmijë (5.000) Euro do të dënohet për kundërvajtje personi zyrtar dhe çdo person tjetër fizik i bartësit të statistikave zyrtare nga neni 5 i këtij ligji nëse vepron në kundërshtim me nenin 31. paragrafi 3. dhe në kundërshtim me nenet 34-41 të këtij ligji, si dhe do t'i nënshtrohet ndjekjes penale sipas ligjit në fuqi.
6. Të hyrat nga gjobat e shqiptuara do të derdhen në Buxhetin e Kosovës.

KREU XII
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 48
Emërimet

1. Anëtarët e Këshillit duhet të emërohen në afatin prej tre (3) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Institucionet të cilat duhet t`i kenë anëtarët në Këshill, sipas nenit 9 të këtij ligji, duhet të njoftohen në afatin prej një (1) muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
3. Kryeministri nxjerr vendim për themelimin e Këshillit, pas caktimit të anëtarëve të Këshillit nga institucionet në pajtim me nenin 9 paragrafi 1., nën-paragrafët 1.1 deri 1.10 të këtij ligji.

Neni 49
Zbatimi i ligjit

Zyra e Kryeministrit në afatin prej gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton aktet nënligjore për ASK-në për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji, për të siguruar organizimin e brendshëm dhe detyrat e detajuara në këtë ligj.

Neni 50
Ligji në fuqi

Ky ligj shfuqizon Rregulloren nr.2001/14 për Themelimin e Entit Statistikor të Kosovës (UNMIK/REG/2001/14, 2 korrik 2001).

Neni 51
Hyrja në fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-036
21 tetor 2011

Shpallur me dekretin Nr. DL-047-2011, datë 15.11.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 26 / 25 NËNTOR 2011, PRISHTINË

LIGJI Nr. 03/L-143
PËR ARMËT

Përmbajtja

Kreu I: Dispozita të përgjithshme 614
Kreu II: Blerja dhe posedimi i armëve 623
Kreu III: Kartelat për regjistrimin e armëve dhe amnestia 634
Kreu IV: Marrja dhe konfiskimi i lejes për armë 635
Kreu V: Obligimet për armët dhe municionin 638
Kreu VI: Prodhimi i armës dhe municionit 642
Kreu VII: Tregtia me armë, pjesë të armës dhe municion 645
Kreu VIII: Bartja e armëve, pjesëve të armëve dhe municionit përmes kufirit shtetëror 646
Kreu IX: Poligonet civile për qitje 648
Kreu X: Evidencat 649
Kreu XI: Mbikëqyrja 651
Kreu XII: Dispozitat ndëshkuese 651
Kreu XIII: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 654

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Miraton

LIGJ PËR ARMËT

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Ky ligj rregullon kushtet për blerje, posedim, mbajtje, ruajtje, prodhim, riparim, paaftësim, tregtim, shitje, gjurmim, transportim dhe importim të armëve për personat fizik dhe personat juridik, brenda territorit të Republikës së Kosovës, si dhe eksportimin nga Republika e Kosovës.
2. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për armatimin ushtarak, pajisjet, armët dhe municionin e dedikuar për nevojat e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Agjencionit për Inteligjencë të Kosovës, Policisë së Kosovës, Shërbimit Korrektues, dhe organeve të tjera të autorizuara shtetërore.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **"Certifikatë biznesi"** nënkupton certifikatën që personi juridik është i regjistruar në regjistrin biznesor të Republikës së Kosovës.
   1.2. **"Licencë"** nënkupton dokumentin që i lëshohet personit juridik nga organi kompetent dhe për qëllim të këtij ligji përmban: licencë për prodhim, licencë për riparim, licencë për tregti, licencë për transport të armës, municionit dhe eksplozivëve, licencë për poligonet civile për qitje, licencë për çaktivizim.
   1.3. **"Leja"** nënkupton dokumentin që i lëshohet personit juridik ose personit fizik nga organi kompetent, dhe për qëllim të këtij ligji përmban:
      1.3.1. Personat fizik: leje për gjueti ose shenjëtari, leje për armë koleksionuese, leje për mbajtje të armës së zjarrit dhe leje për kategorinë D.
      1.3.2. Personat juridik: leje për kategorinë D, leje për posedim të armës së zjarrit, leje për prodhim të armës, pjesëve të armës së zjarrit dhe municionit të kategorisë A, leje për riparim të armëve të kategorisë A, leje për armë koleksionuese, leje për tregti me armë, leje për transport të armëve.
   1.4. **"Pëlqimi"** nënkupton aprovimin nga organi kompetent për personin juridik dhe personin fizik për blerjen e armëve të kategorisë B, C, D, blerjen e armëve koleksionuese dhe çaktivizimin e armëve të zjarrit.
   1.5. **"Certifikatë"** nënkupton dëshmi për kualifikime të specializuara për personin fizik nga organi kompetent.
   1.6. **"Leje e veçantë"** nënkupton leje që u jepet nga organi kompetent personave juridik dhe personave fizik për:
      1.6.1. Transport nga personat fizik për armë të lejuara, nga vendbanimi i personit fizik në vendin për gjueti ose shenjëtari, ose në vendin për riparim dhe transport të armëve koleksionuese të lejuara në vendin për riparim ose për ekspozitë.
      1.6.2. Transport nga personat juridik për armë të lejuara nga vendi i biznesit ose depoja në vendin për gjueti, shenjëtari ose në vendin për riparim dhe transport për armët koleksionuese të lejuara në vendin për riparim ose për ekspozitë dhe leje e veçantë për armët e kategorisë A sipas ligjit në fuqi për armët për zbatimin e ligjit.
   1.7. **"Arma e zjarrit"** nënkupton një mjet që mund të përdoret si armë, e cila mund të gjuaj një apo më shumë predha të shtytura me shpejtësi të madhe nga gazrat e krijuara përmes djegies së shpejtë dhe të mbyllur të shtytësit, apo përmes mënyrave të tjera të shtytjes së predhës së shtënë nga arma e zjarrit;
   1.8. **"Armë e shkurtër e zjarrit"** nënkupton armën e zjarrit me tytë, e cila nuk kalon gjatësinë prej 30 cm apo gjatësia e gjithmbarshme e së cilës nuk kalon 60 cm;
   1.9. **"Armë e gjatë e zjarrit"** nënkupton çdo armë te zjarrit me tytë më të gjatë se 30 cm apo gjatësia e gjithmbarshme e secilës është më e madhe se 60 cm;

1.10. **"Armë automatike e zjarrit"** nënkupton armën e zjarrit, e cila mbushet automatikisht sa herë që shkrepet plumbi, dhe e cila mund të shkrep me shumë se një plumb me një tërheqje të këmbëzës;
1.11. **"Armë gjysmë-automatike e zjarrit"** nënkupton armën e zjarrit që rimbushet në mënyrë automatike sa herë që shkrepet plumbi dhe e cila mund të shkrep vetëm një plumb me një tërheqje të këmbëzës;
1.12. **"Armë të drejtuara me energji (ADE)"** nënkupton lloj të armës që liron energji në një drejtim të shënjuar pa përdorur predhën. Kjo armë e bartë energjinë tek shënjestra për qëllim të efektit të dëshiruar;
1.13. **"Armë me mbushje mekanike e zjarrit"** nënkupton armën e zjarrit, e cila pas shkrepjes së plumbit është e paraparë për t'u rimbushur me dorë nga karikatori apo nga cilindri;
1.14. **"Armë teke"** nënkupton armë e zjarrit pa karikator, e cila mbushet para çdo shkrepjeje përmes futjes me dorë të fishekut në fole, apo hapjen për mbushje në prere të tytës;
1.15. **"Armë pneumatike"** nënkupton armën përmes së cilës shkrepet predha me presion të ajrit apo gazrave të kompresuara, në parim ky operacion i ngjashëm me punën e sistemeve të gypave pneumatikë;
1.16. **"Armë për përdorim të mjeteve të ndryshme"** nënkupton të gjitha llojet e pushkëve, pistoletave, revolverëve apo të mjeteve të tjera, të cilat nën shtypjen e barotit ose të gazrave përhapin në një drejtim gaz ngacmues që ka ndikim në shëndetin e njeriut;
1.17. **"Armë e zjarrit për sinjalizim të lehtë akustik"** nënkupton armët e zjarrit që zakonisht përdoret si sinjal për ndonjë fatkeqësi, si dhe për qëllime të tjera sinjalizuese në det, dhe në mes të fluturakeve dhe njerëzve në tokë, duke përfshirë të gjitha llojet e pistoletave, revolverëve dhe mjeteve të tjera, të cilat nën shtypjen e armës, barotit apo të gazrave shkrepin apo hedhin të shtëna sinjalizuese në një drejtim dhe zbrazin apo shkapërderdhin predha, me përjashtim të pistoletave ndriçuese për përdorim ushtarak;
1.18. **"Armë eksplozive"** nënkupton në mes të tjerash, çdo lloj i bombës, minës, raketës, granatës apo mjetit tjetër që përmban substanca eksplozive apo materiale ndezëse, ndaj të cilave për shkak të proceseve të brendshme apo të jashtme (peshës, ndikimit, fërkimit, reagimit kimik, energjisë elektrike dhe të ngjashme) shkaktohet lirimi apo krijimi i energjisë dhe eksplodimit. Në bazë të këtij ligji, armë eksplozive gjithashtu konsiderohen pjesët e eksplozivëve, detonatorët, mjetet piroteknike apo pjesët e tjera për të cilat qartë duket se janë të parapara për përgatitjen e armëve eksplozive. Ky përkufizim është i paraparë të përfshijë armët termobarike, të cilat dallohen nga armët konvencionale eksplozive për shkak se funksionojnë me oksigjen atmosferik dhe nuk kanë oksidues në eksplozivët e tyre. Armët termobarike, po ashtu quhen armë termobarike me impuls të lartë (TIL), eksploziv karburant-ajër (EKA apo FAX), si dhe nganjëherë quhen edhe municione karburant-ajër, armë me nxehtësi dhe shtypje apo bomba vakumike.
1.19. **"Armët me tojë apo tetivë"** nënkupton harqet dhe mekanizmat e tjerë që funksionojnë nën shtypjen e tojës apo tetivës së shtrënguar, të cilat gjuajnë me shigjetë apo predhë tjetër;

1.20. **"Armë e ftohtë"** nënkupton cilido mjet që mund të përdoret për sulm apo për shkaktim të lëndimeve trupore, duke përdorë forcë fizike nga sulmuesi, në rastet kur ato mbahen në tubime publike, në objekte publike apo në vende të ngjashme;

1.21. **"Armë me elektroshok"** nënkupton armë që konsiderohet si armë pa aftësuese që përdoret për qetësimin e personit apo të shtazës përmes elektroshokut që ka për qëllim pengimin e funksioneve të muskujve sipërfaqësorë. Përveç kësaj, armët e elektroshokut, në mes tjerash siç janë, armët dhe shkopinjtë për paralizim të përkohshëm, që shkaktojnë shok elektrik përmes kontaktit të drejtpërdrejtë;

1.22. **"Armë për qëllime industriale"** nënkupton armën e prodhuar për alarmim, sinjalizim, shpëtim të jetës, therje të kafshëve apo për peshkim me harpun për qëllime industriale ose teknike, me kusht që ato të përdoren vetëm për qëllimin e lartcekur.

1.23. **"Armë zjarri për gjueti"** nënkupton armë zjarri e prodhuar apo kryesisht e përdorur për gjueti të shtazëve për qëllime të të ushqyerit apo për sport, të cilat dallohen nga ato të kategorisë A apo nga armët që kryesisht përdoren për qëllime luftarake dhe të cilat i përkasin kategorisë B dhe C, përmes të cilave gjuetia lejohet në përputhje me dispozita ligjore përkitazi me gjuetinë;

1.24. **"Armë zjarri sportive"** nënkupton armë zjarri e prodhuar apo kryesisht e përdorur për ngjarje specifike dhe të parapara sportive, dhe është armë zjarri që i përket kategorisë B, C dhe D, e cila është në përputhje me dispozitat e veçanta që rregullojnë sportet e qitjes;

1.25. **"Armë e koleksionit apo relikte"** nënkupton armë e zjarrit që rrjedh nga kategoritë B, C dhe D, e cila duhet të futet në së paku njërën prej tri kategorive vijuese:

1.25.1. Armët e zjarrit që janë prodhuar së paku pesëdhjetë (50) vjet para datës aktuale, duke mos përfshirë imitimet e saj;

1.25.2. Armët e zjarrit të certifikuara nga kuratori i muzeut të vendit, i cili i ekspozon armët e zjarrit si kuriozitete dhe relikte për interesa të muzeut; dhe

1.25.3. Çdo armë tjetër e zjarrit, ku vlera substanciale e vlerës së tyre monetare vjen nga fakti se janë të reja, të rralla, bizare apo për shkak të ndërlidhjes së tyre me ndonjë figurë, periudhë apo ngjarje historike. Dëshmia për kualifikimin e ndonjë arme të caktuar në kuadër të kësaj kategorie mund të caktohet përmes dëshmisë që armët e ngjashme nuk janë në dispozicion, përveç në rast se janë eksponate të koleksionarëve, apo përveç nëse vlera e armëve të ngjashme të zjarrit që është në dispozicion përmes kanaleve të rregullta komerciale është shumë më e vogël. Kjo vlerë përcaktohet nga organi kompetent përmes akteve nënligjore.

1.26. **"Armë dekorative"** nënkupton gjësend i prodhuar për qëllime dekorative, i cili nuk mund të përdoret si armë e zjarrit;

1.27. **"Imitim i armës"** nënkupton mjet, dukja e jashtme e të cilit ngjason me atë të armës, por i cili nuk mund të përdoret si armë zjarri apo nuk mund

prodhohet pa ndonjë mekanizëm të nevojshëm të qitjes, e as që mund të përshtatet për qitje;

1.28. **"Armë antike e zjarrit"** nënkupton çdo armë te zjarrit që ndizet me shkrepsë, gur stralli apo me kapsollë ose me sistem të ngjashëm të ndezjes e prodhuar para vitit 1899;

1.29. **"Riprodhim i armës se zjarrit antike"** nënkupton kopje te armës së zjarrit antike, mekanizmi shkrepës i të cilës është modifikuar përmes teknologjisë moderne;

1.30. **"Pjesa kryesore e armës së zjarrit"** nënkupton çdo element që është i dizajnuar në mënyrë specifike për armë të zjarrit dhe është thelbësor për funksionimin e saj: duke përfshirë mes të tjerash, mekanizmin e këmbëzës, gjilpërën goditëse, tytën, kornizën apo pranuesin, rrëshqitësin apo cilindrin, shulin apo shtratin e folesë së fishekut, shulin dhe pjesët përbërëse të tij;

1.31. **"Pajisje e posaçme për armë të zjarrit"** nënkupton çdo mekanizëm që është i prodhuar dhe i dedikuar për përmirësimin e nomenklaturës themelore të armës së zjarrit, e cila përmes aplikimit të saj, e rritë performancën dhe cilësinë e përdorimit të armës së zjarrit, përveç shënjestrës optike;

1.32. **"Zbutësi apo shurdhues i zhurmës"** nënkupton pajisje që i bashkëngjitet tytës apo është pjesë e saj me qëllim të zvogëlimit të zhurmës dhe flakës së krijuar nga qitja me armë zjarri.

1.33. **"Shënjestra optike"** nënkupton pajisje te posaçme për armë të zjarrit apo për armë të ftohta, që është e prodhuar si mjet ndihmës për shënjestrim apo mjet optik dhe që përdoret si ndihmë në caktimin e shënjestrës, duke e udhëhequr syrin dhe duke e përshtatur atë me armën apo me mjetin tjetër që duhet të drejtohet kah shënjestra. Shënjestra optike mund të përdoret për të përmirësuar armët e gjuetisë dhe ato sportive, të cilat përdoren për qëllime përkatëse të autorizuara, sipas autorizimeve nga organi kompetent, siç është asociacioni i shenjëtarisë apo ai i gjuetisë;

1.34. **"Përshtatësit e kalibrit apo të tytës"** nënkupton pajisje të dedikuara për përdorim në gjueti dhe në qitje sportive, të cilat futen në tytë të armës së zjarrit me qëllim të ndryshimit të llojit të tytës apo të kalibrit të armë së zjarrit dhe përmes të cilave arma e zjarrit nuk e ndryshon kategorinë ekzistuese, në përputhje me këtë ligj;

1.35. **"Arma e zjarrit që në mënyrë të përhershme është paaftësuar për përdorim (çaktivizuar)"** nënkupton armët e zjarrit e kategorisë B, C dhe D, e cila në mënyrë të përhershme është bërë jofunksionale, përmes zbatimit të procedurës teknike në njërën nga pjesët kryesore të armës së zjarrit dhe e cila është certifikuar nga organi kompetent;

1.36. **"Municion"** nënkupton predhat, siç janë plumbat, plumbat e pushkës ajrore dhe predhat e tjera së bashku me fitilat dhe mbushësit e tyre, të cilët mund të shkrepen nga arma e zjarrit apo të shkrepen ndryshe, përkufizimi përfshinë, por duke marrë parasysh avancimet teknologjike, nuk është i kufizuar në:

1.36.1. Plumbi është njësi e municionit për gëzhojë moderne të armës së vogël, e cila paraqet kombinimin e plumbit, ndezësit, mbushësit dhe të gëzhojës në një njësi të vetme;

1.36.2. Numrin e madh të predhave të vogla, qëllimi i të cilave është

shkrepja e përnjëhershme me një të shtënë të vetme po ashtu quhet sacme, armët që mund të mbahen me dorë të prodhuara për këtë lloj të municionit janë kryesisht të njohura si pushkë gjuetie; dhe

1.36.3. Plumbi i pushkës ajrore është predhë jo sferike e paraparë për qitje nga pushka ajrore.

1.37. **"Municioni me nivel të lartë depërtues (që zakonisht njihen si plumba depërtues të mjeteve të blinduara)"** nënkupton çdo plumb i armës së vogël apo pushkës ose municion i armës së vogël ose pushkës me predhë apo me bërthamë të predhës, e cila është e prodhuar plotësisht (duke përjashtuar praninë e gjurmëve të substancave të tjera, nga legurat e tungstenit, çelikut, hekurit, bronzit, tunxhit, beriliumit, bakrit apo uraniumit të varfëruar ose plumbat me mbështjellës të plotë më të mëdhenj se kalibri 22, të prodhuar dhe të paraparë për përdorim në armë të vogla apo në pushkë, ku mbështjellësi i të cilëve peshon më shumë se 25% të peshës totale të predhës, duke mos përfshirë ato predha të armëve të vogla apo të pushkëve, bërthamat e të cilëve janë të përbëra nga materialet e buta, siç janë plumbi dhe legurat e plumbit, zinku apo legurat e zinkut, predhat e thyeshme që janë të prodhuar kryesisht për qëllime sportive, dhe çfarëdo predha ose bërthama të tjera të tyre që kryesisht janë të parapara për qëllime sportive apo industriale apo ato që përndryshe nuk janë "municion që depërton në mjetet e blinduara", ashtu siç është i përkufizuar ky term në ligj. Ky përkufizim nuk konsiderohet se i përfshinë predhat e pushkës teke, përveç nëse është në përputhje me përkufizimin e cekur më lartë;

1.38. **"Municioni me predhë eksplozivë"** nënkupton municion të paraparë vetëm për përdorim ushtarak, plumbi i të cilit përmban mbushje që eksplodon në momentin e goditjes apo që ka fitil të përcaktuar me kohë ose të vonuar, që do të rezulton me eksplodimin e municionit në kohën e paracaktuar;

1.39. **"Municioni me plumba të ndezshëm"** nënkupton por nuk kufizohet, në municionin e paraparë për përdorim ushtarak, plumbat e të cilit përmbajnë përzierje kimike të ndezshme, dhe mund të përfshijë municion që përmban metal të përzier ekzotermik dhe piroforik në formë të predhës, dhe është i paraparë për qëllim të hedhjes apo përhapjes së flakës për të nxitur hedhësin e flakës;

1.40. **"Municioni gjurmëlënës"** nënkupton lloj të municionit që lë gjurmë në ajër gjatë trajektores së vet në formë të gjurmës së tymit apo flakës, për të lehtësuar gjetjen e cakut. Në municionin gjurmëlënës përdoren plumbat e posaçëm që janë të modifikuar për të pranuar mbushje të vogël piroteknike në bazën e tyre. Pasi që të ndizet pas shkrepjes, përbërja ndizet me flakë, duke e bërë kështu predhën që të shihet me sy të lirë;

1.41. **"Municioni për armët për përdorim të agjentëve kimikë"** nënkupton municion që përmban mbushje kimike në plumb, që ndikon në shëndetin e njerëzve apo të shtazëve;

1.42. "**Organi kompetent"** nënkupton Ministrinë e Punëve të Brendshme;

1.43. **"Mbajtja e armës së zjarrit"** nënkupton të gjitha mënyrat e bartjes, përmes të cilave arma e zjarrit është e gatshme për përdorim të menjëhershëm nga pronari i saj, apo kur pronari ka qasje të menjëhershme në armën e zjarrit;

1.44. **“Prodhim i armëve të zjarrit dhe municionit”** nënkupton çdo veprimtari e hulumtimit, studimit, zhvillimit, riprodhimit dhe e montimit të armëve, të pjesëve të armëve dhe të municionit, përveç veprimtarive të zbatuara nga pronari i armës se zjarrit të gjuetisë apo të asaj sportive, me qëllim të rimbushjes së municionit të armës për nevoja personale, e cila përdoret si armë e gjuetisë apo sportive;

1.45. **“Riparim i armës së zjarrit”** nënkupton eliminimin e defekteve apo mirëmbajtja e armës së zjarrit, si dhe zëvendësimi i pjesëve jofunksionale, të vjetruara apo atyre të prishura të armës së zjarrit me pjesë origjinale funksionale sipas nevojës dhe kërkesës;

1.46. **“Me shitblerje të armëve të zjarrit, municionit dhe të pjesëve të armëve të zjarrit”** nënkupton furnizimin me armë të zjarrit, me municion dhe me pjesë të armëve të zjarrit dhe të municionit me qëllim të shitjes, ndërmjetësimit, transaksionit dhe të mbajtjes në depo të armëve dhe të municionit. Ndërmjetësimi është veprimtari e entiteteve juridike apo e personave fizikë, të cilët veprojnë si agjentë për të tjerët gjatë negocimit apo nënshkrimit të kontratave, blerësit, shitjet apo transferit të armëve të zjarrit, të municionit apo të pjesëve të armëve të zjarrit në kompensim për një pagesë apo formë tjetër të kompensimit;

1.47. “**Me transport të armëve të zjarrit dhe të municionit”** nënkupton dërgimin e armëve të zjarrit, pjesëve të armëve të zjarrit dhe të municionit nga furnizuesi tek entiteti që i merr ato;

1.48. **“Gjurmimi i armëve të zjarrit dhe i pjesëve të armëve të zjarrit”** nënkupton gjurmimin sistematik të armëve të zjarrit dhe, aty ku është e mundur, të pjesëve të armëve të zjarrit prej prodhuesit tek blerësi;

1.49. **“Vendi publik”** do të ketë kuptimin siç është definuar me ligjin e aplikueshëm për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike.

1.50. **”Armët e kombinuara të zjarrit”** konsiderohen armët e zjarrit me më shumë tyta. Kombinimi i tytave mund të përbëhet prej tytave të vjaskuara dhe atyre të pavjaskuara;

1.51. **“Sekuestrim”** nënkupton pezullimin e përkohshëm i së drejtës të dhënë sipas këtij ligji nga organi kompetent apo prokurori i shtetit;

1.52. **“Konfiskim”** nënkupton masën e urdhëruar nga gjykata, pas procedurës gjyqësore, përkitazi me veprën penale që rezultojnë me heqjen e përhershme të së drejtës në pronën e fituar përmes kryerjes së veprës penale.

Neni 3
Kuptimi i armës dhe llojet

1. **“Armë”** sipas këtij ligji, konsiderohet, por nuk kufizohet, secili mjet ose vegël e punuar me qëllim që nën presionin e gazrave, të cilat shkaktohen gjatë djegies së materialeve shpërthyese, elektricitetit, gazrave nën presion ose energjisë tjetër potenciale të hedhë predha në formë të plumbit, grumbullit prej saçmash, gazi, lëngu, shigjete ose përbërësish të tjerë, që është e përcaktuar ose është përdorur për të shkaktuar dëm trupor, dëm fizik, dëm psikologjik, dhe po ashtu çdo mjet tjetër qëllimi i të cilit është të bëjë sulm fizik ndaj integritetit fizik të njerëzve ose pronës.

2. Sipas këtij ligji armë konsiderohen:
   2.1. armët e zjarrit;
   2.2. armët e koleksionit;
   2.3. armët pneumatike (ajrore);
   2.4. armët për përhapjen e gazrave irritues;
   2.5. armët shpërthyese;
   2.6. armët me hark, tojë – tetivë apo me mekanizëm elastik;
   2.7. armët e ftohta;
   2.8. armët për sinjalizim me dritë dhe me zë;
   2.9. paralizuesit elektrikë; dhe
   2.10. armët me drejtim energjetik.
3. Si armë konsiderohen po ashtu municioni dhe pjesët kryesore të armëve, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.
4. Si armë sipas këtij ligji nuk konsiderohen:
   4.1. armët për qëllime industriale;
   4.2. armët dekorative;
   4.3. imitimet e armëve;
5. armët të cilat janë bërë të papërdorshme në mënyrë të përhershme (të çaktivizuara) përmes zbatimit të procedurave teknike, të cilat janë të garantuara nga organi kompetent apo të njohura nga organi kompetent; dhe
6. harpunët për peshkim nën ujë.

Neni 4
Kategorizimi i Armëve

1. Armët, sipas këtij ligji, kategorizohen si në vijim:
   1.1. Kategoria A - armët e zjarrit të ndaluara janë:
      1.1.1. predhat ushtarake plasëse dhe sistemet për lansim (A1);
      1.1.2. armë zjarri automatike (A2);
      1.1.3. armë zjarri të kamufluara në formë të një mjeti tjetër (A3);
      1.1.4. municion me shkallë të lartë depërtuese, municioni me predha shpërthyese, municioni me predha ndezëse, si dhe predhat për municion të tillë (A4);
      1.1.5. municioni për pistoleta dhe revolver me predhë shpërndarëse dhe hapëse si dhe predhat për municion të tillë, përveç në rastet e armëve për gjueti apo për shenjëtari të personave që kanë të drejtë t'i përdorin ato(A5);
      1.1.6. armët e zjarrit me shurdhues të montuar (A6);
      1.1.7. armë zjarri me tytë të vjaskuar me kalibër mbi 12,7 milimetra (A7);
      1.1.8. armë zjarri e gjatë gjysmë-automatike për dedikim civil që duken si armë zjarri automatike (A8);
      1.1.9. mjetet plasëse dhe pjesët e tyre (A9);
      1.1.10. armë me gaz dhe municioni i saj (A10);
      1.1.11. pajisja e veçantë për armë zjarri (A11);
      1.1.12. paralizues elektrikë (A12);
      1.1.13. municioni gjurmëlënës (A13);

1.1.14. municioni me veprim të dyfishtë (A14);
1.1.15. municioni me kalibër 5.7 x 28 mm SS190 (A15); dhe
1.1.16. armë të drejtuara me energji (A16);
1.1.17. armët e zjarrit me vjaska poligonale (A17);

1.2. Kategoria B – armët e zjarrit për të cilat kërkohet leja janë:
1.2.1. armët e shkurta të zjarrit gjysmë-automatike apo përsëritëse (B1);
1.2.2. armë zjarri të shkurtra për një qitje, me ndezje qendrore (B2);
1.2.3. armë me ndezje anësore të shkurtra për një qitje, me gjatësi të përgjithshme më të vogël se 28 cm (B3);
1.2.4. armë zjarri të gjata gjysmë-automatike, me arkëz dhe fole për fishekë së bashku që mund të mbajnë më tepër se tre (3) fishekë (B4);
1.2.5. armë zjarri të gjata gjysmë-automatike, me arkëz dhe fole për fishekë së bashku, që mund të pranojnë deri në tre (3) fishekë dhe mbushësi i të cilave ndërrohet, përkatësisht kjo armë mundet të konvertohet, me ndihmën e veglës së rëndomtë, me ç'rast arkëzat e fishekëve mund të pranojnë më tepër se tre (3) fishekë (B5);
1.2.6. armë zjarri e gjatë gjysmë-automatike ose me përsëritje (repetim), me tytë të pavjaskuar të gjatë deri më 60 cm (B6); dhe
1.2.7. armë zjarri pneumatike me energji të predhës mbi 7,5 J dhe kalibër mbi 4,5 mm (B7).

1.3. Kategoria C- armët zjarrit që mund të blihen në bazë të lejes së lëshuar me kushte lehtësuese janë:
1.3.1. armë zjarri e gjatë me përsëritje (repetim), që nuk është përfshirë në pikën 1.2.6 të kategorisë B (C1);
1.3.2. armë zjarri e gjatë me një gjuajtje me tytë të vjaskuar (C2);
1.3.3. armë zjarri e gjatë gjysmë-automatike, që nuk është përfshirë në pikat 1.2.4 deri 1.2.6 të kategorisë B (C3);
1.3.4. armë e shkurtër zjarri me një qitje me goditje anësore, gjatësia e përgjithshme e së cilës nuk është më e vogël se 28 cm (C4);
1.3.5. armë zjarri me një qitje, e gjatë me tytë të pavjaskuar (C5);
1.3.6. armët pneumatike me energji të predhës deri ne 7.5 J dhe kalibër deri 4.5 mm (C6);
1.3.7. armë zjarri për sinjalizim me dritë dhe me zë (C7); dhe
1.3.8. adaptues (C8).

1.4. Kategoria D - armët zjarri që duhet të lajmërohen dhe për të cilat lëshohet leje janë:
1.4.1. armët e zjarrit antike (D1);
1.4.2. armët me hark apo tojë (D2); dhe
1.4.3. armët e ftohta (D3).

2. Armët e zjarrit të kombinuara do të jenë të klasifikuara/grupuara në kategorinë e armëve të zjarrit me tytë të vjaskuar ose kalibrit më të madh me tytë të pavjaskuar, në rast se nuk ka tytë të vjaskuar".
3. Përjashtimisht nga paragrafi 1 pika 1.1 i këtij neni, si armë zjarri të ndaluara nuk konsiderohen armët e zjarrit te gjuetisë dhe ato sportive të pajisura me shënjestër optike.

KREU II
BLERJA DHE POSEDIMI I ARMËVE

Neni 5
Pëlqimi

1. Armët, pjesët e armëve dhe municioni mund të blihen vetëm në bazë të pëlqimit të lëshuar nga organi kompetent, në përputhje me kategorizimin e armëve nga neni 4 i këtij ligji.
2. Organi Kompetent në bashkëpunim me Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme, me akt nënligjor përcakton llojet e armëve që mund të blihen në bazë të pëlqimit.

Neni 6
Kufizimi i pëlqimit

1. Personi fizik, i cili është shtetas apo i huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Kosovës, ose personi juridik me seli biznesi të regjistruar në regjistrin e biznesit të Republikës së Kosovë mund të kërkojnë pëlqim për blerjen e armës se zjarrit nga kategoria B dhe C të këtij ligji të cilin e lëshon organi kompetent.
2. Pjesët kryesore të armëve dhe municionit për armët me tyta të vjaskuara mund të blihen në bazë të pëlqimit në përputhje me llojin e armës së zjarrit për të cilën është lëshuar leja.
3. Pëlqimi për blerjen e armëve të zjarrit dhe pjesëve të armëve të zjarrit dhe të municionit nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni vlen gjashtë (6) muaj nga dita e lëshimit të pëlqimit.
4. Municioni për armët me tyta të pavjaskuara mund të blihet në bazë të lejes së lëshuar për këto armë.
5. Personi fizik mund të blejë dhe të posedojë municion për armë me tytë me vjaska më së shumti deri në dyqind (200) fishekë gjatë vitit kalendarik, dhe vetëm pesëdhjetë (50) fishekë me një kërkesë, përveç nëse dëshmohet se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për blerje dhe posedim të sasive më të mëdha si për gjueti, shenjëtari ose në aktivitete të ngjashme,
6. Personi fizik ose personi juridik i regjistruar si shoqatë e gjuetisë, shenjëtarisë ose qendër për trajnim mund të posedojë deri ne tre (3) kg barut të zi me qëllim të rimbushjes së municionit për armët me tytë pa vjaska për të cilën ata posedojnë leje.
7. Personi fizik dhe personi juridik mund të posedojnë municion të pakufizuar për armët pneumatike për të cilat ata posedojnë lejen nga kategoria D.
8. Personat juridikë që janë të regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë së sigurisë të personave, sigurimin e parave dhe sendeve të tjera me vlerë dhe gjërave tjera te vlefshme gjatë transportimit, si dhe personat juridik që japin trajnime ose janë të regjistruar si shoqata të shenjëtarisë ose gjuetisë, mund të posedojnë municion për armë në sasi prej më së shumti pesëdhjetë (50) fishekë për çdo armë të lejuar për posedim.

Neni 7
Kërkesa e personit fizik për blerjen e armës së zjarrit

1. Pëlqimi për blerjen e armës se zjarrit mund ti lëshohet personit fizik në bazë të kërkesës së paraqitur nga ai/ajo, nëse i plotëson kushtet si në vijim:
   1.1. ka mbushur njëzetenjë (21) vjet;
   1.2. posedon aftësi të plotë ligjore për veprim;
   1.3. posedon aftësi fizike dhe psikike dhe është i aftë të posedojë apo mbajë armë zjarri;
   1.4. nuk paraqet rrezik për rendin publik;
   1.5. ka shkaqe të arsyeshme për blerjen e armës së zjarrit, sipas nenit 11 të këtij ligji;
   1.6. kalon testin teorik dhe praktik i cili vërteton njohuritë teknike për përdorimin, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e duhur të armës së zjarrit dhe njohuri për dispozitat ligjore për armët;
   1.7. është shtetas i Republikës së Kosovës ose i huaj, me qëndrim të përhershëm të lejuar në territorin e Republikës së Kosovës, përveç nëse me marrëveshje ndërkombëtare është përcaktuar ndryshe; dhe
   1.8. paraqet dëshminë që personi nuk është nën hetime penale.
   1.9. blerja e armës se zjarrit për gjueti do te përfshin dëshminë që është anëtar i certifikuar i shoqatës së gjuetarëve.

Neni 8
Dëshmia për aftësi të plotë veprimi

1. Qendra për punë sociale lëshon dëshminë, me të cilën vërteton se aplikantit me vendim gjyqësor nuk i është marrë ose kufizuar aftësia për të vepruar.
2. Dëshmia nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të jetë më i vjetër se tre (3) muaj.

Neni 9
Vërtetim për aftësi fizike dhe psiqike

1. Aftësia për posedimin dhe mbajtjen e armës së zjarrit sipas nenit 7 paragrafi 1.3. të këtij ligji përcaktohet përmes vërtetimit mjekësor, i cili nuk mund të jetë më i vjetër se tre (3) muaj.
2. Shpenzimet e kontrollit mjekësor i bartë personi fizik.
3. Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me organin kompetent, me akt nënligjor përcakton llojin dhe mënyrën e kryerjes së kontrollit mjekësor për verifikimin e aftësisë shëndetësore për posedimin dhe mbajtjen e armës së zjarrit.
4. Kontrollin mjekësor të personit fizik të cekur në këtë nen, për verifikimin e aftësisë shëndetësore lidhur me posedimin dhe mbajtjen e armës së zjarrit duhet ta kryejnë institucionet përkatëse shëndetësore që i përcakton Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me organin kompetent.

Neni 10
Rreziku për rendin publik

1. Rrezik për rendin publik në kuptim të nenit 7 paragrafi 1.4. të këtij ligji konsiderohet nëse:
   1.1. personi fizik është dënuar me vendim të formës së prerë për vepër penale;
   1.2. personi fizik është dënuar me vendim të formës së prerë për kundërvajtje të prishjes së rendit dhe qetësisë publike si pasojë e elementeve të dhunës; dhe
   1.3. rrethanat e tjera që tregojnë se armët e zjarrit mund të keqpërdoren, e veçanërisht kur personi është regjistruar në evidencën e organeve kompetente për konsumim të shpeshtë dhe tej mase të alkoolit ose për përdorim të drogave narkotike apo substancave psikotrope, për dhunë në familje, në institucion arsimor ose në vendin e punës.
2. Vërtetimi i lëshuar nga gjykata në lidhje me paragrafin 1.1, 1.2, 1.3 të këtij neni dhe paragrafin 1.8 të nenit 7 të këtij ligji nuk duhet të jetë më i vjetër se gjashtë (6) muaj.
3. Organi kompetent do ta ndërpretë procedurën për lëshimin e pëlqimit për blerjen e armës, nëse kundër personit fizik zhvillohet procedurë për vepër penale ose kundërvajtje deri në marrjen e vendimit të plotfuqishëm.

Neni 11
Arsyet për blerjen e armës për personat fizik

Personit fizik mund t'i lëshohet pëlqimi për blerjen e armës së zjarrit, pjesët e armës ose municionit vetëm për aktivitetet e gjuetisë, shenjëtarisë, ose për qëllime koleksioni.

Neni 12
Provimi profesional

1. Testimi i njohurisë profesionale për përdorimin, mirëmbajtjen dhe njohurinë mbi dispozitat e këtij ligji, bëhet përmes dhënies së provimit profesional, i përcaktuar nga organi kompetent.
2. Provimi profesional përbëhet nga pjesa teorike dhe praktike:
   2.1. në pjesën teorike të provimit verifikohen njohuritë teorike për:
      2.1.1. posedimin dhe ruajtjen e armëve te zjarrit dhe municionit;
      2.1.2. përdorim të armëve të zjarrit;
      2.1.3. ofrimin e ndihmës së parë.
   2.2. pjesa praktike e provimit përmban:
      2.2.1. testin e njohurive për përdorim të sigurt të armëve të zjarrit dhe municionit; dhe
      2.2.2. qitjen në shenjë dhe vlerësimin e rezultateve.
3. Aftësimi praktik për mënyrën e përdorimit me armë zjarri të personave fizikë që kërkojnë pëlqim për blerjen e armës se zjarrit bëhet nga personi juridik i licencuar. Personi juridik i licencuar duhet t'i lëshojnë certifikatën personit fizik pas përfundimit të suksesshëm të aftësimit praktik.
4. Aftësimin praktik për mënyrën e përdorimit me armë zjarri, gjuetie apo shenjëtarie

të personave fizik, që kërkojnë leje për blerjen e armës së zjarrit e kryen shoqata e licencuar e gjuetarëve ose shenjëtarëve, të cilët duhet të lëshojnë certifikatë pas kalimit të suksesshëm të aftësimit praktik.
5. Licenca për personat juridik nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni lëshohet nga organi kompetent.
6. Aftësimin praktik nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni e bëjnë instruktorë të certifikuar.
7. Organi kompetent me akt nënligjor përcakton kushtet minimale teknike dhe të sigurisë që duhet t'i plotësojë personi juridik respektivisht shoqata e gjuetarëve ose e shenjëtarëve lidhur me objektet për aftësimin praktik, si dhe për njohuritë teorike dhe praktike.
8. Organi kompetent me akt nënligjor do të përcaktojë llojin dhe modalitetet e aftësimit teorik dhe praktik si dhe verifikimin e kualifikimit të instruktorëve të punësuar te personat juridik që do të licencohen për ofrim të aftësimit.
9. Shpenzimet për aftësimin praktik dhe mbajtjen e provimit i bart kërkuesi i pëlqimit për blerjen e armës se zjarrit.

Neni 13
Aplikimi për blerjen e armës së zjarrit për persona juridik

1. Personi juridik duhet të aplikojë për marrjen e pëlqimit për blerjen e armës së zjarrit tek organi kompetent.
2. Kushtet e kërkesës për dhënien e pëlqimit për personin juridik janë të përcaktuara në nenin 23 deri në nenin 29 të këtij ligji.
3. Personi juridik i cili kërkon pëlqimin, i bëhet verifikimi i së kaluarës nga organi kompetent.
4. Afatet kohore dhe procedurat për shqyrtimin e kërkesës dhe ankesave që vlejnë për personin fizik sipas nenit 15 dhe 16 të këtij ligji aplikohen edhe ndaj personit juridik.

Neni 14
Arsyet për blerjen e armëve te zjarrit për personin juridik

1. Personi juridik duhet të jetë i licencuar për sigurimin fizik te personave ose sigurimin e transportit të parave dhe sendeve me vlerë. Posedimi i armës së zjarrit kufizohet në një (1) armë zjarri për tre (3) punëtorë të licencuar të sigurisë tek personat juridik të regjistruar në sferën e sigurisë së personave, ndërsa për persona juridik nga sfera e sigurimit të bartjes së parave dhe sendeve të tjera me vlerë një (1) armë zjarri për një (1) punëtor të licencuar të sigurisë.
2. Personave juridik të cilët ofrojnë trajnime (aftësim) mund tu lëshohet pëlqimi për blerjen e armës se zjarrit në bazë të licencës për punën të cilën e kryejnë. Personat juridik nga ky paragraf mund të posedojnë më së shumti tetë (8) revolver, tetë (8) pushkë dhe tetë (8) pistoleta.
3. Shoqatat e gjuetarëve, shenjëtarëve dhe personat juridik të cilët posedojnë vende për gjueti, shenjëtari mund tu jepet pëlqimi të blejnë armë zjarri për qëllim gjuetie ose shenjëtarie.

4. Institucionet shkencore, organet shtetërore ose persona juridik të tjerë për hulumtime shkencore për kafshë mund tu jepet pëlqimi të blejnë armë zjarri ose armë pneumatike me municion të cilat do të përdoren veçanërisht për paaftësim të përkohshëm të kafshëve.

Neni 15
Procedura dhe afati për shqyrtimin e kërkesës

1. Të gjitha kërkesat për të blerë armë zjarri duhet të shqyrtohen dhe vendoset për to nga komisioni shqyrtues i zgjedhur nga organi kompetent. Komisioni shqyrtues përbëhet nga tre (3) anëtarë:
   1.1. një (1) drejtor i një departamenti të MPB-së, që duhet të jetë kryetar i komisionit;
   1.2. një (1) zyrtar ligjor nga MPB-ja; dhe
   1.3. një (1) përfaqësues i Policisë së Kosovës.
2. Komisioni shqyrtues do të vendos lidhur me kërkesën për lëshimin e pëlqimit për blerjen e armës së zjarrit për personin fizik dhe personin juridik brenda afatit prej tre (3) muajve pas parashtrimit të kërkesës, ose në raste të ndërlikuara deri në gjashtë muaj, me ç'rast komisioni shqyrtues obligohet ta informojë palën që ka parashtruar kërkesën për arsyet e rastit të ndërlikuar.
3. Nëse komisioni shqyrtues refuzon kërkesën e personit fizik ose personit juridik, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë ankese në komisionin e ankesave në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur vendimi i komisionit shqyrtues është pranuar.
4. Komisioni i ankesave duhet të përbëhet nga tre (3) anëtarë si në vijim: kryetari i komisionit i cili është anëtar i Ministrisë për Punë të Brendshme dhe drejtor i një Departamenti të MPB-së, një (1) zyrtar ligjor nga MPB-ja dhe një (1) zyrtar ligjor nga Policia e Kosovës. Anëtarët e komisionit shqyrtues nuk kanë të drejtë të jenë pjesë e Komisionit për Ankesa.
5. Komisioni i ankesave në afat prej tridhjetë (30) ditësh duhet të vendos lidhur me ankesën.
6. Organi kompetent me akt nënligjor i përcakton rregullat e punës për komisionin shqyrtues dhe komisionin e ankesave si dhe emëron anëtarët e komisioneve.

Neni 16
Afati kohor për regjistrim

1. Personit fizik ose juridik, të cilit i është lëshuar pëlqimi për blerjen e armës së zjarrit, duhet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e blerjes së armës, të paraqes kërkesë te organi kompetent për regjistrimin e armës dhe lëshimin e lejes për posedim te armës për gjueti ose shenjëtari të personit fizik ose leje për posedimin e armës se zjarrit për personin juridik.
2. Personi juridik i licencuar që merret me shitblerje të armëve, në afat prej pesë (5) ditëve nga shitblerja e armëve te zjarrit, duhet të paraqes raport te organi kompetent për shitblerjen dhe të prezanton gëzhojat dhe plumbat e qitjes provuese.
3. Raporti nga paragrafi 2 i këtij neni duhet të përmbajë të dhëna për personin fizik

ose juridik i cili i ka blerë armët, personin juridik i cili e ka shitur armën dhe të dhënat e sakta për armët e shitura. Së paku dy (2) gëzhoja dhe dy (2) plumba nga qitjet provuese dorëzohen me raport. Forma e këtij raporti do të jetë pjesë përbërëse e aktit nënligjor sipas nenit 69 të këtij ligji.

4. Organi kompetent, ia cakton çdo arme numrin unik (të veçantë) të identifikimit.

Neni 17
Llojet e lejeve për persona fizik

1. Lejet për personat fizik janë:
   1.1. leje për mbajtjen e armës së zjarrit;
   1.2. leje për armë koleksionuese;
   1.3. leje për armë gjuetie ose shenjëtarie; dhe
   1.4. leje për armë të kategorisë D.

Neni 18
Leja për mbajtje të armës së zjarrit

1. Leja për mbajtje të armës së zjarrit është leje e cila lejon punëtorin e certifikuar dhe të kontraktuar tek personi juridik i licencuar në fushën e sigurisë të personave, sigurimin e parave dhe gjërave tjera me vlerë, që të mbajë armë zjarri të kategorisë B dhe C gjatë orarit të punës në vendin e punës.
2. Personat juridik që posedojnë armë zjarri në bazë të lejes për posedimin e armës se zjarrit duhet t'i japin armët e zjarrit për përdorim vetëm punëtorëve të certifikuar që kanë kontratë pune me atë person juridik dhe që kryejnë punën e sigurisë ndaj personave ose për bartjen parave dhe sendeve të tjera me vlerë, si dhe plotësojnë kushtet e cekura në nenin 7 të këtij ligji.
3. Me kërkesën e personit juridik nga paragrafi 1 i këtij neni, organi kompetent, përdoruesit të armës së zjarrit i lëshon leje për mbajtjen e armës se zjarrit me afat të vlefshmërisë prej një (1) viti.
4. Afati i vlefshmërisë së lejes për mbajtjen e armës së zjarrit do të vazhdohet, me kërkesën e personit juridik, nëse personi nën emrin e të cilit është dhënë leja edhe më tej i plotëson kushtet nga neni 7 i këtij ligji.
5. Personi juridik bën kërkesën për vazhdimin e lejes për mbajtje të armës së zjarrit më së voni dy (2) muaj para skadimit të afatit të vlefshmërisë së saj.
6. Personit, të cilit i ka pushuar marrëdhënia e punës te personi juridik nga paragrafi 1 i këtij neni, në ditën e pushimit të marrëdhënies së punës është i obliguar që armën dhe lejen për mbajtje të armës së zjarrit t'ia dorëzojë personit përgjegjës të personit juridik.
7. Personi juridik nga paragrafi 6 i këtij neni është i obliguar që në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pushimit të marrëdhënies së punës ta njoftojë me shkrim organin kompetent lidhur me personin, të cilit i ka pushuar marrëdhënia e punës. Organi kompetent menjëherë e merr lejen për mbajtje te armës se zjarrit.

Neni 19
Leja për armë koleksionuese

1. Leja për armë koleksionuese është leje që e lejon personin fizik të posedon koleksion të armëve sipas këtij ligji.
2. Leja për blerjen e armës së koleksionit i lëshohet personit fizik në bazë të kërkesës, nëse i përmbush kushtet nga nenet 7, 39 dhe 40 të këtij ligji.
3. Nëse koleksioni i armëve përbëhet nga më shumë se njëzetepesë (25) armë zjarri, në bazë të kërkesave nga paragrafi 2 i këtij neni, koleksionuesi duhet t'ia bashkangjesë kërkesës pëlqimin me shkrim dhe të nënshkruar për organin kompetent rreth faktit se ai do të lejojë kontroll të papenguar të këtyre armëve të zjarrit si dhe të përmbush kriteret mbi certifikimin e vendit të ruajtjes.
4. Koleksionuesi të cilit i është lëshuar pëlqimi për blerjen e armës koleksionuese, është i obliguar që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e blerjes së armës, të parashtrojë kërkesë pranë organit kompetent për regjistrimin e armës dhe për lëshimin e lejes për armën koleksionuese.
5. Leja nga paragrafi 4 i këtij neni lëshohet me afat vlefshmërie prej dhjetë (10) vjetësh.
6. Pas lëshimit të lejes së parë për koleksionimin e armëve nga paragrafi 4 i këtij neni, pëlqimi për blerjen e një arme tjetër koleksionuese lëshohet nëse koleksionuesi e përmbush vetëm kushtin nga neni 7, paragrafi 1.5 i këtij ligji.
7. Armët që i takojnë kësaj leje nuk duhet të mbahen me vete por vetëm munden të dërgohen në vendin për riparim ose të ekspozohen sipas lejes së veçantë të lëshuar nga organi kompetent. Municioni nuk mund të blihet për këto armë zjarri.

Neni 20
Leja për armë gjuetie ose shenjëtarie

1. Leja për gjueti ose shenjëtari është leje e cila e lejon personin fizik të posedon armë zjarri që i takojnë kategorisë B dhe C vetëm për qëllime gjuetie ose shenjëtarie.
2. Armët e zjarrit mund të barten nga vendbanimi deri te poligoni për qitje, terreni për gjueti ose dyqani për riparim me leje të veçantë të lëshuar nga organi kompetent.
3. Nëse depoja e armëve të zjarrit të shoqatës së shenjëtarisë dhe gjuetisë nuk gjendet në poligonin e qitjes civile ose në terrenin e gjuetisë apo në terrenin e përcaktuar për të, anëtarët e shoqatave të tilla janë të detyruar të kenë leje të veçantë të lëshuar nga organi kompetent.
4. Njoftimi i organit kompetent në bazë të paragrafit 3 të këtij neni duhet të bëhet në afat prej shtatë (7) ditësh para transportimit të armëve të zjarrit.
5. Anëtari aktiv i shoqatës së gjuetisë ose shenjëtarisë, i cili posedon leje për gjueti ose shenjëtari mund të merr me qira një (1) ditore, armë zjarri për gjueti ose shenjëtari nga shoqata e gjuetisë ose shenjëtarisë për rajonin e gjuetisë ose shenjëtarisë. Shoqata e gjuetisë ose shenjëtarisë, duhet të jep vërtetim të dhënies me qira anëtarit aktiv derisa anëtari aktiv është në posedim të armës së zjarrit me qira.
6. Leja nga paragrafi 1 i këtij neni ka afat vlefshmërie pesë (5) vite.

Neni 21
Leja për armët e kategorisë D

1. Personi fizik mund të blejë armë nga kategoria D nëse i përmbush kushtet nga neni 7, paragrafi 1.1 të këtij ligji.
2. Armët që i takojnë kategorisë D, duhet të barten vetëm në vendet e gjuetisë, shenjëtarisë ose vendet për riparim në bazë të lejes së veçantë të lëshuar nga organi kompetent.
3. Personi fizik i cili ka blerë armë sipas këtij neni, prezanton armën tek organi kompetent në afat prej pesë (5) ditëve nga dita që është blerë arma.
4. Leja nga paragrafi 1 i këtij neni ka afat vlefshmërie pesë (5) vite.

Neni 22
Llojet e lejeve për personat juridik

1. Llojet e lejeve për personat juridik përfshin:
   1.1. leje për posedimin e armës së zjarrit;
   1.2. leje për prodhim të armëve, pjesëve të armës dhe municionit të kategorisë A;
   1.3. leje për riparim të armëve të kategorisë A;
   1.4. leje për koleksion të armëve;
   1.5. leje për shitblerje të armëve dhe municionit;
   1.6. leje për transport të armëve; dhe
   1.7. leje për armë të kategorisë D të armëve.
2. Procedurat për aplikim të komisionit shqyrtues dhe komisionit të ankesave bëhen në përputhje me nenin 15 të këtij ligji.

Neni 23
Leja për posedim të armës së zjarrit

1. Leja për posedim të armës së zjarrit është leje e cila e lejon personin juridik të licencuar të posedoj armë zjarri që i takojnë kategorisë B dhe C.
2. Personi juridik mund të merr lejen për posedim të armës se zjarrit vetëm nëse:
   2.1. kryen punën e sigurisë në lëmin e bartjes së parave dhe sendeve të tjera me vlerë;
   2.2. kryen punën e sigurisë fizike për persona;
   2.3. kryen aftësimin praktik; ose
   2.4. kryen hulumtime shkencore në lidhje me kafshët. Ky lloj i personit juridik mund të posedojë armë të zjarrit ose armë pneumatike me municion vetëm për paaftësim të përkohshëm të kafshëve.
3. Personi juridik nga paragrafi 2 i këtij neni duhet të paraqet kërkesën për leje për posedim të armës së zjarrit. Kërkesa duhet të përmbajë:
   3.1. emrin e kompanisë dhe personin përgjegjës;
   3.2. numrin e punëtorëve të certifikuar dhe të regjistruar;
   3.3. certifikatën e biznesit;
   3.4. licencën nga organi kompetent për të kryer punët nga paragrafi 2 të këtij neni;

3.5. vërtetimin gjyqësor që puna e personit juridik nuk ndalohet ose ndërpritet me vendim të formës së prerë të gjykatës kompetente;
3.6. dëshminë se e kanë selinë e biznesit në Republikën e Kosovës;
3.7. dëshminë nga organi kompetent që posedojnë hapësirë për ruajtjen dhe vendosjen e sigurt të armës së zjarrit dhe municionit;dhe
3.8. kontratën që verifikon veprimtarinë e tyre.

4. Shoqatat e gjuetisë dhe shenjëtarisë duhet të paraqesin kërkesë për lëshimin e lejes për posedimin e armës se zjarrit. Kërkesa përfshin të dhënat në vijim:
4.1. emrin e shoqatës dhe personit përgjegjës;
4.2. certifikatën e biznesit;
4.3. certifikatën për poligonin e qitjes (llojin) ose poligonin e gjuetisë nga organi kompetent;dhe
4.4. certifikatën nga organi kompetent që ata posedojnë hapësirë për ruajtjen dhe vendosjen e sigurt të armës dhe municionit.
5. Leja për posedimin e armës së zjarrit i jepet personit juridik me afat të vlefshmërisë prej pesë (5) viteve.
6. Leja për posedimin e armës se zjarrit mund të vazhdohet me kërkesë me shkrim të personit juridik, të paraqitur tek organi kompetent më së voni dy (2) muaj para skadimit të afatit të vlefshmërisë së saj.
7. Personi juridik duhet t'ia bashkangjesë kërkesës për vazhdimin e lejes për posedim të armës se zjarrit dëshminë se i plotëson kushtet nga paragrafi 3 i këtij neni.
8. Leja për posedimin e armëve të zjarrit i jepet vetëm personit juridik që ka së paku qarkullim vjetor mbi tridhjetëmijë (30 000) Euro brenda vitit paraprak kalendarik, ose ka buxhet fillestar prej tridhjetëmijë (30 000) Euro me rastin e themelimit të veprimtarisë.

Neni 24
Leja për prodhim të armëve të kategorisë A

1. Leja për prodhim, është leje që lejon personin juridik të prodhon armë, pjesët e armës dhe municion të kategorisë A.
2. Aplikuesi i lejes për prodhim të armës, pjesëve të armës dhe municionit të kategorisë A, duhet të paraqet kërkesë për marrjen e kësaj leje. Kërkesa duhet t'i përfshijë të dhënat vijuese:
2.1. emrin e personit juridik dhe personit përgjegjës;
2.2. certifikatën e biznesit;
2.3. vërtetimin gjyqësor që puna e personit juridik nuk është e ndaluar ose ndërprerë me vendim të formës së prerë të gjykatës kompetente; dhe
2.4. vërtetim nga organi kompetent që personi juridik i plotëson kushtet teknike dhe hapësinore, për vendosje të sigurt të armëve.
3. Personit juridik të cilit i është dhënë licenca nga neni 49 i këtij ligji duhet ta informojë organin kompetent në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e fillimit të prodhimit të armëve, pjesëve të armëve dhe municionit.
4. Organi kompetent në bashkëpunim me Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, nxjerr akt nënligjor për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë që duhet t'i plotësojnë objektet ku do të bëhet prodhimi, riparimi apo shitblerja, si dhe deponimi i armëve dhe i municionit.

5. Leja nga paragrafi 1 i këtij neni ka afat vlefshmërie dhjetë (10) vite.
6. Kriteret dhe kushtet për prodhim të armës, pjesëve të armës dhe municionit të kategorisë A do të përcaktohen me dispozita të ligjeve përkatëse.

Neni 25
Leja për riparim të armëve të kategorisë A

1. Leja për riparim, është leje që lejon personin juridik të riparojë armë të kategorisë A.
2. Aplikuesi i lejes për riparim të armës të kategorisë A duhet të paraqet kërkesë për lëshimin kësaj leje. Kërkesa përfshinë të dhënat si në vijim:
   2.1. emri i personit juridik dhe personit përgjegjës;
   2.2. certifikata e biznesit;
   2.3. vërtetim gjyqësor që puna e personit juridik nuk është e ndaluar ose ndërprerë me vendim të formës së prerë të gjykatës kompetente; dhe
   2.4. vërtetim nga organi kompetent që personi juridik i plotëson kushtet teknike dhe hapësinore për vendosje të sigurt të armëve.
3. Personit juridik të cilit i është dhënë licenca nga neni 51 i këtij ligji duhet ta informojë organin kompetent në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e fillimit të riparimit të armëve, pjesëve të armëve dhe municionit.
4. Organi kompetent në bashkëpunim me Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës nxjerr akt nënligjor për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë, që duhet t'i plotësojnë objektet ku do të bëhet prodhimi, riparimi apo shitblerja, si dhe deponimi i armatimit dhe i municionit.
5. Leja nga paragrafi 1 i këtij neni ka afat vlefshmërie dhjetë (10) vite.
6. Kriteret dhe kushtet për riparim të armës të kategorisë A, do të përcaktohen me dispozita të ligjeve përkatëse.

Neni 26
Leja për armë koleksionuese

1. Leja për armë koleksionuese është leje që lejon personin juridik të posedojë armë koleksionuese sipas këtij ligji.
2. Personi juridik nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të paraqet kërkesë tek organi kompetent për marrjen e pëlqimit për blerjen e armës koleksionuese. Kërkesa përfshin të dhënat si në vijim:
   2.1. emri i personit juridik dhe personit përgjegjës;
   2.2. certifikatën e biznesit;
   2.3. vërtetimin gjyqësor që puna e personit juridik nuk është e ndaluar ose ndërprerë me vendim të formës së prerë të gjykatës kompetente;
   2.4. certifikata e lëshuar nga organi kompetent që personi juridik i plotëson kushtet teknike dhe hapësinore për ruajtje dhe ekspozim të sigurt të armëve në muze; dhe
   2.5. nëse koleksioni i armëve të zjarrit koleksionuese përbëhet nga më shumë se njëzetepesë (25) armë, në bazë të kërkesave nga paragrafi 1 i këtij neni, personi juridik duhet t'ia bashkangjesë kërkesës pëlqimin me shkrim dhe të

nënshkruar organit kompetent rreth faktit se ai do të lejojë kontroll të papenguar të këtyre armëve të zjarrit si dhe të përmbush kriteret mbi certifikimin e vendit të ruajtjes.

3. Obligimet për regjistrim nga neni 16 i këtij ligji duhet të aplikohen përveç prezantimit të gëzhojave dhe plumbave prej qitjes provuese.
4. Leja nga paragrafi 1 i këtij neni ka afat vlefshmërie dhjetë (10) vite.

Neni 27
Leja për tregti me armë dhe municion

1. Leja për tregti me armë dhe municion për personat juridik lëshohet nga organi kompetent me pëlqimin paraprak të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë për Punë të Jashtme.
2. Kërkesa për lëshimin e lejes sipas paragrafit 1 të këtij neni përfshin:
   2.1. licencën e lëshuar nga organi kompetent për aktivitetet e tregtisë me armë dhe municion në pajtim me nenin 55 të këtij ligji;
   2.2. emrin e kompanisë, certifikata e biznesit, emrin personit përgjegjës, adresën e dërguesit dhe pranuesit dhe emrin e teknikut të personit juridik;
   2.3. emrin e kompanisë prodhuese dhe shtetit të armëve dhe municionit;
   2.4. llojin, markën, modelin numrin serik, kalibrin dhe sasinë e armëve e të municionit.
   2.5. vërtetimin për shfrytëzuesin e fundit; dhe
   2.6. kontratën apo dokumentin tjetër zyrtar për sasinë e kontraktuar të armëve, municionit dhe pjesëve të armëve.
3. Leja për tregti me armë lëshohet me afat vlefshmërie deri në gjashtë (6) muaj.
4. Leja nga paragrafi 3 i këtij neni revokohet nëse në periudhën për sa është e vlefshme leja për tregti, ndërmerren masa restriktive nga organizatat ndërkombëtare për të ndaluar tregtinë.
5. Tekniku i armëve i personit juridik që merret me tregti të armëve duhet të jetë i certifikuar në çështje teknike lidhur me armët dhe municionet.
6. Ndalohet që të punësuarit në organet shtetërore të përfshihen në kompanitë e licencuara për tregti me armë, si përgjegjës, teknik ose të punësuar.

Neni 28
Leja për transport të armëve

1. Për çdo transportim të armëve, pjesëve të armëve dhe municionit nevojitet leje nga organi kompetent.
2. Dispozitat nga nenet 24, 49 dhe 51 të këtij ligji zbatohen për personat juridik që transportojnë armë dhe municion.
3. Personi juridik duhet të paraqet kërkesë për leje për transport të armëve, pjesëve të armëve dhe municionit, e cila përmban:
   3.1. certifikatën e biznesit.
   3.2. licencë për transport të armëve dhe municionit e lëshuar nga organi kompetent.
   3.3. licencë për transport nga Ministria e Transportit dhe Postë- Telekomunikacionit.

3.4. emrin e kompanisë, selinë e biznesit, emrin personal, adresën e dërguesit, transportuesit dhe pranuesit;
3.5. emrin e kompanisë, dhe selinë e prodhuesit të armës dhe municionit;
3.6. llojin, markën, modelin, numrin serik, kalibrin, kategorinë dhe sasinë e armëve e të municionit;
3.7. kohën e përafërt, datën, drejtimin e lëvizjes dhe vendin e dorëzimit;
3.8. llojin e mjetit transportues, numrin e tabelave të regjistrimit, emrin dhe mbiemrin dhe një (1) kopje të dokumentit personal letërnjoftimit ose pasaportës të vozitësit;
3.9. masat e sigurisë të implementuara nga transportuesi gjatë kohës së transportit; dhe
3.10. emrin pikës së kalimit kufitar ku transportohen armët dhe municioni dhe data e arritjes në pikën e kalimit kufitare në rast të eksportit apo importit.

4. Leja për transport të armëve, pjesëve të armëve dhe municionit lëshohet me afat vlefshmërie deri në tre (3) muaj.
5. Organi kompetent sipas nevojës do të caktojë marrjen e masave të veçanta për sigurim gjatë transportit të armës dhe municionit.

Neni 29
Leja për armët e kategorisë D për personat juridik

1. Leja për armët e kategorisë D, është leja e lëshuar nga organi kompetent që u lejon personave juridik të licencuar, për posedim të armëve që i takojnë kategorisë D.
2. Armët e regjistruara sipas kësaj leje mund të barten vetëm në vendet e gjuetisë, shenjëtarisë ose vendet për riparim në bazë të lejes të veçantë të lëshuar nga organi kompetent.
3. Personi juridik i cili ka blerë armë sipas këtij neni duhet ta prezantojë armën tek organi kompetent në afat kohor prej pesë (5) ditëve nga dita që është blerë arma.

Neni 30
Refuzimi për të gjitha llojet e lejeve për armë/armë zjarri

Organi kompetent refuzon kërkesën për lëshimin e lejes për armë zjarri të gjuetisë ose shenjëtarisë, lejes për mbajtjen e armës së zjarrit, lejes për posedimin e armëve të zjarrit, lejes për armë koleksionuese, apo lejen e armëve të kategorisë D, nëse për armën/armën e zjarrit nuk mund të dëshmohet prejardhja, nëse nuk është e vulosur në mënyrën e përcaktuar me ligj ose nëse në procedurën e regjistrimit konfirmohet ekzistimi i shkaqeve për refuzimin e kërkesës për regjistrimin e armës.

KREU III
KARTELAT PËR REGJISTRIMIN E ARMËVE DHE AMNESTIA

Neni 31
Kartelat për regjistrimin e armëve dhe kartelat për autorizimin e armëve

1. Kartelat për regjistrimin e armëve dhe kartelat për autorizimin e armëve të cilat janë lëshuar në bazë të dispozitave ligjore në fuqi duhet të zëvendësohen në afat

kohor prej dy (2) viteve prej ditës kur hyn në fuqi ky ligj nëse pronari i plotëson kushtet nga neni 7 për personat fizik ose neni 23 për personat juridik.

2. Personi i cili paraqet kërkesën për zëvendësimin e kartelës së lëshuar në bazë të dispozitave në fuqi konsiderohet se ka leje për armë deri në momentin kur të vendoset për kërkesën.

Neni 32
Legalizimi i armëve të zjarrit

1. Personat fizik që përmbushin kriteret e përshkruara në nenin 7, si dhe personat juridik te cilët i përmbushin kriteret te parapara në nenin 23 të cilët kanë në posedim armë zjarri të kategorisë B, C dhe D sipas këtij ligji dhe që nuk kanë leje mund të parashtrojnë kërkesën për legalizim të këtyre armëve.
2. Armë zjarri nga paragrafi 1 i këtij neni:
   2.1. nuk guxon të rrjedh nga kryerja e veprës penale, përkatësisht të jetë e dedikuar apo përdorur për kryerjen e veprës penale;
   2.2. të mos jetë në pronësi të personit tjetër fizik ose juridik; dhe
   2.3. shenjat e armës së zjarrit të mos jenë të dëmtuara apo të shkatërruara;
3. Lejet nga paragrafi 1 i këtij neni mund të jepen në bazë të kërkesës personale të personit fizik ose juridik.
4. Armët e zjarrit që rezultojnë nga kërkesat për legalizim, e të cilat nuk janë në përputhje me paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni do të konfiskohen dhe shkatërrohen.
5. Organi kompetent me akt nënligjor përcakton procedurat, kushtet dhe kriteret për legalizimin e armëve.

Neni 33
Amnestia për armë

Personi fizik ose personi juridik që posedon armë zjarri të kategorisë A, B, C dhe D dhe për të cilën është lëshuar kartelë regjistrimi për armë ose kartelë autorizimi për armë ose ndonjë dokument përkatës nga organi kompetent por janë të ndaluara sipas dispozitave të këtij ligji duhet në afat kohor prej gjashtë muajve nga dita kur ky ligj hyn në fuqi ta dorëzojë armën e zjarrit të kategorisë B, C dhe D tek personi juridik nga neni 53, paragrafi 2 i këtij ligji, me qëllim të çaktivizimit, dhe armët e zjarrit të kategorisë A, B, C dhe D, organit kompetent për shkatërrim ose ruajtje të përkohshme.

KREU IV
MARRJA DHE KONFISKIMI I LEJES PËR ARMË

Neni 34
Marrja e lejes për armë

1. Leja për gjueti ose shenjëtari, leja për armë koleksioni, leja për mbajtjen e armës së zjarrit dhe leja për armët e kategorisë D, personit fizik i merret në rastet, kur:
   1.1. skadon afati i lejes dhe kur e njëjta nuk është vazhduar;
   1.2. është marrë vendim i formës së prerë për marrjen e lejes;

1.3. leja për qëndrim të përhershëm të të huajit në territorin e Republikës së Kosovës ka pushuar në pajtim me dispozitat e Ligjit për të Huajt; apo
1.4. vdes poseduesi i lejes.

2. Leja për posedimin e armës së zjarrit, leja për armët e kategorisë D, ose leja për posedimin e armës koleksionuese personit juridik i merret në rastet kur:
2.1. skadon afati i lejes për posedim të armës dhe e njëjta nuk është vazhduar;
2.2. është marrë vendim i formës së prerë për marrjen e lejes mbi posedimin e armës së zjarrit; apo
2.3. personi juridik pushon së ekzistuari;

3. Nëse është marrë leja për posedimin e armës se zjarrit, leja për mbajtjen e armës së zjarrit duhet të merret po ashtu.

Neni 35
Konfiskimi i lejes

1. Organi kompetent ekzekuton vendimin për konfiskim në bazë të vendimit gjyqësor të lejes për gjueti ose shenjëtari, lejes për armë koleksioni, lejes për mbajtjen e armës se zjarrit ose lejes për armët e kategorisë D të personit fizik në rast se konstaton se personi:
1.1. e ka humbur aftësinë e plotë ligjore të veprimit, sipas nenit 8 të këtij ligji;
1.2. e ka humbur aftësinë fizike dhe psiqike të posedojë ose të mbajë armë në pajtim me nenin 9 të këtij ligji;
1.3. me aktgjykim të formës së prerë është dënuar për vepër penale ose kundërvajtje nga neni 10, paragrafi 1.1, 1.2, dhe 1.3 të këtij ligji; apo
1.4. ka cenuar detyrimet e përcaktuara me këtë ligj.

2. Organi kompetent ekzekuton vendimin për konfiskim në bazë të vendimit gjyqësor të lejes për posedim të armës së zjarrit, lejes për armë koleksionuese ose lejes për armët e kategorisë D të personit juridik në rast se konstaton se:
2.2. nuk ekzistojnë më shkaqet për dhënien e lejes; apo
2.3. personi juridik i cenon obligimet e përcaktuara me këtë ligj.
2.4. Ankesa kundër këtij vendimi mund t'i paraqitet Komisionit të Ankesave në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të vendimit.

3. Ankesa kundër vendimit nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.

4. Në rast kur leja për gjueti ose shenjëtari, leja për armë koleksioni, leja për posedim të armës së zjarrit ose leja për armët e kategorisë D merret në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, pikën 2.2 dhe paragrafin 4 të këtij neni, kërkesa e re për dhënien e pëlqimit për blerjen e armës mund të paraqitet pas pesë (5) viteve nga dita e marrjes së vendimit të formës së prerë për konfiskim;

5. Pas marrjes së vendimit të formës së prerë nga paragrafi 3 i këtij neni, organi kompetent e shlyen armën nga evidenca dhe e shkatërron atë në prani të komisionit të ankesave. Për asgjësimin e armës nuk i paguhet kompensim pronarit të armës.

Neni 36
Sekuestrimi

1. Në rastin kur kundër poseduesit të lejes për gjueti ose shenjëtari, lejes për armë koleksioni, lejes për mbajtjen e armës se zjarrit ose lejes për armët e kategorisë D është ngritur procedurë penale për vepër penale nga neni 10 paragrafi 1 pika 1.1 i këtij ligji ose procedura për kundërvajtje nga neni 10 paragrafi 1 pika 1.2 nga ky ligj, organi kompetent sekuestron lejen për gjueti ose shenjëtari, lejen për mbajtjen e armës së zjarrit, lejen për armë koleksioni, armën/armën e zjarrit dhe municionin deri në marrjen e vendimit të plotfuqishëm.
2. Organi kompetent sekuestron lejen, armën/armën e zjarrit dhe municionin, nëse gjatë vazhdimit të vlefshmërisë së lejes, përcakton se arma/arma e zjarrit është e amortizuar ose e dëmtuar në atë masë sa që me përdorimin e saj do të mund të rrezikohej siguria publike ose arma/arma e zjarrit nuk mund të riparohet nga pronari për shkak të kushteve ekonomike.
3. Pronari mund të paraqesë ankesë tek Komisioni i Ankesave në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të vendimit në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni. Ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.

Neni 37
Shitja e armëve të zjarrit të konfiskuara

1. Nëse arma e zjarrit ka prejardhje ligjore, organi kompetent do t'i lëshoj vërtetim për konfiskim dhe do ta urdhëroj personin fizik ose personin juridik që në afat prej tre (3) muajve ta shesë armën e zjarrit dhe municionin pasi që ka mbaruar procedura e ankimit.
2. Nëse pronari ose personi juridik në afatin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni nuk e shet armën e zjarrit dhe municionin e marrë, organi kompetent do ta bëjë shitjen e armës së zjarrit dhe municionit përmes ankandit publik, personave juridik që merren me shitblerjen e armëve dhe të municionit, personave fizikë ose personave juridik, të cilët kanë marrë pëlqimin për blerjen e armës së zjarrit. Për armën e zjarrit dhe municionin e shitur, pronarit i takon çmimi shitës i zvogëluar për shumën e shpenzimeve të shitjes.
3. Nëse arma e zjarrit nuk shitet përmes ankandit publik, me armën e zjarrit do të veprohet sipas nenit 35 të këtij ligji.

Neni 38
Procedurat për armët/armët e zjarrit e konfiskuara

1. Arma/arma e zjarrit dhe municioni i konfiskuar në procedurën penale ose kundërvajtëse do t'i dorëzohen organit kompetent në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita kur vendimi merr formë të prerë.
2. Nëse pajisja është e ndaluar me këtë ligj, arma/arma e zjarrit dhe municioni nga paragrafi 1 i këtij neni asgjësohet.
3. Përjashtimisht, nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, armët/armët e zjarrit dhe municionet e konfiskuara në procedurë kundërvajtëse, munden përsëri të

shfrytëzohen për nevoja zyrtare të organeve kompetente të sigurisë dhe Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, nëse kanë qenë pjesë e armatimit të tyre.

4. Arma e zjarrit dhe municioni i konfiskuar në procedurë kundërvajtëse prejardhja ligjore e së cilës është dëshmuar dhe shenjëzimi është i padëmtuar, mund të shitet përmes ankandit publik personave juridik ose personave fizik të cilët kanë marrë pëlqimin për blerjen e armës së zjarrit.
5. Mjetet e realizuara me shitjen e armës/armës së zjarrit dhe municionit derdhen si të ardhura vjetore në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

KREU V
OBLIGIMET PËR ARMËT DHE MUNICIONIN

Neni 39
Obligimi për kujdesin e armës

1. Pronari ose shfrytëzuesi i armës është i detyruar që armën ta mirëmbajë në kushte adekuate, ta përdorë atë me kujdes dhe ta ruaj në mënyrë që të pamundësojë qasjen e personave të paautorizuar në të.
2. Pronari ose shfrytëzuesi i armës së zjarrit nuk duhet t'i fshijë ose t'i ndryshojë shenjat identifikuese të gdhendura në armën e zjarrit nga ana e prodhuesit të armës ose shenjat e vëna në mënyrë plotësuese në armë nga ana e organeve të tjera shtetërore kompetente.

Neni 40
Obligimi për të siguruar armët

1. Pronari ose shfrytëzuesi i armës është i detyruar që armën ta mbajë në mënyrë që nuk do ta rrezikojë sigurinë personale dhe sigurinë e të tjerëve.
2. Pronari ose shfrytëzuesi i armës duhet që transportin e armës ta bëjë në atë mënyrë që arma e zjarrit, nëse është e mundur teknikisht, të jetë e çmontuar, respektivisht tyta të jetë e ndarë nga mekanizmi për mbyllje, e nëse kjo nuk është e mundur, së paku municioni të jetë i ndarë nga arma e zjarrit.
3. Ndalohet përdorimi i armës nga ana e pronarit ose e shfrytëzuesit të armës nën ndikimin e alkoolit, të drogave ose në kushte të tjera ku nuk mund ta kuptojë rëndësinë e veprimeve të tij/a.
4. Ndalohet mbajtja e armës përveç nëse ndryshe përcaktohet me këtë ligj.
5. Është e ndaluar që arma e gjahut apo sportive të përdoret jashtë vendit të gjuetisë ose poligonit civil të qitjes. Nëse pronari ose shfrytëzuesi i armës së gjuetisë transporton armën jashtë vendit të gjuetisë ose poligonit civil të qitjes pronari ose shfrytëzuesi është i detyruar që armën e gjuetisë ta transportojë në këllëf adekuat, ndërsa municionin doemos duhet ndarë nga arma.
6. Ndalohet mbajtja dhe përdorimi i armës koleksionuese jashtë objektit të banimit ose vendqëndrimit të koleksionuesit. Arma koleksionuese mund të bartet jashtë vendqëndrimit apo vendbanimit vetëm për qëllim të riparimit, të ekspozimit ose të shitjes së armës koleksionuese në bazë të lejes së veçantë së organit kompetent.
7. Ndalohet furnizimi, posedimi dhe prodhimi i municionit për armën koleksionuese.

8. Dispozita nga paragrafi 4 i këtij neni nuk vlejnë për pjesëmarrësit e:
   8.1. produksionit të filmit, shfaqjeve teatrale dhe manifestimeve të tjera kulturore, për të cilat kërkohet të përdoren armë të zbrazëta apo armë me municion manovrues/shkollor; dhe
   8.2. garave sportive, pas dhënies së sinjalit nga ana e organizatorit.
9. Organi kompetent duhet të jetë i informuar për ngjarjet nga paragrafi 8 pikat 8.1 dhe 8.2 të këtij neni së paku katërmbëdhjetë (14) ditë para ngjarjes. Organizata përkatëse duhet të marrë pëlqim nga organi kompetent para ngjarjeve.
10. Arma pneumatike/ajrore dhe arma me hark duhet të ndalohen të përdoren jashtë poligonit të qitjes ose ndonjë hapësire tjetër të licencuar dhe të siguruar;
11. Armën sportive, armën ajrore dhe armën me hark mund ta përdorin edhe personat prej gjashtëmbëdhjetë (16) deri njëzetenjë (21) vjet vetëm në poligone civile të licencuara për qitje ose në hapësira të tjetra të siguruar dhe caktuar për gara në qitje sportive vetëm nën mbikëqyrjen e personit të rritur të autorizuar.
12. Ndalohet ndryshimi i armëve nga një kategori në tjetrën, gjegjësisht shndërrimi i armës jo vdekjeprurëse në armë vdekjeprurëse.

Neni 41
Obligimi i prezantimit të lejes për mbajtje të armës së zjarrit para personit të autorizuar

1. Personi i cili me vete mban armë, duhet ta ketë me vete lejen për mbajtje të armës së zjarrit.
2. Me kërkesë të personit të autorizuar zyrtar, personi nga paragrafi 1 i këtij neni duhet t'a tregojë lejen dhe armën e zjarrit.

Neni 42
Ruajtja e armëve të zjarrit

1. Personat fizik të cilët posedojnë armë të zjarrit të lejuara, janë të detyruar që armën e zjarrit ta ruajnë në dollap të mbyllur, në kasafortë ose në lokal të veçantë që është i siguruar teknikisht. Arma e zjarrit dhe municioni duhet të ruhen ndaras.
2. Organi kompetent me akt nënligjor, përcakton kushtet minimale për ruajtjen e armëve te zjarrit dhe municionit.

Neni 43
Obligimi i personit juridik për ruajtjen e armës së zjarrit

1. Personat juridik duhet që armët e zjarrit t'i ruajnë ndaras nga municioni në lokal që është i siguruar teknikisht, në dollap të hekurt ose në kasafortë. Arma e zjarrit dhe municioni duhet të ruhen ndaras në dhoma të dedikuara për ruajtjen e armëve të zjarrit dhe municionit.
2. Personat juridik janë të detyruar që për armën e zjarrit dhe municionin të mbajnë evidenca dhe të përcaktojnë personin përgjegjës për mbikëqyrjen e armës së zjarrit dhe municionit. Personi juridik duhet ta informojë organin kompetent për identitetin e personit përgjegjës. Për çdo ndryshim të personit përgjegjës, personat

juridik janë të detyruar ta informojnë organin kompetent në afat prej tre (3) ditë nga dita e ndryshimit.

3. Personi përgjegjës duhet të jetë i aftë ta kontrollojë mënyrën e ruajtjes së armës se zjarrit dhe municionit si dhe mbajtjen e evidencës.
4. Muzetë duhet t'i ruajnë armët e zjarrit në lokale, të cilat janë të siguruara teknikisht dhe ta ekspozojnë atë ashtu që të pamundësohet qasja e paautorizuar ndaj armëve të zjarrit.
5. Organi kompetent përcakton me akt nënligjor kushtet minimale teknike për ruajtjen e armëve të zjarrit dhe municionit.

Neni 44
Shitja e armëve të zjarrit

1. Arma e zjarrit mund t'u shitet vetëm personave juridik dhe personave fizik që posedojnë pëlqim për furnizim me armë te zjarrit, të dhënë në pajtim me këtë ligj.
2. Shitja e armës së zjarrit midis personave fizik bëhet me kontratë, të vërtetuar e cila përmban: emrin, mbiemrin, datën e lindjes, numrin e amzës, numrin personal, numrin e letërnjoftimit ose pasaportës, vendbanimin dhe adresën e banimit të palëve në kontratë, llojin, markën dhe kalibrin e armës se zjarrit, të dhënat për prodhuesin, të dhënat që përfshihen në pëlqim, respektivisht pëlqimi, vendi dhe data e lidhjes së kontratës.
3. Ndërrimi i armëve të zjarrit konsiderohet si shitje dhe zbatohen procedurat e njëjta sikurse për shitjen e armëve, në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni.
4. Personi fizik, i cili ka blerë apo ka ndërruar armë të zjarrit në pajtim me paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni, është i detyruar që në afat prej tetë ditëve nga dita e lidhjes së kontratës për shitblerje, t'ia dorëzojë armën e zjarrit të blerë për qitje provuese organit kompetent.
5. Ndalohet shitja/blerja e armëve, municionit dhe pjesëve për armë përmes internetit.

Neni 45
Zhdukja, humbja apo vjedhja

1. Në rast të zhdukjes, humbjes apo të vjedhjes së armës, pjesëve të armës apo municionit, pronari, shfrytëzuesi apo personi juridik, duhet ta paraqesin rastin tek organi kompetent në afat prej njëzetekatër (24) orëve nga momenti kur ai/ajo e ka vërejtur zhdukjen.
2. Në rast të zhdukjes, humbjes apo vjedhjes të pëlqimit për blerje të armës së zjarrit, pjesët e armës së zjarrit dhe municion, lejes për gjueti apo shenjëtari sport, të lejes për koleksion, lejes për mbajtjen e armës së zjarrit, lejes për posedim të armës se zjarrit, lejes për armët e kategorisë D, pronari apo personi juridik, duhet ta informojë organin kompetent ku është e regjistruar arma apo në stacionin më të afërt policor. Pronari duhet të paraqes kërkesë për lëshimin e kopjeve të atyre dokumenteve tek organi kompetent i cili duhet ti lëshojnë këto kopje brenda tetë (8) ditëve.

Neni 46
Armët apo municioni i gjetur

1. Arma ose municioni i gjetur duhet të lajmërohet menjëherë në stacionin më të afërt policor.
2. Pas skadimit të tre (3) muajve nga dita e dorëzimit, nëse nuk gjendet pronari i armës ose i municionit, vendoset në përputhje me nenin 38 të këtij ligji.

Neni 47
Ndërrimi i vendbanimit

Nëse personi fizik i cili posedon leje për gjueti ose shenjëtari leje për armët e kategorisë D, ose lejes për armë koleksionuese ose personi juridik i cili posedon leje për posedimin e armës së zjarrit, leje për armë koleksionuese ose leje për armët e kategorisë D e ndërron vendbanimin, vendqëndrimin ose selinë, personi fizik ose personi juridik duhet ta prezantojë armën tek stacioni më i afërt policor në afat prej tridhjetë (30) ditëve në vendbanimin apo vendqëndrimin e ri.

Neni 48
Trashëgimi i armës

1. Në rast të vdekjes së pronarit të armës, anëtarët e moshës madhore të familjes së tij ose persona të tjerë të moshës madhore që kanë jetuar me të, në të njëjtën familje, janë të detyruar që në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga vdekja e personit t'ua dorëzojnë armën dhe municionin organit kompetent ose stacionit policor më të afërt, për të cilën duhet të jepet dëshmi për dorëzim. Ne rastet kur anëtarët madhor te familjes nuk e dinë vendin se ku gjendet arma, por janë të sigurt se i vdekuri ka poseduar armën, ata duhet ta informojnë organin kompetent.
2. Arma dhe municioni duhet të ruhen nga organi kompetent deri sa të vendoset në lidhje me trashëgiminë.
3. Organi kompetent me akt nënligjor përcakton mënyrën e dorëzimit, pranimit dhe ruajtjes së armës dhe municionit në rast të vdekjes së pronarit të armës, si dhe formën dhe përmbajtjen e dëshmisë për dorëzim për armën dhe municionin që lëshohet nga organi kompetent.
4. Personi që ka trashëguar armën dhe i përmbush kushtet nga nenit 7 të këtij ligji, në afat prej dy (2) muajve, pas përfundimit të procedurës së trashëgimisë mund të paraqet kërkesë për dhënien e lejes për armën. Personi që ka trashëguar armën dhe nuk i përmbush kushtet nga neni 7 i këtij ligji ose nuk e dëshiron marrjen e lejes, e informon organin kompetent që të fillojë procedurën në pajtim me nenin 36 të këtij ligji.
5. Nëse kërkesa nga paragrafi 4 i këtij neni nuk paraqitet në afatin e paraparë ose kur kërkesa refuzohet, arma dhe municioni merren dhe me ato veprohet në pajtim me nenin 34 të këtij ligji.
6. Në rast kur i vdekuri nuk ka trashëgimtarë, me armën veprohet sipas nenit 38 të këtij ligji.
7. Organi kompetent do të informohet nga gjykata kompetente për përfundimin e procedurës së trashëgimisë në afat prej tetë (8) ditëve.

KREU VI
PRODHIMI I ARMËS DHE MUNICIONIT

Neni 49
Licenca për prodhim të armëve, pjesëve të armës dhe municionit

1. Prodhim të armës, pjesëve të armës dhe municionit mund të bëjnë personat juridikë me seli në territorin e Kosovës, e të cilat kanë marrë licencën për kryerjen e kësaj veprimtarie.
2. Aplikanti paraqet kërkesën tek organi kompetent për lëshimin e licencës për prodhim. Kërkesa përfshinë dokumentet sipas nenit 23 paragrafit 3 pikat 3.1, 3.2, 3.3, 3.5, 3.6 dhe 3.7 të këtij ligji.
3. Organi kompetent vendos brenda tridhjetë (30) ditëve në lidhje me kërkesën nga paragrafi 2 i këtij neni sipas procedurave nga neni 15 të këtij ligji.
4. Licencën nga paragrafi 1 i këtij neni e lëshon organi kompetent, pas marrjes së pëlqimit nga Ministria për Forcën e Sigurisë dhe pas regjistrimit paraprak në regjistrin e biznesit të Republikës së Kosovës.

Neni 50
Përmbajtja e licencës

1. Licenca nga neni 49 i këtij ligji mund të jepet për prodhim të të gjitha llojeve të armëve, pjesëve të armës dhe municionit, që mund të furnizohen në bazë të lejes, ose vetëm për kategori/lloje të veçanta të armëve dhe municionit.
2. Licenca nga paragrafi 1 i këtij neni nuk do të vlejë nëse personi juridik nuk ka filluar me ushtrimin e veprimtarisë në afat prej një (1) viti nga dita e dhënies së licencës.
3. Afati nga paragrafi 2 i këtij neni, mund të vazhdohet nëse dëshmohet se janë paraqitur rrethana të reja, të cilat ndikojnë në fillimin e prodhimit të të gjitha llojeve të armëve dhe municionit. Kjo periudhë shtesë nuk mund të jetë më e gjatë se një (1) vit.

Neni 51
Licenca për riparim të armës

1. Riparimin e armës mund ta bëjnë personat juridik me seli në territorin e Kosovës, të cilat e kanë marrë licencën për kryerjen e kësaj veprimtarie.
2. Aplikanti paraqet kërkesën tek organi kompetent për lëshimin e licencës për riparim. Kërkesa përfshinë dokumentet sipas nenit 23 paragrafit 3 pikat 3.1, 3.2, 3.3, 3.5, 3.6 dhe 3.7 të këtij ligji.
3. Organi kompetent vendos brenda tridhjetë (30) ditëve në lidhje më kërkesën nga paragrafi 2 i këtij neni sipas procedurave nga neni 15 të këtij ligji.
4. Licencën nga paragrafi 1 i këtij neni e lëshon organi kompetent, pas marrjes së pëlqimit nga Ministria për Forcën e Sigurisë dhe pas regjistrimit paraprak në regjistrin e biznesit të Republikës së Kosovës.
5. Licenca nga paragrafi 1 i këtij neni mund të jepet për riparim të të gjitha llojeve të

armëve, që mund të furnizohen në bazë të lejes, ose vetëm për kategori/lloje të veçanta të armëve.

6. Licenca nga paragrafi 1 i këtij neni nuk do të vlejë nëse personi juridik nuk ka filluar me ushtrimin e veprimtarisë në afat prej një (1) viti nga dhënia e licencës.
7. Afati nga paragrafi 6 i këtij neni, mund të vazhdohet nëse dëshmohet se janë paraqitur rrethana të reja, të cilat ndikojnë në fillimin e prodhimit dhe riparimit të të gjitha llojeve të armëve dhe municionit. Kjo periudhë shtesë nuk mund të jetë më e gjatë se një (1) vit.
8. Personat juridik që bëjnë riparimin e armëve duhet të riparojnë vetëm armët e regjistruara.
9. Personat juridik nga paragrafi 8 i këtij neni janë të detyruar të lëshojnë vërtetim për secilën armë të riparuar.
10. Pas riparimit të bërë të pjesëve kryesore të armës së zjarrit, personat juridik nga paragrafi 9 i këtij neni, janë të detyruar të bëjnë qitje provuese të armës se zjarrit.
11. Personat juridik nga paragrafi 10 i këtij neni janë të detyruar që në afat prej pesë (5) ditësh nga kryerja e qitjeve provuese të armës, t'i paraqesin raport për qitjen provuese organit kompetent.
12. Raporti nga paragrafi 11 i këtij neni, duhet të përmbajë të dhëna për personin fizik, ose personin juridik që posedon armën e zjarrit, të dhënat për armën e zjarrit (markën, llojin, prodhuesin, shteti i prodhuesit, numri serik, kalibri, pjesët kryesore të riparuara) dhe qitjen provuese. Së paku dy (2) gëzhoja dhe predha nga qitjet e bëra provuese duhet ti bashkangjiten raportit.
13. Pronari i armës së zjarrit së riparuar duhet ta prezantojë armën e zjarrit të riparuar tek organi kompetent në afat prej pesë (5) ditëve në rastet kur pjesët kryesore të armës se zjarrit janë riparuar.

Neni 52
Obligimi i personit juridik

1. Armët dhe municionet në procesin e prodhimit dhe riparimit duhet të përdoren vetëm nga ana e personave që kanë leje.
2. Personat juridik janë të detyruar të sigurojnë mbrojtje të përhershme fiziko – teknike në lokalet ku i ruajnë armët dhe municionin.
3. Organi kompetent me akt nënligjor përcakton kushtet minimale teknike dhe të sigurisë për lokalet e tyre.

Neni 53
Armët gjatë riparimit

1. Arma që është pranuar për riparim nuk guxon të bartet nga lokali i punës, përveç nëse është e nevojshme qitja provuese.
2. Për kontrollimin e armës së riparuar, personi juridik që posedon licencën nga neni 51 i këtij ligji mund të blejë dhe të ruaj lloje dhe sasi të nevojshme të municionit në bazë të pëlqimit për blerje të municionit.

Neni 54
Paaftësimi/çaktivizim i përhershëm

1. Paaftësimi i përhershëm /çaktivizimi i armës së zjarrit bëhet me marrjen e njërës nga procedurat teknike:
   1.1. në folenë e plumbave të ketë tri vrima të vendosura drejtpërdrejtë, në kënd prej njëqindenjëzet (120) shkallëve, me diametër të barabartë me kalibrin e tytës së armës se zjarrit ose foleja e plumbave të jetë e mbyllur vazhdimisht me mbështjellës, që pamundëson mbushjen e mëtejme të armës se zjarrit me municion;
   1.2. tyta e armës se zjarrit të jetë e mbyllur (me metal të shkrirë) nëpër tërë gjatësinë e tytës ose vetëm në pjesën e folesë së plumbit, gjegjësisht nëpër gjatësinë e saj;
   1.3. tyta e armës të jetë e prerë për së gjati nëpër tërë gjatësinë e saj, me prerje të gjerë së paku pesë (5) milimetra, e cila fillon nga foleja e saj, kurse mbaron me vrimën e tytës;
   1.4. pjesa e përparme e mekanizmit për mbyllje (mbyllësi) të mënjanohet, gjegjësisht të pritet në kënd prej dyzetepesë (45) shkallësh ose vrima për dalje të gjilpërës goditëse të mekanizmit për mbyllje (mbyllësit) me tërheqësin të jetë e mbyllur përgjithmonë, ndërsa gjilpëra goditëse të hiqet; apo
   1.5. tyta e revolverit të jetë e mbyllur në pajtim me paragrafin 1.2 dhe 1.3 të këtij neni, pasi që të jetë shpuar një vrimë, me diametër të barabartë me kalibrin e armës; foleja e plumbave të revolverit të jetë e mbyllur me mbështjellës të metaltë, i cili përfshin brendinë e tytës.
2. Paaftësimin/çaktivizimin e përhershëm të armës së zjarrit mund ta bëjnë personat juridikë me seli në territorin e Republikës së Kosovës, të cilët kanë marrë licencë për prodhimin e armëve dhe municionit, ose për riparimin e armëve, dhe kanë marrë licencën për çaktivizim nga organi kompetent.
3. Aplikanti paraqet kërkesën tek organi kompetent për marrjen e licencës për paaftësim/çaktivizim. Kërkesa përfshin dokumentet sipas nenit 23 paragrafit 3 pikat 3.1, 3.2, 3.3, 3.5, 3.6 dhe 3.7. dhe dëshminë për posedim të licencës për prodhim ose riparim.
4. Organi kompetent vendos brenda tridhjetë (30) ditëve në lidhje me kërkesën nga paragrafi 2 i këtij neni sipas procedurave nga neni 15 të këtij ligji.
5. Pas kryerjes së njërës nga procedurat teknike nga paragrafi 1. këtij neni, personat juridikë duhet të japin vërtetim se është kryer procedura teknike për paaftësimin e plotë të armës se zjarrit dhe duhet ta informojnë organin kompetent brenda dyzetetetë (48) orëve.
6. Arma e zjarrit e cila është paaftësuar përgjithmonë për përdorim, pronari i saj është i detyruar që në afat prej tetë (8) ditëve t'ia dorëzojë armën e zjarrit dhe vërtetimin nga paragrafi 5 i këtij neni komisionit shqyrtues. Komisioni jep vërtetim se arma e zjarrit është paaftësuar përgjithmonë për përdorim. Komisioni Shqyrtues duhet ta vendosë shenjën e identifikimit në armën e zjarrit të paaftësuar, e cila përfshinë shkronjat e kodit zyrtar ndërkombëtar të Kosovës, vitin e paaftësimit dhe shenjën D të paaftësimit.
7. Është i ndaluar riaftësimi për përdorimin e armës së zjarrit, që është paaftësuar përgjithmonë për përdorim.

8. Është i ndaluar eksportimi i armëve të zjarrit të paaftësuara.
9. Arma e zjarrit e çaktivizuar ndalohet te nxjerrët nga vendi ku mbahet.

KREU VII
TREGTIA ME ARMË, PJESË TË ARMËS DHE MUNICION

Neni 55
Licenca për tregti me armë pjesë të armëve dhe municion

1. Tregti me armë, pjesë të armëve dhe municion mund të bëjnë personat juridik me seli në Republikën e Kosovës, të cilët regjistrohen në regjistrin e bizneseve.
2. Aplikanti paraqet kërkesën tek organi kompetent për lëshimin e licencës për tregti. Kërkesa përfshinë dokumentet sipas nenit 23 paragrafit 3 pikat 3.1, 3.2, 3.3, 3.5, 3.6 dhe 3.7. të këtij ligji.
3. Organi kompetent vendos brenda tridhjetë (30) ditëve në lidhje me kërkesën nga paragrafi 2 i këtij neni sipas procedurave nga neni 15 të këtij ligji.
4. Tregtia me armë dhe municion nga neni 4 - kategoria A, duhet të bëhet vetëm me leje të veçantë të lëshuar nga organi kompetent dhe me pëlqimin paraprak të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës sipas dispozitave që rregullojnë pajisjen me armë dhe municion të organeve të autorizuara shtetërore.
5. Personat juridik nga paragrafi 1 i këtij neni mund t'u shesin armë të zjarrit dhe municion vetëm personave fizik dhe juridik, të cilët posedojnë pëlqim për blerje të armëve të zjarrit dhe municionit.
6. Dispozitat nga nenet 24, 49 dhe 50 të këtij ligji zbatohen për personat juridik, të cilët bëjnë tregti me armë dhe municion.
7. Personat juridik mund t'u shesin municion për armë të zjarrit personave fizik, në pajtim me nenin 6, paragrafin 5 dhe 6 të këtij ligji, ndërsa municion për armë te zjarrit mund t'u shesin personave juridik që merren me veprimtaritë e përcaktuara në nenin 6 paragrafin 8 të këtij ligji.

Neni 56
Shënjimi i armëve të zjarrit

1. Vetëm armët e zjarrit, municioni dhe pjesët e armëve të zjarrit të cilët janë në rregull të shenjëzuara mund të shiten.
2. Organi kompetent në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë do të nxjerrë akt nënligjor për shënjimin e armëve te zjarrit, pjesëve të armëve te zjarrit dhe municionit.

Neni 57
Ruajtja

Depot dhe objektet ku bëhet tregtia me armë dhe municion duhet t'i plotësojnë kushtet për vendosjen dhe ruajtjen e armëve shpërthyese, në pajtim me këtë ligj dhe me ligjin për përdorim civil të eksplozivëve.

Neni 58
Shënjimi i armëve të zjarrit të importuara

1. Personi juridik nga neni 55, paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji, i cili importon armë të zjarrit, e ka për detyrë që armën e zjarrit ta shënjojë me shenjën për import.
2. Shenja nga paragrafi 1 i këtij neni shtypet në një pjesë të armës se zjarrit në vendin ku janë shtypur shenjat e tjera të armës se zjarrit (prodhuesi).
3. Shenja nga paragrafi 1 i këtij neni është në formë rrethi me diametër prej 6 milimetrash, e shtypur në armë e zjarrit në thellësi prej më së paku 0,8 milimetra.
4. Shenja nga paragrafi 1 i këtij neni përmban kodin zyrtar ndërkombëtare të Kosovës dhe vitin e importit të armës se zjarrit.
5. Armët e zjarrit dhe municioni që kalojnë transit nëpër territorin e Kosovës nuk shënjohen me vulën e importit.

KREU VIII
BARTJA E ARMËVE, PJESËVE TË ARMËVE DHE MUNICIONIT PËRMES KUFIRIT SHTETËROR

Neni 59
Licenca për transport të armëve, pjesëve të armës dhe municionit

1. Transport me armë, pjesë të armëve dhe municion mund të bëjnë personat juridikë me seli në Republikën e Kosovës, të cilët regjistrohen në regjistrin e bizneseve.
2. Aplikanti paraqet kërkesën tek organi kompetent për lëshimin e licencës për transport. Kërkesa përfshin dokumentet sipas nenit 23 paragrafit 3 pikat 3.1, 3.2, 3.3, 3.5, 3.6 dhe 3.7. të këtij ligji dhe licencë nga Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit.
3. Organi kompetent vendos brenda tridhjetë (30) ditëve në lidhje me kërkesën nga paragrafi 2 i këtij neni sipas procedurave nga neni 15 të këtij ligji.
4. Tregtia me armë dhe municion nga neni 4 - kategoria A, duhet të bëhet vetëm me leje të veçantë të lëshuar nga organi kompetent dhe me pëlqimin paraprak të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës sipas dispozitave që rregullojnë pajisjen me armë dhe municion të organeve të autorizuara shtetërore.

Neni 60
Transport i armëve, pjesëve të armëve ose municionit nga personi fizik

1. Shtetasi i Republikës së Kosovës ose i huaji me vendqëndrim të përhershëm ose i huaji që kalon transit, mund t'i bartë vetëm ato lloje të armës dhe municionit, të cilat në pajtim me dispozitat e këtij ligji mund t'i blejnë, posedojnë ose mbajnë.
2. Gjatë bartjes të armës dhe municionit nga paragrafi 1 i këtij neni, shtetasi i Republikës së Kosovës ose i huaji e kanë për detyrë ta paraqesin armën dhe municionin dhe lejen e lëshuar nga zyrtari përgjegjës, zyrtarit policor në pikën kufitare.
3. Nëse zyrtari i autorizuar në pikën kufitare gjatë kontrollit të mjetit transportues gjen armë dhe municion, të cilin nuk e ka lajmëruar ose për armën dhe municionin

nuk e ka paraqitur lejen/licencën, zyrtari i autorizuar duhet t'ia sekuestrojë armën dhe municionin deri në përfundim të procedurës për kundërvajtje ose procedurës penale, me vendim të plotfuqishëm.

4. Organi kompetent rregullon me akt nën ligjor mënyrën e bartjes së armëve dhe municionit në kufirin shtetëror.

Neni 61
Transporti i armës për gjueti nga personi fizik

1. Shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët kanë qëndrim të përhershëm në vende të jashtme dhe të huajt, kanë mundësi që për qëllime të gjuetisë të transportojnë armë gjahu dhe municion për atë armë në Republikën e Kosovës, nëse kanë leje për posedimin e armës së gjahut për gjueti dhe posedojnë sigurimin shëndetësor të lëshuar nga organi kompetent i shtetit tjetër dhe ftesën për pjesëmarrje në gjah, të aprovuar paraprakisht nga organi kompetent.
2. Personat e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni janë të obliguar që gjatë kalimit në pikën kufitare ta paraqesin armën për gjueti dhe municionin tek zyrtari policor.
3. Zyrtarët policorë gjatë kontrollit në pikën kufitare i lëshojnë personit nga paragrafi 1 i këtij neni pëlqim për transport të armëve për gjueti gjatë aktiviteteve të gjuetisë në territorin e Republikës së Kosovës.
4. Organi kompetent me akt nënligjor do të përcaktoj procedurat për aprovimin e ftesës për aktivitete të gjuetisë.

Neni 62
Transportimi i armëve nga anëtarët e shoqatave të shenjëtarisë

1. Anëtarët e shoqatës të shenjëtarisë në grupe apo në mënyrë individuale të cilët udhëtojnë në vend të huaj për arsye të pjesëmarrjes në gara të qitjes ose për arsye të përgatitjeve për gara të tilla, kanë mundësi që përmes kufirit shtetëror të bartin armë dhe municion për ato nevoja të përcaktuara me pëlqim nga organi kompetent.
2. Anëtarët e shoqatave të huaja të shenjëtarisë mund të transportojnë armë sportive në Republikën e Kosovës me qëllim të pjesëmarrjes në gara për qitje ose me qëllim të përgatitjeve për gara në qitje, me pëlqim të dhënë nga organi kompetent i Republikës së Kosovës dhe në bazë të dokumentit tjetër adekuat të dhënë nga organi kompetent i ndonjë shteti tjetër.
3. Zyrtarët e autorizuar në pikën e kalimit kufitar ua lëshojnë pëlqimin personave nga paragrafi 2 i këtij neni.
4. Anëtarët e shoqatës së shenjëtarisë nga paragrafi 2 i këtij neni, duhet të posedojnë sigurimin shëndetësor.
5. Organi kompetent me akt nënligjor do të përcaktoj procedurat për aprovimin e ftesës për gara të qitjes.

Neni 63
Shitja e armëve, pjesëve të armëve ose municionit të konfiskuara në kufi

1. Armët e gjahut, armët sportive dhe municioni për armë që janë konfiskuar nga zyrtarët të autorizuar në pikat kufitare mund të shiten pas njoftimit, përmes

ankandit publik të personave juridikë që kanë licencën për tregti të armëve, pjesëve të armës dhe municionit personave juridik dhe personave fizik që kanë pëlqim për blerje të armës së zjarrit.
2. Me armët e zjarrit dhe municionin tjetër që është konfiskuar nga zyrtarët e autorizuar në pikat kufitare veprohet në pajtim me nenin 38 të këtij ligji.

Neni 64
Marrëveshjet ndërkombëtare

Armët dhe municioni nuk mund të transportohen përmes pikës së kalimit kufitar, përveç nëse me marrëveshje ndërkombëtare është përcaktuar ndryshe.

KREU IX
POLIGONET CIVILE PËR QITJE

Neni 65
Licenca për poligonet civile për qitje

1. Poligonet civile për qitje janë objekte të dedikuara për ushtrime sportive – rekreative në qitje, si dhe për aftësime lidhur me përdorimin e drejtë dhe të sigurt të armës se zjarrit, që plotësojnë kushte teknike dhe të sigurta për përdorimin e armës së zjarrit, armës së gjuetisë dhe armës sportive.
2. Poligonet civile për qitje mund të hapen nga personat juridik, të cilët duhet të marrin licencë nga organi kompetent dhe ti plotësojnë kushtet për regjistrim në regjistrin e bizneseve.
3. Aplikuesi paraqet kërkesën tek organi kompetent për lëshimin e licencës për poligonet civile për qitje. Kërkesa përfshin dokumentet sipas nenit 23 paragrafit 3 pikat 3.1, 3.2, 3.3, 3.5, 3.6 dhe 3.7 të këtij ligji.
4. Organi kompetent vendos brenda tridhjetë (30) ditëve në lidhje me kërkesën nga paragrafi 2 i këtij neni sipas procedurave nga neni 15 i këtij ligji.
5. Personi juridik nga paragrafi 1,i këtij neni e ka për detyrë të hartojë rendin shtëpiak të poligonit civil për qitje, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e themelimit të poligonit për qitje, pas miratimit nga organi kompetent.
6. Dispozitat nga nenet 24, 49 dhe 50 të këtij ligji, duhet të zbatohen për hapjen e poligoneve civile për qitje.
7. Dispozitat e këtij ligji për poligonet civile të qitjes nuk zbatohen për vendet e gjuetisë, të cilat shoqatat e gjuetarëve i shfrytëzojnë për qitje dhe për testimin e armës së gjuetisë në pajtim me dispozitat e ligjit për gjueti.
8. Organi kompetent me akt nënligjor përcakton kushtet teknike dhe të sigurisë që duhet t'i plotësojnë objektet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 66
Leja për përdorimin e poligoneve për qitje

1. Qitje në poligonet civile mund të bëjnë personat fizikë, të cilët kanë leje të mbajnë armë të atillë ose kanë parashtruar kërkesë për blerjen e armës dhe marrin pjesë në trajnimin praktik për tu pajisur me pëlqim.

2. Personat fizikë nga paragrafi 1 i këtij neni kanë për detyrë që gjatë qitjes të mbajnë syze mbrojtëse dhe mbrojtës për vesh.

Neni 67
Municioni për poligonet për qitje

1. Poligonet civile për qitje mund të furnizohen me sasi më të mëdha të municionit për qitje në poligonet e qitjes, në bazë të pëlqimit paraprak të organit kompetent.
2. Organi kompetent do të jep pëlqimin për blerje të shumëfishtë me municion me afat të vlefshmërisë deri në një (1) vit dhe për sasi të përcaktuara të municionit në pajtim me mundësitë për vendosjen dhe shfrytëzimin e municionit.

KREU X
EVIDENCAT

Neni 68
Mbajtja e evidencave nga organi kompetent

1. Organi kompetent mban evidencë për:
   1.1. pëlqimet e lëshuara për blerje të armëve, pjesëve të armës dhe municionit;
   1.2. kërkesat e paraqitura për regjistrimin e armës;
   1.3. kërkesat për njohjen e lejeve/licencave ekzistuese;
   1.4. lejet për armët e gjuetisë dhe shenjëtarisë;
   1.5. lejet për mbajtjen e armës se zjarrit;
   1.6. pëlqim për blerjen e armëve koleksionuese;
   1.7. kërkesat e dorëzuara për regjistrimin e armëve koleksionuese;
   1.8. lejet për armë koleksionuese;
   1.9. lejet për armë nga kategoria D;
   1.10. armë dhe municion të konfiskuar, të gjetur, të dorëzuar;
   1.11. licenca/lejet për prodhim dhe riparim;
   1.12. dokument dëshmues për armë zjarri e cila është paaftësuar përherë;
   1.13. lejet/licencat për tregti;
   1.14. lejet/licencat për transport;
   1.15. licencat për hapjen e poligoneve civile për qitje;
   1.16. aprovim për import dhe export të armëve, pjesëve të armës dhe të municionit për organet shtetërore;
   1.17. lejet për transportimin e armëve për persona apo shoqata qe marrin pjese ne gara te gjuetisë apo shenjëtarisë dhe municionit të dhënë nga përfaqësia diplomatike – konsulare;
   1.18. baza e të dhënave të fotografive digjitale të secilës armë të regjistruar;
   1.19. lista shtetërore e numrit identifikues;
   1.20. lista shtetërore e armëve;
   1.21. leje për mbajtjen e armës për gjueti gjatë kohës të gjuetisë në shtet;
   1.22. lejet për mbajtjen e armës sportive; dhe
   1.23. lejet për licencë për transitin e armës dhe municionit.

Neni 69
Obligimi për mbajtjen e evidencave

1. Shoqatat e gjuetarëve dhe të shenjëtarisë, qendrat e trajnimit, personat juridik shfrytëzues të terreneve të gjuetisë dhe personat e tjerë juridik që posedojnë armë te zjarrit në bazë të lejes për posedimin e armëve te zjarrit janë të obliguar të mbajnë evidencë të armëve te armeve te zjarrit dhe municionit edhe për personat, të cilëve ua japin armën e zjarrit për përdorim.
2. Evidencë të armëve të zjarrit dhe të municionit janë të detyruar të mbajnë personat juridik që bëjnë:
   2.1. prodhimin e armëve, pjesëve të armës dhe të municionit, për armët, pjesët e armëve dhe municionin e prodhuar dhe të porositur;
   2.2. riparimin e armëve, evidencë për armën e riparuar; dhe
   2.3. tregti me armë, pjesë të armës dhe municion, për armë, pjesë të armës dhe municion të blerë dhe të shitur.
3. Personat juridikë janë të obliguar të mbajnë evidencë për qitjet provuese (fishekët dhe arkëzat) për çdo armë te zjarrit.
4. Poligonet civile të qitjes, janë të obliguar të mbajnë evidencë për municionin e dhënë dhe të përdorur.
5. Procedurat e lejes së veçantë do të përcaktohen me akt nën ligjor.

Neni 70
Përcaktimi i formës së formularëve dhe kërkesave

1. Në pajtim me këtë ligj, organi kompetent me akt nënligjor cakton formën e kërkesës dhe formularëve për:
   1.1. dhënien e pëlqimit për blerjen e armës se zjarrit, pjesës së armës te zjarrit dhe municionit;
   1.2. kërkesën për zëvendësimin e lejes për armën e dhënë nga organi kompetent në shtetin tjetër;
   1.3. lejen për armë të gjuetisë ose shenjëtarisë;
   1.4. lejen për posedimin e armës;
   1.5. lejen për mbajtjen e armës se zjarrit;
   1.6. lejen për armë të kategorisë D;
   1.7. lejen/licencën për prodhim, tregti, transport të armëve, pjesëve të armës dhe municionit;
   1.8. lejen/licencën për riparim të armës;
   1.9. lejen për bartjen e armës dhe municionit jashtë shtetit;
   1.10. lejen për bartjen e armës dhe municionit të dhënë për përfaqësitë diplomatike konsullore;
   1.11. lejen për posedimin dhe mbajtjen e armës së gjuetisë gjatë gjuetisë në shtet;
   1.12. lejen për bartjen e armës sportive;
   1.13. lejen për transit të armëve dhe municionit;
   1.14. licencën për hapjen e poligoneve të qitjes, dhe
   1.15. lejen për mënyrën e mbajtjes së evidencës së armëve dhe të municionit.
2. Evidencat duhet të ruhen më së paku njëzet (20) vite nga të gjitha entitetet e lartpërmendura.

3. Organi kompetent do të përcaktojë me akt nënligjor mënyrën e gjurmimit të armëve të zjarrit dhe municionit.

KREU XI
MBIKËQYRJA

Neni 71
Mbikëqyrja nga organi kompetent

1. Organi kompetent mbikëqyrë përmbushjen e kushteve të parapara për prodhimin, riparimin, tregtim, vendosjen, ruajtjen e armëve dhe municionit, përdorimin e poligoneve të qitjes, ligjshmërinë e posedimit dhe mbajtjes së armëve të zjarrit dhe municionit, si dhe mbajtjen e evidencave.
2. Personat e autorizuar fizik dhe juridik janë të obliguar ta mundësojnë kryerjen e mbikëqyrjes, të kontrollit të armëve, ta vënë në disponim dokumentacionin përkatës dhe t'i japin të dhënat dhe njoftimet e nevojshme.
3. Organi kompetent personit juridik ia ndalon prodhimin, riparimin, tregtinë me armë dhe municion ose shfrytëzimin e poligonit për qitje civile, nëse vërteton se kushtet mbi bazën e të cilave është dhënë licenca/leja e paraparë me këtë ligj kanë pushuar së ekzistuari apo parregullsitë e evidentuara nuk evitohen në afatin e caktuar.
4. Personat juridik, të cilëve i është marrë leja/licenca për prodhimin, riparimin ose tregtinë me armë dhe municion ose shfrytëzimin e poligonit për qitje civile, kërkesën për lëshimin e sërishëm të licencës/lejes mund ta parashtrojnë pas kalimit të afatit prej dy (2) viteve nga plotfuqishmëria e vendimit, me të cilin u është marrë licenca/leja.
5. Armët e zjarrit dhe municioni, me të cilat disponon personi juridik i dorëzohen organit kompetent në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e marrjes së vendimit të formës së prerë.
6. Armët e zjarrit dhe municioni nga paragrafi 5 i këtij neni u shiten në ankand publik personave juridik që merren me tregtinë e armëve dhe municionit dhe personave fizik qe kanë pëlqimin për blerjen e armëve të zjarrit dhe municionit.
7. Mjetet e realizuara nga shitja e armëve të zjarrit dhe municionit janë mjete të personit juridik. Organi kompetent ka të drejtë që të kompensohet për shpenzimet procedurale.

KREU XII
DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 72
Dispozitat ndëshkuese

1. Personat fizik dhe personat juridik qe veprojnë ne kundërshtim me dispozitat e këtij ligji do te sanksionohen.
2. Lidhur me përgjegjësinë penale vlejnë dispozitat e Kodit Penal te Kosovës.

Neni 73

1. Me gjobë prej dhjetëmijë (10.000) Euro deri në njëqindmijë (100.000) Euro gjobitet personi juridik, i cili do të tregtojë, furnizojë, ndërmjetësoj, posedojë, prodhojë, riparojë, ndërrojë ose t'i japë dikujt tjetër armë, pjesë të armëve dhe municion, i cili furnizim, ndërmjetësim, tregtim, posedim, prodhim, riparim ose qarkullim është i ndaluar apo është ne kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.
2. Për veprimet e parapara në paragrafin 1 i këtij neni personit juridik do t'i shqiptohet masë plotësuese e marrjes së armës, municionit dhe e ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë (prodhimit, riparimit, qarkullimit me armë dhe municion ose shfrytëzimit të poligonit për qitje civile) në afat prej dy (2) deri në pesë (5) vite.

Neni 74

1. Personi juridik dënohet për kundërvajtje me gjobë prej njëmijë (1000) Euro deri më dhjetëmijë (10.000) Euro, ndërsa personi fizik dënohet me gjobë prej pesëqind (500) Euro deri pesëmijë (5.000) Euro ose me burg deri në gjashtëdhjetë (60) ditë, i cili:
   1.1. e mban armën në mënyrë që bie ndesh me dispozitat e nenit 18 të këtij ligji;
   1.2. në afatin e përcaktuar nuk do të parashtrojë kërkesë për regjistrimin e armës dhe lëshimin e lejes për armë te organi kompetent neni 16, paragrafi 1 i këtij ligji;
   1.3. nuk ka leje për bartjen e armës nga depoja për armë në shoqatën e shenjëtarisë/gjuetisë deri në poligonin e qitjes ose në terren të caktuar për gjueti, si dhe në drejtim të kundërt neni 19, paragrafi 7, neni 20 paragrafi 2 dhe neni 21 paragrafi 2 të këtij ligji;
   1.4. nuk e paraqet te organi kompetent armën koleksionuese që e ka blerë ose që e posedon sipas nenit 19 paragrafi 4 i këtij ligji;
   1.5. që vepron në kundërshtim me nenin 43, paragrafi 3 i këtij ligji;
   1.6. vepron në kundërshtim me nenin 45 të këtij ligji;
   1.7. vepron në kundërshtim me nenin 47 të këtij ligji;
   1.8. vepron në kundërshtim me nenin 48, paragrafi 1 i këtij ligji;
   1.9. vepron në kundërshtim me nenin 60, paragrafi 2 i këtij ligji,
   1.10. vepron në kundërshtim me nenin 61 paragrafi 2 i këtij ligji; dhe
   1.11. vepron në mënyrë që bie ndesh me dispozitat e nenit 69, paragrafi 2 i këtij ligji.
2. Për kundërvajtjen nga paragrafi 1, pikat 1.1, 1.3, 1.7 dhe 1.8 të këtij neni, personit fizik dhe personit juridik do t'i shqiptohet edhe dënimi plotësues - marrja e armës dhe e municionit.

Neni 75

1. Me gjobë për kundërvajtje prej dhjetëmijë (10.000) deri në pesëdhjetëmijë (50.000) Euro do të gjobitet personi juridik, i cili:
   1.1. vepron në kundërshtim me nenin 44 të këtij ligji;
   1.2. e ruan armën në mënyrë që bie ndesh me dispozitat e këtij ligji;
   1.3. vepron në kundërshtim me nenin 50, paragrafi 2 i këtij ligji;

1.4. pranon ta riparojë armën që nuk është e regjistruar neni 51 paragrafi 8 i këtij ligji;
1.5. vepron në kundërshtim me nenin 52, paragrafi 2 i këtij ligji;
1.6. e ka pranuar armën për riparim që ka qenë e nxjerrë nga vendi i punës neni 53, paragrafi 1 i këtij ligji;
1.7. bën tregti me armë dhe municion në mënyrë që bie ndesh me dispozitat e nenit 54, paragrafët 5 dhe 6 të këtij ligji;
1.8. lëshon në qarkullim armë, municion dhe pjesë të armës që nuk janë shënuar, testuar, vulosur, gjegjësisht shënjuar në pajtim me rregullat për testim dhe vulosje, gjegjësisht me ato për shënjimin e armëve të vogla dhe të lehta të zjarrit dhe të municionit neni 56 i këtij ligji;
1.9. bartë armë dhe municion pa leje ose në kundërshtim me urdhrat për ndërmarrjen e masave të posaçme për siguri gjatë transportit neni 59 i këtij ligji;
1.10. vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 60, paragrafi 2 i këtij ligji.

2. Me gjobë prej njëmijë (1.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro dënohet për veprat e parapara me këtë nen edhe personi përgjegjës te personi juridik, ndërsa për paragrafi 1 pika 1.2 dhe 1.8 te këtij neni me të njëjtin dënim të paraparë me gjobë.
3. Për shkeljet e këtij neni do të shqiptohen edhe dënimet plotësuese në kohëzgjatje prej një (1) deri në tre (3) vite.
4. Armët dhe municioni konfiskohen.

Neni 76

1. Gjobitet në shumë prej pesëmijë (5.000) deri në pesëdhjetëmijë (50.000) personi juridik, i cili:
1.1. nuk u japë vërtetim për aftësim praktik për manipulim me armë personave fizikë - kërkuesve të lejes për furnizim me armë neni 12, paragrafët 3 dhe 4 të këtij ligji;
1.2. në afatin e përcaktuar nuk parashtron kërkesë për regjistrimin e armës dhe lëshimin e lejes për armë neni 16 paragrafi 1 i këtij ligji;
1.3. në afatin e përcaktuar nuk e njofton organin kompetent neni 16 paragrafi 2 i këtij ligji;
1.4. jep vërtetim me të cilin i besohet arma e gjuetisë për gjueti njëditëshe në rajonin e gjuetisë, personit që nuk është anëtarë aktiv i shoqatës së gjuetarëve neni 20 paragrafi 5 i këtij ligji;
1.5. jep në përdorim armë personave, të cilët posedojnë leje gjueti, por nuk janë anëtarë aktivë të shoqatës së gjuetarëve neni 20, paragrafi 5 i këtij ligji;
1.6. në afatin e përcaktuar, nuk paraqet zhdukjen, humbjen ose vjedhjen e armës dhe municionit, pëlqimit për blerje te armës apo lejes neni 45 paragraf 1 i këtij ligji;
1.7. gjatë ndërrimit të selisë në afatin e përcaktuar nuk paraqet armën tek organi kompetent neni 47 i këtij ligji;
1.8. në afatin e përcaktuar nuk kryen gjuajtjen provuese të armës, pas kryerjes së riparimit të pjesëve kryesore të armës së zjarrit neni 51, paragrafi 9 i këtij ligji; dhe

1.9. nuk mban evidencë në pajtim me dispozitat e nenit 69 të këtij ligji.

2. Personi përgjegjës tek personi juridik gjobitet në shumë prej dyqind (200) deri në njëmijë (1000) Euro për veprat e parapara në nenin 75 paragrafi 1. pikat 1.1, 1.2, 1.3, 1.6, 1.7, 1.8 dhe 1.9 të këtij ligji..
3. Për vepra nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni do të shqiptohet dënimi plotësues - marrje e armës dhe municionit.

KREU XIII
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 77
Aktet nënligjore

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të nxirren në afat prej një (1) viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 78
Procedurat dhe kushtet e dorëzimit vullnetar të armëve

Qeveria e Kosovës me akt nënligjor do të përcaktojë procedurat, kushtet dhe kriteret për dorëzim vullnetar të armëve të vogla dhe të lehta AVL-ve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 79
Të hyrat nga ligji

Të gjitha mjetet e realizuara ne bazë të këtij ligji derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Neni 80
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore që janë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 81
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-143
17 shtator 2009

Shpallur me dekretin Nr. DL-025-2009, datë 13.10.2009 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI IV / Nr. 59 / 29 TETOR 2009

LIGJI Nr. 03/L-246
PËR PAJISJE ME ARMË, MUNICION DHE PAJISJE PËRKATËSE TË SIGURISË PËR INSTITUCIONET E AUTORIZUARA SHTETËRORE PËR SIGURI

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 655
Kreu II: Prodhimi dhe riparimi i PQV-së 663
Kreu III: Tregtia e PQV-së 667
Kreu IV: Siguria e PQV-së 670
Kreu V: Kontrolli i cilësisë së PQV-së 671
Kreu VI: Mbikëqyrja 672
Kreu VII: Dispozitat ndëshkuese 673
Kreu VIII: Dispozitat kalimtare 674
Kreu IX: Dispozitat përfundimtare 675

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR PAJISJE ME ARMË, MUNICION DHE PAJISJE PËRKATËSE TË SIGURISË PËR INSTITUCIONET E AUTORIZUARA SHTETËRORE PËR SIGURI

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i dispozitave ligjore lidhur me pajisjen me armë, municion dhe pajisje përkatëse për siguri për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri.

Neni 2
Fushëveprimi

Ky ligj rregullon prodhimin, riparimin, tregtinë, importin, eksportin, vënien e shenjave identifikuese, evidentimin, sigurinë gjatë deponimit dhe transportit, dhe vlerësimin e përputhshmërisë me kushtet për armët, municionin dhe pajisjet përkatëse për siguri për

nevojat e institucioneve të autorizuara shtetërore të sigurisë, përveç për nevojat për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **Institucionet e Autorizuara Shtetërore të Sigurisë** - Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës, Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Shërbimin Korrektues, Doganën e Kosovës dhe Agjencionin Pyjor të Kosovës;
   1.2. **Pajisje për qëllime të veçanta (PQV)**- armët, muninicionin dhe pajisjet përkatëse për siguri të dedikuara për institucionet shtetërore për siguri;
   1.3. **Armë**- nënkupton por nuk kufizohet në secilin mjet ose vegël e punuar me qëllim që nën presionin e gazrave, të cilat shkaktohen gjatë djegies së materialeve shpërthyese, elektricitetit, gazrave nën presion ose energjisë tjetër potenciale, të hedhë predha në formë të plumbit, grumbullit prej saçmash, gazi, lëngu, shigjete ose përbërësish të tjerë, që është e përcaktuar ose është përdorur për të shkaktuar dëme trupore, dëme fizike, dëme psikologjike, dhe po ashtu çdo mjet tjetër, qëllimi i të cilit është të bëjë sulm fizik ndaj integritetit fizik të njerëzve ose pronës;
   1.4. **Armë e zjarrit** - pajisja që mund të përdoret si armë e cila gjuan një predhë të vetme ose shumë predha me shpejtësi të madhe përmes shtytjes së gazrave që krijohen nga djegia e shpejtë e brendshme e lëndës shtytëse ose përmes formave tjera të shtytjes së predhës që shkrepet nga arma e zjarrit;
   1.5. **Armë e shkurtër e zjarrit -** arma e zjarrit me tytë jo më të gjatë se 30 cm ose gjatësia e përgjithshme e së cilës nuk është më e madhe se 60 cm;
   1.6. **Armë e gjatë e zjarrit** - çdo armë të zjarrit tyta e së cilës është më e gjatë se 30 cm ose gjatësia e së cilës është më e madhe se 60 cm;
   1.7. **Armë automatike e zjarrit -** arma e zjarrit e cila rimbushet në mënyrë automatike sa herë që shkrepet ndonjë plumb dhe e cila mund të gjuajë më shumë se një plumb me një të tërhequr të këmbëzës;
   1.8. **Armë gjysmë-automatike e zjarrit** – arma e zjarrit e cila rimbushet sa herë që shkrepet ndonjë plumb dhe e cila mund të gjuaj vetëm një plumb me një të tërhequr të këmbëzës;
   1.9. **Armë e zjarrit me përsëritje** - arma e zjarrit e cila pas gjuajtjes së një plumbi është e dizajnuar që të rimbushet nga karikatori ose cilindri përmes veprimit me dorë;
   1.10. **Armë të drejtuara me energji (ADE)** - lloji i armës që liron energji në një drejtim të shënjuar pa përdorur predhën. Kjo armë e bartë energjinë tek shënjestra për qëllime të efektit të dëshiruar;
   1.11. **Armë për përdorim të mjeteve të ndryshme -** të gjitha llojet e pushkëve, pistoletave, revolverëve apo të mjeteve të tjera, të cilat nën shtypjen e barotit ose të gazrave përhapin në një drejtim gaz ngacmues që ka ndikim në shëndetin e njeriut;
   1.12. **Armë e zjarrit për sinjalizim të lehtë akustik**- arma e zjarrit e cila

përdoret zakonisht si sinjal për ndonjë fatkeqësi si dhe për qëllime të tjera sinjalizuese në det dhe ndërmjet aeroplanëve e njerëzve në tokë, përfshirë të gjitha llojet e pistoletave, revolverëve dhe pajisjeve të tjera, të cilat nën presionin e barotit ose gazrave, gjuajnë ose hedhin predha sinjalizuese në një drejtim dhe nxjerrin ose shpërndajnë predha, me përjashtim të pistoletave për sinjalizim me dritë që janë për përdorim ushtarak;

1.13. **Armë eksplozive** - nënkupton, por nuk kufizohet në çdo lloj të bombës, minës, raketës, granatës apo mjetit tjetër që përmban substanca eksplozive apo materiale ndezëse, ndaj të cilave për shkak të proceseve të brendshme apo të jashtme (peshës, ndikimit, fërkimit, reagimit kimik, energjisë elektrike dhe të ngjashme) shkaktohet lirimi apo krijimi i energjisë dhe eksplodimit. Sipas këtij Ligji, armë eksplozive gjithashtu konsiderohen pjesët e eksplozivëve, detonatorët, mjetet piroteknike apo pjesët e tjera për të cilat qartë duket se janë të parapara për përgatitjen e armëve eksplozive. Ky përkufizim përfshin armët termobarike, të cilat dallohen nga armët konvencionale eksplozive për shkak se funksionojnë me oksigjen atmosferik dhe nuk kanë oksidues në eksplozivët e tyre. Armët termobarike, po ashtu quhen armë termobarike me impuls të lartë (TIL), eksploziv karburant-ajër (EKA apo FAX), si dhe nganjëherë quhen edhe municione karburant-ajër, armë me nxehtësi dhe shtypje apo bomba vakumike;

1.14. **Armë e ftohtë** - çdo mjet që përdoret për të kryer një sulm ose për të shkaktuar lëndime trupore, përmes përdorimit të forcës fizike nga sulmuesi, kur këto mbahen në tubime dhe objekte publike dhe vende të ngjashme;

1.15. **Armë me elektroshok** - arma pa aftësuese që përdoret për qetësimin e personit apo të shtazës përmes elektroshokut që ka për qëllim pengimin e funksioneve të muskujve sipërfaqësor. Përveç kësaj, armë elektroshoku, nënkupton por nuk kufizohet në armë dhe shkopinj për paralizim të përkohshëm, që shkaktojnë shok elektrik përmes kontaktit të drejtpërdrejtë;

1.16. **Pjesa kryesore e armës së zjarrit -** çdo element që është i dizajnuar në mënyrë specifike për armë të zjarrit dhe është thelbësor për funksionimin e saj, duke përfshirë mes tjerash, mekanizmin e këmbëzës, gjilpërën goditëse, tytën, kornizën apo pranuesin, rrëshqitësin apo cilindrin, shulin apo shtratin e folesë së fishekut, shulin dhe pjesët përbërëse të tij;

1.17. **Pajisje e posaçme për armë të zjarrit** - çdo mekanizëm që është i prodhuar dhe i dedikuar për përmirësimin e nomenklaturës themelore të armës së zjarrit, e cila përmes aplikimit të saj, e rritë performancën dhe cilësinë e përdorimit të armës së zjarrit, përveç shënjestrës optike;

1.18. **Zbutësi apo shurdhuesi** - pajisja që i bashkëngjitet tytës apo është pjesë e saj me qëllim të zvogëlimit të zhurmës dhe flakës së krijuar nga qitja me armë zjarri;

1.19. **Mjete optike të armëve të zjarrit për shikim (po ashtu të njohura si optikat e armëve të zjarrit të policisë) -** mjetet e autorizuara për përdorim policor, të cilat mund të prodhohen drejtpërdrejt apo të ngjitura në armë zjarri, për qëllim të identifikimit apo gjetjes së cakut, por që zakonisht nuk përfshinë shënjestrat e hekurit, shënjestrat me harqe (peep-sights), dhe shënjestrat e hekurta apo me harqe (peep-sights) që palohen. Optikat e

armëve të zjarrit nënkuptojnë përfshirjen e mjeteve që rrisin aftësinë e përdoruesit të autorizuar që të identifikojë, njohë, të shohë largësinë nëpërmes zmadhimit, mjeteve jozmadhuse të cakut, zërit, shënjestrimit direkt të laserit jo-vdekjeprurës, shënjestrimit infrared (reze ultra violete) apo optikat që mundësojnë identifikimin e cakut të jenë në nivele të ndriçimit duke iu qasur errësirës së tërësishme dhe gjetjes së cakut, i cili do të mund të ndihmojë në objektivat legjitime policore;

1.20. **Municion** - predhat siç janë plumbat, saçmet e armëve ajrore dhe predhat, bashkë me fitilat dhe kapsollat e tyre, të cilat mund të gjuhen nga armët ose të hidhen në ndonjë mënyrë tjetër. Për arsye të avancimeve teknologjike, nuk do të kufizohet në të dhënat e përfshira në këtë përkufizim;

1.21. **Plumb** - njësia e municionit për gëzhojë moderne të armës së vogël, e cila paraqet kombinimin e plumbit, ndezësit, mbushësit dhe të gëzhojës në një njësi të vetme;

1.22. **Saçme** – numri i madh të predhave të vogla, qëllimi i të cilave është shkrepja e përnjëhershme me një të shtënë të vetme; armët që mund të mbahen me dorë të prodhuara për këtë lloj të municionit janë kryesisht të njohura si pushkë gjuetie;

1.23. **Plumbi i pushkës ajrore** - predhë josferike e paraparë për qitje nga pushka ajrore;

1.24. **Municioni me nivel të lartë depërtues**- (të cilit zakonisht i referohemi si plumba që depërtojnë në mjetet e blinduara) - çdo plumb të pistoletave dhe pushkëve ose municion të pistoletave dhe pushkëve me predha ose me pjesën qendrore të predhave të prodhuara në tërësi (duke përjashtuar praninë e gjurmëve të substancave të tjera) nga aliazhet e tungstenit, çeliku, hekuri, tunxhi, bronzi, bakër beriliumi ose uraniumi i varfëruar, ose plumba të mbështjellë plotësisht të kalibrit më të madh se 22 mm të dizajnuar ose të destinuar për përdorim në pistoleta ose pushkë, dhe mbështjellësi i të cilave ka peshën më të madhe se 25% të peshës së përgjithshme të predhës, duke përjashtuar ato predha të pistoletave ose pushkëve, bërthama e të cilave përbëhet nga materialet e buta siç janë plumbi ose aliazhet e plumbit, zinku ose aliazhet e zinkut, predhat e thyeshme të dizajnuara kryesisht për qëllime sportive dhe çdo predhë tjetër ose bërthamë e predhës e cila kryesisht është e destinuar për qëllime sportive ose industriale ose të cilat në ndonjë mënyrë tjetër nuk përbëjnë "municion që depërton në mjetet e blinduara" siç përkufizohet ai term me ligj. Ky përkufizim nuk përfshinë predhat e armëve teke;

1.25. **Municion me predhë eksplozive -** municioni i paraparë vetëm për përdorim nga institucionet për zbatim të ligjit, plumbi i të cilit përmban mbushje që eksplodon në momentin e goditjes apo që ka fitil të përcaktuar me kohë ose të vonuar, që do të rezultojë me eksplodimin e municionit në kohën e paracaktuar;

1.26. **Municioni me plumba të ndezshëm** - nënkupton, por nuk kufizohet në municionin e paraparë për përdorim të zbatimit të ligjit, plumbat e të cilit përmbajnë përzierje kimike të ndezshme, dhe mund të përfshijë municion që përmban metal të përzier ekzotermik dhe piroforik në formë të predhës, dhe

është i paraparë për qëllim të hedhjes apo përhapjes së flakës për të nxitur hedhësin e flakës;

1.27. **Municioni gjurmëlënës –** lloji i municionit që lë gjurmë në ajër gjatë trajektores së vet në formë të gjurmës së tymit apo flakës, për të lehtësuar gjetjen e cakut. Në municionin gjurmëlënës përdoren plumbat e posaçëm që janë të modifikuar për të pranuar mbushje të vogël piroteknike në bazën e tyre. Pasi që të ndizet pas shkrepjes, përbërja ndizet me flakë, duke e bërë kështu predhën që të shihet me sy të lirë;

1.28. **Municioni për armët për përdorim të agjentëve kimikë** - municioni që përmban mbushje kimike në plumb, që ndikon në shëndetin e njerëzve apo të shtazëve;

1.29. **Mbajtja e armës së zjarrit**- të gjitha mënyrat e bartjes, përmes të cilave arma e zjarrit është e gatshme për përdorim të menjëhershëm nga poseduesi i saj apo kur poseduesi ka qasje të menjëhershme në armën e zjarrit;

1.30. **Prodhim i armëve të zjarrit dhe municionit** - çdo veprimtari e hulumtimit, studimit, zhvillimit, riprodhimit dhe e montimit të armëve, të pjesëve të armëve dhe të municionit, përveç veprimtarive të zbatuara nga pronari i armës së zjarrit të gjuetisë apo të asaj sportive me qëllim të rimbushjes së municionit të armës për nevoja personale, e cila përdoret si armë e gjuetisë apo sportive;

1.31. **Riparim i armës së zjarrit** - eliminimi i defekteve apo mirëmbajtjen e armës së zjarrit, si dhe zëvendësimin e pjesëve jofunksionale, të vjetruara apo atyre të prishura të armës së zjarrit me pjesë origjinale funksionale sipas nevojës dhe kërkesës;

1.32. **Tregti e armës, municionit dhe të pjesëve të armëve të zjarrit -** furnizimi me armë të zjarrit, me municion dhe me pjesë të armëve të zjarrit dhe të municionit me qëllim të shitjes, ndërmjetësimit, transaksionit dhe të mbajtjes në depo të armëve dhe të municionit. Ndërmjetësimi është veprimtari e entiteteve juridike apo e personave fizik, të cilët veprojnë si agjentë për të tjerët gjatë negocimit apo nënshkrimit të kontratave, blerjes, shitjes apo transferit të armëve të zjarrit, të municionit apo të pjesëve të armëve të zjarrit në kompensim për një pagesë apo formë tjetër të kompensimit;

1.33. **Transport të armëve të zjarrit dhe të municionit -** dërgimi i armëve të zjarrit, pjesëve të armëve të zjarrit dhe të municionit nga furnizuesi te entiteti që i merr ato;

1.34. **Pajisje e policisë** - çdo pajisje e përcaktuar me Ligjin për Policinë;

1.35. **Armë që përdoren gjatë përdorimit të forcës në vazhdimësi nga ana e policisë**, **të cilave iu referohemi si armë jo vdekjeprurëse ose armë nënshtruese** - armët e destinuara që të mos vrasin ose t'u shkaktojnë lëndime të rënda trupore shënjestrës së gjallë;

1.36. **Armë të klasifikuara në kategorinë A1** - armët që mund të përdoren për shpërndarje të turmës përmes një mekanizmi lansues që hedh 37 mm municion me gaz, municion nënshtrues ose municion amortizues. Ky përkufizim në asnjë mënyrë nuk duhet të interpretohet ashtu që armët e kategorisë A1 mund të përdoren për ndonjë qëllim tjetër, përveç atij të përshkruar në këtë ligj;

1.37. **Person përgjegjës** - individi i cili është ligjërisht përgjegjës për aktivitetet e aplikuesit ose poseduesit të licencës;
1.38. **Organi Kompetent** - Ministria e Punëve të Brendshme;
1.39. **Modifikimi i armëve të zjarrit** - ndryshimi i kategorisë fillestare të armëve të zjarrit përmes shtimit të pjesëve shtesë apo pajisjeve;
1.40. **Pastrimi i pjesëve të brendshme -** niveli i parë të riparimit të cilin shfrytëzuesi nuk është në gjendje ta rregullojë ose pastrojë pa një aftësim përkatës dhe pa certifikim si armëtar ose pa veglat e nevojshme të armëtarit.

2. Pajisjet speciale kolektive, të cilat janë subjekt të certifikatës së përdoruesit të fundit, në përputhje me Qëndrimin e Përbashkët për eksportin e armëve gjegjësisht lista ushtarake mund të ketë gjërat vijuese:
2.1. municion dhe pajisje për vendosjen e kapsollës, komponente veçanërisht e projektuar (ML 3);
2.2. pajisjet për kontrollin e zjarrit dhe pajisjet e ndërlidhura për alarmim dhe paralajmërim, pajisjet testuese, balancuese dhe të kundërmasave, siç janë: sistemet për gjuajtje në shenjë, për caktimin e shenjës, për gjetjen e largësisë, për vëzhgim dhe për përcjellje, si dhe pajisjet për zbulim, bashkim të të dhënave, për njohje dhe identifikim dhe pajisjet për integrimin e njësorëve (censorëve) (ML5);
2.3. automjetet tokësore dhe pjesët si në vijim: automjete të blinduara, mbrojtja e blinduar për pjesët kryesore, dritat për terr (ML 6);
2.4. agjentë kimik për kontrollin e turmave (ML 7);
2.5. pajisjet e blinduara apo ato mbrojtëse (ML 13) si në vijim: helmetat, mbrojtëset dhe veshjet trupore anti-plumb;
2.6. simulatorët aftësues për çdo armë të zjarrit (ML 14);
2.7. pajisjet për qartësimin e pamjes (ML 15) si në vijim: incizuesit, kamerat, pajisjet për intensifikimin e pamjes, pajisjet infra të kuqe apo të nxehtësisë për qartësimin e pamjes;
2.8. pajisjet e ndryshme (ML 17), siç janë robotët.

3. Lista e autorizuar për pajisje për qëllime të veçanta është lista e pajisjeve sipas nevojave shtetërore dhe në bazë të kërkesave të institucioneve shtetërore të sigurisë e cila miratohet nga Kryeministri pas konsultimeve me Këshillin e Sigurisë të Kosovës.

Neni 4
Përgjegjësitë

1. Organi Kompetent në përputhje me autorizimet që i janë dhënë, kryen aktivitetet e mbikëqyrjes së prodhimit, riparimit, tregtisë, importit, eksportit, deponimit dhe vënies së shenjave të PQV-së sipas këtij ligji, dhe mban një bazë të integruar të të dhënave për artikujt e importuar dhe eksportuar siç parashihet në këtë ligj.
2. Organi Kompetent mban bazën qendrore të të dhënave, e cila përfshinë të gjitha armët, municionin dhe eksplozivët brenda Republikës së Kosovës. Në këtë bazë të të dhënave ju lejohet qasje disa institucioneve të ndryshme bazuar në nevojat e atyre institucioneve.
3. Institucionet e autorizuara shtetërore të sigurisë caktojnë personin përgjegjës për

bashkëpunim me organin kompetent rreth aktiviteteve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni.

4. Në pajtim me listën e autorizuar shtetërore të pajisjeve të nënshkruar nga Kryeministri, Organi Kompetent është autoriteti qendror për aprovimin e të gjitha transfereve dhe prokurimin e PQV-së, në pajtim me këtë ligj dhe ligjeve të tjera që ndërlidhen me fushën e sigurisë përveç për pajisjet për Forcën e Sigurisë të Kosovës.
5. Të dhënat që rezultojnë nga zbatimi i këtij ligji do të ruhen së paku njëzet (20) vjet.
6. Organi Kompetent do të harton raportin vjetor për eksport të armëve sipas Ligjit për tregtinë e mallrave strategjike

Neni 5
Kategoritë e armëve

1. Kategoritë e mëposhtme të armëve mund të përdoren nga Policia e Kosovës, sipas Ligjit për Armët:
   1.1. Kategoria A1, 37 mm ose platforma të ngjashme të lansimit, të përcaktuara më lartë;
   1.2. Kategoria A2, armë zjarri automatike;
   1.3. Kategoria A6, armët e zjarrit me shurdhues të montuar;
   1.4. Kategoria A7, armë zjarri me tytë të vjaskuar me kalibër mbi 12,7 milimetra;
   1.5. Kategoria A8, armë zjarri e gjatë gjysmë-automatike për dedikim civil që duken si armë zjarri automatike;
   1.6. Kategoria A9, lëndët plasëse dhe pjesët e tyre;
   1.7. Kategoria A10, armë me gaz (agjenteve kimik) dhe municioni i saj;
   1.8. Kategoria A1, pajisja e veçantë për armë zjarri;
   1.9. Kategoria A12, paralizues elektrikë (armë me elektroshok);
   1.10. Kategoria A13, municioni gjurmëlënës;
   1.11. Kategoria A17, armët e zjarrit me tyta poligonale;
   1.12. Kategoria B1, armët e shkurta të zjarrit gjysmë-automatike apo përsëritëse;
   1.13. Kategoria B2, armë zjarri të shkurtra për një qitje, me ndezje qëndrore;
   1.14. Kategoria B3, armë me ndezje anësore të shkurtra për një qitje, me gjatësi të përgjithshme më të vogël se 28 cm;
   1.15. Kategoria B4, armë zjarri të gjata gjysmë-automatike, me arkëz dhe fole për fishekë që së bashku mund të mbajnë më tepër se tre fishekë;
   1.16. Kategoria B5, armë zjarri të gjata gjysmë-automatike, me arkëz dhe fole për fishekë së bashku, që mund të pranojnë deri në tre fishekë dhe mbushësi i të cilave ndërrohet, përkatësisht kjo armë mund të konvertohet, me ndihmën e veglës së rëndomtë, me ç'rast arkëzat e fishekëve mund të pranojnë më tepër se tre fishekë;
   1.17. Kategoria B6, armë zjarri e gjatë gjysmë-automatike ose me përsëritje (repetim), me tytë të pavjaskuar të gjatë deri në 60 cm;
   1.18. Kategori C1, armë zjarri e gjatë me përsëritje (repetim), që nuk është përfshirë në pikën 6 të kategorisë B;
   1.19. Kategoria C2, armë zjarri e gjatë me një gjuajtje me tytë të vjaskuar;

1.20. Kategoria C3, armë zjarri e gjatë gjysmë-automatike, që nuk është përfshirë në pikat 4,5,6,7 të kategorisë B;
1.21. Kategoria C4, armë e shkurtër zjarri me një qitje, me goditje anësore, gjatësia e përgjithshme e së cilës nuk është më e vogël se 28 cm;
1.22. Kategoria C5, armë zjarri me një qitje, e gjatë me tytë të pavjaskuar;
1.23. Kategoria C6, armë për sinjalizim me dritë dhe me zë;
1.24. Kategoria C7, adaptues;
1.25. Kategoria D4, armët e ftohta.

2. Kategoritë e mëposhtme të armëve mund të përdoren nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë:
2.1. Kategoria B1, armët e shkurta të zjarrit gjysmë-automatike apo përsëritëse dhe të kufizuara në pistoleta;
2.2. Kategoria A17, armët e zjarrit me tyta poligonale dhe të kufizuara në pistoleta;

3. Kategoritë e mëposhtme të armëve mund të përdoren nga Shërbimi Korrektues:
3.1. Kategoria B1, armët e shkurta të zjarrit gjysmë-automatike apo përsëritëse dhe të kufizuara në pistoleta;
3.2. Kategoria B6, armë zjarri e gjatë gjysmë-automatike ose me përsëritje (repetim), me tytë të pavjaskuar të gjatë deri në 60 cm;
3.3. Kategoria C1, armë zjarri e gjatë gjysmë-automatike ose me përsëritje (repetim) me tytë të pavjaskuar të gjatë mbi 60 cm në gjatësi;
3.4. Kategoria A1, 37 mm ose platforma të ngjashme të lansimit, të kufizuara sipas përkufizimeve;
3.5. Kategoria A17, armë zjarri me tyta poligonale dhe të kufizuara në pistoleta;
3.6. Kategoria A2, armë zjarri automatike.

4. Kategoritë e mëposhtme të armëve mund të përdoren nga Dogana e Kosovës:
4.1. Kategoria B1, armët e shkurta të zjarrit gjysmë-automatike apo përsëritëse dhe të kufizuara në pistoleta;
4.2. Kategoria A17, armët e zjarrit me tyta poligonale dhe të kufizuara në pistoleta.

5. Kategoritë e mëposhtme të armëve mund të përdoren nga Agjencioni Pyjor i Kosovës:
5.1. Kategoria B6, armët e zjarrit të gjata përsëritëse dhe gjysmë-automatike me tyta të pavjaskuara që nuk janë më të gjata se 60 cm; dhe
5.2. Kategoria C1, armët e zjarrit, të gjata përsëritëse dhe gjysmë automatike me tyta të pavjaskuara që nuk janë më të gjata se 60 cm (pushkët e gjuetisë).

6. Kategoritë e mëposhtme të armëve mund të përdoren nga Inspektorati Policor i Kosovës:
6.1. Kategoria B1, armët e shkurta të zjarrit gjysmë-automatike apo përsëritëse dhe të kufizuara në pistoleta;
6.2. Kategoria A17, armët e zjarrit me tyta poligonale dhe të kufizuara në pistoleta**.**

Neni 6
Municioni

Institucionet shtetërore të sigurisë mund të blejnë municion për armët e cekura në nenin 5 sipas kërkesave të tyre.

Neni 7
Pajisje

1. Institucionet shtetërore të sigurisë mund të propozojnë të blihen pajisje nga lista ushtarake sipas përgjegjësive të tyre dhe Ligjit për tregtinë e mallrave strategjike.
2. Pajisjet e tjera të sigurisë që nuk janë përmendur në listën Ushtarake të BE-së dhe në Ligjin për tregtinë e mallrave strategjike mund të blihen sipas Ligjit për prokurim publik.

KREU II
PRODHIMI DHE RIPARIMI I PQV-së

Neni 8
Prodhimi dhe riparimi - Informacion i përgjithshëm

1. Prodhimi i PQV-së, që përmendet në këtë ligj bazohet në kërkesën e Organit Kompetent dhe institucioneve të autorizuara shtetërore të sigurisë, të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës pas propozimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Ndalohet prodhimi i armatimit dhe pajisjeve që përcaktohen me këtë ligj për nevoja të tregut civil.
3. Institucionet e autorizuara shtetërore të sigurisë caktojnë një person përgjegjës për riparim dhe vlerësim. Personi përgjegjës vlerëson se a mund të bëhet riparimi në punëtoritë riparuese të nivelit të parë ose të dytë, apo për të dërguar ato për riparim tek prodhuesi:
   3.1. Riparim i nivelit të parë do të thotë se riparimi përfundohet ose bëhet nga armëtari i certifikuar në mënyrë të veçantë për llojin e armës që duhet të riparohet. Riparimi i nivelit të parë, nënkupton, por nuk kufizohet në:
      3.1.1. udhëzimin e shfrytëzuesve për përdorimin e duhur dhe të sigurt të armëve të zjarrit;
      3.1.2. inspektimin e plotë të montimit dhe çmontimit për përdorim adekuat;
      3.1.3. përshtatjet e shënjestrës në armët e zjarrit me cakun e fiksuar;
      3.1.4. pastrimin e pjesëve të brendshme;
      3.1.5. riparimet, inspektimet dhe testimet e pistoletave, pushkëve dhe armëve teke, sipas certifikimit përkatës të armëtarit dhe veglave të autorizuara nga departamenti;
      3.1.6. inspektimin dhe testimin e armëve të përdorura nga zyrtarët për gjuajtje, shkrimin dhe mbajtjen e shënimeve për rezultatet e inspektimeve dhe testimeve, siç lejohet nga certifikimi përkatës i armëtarit dhe veglave në dispozicion;

3.2. Niveli i dytë i riparimit nënkupton riparimin e bërë nga armëtari i certifikuar për armën specifike që duhet të riparohet, por që nuk kufizohet vetëm në:
   3.2.1. të gjitha pikat e përshkruara për riparimin e nivelit të parë;
   3.2.2. drejtimin e tytave dhe gjilpërave për qitje;
   3.2.3. riparimin e mekanizmit të këmbëzës;
   3.2.4. riparimin e shulit dhe mekanizmit për montimin e shulit;
   3.2.5. riparimin e shufrës mbajtëse ose sustës(ave) së shufrës mbajtëse;
   3.2.6. riparimin e pranuesit të epërm;
   3.2.7. riparimin e pranuesit të poshtëm;
   3.2.8. riparimin e sistemeve të shënjestrimit të fiksuar dhe jo të fiksuar të armës së zjarrit;
   3.2.9. riparimin e kafazit të karikatorit;
   3.2.10. riparimet e veçanta dhe të specializuara që lejohen sipas certifikimit përkatës të armëtarit dhe veglave në dispozicion, sipas ligjeve, dhe udhëzimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Organit Kompetnet dhe Policisë së Kosovës për specifikimet e armëve; dhe
   3.2.11. inspektimin, testimin dhe modifikimin e nevojshëm të armëve për të siguruar në përputhje me ligjet, rregullat dhe rregulloret e Qeverisë së Kosovës, Organit Kompetent dhe Policisë së Kosovës që kanë të bëjnë me specifikimet e armëve, siç lejohet sipas certifikimit përkatës të armëtarit dhe veglave në dispozicion.

4. Personat përgjegjës të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni lejohen të ushtrojnë përgjegjësitë e lartpërmendura pasi të jenë çertifikuar si armëtarë lidhur me armën/armën e zjarrit përkatëse, sipas këtij ligj dhe Ligjit për Armët dhe për të siguruar përputhje me Qeverinë e Republikës së Kosovës, Organin Kompetent në lidhje me rregullat dhe rregulloret që kanë të bëjnë me specifikimet e armëve.
5. Institucioneve të autorizuara të sigurisë u lejohet t'ia kontraktojnë riparimin ndonjë organi tjetër të jashtëm që paguhet me buxhetin e institucioneve të tyre përkatëse.

Neni 9
Licenca për prodhimin e PQV-së

1. PQV-të mund të prodhohen nga prodhuesit e licencuar me seli biznesi në territorin e Republikës së Kosovës, dhe që posedojnë licencë për prodhim sipas Ligjit për Armë.
2. Aplikuesi për prodhim të PQV-ve parashtron kërkesën për licencë për të prodhuar PQV-të, e cila përmban këto informata:
   2.1. emrin e personit juridik që aplikon dhe emrin e personit përgjegjës;
   2.2. certifikatën e regjistrimit të aplikuesit në regjistrin e bizneseve të Republikës së Kosovës;
   2.3. vërtetimin e gjykatës që verifikon se aplikuesi nuk është nën hetime;
   2.4. vërtetimin e Organit Kompetent se subjekti i aplikuesit përmbush kushtet për deponimin e armëve;
   2.5. licencë për prodhim të armëve dhe municionit sipas Ligjit për Armë;
3. Kërkesa për këtë lloj të licencës shqyrtohet nga komisionet e themeluara sipas Ligjit për Armë;

4. Licencën nga paragrafi 1. i këtij neni e lëshon Organi Kompetent, pas pëlqimit nga Ministria e Forcës së Sigurisë.

Neni 10
Përmbajtja e licencës për prodhim

1. Licenca nga neni 7 i këtij ligji mund të lëshohet për prodhimin e PQV-ve të të gjitha llojeve, ose vetëm për kategori/ lloje të caktuara të PQV-së.
2. Licenca nga paragrafi 1. i këtij neni nuk vlen nëse poseduesi i licencës nuk e ka filluar aktivitetin e tij brenda një viti pas dhënies së licencës.
3. Afati kohor nga paragrafi 2. i këtij neni mund të zgjatet nëse dëshmohet se janë krijuar rrethana të reja të cilat ndikojnë në fillimin e prodhimit të PQV-së**,** por i cili nuk mund të jetë më e gjatë se një (1) vit.

Neni 11
Detyra e poseduesit të licencës

1. Gjatë procesit të prodhimit, PQV-të përdoren vetëm nga personat e punësuar dhe të licencuar.
2. PQV-të nuk duhet të përzihen me pajisjet për tregun civil.
3. PQV-të nuk ekspozohen e as përdoren nga personeli i paautorizuar.
4. Poseduesit e licencës sigurojnë mbrojtje të përhershme fizike dhe teknike të objekteve ku deponohen PQV-të.

Neni 12
Licenca për riparimin e PQV-së

1. PQV-të mund të riparohen nga riparuesit e licencuar me seli biznesi në territorin e Republikës së Kosovës dhe që posedojnë licencë për riparim sipas Ligjit për Armë.
2. Kërkesa për licencë për riparim të PQV-së, përmban këto informata:
   2.1. emrin e personit juridik që aplikon dhe emrin e personit përgjegjës;
   2.2. certifikatën e regjistrimit të aplikuesit në regjistrin e bizneseve të Republikës së Kosovës;
   2.3. vërtetimin e gjykatës që verifikon se aplikuesi nuk është nën hetime;
   2.4. vërtetimin e organit kompetent se subjekti i aplikuesit përmbushë kushtet për deponimin e armëve;
   2.5. licencën për riparim të armëve dhe municionit sipas Ligjit për Armë.
3. Kërkesa për këtë lloj të licencës shqyrtohet nga komisionet sipas Ligjit për Armë.
4. Licencën nga paragrafi 1. i këtij neni e lëshon Organi Kompetent, pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Forcës së Sigurisë.

Neni 13
Përmbajtja e licencës për riparim

1. Licenca nga neni 10 i këtij ligji mund të lëshohet për riparimin e PQV-së, të të gjitha llojeve, ose vetëm për kategori/ lloje të caktuara të PQV-ve.

2. Licenca nga paragrafi 1. i këtij neni nuk vlen nëse poseduesi i licencës nuk e ka filluar aktivitetin e tij brenda një viti pas dhënies së licencës.
3. Afati kohor nga paragrafi 2. i këtij neni mund të zgjatet, nëse dëshmohet se janë krijuar rrethana të reja të cilat ndikojnë në fillimin e riparimit të PQV-ve, por nuk mund të jetë më i gjatë se një (1) vit.

Neni 14
Detyra e poseduesit të licencës për riparim

1. Poseduesi i licencës është i detyruar që gjatë procesit të riparimit, PQV-të përdoren vetëm nga personat e punësuar dhe të autorizuar me licencë.
2. PQV-të nuk përzihen me pajisje për tregun civil.
3. PQV-të nuk ekspozohen e as përdoren nga personeli i paautorizuar.
4. Poseduesit e licencës sigurojnë mbrojtje të përhershme fizike dhe teknike të objekteve ku deponohen PQV-të.
5. Arma nuk largohet nga objektet e poseduesit të licencës derisa ajo është duke u riparuar. Qitja provuese, nëse është e nevojshme, bëhet në lokacionin për të cilin është arritur pajtimi dhe nën mbikëqyrjen e organit kompetent.
6. Poseduesi i licencës nga neni 10 i këtij ligji, përdorë municionin e deponuar nga Organi Kompetent për qitje provuese të armës gjatë riparimit.
7. Gjatë riparimit të armëve llojit PQV nga poseduesi i licencës mbahen këto shënime (por nuk kufizohen në):
   7.1. numrin dhe datën e riparimit;
   7.2. individin të cilit i është kthyer arma PQV;
   7.3. ndonjë ndryshim në shenjat identifikuese ose në numrat serik për shkak të natyrës së riparimit;
   7.4. natyrën e riparimit;
   7.5. tiparet identifikuese të prodhimit të armës së zjarrit;
   7.6. zyrtarin përgjegjës që kërkon riparimin e armës;
   7.7. hollësitë identifikuese të armës së zjarrit;
   7.8. arsyet për refuzimin dhe natyrën e defektit të armës.
8. Personi përgjegjës për riparime informon Organin Kompetent për çdo ndryshim në lidhje me riparimin e armës, brenda dyzetetetë (48) orëve.

Neni 15
Evidencat

Evidencat për objektet dhe kapacitetet prodhuese për PQV-të mbahen nga Organi Kompetent.

Neni 16
Aplikuesit e huaj

1. Aplikuesit e huaj të regjistruar si biznes në territorin e Republikës së Kosovës, mund të licencohen në fushën e prodhimit të PQV-së.
2. Aplikuesit e huaj licencohen sipas procedurave të njëjta me aplikuesit vendor.

KREU III
TREGTIA E PQV-së

Neni 17
Përshkrim i përgjithshëm i tregtisë me PQV

1. Tregtia e PQV-së përfshinë të gjitha aktivitetet tregtare dhe shërbimet e ofruara në lidhje me PQV-të. Aktivitetet e tregtisë janë të kufizuara në prokurimin e PQV-së, aktivitetet e ofrimit të shërbimeve kufizohen në transportimin, deponimin dhe mirëmbajtjen e PQV-së.
2. Organi Kompetent lëshon licencën për tregtinë e armëve, municionit dhe pajisjeve të tjera për qëllime të veçanta me pëlqimin paraprak të Ministrisë së Forcës së Sigurisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Neni 18
Licenca për tregti me PQV

1. Poseduesi i licencës i regjistruar për tregtimin e PQV-së, duhet të shënohet dhe mbahet në listën e kompanive tregtare për PQV-të të licencuara nga Organi Kompetent.
2. Aplikuesit për tregti të PQV-së parashtrojnë kërkesën për licencë tek Organi Kompetent për tregti të PQV-së, e cila përmban të dhënat në vijim:
   2.1. emrin e personit juridik që aplikon dhe personin përgjegjës;
   2.2. vërtetimin e regjistrimit të aplikuesit në regjistrin e bizneseve të Republikës së Kosovës;
   2.3. vërtetimin e gjykatës kompetente që verifikon se aplikuesi nuk është nën hetime;
   2.4. vërtetimin e Organit Kompetent se objektet e aplikuesit i përmbushin kushtet për deponimin e armëve;
   2.5. licencën për tregti të armëve dhe municionit sipas Ligjit për Armë.
3. Kërkesa për këtë lloj të lejes shqyrtohet nga komisionet sipas Ligjit për Armë dhe do të përfshijë verifikimin e së kaluarës financiare dhe ligjore si dhe kontrollin e sigurisë së personit përgjegjës.
4. Poseduesi i licencës informon Organin Kompetent brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga fillimi i tregtisë së PQV-së.
5. Tregtia e eksplozivëve kryhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe ligjeve të tjera në pajtim me normat dhe konventat ndërkombëtare.

Neni 19
Kufizimet në tregtinë me PQV

1. Aktivitetet e importimit të PQV-së për kërkesat e institucioneve të autorizuara shtetërore të sigurisë zhvillohen nga Organi Kompetent në përputhje me Kodin për Dogana dhe Akcizë në Kosovë. Importi sipas këtij ligji bazohet në kërkesën e institucioneve të autorizuara shtetërore të sigurisë.
2. Ndalohet eksportimi i pajisjeve të shënuara si PQV.

3. Si përjashtim PQV-të mund të eksportohen tek prodhuesi për arsye të riparimit ose garancive apo për eksportim të përkohshëm për qëllime operative.
4. Eksportimi i përkohshëm nga paragrafi 3. i këtij neni nënkupton autorizimin nga Organi Kompetent për eksportimin e përkohshëm të PQV-së jashtë Republikës së Kosovës, për përdorim ekskluziv zyrtar të personave të autorizuar.
   4.1. eksportimi i përkohshëm i PQV-së mund të kryhet nga persona të autorizuar për detyra zyrtare jashtë Republikës së Kosovës;
   4.2. eksportimi i përkohshëm lejohet nga Organi Kompetent në bazë të kërkesës paraprake nga personi i agjencioneve të autorizuara dhe ligjeve relevante si dhe akteve nënligjore në fuqi;
   4.3. eksportimi i përkohshëm i PQV-së bëhet vetëm gjatë periudhës së përcaktuar të autorizimit nga Organi Kompetent, dhe kthehet në Republikën e Kosovës pas skadimit të lejes;
   4.4. afati kohor nga nën-paragrafi 4.3 i këtij paragrafit, mund të vazhdohet nëse paraqiten rrethana të reja të cilat ndikojnë në ndryshimin e afatit kohor të lejes për eksportim të përkohshëm. Kjo periudhë shtesë nuk mund të jetë më e gjatë se afati kohor i nevojshëm për arritjen e objektivave zyrtare të autorizuara të personit jashtë vendit;
   4.5. tjetërsimi i PQV-së nuk bëhet gjatë periudhës së eksportimit të përkohshëm;
   4.6. eksportimi i PQV-së sipas lejes për eksportim të përkohshëm nuk mund të shitet apo në mënyrë tjetër t'i bartet personit nga shteti i huaj gjatë qëndrimit jashtë shtetit në bazë të licencës për eksportim të përkohshëm;
   4.7. lejet për eksportim të përkohshëm të PQV-së duhet të mbahen nga organi kompetent në bazën qendrore të të dhënave.
5. Lejet për importimin e PQV-ve, të destinuara për t'u përdorur nga institucionet e autorizuara shtetërore të sigurisë, lëshohen nga Organi Kompetent pas vendimit nga Komisionet e themeluara sipas Ligjit për armë.
6. Leja për importimin e PQV-së duhet të mbahet nga Organi Kompetent në bazën qendrore të të dhënave.

Neni 20
Vënia e shenjave identifikuese të PQV-ve

1. PQV-të importohen vetëm pasi armët, municioni dhe pajisjet tjera të jenë shënuar me shenjat e duhura identifikuese në përputhje me marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare dhe ligjet relevante të Republikës së Kosovës. Përveç kësaj armët do të shënjohen edhe me shenja identifikuese të cilësisë sipas Komisionit të Përhershëm Ndërkombëtar për Testimin e Armëve të Zjarrit (CIP) ose standardeve të Institutit të Prodhuesve të Armëve dhe Municionit Sportiv (SAAMI).
2. PQV-të shënjohen me shenjën e dukshme "PQV" dhe nuk do të jenë të destinuara për tregun civil.

Neni 21
Leja për tregti të PQV-së

1. Zhvillimi i tregtimit së PQV-së nga aplikuesi lejohet nga Organi Kompetent me pëlqimin paraprak të Ministrisë së Forcës së Sigurisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme.

2. Kërkesa për lëshimin e lejes sipas paragrafit 1. të këtij neni përmban:
   2.1. emrin e kompanisë, vendin kryesor të biznesit të kompanisë apo degën e regjistruar të biznesit, emrin personal dhe adresën e dorëzuesit dhe pranuesit;
   2.2. emrin e kompanisë, vendin kryesor të biznesit të kompanisë apo degën e regjistruar të biznesit prodhues të armëve, municionit dhe pajisjeve të tjera;
   2.3. llojin, markën, numrin serik, kalibrin dhe sasinë e armëve, municionit dhe pajisjeve të tjera.
3. Parashtruesi i kërkesës nga paragrafi 1. i këtij neni i bashkëngjet kërkesës edhe këto informata:
   3.1. certifikatën e shfrytëzuesit të fundit, dhe
   3.2. kontratën ose ndonjë dokument tjetër zyrtar në lidhje me sasinë e kontraktuar të armëve, municionit dhe pajisjeve të tjera.
4. Leja lëshohet për një periudhë të vlefshmërisë prej gjashtë (6) muajsh.
5. Leja nga paragrafët e lartpërmendur mund të revokohet nëse gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës për tregti, kanë hyrë në fuqi masa kufizuese nga organizatat ndërkombëtare që e ndalojnë tregtinë.

Neni 22
Transportimi i PQV-së – Përshkrim i përgjithshëm

1. Transportimi i PQV-së nga poseduesit e licencës në territorin e Republikës së Kosovës, mund të bëhet përmes vendkalimeve kufitare shtetërore.
2. Transportimi i PQV-së duhet të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjeve përkatëse.
3. I gjithë transporti i PQV-së i nënshtrohet masave të veçanta të sigurisë dhe shoqërohet me përcjellje të veçantë të policisë.
4. Personi juridik duhet t'i mbulojë shpenzimet e masave të veçanta të sigurisë si dhe të përcjelljes nga policia.

Neni 23
Licenca për transport të PQV-së

1. PQV-ja mund të transportohet nga poseduesit e licencës me seli biznesi apo dege e regjistruar të biznesit në territorin e Republikës së Kosovës, dhe që posedojnë licencë për këto lloje aktivitetesh.
2. Aplikuesi për transport të PQV-së parashtron kërkesën për licencë për transportimin e PQV-së tek Organi Kompetent, e cila duhet të përmbajë:
   2.1. emrin e personit juridik që aplikon dhe emrin e personit përgjegjës;
   2.2. certifikatën e regjistrimit të aplikuesit në regjistrin e bizneseve të Republikës së Kosovës;
   2.3. vërtetimin e gjykatës kompetente që verifikon se aplikuesi nuk është nën hetime;
   2.4. vërtetimin e Organit Kompetent se mjetet transportuese të aplikuesit përmbushin kushtet për transportin e PQV-së.
   2.5. licencën për transport të armëve dhe municionit sipas Ligjit për Armë.
3. Kërkesa për këtë lloj të lejes shqyrtohet nga komisionet sipas Ligjit për Armë duke

përfshirë verifikimin e së kaluarës financiare dhe ligjore të subjektit se biznesit si dhe verifikimin e së kaluarës të personit përgjegjës.

4. Licencën nga paragrafi 1. të këtij neni e lëshon Organi Kompetent, në bashkëpunim me Ministrinë e Forcës së Sigurisë.

Neni 24
Leja për transport të PQV-së

1. Leja nevojitet për çdo transport të PQV-së.
2. Aplikuesi parashtron kërkesë për leje për çdo transport të PQV-së, e cila duhet të përmbajë:
   2.1. emrin e kompanisë, vendin kryesor të biznesit të kompanisë dhe degën e regjistruar të biznesit, emrin personal, adresën e dërguesit, transportuesit dhe pranuesit;
   2.2. emrin e kompanisë, vendin kryesor të biznesit të kompanisë dhe degën e regjistruar të biznesit prodhuese të armëve, municionit dhe pajisjeve të tjera.
   2.3. llojin, markën, numrin serik, kalibrin, kategorinë dhe sasinë e armëve, municionit dhe pajisjeve të tjera;
   2.4. kohën e përafërt, datën, drejtimin e lëvizjes dhe vendin e dorëzimit;
   2.5. llojin e mjetit transportues, numrin e tabelave të regjistrimit, emrin dhe mbiemrin dhe një kopje të dokumentit personal, letërnjoftimit ose pasaportës së vozitësit;
   2.6. masat e veçanta të sigurisë gjatë kohës së transportimit;
   2.7. emrin e pikës së vendkalimit kufitar ku armët, municioni dhe pajisjet të tjera do të transportohen dhe data e arritjes në vendkalimin përkatës kufitar; dhe
   2.8. licencën për transport të PQV-së.
3. Poseduesit e lejes që transportojnë armë, municion dhe pajisje tjera duhet të posedojnë lejen që lejon aktivitetin e transportimit të armëve dhe municionit nga Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit sipas Marrëveshjes Evropiane që ka të bëjë me Rregulloret për Transportin Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme (ADR).
4. Leja mund të lëshohet për afat të vlefshmërisë deri në tre (3) muaj.
5. Të njëjtat kushte aplikohen për PQV gjatë tranzitit.

KREU IV
SIGURIA E PQV-së

Neni 25
Siguria e përgjithshme e PQV-së

1. Siguria dhe ruajtja e PQV-së bëhet në përputhje me këtë ligj, me Ligjin për Transportin e Mallrave të Rrezikshme, Ligjin për Klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë me dispozitat e tjera ligjore që rregullojnë sigurinë, mbrojtjen mjedisore dhe mbrojtjen gjatë përdorimit të materialeve të rrezikshme.
2. Masat e sigurisë përfshijnë: sigurinë gjatë transportit, sigurinë e rezervave, masat pas humbjes ose vjedhjes, përdorimin e sigurt të armëve të zjarrit, kriteret për

përdorimin e forcës, të dhënat për PQV-të, lëshimin e kartelave të autorizimit dhe lokacionet e aftësimit dhe të qitjes.

Neni 26
Menaxhimi dhe deponimi i PQV-së

Organet shtetërore që lejohen me ligj që të posedojnë dhe mbajnë armë, municion dhe pajisje të tjera caktojnë një person përgjegjës për deponimin dhe menaxhimin e PQV-së.

Neni 27
Vendet për deponim

1. Institucionet shtetërore të autorizuara të sigurisë deponojnë armë të ndara nga municioni në objektet të siguruara teknikisht ose në ndonjë kasafortë.
2. Institucionet shtetërore të autorizuara të sigurisë mbajnë evidencë për armët dhe municionin dhe emërojnë një person përgjegjës për mbikëqyrjen e armëve dhe municionit. Institucionet shtetërore të autorizuara të sigurisë e informojnë Organin Kompetent për identitetin e personit përgjegjës. Nëse personi përgjegjës ndërrohet, institucionet shtetërore të autorizuara të sigurisë e informojnë Organin Kompetent brenda tri (3) ditësh nga dita e ndërrimit të personit.
3. Personi përgjegjës duhet të inspektojë mënyrën në të cilën ruhen armët dhe municioni, dhe në të cilën mbahen shënimet, eksplozivët ruhen sipas klasifikimit të rrezikshmërisë të Kombeve të Bashkuara dhe Ligjit për Transportin e Mallrave të Rrezikshme.

Neni 28
Zhdukja, Humbja ose vjedhja e PQV

Në rast të zhdukjes, humbjes ose vjedhjes së PQV-së, pronari, shfrytëzuesi ose personi juridik informon Organin Kompetent dhe Policinë e Kosovës menjëherë por jo më vonë se njëzetekatër (24) orë nga momenti kur ai/ajo e ka vërejtur këtë gjë.

KREU V
KONTROLLI I CILËSISË SË PQV-së

Neni 29
Kontrolli i cilësisë – Informacione të përgjithshme

1. Konfirmimi i respektimit të kushteve të përcaktuara për PQV, gjatë procesit të prodhimit dhe riparimit dhe para se të vihen PQV-të në qarkullim, bëhet nga Komisioni për Kontrollin e Cilësisë që përbëhet nga përfaqësuesit e Organit Kompetent, Ministrisë së Drejtësisë, Doganave dhe institucioneve të akredituara që janë të autorizuar nga Organi Kompetent.
2. Gjatë procesit të prodhimit dhe riparimit, për qëllim të konfirmimit të përputhjes me kushtet e përcaktuara për PQV-të, Organi Kompetent ka autoritet që t'ua

caktojë prodhuesve edhe një person tjetër përveç atyre të punësuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë dhe Dogana e Kosovës pas rekomandimit me shkrim të Komisionit për Kontrollin e Cilësisë.

3. Prodhuesit e PQV-së janë të obliguar që t'i sigurojnë personit të cekur në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni kushtet e punës që kërkohen për vlerësimin e respektimit të kushteve të përcaktuara për PQV.

Neni 30
Dokumentacioni i Standardizuar për Kontrollin e Kualitetit

1. Vlerësimi i respektimit të kushteve të përcaktuara për PQV, bëhet në bazë të dispozitave ligjore që rregullojnë cilësinë e produkteve, që përfshijnë si më poshtë:
   1.1. të dhënat teknike për mjetet dhe sistemet e PQV-së;
   1.2. përmbajtja e mjeteve dhe sistemeve të PQV-së;
   1.3. dokumentacioni teknik përcjellës;
   1.4. kushtet teknike dhe standardet për mjetet dhe sistemet e PQV-së;
   1.5. metodat për testimin dhe konfirmimin e karakteristikave të përcaktuara të cilësisë;
   1.6. kriteret për llogaritjen dhe vlerësimin e cilësisë së mjeteve dhe sistemeve të PQV-së.

KREU VI
MBIKËQYRJA

Neni 31

1. Organi kompetent, në pajtueshmëri me këtë ligj dhe ligjet përkatëse që rregullojnë këtë fushë, mbikëqyrë:
   1.1. zhvillimin e procedurave standarde të veprimit që kanë të bëjnë me aftësimin nga të gjitha subjektet që posedojnë PQV.
   1.2. zhvillimin e procedurave standarde të veprimit që kanë të bëjnë me përdorimin e sigurtë të PQV-së nga të gjitha subjektet që janë në posedim të PQV-së.
   1.3. zhvillimin e procedurave standarde të veprimit që kanë të bëjnë me evidentimin dhe lëshimin e kartelave të autorizimit nga të gjitha subjektet që posedojnë PQV.
   1.4. zhvillimin e procedurave standarde të veprimit që kanë të bëjnë me poligonet e qitjes që do përdoren nga të gjitha subjektet që posedojnë PQV.
   1.5. zhvillimin e procedurave standarde të veprimit që kanë të bëjnë me përdorimin e forcës nga të gjitha subjektet që posedojnë PQV.
   1.6. zhvillimin e procedurave standarde të veprimit që kanë të bëjnë me deponimin dhe menaxhimin e armëve të zjarrit nga të gjitha subjektet që posedojnë PQV.

KREU VII
DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 32

1. Personat juridik dhe personat përgjegjës qe veprojnë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji do të ndëshkohen.
2. Lidhur me përgjegjësinë penale vlejnë dispozitat e Kodit Penal të Kosovës.

Neni 33

1. Personi juridik dënohet për kundërvajtje me gjobë prej njëmijë (1.000) deri ne dhjetëmijë (10.000) Euro nëse:
   1.1. vepron në kundërshtim me nenin 9. të këtij ligji;
   1.2. vepron në kundërshtim me nenin 11 paragrafi 1. të këtij ligji;
   1.3. vepron në kundërshtim me nenin 12 të këtij ligji;
   1.4. vepron në kundërshtim me nenin 16 paragrafi 4. të këtij ligji;
   1.5. vepron në kundërshtim me nenin 20 paragrafët 2. dhe 3. të këtij ligji;
   1.6. vepron në kundërshtim me nenin 26 paragrafi 1. të këtij ligji;
   1.7. vepron në kundërshtim me nenin 27 paragrafi 3. të këtij ligji;

Neni 34

1. Personi Juridik dënohet për kundërvajtje me gjobë prej pesëmijë (5.000) deri në pesëdhjetëmijë (50.000) Euro, ndërsa personi përgjegjës prej dyqind (200) deri njëmijë (1.000) Euro nëse:
   1.1. vepron në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 2. të këtij ligji;
   1.2. vepron në kundërshtim me nenin 8 paragrafi 1. të këtij ligji;
   1.3. vepron në kundërshtim me nenin 10 paragrafi 1. të këtij ligji;
   1.4. vepron në kundërshtim me nenin 18 paragrafi 1. të këtij ligji.

Neni 35

1. Personi Juridik dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dhjetëmijë (10.000) deri në pesëdhjetëmijë (50.000) Euro, ndërsa personi përgjegjës prej njëmijë (1.000) deri dhjetëmijë (10.000) Euro nëse:
   1.1. vepron në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 1. të këtij ligji;
   1.2. vepron në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1. të këtij ligji;
   1.3. vepron në kundërshtim me nenin 15 paragrafi 2. të këtij ligji;
   1.4. vepron në kundërshtim me nenin 20 paragrafi 1. të këtij ligji;
   1.5. vepron në kundërshtim me nenin 21 paragrafi 1. të këtij ligji;
   1.6. vepron në kundërshtim me nenin 22 paragrafi 1. të këtij ligji.

KREU VIII
DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 36
Aktet nënligjore të Organit Kompetent

1. Organi Kompetent brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji nxjerrë aktet nënligjore për:
   1.1. listën e autorizuar të pajisjeve të institucioneve shtetërore të sigurisë në bazë të kërkesave nga agjencionet ekzekutive e cila më tutje trajtohet si informacion i klasifikuar;
   1.2. kushtet minimale për aftësim, të cilat zbatohen nga të gjitha subjektet që posedojnë PQV;
   1.3. përcaktimin e standardeve minimale teknike dhe të sigurisë për objektet;
   1.4. procedurat për lëshimin e lejes për eksportim të përkohshëm të PQV-së;
   1.5. kushtet minimale për deponimin dhe menaxhimin e PQV, që zbatohen nga të gjitha subjektet që posedojnë PQV;
   1.6. procedurat për trajtimin e armëve, municionit dhe pajisjeve të tjera të humbura ose vjedhura;
   1.7. kushtet minimale për përdorimin e forcës së PQV-së, të cilat duhet të zbatohen nga të gjitha subjektet që posedojnë PQV;
   1.8. kushtet minimale për evidentimin e PQV-së dhe lëshimin e kartelave të autorizimit të cilat duhet të zbatohen nga të gjitha subjektet që posedojnë PQV;
   1.9. poligonet e qitjes të aprovuara të cilat përdoren nga të gjitha subjektet që posedojnë PQV;
   1.10. nivelin e dytë për riparim të organizuar në mënyrë të centralizuar;
   1.11. qasjen në bazën e të dhënave dhe strukturën e kësaj baze të të dhënave;
   1.12. kriteret për përcjellje, përjashtimisht kur transportimi i PQV-së bëhet nga organet e autorizuara shtetërore për qëllime operacionale;
   1.13. procedurat për verifikimin e importit nga përdoruesi i fundit;
   1.14. procedurat e kontrollit të cilësisë dhe akreditimin e personave juridik;
   1.15. rregullat për vlerësimin e respektimit dhe cilësisë së produktit për PQV;
   1.16. masat e përgjithshme dhe të veçanta që përbëjnë sistemin e përgjithshëm të sigurisë të cekura në nenin 20 të këtij ligji;
   1.17. masat e sigurisë të institucioneve të autorizuara shtetërore për siguri, që do të jenë përgjegjëse për caktimin e një personi përgjegjës.

Neni 37
Aktet nënligjore të Qeverisë

Qeveria brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të nxjerrë aktet nënligjore për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë të cilat duhet të plotësojnë objektet ku zhvillohet prodhimi, riparimi ose tregtia dhe ku deponohen armët, municioni dhe pajisjet tjera.

KREU IX
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 38
Të hyrat nga ligji

Mjetet e grumbulluara në bazë të këtij ligji derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Neni 39
Shfuqizimi

Me hyrjen ne fuqi të këtij ligji shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore që nuk janë në përputhje me këtë ligj.

Neni 40
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-246
28 tetor 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-073-2010, datë 09.11.2010 nga u.d. Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 91 / 10 DHJETOR 2010

LIGJI Nr. 04/L-022
PËR PËRDORIM CIVIL TË EKSPLOZIVËVE

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 676
Kreu II: Autoritetet 680
Kreu III: Personat e autorizuar 683
Kreu IV: Artikujt e lejuar dhe të ndaluar 684
Kreu V: Plasimi ne tregun e Kosovës 686
Kreu VI: Shitja e eksplozivëve 687
Kreu VII: Masat e sigurisë 689
Kreu VIII: Licencat dhe lejet 695
Kreu IX: Ndryshimi dhe revokimi i licencës dhe lejes 701
Kreu X: Evidenca dhe mbajtja e të dhënave 702
Kreu XI: Incidente dhe aksidente 704
Kreu XII: Procedurat e veçanta 704
Kreu XIII: Dispozitat ndëshkuese 705
Kreu XIV: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 707

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR PËRDORIM CIVIL TË EKSPLOZIVËVE

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Me këtë ligj përcaktohen kushtet dhe kriteret e prodhimit, tregtimit, importit, eksportit, transitit, transferimit, deponimit, përdorimit dhe asgjësimit të eksplozivëve apo fishekzjarrëve si dhe kriteret për mbikëqyrjen dhe aplikimin e këtij ligji me qëllim të mbrojtjes së njerëzve, pasurisë dhe mjedisit.
2. Ky ligj zbatohet për të gjithë eksplozivët për përdorim civil dhe fishekzjarrët brenda Republikës së Kosovës dhe çfarëdo aktiviteti ku aplikohet Marrëveshja Evropiane, për bartjen ndërkombëtare të mallrave të rrezikshme përmes rrugës (ADR), dhe marrëveshjeve tjera ndërkombëtare për bartje siç janë:
   2.1. Marrëveshja Ndërkombëtare për bartjen e mallrave të rrezikshme në hekurudhë (RID);

2.2. Organizata Ndërkombëtare për Aviacion Civil (ICAO);
2.3. Kodi Ndërkombëtar për bartjen e mallrave të rrezikshme përmes detit (IMDG).

3. Ky ligj përfshinë eksplozivët e lejuar, nitratin e amoniumit dhe lëndë tjera, të cilat vetvetiu nuk janë eksplozivë, siç janë agjentët oksidues dhe lëndët djegëse. Por ky ligj nuk përfshinë lëndët eksplozive të prodhuara si pjesë e procesit të përpunimit, i cili pastaj i ripërpunon ato për të prodhuar ndonjë lëndë apo përgatitje e cila nuk është lëndë eksplozive.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
1.1. **Përdorimi civil i eksplozivëve** - përdorimi i eksplozivëve nga personat juridik të autorizuar nga organi kompetent të cilët posedojnë leje për shpërthim dhe leje të lëshuara nga KPMM apo Ministria;
1.2. **Eksplozivët që përdoren për qëllime komerciale** - çdo eksploziv, detonator apo mjet tjeter kimik apo teknik, të cilët përdoren apo kanë qëllim që të përdoren për aktivitete minimi në lidhje me çdo kërkim, minierë apo gurore sipas Ligjit për Miniera dhe Minerale;
1.3. **Iniciuesit e eksplozivëve** - të gjitha llojet e kapsollave, ndezësve dhe shkopinjve, fitilat si dhe mjetet piroteknike të cilat shfrytëzohen gjatë inicimit të eksplozivëve pa marrë parasysh mënyrën e aktivizimit para minimeve;
1.4. **Baruti** - eksplozivi i cili digjet me mjetet përçuese termale.
1.5. **Produktet e mbushura me eksplozivë** - produktet të cilat përmbajnë ose janë të mbushura me eksplozivë, në të cilat bazohet efikasiteti i tyre;
1.6. **Produktet Piroteknike -** çdo produkt që përmban substancë apo përzierje të substancave të dizajnuara që lirojnë nxehtësi,dritë, zhurmë, gaz, tym apo kombinimi i tyre sjellë efekte përmes reaksioneve kimike, ekzotermike të vetë qëndrueshme për zbavitje dhe qëllime të tjera të cilat emërtohen si fishekzjarrë.
1.7. **Substancat eksplozive -** substanca të ngurta ose të lëngëta apo përzierjet e tyre të gatshme që mund të përdoren për reaksion kimik që lirojnë gazra, temperaturë dhe shtypje shpejtësia e të cilave mund të shkatërrojë ambientin;
1.8. **ADR** - Marrëveshja Evropiane për bartjen ndërkombëtare të mallrave të rrezikshme përmes rrugës;
1.9. **RID** - Marrëveshja Ndërkombëtare për bartjen e mallrave të rrezikshme në hekurudhë;
1.10. **ICAO** - Organizata Ndërkombëtare për Aviacion Civil;
1.11. **IMDG** - Kodi Ndërkombëtar për bartjen e mallrave të rrezikshme përmes detit;
1.12. **PUN** - Prezenca Ushtarake Ndërkombëtare;
1.13. **Shitja** - shitja e eksplozivëve dhe fishekzjarrëve nga personi juridik të licencuar për tregti, dhe personit juridik apo personit fizik i pajisur me leje për shitjen e fishekzjarrëve të, kategorisë 2 dhe 3;

1.14. **Tregtim -** qarkullimi i eksplozivëve në treg nga personat e autorizuar;
1.15. **Prodhim -** prodhimi, përpunimi ose modifikimi i eksplozivëve;
1.16. **Furnizues –** personi i autorizuar i cili nxjerr eksplozivët në treg;
1.17. **Përdorim i eksplozivëve –** trajtimi i drejtpërdrejt ose aktivizimi i eksplozivëve;
1.18. **Përdorim i fishekzjarrëve** - veprimi me fishekzjarrë;
1.19. **Trajtim -** paketimi, ngarkimi, shkarkimi, transferimi dhe asgjësimi i eksplozivëve;
1.20. **Deponim -** vendosja e eksplozivëve apo fishekzjarrëve në objekte të destinuara për deponim të eksplozivëve, ku duhet të ofrohen kushtet adekuate të sigurisë;
1.21. **Import -** transportimi dhe lëvizja e eksplozivëve apo fishekzjarrëve në territorin e Kosovës;
1.22. **Eksport -** transportimi i eksplozivëve apo fishekzjarrëve nga territori i Kosovës;
1.23. **Transit -** transportimi i eksplozivëve apo fishekzjarrëve përmes territorit të Kosovës;
1.24. **Transferim -** lëvizja fizike e eksplozivëve apo fishekzjarrëve brenda territorit të Kosovës;
1.25. **Numri i KB-së -** numri identifikues dhe shkallën e rrezikshmërisë së materieve të rrezikshme, lehtë ndezëse dhe shpërthyese, të renditura në tabelën e Marrëveshjes Evropiane për Transportimin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme;
1.26. **Përpunimi i eksplozivit apo fishekzjarrëve** - procesi i prodhimit të eksplozivit apo fishekzjarrëve, ribërja, përpunimi i eksplozivit, natyra fizike apo kimike e eksplozivit, dhe çmontimi apo montimi i eksplozivit;
1.27. **Klasifikimi i rrezikshmërisë i KB**-së - substancat dhe materiet që paraqesin:
    1.27.1. rrezikshmëri nga eksplodimit masiv, (ndarja 1.1);
    1.27.2. rrezikshmëri nga shpërthimi, por nuk paraqet rrezikshmëri të eksplodimit masiv, (ndarja 1.2);
    1.27.3. rrezikshmëri për shkaktimin e zjarrit apo një shpërthimi të vogël paraqet rrezikshmëri të vogël të rrezikut apo të dyja, por nuk paraqet rrezikshmëri të eksplodimit masiv, (ndarja 1.3);
    1.27.4. rrezikshmëri jo të rëndësishme, (ndarja 1.4);
    1.27.5. substanca të ndjeshme që paraqesin rrezikshmëri të eksplodimit masiv, (ndarja 1.5);
    1.27.6. produkte të ndjeshme që nuk paraqesin rrezikshmëri të eksplodimit masiv, (ndarja 1.6).
1.28. **Paketim** - çdo mbyllje apo fiksim dhe mbështjellës që ka për qëllim të mundësojë manipulimin, sigurinë dhe transportin e tij por që nuk përfshinë:
    1.28.1. çdo zarf, kuti apo pajisje që formojnë pjesë të një artikulli;
    1.28.2. çdo lloj djepi, kuti, enë e mallrave, enë aeroplani, enë me paletë integrale, paletë e aeroplanit apo automjet.
1.29. **Paketim i brendshëm dhe paketim i jashtëm –** paketimi i brendshëm do të thotë paketimi që në mënyrë direkte rrethon eksplozivin përveç kur

paketimi është pjesë përbërëse e materialit eksploziv, dhe paketimi i jashtëm i cili në mënyrë direkte rrethon ndonjë material të eksplozivit dhe i cili është i vetmi paketim.

1.30. **Municion** - pajisja komplete, predha, gëzhoja, mina, pajisjen për demolim të mbushur me eksploziv, shtytës, mjete piroteknike, përzierje iniciuese apo material nuklear, biologjik ose kimik për përdorim, në lidhje me sulmin, mbrojtjen, ose trajnimin apo qëllime të cilat nuk janë operative, përfshirë edhe pjesët e sistemeve të armës të cilat përmbajnë eksploziv;

1.31. **Detonim** - reagimi i cili lëviz nëpër materialin e eksplozivit me shpejtësinë tejzanore. Në materialin e reaguar, ndryshimi i shpejtë i eksplozivëve në produkte gazi me anë të një valë shoku që kalon përmes eksplozivit, një valë ekzotermike që vijon dhe mban një shok tejzanor para një eksplozivi, reaksioni i zbërthimit në të cilën zona e reaksionit kimik përhapet nëpërmjet mesit fillestar në shpejtësi tejzanore prapa shokut frontal;

1.32. **Eksplozivë** - eksplozivët për përdorim civil, mjetet për inicim të eksplozivëve, ashkël, produkt i mbushur me eksploziv, substancat piroteknike dhe materialet e papërpunuara me karakter eksploziv;

1.33. **ANFO** – lloji i eksplozivit që fitohet me përzierjen e ammonium nitratit dhe naftës;

1.34. **Nitrometani** - karburanti më efikas që përdoret në këtë lloj eksplozivi ANFO. Ky lloj eksplozivi është eksplozivi që është përdorur në miniera qymyri, gurore, miniera metali, dhe ndërtime civile. Ky karburant, shërben për mjete shpërthyese të improvizuara, ku është e njohur si bombë e plehrave;

1.35. **Nitrat Ammonium** - materia kimike e cila ka pikën e shkrirjes 170 gradë celsius dhe zbërthehet mbi 210 gradë celsius dhe me këtë ligj është kategorizuar në nivelin 1 të kategorizimit të klasifikimit të rrezikshmërisë së KB-së;

1.36. **Inert** - një municion që nuk përmban eksploziv, piroteknikë, lotsjellës apo substanca tjera radioaktive, kimike, biologjike ose toksike;

1.37. **SNSH** - sasia neto shpërthyese të njohur edhe si përmbajtje neto shpërthyese ose peshë neto shpërthyese, e dërgesës së municioneve të veçanta;

1.38. **PSO -** Procedurat Standarde të Operimit;

1.39. **Shënjimi CE -** shënjimin e njohur e cila është shenjë e detyrueshme e përputhshmërisë në shumë produkte në tregun e vetëm në Zonën Ekonomike Evropiane - ZEE;

1.40. **Ministria** - Ministrinë e Punëve të Brendshme;

1.41. **KPMM** – Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale të Kosovës;

1.42. **Licencë** – autorizimi i lëshuar nga organi Kompetent personit juridik me të cilën mbajtësi i saj autorizohet që të angazhohet në një lloj të veçantë biznesi apo aktiviteti tjetër në pajtim me kushtet e përcaktuara në licencë sipas këtij ligji;

1.43. **Leja** - autorizimi i lëshuar nga organi kompetent personit juridik për të ushtruar një aktivitet specifik operacional sipas këtij ligji.

KREU II
AUTORITETET

Neni 3
Kompetencat dhe përgjegjësitë

1. Ministria lëshon licencat për: prodhim, import, eksport, transit, tregtim, përdorim, deponim, asgjësim, shitje dhe transferim, dhe udhëheq procedurat për përcaktimin e lokacioneve të ngarkimit, shkarkimit dhe asgjësimit të eksplozivëve dhe fishekzjarrëve jashtë objekteve të personit juridik.
2. Ministria lëshon lejet për import, eksport, transit, transferim, përdorim dhe asgjësim të eksplozivëve dhe fishekzjarrëve.
3. Ministria lëshon lejet për dyqanet e shitjes me pakicë për shitjen e fishekzjarrëve.
4. Ministria është përgjegjëse për:
   4.1. dhënien e udhëzimeve dhe pëlqimin për përdorimin e eksplozivëve dhe fishekzjarrëve;
   4.2. mbajtjen e listës së përditësuar të eksplozivëve dhe fishekzjarrëve;
   4.3. udhëheqjen e procedurave për lëshimin e licencave për prodhimin e eksplozivëve dhe fishekzjarrëve, importin, eksportin, transitin, tregtimin, deponimin asgjësimin dhe përdorimin e tyre;
   4.4. bashkëpunimin për përgatitjen e njohurive profesionale dhe aftësive standarde të personelit, i cili sipas këtij ligji duhet të jetë profesionalisht i kualifikuar;
   4.5. mbajtjen e evidencave për eksplozivët dhe fishekzjarrët dhe ofrimin e tyre organeve kompetente;
   4.6. mbledhjen, elaborimin, ruajtjen, ofrimin dhe përdorimin e të dhënave në pajtim me këtë ligj;
   4.7. bashkëpunimin me organet dhe organizatat ndërkombëtare në aktivitetet e ndërlidhura me eksplozivë;
   4.8. kërkimin e informatave në lidhje me shkeljen e këtij ligji nga ana e organeve mbikëqyrëse;
   4.9. ndalimin e prodhimit, importit, eksportit, transitit, tregtimit, deponimit asgjësimit dhe përdorimit të eksplozivëve apo fishekzjarrëve në kundërshtim me këtë ligj.
5. Ministria cakton listën shtetërore, me eksplozivet dhe fishekzjarrët e lejuar dhe të ndaluar me akt nënligjor.
6. Ministria është përgjegjëse dhe sigurohet që përdoruesi i fundit posedon certifikatë.
7. Ministria do të bashkëpunojë me KPMM-në për lejet e minimit.
8. Ministria do të formojë një ekip të përbashkët inspektimi në rast hetimi të incidentit me një inspektor miniere të KPMM-së dhe Policisë së Kosovës.
9. Ministria është përgjegjëse për verifikimin e shënjimit CE të produkteve gjatë kohës së importit.
10. Ministria do të përcaktojë me akt nënligjor përjashtimet në listën shtetërore të eksplozivëve për qëllim të analizave laboratorike, testimin, demonstrimet, eksperimentet, shfaqjet teatrale, produktet farmaceutike dhe rimbushjen e municioneve të armëve të vogla, siç është përcaktuar në Ligjin për Armë.

Neni 4
Autoriteti i përgjithshëm i inspektimit

1. Inspektimi për zbatimin e këtij ligji bëhet nga inspektorët e departamentit përgjegjës në ministri.
2. Inspektori nga paragrafi 1. i këtij neni ka të drejtë të:
   2.1. kërkoj dokumentet;
   2.2. të hyjë dhe kontrolloj hapësirat;
   2.3. lëshoj njoftime për përmirësim;
   2.4. paralajmëroj;
   2.5. informoj policinë;
   2.6. caktoj afatin kohor për eliminimin e parregullsive dhe të ndaloj përkohësisht prodhimin, qarkullimin, ngarkimin, shkarkimin dhe përdorimin e eksplozivëve apo fishekzjarrëve;
3. propozoj organeve kompetente revokimin e licencave të prodhimit dhe tregtisë;
4. kërkoj shpjegime me shkrim në lidhje me subjektin e inspektimit nga personat përgjegjës apo personat tjerë;
5. propozoj ndjekjen penale dhe kundërvajtëse tek autoritetet kompetente;
6. marrë pjesë në hetime lidhur me incidentet.
7. Përmbajtja dhe mënyra e provimit për certifikimin e inspektorit përcaktohet nga ministria me akt nënligjor.

Neni 5
Autorizimet e inspektorëve

1. Autorizimet e inspektorit janë si në vijim të:
   1.1. hyjë dhe të kontrolloj hapësirat;
   1.2. hyjë edhe pa pëlqim të shfrytëzuesit;
   1.3. aplikoj për urdhër dhe të lëshoj urdhra;
   1.4. ketë qasje në sendet e konfiskuara;
   1.5. kërkoj emrin dhe adresën;
   1.6. kërkoj shoqërimin e personave para inspektorit për t'iu përgjigjur pyetjeve;
   1.7. kërkoj ofrimin e fakteve;
   1.8. japë udhëzime për kundërvënie;
   1.9. japë udhëzime në situata të rrezikut;
   1.10. të parandaloj lëndimet dhe dëmtimet duke ndërmarrë veprime direkte;
   1.11. ekzaminoj dokumentacionin në lidhje me eksplozivët apo fishekzjarrët, të hyjë, kontrolloj dhe ekzaminoj objektet, vend-punishtet në të cilat eksplozivët apo fishekzjarrët prodhohen, deponohen, tregtohen, barten, përdoren dhe asgjësohen;
   1.12. urdhëroj eliminimin e parregullsive;
   1.13. ekzaminoj dokumentet që vërtetojnë kualifikimin profesional të personelit;
   1.14. ndaloj përkohësisht aktivitetet në lidhje me prodhimin, tregtimin, deponimin dhe përdorimin e eksplozivëve apo fishekzjarrëve, nëse kriteret e përcaktuara me ligj nuk plotësohen;
   1.15. ndaloj prodhimin, tregtimin, deponimin dhe përdorimin e eksplozivëve apo fishekzjarrëve, nëse zbulohen parregullsi të masave të sigurisë;

1.16. ndaloj përdorimin e eksplozivëve apo fishekzjarrëve, nëse kriteret e përcaktuara në këtë ligj nuk janë të përmbushura;
1.17. ndaloj përdorimin e objekteve të deponimit të cilat nuk i plotësojnë kushtet për deponimin e eksplozivëve apo fishekzjarrëve;
1.18. ndaloj prodhimin dhe tregtimin e eksplozivëve apo fishekzjarrëve, kur përdoret paketimi i papërshtatshëm;
1.19. ndaloj përdorimin e objekteve për deponim dhe objektet për ngarkim dhe shkarkim, kur kriteret e përcaktuara me këtë ligj nuk përmbushen;
1.20. urdhëroj masa të tjera të domosdoshme për mbrojtjen e njerëzve, e pasurisë dhe mjedisit.

2. Përveç paragrafit 1. të këtij neni, inspektori ka autorizimet si në vijim të:
2.1. ekzaminoj, testoj, matë, fotografoj apo filmoj çdo gjë në lokacion që ka ta bëjë me eksplozivë apo fishekzjarr;
2.2. marr mostrat në lokacion;
2.3. heq eksplozivin apo përbërësin e eksploziveve apo të fishekzjarrëve për ekzaminim apo testim;
2.4. kopjoj dokumentin;
2.5. marr afër apo brenda lokacionit ndonjë person, pajisje dhe material që në masë të arsyeshme i nevojiten inspektorit për ushtrimin e detyrës së tij.

3. Autorizimet e inspektorit mund të kufizohen:
3.1. sipas kushteve të emërimit të veçantë;
3.2. me njoftim me shkrim të dhënë nga ministria për inspektorin;
3.3. me njoftim me shkrim të dhënë nga kryeinspektori për inspektorin.

4. Ankesa kundër çdo mase të përcaktuar në këtë nen nuk e ndalon ekzekutimin e saj.

5. Për përdorim, asgjësim dhe deponimin e eksplozivëve për nevojat e minierave nëntokësore, inspektimin e bën inspektori i minierave dhe mineraleve në bazë të autorizimeve që ka, sipas Ligjit për Miniera dhe Minerale.

Neni 6
Emërimi i inspektorëve

1. Ministria emëron për inspektor personat që kanë kualifikim përkatës për të vënë në fuqi dispozitat përkatëse brenda fushës së përgjegjësive të tyre, të cilët e kanë të dhënë provimin për inspektor.

2. Emërimi i inspektorëve sipas paragrafit 1. të këtij neni, bëhet me vendim i cili përcakton autorizimet e bartura tek inspektorët sipas dispozitave përkatëse që do të ushtrohen nga personi i emëruar.

3. Inspektorët e emëruar, do të pajisen me kartelat zyrtare të identifikimit.

4. Procedura e emërimit të inspektorëve dhe detajet tjera, përcaktohen me akt nënligjor të lëshuar nga ministria.

Neni 7
Mbikëqyrja nga Policia e Kosovës

1. Policia e Kosovës bën mbikëqyrjen e vlefshmërisë së dokumenteve që i përkasin tregtisë, importimit, eksportimit, transitit, bartjes, deponimit dhe përdorimit të eksplozivëve apo fishekzjarrëve, gjatë transportit dhe gjatë kalimit kufitar.

2. Policia e Kosovës bën përcjelljen për çdo import, eksport, transit, dhe transfer të eksplozivëve apo fishekzjarrëve, nga pika e nisjes deri në destinacionin e fundit në bashkëpunim të ngushtë me departamentin përgjegjës të ministrisë.
3. Procedurat e kërkesave dhe përcjelljes së eksplozivëve apo fishekzjarrëve, si dhe ekzekutimi i tyre së bashku me shpenzimet e përcjelljes, do të rregullohen me akt nënligjor nga ministria.

KREU III
PERSONAT E AUTORIZUAR

Neni 8
Kriteret e përgjithshme

1. Vetëm personat e autorizuar dhe kualifikuar mund të përdorin dhe deponojnë eksplozivë apo fishekzjarrë për personat juridik të licencuar.
2. Personi i autorizuar nga paragrafi 1. i këtij neni, duhet të përmbushë kriteret si në vijim:
   2.1. të ketë së paku njëzetenjë (21) vjet;
   2.2. të posedoj aftësi psiko-fizike;
   2.3. të ketë përvojë dhe ekspertizë përkatëse;
   2.4. të mos jetë i ndjekur penalisht;
   2.5. të mos jetë i evidentuar si përdorues i lëndëve narkotike dhe psikotrope;
   2.6. të jetë profesionalisht i kualifikuar.
3. Ministria në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, nxjerr akt nënligjor ku përcakton kushtet dhe kriteret për vërtetimin e aftësisë psiko-fizike dhe procedurat për lëshimin e certifikatës.
4. Ministria lëshon dy lloje të certifikatave të kualifikimit, sipas kërkesës së aplikuesit.
   4.1. certifikata e kualifikimit i vërteton poseduesit të licencës, se personi është i kualifikuar për:
   4.2. transportimin e eksplozivëve apo fishekzjarrëve;
   4.3. deponimin dhe mbajtjen e eksplozivëve apo fishekzjarrëve.
5. Ministria duhet t'ia lëshoj certifikatën për kualifikim aplikuesit nëse:
   5.1. ka kontratë të vlefshme;
   5.2. i përmbush kushtet nga paragrafi 2. i këtij neni;
   5.3. është korporatë biznesi në të cilën personi përgjegjës, sekretari i korporatës apo partneri tjetër ne subjektin afarist nuk është person i ndaluar, që nënkupton personin i cili është ligjërisht i autorizuar të posedoj apo përdor eksploziv apo fishekzjarr.

Neni 9
Obligimet e personave të autorizuar

1. Personat e autorizuar, brenda kompetencave dhe përgjegjësive të përcaktuara, sigurojnë prodhimin, tregtimin, përdorimin, trajtimin, deponimin dhe asgjësimin e sigurt të eksplozivëve apo fishekzjarrëve në pajtim me këtë ligj.

2. Tregtia dhe përdorimi i eksplozivëve apo fishekzjarrëve ju lejohet vetëm personave profesionalisht të kualifikuar. Kualifikimi vërtetohet me anë të certifikatës së kualifikimit.
3. Personi i autorizuar është i obliguar të ofroj informata apo dokumente për vërtetimin e identitetit të tij, si dhe të ketë njohuri adekuate mbi praktikat e sigurisë në përdorimin dhe trajtimin e eksplozivit apo fishekzjarrëve.
4. Edukimi, kriteret, kualifikimet profesionale, programet e trajnimit profesional si dhe certifikimi profesional, përcaktohen me akt nënligjore nga ministria.

KREU IV
ARTIKUJT E LEJUAR DHE TË NDALUAR

Neni 10
Eksplozivët apo fishekzjarrët e lejuar dhe të ndaluar

1. Materialet eksplozive sipas këtij ligji janë:
   1.1. eksplozivët komercial;
   1.2. mjetet për inicimin e eksplozivëve;
   1.3. baruti;
   1.4. produktet e mbushura me eksplozivë;
   1.5. substancat piroteknike;
   1.6. lëndët e para me përbërje eksplozive.
2. Eksplozivët lejohen sipas një vlerësimi i cili përcakton nëse i përgjigjet, apo përjashtohet, nga klasa 1 e skemës së klasifikimit të KB-së për transportimin e mallrave të rrezikshme, dhe sipas numrit serik të Kombeve të Bashkuara, kodit të rrezikshmërisë dhe grupit të përputhshmërisë.
3. Departamenti përgjegjës i ministrisë përcakton eksplozivin si eksploziv të lejuar sipas këtij ligji.
4. Nëse përbërja apo cilësia e një eksplozivi të lejuar ndërron, atëherë eksplozivi nuk do të jetë eksploziv i lejuar.
5. Departamenti përgjegjës i ministrisë përcakton në listën shtetërore eksplozivet e lejuar si dhe kategorizimin e tyre.
6. Departamenti përgjegjës i ministrisë shpall në listë të veçantë fishekzjarrët e lejuar dhe kategorizimin e tyre.
7. Sipas paragrafit 6. të këtij neni, asnjë substancë piroteknike e cila përmban squfur, fosfor të përzier me klorat potasiumi, klorate tjera, apo që përmban njërën nga përzierjet e tilla, nuk do të lejohet.
8. Për të parashtruar kërkesë për lejimin e eksplozivëve apo fishekzjarrëve të cilat nuk janë në listën shtetërore të eksplozivëve apo fishekzjarrëve, aplikuesi ia parashtron kërkesën ministrisë.
9. Kërkesa nga paragrafi 8. i këtij neni duhet të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 13 paragrafi 2. dhe 3. të këtij ligji si në vijim:
   9.1. SNE - sasinë neto të eksplozivit të një produkti;
   9.2. kategorinë e rrezikshmërisë së KB-së;
   9.3. përbërjen e eksplozivëve apo fishekzjarrëve;
   9.4. tiparet e eksplozivëve apo fishekzjarrëve.

10. Klasifikimi i rrezikshmërisë së KB-së dhe grupeve të pajtueshmërisë do të rregullohen me akt nënligjor nga ministria.

Neni 11
Përjashtimet

1. Përjashtimet nga ky ligj kanë të bëjnë me:
   1.1. aktivitetet e lejuara me eksplozivë të zbatuara nga FSK, PK dhe Dogana e Kosovës dhe OJQ të autorizuara për deminim sipas ligjeve në fuqi;
   1.2. mjetet shpërthyese nukleare dhe biologjike;
   1.3. eksplozivët që përdoren për inflatorët e "jastëkëve me ajër"
2. Prodhimin e eksplozivëve për qëllime të analizave laboratorike, testimeve, demonstrimeve apo eksperimentimeve, por jo për përdorim praktik apo shitje, aty ku sasia totale e eksplozivëve që prodhohet në çfarëdo kohe, nuk tejkalon njëqind (100) gram.
3. Sipas paragrafit 1. të këtij neni nuk mund të lejohet marrja apo mbajtja e eksplozivëve për të cilët kërkohet certifikata për eksplozivë sipas këtij ligji.
4. Prodhimi apo asgjësimi i municionit të armëve të vogla, apo përgatitja e fishekëve për përdorim me armë zjarri që përdoren në inskenimet e ngjarjeve historike, ku sasia e përgjithshme e kapsollës dhe shtytësit e përdorur për një herë nuk tejkalon dy (2) kilogramë, si dhe për këto qëllime, sasia e shtytësit të përdorur përfshinë shtytësin e hequr nga fishekët.
5. Përgatitja, montimi dhe aktivizimi i fishekzjarrëve në vendin e planifikuar për përdorim të fishekzjarrëve në sasi prej jo më shumë se dhjetë (10) kilogram gjatë një periudhe kohore, në një lokacion për të cilin personi ka licencë apo regjistrim për deponim të eksplozivëve, për qëllime të lëshimit të fishekzjarrëve, që do të bëhet po nga ai person.
6. Përgatitja, montimi dhe aktivizimi i eksplozivëve për përdorim me efekte speciale teatrale, televizive apo në kinema.
7. Ripërpunimi i eksplozivit për të formuar një produkt farmaceutik i cili në vetvete nuk është eksploziv.
8. Leja e lëshuar nga ministria për përdorim të eksplozivëve sipas këtij ligji nuk e përfshinë lejen për minim për përdorim në miniera dhe gurore e cila është përgjegjësi e KPMM-së, sipas Ligjit për Miniera dhe Minerale.

Neni 12
Nitrat Amoniumi

1. Rreziku nga zjarri apo shpërthimi, zmadhohet në masë të madhe nëse nitrat amoniumi përzihet me materie djegëse ose të papajtueshme, si metale pluhur, metale alkali, urea, krom ose kripëra bakri, materiale organike dhe të qymyrgurit, squfur, nitritet, alkalet, acidet, klorik dhe agjentë reduktues.
2. Ministria përgatitë udhëzues për deponimin e nitrat amoniumit dhe llojeve tjera të plehrave kimike që përmbajnë azot.
3. Ministria me akt nënligjor përcakton minimumin e rrezikut të shpërthimit, gjithashtu mund të zvogëloj rreziqet që lidhen me oksidimin dhe lirimin e gazrave toksike në zjarr.

4. Plehrat që përmbajnë 28% apo më pak azot, zakonisht nuk paraqesin rrezik shpërthimi ku për këtë arsye për të identifikuar masat e nevojshme, ammonium nitrati në plehra mund të ndahen në dy grupe:
   4.1. plehrat që përmbajnë më shumë se 28% azot. Shumica e këtyre janë lloje të pastra të nitrat amoniumit, edhe pse ato përfshijnë një numër të vogël të përzierjeve të plehrave;
   4.2. plehrat që përmbajnë 28% apo më pak azot. Përzierja e plehrave formon proporcion të madh të këtij grupi. Llojet e pastra të azotit janë zakonisht përzierje e nitrateve të ammoniumit me gurë gëlqeror ose materiale të ngjashme inerte.

KREU V
PLASIMI NE TREGUN E KOSOVËS

Neni 13
Kriteret e përgjithshme

1. Personi përgjegjës i personit juridik duhet të furnizoj me eksplozivë apo fishekzjarrë, personin tjetër, me qëllim të shpërndarjes, përdorimit dhe importit, përveç ri-eksportit jashtë Republikës së Kosovës nëse:
   1.1. eksplozivët apo fishekzjarrët përmbushin kriteret thelbësore të sigurisë që zbatohen ndaj atyre eksplozivëve apo fishekzjarrëve në përputhje me këtë ligji;
   1.2. eksplozivet dhe fishekzjarrët duhet të jenë në përputhje me listën shtetërore.
   1.3. shënjimi CE-së duhet të jetë i vendosur në eksploziv apo fishekzjarrë në pajtim me rregulloret përkatëse;
   1.4. përveç shënjimit CE, pakoja për eksploziv apo fishekzjarr është paraparë me shënjimet e mëposhtme:
      1.4.1. klasifikimin e KB-së për rrezikshmëri;
      1.4.2. emri dhe adresa e prodhuesit;
      1.4.3. vendi i prodhimit;
      1.4.4. viti i prodhimit;
      1.4.5. emrin dhe llojin e produktit.
   1.5. Përveç shënjimit CE, në fishekzjarrët duhet të vendoset etiketa me shenjat e mëposhtme:
      1.5.1. emri dhe adresa e prodhuesit;
      1.5.2. vendi i prodhimit;
      1.5.3. viti i prodhimit;
      1.5.4. emri dhe lloji i produktit;
      1.5.5. mosha minimale e personave të cilëve iu lejohet blerja;
      1.5.6. distanca minimale e sigurisë;
      1.5.7. këshilla sigurie, nëse ka ndonjë.
   1.6. udhëzuesit e eksplozivëve apo fishekzjarrëve hartohen në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
2. Eksplozivët apo fishekzjarrët mund të vihet në treg dhe përdorim, pasi prodhuesi ose furnizuesi të merr leje paraprakisht dhe udhëzuesin për përdorim dhe asgjësim të sigurt nga ministria.

3. Prodhuesi ose furnizuesi duhet ti dorëzon organit kompetent deklaratën mbi përputhshmërinë e produktit sipas direktivës se BE-se, për plasimin e eksploziveve dhe fishekzjarrëve në treg.
4. Ministria me akt nënligjor përcakton procedurat dhe format për vendosjen në treg të eksplozivëve apo fishekzjarrëve, si dhe kriteret për shënjimin CE-së dhe shënimin e pakove.

KREU VI
SHITJA E EKSPLOZIVËVE

Neni 14
Shitja e eksplozivëve të lejuar

1. Gjatë shitjes së eksplozivëve të lejuar do të aplikohen të gjitha kriteret për transferim dhe leje në pajtim me këtë ligj.
2. Personi juridik i licencuar mund të shes eksplozivë vetëm nëse poseduesi i licencës mban licencë apo leje për shitje të eksplozivëve.
3. Ministria mund të marr mostra të eksplozivëve në treg për të bërë ekzaminime në periudha të caktuara dhe të pacaktuara kohore, për të vërtetuar përshtatshmërinë e tyre.
4. Ministria mund të marr mostra eksplozivësh për të vlerësuar përshtatshmërinë e tyre me kriteret e përcaktuara teknike.
5. Në rast se përdorimi i mëtutjeshëm i një eksplozivi paraqet rrezik për jetën e njerëzve dhe mjedisit, ministria mund të ndalojë përkohësisht shitjen e eksplozivëve deri në kryerjen e një verifikimi të përshtatshmërisë.
6. Nëse mostrat e marra nuk janë në pajtim me kriteret e përcaktuara teknike, ministria duhet të ndalojë shitjen e eksplozivëve të tillë.
7. Prodhuesi apo furnizuesi duhet të mbuloj shpenzimet e ekzaminimit.
8. Dokumentet dhe shenjat e huaja të përshtatshmërisë, janë të vlefshme në Republikën e Kosovës, pasi që të vërtetohen nga inspektorati për eksploziv i Ministrisë sipas kritereve teknike të Kosovës për eksploziv. Inspektorati për eksploziv gjatë këtij procesi, nëse është e nevojshme, mund të mbështet nga laboratori i kriminalistikës së Policisë së Kosovës.
9. Ministria me akt nënligjor përcakton kriteret teknike për eksplozivët dhe procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë, të përcaktuara në paragrafët 4. deri në 8. të këtij neni, si dhe procedurat dhe kriteret për pranimin e dokumenteve të huaja mbi përshtatshmërinë.

Neni 15
Shitja e fishekzjarrëve

1. Fishekzjarrët shiten vetëm nga personat e autorizuar dhe të licencuar për tregti ose për shitje me pakicë për fishekzjarrë.
2. Fishekzjarrët duhet të kategorizohen nga prodhuesi sipas llojit të përdorimit, apo qëllimit dhe nivelit të rrezikut, duke përfshirë nivelin e zhurmës si në vijim:
   2.1. fishekzjarrët e kategorisë 1 që paraqesin rrezik shumë të ulët dhe nivel të zërit të papërfillshëm, dhe të cilët kanë për qëllim të përdoren në vende të

izoluara, duke përfshirë fishekzjarr që kanë për qëllim të përdoren brenda vendbanimeve;

2.2. fishekzjarrët e kategorisë 2 që paraqesin rrezik të ulët dhe nivel të ulët të zërit dhe që kanë për qëllim të përdoren në vende të hapura dhe të izoluara;

2.3. fishekzjarrët e kategorisë 3 që paraqesin rrezik të mesëm, të cilët kanë për qëllim të përdoren në vende të hapura dhe të mëdha, dhe që kanë nivel të zhurmës e cila nuk dëmton shëndetin e njeriut;

2.4. fishekzjarrët e kategorisë 4 që paraqesin rrezik të lartë, që kanë për qëllim të përdoren vetëm nga personat me përgatitje të specializuar, zakonisht njihen si fishekzjarrë për përdorim profesional dhe të cilët kanë nivel të zhurmës që nuk e dëmton shëndetin e njeriut.

3. Substancat piroteknike teatrale ndahen si në vijim:

3.1. substancat piroteknike për përdorim në skenë që paraqesin rrezik të ulët të kategorisë T1;

3.2. substancat piroteknike për përdorim në skenë që kanë për qëllim të përdoren vetëm nga persona me përgatitje të specializuar të kategorisë T2;

4. Substancat piroteknike të tjera ndahen si në vijim:

4.1. substancat piroteknike që nuk iu takojnë fishekzjarrëve apo substancave piroteknike teatrale dhe që paraqesin rrezik të ulët të kategorisë P1;

4.2. substancat piroteknike që nuk iu takojnë fishekzjarrëve apo substancave piroteknike teatrale, të cilat kanë për qëllim të përdoren vetëm nga persona me përgatitje të specializuar të kategorisë P2.

5. Fishekzjarrët prodhohen në lloje të ndryshme por zakonisht ju takojnë llojeve si në vijim:

5.1. F1 Torta është fishekzjarr i konstruktuar nga shumë gypa të kartonit të ngjitur së bashku. Secili gyp përmban një gjuajtje, dhe këto të gjitha janë të lidhura me fitil të brendshëm. Në momentin kur torta ndizet, fitili digjet nga gypi në gyp, duke ndezur çdo gjuajtje me radhë. Pra, torta me 16 gjuajtje do të ketë 16 gypa të tjerë. Tortat janë të prodhuara të vendosen në tokë. Ato qëndrojnë në tokë por secila gjuajtje godet jashtë gypit lartë në ajër.

5.2. F2 Qiri është emër tradicional për fishekzjarrët të cilët janë të pranishëm me shekuj. Në formën më të thjeshtë, është vetëm gyp nga kartoni me guaskë të vendosur brenda. Fitili është i vendosur në gypin dhe ndez mbushjen e ngritjes, duke hedhur guaskën jashtë nga kulmi i hapur në ajër, ku dhe pëlcet me efektin e tij. Vetë qiri mbetet në tokë.

5.3. F3 Raketa përbëhet nga tri pjesë kryesore. Koka, zakonisht përbëhet nga kartoni apo plastika, përmban vetë efektin. Kjo ngritët në kulmin e "motorit" cilindrik, e cila ndizet me fitil. Motori përmban lëndë ndezëse të ngurtë shtytëse dhe mund ta nxitoj raketën me qindra milje në orë në disa raste. Kur motori digjet, mbushja e kthyer pëlcet në kokën, duke ndezur ngarkesë. Këto komponente vendosen në shkop të gjatë, të prodhuar nga druri apo kunji. Shkopi vendoset në gypin hedhës i cili është zakonisht copë e plastikës e mprehtë apo kanal.

5.4. F4 Shatërvanët kanë formë të vullkanit. Të gjithë shatërvanët krijojnë rend të shkënditjeve, nga niveli tokësor, përveç pjesës së krisjes, janë të qetë në veprim dhe lirojnë vetëm zhurmën "roar".

5.5. F5 Mina është fishekzjarri më i fuqishëm që mund të blihet, shkaku se e gjithë përbërja pëlcet përnjëherë. Ndërsa përbërja e tortës, qiriut apo të tjerave fishekzjarrëve, pëlcet "pjesë pjesë". Në minë sasia në vrimë është e paketuar lirshëm në një gyp të kartonit. Fitili ndez këtë dhe plasja godet jashtë pjesës së skajshme të gypit në ajër dhe paraqitet nga niveli tokësor.

5.6. F6 Rrota është disk nga kartoni apo plastika me një numër të goditësve apo shatërvanëve që i përngjajnë raketave të vendosura rreth perimetrit. Secila ndizet për të shkaktuar shkënditje dhe goditje, duke e rrotulluar rrotën. Lëvizja e shpejtë e më shumë rrotave zmadhon efektin.

5.7. F7 "Sib" (Kuti e vetme ndezëse) është vetëm një tortë shumë e madhe me numër më të madh të efekteve. Gypat e jashtëm janë të vendosur lehtë, pra kutia mbulon pjesën e majtë dhe të djathtë të vendit të ekspozuar.

5.8. F8 Të tjerat përfshijnë shkëndues, shtizë, ujvarë dhe pëllumba.

5.9. Eksplozivët e ulët janë përzierje ku niveli i zbërthimit vazhdon përmes materialit më të ulët të shpejtësisë së zërit.

5.10. Barut, po ashtu i quajtur barut i zi, është përzierje nga squfuri, qymyr druri dhe kalium nitrati. Digjet shpejt, duke prodhuar volum të nxehtësisë së ngurtë dhe gazra që mund të përdoren si shtytës në armë të zjarrit dhe si përbërje e piroteknikave në fishekzjarre. Baruti për përdorim të armëve të zjarrit përjashtohet nga ky ligj dhe do të rregullohet sipas Ligjit për Armë.

6. Fishekzjarrët e kategorisë 1, 2 dhe 3 të paragrafit 2. të këtij neni, mund t'ju shiten personave prej moshës si në vijim:
   6.1. kategoria 1: dymbëdhjetë (12) vjet;
   6.2. kategoria 2: gjashtëmbëdhjetë (16) vjet;
   6.3. kategoria 3: tetëmbëdhjetë (18) vjet;
   6.4. kategoria T1 dhe P1: tetëmbëdhjetë (18) vjet.
7. Fishekzjarrët e kategorisë 4 sipas paragrafit 2 të këtij neni, të kategorisë T2 sipas paragrafit 3. dhe P2, paragrafi 4. të këtij neni mund të shiten vetëm nga personat e autorizuar dhe të licencuar.
8. Furnizuesit e fishekzjarrëve mbajnë evidencat për çdo furnizim që tejkalon pesëdhjetë (50) kg së paku tri (3) vite.

KREU VII
MASAT E SIGURISË

Neni 16
Kriteret e përgjithshme

1. Sipas dispozitave të këtij ligji, gjatë përdorimit të eksplozivit apo fishekzjarrëve, ndërmerren të gjitha masat për mbrojtjen e shëndetit, jetës së njerëzve, pronës dhe mjedisit.
2. Poseduesi i licencës që është i përfshirë në aktivitetet e prodhimit, tregtisë, përdorimit, deponimit dhe asgjësimit të eksplozivëve apo fishekzjarrëve, duhet të garantoj sigurinë e personave dhe pronës, si dhe duhet të ndërmarr të gjitha masat e parashikuara ne pajtim me nenin 28 të këtij ligji.
3. Masat nga paragrafi 2. i këtij neni definohen me dokumentacionin gjegjës të përcaktuar me nenin 40 të këtij ligji.

4. Poseduesi i licencës përgatit planin e masave në rast të aksidenteve apo rasteve tjera emergjente, siç janë: eksplodimi, zjarret dhe prishjet.
5. Planet do të përmbajnë informatat relevante kontaktuese për agjencitë lokale emergjente përgjegjëse.
6. Poseduesi i licencës informon të gjithë personat e përfshirë në çdo aktivitet që ka të bëjë me eksploziv lidhur me masat e sigurisë të dorëzuara me dokumentet e përgjithshme, planin për masat që do të ndërmerren, si dhe të siguroj trajnimin e tyre për t'u përballë me aksidentet dhe rastet tjera emergjente.
7. Trajnimet duhet të mbahen çdo gjashtë (6) muaj për të gjithë punonjësit apo personat e involvuar në punët me eksplozivë.
8. Objektet e planifikuara për prodhimin, tregtimin dhe deponimin e eksplozivëve duhet të jenë fizikisht dhe teknikisht të sigurta, si dhe duhet të jenë jashtë zonave urbane me përjashtim të depove të lejuara për vendet e shitjeve për fishekzjarrë. Kriteret për vendosjen e objekteve duhet të definohen dhe dorëzohen tek ministria për aprovim, që të sigurojnë vendosjen e duhur të depove për eksplozivë.
9. Secili posedues i licencës i përfshirë në aktivitetet e përdorimit të eksplozivëve në çfarëdo mënyre, organizon dhe mbikëqyrë ekzekutimin e masave dhe kushteve të përcaktuara me ligj.
10. Secili posedues i licencës që është i përfshirë në aktivitetin e prodhimit, tregtisë dhe përdorimit të eksplozivëve, është i obliguar të informojë menjëherë stacionin më të afërt të policisë mbi llojin dhe sasinë e eksplozivëve të humbur apo të vjedhur.
11. Secili posedues i licencës që prodhon apo deponon eksploziv apo fishekzjarr, do të marrë masat e nevojshme, që të shmangë rrezikun ndaj sigurisë dhe shëndetit të personave apo pronës.
12. Secili posedues i licencës që deponon eksplozivë në një lokacion, duhet të sigurojë që distanca ndarëse e përcaktuar, të mbahet në mes depos dhe objektit apo vendeve tjera jashtë atij lokacioni, mbi të cilin vlen ajo skemë.
13. Ministria me akt nënligjor do të përcaktoj kriteret për distancat e depove për eksplozivë dhe kriteret e sigurisë për deponimin dhe vendosjen e eksplozivëve.
14. Secili posedues i licencës do të sigurojë që qasja për personat e paautorizuar tek eksplozivët është e ndaluar.

Neni 17
Mbrojtja nga zjarri

1. Çdo posedues i licencës që prodhon ose është përgjegjëse për deponimin e materialeve të eksplozivëve duhet të hartojë dhe mirëmbajë dokumentet me rregullat e PSO për mbrojtjen nga zjarri, si në vijim:
   1.1. ndalohet pirja e duhanit në 20 m nga depoja. JO DUHANI / JO DRITA TË ZHVESHURA, shenjat të jenë të dukshme dhe të jenë të vendosura përreth depos;
   1.2. bari duhet prerë poshtë dhe të mirëmbahet shkurt, përreth depos;
   1.3. flaka dhe pajisjet që prodhojnë shkëndija nuk duhet të përdoren brenda njëzet (20) m nga depoja. Kur këto pajisje janë të nevojshme për rregullimin e depos, të gjithë eksplozivët duhet larguar;

1.4. ngjyrat, vajrat, benzina si dhe materialet e tjera të ndezshme ndalohet të deponohen me eksplozivë. Materialet e autorizuara për pastrim mund të përdoren në depo për mirëmbajtje por duhet të largohen kur nuk janë në përdorim;
1.5. kontejnerët e zbrazur të çdo lloji nuk duhet të deponohen me eksplozivë;
1.6. së paku dy aparate për zjarrfikje me ujë, duhet të jenë në vende të dukshme jashtë çdo depoje të eksplozivëve;
1.7. të gjitha pajisjet e zjarrfikjes duhet të jenë të mirëmbajtura dhe të servisuara;
1.8. duhet të vendoset rrufepritës sipas standardeve të BE-së EN 62305;
1.9. tabela me artikujt të cilët nuk janë të lejuar në depo, duhet të jetë e vendosur në vend të dukshëm në hyrje të depos. Detajet e artikujve të ndaluar duhet të jenë si në vijim:
1.9.1. fanar, llampat me vaj, dhe stufat, si dhe të gjitha pajisjet që shkaktojnë shkëndijë apo flakë;
1.9.2. shkrepëset, ose ndonjë gjë portative që shkakton shkëndijë ose flakë;
1.9.3. pirja e duhanit.
1.9.4. lëngjet ndezëse dhe tretësit përveç atyre të lejuar për mirëmbajtje të kontejnerëve apo të cilët gjenden në rezervuarin e automjetit;
1.9.5. ushqimi dhe pijet;
1.9.6. të gjitha llojet e radio pajisjeve, duke përfshirë edhe telefonat mobil;
1.9.7. armët e zjarrit përveç atyre që mbahen nga rojet;
1.9.8. barërat përveç atyre që janë në kutinë e ndihmës së parë;
1.9.9. municioni që nuk është i lejuar të deponohet;
1.9.10. çdo burim i pambrojtur i energjisë elektrike.

Neni 18
Mbrojtja e eksplozivëve nga eksplodimet

1. Secili posedues i licencës në kontroll apo në punë, në lokacionet për eksploziv duhet të marrë masa të nevojshme dhe të jetë i kujdesshëm për të parandaluar incidentet me eksplozivë në atë lokacion.
2. Poseduesi i licencës vendos njoftimin që paralajmëron personat në fabrikë mbi përgjegjësinë për kundërvajtje, i cili duhet të jetë i vendosur në vend të dukshëm i lexueshëm qartë, ashtu që çdokush që hyn në lokacion të mund ta shoh dhe ta lexoj.

Neni 19
Deponimi

1. Depot e eksplozivëve dhe dyqanet e shitjes me pakicë të fishekzjarrëve licencohen nga ministria.
2. Personi juridik duhet të përmbush kriteret nga neni 16 i këtij ligji.
3. Secili person që deponon eksplozivë, duke përfshirë trajtimin, transportin brenda lokacionit dhe testimin e eksplozivëve që lidhet me atë deponim, do te marr të gjitha masat e nevojshme si në vijim:
3.1. parandalimin e zjarreve apo eksplodimeve të paplanifikuara;
3.2. kufizimin e nivelit të zjarrit apo eksplodimit, duke përfshirë masat për

parandalimin e përhapjes së zjarrit dhe komunikimin e eksplodimeve nga një vend në tjetrin;

3.3. për mbrojtjen e personave nga efektet e zjarrit apo eksplodimit.

4. Personat juridik duhet të informojnë të gjithë personat e përfshirë në çfarëdo aktiviteti me eksplozivë mbi masat e sigurisë të paraqitura me dokumentet e veta të përgjithshme, në planin e masave, si dhe të sigurojë trajnimin për t'u përballë me aksidentet apo rastet tjera emergjente.
5. Secili person që deponon eksplozivë në një lokacion do të sigurojë që distanca e ndarjes së jashtme apo e brendshme, të mbahet në mes të eksplozivëve dhe deponisë si dhe objekteve apo vendeve të tjera jashtë atij lokacioni. Kriteret e vendosjes së eksplozivëve dhe distancave për deponim do të përcaktohen nga ministria me akt nënligjor sipas nenit 28 të këtij ligji.
6. Objektet për prodhim dhe deponim duhet të jenë të ndërtuara dhe të pajisura në atë mënyrë që të sigurojnë mbrojtjen e njerëzve, pasurisë dhe mjedisit.
7. Eksplozivët deponohen në objekte statike apo mobile të dedikuara për deponim.
8. Objektet për prodhim dhe deponim duhet të jenë të sigurta ndaj qasjes së pa autorizuar.
9. Ministria do të përcaktojë me akt nënligjor kriteret e objekteve për prodhim dhe deponim, si dhe kriteret për lokacionet e ngarkimit dhe shkarkimit të eksplozivëve apo fishekzjarrëve.
10. Dyqanet me pakicë të fishekzjarrëve duhet po ashtu të përmbushin kriteret e veçanta teknike dhe të sigurisë, të cilat përcaktohen në Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri.

Neni 20
Dizajni i depos

Shfrytëzuesit e objekteve për deponimin e eksplozivëve apo fishekzjarrëve, duhet të marrin të gjitha masat për parandalimin e qasjes ndaj eksplozivëve apo fishekzjarrëve nga personat e paautorizuar.

Neni 21
Zonat e rrezikut të eksplodimit dhe distancat ndarëse - siguria

Distancat ndarëse në ndërtimin e depove duhet të bazohen në klasifikimin e rrezikut dhe sasinë e eksplozivëve në depo. Kriteret e distancave ndarëse dhe të vendosjes së depove, janë të cekura në udhëzuesin për siguri të eksplozivëve ose udhëzuesin për siguri të fishekzjarrëve.

Neni 22
Qasja e paautorizuar

1. Objektet e prodhimit dhe deponimit duhet të jenë të sigurta nga qasja e paautorizuar.
2. Asnjë person nuk duhet të hyjë pa lejen e poseduesit të licencës në:
   2.1. depo, brenda apo jashtë lokacionit;
   2.2. objektin e shfrytëzuar për prodhimin e eksplozivëve apo fishekzjarrëve brenda apo jashtë lokacionit;

2.3. lokacion me kufij qartë të shënjuar, në të cilin deponohen apo prodhohen eksplozivët apo fishekzjarrët.
3. Personi që posedon armë të zjarrit nuk mund të hyjë në depo.
4. Paragrafi 2. i këtij neni nuk aplikohet për depot e eksplozivëve që janë nën mbikëqyrjen e ministrisë.
5. Autorizimi mund t'ju lëshohet vetëm inspektorëve për eksplozivë të ministrisë.

Neni 23

Nëse personi futet ilegalisht ose mban armë të zjarrit në lokacionet e licencuara për eksplozivë apo fishekzjarrë, inspektori, ofruesi i sigurisë ose poseduesi i licencës duhet menjëherë ta informojë policinë.

Neni 24
Manovrimi dhe përdorimi i eksplozivëve të përgjithshëm

1. Para se punëdhënësi të lejoj punëtorin që të manovroj ose përdor eksplozivë apo fishekzjarrë, punëdhënësi duhet të sigurojë se ai person është personi përkatës.
2. Një person i cili është duke kryer ndonjë veprim që përfshinë eksplozivë apo fishekzjarrë, duhet të ndërmerr masa të arsyeshme dhe të kujdeset për të shmangur rrezikun e sigurisë, shëndetit ose pronës.
3. Personat juridik mund të përdorin eksplozivët apo fishekzjarrët, vetëm në lokacione dhe për qëllime të përcaktuara në licencën për përdorimin e eksplozivëve apo fishekzjarrëve.
4. Përdorimi i eksplozivëve apo fishekzjarrëve në ndonjë lokacion, duhet të bëhet vetëm me lejen e ministrisë, masat e zbatuara nga ministria do të rregullohen me akt nënligjor.
5. Përjashtimisht nga paragrafi 3. i këtij neni, në raste të veçanta ministria mund të vendos ndryshe.
6. Eksplozivët apo fishekzjarrët mund të asgjësohen vetëm në lokacionet ku lejohet asgjësimi, nëse sasia SNSH e eksplozivëve nuk tejkalon pesëdhjetë (50) kg apo sasinë e përcaktuar sipas udhëzuesit të prodhuesit.
7. Eksplozivët apo fishekzjarrët asgjësohen vetëm nga personeli i kualifikuar profesional, pas marrjes së pëlqimit nga ministria.
8. Eksplozivët e papërdorur që janë sjellë në lokacionin ku është bërë shpërthimi nga vendi i deponimit, nuk do të kthehen prapa në vendin e deponimit por do të asgjësohen në lokacionin e autorizuar për shpërthim.
9. Lokacionet për ngarkim dhe shkarkim të eksplozivëve jashtë objekteve të prodhuesit ose furnizuesit përcaktohen nga ministria në marrëveshje me komunat.
10. Personi juridik duhet të përmbush kriteret nga neni 16, paragrafët 1. deri 10. të këtij ligji.
11. Mospajtimi me këtë nen mund të jetë bazë për pezullim ose anulim e mbajtësit të autoritetit.

Neni 25
Manovrimi dhe përdorimi

Personi nuk duhet të përgatis eksplozivët apo fishekzjarrët për përdorim të manovroj ose të përdorë eksplozivë apo fishekzjarrë në ndonjë mënyrë tjetër nga mënyra e përcaktuar me këtë ligj.

Neni 26
Transporti i Eksplozivëve - Siguria

Eksplozivët duhet të transportohen vetëm në pajtim me marrëveshjet nga paragrafi 2. i nenit 1 të këtij ligji.

Neni 27
Hedhja dhe asgjësimi

1. Personi i cili hedh eksplozivët apo fishekzjarrët ose dekontaminon mallrat e kontaminuara me eksplozivë, duhet të siguroj derisa të jetë praktikisht e arsyeshme, se ato do të hedhen ose dekontaminohen në mënyrë të sigurt.
2. Përdorimi i njërës nga katër metodat që janë djegia, detonimi, shpërbërja ose tretja me një tretës ose shkatërrim kimik, do të varet nga përbërja e eksplozivit, rreziqet e tij, lloji dhe pozita e lokacionit për hedhje. Groposja dhe hedhja në det nuk janë metoda të përshtatshme të hedhjes së eksplozivëve apo fishekzjarrëve.

Neni 28
Kriteret e sigurisë shtesë

1. Ministria me akt nënligjor do të përcaktojë masat e mëposhtme të sigurisë, dhe më tej do të quhen Udhëzuesit për Siguri të Eksplozivëve USE respektivisht Udhëzues për Siguri të Fishekzjarrëve USF.
   1.1. udhëzuesi për siguri të eksplozivëve përmban sigurinë për:
      1.1.1. parandalimin e zjarrit;
      1.1.2. parandalimin e shpërthimit;
      1.1.3. sigurinë për prodhim;
      1.1.4. siguria për zonat e rrezikut të shpërthimit dhe ndarjen në distancë;
      1.1.5. qasje të eksplozivëve;
      1.1.6. largimin e personave që hyjnë pa leje;
      1.1.7. trajtimin dhe përdorimin e eksplozivëve;
      1.1.8. transportim të eksplozivëve;
      1.1.9. hedhjen dhe asgjësimin.
   1.2. udhëzuesi për siguri të fishekzjarrëve përmban sigurinë për:
      1.2.1. parandalimin e zjarrit;
      1.2.2. siguria për parandalimin e shpërthimit;
      1.2.3. siguria për prodhim;
      1.2.4. zonat e rrezikut të shpërthimit dhe ndarjen në distancë;
      1.2.5. qasje të fishekzjarrëve;

1.2.6. largimin e personave që hyjnë pa leje;
1.2.7. trajtimin dhe përdorimin e fishekzjarrëve;
1.2.8. transportim të fishekzjarrëve;
1.2.9. hedhjen dhe asgjësimin.

KREU VIII
LICENCAT DHE LEJET

Neni 29
Specifikimet e përgjithshme

1. Licenca e përgjithshme lëshohet nga ministria me kërkesën e aplikuesit.
2. Licenca e përgjithshme lëshohet për personat juridik që aplikojnë në lëmitë si në vijim:
   2.1. licenca për prodhimin e eksplozivëve dhe fishekzjarrëve;
   2.2. licenca për import, eksport, transit dhe transferim të eksplozivëve dhe fishekzjarrëve;
   2.3. licenca për përdorimin e eksplozivëve dhe fishekzjarrëve.
3. Lejet e mëposhtme mund të lëshohen për personat juridik që aplikojnë për:
   3.1. leje për import, eksport, transit ose transferimin e eksplozivëve dhe fishekzjarrëve;
   3.2. leje për shitje me pakicë të fishekzjarrëve;
   3.3. leje për deponim;
   3.4. leje për asgjësim;
   3.5. leje për prodhim;
   3.6. leje për përdorimin e fishekzjarrëve;
   3.7. leja për objektet ku bëhet prodhimi i eksplozivëve;
   3.8. leja për përdorim (leja për minim);
4. Kriteret e përgjithshme për kërkesën e personit juridik që aplikon për licencat nga paragrafi 1. i këtij neni, janë si në vijim.
5. Kërkesës nga paragrafi 1. i këtij neni duhet t'i bashkangjiten dokumentet si në vijim:
   5.1. certifikata e biznesit;
   5.2. certifikata nga gjykata se personit juridik nuk i është ndaluar ose ndërprerë aktiviteti me vendim të formës së prerë të gjykatës kompetente;
   5.3. garancioni bankar pesë (5) vjeçar me vlerë të dhjetëmijë (10.000) Euro.
6. Ministria do të përgjigjet brenda tridhjetë (30) ditësh në lidhje me kërkesën për licencë.
7. Ministria do të përgjigjet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh në lidhje me kërkesën për leje.
8. Ankesa bëhet sipas ligjit për procedurën administrative dhe ligjet e tjera relevante.
9. Licencat janë të vlefshme për një periudhë prej pesë (5) vjetësh.

Neni 30
Personat juridik të huaj

Personat juridik nga vendet e huaja, kanë të drejtë të aplikojnë për licencë në Republikën e Kosovës, me kusht që ata të plotësojnë kriteret e njëjta si aplikantët vendor në përputhje me këtë ligj dhe ligjet tjera relevante në fuqi.

Neni 31
Licenca dhe leja për prodhim

1. Personi juridik mund të filloj prodhimin e eksplozivëve apo fishekzjarrëve, pasi që i është lëshuar licenca dhe leja për prodhim të eksplozivëve apo fishekzjarrëve nga ministria.
2. Licenca për prodhim të eksplozivëve apo fishekzjarrëve vlen pesë (5) vite nga data e lëshimit, me kohë të kufizuar dhe me kufizime tjera me qëllim që të sigurojë mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së personave, si dhe mbrojtjen e pronës dhe mjedisit.
3. Kërkesës për licencë për prodhim të eksplozivëve apo fishekzjarrëve të përcaktuara nga paragrafi 1. i këtij neni duhet ti bashkëngjiten si në vijim:
   3.1. të dhënat për llojin e eksplozivëve apo fishekzjarrëve që planifikohen të prodhohen;
   3.2. të dhënat për procesin dhe teknologjinë e prodhimit;
   3.3. certifikata e personave të autorizuar ose të kualifikuar;
4. Para fillimit të prodhimit individual të një produkti eksploziv ose fishekzjarr, personi juridik i licencuar për prodhim do të kërkojë leje për prodhimin e eksplozivëve ose fishekzjarrëve.
5. Kërkesës nga paragrafi 4. i këtij neni duhet bashkëngjitur dokumentet si në vijim:
   5.1. kopjen e licencës për prodhimin;
   5.2. lejen për depo të sigurt;
   5.3. lejen për objektet ku prodhohen eksplozivët;
   5.4. planin emergjent;
   5.5. planin e sigurisë së lokacionit.
6. Në bazë të licencës së lëshuar për prodhim, eksplozivi i prodhuar i nënshtrohet testimit pas gjashtë (6) muajve në vitin e parë dhe vazhdon për çdo dymbëdhjetë (12) muaj.
7. Kriteret nga paragrafi 1. dhe 4. i këtij neni nuk vlejnë për:
   7.1. prodhimin e eksplozivëve për qëllime të analizave laboratorike, testimin, demonstrimin ose eksperimentin ku sasia totale e eksplozivëve që prodhohet në çdo kohë nuk tejkalon njëqind (100) gram;
   7.2. prodhimin ose asgjësimin e municionit të armëve të vogla ose përgatitjen e fishekëve për përdorim me armë zjarri, që do të përdoren për shënim të ngjarjeve historike, ku sasia totale e mbushësit dhe shtytësit të përdorur në çdo kohë nuk tejkalon dy (2) kilogram, dhe për këto qëllime sasia e shtytësit të përdorur përfshinë shtytësin e larguar nga fisheku;
   7.3. përgatitja e mbushjeve për shkrepje në lidhje me përdorimin e tyre;
   7.4. përgatitja, montimi, çmontimi dhe vërja e kapsollës në përdorimin e fishekzjarrëve në vendet e planifikuara për përdorim;

7.5. përgatitja, montimi dhe aktivizimi i kapsollës së fishekzjarrëve, në sasitë prej jo mbi dhjetë (10) kilogram në çdo kohë, në lokacion në lidhje me të cilin personi juridik posedon licencën për deponim të eksplozivëve për qëllime të përdorimit të fishekzjarrëve që do të ofrohet nga ai person përgjegjës i personit juridik;
7.6. përgatitja, montimi dhe aktivizimi i kapsollës së eksplozivëve për përdorim në shfaqje teatrale, televizive ose kinema;
7.7. ripërpunimi i eksplozivëve për të formuar një produkt farmaceutik që në vete nuk është eksploziv;
7.8. përzierja për përdorim të menjëhershëm të nitrat amoniumit me karburant ose lëndë shpërthyese nga nitrat amoniumi me substancë tjetër në minierë ose gurëthyes, për të prodhuar eksplozivë që nuk hyn në funksion me kapsollë;
7.9. përdorimi i eksplozivëve të pandjeshëm në prodhim të produkteve të cilët nuk janë eksplozivë;
7.10. prodhimi i eksplozivëve nga një kompani që është pronë vartëse e një kompanie tjetër në lokacion, në lidhje me të cilën kompania tjetër mban licencën për prodhim të eksplozivëve, dhe prodhimi i tillë është pronë vartëse në pajtim me kushtet e asaj licence.

8. Leja për prodhimin e eksplozivëve dhe fishekzjarrëve është e vlefshme për dymbëdhjetë (12) muaj.

Neni 32
Licenca, dhe leja për import, eksport, transit dhe transferim të eksplozivëve apo fishekzjarrëve

1. Eksplozivët apo fishekzjarrët mund të vendosen në treg nëse përmbushen kriteret nga neni 13 paragrafi 2. të këtij ligji.
2. Përveç kritereve të përcaktuara në nenin 13 paragrafi 1. dhe 2. të këtij ligji, për vendosjen e eksplozivëve apo fishekzjarrëve në treg duhet të përmbushen kriteret si në vijim:
   2.1. shenja CE duhet të fiksohet në eksploziv dhe në paketim:
      2.1.1. të natyrës së qëndrueshme ashtu që do të mbesin të dukshme, lehtë të lexueshme dhe të pashlyeshme gjatë transportit normal ose deponimit;
      2.1.2. të është vendosur në eksplozivë ose kur nuk është praktike, vendoset në tiketën identifikuese që ngjitet për eksploziv dhe që është dizajnuar ashtu që pamundëson ripërdorimin e tij;
      2.1.3. kur asnjëra nga të mësipërmet nuk janë praktike, atëherë ngjitet tiketa identifikuese në paketimin e eksplozivëve;
3. Kërkesës për licencë për import, eksport, transit ose transferimin e eksplozivëve ose fishekzjarrëve, duhet t'i bashkëngjiten dokumentet si në vijim:
   3.1. certifikata për regjistrim të biznesit;
   3.2. certifikata ADR.
4. Para importimit, eksportimit, transitit ose transferimit të një produkti, eksplozivi apo fishekzjarri, personi juridik i licencuar për import, eksport, transit ose

transferim duhet të kërkojë lejen për import, eksport, transit ose transferimin e eksplozivëve apo fishekzjarrëve.

5. Kërkesa nga paragrafi 3. i këtij neni përmban si në vijim**:**
   5.1. emrin dhe adresën e personit juridik dhe personit përgjegjës;
   5.2. emrin e eksplozivit dhe numrin identifikues të KB-së;
   5.3. emrin dhe adresën e prodhuesit;
   5.4. emrin dhe adresën e shitësit ose dërguesit të eksplozivit dhe emrin dhe adresën e blerësit ose pranuesit të eksplozivit;
   5.5. emrin dhe adresën e vozitësit të automjetit, tipin e automjetit dhe numrin e targave të automjetit;
   5.6. sasinë e eksplozivëve;
   5.7. tabelën e të dhënave të sigurisë;
   5.8. informatat identifikuese të eksplozivëve apo fishekzjarrëve;
   5.9. datën dhe kohën e importit, eksportit dhe transitit;
   5.10. kohën dhe vendin e ndalesave të parashikuara;
   5.11. hyrjen dhe daljen në kalimin kufitar dhe rrugën e transportit. nëse është e aplikueshme;
   5.12. qëllimi i transferimit nëse është i aplikueshme.
6. Kërkesës nga paragrafi 5. i këtij neni duhet t'i bashkëngjiten dokumentet si në vijim:
   6.1. kopja e licencës për import, eksport, transit ose transferim;
   6.2. licencën e importit ose transitit të vendit në të cilin eksplozivët janë duke u eksportuar ose përmes së cilit është duke u bërë transiti i eksplozivëve;
   6.3. certifikatën e përdoruesit të fundit.
7. Do të kërkohet dëshmia e kushteve adekuate për transport në përputhje me normat ndërkombëtare.
8. Ministria përcakton masat e veçanta të sigurisë për import, eksport apo kalim transit nëpër territorin e Republikës së Kosovës.
9. Personat përgjegjës të personave juridik të cilët janë duke transportuar eksplozivët apo fishekzjarrët obligohen që licencën për import, eksport, transit apo transferim ta posedojnë me vete dhe duhet t'ia prezantojnë Policisë së Kosovës me kërkesën e tyre.
10. Eksporti i eksplozivëve mbikëqyret nga ministria në pajtim me ligjet relevante në fuqi.
11. Leja për eksport, import, transit ose transferim vlen në afatin kohor prej tridhjetë (30) ditësh, për negocimin dhe kontraktimin dhe mund të shfrytëzohet vetëm për një ditë dhe atë për ditën kur transportohet artikulli.
12. Në rast të rrezikimit të sigurisë publike dhe për të parandaluar posedimin dhe përdorimin ilegal të eksplozivëve, ministria mund të kufizoj ose të ndaloj importin eksportin transitin ose transferimin e eksplozivëve.
13. Ministria përkohësisht mund të kufizojë ose të ndalojë transferimin e eksplozivëve apo fishekzjarrëve në tërë territorin, ose në një pjesë të territorit të Kosovës, më qëllim të ruajtjes së sigurisë publike.

Neni 33
Licenca dhe leja për përdorimin e eksplozivëve ose fishekzjarrëve

1. Personat juridik mund të përdorin eksplozivë apo fishekzjarrë, nëse i është lëshuar licenca për përdorimin e eksplozivëve ose fishekzjarrëve nga ministria.
2. Licenca për përdorimin e eksplozivëve ose fishekzjarrëve është e vlefshme pesë (5) vjet nga data e lëshimit, duke qenë afat kohor i kufizuar dhe subjekt i kufizimeve të tjera me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së e shëndetit dhe jetës së njerëzve, pronës dhe mjedisit.
3. Kërkesës për licencë për përdorimin e eksplozivëve ose fishekzjarrëve duhet t'i bashkëngjiten dokumentet si në vijim:
   3.1. të dhënat për llojin e eksplozivëve ose fishekzjarrëve, të cilat janë planifikuar të përdoren;
   3.2. të dhënat për procesin dhe teknologjinë e përdorimit;
   3.3. certifikata e personave të autorizuar ose të kualifikuar.
4. Para përdorimit të një produkti, eksplozivi ose fishekzjarrëve, personi juridik i licencuar për prodhim, duhet të parashtroj kërkesë për leje për përdorimin e eksplozivëve, dhe leje të kategorisë 4 apo T2.
5. Kërkesës nga paragrafi 4. i këtij neni duhet t'i bashkëngjiten dokumentet si në vijim:
   5.1. kopjen e lejes për deponimin e sigurt;
   5.2. planin emergjent;
   5.3. planin e sigurisë së lokacionit;
6. Leja për përdorim të eksplozivëve është e vlefshme për një periudhë të kufizuar kohore (koha e nevojshme për procesin).
7. Leja për përdorimin e fishekzjarrëve të kategorisë 2 dhe 3 për një person fizik mund të lëshohet nga stacioni i policisë lokale sipas kërkesës.
8. Kërkesës nga paragrafi 7. i këtij neni i bashkëngjitet harta e lokacionit.
9. Policia lokale do të vendosë mbi kërkesën brenda tetë (8) ditëve.
10. Leja për përdorimin e fishekzjarrëve të kategorisë 4, T1 dhe T2, mund të lëshohet për personin juridik të licencuar nga ministria, sipas kërkesës.
11. Kërkesës nga paragrafi 10. i këtij neni i bashkëngjitet harta e lokacionit.
12. Ministria do të vendosë mbi kërkesën brenda tetë (8) ditëve.
13. Leja është e vlefshme për një ditë ose numrin e ditëve të miratuar nga ministria.
14. Ministria ka të drejtë me njoftim publik të ndalojë përdorimin dhe shitjen e fishekzjarrëve për kategoritë 2, 3 dhe 4, kur është e nevojshme gjatë periudhave të thatësirave klimatike dhe kur rreziku i zjarrit është në nivel shumë të lartë.

Neni 34
Leja për shitjen e eksplozivëve ose fishekzjarrëve

1. Në bazë të kërkesës leja për shitjen e eksplozivëve ose fishekzjarrëve lëshohet nga ministria:
   1.1. për shitjen e eksplozivëve për personat juridik, dhe në mes personave juridik vetëm në raste të veçanta;
   1.2. për shitjen e fishekzjarrëve për dyqanet me pakicë.

2. Kërkesës nga paragrafi 1. i këtij neni i bashkëngjiten dokumentet si në vijim:
   2.1. kopja e certifikatës së biznesit;
   2.2. certifikatën nga gjykata se ndaj personit juridik nuk është duke u zhvilluar proces gjyqësor apo është ndërprerë me vendim të formës së prerë nga gjykata kompetente;
   2.3. kopja e lejes për deponim;
   2.4. kopja e certifikatës e personit të kualifikuar sipas nenit 8 të këtij ligji;
   2.5. plani emergjent;
   2.6. plani i sigurisë së lokacionit.
3. Ministria do të vendosë brenda tridhjetë (30) ditëve në lidhje me lejet për shitje për eksplozivë apo për fishekzjarrë.
4. E drejta për ankesë aplikohet në përputhje me ligjin për procedurën administrative.
5. Leja për shitjen e eksplozivëve është e vlefshme për pesë (5) vjet.

Neni 35
Leja për deponim

1. Personi juridik duhet të deponojë eksplozivë ose fishekzjarrë vetëm nëse posedon leje për deponim dhe përmbush kushtet e kësaj leje.
2. Përjashtimet nga paragrafi 1. i këtij neni janë:
   2.1. barut i zi deri në pesë (5) kg, barut konvencional;
   2.2. fishekzjarrë të kategorisë 2 dhe 3 deri në një (1) kg.
3. Leja mund t'ju lëshohet personave juridik në bazë të kërkesës.
4. Kërkesës për leje nga paragrafi 3. i këtij neni i bashkëngjiten dokumentet si në vijim:
   4.1. kopja e lejes për tregti, prodhim ose përdorim të eksplozivëve ose fishekzjarrëve;
   4.2. plani i projektit sipas neneve 19, 20 dhe 21 të këtij ligji;
   4.3. ekstrakti nga plani i kadastrës së komunës lokale (1:25.000);
   4.4. skema e hollësishme në vendin e deponimit në 1:1000;
   4.5. lloji i propozuar i eksplozivëve KB Grupi i rrezikshmërisë dhe SNSH;
   4.6. vlerësimi i rrezikut.
5. Ministria do të vendosë brenda tridhjetë (30) ditëve në lidhje me kërkesën.
6. Leja për deponim është e vlefshme për pesë (5) vjet.

Neni 36
Leja për asgjësim

1. Asgjësimi duhet të jetë në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 24 dhe 27 të këtij ligji.
2. Leja për asgjësim nuk aplikohet për procedurat e zbatuara në vendin e licencuar të caktuar për shpërthim, ku asgjësohen eksplozivët që kanë mbetur të pa përdorur pasi që janë larguar nga depoja.
3. Leja për asgjësim mund t'i jepet personit juridik të licencuar për prodhim ose përdorim, ose personit juridik të lejuar për tregti në bazë të kërkesës.
4. Kërkesa nga paragrafi 3. i këtij neni duhet të përmbajë si në vijim:

4.1. kopjen e licencës apo lejes përkatëse;
4.2. vendin e asgjësimit;
4.3. procedurën e propozuar për asgjësim.
5. Ministria do të vendos brenda tridhjetë (30) ditësh në lidhje me kërkesën.
6. Leja për asgjësim është e vlefshme për një ditë ose për numrin e ditëve të miratuara nga ministria.

Neni 37
Leja e objekteve për prodhimin e eksplozivëve dhe fishekzjarrëve

1. Leja mund t'iu lëshohet personave juridik të cilët aplikojnë në bazë të kërkesës.
2. Kërkesa nga paragrafi 1. i këtij neni duhet të përmbajë si në vijim:
   2.1. kopjen e lejes, për prodhimin apo përdorimin e eksplozivëve apo fishekzjarrëve;
   2.2. planin e projektit sipas neneve 19, 20 dhe 21 të këtij ligji;
   2.3. ekstrakt nga plani i kadastrës së komunës lokale (1:25.000);
   2.4. skemën e hollësishme të vendit të deponimit në 1:1000;
   2.5. lloji i propozuar i eksplozivëve KB grup i rrezikshmërisë dhe SNSH;
   2.6. vlerësimin e rrezikut;
   2.7. vendosjen e sistemit të sigurisë elektrike sipas standardeve evropiane.
3. Ministria do të vendosë brenda tridhjetë (30) ditëve në lidhje me kërkesën.
4. Leja për deponim është e vlefshme për pesë (5) vjet.

KREU IX
NDRYSHIMI DHE REVOKIMI I LICENCËS DHE LEJES

Neni 38
Ndryshimi i licencave dhe lejeve

1. Ministria mund të ndryshojë licencën ose lejen:
   1.1. kur ndryshon distanca e ndarjes sipas nenit 21 të këtij ligji;
   1.2. kur ndryshimi është i nevojshëm për të ofruar sigurinë;
   1.3. kur ka ndryshime në të dhënat e personit juridik.
2. Licenca apo leja mund të ndryshohet nga ministria, pa pajtim të të licencuarit.
3. Poseduesi i licencës mund të aplikojë në ministri për ndryshim të licencës ose lejes në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh para se aplikuesi ta kërkoj ndryshimin e lejes apo licencës në mënyrë që të prodhoj efekte.
4. Ministria mund të ndryshojë licencën ose lejen vetëm nëse përcakton se ndryshimi është në interes të administrimit efektiv të këtij ligji,me ç'rast të licencuarin e njofton me shkrim në lidhje me vendimin dhe ndryshimin.
5. Nëse ministria vendos për mos ndryshimin e licencës ose lejes duhet menjëherë ta njoftoj me shkrim poseduesin e licencës në lidhje me:
   5.1. vendimin;
   5.2. arsyetimin për vendimin;
   5.3. të drejtën e mbajtësit për ankesë sipas Ligjit për Procedurën Administrative.

Neni 39
Revokimi i licencës dhe lejeve

1. Ministria do të revokojë licencën ose lejen e lëshuar nëse:
   1.1. ka pasur ndryshim në vend ose nëse vendi në të cilin eksplozivët prodhohen apo deponohen nuk është më i përshtatshëm për prodhimin ose deponimin e eksplozivëve apo fishekzjarrëve;
   1.2. Ministria, merr informata se poseduesit të licencës, të cilit i është lëshuar licenca ose leja, është person i pa aftë për atë lloj të lejes apo licencës;
   1.3. në marrëveshje me poseduesin e licencës ose personin përgjegjës;
   1.4. poseduesi i licencës nuk i përmbush më kriteret e përcaktuara me këtë ligj;
   1.5. nëse poseduesi i licencës nuk ushtron veprimtarinë e prodhimit të eksplozivëve brenda një (1) viti nga lëshimi i licencës për prodhimin e eksplozivëve, ose ndërpret veprimtarinë e tij për më shumë se dy (2) vjet.
2. Personit të cilit i është revokuar licenca do të sigurojë që të gjithë eksplozivët janë larguar nga vendi brenda njëzet (20) ditëve pas revokimit të licencës:
3. Licenca duhet t'i kthehet ministrisë në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga data që revokimi hyn në fuqi.
4. Të gjitha, evidenca të cilat janë mbajtur në bazë të dispozitave të këtij ligji, i dërgohen ministrisë nga të licencuarit, jo më vonë se tetë (8) ditë pasi që vendimi për revokim të bëhet i plotfuqishëm.
5. Në rast të revokimit të licencës konfiskimi behet sipas Kodit Penal, nëse personi juridik nuk bashkëpunon me organin kompetent.

KREU X
EVIDENCA DHE MBAJTJA E TË DHËNAVE

Neni 40
Mbajtja e të dhënave

1. Ministria duhet të mbaj regjistrin e të dhënave si në vijim:
   1.1. emrin dhe adresën e të licencuarit dhe personit përgjegjës;
   1.2. adresën e lokacionit ku prodhohen, deponohen, ose përdoren eksplozivët;
   1.3. llojin e rrezikut dhe sasinë maksimale të eksplozivëve apo fishekzjarrëve që mund të deponohen njëkohësisht;
   1.4. natyrën e poseduesit të licencës dhe qëllimin e përdorimit të eksplozivëve apo fishekzjarrëve;
   1.5. llojin e eksplozivëve dhe fishekzjarrëve të prodhuar ose të deponuar;
   1.6. planin në shkallë të lejuar për të treguar distancat ndarëse ose kushtet e licencës që duhet të mbahen rreth depove dhe objekteve ku prodhohen eksplozivët ose fishekzjarrët;
   1.7. hartën në shkallë të mjaftueshme që tregon lokacionin e depove;
   1.8. llojin e depove, përfshirë materialin nga i cili është ndërtuar.
2. Poseduesit e licencës për prodhim të eksplozivëve apo fishekzjarrëve obligohet që të njoftojnë ministrinë për çdo fillim ose ndërprerje të procesit të prodhimit, tregtisë apo përdorimit të eksplozivëve apo fishekzjarrëve.

3. Poseduesit e licencës obligohen që të njoftojnë ministrinë për çdo ndryshim në procesin e prodhimit, tregtisë apo përdorimit të eksplozivëve apo fishekzjarrëve.
4. Ministria me qëllim të posedimit të të dhënave, mban evidencat si në vijim:
   4.1. evidencën për licencat e lëshuara për prodhim, tregti, import, eksport, transit, transferim, deponim dhe përdorim;
   4.2. evidencën për licencat e revokuara për prodhim, tregti, import, eksport, transit, transferim, deponim dhe përdorim;
   4.3. evidencën për mostrat e marra të eksplozivëve;
   4.4. evidencën e eksplozivëve me udhëzuesit për përdorim, për të cilën është dhënë leja nga ministria;
   4.5. evidencën e lejeve të lëshuara.
5. Ministria me akt nënligjor përcakton mënyrën e mbajtjes së evidencës, formatin dhe përmbajtjen e të dhënave.

Neni 41
Të dhënat për prodhim, tregti, shitje dhe përdorim

1. Çdo posedues i licencës që kërkon posedimin ose mbajtjen e ndonjë eksplozivi ose fishekzjarri, do të vendosë dhe do të mirëmbajë të dhënat e përditësuar në vend të sigurt për njëzet (20) vite nga data e futjes së të dhënave të fundit.
2. Çdo posedues i licencës që është prodhues i eksplozivëve apo fishekzjarrëve, do të mbajë evidenca për llojin dhe sasinë e eksplozivëve apo fishekzjarrëve të prodhuar, të shitur dhe asgjësuar. Të dhënat duhet të ruhen së paku tridhjetë (30) vite.
3. Çdo posedues i licencës që është angazhuar në aktivitetin e tregtisë, importit, eksportit, transitit, transferimit dhe përdorimit të eksplozivëve apo fishekzjarrëve, duhet patjetër të mbajë evidencë për llojet dhe sasinë e eksplozivëve apo fishekzjarrëve të blerë, shitur asgjësuar dhe, të kthyer.
4. Mënyra e mbajtjes së evidencës, formati dhe përmbajtja e të dhënave, do të përcaktohen me akt nënligjor nga ministria.
5. Ministria mund të inspektojë dokumentin ose artikujt, dhe të bëj kopje, fotografi, ose të merr ekstrakte nga dokumenti ose artikulli, nëse është e nevojshme për hetimin.
6. Për çdo lloj të eksplozivit apo fishekzjarrëve, poseduesi i licencës duhet të mbajë:
   6.1. deklaratën e përshtatshmërisë;
   6.2. specifikat teknike;
   6.3. udhëzuesit për përdorim, deponim dhe asgjësim;
   6.4. shënjimin e klasës së produkteve eksplozive piroteknike;
   6.5. shenjën me të dhënat për siguri.

Neni 42
Raportimi i eksplozivëve të humbur

1. Çdo posedues i licencës që posedon, mban, mbush, zbraz ose transporton eksplozivë apo fishekzjarrë, do të sigurojë se humbja e çfarëdo eksplozivi apo fishekzjarrëve të raportohet menjëherë në ministri dhe Polici të Kosovës:
   1.1. datën dhe kohën kur është zbuluar humbja për herë të parë;

1.2. vendin ku është zbuluar;
1.3. përshkrimin e çdo lloji të eksplozivit apo fishekzjarrëve që është humbur;
1.4. për çdo lloj eksplozivi apo fishekzjarri të humbur, numrin e artikujve të humbur dhe peshën totale nominale.

KREU XI
INCIDENTE DHE AKSIDENTE

Neni 43
Raportimi i incidenteve

Poseduesit e licencës së eksplozivëve apo fishekzjarrëve, të cilët janë përfshirë në incident me eksplozivë apo fishekzjarrë, duhet menjëherë ta njoftojnë Ministrinë dhe Policinë e Kosovës, me njoftimin verbal të përcjellur me shkrim për incidentin dhe humbjen e jetës, lëndimet personale ose dëmtimet e pronës, të shkaktuara nga incidenti.

Neni 44
Hetimi i incidenteve me eksplozivë

1. Inspektori duhet të hetojë incidentin me eksplozivë apo fishekzjarrë në bashkëpunim me inspektorët e Policisë së Kosovës dhe KPMM-së, në rast të incidentit me eksplozivë në vendin e minimit.
2. Poseduesi i licencës duhet të siguroj se në vendin e incidentit nuk është ndërhyrë derisa të gjitha të dhënat rreth incidentit kanë qenë të regjistruara:
   2.1. duhet të fotografohet vendi;
   2.2. të merren matjet e mjaftueshme për të lejuar zhvillimin e një plani të saktë të vendit;
   2.3. lista e dëshmitarëve të cilët kanë qenë pjesë e incidentit.
3. Hetimi i aksidenteve dhe incidenteve me eksplozivë duhet të rregullohet me akt nënligjor nga ministria.

KREU XII
PROCEDURAT E VEÇANTA

Neni 45
Vlerësimi i rrezikut

1. Çdo person juridik që ka nën kontroll lokacionin me eksploziv apo fishekzjarr, duhet të bëj vlerësimin e rrezikut.
2. Ministria mund të lëshojë njoftim me shkrim duke kërkuar nga personat që janë në kontroll ose që punojnë në ato lokacione, që të ndërmarrin hapa të nevojshëm për të parandaluar, larguar ose zvogëluar rrezikun.
3. Njoftimi nga paragrafi 2. i këtij neni duhet të përmbaj si në vijim:
   3.1. situatën që inspektori vlerëson se shkakton rrezik;
   3.2. arsyet për krijimin e situatës.
4. Ministria do të përcaktoj me akt nënligjor mënyrën për vlerësimin e rrezikut.

Neni 46
Procedurat emergjente

1. Çdo operator i lokacionit duhet të përgatis planin emergjent në lokacion.
2. Plani emergjent, duhet të përditësohet çdo vit.
3. Plani emergjent duhet të testohet çdo vit;
4. Autoriteti lokal është përgjegjës për të siguruar pjesëmarrjen e shërbimeve emergjente gjatë testimit të përcaktuara në paragrafin 3. të këtij neni.

Neni 47
Mbrojtja e hapësirës ajrore

1. Ministria dhe KPMM-ja do të sigurojnë koordinim me organin kompetent për sigurinë e aviacionit për çdo rast të veçantë të përdorimit civil të eksplozivëve.
2. Procedurat e veçanta për ruajtjen e sigurisë së aviacionit do të përcaktohet me akt nënligjor nga ministria.

KREU XIII
DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 48
Gjobat

1. Personi juridik për kundërvajtje dënohet me gjobë në shumë prej njëmijë (1000) deri shtatëmijë (7000) Euro nëse:
   1.1. nuk e informon stacionin më të afërm të policisë rreth eksplozivëve të vjedhur ose të humbur, sipas paragrafit 8. të nenit 16 të këtij ligji;
   1.2. nuk i dërgon evidencat ministrisë në afatin e caktuar sipas paragrafi 3. të nenit 39 të këtij ligji;
   1.3. nuk informon ministrinë për fillimin ose ndërprerjen e prodhimit sipas paragrafit 2. nenit 40 të këtij ligji;
   1.4. nuk e tregon licencën me kërkesë të zyrtarit të policisë sipas paragrafit 8. të nenit 32 të këtij ligji;
   1.5. nuk mban evidenca sipas nenit 41 këtij ligji.
2. Personi juridik për kundërvajtje dënohet me gjobë në shumë prej pesëmijë (5000) deri pesëmbëdhjetëmijë (15000) Euro nëse:
   2.1. nxjerr eksplozivët në treg apo fillon të përdor eksplozivët para se ministria t'i ketë lëshuar lejen dhe udhëzuesin për përdorim dhe asgjësim sipas paragrafit 2. të nenit 13 të këtij ligji;
   2.2. prodhon eksplozivë apo fishekzjarrë pas skadimit të afatit të licencës në kundërshtim me paragrafin 2. të nenit 31 të këtij ligji;
   2.3. nuk posedon të dhënat e përcaktuara në paragrafin 6. të nenit 41 të këtij ligji;
   2.4. shet eksplozivë në kundërshtim me paragrafin 2. të nenit 14 të këtij ligji;
   2.5. transferon eksplozivë apo fishekzjarrë në kundërshtim me paragrafin 1. dhe 3. të nenit 32 të këtij ligji;

2.6. përdorimi i eksplozivëve në kundërshtim me paragrafin 4. nenin 24 të këtij ligji.

3. Personi juridik për kundërvajtje dënohet me gjobë në shumë prej dhjetëmijë (10000) deri tridhjetepesëmijë (35000) Euro nëse:
   3.1. nuk siguron mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve, pronës dhe mjedisit sipas paragrafit 1. dhe 2. të nenit 16 të këtij ligji;
   3.2. nuk garanton objekte të sigurta fizikisht dhe teknikisht për prodhim, tregtim dhe deponim të eksplozivëve sipas paragrafit 6. të nenit 16 të këtij ligji;
   3.3. nxjerr eksplozivë në treg ose fillon përdorimin e eksplozivëve në kundërshtim me paragrafin 1. të nenit 13 të këtij ligji;
   3.4. lejon përdorimin e eksplozivëve nga personeli i pakualifikuar në kundërshtim me nenin 9 të këtij ligji;
   3.5. prodhon eksplozivë apo fishekzjarrë në kundërshtim me nenin 31 paragrafin 1. dhe 3. të këtij ligji;
   3.6. prodhon eksplozivë apo fishekzjarrë në kundërshtim me paragrafin 2. të nenit 31 të këtij ligji;
   3.7. përdorë eksplozivët në kundërshtim me paragrafin 4. nenin 24 të këtij ligji;
   3.8. eksporton eksplozivët apo fishekzjarrët në kundërshtim me paragrafin 1., 3. dhe 4. neni 32 të këtij ligji;
   3.9. importon eksplozivët apo fishekzjarrët në kundërshtim me nenin 32 të këtij ligji;
   3.10. transferon eksplozivë apo fishekzjarrë në kundërshtim me kufizimet sipas paragrafit 11. të nenit 32 të këtij ligji;
   3.11. nuk siguron mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve sipas paragrafit 5. të nenit 24 të këtij ligji;
   3.12. nuk asgjëson eksplozivët e papërdorur sipas paragrafit 10. të nenit 24 të këtij ligji;
   3.13. asgjëson eksplozivët në kundërshtim me paragrafin 7. të nenit 24 të këtij ligji;
   3.14. asgjëson eksplozivë në kundërshtim me paragrafin 8. të nenit 24 të këtij ligji;
   3.15. deponon eksplozivët apo fishekzjarrët në kundërshtim me paragrafin 1. të nenit 35 të këtij ligji;
   3.16. lejon që eksplozivët të përdoren nga personel i pakualifikuar në kundërshtim me paragrafin 2. të nenit 9 të këtij ligji;
   3.17. nuk e informon ministrinë sipas paragrafit 3. neni 40 të këtij ligji.

4. Konfiskimi i eksplozivëve duhet të urdhërohet si një sanksion dytësor për kundërvajtje të vogla nga nën-paragrafët 2.4 të paragrafit 2. dhe nën-paragrafit 3.7 të paragrafit 3. të këtij neni.

Neni 49

1. Punëtorët e organeve të autorizuara dënohen për kundërvajtje me gjobë në shumën prej njëqind (100) deri pesëqind (500) Euro nëse:
   1.1. prodhon eksplozivë apo fishekzjarrë në kundërshtim me paragrafin 1. dhe 3. të nenit 31 të këtij ligji;

1.2. shet eksplozivë apo fishekzjarrë në kundërshtim me paragrafin 2. të nenit 14 të këtij ligji;
1.3. përdorimi i eksplozivëve në kundërshtim me paragrafin 4. nenin 24 të këtij ligji.

2. Zyrtari i policisë në pajtim me legjislacionin penal konfiskon përkohësisht produktet nga nën-paragrafi 1.3 i paragrafit 1. të këtij neni në vendin e ndodhjes së kundërvajtjes.
3. Konfiskimi i eksplozivëve mund të urdhërohet si sanksion dytësor për kundërvajtje nga ky nen.

Neni 50

Punëtori i organeve të autorizuara dënohet me gjobë në shumën prej njëqind (100) Euro në vendin e kryerjes së kundërvajtjes, nëse nuk e prezanton licencën me kërkesën e zyrtarit policor.

KREU XIV
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 51

1. Memorandumi i Mirëkuptimit mund të nënshkruhet që të fitohen njohuri profesionale në rastet kur nevojiten ekspertizat e veçanta.
2. Terminologjia specifike për eksplozivë për përdorim civil sipas standardeve të BE-së 13857 -1: 2003 përcaktohet me akt nënligjor nga ministria.

Neni 52

Të gjitha mjetet e realizuara në bazë të këtij ligji derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Neni 53
Mbikëqyrja

Mbikëqyrja për zbatimin e këtij ligji bëhet nga ministria, policia, doganat dhe organet tjera mbikëqyrëse dhe inspektuese, secila në pajtim me kompetencat e veta.

Neni 54
Licencat Ekzistuese

1. Licenca apo leja e lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji duhet të vazhdojë të jetë e vlefshme nëse:
   1.1. është e vlefshme;
   1.2. nuk ka skaduar apo ndryshe në mënyrë të vlefshme dhe ligjërisht është përfunduar në përputhje me termat dhe kushtet e saj.

2. Kërkesa për licencë apo leje e cila është parashtruar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, dhe për të njëjtën nuk ka përfunduar procedura e vendosjes, duhet të procedohet dhe t'i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji.
3. Licencat apo lejet sipas paragrafit 1. dhe 2. përcaktohen gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 55
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Përdorim Civil të Eksplozivëve nr. 03/L-005.

Neni 56
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi gjashtë (6) muaj pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-022
29 korrik 2011

Shpallur me dekretin Nr. DL-014-2011, datë 09.08.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 9 / 22 GUSHT 2011, PRISHTINË

LIGJI Nr. 04/L-012
PËR MBROJTJE NGA ZJARRI

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 709
Kreu II: Organizimi i mbrojtjes nga zjarri 710
Kreu III: Kategorizimi i objekteve 711
Kreu IV: Masat e mbrojtjes nga zjarri 713
Kreu V: Mbikëqyrja e zbatimit të masave për mbrojtje nga zjarri 717
Kreu VI: Trajnimi dhe aftësimi profesional 720
Kreu VII: Dispozitat ndëshkimore 721
Kreu VIII: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 723

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR MBROJTJE NGA ZJARRI

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i mekanizmave mbrojtës për parandalimin e shkaqeve dhe përhapjes së zjarrit, duke përfshirë edhe shpërthimet me qëllim të mbrojtjes së njerëzve, pasurisë dhe mjedisit.

Neni 2
Fushëveprimi

Fushëveprimi i këtij ligji është ndërmarrja e masave për mbrojtje nga zjarri, që zbatohen nga institucionet përkatëse shtetërore si dhe personat fizik dhe juridik.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **Ministria -** Ministria e Punëve të Brendshme (MPB);

1.2. **Agjencia -** Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME) është Agjenci ekzekutive në kuadër të MPB-së.
1.3. **Mbrojtja nga zjarri -** tërësi e masave dhe veprimeve të cilat ndërmerren në parandalimin e shkaktimit të zjarrit apo për zvogëlimin e pasojave nga zjarri;
1.4. **Inspektor -** inspektori për mbrojtje nga zjarri pranë AME-së i cili është i autorizuar për mbikëqyrjen e zbatimit të masave mbrojtëse nga zjarri;
1.5. **Prona -** prona e paluajtshme dhe e luajtshme e cila është në pronësi të personit fizik apo juridik siç është përcaktuar në nenin 10 të Ligjit nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore.
1.6. **Pronar** - personi fizik apo juridik, i cili ka në pronësi pronën;
1.7. **Shfrytëzues** - personi fizik apo juridik, i cili ka në shfrytëzim pronën në mënyrë të ligjshme;
1.8. 1.8**. Komisioni** - organi i themeluar me akt juridik i cili vendos për çështje të caktuara sipas legjislacionit në fuqi;
1.9. 1.9**. Kategorizimi -** klasifikim i objekteve dhe pjesëve të objekteve në bazë të shkallës së rrezikshmërisë nga zjarri;
1.10. **Plani shtetëror për mbrojtje nga zjarri** – përcaktimi i detyrave, zonave të veprimit si dhe fushat e përgjegjësisë dhe veprimtarisë për mbrojtje nga zjarri në nivel vendi;
1.11. **Plani komunal për mbrojtje nga zjarri** – përcaktimi i detyrave, zonave te veprimit si dhe fushat e përgjegjësisë dhe veprimtarisë për mbrojtje nga zjarri në nivel komunal;
1.12. **Vlerësimi i rrezikut** – përcaktimi i shkallës së rrezikut nga zjarri në një vend apo vendndodhje të veçantë, si dhe masat e duhura mbrojtëse;
1.13. **Objektet** - ndërtesat dhe pjesët e ndërtesave si pasuri e paluajtshme;
1.14. **Mjedisi** - rrethina natyrore, ajri, toka, uji, flora dhe fauna, në tërësinë e ndërveprimit dhe trashëgiminë kulturore si pjesë e rrethinës që e ka krijuar njeriu.
1.15. **Institucionet Shtetërore** – institucionet përkatëse kompetente, të nivelit qendror dhe komunal, për zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri.

KREU II
ORGANIZIMI I MBROJTJES NGA ZJARRI

Neni 4
Përgjegjësitë e Ministrisë

1. Ministria është përgjegjëse për:
1.1. analizimin e gjendjes për mbrojtje nga zjarri dhe ndërmerr masa për përmirësimin e saj;
1.2. hartimin e programit vjetor për mbrojtje nga zjarri të cilin e miraton Qeveria e Republikës së Kosovës;
1.3. hartimin e planit shtetëror për mbrojtje nga zjarri;
1.4. mbikëqyrjen e funksioneve ekzekutive të agjencisë dhe komunave në lëmin e mbrojtjes nga zjarri;

1.5. hartimin e programeve të trajnimit dhe ngritjes profesionale të kuadrove për mbrojtje nga zjarri.

Neni 5
Përgjegjësitë e komunave

1. Komuna është përgjegjëse për:
   1.1. nxjerrjen e planit për mbrojtje nga zjarri në nivel komunal ne bazë të vlerësimit të rrezikut nga zjarri ne pajtim me Planin shtetëror për mbrojtje nga zjarri;
   1.2. zbatimin dhe përmirësimin e masave për mbrojtje nga zjarri dhe avancimin e tyre.
   1.3. shqyrtimin e përmbajtjes së planit për mbrojtje nga zjarri së paku njëherë në vit dhe vlerësimin e përputhshmërisë të këtij plani me Planin komunal zhvillimor, Planin zhvillimor urban të komunës, dhe Planet rregulluese urbane, me ndryshimet ndërtimore të cilat mund të kenë ndodhur.

Neni 6
Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave

1. Agjencia për menaxhimin e emergjencave vepron si Agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe i përgjigjet Ministrit.
2. Agjencia udhëhiqet nga Kryeshefi i cili zgjidhet në pajtueshmëri me rregullat në fuqi për emërimin e nëpunësve të lartë civilë të shërbimit civil.
3. Agjencia për menaxhimin e emergjencave është përgjegjëse për mbikëqyrjen e të gjitha aktiviteteve të kryera sipas dispozitave të këtij ligji dhe ka kompetenca për nxjerrjen e udhëzuesve lidhur me të gjitha veprimtaritë për mbrojtje nga zjarri.
4. Qeveria me akt nënligjor të propozuar nga Ministria përcakton strukturën e organizimit të Agjencisë.

KREU III
KATEGORIZIMI I OBJEKTEVE

Neni 7
Kategorizimi i objekteve

1. Objektet dhe pjesët e objekteve radhiten në katër kategori sipas rrezikshmërisë nga zjarri:
   1.1. në Kategorinë e I (Parë) hynë objektet varësisht prej procesit teknik që zhvillohet në to;
   1.2. në Kategorinë e II (Dytë) hynë objektet sipas llojit të materialit që prodhohet përpunohet apo deponohet;
   1.3. në Kategorinë e III (Tretë) hynë objektet sipas llojit të përbërjes së materialeve në ndërtimtari; dhe
   1.4. në Kategorinë e IV (Katërt) hynë objektet sipas rëndësisë së tyre.
2. Ministria, me akt nënligjor përcakton kriteret për kategorizimin dhe klasifikimin e objekteve në kategoritë përkatëse të rrezikshmërisë nga zjarri.

Neni 8
Masat për mbrojtje nga zjarri sipas kategorive të objekteve

1. Pronarët apo shfrytëzuesit e objekteve, pjesëve të objekteve dhe mjedisit janë të obliguar të marrin masat për mbrojtje nga zjarri, të përcaktuara me këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë të këtij ligji si dhe në përputhje me planin e mbrojtjes nga zjarri.
2. Pronarët apo shfrytëzuesit e objekteve, pjesëve të objekteve dhe mjedisit janë të detyruar të ndërmarrin masat si në vijim:
   2.1. për kategorinë e I (parë) të rrezikshmërisë, janë të obliguar të hartojnë planin e mbrojtjes nga zjarri në bazë të vlerësimeve të rrezikshmërisë, si dhe të formojnë njësitë e mbrojtjes nga zjarri me kuadro të nevojshëm dhe mjetet e domosdoshme për punë për zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri;
   2.2. për kategorinë e II (dytë) të rrezikshmërisë nga zjarri, janë të obliguar të hartojnë planin e mbrojtjes nga zjarri në bazë të vlerësimeve të rrezikshmërisë nga zjarri, të kenë numër të mjaftueshëm të punëtorëve të cilët janë të trajnuar në këtë fushë dhe mund të kryejnë kujdestarinë e përhershme për fikjen e zjarrit dhe zbatimin e masave mbrojtëse nga zjarri;
   2.3. për kategorinë e III (tretë) të rrezikshmërisë nga zjarri, janë të obliguar të kenë së paku një punëtor i cili është i trajnuar dhe drejtpërdrejt organizon dhe përkujdeset për zbatimin e masave për mbrojte nga zjarri;
   2.4. për kategorinë e IV (katërt të rrezikshmërisë nga zjarri, janë të obliguar të kenë një punëtor të trajnuar dhe ngarkuar me punët e mbrojtjes nga zjarri.
3. Planin e mbrojtjes nga zjarri, janë të obliguar ta nxjerrin pronarët, përkatësisht shfrytëzuesit e objekteve, pjesëve të objekteve dhe mjedisit, të radhitura në kategorinë e parë dhe të dytë të rrezikshmërisë dhe ky plan duhet të jetë i harmonizuar me planin komunal për mbrojtje nga zjarri.
4. Personat juridik përgjegjës për punët e mbrojtjes nga zjarri, duhet të punësojnë personat të cilët kanë të kryer trajnimet profesionale për zjarrfikës apo drejtimit teknik, dhe të cilët e kanë të dhënë provimin profesional për kryerjen e punëve për mbrojtje nga zjarri.
5. Ministria me akt nënligjor cakton përmbajtjen e programit dhe mënyrën e dhënies së provimit profesional nga paragrafi 4. i këtij neni, i cili ka të bëjë me mbrojtjen nga zjarri.

Neni 9
Aktet e brendshme për mbrojtje nga zjarri

Personat fizik apo juridik që janë pronarë ose shfrytëzues të objekteve, pjesëve të objekteve dhe mjedisit, varësisht nga kushtet dhe nevojat e tyre obligohen që në harmoni me planin për mbrojtje nga zjarri dhe me këtë ligj, me anë të një rregulloreje të brendshme të përcaktojnë masat dhe veprimet në lidhje me zbatimin dhe avancimin e mbrojtjes nga zjarri.

KREU IV
MASAT E MBROJTJES NGA ZJARRI

Neni 10

Ministria merr pjesë në hartimin e planeve hapësinore nga fushë veprimtaria e mbrojtjes nga zjarri.

Neni 11
Kushtet e posaçme të ndërtimit me qëllim të mbrojtjes nga zjarri

1. Kushtet e posaçme të ndërtimit, në kuptim të përcaktimit të kushteve të rregullimit hapësinor, me qëllim të mbrojtjes nga zjarri, i përcakton Ministria-Agjencia.
2. Qeveria sipas propozimit të Ministrisë përcakton me akt nënligjor se për cilat lloje të objekteve zbatohen kushtet e posaçme të ndërtimit me qëllim të mbrojtjes nga zjarri si dhe mënyrën e bashkëpunimit të Ministrisë me Ministrinë për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor në lëmin e ndërtimit dhe dhënien e pëlqimit nga Agjencia për masat e mbrojtjes nga zjarri.

Neni 12
Masat e parapara për mbrojtje nga zjarri

1. Personat juridik të regjistruar për projektime, janë të obliguar që për objektet në të cilat kërkohen kushte të veçanta ndërtimi, masat e mbrojtjes nga zjarri të parashikuara në projektin kryesor, të tregohen në mënyrë grafike të përllogaritura dhe të shpjeguara me shkrim, me qëllim të vlerësimit të masave për mbrojtje nga zjarri.
2. Pjesë përbërëse e projektit kryesor nga paragrafi 1. i këtij neni, për dhënie të lejes ndërtimore, paraqet një dëshmi rreth masave të parapara të mbrojtjes nga zjarri.
3. Personat juridik të regjistruar për projektime, të cilët e kanë hartuar projektin kryesor, do të bëjnë verifikimin e të njëjtit në mënyrën e përcaktuar me rregulloren e tyre të brendshme, dhe pas verifikimit të kryer të bashkëngjisin deklaratën me të cilën vërteton se, masat për mbrojtje nga zjarri të aplikuara në projektet kryesore janë në harmoni me këtë ligj dhe kriteret e rregullimit hapësinor, kriteret dhe normativat teknike.
4. Me rastin e projektimit dhe ndërtimit të objekteve të banimit kolektiv, objekteve publike, qendrave tregtare, hoteleve, kinemave, teatrove, bibliotekave, postave, spitaleve, hallave sportive, pallateve koncertale si dhe objekteve tjera publike, duhet të sigurohen kushtet për evakuim të papengueshëm të njerëzve në rast të shpërthimit të zjarrit me ndërtimin e shkallëve për evakuim si dhe me pajisje përkatëse për alarm dhe fikje të zjarrit.
5. Personat juridik të regjistruar për projektime sipas paragrafi 1. të këtij neni, duhet të kenë personat e punësuar me trajnime përkatëse profesionale dhe me provim të mbaruar profesional nga lëmi i mbrojtjes nga zjarri.

Neni 13
Kushti për dhënien e lejes për ndërtim

Organi kompetent për dhënien e lejes për ndërtim, rekonstruim mund të jep lejen për ndërtim vetëm atëherë kur të sigurojë se projekti kryesor për ndërtim në bazë të cilit jepet leja e ndërtimit, ka paraparë përmbushjen e kushteve të posaçme të ndërtimit, me qëllim të mbrojtjes nga zjarri, siç është përcaktuar në nenin 11 të këtij ligji.

Neni 14
Leja e përdorimit

1. Leja e përdorimit të objektit apo objekteve të ndërtuara dhe rekonstruktuara, jepet atëherë kur vërtetohet se janë zbatuar masat e mbrojtjes nga zjarri të parapara në projektin kryesor të ndërtimit.
2. Përfaqësuesi i agjencisë merr pjesë në punën e komisionit për pranim teknik të objekteve sa i përket fushës për mbrojtje nga zjarri.
3. Nëse gjatë kryerjes së kontrollimit teknik, vërtetohet se me rastin e ndërtimit apo rekonstruktimin e objektit, nuk janë zbatuar masat për mbrojtje nga zjarri të parapara në projektin kryesor të ndërtimit, nuk do të jepet leja e përdorimit derisa të jenë zbatuar masat për mbrojtje nga zjarri.

Neni 15
Materiali rezistues ndaj zjarrit

1. Punët përfundimtare të sipërfaqeve vertikale dhe horizontale të daljeve dhe rrugëve dalëse në objekte, duhet të jenë të ndërtuara nga materiali me karakteristika rezistuese ndaj zjarrit.
2. Për materialet e përdorura për ndërtim në punët nga paragrafi 1. të këtij neni, kryesi i punimeve është i obliguar të siguroj dëshminë për karakteristikat e materialit rezistues ndaj zjarrit, të përdoruara nga prodhuesi gjatë ndërtimit si dhe të njëjtat t'i ofroj për verifikim komisionit, nga neni 14 i këtij ligji.

Neni 16
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe mjeteve

1. Pronarët e objekteve, pjesëve të objekteve dhe mjedisit, janë të obliguar të mirëmbajnë në gjendje të rregullt pajisjet, instalimet, ventilimet e gazrave, oxhaqet si dhe pajisjet e tjera, të cilat paraqesin rrezik për zgjerimin e zjarrit në harmoni me normativat teknike dhe udhëzimet e prodhuesve për të cilat duhet të ketë dokumentacion.
2. Për instalimin e pajisjeve stabile të destinuara për lajmërimin dhe fikjen e zjarrit, detektimin e gazrave dhe avujve të ndezshëm, si dhe pajimet tjera mbrojtëse dhe instalimeve të cilat shërbejnë për evitimin e shkaktimit dhe zgjerimin e zjarrit dhe shpërthimit, kryesi i punëve është i detyruar të siguroj dëshminë nga prodhuesi për funksionim të rregullt të tyre, dhe procesverbalin mbi verifikimet e kryera nga personi juridik i autorizuar, dhe t'i jepet në shikim komisionit nga paragrafi 2. i nenit 14 të këtij ligji.

3. Pronarët dhe shfrytëzuesit e objekteve, pjesëve të objekteve dhe mjedisit, obligimet e përcaktuara si në paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni i rregullojnë me marrëveshje përmes kontratës, në pajtim me ligjet në fuqi.
4. Në qoftë se nuk mund të vërtetohet pronari nga paragrafi 1. i këtij neni, obligimet e përcaktuara i bien në barrë shfrytëzuesit.

Neni 17
Dëshmia për gjendjen e rregullt të pajisjeve

1. Mirëmbajtja e pajisjeve sipas paragrafit 2. të nenit 16 të këtij ligji, duhet të kontrollohet të paktën një (1) herë në vit nga personat e autorizuar, sipas paragrafit 6. të këtij neni, në varshmëri me normativat teknike dhe udhëzimet e prodhuesve. Me rastin e kontrollimit mbahet procesverbal në të cilën shënohet se kur është bërë kontrollimi, kush e ka kryer dhe çfarë është vërtetuar nga kontrolli.
2. Aparatet bartëse dhe lëvizëse për shuarjen e zjarreve duhet të kontrollohen çdo gjashtë (6) muaj.
3. Punë kryesit e organizatës së autorizuar nga paragrafi 2. të nenit 16 dhe paragrafit 1. të këtij neni, të cilët kryejnë kontrollimin, duhet të kenë të dhënë provimin profesional për ushtrimin e kontrollit.
4. Ministria përcakton kushte të posaçme teknike dhe kushte të tjera, të cilat duhet t'i plotësojë personi i autorizuar nga paragrafi 2. i nenit 16 dhe paragrafi 1. i këtij neni.
5. Ministria përcakton programin dhe mënyrën e dhënies së provimit, nga paragrafi 3. i këtij neni.
6. Ministria jep autorizimin për kryerje të punëve nga paragrafi 2. i nenit 16 dhe paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 18
Certifikata nga prodhuesi i pajisjeve

1. Prodhimi dhe qarkullimi i pajisjeve, stabilimenteve dhe mjeteve të dedikuara për fikje të zjarrit, lajmërim dhe pengim të zgjerimit të zjarrit si dhe pajisjeve të tjera mbrojtëse e instalimeve, përcaktohet me akt nënligjor.
2. Për prodhimtarinë, veprimet dhe shërbimet me të cilat shfrytëzohen stabilimentet, mjetet, pajisjet dhe instalimet nga paragrafi 1. i këtij neni, për të cilat nuk janë të parapara normativat kosovare, mund të aplikohen standardet e BE-së.
3. Pajisjet, mjetet dhe stabilimentet nga paragrafi 1. i këtij neni, të cilat importohen nga jashtë, mund të vihen në qarkullim vetëm nëse importuesi e ka marrë certifikatën e personit juridik, të autorizuar mbi rregullsinë e atyre pajisjeve, mjeteve dhe stabilimenteve, si dhe përshtatjen e tyre për qëllimet e dedikuara.
4. Për çdo pajisje të importuar dhe për çdo sasi të importuar të pjesëve të pajisjeve apo mjeteve për fikje të zjarrit, alarmim dhe pengim të përhapjes së zjarrit, importuesi është i obliguar që ta siguroj certifikatën e paraparë në paragrafin 3. të këtij neni, vetëm nëse kjo është e rregulluar ndryshe me marrëveshje ndërshtetërore.
5. Kur me dispozita të posaçme është caktuar që për vënien në qarkullim të pajisjeve

dhe stabilimenteve nga paragrafi 1. deri 4. të këtij neni nevojitet leja atëherë lejen e tillë e jep Ministria – Agjencia.
6. Dispozitat nga paragrafi 2., 3., 4. dhe 5. të këtij neni, vlejnë edhe për pajisjet mbrojtëse dhe personale të zjarrfikësve, të cilat i shfrytëzojnë në fikjen e zjarrit dhe intervenimet e tjera.
7. Ministria përcakton kushtet e posaçme teknike dhe kushtet tjera të cilat duhet t'i plotësoj personi juridik nga paragrafi 3. dhe 4. të këtij neni.
8. Ministria jep autorizime për kryerjen e punëve nga paragrafi 3. dhe 4. i këtij neni.

Neni 19
Pajisjet, mjetet dhe stabilimentet për fikjen e zjarrit

1. Pronarët apo shfrytëzuesit e objekteve, pjesëve të objekteve dhe mjedisit, obligohen të posedojnë pajisjet, mjetet dhe stabilimentet për fikjen e zjarrit.
2. Llojin e pajisjeve, stabilimenteve dhe mjeteve nga paragrafi 1. i këtij neni, si dhe vendet në të cilat vendosen, përcaktohen me akt nënligjore.
3. Ministria nxjerr akt nënligjor lidhur me zgjedhjen dhe caktimin e sasisë së aparateve për fikje të zjarrit, kushteve të cilat duhet t'i plotësojnë personat e autorizuar, të cilët e kryejnë veprimtarinë kontrolluese, servisimin dhe mirëmbajtjen e aparateve, si dhe afatin e zbatimit të kontrollit të rregullimit dhe servisimit.
4. Pajisjet dhe mjetet për fikje të zjarrit duhet të shfrytëzohen vetëm sipas dedikimit, dhe të jenë në gjendje të rregullt, posaçërisht të shënuar dhe të kapshme për përdorim.
5. Kontrollimin e rregullsisë dhe servisimit të aparateve nga paragrafi 3. i këtij neni, mund ta ushtrojnë personat e autorizuar, të cilët janë teknikisht dhe profesionalisht të aftësuara, në bazë të autorizimeve të Ministrisë- Agjencisë.
6. Personat të cilët e kryejnë mbikëqyrjen e rregullsisë dhe servisimit të aparateve nga paragrafi 3. i këtij neni, duhet ta kenë të dhënë provimin profesional për kryerjen e këtyre punëve.
7. Programi dhe mënyra e dhënies së provimit nga paragrafi 6. i këtij neni përcaktohet nga ministria.
8. Regjistri i personave të autorizuar, të cilët i kryejnë punët nga paragrafi 2. i nenit 16, paragrafi 1. i nenit 17 dhe paragrafi 3. i nenit 18 të këtij ligji, do të jetë publik.
9. Me punë të caktuara lidhur me avancimin e mbrojtjes nga zjarri mund të merren personat fizik dhe juridik, të cilët i plotësojnë kriteret në pikëpamje të përgatitjeve teknike dhe të disponojnë me kuadro profesionale për ushtrimin kualitativ të punëve, lidhur me avancimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit.

Neni 20
Kujdestaria e zjarrfikësve

1. Me qëllim të pengimit dhe mënjanimit të rrezikut nga zjarri, obligohet të sigurohet kujdestaria e zjarrfikësve, gjegjësisht shërbimi vëzhgues alarmues, si dhe pajisje dhe mjete përkatëse për fikje të zjarrit për rastet si në vijim:
   1.1. në objektet gjatë mbajtjes së tubimeve publike apo aktiviteteve tjera;

1.2. në ambiente të hapura në kohën kur vlerësohet apo supozohet rreziku për paraqitje të zjarrit në mjedise të tilla, kryerja e korrje shirjeve të përmasave të mëdha, kantieret e mëdha, parqet nacionale, pyjet dhe të ngjashme.

2. Kujdestarinë e zjarrfikësve, respektivisht shërbimin vëzhgues-alarmues në rastet nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1. i këtij neni obligohet ta siguroj organizatori, kurse për rastet nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2. i këtij neni, pronari apo shfrytëzuesi nëse nuk mund të vërtetohet pronari i objekteve të përmendura.

Neni 21
Kujdestaria zjarrfikëse në komuna

Në komunat ku nuk është e organizuar kujdestaria zjarrfikëse, respektivisht shërbimi vëzhgues-alarmues sipas nenit 19 i këtij ligji, nëse ekziston mundësia e shfaqjes së zjarrit të përmasave të mëdha, organet komunale, në bazë të vlerësimit të rrezikshmërisë nga zjarri, janë të detyruar të organizojnë kujdestari të tillë.

Neni 22
Proceset teknologjike në objekte të veçanta

1. Proceset teknologjike në të cilat shfrytëzohen apo prodhohen fluidet, gazrat e ndezshme apo materiet shpërthyese, mund të kryhen vetëm në objektet ose pjesët e tyre, të cilat janë të ndara nga pjesët e tjera prodhuese dhe depozituese, objekte të pajisura me pengesa rezistuese ndaj zjarrit që pamundësojnë përhapjen e zjarrit.
2. Proceset teknologjike nga paragrafi 1. të këtij neni, si dhe punët me flakë të hapur në afërsi të fluideve dhe gazrave të ndezshme, materieve shpërthyese dhe të tjera, të cilat mund të shkaktojnë zjarr, duhet të organizohen në atë mënyrë që rreziku nga zjarri të mënjanohet, respektivisht të bie në masën më të vogël, varësisht nga natyra dhe kushtet e punës.
3. Objektet sipas paragrafi 1. të këtij neni, mund të ndërtohen vetëm në vendet ku ndërtimi i tyre nuk cenon sigurinë nga zjarri të objekteve ekzistuese dhe mjedisit që e rrethon.

KREU V
MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË MASAVE PËR MBROJTJE NGA ZJARRI

Neni 23
Organet kompetente

1. Mbikëqyrjen dhe inspektimin për zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri në objekte, pjesë të objekteve, pajisjeve, stabilimenteve në territorin e Republikës së Kosovës e kryejnë inspektorët e Agjencisë për mbrojtje nga zjarri.
2. Mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri, e kryejnë inspektorët kompetent të agjencisë në bashkëpunim me inspektorët tjerë të institucioneve përkatëse si dhe me personat juridik.
3. Me vendimin e organit kompetent të komunës dhe me pëlqimin paraprak të marrë nga ministria, për punë të caktuara të kontrollit të masave të parapara për mbrojtje

nga zjarri, mund të autorizohen njësitë e zjarrfikës dhe shpëtimit dhe shoqatat vullnetare për zjarr-fikje, të përcaktuara me këtë ligj dhe akt nënligjor të nxjerra në bazë të këtij ligji.

4. Me vendimin nga paragrafi 3. të këtij neni, përcaktohen:
   4.1. lloji i objekteve, pjesëve të objekteve dhe mjedisit të cilat do të përfshihen në kontrollim;
   4.2. mënyra dhe procedura e kryerjes së punëve kontrolluese;
   4.3. mënyra e informimit të organit kompetent për emergjenca mbi mangësitë e konstatuara gjatë kontrollimit;
   4.4. kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë personat për ushtrimin e kontrollit nga aspekti i përgatitjes profesionale.
5. Ministria, me akt nënligjor, përcakton formën e kartelave identifikuese, me të cilat vërtetohet identiteti i personave të autorizuar për kryerjen e punëve të inspektimit.

Neni 24
Kualifikimet për inspektorë të Agjencisë

1. Punët e inspektorit të agjencisë i kryejnë personat të cilët posedojnë përgatitje superiore ose të lartë shkollore, të profilit teknik dhe provimin e dhënë profesional.
2. Për punën e tyre, inspektorët i përgjigjen strukturës përkatëse të agjencisë.
3. Ministria, me akt nënligjor përcakton programin dhe mënyrën e dhënies së provimit profesional në harmoni me paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni.

Neni 25
Të drejtat dhe detyrat e inspektorit

1. Gjatë mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët kontrollojnë të gjitha objektet, stabilimentet, impiantet dhe ndërmarrin masa tjera të nevojshme për vërtetimin dhe zbatimin e masave të përcaktuara për mbrojtje nga zjarri.
2. Gjatë mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët kanë të drejtë të hyjnë në objekte banimi sipas kërkesës së banorëve me qëllim të mënjanimi të rrezikut për jetën e njerëzve dhe pasurisë.
3. Pronarët, respektivisht shfrytëzuesit e objekteve, janë të obliguar që inspektorëve t'ju mundësojnë mbikëqyrjen inspektuese, t'ju ofrojnë dokumentacionin dhe të dhëna të nevojshme.

Neni 26
Mbajtja e procesverbalit nga inspektorët

1. Për kontrollin e kryer, inspektori për mbrojtje nga zjarri është i obliguar të përpilojë procesverbalin.
2. Një kopje e procesverbalit i dorëzohet pronarit, respektivisht shfrytëzuesit të objektit, pjesës së objektit ku është kryer inspektimi.
3. Gjatë kontrollit, inspektori është i obliguar të ruaj konfidencialitetin e të dhënave në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Ligjin për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë.

Neni 27
Njoftimi

Nëse gjatë mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët e mbrojtjes nga zjarri të agjencisë, konstatojnë se gjatë ndërtimit të objekteve nuk janë zbatuar masat e mbrojtjes nga zjarri të parapara me projektin kryesor, atëherë e informon organin kompetent për urbanizëm i cili e ka dhënë lejen për ndërtim për ndërmarrjen e masave ligjore.

Neni 28

1. Nëse gjatë mbikëqyrjes inspektuese, inspektori i mbrojtjes nga zjarri i agjencisë konstaton se nuk janë përmbushur kushtet nga neni 17 i këtij ligji, me vendim ndalohet përdorimi i tyre.
2. Ankesa kundër vendimit nga paragrafit 1. të këtij neni, nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.

Neni 29
Detyrimet e pronarëve dhe shfrytëzuesve

1. Me qëllim të evitimit të shfaqjes së zjarrit, shpëtimit të njerëzve, pasurisë së rrezikuar nga zjarri, ministria me vendim i obligon pronarët, shfrytëzuesit e objekteve apo pjesëve të objektit, që të ndërmarrin masa të caktuara të mbrojtjes nga zjarri, të përcaktuara me këtë ligj rregullave teknike, planeve për mbrojtje nga zjarri të:
   1.1. mbajnë në gjendje të rregullt stabilimentet, instalimet apo pajisjet;
   1.2. rindërtojnë objektin apo pjesët e caktuara të objektit;
   1.3. largojnë mbeturinat nga objektet, të cilat kanë mbetur në procesin e punës apo janë të vendosura në vendet e ndaluara me ligjet përkatëse;
   1.4. largojnë lëndët nga objektet apo mjedisi, të cilat paraqesin rrezik për shkaktimin dhe përhapjen e zjarrit;
   1.5. mirëmbajnë të gjitha rrugët pyjore në gjendje që të mundësojnë afrimin e automjeteve zjarrfikëse në çdo kohë;
   1.6. vendosin instalime stabile, gjysmë stabile, të lëvizshme, pajisje të tjera përkatëse dhe instalime për alarmim dhe fikje të zjarrit, si dhe pajisje dhe instalime të tjera mbrojtëse;
   1.7. të ketë dalje të nevojshme nga objektet apo pjesët e objekteve për mundësimin e daljes së shpejtë të personave në rast zjarri;
   1.8. të pamundësojnë afrimin e automjeteve, të cilat gjatë punës mund të hedhin shkëndija në vendet ku do të paraqesin rrezik nga zjarri;
   1.9. të mbajnë në gjendje të rregullt pajisjen zjarrfikëse dhe mjetet tjera për fikje të zjarrit, apo ato pajisje dhe mjete t'i vënë në vend të caktuar dhe të dukshëm;
   1.10. të largojnë ato elemente nga stabilimentet, instalimet dhe pajisjet, të cilat gjatë punës mund të shkaktojnë zjarr;
   1.11. të largojnë materiet e ndezshme, të cilat u janë shtuar elementeve konstruktive të objekteve apo të cilave u janë përpunuar hapësirat dalëse

horizontale e vertikale të rrugëve, nëse ato elemente paraqesin rrezik për shkaktim dhe përhapje të shpejtë të zjarrit;

1.12. të pamundësojnë hedhjen nga jashtë të sendeve, të cilat do të mund të shkaktojnë zjarr në objekte në të cilat afrimi është i kufizuar;

1.13. të furnizojnë sasinë dhe llojin e caktuar të pajisjes teknike dhe mjeteve për alarmim dhe fikje të zjarrit;

1.14. të sigurojnë kujdestari zjarrfikëse në objekte dhe pjesët e objekteve.

2. Për shkak të rrezikshmërisë së drejtpërdrejt nga zjarri Agjencia me vendim ndalon:

2.1. magazinimin e lëndëve sekondare, repromaterialit, produkteve finale dhe materieve tjera;

2.2. përdorimin e flakës së hapur në objektet e mbyllura dhe të hapura;

2.3. përdorimin e objekteve, apo pjesëve të objekteve, stabilimenteve, instalimeve dhe pajisjeve tjera nëse me adaptimin e tyre nuk mund të hiqen mangësitë që mund të shkaktojnë zjarr;

2.4. përdorimin e pajisjeve, instalimeve dhe mjeteve derisa nuk merren masat që rreziku të evitohet;

2.5. kryerjen e punëve të caktuara në objekte apo pjesë të objekteve, ngjyrosje, rrjedhje të fluideve të ndezshme dhe gazrave dhe ndezje të ngjyrave.

3. Ankesa kundër vendimit nga paragrafi 2. i këtij neni nuk e ndalon ekzekutimin e tij.

Neni 30
Mbajtja e evidencës

1. Agjencia mban evidencë nga lëmi i mbrojtjes nga zjarri për tërë territorin e Kosovës.
2. Ministria me akt nënligjor përcakton përbërjen e evidencave nga paragrafi 1. të këtij neni, si dhe mënyrën e mbajtjes së tyre nga agjencia dhe komuna.

Neni 31
Bashkëpunimi me institucionet përkatëse shkencore

Ministria-Agjencia me qëllim të zbatimit dhe avancimit të masave për mbrojtjen nga zjarri të përcaktuara me këtë ligj dhe akte nënligjore, bashkëpunon me institucionet përkatëse shkencore dhe hulumtuese si dhe bën ekzaminimin dhe analizat tjera laboratorike.

KREU VI
TRAJNIMI DHE AFTËSIMI PROFESIONAL

Neni 32

1. Trajnimi dhe aftësimi profesional i zjarrfikësve do të bëhet nga njësia përkatëse e MPB-se për trajnime si dhe institucionet tjera arsimore të cilat janë te licencuara dhe akredituara nga Ministria përkatëse për arsim, shkencë dhe teknologji.
2. Ministria përcakton kushtet teknike te cilat duhet ti plotësoj institucioni i cili bën trajnimin dhe ngritjen profesionale te zjarr-fikjes dhe shpëtimit.

Neni 33
Financimi

1. Mjetet për financimin e aktiviteteve dhe zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes nga zjarri, sipas këtij ligji sigurohen nga buxheti i Republikës së Kosovës.
2. Mjetet për zbatimin e masave të mbrojtjes nga zjarri, të përcaktuara me planin e mbrojtjes nga zjarri të komunave sigurohen nga buxhetet komunale.

KREU VII
DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 34
Gjobat

1. Me gjobë prej pesëqind (500) deri tremijë (3000) Euro për kundërvajtje do të dënohen personat juridik nëse:
   1.1. nuk posedojnë leje për projektin kryesor dhe i cili nuk është në harmoni me kushtet e rregullimit hapësinor sipas nenit 14 të këtij ligji;
   1.2. kryen punët në kundërshtim me dispozitat e neneve 16, 17 dhe 18 të këtij ligji;
   1.3. nuk posedon dëshmi lidhur me rregullimin e pajisjeve, instalimeve të cilat shërbejnë për fikje dhe lajmërim të zjarrit dhe pajisje dhe instalime të tjera, të cilat bien ndesh me paragrafin 2. të nenit 16 dhe paragrafin 1. të nenit 17, si dhe certifikatën sipas paragrafit 3. të nenit 18 të këtij ligji;
   1.4. kryen punët në kontrollimin dhe servisimin e aparateve të mbrojtjes nga zjarri në kundërshtim me paragrafin 5. të nenit 19 të këtij ligji;
   1.5. nëse trajnimin dhe aftësimin profesional të zjarrfikësve e kryen në kundërshtim me paragrafin 1. të nenit 32 të këtij ligji.
2. Për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni, personi përgjegjës i personit juridik do të dënohet me gjobë në të holla, në shumën prej treqind (300) deri pesëqind (500) Euro.

Neni 35

1. Me gjobë prej pesëqind (500) deri njëmijë (1.000) Euro do të dënohet për kundërvajtje personi juridik nëse:
   1.1. nuk sjell rregulloren me të cilën përcaktohen masat dhe punët lidhur me rregullimin dhe përparimin e mbrojtjes nga zjarri, apo nuk zbaton masat në përparimin e mbrojtjes nga zjarri të parapara me rregulloren për mbrojtjen nga zjarri, sipas nenit 9 të këtij ligji;
   1.2. kryesi i punimeve për përpunimin e sipërfaqeve të daljeve horizontale dhe vertikale dhe rrugëve dalëse në objekte, përdor material ndërtimor i cili nuk i justifikon karakteristikat rezistuese ndaj zjarrit sipas paragrafit 1. të nenit 15 të këtij ligji;
   1.3. nuk mirëmban në gjendje të rregullt stabilimentet, pajisjet elektrike, të gazit, ventilimin dhe instalime të tjera, oxhaqet dhe pajisje të tjera dhe nëse për mirëmbajtje nuk posedon dokumentacion sipas paragrafit 1. të nenit 16 të këtij ligji;

1.4. nuk kontrollohen instalimet së paku një herë në vit nga personi juridik i autorizuar ose për kontrollet e bëra nuk mbahet evidencë sipas paragrafit 1. të nenit 17 të këtij ligji;
1.5. i vë në qarkullim pajisjet, stabilimentet që përdoren për fikje, lajmërim dhe pengim të përhapjes së zjarrit, për të cilin nuk është siguruar certifikata e personit juridik të autorizuar për gjendjen e tyre të rregullt sipas paragrafit 3. të nenit 18 të këtij ligji;
1.6. pa leje vihen në qarkullim stabilimentet, pajisjet dhe mjetet, të cilat nevojiten për fikje të zjarrit dhe lajmërim për të cilat nevojitet leja sipas paragrafit 5. neni 18 të këtij ligji;
1.7. nuk posedon stabilimentet, pajisjet dhe mjetet për fikje të zjarrit si pas nenit 19 të këtij ligji;
1.8. nuk sigurohet kujdestaria zjarrfikëse në formën e shërbimit për lajmërim me anë të vrojtimit me mjetet dhe pajisjet përgjegjëse për shuarje të zjarrit sipas nenit 20 të këtij ligji;
1.9. nuk i mundëson inspektorit për mbrojtje nga zjarri, kryerjen e punës së tij apo nëse refuzon të jap në shikim dokumentacionin me shkrim apo t'u ndihmoj në të dhënat e tjera të nevojshme informuese sipas paragrafit 3. të nenit 25 të këtij ligji;
1.10. nuk zbaton masat e dhëna nga inspektorët për parandalim nga zjarri sipas nenit 27 të këtij ligji;
1.11. nuk zbatohet vendimi i nxjerr nga ministria, sipas nenit 28 të këtij ligji;

2. Për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni do të dënohen me gjobë prej njëqind (100) deri treqind (300) Euro edhe personat përgjegjës të personave juridik.

Neni 36

1. Me gjobë prej njëqind (100) deri treqind (300) Euro do të dënohen për kundërvajtje personat nëse:
1.1. si pronar, apo shfrytëzues i objekteve, pjesëve të objekteve apo mjedisit, nuk mban në gjendje të rregullt pajisjet, stabilimentet elektrike, gazrat, ventilimet dhe instalimet tjera, oxhaqet dhe pajisje të tjera, të cilat mund të shkaktojnë zjarr dhe nëse për mirëmbajtje nuk posedon dokumentacion sipas paragrafit 1. të nenit 16 të këtij ligji;
1.2. nuk u mundëson inspektorëve për mbrojtje nga zjarri kryerjen e punëve të tyre dhe dhënien e shënimeve të domosdoshme sipas paragrafit 3. të nenit 25 të këtij ligji;
1.3. nuk zbaton vendimet e inspektorit të agjencisë, sipas nenit 28 të këtij ligji;
1.4. nuk zbaton vendimin e ministrisë sipas paragrafit 1. të nenit 29 të këtij ligji.

Neni 37

1. Për kundërvajtjen nga neni 35 të këtij ligji, inspektimi i kryer për të dytën herë, përveç gjobës në të holla shqiptohet edhe masa e ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë në afat prej gjashtë (6) muajsh.
2. Për kundërvajtjen nga neni 35 të këtij ligji, inspektimi i kryer për të tretën herë, përveç gjobës në të holla shqiptohet masa e ndalimit për pezullim të aktivitetit.

KREU VIII
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 38

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ministria në afat brenda një (1) viti nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji.
2. Ministria në bashkëpunim me ministritë tjera përgjegjëse në kuadër të kompetencave të përcaktuara me ligj, nxjerr akte nënligjore lidhur me kushtet e sigurisë dhe mbrojtjes nga zjarri.

Neni 39

1. Komunat janë të obliguara të harmonizojnë planin e mbrojtjes nga zjarri, të përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji, në afatin prej gjashtë (6) muajsh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Personat juridik dhe shërbimet profesionale, janë të obliguara të harmonizojnë rregulloret për mbrojtje nga zjarri të përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji në afatin kohor prej gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi.
3. Personat e autorizuar sipas paragrafit 2. i nenit 16, paragrafët 1. dhe 2. të nenit 17 dhe paragrafit 5. të nenit 19 të këtij ligji, janë të obliguara që në afat prej gjashtë (6) muajsh, nga dita e nxjerrjes së akteve nënligjore, të cilat rregullojnë kushtet për kryerjen e punëve të inspektimit, të harmonizojnë veprimtarinë e tyre me dispozitat e këtyre akteve.
4. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për objektet, pjesët e objekteve dhe mjedisin me interes të veçantë në rast se nuk janë të rregulluara me ligj përkatës në fushën e mbrojtjes nga zjarri.

Neni 40
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 02/L-41.

Neni 41
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-012
21 korrik 2011

Shpallur me dekretin Nr. DL-009-2011, datë 03.08.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 7 / 10 GUSHT 2011, PRISHTINË

LIGJI Nr. 04/L-027
PËR MBROJTJE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 724
Kreu II: Të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve 731
Kreu III: Përgjegjësitë 737
Kreu IV: Programimi dhe planifikimi 739
Kreu V: Monitorimi, njoftimi dhe paralajmërimi 741
Kreu VI: Masat mbrojtëse 745
Kreu VII: Mbrojtja personale dhe reciproke 748
Kreu VIII: Strukturat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë 749
Kreu IX: Administrimi 758
Kreu X: Mbikëqyrja 760
Kreu XI: Puna profesionale, shëndeti dhe siguria në punë 760
Kreu XII: Arsimimi dhe trajnimi 765
Kreu XIII: Financimi 767
Kreu XIV: Dispozitat ndëshkimore 768
Kreu XV: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 771

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Miraton

LIGJ PËR MBROJTJE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky Ligj ka për qëllim mbrojtjen dhe shpëtimin e njerëzve, kafshëve, pronave, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Neni 2
Fushëveprimi

1. Fushëveprimi i këtij ligji është menaxhimi i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, zvogëlimi i numrit të fatkeqësive, parandalimi si dhe zvogëlimi i numrit të viktimave dhe pasojave tjera nga fatkeqësitë e tilla.

2. Shteti është përgjegjës për organizimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera si sistem unik dhe integral shtetëror.
3. Sistemi i mbrojtjes nga paragrafi 2. i këtij neni përmban programimin, planifikimin, organizimin, menaxhimin, zbatimin, mbikëqyrjen, koordinimin dhe financimin e masave dhe aktiviteteve për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **Ministria** –Ministria e Punëve të Brendshme(MPB);
   1.2. **Agjencia** - Agjencia e Menaxhimit Emergjent (AME) si agjenci ekzekutive e themeluar me ligj në kuadër të MPB-së;
   1.3. **Strukturat për Mbrojtje Shpëtim dhe Ndihmë (SMSHN)**- personat fizik dhe juridik te cilët me resurset e tyre njerëzore dhe materiale në dispozicion, të destinuara për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera;
   1.4. **Fatkeqësi –** një ngjarje apo pjesë të ngjarjes të shkaktuar nga forcat madhore të natyrës apo forcat tjera te pakontrolluara, të cilat rrezikojnë jetën e njerëzve, kafshëve dhe pronave, shkaktojnë dëme në trashëgiminë kulturore dhe mjedis, në përmasat e atilla që kërkojnë ndërmarrjen e masave dhe dislokimin e forcave dhe resurseve të veçanta;
   1.5. **Fatkeqësi natyrore –** janë: tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, ortek, erë e fuqishme, breshër, borë me shi, acar, thatësi, zjarr fushor, shpërthim i sëmundjeve infektive që ndikojnë në njerëz, kafshë ose bimë dhe fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga forcat natyrore;
   1.6. **Fatkeqësi tjera –** janë: aksidentet që përfshijnë trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, zjarret, fatkeqësitë në miniera, shkatërrimet e pendave, aksidentet nukleare dhe aksidentet tjera ekologjike dhe industriale të shkaktuara nga aktivitetet dhe veprimet e njeriut, lufta dhe gjendja emergjente, përdorimi i armëve dhe mjeteve të shkatërrimit në masë, sulmet terroriste me mjete klasike dhe forma tjera të dhunës në masë;
   1.7. **Krizë -** gjendjen e sigurisë në hapësirën regjionale e më gjerë e cila nuk mund të kontrollohet me resurse dhe masa të zakonshme në të cilën janë të kërcënuara vlerat themelore të Republikës së Kosovës për shkaqe ekonomike, sociale, ushtarake dhe shkaqe tjera të cilat mund të kalojnë përtej kufijve dhe paraqesin kërcënim të pashmangshëm tek vendet tjera përkatëse;
   1.8. **Aksident ekologjik -** një aksident mjedisor, sipas përcaktimit në dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit, të shkaktuar nga një ngjarje e papritur apo e pakontrolluar për shkak të ndërhyrjes në mjedis, e cila për pasoj mund të kërcënoj jetën dhe shëndetin e njerëzve apo cilësinë e mjedisit;
   1.9. **Aksident industrial -** një ngjarje e cila ka dal jashtë kontrollit gjatë kryerjes së aktiviteteve apo veprimit me makineri dhe materie të rrezikshme ose të dëmshme, ku një ngjarje e tillë rezulton në kërcënimin e jetës apo shëndetin e njerëzve, kafshëve, pronave, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit;

1.10. **Materie e rrezikshme -** çdo materie në gjendje të ngurtë, të gaztë apo të lëngët, e cila me rrjedhje të pakontrolluar në mjedis paraqet rrezik të pashmangshëm për jetën apo shëndetin e njerëzve dhe kafshëve apo shkakton çrregullim apo dëmtim të pronave dhe ndikon dëmshëm në mjedis;

1.11. **Rrezik -** mundësia e dëmtimit apo kërcënimit të jetës apo shëndetit të njerëzve dhe kafshëve dhe mundësia e shkaktimit të çrregullimeve dhe dëmeve ndaj pronave, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit;

1.12. **Kërcënim -** ekspozimi real dhe i atëçastshëm i njerëzve, kafshëve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit ndaj rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

1.13. **Shkalla e kërcënimit -** shkalla e pritur të dëmeve dhe pasojave tjera nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

1.14. **Dëmi i shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera -** dëmi i drejtpërdrejt dhe kostoja e intervenimeve dhe masave të ndërmarra për zvogëlimin e pasojave dëmtuese të fatkeqësive;

1.15. **Masë parandaluese -** çdo masë të ndërmarr për parandalimin e ndodhjes së fatkeqësisë ose për lehtësimin e pasojave të dëmshme të saj;

1.16. **Mjedisi** - rrethina natyrore, ajrin, tokën, ujin, florën dhe faunën, në tërësinë e ndërveprimit dhe trashëgiminë kulturore si pjesë e rrethinës që e ka krijuar njeriu;

1.17. **Trashëgimia kulturore -** ndërtesat dhe pjesët e ndërtesave, anekset, ngastrat e tokës, vendbanimet, vegjetacionin dhe format tjera natyrore të krijuara nga njeriu, objektet kulturore dhe historike objektet e palëvizshme të trashëgimisë kulturore, objektet lëvizëse dhe koleksionet e gjësendeve me vlera kulturore për shtetin objekte të lëvizshme të trashëgimisë kulturore;

1.18. **Mobilizim -** procedurat dhe aktivitetet për alarmimit te Strukturave për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe forcave tjera të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës me qëllim të qenit të gatshëm për kryerjen e detyrave në gjendje lufte apo në raste tjera emergjente.

1.19. **Aktivizim -** procedurat dhe aktivitetet për ngritje dhe dislokim të organizuar të mekanizmave te shërbimeve Emergjente dhe Strukturave për Mbrojtje dhe Shpëtim, resurseve në operacionet e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;

1.20. **Paralajmërim -** procedurat dhe aktivitetet për njoftimin e popullatës, komunitetit lokal, autoriteteve kombëtare, ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera, duke përdorur sinjale zanore nëse ekziston rreziku nga fatkeqësia natyrore apo fatkeqësia tjetër si dhe aktivizimin e njësive, shërbimeve dhe strukturave operative të caktuara për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;

1.21. **Reagimi Emergjent** – aktivitetet te cilat adresojnë efektet e shpejta dhe te drejtpërdrejta te një incidenti, duke i përfshirë veprimet e menjëhershme për ruajtjen e jetës, te mirave materiale dhe mjedisit, plotësimin e nevojave elementare njerëzore si dhe mirëmbajtjen e strukturës sociale, ekonomike dhe politike te komunitetit te goditur.

1.22. **Resurset për mbrojtje - shpëtim dhe ndihmë -** të gjitha burimet njerëzore, teknike, materiale dhe financiare, duke përfshirë mjetet dhe pajisjet për mbrojtje dhe shpëtim, objektet e strehimit dhe mjetet tjera të mbrojtjes,

mjetet dhe pajisjet për trajnim, depot, mjetet e transportit, mjetet për komunikim dhe njoftim, të destinuara për tu përdor apo të përdorura në mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;

1.23. **Mjetet dhe pajisjet për mbrojtje dhe shpëtim -** mjetet për mbrojtje personale dhe kolektive, pajisjet, automjetet dhe mjetet tjera teknike të nevojshme për ekspertë, njësi të shpëtimit, shërbimet dhe resurset në operacionet e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.

1.24. A**rtikujt e ndihmës -** ushqimin, ujin e pijshëm, veshmbathjen, medikamentet pajisjet strehuese dhe të tjera të destinuara për shpërndarje pa pagesë tek popullata e rrezikuar apo e goditur si ndihmë për lehtësimin e pasojave të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësive tjera;

1.25. **Vlerësimi i rrezikut -** analizat cilësore dhe sasiore të rrethanave natyrore dhe të tjera të lidhura me ndodhitë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, përfshirë vlerësimin e drejtimit të mundshëm të zhvillimit dhe pasojave të mundshme nga fatkeqësia, nivelin e propozuar të mbrojtjes nga rreziqet përkatëse dhe propozimin për masat parandaluese dhe të tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;

1.26. **Plani i reagimit emergjent -** plani për mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmë në rast të fatkeqësisë së caktuar të hartuar në bazë të vlerësimit të rreziqeve dhe të gjeturave të ekspertëve;

1.27. **Personi përgjegjës për shkaktimin e fatkeqësisë -** çdo person fizik apo juridik i cili e shkakton fatkeqësinë me veprim apo mos veprim;

1.28. **Personi i panjohur përgjegjës për shkaktimin e fatkeqësisë -** çdo person fizik apo juridik i cili e shkakton fatkeqësinë identiteti i të cilit është i panjohur për organet përgjegjëse në kohën kur zhvillohen operacionet e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;

1.29. **Mbrojtja -** masat organizative, teknike dhe të tjera, përdorimin e mjeteve teknike dhe të tjera për mbrojtje të menjëhershme personale dhe kolektive të njerëzve, kafshëve, pronave, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit kundër pasojave të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.

1.30. **Shpëtimi -** masat dhe procedurat për shpëtimin e njerëzve, kafshëve, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga pasojat e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera;

1.31. **Ndihma -** masat dhe shërbimet e specialistëve, njësive dhe shërbimeve të shpëtimit, përdorimin e pajisjeve dhe mjeteve për ndihmë.

1.32. **Ndihma e parë -** trajtimin fillestar të personave të lënduar dhe sëmurë, jeta dhe shëndeti i të cilëve është në rrezik nga pasojat e fatkeqësisë natyrore apo fatkeqësisë tjetër të ndodhur në fushë dhe jashtë institucioneve shëndetësore në kuadër të operacioneve të shpëtimit;

1.33. **Kushtet elementare për jetë -** në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, nënkupton kujdesin mjekësor emergjent për njerëzit dhe kafshët, strehimin, ujin e pijshëm, ushqimin, medikamentet dhe nevojat tjera për jetën dhe shëndetin e popullatës së goditur;

1.34. **Zonë -** sipërfaqe e integruar gjeografike, urbane apo tjetër e cila përfshinë dy apo më shumë komuna të cilat për qëllime të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera që përfaqësojnë një tërësi;

1.35. **Strehimore -** një objekt apo pjesën e një objekti i cili është i ndërtuar dhe pajisur me mjete të ajrosjes dhe me pajisjet tjera esenciale të banimit, të cilat ofrojnë akomodim dhe mbrojtje nga fatkeqësitë natyre dhe fatkeqësitë e tjera;
1.36. **Qytetari –** shtetasi i Republikës së Kosovës apo i huaji për qëllime të këtij ligji.

Neni 4
Detyrat themelore të sistemit të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera

1. Detyrat themelore të sistemit të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera janë:
   1.1. zbulimi, monitorimi dhe hulumtimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
   1.2. parandalimi i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
   1.3. njoftimi, paralajmërimi dhe alarmimi për rrezikun e pashmangshëm dhe dhënia e udhëzimeve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;
   1.4. trajnimi dhe aftësimi profesional për detyrat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;
   1.5. organizimi i gatishmërisë emergjente, krijimi dhe mirëmbajtja e formave tjera të gatishmërisë për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;
   1.6. vetëmbrojtja, vetë ndihma dhe ndihma reciproke;
   1.7. mobilizimi dhe aktivizimi i mekanizmave për mbrojtje dhe shpëtim dhe Strukturave për mbrojtje dhe shpëtim, resurseve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;
   1.8. përcaktimi dhe zbatimi i masave mbrojtëse;
   1.9. shpëtimi dhe ndihma;
   1.10. rimëkëmbja nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera deri te sigurimi i kushteve elementare për jetë;
   1.11. vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
   1.12. bashkëpunimi ndërkombëtar lidhur me zbatimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
   1.13. mbikëqyrja e zbatimit të rregullave për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
   1.14. dhënia e ndihmës për vendet tjera në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Neni 5
Mbrojtja dhe Shpëtimi

1. Mbrojtja dhe shpëtimi organizohen si element integral i Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Emergjencave.
2. Mbrojtja, shpëtimi dhe aktivitetet tjera të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera janë të natyrës humanitare dhe jo ushtarake.

Neni 6
Njoftimi për rrezikun

Çdo person është i obliguar që ta njoftoj qendrën më të afërt emergjente ose policinë për çdo rrezik nga fatkeqësitë natyrore apo fatkeqësitë tjera sa më shpjet që e vëren apo kupton për të.

Neni 7
Subjektet për ofrimin e mbrojtjes

1. Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera sigurohet nga:
   1.1. qytetaret të cilët jetojnë në Republikën e Kosovës;
   1.2. personat e organizuar vullnetarisht në klube, shoqata profesionale dhe organizata tjera joqeveritare të përfshira në aktivitetet e lidhura me mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
   1.3. shërbimet e shpëtimit;
   1.4. ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera;
   1.5. organet e qeverisjes lokale; dhe
   1.6. shteti, brenda autoritetit ose të drejtat dhe përgjegjësitë e tij përkatëse.

Neni 8
Zbatimi i mbrojtjes dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera zbatohet si nënsistem unik i sistemit kombëtar të sigurisë dhe ndërlidhet me nënsistemet tjera të sigurisë në nivel lokal, rajonal dhe qendrorë.
2. Shteti zbaton mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, duke luajtur një rol aktiv në mekanizmat ndërkombëtar të bazuar në traktatet ndërkombëtare, në veçanti nëpërmjet njoftimit reciprok të rreziqeve dhe pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe ndihmave reciproke në rastet e fatkeqësive të tilla.
3. Shteti përkrah bashkëpunimin me autoritetet ndërkombëtare ne fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, duke nënshkruar marrëveshjet ndërkombëtare, posaçërisht me vendet fqinje, duke njoftuar vendet tjera për rreziqet dhe pasojat e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera dhe duke ofruar ndihmë në rastet e fatkeqësive të tilla

Neni 9
Pajtueshmëria me të drejtën ndërkombëtare

Çdo formë e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera duhet të bazohet dhe zbatohet në pajtueshmëri me parimet e së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe së drejtës ndërkombëtare për mbrojtje të njerëzve, kafshëve, trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit nga efektet dëmtuese dhe të obligimeve të pranuara ndërkombëtare.

Neni 10
Parimi i së drejtës për mbrojtje

1. Çdo person ka të drejtë në mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
2. Në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera mbrojtja dhe shpëtimi i jetës së njerëzve ka prioritet mbi çdo aktivitet tjetër të mbrojtjes dhe shpëtimit.

Neni 11
Parimi i ndihmës

Në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, çdo person është i obliguar të ofroj ndihmë sipas aftësive psiko-fizike.

Neni 12
Parimi i informimit

1. Informimi për rreziqet dhe aktivitetet e organeve qendrore, lokale dhe të tjerëve, përgjegjëse për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, duhet të jenë publike.
2. Organet qendrore dhe lokale detyrohen që ta njoftojnë popullatën e një zone të caktuar e cila ka rrezik të goditet nga fatkeqësia natyrore apo fatkeqësia tjetër.

Neni 13
Parimi i parandalimit

Në fushën e mbrojtjes kundër fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, organet qendrore, lokale dhe subjektet e tjera brenda kompetencave të tyre, përparësi duhet t'i japin organizimit dhe zbatimit të masave të parandalimit.

Neni 14
Parimi i përgjegjësisë

Çdo person fizik dhe juridik është përgjegjës për zbatimin e masave për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Neni 15
Parimi "hap pas hapi" i dislokimit të forcave dhe resurseve

1. Kur në një fatkeqësi natyrore apo fatkeqësi tjetër kërkohet mbrojtja, shpëtimi dhe ndihma, nivelet lokale fillimisht do t'i dislokojnë njësitë dhe resurset e tyre vetanake.
2. Kur shkalla e fatkeqësisë apo rrezikut tejkalon kapacitetet e njësive të shërbimeve emergjente dhe resurseve aktuale të nivelit lokal apo kur ato nuk mund të sigurohen nga niveli lokal fqinjë, ato i siguron shteti nga regjionet tjera.
3. Nëse forcat dhe resurset në dispozicion janë të pamjaftueshme për tu përball me operacionet e domosdoshme të shpëtimit dhe ndihmës, atëherë, mund të kërkohet dislokimi i Forcës se Sigurisë së Kosovës dhe resurset e tyre për mbrojtje.

KREU II
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QYTETARËVE

Neni 16
Përgjegjësitë e qytetarëve

1. Me qëllim të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera qytetarët janë të obliguar që:
   1.1. të marrin pjesë në strukturat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.
   1.2. të ofrojnë mjete materiale.
   1.3. të jenë të trajnuar dhe përgatitur për mbrojtje personale dhe reciproke dhe për zbatimin e masave të nevojshme të parandalimit.

Neni 17
Ndihma në situatat e kërcënimit të jetës

1. Çdo person është i obliguar që ta ndihmoj personin tjetër, jeta apo shëndeti i të cilit është në rrezik, gjithmonë duke mos e rrezikuar jetën dhe shëndetin e tij.
2. Nëse një person nuk është në gjendje ta ofroj ndihmën e nevojshme, ai pa vonesë duhet ta informoj shërbimin përkatës të shpëtimit apo qendrën operative emergjente apo në çfarëdo mënyre tjetër, në mënyrë që ndihma e tillë të sigurohet.

Neni 18
Pjesëmarrja në Strukturat për Mbrojtje dhe Shpëtim

Çdo qytetar i Republikës së Kosovës është i obliguar të marr pjesë në strukturat për mbrojtje dhe shpëtim përveç nëse është i caktuar për angazhim në detyra ushtarake apo profesionale.

Neni 19
Pjesëmarrja vullnetare

1. Pjesëmarrja vullnetare ne strukturat për mbrojtje dhe shpëtim është e hapur për:
   1.1. meshkuj dhe femra, mbi moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeçare;
   1.2. prindër të vetëm me fëmijë mbi moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeçare;
   1.3. meshkuj dhe femra, të cilëve u ka pushuar obligimi nga neni 18 i këtij ligji.
2. Çdo person i cili merr pjesë vullnetarisht në strukturat për mbrojtje dhe shpëtim ka të njëjtat të drejta dhe obligime të cilat i kanë pjesëtarët e rregullt.

Neni 20
Angazhimi në detyrë

1. Shtetasi angazhohet në strukturat për mbrojtje dhe shpëtim nga një organ përkatës përgjegjës për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
2. Shtetasi i angazhuar në strukturat për mbrojtje dhe shpëtim, i lëshohet karta identifikuese e pjesëtarit për kohëzgjatjen e angazhimit.

3. Pjesëtarëve në strukturat për mbrojtje dhe shpëtim dhe shtetasve të cilëve u është dhënë statusi i përkohshëm i pjesëtarit të kësaj strukture, identifikohet duke bartur shenjen, uniformën dhe kartelat e identifikuese të strukturës për mbrojtje dhe shpëtim te angazhuar nga shteti në momente të caktuara.
4. Qytetarët që marrin pjesë vullnetarisht dhe jo profesionalisht në operacionet e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në njësitë, shërbimet dhe strukturat tjera operative të shoqatave dhe organizatave joqeveritare, kanë të njëjtat të drejta dhe obligime si pjesëtarë te rregullt të strukturave për mbrojtje dhe shpëtim në gjendjet emergjente dhe të luftës dhe duhet ta identifikojnë veten me një kartë identifikuese të pjesëtarit të organizatës.
5. Kartelat dhe shenjat e identifikimit të pjesëtarit të strukturës për mbrojtje dhe shpëtim do të përdoren edhe nga nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit gjatë zbatimit të operacioneve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.
6. Ministria me akt nënligjor përcakton formën dhe përmbajtjen e kartelës së identifikimit për prestarët e strukturës për mbrojtje dhe shpëtim.

Neni 21
Kushtet e angazhimit

1. Çdo shtetas i aftë për punë mund të angazhohet në mbrojtje dhe shpëtim sipas këtij ligji. Kushtet për aftësitë psiko-fizike për angazhim në mbrojtje dhe shpëtim duhet te vendosen vetëm për detyrat e posaçme dhe të rrezikshme.
2. Në struktura për mbrojtje dhe shpëtim nuk mund të angazhohen personat si në vijim:
   2.1. shtetasit gjendja psiko-fizike e të cilëve nuk përputhet me kushtet e operacioneve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;
   2.2. gratë shtatzëna, nënat dhe prindërit e vetëm me fëmijë nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeçare.
3. Ministria me akt nënligjor përcakton detyrat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës që konsiderohen të rrezikshmërisë së posaçme për të cilat kërkohet vendosja e një kushti të posaçëm psiko-fizik dhe shëndetësor.

Neni 22
Të drejtat e vullnetarëve

1. Personat të cilët janë të përfshirë vullnetarisht dhe jo profesionalisht, në operacione të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës dhe janë të organizuar në njësi, shërbime dhe struktura tjera operative brenda shoqatave dhe organizata tjera jo qeveritare - njësi të zjarrfikjes, organizmat e Kryqit të Kuq, shërbimet e shpëtimit në male, klubet e zhytësve, organizatat e zbuluesve, klubet radio amatore dhe organizatat tjera, bazuar në planet e reagimit emergjent nuk duhet të caktohen në detyra mbrojtëse apo operacione të strukturave për mbrojtje dhe shpëtim, duke marr parasysh që kushtet e përcaktuara dhe kërkesat për aftësi specifike si dhe shërbimet që ata ofrojnë brenda strukturave të tilla nuk mund të ofrohen nga pjesëtar të tjerë.
2. Personat nga paragrafi 1. i këtij neni, kanë të njëjtat të drejta dhe obligime sikurse ato të pjesëtarit të organizatave vullnetare.

3. Në gjendje lufte, njësitë, shërbimet dhe strukturat tjera operative të përmendura në paragrafin 1. të këtij neni, së bashku me strukturat për mbrojtje dhe shpëtim do të angazhohen në operacione të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.

Neni 23
Obligimet për trajnime

Te gjithë pjesëtaret të cilët angazhohen në detyrat për mbrojtje dhe shpëtim paraprakisht duhet te trajnohen dhe aftësohen për ato detyra sipas legjislacionit ne fuqi.

Neni 24
Thirrja

1. Pjesëtaret e strukturave për mbrojtje dhe shpëtim mund të thirren nga organi përkatës për:
   1.1. intervistë për sistemim;
   1.2. trajnime themelore dhe të avancuara;
   1.3. ushtrime dhe forma tjera të trajnimeve praktike;
   1.4. zbatimin e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës si dhe ato të rimëkëmbjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Neni 25
Obligimet materiale

1. Çdo qytetar duhet t'i përmbush obligimet e tija materiale duke i dhënë në përdorim strukturave përkatëse të menaxhimit emergjent në nivele lokale dhe qendrore automjetet, makinat dhe mjetet e tjera, objektet, pajisjet, burimet energjetike, të nevojshme për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera
2. Obligimi material mund t'u ngarkohet edhe personave juridik, përveç për mjetet dhe pajisjet e caktuara për qëllime të mbrojtjes apo sigurisë të destinuara për mbrojtje shëndetësore apo mbrojtjes shpëtimit dhe ndihmës sipas këtij ligji.
3. Obligimet materiale për nevoja të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera rregullohet me Akte nënligjor nga Qeveria.

Neni 26
Obligimi për paraqitje

1. Çdo person, subjekt i pjesëmarrjes në detyrat për mbrojtje dhe shpëtim apo i obligimeve materiale me rastin e thirrjes nga organi përgjegjës është i obliguar të paraqitet apo dorëzoj mjetet materiale në kohën dhe vendin e caktuar.
2. Nëse personi nuk i përgjigjet thirrjes dhe nuk e arsyeton mosardhjen, organi përgjegjës lëshon urdhër për sjellje të detyruar të tij.

Neni 27
Kompensimi

1. Pjesëtarëve të strukturave për mbrojtje dhe shpëtim, gjatë kryerjes së detyrave në këto struktura, gjatë aftësimit dhe realizimit të obligimeve materiale, në bazë të thirrjes së organit kompetent, i takon kompensimi, gjegjësisht fitimi i humbur për kohën e mungesës në punë, për shkak të kryerjes së detyrave të lartshënuara, në vlerë dhe në kushte si i përcakton Qeveria e Republikës së Kosovës.
2. Të njëjtat të drejta për kompensim, i gëzojnë edhe vullnetarët që kryejnë detyra të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në njësi, shërbime dhe struktura tjera operative të shoqatave dhe organizatave jo qeveritare.
3. Nëse kryerja e detyrave ose obligimeve në strukturat për mbrojtje dhe shpëtim zgjatë më shumë se katër (4) orë, pjesëtari ka të drejtë në ushqim pa pagesë, në ngarkesë të subjektit që e ka ftuar.
4. Punëdhënësi nuk ka të drejt në shkarkimin, ndërrimin e vendit të punës apo dëmtimin e pjesëtarit të strukturës për mbrojtje dhe shpëtim, gjegjësisht qytetarit, i cili në përputhje me këtë ligj merr pjesë në zbatimin e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, për shkak të pjesëmarrjes së tij në kryerjen e këtyre detyrave.

Neni 28
Mbrojtja gjatë zbatimit të detyrave

1. Lëndimi ose sëmundja, e cila ndodh gjatë kryerjes së detyrave, gjatë trajnimeve apo gjatë përmbushjes së obligimeve materiale në strukturat për mbrojtje dhe shpëtim, trajtohet lëndim në punë ose sëmundje profesionale dhe qytetari gëzon të drejtat e tija sipas legjislacionit në fuqi.
2. Një lëndim të cilin e pëson shtetasi gjatë rrugës nga shtëpia apo nga puna për tek vendi i takimit, apo në kthim mbrapa duke e përdorur të njëjtën marshut sipas paragrafit 1. të këtij neni.
3. Vendi dhe koha e lëndimit do të përcaktohet nga organi që e ka lëshuar urdhrin për thirrje apo nga përgjegjësi i strukturave për mbrojtje dhe shpëtim, apo nga udhëheqësi i intervenimit.
4. Familja e ngushtë e pjesëtarit, që ka humbur jetën gjatë kryerjes së detyrës, apo obligimeve të tjera në strukturat për mbrojtje dhe shpëtim, ka të drejtë për pension dhe të drejtën e shpenzimeve, transportit dhe varrimit, në përputhje me rregullat për sigurim pensional, invalidor dhe sigurimin shëndetësor.

Neni 29
E drejta në ndihmë të njëhershme

1. Shtetasi gjatë realizimit të detyrave ose të obligimeve të tjera në strukturat për mbrojtje dhe shpëtim lëndohet apo sëmuret pa faj të vet, ashtu që organizmi i tij pëson invaliditet së paku 20%, sipas rregullave për invalid, ka të drejtë për ndihmë të njëhershme me para.
2. Për ndihmë të njëhershme me para, nga par 1. i këtij neni, kanë të drejtë edhe

anëtarët e familjes së ngushtë të pjesëtarit, që e ka humbur jetën gjatë kryerjes së detyrës, përmbushjes së obligimeve të tjera në strukturat për mbrojtje dhe shpëtim.

3. Kushtet për përfitimin e ndihmës nga paragrafi 1. dhe 2. të këtij neni si dhe vlera përkatëse përcaktohet nga Qeveria me Akt nënligjor dhe nuk mund të jetë më e ulët se dymbëdhjetë (12) paga mesatare mujore të nëpunësit civil në gjashtë (6) muajt e fundit.

Neni 30
Dëmshpërblimi

1. Qytetari, i cili ka pësuar dëme gjatë kryerjes së detyrave dhe obligimeve tjera në operacionet e mbrojtjes dhe shpëtimit ka të drejtë kompensimi sipas këtij ligji.
2. Qytetarët dhe personat juridik, që janë të ngarkuar me obligime materiale, kanë të drejtë në kompensimin për përdorimin e mjeteve që i kanë dhënë për nevoja të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, si dhe në kompensim dëmi, nëse ato janë dëmtuar ose shkatërruar.
3. Llojet e mjeteve materiale për të cilat organi përkatës mund të përcaktoj obligim material, vlerën e kompensimit për përdorimin e tyre dhe procedurat për vlerësimin dhe shpagimin e dëmeve të pësuara do t'i përcaktoj Qeveria me akt nënligjor.

Neni 31
Detyrimet ndaj dëmeve

1. Organet kompetente janë përgjegjëse për kompensimin e dëmeve të shkaktuara ndaj personave të tretë, me qëllim apo nga pakujdesia, gjatë kryerjes së aktiviteteve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, gjatë trajnimeve dhe detyrave tjera zyrtare, të cilat lidhen me mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
2. Çdo qytetar, i cili gjatë kryerjes së detyrave shkakton dëm me dashje apo nga pakujdesia, nga paragrafi 1. i këtij neni, përgjigjet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 32
Grumbullimi dhe mbrojtja e të dhënave personale dhe materiale

1. Organi përkatës grumbullon, përpunon, përdor dhe mban të dhënat personale dhe materiale për:
   1.1. pjesëtarët e SMSHN, nëpunësve civil në fushën e mbrojtjes dhe ndihmës si dhe vullnetarëve në zbatimin e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, emri, mbiemri, data, vendi i lindjes, adresa e përhershme dhe e përkohshme e banimit, datëlindjet e fëmijëve, të dhënat e njohurive dhe aftësive lidhur me mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, arsimim, punësimin, numrin e telefonit fiks dhe mobil si dhe resurset materiale të tyre;
   1.2. pjesëtarët e SMSHN përveç të dhënave në nën-paragrafin 1.1. të këtij paragrafi, duhet të paraqesin edhe të dhënat plotësuese për datën e kontrollit të fundit të gjendjes psiko-fizike dhe shëndetësore, përgjegjësitë brenda këtyre strukturave, për qëllime të sigurimit të përgatitjeve, mobilizimit, aktivizimit dhe dispozitave të të drejtave dhe obligimeve të pjesëtarëve SMSHN dhe forcave tjera të kësaj natyre;

1.3. llojin, kapacitetin dhe gjendjen e mjeteve të transportit dhe mjeteve tjera subjekte të obligimit material si dhe emrin, mbiemrin, adresën e shtëpisë apo të punës të pronarëve dhe përdoruesve të mjeteve të tilla, pajisjeve dhe objekteve, për qëllime të kompletimit të ekipeve, njësive dhe shërbimeve.

2. Organi përkatës mban bazën e të dhënave personale për pjesëtarët e mundshëm SMSHN, nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe ndihmës, vullnetarët, dhe personat subjekt të obligimeve materiale.
3. Mbrojtja e të dhënave të përcaktuara në këtë nen bëhet në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 33
Komunikimi i të dhënave personale dhe materiale

1. Organi përkatës mund t'i komunikoj të dhënat personale dhe materiale të përcaktuara në nenin 32 të këtij ligji tek:
   1.1. autoriteti qendror dhe lokal me kërkesë;
   1.2. ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera, për pjesëtarët e SMSHN, të caktuar tek ata.
2. Organet, ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera nga paragrafi 1. i këtij neni mund t'i përdorin të dhënat e tilla vetëm për qëllime të organizimit të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe janë përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale sipas ligjit në fuqi.

Neni 34
Burimet e të dhënave

1. Organi përkatës duhet t'i siguroj të dhënat personale të përcaktuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nga bazat ekzistuese të të dhënave. Autoritetet dhe shërbimet që grumbullojnë të dhënat e tilla duhet t'i ofrojnë ato me kërkesë të organit përkatës.
2. Nëse të dhënat personale nuk mund të sigurohen nga bazat ekzistuese të të dhënave, organi përkatës mund t'i siguroj ato drejtpërsëdrejti nga pjesëtarët e SMSHN, organizatat e ndryshme vullnetare apo ato qeveritare dhe joqeveritare.
3. Të dhënat personale nga neni 32 i këtij ligji, duhet të asgjësohen pas kalimit të afatit të qëllimit për të cilin ato janë grumbulluar.
4. Çdo person ka të drejt, t'i shikoj të dhënat e tij të mbajtura nga organi përkatës.
5. Organi përkatës është i detyruar që ta informoj çdo person lidhur me të dhënat e tija brenda tetë (8) dite pas paraqitjes së kërkesës nga ana e tij.

Neni 35
Komunikimi i ndryshimeve të të dhënave personale dhe materiale

Pjesëtarët e SMSHN, qytetarët dhe personat juridik subjekte të obligimeve materiale janë të obliguar ta informojnë organin përkatës për çdo ndryshim të të dhënave personale dhe të të dhënave tjera të përcaktuara në nenin 32 të këtij ligji, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e ndryshimit.

KREU III
PËRGJEGJËSITË

Neni 36
Përgjegjësitë e nivelit qendror

1. Shteti është përgjegjës për:
   1.1. menaxhimin e sistemit të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
   1.2. aktivitetet e zhvillimit të kërkimeve dhe plan projekteve për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
   1.3. përgatitjen dhe zbatimin e strategjisë dhe programeve shtetërore për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
   1.4. përpunimin e vlerësimit të rreziqeve dhe planeve shtetërore të reagimit emergjent;
   1.5. organizimin dhe pajisjen e strukturave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës shtetërore;
   1.6. menaxhimin e strukturave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera që godasin dy apo më tepër komuna;
   1.7. organizimin dhe zbatimin e monitorimit, paralajmërimit dhe alarmimit në nivel qendrorë dhe regjional.
   1.8. organizimin dhe mirëmbajtjen e sistemit unik të paralajmërimit publik;
   1.9. vendosjen dhe mirëmbajtjen e komunikimit elektronik për qëllime të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës deri tek niveli lokal dhe përcaktimin e sistemit unik elektronik të komunikimit;
   1.10. vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
   1.11. organizimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të informimit dhe komunikimit për nevoja të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës derisa përfshihen komunat dhe organet menaxheriale, njësitë, shërbimet dhe strukturat tjera operative të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;
   1.12. ndihmën në restaurim dhe rimëkëmbje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera me qëllim të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të njerëzve, pronave, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, parandalimin e dëmeve të ardhshme dhe sigurimin e kushteve elementare për jetë;
   1.13. përpunimin e programeve të aftësimit dhe të trajnimeve në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera dhe zbatimin e programeve të rëndësisë shtetërore.

Neni 37
Përgjegjësitë e nivelit lokal

1. Niveli lokal është përgjegjëse për zbatimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e tij.
2. Niveli lokal është përgjegjës për:

2.1. menaxhimin e sistemit të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në nivelin lokal;
2.2. monitorimin e rreziqeve, paralajmërimin dhe alarmimin e popullatës për kërcënimet e mundshme;
2.3. pajisjen me mjete elektronike të komunikimit për nevoja të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në përputhshmëri me një sistem unik të komunikimit dhe informimit;
2.4. planifikimin dhe zbatimin e masave mbrojtëse;
2.5. përpunimin e vlerësimit të rreziqeve dhe planeve të reagimit emergjent;
2.6. organizimin, zhvillimin dhe menaxhimin e mbrojtjes personale dhe reciproke;
2.7. organizimin, menaxhimin dhe zbatimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në nivel lokal;
2.8. përcaktimin, organizimin dhe pajisjen e njësive dhe shërbimeve komunale të SMSHN dhe organizatave tjera të kësaj fushe;
2.9. furnizimin me resurse të domosdoshme për akomodim emergjent në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera;
2.10. përpunimin dhe zbatimin e programeve trajnuese të rëndësisë lokale;
2.11. koordinimin e planeve të reagimit emergjent dhe operacioneve tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë me komunat fqinjë;
2.12. furnizimin me kushte elementare të jetës dhe restaurimit, rimëkëmbjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
2.13. identifikimin e organizatave të rëndësisë së veçantë për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në nivel lokal;
2.14. bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës sipas këtij ligji.

3. Komunat bashkëpunojnë midis tyre në kryerje të detyrave të lidhura me mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe mund t'i bashkojnë resurset e tyre dhe të krijojnë resurse të përbashkëta për tu marr me çështjet e përbashkëta në këtë fushë.

Neni 38
Përgjegjësitë e ndërmarrjeve, institucioneve dhe organizatave tjera

1. Institucionet dhe ndërmarrjet duhet të sigurojnë kushte dhe mundësi të nevojshme për realizimin e mbrojtjes personale dhe reciproke si dhe implementimin e masave mbrojtëse të përcaktuara me këtë ligj.
2. Institucionet dhe ndërmarrjet që përdorin, prodhojnë, transportojnë dhe deponojnë materie të rrezikshme, karburante dhe derivate të tyre dhe gazra energjetike dhe kryejnë veprimtari me mjete të rrezikshme, obligohen që të bëjnë vlerësimin e rreziqeve dhe të hartojnë plane të reagimit emergjent në pajtim me dispozitat ligjore.
3. Institucionet dhe ndërmarrjet nga paragrafi 2. i këtij neni, me shpenzime të veta duhet të vendosin dhe të mirëmbajnë pajisjet për ndërhyrje, të organizojnë forcat e nevojshme për shpëtim dhe ndihmë, të sigurojnë lajmërimin dhe alarmimin e punëtorëve dhe të popullatës për rrezikun dhe të bashkë-financojnë aktivitetet përgatitore të nivelit lokal në proporcion me madhësinë dhe shkallën e rrezikut, të cilën e shkakton veprimtaria e tyre.

4. Përveç institucioneve dhe ndërmarrjeve nga paragrafi 2. i këtij neni, organizatat të cilat kryejnë veprimtari edukative-arsimore, sociale, mjekësore dhe të tjera që përfshijnë kujdesin apo mbrojtjen e numrit të madh të personave, janë të obliguar të përpunojnë plane të reagimit emergjent apo të zbatojnë masa parandaluese.
5. Aktivitetet dhe mjetet nga paragrafi 2. dhe 4. i këtij neni, do të përcaktohen nga Qeveria, me akt nënligjor.

Neni 39
Përgjegjësitë e pronarëve dhe shfrytëzuesve

1. Pronarët dhe shfrytëzuesit e ndërtesave të banimit janë përgjegjës për zbatimin e masave të përcaktuara te mbrojtjes sipas kreut VI dhe për sigurimin e mjeteve të nevojshme për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.
2. Pronarët dhe shfrytëzuesit e trashëgimisë kulturore janë përgjegjës për zbatimin e masave të përcaktuara mbrojtëse.
3. Pronarët dhe shfrytëzuesit nga paragrafi 1. i këtij neni duhet t'u ofrojnë në dispozicion të dhënat për ndërtesat dhe shfrytëzuesit e banesave.

KREU IV
PROGRAMIMI DHE PLANIFIKIMI

Neni 40
Projektet për hulumtim dhe zhvillim

1. Projektet për hulumtim dhe zhvillim lidhur me mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera janë pjesë përbërëse e programit Qendror të hulumtimeve.
2. Ministria, përkatësisht Agjencia përgjegjëse për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera merr pjesë në vendimmarrje lidhur me projektet hulumtuese dhe zhvillimore që duhet të përfshihen në programin Qendror të hulumtimeve duke propozuar projektet për hulumtim dhe zhvillim që kanë të bëjnë me mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
3. Ministria, pas harmonizimit paraprak me ministritë gjegjëse për aktivitete hulumtuese, mund të financojë projekte hulumtuese dhe zhvillimore që kanë të bëjnë me mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në mënyrë te pavarur.

Neni 41
Programi Qendror

1. Qëllimi i programit Qendror është vendosja e objektivave, politikës dhe strategjisë për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
2. Programi Qendror hartohet për një periudhe pesë (5) vjeçare dhe përfshinë:
   2.1. gjendjen e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
   2.2. objektivat kryesore të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për periudhën që e mbulon programi Qendror;
   2.3. zhvillimin e sistemeve të monitorimit, informimit, komunikimit, mbështetjes dhe sistemeve tjera për nevoja të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;

2.4. zhvillimin e aktiviteteve të parandalimit;
2.5. zhvillimin e strukturave dhe kapaciteteve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;
2.6. udhëzimet për aftësim dhe trajnim;
2.7. udhëzimet për projekte hulumtuese dhe zhvillimore;
2.8. sigurimi i mjeteve financiare dhe mjeteve tjera.

Neni 42
Plani vjetor

Detyrat e përcaktuara në Programin qendror duhet të detajizohen në planet vjetore të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera

Neni 43
Programet dhe planet lokale

Programet dhe planet e nivelit lokal për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, nuk mund të jenë në kundërshtim me programin qendror.

Neni 44
Vlerësimi i rrezikshmërisë

1. Planifikimi i aktiviteteve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, si dhe në gjendje te jashtëzakonshme, duhet të bazohen në vlerësimin e rrezikshmërisë.
2. Vlerësimin e rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, si dhe gjendjen emergjente në nivel vendi e bën Agjencia në bashkëpunim me institucionet tjera.
3. Vlerësimin e rrezikshmërisë për nivelin lokal e bën organi përgjegjës lokal.
4. Metodologjinë për vlerësimin e rrezikshmërisë e përcakton Qeveria me akt nënligjor.

Neni 45
Planet e reagimit emergjent

1. Mbrojtja, shpëtimi dhe ndihma në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera dhe në gjendje të jashtëzakonshme duhet të planifikohen nëpërmjet planeve të reagimit emergjent.
2. Qëllimi i planeve të reagimit emergjent është sigurimi i ndërmarrjes së veprimeve të organizuara dhe të koordinuara për parandalimin e fatkeqësive apo zvogëlimin e pasojave të tyre dhe në rast të fatkeqësisë, të sigurohen sa më shpejt që të jetë e mundur kushtet elementare për jetë.

Neni 46
Autoritetet e planifikimit

1. Planet kombëtare të reagimit duhet të përgatiten nga Agjencia në bashkëpunim me institucionet e tjera përkatëse sipas fushave të përgjegjësisë.

2. Planet lokale të reagimit emergjent hartohen nga autoritetet lokale.
3. Kryetari i komunës, për plotësim mund të kërkoj nga institucionet dhe ndërmarrjet tjera, përveç atyre të përcaktuara në nenin 42 të këtij ligji, të hartojnë plane të reagimit emergjent.
4. Autoritetet përgjegjëse për planifikimin e reagimit emergjent janë përgjegjëse që planet e miratuara t'i prezantojnë para publikut.
5. Qeveria me akt nënligjor përcakton përmbajtjen dhe procedurat për përpunimin e planeve të reagimit emergjent.

Neni 47
Plotësimi i planeve

Planet e reagimit emergjent duhet të plotësohen me rastin e çdo ndryshimi në aspektin e faktorëve te rreziqeve dhe kapaciteteve të shërbimeve emergjente - organizatave dhe resurseve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, duke i marr parasysh të gjeturat dhe përvojat e reja të arritura në menaxhimin e fatkeqësive.

KREU V
MONITORIMI, NJOFTIMI DHE PARALAJMËRIMI

Neni 48
Sistemi i monitorimit, njoftimit dhe paralajmërimit

1. Me qëllim të identifikimit dhe monitorimit të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Ministria organizon një sistem unik të njoftimit, paralajmërimit, menaxhimit dhe zbatimit të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.
2. Objektivat themelore të sistemit nga paragrafi 1. i këtij neni janë:
   2.1. grumbullimi, përpunimi, analiza dhe komunikimi i të dhënave përkatëse për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, për kryerjen e detyrave tjera përkatëse për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
   2.2. njoftimi dhe paralajmërimi i qytetarëve për rrezikun e pashmangshëm dhe dhënia e udhëzimeve për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
   2.3. njoftimi dhe aktivizimi i personave që kryejnë detyra të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës për rrezikun dhe komunikimi i vendimeve të arritura nga organet përkatëse qe janë përgjegjëse për zbatimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.

Neni 49
Skema organizative e sistemit

1. Sistemi monitorimit, njoftimit dhe paralajmërimit përfshin:
   1.1. rrjetin e monitorimit;
   1.2. qendrat e njoftimit emergjent;
   1.3. paralajmërimin.
2. Qeveria me akt nënligjor rregullon organizimin dhe operimin e sistemit të monitorimit, njoftimit dhe paralajmërimit

Neni 50
Rrjeti i monitorimit

1. Monitorimi, njoftimi dhe paralajmërimi bazohet në:
   1.1. komunikimet nga individët dhe organizatat;
   1.2. vrojtimet dhe komunikimet e bëra nga zjarrfikësit, shpëtimtarët malor, shpellorët, zhytësit, pylltarët, gjuetarët, peshkatarët, klubet automobilistike, klubet nautike, klubet aeronautike, kompanitë hekurudhore, rrugore dhe institucionet dhe ndërmarrjet tjera;
   1.3. komunikimet nga shërbimet e monitorimit dhe vëzhgimit të themeluara për qëllime të monitorimit të kushteve meteorologjike, hidrologjike, sizmologjike, radiologjike, ekologjike dhe të tjera;
   1.4. vëzhgimet e bëra nga autoritetet e kontrollit të hapësirës ajrore dhe;
   1.5. shkëmbimin ndërkombëtar të informacioneve dhe të dhënave.
2. Shërbimet dhe autoritetet nga paragrafi 1. i këtij neni duhet t'i komunikojnë informacionet përkatëse për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera te qendra operative emergjente pa pagesë.

Neni 51
Shfrytëzimi i të dhënave publike dhe statistikore

1. Me qëllim të vlerësimit të rrezikshmërisë, planifikimit dhe zbatimit të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës organet qendrore dhe lokale janë të autorizuara për shfrytëzim, në bazë të fushëveprimit të tyre, të të dhënave mbi resurset, rreziqet natyrore dhe rreziqet tjera, banorët në zonat e rrezikuara, ndërtesat e banimit dhe të tjera, shërbimet publike, ndërmarrjet, shoqatat, institucionet dhe organizatat jo qeveritare, aktivitetet e të cilave janë të rëndësishme për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.
2. Me qëllim të vlerësimit të rrezikshmërisë, planifikimit dhe zbatimit të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë, organet qendrore dhe lokale janë të autorizuara për shfrytëzimin, e të dhënave personale të banorëve nën rrezik, duke përfshirë numrin personal të regjistrit të qytetarit, emrin dhe mbiemrin, datëlindjen, adresën e përkohshme dhe të përhershme të banimit dhe të dhënat mbi marrëdhënien e punës.
3. Me qëllim të vlerësimit të dëmeve të dhënat e tilla mund të përfshijnë edhe detajet lidhur me pronat e luajtshme dhe të paluajtshme të dëmtuara si pasojë e fatkeqësisë.
4. Për kryerjen e detyrave organet përkatëse qendrore dhe lokale duhet të marrin dhe përpunojnë të dhëna specifike nga regjistri qendror i qytetarëve, regjistri i bizneseve të Kosovës, të gjitha regjistrat dhe shënimet dhe të dhënat lidhur me strehimin, regjistrin e të dhënave bujqësore dhe të ngjashme,në pajtueshmëri me autorizimet e dhëna.
5. Për zbatimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në fazën e kërcënimit të menjëhershëm të fatkeqësisë apo në rast të fatkeqësisë, në mënyrë që të kryejnë rimëkëmbjen dhe sanimin pas fatkeqësisë, autoritetet qendrore dhe lokale janë të autorizuara të shfrytëzojnë të dhënat e korrigjuara mbi vendndodhjen, sasinë dhe

cilësinë e shërbimeve të ofruara nga kompanitë publike, për numrin e strehimit individual lidhur me furnizimin me ujë, sistemin e kanalizimit, energjinë elektrike, ngrohje, gaz, linjat e komunikimit, mbeturinave komunale dhe të dhëna tjera të rëndësishme për zbatimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.

6. Përveç organeve përgjegjëse qendrore dhe lokale të dhënat sipas këtij neni, mund të përdoren edhe nga organet drejtuese, udhëheqësit e shërbimeve, njësive dhe strukturave operative si dhe komandantët e incidenteve në pajtueshmëri me profesionin dhe autorizimet e tyre për zbatimin e operacioneve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në rast të rrezikut të menjëhershëm apo në rast të fatkeqësisë, të gjerësisë e cila kërkon mbrojtje dhe shpëtim të njerëzve, pasurisë, kafshëve, trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit.
7. Agjencia grumbullon dhe menaxhon të dhënat nga ky nen dhe neni 54 i këtij ligji, në bazat qendrore të të dhënave të integruara të cilat shërbejnë si bazë për planifikimin dhe njoftimin e rreziqeve dhe zbatimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në rastet e fatkeqësive në tërë vendin apo në pjesët e veçanta të vendit dhe duhet të ofrojnë qasje në këto të dhëna për autoritetet përkatëse qendrore dhe lokale si dhe për përgjegjësitë e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës të përcaktuar në paragrafin 5. të këtij neni. Me kërkesë të Agjencisë, të dhënat e tilla duhet të dorëzohen nga menaxherët e bazave të të dhënave të cilat financohen nga parat publike dhe në versionin elektronik.
8. Autoritetet qendrore dhe lokale, organet drejtuese, udhëheqësit e shërbimeve, njësitë dhe strukturat tjera operative dhe komandantët e incidenteve të cilët planifikojnë dhe zbatojnë mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë janë të obliguar të sigurojnë mbrojtje të të dhënave personale në përputhje me legjislacionin ne fuqi.

Neni 52
Bazat e të dhënave

1. Me qëllim të marrjes me çështje administrative dhe teknike Agjencia grumbullon, përpunon, komunikon dhe përdor të dhëna për:
   1.1. fenomenet natyrore;
   1.2. burimet e rreziqeve të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera;
   1.3. fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera si dhe dëmet e shkaktuara nga ato;
   1.4. strukturat dhe resurset e tyre të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;
   1.5. intervenimet nga strukturat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;
   1.6. shpenzimet për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
2. Autoritetet qendrore, lokale, institucionet dhe organizatat tjera, organet drejtuese dhe komandantët e incidenteve janë të obliguar t'i komunikojnë të dhënat nga paragrafi 1. i këtij neni, sipas formës së përcaktuar dhe pa pagesë te Agjencia, ku ato integrohen në bazën qendrore të të dhënave dhe bëhen të arritshme për të autorizuarit.
3. Të dhënat përdoren edhe për përpunimin e programeve për rimëkëmbje dhe sanim pas fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.
4. Metodologjia e grumbullimit, përpunimit, mbajtjes dhe komunikimit të të dhënave përcaktohen me akt nënligjor i nxjerr nga ministria, ndërsa shkëmbimi i të dhënave me vendet e huaja dhe organizatat ndërkombëtare do të rregullohen me marrëveshje ndërshtetërore.

Neni 53
Përdorimi i komunikimit elektronik

1. Përdorimi i komunikimit elektronik me qëllim të mbajtjes dhe transferimit të të dhënave brenda sistemit të monitorimit, njoftimit dhe paralajmërimit ka prioritet mbi çdo lloj tjetër të komunikimit.
2. Me qëllim të menaxhimit dhe zbatimit të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës dhe detyrave tjera operative brenda fushëveprimit të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera Ministria do të krijoj një sistem autonom të komunikimit elektronik.

Neni 54
Organizimi dhe veprimi i Qendrave Operative Emergjente

1. Me qëllim të kryerjes së detyrave operative dhe të komunikimit lidhur me monitorimin, njoftimin dhe paralajmërimin në kuadër të Agjencisë, Ministria themelon qendrat operative emergjente.
2. Në këto qendra përfshihen:
   2.1. qendra Operative e Agjencisë;
   2.2. qendrat Operative Emergjente Regjionale dhe;
   2.3. qendrat Operative Emergjente Lokale.
3. Qendrat operative emergjente lokale mirëmbahen nga Kuvendet Komunale, dhe janë aktive dhe operative vetëm në rastet fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera apo në gjendje te jashtëzakonshme.
4. Vendimi për aktivizimin e Qendrës Operative Emergjente lokale merret nga Kryetari i Komunës me kërkesën e menaxherit emergjent lokal apo komandantit të incidentit.

Neni 55
Puna e qendrave operative emergjente dhe transmetimi i informatave emergjente

1. Qendra Operative e Agjencisë dhe Qendrat Operative Emergjente Regjionale të Agjencisë, operojnë pandërprerë njëzetekatër (24) orë në ditë, shtatë (7) ditë në javë.
2. Qendrat Operative Emergjente Regjionale pranojnë, përpunojnë dhe transferojnë thirrjet emergjente nga numri 112 që kërkojnë ndihmën e zjarrfikësve, shërbimeve mjekësore emergjente, ndihmën e shërbimeve tjera të shpëtimit dhe aktivizojnë strukturat e reagimit emergjent, në përputhje me planet e reagimit emergjent, planet e aktivizimit dhe vendimet e autoriteteve përkatëse.
3. Kërkesat e drejtpërdrejta, apelet, njoftimet dhe udhëzimet në rastet e paralajmërimit, si dhe komunikimet tjera lidhur me rrezikun duhet të komunikohen nëpërmjet Qendrave Operative Emergjente Regjionale me kërkesën e Qeverisë së Kosovës, Kryetarit të Komunës, Komandantit te Incidentit si dhe autoritetit qendror dhe lokal përgjegjës.
4. Komunikimet nga paragrafi 3. i këtij neni publikohen pa vonesë dhe pa pagesë, sipas Ligjit për Media.

5. Publikimi i apeleve urgjente, njoftimeve dhe porosive tjera kanë prioritet në çdo shtëpi mediale.

Neni 56
Sistemi i paralajmërimit

1. Paralajmërimi organizohet si sistem unik i paralajmërimit publik i cili menaxhohet në nivelin qendror, regjional dhe lokal.
2. Paralajmërimet në raste të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera duhet të zbatohen nga Qendrat Operative Emergjente dhe shërbimet përkatëse të institucioneve dhe organizatave tjera mbi bazën e informacioneve të verifikuara apo me kërkesë të komandantëve të incidenteve, dhe organeve tjera drejtuese.
3. Institucionet dhe organizatat tjera janë të obliguara për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe sigurimin e funksionimit të mjeteve të paralajmërimit të cilat mundësojnë paralajmërimin e qytetarëve të rrezikuar drejtpërsëdrejti nga fatkeqësitë.
4. Mjetet paralajmëruese nga paragrafi 3. i këtij neni duhet të integrohen në sistemin e paralajmërimit publik të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni.
5. Ministria është përgjegjëse për organizimin, mirëmbajtjen dhe operimin e sistemit unik të paralajmërimit në nivel vendi.
6. Ministria me akt nënligjor përcakton llojin, numrin dhe përdorimin e sinjaleve alarmuese që do të aplikohen në tërë territorin e vendit.

KREU VI
MASAT MBROJTËSE

Neni 57
Masat mbrojtëse

1. Masat mbrojtëse ndër të tjera përfshinë:
   1.1. masat hapësinore, urbanistike, ndërtimore dhe masat tjera teknike;
   1.2. evakuimin;
   1.3. akomodimin dhe kujdesin e njerëzve të rrezikuar;
   1.4. mbrojtjen radiologjike, kimike dhe biologjike;
   1.5. strehimin;
   1.6. mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Neni 58
Masat hapësinore, urbanistike, ndërtimore dhe masat tjera teknike

1. Masat hapësinore, urbanistike, ndërtimore dhe masat e tjera teknike, ndërmerren gjatë planifikimit hapësinor, urban dhe ndërtimor me qëllim të parandalimit apo zvogëlimit të efekteve të dëmshme si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera si dhe për të mundësuar mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën.
2. Projektet për ndërtimin e objekteve, të destinuara për shfrytëzim kolektiv, furnizim të qytetarëve, transport publik, si dhe deponim, prodhim dhe përdorim të materieve të rrezikshme, të naftës dhe të derivateve të saj, si dhe të gazrave energjetike, duhet të përmbajnë elaborate për siguri nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

3. Qeveria me akt nënligjor, përcakton llojin e objekteve, masat hapësinore, urbanistike, ndërtimore dhe masat e tjera teknike të mbrojtjes.

Neni 59
Evakuimi

1. Evakuimi i banorëve të rrezikuar bëhet atëherë kur me masa të tjera nuk mund të garantohet siguria e tyre.
2. Vendimi për evakuim merret nga Qeveria, Kryetari i Komunës ose në raste emergjente nga komandanti i incidentit.
3. Lëvizja e banorëve nga zona e paraparë për evakuim në vendin e caktuar duhet të bëhet sipas mënyrës dhe afateve kohore të përcaktuara në planet e reagimit emergjent apo siç është përcaktuar në vendimin e organit kompetent.
4. Zhvendosja e banorëve në komunitetin tjetër lokal nuk mund të ndikojë në ndryshimin e statusit juridik të tyre.
5. Komuna, në të cilin janë vendosur banorët e evakuuar, e siguron akomodimin, kujdesin dhe edukimin e tyre.
6. Shpenzimet nga paragrafi 5. i këtij neni, Komunës ia kompenson Komuna nga ku ata janë zhvendosur apo shteti.

Neni 60
Akomodimi dhe kujdesi ndaj njerëzve në rrezik

1. Qeveria dhe komunat janë të obliguar të sigurojnë strehim dhe kujdes të domosdoshëm për qytetarët, të cilët në rast të fatkeqësisë natyrore apo fatkeqësisë tjetër kanë humbur shtëpitë dhe mjetet e tyre të jetës dhe nuk mund të kthehen në vendbanimet e tyre për shkak të rrezikut.
2. Në raste të jashtëzakonshme, kur nuk mund të sigurohet akomodim tjetër, Kryetari i Komunës kërkon nga pronarët ose shfrytëzuesit e ndërtesave të banimit t'i strehojnë përkohësisht banorët e evakuuar të cilët janë të rrezikuar.

Neni 61
Mbrojtja radiologjike, kimike dhe biologjike

1. Mbrojtja radiologjike, kimike dhe biologjike, përbën masat dhe mjetet për mbrojtje të drejtpërdrejtë nga efektet e armëve nukleare, kimike dhe biologjike, si dhe nga pasojat e incidenteve që përfshijnë materiet e rrezikshme.
2. Pronarët dhe shfrytëzuesit e objekteve dhe të pajisjeve të destinuara për furnizim publik, transport dhe deponim të gjërave ushqimore, medikamenteve, ushqimit për kafshë, shërbimet publike, shëndetësore, ruajtje dhe arsimim të fëmijëve, duhet t'i sigurojnë mjetet mbrojtëse dhe t'i ndërmarrin masat e parapara për mbrojtje kimike, biologjike dhe radiologjike.
3. Qeveria me akt nënligjor rregullon organizimin e mbrojtjes radiologjike, kimike dhe biologjike, si dhe i përcakton mjetet dhe masat për mbrojtje.

Neni 62
Strehimi

1. Strehimoret dhe objektet tjera për mbrojtje ndërtohen me qëllim të mbrojtjes së njerëzve në raste të luftës apo rreziqeve tjera.
2. Strehimoret ndahen në strehimore të mbrojtjes elementare dhe plotësuese.
3. Strehimoret e mbrojtjes elementare ndërtohen në qytete dhe vendbanime të rrezikuara brenda ndërtesave të reja, të destinuara për shërbime të shëndetit publik, kujdesit dhe edukimit të fëmijëve, mbrojtje të trashëgimisë kulturore, informimit publik, televizioneve dhe radiove kombëtare, trafikut hekurudhor dhe ajror si dhe në ndërtesat e rëndësishme për furnizim me energji dhe ndërtesat industriale të destinuara për tu shfrytëzuar në kohë lufte për mbajtjen e aktiviteteve të rëndësisë së veçantë për mbrojtje dhe siguri.
4. Strehimoret në ndërtesat e reja në vendbanimet e caktuara, pllaka e parë duhet të përforcohet deri në masën që i reziston depërtimit të rrënojave.
5. Strehimoret ndërtohen si objekte të përdorimit të dyfishtë deri në masën që nuk e çrregullon funksionin e tyre mbrojtës.
6. Objektet tjera për mbrojtje duhet të ndërtohen në atë formë që sigurojnë strehim nga rrënojat.

Neni 63
Strehimoret publike

1. Me qëllim të sigurimit të strehimit për njerëzit në vendet publike duhet të përdoren strehimoret publike apo objektet tjera të përshtatshme.
2. Strehimoret publike janë në kompetencë të autoriteteve lokale.

Neni 64
Funksionet mbrojtëse të strehimoreve

1. Strehimoret për mbrojtje elementare duhet të sigurojnë mbrojtje nga mbi-presioni, rrënojat, radioaktiviteti, zjarri dhe efektet e armëve dhe materiet tjera kimike si dhe duhet të furnizohen në masën që mundëson banim për një kohë më të gjatë.
2. Strehimoret e mbrojtjes plotësuese duhet të sigurojnë mbrojtje nga rrënojat.

Neni 65
Mirëmbajtja dhe përdorimi i strehimoreve

1. Pronarët dhe shfrytëzuesit janë të obliguar të mirëmbajnë strehimoret në gjendjen që i përputhen qëllimit.
2. Në raste emergjente, strehimorja duhet të bëhet e gatshme për përdorim brenda njëzetekatër (24) orëve.
3. Ndryshimet që e dobësojnë funksionin mbrojtës të strehimoreve janë të ndaluara pa përjashtim.

Neni 66
Financimi i ndërtimit të strehimoreve

1. Investitorët janë të obliguar t'i ndërtojnë strehimoret me mjete vetanake financiare.
2. Në rastet e strehimoreve publike investitor është niveli lokal.
3. Me qëllim të përkrahjes së ndërtimit të strehimoreve, shteti mund të ofroj garanci dhe subvencione.
4. Ministria vendos për kërkesat, për marrjen e garancive dhe dhënien e subvencioneve.
5. Qeveria me akt nënligjor përcakton lokacionet dhe hapësirat ku duhet të ndërtohen strehimoret, si dhe kushtet për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tyre.
6. Ministria me akt nënligjor përcakton normat teknike për strehimore dhe për adaptimin e objekteve për strehim.

Neni 67
Mbrojtja e trashëgimisë kulturore

1. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore përfshinë përgatitjet dhe ndërmarrjen e masave për zvogëlimin e rreziqeve, parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit negativ të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera në trashëgiminë kulturore.
2. Përgatitjet dhe masat zbatohen nga pronarët dhe shfrytëzuesit e trashëgimisë kulturore, shërbimi për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, nivelet qendrore dhe lokale.
3. Gjatë realizimit të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, sipas nevojës, marrin pjesë edhe njësitë dhe shërbimet gjegjëse të mbrojtjes dhe shpëtimit, njësitë e zjarrfikjes, si dhe strukturat tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.
4. Qeveria me akt nënligjor rregullon mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.

KREU VII
MBROJTJA PERSONALE DHE RECIPROKE

Neni 68
Shtrirja dhe përgjegjësitë

1. Mbrojtja personale dhe reciproke përfshin masat që i ndërmarrin qytetarët për pengimin dhe zvogëlimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera për shëndetin, jetën dhe pronat e tyre.
2. Organizimi, zhvillimi dhe drejtimi i mbrojtjes personale dhe reciproke është në kompetencë të autoritetit lokal, të cilët mund të themelojnë shërbime këshillimi.
3. Qeveria me akt nënligjor përcakton mjetet dhe pajisjet për mbrojtje personale dhe kolektive, të cilat duhet të sigurohen nga qytetarët, pronarët dhe shfrytëzuesit e ndërtesave, ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera, si dhe organet publike, në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.

KREU VIII
STRUKTURAT PËR MBROJTJE, SHPËTIM DHE NDIHMË

Neni 69
Detyrat dhe organizimi i mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës

1. Mbrojtja, shpëtimi dhe ndihma, në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, përfshin:
   1.1. ndihmën për qytetarët e rrezikuar dhe të goditur;
   1.2. ndihmën e parë mjekësore;
   1.3. ndihmën e parë veterinare;
   1.4. shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin nga zjarret;
   1.5. shpëtimin nga rrënojat, ortekët, rrëshqitjet;
   1.6. shpëtimin nga vërshimet dhe format tjera të shfaqjes së ujit, katastrofat e tjera meteorologjike, fatkeqësitë ekologjike dhe nga fatkeqësitë e tjera nga lumenjtë dhe liqenet;
   1.7. shpëtimin në rastet të aksidenteve të mëdha në trafik;
   1.8. shpëtimin në raste e incidenteve në miniera;
   1.9. shpëtimin në bjeshkë;
   1.10. shpëtimin në shpella, humnera, etj;
   1.11. shpëtimin në ujë dhe nën ujë;
   1.12. shpëtimin në raste të çrregullimeve të papritura;
   1.13. mbrojtjen radiologjike, kimike dhe biologjike nga armët nukleare, kimike dhe biologjike, mjetet tjera të shkatërrimit në masë dhe në incidentet që përfshijnë materiet e rrezikshme;
   1.14. kërkimin e personave të humbur në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
   1.15. shpëtimin në raste të luftës, sulmeve terroriste dhe formave tjera të dhunës në masë;
   1.16. sigurimin e kushteve elementare për jetë.

Neni 70
Zbatimi i detyrave

1. Detyrat zbatohen nga:
   1.1. njësitet, shërbimet dhe strukturat operative të shoqatave dhe organizatave tjera jo qeveritare;
   1.2. Organizatat dhe institucionet;
   1.3. njësitë dhe ekipet e reagimit emergjent;
   1.4. Policia e Kosovës;
   1.5. Forca e Sigurisë së Kosovës.

Neni 71
Shoqatat dhe organizatat tjera jo qeveritare

1. Njësitë, shërbimet dhe strukturat operative të shoqatave dhe organizatave tjera joqeveritare, kryejnë detyrat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës apo të shërbimit

publik, në bazë të vendimit të autoritetit të nivelit lokal apo qendror, nëse i përmbushin kushtet e parapara me këtë ligj.

2. Organi kompetent vendos për:
   2.1. strukturën, shtrirjen dhe mënyrën e kryerjes së detyrave apo shërbimit publik;
   2.2. fillimin e realizimit të detyrave apo shërbimit publik;
   2.3. mjetet financiare që i siguron organi përkatës i nivelit lokal apo qendror për kryerjen e detyrave apo shërbimit publik;
   2.4. mjetet financiare për pagimin e kontributeve për qytetarët që përsojnë gjatë intervenimit dhe sëmundjes profesionale;
   2.5. mbikëqyrjen e kryerjes së detyrave apo shërbimit publik.
3. Shtrirja dhe mënyra e zbatimit të detyrave apo shërbimit publik përcaktohet në përputhje me standardet e zbatueshme për organizimin dhe pajisjet e njësive, shërbimeve dhe strukturave tjera operative të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.
4. Kur përcaktohet nga organi kompetent që njësitë, shërbimet dhe strukturat tjera operative të një shoqate apo organizate tjetër jo qeveritare dështojnë në kryerjen e detyrave apo shërbimit publik, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe vendimin e organit kompetent përcaktohet afati kohor për të cilin shoqata apo organizata përkatëse duhet rregulluar gjendjen.
5. Nëse shoqata apo organizata dështon në rregullimin e gjendjes brenda afatit të përcaktuar, duhet të largohet nga zbatimi i detyrave apo shërbimit publik përkatës.
6. Pavarësisht nga dispozitat e këtij neni, shoqatat dhe organizatat tjera jo qeveritare mund të marrin pjesë vullnetarisht në mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, nëse mund të sigurojnë personelin dhe pajisjet e nevojshme

Neni 72
Shërbimet e mbrojtjes publike, shpëtimit dhe ndihmës

1. Shërbimet e mbrojtjes publike, shpëtimit dhe ndihmës përfshijnë:
   1.1. shërbimin e zjarrfikës që sigurohet nga njësitë e zjarrfikëseve në përputhje me Ligjin për zjarrëfikje dhe shpëtim;
   1.2. shërbimin e shpëtimit bjeshkatar të siguruar nga stacionet e shpëtimit bjeshkatar në përputhje me standardet për organizim dhe pajisje të njësive, shërbimeve dhe strukturave operative për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;
   1.3. shërbimin e shpëtimit në shpella dhe humnera të siguruar nga shpellarët-shpëtimtar të organizuar në klube të shpellarëve në përputhshmëri me vendimet e organit përgjegjës qendror;
   1.4. shërbimet e shpëtimit në ujë të siguruar nga zhytësit në përputhje me standardet për organizim dhe pajisje të njësive, shërbimeve dhe strukturave tjera operative të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;
   1.5. shërbimin për mbrojtje dhe shpëtim në rast të fatkeqësive ekologjike dhe fatkeqësive tjera të organizuara nga niveli lokal dhe qendror.
2. Shërbimi i Hetimeve Unike për grumbullimin, komunikimin dhe incizimin e të dhënave për qytetarët e goditur në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera, përfshirë gjendjen e luftës dhe atë emergjente, duhet të organizohen dhe trajtohen nga Kryqi i Kuq i Republikës së Kosovës.

3. Kryqi i Kuq i Republikës së Kosovës do të kujdeset për kurset e trajnimit për ndihmën e parë dhe të zbatoj fuqi tjera publike në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe do të zbatoj detyrat në përputhshmëri me standardet për organizimin dhe pajisjen e njësive, shërbimeve dhe strukturave tjera operative për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

Neni 73
Ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera

1. Me qëllim të zbatimit të detyrave specifike operative të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, organi përgjegjës qendror apo lokal mund të angazhoj ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera, nëse ato janë në gjendje të sigurojnë personelin dhe pajisjet e nevojshme.
2. Ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera me qëllim të zbatimit të detyrave nga paragrafi 1. i këtij neni, duhet të sigurojnë trajnime për punëtorët e tyre dhe të përgatiten për veprim në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.
3. Organi përgjegjës qendror ose lokal do të kompensoj ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera të angazhuara për zbatimin e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës për koston e efektive të dalë nga pjesëmarrja në zbatimin e detyrave dhe përgatitjeve të cilat nuk janë në aktivitetet e tyre të zakonshme.
4. Qeveria në standardet e saj për organizimin dhe pajisjen e njësive, shërbimeve dhe strukturave tjera operative të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës duhet të përfshijë edhe standardet për angazhimin e ndërmarrjeve, institucioneve dhe organizatave tjera të cilat kanë pajisje specifike apo kapacitete tjera ose janë të përfshira në aktivitete të rëndësishme për zbatimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.
5. Ministria - Agjencia apo institucionet tjera përgjegjëse qendrore apo lokale për llojin e fatkeqësisë, duhet të nënshkruajnë marrëveshje me ndërmarrje, institucione dhe organizata tjera, ku përcaktohen pjesëmarrja dhe obligimet e tyre sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 3. të këtij neni.
6. Në pajtueshmëri me standardet e zbatueshme për organizimin, pajisjen dhe trajnimin e njësive, shërbimeve dhe strukturave tjera operative të shoqatave dhe organizatave jo qeveritare, Agjencia dhe organi përkatës lokal duhet të nënshkruajnë marrëveshje sipas paragrafit 5. të këtij neni edhe me shoqatat dhe organizatat jo qeveritare që organizojnë njësitë, shërbimet dhe strukturat tjera operative të tilla.
7. Marrëveshjet nga paragrafi 5. dhe 6. të këtij neni, përveç tjerash duhet të përcaktojnë në veçanti llojin dhe madhësinë e njësisë, shërbimit dhe strukturës tjetër operative, zbatimin e shërbimeve publike sipas këtij ligji, përgjegjësinë për arritjen dhe mbajtjen e gatishmërisë dhe obligimeve tjera shtetërore të lidhura me pjesëmarrjen e tyre në mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.
8. Me qëllim të mbajtjes së nivelit të caktuar te gatishmërisë, të nevojshme për zbatimin e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat vullnetare, shoqatat dhe organizatat tjera jo qeveritare, bazuar në paragrafin 5. dhe 6. të këtij neni, mund të pajisen pa pagesë me pajisje dhe pajime të mbrojtjes dhe shpëtimit, për të cilat ata obligohen t'i mirëmbajnë. Pajisjet dhe pajimet e tilla mund të largohen vetëm për qëllime të zëvendësimit me pajisje të reja si dhe ne raste te ndërprerjes se marrëveshje.

Neni 74
Njësitë dhe shërbimet e mbrojtjes dhe shpëtimit

1. Nëse detyrat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës nuk mund të kryhen nga shërbimet profesionale të shpëtimit, njësitë dhe shërbimet e mbrojtjes dhe shpëtimit organizohen si më poshtë:
   1.1. njësitë teknike të shpëtimit;
   1.2. njësitë për ndihmë të parë veterinare;
   1.3. njësitë dhe shërbimet për mbrojtje radiologjike, kimike dhe biologjike;
   1.4. shërbimet për shfrytëzimin e strehimoreve;
   1.5. qendrat e logjistikës dhe të informimit;
   1.6. shërbimet e mbështetjes dhe
   1.7. njësitë dhe shërbimet tjera bazuar në vlerësimin e rreziqeve.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, organizohen komisione të përhershme dhe të përkohshme të ekspertëve për vlerësimin e dëmeve në ndërtesa si dhe për detyra tjera të posaçme, në përputhje me planet e reagimit emergjent dhe vlerësimin e rreziqeve për zbatimin e detyrave të caktuara të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.
3. Qeveria me akt nënligjor përcakton njësitë dhe shërbimet nga paragrafi 1. i këtij neni të cilat duhet të organizohen nga niveli qendror dhe lokal, ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera në përputhje me standardet e aplikueshme për organizimin, pajisjen dhe trajnimin e SMSHN.

Neni 75
Mbrojtja nga mjetet e pa shpërthyera

1. Mbrojtja nga mjetet e pa shpërthyera përmban - zbulimin, sigurimin, largimin, transportin dhe shkatërrimin e tyre.
2. Për zbatimin e detyrave nga paragrafi 1. i këtij neni vlejnë dispozitat e ligjit për themelimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Neni 76
Ruajtja e rendit dhe qetësisë publike

Në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera Policia e Kosovës është përgjegjëse për të siguruar qetësi dhe rend publik në zonat e kërcënuara dhe të goditura.

Neni 77
Mobilizimi dhe aktivizimi

1. Vendimin për mobilizimin e SMSHN, organizatave dhe shërbimeve tjera emergjente e nxjerrin organet përkatëse si pas nivelit.
2. Vendimi për aktivizimin e SMSHN dhe shërbimeve tjera emergjente në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera merret në raport me dispozitat e përcaktuara në Planin e Reagimit Kombëtar sipas niveleve përkatëse.

Neni 78
Menaxhimi i strukturave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës

1. Menaxhimi operativ dhe taktik i SMSHN organizohet dhe zbatohet sipas parimeve të Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Emergjencave dhe në harmoni me Planin e Reagimit Kombëtar
2. Menaxhimi duhet të bazohet në zbatimin e detyrueshëm të vendimeve të marra nga autoritetet përgjegjëse për menaxhimin e njësive për mbrojtje dhe shpëtim, si dhe shërbimeve tjera të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.
3. Çdo komandant apo udhëheqës duhet të caktoj zëvendës. Në mungesë të zëvendësit, ai duhet të caktoj personin tjetër që ta zëvendësoj atë.
4. Çdo komandant apo udhëheqës duhet t'i njohë eprorët dhe vartësit e tij.
5. Asnjë personi nuk duhet t'i kërkohet apo lejohet zbatimi i vendimit, kur rasti në të cilin bëhet një gjë e tillë, kryhet krim apo veprim në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar humanitar.

Neni 79
Menaxhimi i njësive, shërbimeve dhe strukturave tjera operative

1. Njësitë, shërbimet dhe strukturat tjera operative të organizuara në shoqata dhe organizata tjera jo qeveritare, të cilat marrin pjesë në mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, menaxhohen në mënyrë të pavarur nga udhëheqësit e tyre në përputhje me dispozitat teknike dhe ligjore.
2. Kur mbrojtja, shpëtimi dhe ndihma realizohet nga më shumë se një njësi, shërbim apo strukturë operative tjetër, të gjithë duhet vepruar në përputhje me vendimet e marra nga Komandanti i Incidentit te caktuar.

Neni 80
Pjesëmarrja e forcave të sigurisë dhe atyre policore

1. Nëse forcat e sigurisë marrin pjesë në mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë menaxhimin e tyre e bëjnë eprorët e tyre në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Komandanti i Incidentit.
2. Policia, organizimin dhe zbatimin e detyrave në mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë duhet t'i kryej në përputhje me rregullat dhe udhëzimet e dhëna nga Komandanti i Incidentit.

Neni 81
Detyrat e komandantit të Incidentit

1. Komandanti i Incidentit do të:
   1.1. verifikon gatishmërinë për intervenim të njësive emergjente dhe resurseve tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;
   1.2. udhëheq mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën në rast të fatkeqësive;
   1.3. siguroj ndërlidhje dhe veprim të koordinuar për të gjitha SMSHN;
   1.4. bëj propozime lidhur me përgatitjen e SMSHN si dhe për rimëkëmbje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

1.5. kërkoj aktivizimin e Qendrave Operative Emergjente.

2. Komandanti i Incidentit mund të caktoj përgjegjës për të menaxhuar intervenimet individuale të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.

Neni 82
Kompetencat e veçanta

1. Në drejtimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, Komandanti i Incidentit ka të drejtë dhe detyrë të ndaloj qasjen e personave të paautorizuar në zonat e goditura dhe të urdhëroj që:
   1.1. njerëzit, kafshët dhe të mirat materiale të zhvendosen nga ndërtesat dhe zonat e goditura;
   1.2. të lejohet qasja në strehimore;
   1.3. të mundësohet përdorimi apo vendosja e mjeteve të veçanta të komunikimit;
   1.4. të bëhet largimi i pengesave që pengojnë intervenimin e suksesshëm;
   1.5. të vihen në dispozicion për përdorim mjetet private të transportit për bartjen e të lënduarve apo mjeteve të nevojshme për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;
   1.6. qytetarët e përgatitur të marrin pjesë në aktivitetet e shpëtimit në përputhje me aftësitë dhe resurset e tyre të përshtatshme për shpëtim;
   1.7. pronat private të përdoren për qëllime të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;
   1.8. pronat të përdoren si depo të përkohshme për rrënoja, pjesë dhe materiale tjera të dala gjatë kryerjes së detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës të destinuara për sigurimin e kushteve elementare për jetë;
   1.9. shkatërrimin e ndërtesave apo prerjen e pemëve.
2. Masat e përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, mund të urdhërohen vetëm atëherë kur asnjë masë tjetër nuk mund të siguroj mbrojtje të njerëzve dhe pronave si dhe zbatim të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës dhe duhet të aplikohen jo më shumë se sa është plotësisht e domosdoshme.
3. Zhvendosja e njerëzve nga paragrafi 1. i këtij neni duhet të urdhërohet nëse jeta e tyre gjendet para rrezikut të pashmangshëm për shkak të zjarrit, eksplodimit apo rrezikut tjetër për kohëzgjatjen e rrezikut të tillë. Policia e Kosovës duhet të ndihmoj zhvendosjen.
4. Gjatë mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës Komandanti i Incidentit ka të drejtë t'i urdhëroj institucionet dhe organizatat tjera nënshkruese të kontratave, organet kompetente qendrore apo lokale, për zbatimin e detyrave të veçanta sipas këtij ligji, punë urgjente ndërtimore, teknike dhe të tjera.
5. Nëse detyrat duhet të kryhen me qëllim të shpëtimit dhe mbrojtjes së njerëzve, pronave, kafshëve apo mjedisit apo për mbrapsjen e rrezikut të pashmangshëm, komandanti i incidentit ka të drejt që të urdhëroj që këto detyra të kryhen nga personat fizik dhe juridik të cilët kanë kapacitet apo pajisje adekuate. Urdhri duhet të jetë me shkrim apo në situatat e papritura edhe me gojë dhe duhet të precizoj llojin dhe shtrirjen e punës që duhet kryer.
6. Për urdhëratë e dhëna nga Komandanti i Incidentit duhet të mbahen shënime. Për vendimet me implikime të mëdha financiare duhet të lëshohen urdhra me shkrim. Kur e lejojnë rrethanat duhet të lëshohen urdhra me shkrim sa më shpejt që të jetë e mundur. Në rastet urgjente Komandanti i Incidentit duhet të ketë të drejt që të

urdhëroj pronarët privat të objekteve të banimit apo objekteve tjera, të ofrojnë strehim dhe kujdes të përkohshëm për personat e kërcënuar derisa të merret vendimi nga Kryetari i Komunës apo Qeveria.

7. Nëse operacionet e mbrojtjes dhe shpëtimit drejtohen nga autoritetet përgjegjëse regjionale apo qendrore, vendimi për mbulimin e shpenzimeve të punëve urgjente të menaxhuara nga autoritetet e komunitetit lokal duhet të bëhet nga Kryetari i Komunës.

Neni 83
Ndihma

1. Kur, në rast të fatkeqësisë natyrore apo fatkeqësisë tjetër, kërkohet ndihma e komunitetit fqinjë lokal në kuptimin e strukturave dhe resurseve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, Komandanti i Incidentit mund ta kërkojnë këtë ndihmë, në koordinim me Kryetarin e Komunës.
2. Përveç ndihmës së siguruar nga marrëveshjet bilaterale, Komandanti i Incidentit mund të kërkojnë ndihmë nga një komunitet lokal i afërt në shtetin fqinjë.
3. Përveç ndihmës së siguruar nga marrëveshjet bilaterale, kërkesa për ndihmë nga vendet tjera në aspektin e forcave dhe resurseve në rastin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera bëhet nga Qeveria.
4. Komunitetet lokale në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera mund të ofrojnë ndihmë në komunitetin lokal të vendit tjetër të siguruar nga një marrëveshje ndërshtetërore.

Neni 84
Zbatimi i mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në vendet tjera

1. Ndihma për vendet tjera në zbatimin e mbrojtjes dhe shpëtimit në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe përmbushja i obligimeve ndërkombëtare të shtetit duhet të kryhet nga njësitë, shërbimet dhe strukturat operative të caktuara për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, të cilat organizohen në nivel qendror sipas këtij ligji.
2. Njësitë, shërbimet apo strukturat operative të dislokuara në vendet tjera për kryerjen e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës me qëllim të përmbushjes së obligimeve ndërkombëtare të shtetit duhet të udhëhiqen nga komandantët apo udhëheqësit e tyre dhe në përputhje me vendimet e marra nga autoritetet qendrore apo autoritetet e organizmave ndërkombëtar në të cilat zhvillohen operacionet. Në raste të pasigurisë, duhet të vendos komandanti apo udhëheqësi, në përputhje me udhëzimet e siguruara nga një organ përkatës i Republikës se Kosovës.
3. Të gjithë pjesëtarët e njësive, shërbimeve dhe strukturave operative të dislokuar jashtë vendit për trajnime, ushtrime, ofrimin e ndihmës në rast të fatkeqësisë apo për të përmbush obligimet ndërkombëtare të shtetit janë të obliguar të kenë sigurim jetësor në rast të vdekjes, humbjes së përhershme dhe të përkohshme të aftësive të tyre për punë.
4. Bazuar në vendimet e marra nga organi përkatës dhe në përputhje me planet e reagimit emergjent çdo njësi, shërbim apo strukturë operative mund të dislokohet në rajonet kufitare për të ofruar ndihmë në zonat kufitare të vendeve tjera.

Neni 85
Përgjegjësi për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë

1. Përgjegjësi për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë duhet të caktohet në ndërtesat e banimit, institucionet dhe organizata tjera në përputhje me rreziqet në zonat e banuara.
2. Përgjegjësi i mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës duhet të drejtoj zbatimin e mbrojtjes personale dhe reciproke të banorëve të organizoj dhe koordinoj zbatimin e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës brenda zonës së tyre.

Neni 86
Simbolet

1. Simbolet e pjesëtarëve të angazhuar në SMSHN përfshinë:
   1.1. simbolin që dëshmon anëtarësinë;
   1.2. simbolin që dëshmon pozitën;
   1.3. simbolin që dëshmon fushëveprimin përkatës.
2. Ndalohet riprodhimi, apo përdorimi i paautorizuar i Simboleve dhe uniformës dhe çdo riprodhim i Simboleve të mjeteve të qarkullimit të njësive dhe shërbimeve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.
3. Simboli përcaktohet me akt nënligjor nga Qeveria.
4. Me akt nënligjor Ministria përcakton llojin, formën dhe modelin e uniformës për SMSHN.

Neni 87
Shpërblimet dhe mirënjohjet

1. Për rezultatet e dalluara në fushën e mbrojtjes dhe të shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, jepen mirënjohje dhe shpërblime për:
   1.1. kontribut në parandalimin e rreziqeve;
   1.2. kontribut në zbatimin e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;
   1.3. veprime të guximshme;
   1.4. shpikje dhe inovacione;
   1.5. arritje në zhvillim dhe hulumtim;
   1.6. arritje në trajnime dhe aftësim;
   1.7. veprën jetësore në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.
2. Mirënjohjet dhe shpërblimet, nga paragrafi 1. e këtij neni përcaktohen me Akt nënligjor, nga Qeveria me propozimin e Ministrisë.

Neni 88
Kuvendi i Republikës së Kosovës

1. Në kuptim të këtij ligji Kuvendi kryen detyrat si më poshtë:
   1.1. përcakton kahjet themelore të organizimit dhe zbatimit të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

1.2. miraton programin kombëtar për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, të propozuar nga Qeveria;
1.3. mbikëqyr zbatimin e planit kombëtar dhe zbatimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
1.4. me propozimin e Qeverisë, merr vendime lidhur me furnizimin me resurse dhe çështje tjera të rimëkëmbjes nga fatkeqësitë e mëdha natyrore.

Neni 89
Qeveria e Republikës së Kosovës

1. Qeveria kryen detyrat si më poshtë:
1.1. drejton dhe koordinon organizimin, përgatitjen dhe zbatimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në vend;
1.2. miraton planin vjetor për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
1.3. miraton planet kombëtare të reagimit emergjent;
1.4. menaxhon mbrojtjen, shpëtimin, ndihmën dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë e mëdha natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
1.5. aranzhon ndihmën ndërkombëtare në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
1.6. propozon kuvendit miratimin e programin kombëtar për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Neni 90
Komisionet për vlerësimin e dëmeve

1. Vlerësimi i dëmeve në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera dhe përgatitja e propozimeve për rimëkëmbje nga fatkeqësitë e tilla, bëhet nga komisionet në nivel qendror dhe lokal.
2. Anëtarët e komisioneve nga paragrafi 1. të këtij neni, caktohen në cilësinë e ekspertëve, përfaqësuesit e administratës publike, komunitetet lokale, shërbimet publike, organizatat dhe kompanitë e sigurimeve.
3. Nga palët e dëmtuara kërkohet që të grumbullojnë prova lidhur me dëmet e pësuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera me shpenzime të tyre dhe t'i dorëzojnë tek komisioni përkatës për vlerësim dhe miratim.
4. Me propozim të Ministrisë, Qeveria me akt nënligjor përcakton përbërjen e komisioneve dhe metodologjinë e vlerësimit të dëmeve materiale dhe pasojave tjera të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Neni 91
Detyrat e Kryetarit të Komunës

1. Kryetari i Komunës kryen detyrat si më poshtë:
1.1. kujdeset për realizimin e përgatitjeve për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
1.2. miraton planet e reagimit emergjent në nivel komunal;

1.3. përcakton llojin dhe madhësinë e SMSHN;
1.4. kujdeset për implementimin e masave për parandalimin dhe lehtësimin e pasojave të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera;
1.5. menaxhon mbrojtjen, shpëtimin ndihmën dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
1.6. kujdeset për njoftimin e banorëve për rrezikun, gjendjen e mbrojtjes dhe masat e ndërmarra për mbrojtje;
1.7. cakton Komandantin e Incidentit me rekomandimin e Menaxherit Emergjent.

Neni 92
Menaxhmenti

1. Menaxhmenti i ndërmarrjeve, institucioneve dhe organizatave tjera ka për detyrë të:
   1.1. kujdeset për implementimin e përgatitjeve për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
   1.2. menaxhon mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.
2. Me qëllim të menaxhimit operativ dhe teknik të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, menaxhmenti cakton Komandantin e Incidentit, apo menaxherin dhe miraton planet e reagimit emergjent.
3. Komandanti i Incidentit dhe strukturat e përcaktuara në paragrafin 2. të këtij neni caktohen nga përfaqësues të ndërmarrjeve, institucioneve dhe organizatave tjera dhe nga institucionet të cilat ofrojnë trajtim mjekësor të rëndësisë regjionale.

KREU IX
ADMINISTRIMI

Neni 93
Detyrat e Ministrive

1. Qeveria i drejton dhe koordinon aktivitetet e Ministrive në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
2. Ministritë përkatëse janë përgjegjëse për zbatimin e masave për parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, respektivisht zvogëlimin e pasojave brenda kompetencave të tyre.
3. Ministritë përkatëse janë përgjegjëse për gjendjen e gatishmërisë për kryerjen e aktiviteteve brenda kompetencave të tyre në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.
4. Detyrat dhe përgjegjësit e institucioneve qendrore dhe strukturave te reagimit emergjent përcaktohen ne Planin e Reagimit Kombëtar.

Neni 94
Agjencia e Menaxhimit Emergjent dhe detyrat e saj

1. Agjencia e Menaxhimit Emergjent vepron si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe i përgjigjet drejtpërsëdrejti Ministritë.
2. Agjencia udhëhiqet nga Kryeshefi në pajtueshmëri me rregullat në fuqi për emërimin e nëpunësve të lartë në shërbimin civil.
3. Struktura organizative e Agjencisë rregullohet ma akt nënligjor të miratuar nga Qeveria.
4. Agjencia kryen detyra menaxheriale dhe teknike të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, veçanërisht në:
   4.1. elaborimin e propozimeve për projekte zhvillimore dhe kërkimore;
   4.2. elaborimin e propozimit për programin dhe planin kombëtar;
   4.3. kujdeset për organizimin dhe funksionimin e sistemit të monitorimit, lajmërimit dhe alarmimit,
   4.4. planifikimin, ngritjen, funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemit unik të komunikimit, informimit dhe përcaktimit të kushteve teknike për integrimin e sistemeve tjera;
   4.5. elaborimin e vlerësimit të rreziqeve dhe dokumenteve teknike për planifikimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës si dhe drejtimin dhe koordinimin e masave për parandalim dhe lehtësimin e pasojave;
   4.6. monitorimin dhe lajmërimin e rrezikut dhe dhënia e udhëzimeve për përballje me to;
   4.7. hartimin e draft planeve kombëtare të reagimi emergjent në bashkëpunim me ministritë dhe agjencitë qeveritare;
   4.8. organizimin, pajisjen dhe trajnimin e strukturave qendrore të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës dhe strukturave tjera të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës si dhe krijimin e kushteve për funksionimin e strukturave organizative të Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Emergjencave;
   4.9. mbikëqyrjen dhe koordinimin e organizimit të SMSHN dhe shërbimeve tjera.
   4.10. përgatitjen e plan programeve, organizimin dhe realizimin e trajnimeve dhe aftësimit në fushën e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;
   4.11. klasifikimin e resurseve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë dhe
   4.12. krijimin dhe mirëmbajtjen e rezervave materiale kombëtare për raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.
5. Agjencia është përgjegjës për zhvillimin e koordinuar të SMSHN në vend, në përputhshmëri me vlerësimin e rreziqeve dhe planeve të reagimit emergjent dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria.
6. Në fushën e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës Agjencia ka të drejtë që në bazë të vendimeve të marra nga Qeveria apo në bazë të kërkesës së komandantit të incidentit të siguroj për popullatën e goditur resurse ndihmash apo pajisje dhe mjete specifike të mbrojtjes dhe shpëtimit të domosdoshme për veprimin e strukturave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës dhe shërbimeve tjera emergjente.
7. Ndihma në resurse, pajisje dhe mjete të mbrojtjes mund të jetë pa pagesë dhe e bazuar në një marrëveshje përkatëse.

8. Ndihma e tillë, në mënyrë të veçantë, mund të jepet për të siguruar nivelin e duhur të gatishmërisë për zbatimin e detyrave të caktuara të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në përputhje me standardet e përcaktuara nga Ministria.

KREU X
MBIKËQYRJA

Neni 95
Zyra e Inspektorit Kryesor

1. Monitorimi i zbatimit të këtij Ligji, në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera mbikëqyret nga Zyra e Inspektorit Kryesor të Agjencisë.
2. Inspektori Kryesor gjatë zhvillimit të inspektimit mbikëqyrë:
   2.1. zbatimin e masave për parandalimin dhe lehtësimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
   2.2. gjendjen e planeve dhe përgatitjeve të tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;
   2.3. zbatimin e detyrave të monitorimit, lajmërimit dhe paralajmërimit;
   2.4. aftësitë, pajisjet dhe gatishmërinë e SMSHN dhe shërbimeve tjera emergjente.
   2.5. mënyrën e trajtimit të çështjeve administrative dhe teknike në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
3. Ministria me akt nënligjor përcakton mënyrën e mbikëqyrjes nga Inspektori Kryesor në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

KREU XI
PUNA PROFESIONALE, SHËNDETI DHE SIGURIA NË PUNË

Neni 96
Kushtet e veçanta të punës

1. Për punëtorët për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera, vlejnë dispozita për shërbyesit civil të legjislacionit në fuqi, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.
2. Në përputhshmëri me rregullat e përgjithshme, nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit në detyra të caktuara të përshkruara në sistematizim janë të obliguar të punojnë sipas kërkesave të shërbimit në kushte të veçanta, përfshirë punën gjatë natës, vikendeve, festave, ditëve të lira, detyrave të rregullta apo të përkohshme, punën në terren apo punën sipas orarit jo të rregullt.
3. Për shkak të kërkesave të shërbimit, nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit janë të obliguar të punojnë në bazë të vendimit të mbikëqyrësit të tyre në kushte të posaçme të punës sipas orarit jo të rregullt dhe nën kushte jo të rregullta të punës, përfshirë rreziqet dhe ngarkesat e veçanta në punë.
4. Puna jashtë orarit, angazhimi, detyra në gatishmëri apo puna në një vend tjetër specifik duhet të urdhërohet, përveç në rastet e përcaktuara me rregullat e përgjithshme, edhe për shkak të kërkesave të shërbimit në vijim:

4.1. kërcënimi i drejtpërdrejt nga fatkeqësia natyrore apo fatkeqësia tjetër apo kërcënimi i shpallur nga lëndët djegëse;

4.2. rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera që kërkojnë përforcime në trupa menaxhues, shërbime, njësi dhe struktura operative që kryejnë operacione të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës apo kur operacionet e tilla duhet të vazhdojnë më tutje;

4.3. rrethanat në të cilat është ofruar ndihma në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera në komunitetet apo vendet tjera apo edhe në organizatat ndërkombëtare bazuar në vendimet e autoriteteve;

4.4. në situatat pas ndodhjes së fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera në të mirë të furnizimit me kushtet elementare për jetë në zonat e goditura, përfshirë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia;

4.5. një kërcënim i shtuar nga sulmi në vend, kërcënimi i drejtpërdrejt nga lufta, gjendja emergjente, shtimi i nivelit të gatishmërisë për shkak të situatave krize apo nëse situata e ndryshuar e sigurisë paraqet rrezik ndaj njerëzve, të mirave materiale, kafshëve, trashëgimisë kulturore apo mjedisit në shkallë të gjerë;

4.6. vazhdimi i punës në mungesë apo humbje të punëtorëve, për të siguruar funksionim të papenguar të qendrave emergjente të paralajmërimit dhe shërbimeve të kujdestarisë në kapacitetin e domosdoshëm, për zbatimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës si dhe mbështetjen e shërbimeve të lartpërmendura.

5. Puna jashtë orarit urdhërohet me shkrim. Nëse kjo nuk është e mundur për shkak të urgjencës së mbrojtjes dhe shpëtimit duhet të urdhërohet verbalisht. Në raste të tilla urdhri me shkrim duhet t'i dorëzohet shërbyesit civil jo më vonë se fundi i javës nga java në të cilën është dhënë urdhri. Puna jashtë orarit mund të zgjasë deri në gjashtë (6) orë për ditë, njëzet (20) orë për javë, tetëdhjetë (80) orë për muaj dhe njëqindetetëdhjetë (180) orë për vit. Afatet kohore duhet të përcaktohen duke u bazuar në mesataren gjashtëmujore.
6. Nëpunësve civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit, duhet tu jepet e drejta në përfitimin e shtesave të veçanta për punën në kushte të posaçme në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi.
7. Nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit, të caktuar nga mbikëqyrësit e tyre, si dhe ata të cilët kryejnë detyra operative, janë të obliguar të bartin me vete pajisjet teknike në mënyrë që të jenë të informuar për rrezikun apo ndodhin e fatkeqësisë, përveç gjatë pushimeve vjetore apo kur janë jashtë vendit.
8. Nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit të caktuar në detyra operative të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, janë të obliguar të jenë të siguruar për raste të humbjes së jetës, humbjeve të përhershme apo të përkohshme të aftësive të përgjithshme të punës që ndodhin në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, si dhe gjatë ushtrimeve, arsimimit apo trajnimeve.
9. Pjesëtarët e SMSHN-së dhe qytetarët që marrin pjesë vullnetarisht në detyrat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës sipas këtij ligji, kërkohet gjithashtu të kenë sigurim të veçantë.
10. Të drejtë në sigurim afatgjatë apo në sigurim të detyrueshëm pensional, kanë shërbyesit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit të caktuar në detyra operative të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 97
Kompensimi për punë ne kushtet e veçanta

1. Nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera te cilët janë të obliguar te punojnë në kushte te veçanta përveç kompensimit te përcaktuar ne ligjin për pagat e nëpunësve civil do te përfitojnë si ne vijim.
   1.1. njëzet përqind (20%), kur kryejnë detyra organizative, menaxhuese, inspektuese apo operative;
   1.2. pesëmbëdhjetë përqind (15%), kur kryejnë detyra profesionale dhe teknike të lidhura me zbulimin, sigurimin, zhvendosjen dhe shkatërrimin e mjeteve eksploduese;
   1.3. dhjetë përqind (10%), kur kryejnë detyra teknike, analitike, mbikëqyrëse dhe detyra tjera operative;
   1.4. pesë përqind (5%), kur kryejnë detyra teknike dhe fizike ndihmëse.
2. Përqindja e përfitimit nga paragrafit 1. i këtij neni përcaktohet në raport me shtrirjen, llojin dhe natyrën e punës së kryer në kushte të posaçme dhe jashtë përgjegjësisë.

Neni 98
Puna në ndërrime të ndara dhe orët e ndryshuara të punës

1. Ngarkesa ditore e punës së nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit nuk duhet t'i kaloj dymbëdhjetë (12) orë në ditë. Mesatarja e ngarkesës ditore të punës së punëtorëve duhet të llogaritet si mesatare e ngarkesës së punës për periudhën e cila nuk duhet kaluar gjashtë muaj.
2. Puna me ndërrime përfshinë të punuarit në rotacion ku punëtorët punojnë sipas orarit dymbëdhjetë (12) orësh, të përcjellur me njëzetekatër (24) apo dyzetetetë (48) orë pushim dhe të punuarit sipas orarit të posaçëm në mëngjes, pasdite por jo sipas radhës. Nëse puna kryhet në ndërrime apo në rotacion, duhet të sigurohet ndryshimi periodik i ndërrimeve.
3. Nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit të cilët punojnë me ndërrime duhet tu jepet pushimi minimal ditor dhe javor i përcaktuar në afatin i cili nuk i kalon gjashtë (6) muaj.
4. Nëse shërbyesi civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit detyrohet të punoj gjatë ditëve të lira për shkak të kërkesave të shërbimit, atij duhet t'i jepet pushimi javor në muajin aktual apo më së voni në muajin pasues.
5. Puna në ndërrime mund të urdhërohet bazuar në vendimin e mbikëqyrësit për shkak të kërkesave të shërbimit sipas paragrafit 4. të nenit 101 të këtij ligji, masa e përkohshme për të siguruar kushtet elementare për jetë në zonën e goditur apo derisa nuk është më e nevojshme puna në ndërrime.
6. Nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit të cilët punojnë në ndërrime apo në rrotacion duhet të kenë të drejt në pagesë të mjeteve ekzistenciale, nëse është e pamundur të sigurohen shujta gjatë kohës së rregullt të punës. Pagesa ekzistenciale për punën gjatë natës duhet të jetë tridhjetë përqind (30%) më e lartë.

Neni 99
Puna përtej ngarkesës së përcaktuar

Nëse puna e nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit tejkalon normën e përcaktuar mujore apo javore, diferenca duhet të llogaritet si punë jashtë orarit e cila nuk duhet t'i kaloj njëzet (20) orë për javë apo tetëdhjetë (80) orë për muaj, nëse nuk është e mundur të ndryshohet orari i punës sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 100
Shërbimi i kujdestarisë dhe kushtet tjera të posaçme të punës

1. Nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit duhet të kryejnë shërbim kujdestarie si mënyrë e rregullt apo të veçantë në vendin e punës apo në ndonjë vend tjetër të paracaktuar.
2. Qëndrimi në thirrje në shtëpi nuk duhet të llogaritet në obligim normativ javor apo mujor. Nëse nëpunësi civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit kryen punë gjatë kohës në thirrje, ato orë duhet të llogariten si punë jashtë orarit.
3. Bazuar në vendimin e mbikëqyrësit i cili është marrë nga ai vetë apo me kërkesën e komandantit të incidentit, nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit duhet të vazhdojnë punën nëse fatkeqësia natyrore apo fatkeqësia tjetër ndodh gjatë orarit të rregullt të punës dhe operacionet e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës nuk kanë përfunduar gjatë orarit të rregullt të punës. Kjo punë duhet të konsiderohet si punë jashtë orarit.

Neni 101
Puna në kushte të papërshtatshme

1. Nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit janë të detyruar të punojnë në kushte të papërshtatshme ku përfshihen zhurma, dridhjet, zonat e ndotura, aerosole, gazrat, substancat e rrezikshme kimike,mjete eksploduese dhe eksplozive dhe substancat tjera të rrezikshme, nëse janë të trajnuar për zbatimin e detyrave në kushte të tilla dhe të pajisur me pajisje mbrojtëse personale.
2. Nëse nëpunësi civil nuk posedon pajisjet mbrojtëse personale të nevojshme, ka të ketë të drejtë ta refuzoj detyrën e tillë dhe menjëherë ta informoj eprorin tjetër më të lartë.
3. Nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit të cilët kanë mbet të paaftë për shkak të lëndimeve të pësuara në punë, apo sëmundje profesionale apo në zbatimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, do të ricaktohen në vende tjera të punës te organit përkatës në raport me aftësitë e mbetura për punë apo u jepet e drejta për rehabilitim profesional.
4. E drejta për ricaktim në detyrë në organet lokale apo rehabilitimit profesional vlen edhe për nëpunësit civil të nivelit lokal në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit. Nëse ricaktimi është i pamundur apo nëse rehabilitimi profesional nuk mund të llogaritet i përshtatshëm, atëherë në rrethana të tilla aplikohet legjislacioni në fuqi.

Neni 102
Ditët e lira shtesë dhe kohëzgjatja e kompensimit nga shërbimi

1. Me qëllim të mirëmbajtjes së gjendjes psikofizike të nëpunësve civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit i caktuar në detyra operative të zhytjes apo të mbrojtjes nga ngjarjet e papritura, ju jepet pesëmbëdhjetë (15) ditë të lira shtesë të pushimit të rregullt vjetor.
2. Nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit që janë të caktuar në detyra operative të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në përputhje me sistematizimin e tyre për më shumë se dhjetë vite kanë të drejtë që për çdo vit shërbimi të përfitojnë pesë përqind (5%) të pagës bazë në shërbim.
3. Ministria me akt nënligjor përcakton mënyrën dhe rrethanat në të cilat mund të përdoren këto ditë të lira.

Neni 103
Ndihma juridike

1. Nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit të cilët janë subjekt i shkeljeve si pasoj e veprimeve të tyre në kryerjen e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës kanë të drejt në ndihmë juridike pa pagesë të siguruar nga organet qendrore apo lokale.
2. Ndihma juridike duhet t'i sigurohet nëpunësve civil nga një organ, nëse vlerësohet se ata kanë vepruar në përputhshmëri me rregullat dhe standardet profesionale të cilat vlejnë për zbatimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.
3. E drejta në ndihmë juridike pa pagesë duhet të vlej edhe për qytetarët e angazhuar në strukturat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, për kohëzgjatjen e angazhimit.

Neni 104
Shëndeti dhe siguria në punë

1. Për zbatimin e detyrave në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera duhet të aplikohen dispozitat e legjislacionit që rregullojnë çështjet e shëndetit dhe sigurisë në punë, nëse me këtë Ligj nuk parashihet ndryshe.
2. Ministria me akt nënligjor përcakton masat dhe procedurat për sigurimin e shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve, pjesëtarëve të SMSHN, si dhe pjesëtarëve të njësive, shërbimeve dhe strukturave operative brenda shoqatave dhe organizatave tjera joqeveritare.

Neni 105
Greva

1. Gjatë grevave, personat e angazhuar profesionalisht në mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera janë të detyruar të sigurojnë:
   1.1. veprim të pandërprerë të sistemit të monitorimit, paralajmërimit, alarmimit dhe komunikimit elektronik;
   1.2. veprim të pandërprerë të zbatimit të detyrave operative dhe teknike në

mënyrë që të sigurohet veprimi i strukturave apo organeve tjera menaxhuese të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.

2. Gjatë fatkeqësisë natyrore apo fatkeqësisë tjetër apo kur shpallet rreziku i pashmangshëm i ndodhjes së fatkeqësisë, personave nga paragrafi 1. i këtij neni u mohohet e drejta për hyrje në grevë.
3. Përdorimi i sinjaleve të alarmit dhe pajisjeve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës për qëllime të grevës është i ndaluar.

KREU XII
ARSIMIMI DHE TRAJNIMI

Neni 106
Arsimimi

1. Arsimi elementar siguron njohuri bazike mbi rreziqet nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe për mënyrën e mbrojtjes nga fatkeqësitë e tilla.
2. Arsimi sekondar dhe universitar siguron njohuri mbi mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në vartësi të fushës së arsimit.

Neni 107
Trajnimet për mbrojtje personale dhe reciproke

Trajnimi i banorëve për mbrojtje personale dhe reciproke dhe për zbatimin e masave mbrojtëse sigurohet nga niveli qendror dhe niveli lokal si trajnim jo i detyrueshëm.

Neni 108
Trajnimi dhe ngritja profesionale

1. Trajnimi i pjesëtarëve të SMSHN-së dhe shërbimeve tjera emergjente për kryerjen e detyrave në këtë fushëveprim duhet të përfshij trajnimet bazike dhe të avancuara.
2. Trajnimet bazike të pjesëtarëve të SMSHN-së dhe shërbimeve tjera emergjente nuk duhet t'i kalojnë pesëmbëdhjetë (15) ditë, ndërsa ato të avancuara nuk duhet t'i kalojnë pesë (5) ditë për vit.
3. Sipas rregullave trajnimet avancuese duhet të organizohen dhe realizohen në ditët e lira.
4. Pjesëtarët e SMSHN-së dhe shërbimeve tjera emergjente thirren në trajnime nëpërmjet mjeteve që përdoren për thirrje në aktivizim. Sipas rregullave, ftesa duhet tu dorëzohet atyre tridhjetë (30) ditë para fillimit të trajnimit.

Neni 109
Mospjesëmarrja në trajnime

1. Me kërkesën e tij, pjesëtarit të SMSHN-së i mundësohet lirimi i përkohshëm nga trajnimet kur ai:
   1.1. është i paaftë të marr pjesë në trajnim për shkak të sëmundjes apo lëndimeve;

1.2. në kohën e thirrjes për pjesëmarrje në trajnim gjendet në shkollë apo kur për trajnimin në fjalë ai është caktuar të bëjë ndonjë kontroll, test apo merr pjesë në ushtrime të detyrueshme;
1.3. është duke u kujdesur për anëtarin e tij të familjes me ndonjë sëmundje të rëndë;
1.4. pas pranimit të thirrjes për pjesëmarrje në trajnim i ndodh rast vdekjeje në familje; apo
1.5. me pjesëmarrje në trajnim ai do të futet në situatë të vështir për shkak të arsyeve tjera.

2. Lirimi nga trajnimi mund të bëhet edhe për arsye të domosdoshmërisë në punë dhe aktiviteteve bujqësore.
3. Kërkesa për mungesë në trajnim i dorëzohet organit përgjegjës, brenda tetë (8) ditëve nga data e thirrjes, përkatësisht nga data e ndodhjes së arsyes për mungesë.

Neni 110
Qendra e trajnimeve

1. Me qëllim të trajnimit dhe aftësimit profesional në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera themelohet Qendra e Trajnimeve te Integruara ne kuadër te Agjencisë së Menaxhimit Emergjent.
2. Qendra e Trajnimit është përgjegjëse për zbatimin e programeve të caktuara të trajnimeve për pjesëtarët e SMSHN-së dhe shërbimeve tjera emergjente pjesëtarëve të njësive, shërbimeve dhe strukturave tjera operative të shoqatave, organizatave joqeveritare dhe institucioneve tjera.

Neni 111
Programet e Trajnimit

1. Trajnimi dhe aftësimi profesional në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera duhet të organizohen në bashkëpunim me institucionet përkatëse qendrore dhe lokale
2. Ministria miraton zbatimin e programeve të trajnimit të përshtatura në bazë të obligimeve të shtetit në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në organizatat ndërkombëtare në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare.
3. Ministria me akt nënligjor përcakton programet e trajnimeve bazike dhe të avancuara, për pjesëtarët e njësive, shërbimeve, shoqatave, organizatave joqeveritare, institucioneve dhe ndërmarrjeve si dhe kushtet që duhet plotësuar organizatat që ofrojnë trajnime në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

KREU XIII
FINANCIMI

Neni 112
Burimet financiare

1. Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera financohet nga:
   1.1. Buxheti i Republikës së Kosovës;
   1.2. Buxheti i komunave;
   1.3. kështet e sigurimeve;
   1.4. kontributet vullnetare;
   1.5. ndihmat ndërkombëtare;
   1.6. burimet financiare të ndërmarrjeve, institucioneve dhe organizatave tjera;
   1.7. burimet tjera.

Neni 113
Shpenzimet e përgjithshme

1. Aktivitetet administrative, teknike, mbikëqyrëse dhe aktivitetet tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera brenda kompetencave të shtetit financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës.
2. Financimin e aktiviteteve të lidhura me mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe çështjeve tjera në nivelin lokal e bëjnë organet lokale brenda kompetencave të tyre.
3. Organet në nivelin qendror dhe lokal në përputhje me përgjegjësitë e tyre sigurojnë burime financiare për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës të domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve, të mirave materiale dhe mjedisit.
4. Ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera për të cilat kërkohet të organizojnë struktura për mbrojtje dhe shpëtim si dhe të zbatojnë masa dhe detyra që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, sigurojnë mjetet financiare për kompensimin e humbjeve të punëtorëve në aspektin e të hyrave gjatë trajnimeve sikurse edhe burimet financiare për t'i mbuluar shpenzimet për ushtrimet përgatitore dhe shpenzimet tjera lidhur me mbrojtjen.
5. Shpenzimet e operacioneve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në raste të aksidenteve të shkaktuara nga persona të panjohur mbulohen si shtesë nga niveli lokal ku ka ndodhur aksidenti i tillë, apo nga niveli qendror nëse detyrat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës janë nën përgjegjësinë e tij.

Neni 114
Financimi i rimëkëmbjes dhe rindërtimit

Burimet financiare për përfitimin e ndihmës për rindërtim dhe rimëkëmbje sigurohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës me vendim të Qeverisë.

Neni 115
Mbulimi i shpenzimeve

1. Personi fizik apo juridik i cili me qëllim apo për shkak të neglizhencës shkakton kërcënim që përfundon me kosto të intervenimit emergjent apo shkakton një aksident është i obliguar t'i mbuloj shpenzimet e:
   1.1. intervenimeve për mbrojtje dhe shpëtim;
   1.2. rimëkëmbjes dhe sanimit;
   1.3. dëmet e paguara për personat fizik dhe juridik.
2. Nëse kërcënimi apo aksidenti është shkaktuar nga më shumë se një person dhe nuk është i mundur identifikimi individual i tyre, ata janë përgjegjës për shlyerjen e shpenzimeve së bashku pa dallim.
3. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, çdo person fizik apo juridik i cili për shkak të neglizhencës, mungesës së trajnimeve apo për shkak të pajisjes jo adekuate shkakton kërcënim apo një aksident apo gjendje e cila ka rezultuar me shpenzime të intervenimeve emergjente, janë të obliguar t'i shlyejnë shpenzimet në mënyrë proporcionale pjesët e shpenzimeve të intervenimeve të përcaktuara nga Qeveria.
4. Qeveria i përcakton aktivitetet për të cilat pjesëmarrësit janë të obliguar të mbulojnë pjesën proporcionale të dëmit pa marr parasysh shkakun dhe përgjegjësinë për një aksident për të cilin pjesëmarrësit kanë nevojë për sigurim në aksident. Pjesa proporcionale e kostos intervenuese do të mbulohet nga një kompani e sigurimit apo vet pjesëmarrësit nëse nuk janë të siguruar.
5. Mjetet financiare të grumbulluara nga pagesat e intervenimeve emergjente apo intervenimeve proporcionale do të konsiderohen mjete të destinuara për shërbimin e shpëtimit apo strukturave operative të cilët kanë kryer intervenimin dhe mund të përdoren vetëm për aktivitetet e tyre sipas këtij ligji.

KREU XIV
DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 116
Gjobat

1. Me gjobë prej njëmijë (1.000) deri pesëmijë (5.000) Euro, dënohet personi fizik apo juridik, nëse:
   1.1. nuk e lajmëron menjëherë qendrën më të afërt të alarmimit, njësinë policore apo të zjarrfikjes për rrezikun nga fatkeqësia natyrore apo fatkeqësia tjetër qoftë nëse e sheh vet apo njoftohet për të sipas neni 6 të këtij ligji;
   1.2. nëse nuk i kryen apo në ndonjë mënyrë tjetër i ikën kryerjes së obligimeve materiale të përcaktuara në paragrafi 1. neni 25 të këtij ligji;
   1.3. punëdhënësi e largon nga puna apo ja ndërron vendin e punës pjesëtarit të SMSHN apo qytetarit i cili vullnetarisht merr pjesë në zbatimin e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës sipas këtij ligji, apo shkakton çfarëdo dëmi tjetër për shkak të kryerjes së detyrave të përcaktuara në paragrafin 4. neni 27 të këtij ligji;

1.4. nëse në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nuk e lajmëron organin përkatës për ndryshimet e të dhënave të përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji;
1.5. nëse nuk siguron kushte apo mundësi për realizimin e mbrojtjes personale dhe reciproke të punëtorëve, apo nuk i realizon masat e parapara mbrojtëse të përcaktuara në paragrafin 1. neni 38 të këtij ligji;
1.6. nëse në procesin e punës përdor, prodhon, transporton apo deponon materie të rrezikshme, naftë dhe derivate të saj dhe nëse kryen aktivitete ose punon me mjete të prodhimit që paraqesin rrezik për ndodhjen e fatkeqësive, apo nuk bën vlerësimin e rrezikut dhe planin e reagimit emergjent sipas paragrafi 2. të nenit 38 të këtij ligji;
1.7. nëse në relacion me gjerësinë dhe shkallën e rrezikut, me shpenzimet e tija nuk themelon dhe mirëmban gatishmërinë për veprim apo nuk bënë organizimin e forcave të nevojshme për shpëtim dhe ndihmë apo nuk siguron njoftim dhe alarmim të punëtorëve dhe popullatës përreth, për rrezikun apo nuk bënë bashkëfinancimin e aktiviteteve përgatitore të ndërmarrjeve fqinje, institucioneve dhe organizatave tjera apo organeve lokale proporcionalisht me rrezikun e krijuar nga aktiviteti i tij sipas paragrafit 3. të nenit 38 të këtij ligji;
1.8. nuk bënë përpunimin e planeve të reagimit emergjent apo nuk bënë planifikimin e zbatimit të masave të mbrojtjes dhe detyrave të caktuara të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera të përcaktuara në paragrafin 4. të nenit 38 të këtij ligji;
1.9. nëse si pronar ose shfrytëzues i ndërtesave të banimit apo i ndërtesave të tjera nuk ndërmerr masa të parapara mbrojtëse, apo nuk siguron mjete të parapara mbrojtëse për shpëtim dhe ndihmë sipas paragrafit 1. të nenit 39, apo nëse nuk ndërmerr masa të parapara për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe mjedisit sipas paragrafit 2. të nenit 39 të këtij ligji;
1.10. nëse si pronar apo shfrytëzues i ndërtesave banesore, apo ndërtesave të tjera nuk ndihmon punën e përgjegjësit kompetent të mbrojtjes dhe shpëtimit, apo nuk i ofron atij të dhënat për ndërtesën, ose të dhënat për banorë dhe shfrytëzues të tjerë të ndërtesës sipas paragrafit 3. të nenit 39 të këtij ligji;
1.11. nëse me kërkesën e Kryetarit të Komunës nuk i harton planet e reagimit emergjent të përcaktuara në paragrafin 3. të nenit 46 të këtij ligji;
1.12. nëse si pronar apo shfrytëzues i objekteve të destinuara për furnizim publik me ujë, për prodhim, transport apo deponim të ushqimit, medikamenteve apo ushqimit të kafshëve, shërbimeve publike shëndetësore apo kujdesit dhe edukimit të fëmijëve, nuk siguron mjete mbrojtëse apo nuk zbaton masat e përcaktuara për mbrojtje radiologjike, kimike dhe biologjike sipas paragrafit 2. të nenit 61 të këtij ligji;
1.13. nëse si investitor nuk siguron ndërtim të strehimoreve sipas dispozitave të nenit 64 të këtij ligji;
1.14. nëse si pronar apo shfrytëzues i strehimoreve nuk mirëmban ato në gjendjen që përputhet me qëllimin e tyre, apo në rast të emergjencës nuk ua mundëson qasjen apo përdorimin e këtyre personave, për të cilët është e destinuar ajo sipas dispozitave të nenit 65 të këtij ligji;
1.15. nëse nuk bën organizimin përkatës për kryerjen e detyrave apo nuk kujdeset

për aftësimin profesional të punëtorëve të tij ose nuk ndërmerr përgatitje të tjera për veprim në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera sipas paragrafit 2. të nenit 73 të këtij ligji;

1.16. nëse pengon zbatimin e masave apo nëse nuk vepron në përputhje me masat e përcaktuara gjatë menaxhimit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga Komandanti i Incidentit të përcaktuara në paragrafët 1.,3. dhe 4. të nenit 82 të këtij ligji;

1.17. nëse i kopjon, apo në mënyrë të paligjshme i përdor shenjat dhe uniformën SMSHN-së, apo i kopjon dhe i përdor në qarkullim rrugor automjetet e ngjashme me automjetet dhe mjetet tjera transportuese të SMSHN-së, sipas paragrafi 2. të nenit 86 të këtij ligji;

1.18. nëse vepron në kundërshtim me masat e shqiptuara nga Zyra e Inspektorit Kryesor të AME-së sipas dispozitave të nenit 95 të këtij ligji.

2. Me gjobë prej njëqind (100) deri dyqindepesëdhjetë (250) Euro, dënohet personi përgjegjës i personit juridik, apo personi përgjegjës i personit të vetëpunësuar nëse vepron në kundërshtim me paragrafin 1. të këtij neni.

Neni 117

Me gjobë prej njëmijë (1000) deri njëmijepesëqind (1.500) Euro, për kundërvajtje dënohet ndërmarrja, institucioni apo organizata, nëse nuk vendosin, mirëmbajnë dhe sigurojnë funksionimin e aparateve për paralajmërimin e popullatës apo nëse aparatet e tilla nuk i integrojnë në sistemin publik të alarmimit të përcaktuara në paragrafin 3. të nenit 38 të këtij ligji.

Neni 118

1. Me gjobë prej njëmijë (1.000) deri njëmijepesëqind (1.500) Euro, për kundërvajtje dënohet personi përgjegjës i organit qendror apo lokal nëse:
   1.1. nuk bënë vlerësimin e rreziqeve për zonën e tij të përgjegjësisë sipas paragrafit 2., nën-paragrafi 2.5. të nenit 37 të këtij ligji;
   1.2. nuk i punon planet lokale të reagimit emergjent sipas paragrafit 2., nën-paragrafi 2.5. të nenit 37 të këtij ligji;

Neni 119

1. Me gjobë prej dyqind (200) deri pesëqind (500) Euro, për kundërvajtje dënohet personi i cili:
   1.1. në cilësinë e pjesëtarit të SMSHN-së nuk e kryen, apo i ikën pa arsye pjesëmarrjes në struktura sipas paragrafit 1. të nenit 16 të këtij ligji;
   1.2. në cilësinë e pjesëmarrësit vullnetar, në SMSHN nuk trajnohet për kryerjen e detyrave në përputhje me rregulloret sipas paragrafit 3. të nenit 16 të këtij ligji;
   1.3. nuk i përmbush obligimet materiale duke i vënë në dispozicion të SMSHN-së, për përdorim automjetet, makineritë, pajisjet dhe mjetet tjera materiale, objektet, ndërtesat, mjetet dhe burimet e energjisë të nevojshme për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, sipas paragrafit 1. të nenit 25 i këtij ligji;

1.4. pa arsyetim, nuk lajmërohet në kohën apo vendin e caktuar, apo nuk dorëzon mjetet materiale me kërkesën e përgjegjësit sipas paragrafit 1. të nenit 26 të këtij ligji;

1.5. në cilësinë e pronarit apo shfrytëzuesit të shtëpisë së banimit me kërkesën e kryetarit të Komunës refuzon strehimin e banorëve të evakuuar dhe njerëzve në rrezik sipas paragrafit paragrafi 2. të nenit 60 të këtij ligji;

2. Me gjobë prej njëmijë (1.000) deri njëmijepesëqind (1.500) Euro, për kundërvajtje dënohet personi i cili pengon zbatimin e masave apo nuk vepron në përputhshmëri me masat e caktuara nga Komandanti i Incidentit gjatë menaxhimit të mbrojtjes dhe shpëtimit të përcaktuara në paragrafët 1., 3., 4. të nenit 82 të këtij ligji.

KREU XV
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 120
Nxjerrja e akteve nënligjore

Organet e përcaktuara me këtë ligj janë të obliguara të nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, më së largu një (1) vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 121
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, shfuqizohet Ligji Nr. 02/L-68 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera.

Neni 122
Hyrja në fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-027
22 shtator 2011

Shpallur me dekretin Nr. DL-037-2011, datë 07.10.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 22 / 19 TETOR 2011, PRISHTINË

DREJTËSIA

LIGJI Nr. 03/L-202
PËR KONFLIKTET ADMINISTRATIVE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR KONFLIKTET ADMINISTRATIVE

Neni 1
Objekti i ligjit

Me këtë ligj rregullohen kompetenca, përbërja e gjykatës dhe rregullat e procedurës, në bazë të të cilave gjykatat kompetente, vendosin për ligjshmërinë e akteve administrative me të cilat organet kompetente të administratës publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizik dhe juridik dhe palëve të tjera, si dhe për ligjshmërinë e veprimeve të organeve administrative.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është sigurimi i mbrojtjes gjyqësore të të drejtave dhe interesave juridike të personave fizik, juridik dhe palëve të tjera, të cilat të drejta dhe interesa janë cenuar me vendime individuale ose me veprimet e organeve të administratës publike.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **Organ -** organet e administratës publike, organet e qeverisjes qendrore dhe organet e tjera në varësi të tyre, organet e vetëqeverisjes lokale dhe organet në varësi të tyre, kur në ushtrimin e autorizimeve publike vendosin në çështjet administrative.
   1.2. **Akt administrativ -** çdo vendim të organit të paraparë në nën-paragrafin 1.1. të këtij paragrafi, i cili merret në fund të një procedure administrative në ushtrimin e autorizimeve publike dhe që prek, në mënyrë të favorshme ose jo të favorshme të drejtat e njohura ligjërisht, liritë ose interesat e personave fizikë ose juridikë përkatësisht palës tjetër në vendosjen e çështjes administrative.

1.3. **Çështja administrative** - sipas këtij ligji është situata e veçantë e pakontestueshme e me interes publik, në të cilën drejtpërdrejti nga dispozitat juridike, rezulton nevoja që sjellja e ardhshme e palës, të përcaktohet në mënyrë juridike -autoritative

Neni 4
Parimi i ligjshmërisë

Në konfliktin administrativ gjykata kompetent vendos në bazë të kushtetutës dhe ligjeve.

Neni 5
Parimi i deklarimit të palës

Para nxjerrjes së aktgjykimit gjykata secilës palë do ti jap mundësi që të deklarohet, mbi të gjitha kërkesat dhe pretendimet e palëve të tjera dhe mbi të gjitha faktet dhe çështjet juridike, që janë objekt i konfliktit administrativ. Gjykata mund të vendos në konfliktin administrativ pa dhënien e mundësisë palës për tu deklaruar, vetëm në rastet e parashikuara me ligj.

Neni 6
Parimi i shqyrtimit verbal

Në konfliktin administrativ, gjykata vendosë në bazë të shqyrtimit verbal, të drejtpërdrejt dhe publik.

Neni 7
Parimi i efikasitetit

Gjykata e zbaton konfliktin administrativ shpejtë dhe pa zvarritje, duke iu shmangur veprimeve dhe shpenzimeve të panevojshme, me çka e pamundëson keqpërdorimin dhe zvarritjen e realizimit të të drejtave të palëve, të pjesëmarrësve të tjerë në konflikt dhe vendimin e nxjerrë në afat të parashikuar.

Neni 8
Parimi i ndihmës së palës së painformuar

Gjykata kujdeset që mos informimi i palës dhe pjesëmarrësve të tjerë në konflikt, të mos jetë në dëm të të drejtave, të cilat i kanë në bazë të ligjit.

Neni 9

Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.

Neni 10

1. Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejt apo interes ligjor.
2. Organi i administratës, Avokati i Popullit, shoqatat dhe organizatat e tjera, të cilat veprojnë në mbrojtje të interesave publike mund të fillojnë konfliktin administrativ.
3. Organi ka të drejtë të iniciojë konfliktin administrativ, kundër vendimit, që është marrë në bazë të ankesës në procedurën administrative, nëse ai/ajo konsideron se është shkelur ndonjë e drejtë ose interes i tij.
4. Nëse me aktin administrativ është shkelur ligji në favor të personit fizik, personit juridik, konfliktin mund ta iniciojë prokurori publik kompetent ose organi tjetër i autorizuar me ligj. Organet e administratës kanë për detyrë që, kur të kenë mësuar për to, të njoftojnë prokurorin publik kompetent ose organin e autorizuar me ligj.
5. Konfliktin administrativ mund ta iniciojë edhe prokurori publik kompetent ose personi i autorizuar nëse me aktin administrativ është shkelur ligji në dëm të organeve të qeverisjes qendrore dhe të organeve të tjera në varësi të tyre, të organeve të vetëqeverisjes lokale dhe të organeve në varësi të tyre, kur janë shkelur të drejtat pronësore të këtyre organeve.

Neni 11

Konflikti administrativ, sipas aktpadisë, zgjidhet nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës.

Neni 12

Aktgjykimet e gjykatës, të nxjerra në konfliktet administrative, janë të detyrueshme.

Neni 13
Konflikti administrativ

1. Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë.
2. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar.

Neni 14

Konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj.

Neni 15

1. Konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet:
   1.1. kundër akteve të nxjerra në çështjet, në të cilat është siguruar mbrojtja gjyqësore jashtë konfliktit administrativ;
   1.2. kundër akteve të nxjerra në çështjet rreth të cilave, sipas dispozitës së ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ;
   1.3. kundër akteve administrative, që përbëjnë një detyrim të përgjithshëm, të nxjerra nga organet e administratës, përveç kur ato cenojnë të drejtat e ligjshme të palëve.
2. Në çështjet nga nën-paragrafi 1.2. i paragrafit 1. të këtij neni mund të zhvillohet konflikti administrativ kur organi me rastin e nxjerrjes së aktit administrativ i ka kapërcyer kufijtë e kompetencës.

Neni 16

1. Akti administrativ përfundimtar mund të kundërshtohet:
   1.1. për shkak se nuk janë aplikuar fare ose nuk janë aplikuar drejt dispozitat ligjore;
   1.2. për shkak se akti është nxjerrë nga organi jo kompetent;
   1.3. për shkak se në procedurë, që i ka paraprirë aktit, nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike, apo nëse nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike;
   1.4. për shkak se me aktin përfundimtar administrativ i nxjerrë sipas vlerësimit të lirë, organi i ka tejkaluar kufijtë e autorizimit ligjor ose akti i tillë nuk është nxjerrë në pajtim me qëllimin e këtij ligji;
   1.5. për shkak se pala e paditur e ka nxjerrë përsëri aktin e vetë të mëhershëm, më parë të anuluar më aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës kompetente.
2. Akti administrativ nuk mund të kundërshtohet për aplikim jo të drejtë të dispozitave, kur organi kompetent ka vendosur sipas vlerësimit të lirë në bazë të autorizimeve dhe në kuadrin e kufijve që i janë dhënë me dispozitat ligjore, në pajtim me qëllimin për të cilin i është dhënë autorizimi.

Neni 17

Në procedurën e konfliktit administrativ mund të kërkohet edhe kthimi i sendeve të marra, si dhe kompensimi i dëmit që i është shkaktuar paditësit me ekzekutimin e aktit që kontestohet.

Neni 18

Paditës në konfliktin administrativ mund të jetë personi fizik, personi juridik, Avokati i Popullit, shoqatat dhe organizatat e tjera, të cilat veprojnë në mbrojtje të interesit publik, që konsideron se me aktin administrativ i është shkelur ndonjë e drejtë apo ndonjë interes i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, i bazuar në ligj.

Neni 19

1. Kur personit fizik, që është anëtar i ndonjë organizate joqeveritare, e cila sipas rregullave të veta ka për detyrë të mbrojë të drejtat dhe interesat të caktuara të anëtarëve të vet, me akt administrativ i është shkelur ndonjë e drejtë apo interes i tillë, kjo organizatë mundet, me pëlqimin e anëtarit të vet, në emër të tij, të paraqesë padinë dhe të zhvillojë konfliktin administrativ kundër aktit administrativ.
2. Organizata nga paragrafi 1. i këtij neni mundet, në çdo fazë të procedurës, me të drejtat e palës së interesuar, të hyjë në konfliktin e filluar, në favor të anëtarit të saj dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e të përdorë të gjitha mjetet juridike, nëse kjo nuk është në kundërshtim me deklaratat dhe veprimet e palës.

Neni 20

Palë e paditur në konfliktin administrativ është organi, akti i të cilit kontestohet, përkatësisht organi i cili sipas kërkesës së palës ose ankesës së saj nuk e nxjerrë aktin në afatin e caktuar ligjor dhe të njëjtin nuk ia dërgon palës.

Neni 21

Pozitën e palës në konfliktin administrativ e ka edhe personi, të cilit, anulimi i aktit administrativ të kontestuar, do t'i sillte dëm të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

Neni 22

1. Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe.
2. Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.
3. Bashkë me kërkesën për shtyrje duhet paraqitur prova, që tregon se padia është parashtruar.
4. Për shtyrje të ekzekutimit, organi kompetent nxjerr vendimin brenda tri (3) ditëve nga data e marrjes së kërkesës për shtyrje.
5. Organi nga paragrafi 2. i këtij neni mund të shtyjë ekzekutimin e aktit të kontestuar edhe për shkaqe të tjera të arsyeshme deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse nuk është në kundërshtim me interesin publik.
6. Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2. të këtij neni.
7. Për kërkesën, gjykata vendos brenda tri (3) ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

Neni 23
Kompetenca dhe mjetet juridike

1. Për paditë kundër akteve administrative të të gjitha organeve vendos gjykata kompetente për çështjet administrative në shkallë të parë, nëse me dispozita të tjera ligjore nuk është përcaktuar ndryshe.
2. Kundër vendimit të nxjerrë në konfliktin administrativ, ankesa mund të paraqitet te gjykata kompetente për çështje administrative e shkallës së dytë.

Neni 24

1. Kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtrojë Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor.
2. Kërkesa nga paragrafi 1. i këtij neni mund të parashtrohet vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishte ndikim në zgjidhjen e çështjes.
3. Mbi kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të gjykatës vendos Gjykata Supreme e Kosovës.

Neni 25

1. Kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës, prokurori publik mund t'i parashtrojë Gjykatës Supreme të Kosovë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, nëse me vendim të tillë është shkelur ligji, dispozitat e tjera ose akti i përgjithshëm.
2. Mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimit të gjykatës vendos Gjykata Supreme e Kosovës.

Neni 26
Procedura në bazë të padisë

1. Konflikti administrativ fillohet me padi
2. Me padi mund të kërkohet:
   2.1. anulimi ose shpallja e pavlefshme e aktit kontestues;
   2.2. nxjerrja e aktit administrativ, i cili nuk është nxjerrrur në afatin e parashikuar; dhe
   2.3. kthimi i sendeve të marrura dhe kompenzimi i dëmit i shkaktuar me ekzekutimin e aktit administrativ të kontestuar.

Neni 27

1. Padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh, që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës.
2. Ky afat aplikohet edhe për organin e autorizuar për paraqitjen e padisë, nëse i është dorëzuar akti administrativ. Nëse akti administrativ nuk i është dorëzuar, mund të paraqesë padinë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e dorëzimit të aktit administrativ palës, në favor të së cilës është nxjerrë akti.

Neni 28

1. Padia i dorëzohet gjykatës drejtpërsëdrejti ose i dërgohet me postë rekomandë. Padia mund të bëhet edhe në proces verbal në gjykatë. Dita e paraqitjes së padisë në postë rekomande, respektivisht dita e deklarimit të padisë në procesverbal, konsiderohet si ditë kur i është dorëzuar gjykatës.
2. Nëse padia nuk i është dorëzuar gjykatës, por organit tjetër jo kompetent, ndërsa i arrin gjykatës pas skadimit të afatit për paraqitjen e padisë, do të konsiderohet se është paraqitur me kohë, nëse paraqitja e saj në këtë organ ka qenë si pasojë e mos dijës apo e gabimit të hapur të paraqitësit.

Neni 29

1. Nëse organi i shkallës së dytë nuk e ka nxjerrë vendimin brenda tridhjetë (30) ditësh ose në një afat më të shkurtër të caktuar me dispozita të veçanta rreth ankimit të palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë, ndërsa nuk e nxjerr as në afatin e mëtejmë prej shtatë (7) ditësh me kërkesë të përsëritur, pala mund të fillojë konfliktin administrativ sikur t'i është refuzuar ankesa.
2. Në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1. të këtij neni mund të veprojë pala edhe kur sipas kërkesës së saj nuk është nxjerrë vendimi nga organi i shkallës së parë, kundër aktit të të cilit nuk mund të bëhet ankesa.
3. Nëse organi i shkallës së parë, kundër aktit të të cilit mund të bëhet ankesa, nuk ka nxjerrë asnjë vendim në bazë të kërkesës brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh ose në një afat më të shkurtër të paraparë me dispozita të veçanta, pala ka të drejtë t'i drejtohet me kërkesë organit të shkallës së dytë. Kundër vendimit të organit të shkallës së dytë, pala mund të fillojë konfliktin administrativ, por mundet, nën kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni, ta fillojë edhe nëse ky organ nuk ka nxjerrë vendim.

Neni 30

1. Në padi duhen të përfshihen: emërtimi i gjykatës të cilës i paraqitet padia, emri, mbiemri dhe vendbanimi, respektivisht selia e paditësit dhe e të padituri, akti administrativ kundër të cilit është drejtuar padia, arsyet pse ngrihet padia, si dhe në cilin drejtim dhe vëllim propozohet anulimi i aktit administrativ. Bashkë me padinë duhet të bashkangjitët akti që kontestohet në origjinal ose kopje.
2. Nëse me padi kërkohet kthimi i sendit ose kompensimi i dëmit, duhet të shtrohet edhe kërkesa e caktuar në pikëpamje të sendit apo të shumës së dëmit të pësuar.
3. Bashkë me padi, paraqitet edhe nga një kopje e padisë dhe e dokumenteve të bashkëngjitura për organin e paditur dhe për çdo person të interesuar, nëse ekzistojnë të tillë.

Neni 31

1. Paditësi mund të heqë dorë nga padia derisa të mos merret vendimi. Në këtë rast gjykata e pezullon procedurën me vendim.

2. Paditësi mund ta zgjerojë kërkesë padinë deri në përfundimin e shqyrtimit, ndërsa kur shqyrtimi nuk zhvillohet, deri sa të mos nxjerret vendimi i gjykatës kompetente.

Neni 32
Çështja paraprake

Kur vendimi i gjykatës në konfliktin administrativ varet nga çështja juridike e cila përbënë tërësi të mvetësishme juridike, e mbi të cilën gjykata tjetër ose organi tjetër nuk ka vendosur (çështja paraprake), gjykata që zhvillon konfliktin administrativ, mund ta vendos atë çështje, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe; ose mund ta ndërpresë procedurën deri në nxjerrjën e vendimit mbi çështjën paraprake, nga ana e organit kompetent.
Vendimi i gjykatës mbi çështjën paraprake ka efekt juridik vetëm në konfliktin administrativ, në të cilin ajo çështje është zgjidhur.

Neni 33

1. Nëse padia nuk është e plotë, është e pakuptueshme ose ka të meta, kryetari i kolegjit do të ftojë paditësin, që brenda afatit prej tetë (8) ditëve t'i mënjanojë të metat e padisë. Në ftesë duhet të ceken udhëzimet për të mënjanuar të metat e padisë dhe paralajmërimi për pasojat që do të lindin nëse nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës.
2. Nëse paditësi, brenda afatit të cekur, nuk i mënjanon të metat e padisë, kurse ato janë të atilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata do ta hedhë poshtë me vendim padinë, nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm.

Neni 34

1. Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se:
   1.1. padia është paraqitur pas kalimit të afatit ose është e parakohëshme;
   1.2. akti që kontestohet me padi nuk është akt administrativ;
   1.3. është e qartë se me aktin administrativ, që kontestohet me padi, nuk preken të drejtat e paditësit ose interesi i tij i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj;
   1.4. kundër aktit administrativ, i cili kontestohet me anë të padisë, mund të bëhet ankimi, kurse ankimi nuk është bërë fare apo nuk është bërë në kohën e duhur;
   1.5. është fjala për çështjen për të cilën sipas dispozitës shprehimore të ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ;
   1.6. ekziston vendimi i formës së prerë, i nxjerr në konfliktin administrativ, për të njëjtën çështje.
2. Për shkaqe të parashikuara në paragrafin 1. të këtij neni, gjykata mund të hedhë poshtë padinë në çdo fazë të procedurës.

Neni 35

Nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë në bazë të paragrafit 2. të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji, kurse konstaton se akti administrativ i kontestuar përmban të meta esenciale, që e pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së aktit, e anulon me aktgjykim, aktin administrativ edhe pa e dërguar padinë në përgjigje.

Neni 36

1. Nëse organi gjatë kohës së procedurës gjyqësore nxjerr aktin tjetër me të cilin revokohet ose shfuqizohet akti administrativ kundër të cilit është ngritur konflikti administrativ, si dhe në rastin nga neni 29 i këtij ligji nxjerr më vonë aktin administrativ, ky organ, përpos paditësit, do ta njoftojë edhe gjykatën.
2. Në këtë rast gjykata do ta ftojë paditësin që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh të deklarohet nëse me aktin administrativ të nxjerrë në afatin e mëvonshëm:
   2.1. është i kënaqur;
   2.2. nuk heq dorë nga padia;
   2.3. pjesërisht heq dorë nga padia;
   2.4. ai/ajo padinë e zgjeron edhe në aktin tjetër.
3. Nëse paditësi deklaron se me aktin e nxjerr në afatin e mëvonshëm është i kënaqur apo nëse nuk e jep deklaratën brenda afatit nga paragrafi 2. i këtij neni, gjykata do të nxjerrë vendimin mbi pezullimin e procedurës.
4. Nëse paditësi deklaron se me aktin e ri nuk është ai/ajo i kënaqur, gjykata do ta vazhdojë procedurën.

Neni 37

1. Nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë, sipas të paragrafit 2. të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji ose nuk e anulon aktin administrativ sipas nenit 35 të këtij ligji, gjykata do t'ia dërgojë nga një kopje të padisë dhe të dokumenteve të bashkëngjitura në përgjigje palës së paditur dhe personave të interesuar.
2. Përgjigjja jepet në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit të padisë në përgjigje palës.
3. Në afatin e caktuar pala ka për detyrë t'i dërgojë gjykatës të gjitha shkresat që kanë të bëjnë me lëndën. Nëse pala e paditur edhe pas kërkesës së dytë nuk i dërgon shkresat e lëndës, apo nëse deklaron se nuk mund t'i dërgojë, gjykata do të vendosë për çështjen edhe pa shkresat e lëndës.

Neni 38

1. Në konfliktet administrative gjykata vendos në seancë të hapur.
2. Gjykata vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve.
3. Në konfliktet administrative gjykata mund të vendosë në seancë të mbyllur në rast se mund të zbulohen faktet që kanë të bëjnë me jetën private të palëve, mbi sekretin shtetëror, profesional, tregtar dhe me adoptimin.

4. Palët, nëse ka nevojë edhe ekspertët dhe përkthyesit, duhet të jenë të pranishëm në seancën e mbyllur.
5. Gjykata mund të vendosë çështjen pa shqyrtim verbal, nëse ka fakte të mjaftueshme dhe kur palët kanë dhënë pëlqimin e tyre në formë të shkruar.
6. Për përjashtimin e publikut nga seanca, gjykata në bazë të vlerësimit të vet vendos me vendim procedural i cili u komunikohet palëve.

Neni 39

1. Gjyqtari Mbikëqyrës cakton ditën e shqyrtimit dhe në shqyrtim do të ftojë palët dhe personat e interesuar.
2. Shqyrtimi mund të shtyhet vetëm për shkaqe të arsyeshme, për të cilën vendos kolegji.

Neni 40

1. Shqyrtimi drejtohet nga Gjyqtari që gjyko çështjen.
2. Për shqyrtimin mbahet procesverbali, në të cilin përfshihen vetëm faktet dhe rrethanat esenciale.
3. Procesverbali nënshkruhet nga Gjyqtari që gjykon çështjen dhe procesmbajtësi.

Neni 41

1. Mungesa e palës në shqyrtimin verbal nuk e pezullon punën e gjykatës.
2. Për shkak të mungesës së palëve nuk mund të konstatohet se ato kanë hequr dorë nga kërkesat e tyre, por do të lexohen parashtresat e tyre.
3. Nëse në shqyrtim nuk vjen as paditësi dhe as pala e paditur, ndërsa shqyrtimi nuk shtyhet, gjykata do të shqyrtojë konfliktin edhe pa praninë e palëve.

Neni 42

Gjatë shqyrtimit, i pari e merr fjalën Gjyqtari që gjykon çështjen i cili parashtron gjendjen dhe esencën e konfliktit, duke mos dhënë mendimin e vet. Pas kësaj i jepet fjala paditësit që ta arsyetojë padinë, e pastaj përfaqësuesit të palës së paditur dhe personave të interesuar, që t'i arsyetojnë pretendimet e tyre.

Neni 43

1. Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative.
2. Nëse gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, ose konstaton se në procedurën administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi

për zgjidhjen e çështjes, gjykata do të anulojë me aktgjykim aktin e kontestuar administrativ. Në një rast të tillë, organi kompetent ka për detyrë të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerrë akt të ri administrativ.

3. Nëse anulimi i aktit administrativ, sipas paragrafit 2. të këtij neni dhe zhvillimi i përsëritur i procedurës në organin administrativ kompetent do të shkaktonte për paditësin ndonjë dëm, i cili me vështirësi do të riparohej, apo nëse në bazë të dokumenteve zyrtare ose të provave të tjera në shkresat e lëndës është e qartë se gjendja faktike ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative, apo nëse në të njëjtin konflikt administrativ është anuluar një herë akti administrativ, kurse organi administrativ kompetent nuk ka vepruar sipas aktgjykimit, gjykata mundet edhe vetë të vërtetojë gjendjen faktike ose me anë të organit tjetër dhe në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nxjerr aktgjykimin, respektivisht vendimin.

Neni 44

1. Ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga padia, por nuk obligohet nga shkaqet e padisë.
2. Për nulitetin e aktit administrativ gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Neni 45

1. Gjykata nxjerr aktgjykimin, respektivisht vendimin.
2. Mbi këshillimin mbahet procesverbali i veçantë, të cilin e nënshkruajnë Gjyqtari që gjykon çështjen dhe procesmbajtësi.
3. Këshillimi bëhet pa praninë e palëve.

Neni 46

1. Gjykata vendos për konfliktin administrativ me aktgjykim.
2. Me aktgjykim, padia aprovohet ose refuzohet si e pabazuar.
3. Nëse padia aprovohet, gjykata anulon aktin administrativ të kontestuar.
4. Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar.
5. Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendosë edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore.
6. Kur padia është paraqitur në bazë të nenit 29 të këtij ligji, ndërsa gjykata konstaton se është e arsyeshme, do ta aprovojë padinë me aktgjykim dhe do të caktojë organin kompetent të nxjerrë vendimin.

Neni 47

1. Nëse është zhvilluar shqyrtimi verbal, menjëherë pas përfundimit të shqyrtimit verbal dhe këshillimit, gjykata shpallë aktgjykimin, respektivisht vendimin.
2. Në raste të ndërlikuara gjykata mund të heqë dorë nga shpallja verbale e aktgjykimit, respektivisht të vendimit, por jo më vonë se brenda tetë (8) ditësh të nxjerrë aktgjykimin, respektivisht vendimin.
3. Nëse pas përfundimit të shqyrtimit verbal gjykata nuk e nxjerr aktgjykimin, respektivisht vendimin për arsye se duhet më parë të vërtetojë faktin e atillë, për shqyrtimin e të cilit nuk nevojitet një shqyrtim i ri verbal, gjykata do të nxjerrë aktgjykimin, respektivisht vendimin, brenda tetë (8) ditësh nga data kur ta ketë vërtetuar këtë fakt.

Neni 48

1. Aktgjykimi, respektivisht vendimi përmban emërtimin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e Gjyqtarit që gjykon çështjen e të procesmbajtësit, emërtimin e palëve dhe të përfaqësuesve të tyre, objektin e konfliktit administrativ dhe ditën kur aktgjykimi, respektivisht vendimi është nxjerrë e shpallur, dispozitivin, arsyetimin dhe udhëzimin për ankim, nëse është i lejuar.
2. Aktgjykimin, respektivisht vendimin e nënshkruajnë Gjyqtari që gjykon çështjen dhe procesmbajtësi.
3. Aktgjykimi, respektivisht vendimi u dërgohet palëve në kopje të legalizuara.

Neni 49
Procedura sipas mjeteve juridike

1. Kundër vendimit të gjykatës, ankesa i paraqitet gjykatës kompetente, në mënyrën e caktuar në nenin 28 të këtij ligji.
2. Ankesa paraqitet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, që nga dita e pranimit të vendimit të gjykatës.
3. Në çështjet të tjera të procedurës sipas ankesës zbatohen dispozitat e këtij ligji për kërkesë padinë.
4. Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor sipas nenit 24, si dhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë sipas nenit 25, i paraqitet në mënyrën e caktuar në nenin 28 të këtij ligji, gjykatës për vendosje sipas kërkesës.

Neni 50

1. Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor i dërgohet gjykatës brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimit të vendimit kundër të cilit pala paraqet kërkesën.
2. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë paraqitet brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga data kur u është dërguar palëve vendimi, kundër të cilit paraqitet kërkesa.

Neni 51

1. Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm dhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë përmban emërtimin e vendimit gjyqësor, si dhe shkaqet dhe vëllimin në të cilin propozohet rishqyrtimi ose mbrojtja e ligjshmërisë.
2. Nëse kërkesa nga paragrafi 1. i këtij neni nuk është e plotë ose është e pakuptueshme, gjykata vepron në pajtim me dispozitat e nenit 33 të këtij ligji.

Neni 52

1. Kërkesën e palejueshme, të paraqitur pas afatit apo kërkesën e paraqitur nga personi i paautorizuar, gjykata do ta hedhë poshtë me vendim.
2. Nëse gjykata nuk e hedh poshtë kërkesën nga paragrafi 1. i këtij neni, atë do t'ia dërgojë palës së kundërt, e cila, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, mund të japë përgjigjen në kërkesën e bërë.
3. Gjykata, kundër vendimit të së cilës është paraqitur kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm ose kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe organi i paditur, kanë për detyrë që, me kërkesën e gjykatës, t'i dërgojnë të gjitha shkresat e lëndës.

Neni 53

Gjykata vendos mbi kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm ose kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, si rregull, në seancë të mbyllur, ndërsa vendimin e kundërshtuar e shqyrton vetëm brenda kufijve të kërkesës.

Neni 54

1. Gjykata me aktgjykim refuzon ose e aprovon kërkesën.
2. Me aktgjykim me të cilin aprovohet kërkesa, gjykata mund ta anulojë ose ta ndryshojë vendimin gjyqësor, kundër të cilit është paraqitur kërkesa.
3. Nëse gjykata e anulon vendimin gjyqësor, lënda i kthehet gjykatës, vendimi i së cilës është anuluar. Kjo gjykatë e ka për detyrë të ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale dhe t'i shqyrtojë çështjet, në të cilat e ka paralajmëruar gjykata që ka vendosur për kërkesën.

Neni 55
Rishikimi

1. Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi, që ka marrë formë të prerë, kur:
   1.1. pala mëson për fakte të reja, apo nëse konstaton ose krijon mundësi të përdorë prova të reja, në bazë të së cilave konflikti do të mund të zgjidhej në mënyrë më të favorshme për të, po të ishin shtruar ose përdorur këto fakte, apo prova, në procedurën e mëparshme gjyqësore;
   1.2. vendimi i gjykatës ka ardhur si pasojë e veprës penale të gjyqtarit apo punëtorit në gjykatë ose vendimi është nxjerrë me veprim mashtrues të

përfaqësuesit ose të autorizuesit të palës, të kundërshtarit të tij ose të përfaqësuesit apo të autorizuesit të kundërshtarit, kurse ky veprim përbën vepër penale;

1.3. vendimi është bazuar në aktgjykimin e nxjerr në çështjen penale apo civile, kurse ky aktgjykim është anuluar më vonë me vendim gjyqësor të formës së prerë;

1.4. dokumenti në të cilin bazohet vendimi është i falsifikuar, apo nëse dëshmitari, eksperti, ose pala gjatë dëgjimit para gjykatës ka dhënë deklaratë të rreme, kurse vendimi i gjykatës është bazuar në këtë deklaratë;

1.5. pala konstaton apo krijon mundësi ta përdorë vendimin e mëparshëm të nxjerrë në të njëjtin konflikt administrativ; dhe

1.6. personit të interesuar nuk i është dhënë mundësia për të marrë pjesë në konfliktin administrativ.

2. Për shkak të rrethanave nga nën-paragrafi 1.1 dhe nën-paragrafi 1.5 i këtij paragrafi rishikimi do të lejohet vetëm nëse pala, pa faj të vet, nuk ka pasur mundësi që këto rrethana t'i shtrojë në procedurën e mëparshme.

Neni 56

Rishikimi i vendimeve për rrethanat e parashikuara në nën-paragrafët 1.2 dhe 1.4 të nenit 55 të këtij ligji lejohet kur ato rrethana janë vërtetuar me vendim të formës së prerë nga gjykata kompetente.

Neni 57

1. Rishikimi i vendimeve mund të kërkohet jo më vonë se brenda tridhjetë (30) ditësh nga data kur pala të ketë mësuar për shkakun e rishikimit.
2. Nëse pala ka mësuar për shkakun e rishikimit para se të ketë marrë fund procedura para gjykatës, ndërsa këtë shkak nuk ka mundur ta përdorë gjatë procedurës, rishikimi mund të kërkohet brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e dërgimit të vendimit.
3. Pasi të kenë kaluar tre (3) vjet nga data kur vendimi të ketë marrë formën e prerë, rishikimi nuk mund të kërkohet.

Neni 58

Mbi kërkesën për rishikim vendos gjykata, që ka nxjerrë vendimin.

Neni 59

1. Në kërkesë për rishikim duhet theksuar:
   1.1. aktgjykimi ose vendimi, i nxjerr në procedurë, rishikimi i të cilit kërkohet;
   1.2. baza ligjore e rishikimit, provat dhe rrethanat që e bëjnë të besueshme ekzistimin e kësaj baze;
   1.3. rrethanat nga të cilat rezulton se kërkesa është paraqitur në afatin ligjor, dhe me cilat prova vërtetohet;

1.4. në cilin drejtim dhe në cilin vëllim propozohet ndryshimi i aktgjykimit, respektivisht i vendimit të nxjerrë në procedurë, rishikimi i të cilit kërkohet.

Neni 60

1. Mbi kërkesë për rishikim gjykata vendos në seancë të mbyllur.
2. Gjykata do ta hedhë poshtë kërkesën me vendim nëse vërteton se kërkesën e ka paraqitur personi i paautorizuar ose kërkesa nuk është bërë në kohën e duhur, apo pala nuk e ka bërë të paktën të besueshme ekzistimin e bazës ligjore për rishikim.
3. Nëse gjykata nuk e hedh poshtë kërkesën sipas paragrafit 2. të këtij neni, do t'ia dërgojë palës së kundërt dhe personave të interesuar dhe do t'i ftojë që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh t'i përgjigjen kërkesës.

Neni 61

1. Pas skadimit të afatit për përgjigje në kërkesë për rishikim, gjykata vendos me aktgjykim mbi kërkesën për rishikim.
2. Nëse lejohet rishikimi, do të shfuqizohet vendimi i mëparshëm tërësisht ose pjesërisht.
3. Veprimet e mëparshme procedurale, të cilat nuk ndikojnë në shkaqet e rishikimit, nuk përsëriten.
4. Me aktgjykim, me të cilin lejohet rishikimi, do të vendoset edhe për çështjen kryesore.

Neni 62

Në procedurën për rishikim do të zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e këtij ligji për procedurën sipas padisë dhe mjeteve juridike, nëse në nenet 55 deri 61 të këtij ligji nuk është caktuar ndryshe.

Neni 63
Dispozita të tjera të procedurës

Nëse ky ligj nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, do të zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore.

Neni 64

Në konfliktin administrativ secila palë i bart shpenzimet e veta.

Neni 65
Karakteri i detyrueshëm i aktgjykimit

Kur gjykata e anulon aktin, kundër të cilit ka filluar konflikti administrativ, lënda kthehet në gjendjen në të cilin ishte para se të ishte nxjerrë akti i anuluar. Nëse sipas karakterit të çështjes, që ka qenë objekt i konfliktit, duhet që, në vend të aktit të anuluar

administrativ, të nxirret një tjetër, organi kompetent ka për detyrë ta nxjerrë pa shtyrje, jo më vonë se brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e dërgimit të aktgjykimit. Organi kompetent, në këtë rast, është i obliguar nga pikëpamja juridike e gjykatës, si dhe nga vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën.

Neni 66

Vendimet e gjykatës mund të ekzekutohen atëherë kur bëhen të plotfuqishme dhe të ekzekutueshme.

Neni 67

1. Nëse organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ e nxjerr aktin administrativ në kundërshtim me pikëpamjen juridike të gjykatës, apo në kundërshtim me vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën, kurse paditësi paraqet një padi të re, gjykata do ta anulojë aktin e kontestuar dhe, si rregull, vetë do të vendosë për çështjen me aktgjykim. Aktgjykimi i tillë e zëvendëson aktin e organit kompetent.
2. Me rastin e tillë, gjykata e njofton organin që ushtron mbikëqyrjen e organit administrativ.

Neni 68

1. Nëse organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ nuk nxjerr menjëherë, e jo më vonë se brenda tridhjetë (30) ditësh, aktin e ri administrativ ose aktin në zbatimin e aktgjykimit të nxjerrë në bazë të paragrafit 4. të nenit 46 të këtij ligji, pala mund të kërkojë, me parashtresë të veçantë, nxjerrjen e aktit të tillë. Nëse organi kompetent nuk e nxjerr aktin brenda shtatë (7) ditësh nga kjo kërkesë, pala mund të kërkojë nxjerrjen e aktit të tillë nga gjykata që ka nxjerrë aktgjykimin.
2. Në bazë të kërkesës së tillë, gjykata do të kërkojë nga organi kompetent njoftimin mbi shkaqet për të cilat akti administrativ nuk është nxjerrë. Organi kompetent ka për detyrë ta japë këtë njoftim menjëherë, jo më vonë se brenda shtatë (7) ditësh. Nëse nuk e bën këtë, apo nëse njoftimi i dhënë, sipas mendimit të gjykatës, nuk e arsyeton moszbatimin e aktgjykimit të gjykatës, gjykata do të nxjerrë vendimin, i cili e zëvendëson aktin e organit kompetent. Këtë vendim gjykata do t'ia dërgojë organit kompetent për ekzekutim dhe për këtë gjë njëkohësisht do ta njoftojë organin që ushtron mbikëqyrjen. Organi kompetent për ekzekutim ka për detyrë që ta ekzekutojë vendimin e tillë.

Neni 69

Kur në konfliktin administrativ është nxjerrë aktgjykimi, ndërsa organi ka nxjerrë aktin administrativ për ekzekutimin e këtij aktgjykimi, por pranë organit kërkohet rishikimi për këtë akt administrativ, rishikimi mund të lejohet nëse shkaku i rishikimit ka lindur pranë organit që e ka nxjerrë aktin administrativ.

Neni 70
Dispozitat e fundit dhe kalimtare

Për paditë e paraqitura deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen procedurat sipas dispozitave të deritashme, përveç nëse ky ligj është më i favorshëm për palën.

Neni 71

Ky ligj shfuqizon të gjitha dispozitat e ligjit të aplikueshëm për konfliktin administrativ.

Neni 72

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-202
16 shtator 2010

Ligji shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 82 / 21 TETOR 2010

LIGJI Nr. 03/L-199
PËR GJYKATAT

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 792
Kreu II: Parimet e përgjithshme 793
Kreu III: Struktura organizative dhe kompetencat e gjykatave 794
Kreu IV: Kualifikimet, të drejtat dhe detyrimet e gjyqtarve dhe të gjyqtarve porotë 801
Kreu V: Dispozitat kalimtare 805
Kreu VI: Dispozitat përfundimtare 807

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR GJYKATAT

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Fushëveprimi i Ligjit

Ky ligj rregullon organizimin, funksionimin dhe jurisdikcionin e gjykatave në Republikën e Kosovës.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:
   1.1. **Procesi i Emërimit -** proces i verifikimit gjithë përfshirës në mbarë Kosovën të përshtatshmërisë së të gjithë aplikantëve për emërime të përhershme, deri ë moshën e pensionimit të përcaktuar me ligj, në postin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës i cili zhvillohet në përputhje me Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2008/02 dhe nenin 150 të Kushtetutës.
   1.2. **Gjykata Themelore -** gjykatë e shkallës së parë, me seli në shtatë qendra rajonale gjeografike të themeluara me këtë ligj.
   1.3. **Dega -** nën-ndarja gjeografike e një Gjykate Themelore.

1.4. **Gjykata e Apelit -** gjykata e shkallës së dytë, e themeluar me këtë ligj.
1.5. **Departament** - nën-komponentë e gjykatës e themeluar me këtë ligj me qëllim të caktimit të lëndëve sipas natyrës së tyre në mënyrë që të rritet efikasiteti i gjykatës.
1.6. **Divizion -** nën-komponentë i Departamentit të Përgjithshëm të një gjykate e themeluar me qëllim të caktimit të lëndëve sipas natyrës së tyre me në mënyrë që të rritet efikasiteti i gjykatës.
1.7. **Këshilli Gjyqësor i Kosovës** - institucioni i pavarur siç parashihet me Nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
1.8. **Kryetar i Gjykatës -** gjyqtari përgjegjës për menaxhimin dhe veprimet e një gjykate të paraparë me këtë ligj;
1.9. **Gjyqtari Mbikëqyrës** - gjyqtari në krye të degës të Gjykatës Themelore, i cili për veprimet e asaj dege i përgjigjet Kryetarit të Gjykatës Themelore.
1.10. **Instituti Gjyqësor -** organ i pavarur, që vepron në bashkëpunim me KGJPK-në dhe me institucionet, të cilat i trashëgojnë përgjegjësitë e tij për koordinimin e nevojave për aftësimin profesional të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të Kosovës, për aftësimin e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë, si dhe për çështje të tjera në pajtim me ligjin.

KREU II
PARIMET E PËRGJITHSHME

Neni 3
Pavarësia dhe paanshmëria e Gjykatave

1. Gjykatat e themeluara me këtë ligj gjykojnë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.
2. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit dhe marrjes së vendimeve janë të pavarur, të paanshëm, të pandikuar në çfarëdo mënyre nga asnjë person fizik apo juridik, përfshirë edhe organet publike.

Neni 4
Ushtrimi i Pushtetit Gjyqësor

Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat e themeluara me këtë ligj. Gjykatat e themeluara me këtë ligj janë: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.

Neni 5
Përbërja e Gjyqësorit

1. Përbërja e gjyqësorit pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe parimet e njohura ndërkombëtarisht për barazi gjinore.
2. Përbërja e gjyqësorit pasqyron përbërjen etnike të juridiksionit territorial të secilës gjykatë.

Neni 6
Vendimet e Gjykatës

1. Vendimet e gjykatës hartohen në formë të shkruar, në përputhje me ligjin.
2. Vendimet e gjykatës janë të detyrueshme për të gjithë personat fizik dhe juridik.

Neni 7
Qasja në Gjykata

1. Gjykatat trajtojnë të gjithë personat në mënyrë të barabartë askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
2. Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor.
3. Çdo person ka të drejtë t'í drejtohet gjykatës për të kërkuar mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të tij të ligjshme. Çdo person ka të drejtë të përdor mjetet juridike kundër një vendimi gjyqësor apo administrativ që cenon të drejtën apo interesat e tij në mënyrën e caktuar me ligj.
4. Të gjitha seancat gjyqësore do të jenë të hapura për publikun përpos nëse ligji e përcakton ndryshe.
5. Të gjitha gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve.

KREU III
STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE KOMPETENCAT E GJYKATAVE

Neni 8
Struktura organizative

1. Sistemi i gjykatave i Republikës së Kosovës përbëhet nga: Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.
2. Degët themelohen brenda territorit të një Gjykate Themelore.
3. Me qëllim të veprimeve më efikase të gjykatës përkatëse, brenda Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore mund të themelohen Departamente dhe Divizione.

Neni 9
Gjykatat Themelore

1. Gjykatat Themelore janë gjykata të shkallës së parë në territorin e Republikës së Kosovës.
2. Shtatë (7) Gjykata Themelore themelohen si në vijim:
   2.1. Gjykata Themelore e Prishtinës me seli në Prishtinë themelohet për territorin e Komunës së Prishtinës, Fushë Kosovës, Obiliqit, Lipjanit,

Podujevës, Gllogovcit dhe të Graçanicës;

2.2. Gjykata Themelore e Gjilanit me seli në Gjilan themelohet për territorin e Komunës së Gjilanit, Kamenices, Novobërdës, Ranillugut. Parteshit, Vitisë, Kllokotit dhe Vërbocit;

2.3. Gjykata Themelore e Prizrenit me seli në Prizren themelohet për territorin e Komunës së Prizrenit, Dragashit, Suharekës dhe Mamushës;

2.4. Gjykata Themelore në Gjakovë me seli në Gjakovë themelohet për territorin e Komunës së Gjakovës, Malishevës, dhe Rahovecit;

2.5. Gjykata Themelore e Pejës me seli në Pejë themelohet për territorin e Komunës së Pejës, Deçanit, Junikut, Istogut dhe Klinës;

2.6. Gjykata Themelore e Ferizajit me seli në Ferizaj themelohet për territorin e Komunës së Ferizajit, Kaçanikut, Shtimes, Shtërpcës dhe Hanit të Elezit;

2.7. Gjykata Themelore e Mitrovicës me seli në Mitrovicë themelohet për territorin e Komunës së Mitrovicës Jug dhe Mitrovicës Veri, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Skenderajit dhe Vushtrrisë.

Neni 10
Degët e Gjykatave Themelore

1. Përveç selisë kryesore, secila Gjykatë Themelore ka degët e veta të themeluara me këtë ligj.
2. Gjykata Themelore e Prishtinës ka këto degë:
   2.1. dega në Podujevë për komunën e Podujevës;
   2.2. dega në Graçanicë për komunën e Gracanicës;
   2.3. dega në Lipjan për komunën e Lipjanit;
   2.4. dega në Gllogoc për komunën e Gllogovcit.
3. Gjykata Themelore e Gjilanit ka këto degë:
   3.1. dega në Kamenicë, për komunën e Kamenicës dhe komunën e Ranillugut;
   3.2. dega në Viti, për komunën e Vitisë dhe komunën e Kllokotit;
   3.3. dega Novobërdës për komunën e Novobërdës.
4. Gjykata Themelore e Prizrenit ka këto degë:
   5.1. Dega në Dragash për komunën e Dragash;
   5.2. Dega në Suharekës për komunën e Suharekës.
5. Gjykata Themelore e Mitrovicës ka këto degë:
   5.1. dega në Leposaviq për komunën e Leposaviq;
   5.2. dega në Vushtrri për komunën e Vushtrrisë;
   5.3. dega në Zubin Potok për komunën e Zubin Potok-ut;
   5.4. dega në Skenderaj për komunën e Skenderajt.
6. Gjykata Themelore e Gjakovës ka këto degë:
   6.1. dega në Malishevë për komunën e Malishevës;
   6.2. dega në Rahovec për komunën e Rahovecit.
7. Gjykata Themelore e Pejës ka këto degë:
   7.1. dega në Istog për komunën e Istogut;
   7.2. dega në Klinë për komunën e Klinës;
   7.3. dega në Deçan, për komunën e Deçanit dhe komunën e Junikut.
8. Gjykata Themelore e Ferizajit ka këto degë:

8.1. dega Kaçanik, për komunën Kaçanikut dhe komunën e Hanit të Elezit;
8.2. dega e në Shtërpcë për komunën e Shtërpcës.

9. Në qoftë se në territorin e një komune nuk ekziston ndonjë degë, atëherë lëndët nga kjo komunë do të bien nën juridiksionin e selisë kryesore të Gjykatës Themelore.
10. Nëse në territorin e një komunë nuk ekziston një degë e Gjykatës Themelore, atëherë kjo komunë mundet që, me vendim të Kuvendit Komunal, të kërkojë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që të themelojë një degë brenda territorit të saj ose që kjo të përfshihet në juridiksionin e Gjykatës Themelore apo të degës së gjykatës më të afërt gjeografikisht.
11. Këshilli Gjyqësor i Kosovës përpilon dhe shpallë rregulloret për arritjen e përputhshmërisë së këtij nenin 1.3 të Aneksit IV të Propozimit gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit.

Neni 11
Jurisdikcioni i Gjykatës Themelore sipas Lëndës

1. Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe.
2. Gjykatat themelore janë kompetente për të dhënë ndihmë juridike ndërkombëtare dhe për të vendosur për pranimin e vendimeve të gjykatave të huaja.
3. Çështjet administrative dhe ekonomike janë kompetencë ekskluzive të Gjykatës Themelore të Prishtinës.

Neni 12
Organizimi i Brendshëm i Gjykatës Themelore

1. Departamentet në vijim themelohen brenda Gjykatave Themelore me qëllim të ndarjes së çështjeve sipas natyrës së tyre:
   1.1. departamenti për Çështjet Ekonomike që vepron në Gjykatën Themelore në Prishtinës, për gjithë territorin e Republikës së Kosovës;
   1.2. departamenti për Çështjet Administrative që vepron në Gjykatën Themelore në Prishtinës, për gjithë territorin e Republikës së Kosovës;
   1.3. departamenti për Krimet e Rënda që vepron në selinë e secilës Gjykatë Themelore;
   1.4. departamenti i Përgjithshëm që vepron në selinë e secilës Gjykatë Themelore, si dhe në secilën degë të Gjykatës Themelore;
   1.5. departamenti për të Mitur, që vepron në kuadër të gjykatave themelore.
2. Secila Gjykatë Themelore ka Kryetarin e Gjykatës, i cili është përgjegjës për menaxhimin dhe punën e Gjykatës Themelore. Secila degë e Gjykatave Themelore ka një (1) Gjyqtar Mbikëqyrës që i përgjigjet Kryetarit të Gjykatës Themelore përkatëse për punën e degës.
3. Kryetari i Gjykatës Themelore cakton të gjithë gjyqtarët, përfshirë edhe Gjyqtarin Mbikëqyrës, për punë në degët e Gjykatës Themelore përkatëse. Me rastin e caktimit të gjyqtarëve në degët, brenda mundësive, Kryetari i Gjykatës Themelore do të ketë në konsiderim përbërjen etnike të jurisdikcionit territorial të asaj dege.

Gjatë caktimit të Gjyqtarëve Mbikëqyrës, Kryetari i Gjykatës do të këshillohet me Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

4. Kryetari i Gjykatës Themelore i cakton gjyqtarët në departamente për të siguruar gjykimin efikas të lëndëve dhe përkohësisht mund të ri-caktojë gjyqtarët ndërmjet degëve dhe departamenteve sipas nevojës, që të adresohen konfliktet, të zgjidhen lëndët e prapambetura apo të sigurojë shqyrtimin me kohë të çështjeve.
5. Caktimi i lëndëve në departamente përkatëse, brenda gjykatës, bëhet në përputhje me rregulloren e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sipas kompetencës së departamenteve.

Neni 13
Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore

1. Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore është kompetent për çështjet në vijim:
   1.1. kontestet ndërmjet personave juridik vendor dhe të huaj lidhur me çështjet e tyre afariste;
   1.2. riorganizim, falimentim dhe shuarjen e personave juridik, nëse me ligj nuk përcaktohet ndryshe;
   1.3. kontestet lidhur me pengimin e posedimit, me përjashtim të pronës së paluajtshme, ndërmjet palëve të cekura në nën-paragrafi 1.1 të këtij paragrafi;
   1.4. kontestet lidhur me cenimin e konkurrencës, keqpërdorim apo monopolizim dhe pozitën dominuese në treg si dhe marrëveshjet monopoliste;
   1.5. mbrojtjen e të drejtave pronësore dhe të pronës intelektuale.
   1.6. kontestet midis kompanive të aviacionit, për të cilat zbatohet Ligji mbi Kompanitë e Aviacionit, duke përjashtuar kontestet lidhur me të drejtat e udhëtarëve;
   1.7. çështje të tjera të parapara me ligj.
2. Të gjitha çështjet në Departamentin për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore gjykohen nga një (1) gjyqtar profesionist, përpos nëse me ligj nuk parashihet ndryshe.

Neni 14
Departamenti për çështje Administrative i Gjykatës Themelore

1. Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj.
2. Të gjitha çështjet në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore gjykohen nga një (1) gjyqtar profesionist, përpos nëse me ligj nuk parashihet ndryshe.

Neni 15
Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore

1. Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore i gjykon veprat penale në vijim, të parapara me Kodin penal të Kosovës:

1.1. angazhimi në aktet terroriste duke e mos e përjashtuar edhe përfshirjen në në ndihmesën, mundësimin, organizimin apo mbështetjen ndaj terrorizmit apo grupeve terroriste;
1.2. veprat penale kundër së drejtës ndërkombëtare që përfshin por nuk kufizohet në gjenocid, krimet kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës;
1.3. rrezikimi i sigurisë së aviacionit civil.;
1.4. themelimi i skllavërisë, kushteve skllavërore dhe punës së detyruar;
1.5. trafikimi i emigrantëve;
1.6. trafikimi i njerëzve;
1.7. rrezikimi i personave të mbrojtur ndërkombëtarisht;
1.8. pengëmarrja;
1.9. pronësimi i paligjshëm, përdorimi, transferimi apo posedimi i materialit nuklear;
1.10. kërcënimi për përdorimin apo kryerjen e plaçkitjes së materialit nuklear;
1.11. vrasje e rëndë;
1.12. rrëmbimi;
1.13. tortura;
1.14. mashtrimi zgjedhor dhe shkatërrimi i dokumenteve të votimit;
1.15. dhunimi;
1.16. prodhimi, shpërndarja apo përpunimi i paautorizuar i drogave narkotike të rrezikshme dhe substancave hipnotike;
1.17. falsifikimi i parave;
1.18. krimi i organizuar, përfshirë kanosjen gjatë procedurave penale për krim të organizuar;
1.19. veprat penale kundër detyrës zyrtare duke mos e përjashtuar, keqpërdorimin e detyrës apo autoritetit zyrtar, shpërdorimi në zyrë, mashtrimi, pranimi i mitove si dhe shkëmbimi i ndikimit apo një sjellje të një ngjashme;
1.20. çfarëdo krimi që nuk gjendet i listuar në këtë nen i cili bie nën kompetencën ekskluzive apo vartëse të Zyrës së Prokurorisë Speciale të Kosovës siç përcaktohet në Ligjit mbi Zyrën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-52 (13 Mars 2008).
1.21. çfarëdo krimi tjetër i dënueshëm me dhjetë (10) ose me shume vite siç parashihet me ligj.

2. Të gjitha çështjet në Departamentin për Krime të Renda të Gjykatës Themelore gjykohen nga trupi gjykues prej tre (3) gjyqtarëve profesionist, nga të cilët njëri duhet të jetë kryesues i trupit gjykues.

Neni 16
Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore

1. Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore gjykon në shkallë të parë gjitha çështjet, përveç nëse kjo është në kompetencë e një Departamenti tjetër të Gjykatës Themelore.
2. Të gjitha lëndët e paraqitura pranë Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore do të gjykohen nga një (1) gjyqtar profesionalë, përveç nëse me ligj nuk parashihet ndryshe.

Neni 17
Gjykata e apelit

1. Gjykata e Apelit themelohet si gjykatë e shkallës së dytë, me jursdikcion territorial në gjithë Republikën e Kosovës.
2. Selia e Gjykatës së Apelit është në Prishtinë.
3. Përbërja e Gjykatës së Apelit pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Republikës së Kosovës dhe parimet ndërkombëtare të barazisë gjinore. Në përputhje me dispozitat relevante të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe për të siguruar pjesëmarrjen e komunitetit në gjyqësor, pesëmbëdhjetë përqind (15%) e numrit të tërësishëm së ulëseve në Gjykatën e Apelit, por në asnjë rast më pak se dhjetë ulëse, janë të garantuara për gjyqtarët nga radha e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

Neni 18
Kompetencat e Gjykatës së Apelit

1. Gjykata e Apelit është kompetente të shqyrtojë:
   1.1. të gjitha ankesat e ushtruara kundër vendimeve të Gjykatave Themelore;
   1.2. të vendosë në shkallë të tretë, sipas ankesës që është lejuar me ligj dhe për konfliktin e juridiksionit ndërmjet gjykatave themelore;
   1.3. të vendos për konfliktin e jurisdikcionit ndërmjet Gjykatave Themelore;
   1.4. çështjet tjera të parapara me ligj.

Neni 19
Shqyrtimi i lëndëve në Gjykatën e Apelit

1. Gjykata e Apelit shqyrton dhe gjykon lëndët në kolegj prej tre (3) gjyqtarëve profesionistë, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe.
2. Vendimet e Gjykatës së Apelit janë dokumente publike. Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron publikimin e vendimeve të Gjykatës së Apelit. Vendimet, të paktën duhet të publikohen në faqen e internetit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, apo në përputhje me Rregulloren e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Neni 20
Organizimi i Brendshëm i Gjykatës së Apelit

1. Gjykata e Apelit organizohet në departamentet si në vijim:
   1.1. Departamenti i Përgjithshëm;
   1.2. Departamenti për Krime të Rënda;
   1.3. Departamenti për Çështje Ekonomike;
   1.4. Departamenti për Çështje Administrative;
   1.5. Departamenti për të Mitur
2. Gjykata e Apelit ka Kryetarin i cili është përgjegjës për menaxhimin dhe punën e gjykatës.

3. Bazuar në rregulloret e përcaktuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Kryetari i Gjykatës së Apelit:
   3.1. cakton gjyqtarët në departamente për të siguruar gjykim efikas të lëndëve, dhe sipas nevojës, mund të ri caktojë gjyqtarët përkohësisht ndërmjet Departamenteve për zgjedhjen e lëndëve të pazgjidhura apo për të siguruar zgjidhjen e lëndëve me kohë;
   3.2. të caktojë, sipas nevojës, udhëheqësit e Departamenteve për të siguruar veprime efikase të gjykatës, dhe
   3.3. të sigurojë që secila lëndë e parashtruar në Gjykatën e Apelit i caktohet një kolegj prej tre (3) gjyqtarëve dhe do të caktojë gjyqtarin kryesues të këtij kolegji.

Neni 21
Gjykata Supreme

1. Gjykata Supreme e Kosovës është instanca më e lartë gjyqësore në Kosovë dhe ka jurisdikcion në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.
2. Gjykata Supreme përfshin kolegjin e apelit të Agjencionit Kosovar të Pronës si dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, gjyqtarët e së cilës janë pjesë e Gjykatës Supreme.
3. Përbërja e Gjykatës Supreme pasqyron përbërjen etnike të popullatës së Kosovës. Së paku pesëmbëdhjetë (15%) të Gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, por asnjëherë më pak se tre (3) gjyqtarë vijnë nga radhët e komunitetit që nuk është shumicë në Kosovë.
4. Selia e Gjykatës Supreme është në Prishtinë.
5. Gjykata Supreme ka Kryetarin siç parashihet në nenin 103 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kryetari po ashtu mund të kryejë edhe detyra të tjera të parapara me ligj.
6. Gjykata Supreme shqyrton dhe gjykon lëndët në kolegj me nga tre (3) gjyqtarë profesionistë, më përjashtim kur me ligj parashihet një numër më i madh i gjyqtarëve.
7. Bazuar në rregulloret e përcaktuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Kryetari:
   7.1. përgjegjës për menaxhimin dhe punët e Gjykatës Supreme;
   7.2. sipas nevojës, cakton gjyqtarët për të siguruar gjykimin efikas të lëndëve;
   7.3. sigurohet që secila lëndë e paraqitur në Gjykatën Supreme caktohet tek një kolegj adekuat i gjyqtarëve dhe cakton gjyqtarin kryesues të atij kolegji.

Neni 22
Kompetencat e Gjykatës Supreme

1. Gjykata Supreme është kompetente të vendosë lidhur me:
   1.1. kërkesën për mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave të Republikës së Kosovës, siç është paraparë me ligj;
   1.2. revizionin kundër vendimeve të shkallës së dytë të gjykatave në çështjet kontestimore, siç është paraparë me ligj;
   1.3. përcakton qëndrimet parimore dhe mendimet juridike për çështjet që kanë rëndësi për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës;

1.4. lëndët e Agjencisë Kosovare të Pronave, siç parashihet me ligj;
1.5. në Dhomën e Posaçme, lëndët e Agjencisë Kosovare të Privatizimit ose të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, siç parashihet me ligj;
1.6. çështje të tjera të parapara me ligj.

Neni 23
Seanca e përgjithëshme e Gjykatës Supreme

1. Gjykata Supreme mund të thërrasë një Seancë të përgjithëshme të të gjithë gjyqtarëve të saj për nxjerrjen e vendimeve që promovojnë zbatimin unik të ligjeve.
2. Këshilli Gjyqësor i Kosovës përcakton me rregulloret e nevojshme punimet e Seancave të përgjithëshme të gjykatës.

Neni 24
Publikimi i Vendimeve të Gjykatës Supreme

Vendimet e Gjykatës Supreme janë dokumente publike. Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron publikimin e vendimeve të Gjykatës Supreme. Vendimet e tilla publikohen së paku në faqen e internetit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, apo në përputhje me rregulloret e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Neni 25
Rregulloret për Organizimin e Brendshëm të Gjykatave

Këshilli Gjyqësor i Kosovës miraton rregullore për organizimin e brendshëm të gjykatave.

KREU IV
KUALIFIKIMET, TË DREJTAT DHE DETYRIMET E GJYQTARVE DHE TË GJYQTARVE POROTË

Neni 26
Kualifikimi i Gjyqtarëve

1. Kandidatët për tu emëruar si gjykatës siç parashihet në nenin 104 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës duhet të posedojnë kualifikimet e përcaktuara me rregullat dhe sipas procedurave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, por të paktën duhet t'i plotësojnë këto kushte:
   1.1. të jetë shtetas Kosovar
   1.2. të ketë më se paku njëzet e pesë (25) vite;
   1.3. të kenë diplomë të vlefshme universitare të juristit, të pranuar me ligjet e Kosovës;
   1.4. të ketë dhënë provimin e jurisprudencës;
   1.5. ta ketë dhënë provimin për gjyqtar në pajtim me Ligjin për Institutin Gjyqësor;
   1.6. të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet moral;

1.7. të mos jetë i dënuar për vepër penale të përcaktuar me ligjin në fuqi;
1.8. të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune juridike;
1.9. të ketë kaluar me sukses procesin e vlerësimit në bazë të rregullave dhe të procedurave të përcaktuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

2. Përveç kulafikimeve minimale të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, kualifikimet vijuese janë të kërkuara:
2.1. që të ushtroj funksionin e gjyqtarit në Departamentin për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore, kandidati duhet të ketë së paku tri (3) vite përvojë si gjyqtarë në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore dhe së paku gjashtë (6) vite përvojë në fushën juridike duke përfshirë edhe përvojën në lëmin penal;
2.2. që të ushtroj funksionin e gjyqtarit ne Departamentin e Çështjeve Administrative ose Departamentin e Çështjeve Ekonomike te Gjykatës Themelore, kandidati duhet të ketë së paku gjashte (6) vite përvojë ne fushën juridike duke përfshirë edhe përvojën ne çështjet administrative dhe ekonomike, respektivisht;
2.3. që të ushtroj funksionin e gjyqtarit ne Gjykatën e Apelit, kandidati duhet të ketë së paku dhjete (10) vite përvojë si gjyqtar,
2.4. që të ushtroj funksionin e gjyqtarit ne Gjykatën Supreme, kandidati duhet të ketë së paku pesëmbëdhjetë (15) vite përvojë si gjyqtar,

3. Për qëllime të kualifikimeve shtesë të përcaktuara në paragrafin 2. të këtij neni, përvoja në fushën juridike përfshin përvojën si prokurorë, gjyqtarë, avokat ose përvojën në fushën akademike.

Neni 27
Kualifikimet plotësuese për Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme të zbatueshme deri më 1 Janar, 2020

1. Pavarësisht dispozitave në paragrafin 2. të neni 26 të këtij ligji, gjyqtarët e emëruar të Gjykatës së Apelit apo Gjykatës Supreme ndërmjet 1 Janarit 2013 dhe 1 Janarit 2015 mund të kenë kualifikimet shtesë si në vijim:
1.1. për emërim në Gjykatën e Apelit, dhjetë (10) vite përvojë juridike.
1.2. për emërim në Gjykatën Supreme, pesëmbëdhjetë (15) vite përvojë juridike.

2. Të gjitha kriteret e tjera, ashtu siç parashihen në nenin 26 të këtij ligji, mbesin të pandryshuara.

3. Pavarësisht dispozitave në në paragrafin 2. të neni 26 të këtij ligji, gjyqtarët e emëruar të Gjykatës së Apelit apo Gjykatës Supreme ndërmjet 1 Janarit 2015 dhe 1 Janarit 1017 mund të kenë kualifikimet shtesë si në vijim:
3.1. për emërim në Gjykatën e Apelit, dhjetë (10) vite përvojë juridike nga të cilat tre (3) vite si gjyqtar.
3.2. për emërim në Gjykatën Supreme, pesëmbëdhjetë (15) vite përvojë juridike nga të cilat pesë (5) vite si gjyqtar.
3.3. të gjitha kriteret e tjera, ashtu siç parashihen në nenin 26 të këtij ligji, mbesin të pandryshuara.

4. Pavarësisht dispozitave në paragrafin 2. të neni 26 të këtij ligji gjyqtarët e emëruar të Gjykatës së Apelit apo Gjykatës Supreme ndërmjet 1 Janarit 2017 dhe 1 Janarit 1020 mund të kenë kualifikimet shtesë si në vijim:

4.1. për emërim në Gjykatën e Apelit, dhjetë (10) vite përvojë juridike nga të cilat pesë (5) vite si gjyqtar.
4.2. për emërime në Gjykatën Supreme, pesëmbëdhjetë (15) vite përvojë juridike nga e cila shtatë (7) vite si gjyqtar.
4.3. të gjitha kriteret e tjera, ashtu siç parashihen në nenin 26 të këtij ligji, mbesin të pandryshuara.

5. Pavarësisht cilësdo dispozitë në të kundërtën, mandati i të gjithë gjyqtarëve të emëruar në bazë të paragrafin 1. të nenit 150 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është deri në moshën e pensionimit të paraparë me ligj përpos nëse kjo hiqet në përputhje me ligjin. Këshilli Gjyqësor i Kosovës mund të konsiderojë përvojën e tërësishme të gjyqtarëve në fjalë gjatë transferimit dhe ri caktimit të tyre në gjykatat e themeluara me këtë ligj.

Neni 28
Gjyqtarët porotë

1. Gjyqtarët porotë do të shërbejnë vetëm kur kërkohet me ligj.
2. Për t'u emëruar gjyqtarë porotë duhet të përmbushen kualifikimet si në vijim:
   1.1. të jenë shtetas dhe banorë të Kosovës;
   1.2. të kenë më se paku njëzetepesë (25) vite;
   1.3. të kenë përfunduar me sukses trajnimin e kërkuar me ligj që të shërbej në kapacitetin e kërkuar;
   1.4. të kenë përmbushur kriteret e kërkuara nga rregulloret relevante të Këshillit Gjyqësor i Kosovës;
   1.5. të mos jenë të dënuar për vepra penale me përjashtim të kundërvajtjeve;
   1.6. të kenë reputacion të lartë moral në shoqëri.
3. Gjyqtarët porotë do të shpërblehen për shërbimet e tyre sipas një plani të kompensimi i cili përcaktohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Neni 29
Paga dhe kompensimi gjyqësor

1. Gjatë mandatit të tyre në detyrë gjyqtarët do të pranojnë pagat si në vijim:
   1.1. Kryetari i Gjykatës Supreme do të pranojë një pagë ekuivalente me atë të Kryeministrit të Republikës së Kosovës.
   1.2. të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Supreme do të pranojnë një pagë ekuivalente me atë të një ministri në Qeveri.
   1.3. Kryetari i Gjykatës së Apelit do të pranojë një pagë ekuivalente me atë të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës.
   1.4. të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Apelit do të pranojnë një pagë ekuivalente prej nëntëdhjetë (90) % të Kryetarit të Gjykatës së Apelit.
   1.5. Kryetari i Gjykatës Themelore do të pranojë një pagë ekuivalente me atë të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit.
   1.6. gjyqtari mbikëqyrës i një dege të Gjykatës themelore do të pranojë një pagë ekuivalente me nëntëdhjetepesë (95) % të Kryetarit të Gjykatës Themelore.
   1.7. çdo gjyqtar i Gjykatës Themelore do të pranojë një pagë bazë jo më pak se

shtatëdhjetë (70)% të pagës së Kryetarit të Gjykatës Themelore. Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të shpallë një plan për kompensime shtesë të cilat njohin përgjegjësinë unike të gjyqtarëve të cilët shërbejnë në departamentet për krimet e rënda, Çështjet Ekonomike apo Administrative; por shuma e pagës bazë dhe kompensimeve shtesë në asnjë rast nuk do të tejkalojë nëntëdhjetë (90) % të pagës së Kryetarit të Gjykatës Themelore.

2. Paga e një gjyqtari nuk do të zvogëlohet gjatë mandatit në të cilin gjyqtari është emëruar, përveç sanksionimit disiplinor të vendosur nën autoritetin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
3. Gjyqtarët gëzojnë të drejtën e pushimit vjetor prej njëzet (20) ditë pune, me pagesë.

Neni 30
Mbrojtja

Gjyqtarët kanë të drejtë që nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës të kërkojnë masa të veçanta mbrojtëse për veten dhe për familjet e tyre atëherë kur një kërcënimi ndaj jetës së tyre, apo jetës së një anëtari të familjes, vjen nga apo është rezultati i përgjegjësive të tyre gjyqësore.

Neni 31
Imuniteti

Gjyqtarët dhe gjyqtarët porotë gëzojnë të drejtën e imunitetit siç parashikohet me Kushtetutë.

Neni 32
Veprimtaritë Profesionale

1. Gjyqtarët mund të marrin pjesë në organizata profesionale të cilat promovojnë pavarësinë e gjyqësorit, zgjerojnë arsimimin profesional dhe inkurajojnë efikasitetin e gjykatave.
2. Gjyqtarët mund të marrin pjesë në takime profesionale dhe shkencore, ligjërata dhe trajnime, apo në projekte të tjera juridike dhe mund të pranojnë kompensim për veprimtari të tilla, në rast se këto kompensime nuk paraqesin konflikt interesi dhe nëse nuk janë në kundërshti me ligjin, Kodin e etikës gjyqësore apo të akteve tjera nën-ligjore.
3. Gjyqtarët mund të merren me shkrime profesionale apo shkencore, por nuk guxojnë të përdorin apo zbulojnë përmbajtjen e shqyrtimeve gjyqësore, apo informacionin e grumbulluar gjatë procesit gjyqësor i cili nuk ka qenë i përfshirë në vendimin e shkruar.
4. Gjyqtarët që pranojnë shpërblim për pjesëmarrje në veprimtaritë e parapara sipas këtij neni, për këtë shpërblim do ta njoftojnë Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Neni 33
Bashkëpunëtorët profesionalë dhe praktikantët

Bashkëpunëtorët profesionalë dhe praktikantët gjyqësorë përcaktohen me rregulloren e Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Neni 34
Detyrat e gjyqtarëve

1. Gjyqtarët veprojnë në mënyrë objektive, të paanshme dhe të pavarur.
2. Gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, gjyqtarët demonstrojnë disponueshmërinë, respektin për palët dhe dëshmitarëve si dhe vigjilencë në ruajtjen e shkallës më të lartë të kompetencës.
3. Gjatë ushtrimit të funksioneve gjyqësore, gjyqtarët mbrojnë konfidencialitetin e çdo informacioni jo-publik.
4. Gjyqtarët nuk komentojnë në media përmbajtjen, provat dhe vendimet e cilësdo lëndë. Gjyqtarët nuk përfshihen në çfarëdo komunikimi ex-parte me askënd lidhur me lëndët.
5. Gjyqtarët duhet të përfshihen në arsimimin e vazhdueshëm ligjor në përputhje me rregulloret e shpallura nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Neni 35
Ndalesat mbi Sjelljen e Gjyqtarëve

1. Gjyqtarët nuk kryejnë asnjë detyrë apo shërbim që mundet apo mund të perceptohet si ndërhyrje me pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre apo që përndryshe nuk është në përputhje me detyrat e një gjyqtari apo dispozite të Kodit të Mirësjelljes për Gjyqtarë.
2. Gjyqtarët nuk janë pjesëtarë të një partie politike, lëvizjeje apo çfarëdo organizate tjetër politike e as të marrë pjesë në çfarëdo lloj veprimtarie politike. Gjyqtarët nuk do të kërkojnë e as nuk do mbajnë asnjë lloj të zyrës politike.

KREU V
DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 36
Fazat kalimtare

1. Ky ligj do të zbatohet sipas planit kohor në vijim:
   1.1. faza planifikuese: nga data 1 janar 2011 deri më 31 dhjetor 2011 Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të përgatisë fazën zbatuese për të mundësuar kalimin nga struktura e tanishme e gjykatave tek struktura e gjykatave që themelohen me këtë ligj. Këshilli Gjyqësor i Kosovës deri më 1 dhjetor 2011 do të postojë planin e zbatimit në faqen e vet të internetit
   1.2. faza e zbatimit: nga data 1 janar 2012 deri më 31 dhjetor 2012 Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të realizojë planin e vet zbatimit.

2. Neni 29 do të zbatohet nga 1 janari 2011 dhe gjyqtarët deri në reformimin gjyqësorit do t'i marrin pagat si në vijim:
   2.1. Gjyqtarët e Gjykatës së Qarkut do të marrin pagë të barabartë me atë të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit,
   2.2. Gjyqtarët e Gjykatës Komunale do të marrin pagë të barabartë me atë të gjyqtarit të Gjykatës Themelore dhe
   2.3. Gjyqtarët e Gjykatës për Kundërvajtje do të marrin pagë prej nëntëdhjetë perqind (90%), të barabartë me gjyqtarët e Gjykatës Komunale.

Neni 37
Autoriteti i Këshillit Gjyqësor të Kosovës gjatë fazës planifikuese dhe fazës zbatuese

1. Gjatë Fazës Planifikuese, Këshilli Gjyqësor i Kosovës shpall rregullore që referojnë drejt çështjeve si kalimtare edhe operative që rrjedhin si domosdoshmëri nga ky ligj.
2. Gjatë Fazës Planifikuese, Këshilli Gjyqësor i Kosovës po ashtu zhvillon një plan të detajuar për zbatim që përfshin, por nuk kufizohet në:
   2.1. riklasifikimin e lëndëve dhe të numrave të tyre, për ta përshtatur me strukturën e gjykatave të themeluara me këtë ligj;
   2.2. transferimin e lëndëve në gjykatën apo degën e duhur;
   2.3. sistemimin e personelit;
   2.4. transferimin e aseteve fizike ndërmjet gjykatave;
   2.5. caktimin dhe ricaktimin e lëndëve dhe gjyqtarëve në Departamentet kompetente Gjykatës Themelore;
   2.6. transferimin e gjyqtarëve në pozitat e duhura siç është e paraparë me këtë ligj duke pasur parasysh dhe duke respektuar emërimet dhe vendimet e marrura gjatë Procesit të vetëm të Emërimit; dhe
   2.7. të gjitha çështjet tjera që ndërlidhën me kalimin e gjykatave në strukturën e paraparë me këtë ligj, si dhe funksionimin efikas të gjykatave në të ardhmen.
3. Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për planifikimin dhe zbatimin e plotë të dispozitave të këtij ligji dhe për të siguruar tranzicion të lehtë tek struktura e re e gjykatave.

Neni 38
Transferimi dhe Ricaktimi i Gjyqtarëve

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës transferon dhe ricakton gjyqtarët në gjykatat e themeluara me këtë ligj duke marrë parasysh dhe respektuar:
   1.1. emërimet, veçanërisht emërimet e Kryetarëve të Gjykatave, të kryera gjatë Procesit të Emërimit siç ceket në paragrafin 1. të nenit 150 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; dhe
   1.2. integritetin, përvojën, kapacitetin dhe aftësitë menaxheriale sipas vlerësimit gjatë Procesit të Riemërimit siç ceket në paragrafin 1. të nenit 150 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

1.3. transferimi nuk mund të bëhet kundër vullnetit të tyre.

Neni 39
Zgjidhja e lëndëve të pakryera

1. Të gjitha lëndët të cilat më 31 dhjetor të vitit 2012 janë lëndë të shkallës së dytë të Gjykatës Supreme, Gjykatës së Qarkut apo Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje dhe nuk janë zgjidhur me një vendim të formës së prerë, më 1 janar të vitit 2013 trajtohen si lëndë të Gjykatës së Apelit.
2. Të gjitha lëndët të cilat më 31 dhjetor të vitit 2012 janë lëndë të shkallës së parë të Gjykatës Supreme, Gjykatës së Qarkut, Gjykatës Ekonomike të Qarkut, Gjykatës Komunale apo Gjykatave Komunale për Kundërvajtje dhe nuk janë zgjidhur me një vendim të formës së prerë, më 1 janar të vitit 2013 trajtohen si lëndë të Gjykatës Themelore e cila ka juridiksionin territorial përkatës.

Neni 40
Vlefshmëria e Vendimeve të Mëparshme të Formës së Prerë dhe e Drejta në Ankesë

Të gjitha vendimet e formës së prerë të Gjykatës Supreme, Gjykatës së Qarkut, Gjykatës Ekonomike të Qarkut, Gjykatës Komunale, Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje, të nxjerra para transferimit të kompetencave tek gjykatat e themeluara me këtë ligj do të kenë fuqi dhe efekt të plotë.

Neni 41
Buxheti

Për zbatimin e plotë të këtij ligji Qeveria e Kosovës siguron fonde të nevojshme nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

KREU VI
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 42
Shfuqizimi i Ligjeve të Tjera

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, shfuqizohen Ligji për gjykatat e rregullta të KSAK-së, rregulloret e UNMIK-ut dhe Ligji për kundërvajtje.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, çfarëdo referimi në cilindo ligj, rregullore, urdhëresë, rregull apo ndonjë akt tjetër që i mvesh juridiksion të shkallës së parë Gjykatës për Kundërvajtje, Gjykatës Komunale, Gjykatës së Qarkut, Gjykatës Ekonomike, apo Gjykatës Supreme, do të formulohet asisoji që të nënkuptojë Gjykatën Themelore. Çfarëdo referimi në cilindo ligj, rregullore, urdhëresë apo rregull që i mvesh juridiksion të shkallës së dytë Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje, Gjykatës së Qarkut apo Gjykatës Supreme do të formulohet asisoji që të nënkuptojë Gjykatën e Apelit.

Neni 43
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2011 për nenet 29, 35, 36, 38 dhe 40, kurse për nenet e tjera fillon të zbatohet nga 1 janari 2013.

Ligji Nr. 03/L-199
22 korrik 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-047-2010, datë 09.08.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 79 / 24 GUSHT 2010

LIGJI Nr. 04/L-171
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-199
PËR GJYKATAT

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-199 PËR GJYKATAT

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të ndryshoj dhe plotësoj Ligjin Nr. 03/L-199 për Gjykatat.

Neni 2

Neni 18 nënparagrafi 1.2. i ligjit bazik, fshihet.

Neni 3

1. Nenit 22 të ligjit bazik i shtohet nën-paragraf i ri si në vijim:
   "1.1 Gjykata Supreme vendos në shkallë të tretë për ankesat e lejuara me ligj".
2. Nënparagrafi 1.1 i ligjit bazik rinumrohet si nën-paragrafi 1.2. dhe vazhdon rinumrimi deri në fund të ketij neni.

Neni 4
Ndryshimi dhe Plotësimi i Nenit 42

Neni 42 paragrafi 1. i ligjit bazik duhet të riformulohet me tekstin në vijim:

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen Ligji mbi Gjykatat e Rregullta të KSAK-së dhe rregulloret relevante të UNMIK-ut.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-171
20 dhjetor 2012

Shpallur me dekretin Nr. DL-058-2012, datë 21.12.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 37 / 28 DHJETOR 2012, PRISHTINË

LIGJI Nr. 04/L-115
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË KANË TË BËJNË ME PËRFUNDIMIN E MBIKËQYRJES NDËRKOMBËTARE TË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË KANË TË BËJNË ME PËRFUNDIMIN E MBIKËQYRJES NDËRKOMBËTARE TË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Neni 1
Qëllimi

1. Ky ligj ka për qëllim të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve në vijim për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës:
   1.1. Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
   1.2. Ligjit Nr. 03/L-075 për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës;
   1.3. Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
   1.4. Ligjit Nr. 03/L-079 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale;
   1.5. Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
   1.6. Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04 L 101 për Fondet Pensionale të Kosovës;
   1.7. Kodit Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë;
   1.8. Ligji Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat;
   1.9. Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat;
   1.10. Ligji Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
   1.11. Ligji Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
   1.12. Ligji Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë;
   1.13. Ligji Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme;
   1.14. Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës;
   1.15. Ligji Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativ të Komunave;

1.16. Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës;
1.17. Ligji Nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës;
1.18. Ligji Nr. 03/L-237 për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave;
1.19. Ligji Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës;
1.20. Ligji Nr. 03/L-082 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës.
1.21. Ligji Nr. 03/L-033 për Statusin, imunitetet dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin e Kosovës dhe praninë ndërkombëtare ushtarake, si dhe personelin e saj.

Neni 2
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Ligji)

1. Neni 15 i ligjit bazik pas paragrafit 1. shtohet paragraf i ri 2. me tekstin si në vijim:
   2. Gjykatësit ndërkombëtarë, të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë ligj, vazhdojnë të marrin pagën e tyre të specifikuar sipas vendimit për emërim. Qeveria e Kosoves merr pjesë në pagesën e gjykatësve ndërkombëtarë, në periudhën e përcaktuar në vlerë të pagave të gjyqtarëve vendorë.
2. Neni 55 i ligjit bazik, paragrafi 1. dhe paragrafi 2 fshihen nga teksti i ligjit dhe shtohet një paragraf i ri me tekstin si në vijim:
   Mandati i gjykatësve ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim.

Neni 3
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-075 për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës (Ligji)

1. Neni 8 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 8

Auditori i përgjithshëm, i emëruar në përputhje me Kushtetutën dhe me këtë ligj, vazhdon të qëndrojë në post deri në përfundim të mandatit, me kompensimin e cekur në kushtet specifike të emërimit të tij. Qeveria e Kosovës siguron fonde në vlerën e përcaktuar me marrëveshjen në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Zyrës se Auditorit të përgjithshëm.

Neni 4
Ndryshimet dhe plotësimet Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji)

1. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1.12, që përkufizon Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar, fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Kuvendi pas propozimit nga qeveria zgjedh tre (3) anëtarë ndërkombëtarë drejtorë të bordit. Bordi, po ashtu, emëron një shtetas të Kosovës drejtor të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit, i cili nuk do të jetë anëtar i Bordit. Bordi, përveç kryesuesit, po ashtu, emëron zëvendëskryesues njërin prej anëtarëve të tij. Për emërimin, shkarkimin ose ndryshimin e kushteve të referimit të Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit kërkohet vota afirmative e shumicës së Bordit të Drejtorëve. Anëtarët ndërkombëtarë zgjedhën më mandat deri më 31 gusht 2014.

3. Neni 14 i ligjit bazik, paragrafët 7., dhe 9., vlejnë deri në përfundimin e mandatit të anëtarëve ndërkombëtarë të bordit.
4. Neni 31 i ligjit bazik, pas paragrafit 5. shtohet një paragraf i ri 6. me tekstin si në vijim:
   6. Nëse një anëtar ndërkombëtar i bordit i emëruar në pajtim me nenin 31 (5) jep dorëheqje nga Bordi dhe nëse kjo dorëheqje ose largim nga posti ndodh deri më 31 gusht 2014 atëherë ai/ajo do të zëvendësohet me një ndërkombëtar tjetër.

Neni 5
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-079 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale (Ligji)

1. Neni 4 i ligjit bazik që ndryshon nenin 5.2 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   5.2. Bordi mbikëqyrës përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve të cilët emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryeministri.
2. Neni 8 i ligjit bazik që ndryshon nenin 6.1 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   6.1. Sekretaria Ekzekutive ka drejtorin dhe zëvendësdrejtorin të cilët emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryeministri.
3. Neni 10 i ligjit bazik që ndryshon nenin 7.1 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   7.1. Komisioni përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të cilët emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.
4. Neni 13 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 13

Kuvendi, në konsultim me Komisionin, mund të themelojë panele shtesë të Komisionit, anëtarët e të cilëve do të emërohen në bazë të neneve 7.1 dhe 7.2.

5. Neni 16 i ligjit bazik që ndryshon nenin 12.8 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   12.8. Gjykata Supreme e Kosovës vendos lidhur me ankesat në trupin gjykues prej tre (3) gjyqtarëve të cilët emërohen nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës.
6. Pas nenit 27 të ligjit bazik, shtohet një nen i ri 27.A me tekstin si në vijim:

Neni 27.A

1. Mandati i tre (3) anëtarëve ndërkombëtarë të Bordit mbikëqyrës (përfshi edhe kryesuesin), i drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive, i dy (2) anëtarëve ndërkombëtarë të Komisionit (përfshi edhe kryesuesin), si dhe i dy gjykatësve ndërkombëtarë në panelet e ankimit të Gjykatës Supreme të cilët janë emëruar në pajtim me Kushtetutën do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim.
2. Anëtarët dhe gjykatësit ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë Ligj vazhdojnë të marrin pagën e tyre të specifikuar sipas kushteve të emërimit të tyre.
3. Qeveria e Kosoves do të sigurojë fonde për drejtorin e Sekretariatit Ekzekutive të barabartë me pagën e një anëtari vendor të Bordit Mbikëqyrës.
4. Nëse një anëtar ndërkombëtar i emëruar ne pajtim me Kushtetutën jep dorëheqje ose largohet nga pozita e tij/saj dhe nëse ky largim ose dorëheqja ndodh para datës 31 gusht 2014, atëherë ai/ajo do të zëvendësohet me një ndërkombëtar, të dominuar nga Kryeministri për pozitat e anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë së Pronës dhe drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive, si dhe të nominuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme për pozitën e anëtarëve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Anëtareve të Panelit të Ankesave të Gjykatës Supreme, pas konsultimeve me PSBE.

Neni 6
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.3. fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.7, riformulohet me tekstin si në vijim:
   1.7. **Gjykatës Ndërkombëtar** - çdo gjykatës i Misionit Evropian për Politika të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, i cili është emëruar në pajtim me këtë ligj.
3. Neni 11 i ligjit bazik, paragrafi 2. riformulohet me tekstin si në vijim:
   2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Dhoma e Posaçme do të vazhdojë të respektojë dhe zbatojë parimin e kompensimit në vend të kthimit fizik. Kur vendoset për mjetin juridik që do të jepet në një rast të caktuar, Dhoma e Posaçme do të marrë parasysh edhe dispozitat në fuqi të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, duke përfshirë qëllimet publike që përcaktohen në preambulën e atij ligji.

Neni 7
Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04 L-101 për fondet pensionale të Kosovës

1. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 4.6, riformulohet me tekstin si në vijim:
   4.6. Komisioni për përzgjedhje, i propozon kandidatët Kuvendit për vendet e lira në anëtarësim ose për riemërim të anëtarëve të Bordit Drejtues. Komisioni për Përzgjedhje do të përbëhet nga guvernatori i BQK-së - kryesues, Auditori i

Përgjithshëm dhe Ministri i Financave. Mandati i secilit anëtar të emëruar në Bordin Drejtues zgjat tre vjet, me mundësi të rizgjedhjes, nëse mandati i anëtarëve të Bordit skadon dhe asnjë anëtar i ri nuk është emëruar, atëherë anëtarët e Bordit ekzistues do të vazhdojnë mandatin për nëntëdhjetë (90) ditë.

Neni 8
Ndryshimet dhe plotësimet e Kodit Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë (Kodi)

1. Neni 309 i ligjit bazik që rregullon emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave me pëlqimin e PCN-së, fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 1 i Aneksit D, i Kodit, fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 1

Ky Aneks ofron përjashtimet e posaçme të përkufizuara në këtë Aneks që do t'i jepen bashkësive fetare sipas përkufizimit në legjislacionin e aplikueshëm, duke përfshirë edhe legjislacionin për liritë fetare në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Neni 9
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat (Ligji)

1. Neni 1 i ligjit bazik, paragrafi 1.32, që përkufizon PCN-në fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 8 i ligjit bazik paragrafi 2. në rreshtin e tretë fshihet fjala “dhe PCN”.
3. Neni 88 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 10
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-199 për gjykatat (ligji)

1. Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 11, riformulohet me tekstin si në vijim:
   11. Nëse në njërën nga komunat e reja dhe të themeluara mbi bazën e Ligjit për Kufijtë Administrativë Komunal nuk ka gjykatë themelore, komuna me vendim të Kuvendit Komunal mund ta parqet kërkesën para Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK) për të vendosur mbi themelimin e gjykatës themelore në territorin e saj, ose që një nga gjykatat ekzistuese themelore në territorin e komunës tjetër të ketë juridiksion mbi territorin e komunës së re. Të njëjtën të drejtë e ka edhe komuna ekzistuese, ku shumica e popullatës i takon komunitetit jo shumicë në Kosovës, dhe në të cilën nuk ka gjykatë themelore.
      11.1. KGjK do të aprovojë kërkesat e tilla, përveç nëse vlerësohet se ngarkesat e lëndëve për atë juridiksion është e pamjaftueshme për ta arsyetuar ekzistimin e gjykatës së ndarë.
      11.2. Kur KGjK e aprovon kërkesën për themelimin e gjykatës së re

themelore, autoritetet kompetente do t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se cilado gjykatë e re, është themeluar dhe funksionale brenda periudhës gjashtë mujore prej datës së vendimit.

11.3. Nëse KGjK nuk aprovon kërkesën për themelimin e gjykatës së re themelore, ose kur komuna i kërkon gjykatës ekzistuese që të ketë juridiksion për territorin e vet, autoritetet kompetente do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për përmirësimin e qasjes në drejtësi për komunitetet lokale, e cila është vështirësuar për shkak të izolimit gjeografik, mungesës së sigurisë, ose për shkak të faktorëve të tjerë relevant. Këto masa mund të përfshijnë krijimin në kuadër të territorit të komunës së re, të një departamenti të gjykatës themelore ekzistuese prej së cilës komuna e re ka kërkuar të ketë kompetencë për territorin e vet, ose që gjykata themelore të mundësojë mbajtjen e seancave në territorin e komunës së re.

2. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Përbërja e Gjykatës së Apelit pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Republikës së Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore. Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin përkatës në fuqi, si dhe për të siguruar pjesëmarrjen e komunitetit në gjyqësor, pesëmbëdhjetë (15) për qind e numrit të tërësishëm të ulëseve në Gjykatën e Apelit, por jo më pak se dhjetë ulëse, garantohen për gjyqtarët nga radha e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

Neni 11
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.2. fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 1.3, riformulohet me tekstin si në vijim:

1.3. Për të siguruar se gjykatat pasqyrojnë përbërjen etnike të zonës së tyre të juridiksionit në përputhje me nenin 104(3) të Kushtetutës dhe me legjislacionin përkatës në fuqi, Këshilli do të marrë parasysh që të plotësojë vendet e lira të punës ose të ulëseve të rezervuara me anëtarë të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

3. Neni 7 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 7
Mandati i anëtarëve të Këshillit

Anëtarët e Këshillit zgjidhen me mandat 5 (pesë) vjeçar, siç ceket në nenin 108 (6) të Kushtetutës dhe në këtë ligj. Një anëtar i këtij Këshilli mund të zgjidhet për një mandat shtesë jo-vijues pesë (5) vjeçar.

4. Neni 16 i ligjit bazik, paragrafi 3., riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Në përputhje me nenin 104(3) të Kushtetutës, Këshilli zbaton masa dhe veprimet tjera me qëllim rekrutimi, të cilat i konsideron të nevojshme dhe të përshtatshme për të siguruar se një gjykatë ose degë e gjykatës pasqyron përbërjen etnike në zonën e tyre të juridiksionit.

5. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 1., riformulohet si në vijim:
   1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ndërmerr masa të nevojshme për të rritur numrin e gjyqtarëve nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë, prej radhëve të atyre gjyqtarëve që shërbejnë në Kosovë. Për të përmbushur përgjegjësitë e veta, Këshilli, ndër të tjera, nga aplikantët njëlloj të kualifikuar për të shërbyer si gjyqtarë u jep përparësi anëtarëve nga komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovës, ashtu siç është paraparë me nenin 108 të Kushtetutës.
6. Neni 17 i ligjit bazik, pas paragrafit 5., shtohen tre paragraf të rinjë 6, 7 dhe 8, me tekstin si në vijim:
   6. Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të hartojë një rregullore të veçantë për të përshkruar procesin e emërimit dhe të riemërimit të gjykatësve nga komunitetet e nën-përfaqësuara në mesin e gjykatësve që shërbejnë në Kosovë.
   7. Dhënia e përparësisë për kandidatët me kualifikime të barabarta nga komunitetet e nën-përfaqësuara, do të zbatohet përderisa përqindja e gjyqtarëve pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë në Kosovë të jetë nën pesëmbëdhjetë përqind (15%) dhe / përderisa përqindja e gjyqtarëve të cilët janë pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, të jetë nën tetë (8%).
   8. Mandati i dy anëtarëve ndërkombëtarë të Këshillit të emëruar në pajtim me Kushtetutën do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim. Anëtarët ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë ligj vazhdojnë të marrin pagën e tyre.
   9. Neni 52 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 12
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.7, fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 1.3 riformulohet me tekstin si në vijim:
   1.3. Siguron se prokuroritë pasqyrojnë përbërjen etnike të zonës së tyre të juridiksionit në përputhje me nenin 109 (4) dhe 110(3) të Kushtetutës.
3. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Këshilli zbaton masa dhe veprime rekrutimi, si dhe masa të tjera të cilat i konsideron të nevojshme për të siguruar që një zyrë prokuroriale pasqyron përbërjen etnike të zonës së juridiksionit përkatës.
4. Neni 17 i ligjit bazik, pas paragrafit 3. shtohet një paragraf i ri 4. me tekstin si në vijim:
   4. Këshilli harton rregullore të veçantë për të përshkruar procesin e emërimit dhe të riemërimit të prokurorëve nga komunitetet e nën-përfaqësuara në mesin e prokurorëve që shërbejnë në Kosovë.
5. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 1., riformulohet me tekstin si në vijim:
   1. Këshilli ndërmerr masa të nevojshme për të rritur numrin e prokurorëve nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë. Kur ka aplikantë njëlloj të kualifikuar për të shërbyer si prokurorë, Këshilli u jep përparësi anëtarëve nga komunitetet që janë të nënpërfaqësuara në Kosovë siç është paraparë edhe me nenin 109 (4) dhe 110 (3) të Kushtetutës.

6. Neni 18 i ligjit bazik, pas paragrafit 5, shtohet paragrafi i ri 6, me tekstin si në vijim:
   6. Dhënia e përparësisë për kandidatët me kualifikime të barabarta nga komunitetet e nën-përfaqësuara, do të zbatohet përderisa përqindja e prokuroreve pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë në Kosovë të jetë nën pesëmbdhjetë përqind (15%) dhe / ose përderisa përqindja e prokurorëve të cilët janë pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, të jetë nën tetë përqind (8%).

Neni 13
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë (Ligji)

1. Pjesa e parë e preambulës se ligjit, riformulohet me tekstin si në vijim:
   Në bazë të nenit 65 (1) dhe ne pajtim me dispozitat kalimtare dhe përfundimtare nga kreu XIII dhe XIV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Pas nenit 7 të ligjit bazik shtohet një nen i ri 7.A me tekstin si në vijim:

Neni 7.A
Statusi i Kishës Ortodokse Serbe

1. Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë konsiderohet pjesë përbërëse e Kishës Ortodokse Serbe (KOS).
2. Emri dhe organizimi i brendshëm i Kishës Ortodokse Serbe, duke përfshirë edhe hierarkinë dhe veprimtaritë e saj, do të respektohen.
3. Nuk do të ketë ndalim arbitrar për hyrje në Kosovë ose qëndrim brenda Kosovës për priftërinjtë, kandidatët për prift, murgjve, murgeshave dhe vizitorëve.
4. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 7.3, fjalët "**themelojnë dhe**", fshihen nga teksti i ligjit.
5. Neni 8 i ligjit bazik, paragrafi 1, riformulohet me tekstin si në vijim:
   1. Ndërtesat dhe objektet që u takojnë bashkësive fetare, që janë të dedikuara për kryerjen e ceremonive fetare konsiderohen të pacenueshme për sa i përket ndërhyrjes së autoriteteve qeveritare dhe në to mund të hyhet vetëm me pëlqimin e institucionit përkatës fetar, përveç nëse është lëshuar ndonjë urdhër gjyqësor për shkak të aktiviteteve ilegale dhe në rast të rrezikut për jetën ose shëndetin.
6. Neni 12 i ligjit bazik, pas paragrafit 12.4 shtohet një paragraf i ri 12.5 me tekstin si në vijim:
   12.5. Përveç përjashtimeve të përmendura më lart, bashkësitë fetare gëzojnë privilegje doganore dhe tatimore për veprimtari ekonomike, që janë specifike për vetë-qëndrueshmërinë e tyre financiare, siç do të definohet me një akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e financave. Këto privilegje përfshijnë importimin dhe blerjen e produkteve qenësore për prodhim, të materialeve, pajisjeve dhe bagëtisë; dhe eksportimin e produkteve që dalin nga aktivitetet e lartpërmendura.

Neni 14
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1. përkufizimi "**Propozimin Gjithëpërfshirës**", fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Objekt i shpronësimit sipas këtij ligji mund të jenë të drejtat private pronësore dhe të drejtat tjera private për ose ndaj një prone të paluajtshme, me përjashtim të asaj prone të paluajtshme që bën pjesë në atë kategori të pronës, për të cilën Kushtetuta në mënyrë specifike thotë se nuk do të jetë objekt i shpronësimit.
3. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3, shtohet nën-paragraf i ri 3.1. me tekstin si në vijim:
   3.1 Prona e luajtshme dhe e paluajtshme, si dhe asetet tjera të Kishës Ortodokse Serbe do të jenë të pacenueshme dhe nuk do të jenë objekt i shpronësimit.

Neni 15
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (ligji)

1. Pas nenit 3 shtohet nen i ri 3.A me tekstin si në vijim:

Neni 3.A
Të drejtat e refugjatëve dhe personave të zhvendosur

1. Të gjithë refugjatët nga Kosova dhe personat e zhvendosur brenda vendit do të kenë të drejtën e kthimit dhe kërkimit të pronës së tyre dhe posedimeve personale, në pajtim me ligjet vendore dhe ndërkombëtare. Çdo person do të ketë të drejtë të marrë vendim të lirë dhe të jetë i informuar për vendin ku ai kthehet.
2. Institucionet e Republikës së Kosovës ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të krijuar kushte te favorshme për kthim të sigurt dhe të denjë të refugjatëve dhe personave të zhvendosur, bazuar në vendimet e tyre të lira dhe të bazuara në informata të sakta, përfshirë përpjekjet për të promovuar dhe mbrojtur lirinë e tyre të lëvizjes dhe mbrojtjen nga kërcënimi
3. Kushtet e kthimit të personave të zhvendosur dhe mekanizmat e bashkëpunimit me institucionet relevante ndërkombëtare do të përcaktohen nga institucionet e Republikës së Kosovës në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e aplikueshme."

Neni 16
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativë të Komunave (ligji)

1. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Bordi do të përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë, me nga pesë (5) përfaqësues të zgjedhur nga secila komunë dhe një (1) përfaqësues i zgjedhur nga Kryeministri.

2. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 4. riformulohet me tekstin si në vijim:
   4. Kryesuesi i Bordit përzgjidhet nga Kryeministri.
3. Neni 14 i ligjit bazik, fshihet termi **"dhe PCN do të ndërmarrin"** dhe zëvendësohet me termin: "**ndërrmer**".
4. Në Shtojcën 1 (Zonat Kadastrale) të ligjit bazik, emërtimi i komunës "**Hani i Elezit**" në gjuhën serbe dhe angleze ndryshohet në "**Elez Han**"

Neni 17
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës (ligji)

1. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi (c) riformulohet me tekstin si në vijim:
   (c) Një (1) anëtar, i përzgjedhur nga Kryeministri.
2. Neni 14 i ligjit bazik, paragrafi (b), nënparagrafi (iv) riformulohet me tekstin si në vijim:
   iv. Një (1) anëtar, i përzgjedhur nga Kryeministri.

Neni 18
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës (ligji)

1. Titulli i nenit 29 të ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 29
Regjistrimi dhe përcaktimi i shtetësisë

Neni 19
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-237 për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave (Ligji)

1. Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 4.12., riformulohet me tekstin si në vijim:
   4.12 Një (1) përfaqësues nga një prej Universiteteve publike, anëtar;

Neni 20
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës (ligji)

1. Neni 9 i ligjit bazik, paragrafi 3., riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Forca e Sigurisë së Kosovës është e strukturuar dhe e përgatitur për të përmbushur funksionet e sigurisë që nuk i përkasin policisë ose organizatave tjera për zbatim të ligjit.
2. Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 2., riformulohet me tekstin si në vijim:
   2. Forca e Sigurisë së Kosovës është e armatosur lehtë dhe nuk ka armë të rënda, siç janë tanket, artileria e rëndë ose kapacitete sulmuese ajrore. Një rishikim i plotë i këtyre kufizimeve, do të bëhet jo më herët se pesë vjet nga koha e hyrjes në fuqi e Ligjit Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Detyrat fillestare të Forcës së Sigurisë së Kosovës janë:

3. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 2, pika (e) fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 21
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-082 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës (ligji)

1. Neni 5 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 22
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-033 për Statusin, imunitetet dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin e Kosovës dhe praninë ndërkombëtare ushtarake, si dhe personelin e saj

1. Neni 3 i ligjit bazik paragrafi 2. pika (a) riformulohet me tekstin si në vijim:
   (a) Zyra Civile Ndërkombëtare dhe Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian.
2. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3.3. Individët e emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtarë, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, mandati i të cilëve nuk ka përfunduar para deklarimit të përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur gëzojnë statusin, privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara në ligjin bazik.
3. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 6., riformulohet me tekstin si në vijim:
   4.6. Ministri i Punëve të Jashtme nuk mund t'i shpallë PSBE-në ose një anëtar të personelit të tij, anëtarët e personelit të ICO-së, përfshirë individët e përcaktuar në nenin 3.3. të ligjit bazik ose anëtarët e misionit EULEX, si persona non grata.
4. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 7. fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 23

1. Të gjithë anëtarët ndërkombëtarë të emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, në pajtim me Kushtetutën e Republikës se Kosovës, me përjashtim të atyre të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Agjencisë Kosovare të Pronës gjyqtarët ndërkombëtarë të Panelit të Ankesave të Gjykatës Supreme, dhe dy gjyqtarë në Komisionin për Kërkesa Pronësore, nëse për çfarëdo arsye largohen nga pozita para datës 31 gusht 2014 ai/ajo do të zëvendësohet me një anëtar vendor.
2. Nëse në cilindo ligj të aplikueshëm në Republikën e Kosovës përdoren termet ICO ose PCN, të njëjtat shfuqizohen dhe zëvendësohen me institucionet vendore përkatëse.

II. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 24
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të amendamenteve kushtetuese për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë.

Ligji Nr. 04/L-115
31 gusht 2012

Shpallur me dekretin Nr.DL-036-2012, datë 04.09.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr.25 / 7 SHTATOR 2012, PRISHTINË

LIGJI Nr. 03/L-224
PËR KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 823
Kreu II: Kompetencat, përgjegjësitë dhe përbërja e këshillit 824
Kreu III: Rekrutimi, propozimi dhe emërimi i prokurorëve 831
Kreu IV: Vlerësimi dhe transferimi i prokurorëve 833
Kreu V: Procedurat disiplinore 834
Kreu VI: Zyra e prokurorit disiplinor 837
Kreu VII: Trajnimi i prokurorëve 840
Kreu VIII: Dispozitat përfundimtare 840

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe Fushëveprimi i Ligjit

1. Ky ligj rregullon Këshillin Prokurorial të Kosovës (Këshilli-KPK), një institucion tërësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të veta.
2. Këshilli siguron se të gjithë personat që kanë qasje të barabartë në drejtësi dhe prokurorët ta ushtrojnë funksionin në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme.
3. Këshilli siguron se Prokurori i Shtetit pasqyron natyrën shumetnike të Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore.
4. Këshilli është përgjegjës për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërim dhe riemërim për zyrën prokuroriale si dhe vlerëson, ngrit në detyrë, disiplinon, shkarkon, transferon dhe ofron mbështetje për trajnimin e prokurorëve.
5. Së bashku me Kryeprokurorin e Shtetit, Këshilli është përgjegjës për dërgimin dhe menaxhimin e buxhetit të Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **Ditë -** ditë kalendarike.
   1.2. **Këshilli -** Këshilli Prokurorial të Kosovës, institucion tërësisht i pavarur që ushtron detyrat dhe përgjegjësitë siç parashihen në Kushtetutë dhe në këtë ligj.
   1.3. **Komision Disiplinor** - Komisioni Disiplinor Prokurorial.
   1.4. **Kryeprokuror** - personi që është në krye të një prokurorie me përjashtim të Kryeprokurorit të Shtetit apo Kreut të Prokurorisë Speciale.
   1.5. **Kushtetuta** – Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
   1.6. **Prokuror i Shtetit** – institucion i pavarur i autorizuar dhe përgjegjës për ndjekjen e personave të akuzuar për kryerje të veprave penale dhe akteve të tjera siç specifikohen me ligj dhe përfshin si në vijim: Prokurorinë Themelore, Prokurorinë e Apelit, Prokurorinë Speciale, Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe cilëndo njësi tjetër organizative që mund të krijohet për të kryer funksione prokuroriale.
   1.7. **Propozimi mbi Marrëveshjen Gjithëpërfshirëse** – Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës së 26 marsit 2007

KREU II
KOMPETENCAT, PËRGJEGJËSITE DHE PËRBËRJA E KËSHILLIT

Neni 3
Pavarësia e Këshillit

Këshilli është një institucion tërësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të veta me qëllim të sigurimit të një sistemi prokurorial të pavarur, profesional dhe të paanshëm që pasqyron natyrën shumetnike të Republikës së Kosovës dhe parimet e pranuara ndërkombëtarisht të barazisë gjinore.

Neni 4
Detyrat, Kompetencat dhe Kufizimet e Këshillit

1. Detyrat dhe kompetencat e Këshillit përfshijnë, por nuk kufizohen në:
   1.1. të siguruarit që prokurorët veprojnë në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme gjatë kryerjes së të gjitha funksioneve prokuroriale;
   1.2. rekrutimin dhe propozimin tek Presidenti të kandidatëve për emërim dhe riemërim në prokurori, përfshirë kandidatët nga komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë,
   1.3. të siguruarit se prokuroritë pasqyrojnë përbërjen etnike të zonës së tyre të juridiksionit në përputhje me nenin 109.4. dhe 110.3. të Kushtetutës dhe Propozimit mbi Marrëveshjen Gjithëpërfshirëse, Aneksi IV, neni 2.2.
   1.4. propozimi i kandidatëve tek Presidenti për emërim si Kryeprokuror të Shtetit;

1.5. në bashkëpunim në Institutin Gjyqësor të Kosovës, themelon standardet për rekrutimin, organizimin dhe shpalljen e provimit përgatitor për kualifikimin e prokurorëve.
1.6. shpalljen e konkursit publik për prokurorët.
1.7. përcaktimin e numrit të prokurorëve për secilën prokurori.
1.8. emërimin e Kryeprokurorëve për Prokuroritë Themelore dhe Prokurorisë së Apelit, në përputhje me Ligjin mbi Prokurorinë e Shtetit.
1.9. në bashkëpunim me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit zhvillon politikat dhe strategjitë prokuroriale për të luftimin efektiv të kriminalitetit;
1.10. i propozon Qeverisë dhe Kuvendit masat lidhur me sistemin prokurorial dhe për uftimin e kriminalitetit.
1.11. raportimi tek Kuvendi i Kosovës, Presidenti dhe publiku mbi punën e Këshillit dhe të Prokurorisë së Shtetit;
1.12. përgatitja e një raporti vjetor mbi veprimtaritë e Prokurorit të Shtetit dhe shpenzimet e Këshillit.
1.13. siguron dhe publikon informacion dhe të dhëna statistikore mbi sistemin e prokurorisë;
1.14. mbikëqyr administrimin e prokurorive dhe personelit të saj.
1.15. 1.15 mbikëqyrjen e Njësitit për Shqyrtimin e Performansës së Prokurorisë dhe nxjerrjen e rregullave dhe rregulloreve në përputhje me kompetencat e veta.
1.16. ofrimin e mbështetjes për vlerësimet e rregullta periodike të ngarkesës me lëndë të prokurorive dhe zbatimin e sistemit të shpërndarjes së lëndëve për të siguruar funksionimin efikas të prokurorive.
1.17. përgatitjen, dërgimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të sistemit prokuroria për të siguruar funksionim efikas dhe efektiv të prokurorive dhe kontabilitetit për përdorimin e burimeve fiskale.
1.18. shpalljen e Kodit të Etikës Profesionale për anëtarët e Këshillit, shkelja e të cilit paraqet bazë për sanksione, përfshirë shkarkimin nga Këshilli.
1.19. shpalljen e Kodit të Etikës Profesionale për prokurorët, shkelja e të cilit paraqet bazë për sanksione, përfshirë shkarkimin nga zyra.
1.20. shpalljen e Kodit të Etikës Profesionale për punonjësit mbështetës, shkelja e të cilit paraqet bazë për sanksione, përfshirë largimin nga puna.
1.21. percaktimin e procedurave për seancat dhe zhvillimin e seancave disiplinore;
1.22. kur kërkohet, ti rekomandojë Presidentit shkarkimin e Kryeprokurorit të Shtetit.
1.23. përcaktimin e politikave, standardeve dhe udhëzimeve sa i përket trajnimit të prokurorëve dhe personelit tjetër dhe mbikëqyrjen e zbatimit të trajnimit dhe zhvillimit profesional të prokurorëve nga Instituti apo shoqata apo organizata tjera trajnuese.
1.24. bashkëpunimin me individë apo organizata përgjegjëse për monitorimin e pavarur të sistemit prokurorial.
1.25. shpalljen e rregullave dhe rregulloreve në përputhje me ligjet mbi informimin publik lidhur me menaxhimin dhe zbulimin e informacionit që mbahet nga Prokurori i Shtetit.
1.26. themelimin e komisioneve të cilat Këshilli i vlerëson si të nevojshme.

1.27. miratimi i rregullave të punës për funksionimin e Këshillit dhe komisioneve të veta dhe për zgjedhjen e atyre anëtarëve të Këshillit që zgjidhen nga kolegët e tyre, rregulla këto që janë në dispozicion të publikut.

2. Gjatë ushtrimit të detyrave dhe kompetencave, Këshilli vepron në atë mënyrë që respekton dhe ruan pavarësinë e prokurorëve derisa këta kryejnë funksionet e tyre të ndjekjes. Këshilli nuk do të urdhërojë apo ndikojë, të përpiqet të ndikojë apo të ndërmarrë në ndonjë mënyrë tjetër ndonjë veprim apo të japë çfarëdo deklarate e cila në mënyrë të arsyeshme mund të shihej si ndërhyrje apo përpjekje për ndërhyrje në pavarësinë e funksionit të prokurorisë në raport me cilindo person, hetim apo lëndë.

Neni 5
Përbërja dhe Përzgjedhja e Anëtarëve të Këshillit

1. Këshilli përbëhet nga nëntë (9) anëtarë të cilët janë shtetas të Republikës së Kosovës, pesë (5) nga të cilët janë prokurorë.
2. Nga pesë (5) prokurorët që shërbejnë si anëtarë të Këshillit përfshihen:
   2.1. Kryeprokurori i Shtetit;
   2.2. një (1) prokuror nga Prokuroria Speciale që zgjidhet nga prokurorët që shërbejnë në atë zyrë;
   2.3. një (1) prokuror nga Prokuroria e Apelit që zgjidhet nga prokurorët që shërbejnë në atë zyrë, dhe
   2.4. dy (2) prokurorë nga Prokuroria Themelore që zgjidhen nga prokurorët që shërbejnë në atë zyrë.
3. Anëtarët jo-prokurorë të Këshillit emërohen nga Këshilli bazuar në një listë prej së paku pesë (5) kandidatësh për secilën pozitë të dërguar nga organet relevante dhe kjo përfshin:
   3.1. një (1) anëtar nga Oda e Avokatëve të Kosovës i cili ka specializuar në të drejtën penale, me anë të propozimit të Këshillit Ekzekutiv të Odës së Avokatëve;
   3.2. një (1) profesor nga fakultetet juridike të Republikës së Kosovës sipas propozimit të Departamentit për Arsim të Lartë apo të autoritetit relevant që lidhet me arsimin e lartë;
   3.3. një (1) përfaqësues nga shoqëria civile me përgatitje të lartë profesionale dhe me njohuri nga fusha e të drejtave të njeriut.
4. Ministri i Drejtësisë është anëtarë i Këshillit ex officio.
5. Këshilli zgjedh Nën-Kryesuesin nga radha e anëtarëve të Prokurorëve të vet për një mandat tre (3) vjeçar. Të zgjedhurit në këtë pozitë nuk zgjat mandatin e një anëtari të Këshillit.
6. Anëtarësia e Këshillit pasqyron përbërjen shumë-etnike të Republikës së Kosovës dhe parimet e pranuara ndërkombëtarisht të barazisë gjinore. Së paku një anëtar i Këshilli i zgjedhur sipas paragrafit 2. të këtij neni është nga radha e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.
7. Kryeprokurori i Shtetit shërben ex officio si Kryesues për aq kohë sa ai apo ajo mban zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.

Neni 6
Mospërputhshmëria mbi Anëtarësinë

1. Është në mospërputhje me anëtarësinë në Këshill kur një anëtar është:
   1.1. gjyqtar;
   1.2. prokurori i cili nuk është emëruar për të shërbyer si Prokuror Shteti;
   1.3. anëtari i Kuvendit të Republikës së Kosovës apo cilitdo Kuvend Komunal;
   1.4. anëtari i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me përjashtim të Ministrit të Drejtësisë,
   1.5. personi që mban post apo ushtron çfarëdo detyre në ndonjë parti politike apo në ndonjë shoqatë apo fondacion që është e lidhur me cilëndo parti politike, me përjashtim të Ministrit të Drejtësisë;
   1.6. personi që punon për administratën, përfshirë personat që kryejnë detyra në Qeverinë e Republikës së Kosovës apo në organe administrative apo nënadministrative të themeluara me Kushtetutë apo të krijuara me anë të legjislacionit; ose
   1.7. personi që është dënuar për vepër penale, me përjashtim të kundërvajtjes siç përkufizohet me ligj.

Neni 7
Mandatet e Anëtarëve të Këshillit

Përveç anëtarëve ex officio, anëtarët e Këshillit zgjidhen apo emërohen me një mandat pesë (5) vjeçar. Një (1) anëtar mund të zgjidhet për një mandat shtesë pesë (5) vjeçar jo të njëpasnjëshëm.

Neni 8
Përfundimi i Mandatit

1. Mandati i anëtarëve të Këshillit përfundon:
   1.1. me vdekje;
   1.2. me humbjen e zotësisë për veprim për më shumë se tre (3) muaj për shkak të arsyeve mjekësorë të vërtetuara;
   1.3. me dështimin e vazhdueshëm për të marrë pjesë në veprimtaritë e Këshillit për më shumë se tre (3) muaj;
   1.4. me pushimin e statusit mbi të cilin bazohet emërimi, nëse emërimi bazohet në një status të caktuar;
   1.5. me dorëheqje, duke informuar Këshillin me njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditësh; ose
   1.6. kur dënohet për vepër penale, me përjashtim të kundërvajtjes siç përkufizohet me ligj.
2. Nëse një vend në Këshilli lirohet para skadimit të mandatit të një anëtari, pozita e lirë plotësohet në të njëjtën mënyrë si për anëtarin të cilit i ka skaduar mandati. Personi, përpos Kryeprokurorit të Shtetit apo Ministrit të Drejtësisë, i cili zgjidhet të plotësojë një vend të lirë në Këshill emërohet apo zgjidhet me një mandate të plotë pesë (5) vjeçar.

Neni 9
Pavarësia e Anëtarëve të Këshillit

Anëtarët e Këshillit ushtrojnë detyrat e tyre zyrtare në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.

Neni 10
Imuniteti

1. Anëtarët e Këshillit gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile apo shkarkimi për veprimet e kryera, vendimet e marrura apo për shprehjen e mendimeve që janë brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si anëtarë të Këshillit.
2. Anëtarët e Këshillit nuk gëzojnë imunitetin nga paragrafi 1. te nenit 10 të këtij ligji dhe mund të shkarkohen nga detyra nëse këta kanë kryer shkelje të qëllimshme të ligjit.
3. Në rast kur ndaj një anëtari të Këshillit ngritet aktakuzë apo kur ky arrestohet, ai apo ajo duhet sa më parë të njoftojnë Kryesuesin e Këshillit.

Neni 11
Procedurat Disiplinore për Anëtarët e Këshillit

1. Këshilli përcakton dhe publikon rregullat dhe procedurat disiplinore të zbatueshme ndaj anëtarëve të vet duke përfshirë ato procedura që përcaktojnë hetimin, pezullimin apo rekomandimin për shkarkim të cilitdo anëtari të Këshillit.
2. Një komision i përbërë nga tre (3) anëtarë i themeluar nga Kryesuesi vendos mbi bazat për disiplinim dhe sanksione, përfshirë pezullimin dhe shkarkimin e cilitdo anëtari të Këshillit.
3. Një anëtar i cili është pezulluar nga Komisioni gëzon të drejtën e ankesës para Këshillit të plotë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga vendimi për pezullim.
4. Me rekomandimin e komisionit, një anëtar i Këshillit mund të shkarkohet me anë të dy të tretave (2/3) të votave të anëtarëve të Këshillit.
5. Një (1) anëtar i Këshillit i cili është shkarkuar gëzon të drejtën të ankohet kundër vendimit drejtpërsëdrejti në Gjykatën Supreme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e marrjes së vendimit për shkarkim.

Neni 12
Selia e Këshillit, Kuorumi dhe Natyra Publike e Takimeve

1. Selia e Këshillit është në Prishtinë.
2. Kuorumi për takimet e Këshillit është me gjashtë (6) anëtarë dhe vendimet e Këshillit merren me shumicë të thjeshtë të votave nga anëtarët e pranishëm, përveç nëse ligji e përcakton ndryshe.
3. Të gjitha takimet e Këshillit janë të hapura për publikun. Rendi i ditës së Këshillit do të jetë publikisht i hapur së paku dyzetetetë (48) orë para takimit. Këshilli mund të mbyllë takimin me shumicën e votave të anëtarëve kur diskutohet për çështje si në vijim:

3.1. një sekret shtetëror zyrtar zbulimi i të cilit do të përbënte shkelje e ligjit;
3.2. çështjet e personelit që kanë të bëjnë me prokurorin apo punonjësin, përveç takimit të Këshillit ku merret një vendim përfundimtar disiplinor kundër një prokurori;
3.3. vlerësimi i performansës se prokurorëve dhe nëpunësve të tjerë;
3.4. informacioni pronësor zbulimi i së cilës mund të paragjykonte interesat e cilësdo palë që konkurron për një tender qeveritar;
3.5. zbulimi i informacionit apo i të dhënave që do të rrezikonin jetën apo sigurinë e cilitdo person;
3.6. një hetim në vazhdim për sjellje të pahijshme apo veprimtari kriminale zbulimi i së cilës në masë të arsyeshme do të rrezikonte objektivitetin dhe efikasitetin e hetimit;
3.7. informacione pronësore të biznesore, të dhëna, procese apo kode kompjuterike të cilat janë konfidenciale sipas marrëveshjes kontraktuese apo marrëveshjes për mos zbulim ndërmjet tregtarit dhe Këshillit; ose
3.8. cilido informacion tjetër zbulimi i të cilit do të përbënte shkelje të ligjit.

4. Për çdo takim të mbyllur nga Këshilli, Kryetari do të deklarojë për shënimet zyrtare arsyen e përgjithshme apo arsyet për mbylljen e takimit dhe do të regjistrojë votën e anëtarëve të pranishëm të Këshillit. Pasi që Këshilli të ketë mbyllur takimin asnjë anëtar i Këshillit apo person pjesëmarrës në takim nuk diskuton mbi natyrën, përmbajtjen apo rezultatin e takimit derisa shumica e anëtarëve të Këshillit të votojnë për zbulimin e informacionit të tillë, përveç nëse një zbulim i tillë është i ndaluar përmes ligjit të zbatueshëm. Kryesuesi i Këshillit do të largojë nga takimi i mbyllur mbarë personelin i cili përndryshe nuk është i nevojshëm për zhvillimin e takimit punues të Këshillit gjatë seancës së mbyllur.
5. Këshilli mund të thërrasë takim urgjent për të adresuar çështjet që lidhen me sigurinë e godinave ose personelit apo kur rrethana të veçanta kërkojnë veprim të menjëhershëm. Këshilli mund të mblidhet për seancë emergjente me thirrjen e Kryesuesit, apo nëse ky mungon, më thirrjen e Nën-kryesuesit. Obligimi për njoftim prej dyzetetetë (48) orësh i cekur në paragrafin 1. të nenit 12 te këtij ligji hiqet kur bëhet fjalë për seancat emergjente të Këshillit. Brenda njëzetekatër (24) orësh pas përfundimit të seancës emergjente Kryesuesi i zbulon publikut natyrën e emergjencës si dhe pikat e diskutuara në takim, përveç nëse zbulimi përjashtohet me paragrafin 1. te këtij neni.

Neni 13
Buxheti Vjetor

1. Në konsultim me Kryeprokurorin e Shtetit dhe Kryeprokurorët, Këshilli përgatitë buxhetin vjetor operues të Këshillit dhe të zyrave Prokuroriale. Këshilli i dërgon buxhetin e propozuar drejtpërsëdrejti Qeverisë siç përcaktohet me ligj. Nëse Ministri i Ekonomisë dhe Financave dërgon një buxhet për Këshillin dhe prokuroritë i cili ndryshon nga ai që është propozuar nga Këshilli, Ministri i Ekonomisë dhe Financave po ashtu do të i dërgojë për konsiderim Kuvendit të Kosovës buxhetin e rekomanduar fillimisht nga Këshilli dhe çfarëdo komenti mbi këtë.

2. Këshilli edhe Kryeprokurori i Shtetit menaxhojnë buxhetin vjetor për Këshillin dhe prokurorinë mënyrë të pavarur dhe mbajnë përgjegjësi për mbikëqyrjen e shpenzimeve, alokimin e fondeve, mirëmbajtjen e llogarive të sakta dhe aktuale dhe kryerjen e auditimeve financiare.

Neni 14
Mbështetja Administrative për Këshillin

1. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit siguron mbështetje administrative nëpërmjet një sekretariati me personel të nevojshëm për t'ia mundësuar Këshillit t'i kryejë detyrat në më mënyrë efektive dhe të shpejtë.
2. Në sigurimin e kësaj mbështetjeje dhe në përmbushjen e këtij funksioni administrativ, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit do të veprojë në një mënyrë që respekton dhe mbron autoritetin dhe kompetencat e Këshillit siç urdhërohet me Kushtetutë dhe me këtë ligj. Kryeprokurori i Shtetit, në kapacitetin e mbështetjes administrative, ndër të tjera, ka detyrë të:
   2.1. ndihmojë Këshillin në administrimin e zyrave prokuroriale dhe në zbatimin e rregullave, rregulloreve dhe politikave sa i përket personelit, buxhetit dhe administrimit të prokurorive dhe të Këshillit.
   2.2. propozojë rregulla të nevojshme administrative për zbatimin e urdhëresave të Këshillit. Të gjitha rregullat e tilla do të dërgohen tek Këshilli për miratim nga ky i fundit.
   2.3. propozojë rregulla dhe rregullore të reja kurdoherë që është e nevojshme për administrimin efektiv dhe efikas të Këshillit dhe prokurorive.
   2.4. raportojë rregullisht tek Këshilli mbi veprimtaritë e prokurorive dhe ofrimin e rekomandimeve për përmirësime.
   2.5. në përputhje me udhëzimet e Këshillit, përgatit dhe administron një buxhet të konsoliduar për Këshillin dhe Prokuroritë.
   2.6. sipas udhëzimeve të Këshillit, mbikëqyr të gjithë personelin administrativ dhe mbështetës duke përfshirë alokimin e personelit në prokurori bazuar në ngarkesën me lëndë, mirëmbajtjen e regjistrave të personelit, themelimin e një sistemi për vlerësimin e personelit, sigurimin e disiplinimit të duhur të punonjësve administrative dhe mbrojtjen e të drejtave të punësimit.
   2.7. sipas kufizimeve buxhetore dhe udhëzimeve të Këshillit, siguron se prokurori janë të furnizuara siç duhet me materialet e nevojshme për kryerjen efektive dhe efikase të detyrave prokuroriale.
   2.8. ndërmarrjen e detyrave dhe autorizime të atilla siç mund të udhëzojë Këshilli dhe të cilat bien brenda kompetencave udhëzuese.
3. Këshilli dhe Kryeprokurori i Shtetit së bashku do të zhvillojnë dhe miratojnë rregullore që ndërlidhen me strukturën organizative dhe funksionin mbështetës administrativ.

Neni 15
Njësiti për Shqyrtimin e Performansës së Prokurorisë

1. Sipas udhëzimit të Këshillit, Njësiti për Shqyrtimin e Performansës së Prokurorisë raporton mbi punën e zyrave prokuroriale.

2. Këshilli zhvillon dhe miraton rregullore që ndërlidhen me strukturën organizative dhe funksionimin e Njësitit për Shqyrtimin e Performansës së Prokurorisë.
3. Njësiti për Shqyrtimin e Performansës së Prokurorisë ka një buxhet të ndarë brenda buxhetit të konsoliduar të Këshillit dhe i raporton Këshillit në mënyrë të pavarur mbi shpenzimet e veta. Kryeprokurori i Shtetit nëpërmjet një sekretariati me personel të nevojshëm ofron mbështetje administrative për Njësitin për Shqyrtimin e Performansës së Prokurorisë siç mund të udhëzojë Këshilli.

Neni 16
Drejtori i Njësitit për Shqyrtimin e Performansës së Prokurorisë

1. Drejtori i Njësitit për Shqyrtimin e Performansës së Prokurorisë zgjidhet dhe emërohet nga Këshilli në përputhje me procedurat, kriteret dhe kualifikimet që do zhvillohen dhe miratohen nga Këshilli përmes rregulloreve të cilat janë në përputhje me detyrimet kushtetuese dhe detyrimet e rregulloreve të zbatueshme për personelin. Vendi i lirë i punës plotësohet duke u bazuar në një proces konkurrues, të bazuar në meritë dhe të hapur pas publikimit të pozitës.
2. Drejtori është përgjegjës ndaj Këshillit për administrimin efikas dhe efektiv të Njësitit për Shqyrtimin e Performansës së Prokurorisë. Drejtori i raporton drejtpërsëdrejti Kryesuesit të Këshillit dhe i përgjigjet të gjitha kërkesave të anëtarëve të Këshillit për informata.
3. Këshilli cakton pagën e Drejtorit të Njësitit për Shqyrtimin e Performansës së Prokurorisë. Drejtori nuk pranon kompensim shtesë për detyra apo punësim tjetër nga cilido burim tjetër përveç rimbursimit për shpenzime të arsyeshme dhe të nevojshme.

KREU III
REKRUTIMI, PROPOZIMI DHE EMËRIMI I PROKURORËVE

Neni 17
Rekrutimi dhe Përzgjedhja e Kandidatëve

1. Për rekrutimin e kandidatëve për prokurorë, Këshilli përmes një shpallje publike fton të aplikojnë të gjithë profesionistët e kualifikuar ligjor.
2. Në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm, Këshilli zhvillon dhe zbaton procedura për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërim si prokurorë.
3. Në përputhje me Kushtetutën dhe Propozimit mbi Marrëveshjen Gjithëpërfshirëse, Këshilli zbaton fushata rekrutimi si dhe masa të tjera të cilat i konsideron të nevojshme dhe të duhura për të siguruar që një zyrë prokuroriale pasqyron përbërjen etnike të zonës së juridiksionit përkatës.

Neni 18
Propozimi për Emërim dhe Riemërim

1. Këshilli, sipas nevojës, ndërmerr masa të tilla duke mëtuar që në mesin e prokurorëve që shërbejnë në Kosovë apo ndonjë pjesë të saj të rrisë numrin e

prokurorëve nga Komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë. Këshilli nga aplikantët njëlloj të kualifikuar për të shërbyer si prokurorë u jep përparësi anëtarëve nga komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovës, ashtu siç është paraparë me nenin 109 (4) dhe 110 (3) të Kushtetutës, dhe Propozimit mbi Marrëveshjen Gjithëpërfshirëse, Aneksi IV, neni 2.2.

2. Me përfundimin e secilit regjistrim të popullsisë dhe së paku çdo pesë (5) vjet, Këshilli studion përbërjen etnike të prokurorive dhe sipas nevojës kërkon financim shtesë për të rritur numrin e prokurorëve nga komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë për të siguruar se prokuroritë pasqyrojnë përbërjen etnike në zonën e juridiksionit të tyre.
3. Para dorëzimit të propozimeve për emërim ose riemërim, Këshilli kërkon mendimin e prokurorisë përkatëse në të cilën kandidati është propozuar për emërim apo riemërim.
4. Këshilli, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin, i dërgon me shkrim Presidentit propozimet për kandidatët për emërim apo riemërim si prokurorë. Gjatë procesit të nominimit të kandidatëve për emërim apo riemërim, Këshilli merr parasysh edhe kriteret si në vijim:
   4.1. njohurinë profesionale, përvojën dhe performansën e punës, duke përfshirë njohjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut;
   4.2. zotësinë për arsyetim ligjor ashtu siç është dëshmuar përmes veprimtarive profesionale në fushën ligjore, duke përfshirë veprimtaritë si gjykatës, prokuror apo avokat, punët akademike dhe veprimtaritë tjera profesionale;
   4.3. aftësinë profesionale të bazuar mbi rezultatet e karrierës së mëparshme, duke përfshirë pjesëmarrjen në trajnime të organizuara ku është vlerësuar performansa;
   4.4. aftësinë dhe zotësinë për analizimin e problemeve ligjore;
   4.5. aftësinë për të kryer detyrat në mënyrë të paanshme, të ndërgjegjshme, me zell, me vendosmëri dhe përgjegjësi;
   4.6. aftësitë e komunikimit;
   4.7. sjelljen jashtë zyrës; dhe
   4.8. integritetin personal.
5. Të gjitha propozimet për emërime dhe riemërime të prokurorëve arsyetohen me shkrim.

Neni 19
Emërimi dhe Riemërimi i Prokurorëve

1. Me propozim të Këshillit, Presidenti bën emërimin dhe riemërimin e Prokurorëve në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.
2. Nëse Presidenti i Kosovës refuzon të emërojë apo riemërojë ndonjë kandidat, atëherë Presidenti duhet që brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve ti ofrojë Këshillit arsyet me shkrim mbi refuzimin. Këshilli mund që kandidatin e refuzuar së bashku me arsyetimin me shkrim të ia paraqesë edhe njëherë Presidentit, apo Këshilli mund të propozojë një kandidat tjetër.
3. Mandati i emërimit është siç parashihet në nenin 109.5. të Kushtetutës.

Neni 20
Emërimi i Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve

1. Këshilli bën nominimin e Kryeprokurorit të Shtetit nga radhët e Prokurorëve dhe ai emërohet nga Presidenti për një mandat shtatë (7) vjeçare, pa mundësi riemërimi.
2. Këshilli emëron Kryeprokurorët për të gjitha njësitë e tjera të Prokurorit të Shtetit. Çdo prokuror i cili është subjekt i kualifikimeve të përcaktuara me Ligjin mbi Prokurorët e Shtetit ka të drejtë të propozohet për postin e Kryeprokurorit.
3. Kryeprokurori emërohet nga Këshilli për një periudhë katër (4) vjeçare, me mundësi vazhdimi edhe për një mandat shtesë.
4. Në mënyrë që të sigurohet se Prokurori i Shtetit pasqyron natyrën shumetnike të Kosovës, Këshilli përpiqet të sigurojë që anëtarët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë të emërohen në role menaxhuese.
5. Nëse një kandidat i propozuar për Kryeprokuror është anëtar i Këshillit, ai apo ajo nuk mund të merr pjesë në shqyrtime apo votimin për emërimin e Kryeprokurorit.
6. Këshilli autorizohet të largojë një Kryeprokuror nga ajo pozitë, në pajtim me vlerësimet e performansës të ndërmarra në përputhje me ligjin e zbatueshëm, ose me rastin e konstatimit të sjelljes kriminale, keq-menaxhimit, jo-kompetencës, apo dështimit në kryerjen e detyrave të pozitës.

KREU IV
VLERËSIMI DHE TRANSFERIMI I PROKURORËVE

Neni 21
Vlerësimi i Performansës së Prokurorëve

1. Mënyra dhe procedura e vlerësimit të performansës së Prokurorëve përcaktohet përmes rregulloreve dhe rregullave të përpiluara dhe lëshuara nga Këshilli.
2. Këshilli përcakton kriteret për vlerësimin dhe promovimin e Prokurorëve që përfshijnë por nuk kufizohen në:
   2.1. njohurinë profesionale, përvojën e punës dhe performansën, duke përfshirë njohjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut;
   2.2. zotesine per arsyetim ligjor;
   2.3. aftësinë profesionale, përfshirë pjesëmarrjen në forma të organizuara të trajnimit në të cilën është vlerësuar performansa;
   2.4. aftësinë dhe zotësinë për analizimin e problemeve ligjore;
   2.5. aftësinë për të kryer detyrat në mënyrë të paanshme, ndërgjegjshme, me zell, vendosmëri dhe përgjegjësi;
   2.6. aftësitë e komunikimit;
   2.7. sjelljet jashtë zyrës, dhe
   2.8. integritetin personal.
3. Çdo Prokuror i cili i është nënshtruar vlerësimit i merr rezultatet e vlerësimit dhe mund të paraqesë kundërshtimet me shkrim kundër çdo përfundimi apo gjetje.

Neni 22
Transferimi i Prokurorëve

1. Me paraqitjen e kërkesës nga Kryeprokurori, Këshilli mund të transferojë një prokuror në një prokurori tjetër për një periudhë kohore jo më të gjatë se gjashtë (6) muaj për një herë.
2. Transferimi sipas paragrafit 1. të këtij neni mund të ndërmerret në rastet kur një prokurori ka numër të pamjaftueshëm të prokurorëve për të kryer lëndët që i ka në kompetencë.
3. Për raste të jashtëzakonshme, Kryeprokurori i Shtetit mundet përkohësisht të transferojë një prokuror në një prokurori tjetër. Transferim i ndërmarrë sipas kësaj dispozite nuk mund të tejkalojë tridhjetë (30) ditë përveç nëse Këshilli miraton një periudhë më të gjatë.
4. Prokurorët nuk mund të transferohen në ndonjë prokurori tjetër kundër vullnetit të tyre përveç nëse ky ligj e përcakton ndryshe.
5. Me rastin e aplikimit pranë Këshillit, një prokuror mund të transferohet në një prokurori tjetër në mënyrë permanente.
6. Këshilli shpallë rregullat dhe rregulloret që përcaktojnë standardet dhe procedurat që qeverisin ankesat.
7. Kur kryhet një zhvendosjeje apo transferim i përhershëm që tejkalon gjashtë (6) muaj, Këshilli përpiqet të sigurohet se zhvendosja apo transferimi nuk do të ndryshojë përbërjen etnike të prokurorisë e cila ndikohet nga zhvendosja apo transferimi.

KREU V
PROCEDURAT DISIPLINORE

Neni 23
Komisioni Disiplinor i Këshillit

Komisioni Disiplinor përbëhet nga tre (3) anëtarë të Këshillit, dy (2) nga të cilët duhet të jenë prokurorë. Kryesuesi i Komisionit është prokuror

Neni 24
Sjellja e pahijshme

1. Për qëllime të këtij ligji, sjellja e pahijshme nga ana e prokurorëve përbëhet nga:
   1.1. vendimi i formës së prerë për një vepër penale, me përjashtim të kundërvajtjes siç përcaktohet me ligj;
   1.2. neglizhenca në kryerjen e detyrave, dështimi për të kryer, apo keqpërdorimi i funksioneve prokuroriale;
   1.3. dështimi për të kryer funksionet prokuroriale në mënyrë të pavarur dhe të paanshme;
   1.4. shkelja e Kodit të zbatueshëm të Etikës.
2. Komisioni Disiplinor mund të suspendojë pa pagesë prokurorin gjatë cilësdo periudhë të hetimit apo gjatë procedurës disiplinore.

Neni 25
Inicimi i procedurës disiplinore

1. Zyra e Prokurorit Disiplinor i rekomandon Komisionit Disiplinor të Këshillit fillimin e procedurës disiplinore kundër një prokurori mbi bazën e hetimeve të bëra.
2. Me rastin e paraqitjes së rekomandimit për inicimin e procedurës disiplinore, Zyra e Prokurorit Disiplinor njofton me shkrim Komisionin, Këshillin, dhe prokurorin i cili gjendet nën hetim.

Neni 26
Seancat disiplinore

1. Me fillimin e procedurës disiplinore, prokurori nën hetim njoftohet mbi bazat e procedurës disiplinore dhe ftohet nga Komisioni Disiplinor që të paraqitet personalisht në një seancë të mbyllur e cila mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e njoftimit.
2. Një anëtar i Zyrës së Prokurorit Disiplinor apo Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor i paraqet Komisionit Disiplinor rekomandimet për veprim disiplinor dhe dëshmitë e nxjerra nga hetimet që mbështesin zbulimin e një sjellje të pahijshme dhe sanksionet disiplinore.
3. Prokurorët gëzojnë të drejtën për të përfaqësuar veten e tyre apo për të caktuar një mbrojtës të autorizuar për mbrojtjen e tyre dhe kanë qasje në gjitha dëshmitë e grumbulluara gjatë hetimeve dhe në të gjitha shkresat e lëndës.
4. Vendimi i Komisionit mbi atë nëse është kryer sjellja e pahijshme apo mbi shqiptimin e një sanksioni bëhet në pajtim me procedurat dhe rregullat që do të nxirren nga Këshilli me qëllim të kryerjes të zhvillimit të procedurave disiplinore. Vendimi duhet të jetë në formë të shkruar dhe përmban arsyetimin.
5. Një kopje e vendimit i dërgohet prokurorit të akuzuar dhe Zyrës së Prokurorit Disiplinor.

Neni 27
Masat disiplinore

1. Komisioni mund të shqiptojë masat disiplinore si në vijim:
   1.1. qortim;
   1.2. qortim me urdhër për ndërmarrje të veprimeve korrigjuese;
   1.3. zvogëlim i përkohshëm i pagës deri në pesëdhjetë përqind (50%) duke marrë parasysh natyrën e sjelljes së pahijshme; apo
   1.4. ulje në detyrë brenda sistemit prokurorial; apo
   1.5. propozim për largimin nga detyra të Prokurorit të Shtetit.
2. Komisioni Disiplinor shqipton sanksionin që është në përputhje me rrethanat, nivelin e përgjegjësisë, dhe pasojat e sjelljes së pahijshme.
3. Nëse prokurori lirohet nga akuzat në përfundim të procedurës disiplinore, ai apo ajo me vendim të Këshillit kthehet në zyrën e mëhershme prokuroriale.

Neni 28
Shkarkimi nga detyra i Prokurorëve

1. Në bazë të procedurave disiplinore Këshilli vendos nëse sjellja e pahijshme e një prokurori arsyeton shkarkimin nga detyra. Çdo rekomandim nga Këshilli për shkarkim të një prokurori duhet të përfshijë arsyet me shkrim për një rekomandim të tillë dhe konkluzionet e Komisionit.
2. Rekomandimi i Këshillit për shkarkim i dorëzohet Presidentit dhe prokurorit në fjalë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ashtu siç parashihet në paragrafin 1. te këtij neni.
3. Presidenti vendos mbi rekomandimin e Këshillit për shkarkim, në pajtim me Kushtetutën dhe këtë ligj.
4. Para zbatimit të vendimit të tillë, prokurori njoftohet zyrtarisht nga Këshilli lidhur me vendimin e Presidentit për miratimin apo mosmiratimin e shkarkimit nga detyra.

Neni 29
Ankesat ndaj vendimeve disiplinore

1. Ankesat kundër vendimeve të Komisionit Disiplinor mund të i dorëzohen Këshillit përmes Kryesuesit. Një anëtar i Këshillit që ka marrë pjesë në procedurat e Komisionit Disiplinor nuk mund të merr pjesë në shqyrtimin e ankimit.
2. Prokurori i cili është subjekt i procedurave si dhe Zyra e Prokurorit Disiplinor munden që para Këshillit të paraqesin ankesë kundër vendimit të Komisionit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga pranimi i vendimit përfundimtar.
3. Afati për paraqitjen e ankesës sipas këtij neni mund të vazhdohet me kusht që kërkesa për vazhdim të afatit kohor të jetë parashtruar në Këshill brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të cekura. Këshilli nuk pranon vazhdimin e afatit kohor të kërkuar dhe parashtruar pas pesëmbëdhjetë (15) ditëve, në rast se nuk është rezultat i rrethanave të jashtëzakonshme apo katastrofave.
4. Ankesa e ushtruar brenda këtyre afateve kohore e pezullon ekzekutimin e vendimit disiplinor siç parashtrohet në nenin 27 te këtij ligji.

Neni 30
Arsyet për ankesë

1. Ankesa mund të ushtrohet shkaku i:
   1.1. shkeljes së ligjit apo akteve nënligjore të zbatueshme për prokurorët;
   1.2. vërtetimit të gabuar apo prova jo të plota të situatës faktike;
   1.3. shkeljes së procedurës disiplinore.
2. Ankesa në formë të shkruar i dorëzohet Këshillit brenda afateve kohore të parapara me këtë ligj.
3. Ankesa përmban:
   3.1. identifikimin e ankuesit;
   3.2. vendimin që atakohet;
   3.3. datën e pranimit të vendimit; dhe
   3.4. bazën specifike të ankesës.

Neni 31
Afati për Shqyrtimin e ankesës

Bazuar në veprimet e Komisionit Disiplinor, Këshilli shqyrton dhe vendos cilëndo ankesë brenda tre (3) muajsh nga data e parashtrimit së ankesës.

Neni 32
Refuzimi i ankesës

1. Këshilli mund të refuzojë një ankesë, pa mbajtur fare seancë dëgjimore, brenda pesë (5) ditëve, nëse vërtetohet që:
   1.1. ankuesi nuk është njëra nga palët me të drejtë ankimi kundër vendimit;
   1.2. ankesa nuk përmban një apo më shumë arsye që kërkojnë parashtrimin e ankesës;
   1.3. ankesa nuk është paraqitur në afatin e përcaktuar kohor.

KREU VI
ZYRA E PROKURORIT DISIPLINOR

Neni 33
Zyra e Prokurorit Disiplinor

Zyra e Prokurorit Disiplinor themelohet si organ i ndarë dhe i pavarur që i shërben Këshillit Gjyqësor të Kosovës edhe Këshillit Prokurorial të Kosovës. Sa i përket sistemit prokurorial, Prokurori Disiplinor është përgjegjës për hetimin e supozimeve për sjellje të pahijshme të prokurorëve dhe paraqitjen e provave dhe lëndës pranë Komisionit Disiplinor në mbështetje të veprimeve disiplinore për sjelljen e pahijshme.

Neni 34
Pavarësia dhe Paanshmëria e Zyrës së Prokurorit Disiplinor

1. Zyra e Prokurorit Disiplinor vepron në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.
2. Sipas dispozitave të paragrafit 3. të nenit 26 te këtij ligji, asnjë person nuk ka të drejtë të ushtrojë ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, apo të përpiqet të ushtrojë ndikim mbi funksionet e Prokurorit Disiplinor sa i përket çfarëdo hetimi, rekomandimi apo paraqitjes së një lënde pranë Komisionit Disiplinor.

Neni 35
Përgjegjësitë e Zyrës së Prokurorit Disiplinor

1. Zyra e Prokurorit Disiplinor është përgjegjëse për hetimin e prokurorëve aty ku ekziston bazë e arsyeshme për të besuar që mund të jetë kryer sjellja e pahijshme si dhe për ofrimin e rekomandimeve dhe paraqitjes pranë Komisionit Disiplinor të provave në mbështetje të veprimit disiplinor.
2. Zyra e Prokurorit Disiplinor inicion hetime në rastet kur:
   2.1. pranë Zyrës së Prokurorit Disiplinor është paraqitur ankesa e paraqitur nga cilido person fizik apo juridik;

2.2. me vet iniciativë, kur ekziston bazë e arsyeshme për të besuar se një prokuror mund të jetë përfshirë në sjellje të pahijshme.

3. Të gjitha ankesat, pavarësisht origjinës së tyre, dërgohen për hetim në Zyrën e Prokurorit Disiplinor.
4. Zyra e Prokurorit disiplinor heton hollësisht të gjitha çështjet që i referohen, vendos nëse rekomandimet për veprime disiplinore duhet të i paraqiten Komisionit Disiplinor si dhe njofton me shkrim Komisionin Disiplinor dhe prokurorin e dyshuar lidhur me rezultatin e hetimit.
5. Zyra e Prokurorit Disiplinor ka të drejtë të thërrasë dëshmitarët si dhe grumbullojë dokumentet e nevojshme për hetim dhe të përcaktojë nëse rekomandimet për veprim disiplinor duhet të paraqiten tek Komisioni Disiplinor.
6. Zyra e Prokurorit Disiplinor i paraqet Komisionit Disiplinor rekomandimet për veprime disiplinore si dhe provat në mbështetje të veprimit disiplinor për sjelljen e pahijshme.

Neni 36
Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor

1. Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor përzgjidhet me dy të tretat (2/3) e anëtarësisë së përbashkët të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës në përputhje me rregulloret e personelit. Vendi i lirë plotësohet duke u bazuar në një proces konkurrues, të bazuar në meritë dhe të hapur pas shpalljes publike të pozitës.
2. Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor është përgjegjës si për Këshillin Gjyqësor të Kosovës ashtu edhe për Këshillin Prokurorial të Kosovës mbi administrimin efikas dhe efektiv të Zyrës së Prokurorit Disiplinor dhe ushtron përgjegjësitë e tij apo saj përkitazi me rregullat dhe rregulloret e shpallura nga të dy Këshillat.
3. Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor pranon pagë ekuivalente të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit. Drejtori nuk pranon kompensim shtesë për detyra apo punësimin tjetër nga çfarëdo burimi tjetër, përveç rimbursimit për shpenzime të arsyeshme dhe të nevojshme.

Neni 37
Kualifikimet e Drejtorit të Zyrës së Prokurorit Disiplinor

1. Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor duhet të përmbushë kualifikimet si në vijim:
   1.1. të jetë shtetas dhe banor i Kosovës;
   1.2. të ketë diplomë të vlefshme universitare të juridikut, drejtësisë penale, administrimit policor apo në një fushë të ngjashme sipas ligjeve të Kosovës;
   1.3. të ketë së paku pesë (5) vite përvojë punë relevante si avokat, gjyqtar apo zyrtar policor, prokuror apo në një fushë të ngjashme në zbatimin e ligjit apo të administrimit të së drejtës penale;
   1.4. të ketë reputacion profesional pozitiv dhe integritet moral;
   1.5. të ketë përfunduar me sukses cilindo trajnim të kërkuar për pozitën e mandatuar së bashku nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës; dhe

1.6. të mos ketë qenë i dënuar për vepra penale, me përjashtim të kundërvajtjes siç përkufizohet me ligj.

Neni 38
Përzgjedhja dhe Kualifikimet për Personelin e Zyrës së Prokurorit Disiplinor

1. Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor, në konsultim me Këshillin dhe sipas kritereve kualifikuese të cekura në këtë nen, autorizohet të përzgjedhë, emërojë dhe shkarkojë prokurorët disiplinorë. Zyra ndihmon në paraqitjen e rekomandimeve pranë Komisionit Disiplinor për veprime disiplinore kundër prokurorëve si dhe provat në mbështetje të veprimit disiplinor. Të gjitha vendet e lira plotësohen duke u bazuar në një proces konkurrues, të bazuar në meritë dhe të hapur pas shpalljes publike të pozitës.
2. Punonjësit e Zyrës së Prokurorit Disiplinor duhet të përmbushin kualifikimet si në vijim:
   2.1. të jenë shtetas dhe banorë të Kosovës;
   2.2. të kenë diplomë universitare në juridik, drejtësinë penale, administrim policor apo në një fushë të ngjashme sipas ligjeve të Kosovës;
   2.3. të kenë së paku tre (3. vite përvojë pune relevante si avokat, gjyqtar, zyrtar policor, prokuror apo të një fushë të ngjashme në zbatimin e ligjit apo administrimin e së drejtës penale;
   2.4. të kenë reputacion pozitiv profesional dhe integritet moral;
   2.5. të kenë përfunduar me sukses cilindo trajnim të kërkuar për pozitën e përbashkët nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës;
   2.6. të mos ketë qenë i dënuar për vepra penale, me përjashtim të kundërvajtjeve siç përkufizohet me ligj.
3. Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor autorizohet, sipas kritereve të përzgjedhjes të përcaktuara në këtë nen, që të përzgjedhë, emërojë dhe shkarkojë inspektorët. Inspektorët ndihmojnë në zhvillimin e hetimeve për të cilat është përgjegjës Prokurori Disiplinor. Të gjitha vendet e lira plotësohen duke u bazuar në një proces konkurrues, të bazuar në meritë dhe të hapur pas shpalljes publike të pozitës.
4. Një inspektor i Zyrës së Prokurorit Disiplinor duhet të përmbushë kualifikimet si në vijim:
   4.1. të jetë shtetas dhe banor i Kosovës;
   4.2. të ketë së paku tre 3 vite përvojë relevante pune në fushën e zbatimit të ligjit, punë policore, administrim të së drejtës penale apo në një fushë të ngjashme;
   4.3. të ketë reputacion pozitiv në shoqëri;
   4.4. të ketë mbaruar me sukses cilindo trajnim të kërkuar për këtë pozitë të mandatuar së bashku nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës;
   4.5. të mos ketë qenë i dënuar për vepra penale, me përjashtim të kundërvajtjeve.
5. Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor është i autorizuar që sipas nevojës, të përzgjedhë, emërojë dhe shkarkojë, në përputhje me detyrimet Kushtetuese dhe kërkesat e rregulloreve të zbatueshme për personelin, administratën dhe personelin mbështetës që ofron mbështetje administrative për funksionet e personelit të drejtorit, prokurorëve disiplinorë dhe inspektorëve të Zyrës së Prokurorit Disiplinor.

Neni 39
Buxheti për Zyrën e Prokurorit Disiplinor

Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor çdo vit i dërgon Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave në mënyrë të drejtpërdrejtë një buxhet të ndarë për financimin e pagave të personelit të Zyrës së Prokurorit Disiplinor, përfshirë drejtorin, prokurorët disiplinorë, inspektorët dhe personelin administrativ dhe mbështetës si dhe shpenzimet e tjera operative të Zyrës së Prokurorit Disiplinor. Buxheti i Zyrës së Prokurorit Disiplinor administrohet nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me udhëzimin dhe vërtetimin nga Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor. Këshilli Prokurorial i Kosovës nuk ka pushtet të kufizojë apo të drejtojë në ndonjë mënyrë tjetër shpenzimet e Zyrës së Prokurorit Disiplinor dhe po ashtu Këshilli Prokurorial i Kosovës nuk ka pushtet të ri-alokojë buxhetin e Zyrës së Prokurorit Disiplinor apo të përdorë për çfarëdo qëllimi tjetër fondet që janë caktuar për Zyrën e Prokurorit Disiplinor. Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor do të raportojë në baza vjetore para një seance të përbashkët të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës mbi veprimtaritë dhe shpenzimet e Zyrës së Prokurorit Disiplinor.

KREU VII
TRAJNIMI I PROKURORËVE

Neni 40
Politikat e trajnimit, standardet dhe udhëzimet

1. Këshilli në bashkëpunim me Institutin Gjyqësor të Kosovës i përcakton politikat, standardet dhe udhëzimet per rregullimin e trajnimit te prokuroreve, te kandidateve për prokurorore dhe stafit tjetër prokurorial.
2. Këshilli mund të krijojë shoqata apo organizata të tjera për zbatimin e trajnimit të mëtutjeshëm profesional të prokurorëve.
3. Këshilli mund të bashkëpunojë me shoqata ose me organizata të tjera për ngritjen profesionale te prokuroreve dhe te stafit tjetër prokurorial.

KREU VIII
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 41
Vlefshmëria e Veprimeve të Mëparshme të Këshillit themeluar sipas Rregullores Administrative të UNMIK-ut 2005/52 dhe Ligjit mbi Përbërjen e Përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

1. Të gjitha veprimet e mëparshme administrative të Këshillit të marra nën Rregulloren Administrative të UNMIK-ut 2005/52 apo në bazë të Këshillit të themeluar në bazë të Ligjit mbi Përbërjen e Përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe të cilat janë marrë para themelimit të këtij Këshilli dhe transferimit të kompetencave, përfshirë shpalljen e cilësdo rregull, rregullore, skemë tarifore, urdhëresë apo veprimi tjetër zyrtar, do të mbeten të vlefshme dhe në fuqi përpos

nëse shfuqizohen me këtë ligj apo deri në një kohë kur veprimet e tilla Këshilli do t'i ndryshojë, shfuqizojë apo sqarojë.

2. Të gjitha veprimet e mëparshme të Këshillit lidhur me emërimin, transferimin apo disiplinën e prokurorëve mbeten të vlefshme dhe në fuqi përpos nëse shfuqizohen përmes këtij ligji apo akti pasues ligjor.
3. Të gjitha veprimet e mëparshme të Këshillit për personelin sa i përket emërimit, ngritjes në detyrë, transferimit apo shkarkimit të punonjësve administrativ mbeten të vlefshme dhe në fuqi përpos nëse shfuqizohen me këtë ligj apo me veprim pasues të Këshillit.

Neni 42
Përbërja fillestare e Këshillit

1. Pavarësisht nenit 5 të këtij ligji, përbërja fillestare e Këshillit është si në vijim:
   1.1. kryeprokurori i Shtetit
   1.2. prokurori që deri në atë kohë shërben si anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
   1.3. prokurori Special që shërben në Këshillin gjyqësor të Kosovës;
   1.4. ministri i drejtësisë.
   1.5. një (1) prokuror i qarkut dhe një prokuror komunal të zgjedhur nga anëtarët e mësipërm, njëri nga të cilët duhet të jetë nga komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë.
   1.6. tre (3) anëtarët e tjerë të zgjedhur nga Këshilli siç ceket në nenin 5 paragrafi 3. i këtij ligji, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 43
Transferimi i kompetencave

1. Me themelimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës siç ceket me këtë ligj, detyrat dhe kompetencat që deri në atë kohë janë ushtruar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës transferohen tek Këshilli.
2. Prokurorët të cilët në kohën e themelimit të këtij Këshilli siç ceket me këtë ligj, janë anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, transferohen në Këshill dhe mbesin aty deri në skadimin e natyrshëm të mandatit të tyre.
3. Jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë transferojnë në Këshill të gjitha dosjet që kanë të bëjnë me prokurorët.

Neni 44
Shfuqizimi

Ky ligj shfuqizon dhe zëvendëson Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/52 si dhe të gjitha dispozitat tjera ligjore të cilat bien ndesh me këtë ligj.

Neni 45
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 Janar 2011, në përputhje me nenin 80 (6) të Kushtetutës të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-224
30 shtator 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-051-2010, datë 18.10.2010 nga u.d. Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 83 / 29 TETOR 2010

LIGJI Nr. 04/L-115
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË KANË TË BËJNË ME PËRFUNDIMIN E MBIKËQYRJES NDËRKOMBËTARE TË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË KANË TË BËJNË ME PËRFUNDIMIN E MBIKËQYRJES NDËRKOMBËTARE TË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Neni 1
Qëllimi

1. Ky ligj ka për qëllim të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve në vijim për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës:
   1.1. Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
   1.2. Ligjit Nr. 03/L-075 për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës;
   1.3. Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
   1.4. Ligjit Nr. 03/L-079 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale;
   1.5. Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
   1.6. Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04 L 101 për Fondet Pensionale të Kosovës;
   1.7. Kodit Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë;
   1.8. Ligji Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat;
   1.9. Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat;
   1.10. Ligji Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
   1.11. Ligji Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
   1.12. Ligji Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë;
   1.13. Ligji Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme;
   1.14. Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës;
   1.15. Ligji Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativ të Komunave;

1.16. Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës;
1.17. Ligji Nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës;
1.18. Ligji Nr. 03/L-237 për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave;
1.19. Ligji Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës;
1.20. Ligji Nr. 03/L-082 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës.
1.21. Ligji Nr. 03/L-033 për Statusin, imunitetet dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin e Kosovës dhe praninë ndërkombëtare ushtarake, si dhe personelin e saj.

Neni 2
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Ligji)

1. Neni 15 i ligjit bazik pas paragrafit 1. shtohet paragraf i ri 2. me tekstin si në vijim:
   2. Gjykatësit ndërkombëtarë, të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë ligj, vazhdojnë të marrin pagën e tyre të specifikuar sipas vendimit për emërim. Qeveria e Kosoves merr pjesë në pagesën e gjykatësve ndërkombëtarë, në periudhën e përcaktuar në vlerë të pagave të gjyqtarëve vendorë.
2. Neni 55 i ligjit bazik, paragrafi 1. dhe paragrafi 2 fshihen nga teksti i ligjit dhe shtohet një paragraf i ri me tekstin si në vijim:
   Mandati i gjykatësve ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim.

Neni 3
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-075 për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës (Ligji)

1. Neni 8 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 8

Auditori i përgjithshëm, i emëruar në përputhje me Kushtetutën dhe me këtë ligj, vazhdon të qëndrojë në post deri në përfundim të mandatit, me kompensimin e cekur në kushtet specifike të emërimit të tij. Qeveria e Kosovës siguron fonde në vlerën e përcaktuar me marrëveshjen në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Zyrës se Auditorit të përgjithshëm.

Neni 4
Ndryshimet dhe plotësimet Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji)

1. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1.12, që përkufizon Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar, fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Kuvendi pas propozimit nga qeveria zgjedh tre (3) anëtarë ndërkombëtarë drejtorë të bordit. Bordi, po ashtu, emëron një shtetas të Kosovës drejtor të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit, i cili nuk do të jetë anëtar i Bordit. Bordi, përveç kryesuesit, po ashtu, emëron zëvendëskryesues njërin prej anëtarëve të tij. Për emërimin, shkarkimin ose ndryshimin e kushteve të referimit të Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit kërkohet vota afirmative e shumicës së Bordit të Drejtorëve. Anëtarët ndërkombëtarë zgjedhën më mandat deri më 31 gusht 2014.

3. Neni 14 i ligjit bazik, paragrafët 7., dhe 9., vlejnë deri në përfundimin e mandatit të anëtarëve ndërkombëtarë të bordit.
4. Neni 31 i ligjit bazik, pas paragrafit 5. shtohet një paragraf i ri 6. me tekstin si në vijim:
   6. Nëse një anëtar ndërkombëtar i bordit i emëruar në pajtim me nenin 31 (5) jep dorëheqje nga Bordi dhe nëse kjo dorëheqje ose largim nga posti ndodh deri më 31 gusht 2014 atëherë ai/ajo do të zëvendësohet me një ndërkombëtar tjetër.

Neni 5
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-079 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale (Ligji)

1. Neni 4 i ligjit bazik që ndryshon nenin 5.2 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   5.2. Bordi mbikëqyrës përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve të cilët emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryeministri.
2. Neni 8 i ligjit bazik që ndryshon nenin 6.1 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   6.1. Sekretaria Ekzekutive ka drejtorin dhe zëvendësdrejtorin të cilët emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryeministri.
3. Neni 10 i ligjit bazik që ndryshon nenin 7.1 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   7.1. Komisioni përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të cilët emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.
4. Neni 13 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 13

Kuvendi, në konsultim me Komisionin, mund të themelojë panele shtesë të Komisionit, anëtarët e të cilëve do të emërohen në bazë të neneve 7.1 dhe 7.2.

5. Neni 16 i ligjit bazik që ndryshon nenin 12.8 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   12.8. Gjykata Supreme e Kosovës vendos lidhur me ankesat në trupin gjykues prej tre (3) gjyqtarëve të cilët emërohen nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës.
6. Pas nenit 27 të ligjit bazik, shtohet një nen i ri 27.A me tekstin si në vijim:

Neni 27.A

1. Mandati i tre (3) anëtarëve ndërkombëtarë të Bordit mbikëqyrës (përfshi edhe kryesuesin), i drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive, i dy (2) anëtarëve ndërkombëtarë të Komisionit (përfshi edhe kryesuesin), si dhe i dy gjykatësve ndërkombëtarë në panelet e ankimit të Gjykatës Supreme të cilët janë emëruar në pajtim me Kushtetutën do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim.
2. Anëtarët dhe gjykatësit ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë Ligj vazhdojnë të marrin pagën e tyre të specifikuar sipas kushteve të emërimit të tyre.
3. Qeveria e Kosoves do të sigurojë fonde për drejtorin e Sekretariatit Ekzekutive të barabartë me pagën e një anëtari vendor të Bordit Mbikëqyrës.
4. Nëse një anëtar ndërkombëtar i emëruar ne pajtim me Kushtetutën jep dorëheqje ose largohet nga pozita e tij/saj dhe nëse ky largim ose dorëheqja ndodh para datës 31 gusht 2014, atëherë ai/ajo do të zëvendësohet me një ndërkombëtar, të dominuar nga Kryeministri për pozitat e anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë së Pronës dhe drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive, si dhe të nominuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme për pozitën e anëtarëve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Anëtareve të Panelit të Ankesave të Gjykatës Supreme, pas konsultimeve me PSBE.

Neni 6
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.3. fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.7, riformulohet me tekstin si në vijim:
   1.7. **Gjykatës Ndërkombëtar** - çdo gjykatës i Misionit Evropian për Politika të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, i cili është emëruar në pajtim me këtë ligj.
3. Neni 11 i ligjit bazik, paragrafi 2. riformulohet me tekstin si në vijim:
   2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Dhoma e Posaçme do të vazhdojë të respektojë dhe zbatojë parimin e kompensimit në vend të kthimit fizik. Kur vendoset për mjetin juridik që do të jepet në një rast të caktuar, Dhoma e Posaçme do të marrë parasysh edhe dispozitat në fuqi të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, duke përfshirë qëllimet publike që përcaktohen në preambulën e atij ligji.

Neni 7
Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04 L-101 për fondet pensionale të Kosovës

1. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 4.6, riformulohet me tekstin si në vijim:
   4.6. Komisioni për përzgjedhje, i propozon kandidatët Kuvendit për vendet e lira në anëtarësim ose për riemërim të anëtarëve të Bordit Drejtues. Komisioni për Përzgjedhje do të përbëhet nga guvernatori i BQK-së - kryesues, Auditori i

Përgjithshëm dhe Ministri i Financave. Mandati i secilit anëtar të emëruar në Bordin Drejtues zgjat tre vjet, me mundësi të rizgjedhjes, nëse mandati i anëtarëve të Bordit skadon dhe asnjë anëtar i ri nuk është emëruar, atëherë anëtarët e Bordit ekzistues do të vazhdojnë mandatin për nëntëdhjetë (90) ditë.

Neni 8
Ndryshimet dhe plotësimet e Kodit Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë (Kodi)

1. Neni 309 i ligjit bazik që rregullon emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave me pëlqimin e PCN-së, fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 1 i Aneksit D, i Kodit, fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 1

Ky Aneks ofron përjashtimet e posaçme të përkufizuara në këtë Aneks që do t'i jepen bashkësive fetare sipas përkufizimit në legjislacionin e aplikueshëm, duke përfshirë edhe legjislacionin për liritë fetare në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Neni 9
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat (Ligji)

1. Neni 1 i ligjit bazik, paragrafi 1.32, që përkufizon PCN-në fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 8 i ligjit bazik paragrafi 2. në rreshtin e tretë fshihet fjala “dhe PCN”.
3. Neni 88 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 10
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-199 për gjykatat (ligji)

1. Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 11, riformulohet me tekstin si në vijim:
   11. Nëse në njërën nga komunat e reja dhe të themeluara mbi bazën e Ligjit për Kufijtë Administrativë Komunal nuk ka gjykatë themelore, komuna me vendim të Kuvendit Komunal mund ta parqet kërkesën para Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK) për të vendosur mbi themelimin e gjykatës themelore në territorin e saj, ose që një nga gjykatat ekzistuese themelore në territorin e komunës tjetër të ketë juridiksion mbi territorin e komunës së re. Të njëjtën të drejtë e ka edhe komuna ekzistuese, ku shumica e popullatës i takon komunitetit jo shumicë në Kosovës, dhe në të cilën nuk ka gjykatë themelore.
      11.1. KGjK do të aprovojë kërkesat e tilla, përveç nëse vlerësohet se ngarkesat e lëndëve për atë juridiksion është e pamjaftueshme për ta arsyetuar ekzistimin e gjykatës së ndarë.
      11.2. Kur KGjK e aprovon kërkesën për themelimin e gjykatës së re

themelore, autoritetet kompetente do t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se cilado gjykatë e re, është themeluar dhe funksionale brenda periudhës gjashtë mujore prej datës së vendimit.

11.3. Nëse KGjK nuk aprovon kërkesën për themelimin e gjykatës së re themelore, ose kur komuna i kërkon gjykatës ekzistuese që të ketë juridiksion për territorin e vet, autoritetet kompetente do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për përmirësimin e qasjes në drejtësi për komunitetet lokale, e cila është vështirësuar për shkak të izolimit gjeografik, mungesës së sigurisë, ose për shkak të faktorëve të tjerë relevant. Këto masa mund të përfshijnë krijimin në kuadër të territorit të komunës së re, të një departamenti të gjykatës themelore ekzistuese prej së cilës komuna e re ka kërkuar të ketë kompetencë për territorin e vet, ose që gjykata themelore të mundësojë mbajtjen e seancave në territorin e komunës së re.

2. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Përbërja e Gjykatës së Apelit pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Republikës së Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore. Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin përkatës në fuqi, si dhe për të siguruar pjesëmarrjen e komunitetit në gjyqësor, pesëmbëdhjetë (15) për qind e numrit të tërësishëm të ulëseve në Gjykatën e Apelit, por jo më pak se dhjetë ulëse, garantohen për gjyqtarët nga radha e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

Neni 11
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.2. fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 1.3, riformulohet me tekstin si në vijim:

1.3. Për të siguruar se gjykatat pasqyrojnë përbërjen etnike të zonës së tyre të juridiksionit në përputhje me nenin 104(3) të Kushtetutës dhe me legjislacionin përkatës në fuqi, Këshilli do të marrë parasysh që të plotësojë vendet e lira të punës ose të ulëseve të rezervuara me anëtarë të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

3. Neni 7 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 7
Mandati i anëtarëve të Këshillit

Anëtarët e Këshillit zgjidhen me mandat 5 (pesë) vjeçar, siç ceket në nenin 108 (6) të Kushtetutës dhe në këtë ligj. Një anëtar i këtij Këshilli mund të zgjidhet për një mandat shtesë jo-vijues pesë (5) vjeçar.

4. Neni 16 i ligjit bazik, paragrafi 3., riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Në përputhje me nenin 104(3) të Kushtetutës, Këshilli zbaton masa dhe veprimet tjera me qëllim rekrutimi, të cilat i konsideron të nevojshme dhe të përshtatshme për të siguruar se një gjykatë ose degë e gjykatës pasqyron përbërjen etnike në zonën e tyre të juridiksionit.

5. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 1., riformulohet si në vijim:
   1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ndërmerr masa të nevojshme për të rritur numrin e gjyqtarëve nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë, prej radhëve të atyre gjyqtarëve që shërbejnë në Kosovë. Për të përmbushur përgjegjësitë e veta, Këshilli, ndër të tjera, nga aplikantët njëlloj të kualifikuar për të shërbyer si gjyqtarë u jep përparësi anëtarëve nga komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovës, ashtu siç është paraparë me nenin 108 të Kushtetutës.
6. Neni 17 i ligjit bazik, pas paragrafit 5., shtohen tre paragraf të rinjë 6, 7 dhe 8, me tekstin si në vijim:
   6. Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të hartojë një rregullore të veçantë për të përshkruar procesin e emërimit dhe të riemërimit të gjykatësve nga komunitetet e nën-përfaqësuara në mesin e gjykatësve që shërbejnë në Kosovë.
   7. Dhënia e përparësisë për kandidatët me kualifikime të barabarta nga komunitetet e nën-përfaqësuara, do të zbatohet përderisa përqindja e gjyqtarëve pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë në Kosovë të jetë nën pesëmbëdhjetë përqind (15%) dhe / përderisa përqindja e gjyqtarëve të cilët janë pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, të jetë nën tetë (8%).
   8. Mandati i dy anëtarëve ndërkombëtarë të Këshillit të emëruar në pajtim me Kushtetutën do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim. Anëtarët ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë ligj vazhdojnë të marrin pagën e tyre.
   9. Neni 52 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 12
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.7, fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 1.3 riformulohet me tekstin si në vijim:
   1.3. Siguron se prokuroritë pasqyrojnë përbërjen etnike të zonës së tyre të juridiksionit në përputhje me nenin 109 (4) dhe 110(3) të Kushtetutës.
3. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Këshilli zbaton masa dhe veprime rekrutimi, si dhe masa të tjera të cilat i konsideron të nevojshme për të siguruar që një zyrë prokuroriale pasqyron përbërjen etnike të zonës së juridiksionit përkatës.
4. Neni 17 i ligjit bazik, pas paragrafit 3. shtohet një paragraf i ri 4. me tekstin si në vijim:
   4. Këshilli harton rregullore të veçantë për të përshkruar procesin e emërimit dhe të riemërimit të prokurorëve nga komunitetet e nën-përfaqësuara në mesin e prokurorëve që shërbejnë në Kosovë.
5. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 1., riformulohet me tekstin si në vijim:
   1. Këshilli ndërmerr masa të nevojshme për të rritur numrin e prokurorëve nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë. Kur ka aplikantë njëlloj të kualifikuar për të shërbyer si prokurorë, Këshilli u jep përparësi anëtarëve nga komunitetet që janë të nënpërfaqësuara në Kosovë siç është paraparë edhe me nenin 109 (4) dhe 110 (3) të Kushtetutës.

6. Neni 18 i ligjit bazik, pas paragrafit 5, shtohet paragrafi i ri 6, me tekstin si në vijim:
   6. Dhënia e përparësisë për kandidatët me kualifikime të barabarta nga komunitetet e nën-përfaqësuara, do të zbatohet përderisa përqindja e prokuroreve pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë në Kosovë të jetë nën pesëmbdhjetë përqind (15%) dhe / ose përderisa përqindja e prokurorëve të cilët janë pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, të jetë nën tetë përqind (8%).

Neni 13
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë (Ligji)

1. Pjesa e parë e preambulës se ligjit, riformulohet me tekstin si në vijim:
   Në bazë të nenit 65 (1) dhe ne pajtim me dispozitat kalimtare dhe përfundimtare nga kreu XIII dhe XIV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Pas nenit 7 të ligjit bazik shtohet një nen i ri 7.A me tekstin si në vijim:

Neni 7.A
Statusi i Kishës Ortodokse Serbe

1. Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë konsiderohet pjesë përbërëse e Kishës Ortodokse Serbe (KOS).
2. Emri dhe organizimi i brendshëm i Kishës Ortodokse Serbe, duke përfshirë edhe hierarkinë dhe veprimtaritë e saj, do të respektohen.
3. Nuk do të ketë ndalim arbitrar për hyrje në Kosovë ose qëndrim brenda Kosovës për priftërinjtë, kandidatët për prift, murgjve, murgeshave dhe vizitorëve.
4. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 7.3, fjalët "**themelojnë dhe**", fshihen nga teksti i ligjit.
5. Neni 8 i ligjit bazik, paragrafi 1, riformulohet me tekstin si në vijim:
   1. Ndërtesat dhe objektet që u takojnë bashkësive fetare, që janë të dedikuara për kryerjen e ceremonive fetare konsiderohen të pacenueshme për sa i përket ndërhyrjes së autoriteteve qeveritare dhe në to mund të hyhet vetëm me pëlqimin e institucionit përkatës fetar, përveç nëse është lëshuar ndonjë urdhër gjyqësor për shkak të aktiviteteve ilegale dhe në rast të rrezikut për jetën ose shëndetin.
6. Neni 12 i ligjit bazik, pas paragrafit 12.4 shtohet një paragraf i ri 12.5 me tekstin si në vijim:
   12.5. Përveç përjashtimeve të përmendura më lart, bashkësitë fetare gëzojnë privilegje doganore dhe tatimore për veprimtari ekonomike, që janë specifike për vetë-qëndrueshmërinë e tyre financiare, siç do të definohet me një akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e financave. Këto privilegje përfshijnë importimin dhe blerjen e produkteve qenësore për prodhim, të materialeve, pajisjeve dhe bagëtisë; dhe eksportimin e produkteve që dalin nga aktivitetet e lartpërmendura.

Neni 14
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1. përkufizimi "**Propozimin Gjithëpërfshirës**", fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Objekt i shpronësimit sipas këtij ligji mund të jenë të drejtat private pronësore dhe të drejtat tjera private për ose ndaj një prone të paluajtshme, me përjashtim të asaj prone të paluajtshme që bën pjesë në atë kategori të pronës, për të cilën Kushtetuta në mënyrë specifike thotë se nuk do të jetë objekt i shpronësimit.
3. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3, shtohet nën-paragraf i ri 3.1. me tekstin si në vijim:
   3.1 Prona e luajtshme dhe e paluajtshme, si dhe asetet tjera të Kishës Ortodokse Serbe do të jenë të pacenueshme dhe nuk do të jenë objekt i shpronësimit.

Neni 15
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (ligji)

1. Pas nenit 3 shtohet nen i ri 3.A me tekstin si në vijim:

Neni 3.A
Të drejtat e refugjatëve dhe personave të zhvendosur

1. Të gjithë refugjatët nga Kosova dhe personat e zhvendosur brenda vendit do të kenë të drejtën e kthimit dhe kërkimit të pronës së tyre dhe posedimeve personale, në pajtim me ligjet vendore dhe ndërkombëtare. Çdo person do të ketë të drejtë të marrë vendim të lirë dhe të jetë i informuar për vendin ku ai kthehet.
2. Institucionet e Republikës së Kosovës ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të krijuar kushte te favorshme për kthim të sigurt dhe të denjë të refugjatëve dhe personave të zhvendosur, bazuar në vendimet e tyre të lira dhe të bazuara në informata të sakta, përfshirë përpjekjet për të promovuar dhe mbrojtur lirinë e tyre të lëvizjes dhe mbrojtjen nga kërcënimi
3. Kushtet e kthimit të personave të zhvendosur dhe mekanizmat e bashkëpunimit me institucionet relevante ndërkombëtare do të përcaktohen nga institucionet e Republikës së Kosovës në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e aplikueshme."

Neni 16
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativë të Komunave (ligji)

1. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Bordi do të përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë, me nga pesë (5) përfaqësues të zgjedhur nga secila komunë dhe një (1) përfaqësues i zgjedhur nga Kryeministri.

2. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 4. riformulohet me tekstin si në vijim:
   4. Kryesuesi i Bordit përzgjidhet nga Kryeministri.
3. Neni 14 i ligjit bazik, fshihet termi **"dhe PCN do të ndërmarrin"** dhe zëvendësohet me termin: "**ndërrmer**".
4. Në Shtojcën 1 (Zonat Kadastrale) të ligjit bazik, emërtimi i komunës "**Hani i Elezit**" në gjuhën serbe dhe angleze ndryshohet në "**Elez Han**"

Neni 17
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës (ligji)

1. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi (c) riformulohet me tekstin si në vijim:
   (c) Një (1) anëtar, i përzgjedhur nga Kryeministri.
2. Neni 14 i ligjit bazik, paragrafi (b), nënparagrafi (iv) riformulohet me tekstin si në vijim:
   iv. Një (1) anëtar, i përzgjedhur nga Kryeministri.

Neni 18
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës (ligji)

1. Titulli i nenit 29 të ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 29
Regjistrimi dhe përcaktimi i shtetësisë

Neni 19
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-237 për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave (Ligji)

1. Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 4.12., riformulohet me tekstin si në vijim:
   4.12 Një (1) përfaqësues nga një prej Universiteteve publike, anëtar;

Neni 20
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës (ligji)

1. Neni 9 i ligjit bazik, paragrafi 3., riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Forca e Sigurisë së Kosovës është e strukturuar dhe e përgatitur për të përmbushur funksionet e sigurisë që nuk i përkasin policisë ose organizatave tjera për zbatim të ligjit.
2. Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 2., riformulohet me tekstin si në vijim:
   2. Forca e Sigurisë së Kosovës është e armatosur lehtë dhe nuk ka armë të rënda, siç janë tanket, artileria e rëndë ose kapacitete sulmuese ajrore. Një rishikim i plotë i këtyre kufizimeve, do të bëhet jo më herët se pesë vjet nga koha e hyrjes në fuqi e Ligjit Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Detyrat fillestare të Forcës së Sigurisë së Kosovës janë:

3. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 2, pika (e) fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 21
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-082 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës (ligji)

1. Neni 5 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 22
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-033 për Statusin, imunitetet dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin e Kosovës dhe praninë ndërkombëtare ushtarake, si dhe personelin e saj

1. Neni 3 i ligjit bazik paragrafi 2. pika (a) riformulohet me tekstin si në vijim:
   (a) Zyra Civile Ndërkombëtare dhe Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian.
2. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3.3. Individët e emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtarë, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, mandati i të cilëve nuk ka përfunduar para deklarimit të përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur gëzojnë statusin, privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara në ligjin bazik.
3. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 6., riformulohet me tekstin si në vijim:
   4.6. Ministri i Punëve të Jashtme nuk mund t'i shpallë PSBE-në ose një anëtar të personelit të tij, anëtarët e personelit të ICO-së, përfshirë individët e përcaktuar në nenin 3.3. të ligjit bazik ose anëtarët e misionit EULEX, si persona non grata.
4. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 7. fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 23

1. Të gjithë anëtarët ndërkombëtarë të emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, në pajtim me Kushtetutën e Republikës se Kosovës, me përjashtim të atyre të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Agjencisë Kosovare të Pronës gjyqtarët ndërkombëtarë të Panelit të Ankesave të Gjykatës Supreme, dhe dy gjyqtarë në Komisionin për Kërkesa Pronësore, nëse për çfarëdo arsye largohen nga pozita para datës 31 gusht 2014 ai/ajo do të zëvendësohet me një anëtar vendor.
2. Nëse në cilindo ligj të aplikueshëm në Republikën e Kosovës përdoren termet ICO ose PCN, të njëjtat shfuqizohen dhe zëvendësohen me institucionet vendore përkatëse.

II. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 24
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të amendamenteve kushtetuese për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë.

Ligji Nr. 04/L-115
31 gusht 2012

Shpallur me dekretin Nr.DL-036-2012, datë 04.09.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr.25 / 7 SHTATOR 2012, PRISHTINË

LIGJI Nr. 03/L-053
MBI KOMPETENCAT, PËR ZGJEDHJEN E LËNDËVE DHE CAKTIMIN E LËNDËVE TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE TË EULEX-it NË KOSOVË

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 855
Kreu II: Kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it 857
Kreu III: Kompetencat e prokurorëve të EULEX-it 864
Kreu IV: Dispozitat përfundimtare dhe kalimtare 868

Në mbështetje të Kapitullit IV neni 65 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me qëllim të caktimit të kompetencave, përzgjedhjen e l nd ve dhe caktimin e l nd ve t gjyqtareve dhe prokurorëve t EULEX-it n Kosovë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJIN MBI KOMPETENCAT, PËR ZGJEDHJEN E LËNDËVE DHE CAKTIMIN E LËNDËVE TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE TË EULEX-it NË KOSOVË

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj rregullon përfshirjen dhe kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Republikës së Kosovës.

Përkufizimet

Për qëllimet e këtij ligji:
- **"EULEX KOSOVË"-** do të thotë Misioni i Politikës Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje i vendosur në Kosovë nga Bashkimi Evropian;
- **"Shefi i EULEX KOSOVË"-** do të thotë personi që i përket EULEX KOSOVË e që është përzgjedhur dhe emëruar nga autoriteti kompetent që të punojë në Kosovë në këtë pozitë specifike;
- **"Shefi i Komponentit të Drejtësisë"-** do të thotë personi që i përket EULEX

KOSOVË e që është përzgjedhur dhe emëruar nga autoriteti kompetent që të punojë në Kosovë në këtë pozitë specifike;

- **"Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it"-** do të thotë gjyqtari që i përket EULEX KOSOVË e që është përzgjedhur dhe emëruar nga autoriteti kompetent për të punuar në Kosovë në këtë pozitë specifike;
- **"Kryeprokuror i EULEX-it"-** do të thotë prokurori që i përket EULEX KOSOVË e që është përzgjedhur dhe emëruar nga autoriteti kompetent për të punuar në Kosovë në këtë pozitë specifike;
- **"Gjyqtar i EULEX-it"-** do të thotë gjyqtari që i përket EULEX KOSOVË e që është përzgjedhur dhe emëruar nga autoriteti kompetent që të punojë në Kosovë në këtë pozitë specifike;
- **"Prokuror i EULEX-it"-** do të thotë prokurori që i përket EULEX KOSOVË e që është përzgjedhur dhe emëruar nga autoriteti kompetent që të punojë në Kosovë në këtë pozitë specifike;
- **"Koordinator i EULEX-it për të Drejtat Pronësore"-** do të thotë personi që i përket EULEX KOSOVË e që është përzgjedhur dhe caktuar nga Shefi i Komponentit të Drejtësisë të EULEX-it për të punuar në këtë pozitë specifike në Kosovë;
- **"Zyrtar policor i EULEX-it"-** do të thotë personi që i përket EULEX KOSOVË e që është përzgjedhur dhe emëruar nga autoriteti kompetent për të punuar në këtë pozitë specifike në Kosovë;
- **"Zyrtar korrektues i EULEX-it"-** do të thotë personi që i përket EULEX KOSOVË e që është përzgjedhur dhe emëruar nga autoriteti kompetent për të punuar në këtë pozitë specifike në Kosovë;
- **"Zyrtar policor i Kosovës"-** do të thotë pjesëtari i Shërbimit Policor të Kosovës, siç përcaktohet sipas ligjit në fuqi;
- **"Zyrtar korrektues i Kosovës"-** do të thotë pjesëtari i personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës, siç përcaktohet sipas ligjit në fuqi;
- **"Prokuroria publike e Kosovës"-** nënkupton organin e pavarur publik me përgjegjësi për të kryer hetimin e veprave penale, zbulimin dhe mbledhjen e provave dhe informatave më qëllim të fillimit dhe zhvillimit të procedurave penale, ndjekjen e personave të dyshuar për vepra penale, dhe kryerjen e funksioneve tjera siç parashihen sipas ligjit në fuqi;
- **"Kryeprokuror publik i Kosovës"-** do të thotë prokurori publik që udhëheq Prokurorinë publike të Kosovës në pajtim me ligjin në fuqi;
- **"Prokuror publik i Kosovës"-** do të thotë banori i Kosovës i emëruar si prokuror sipas ligjit në fuqi;
- **"Gjyqtar i Kosovës"-** do të thotë banori i Kosovës i emëruar si gjyqtar sipas ligjit në fuqi;
- **"Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës" apo "PSRK"-** do të thotë zyra prokuroriale e përhershme dhe e specializuar që funksionon në kuadër të Prokurorisë publike të Kosovës;
- **"Agjenci për zbatimin e ligjit"-** do të thotë policia e Kosovës dhe ndonjë organ apo agjenci tjetër e themeluar në Kosovë që në mënyrë legjitime mund të ushtrojë kompetenca të ngjashme dhe funksione tipike me ato të policisë së Kosovës në pajtim me ligjin në fuqi; ky përkufizim përfshin edhe policinë e EULEX-it

- **"Ligji në fuqi"-** do të thotë ligji në fuqi në Kosovë në përputhje me Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 1999/24 mbi Ligjin në fuqi në Kosovë, dhe çfarëdo akti tjetër të ardhshëm normativ të nxjerrë në Kosovë nga organi kompetent pas miratimit të këtij ligji;
- **"KPPK"-** do të thotë Kodi i përkohshëm penal i Kosovës, i shpallur me anë të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2003/25;
- **"KPPPK"-** do të thotë Kodi i përkohshëm i procedurë penale i Kosovës i shpallur me anë të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2003/26;
- **"KPSFRJ"-** do të thotë Kodi penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, i ndryshuar dhe publikuar në Gazetën zyrtare nr. 44/76 të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë;
- **"LPK"-** do të thotë Ligji penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, i ndryshuar dhe publikuar në Gazetën zyrtare nr. 25/77 të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës;
- **"Dita e tranzicionit"-** do të thotë dita në të cilën EULEX KOSOVË fillon mandatin e vet në Kosovë.

KREU II
KOMPETENCAT E GJYQTARËVE TË EULEX-it

Neni 2
Kompetencat e përgjithshme të gjyqtarëve të EULEX-it

2.1. Gjyqtarët e EULEX-it do të kenë kompetencë dhe përgjegjësi që të ushtrojnë funksionet për lëndët që janë në kuadër të juridiksionit të gjykatave ku ata janë caktuar nga Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara me anë të këtij ligji dhe nga EULEX KOSOVË.

2.2. Gjyqtarët e EULEX-it do të bashkëpunojnë me gjyqtarët kosovar që punojnë në gjykata të ndryshme ku ata janë caktuar në pajtim me modalitetet e përcaktuara me anë të këtij ligji dhe nga EULEX KOSOVË.

2.3. Sipas nevojës, aspektet relevante të aktivitetit dhe bashkëpunimit të gjyqtarëve të EULEX-it me gjyqtarët që punojnë në gjykatat vendore do të përcaktohen me tutje, për aq sa është e nevojshme, me anë të një marrëveshje të veçantë ndërmjet Shefit të EULEX KOSOVË, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës.

2.4. Përveç ushtrimit të funksioneve gjyqësore në përputhje me dispozitat e neneve 3,4 dhe 5 të këtij ligjit, gjyqtarët e EULEX-it do të monitorojnë, udhëzojnë dhe këshillojnë gjyqtarët kosovar për sa i përket parimit të pavarësisë së gjyqësorit dhe në përputhje me modalitetet e përcaktuara me anë të këtij ligji dhe nga EULEX KOSOVË.

2.5. Gjyqtarët e EULEX-it do të jenë të pavarur në ushtrimin e funksioneve të tyre.

2.6. Pas konsultimit me Shefin e Komponentit të Drejtësisë, Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it dhe Kryeprokurori i EULEX-it, do t'ia propozojnë Asamblesë se gjyqtarëve të EULEX-it përkatësisht Asamblesë se Prokurorëve të EULEX-it, modalitetet për përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve në bazë të kritereve objektive dhe masat siguruese procedurale të cilat do të jenë në

përputhje me ligjin në fuqi. Këto modalitete që do të miratohen nga Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it dhe Asambleja se Prokurorëve të EULEX-it, do të sigurojnë respektimin e pavarësisë dhe paanësisë së gjyqtarëve të EULEX-it si dhe të autonomisë së prokurorëve të EULEX-it në ushtrimin e funksioneve të tyre.

Neni 3
Juridiksioni dhe kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it në procedurë penale

3.1. Gjyqtarët e EULEX-it të caktuar në procedurë penale do të kenë juridiksion dhe kompetencë për çdo lëndë të hetuar a të ndjekur penalisht nga PSRK-ja.

3.2. Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do ta caktojë cilindo gjyqtar të EULEX-it në fazën përkatëse të procedurës penale të lëndës së hetuar a ndjekur penalisht nga PSRK-ja në përputhje me modalitetet për përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të përcaktuara nga Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it dhe në pajtim me këtë ligji. Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it mund të vendos lidhur me veprimet e arsyeshme që një fazë përkatëse e procedurës penale të mos i caktohet gjyqtarëve të EULEX-it.

3.3. Para fillimit të fazave përkatëse të procedurës dhe pas kërkesës së prokurorit të EULEX-it të caktuar në lëndë apo që punon në ekipin e përzier të identifikuar në nenet 9 dhe 10 të këtij ligji apo pas kërkesës së cilësdo palë në procedurë, apo pas kërkesës me shkrim të kryetarit ë gjykatës kompetente apo të seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të Kosovës kur nuk zbatohen dispozitat lidhur me përjashtmin e një gjyqtari apo një gjyqtari porotë të parapara sipas KPPPK-së (neni 40-44 i KPPPK-së), Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do të ketë kompetencë, çdoherë kur konsiderohet e nevojshme që të sigurohet administrimi i duhur i drejtësisë, që t'i caktojë gjyqtarët e EULEX-it në fazën përkatëse të një procedure penale në përputhje me modalitetet për përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të përcaktuara nga Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it dhe në pajtim me këtë ligj, për krimet e poshtëshënuara, atëherë kur hetimi a ndjekja penale nuk kryhet nga PSRK-ja:

a) sulm kundër rendit juridik të Kosovës (neni 108, KPPK);
b) nxitja e urrejtjes, e përçarjes ose e mos durimit kombëtar, racor, fetar a etnik (neni 115, KPPK);
c) rrëmbimi i fluturakes (neni 132, KPPK), rrezikimi i sigurisë së aviacionit civil (neni 133, KPPK), rrezikimi i sigurisë së lundrimit detar (neni 134, KPPK), rrezikimi i sigurisë së platformave fikse të vendosur në pragun kontinental (neni 135, KPPK);
d) piratëria (neni 136, KPPK);
e) kontrabandimi me emigrantë (neni 138, KPPK), Trafikimi me njerëz (neni 139, KPPK);
f) rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to (neni 142, KPPK);
g) vrasja (neni 146, KPPK), vrasja e rëndë (neni 147, KPPK); Marrja e pengjeve (neni 143, KPPK), Rrëmbim i personit (neni 159, KPPK);
h) shkelja e statusit të barabartë të banorëve të Kosovës (neni 158, KPPK)

i) tortura (neni165, KPPK);
j) të gjitha veprat penale kundër integritetit seksual të paraqitura në nenet 193-204 të KPPK-së çdoherë që ato janë të dënueshme me pesë ose më tepër vite burgim duke marrë parasysh maksimumin e sanksionimit të mundshëm të paraparë me ligj;
k) blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike (neni 229, KPPK), prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm dhe i substancave psikotropike (neni 230, KPPK);
l) shkaktimi i bankrotimit (neni 234, KPPK), dëmtimi i kreditorëve (neni 235 KPPK), keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi (neni 236, KPPK), lidhja e kontratave të dëmshme (neni 237, KPPK), shmangia nga tatimi (neni 249, KPPK), organizimi i skemave piramidale dhe i bixhozit të paligjshëm (neni 243, KPPK), falsifikimi i parasë (neni 244, KPPPK), pranim i paarsyeshëm i dhuratave (neni 250, KPPK), dhënia e arsyetueshme e dhuratave (neni 251, KPPK);
m) rastet e rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes (neni 256, KPPK), mashtrimi (neni 261, KPPK), shtrëngimi (neni 267, KPPK);
n) pjesëmarrja në grup që kryen vepër penale (neni 320, KPPK)
o) furnizimi, transporti, prodhimi ose shitja e paautorizuar e armëve (neni 327, KPPK);
p) Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit (neni 339, KPPK), përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës (neni 340, KPPK), mashtrimi në detyrë (neni 341, KPPK), pranimi i ryshfetit (neni 343, KPPK), dhënia e ryshfetit (neni 344, KPPK);
q) krimet e paraqitura në nenet 30, 31, 32, 33, 34, 138, 141, 149, 215, 219, 222 dhe 223 të LKP;
r) krimet e paraqitura në nenet 74-82 të LPK-së (veprat penale kundër dinjitetit të personal dhe moralit) të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/1 mbi ndryshimin e Ligjit në fuqi për veprat penale që kanë të bëjnë me dhunën seksuale, çdoherë që ato janë të dënueshme me pesë ose më tepër vite burgim duke marrë parasysh maksimumin e sanksionimit të mundshëm të paraparë me ligj;
s) krimet e paraqitura në nenet 134, 240, 241, 245 të KPSFRJ;
t) nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar dhe etnik (neni 1, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/4);
u) trafikimi me njerëz (neni 2, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/4 mbi Ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë).

3.4. Para fillimit të fazave përkatëse të procedurës, dhe pas kërkesës së prokurorit të EULEX-it të caktuar në lëndë apo që punon në ekipin e përzier të identifikuar në nenet 9 dhe 10 të këtij ligji apo pas kërkesës së cilësdo palë në procedurë, apo pas kërkesës me shkrim të kryetarit të gjykatës së instancës me të lartë nga i cili kërkohet që të marrë vendim në përputhje me paragrafin 1 të nenit 35 të KPPPK-së, Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do të ketë kompetencë që t'i caktojë gjyqtarët e EULEX-it në fazën përkatëse të një procedure penale në përputhje me modalitetet për përzgjedhjen dhe caktimin e

lëndëve të përcaktuara nga Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it dhe në pajtim me ligjin në fuqi për çdo vepër penale, përfshirë këtu veprat penale kundër personave apo pronës, ku viktima, prona apo objekti i veprës penale duken të jenë përzgjedhur për shkak të lidhjes, bashkimit, afërsisë, mbështetjes apo anëtarësisë së tyre të vërtetë apo të perceptuar me një grup të vërtetë apo të perceptuar të identifikuar sipas racës, origjinës kombëtare, etnike apo shoqërore, afërsisë me ndonjë minoritet kombëtar apo grup politik, gjuhës, ngjyrës, besimit, gjinisë, moshës, të metave fizike apo mentale, orientimit seksual, apo faktorëve tjerë të ngjashëm.

3.5. Për qëllimet e dispozitave të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, administrimi i duhur i drejtësisë është i nevojshëm që të sigurohet:
   a) nëse ka pasur kërcënime ndaj gjyqtarit kosovar, dëshmitarëve apo palëve të procedurës lidhur me lëndën, dhe kjo në mënyrë të arsyeshme bën të besohet se do të ketë keqpërdorim të drejtësisë në rast se lënda mbahet në përgjegjësi të veçantë të gjyqtarit kosovar; apo
   b) nëse është e arsyeshme të besohet se aktiviteti i gjyqtarit të EULEX-it, për shkak të kompleksitetit apo natyrës së veçantë të lëndës, është i nevojshëm për të shmangur keqpërdorimin e drejtësisë.

3.6. Në rastet e parapara në paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, gjyqtari kosovar që përndryshe duhet t'i jetë caktuar lënda, kryetari i gjykatës kompetente apo i gjykatës së instancës me të lartë dhe palët në procedurë kanë të drejtë të dëgjohen nga Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it. Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do t'ia ofrojë kryetarit të gjykatës që ka kompetencë dhe palëve të procedurës arsyet e vendimit për pranimin apo refuzimin e kërkesës për të caktuar një gjyqtar të EULEX-it në një procedurë të veçantë. Ankesa kundër këtij vendimi nuk lejohet dhe ky vendim do të jetë detyrues për të gjitha autoritetet e Kosovës.

3.7. Kolegjet në të cilat gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë juridiksionin e tyre në procedurat penale do të përbëhen me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it dhe do të kryesohen nga gjyqtarët e EULEX-. Sidoqoftë, Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do të ketë kompetencë, me përjashtim të kësaj rregulle dhe për arsye të bazuara, që të vendosë që kolegji të ketë përbërje shumicë apo të plotë të gjyqtarëve vendor ose mund të vendos që të mos caktojë fare gjyqtarët e EULEX-it për fazat e posaçme të procedurës.

3.8. Kur procedurat penale janë të lidhura me ato të referuara në paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, gjyqtarët e EULEX-it, kanë kompetencë që të ushtrojë funksionet e tyre lidhur me këto procedura tjera, pavarësisht nga kualifikimi ligjor i veprës penale dhe pavarësisht nga natyra e krimit.

3.9. Në ushtrimin e funksionit të tyre të monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit, gjyqtarët e EULEX-it kanë kompetencë që të kenë qasje në çdo fazë të procedurës, të marrin kopjet e duhura të dokumenteve dhe të kërkojnë me shkrim informata lidhur me statusin e çdo lënde penale në procedurë apo të përfunduar që është në juridiksionin ose kompetencën e cilësdo gjykatë në Kosovë. Kjo do të përfshijë edhe kërkesën për informata që kanë të bëjnë me ekzekutimin e aktgjykimeve dhe vendimeve të plotfuqishme.

3.10. Shefi i Komponentit të Drejtësisë do të ketë kompetencë që të kërkojë dhe marrë

nga kryetarët e gjykatave të ndryshme në Kosovë informatat që kanë të bëjnë me lëndët që mund të jenë në kompetencë të gjyqtarëve të EULEX-it

Neni 4
Kompetencat e Kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-in dhe të Kryeprokurorit të Kosovës në rastet e ekzistimit të procedurave për përjashtim

4.1. Pavarësisht nga krimet e paraqitura në paragrafin 3 të nenit 3 të këtij ligji, në qoftë se parashtrohet kërkesë për përjashtim të gjyqtarit kosovar në përputhje me dispozitat e paragrafit 3 të nenit 40 dhe nenit 42 të KPPPK-së, Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do të ketë kompetencë që t'i caktojë gjyqtarët e EULEX-it në fazën përkatëse të çdo procedure penale në përputhje me modalitete për përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të përcaktuara nga Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it çdoherë që kërkesa për përjashtim përmban elemente të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme bëjnë të besohet se caktimi i një gjyqtari tjetër kosovar në procedurë sipas KPPPK-së nuk përjashton rrethanat që vënë në dyshim paanësinë e gjyqtarit kosovar.

4.2. Në rastin e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, një kopje e kërkesës për përjashtim e parashtruar në përputhje me KPPPK-në do t'i dërgohet pa vonesë Kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it nga pala përkatëse e procedurës.

4.3. Refuzimi i kërkesës për përjashtim e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni nga Kryetari i gjykatës së identifikuar në dispozitat e nenit 43 të KPPPK-së nuk do ta pengojë Kryetarin e Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it në ushtrimin e kompetencës për të caktuar ndonjë gjyqtar të EULEX-it në fazën përkatëse të procedurës, para fillimit të asaj procedure, çdoherë që ai konsideron se rrethanat që vënë në dyshim paanësinë e gjyqtarit kosovar nuk janë mënjanuar nga ajo procedurë e veçantë. Në rrethana të tilla nuk zbatohet paragrafi 4 i nenit 42 i KPPPK-së.

4.4. Nëse kryetari i gjykatës apo seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Kosovës e identifikuar në dispozitat e nenit 43 të KPPPK-së besojnë se kërkesa për përjashtim e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, është e bazuar, atëherë një kërkesë me shkrim i dërgohet Kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it dhe do të zbatohen dispozitat e paragrafit 5 të këtij neni Në rrethana të tilla nuk zbatohet paragrafi 4 i nenit 42 i KPPPK-së.

4.5. Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it gjithashtu do të ketë kompetencë që, pas kërkesë me shkrim të kryetarit të gjykatës së identifikuar në nenet 41 dhe 43 të KPPPK-së, apo të seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të Kosovës të identifikuar në paragrafin 3 të nenit 43 të KPPPK-së, t'i caktojë gjyqtarët e EULEX-it në fazën përkatëse të çdo procedure penale në përputhje me modalitete për përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të përcaktuara nga Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it, çdoherë që një gjyqtar kosovar përjashtohet në përputhje me dispozitat e KPPPK-së dhe nuk është e mundshme, për arsye ligjore apo faktike që të caktojë në procedurë një gjyqtar tjetër kosovar dhe të përfshihen ata të referuar në paragrafin 1 të këtij neni. Në rrethana të tilla nuk zbatohet paragrafi 4 i nenit 42 i KPPPK-së.

4.6. Në përputhje me paragrafët 1, 3 dhe 5 të këtij neni nuk lejohet ankesë kundër vendimeve të marra nga Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it.

4.7. Kolegjet në të cilat gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë kompetencat e tyre në ato procedura penale në të cilat janë caktuar sipas dispozitave të paragrafëve 1-5 të këtij neni gjithmonë do të përbëhen nga tre gjyqtarë, nga të cilët së paku dy janë gjyqtarë të EULEX-it dhe njëri nga gjyqtarët e EULEX-it do të jetë kryetar i kolegjit. Sidoqoftë, Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do të ketë kompetencë, me përjashtim nga kjo rregull dhe për arsye të bazuara, që të vendos që kolegji të përbëhet nga shumica apo numri i përgjithshëm i gjyqtarëve kosovar apo mund të vendos që gjyqtarët e EULEX-it të mos caktohen në një fazë të veçantë të procedurës.

4.8. Në qoftë se, sipas ligjit në fuqi, një gjyqtar i EULEX-it do t'i nënshtrohet procedurës për përjashtim, apo nëse është bërë kërkesë për përjashtim të një gjyqtari të EULEX-it, Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do të ketë kompetencë që të vendos lidhur me atë përjashtim, me përjashtim të dispozitave të KPPPK-së. Nëse kërkesa për përjashtim drejtohet kundër Kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, atëherë Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it do të vendos lidhur me këtë çështje.

4.9. Në qoftë se, sipas ligjit në fuqi, një prokuror i EULEX-it do t'i nënshtrohet procedurës për përjashtim, Kryeprokurori i EULEX-it do të ketë kompetencë që të vendos lidhur me atë përjashtim, me përjashtim të dispozitave të KPPPK-së. Nëse kërkesa për përjashtim drejtohet kundër Kryeprokurorit të EULEX-it, atëherë Asambleja e prokurorëve do të EULEX-it do të vendos lidhur me këtë çështje.

4.10. EULEX KOSOVË do të themelojë Asamblenë e gjyqtarëve të EULEX-it si dhe Asamblenë e prokurorëve të EULEX-it të cilat do të jenë përgjegjëse që të menaxhojnë të gjitha çështjet lidhur me administrimin dhe punën gjyqtarëve të EULEX-it, përkatësisht prokurorëve të EULEX-it, në përputhje me modalitetet e përcaktuara nga EULEX KOSOVË. Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it dhe Asambleja e prokurorëve të EULEX-it gjithashtu do të jenë përgjegjëse që të vendosin për kërkesat për përjashtim kundër Kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, përkatësisht Kryeprokurororit të EULEX-it.

Neni 5
Kompetenca e gjyqtarëve të EULEX-it për lëndët civile

5.1. Gjyqtarët e EULEX-it të caktuar në procedurë civile do të kenë kompetencë që të përzgjedhin dhe marrin përgjegjësi, në pajtim me Kryetarin e Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it dhe në përputhje me modalitetet për përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të përcaktuara nga Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it për:

a) lëndët që janë në kompetencë të Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, përfshirë këtu lëndët që i janë referuar ndonjë gjykate tjetër në pajtim me ligjin në fuqi;

b) lëndët që janë në juridiksion të cilësdo gjykatë në Kosovës lidhur me ankesat kundër vendimeve të Komisionit Kosovar për Kërkesa Pronësore në pajtim me ligjin në fuqi;

c) çdo lëndë të re apo të pazgjidhur civile që ka të bëjë me pronën, përfshirë këtu ekzekutimin e procedurave që janë në juridiksion të cilësdo gjykatë në Kosovë, nëse:
   (i) ekziston dyshimi i bazuar i përpjekjeve për të ndikuar në paanësinë apo pavarësinë e gjyqësorit vendor; apo
   (ii) ekziston dyshimi i bazuar se gjyqësori vendor nuk është i gatshëm apo është i paaftë që ta shqyrtojë lëndën siç duhet; apo
   (iii) ekziston dyshimi i bazuar në shkeljen serioze të zhvillimit të drejtë të procedurës.

5.2. Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do t'i caktojë gjyqtarët e EULEX-it në kolegjet e gjykatave përveç Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit. Kolegjet do të përbëhen nga tre gjyqtarë, dy nga të cilët do jenë gjyqtarë të EULEX-it. Kur shfaqet nevoja për dërgimin e një gjyqtari të EULEX-it në një gjykatë tjetër, Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it mund të bëjë këtë vetëm për hir të organizimit më të mirë të drejtësisë, në bazë të kritereve objektive të përcaktuar në përputhje me modalitetet për përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të përcaktuara nga Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it

5.3. Kryetari i Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur më çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit do t'i caktojë gjyqtarët e EULEX-it në kolegjet e Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit. Kolegjet do të përbëhen nga tre gjyqtarë, dy nga të cilët do të jenë gjyqtarë të EULEX-it. Kolegji për ankesa do të përbëhet nga pesë gjyqtarë, tre nga të cilët do të jenë gjyqtarë të EULEX-it.

5.4. Si rregull, kryetari i kolegjit në kolegjet e lartpërmendura do të jetë një gjyqtar i EULEX-it

5.5. Me përjashtim të paragrafëve 2,3 dhe 4 të këtij neni, si dhe për arsye të bazuara, Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do të ketë kompetencë që ta përcaktojë përbërjen e kolegjeve me përbërje të plotë të gjyqtarëve të EULEX-it apo me përbërje shumicë apo të plotë të gjyqtarëve vendor. Kjo përfshin edhe kompetencën për të vendosur që të mos caktojë fare gjyqtarët e EULEX-it në fazat e veçanta të procedurës.

5.6. Në ushtrimin e funksionit të tyre të monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit, gjyqtarët e EULEX-it do të kenë kompetencë që të kërkojnë me shkrim informata lidhur me statusin e çdo lënde civile në procedurë apo të përfunduar që është në juridiksionin ose kompetencën e cilësdo gjykatë në Kosovë. Gjyqtarët e EULEX-it do të kenë të drejtë që t'i marrin kopjet e duhura të dokumenteve që kanë të bëjnë me çdo kontest apo procedurë civile që janë në juridiksionin ose kompetencën e cilësdo gjykatë në Kosovë.

5.7. Në rastin e paraparë sipas pikës c), paragrafi 1 i këtij neni, gjyqtari kosovar që përndryshe duhet t'i jetë caktuar lënda, kryetari i gjykatës kompetente dhe palët në procedurë kanë të drejtë të dëgjohen nga Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it. Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do t'ia ofrojë Kryetarit të gjykatës që ka kompetencë territoriale dhe palëve të procedurës arsyet e vendimit lidhur me caktimi e një gjyqtari të EULEX-it në një procedurë

të veçantë. Nuk lejohet kundërshtim kundër këtij vendimi dhe ky vendim do të jetë detyrues për të gjitha autoritetet e Kosovës.

Neni 6
Dispozitat lidhur me Koordinatorin e EULEX-it për të Drejtat Pronësore në Kosovë

6.1. Koordinatori i EULEX-it për të Drejtat Pronësore do të ndihmojë në koordinimin e çështjeve lidhur me të drejtat pronësore, si dhe zgjidhjen e kërkesave ndërmjet palëve të përfshira në këtë çështje, duke përfshirë por jo kufizuar në Agjencinë Kosovare të Pronës, Komisionin Kosovar për Kërkesa Pronësore, Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, gjykatat e rregullta, apo Shërbimin Policor të Kosovës.

6.2. Të gjitha palët që merren me çështjet e të drejtave pronësore, përfshirë këtu zgjidhjen e kërkesave në Kosovë, janë të obliguar që t'i ofrojnë falas Koordinatorit të EULEX-it për të Drejtat Pronësore çdo informatë të kërkuar nga ta dhe t'i lejojnë qasje në të gjitha elementet e nevojshme për zbatimin e mandatit të vet.

KREU III
KOMPETENCAT E PROKURORËVE TË EULEX-it

Neni 7
Kompetencat e përgjithshme të prokurorëve të EULEX-it

7.1. Prokurorët e EULEX-it do të kenë kompetenca dhe përgjegjësi që të ushtrojnë funksionet e tyre, përfshirë këtu kompetencat për të kryer hetime penale dhe për të marrë përgjegjësi për hetimet penale apo procedurat e lëndëve të reja dhe atyre të pazgjidhura në kuadër të PSRK-së apo në kuadër të zyrave prokuroriale ku ata janë caktuar nga Kryeprokurori i EULEX-it dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara me anë të këtij ligji dhe nga Asambleja e prokurorëve të EULEX-it.

7.2. Prokurorët e EULEX-it do të bashkëpunojnë me prokurorët publik të Kosovës që punojnë në zyra të ndryshme prokuroriale ku ata janë caktuar në pajtim me modalitetet e përcaktuara me anë të këtij ligji dhe nga Asambleja e prokurorëve të EULEX-it.

7.3. Përveç ushtrimit të funksioneve të tyre hetuese dhe prokuroriale sipas dispozitave të nenit 8 të këtij ligji, prokurorët e EULEX-it do të monitorojnë, udhëzojnë dhe këshillojnë prokurorët publik të Kosovës për sa i përket parimit të autonomisë së prokurorëve dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara me anë të këtij ligji dhe nga Asambleja e prokurorëve të EULEX-it. Roli i tyre si monitorues, monitorues dhe këshillues nuk do të jetë i kufizuar në lëndët për të cilat prokurorët e EULEX-it mund të ushtrojnë kompetencat e tyre.

7.4. Prokurorët e EULEX-it do t'i ushtrojnë funksionet e tyre në pajtim me ligjin në fuqi. Ata do të jenë nën autoritetin e veçantë të Kryeprokurorit të EULEX-it dhe nuk do t'i nënshtrohen autoritetit të asnjë institucioni kosovar.

Neni 8
Kompetencat e prokurorëve të EULEX-it në Kosovë

8.1. Prokurorët e EULEX-it do të jenë kompetent për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve që janë në kompetencë të veçantë të PSRK-ës sipas ligjit mbi themelimin e PSRK-në, dhe krimet, përfshirë këtu tentimin dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në krime, të paraqitura në të gjitha pikat e paragrafit 3 të nenit 3 të këtij ligji.

8.2. Prokurorët e EULEX-it gjithashtu do të kenë kompetencë që të hetojnë dhe ndjekin penalisht krimet procedurat e të cilave janë të ndërlidhura sipas ligjit në fuqi, me të atyre të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, dhe të krimeve tjera në përputhje me modalitetet e përcaktuara sipas neneve tjera të këtij ligji

Neni 9
Ushtrimi i kompetencave të prokurorëve të EULEX-it të caktuar në zyrat prokuroriale në Kosovë

9.1. Prokurorët e EULEX-it do të punojnë, kur është e mundur, në ekipe të përziera me prokurorët publik të Kosovës për të hetuar apo ndjekur penalisht cilindo nga krimet e paraqitura në paragrafin 3 të nenit 3 të këtij ligji.

9.2. Sipas nevojës, aspektet relevante të aktivitetit dhe bashkëpunimit të prokurorëve të EULEX-it me prokurorët publik të Kosovës që punojnë në zyrat vendore prokuroriale do të specifikohet me tutje, për aq sa është e nevojshme, me anë të një marrëveshje të veçantë ndërmjet Shefit të EULEX KOSOVË, Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Prokurorisë publike të Kosovës dhe Prokurorive të qarkut.

9.3. Kur gjykata komunale është gjykatë kompetente në shkallë të parë për cilindo nga krimet e paraqitura në paragrafin 3 të nenit 3 të këtij ligji, prokurori komunal publik i Kosovës që është caktuar në lëndë mund të kërkojë këshilla nga çdo prokuror i EULEX-it çdoherë që e sheh të arsyeshme.

9.4. Në çdo rrethanë, prokurori publik komunal i Kosovës i identifikuar sipas paragrafit 3 të këtij neni do ta njoftojë, brenda shtatëdhjetedy orëve, cilindo nga prokurorët e EULEX-it të caktuar ne rajonin e tij lidhur me përmbajtjen e njoftimit të aktvendimit të shkallës së parë (neni 392 apo 473(2) i KPPPK-së) për cilindo nga krimet e paraqitura në paragrafin 3 të nenit 3 të këtij ligji që është në juridiksion të gjykatës komunale si gjykatë në shkallë të parë.

9.5. Kryeprokurorët komunal do t'i njoftojnë Kryeprokurorët e qarkut që punojnë në zyrat kompetente për territorin brenda të cilit ata ushtrojnë veprimtarinë e tyre për hetimin apo ndjekjen aktuale penale të krimeve të paraqitura në paragrafin 3 të nenit 3 të këtij ligji që janë në kompetencë të gjykatës komunal si gjykatë e shkallës së parë. Kryeprokurorët komunal do të jenë të detyruar t'ju ofrojnë prokurorëve të EULEX-it të njëjtat informata dhe pasi që ata të kenë kërkuar t'ju japin çfarëdo informate përkatëse për lëndën.

9.6. Kryeprokurorë e qarkut do t'i njoftojnë prokurorët e EULEX-it të caktuar në zyrat e tyre prokuroriale dhe para se lënda t'i caktohet një prokurori publik të Kosovës të së njëjtës zyre, për çdo lëndë që mund të jetë paraqitur në paragrafin

3 të nenit 3 të këtij ligji apo për të cilën prokurorët e EULEX-it mund të ushtrojnë funksionet e tyre.

9.7. Në ushtrimin e funksioneve të tyre të monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit, prokurorët e EULEX-it do të kenë kompetencë që të kontrollojnë çdo lëndë të pazgjidhur apo të përfunduar si dhe të marrin kopjet e tyre dhe të kërkojnë informata lidhur me ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë.

Neni 10
Përgjegjësia e përbashkët e ekipeve të përziera dhe mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

10.1. Çdo veprim procedural apo hetues që lidhet me hetimin a ndjekjen penale të sjelljes së supozuar kriminale që mund të jetë në kompetencë të ekipeve të përziera të prokurorëve të EULEX-it dhe prokurorëve publik të Kosovës ndërmerret me pajtimin e prokurorit të EULEX-it dhe prokurorit publik të Kosovës që punojnë në të njëjtën lëndë.

10.2. Në rrethana të mosmarrëveshjeve ndërmjet prokurorit të EULEX-it dhe prokurorit publik të Kosovës që punojnë në të njëjtën lëndë për sa i përket përmbajtjes ose ndërmarrjes së ndonjë veprimi të veçantë procedural, ata do t'ia drejtojnë këtë çështje Kryeprokurorit të qarkut i cili vendos për të brenda njëzetekatër orëve. Në rrethana të mosmarrëveshjeve brenda ekipeve të përziera të PSRK-ës, Kryeprokurori i PSRK-së do të vendos lidhur me atë çështje.

10.3. Brenda njëzetekatër orëve pas njoftimit të vendimit të marrë nga Kryeprokurori i qarkut apo Kryeprokurori i PSRK-së lidhur me mosmarrëveshjen, prokurori i EULEX-it ka të drejtë që të kërkojë nga Kryeprokurori i EULEX-it dhe nga Kryeprokurori publik i Kosovës rishikimin e vendimit. Kryeprokurori i EULEX-it dhe Kryeprokurori publik i Kosovës do të gjejnë së bashku një zgjidhje sa më shpejtë që të jetë e mundur.

10.4. Në rrethana urgjente, ose kur vonesa mund të ndikojë në kryerjen apo rezultatin e hetimit, ndjekjes penale apo zhvillimi të drejtë të procedurës, Kryeprokurori i EULEX-it do të ketë të drejtë që të ndërmarrë çfarëdo veprimi urgjent procedural, apo të caktojë cilindo prokuror të EULEX-it apo prokuror publik të Kosovës për një qëllim të tillë.

Neni 11
Kompetencat e prokurorëve të EULEX-it për krimet e motivuara nga urrejtja

11.1. Në çdo kohë gjatë procedurës dhe në pajtim me Kryeprokurorin e EULEX-it, prokurorët e EULEX-it mund të marrin përgjegjësi për çdo hetim a ndjekje penale të çdo vepre penale, përfshirë këtu veprat penale kundër personave apo pronës, ku viktima, prona apo objekti i veprës penale duken të jenë përzgjedhur për shkak të lidhjes, bashkimit, afërsisë, mbështetjes apo anëtarësisë së tyre të vërtetë apo të perceptuar me një grup të vërtetë apo të perceptuar të identifikuar sipas racës, origjinës kombëtare, etnike apo shoqërore, afërsisë me ndonjë minoritet kombëtar apo grup politik, gjuhës, ngjyrës, besimit, gjinisë, moshës, të metave fizike apo mentale, orientimit seksual, apo faktorëve tjerë të ngjashëm.

11.2. Për qëllimet e paragrafit 1 të këtij neni, prokurori i EULEX-it ia paraqet një kërkesë Kryeprokurorit të zyrës që është kompetente për hetimin a ndjekjen e rastit.
11.3. Kryeprokurori përkatës do t'ia përcjell lëndën prokurorit të EULEX-it të caktuar nga Kryeprokurori i EULEX-it brenda njëzetekatër orëve.

Neni 12
Kompetencat e prokurorëve të EULEX-it në rast të mosgatishmërisë apo paaftësisë të prokurorëve publik të Kosovës

12.1. Në çdo fazë të çdo procedure penale, nëse një prokuror publik i Kosovës nuk është i gatshëm apo është i paaftë që të ushtrojë detyrat e tij dhe kjo mosgatishmëri apo paaftësi mund të rrezikojë hetimin apo ndjekjen e duhur të një vepre penale, apo kurdoherë që ekziston dyshimi i bazuar se bëhen përpjekje për të ndikuar në hetimin apo ndjekjen e një vepre penale, Kryeprokurori i EULEX-it ka kompetencë që të kërkojë nga Kryeprokurori i zyrës kompetente që atë lëndë t'ia caktojë:
12.2. një prokurori tjetër publik të Kosovës që punon në të njëjtën zyre prokuroriale,
12.3. apo cilitdo prokuror të EULEX-it që do të marrë përgjegjësinë për hetimin apo ndjekjen penale përkatëse.
12.4. Nëse Kryeprokurori i zyrës kompetente kundërshton kërkesën e Kryeprokurorit të EULEX-it, Kryeprokurori i EULEX-it do ta njoftojë Kryeprokurorin publik të Kosovës dhe së bashku do të marrin një vendim të përbashkët i cili do të respektohet nga Kryeprokurori i zyrës kompetente.
12.5. Në rrethana urgjente, ose kur vonesa mund të ndikojë në kryerjen apo rezultatin e hetimit, ndjekjes penale apo zhvillimit të drejtë të procedurës, Kryeprokurori i EULEX-it do të ketë të drejtë që të ndërmarrë çdo veprimi urgjent procedural, apo të caktojë cilindo prokuror të EULEX-it apo prokuror publik të Kosovës për një qëllim të tillë.

Neni 13
Ndryshimi i vendit për procedurat penale dhe civile

13.1. Nëse është e nevojshme për arsye të sigurisë, Shefi i Komponentit të Drejtësisë, pas propozimit të Kryeprokurorit të EULEX-it apo të Kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, do të ketë kompetencë të ndryshojë vendin e gjykimit apo të një faze të veçantë të një procedure penale apo civile kurdoherë që një gjykatës i misionit të EULEX-it apo një prokuror i misionit të EULEX-it është përfshirë. Shefi i Komponentit të Drejtësisë do të marrë vendim të bazuar dhe do t'ia dërgojë atë kryetarit të gjykatës që përndryshe edhe është kompetente të vendos për lënën.
13.2. Veprat penale që supozohet të jenë kryer nga anëtarët e gjyqësorit vendor apo nga të punësuarit e gjykatave të ndryshme në Kosovë do të hetohen, ndiqen dhe gjykohen nga një zyre prokuroriale dhe nga një gjykatë që ushtron kompetenca dhe juridiksion në një rajon të ndryshëm nga ai ku gjyqtari, prokurori apo i punësuari ushtrojnë zakonisht funksionet e tyre. Një sistem rotacioni do të

caktojë zyrën prokuroriale dhe gjykatën që ka kompetencë territoriale sipas kritereve të mëposhtme:

a) nëse krimi i supozuar ka ndodhur në regjionin e Pejës apo të Mitrovicës, zyra prokuroriale dhe gjykata kompetente do të identifikohen në prokurorinë e qarkut apo në atë komunale ose në gjykatën e qarkut apo në gjykatën komunale të Prishtinës;
b) nëse krimi i supozuar ka ndodhur në regjionin e Prishtinës apo të Gjilanit, zyra prokuroriale dhe gjykata kompetente do të identifikohen në prokurorinë e qarkut apo në atë komunale ose në gjykatën e qarkut apo në gjykatën komunale të Prizrenit;
c) nëse krimi i supozuar ka ndodhur në regjionin e Prizrenit, zyra prokuroriale dhe gjykata kompetente do të identifikohen në prokurorinë e qarkut apo në atë komunale ose në gjykatën e qarkut ose në gjykatën komunale të Gjilanit.

13.3. Në rast të riorganizimit substancial të sistemi të gjykatave apo të prokurorive pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Shefi i Komponentit të Drejtësisë, ose Këshilli Gjyqësor i Kosovës sipas kërkesës së Shefit të Komponentit të Drejtësisë, ose Këshillit Gjyqësor të Kosovës pa ndonjë kërkesë por pas mbarimit të mandatit të EULEX KOSOVË, do të ketë kompetencë që të përcaktojë një sistem të ri rotacioni për lëndët e përshkruara në paragrafin 2 të këtij neni.

13.4. Çdoherë që një vepër e supozuar penale është kryer nga një gjykatës, prokuror apo një i punësuar në një gjykatë të veçantë, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe autoritetet publike do të jenë të detyruara që t'ia paraqesin zyrës së prokurorit të identifikuar sipas sistemit të lartpërmendur të rotacionit një raport përkatës penal, njoftimin për krimin dhe informatat që kanë të bëjnë me zhvillimet e hetimeve.

13.5. Në çdo fazë të procedurës, në rast të shkelje së saj, Kryeprokurori i EULEX-it apo Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do të kenë kompetencë t'ia kalojë lëndën zyrës prokuroriale përkatësisht gjykatës kompetente në përputhje me sistemin e lartpërmendur të rotacionit.

13.6. Kompetenca e përmendur në paragrafin 5 të këtij neni, do të ushtrohet në atë mënyrë që të shmang vonesat e tepruara të procedurës dhe pengimin e procesit gjyqësor.

KREU IV
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 14

14.1. Ky ligj mund të shfuqizohet apo ndryshohet në përputhje me procedurat e përcaktuara sipas ligjit në fuqi por vetëm në konsultim me Shefin e EULEX KOSOVË i cili do të kërkojë këshillën e Shefit të Komponentit të Drejtësisë.

14.2. Për qëllimet e paragrafit 1 të këtij neni, autoritetet e Kosovës do të bëjnë konsultime me Shefin e EULEX KOSOVË më qëllim të vlerësimit të nevojës së shfuqizimit, përmirësimit dhe ndryshimit të këtij ligji.

Neni 15

15.1. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Departamenti i Drejtësisë i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) do t'ia dorëzojë Kryeprokurorit të EULEX-it dhe Kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, në pajtim me modalitetet dhe procedurat e përcaktuar nga UNMIK-u dhe Bashkimi Evropian, të gjitha dosjet, informatat, arkivat dhe të dhënat në formë elektronikë dhe të shtypur lidhur me lëndët që aktualisht hetohen, ndiqen ose janë hequr nga procedura nga prokurorët ndërkombëtar të UNMIK-ut dhe nga ZPSK-ja, si dhe lëndët që janë apo kanë qen në kompetencë të gjyqtarëve ndërkombëtar të UNMIK-ut.

15.2. Kryeprokurori i EULEX-it dhe Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do të vendosin në pajtim me këtë ligj se cilat nga lëndët e dorëzuara sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të jenë në kompetencë të gjyqtarëve përkatësisht prokurorëve të misionit të EULEX-it, dhe cilat lëndë tjera, për arsye të bazuara, do të duhet të mbesin në kompetencë të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it pasi që ato të kenë qen në kompetencë të gjyqtarëve ndërkombëtar të UNMIK-ut apo prokurorëve ndërkombëtar të UNMIK-ut.

15.3. Për lëndët e dorëzuara sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe të cilat gjenden në fazën e gjykimit kryesor në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përbërja e kolegjeve në procedurë penale mund të mbetet e pandryshuar për procedurë të mëtutjeshme nëse anëtarët e njëjtë të kolegjit vazhdojnë funksionet e tyre si gjyqtarë të EULEX-it pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Në rrethana të tilla Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do të caktojë gjyqtarin e mëparshëm dhe përkatës ndërkombëtar të UNMIK-ut si gjyqtar të EULEX-it për të njëjtën procedurë.

15.4. Në rrethana të nevojës për të rifilluar gjykimin kryesor për arsye procedurale apo arsye tjera, Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do të caktojë një kolegj të ri në pajtim me këtë ligj.

15.5. Për lëndët e dorëzuara në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni dhe të cilat janë në juridiksion të Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, përbërja e kolegjeve mund të mbetet e pandryshuar për procedurë të mëtutjeshme nëse anëtarët e njëjtë të kolegjit vazhdojnë funksionet e tyre si gjyqtarë të EULEX-it pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Gjyqtari i mëparshëm dhe përkatës ndërkombëtar i UNMIK-ut do të caktohet si gjyqtar i EULEX-it për të njëjtën procedurë në pajtim me ligjin në fuqi.

15.6. Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it në konsultim me Kryetarin e Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me çështjet që kanë të bëjnë Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit mund ta caktojë një gjyqtar të EULEX-it në fazën e veçantë të procedurës që më herët i është caktuar një gjyqtari ndërkombëtar të UNMIK-ut, apo të caktojë një gjyqtar të EULEX-it në një kolegj të veçantë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me kusht që fillimi i një procedure të re me anëtarë të ri të kolegjit të mos jetë e detyrueshme sipas ligjit në fuqi.

15.7. Nëse një dispozitë e ligjit në fuqi para ditës së tranzicionit, parasheh që Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës apo ndonjë gjyqtar tjetër kosovar ka të drejtë që

të caktojë një gjyqtar ndërkombëtar në procedurë, kjo kompetencë do të bartet tek Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it që nga dita e tranzicionit.

Neni 16

Gjatë kohëzgjatjes së EULEX KOSOVË në Kosovë, gjuhë zyrtare të gjykatave të Kosovës, përveç gjuhës shqipe dhe serbe si dhe gjuhës turke në rajonet ku gjendet komunitetit turk, do të jetë edhe gjuha angleze në ato procedura ku janë të përfshirë gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it.

Neni 17

17.1. Gjatë kohëzgjatjes së EULEX KOSOVË në Kosovë, policia e EULEX-it do të ketë kompetencë që të ushtrojë autorizimet e veta ashtu siç njihen me anë të ligjit në fuqi për policinë e Kosovës dhe në përputhje me modalitetet e përcaktuara nga Shefi i EULEX KOSOVË.

17.2. Gjatë kohëzgjatjes së EULEX KOSOVË në Kosovë, policia e EULEX-it do të ketë kompetencë që të ushtrojë funksionet e policisë gjyqësore në përputhje me ligjin dhe modalitetet e përcaktuara nga Shefi i EULEX KOSOVË.

17.3. Gjatë kohëzgjatjes së EULEX KOSOVË në Kosovë, zyrtarët korrektues të EULEX-it do t'i ushtrojnë kompetencat dhe funksionet e tyre si personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës, duke përfshirë ato kompetenca dhe funksione që vlejnë për zyrtarëve korrektues të Kosovës në përputhje me ligjin në fuqi dhe me modalitetet e përcaktuara nga Shefi i EULEX KOSOVË.

17.4. Sipas nevojës, aspektet relevante të aktiviteteve dhe bashkëpunimit të policisë së EULEX-it me policinë e Kosovës dhe të zyrtarëve korrektues të EULEX-it me personelin e Shërbimit Korrektues të Kosovës mund të përcaktohen më tutje, për aq sa është e nevojshme, me anë të një Marrëveshje ndërmjet Shefit të EULEX KOSOVË dhe autoriteteve kompetente. Kjo marrëveshje do të pasqyrojë përmbajtjen dhe modalitetet e përcaktuara nga Shefi i EULEX KOSOVË.

Neni 18

18.1. Në rast të riorganizimit substancial të sistemit të gjykatave apo të zyrave prokuroriale pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Kryeprokurori i zyrës që ka kompetencë për lëndën sipas legjislacionit të ri do të jetë organ kompetent që të ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë që i janë caktuar Kryeprokurorit të qarkut apo Kryeprokurorit komunal me anë të këtij ligji.

18.2. Në mënyrë të ngjashme, të gjitha referimet që i bëhen në këtë ligj zyrave prokuroriale komunale apo të qarkut, gjykatave komunale apo të qarkut, prokurorisë publike komunale të Kosovës apo prokurorisë publike të qarkut të Kosovës do të interpretohen në përputhje me strukturën e re te sistemit të gjykatave apo zyrave prokuroriale.

18.3. Autoritetet kompetente do të jenë të obliguara që të ndryshojë këtë ligj në përputhje me strukturën e re të gjykatave apo zyrave prokuroriale me qëllim që t'ia mundësojë EULEX KOSOVË të ushtrojë kompetencat dhe funksionet e veta siç duhet.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës
Me datën: 13.03.2008

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III / Nr. 27 / 03 QERSHOR 2008

LIGJI Nr. 03/L-223
PËR KËSHILLIN GJYQËSOR TË KOSOVËS

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat themelore 872
Kreu II: Kompetencat, përgjegjësite dhe përbërja e këshillit 873
Kreu III: Rekrutimi, emërimi dhe caktimi i gjyqtarëve 879
Kreu IV: Vlerësimi, ngritja në detyrë dhe transferimi i gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë 881
Kreu V: Administrimi i gjykatave 882
Kreu VI: Procedurat disiplinore 887
Kreu VII: Zyra e prokurorit disiplinor 890
Kreu VIII: Trajnimi gjyqësor 893
Kreu IX: Dispozitat përfundimtare 894

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR KËSHILLIN GJYQËSOR TË KOSOVËS

KREU I
DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1
Qëllimi dhe fushëveprimi i ligjit

Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) duke përfshirë procedurat për rekrutim, emërime, riemërime, transferime, disiplinë, vlerësim, ngritje në detyrë dhe trajnim të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë; për menaxhimin dhe administrimin e gjykatave, për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të gjyqësorit; dhe themelimin e gjykatave dhe degëve të reja.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **Kushtetuta** – Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
   1.2. **Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit** - Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës së 26 mars 2007.
   1.3. **Këshilli** - Këshilli Gjyqësor i Kosovës si një institucion i pavarur përgjegjës për administrimin e gjykatave siç ceket me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me këtë ligj.

1.4. **Ditë** - ditët kalendarike.
1.5. **Gjyqësori** - gjyqtarët dhe gjyqtarët porotë.
1.6. **Kryesues** – personi i zgjedhur nga anëtarësia e Këshillit Gjyqësor të Kosovës sipas Kushtetutës si kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe i cili shërben si zyrtar kryesor administrative i gjyqësorit të Kosovës.
1.7. **Presidenti** – Presidenti i Republikës së Kosovës.
1.8. **Sekretariati -** njësinë e themeluar brenda Këshillit Gjyqësor më qëllim të ofrimit të mbështetjes administrative për Këshillin dhe gjykatat.
1.9. **Drejtor i Sekretariatit** - kreun e Sekretariatit.
1.10. **Instituti** - Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK).
1.11. **Këshilli i Përkohshëm** - Këshilli i themeluar me anë të ligjit mbi Përbërjen e Përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, 2008/03-L-123.
1.12. **Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK)** – trupi i themeluar sipas nenit 110 të Kushtetutës dhe të rregulluar me Ligjin mbi Këshillin Prokurorial të Kosovës të Republikës së Kosovës.

KREU II
KOMPETENCAT, PËRGJEGJËSITE DHE PËRBËRJA E KËSHILLIT

Neni 3
Pavarësia e Këshillit

Këshilli është plotësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të veta me qëllim të sigurimit të një sistemi të drejtësisë të pavarur, të drejtë, apolitik, të qasshëm, profesional dhe të paanshëm i cili pasqyron natyrën shumë etnike të Republikës së Kosovës dhe zbaton Kushtetutën si dhe parimet e pranuara ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore.

Neni 4
Kompetencat dhe përgjegjësitë

1. Përgjegjësitë e Këshillit përfshijnë, por nuk kufizohen, në:
   1.1. sigurimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së sistemit gjyqësor;
   1.2. rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërimin dhe riemërimin e gjyqtarëve, përfshirë kandidatët nga komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë;
   1.3. në mënyrë që të sigurohet se gjykatat pasqyrojnë përbërjen etnike të zonës së tyre të juridiksionit në përputhje me nenin 104(3) të Kushtetutës dhe Shtojcën IV, neni 2.2 të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit, Këshilli do të ketë në konsiderim plotësimin e vendeve të lira të punës apo të ulëseve të rezervuara për anëtarët e komuniteteve të cilët nuk janë shumicë në Kosovë;
   1.4. propozimin te Presidenti për emërimin, riemërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin;
   1.5. shpalljen e rregulloreve mbi transferimin dhe procedurën disiplinore për gjyqtarë;

1.6. propozimin tek Presidenti për Emërimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës;
1.7. propozimin për emërimin e kryetarit të Gjykatës së Apelit, të kryetarëve të Gjykatave Themelore dhe emërimin e gjyqtareve mbikëqyrës në përputhje me ligjin për gjykatat;
1.8. organizimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të duhur të gjykatave;
1.9. sigurimin e vlerësimeve të rregullta periodike mbi ngarkesën e lëndëve të gjykatave ashtu që të sigurohet funksionimi efikas i gjykatave;
1.10. mbikëqyrjen e inspektimit gjyqësor, administrimit gjyqësor dhe nxjerrjen e rregulloreve të brendshme për gjykatat në përputhje me ligjit ekzistues;
1.11. përgatitjen, dërgimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të gjyqësorit për të sigurua funksionimin efikas të gjykatës dhe llogaritjen e përdorimit të burimeve fiskale;
1.12. shpalljen e konkursit publik Për gjyqtarë dhe gjyqtarë porotë;
1.13. përcaktimin e numrit të Gjyqtarëve në secilën gjykatë dhe degë dhe mbikëqyrjen e administratorëve të gjykatave;
1.14. rekomandimin tek Kuvendi për themelimin e gjykatave të reja dhe degëve të reja;
1.15. administrimin e gjyqësorit dhe personelit të tij si dhe nxjerrjen e rregulloreve dhe akteve nën-ligjore në përputhje me kompetencat e veta;
1.16. shpalljen e Kodit të Etikës Profesionale për anëtarët Këshillit, shkelja e të cilës është bazë për sanksione, përfshirë shkarkimin nga Këshilli;
1.17. shpallen e kodit të etikës profesionale për gjyqtarë dhe gjyqtarë porotë, shkelja e së cilës paraqet bazën për sanksione, përfshirë shkarkimin nga zyra;
1.18. shpalljen e kodit të etikës për punonjësit mbështetës të gjykatës, shkelja e të cilit paraqet bazë për sanksione, përfshirë shkarkimin nga puna;
1.19. në bashkëpunim me Institutin organizon provimin përgatitor për kualifikimet e kandidatëve për gjyqtarë;
1.20. përcaktimin e politikave, standardeve dhe udhëzimeve lidhur me trajnimin e gjyqtarëve, gjyqtarëve porotë dhe personelit tjetër gjyqësorë dhe mbikëqyrjen e zbatimit të trajnimit profesional të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë nga Instituti dhe nga shoqatat dhe organizatat e tjera trajnuese;
1.21. sigurimin e informacioneve dhe të dhënave statistikore mbi sistemin gjyqësor;
1.22. bashkëpunimin me individë dhe organizata përgjegjëse për monitorim të pavarur të sistemit të drejtësisë;
1.23. shpalljen e akteve nën-ligjore në përputhje me ligjet për Informimin publik që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe zbulimin e informacionit që ruhet nga gjyqësori i Kosovës;
1.24. miratimin e rregullave të punës për funksionimin e Këshillit dhe Komisioneve të tij, si dhe për zgjedhjen e atyre anëtarëve gjyqësore të përzgjedhur nga kolegët e tyre, rregulla të cilat do të jenë në dispozicion publik;
1.25. raportimin tek Kuvendi i Kosovës, Presidenti dhe publiku mbi punën e Këshillit dhe të gjyqësorit në përgjithësi;
1.26. përgatitja e raportit vjetor mbi veprimtaritë e gjykatave dhe shpenzimet e Këshillit;

1.27. shpallja e një skeme uniforme të taksave gjyqësore të zbatueshme në mbarë Republikën e Kosovës.

Neni 5
Përbërja dhe përzgjedhja e anëtarëve të Këshillit

1. Këshilli përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë siç ceket në Kushtetutë duke pasur kualifikimet dhe ekspertizën e nevojshme profesionale.
2. Pesë (5) anëtarët gjyqësorë të Këshillit të zgjedhur sipas nenit 65(10) dhe nenit 108.6 (1) të Kushtetutës janë si në vijim:
   2.1. dy (2) gjyqtarë të Gjykatës Supreme, të zgjedhur nga gjyqtarët e Gjykatës Supreme;
   2.2. një (1) gjyqtar i Gjykatës së Apelit, i zgjedhur nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit; dhe
   2.3. dy (2) gjyqtarë të Gjykatave Themelore,të zgjedhur nga gjyqtarët e Gjykatës Themelore.
3. Anëtarët e tjerë të Këshillit zgjedhën në përputhje me nenin 65 dhe nenin 108.6, pika 2,3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
4. Anëtarë të Këshillit mund të jenë edhe personat që nuk janë gjyqtarë ose prokurorë, por që janë juristë të jashtëm, profesorë të universitetit ose profesionistë me përvojë relevante, së paku prej dhjetë (10) vjetësh dhe të cilët kanë njohuri për gjyqësorin e Kosovës. Profesionistët mund të emërohen edhe jashtë fushës juridike dhe mund të përfshijnë persona me ekspertizë në menaxhment, financa, teknologji informative ose shkenca sociale.

Neni 6
Kryesuesi dhe zëvendës-kryesuesi i Këshillit

1. Kryesuesi dhe Zëvendës- kryesuesi zgjidhën nga anëtarët e Këshillit siç ceket në Nenin 108(7) të Kushtetutës. Zgjedhja si Kryesues dhe Zëvendës-kryesues nuk zgjat mandatin e një anëtari të Këshillit.
2. Kryesuesi i Këshillit shërben si anëtar i Këshillit me kohë të plotë. Nëse Kryesuesi është Gjyqtar, ai nuk do të humbasë statusin e tij apo saj si gjyqtar dhe ka të drejtë t'i kthehet shërbimit si gjyqtar i gjykatës në të cilën është caktuar me përfundimin e mandatit. Kryesuesi ka këto autorizime:
   2.1. kryeson të gjitha takime e Këshillit;
   2.2. miraton përgatitjen e të gjithë rendeve të ditës dhe pikave që do t'i dërgohen Këshillit për konsiderim dhe vendim;
   2.3. përfaqëson Këshillin para publikut, agjencive qeveritare dhe organeve të tjera publike;
   2.4. mbikëqyr dhe menaxhon punën e Këshillit dhe komisioneve të tij;
3. I propozon Ministrisë së Financave dhe Kuvendit të Kosovës buxhetin e propozuar të Këshillit për shpenzimet e veprimeve dhe të personelit të Këshillit dhe të gjykatave;
4. Paraqitet, së paku një herë në vit, para Kuvendit të Kosovës dhe raporton mbi performansën, veprimet, shpenzimet dhe nevojat e gjyqësorit të Kosovës;

5. Me pëlqimin e Këshillit, cakton anëtarët e komisioneve të përhershme siç ceket me këtë ligj, dhe ndërmerr detyra të tjera sipas udhëzimit të Këshillit.
6. Zëvendës-kryesuesi plotëson përgjegjësitë dhe detyrat e Kryesuesit kur ai apo ajo mungon. Zëvendës-kryesuesi ka autoritet të plotë për të vepruar në emër të Këshillit në rast të mungesës apo paaftësisë së Kryesuesit.
7. Gjatë mandatit të tyre, Kryesuesi dhe Nën-kryesuesi pranojnë kompensimin si më poshtë:
   7.1. kryesuesi pranon rrogë si ajo e Kryetarit të Gjykatës Supreme.
   7.2. nën-kryesuesi pranon rrogë si ajo e Kryetarit të Gjykatës së Apelit.
8. Gjatë mandatit të tyre Kryesuesi dhe Zëvendës-kryesuesi pranojnë vetëm pagën e parashtruar në këtë nen, përveç për rimbursime të shpenzimeve të arsyeshme dhe të nevojshme që ndërlidhet me ushtrimin e detyrave të tyre dhe nuk do të pranojë kompensim shtesë nga cilido burim tjetër për detyrat apo punësimin tjetër. Nëse Kryesuesi apo Zëvendës-kryesuesi është gjyqtar, me skadimin e shërbimit të tyre do të pranojnë kompensimin që lidhet me pozitën fillestare gjyqësore në të cilën këta do të kthehen.

Neni 7
Mandati i anëtarëve të Këshillit

Përveç siç parashtrohet në nenin 151 të Kushtetutës dhe Planit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit, Shtojca IV, neni 4.2, anëtarët e Këshillit zgjidhen me një mandate pesë (5) vjeçar, siç ceket në nenin 108(6) të Kushtetutës dhe këtij ligji. Anëtari mund të zgjidhet për një mandat shtesë jo vijues pesë (5) vjeçar.

Neni 8
Përfundimi i mandatit

1. Mandati i një anëtari të Këshillit përfundon me:
   1.1. vdekje;
   1.2. humbje e zotësisë për veprim për më shumë se tre (3) muaj për shkaqe mjekësore të vërtetuara;
   1.3. me dështimin e vazhduar për të marrë pjesë në veprimtaritë e Këshillit për më gjatë se tre (3) muaj, nëse emërimi bazohet në një status të caktuar, me pushimin e statusit mbi të cilin bazohet emërimi;
   1.4. me dorëheqje duke i ofruar Këshillit njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditësh.
2. Kur dënohet nga gjykata për vepër penale, me përjashtim të veprës së kundërvajtjes siç përkufizohet me ligj.
3. Përveç siç parashtrohet në nenin 151, vendi i lirë i punës në Këshill plotësohet në mënyrën e parashtruar në nenin 108 të Kushtetutës dhe sipas këtij ligji. Nëse në Këshill lirohet një vend i punës para përfundimit të mandatit, kjo pozitë e lirë plotësohet sipas kritereve që gjenden në nenin 108 të Kushtetutës dhe sipas këtij ligji. Personi që përzgjidhet të plotësojnë një vend të lirë punë në Këshill do të emërohet për një mandate të plotë pesë (5) vjeçar.

Neni 9
Komisionet e Këshillit

1. Këshilli ka komisionet e veta të përhershme si në vijim:
   1.1. Komisioni për Çështje Normative;
   1.2. Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel;
   1.3. Komisioni për Administrimin e Gjykatave;
   1.4. Komisioni Disiplinor.
2. Këshilli mund të themelojë edhe komisione të tjera të përkohshme ose të përhershme, sipas nevojës.

Neni 10
Pavarësia dhe paanshmëria e anëtarëve të Këshillit

Anëtarët e Këshillit ushtrojnë detyrat e tyre në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.

Neni 11
Mospërputhshmëria mbi anëtarësinë

1. Brenda kuptimit të nenit 108 (5) dhe (6) të Kushtetutës, anëtarësia në Këshill është në mospërputhje kur:
   1.1. një (1) gjyqtar apo prokuror nuk është emëruar në detyrë;
   1.2. personi i cili është dënuar për vepër penale, më përjashtim të kundërvajtjes, siç përkufizohet me ligj;
   1.3. është anëtar në Qeverinë e Republikës së Kosovës apo cilido kryetar komune; anëtar në Kuvendin e Republikës së Kosovës apo në cilindo kuvend komunal;
   1.4. personi që ushtron funksionin apo kryen çfarëdo detyre në cilëndo parti politike apo cilëndo shoqatë apo fondacion të lidhur me ndonjë parti politike; ose
   1.5. personi që punon për administratën, përfshirë personat që kryejnë detyra në Qeverinë e Republikës së Kosovës apo në organet administrative apo nën-administrative të themeluara me Kushtetutë apo të krijuara përmes legjislacionit.
   1.6. një (1) anëtar i zgjedhur i Këshillit shkarkohet nga Këshilli nëse ky nuk jep dorëheqje nga një pozitë që është në mospërputhje para emërimit si anëtar i Këshillit.

Neni 12
Imuniteti i anëtarëve të Këshillit

1. Anëtarët e Këshillit gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile apo shkarkimi për veprimet e marrura, vendimet e marrura apo për shprehjen e mendimeve që janë brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si anëtar të Këshillit.
2. Anëtarët e Këshillit nuk gëzojnë imunitet sipas paragrafit 1. të këtij neni dhe mund të shkarkohen nga zyra nëse këta kanë kryer shkelje me dashje të ligjit.
3. Kryesuesi i Këshillit duhet të njoftohet sa më parë në rast kur ndaj një anëtari të Këshillit ngitet aktakuzë apo kur ky arrestohet.

Neni 13
Procedurat disiplinore për anëtarët e Këshillit

1. Këshilli përcakton rregullat për zbatimin e procedurës disiplinore ndaj anëtarëve të vet duke përfshirë procedurat që rregullojnë hetimin, pezullimin ose rekomandimin për shkarkim të cilit do anëtar të Këshillit.
2. Një (1) komision i përbërë nga tre (3) anëtarë i themeluar nga kryesuesi vendos për masat disiplinore dhe për sanksione, përfshirë pezullimin dhe shkarkimin e cilit do anëtar të Këshillit.
3. Një (1) anëtar i cili është pezulluar nga komisionin gëzon të drejtën e ankesës para këshillit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga vendimi për pezullim.
4. Me rekomandimin e komisionit, një anëtar i Këshillit mund të shkarkohet me anë të dy të tretave (2/3) të votave të anëtarëve të Këshillit.
5. Një (1) anëtar i Këshillit i cili është shkarkuar gëzon të drejtën të ankohet kundër vendimit drejtpërsëdrejti në Gjykatën Supreme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga vendimi për shkarkim.

Neni 14
Natyra publike e takimeve dhe selia e Këshillit

1. Të gjitha takimet e Këshillit janë të hapura për publikun. Rendi i ditës së Këshillit do të jetë publikisht i hapur së paku njëzet e katër (24) orë para takimit. Këshilli mund të vendos të mbajë takim të mbyllur për publikun me shumicën e votave të anëtarëve për çështjet si në vijim:
   1.1. një sekret shtetëror zyrtar zbulimi i të cilit do të ishte shkelje e ligjit;
   1.2. çështje e personelit që kanë të bëjnë me gjyqtarë apo punonjës të gjyqësorit, përpos takimit të Këshillit ku merret një vendim përfundimtar disiplinor kundër një gjyqtari;
   1.3. informacioni jo publik apo zbulimi i të dhënave që do të rrezikonin jetën apo sigurinë e cilitdo person;
   1.4. një hetim në vazhdim për sjellje të pahijshme apo veprimtari kriminale zbulimi i së cilës në masë të arsyeshme do të rrezikonte objektivitetin dhe efikasitetin e hetimit;
   1.5. vlerësimi i performansës se gjyqtarëve dhe nëpunësve administrative siç ceket në nenin 19 të këtij ligji;
   1.6. informacioni pronësor zbulimi i së cilës mund të paragjykonte interesat e cilësdo palë që konkurron për një tender qeveritar
   1.7. informacione, të dhëna, procese apo kode kompjuterike të biznesit pronësor të cilat janë konfidenciale sipas marrëveshjes kontraktuese apo marrëveshjes për mos zbulim ndërmjet tregtarit dhe Këshillit; dhe
   1.8. cilido informacion tjetër zbulimi i të cilit do të përbënte shkelje të ligjit.
2. Për çdo takim të mbyllur nga Këshilli, Kryesuesi do të deklarojë për shënimet zyrtare arsyen apo arsyet e përgjithshme për takimin e mbyllur dhe do të regjistrojë votën e anëtarëve të pranishëm të Këshillit. Pasi që Këshilli ka mbyllur takimin asnjë anëtar i Këshillit apo asnjë person pjesëmarrës në takim nuk diskuton mbi natyrën, përmbajtjen apo rezultatin e takimit përpos nëse me ligj është paraparë ndryshe.

3. Këshilli mund të thërrasë takim urgjent për të adresuar çështjet që lidhen me sigurinë e godinave ose personelit të gjykatës apo kur rrethana të veçanta kërkojnë veprim të menjëhershëm. Këshilli mund të mblidhet për seancë urgjente me thirrjen e Kryesuesit, apo nëse ky mungon, më thirrjen e Zëvendës kryesuesit. Obligimi për njoftim prej dyzetetetë (48) orësh i cekur në paragrafin e parë të këtij Neni hiqet kur bëhet fjalë për seancat emergjente të Këshillit. Brenda njëzetekatër (24) orësh pas përfundimit të seancës emergjente Kryesuesi i zbulon publikut natyrën e emergjencës si dhe pikat e diskutuara në takim, përveç nëse zbulimi përjashtohet me paragrafin 1. të këtij neni.
4. Kuorumi i Këshillit formohet me nëntë (9) anëtarë, dhe vendimet e Këshillit merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm, përveç nëse ligji parasheh ndryshe.
5. Selia e Këshillit është në Prishtinë.

Neni 15
Propozimi i buxhetit vjetor

1. Në konsultim me Kryetarët e Gjykatave, Këshilli propozon buxhetin vjetor operues të Këshillit dhe të gjykatave. Këshilli i dërgon buxhetin drejtpërsëdrejti qeverisë siç ceket me ligj. Nëse ministri i Ekonomisë dhe Financave dërgon një buxhet për Këshillit dhe gjykatat i cili ndryshon nga ai që është propozuar nga Këshilli, ministri i Ekonomisë dhe Financave po ashtu do t'i dërgojë për konsiderim Kuvendit të Kosovës buxhetin e rekomanduar në fillim nga Këshilli dhe çfarëdo komenti mbi këtë.
2. Këshilli menaxhon buxhetin vjetor për Këshillin dhe gjykatat në mënyrë të pavarur dhe mban përgjegjësi për mbikëqyrjen e shpenzimeve, alokimit të fondeve dhe mirëmbajtjen e llogarive të sakta dhe aktuale dhe kryerjen e auditimeve financiare.

KREU III
REKRUTIMI, EMËRIMI DHE CAKTIMI I GJYQTARËVE

Neni 16
Rekrutimi i Gjyqtarëve dhe Gjyqtarëve Porotë

1. Këshilli, përmes një njoftimi publik fton të gjithë profesionistët e kualifikuar ligjorë që të aplikojnë për kandidatë për emërime gjyqësore dhe cilindo person të kualifikuar që të aplikojë për kandidat për emërime për gjyqtarë porotë.
2. Këshilli zhvillon dhe zbaton procedurat për rekurutimin dhe emërimin e kandidatëve për t'u emëruar si gjyqtarë dhe gjyqtarë porotë të cilat janë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e zbatueshme.
3. Në përputhje me nenin 104(3) të Kushtetutës dhe Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit, Shtojca IV, neni 2.2, Këshilli zbaton fushata dhe masa të tjera të qëllimshme rekrutimi që cilat i konsideron si të nevojshme dhe të përshtatshme për të siguruar se një gjykatë apo degë e gjykatës pasqyron përbërjen etnike në zonën e tyre të juridiksionit.

Neni 17
Propozimi për emërim dhe riemërim

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ndërmerr masa të atilla të nevojshme për të rritur numrin e gjyqtarëve që nuk janë shumicë në Kosovë nga radha e gjyqtarëve që shërbejnë në Kosovë apo në cilëndo pjesë të saj. Për të përmbushur përgjegjësitë e veta, Këshilli, *ndër të tjera*, nga radha e aplikueseve me kualifikime të barabarta për shërbimin e gjyqtarit, do të ketë preferencë ndaj anëtarëve nga komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë siç parashtrohet në nenin 108 të Kushtetutës dhe në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit, Shtojca IV, neni 2.
2. Me përfundimin e secilit regjistrim popullsie së paku çdo pesë (5) vjet, Këshilli studion përbërjen etnike të Gjykatave Themelore dhe kërkon nga Kuvendi fond të atillë që është i nevojshëm për të rritur numrin e gjyqtarëve nga radha e komuniteteve të nuk janë shumicë në Kosovë për të siguruar se gjykatat pasqyrojnë përbërjen etnike në zonën e tyre të juridiksionit.
3. Para dërgimit të një propozimi për emërimin ose riemërimin e një gjyqtari, Këshilli do të ketë në konsiderim opinionin e gjykatës përkatëse, në të cilën propozohet kandidati.
4. Këshilli, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin, i dërgon Presidentit të Republikës së Kosovës me shkrim propozimet e kandidatëve për t'u emëruar gjyqtarë dhe gjyqtarë porotë. Me rastin e emërimit të një kandidati për emërim apo riemërim, Këshilli, në mes tjerash do të marrë parasysh kriteret në vijim:
   4.1. njohurinë profesionale, përvojën e punës dhe performansën, përfshirë të njohurit dhe respektimin e të drejtave të njeriut;
   4.2. kapacitetin për arsyetime ligjore siç të jetë dëshmuar përmes veprimtarive profesionale në fushën e drejtësisë, përfshirë këtu si gjyqtar, prokuror apo avokat, punë akademike apo veprimtari tjetër profesionale;
   4.3. aftësinë profesionale bazuar në rezultat a karrierës së mëparshme, përfshirë pjesëmarrjen në forma të organizuara të trajnimit ku është vlerësuar performansa;
   4.4. aftësinë dhe kapacitetin në analizimin e problemeve ligjore;
   4.5. aftësinë për të kryer detyrat e zyrës në mënyrë të paanshme, të vetëdijshme, të zellshme, të vendosur dhe të përgjegjshme;
   4.6. aftësinë komunikuese;
   4.7. sjelljen jashtë zyrës; dhe
   4.8. integritetin personal.
5. Të gjitha propozimet për emërime dhe riemërime të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë duhet të jenë të arsyetuara me shkrim.

Neni 18
Emërimi dhe riemërimi i Gjyqtarëve dhe Gjyqtarëve Porotë

1. Presidenti emëron dhe riemëron gjyqtarët dhe gjyqtarët porotë bazuar në propozimet e Këshillit dhe në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.
2. Nëse Presidenti i Kosovës refuzon të emërojë apo riemërojë cilindo kandidat, Presidenti siguron brenda afatit gjashtëdhjetë (60) ditor arsyet e refuzimit të tij ndaj

Këshillit. Këshilli mund ta paraqesë edhe një herë tjetër kandidatin e refuzuar para Presidentit së bashku me arsyetimin në formë të shkruar, ose Këshilli mund të propozojë një kandidat tjetër.

KREU IV
VLERËSIMI, NGRITJA NË DETYRË DHE TRANSFERIMI I GJYQTARËVE DHE GJYQTARËVE POROTË

Neni 19
Vlerësimi i performansës së Gjyqtarëve

1. Mënyra dhe procedura për vlerësimin e performansës së gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë themelohet me anë të rregulloreve dhe rregullave të zhvilluara dhe të nxjerra nga Këshilli.
2. Këshilli themelon kritere për vlerësimin dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë ku përfshihen por nuk kufizohen në:
   2.1. njohurinë profesionale, përvojën e punës dhe performansën, përfshirë të njohurit dhe respektimin e të drejtave të njeriut;
   2.2. kapacitetin për arsyetime ligjore;
   2.3. aftësinë profesionale bazuar në rezultat a karrierës së mëparshme, përfshirë pjesëmarrjen në forma të organizuara të trajnimit ku është vlerësuar performansa;
   2.4. aftësinë dhe kapacitetin në analizimin e problemeve ligjore;
   2.5. aftësinë për të kryer detyrat e zyrës në mënyrë të paanshme, të vetëdijshme, të zellshme, të vendosur dhe të përgjegjshme;
   2.6. aftësinë komunikuese;
   2.7. sjelljen jashtë zyrës; dhe
   2.8. integritetin personal.
3. Nëse performansa e një gjyqtari apo gjyqtari porotë i cili është anëtar i Këshillit është në vlerësim e sipër, gjyqtari apo gjyqtari porotë nuk mund të marrë pjesë në shqyrtimet apo votimet e Këshillit.
4. Çdo gjyqtar apo gjyqtar porotë i vlerësuar pranon rezultatet e vlerësimit dhe për cilindo konkluzion apo gjetje mund të paraqet mospajtimet me shkrim.

Neni 20
Transferimi i Gjyqtarëve

1. Me miratimin e Kryetarëve përkatës të Gjykatave, Këshilli mund të transferojë një gjyqtar në një gjykatë tjetër për një periudhë kohore, por jo më gjatë se gjashtë (6) muaj për një herë të vetme.
2. Transferimi sipas paragrafit 1. të këtij neni mund të kryhet në rastet kur gjykata tjetër ka numër të pamjaftueshëm të gjyqtarëve për dëgjimin e një lëndë të caktuar nën kompetencën e saj.
3. Kryesuesi i Këshillit, në rrethana të jashtëzakonshme, mund të transferojë përkohësisht një gjyqtar në një gjykatë apo degë tjetër të gjykatës. Cilido transfer brenda kësaj dispozite nuk do të tejkalojë tridhjetë (30) ditë përveç nëse një kohë më e gjatë miratohet nga Këshilli.

4. Gjyqtarët në asnjë rast nuk mund të transferohen në cilëndo gjykatë tjetër kundër vullnetit të tyre, përveç kur është e nevojshme të sigurohet funksionimi efikas i gjykatave apo për të adresuar rrethana të jashtëzakonshme.
5. Gjyqtarët mund të aplikojnë pranë Këshillit për transferim të përhershëm në një gjykatë tjetër.
6. Gjyqtarët kanë të drejtë në ankesë drejtpërsëdrejti në Gjykatën Supreme kundër një vendimi të Këshillin për zhvendosje të përhershme apo transfer që tejkalon periudhën gjashtë (6) mujore. Këshilli shpallë rregullat dhe rregulloret që themelojnë standardet dhe procedurat që qeverisnin ankesat.
7. Kur kryhet një transferim i përhershëm apo që tejkalon periudhën gjashtë (6) mujore, Këshilli do të përpiqet të sigurohet se zhvendosja apo transferimi nuk do të ndryshojë përbërjen etnike të gjykatës e cila preket nga zhvendosja apo transferi.

KREU V
ADMINISTRIMI I GJYKATAVE

Neni 21
Funksionimi i Gjykatave

Këshilli mbikëqyr funksionimin e gjykatave të Republikës së Kosovës dhe përcakton politikat dhe strategjitë për funksionimin efikas dhe efektiv të gjykatave. Kryesuesi i Këshillit është zyrtari kryesor administrativ i gjykatave dhe së bashku me Këshillin do të jetë përgjegjës për punën efektive dhe efikase të gjykatave. Kryesuesi mund të kryejë delegime të përshtatshme të pushtetit.

Neni 22
Emërimi i Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës

1. Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës do të emërohet siç ceket në nenin 103 (4) të Kushtetutës.
2. Kryetarët e Gjykatave emërohen nga Këshilli në konsultim me gjyqtarët e gjykatave përkatëse. Në emërimin e Kryetarëve të Gjykatave, Këshilli do të marrë në konsiderim trajnimin e specializuar menaxheria apo përvojën.
3. Këshilli, në konsultim me Kryetarin e Gjykatës Themelore emëron Gjyqtarin Mbikëqyrës të secilës degë të Gjykatës Themelore.
4. Këshilli, në konsultim me Kryetarin e Gjykatës Themelore mund të caktojë një nën kryetar gjykate i cili do të ndihmojë në menaxhimin e gjykatës dhe në mungesë të Kryetarit të Gjykatës ky shërben si ushtrues detyre i Kryetarit të Gjykatës.
5. Kryetarët e Gjykatave emërohen me një mandat katër (4) vjeçar, me mundësinë e riemërimit për një (1) mandat shtesë. Pas përfundimit të mandatit si Kryetar i Gjykatës, gjyqtari do të vijojë të shërbejë si gjyqtar në të njëjtën gjykatë në të cilat ishin emëruar fillimisht.
6. Gjyqtarët Mbikëqyrës emërohen me një mandat katër (4) vjeçar, me mundësinë e riemërimit për një (1) mandat shtesë. Pas përfundimit të mandatit si Gjyqtar Mbikëqyrës, gjyqtari do të vijojë të shërbejë si gjyqtar në të njëjtën gjykatë në të cilat ishin emëruar fillimisht.

7. Nëse një kandidat i propozuar për Kryetar Gjykate njëkohësisht është edhe anëtar i Këshillit, ky anëtar nuk mund të marrë pjesë në shqyrtimet apo votimet mbi emërimin e tij apo të saj si Kryetar apo Kryetare e Gjykatës
8. Në mënyrë që të sigurohet se gjykatat pasqyrojnë natyrën shumetnike të Kosovës, Këshilli do të përpiqet të sigurojë se anëtarët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë të emërohen në role menaxhuese në gjyqësor, përfshirë këtu si Kryetarë Gjykatë dhe gjyqtarë Mbikëqyrës.

Neni 23
Shkarkimi i Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës

1. Përveç siç parashtrohet në nenin 103(4) të Kushtetutës, Këshilli mund të largojë nga pozita një Kryetar të Gjykatës apo Gjyqtar Mbikëqyrës me rastin e gjetjes së sjelljes kriminale, keq menaxhimit, paaftësisë apo dështimit në përmbushjen e detyrave të zyrës. Këshilli do të marrë në konsideratë mendimin e gjyqtarëve të gjykatës apo degës së gjykatës përkatëse. Largimi i Kryetarit të Gjykatës apo Gjyqtarit Mbikëqyrës nuk përbën shkarkim nga zyra gjyqësore.
2. Këshilli mund të pezullojë një Kryetar Gjykate apo Gjyqtar Mbikëqyrës nga kjo pozitë gjatë periudhës së hetimin për akuza të sjelljes kriminale, keq menaxhimit, paaftësisë apo dështimit në përmbushjen e detyrave të tyre, pezullim i cili nuk përbën pezullim nga zyra gjyqësore. Në rastin kur Këshilli pezullon një Kryetar Gjykate, nën-Kryetari i Gjykatës bëhet ushtrues detyre i Kryetarit të Gjykatës deri në kohën kur Këshilli të tërheqë pezullimin apo deri në emërimin e një Kryetari të ri të Gjykatës. Në rastin kur Këshilli pezullon një Gjyqtar Mbikëqyrës, Kryetari i Gjykatës Themelore emëron një ushtrues detyre të Gjyqtarit Mbikëqyrës deri në kohën kur Këshilli të tërheqë pezullimin apo deri në emërimin e një Gjyqtari të ri Mbikëqyrës.

Neni 24
Përgjegjësitë e Kryetarit të Gjykatës

1. Kryetari i secilës Gjykatë Themelore dhe i Gjykatës së Apelit është përgjegjës për administrimin ditor të gjykatës në përputhje me rregullat dhe procedurat e themeluara nga Këshilli. Kryetari i Gjykatës organizon dhe bashkërendon funksionimin e gjykatës; mbikëqyr veprimtaritë financiare të gjykatës; dhe ndërmerr aso veprimtarish siç ceken me rregullat, procedurat apo urdhëresat e themeluara nga Këshilli.
2. Kryetarët e Gjykatave Themelore mund të autorizojnë punësimin, masat disiplinore dhe përfundimin e personelit jo gjyqësor në përputhje me rregulloret e zbatueshme për personelin.
3. Kryetari i një Gjykate Themelore ka autoritet të përgjithshme administrative dhe do të sigurojë administrimin efikas dhe efektiv të drejtësisë nga të gjitha degët, departamentet dhe divizionet e gjykatës. Kryetari i Gjykatës, në bashkëpunim me gjyqtarët e gjykatës, zhvillon planin vjetor për menaxhimin e lëndëve dhe cakton lëndët tek departamentet dhe gjyqtarët në atë mënyrë që të sigurojë zgjidhjen efikase të lëndëve. Kryetari i Gjykatës Themelore në baza vjetore i dërgon

Këshillit një raport mbi suksesin e zbatimit të planin të mëparshëm vjetor për menaxhimin e lëndëve. Kryetari i Gjykatës Themelore i dërgon Këshillit raport tremujor me shkrim që adreson punën e gjykatës, identifikon çfarëdo probleme me të cilat ballafaqohet gjykata, si dhe propozon hapa riparues për të adresuar probleme të tilla. Kryetari i Gjykatës, brenda rregullave dhe urdhëresave të Këshillit, do të ndërmarrë hapa të tjerë të atillë sipas nevojës për të siguruar menaxhim efektiv të gjykatës dhe burimeve të saja si dhe gjykimin e lëndëve brenda kohës. Kryetari i Gjykatës mund të kryejë delegime të përshtatshme të autoritetit.

4. Kryetari i Gjykatës është përgjegjës për të siguruar se gjykata dhe proceset e saja janë të hapura dhe transparente për publikun. Pas shqyrtimit dhe pranimit nga Këshilli, raportet tremujore dhe vjetore mbi planin për menaxhimin e lëndëve do të bëhen publike.
5. Kryetari i Gjykatës është përgjegjës për të siguruar qasjen e publikut në gjykata, përfshirë qasjen e personave nga komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë.
6. Kryetari i Gjykatës thërret takimin vjetor të të gjithë gjyqtarëve në atë gjykatë për këshillime mbi administrimin e drejtësisë brenda asaj gjykate; për të studiuar organizimin e gjykatës; për të shqyrtuar dhe propozuar ndryshime në procedura dhe praktika; për të ekzaminuar punën e arritur nga gjykata; dhe për të adresuar çfarëdo problemi të administratës më të cilin ballafaqohet gjykata. Kryetari i Gjykatës brenda nëntëdhjetë (90) ditësh i dërgon Këshillit një raport mbi rezultatet e takimit vjetor të gjyqtarëve.
7. Kryetari i gjykatës mund të delegojë kompetenca të caktuara.

Neni 25
Përgjegjësitë e Gjyqtarëve mbikëqyrës të Gjykatave Themelore

1. Kryetari Mbikëqyrës i një dege të Gjykatës Themelore ka autoritet të përgjithshëm administrative mbi mbarë personelin gjyqësor dhe administrative brenda degës. Gjyqtari Mbikëqyrës brenda degës zbaton rregullat dhe urdhëresat e Këshillit si dhe urdhëresat e Kryetarit të Gjykatës Themelore. Gjyqtari Mbikëqyrës i raporton Kryetarit të Gjykatës në baza tremujorë mbi nevojat dhe veprimet e degës.
2. Gjyqtari Mbikëqyrës mund të kryejë delegime të përshtatshme të autoritetit.

Neni 26
Asambleja e Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës

1. Këshilli themelon një organ këshillëdhënës të quajtur Asambleja e Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës për të këshilluar Këshillin mbi çështjen që ndërlidhen me veprimet e gjykatave.
2. Asambleja përbëhet nga Kryetari i Gjykatës Supreme, Kryetari i Gjykatës së Apelit, Kryetarët e Gjykatave Themelore dhe një Gjyqtar Mbikëqyrës nga secila Gjykatë Themelore që caktohet nga Këshilli.
3. Asambleja ushtron vetëm pushtet këshillëdhënës që i nënshtrohet rregulloreve të nxjerra nga Këshilli. Këshilli mund të ftojë Kuvendin apo anëtarët individualë të Asamblesë për pjesëmarrje në takimet e Këshillit kur Këshilli vendos, me diskrecionin e vet ekskluziv, që pjesëmarrja e tillë do të ishte ndihmuese për Këshillin.

Neni 27
Sekretariati i Këshillit

1. Sekretariati themelohet për të ndihmuar Këshillin dhe për të zbatuar rregullat, rregulloret dhe politikat e Këshillit lidhur menaxhimin, buxhetin dhe administrimin e gjykatave.
2. Sekretariati zhvillon dhe propozon rregulla administrative që janë të nevojshme për zbatimin e urdhëresave të Këshillit. Të gjitha rregullat e tilla do t'i dërgohen Këshillit për miratim.
3. Sekretariati i propozon Këshillit politika të reja, rregulla dhe rregullore kurdoherë që është e nevojshme për administrimin efikas dhe efektiv të gjykatave.
4. Sekretariati i raporton rregullisht Këshillit mbi punën e gjykatave dhe ofron rekomandime për përmirësime.
5. Sipas udhëzimeve të Këshillit dhe të Komisionit të tij për Buxhet, Financa dhe Personel, Sekretariati përgatitë një buxhet të konsoliduar për gjyqësorin dhe administron buxhetin e miratuar të gjyqësorit.
6. Sipas udhëzimeve të Këshillit dhe të Komisionit të tij për Buxhet, Financa dhe Personel, Sekretariati menaxhon me personelin administrativ dhe mbështetës të gjyqësorit përfshirë këtu alokimin e personelit administrativ dhe mbështetës në gjykata bazuar në ngarkesën me punë, mirëmbajtjen e regjistrave të personelit, themelimin e sistemit të vlerësimit të performansës, sigurimin i disiplinimit të duhur të punonjësve të gjykatës si dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre të punësimit.
7. Bazuar në kufizimet buxhetore dhe në udhëzimet e Këshillit, Sekretariati sigurohet që gjykatat kanë furnizim të duhur me materialet e nevojshme për funksionimin efikas dhe efektiv të gjykatave.
8. Sekretariati ofron mbështetje administrative për Këshillin dhe komisionet e veta dhe ndërmerr detyra dhe autoritete të tjera sipas udhëzimeve të Këshillit.
9. Këshilli zhvillon dhe miraton rregullore që ndërlidhen me strukturën organizative dhe funksionimin e Sekretariatit.

Neni 28
Drejtori i Sekretariatit

1. Drejtori përzgjidhet, emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli në përputhje me procedurat, kriteret dhe kualifikimet që zhvillohen dhe miratohen nga ana e Këshillit përmes rregulloreve të cilat janë në përputhje me detyrimet Kushtetuese si dhe detyrimet nga rregulloret e zbatueshme të personelit.
2. Drejtori është përgjegjës ndaj Këshillit për administrimin efikas dhe efektiv të Sekretariatit dhe të gjykatave. Drejtori i raporton drejtpërsëdrejti Kryesuesit të Këshillit. Drejtori do merr pjesë në të gjitha takimet e Këshillit dhe i përgjigjet të gjitha kërkesave të Këshillit për informacion.
3. Këshilli cakton pagën e Drejtorit të Sekretariatit. Drejtori nuk do të pranojë kompensim shtesë për çfarëdo detyre apo punësimi nga cilido burim tjetër përpos rimbursimit për shpenzime të arsyeshme dhe të nevojshme.

Neni 29
Njësia për shqyrtimin e performansës së Gjyqësorit

1. Sipas udhëzimit të Këshillit dhe Komisioneve të saj për Administrimin e Gjykatave, Njësia për Shqyrtimin e Përformansës së Gjyqësorit vlerëson punën e gjykatave dhe i propozon Këshillit politika apo udhëzime për reformimin apo përmirësimin e punës së gjykatave.
2. Këshilli zhvillon dhe miraton rregullore që kanë të bëjnë me strukturën organizative dhe funksionimin e Njësisë për Shqyrtim.
3. Njësia për Shqyrtimin e Përformansës së Gjyqësorit ka një buxhet të veçantë brenda buxhetit të konsoliduar të gjyqësorit dhe në mënyrë të pavarur i raporton Këshillit mbi shpenzimet e veta. Sekretariati i ofron Njësisë për Shqyrtim të Performansës Gjyqësore mbështetje buxhetore sipas udhëzimeve të Këshillit.

Neni 30
Drejtori i njësisë për shqyrtimin e performansës së Gjyqësorit

1. Drejtori i Njësisë për Shqyrtimin e Performansës së Gjyqësorit përzgjidhet, emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli në përputhje me procedurat, kriteret dhe kualifikimet që zhvillohen dhe miratohen nga ana e Këshillit përmes rregulloreve të cilat janë në përputhje me detyrimet Kushtetuese si dhe detyrimet nga rregulloret e zbatueshme të personelit. Vendi i lirë i punës plotësohet pas shpalljes publike të pozitës dhe bazohet në një proces konkurrues, të bazuar në merita dhe të hapur.
2. Drejtori është përgjegjës ndaj Këshillit për administrimin efikas dhe efektiv të Njësisë për Shqyrtim të Performansës Gjyqësore. Drejtori i raporton drejtpërsëdrejti Kryesuesit të Këshillit. Drejtori i përgjigjet të gjitha kërkesave të Këshillit për informacion.
3. Këshilli cakton pagën e Drejtorit të Njësisë për Shqyrtimin e Performansës së Gjyqësorit. Drejtori nuk do të pranojë kompensim shtesë për çfarëdo detyre apo punësimi nga cilido burim tjetër përpos rimbursimit për shpenzime të arsyeshme dhe të nevojshme

Neni 31
Administratorët e Gjykatave

1. Administratorët e gjykatave zgjidhen dhe shkarkohen në pajtim me ligjin për shërbimin civil, në konsultim me kryetarin e gjykatës përkatëse ose të gjyqtarit mbikëqyrës të degës, ku do të shërbej administratori. Të gjitha vendet e lira të punës për administratorët të gjykatave do të plotësohen përmes një procesi konkurrues pas shpalljes publike të pozitës, në pajtim me ligjin për shërbimin civil.
2. Administratorët do të shkarkohen përmes një procesi të përcaktuar me rregullat e ligjit për shërbimin civil.
3. Sipas udhëzimit të Kryetarit të Gjykatës themelore apo të Gjyqtarit Mbikëqyrës së një degë, nëse është e aplikueshme, dhe sipas rregullave, rregulloreve dhe urdhëresave të Këshillit për politikat, Administratorët e Gjykatave menaxhojnë funksionet administrative të gjykatës, duke përfshirë:

3.1. regjistrimin, hartimin dhe monitorimin e statistikave dhe raporteve të gjykatës;
3.2. regjistrimin dhe arkivimin e dosjeve të gjykatës dhe lëndëve të mbyllura;
3.3. mirëmbajtjen e plotë dhe të saktë të dosjeve të gjykatës;
3.4. sigurinë e gjykatës;
3.5. menaxhimin e stafit administrative të gjykatës;
3.6. zbatimin dhe të siguruarit e zbatueshmërisë së rregulloreve për personelin e gjyqësorit;
3.7. mirëmbajtja e saktë e llogarive financiare;
3.8. të sigurojë qasjen e publikut në regjistrat e gjykatës dhe informacionin që mund të zbulohet për publikun;
3.9. caktimi sipas nevojës i stafit administrativ në detyra për të siguruar veprime efektive dhe efikase të gjykatës;
3.10. të sigurojë zbatimin dhe përputhshmërine me rregullat dhe procedurat e themeluara nga Këshilli;
3.11. ndërmarrja e detyrave dhe përgjegjësive të tjera siç mund të caktohen nga Kryetari i gjykatës apo Gjyqtari Mbikëqyrës.

Neni 32
Komisioni Administrativ i Gjykatës Themelore

1. Secila Gjykatë Themelore ka një Komision Administrativ të përbërë nga Kryetari i Gjykatës Themelore dhe Gjyqtari Mbikëqyrës nga secila degë e saj. Kryesues i Komisionit Administrativ është Kryetari i Gjykatës Themelore.
2. Komisioni Administrativ takohet rregullisht dhe jo më pak se katër (4) herë gjatë vitit me thirrjen nga Kryetari i Gjykatës për të vlerësuar punën e gjykatës dhe për ndërmarrjen e veprimeve riparuese në përputhje me rregullat dhe udhëzimet e Këshillit që janë të nevojshme për përmirësimin e veprimeve administrative të gjykatës.
3. Administratori i Gjykatës Themelore shërben si sekretar i Komisionit Menaxhues.

KREU VI
PROCEDURAT DISIPLINORE

Neni 33
Komisioni Disiplinor i Këshillit

Komisioni Disiplinor përbëhet nga tre (3) anëtarë të Këshillit dy (2) nga të cilët duhet të jenë gjyqtarë. Kryesuesi i Komisionit është gjyqtar. Gjyqtarët emërohen nga Këshilli.

Neni 34
Sjellja e pahijshme

1. Për qëllimet e këtij ligji, sjellje të pahijshme nga gjyqtari apo gjyqtari porotë përbën:
   1.1. dënimi përfundimtar për një vepër penale,përpos kundërvajtjeve siç përkufizohet me ligj;
   1.2. neglizhencë në kryerjen, dështimin për të kryer apo abuzimin e funksioneve gjyqësore;

1.3. të dështuarit e kryerjes së funksioneve gjyqësore në mënyrë të pavarur dhe të paanshme;
1.4. shkelja e kodeve të zbatueshme të etikës.

2. Komisioni Disiplinor mund të pezullojë gjyqtarin apo gjyqtarin porotë me pagesë gjatë cilësdo fazë të hetimit apo gjatë procedurës disiplinore.
3. Këshilli Gjyqësor nxjerr rregullore që përcakton sjelljet e pahijshme.

Neni 35
Inicimi i procedurave disiplinore

1. Zyra e Këshillit Disiplinor i rekomandon Komisionit Disiplinor të Këshillit mbi inicimin e procedurave disiplinore kundër një gjyqtari apo gjyqtari porotë mbi bazën e hetimit të zhvilluar.
2. Me rekomandimin e inicimit të procedurës disiplinore, Këshilli Disiplinor do të njoftoj me shkrim Komisionin, Këshillin dhe gjyqtarin apo gjyqtarin porotë nën hetim.

Neni 36
Seancat disiplinore

1. Pasi që Komisioni Disiplinor ka marrë vendimin për inicimin e procedurës disiplinore, gjyqtari apo gjyqtari porotë nën hetim do të njoftohen për bazën e procedurës disiplinore dhe do të ftohen nga Komisioni Disiplinor që të paraqiten personalisht në një seancë të mbyllur e cila do të zhvillohet brenda tridhjetë (30) ditëve të punës nga data e njoftimit.
2. Një këshilltar disiplinor apo drejtori i Zyrës së Këshillit Disiplinor paraqet para Komisionit Disiplinor rekomandimin për veprim disiplinor dhe provat e nxjerra gjatë hetimit të cilat mbështesin gjetjen e sjelljes së pahijshme si dhe sanksionet disiplinore.
3. Gjyqtarët dhe gjyqtarët porotë kanë të drejtën e vet-përfaqësimit apo të caktimit të një avokati të autorizuar për mbrojtjen e tyre dhe kanë qasje në të gjitha provat e fituara gjatë hetimit dhe në të gjitha shkresat e lëndës.
4. Vendimi i Komisionit mbi atë nëse sjellja e pahijshme ka ngjarë dhe nëse do të vendosen sanksione merret në përputhje me rregullat dhe procedurat që do shpallen nga Këshilli për qeverisjen e zhvillimit të procedurave disiplinore dhe bëhet me shkrim si dhe përmban arsyetimin. Një kopje e vendimit do t'i jepet gjyqtarit apo gjyqtarit porotë të akuzuar në procedurë si dhe Zyrës së Këshillit Disiplinor.

Neni 37
Masat disiplinore

1. Komisioni Disiplinor mund të vendosë sanksionet disiplinore si në vijim:
1.1. qortim;
1.2. qortim me udhëzim për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese;
1.3. ulje të përkohshme të rrogës deri në pesëdhjetë përqind (50%) duke pasur parasysh natyrën e sjelljes së pahijshme; ose

1.4. propozim për largimin nga zyra të gjyqtarit apo gjyqtarit porotë.

2. Komisioni vendos një sanksion i cili është në përputhje me rrethanat, nivelin e përgjegjësisë si dhe pasojat e sjelljes së pahijshme.
3. Komisioni, siç ceket në këtë ligj, i dërgon Këshillit një rekomandim në formë të shkruar për shkarkimin nga detyra të një gjyqtari.
4. Nëse gjyqtari apo gjyqtari porotë pas përfundimit të procedurës disiplinore lirohet nga akuzat, ai apo ajo, me vendim të Këshillit, kthehet në zyrën e tij apo saj të mëparshme.

Neni 38
Shkarkimi i Gjyqtarëve dhe Gjyqtarëve Porotë

1. Bazuar në procedurat disiplinore, Këshilli vendos nëse sjellja e pahijshme e gjyqtarit apo gjyqtarit porotë justifikon shkarkimin. Çdo rekomandim i Këshillit për shkarkimin e një gjyqtari apo gjyqtari porotë përfshin arsyet me shkrim për rekomandimet e tilla si dhe konkluzionet themelore të Komisionit.
2. Rekomandimi i Këshillit për shkarkim, siç parashihet në paragrafin 1. të këtij neni, i dërgohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh Presidentit dhe gjyqtarit apo gjyqtarit porotë në fjalë.
3. Presidenti i Republikës së Kosovës vendos për rekomandimin e Këshillit për shkarkim në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovë dhe me këtë ligj.
4. Lidhur me vendimin e Presidentit të Kosovës mbi miratimin apo refuzimin për shkarkim, gjyqtarët dhe gjyqtarët porotë njoftohen zyrtarisht nga Këshilli para se një vendim i tillë të zbatohet.

Neni 39
Ankimi ndaj vendimeve disiplinore

1. Ankesat kundër vendimeve të Komisionit Disiplinor mund t'i dërgohen Këshillit. Në procesin e ankimues nuk mund të marrë pjesë anëtari i Këshillit i cili ka qenë i pranishëm në seancat e Komisionit.
2. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i vendimit përfundimtar, gjyqtari apo gjyqtari porotë i cili është subjekt i vendimeve si dhe Zyra e Këshillit Disiplinor mund të ushtrojnë pranë Këshillit ankesë kundër vendimit të Komisionit.
3. Afati për ankesë në këtë paragraf mund të vazhdohet me kusht që kërkesa për zgjatje të kohës është paraqitur pranë Këshillit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve në dispozicion. Këshilli nuk do të mundësojë asnjë vazhdim të kohës për ankesën e parashtruar pas pesëmbëdhjetë (15) ditësh, përpos paraqitjes së rrethanave të jashtëzakonshme apo katastrofale.
4. Ankesa e ushtruar brenda këtyre afateve kohore pezullon ekzekutimin e vendimit disiplinor.

Neni 40
Arsyet për ankesë

1. Ankesa mund të ushtrohet nën rrethanat si në vijim:
   1.1. shkelja e ligjit apo akteve nen-ligjore që janë të zbatueshme për gjyqtarët dhe gjyqtarët porotë;
   1.2. provat e gabuara apo jo të plota apo vërtetimi i situatës faktike;
   1.3. shkelja e procedurave disiplinore.
2. Ankesa dërgohet me shkrim pranë Këshillit brenda afateve kohore të cekura në nenin 39 të këtij ligji.
3. Ankesa përmban:
   3.1. identifikimin e ankimuesit;
   3.2. vendimi ndaj të cilit ankimohet;
   3.3. data e pranimit të vendimit; dhe
   3.4. baza specifike e ankesës.

Neni 41
Afati për dëgjimin e ankesës

Këshilli dëgjon dhe vendos mbi cilëndo ankesë nga veprimet e Komisionit Disiplinor brenda tre (3) muajsh nga data e paraqitjes se anekses.

Neni 42
Refuzimi i ankesës

1. Këshilli mund të refuzojë një ankesë, pa zhvilluar seancë dëgjimore, brenda pesë (5) ditëve të punës, nëse përcaktohet se:
   1.1. Ankimuesi nuk është një nga palët që ka të drejtë të ankimojë vendimin;
   1.2. Ankesa nuk përmban një apo më shumë arsye që kërkojnë paraqitjen e ankesës;
   1.3. Ankesa nuk është zhvilluar brenda kohës së përcaktuar.

KREU VII
ZYRA E PROKURORIT DISIPLINOR

Neni 43
Zyra e Prokurorit Disiplinor

Zyra e Prokurorit Disiplinor themelohet si organ i ndarë dhe i pavarur që i shërben si Këshillit Gjyqësor të Kosovës ashtu edhe Këshillit Prokurorial të Kosovës. Sa i përket sistemit gjyqësor, Këshilli është përgjegjës për hetimin e supozimeve për sjellje të pahijshme të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë dhe paraqitjen e provave dhe lëndës pranë Komisionit Disiplinor në mbështetje të veprimeve disiplinore për sjelljen e pahijshme.

Neni 44
Pavarësia dhe Paanshmëria e zyrës së Prokurorit Disiplinor

1. Zyra e Prokurorit Disiplinor në administrimin e funksioneve të saja vepron në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.
2. Sipas dispozitave të paragrafit 3. të nenit 36 të këtij ligji, asnjë person nuk ka të drejtë të ushtrojë ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, apo të përpiqet të ushtrojë ndikim mbi funksionet e Prokurorit Disiplinor sa i përket çfarëdo hetimi, rekomandimi apo paraqitjes së një lënde pranë Komisionit Disiplinor.

Neni 45
Përgjegjësitë e zyrës së Prokurorit Disiplinor

1. Zyra e Prokurorit Disiplinor është përgjegjëse për inicimin e hetimeve ndaj gjyqtarëve apo gjyqtarëve porotë aty ku ekziston bazë e arsyeshme për të besuar që sjellja e pahijshme mund të ketë ndodhur si dhe për ofrimin e rekomandimeve dhe paraqitjes pranë Komisionit Disiplinor të provave në mbështetje të veprimit disiplinor.
2. Zyra e Prokurorit Disiplinor inicion hetime në rastet kur:
   2.1. pranë Zyrës së Prokurorit Disiplinor ekziston ankesa e paraqitur nga cilido person fizik apo juridik;
   2.2. me vet iniciativë, kur ekziston bazë e arsyeshme për të besuar se një gjyqtar apo gjyqtar porotë mund të jetë përfshirë në sjellje të pahijshme.
3. Të gjitha ankesat, pavarësisht origjinës së tyre, dërgohen për hetim në Zyrën e Prokurorit Disiplinor.
4. Zyra e Prokurorit disiplinor heton hollësisht të gjitha çështjet që i referohen, vendos nëse rekomandimet për veprime disiplinorë duhet t'i paraqiten Komisionit Disiplinor si dhe njofton me shkrim Komisionin Disiplinor dhe gjyqtarët apo gjyqtarët porotë të dyshuar lidhur me rezultatin e hetimit.
5. Zyra e Prokurorit Disiplinor ka të drejtë të thërrasë dëshmitarët si dhe dokumentet e nevojshme për hetim dhe të përcaktojë nëse rekomandimet për veprim disiplinor duhet të paraqiten tek Komisioni Disiplinor.
6. Zyra e Prokurorit Disiplinor i paraqet Komisionit Disiplinor rekomandimet për veprime disiplinore si dhe provat në mbështetje të veprimit disiplinor për sjelljen e pahijshme.

Neni 46
Drejtori i zyrës së Prokurorit Disiplinor

1. Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor zgjidhet nga dy të tretat (2/3) e anëtarësisë së përbashkët nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës si dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës në përputhje me rregulloren për personelin. Vendi i lirë i punës plotësohet pas shpalljes publike të njoftimit, në bazë të procesit konkurrues.
2. Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor është përgjegjës si për Këshillin Gjyqësor të Kosovës ashtu edhe për Këshillin Prokurorial të Kosovës mbi administrimin efikas dhe efektiv të Zyrës së Këshillit Disiplinor dhe ushtron përgjegjësitë e veta përkitazi me rregullat dhe rregulloret e shpallura nga të dy këshillat.

3. Drejtori i Zyrës së Këshillit Disiplinor pranon pagë ekuivalente me atë të një gjyqtari të Gjykatës së Apelit. Drejtori nuk do të pranojë kompensim shtesë për çfarëdo detyrë apo punësimi tjetër nga cilido burim tjetër përveç për shpenzime të arsyeshme dhe të nevojshme.

Neni 47
Kualifikimet e drejtorit të zyrës së Prokurorit Disiplinor

1. Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor duhet të përmbushë kualifikimet si në vijim:
   1.1. të jetë qytetar dhe banor i Kosovës;
   1.2. të ketë diplomë të vlefshme universitare të juridikut, administrimit policor apo në një fushë të ngjashme në përputhje me ligjet e Kosovës;
   1.3. të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune relevante si avokat, gjyqtar apo zyrtar policie, prokuror apo në një fushë të ngjashme në zbatimin e ligjit apo të administrimit të së drejtës penale;
   1.4. të ketë reputacion profesional pozitiv dhe integritet moral;
   1.5. të kenë përfunduar me sukses cilindo trajnim të kërkuar për pozitën e mandatuar së bashku nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës;
   1.6. Të mos ketë qenë i dënuar për vepra penale, me përjashtim të kundërvajtjes siç përcaktohet me ligj.

Neni 48
Përzgjedhja dhe kualifikimet e personelit të zyrës së Prokurorit Disiplinor

1. Zyra e Prokurorit Disiplinor, në konsultim me Këshillin dhe sipas kritereve kualifikuese të cekura në këtë nen, autorizohet të përzgjedhë, emërojë dhe shkarkojë këshilltarët disiplinorë. Zyra ndihmon në paraqitjen e rekomandimeve pranë Komisionit Disiplinor për veprime disiplinore kundër gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë si dhe provat në mbështetje të veprimin disiplinor. Të gjitha vendet e lira të punës plotësohen pas shpalljes publike të njoftimit, në bazë të procesit konkurrues, të bazuar në mërita dhe të hapur publik
2. Anëtarët e Prokurorit Disiplinor duhet të përmbushim kualifikimet si në vijim:
   2.1. të jenë shtetas dhe banorë të Kosovës;
   2.2. të kenë diplomë universitare në juridik, drejtësinë penale, administrim të policisë apo në një fushë të ngjashme sipas ligjit të Kosovës;
   2.3. të ketë së paku tre (3) vite përvojë relevante pune si avokat, gjyqtar, zyrtar policor, prokuror apo të një fushe të ngjashme në zbatimin e ligjit apo administrimin e së drejtës penale.
   2.4. të kenë reputacion pozitiv profesional dhe integritet moral;
   2.5. të ketë përfunduar me sukses cilindo trajnim të kërkuar për pozitën e përbashkët nga Këshillit Gjyqësor i Kosovës dhe Këshillit Prokurorial i Kosovës;
   2.6. të mos ketë qenë i dënuar për vepra penale, me përjashtim të kundërvajtjeve siç përkufizohet me ligj.

3. Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor autorizohet, sipas kritereve të përzgjedhjes të përcaktuara në këtë nen, që të përzgjedhë, emërojë dhe shkarkojë inspektorët që ndihmojnë në zhvillimit të hetimeve për të cilat është përgjegjës Prokurori Disiplinor.
4. Inspektori i Prokurorit Disiplinor duhet të përmbushë kualifikimet si në vijim:
   4.1. të jetë shtetas dhe banor i Kosovës;
   4.2. të ketë së paku tre (3) vjet përvojë relevante pune në fushën e zbatimit të ligjit, punë policore, administrim të së drejtës penale apo në një fushë të ngjashme;
   4.3. të ketë reputacion pozitiv në shoqëri;
   4.4. të ketë mbaruar me sukses cilindo trajnim të kërkuar për këtë pozitë të mandatuar së bashku nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës;
   4.5. të mos ketë qenë i dënuar për vepra penale, me përjashtim të kundërvajtjeve.
5. Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor po ashtu autorizohet që sipas nevojës, të përzgjedhë, emërojë dhe shkarkojë, në përputhje me kërkesat Kushtetuese dhe kërkesat e rregulloreve të zbatueshme për personelin, administratën dhe personelin mbështetës që ofron mbështetje administrative për funksionet e personelit të drejtorit, këshilltarëve disiplinorë dhe inspektorëve të Zyrës së Prokurorit Disiplinor.

Neni 49
Buxheti për zyrën e Prokurorit Disiplinor

Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor çdo vit i dërgon Kuvendit në mënyrë të drejtpërdrejtë një buxhet të ndarë për financimin e pagave të personelit të Zyrës së Prokurorit Disiplinor, përfshirë drejtorin, këshilltarët disiplinorë, inspektorët dhe personelin administrativ dhe mbështetës si dhe shpenzimet e tjera operative të Zyrës së Këshillit Disiplinor. Buxheti për Prokurorin Disiplinor, me udhëzimin dhe certifikimin e drejtorit të Zyrës së Prokurorit Disiplinor, administrohet nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk do të ketë pushtet të kufizojë apo të drejtojë në ndonjë mënyrë tjetër shpenzimet e Zyrës së Prokurorit Disiplinor dhe po ashtu Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk ka pushtet të rialokojë buxhetin e Prokurorit të Zyrës Disiplinore apo të përdorë fondet e caktuara për Zyrën e Prokurorit Disiplinor për çfarëdo qëllimi tjetër. Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor në baza vjetore do të raportojë para një seance të përbashkët të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës mbi veprimtaritë dhe shpenzimet e Zyrës së Prokurorit Disiplinor.

KREU VIII
TRAJNIMI GJYQËSOR

Neni 50
Politikat e trajnimit, standardet dhe udhëzimet

Këshilli në bashkërendim me Institutin Gjyqësor të Kosovës përcakton politikat, standardet dhe udhëzimet për rregullimin e trajnimit të gjyqtarëve, gjyqtarëve porotë dhe stafit tjetër gjyqësor.

Neni 51
Delegimi i përgjegjësive për trajnim gjyqësor

1. Këshilli mund të bashkëpunojë me shoqata ose organizata të tjera me qëllim të ngritjes profesionale të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë.
2. Këshilli mund të kërkojë rishikimin e cilitdo program trajnimi në mënyrë që të sigurohet zbatimi i politikave dhe standardeve për trajnimin profesional të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë.

KREU IX
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 52
Përbërja e përkohshme e Këshillit

1. Deri në mbarimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të zbatimit të Propozimit mbi Marrëveshjen Gjithëpërfshirëse për Zgjidhjen e Statusit për Kosovën, Këshilli përbëhet siç parashihet me nenin 151 të Kushtetutës.
2. Deri në mbarimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të zbatimit të Propozimit mbi Marrëveshjen Gjithëpërfshirëse për Zgjidhjen e Statusit për Kosovën, dy (2) nga katër (4) anëtarët e zgjedhur nga deputetët që mbajnë ulëset e caktuara gjatë shpërndarjes së përgjithshme të ulëseve do të jenë anëtarë ndërkombëtarë të përzgjedhur nga Zyra e Përfaqësuesit Ndërkombëtar mbi propozimin e EULEX-it në përputhje me nenin 151(2) të Kushtetutës. Njëri nga anëtarët ndërkombëtarë është gjyqtar.

Neni 53
Tranzicioni i Këshillit Prokurorial

1. Deri në themelimin e Këshillit Prokurorial të cekur në nenin 110 të Kushtetutës, detyrat dhe funksionet e Këshillit lidhur me prokurorinë publike ushtrohen nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.
2. Prokurorët të cilët janë anëtarë të Këshillit në të njëjtën kohë që themelohet Këshilli Prokurorial transferohet tek Këshilli Prokurorial dhe mbeten aty deri në skadimin e natyrshëm të mandatit të tyre.
3. Vendi i lirë i punës në Këshill i shkaktuar nga transferimi i cilitdo prokuror apo prokurorë në Këshillin Prokurorial që në atë kohë ka qenë duke shërbyer në Këshill do të plotësohet siç parashihet me këtë ligj apo nenin 151(1) të Kushtetutës.

Neni 54
Vlefshmëria e veprimeve të mëparshme të Këshillit themeluar sipas Rregullores Administrative të UNMIK-ut 2005/52 dhe Ligjit mbi përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

1. Të gjitha veprimet e mëparshme administrative të Këshillit të marra nën Rregulloren Administrative të UNMIK-ut 2005/52 apo në bazë të Ligjit mbi Përbërjen e Përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përfshirë shpalljen e

cilitdo rregull, rregullore, tarifë, direktivë apo veprimi tjetër zyrtar, do të mbetet i vlefshëm dhe në fuqi përpos nëse shfuqizohet me këtë ligj apo deri në një kohë kur veprimet e tilla Këshilli do t'i ndryshojë, shfuqizojë apo sqarojë.

2. Të gjitha veprimet e mëparshme të Këshillit lidhur me riemërimin, transferimin apo disiplinën e gjyqtarëve mbetet i vlefshëm dhe në fuqi përpos nëse shfuqizohet përmes këtij ligji apo akti pasues ligjor.
3. Të gjitha veprimet e mëparshme të Këshillit për personelin sa i përket emërimit, ngritjes në detyrë, transferimit apo ndërprerjes së punës së punonjësve administrativ mbetet i vlefshëm dhe në fuqi përpos nëse shfuqizohet me këtë ligj apo me veprim pasues të Këshillit.

Neni 55
Shfuqizimi

Ky ligj shfuqizon dhe zëvendëson Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/52 si dhe të gjitha dispozitat tjera ligjore të cilat bien ndesh me të.

Neni 56
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi gjashtë (6) muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-223
30 shtator 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-053-2010, datë 18.10.2010 nga u.d. Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 84 / 03 NËNTOR 2010

LIGJI Nr. 04/L-115
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË KANË TË BËJNË ME PËRFUNDIMIN E MBIKËQYRJES NDËRKOMBËTARE TË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË KANË TË BËJNË ME PËRFUNDIMIN E MBIKËQYRJES NDËRKOMBËTARE TË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Neni 1
Qëllimi

1. Ky ligj ka për qëllim të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve në vijim për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës:
   1.1. Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
   1.2. Ligjit Nr. 03/L-075 për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës;
   1.3. Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
   1.4. Ligjit Nr. 03/L-079 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale;
   1.5. Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
   1.6. Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04 L 101 për Fondet Pensionale të Kosovës;
   1.7. Kodit Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë;
   1.8. Ligji Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat;
   1.9. Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat;
   1.10. Ligji Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
   1.11. Ligji Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
   1.12. Ligji Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë;
   1.13. Ligji Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme;
   1.14. Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës;
   1.15. Ligji Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativ të Komunave;

1.16. Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës;
1.17. Ligji Nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës;
1.18. Ligji Nr. 03/L-237 për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave;
1.19. Ligji Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës;
1.20. Ligji Nr. 03/L-082 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës.
1.21. Ligji Nr. 03/L-033 për Statusin, imunitetet dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin e Kosovës dhe praninë ndërkombëtare ushtarake, si dhe personelin e saj.

Neni 2
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Ligji)

1. Neni 15 i ligjit bazik pas paragrafit 1. shtohet paragraf i ri 2. me tekstin si në vijim:
   2. Gjykatësit ndërkombëtarë, të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë ligj, vazhdojnë të marrin pagën e tyre të specifikuar sipas vendimit për emërim. Qeveria e Kosoves merr pjesë në pagesën e gjykatësve ndërkombëtarë, në periudhën e përcaktuar në vlerë të pagave të gjyqtarëve vendorë.
2. Neni 55 i ligjit bazik, paragrafi 1. dhe paragrafi 2 fshihen nga teksti i ligjit dhe shtohet një paragraf i ri me tekstin si në vijim:
   Mandati i gjykatësve ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim.

Neni 3
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-075 për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës (Ligji)

1. Neni 8 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 8

Auditori i përgjithshëm, i emëruar në përputhje me Kushtetutën dhe me këtë ligj, vazhdon të qëndrojë në post deri në përfundim të mandatit, me kompensimin e cekur në kushtet specifike të emërimit të tij. Qeveria e Kosovës siguron fonde në vlerën e përcaktuar me marrëveshjen në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Zyrës se Auditorit të përgjithshëm.

Neni 4
Ndryshimet dhe plotësimet Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji)

1. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1.12, që përkufizon Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar, fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Kuvendi pas propozimit nga qeveria zgjedh tre (3) anëtarë ndërkombëtarë drejtorë të bordit. Bordi, po ashtu, emëron një shtetas të Kosovës drejtor të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit, i cili nuk do të jetë anëtar i Bordit. Bordi, përveç kryesuesit, po ashtu, emëron zëvendëskryesues njërin prej anëtarëve të tij. Për emërimin, shkarkimin ose ndryshimin e kushteve të referimit të Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit kërkohet vota afirmative e shumicës së Bordit të Drejtorëve. Anëtarët ndërkombëtarë zgjedhën më mandat deri më 31 gusht 2014.

3. Neni 14 i ligjit bazik, paragrafët 7., dhe 9., vlejnë deri në përfundimin e mandatit të anëtarëve ndërkombëtarë të bordit.
4. Neni 31 i ligjit bazik, pas paragrafit 5. shtohet një paragraf i ri 6. me tekstin si në vijim:
   6. Nëse një anëtar ndërkombëtar i bordit i emëruar në pajtim me nenin 31 (5) jep dorëheqje nga Bordi dhe nëse kjo dorëheqje ose largim nga posti ndodh deri më 31 gusht 2014 atëherë ai/ajo do të zëvendësohet me një ndërkombëtar tjetër.

Neni 5
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-079 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale (Ligji)

1. Neni 4 i ligjit bazik që ndryshon nenin 5.2 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   5.2. Bordi mbikëqyrës përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve të cilët emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryeministri.
2. Neni 8 i ligjit bazik që ndryshon nenin 6.1 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   6.1. Sekretaria Ekzekutive ka drejtorin dhe zëvendësdrejtorin të cilët emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryeministri.
3. Neni 10 i ligjit bazik që ndryshon nenin 7.1 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   7.1. Komisioni përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të cilët emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.
4. Neni 13 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 13

Kuvendi, në konsultim me Komisionin, mund të themelojë panele shtesë të Komisionit, anëtarët e të cilëve do të emërohen në bazë të neneve 7.1 dhe 7.2.

5. Neni 16 i ligjit bazik që ndryshon nenin 12.8 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   12.8. Gjykata Supreme e Kosovës vendos lidhur me ankesat në trupin gjykues prej tre (3) gjyqtarëve të cilët emërohen nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës.
6. Pas nenit 27 të ligjit bazik, shtohet një nen i ri 27.A me tekstin si në vijim:

Neni 27.A

1. Mandati i tre (3) anëtarëve ndërkombëtarë të Bordit mbikëqyrës (përfshi edhe kryesuesin), i drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive, i dy (2) anëtarëve ndërkombëtarë të Komisionit (përfshi edhe kryesuesin), si dhe i dy gjykatësve ndërkombëtarë në panelet e ankimit të Gjykatës Supreme të cilët janë emëruar në pajtim me Kushtetutën do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim.
2. Anëtarët dhe gjykatësit ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë Ligj vazhdojnë të marrin pagën e tyre të specifikuar sipas kushteve të emërimit të tyre.
3. Qeveria e Kosoves do të sigurojë fonde për drejtorin e Sekretariatit Ekzekutive të barabartë me pagën e një anëtari vendor të Bordit Mbikëqyrës.
4. Nëse një anëtar ndërkombëtar i emëruar ne pajtim me Kushtetutën jep dorëheqje ose largohet nga pozita e tij/saj dhe nëse ky largim ose dorëheqja ndodh para datës 31 gusht 2014, atëherë ai/ajo do të zëvendësohet me një ndërkombëtar, të dominuar nga Kryeministri për pozitat e anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë së Pronës dhe drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive, si dhe të nominuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme për pozitën e anëtarëve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Anëtareve të Panelit të Ankesave të Gjykatës Supreme, pas konsultimeve me PSBE.

Neni 6
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.3. fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.7, riformulohet me tekstin si në vijim:
   1.7. **Gjykatës Ndërkombëtar** - çdo gjykatës i Misionit Evropian për Politika të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, i cili është emëruar në pajtim me këtë ligj.
3. Neni 11 i ligjit bazik, paragrafi 2. riformulohet me tekstin si në vijim:
   2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Dhoma e Posaçme do të vazhdojë të respektojë dhe zbatojë parimin e kompensimit në vend të kthimit fizik. Kur vendoset për mjetin juridik që do të jepet në një rast të caktuar, Dhoma e Posaçme do të marrë parasysh edhe dispozitat në fuqi të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, duke përfshirë qëllimet publike që përcaktohen në preambulën e atij ligji.

Neni 7
Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04 L-101 për fondet pensionale të Kosovës

1. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 4.6, riformulohet me tekstin si në vijim:
   4.6. Komisioni për përzgjedhje, i propozon kandidatët Kuvendit për vendet e lira në anëtarësim ose për riemërim të anëtarëve të Bordit Drejtues. Komisioni për Përzgjedhje do të përbëhet nga guvernatori i BQK-së - kryesues, Auditori i

Përgjithshëm dhe Ministri i Financave. Mandati i secilit anëtar të emëruar në Bordin Drejtues zgjat tre vjet, me mundësi të rizgjedhjes, nëse mandati i anëtarëve të Bordit skadon dhe asnjë anëtar i ri nuk është emëruar, atëherë anëtarët e Bordit ekzistues do të vazhdojnë mandatin për nëntëdhjetë (90) ditë.

Neni 8
Ndryshimet dhe plotësimet e Kodit Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë (Kodi)

1. Neni 309 i ligjit bazik që rregullon emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave me pëlqimin e PCN-së, fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 1 i Aneksit D, i Kodit, fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 1

Ky Aneks ofron përjashtimet e posaçme të përkufizuara në këtë Aneks që do t'i jepen bashkësive fetare sipas përkufizimit në legjislacionin e aplikueshëm, duke përfshirë edhe legjislacionin për liritë fetare në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Neni 9
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat (Ligji)

1. Neni 1 i ligjit bazik, paragrafi 1.32, që përkufizon PCN-në fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 8 i ligjit bazik paragrafi 2. në rreshtin e tretë fshihet fjala “dhe PCN”.
3. Neni 88 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 10
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-199 për gjykatat (ligji)

1. Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 11, riformulohet me tekstin si në vijim:
   11. Nëse në njërën nga komunat e reja dhe të themeluara mbi bazën e Ligjit për Kufijtë Administrativë Komunal nuk ka gjykatë themelore, komuna me vendim të Kuvendit Komunal mund ta parqet kërkesën para Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK) për të vendosur mbi themelimin e gjykatës themelore në territorin e saj, ose që një nga gjykatat ekzistuese themelore në territorin e komunës tjetër të ketë juridiksion mbi territorin e komunës së re. Të njëjtën të drejtë e ka edhe komuna ekzistuese, ku shumica e popullatës i takon komunitetit jo shumicë në Kosovës, dhe në të cilën nuk ka gjykatë themelore.
      11.1. KGjK do të aprovojë kërkesat e tilla, përveç nëse vlerësohet se ngarkesat e lëndëve për atë juridiksion është e pamjaftueshme për ta arsyetuar ekzistimin e gjykatës së ndarë.
      11.2. Kur KGjK e aprovon kërkesën për themelimin e gjykatës së re

themelore, autoritetet kompetente do t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se cilado gjykatë e re, është themeluar dhe funksionale brenda periudhës gjashtë mujore prej datës së vendimit.

11.3. Nëse KGjK nuk aprovon kërkesën për themelimin e gjykatës së re themelore, ose kur komuna i kërkon gjykatës ekzistuese që të ketë juridiksion për territorin e vet, autoritetet kompetente do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për përmirësimin e qasjes në drejtësi për komunitetet lokale, e cila është vështirësuar për shkak të izolimit gjeografik, mungesës së sigurisë, ose për shkak të faktorëve të tjerë relevant. Këto masa mund të përfshijnë krijimin në kuadër të territorit të komunës së re, të një departamenti të gjykatës themelore ekzistuese prej së cilës komuna e re ka kërkuar të ketë kompetencë për territorin e vet, ose që gjykata themelore të mundësojë mbajtjen e seancave në territorin e komunës së re.

2. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Përbërja e Gjykatës së Apelit pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Republikës së Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore. Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin përkatës në fuqi, si dhe për të siguruar pjesëmarrjen e komunitetit në gjyqësor, pesëmbëdhjetë (15) për qind e numrit të tërësishëm të ulëseve në Gjykatën e Apelit, por jo më pak se dhjetë ulëse, garantohen për gjyqtarët nga radha e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

Neni 11
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.2. fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 1.3, riformulohet me tekstin si në vijim:

1.3. Për të siguruar se gjykatat pasqyrojnë përbërjen etnike të zonës së tyre të juridiksionit në përputhje me nenin 104(3) të Kushtetutës dhe me legjislacionin përkatës në fuqi, Këshilli do të marrë parasysh që të plotësojë vendet e lira të punës ose të ulëseve të rezervuara me anëtarë të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

3. Neni 7 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 7
Mandati i anëtarëve të Këshillit

Anëtarët e Këshillit zgjidhen me mandat 5 (pesë) vjeçar, siç ceket në nenin 108 (6) të Kushtetutës dhe në këtë ligj. Një anëtar i këtij Këshilli mund të zgjidhet për një mandat shtesë jo-vijues pesë (5) vjeçar.

4. Neni 16 i ligjit bazik, paragrafi 3., riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Në përputhje me nenin 104(3) të Kushtetutës, Këshilli zbaton masa dhe veprimet tjera me qëllim rekrutimi, të cilat i konsideron të nevojshme dhe të përshtatshme për të siguruar se një gjykatë ose degë e gjykatës pasqyron përbërjen etnike në zonën e tyre të juridiksionit.

5. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 1., riformulohet si në vijim:
   1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ndërmerr masa të nevojshme për të rritur numrin e gjyqtarëve nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë, prej radhëve të atyre gjyqtarëve që shërbejnë në Kosovë. Për të përmbushur përgjegjësitë e veta, Këshilli, ndër të tjera, nga aplikantët njëlloj të kualifikuar për të shërbyer si gjyqtarë u jep përparësi anëtarëve nga komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovës, ashtu siç është paraparë me nenin 108 të Kushtetutës.
6. Neni 17 i ligjit bazik, pas paragrafit 5., shtohen tre paragraf të rinjë 6, 7 dhe 8, me tekstin si në vijim:
   6. Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të hartojë një rregullore të veçantë për të përshkruar procesin e emërimit dhe të riemërimit të gjykatësve nga komunitetet e nën-përfaqësuara në mesin e gjykatësve që shërbejnë në Kosovë.
   7. Dhënia e përparësisë për kandidatët me kualifikime të barabarta nga komunitetet e nën-përfaqësuara, do të zbatohet përderisa përqindja e gjyqtarëve pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë në Kosovë të jetë nën pesëmbëdhjetë përqind (15%) dhe / përderisa përqindja e gjyqtarëve të cilët janë pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, të jetë nën tetë (8%).
   8. Mandati i dy anëtarëve ndërkombëtarë të Këshillit të emëruar në pajtim me Kushtetutën do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim. Anëtarët ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë ligj vazhdojnë të marrin pagën e tyre.
   9. Neni 52 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 12
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.7, fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 1.3 riformulohet me tekstin si në vijim:
   1.3. Siguron se prokuroritë pasqyrojnë përbërjen etnike të zonës së tyre të juridiksionit në përputhje me nenin 109 (4) dhe 110(3) të Kushtetutës.
3. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Këshilli zbaton masa dhe veprime rekrutimi, si dhe masa të tjera të cilat i konsideron të nevojshme për të siguruar që një zyrë prokuroriale pasqyron përbërjen etnike të zonës së juridiksionit përkatës.
4. Neni 17 i ligjit bazik, pas paragrafit 3. shtohet një paragraf i ri 4. me tekstin si në vijim:
   4. Këshilli harton rregullore të veçantë për të përshkruar procesin e emërimit dhe të riemërimit të prokurorëve nga komunitetet e nën-përfaqësuara në mesin e prokurorëve që shërbejnë në Kosovë.
5. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 1., riformulohet me tekstin si në vijim:
   1. Këshilli ndërmerr masa të nevojshme për të rritur numrin e prokurorëve nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë. Kur ka aplikantë njëlloj të kualifikuar për të shërbyer si prokurorë, Këshilli u jep përparësi anëtarëve nga komunitetet që janë të nënpërfaqësuara në Kosovë siç është paraparë edhe me nenin 109 (4) dhe 110 (3) të Kushtetutës.

6. Neni 18 i ligjit bazik, pas paragrafit 5, shtohet paragrafi i ri 6, me tekstin si në vijim:
   6. Dhënia e përparësisë për kandidatët me kualifikime të barabarta nga komunitetet e nën-përfaqësuara, do të zbatohet përderisa përqindja e prokuroreve pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë në Kosovë të jetë nën pesëmbdhjetë përqind (15%) dhe / ose përderisa përqindja e prokurorëve të cilët janë pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, të jetë nën tetë përqind (8%).

Neni 13
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë (Ligji)

1. Pjesa e parë e preambulës se ligjit, riformulohet me tekstin si në vijim:
   Në bazë të nenit 65 (1) dhe ne pajtim me dispozitat kalimtare dhe përfundimtare nga kreu XIII dhe XIV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Pas nenit 7 të ligjit bazik shtohet një nen i ri 7.A me tekstin si në vijim:

Neni 7.A
Statusi i Kishës Ortodokse Serbe

1. Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë konsiderohet pjesë përbërëse e Kishës Ortodokse Serbe (KOS).
2. Emri dhe organizimi i brendshëm i Kishës Ortodokse Serbe, duke përfshirë edhe hierarkinë dhe veprimtaritë e saj, do të respektohen.
3. Nuk do të ketë ndalim arbitrar për hyrje në Kosovë ose qëndrim brenda Kosovës për priftërinjtë, kandidatët për prift, murgjve, murgeshave dhe vizitorëve.
4. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 7.3, fjalët "**themelojnë dhe**", fshihen nga teksti i ligjit.
5. Neni 8 i ligjit bazik, paragrafi 1, riformulohet me tekstin si në vijim:
   1. Ndërtesat dhe objektet që u takojnë bashkësive fetare, që janë të dedikuara për kryerjen e ceremonive fetare konsiderohen të pacenueshme për sa i përket ndërhyrjes së autoriteteve qeveritare dhe në to mund të hyhet vetëm me pëlqimin e institucionit përkatës fetar, përveç nëse është lëshuar ndonjë urdhër gjyqësor për shkak të aktiviteteve ilegale dhe në rast të rrezikut për jetën ose shëndetin.
6. Neni 12 i ligjit bazik, pas paragrafit 12.4 shtohet një paragraf i ri 12.5 me tekstin si në vijim:
   12.5. Përveç përjashtimeve të përmendura më lart, bashkësitë fetare gëzojnë privilegje doganore dhe tatimore për veprimtari ekonomike, që janë specifike për vetë-qëndrueshmërinë e tyre financiare, siç do të definohet me një akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e financave. Këto privilegje përfshijnë importimin dhe blerjen e produkteve qenësore për prodhim, të materialeve, pajisjeve dhe bagëtisë; dhe eksportimin e produkteve që dalin nga aktivitetet e lartpërmendura.

Neni 14
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1. përkufizimi "**Propozimin Gjithëpërfshirës**", fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Objekt i shpronësimit sipas këtij ligji mund të jenë të drejtat private pronësore dhe të drejtat tjera private për ose ndaj një prone të paluajtshme, me përjashtim të asaj prone të paluajtshme që bën pjesë në atë kategori të pronës, për të cilën Kushtetuta në mënyrë specifike thotë se nuk do të jetë objekt i shpronësimit.
3. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3, shtohet nën-paragraf i ri 3.1. me tekstin si në vijim:
   3.1 Prona e luajtshme dhe e paluajtshme, si dhe asetet tjera të Kishës Ortodokse Serbe do të jenë të pacenueshme dhe nuk do të jenë objekt i shpronësimit.

Neni 15
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (ligji)

1. Pas nenit 3 shtohet nen i ri 3.A me tekstin si në vijim:

Neni 3.A
Të drejtat e refugjatëve dhe personave të zhvendosur

1. Të gjithë refugjatët nga Kosova dhe personat e zhvendosur brenda vendit do të kenë të drejtën e kthimit dhe kërkimit të pronës së tyre dhe posedimeve personale, në pajtim me ligjet vendore dhe ndërkombëtare. Çdo person do të ketë të drejtë të marrë vendim të lirë dhe të jetë i informuar për vendin ku ai kthehet.
2. Institucionet e Republikës së Kosovës ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të krijuar kushte te favorshme për kthim të sigurt dhe të denjë të refugjatëve dhe personave të zhvendosur, bazuar në vendimet e tyre të lira dhe të bazuara në informata të sakta, përfshirë përpjekjet për të promovuar dhe mbrojtur lirinë e tyre të lëvizjes dhe mbrojtjen nga kërcënimi
3. Kushtet e kthimit të personave të zhvendosur dhe mekanizmat e bashkëpunimit me institucionet relevante ndërkombëtare do të përcaktohen nga institucionet e Republikës së Kosovës në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e aplikueshme."

Neni 16
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativë të Komunave (ligji)

1. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Bordi do të përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë, me nga pesë (5) përfaqësues të zgjedhur nga secila komunë dhe një (1) përfaqësues i zgjedhur nga Kryeministri.

2. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 4. riformulohet me tekstin si në vijim:
   4. Kryesuesi i Bordit përzgjidhet nga Kryeministri.
3. Neni 14 i ligjit bazik, fshihet termi **"dhe PCN do të ndërmarrin"** dhe zëvendësohet me termin: "**ndërrmer**".
4. Në Shtojcën 1 (Zonat Kadastrale) të ligjit bazik, emërtimi i komunës "**Hani i Elezit**" në gjuhën serbe dhe angleze ndryshohet në "**Elez Han**"

Neni 17
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës (ligji)

1. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi (c) riformulohet me tekstin si në vijim:
   (c) Një (1) anëtar, i përzgjedhur nga Kryeministri.
2. Neni 14 i ligjit bazik, paragrafi (b), nënparagrafi (iv) riformulohet me tekstin si në vijim:
   iv. Një (1) anëtar, i përzgjedhur nga Kryeministri.

Neni 18
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës (ligji)

1. Titulli i nenit 29 të ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 29
Regjistrimi dhe përcaktimi i shtetësisë

Neni 19
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-237 për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave (Ligji)

1. Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 4.12., riformulohet me tekstin si në vijim:
   4.12 Një (1) përfaqësues nga një prej Universiteteve publike, anëtar;

Neni 20
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës (ligji)

1. Neni 9 i ligjit bazik, paragrafi 3., riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Forca e Sigurisë së Kosovës është e strukturuar dhe e përgatitur për të përmbushur funksionet e sigurisë që nuk i përkasin policisë ose organizatave tjera për zbatim të ligjit.
2. Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 2., riformulohet me tekstin si në vijim:
   2. Forca e Sigurisë së Kosovës është e armatosur lehtë dhe nuk ka armë të rënda, siç janë tanket, artileria e rëndë ose kapacitete sulmuese ajrore. Një rishikim i plotë i këtyre kufizimeve, do të bëhet jo më herët se pesë vjet nga koha e hyrjes në fuqi e Ligjit Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Detyrat fillestare të Forcës së Sigurisë së Kosovës janë:

3. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 2, pika (e) fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 21
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-082 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës (ligji)

1. Neni 5 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 22
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-033 për Statusin, imunitetet dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin e Kosovës dhe praninë ndërkombëtare ushtarake, si dhe personelin e saj

1. Neni 3 i ligjit bazik paragrafi 2. pika (a) riformulohet me tekstin si në vijim:
   (a) Zyra Civile Ndërkombëtare dhe Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian.
2. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3.3. Individët e emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtarë, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, mandati i të cilëve nuk ka përfunduar para deklarimit të përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur gëzojnë statusin, privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara në ligjin bazik.
3. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 6., riformulohet me tekstin si në vijim:
   4.6. Ministri i Punëve të Jashtme nuk mund t'i shpallë PSBE-në ose një anëtar të personelit të tij, anëtarët e personelit të ICO-së, përfshirë individët e përcaktuar në nenin 3.3. të ligjit bazik ose anëtarët e misionit EULEX, si persona non grata.
4. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 7. fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 23

1. Të gjithë anëtarët ndërkombëtarë të emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, në pajtim me Kushtetutën e Republikës se Kosovës, me përjashtim të atyre të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Agjencisë Kosovare të Pronës gjyqtarët ndërkombëtarë të Panelit të Ankesave të Gjykatës Supreme, dhe dy gjyqtarë në Komisionin për Kërkesa Pronësore, nëse për çfarëdo arsye largohen nga pozita para datës 31 gusht 2014 ai/ajo do të zëvendësohet me një anëtar vendor.
2. Nëse në cilindo ligj të aplikueshëm në Republikën e Kosovës përdoren termet ICO ose PCN, të njëjtat shfuqizohen dhe zëvendësohen me institucionet vendore përkatëse.

II. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 24
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të amendamenteve kushtetuese për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë.

Ligji Nr. 04/L-115
31 gusht 2012

Shpallur me dekretin Nr.DL-036-2012, datë 04.09.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr.25 / 7 SHTATOR 2012, PRISHTINË

LIGJI Nr. 03/L-121
PËR GJYKATËN KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Përmbajtja

Kreu I: Organizimi i gjykatës kushtetuese 908
Kreu II: Procedura 914
Kreu III: Procedurat e veçanta 918
Kreu IV: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 923

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Me qëllim të rregullimit të mëtejshëm të organizimit dhe funksionimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR GJYKATËN KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KREU I
ORGANIZIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE

1. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1
Fushëveprimi

Ky ligj rregullon më tej organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, procedurat për paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesave pranë Gjykatës Kushtetuese, kushtet dhe procedurat për emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, kualifikimet tjera përkatëse për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, parimet dhe rregullat themelore procedurale dhe çështje tjera organizative.

Neni 2
Organizimi i punës së Gjykatës Kushtetuese

1. Gjykata Kushtetuese gëzon pavarësi organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës ("Kushtetuten") dhe me ligj.

2. Gjykata Kushtetuese përcakton organizimin e vet të brendshëm, rregulloren e punës, proceset e vendimmarrjes dhe çështje të tjera organizative në pajtim me ligjin.

Neni 3
Selia dhe simbolet

1. Selia e Gjykatës Kushtetuese është në Prishtinë.
2. Gjykata Kushtetuese zhvillon seancat në selinë e saj, por përjashtimisht, me vendimin e saj mund të zhvilloj seanca edhe në vendet tjera të Republikës së Kosovës.
3. Gjykata Kushtetuese ka simbolin dhe vulën e vet të cilat përcaktohen me rregullore të punës.

2. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese

Neni 4
Kushtet shtesë për emërimin e gjyqtareve

1. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të jenë:
   1.1. shtetas të Republikës së Kosovës;
   1.2. jurist të shquar me reputacion të shkëlqyeshëm profesional me jo më pak se dhjetë (10) vjet përvojë pune profesionale veçanërisht në fushën e së drejtës publike dhe kushtetuese të dëshmuar, *mes tjerash,* përmes punës profesionale si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, shërbyes civil ose mësimdhënës universitar dhe punë tjera të rëndësishme të natyrës juridike;
   1.3. individ me reputacion të shkëlqyeshëm moral, të cilët kanë aftësi të plotë veprimi dhe të cilët nuk janë dënuar për vepër penale.

Neni 5
Papajtueshmëria e funksionit

1. Gjatë mandatit të tij gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk ka të drejtë të jetë:
   1.1. anëtar i një partie, lëvizje ose çfarëdo organizate tjetër politike;
   1.2. anëtar i bordit drejtues të një ndërmarrje publike, shoqërie tregtare ose organizate jo qeveritare;
   anëtar i një sindikate;
2. Përveç ndalesave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk ka të drejtë të ushtrojë ndonjë detyrë tjetër publike apo profesionale për të cilën shpërblehet me pagesë, përveç ushtrimit të funksionit të ligjëruesit të shkencave juridike në një universitet të akredituar. Për qëllime të këtij ligji, nuk konsiderohet detyrë publike apo profesionale nëse gjyqtari pa pagesë merret me veprimtari shkencore, apo pa pagesë angazhohet si anëtar në institute ose shoqata të juristëve, në organizata humanitare, kulturore, sportive dhe organizata tjera, përderisa këto aktivitete nuk kanë lidhje me punën e ndonjë partie politike.

3. Gjyqtari i propozuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk mund të emërohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës nëse nuk paraqet dëshmi se ka dhënë dorëheqje nga funksionet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.
4. Secili gjyqtar ka për detyrë të njoftojë Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese me shkrim për çdo aktivitet që kryen jashtë funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese për të cilën kompensohet me mëditje ose çfarëdo forme tjetër të kompensimit. Në rast se Kryetari i Gjykatës Kushtetuese shpreh kundërshtimin e vet, gjyqtari ka të drejtë të kërkojë që vendimi i Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të rishqyrtohet nga të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. Vendimi i tillë mund të hidhet poshtë nga shumica e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Neni 6
Procedura për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese

1. Me këtë ligj themelohet Komisioni i posaçëm për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë "Komisioni"). Ky Komision i paraqet Kuvendit listën e ngushtë të kandidatëve të kualifikuar për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, në pajtim me procedurën e përcaktuar në këtë nen.
2. Komisioni përbëhet nga këta anëtarë:
   2.1. Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës apo një anëtar i Kuvendit përfaqësues i deleguar i tij/saj;
   2.2. Udhëheqësit e secilit grup parlamentar të Kuvendit të Republikës së Kosovës apo anëtarët e Kuvendit përfaqësues të deleguar të tyre;
   2.3. Kryetari i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës;
   2.4. Avokati i Popullit;
   2.5. Përfaqësuesi i Këshillit Konsultativ për Komunitete;
   2.6. Përfaqësuesi i Gjykatës Kushtetuese.
3. Komisionin e thërret dhe kryeson Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës apo përfaqësuesi i deleguar i tij/saj. Komisioni ka dy zëvendës kryesues të cilët zgjidhen në mesin e anëtarëve të tij, ku njëri nga ta do të jetë nga radhët e deputetëve të komunitetit tjetër nga komuniteti i kryesuesit.
4. Komisioni vendos me shumicën e thjeshtë të votave. Në rast të votimit të barabartë, vota e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës apo përfaqësuesit të tij/saj të deleguar është vendimtare.
5. Në rast se ndonjëri nga anëtaret e Komisionit ka konflikt të interesit në lidhje me rastin, atëherë ai/ajo nuk merr pjesë në punën e Komisionit për atë rast.
6. Procedurën për përcaktimin e listës së ngushtë të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese e fillon Komisioni. Komisioni publikon thirrjen/ftesën në media të shkruara dhe elektronike duke përfshirë edhe ato të cilat kryesisht lexohen nga komunitetet që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës, të Kuvendit, institucioneve gjyqësore, fakulteteve juridike, Odës së Avokatëve, shoqatave të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, partive politike, personave të tjerë relevant juridik dhe individëve që të propozojnë kandidat për zgjedhjen e një apo më shumë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë ftesa/thirrja). Një person mund të propozojë veten për kandidat.

7. Në thirrje/ftesë ceken kushtet për zgjedhjen e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese të përcaktuara me Kushtetutë dhe me këtë ligj, afati për paraqitjen e propozimit për kandidatin Komisionit, i cili nuk duhet të jetë më i shkurtër se 15 apo më i gjatë se 20 ditë, dhe dokumentet përcjellëse të cilat dorëzohen me propozim.
8. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në paragrafin e mëparshëm, Komisioni, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, shqyrton nëse kandidatët e propozuar i plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese të përcaktuara me Kushtetutë dhe me këtë ligj, dhe hedhë poshtë kandidaturat që nuk plotësojnë këto kushte. Në zbatimin e kësaj përgjegjësie, Komisioni aplikon përvojat e krijuara për përzgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve tjerë të gjyqësorit në Republikën e Kosovës.
9. Komisioni zhvillon intervistë me secilin kandidat i cili plotëson kushtet për tu zgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese dhe në bazë të të dhënave të paraqitura dhe rezultateve të intervistës, përgatitë listën e ngushtë të kandidateve të kualifikuar për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese.
10. Lista e ngushtë përmban më shumë kandidatë sesa numri i gjyqtarëve të cilët do të zgjedhën, por jo më tepër se pesë (5) kandidatë për një post të lirë.
11. Komisioni, bashkangjitur me listën e ngushtë, i dërgon Kuvendit të Republikës së Kosovës listën e të gjithë kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese.
12. Propozimi i Komisioni përmban arsyetim përse Komisioni ju ka dhënë përparësi disa kandidatëve në krahasim me kandidatët tjerë.

Neni 7
Emërimi dhe fillimi i mandatit

1. Procedura për emërimin e gjyqtarit të ri, sipas këtij ligji, fillon të paktën tre (3) muaj para përfundimit të mandatit të rregullt të gjyqtarit paraprak.
2. Mandati i gjyqtarit të ri fillon në ditën kur përfundon mandati i gjyqtarit paraprak. Gjyqtari i ri emërohet nga Presidenti dhe e jep betimin para Presidentit para fillimit të mandatit të tij. Në rast se mandati i gjyqtarit përfundon sipas nenit 8 të këtij ligji mandati i gjyqtarit zëvendësues fillon në ditën kur emërohen nga Presidenti dhe japin betimin para Presidentit.
3. Përjashtimisht prej paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, mandati i gjyqtarëve të parë të Gjykatës Kushtetuese fillon në ditën kur emërohen nga Presidenti dhe japin betimin para Presidentit.
4. Teksti i betimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese është si vijon:
"Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës do t'i qëndroj besnik Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe do të ushtroj funksionin e gjyqtarit me nder, përgjegjësi dhe paanshmëri, duke e respektuar rregullat e etikës profesionale."

Neni 8
Përfundimi i mandatit

1. Mandati i Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese përfundon me:

1.1. skadimin e kohës së rregullt për të cilën është zgjedhur;
1.2. ndërprerjen e mandatit para kohe sipas nenit 9 te këtij ligji.

2. Gjashtë muaj para përfundimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, sipas pikës 1.1. të paragrafit 1 të këtij neni, Kryetari i Gjykatës njofton Kuvendin e Republikës së Kosovës me qëllim që të filloj procedurën për propozimin e gjyqtarit të ri.

Neni 9
Përfundimi i mandatit para kohës

1. Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese i pushon mandati para skadimit të kohës së rregullt për të cilën është zgjedhur në rast të:
   1.1. dorëheqjes;
   1.2. vdekjes;
   1.3. humbjes së përhershme të aftësisë së veprimit të konstatuar nga gjykata kompetente;
   1.4. sëmundjes apo problemeve të tjera shëndetësore, të cilat e bëjnë të pamundur ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese;
   1.5. shkarkimit sipas nenit 118 të Kushtetutës.
2. Përfundimi i mandatit sipas pikës 1.4. të paragrafit 1 të këtij neni duhet të bazohet në vendimin e marrë nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese pas shqyrtimit të të gjitha analizave dhe konstatimeve relevante mjekësore. Miratimi i vendimi sipas nenit në fjalë kërkon 2/3 e shumicës së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, me përjashtim të gjyqtarit mandati i të cilit është nën shqyrtim.

Neni 10
Detyrat e gjyqtarëve

1. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese kanë për detyrë të ushtrojnë me ndërgjegje dhe në mënyrë të paanshme funksionin e gjyqtarit dhe të vendosin sipas bindjes së lirë në pajtim me Kushtetutën.
2. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese kanë për detyrë të ruajnë reputacionin dhe dinjitetin e Gjykatës Kushtetuese.
3. Secili gjyqtar ka për detyrë të marrë pjesë në punën dhe procesin e vendimmarrjes së Gjykatës, si dhe të kryej punët tjera të caktuara me ligj dhe me rregulloren e punës.

Neni 11
Kryetari dhe Zëvendës Kryetari

1. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese:
   1.1. koordinon aktivitetet e Gjykatës Kushtetuese dhe punën e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese;
   1.2. thërret dhe drejton seancat verbale të Gjykatës Kushtetuese;
   1.3. përfaqëson Gjykatën Kushtetuese;
   1.4. nënshkruan aktet e Gjykatës Kushtetuese;

1.5. kryen detyra të tjera të përcaktuara me këtë ligj ose me rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese.

2. Zëvendëskryetari i Gjykatës Kushtetuese ushtron detyrat e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese kur ky i fundit mungon ose për çfarëdo arsye tjetër nuk është në gjendje të ushtrojë detyrat e tij. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese mund t'ia delegojë Zëvendëskryetarit disa detyra të caktuara për të mbështetur Kryetarin në ushtrimin e detyrave të tij.

3. Administrimi i Gjykatës Kushtetuese

Neni 12
Sekretaria

1. Gjykata Kushtetuese ka Sekretarinë e vet e cila kryesohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese.
2. Sekretaria kryen punët administrative dhe ka për detyrë të mbështesë punën e Gjykatës Kushtetuese. Sekretaria:
   2.1. pranon dhe dërgon të gjitha shkresat dhe komunikimet tjera zyrtare;
   2.2. mban regjistrin e Gjykatës;
   2.3. siguron incizimet e përcaktuara me ligj;
   2.4. përgatitë transkriptet dhe procesverbalet;
   2.5. kryen punët e informimit publik dhe përgjigjet në kërkesa për informata lidhur me punën e Gjykatës Kushtetuese;
   2.6. mban vulën e Gjykatës Kushtetuese; dhe
   2.7. kryen punët tjera të përcaktuara me ligj dhe me rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese.
3. Organizimi dhe mënyra e punës së Sekretarisë rregullohen me rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese.
4. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e Sekretarisë. Sekretari përzgjidhet dhe emërohet nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese me shumicë të votave. Hollësitë lidhur me përzgjedhjen, emërimin, kushtet e punës dhe pagën e Sekretarit të Përgjithshëm përcaktohen në rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese. Sekretari i Përgjithshëm i raporton Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese dhe për punën e tij i'u përgjigjet të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.
5. Sekretari i Përgjithshëm emëron dhe shkarkon të punësuarit e Sekretarisë në pajtim me ligjin në fuqi për shërbimin civil. Ndaj të punësuarve të Sekretarisë zbatohen dispozitat ligjore për shërbyesit civil.

Neni 13
Këshilltarët Juridik

Këshilltarët juridik mbështesin punën profesionale të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Kushtet për emërimin, shkarkimin, dhe statusin e këshilltarëve juridik caktohen me rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese. Pagat e këshilltarëve juridik caktohen në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 14
Buxheti

1. Gjykata Kushtetuese financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës.
2. Pavarësisht nga dispozitat e ligjeve tjera, Gjykata Kushtetuese përgatit propozimin e buxhetit të saj vjetor dhe i'a dërgon propozimin e tillë për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës. As Qeveria apo ndonjë organizatë tjetër buxhetore nuk ka të drejtë të ndryshojë ose në çfarëdo mënyre tjetër të modifikojë ose të ndikojë në propozimin e buxhetit të përgatitur nga Gjykata Kushtetuese. Buxheti i propozuar nga Gjykata Kushtetuese përfshihet në tërësi në propozimin për Buxhetin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës që i paraqitet Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim.
3. Gjykata Kushtetuese menaxhon në mënyrë të pavarur buxhetin e saj dhe i nënshtrohet auditimit të brendshëm dhe si dhe auditimit të jashtëm nga Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës.

Neni 15
Pagat e Gjyqtareve

Paga e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese është 1.3 herë sa ajo e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.

KREU II
PROCEDURA

1. Dispozitat e përgjithshme procedurale

Neni 16
Rregulli i përgjithshëm

1. Dispozitat e kësaj pjese zbatohen ndaj të gjitha procedurave gjyqësore para Gjykatës Kushtetuese, përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë ligj.
2. Në rast të mungesës së dispozitave procedurale, Gjykata zbaton në mënyrë të arsyeshme dhe analoge dispozitat përkatëse të ligjeve tjera procedurale duke marrë parasysh natyrën e çështjes, si dhe veçoritë e procedurës para Gjykatës Kushtetuese.

Neni 17
Parimi i Publicitetit

1. Seancat, përfshirë edhe shpallja e aktgjykimeve janë të hapura për publikun.
2. Gjykata Kushtetuese mund të vendosë të përjashtojë publikun kur vlerëson që është e nevojshme për ruajtjen e:
   2.1. sekretit shtetëror, rendit ose moralit publik;
   2.2. informacionit të fshehtë i cili do të rrezikohej nga shqyrtimi publik;
   2.3. jetës private ose sekretit afarist të palës në procedurë.

3. Procedura për përjashtimi e publikut nga paragrafi 2 mund të iniciohet me kërkesën e palës.
4. Gjatë procesit të këshillimit dhe votimit në kuadër të marrjes së vendimit nga Gjykata Kushtetuese, marrin pjesë vetëm gjyqtarët.

Neni 18
Përjashtimi i gjyqtarit

1. Gjyqtari përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurë sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës kur gjyqtari:
   1.1. është i përfshirë në çështjen e cila është objekt i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese;
   1.2. është në lidhje martesore ose jashtëmartesorë ose në lidhje familjare më një palë në procedurë, në pajtim me ligjin në fuqi; ose
   1.3. sipas detyrës zyrtare është marrë më herët me çështjen para se ajo t'i jetë referuar Gjykatës Kushtetuese.
2. Gjykatësi nuk është i përfshirë në çështje në kuptimin e paragrafit 1, pika 1.1. vetëm pse i takon një grupi shoqëror ose gjinor, një profesioni ose një partie politike interesat e së cilës mund të preken nga rezultati i procesit para Gjykatës Kushtetuese.
3. Paragrafi 1, pika 1.3. nuk përfshin pjesëmarrjen në procedurë legjislative si dhe shprehjen e mendimit profesional ose akademik për një çështje juridike, e cila mund të jetë me rëndësi për procesin para Gjykatës Kushtetuese.
4. Vendimi për përjashtimin e gjyqtarit duhet të jetë i arsyetuar.
5. Gjyqtari i cili ka njohuri se plotëson të paktën njërin prej kushteve për përjashtim nga procedura, ka për detyrë ta njoftojë me shkrim Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese dhe të kërkojë përjashtimin e tij/saj nga procedura. Në këtë rast, paragrafët 3 dhe 4 zbatohen përshtatshmërish.

Neni 19
Marrja e vendimeve

1. Gjykata Kushtetuese vendos si trup gjykues i përbërë prej të gjithë gjyqtarëve të pranishëm të Gjykatës Kushtetuese.
2. Gjykata Kushtetuese ka kuorum nëse janë të pranishëm shtatë (7) gjyqtarë.
3. Gjykata Kushtetuese merr vendime me shumicën e votave të gjyqtarëve që janë të pranishëm dhe që votojnë.
4. Secili gjyqtar është i obliguar për të votuar për ose kundër vendimit.

Neni 20
Vendimet

1. Gjykata Kushtetuese vendosë mbi çështjen pas mbarimit të seancës së shqyrtimit verbal. Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shqyrtimi verbal.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, sipas vlerësimit të saj, gjykata mund të vendosë mbi çështjen që është objekt shqyrtimi kushtetues mbi bazën e shkresave të lëndës.

3. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese duhet të jenë në formë të shkruar, të arsyetuara dhe nënshkruara, nga kryetari i gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtari raportues. Përfundimet e arritura nga shumica e gjyqtareve përcaktojnë vendimin e gjykatës. Vendimet shpallen publikisht.
4. Vendimi i dërgohet secilës palë sipas detyrës zyrtare dhe shpallet në Gazetën Zyrtare.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, përveç nëse Gjykata Kushtetuese në vendim ka caktuar ndryshe.

Neni 21
Përfaqësimi

Palët gjatë procesit para Gjykatës Kushtetuese përfaqësohen vet ose nga një përfaqësues i autorizuar nga pala.

Neni 22
Procedimi i kërkesës

1. Fillimi i procedurës para Gjykatës Kushtetuese bëhet përmes paraqitjes së kërkesës në gjykatë. Kërkesat dorëzohen me shkrim në Sekretarinë e Gjykatës Kushtetuese. Sekretaria regjistron menjëherë të gjitha kërkesat në regjistrin e Gjykatës Kushtetuese sipas radhës në të cilën janë parashtruar. Kërkesat duhet të jenë të arsyetuara dhe atyre duhet të ju bashkëngjiten provat e nevojshme.
2. Sekretaria ia dërgon nga një kopje të kërkesës palës kundërshtare dhe palës (palëve) apo pjesëmarrësve të tjerë në procedurë. Pala kundërshtare ka dyzet e pesë (45) ditë nga pranimi i kërkesës për të dorëzuar në Sekretari përgjigjen e saj në kërkesë së bashku me arsyetimin dhe provat e nevojshme.
3. Sekretari ia dërgon kërkesën dhe përgjigjen në kërkesë gjyqtarit raportues i cili përgatit raportin paraprak lidhur me faktet, lejueshmërinë dhe themelësinë e kërkesës. Gjyqtari raportues caktohet nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese sipas procedurës së përcaktuar në rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese.
4. Nëse kërkesa ose përgjigja në kërkesë nuk është e qartë ose e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të qartësuar ose plotësuar kërkesën, përkatësisht përgjigjen në kërkesë. Gjyqtari raportues ka të drejtë të kërkojë prova shtesë, nëse kjo është e nevojshme për të vlerësuar lejueshmërinë dhe themelësinë e kërkesës.
5. Brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i kërkesës dhe përgjigjes në kërkesë gjyqtari raportues ia dërgon kolegjit shqyrtues raportin paraprak. Në rast se përgjigja në kërkesë nuk dorëzohet brenda afatit të paraparë ose sipas natyrës së procedurës së veçantë nuk kërkohet një përgjigje në kërkesë, gjyqtari raportues përgatit raportin paraprak vetëm në bazë të kërkesës.
6. Kolegji shqyrtues vlerëson lejueshmërinë e kërkesës. Kolegji shqyrtues përbëhet nga tre gjyqtarë të caktuar nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese sipas procedurës së përcaktuar në rregulloren e punës.
7. Nëse kolegji shqyrtues unanimisht vjen në përfundim se kërkesa nuk i plotëson kushtet formale për procedim të mëtutjeshëm dhe për këtë shkak nuk është e

lejueshme, kolegji ia dërgon të gjithë gjyqtarëve propozim-vendimin me të cilin hidhet poshtë kërkesa për shkak të mungesës së lejueshmërisë. Kolegji shqyrtues merr të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që të siguroj se kopja e propozim-vendimit u është dërguar gjyqtarëve që mund të mos jenë në territorin e Republikës së Kosovës.

8. Nëse brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve prej pranimit të propozim-vendimit gjyqtarët që nuk kanë qenë anëtarë të kolegjit shqyrtues nuk kundërshtojnë këtë propozim-vendim, atëherë Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e nënshkruan dhe e shpall vendimin me të cilin hidhet poshtë kërkesa për shkak të mungesës së lejueshmërisë.
9. Në rast se kolegji shqyrtues vjen në përfundim se kërkesa është e lejueshme apo nëse të paktën njëri prej gjyqtarëve që nuk ka qenë anëtar i kolegjit shqyrtues kundërshton propozim-vendimin me të cilin hidhet poshtë kërkesa, lënda i dërgohet trupit gjykues. Trupi gjykues gjatë shqyrtimit verbal shqyrton në tërësi lejueshmërinë dhe themelësinë e kërkesës dhe merr vendim sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 23
Tërheqja e palës

Gjykata Kushtetuese do të vendosë për çështjet që i'u janë referuar në mënyrë ligjore nga ana e palëve të autorizuara pavarësisht tërheqjes së palës nga procedura.

Neni 24
Shqyrtimi verbal

Shqyrtimi verbal kryesohet nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese. Procedura e shqyrtimit verbal përcaktohet në rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese.

Neni 25
Provat

Procedura e administrimit dhe shqyrtimit të provave përcaktohet në rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese.

Neni 26
Bashkëpunimi me organet tjera publike

Të gjitha gjykatat dhe organet publike të Republikës së Kosovës kanë për detyrë të mbështesin punën e Gjykatës Kushtetuese dhe të bashkëpunojnë me Gjykatën Kushtetuese sipas kërkesës së saj.

Neni 27
Masat e përkohshme

1. Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa te përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës,

nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.
2. Kohëzgjatja e masave të përkohshme duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale.

Neni 28
Shpenzimet e procedurës

1. Palët i bartin shpenzimet e tyre të procedurës, përveç nëse Gjykata Kushtetuese vendos ndryshe.
2. Pala e cila ka ngritur kërkesë sipas nenit 113, pika 7 të Kushtetutës lirohet nga detyrimi për mbulimin e shpenzimeve të procedurës nëse Gjykata Kushtetuese vendos se kërkesa në fjalë është e lejueshme dhe e bazuar.

KREU III
PROCEDURAT E VEÇANTA

1. Procedura në rastet e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 2 (1) dhe (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Neni 29
Saktësimi i kërkesës

1. Kërkesa e ngritura në pajtim me nenin 113 paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrohen nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Republikës se Kosovës, nga Presidenti i Republikës se Kosovës, Qeveria ose nga ana e Avokatit të Popullit.
2. Kërkesa e ngritur kundër aktit të kontestuar sipas nenit 113 paragrafi 2 të Kushtetutës duhet të specifikoje, inter alia, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën.
3. Kërkesa do të specifikoj kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.

Neni 30
Afatet

Kërkesa e ngritur ne pajtim me nenin 29 te këtij ligji duhet të parashtrohet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit te kontestuar.

2. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 3 (1) të Kushtetutës

Neni 31
Saktësimi i kërkesës

Kërkesa e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 3 (1) të Kushtetutës parashtrohet nga cilado palë e autorizuar në konflikt ose nga cilado palë e autorizuar dhe qe cenohet

drejtpërdrejtë nga i njëjti konflikt. Kërkesa përmban çfarëdo informate te dobishme ne lidhje me konfliktin e supozuar ne pajtueshmëri me rregullat e procedurës së Gjykatës Kushtetuese.

Neni 32
Afatet

Kërkesa e ngritur në bazë te nenit 31 te këtij ligji parashtrohet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve nga çasti i lindjes së konfliktit.

3. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 3 (2) të Kushtetutës

Neni 33
Saktësimi i Kërkesës

Kërkesa e ngritur në bazë te nenit 113, paragrafi 3, pika 2 te Kushtetutës parashtrohet nga Kuvendi i Republikës se Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës ose nga Qeveria. Kërkesa përmban çfarëdo informate te nevojshme në lidhje papajtueshmërinë e supozuar me Kushtetutën dhe referendumin e propozuar ashtu siç përcaktohet me rregullat e procedurës se Gjykatës Kushtetuese.

Neni 34
Afati

1. Gjykata Kushtetuese vendos për kushtetushmërinë e referendumit të propozuar brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të kërkesës.
2. Referendumi, i cili është objekt it kërkesës se ngritur në bazë te nenit 33 të këtij ligji mbahet vetëm pasi që Gjykata Kushtetuese vendos se referendumi i propozuar është në pajtim me kushtetutën.

4. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 3 (3) të Kushtetutës

Neni 35
Afati

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese i marrë ne pajtim me Nenin 113, paragrafi 3, pika 3 te Kushtetutës, mund te merret në afat prej njëzetekatër (24) orësh nga hyrja ne fuqi e vendimit te lartpërmendur.

5. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 3 (4) të Kushtetutës

Neni 36
Efekti suspensiv

Ngritja e kërkesës sipas nenit 113, paragrafi 3, pika 4 të Kushtetutës ka efekt pezullues. Kuvendi i Republikës se Kosovës vepron në bazë të ndryshimit te kontestuar vetëm pasi është marrë vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

Neni 37
Afati

Gjykata Kushtetuese vendos mbi kërkesën e ngritur nga palët e autorizuara sipas nenit 113, paragrafi 3 (4) të Kushtetutës brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

6. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 3 (5) të Kushtetutës

Neni 38
Saktësimi i kërkesës

1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 3 (5) të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:
   1.1. përshkrimin e fakteve për shkeljen e pretenduar(supozuar);
   1.2. dispozitat konkrete të Kushtetutës për të cilat pretendohet se janë shkelur; dhe
   1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet pretendimi për shkeljen kushtetuese.

Neni 39
Afatet

Kërkesa duhet të parashtrohet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e shterjes së mjeteve tjera juridike.

7. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 4 të Kushtetutës

Neni 40
Saktësimi i kërkesës

Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 4 të Kushtetutës, komuna paraqet, ndër të tjera, informatat përkatëse në lidhje me ligjin apo aktin e kontestuar të Qeverisë, cila dispozitë e Kushtetutës supozohet se është shkelur dhe cilat përgjegjësi apo të hyra komunale janë prekur nga një ligj apo akt i tillë.

Neni 41
Afatet

Kërkesa duhet të dorëzohet brenda një (1) viti pas hyrjes në fuqi të dispozitës ligjore apo aktit të qeverisë që kontestohet nga ana e komunës.

8. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 5 të Kushtetutës

Neni 42
Saktësimi i kërkesës

1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:
   1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetushmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit te Republikës së Kosovës;
   1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe
   1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti.

Neni 43
Afati

1. Një ligj apo vendim i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje pas mbarimit të afatit të përcaktuar në pajtim me nenin 113, paragrafi 5 i Kushtetutës.
2. Në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit te Republikës se Kosovës kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, ligji apo vendim i tillë mund ti dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar.
3. Në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese duhet të nxjerrë vendim mbi kontestin jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas dorëzimit të kërkesës.

9. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës

Neni 44
Saktësimi i kërkesës

1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:
   1.1. përshkrimin e fakteve për shkeljen e pretenduar(supozuar);
   1.2. dispozitat konkrete të Kushtetutës për të cilat pretendohet se i ka shkelur Presidenti; dhe
   1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet pretendimi për shkeljen e rëndë të Kushtetutës nga Presidenti i Republikës.

Neni 45
Afatet

Kërkesa duhet të parashtrohet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve që nga dita kur shkelja e pretenduar kushtetuese nga ana e Presidentit është bërë publike.

10. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 7 të Kushtetutës

Neni 46
Lejueshmëria

Gjykata Kushtetuese pranon dhe procedon kërkesën e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nëse konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara ligjore.

Neni 47
Kërkesa individuale

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48
Saktësimi i kërkesës

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
Afatet

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi.

Neni 50
Kthimi në gjendjen e mëparshme

Nëse parashtruesi pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, Gjykata Kushtetuese ka për detyrë që në bazë të kërkesës së parashtruesit ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme. Parashtruesi ka për detyrë të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës dhe të arsyetojë kërkesën në fjalë. Kthimi në gjendjen e mëparshme nuk lejohet nëse ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë ligj.

11. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës

Neni 51
Saktësimi i kërkesës

1. Kërkesa e ngritura në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës do të parashtrohet nga gjykata vetëm nëse ligji i kontestuar duhet zbatohet drejtpërsëdrejti në çështjen që është pjesë e lëndës në shqyrtim dhe vetëm nëse ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit nga ana e gjykatës.
2. Kërkesa do të specifikoj cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën.

Nenin 52
Procedura para gjykatës

Pas ngritjes së kërkesës në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës, procedura para gjykatës referuese do të suspendohet deri në nxjerrjen e një vendimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

Neni 53
Vendimi

Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për pajtueshmërinë e dispozitës ligjore me Kushtetutën dhe nuk vendos për çështje të tjera faktike ose juridike që kanë të bëjnë me kontestin para gjykatës referuese.

12. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 9 të Kushtetutës së Kosovës

Neni 54
Afati

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, sipas mundësisë, duhet të merret brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të kërkesës.

KREU IV
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 55
Përbërja e përkohshme e Gjykatës Kushtetuese

1. Për periudhën e përcaktuar në nenin 152 të Kushtetutës, përbërja e Gjykatës kushtetuese do të jetë sikurse është përcaktuar në atë nen.
2. Asgjë në këtë ligj, përfshirë dispozitat të cilat rregullojnë kriteret për përshtatshmëri, kualifikime profesionale dhe kompensim për gjyqtarët, nuk

aplikohen për të penguar apo ndryshe kufizuar kompetencat dhe përgjegjësitë e autoriteteve kompetente për emërimin e gjyqtarëve ndërkombëtar, të përcaktuar në Kushtetutën dhe Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Republikës së Kosovës, të datës 26 mars 2007. Këto përgjegjësi dhe kompetenca ushtrohen në pajtim me instrumentet e aplikueshme pavarësisht ndonjë dispozite të këtij ligji.

Neni 56
Rastet Paraprake

Afatet e përcaktuara në këtë ligj për fillimin e një procedure për çështjet për të cilat është kompetente Gjykata Kushtetuese dhe të cilat janë ngritur para hyrjes në fuqi të këtij ligji fillojnë të llogariten në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 57
Sekretaria e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese

Themelohet sekretaria e përkohshme e Gjykatës Kushtetuese. Sekretaria e përkohshme e Gjykatës Kushtetuese do të vepron deri në kohën kur Sekretaria e Gjykatës Kushtetuese e përcaktuar ne nenin 12 të këtij ligji te jetë funksionale. Sekretaria e përkohshme kryen detyrat ne pajtim me mjetet e aplikueshme deri ne kohën kur Sekretari i Përgjithshëm, i emëruar në pajtim me nenin 12 te këtij ligji vendos qe Sekretariati te jetë funksional.

Neni 58
Hyrja ne Fuqi

Ky ligj hyn ne fuqi pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-121
16 Dhjetor 2008

Shpallur me dekretin Nr. DL-070-2008, datë 30.12.2008 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI IV / Nr. 46 / 15 JANAR 2009

LIGJI Nr. 04/L-115
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË KANË TË BËJNË ME PËRFUNDIMIN E MBIKËQYRJES NDËRKOMBËTARE TË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË KANË TË BËJNË ME PËRFUNDIMIN E MBIKËQYRJES NDËRKOMBËTARE TË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Neni 1
Qëllimi

1. Ky ligj ka për qëllim të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve në vijim për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës:
   1.1. Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
   1.2. Ligjit Nr. 03/L-075 për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës;
   1.3. Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
   1.4. Ligjit Nr. 03/L-079 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale;
   1.5. Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
   1.6. Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04 L 101 për Fondet Pensionale të Kosovës;
   1.7. Kodit Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë;
   1.8. Ligji Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat;
   1.9. Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat;
   1.10. Ligji Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
   1.11. Ligji Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
   1.12. Ligji Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë;
   1.13. Ligji Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme;
   1.14. Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës;
   1.15. Ligji Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativ të Komunave;

1.16. Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës;
1.17. Ligji Nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës;
1.18. Ligji Nr. 03/L-237 për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave;
1.19. Ligji Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës;
1.20. Ligji Nr. 03/L-082 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës.
1.21. Ligji Nr. 03/L-033 për Statusin, imunitetet dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin e Kosovës dhe praninë ndërkombëtare ushtarake, si dhe personelin e saj.

Neni 2
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Ligji)

1. Neni 15 i ligjit bazik pas paragrafit 1. shtohet paragraf i ri 2. me tekstin si në vijim:
   2. Gjykatësit ndërkombëtarë, të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë ligj, vazhdojnë të marrin pagën e tyre të specifikuar sipas vendimit për emërim. Qeveria e Kosoves merr pjesë në pagesën e gjykatësve ndërkombëtarë, në periudhën e përcaktuar në vlerë të pagave të gjyqtarëve vendorë.
2. Neni 55 i ligjit bazik, paragrafi 1. dhe paragrafi 2 fshihen nga teksti i ligjit dhe shtohet një paragraf i ri me tekstin si në vijim:
   Mandati i gjykatësve ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim.

Neni 3
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-075 për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës (Ligji)

1. Neni 8 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 8

Auditori i përgjithshëm, i emëruar në përputhje me Kushtetutën dhe me këtë ligj, vazhdon të qëndrojë në post deri në përfundim të mandatit, me kompensimin e cekur në kushtet specifike të emërimit të tij. Qeveria e Kosovës siguron fonde në vlerën e përcaktuar me marrëveshjen në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Zyrës se Auditorit të përgjithshëm.

Neni 4
Ndryshimet dhe plotësimet Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji)

1. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1.12, që përkufizon Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar, fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Kuvendi pas propozimit nga qeveria zgjedh tre (3) anëtarë ndërkombëtarë drejtorë të bordit. Bordi, po ashtu, emëron një shtetas të Kosovës drejtor të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit, i cili nuk do të jetë anëtar i Bordit. Bordi, përveç kryesuesit, po ashtu, emëron zëvendëskryesues njërin prej anëtarëve të tij. Për emërimin, shkarkimin ose ndryshimin e kushteve të referimit të Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit kërkohet vota afirmative e shumicës së Bordit të Drejtorëve. Anëtarët ndërkombëtarë zgjedhën më mandat deri më 31 gusht 2014.

3. Neni 14 i ligjit bazik, paragrafët 7., dhe 9., vlejnë deri në përfundimin e mandatit të anëtarëve ndërkombëtarë të bordit.
4. Neni 31 i ligjit bazik, pas paragrafit 5. shtohet një paragraf i ri 6. me tekstin si në vijim:
   6. Nëse një anëtar ndërkombëtar i bordit i emëruar në pajtim me nenin 31 (5) jep dorëheqje nga Bordi dhe nëse kjo dorëheqje ose largim nga posti ndodh deri më 31 gusht 2014 atëherë ai/ajo do të zëvendësohet me një ndërkombëtar tjetër.

Neni 5
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-079 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale (Ligji)

1. Neni 4 i ligjit bazik që ndryshon nenin 5.2 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   5.2. Bordi mbikëqyrës përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve të cilët emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryeministri.
2. Neni 8 i ligjit bazik që ndryshon nenin 6.1 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   6.1. Sekretaria Ekzekutive ka drejtorin dhe zëvendësdrejtorin të cilët emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryeministri.
3. Neni 10 i ligjit bazik që ndryshon nenin 7.1 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   7.1. Komisioni përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të cilët emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.
4. Neni 13 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 13

Kuvendi, në konsultim me Komisionin, mund të themelojë panele shtesë të Komisionit, anëtarët e të cilëve do të emërohen në bazë të neneve 7.1 dhe 7.2.

5. Neni 16 i ligjit bazik që ndryshon nenin 12.8 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   12.8. Gjykata Supreme e Kosovës vendos lidhur me ankesat në trupin gjykues prej tre (3) gjyqtarëve të cilët emërohen nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës.
6. Pas nenit 27 të ligjit bazik, shtohet një nen i ri 27.A me tekstin si në vijim:

Neni 27.A

1. Mandati i tre (3) anëtarëve ndërkombëtarë të Bordit mbikëqyrës (përfshi edhe kryesuesin), i drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive, i dy (2) anëtarëve ndërkombëtarë të Komisionit (përfshi edhe kryesuesin), si dhe i dy gjykatësve ndërkombëtarë në panelet e ankimit të Gjykatës Supreme të cilët janë emëruar në pajtim me Kushtetutën do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim.
2. Anëtarët dhe gjykatësit ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë Ligj vazhdojnë të marrin pagën e tyre të specifikuar sipas kushteve të emërimit të tyre.
3. Qeveria e Kosoves do të sigurojë fonde për drejtorin e Sekretariatit Ekzekutive të barabartë me pagën e një anëtari vendor të Bordit Mbikëqyrës.
4. Nëse një anëtar ndërkombëtar i emëruar ne pajtim me Kushtetutën jep dorëheqje ose largohet nga pozita e tij/saj dhe nëse ky largim ose dorëheqja ndodh para datës 31 gusht 2014, atëherë ai/ajo do të zëvendësohet me një ndërkombëtar, të dominuar nga Kryeministri për pozitat e anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë së Pronës dhe drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive, si dhe të nominuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme për pozitën e anëtarëve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Anëtareve të Panelit të Ankesave të Gjykatës Supreme, pas konsultimeve me PSBE.

Neni 6
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.3. fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.7, riformulohet me tekstin si në vijim:
   1.7. **Gjykatës Ndërkombëtar** - çdo gjykatës i Misionit Evropian për Politika të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, i cili është emëruar në pajtim me këtë ligj.
3. Neni 11 i ligjit bazik, paragrafi 2. riformulohet me tekstin si në vijim:
   2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Dhoma e Posaçme do të vazhdojë të respektojë dhe zbatojë parimin e kompensimit në vend të kthimit fizik. Kur vendoset për mjetin juridik që do të jepet në një rast të caktuar, Dhoma e Posaçme do të marrë parasysh edhe dispozitat në fuqi të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, duke përfshirë qëllimet publike që përcaktohen në preambulën e atij ligji.

Neni 7
Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04 L-101 për fondet pensionale të Kosovës

1. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 4.6, riformulohet me tekstin si në vijim:
   4.6. Komisioni për përzgjedhje, i propozon kandidatët Kuvendit për vendet e lira në anëtarësim ose për riemërim të anëtarëve të Bordit Drejtues. Komisioni për Përzgjedhje do të përbëhet nga guvernatori i BQK-së - kryesues, Auditori i

Përgjithshëm dhe Ministri i Financave. Mandati i secilit anëtar të emëruar në Bordin Drejtues zgjat tre vjet, me mundësi të rizgjedhjes, nëse mandati i anëtarëve të Bordit skadon dhe asnjë anëtar i ri nuk është emëruar, atëherë anëtarët e Bordit ekzistues do të vazhdojnë mandatin për nëntëdhjetë (90) ditë.

Neni 8
Ndryshimet dhe plotësimet e Kodit Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë (Kodi)

1. Neni 309 i ligjit bazik që rregullon emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave me pëlqimin e PCN-së, fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 1 i Aneksit D, i Kodit, fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 1

Ky Aneks ofron përjashtimet e posaçme të përkufizuara në këtë Aneks që do t'i jepen bashkësive fetare sipas përkufizimit në legjislacionin e aplikueshëm, duke përfshirë edhe legjislacionin për liritë fetare në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Neni 9
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat (Ligji)

1. Neni 1 i ligjit bazik, paragrafi 1.32, që përkufizon PCN-në fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 8 i ligjit bazik paragrafi 2. në rreshtin e tretë fshihet fjala “dhe PCN”.
3. Neni 88 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 10
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-199 për gjykatat (ligji)

1. Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 11, riformulohet me tekstin si në vijim:
   11. Nëse në njërën nga komunat e reja dhe të themeluara mbi bazën e Ligjit për Kufijtë Administrativë Komunal nuk ka gjykatë themelore, komuna me vendim të Kuvendit Komunal mund ta parqet kërkesën para Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK) për të vendosur mbi themelimin e gjykatës themelore në territorin e saj, ose që një nga gjykatat ekzistuese themelore në territorin e komunës tjetër të ketë juridiksion mbi territorin e komunës së re. Të njëjtën të drejtë e ka edhe komuna ekzistuese, ku shumica e popullatës i takon komunitetit jo shumicë në Kosovës, dhe në të cilën nuk ka gjykatë themelore.
      11.1. KGjK do të aprovojë kërkesat e tilla, përveç nëse vlerësohet se ngarkesat e lëndëve për atë juridiksion është e pamjaftueshme për ta arsyetuar ekzistimin e gjykatës së ndarë.
      11.2. Kur KGjK e aprovon kërkesën për themelimin e gjykatës së re

themelore, autoritetet kompetente do t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se cilado gjykatë e re, është themeluar dhe funksionale brenda periudhës gjashtë mujore prej datës së vendimit.

11.3. Nëse KGjK nuk aprovon kërkesën për themelimin e gjykatës së re themelore, ose kur komuna i kërkon gjykatës ekzistuese që të ketë juridiksion për territorin e vet, autoritetet kompetente do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për përmirësimin e qasjes në drejtësi për komunitetet lokale, e cila është vështirësuar për shkak të izolimit gjeografik, mungesës së sigurisë, ose për shkak të faktorëve të tjerë relevant. Këto masa mund të përfshijnë krijimin në kuadër të territorit të komunës së re, të një departamenti të gjykatës themelore ekzistuese prej së cilës komuna e re ka kërkuar të ketë kompetencë për territorin e vet, ose që gjykata themelore të mundësojë mbajtjen e seancave në territorin e komunës së re.

2. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Përbërja e Gjykatës së Apelit pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Republikës së Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore. Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin përkatës në fuqi, si dhe për të siguruar pjesëmarrjen e komunitetit në gjyqësor, pesëmbëdhjetë (15) për qind e numrit të tërësishëm të ulëseve në Gjykatën e Apelit, por jo më pak se dhjetë ulëse, garantohen për gjyqtarët nga radha e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

Neni 11
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.2. fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 1.3, riformulohet me tekstin si në vijim:

1.3. Për të siguruar se gjykatat pasqyrojnë përbërjen etnike të zonës së tyre të juridiksionit në përputhje me nenin 104(3) të Kushtetutës dhe me legjislacionin përkatës në fuqi, Këshilli do të marrë parasysh që të plotësojë vendet e lira të punës ose të ulëseve të rezervuara me anëtarë të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

3. Neni 7 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 7
Mandati i anëtarëve të Këshillit

Anëtarët e Këshillit zgjidhen me mandat 5 (pesë) vjeçar, siç ceket në nenin 108 (6) të Kushtetutës dhe në këtë ligj. Një anëtar i këtij Këshilli mund të zgjidhet për një mandat shtesë jo-vijues pesë (5) vjeçar.

4. Neni 16 i ligjit bazik, paragrafi 3., riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Në përputhje me nenin 104(3) të Kushtetutës, Këshilli zbaton masa dhe veprimet tjera me qëllim rekrutimi, të cilat i konsideron të nevojshme dhe të përshtatshme për të siguruar se një gjykatë ose degë e gjykatës pasqyron përbërjen etnike në zonën e tyre të juridiksionit.

5. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 1., riformulohet si në vijim:
   1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ndërmerr masa të nevojshme për të rritur numrin e gjyqtarëve nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë, prej radhëve të atyre gjyqtarëve që shërbejnë në Kosovë. Për të përmbushur përgjegjësitë e veta, Këshilli, ndër të tjera, nga aplikantët njëlloj të kualifikuar për të shërbyer si gjyqtarë u jep përparësi anëtarëve nga komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovës, ashtu siç është paraparë me nenin 108 të Kushtetutës.
6. Neni 17 i ligjit bazik, pas paragrafit 5., shtohen tre paragraf të rinjë 6, 7 dhe 8, me tekstin si në vijim:
   6. Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të hartojë një rregullore të veçantë për të përshkruar procesin e emërimit dhe të riemërimit të gjykatësve nga komunitetet e nën-përfaqësuara në mesin e gjykatësve që shërbejnë në Kosovë.
   7. Dhënia e përparësisë për kandidatët me kualifikime të barabarta nga komunitetet e nën-përfaqësuara, do të zbatohet përderisa përqindja e gjyqtarëve pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë në Kosovë të jetë nën pesëmbëdhjetë përqind (15%) dhe / përderisa përqindja e gjyqtarëve të cilët janë pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, të jetë nën tetë (8%).
   8. Mandati i dy anëtarëve ndërkombëtarë të Këshillit të emëruar në pajtim me Kushtetutën do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim. Anëtarët ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë ligj vazhdojnë të marrin pagën e tyre.
   9. Neni 52 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 12
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.7, fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 1.3 riformulohet me tekstin si në vijim:
   1.3. Siguron se prokuroritë pasqyrojnë përbërjen etnike të zonës së tyre të juridiksionit në përputhje me nenin 109 (4) dhe 110(3) të Kushtetutës.
3. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Këshilli zbaton masa dhe veprime rekrutimi, si dhe masa të tjera të cilat i konsideron të nevojshme për të siguruar që një zyrë prokuroriale pasqyron përbërjen etnike të zonës së juridiksionit përkatës.
4. Neni 17 i ligjit bazik, pas paragrafit 3. shtohet një paragraf i ri 4. me tekstin si në vijim:
   4. Këshilli harton rregullore të veçantë për të përshkruar procesin e emërimit dhe të riemërimit të prokurorëve nga komunitetet e nën-përfaqësuara në mesin e prokurorëve që shërbejnë në Kosovë.
5. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 1., riformulohet me tekstin si në vijim:
   1. Këshilli ndërmerr masa të nevojshme për të rritur numrin e prokurorëve nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë. Kur ka aplikantë njëlloj të kualifikuar për të shërbyer si prokurorë, Këshilli u jep përparësi anëtarëve nga komunitetet që janë të nënpërfaqësuara në Kosovë siç është paraparë edhe me nenin 109 (4) dhe 110 (3) të Kushtetutës.

6. Neni 18 i ligjit bazik, pas paragrafit 5, shtohet paragrafi i ri 6, me tekstin si në vijim:
   6. Dhënia e përparësisë për kandidatët me kualifikime të barabarta nga komunitetet e nën-përfaqësuara, do të zbatohet përderisa përqindja e prokuroreve pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë në Kosovë të jetë nën pesëmbdhjetë përqind (15%) dhe / ose përderisa përqindja e prokurorëve të cilët janë pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, të jetë nën tetë përqind (8%).

Neni 13
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë (Ligji)

1. Pjesa e parë e preambulës se ligjit, riformulohet me tekstin si në vijim:
   Në bazë të nenit 65 (1) dhe ne pajtim me dispozitat kalimtare dhe përfundimtare nga kreu XIII dhe XIV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Pas nenit 7 të ligjit bazik shtohet një nen i ri 7.A me tekstin si në vijim:

Neni 7.A
Statusi i Kishës Ortodokse Serbe

1. Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë konsiderohet pjesë përbërëse e Kishës Ortodokse Serbe (KOS).
2. Emri dhe organizimi i brendshëm i Kishës Ortodokse Serbe, duke përfshirë edhe hierarkinë dhe veprimtaritë e saj, do të respektohen.
3. Nuk do të ketë ndalim arbitrar për hyrje në Kosovë ose qëndrim brenda Kosovës për priftërinjtë, kandidatët për prift, murgjve, murgeshave dhe vizitorëve.
4. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 7.3, fjalët "**themelojnë dhe**", fshihen nga teksti i ligjit.
5. Neni 8 i ligjit bazik, paragrafi 1, riformulohet me tekstin si në vijim:
   1. Ndërtesat dhe objektet që u takojnë bashkësive fetare, që janë të dedikuara për kryerjen e ceremonive fetare konsiderohen të pacenueshme për sa i përket ndërhyrjes së autoriteteve qeveritare dhe në to mund të hyhet vetëm me pëlqimin e institucionit përkatës fetar, përveç nëse është lëshuar ndonjë urdhër gjyqësor për shkak të aktiviteteve ilegale dhe në rast të rrezikut për jetën ose shëndetin.
6. Neni 12 i ligjit bazik, pas paragrafit 12.4 shtohet një paragraf i ri 12.5 me tekstin si në vijim:
   12.5. Përveç përjashtimeve të përmendura më lart, bashkësitë fetare gëzojnë privilegje doganore dhe tatimore për veprimtari ekonomike, që janë specifike për vetë-qëndrueshmërinë e tyre financiare, siç do të definohet me një akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e financave. Këto privilegje përfshijnë importimin dhe blerjen e produkteve qenësore për prodhim, të materialeve, pajisjeve dhe bagëtisë; dhe eksportimin e produkteve që dalin nga aktivitetet e lartpërmendura.

Neni 14
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1. përkufizimi "**Propozimin Gjithëpërfshirës**", fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Objekt i shpronësimit sipas këtij ligji mund të jenë të drejtat private pronësore dhe të drejtat tjera private për ose ndaj një prone të paluajtshme, me përjashtim të asaj prone të paluajtshme që bën pjesë në atë kategori të pronës, për të cilën Kushtetuta në mënyrë specifike thotë se nuk do të jetë objekt i shpronësimit.
3. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3, shtohet nën-paragraf i ri 3.1. me tekstin si në vijim:
   3.1 Prona e luajtshme dhe e paluajtshme, si dhe asetet tjera të Kishës Ortodokse Serbe do të jenë të pacenueshme dhe nuk do të jenë objekt i shpronësimit.

Neni 15
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (ligji)

1. Pas nenit 3 shtohet nen i ri 3.A me tekstin si në vijim:

Neni 3.A
Të drejtat e refugjatëve dhe personave të zhvendosur

1. Të gjithë refugjatët nga Kosova dhe personat e zhvendosur brenda vendit do të kenë të drejtën e kthimit dhe kërkimit të pronës së tyre dhe posedimeve personale, në pajtim me ligjet vendore dhe ndërkombëtare. Çdo person do të ketë të drejtë të marrë vendim të lirë dhe të jetë i informuar për vendin ku ai kthehet.
2. Institucionet e Republikës së Kosovës ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të krijuar kushte te favorshme për kthim të sigurt dhe të denjë të refugjatëve dhe personave të zhvendosur, bazuar në vendimet e tyre të lira dhe të bazuara në informata të sakta, përfshirë përpjekjet për të promovuar dhe mbrojtur lirinë e tyre të lëvizjes dhe mbrojtjen nga kërcënimi
3. Kushtet e kthimit të personave të zhvendosur dhe mekanizmat e bashkëpunimit me institucionet relevante ndërkombëtare do të përcaktohen nga institucionet e Republikës së Kosovës në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e aplikueshme."

Neni 16
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativë të Komunave (ligji)

1. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Bordi do të përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë, me nga pesë (5) përfaqësues të zgjedhur nga secila komunë dhe një (1) përfaqësues i zgjedhur nga Kryeministri.

2. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 4. riformulohet me tekstin si në vijim:
   4. Kryesuesi i Bordit përzgjidhet nga Kryeministri.
3. Neni 14 i ligjit bazik, fshihet termi **"dhe PCN do të ndërmarrin"** dhe zëvendësohet me termin: "**ndërrmer**".
4. Në Shtojcën 1 (Zonat Kadastrale) të ligjit bazik, emërtimi i komunës "**Hani i Elezit**" në gjuhën serbe dhe angleze ndryshohet në "**Elez Han**"

Neni 17
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës (ligji)

1. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi (c) riformulohet me tekstin si në vijim:
   (c) Një (1) anëtar, i përzgjedhur nga Kryeministri.
2. Neni 14 i ligjit bazik, paragrafi (b), nënparagrafi (iv) riformulohet me tekstin si në vijim:
   iv. Një (1) anëtar, i përzgjedhur nga Kryeministri.

Neni 18
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës (ligji)

1. Titulli i nenit 29 të ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 29
Regjistrimi dhe përcaktimi i shtetësisë

Neni 19
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-237 për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave (Ligji)

1. Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 4.12., riformulohet me tekstin si në vijim:
   4.12 Një (1) përfaqësues nga një prej Universiteteve publike, anëtar;

Neni 20
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës (ligji)

1. Neni 9 i ligjit bazik, paragrafi 3., riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Forca e Sigurisë së Kosovës është e strukturuar dhe e përgatitur për të përmbushur funksionet e sigurisë që nuk i përkasin policisë ose organizatave tjera për zbatim të ligjit.
2. Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 2., riformulohet me tekstin si në vijim:
   2. Forca e Sigurisë së Kosovës është e armatosur lehtë dhe nuk ka armë të rënda, siç janë tanket, artileria e rëndë ose kapacitete sulmuese ajrore. Një rishikim i plotë i këtyre kufizimeve, do të bëhet jo më herët se pesë vjet nga koha e hyrjes në fuqi e Ligjit Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Detyrat fillestare të Forcës së Sigurisë së Kosovës janë:

3. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 2, pika (e) fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 21
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-082 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës (ligji)

1. Neni 5 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 22
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-033 për Statusin, imunitetet dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin e Kosovës dhe praninë ndërkombëtare ushtarake, si dhe personelin e saj

1. Neni 3 i ligjit bazik paragrafi 2. pika (a) riformulohet me tekstin si në vijim:
   (a) Zyra Civile Ndërkombëtare dhe Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian.
2. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3.3. Individët e emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtarë, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, mandati i të cilëve nuk ka përfunduar para deklarimit të përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur gëzojnë statusin, privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara në ligjin bazik.
3. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 6., riformulohet me tekstin si në vijim:
   4.6. Ministri i Punëve të Jashtme nuk mund t'i shpallë PSBE-në ose një anëtar të personelit të tij, anëtarët e personelit të ICO-së, përfshirë individët e përcaktuar në nenin 3.3. të ligjit bazik ose anëtarët e misionit EULEX, si persona non grata.
4. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 7. fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 23

1. Të gjithë anëtarët ndërkombëtarë të emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, në pajtim me Kushtetutën e Republikës se Kosovës, me përjashtim të atyre të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Agjencisë Kosovare të Pronës gjyqtarët ndërkombëtarë të Panelit të Ankesave të Gjykatës Supreme, dhe dy gjyqtarë në Komisionin për Kërkesa Pronësore, nëse për çfarëdo arsye largohen nga pozita para datës 31 gusht 2014 ai/ajo do të zëvendësohet me një anëtar vendor.
2. Nëse në cilindo ligj të aplikueshëm në Republikën e Kosovës përdoren termet ICO ose PCN, të njëjtat shfuqizohen dhe zëvendësohen me institucionet vendore përkatëse.

II. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 24
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të amendamenteve kushtetuese për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë.

Ligji Nr. 04/L-115
31 gusht 2012

Shpallur me dekretin Nr.DL-036-2012, datë 04.09.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr.25 / 7 SHTATOR 2012, PRISHTINË

LIGJI Nr. 03/L-052
PËR PROKURORIN SPECIALE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 937
Kreu II: Kompetenca e veçantë e PSRK-së 940
Kreu III: Kompetenca plotësuese e PSRK-së 943
Kreu IV: Juridiksioni për lëndët e hetuara ose të ndjekura penalisht nga PSRK-ja dhe transferimi i përgjithshëm i lëndëve 949
Kreu VI: Dispozitat përfundimtare 951

Në mbështetje të Kapitullit IV neni 65 pika 1 si dhe kapitulli i VII neni 109 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me qëllim të themelimit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Miraton:

LIGJIN PROKURORIN SPECIALE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Themelimi i PSRK-së

1.1. Prokuroria speciale e Republikës së Kosovës (më tej "PSRK") themelohet me anë të këtij ligji si një organ prokurorial i përhershëm dhe i specializuar që vepron në kuadër të Prokurorit të Shtetit të Kosovës.
1.2. Selia e PSRK-së do të jetë në Prishtinë.

Neni 2
Përkufizimet

Për qëllimet e këtij ligji:
- **"EULEX KOSOVË"-** do të thotë Misioni i Politikës Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje i vendosur në Kosovë nga Bashkimi Evropian;
- **"Shefi i Komponentit të Drejtësisë"-** do të thotë personi që i përket EULEX KOSOVË e që është përzgjedhur dhe emëruar nga autoriteti kompetent që të punojë në Kosovë në këtë pozitë specifike;

- **"Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it"-** do të thotë gjyqtari që i përket EULEX KOSOVË e që është përzgjedhur dhe emëruar nga autoriteti kompetent për të punuar në Kosovë në këtë pozitë specifike;
- **"Kryeprokuror EULEX-it"-** do të thotë prokurori që i përket EULEX KOSOVË e që është përzgjedhur dhe emëruar nga autoriteti kompetent për të punuar në Kosovë në këtë pozitë specifike;
- **"Prokuror i EULEX-it"-** do të thotë prokurori që i përket EULEX KOSOVË e që është përzgjedhur dhe emëruar nga autoriteti kompetent për të punuar në Kosovë në këtë pozitë specifike;
- **"Prokuroria publike e Kosovës"-** do të thotë organi i pavarur publik me përgjegjësi për të kryer hetimin e veprave penale, zbulimin dhe mbledhjen e provave dhe informatave më qëllim të fillimit dhe zhvillimit të procedurës penale, ndjekjen e personave të dyshuar për vepra penale, dhe kryerjen e funksioneve siç parashihen me ligjin në fuqi;
- **"Kryeprokuror publik i Kosovës"-** do të thotë prokurori publik që udhëheq Prokurorinë publike të Kosovës;
- **"Kryeprokuror i zyrës"-** do të thotë prokurori publik që udhëheq prokurorinë komunale a të qarkut për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet në pajtim me ligjin në fuqi;
- **"Prokuror publik i Kosovës"-** do të thotë shtetasi i Kosovës i emëruar si prokuror sipas ligjit në fuqi;
- **"Prokuror special"-** do të thotë prokurori i EULEX-it ose prokurori publik i Kosovës që punon në PSRK;
- **"Agjenci për zbatimin e ligjit"-** do të thotë policia e Kosovës dhe ndonjë organ apo agjenci tjetër e themeluar në Kosovë që në mënyrë legjitime mund të ushtrojë kompetenca të ngjashme dhe funksione tipike me ato të policisë së Kosovës në pajtim me ligjin në fuqi; ky përkufizim përfshin edhe policinë e EULEX-it;
- **"Ligji në fuqi"-** do të thotë ligji në fuqi në Kosovë në përputhje me Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 1999/24 mbi Ligjin në fuqi në Kosovë, dhe çfarëdo akti tjetër të ardhshëm normativ të nxjerrë në Kosovë nga organi kompetent pas miratimit të këtij ligji;
- **"KPPK"-** do të thotë Kodi i përkohshëm penal i Kosovës, i shpallur me anë të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2003/25;
- **"KPPPK"-** do të thotë Kodi i përkohshëm i procedurë penale i Kosovës i shpallur me anë të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2003/26;
- **"KPSFRJ"-** do të thotë Kodi penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, i ndryshuar dhe publikuar në Gazetën zyrtare nr. 44/76 të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë;
- **"LPK"-** do të thotë Ligji penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, i ndryshuar dhe publikuar në Gazetën zyrtare nr. 25/77 të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës;
- **"Dita e tranzicionit"-** do të thotë dita në të cilën EULEX KOSOVË fillon mandatin e vet në Kosovë.

Neni 3
Përbërja dhe kompetencat e PSRK-së

3.1. PSRK-ja do të përbëhet nga dhjetë prokurorë publik të Kosovës.

3.2. Prokurorët publik të Kosovë që do të punojnë si prokurorë special do të jenë ata të cilët, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë përzgjedhur dhe emëruar në përputhje me procedurat e përcaktuara sipas ligjin në fuqi, për të punuar në Prokurorinë speciale të Kosovës siç është përcaktuar më herët me anë të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2006/15.

3.3. Pa marrë parasysh dispozitat e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, edhe prokurorët publik tjerë të Kosovës kanë të drejtë që të punojnë si prokurorë special. Ata përzgjidhen dhe emërohen sipas procedurave të përcaktuara në përputhje me ligjin në fuqi.

3.4. Përbërja e PSRK-së mund të ndryshohet sipas nevojave dhe ngarkesës me punë të zyrës dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara sipas ligjit në fuqi.

3.5. Prokurorët special do të kenë kompetencë dhe përgjegjësi për të ushtruar funksionet e tyre, duke përfshirë edhe kompetencat dhe përgjegjësinë për të zhvilluar hetime dhe ndjekur penalisht krimet që janë në kompetencë të veçantë dhe plotësuese të PSRK-së, në të gjitha prokuroritë dhe gjykatat që veprojnë në Kosovë.

3.6. Çdo herë që PSRK-ja merr përgjegjësi për një lëndë që është në kompetencë të saj të veçantë a plotësuese, organet e zbatimit të ligjit dhe prokurorët që punojnë në Kosovë do t'i ofrojnë PSRK-së tërë ndihmën e kërkuar më qëllim të ushtrimit të drejtë të funksioneve dhe mandatit të kësaj zyre.

3.7. PSRK-ja mund të bashkërendojë dhe drejtojë hetimin dhe ndjekjen penale të lëndëve që janë në kompetencë të saj të veçantë a plotësuese nëpërmjet zyrave të prokurorëve të ndryshëm që punojnë në Kosovë. Prokurorët special do të kërkojnë dhe marrin ndihmë nga Kryeprokurorët që punojnë në Kosovë në çdo kohë që ata veprojnë për të bashkërenduar dhe drejtuar hetimin dhe ndjekjen penale të lëndëve për të cilat PSRK-ja ka marrë përgjegjësi.

3.8. Me autorizimin e Kryeprokurorit të PSRK-së, prokurorët special mund të delegojnë tek çdo prokuror që punon në Kosovë ndërmarrjen e aktiviteteve dhe veprimeve të veçanta të procedurës penale ose kryerjen e hetimeve apo ndjekjen penale të lëndëve për të cilën PSRK-ja ka marrë përgjegjësi.

3.9. Kryeprokurori i PSRK-së do të informojë, brenda afatit të përgjithshëm që do të përcaktohet nga Kryeprokurori publik i Kosovës, Kryeprokurorin e zyrës që ka juridiksion mbi lëndën, lidhur me autorizimin e dhënë në pajtim me paragrafin 8 të këtij neni. Kryeprokurori i zyrës mund të kërkojë nga Kryeprokurori i PSRK-së të rishqyrtojë vendimin lidhur me delegimin e veprimeve të veçanta procedurale apo të hetimit a ndjekjes specifike penale.

3.10. Prokurori i identifikuar sipas paragrafit 8 të këtij neni do të njoftojë menjëherë Kryeprokurorin e PSRK-së pas ndërmarrjes së aktivitetit ose veprimit, dhe do t'ia dorëzojë prokurorit special përgjegjës për hetimin a ndjekjen penale, të gjitha informatat, dokumentet dhe dosjet përkatëse të mbledhura sipas aktivitetit ose veprimit të deleguar procedural.

3.11. Në rrethana të delegimit të një hetimi a ndjekje të veçantë të rastit, prokurori i

identifikuar sipas paragrafit 8 të këtij neni do të informojë prokurorin special përgjegjës lidhur me zhvillimet përkatëse që kanë të bëjnë me procedurën. Në çdo kohë gjatë procedurës Kryeprokurori i PSRK-së do të ketë kompetencë që të tërheq, për arsye të besueshme, hetimin ose ndjekjen e deleguar.

Neni 4
Kryeprokurori i PSRK-së

4.1. Kryeprokuror i PSRK-së do të zgjidhet njëri nga prokurorët speciale në pajtim me procedurat e përcaktuara sipas ligjit në fuqi.
4.2. Kryeprokurori i PSRK-së do të drejtoj aktivitetet e PSRK-së dhe të personelit të saj nën mbikëqyrjen e përgjithshme të Kryeprokurorit publik të Kosovës.
4.3. Kryeprokurori i PSRK-së do të jetë përgjegjës për menaxhimin e PSRK-së dhe do të nxjerrë udhëzime të brendshme që rregullojnë aktivitetet e kësaj zyre dhe që janë në përputhje me ligjin në fuqi. Kryeprokurori i PSRK-së mund të kërkojë këshilla nga prokurorët special lidhur me përmbajtjet specifike të udhëzimeve të brendshme çdo herë që kjo është e nevojshme për funksionimin më të mirë të zyrës.
4.4. Kryeprokurori i PSRK-së do të përfaqësojë PSRK-në para personave dhe institucioneve tjera vendore, ndërkombëtare, publike dhe private. Kryeprokurori i PSRK-së mund të caktojë një prokuror tjetër special që të përfaqësojë PSRK-në para personave dhe institucioneve tjera vendore, ndërkombëtare, publike dhe private sipas nevojave dhe ngarkesës me punë të zyrës.
4.5. Kryeprokurori i PSRK-së ose ndonjë prokuror tjetër special i caktuar nga ai do të jetë përgjegjës për t'ju dhënë mediave informata lidhur me aktivitetin e PSRK-së. Në kryerjen e kësaj detyre, Kryeprokurori i PSRK-së ose personi i caktuar nga ai do t'ju përmbahet parimeve të konfidencialitetit dhe nuk do t'ia zbulojë publikut ose personave të paautorizuar informatat e ndjeshme.
4.6. Në rrethana kur PSRK-ja bashkëpunon me organizatat dhe institucionet tjera vendore dhe ndërkombëtare, Kryeprokurori publik i Kosovës do të jetë përgjegjës për të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me publikimin e të dhënave dhe informatave në pajtim me ligjin në fuqi dhe në përputhje me modalitetet e përcaktuara me anë të marrëveshjeve përkatëse me organizatat dhe institucionet e njëjta.
4.7. Në rast të mungesës së tij, Kryeprokurori i PSRK do të caktojë një prokuror special që të ushtrojë funksionet e Kryeprokurorit të PSRK-së. Kryeprokurori i ZPKS-së t'ia delegojë funksionet e veta plotësisht ose pjesërisht një prokurori special të caktuar për një periudhë të caktuar kohore.

KREU II
KOMPETENCA E VEÇANTË E PSRK-së

Neni 5
Kompetenca e veçantë e PSRK-së

5.1. PSRK-ja do të ketë kompetencë të veçantë që të hetojë dhe ndjek penalisht krimet, edhe të atyre në formë të tentimit, dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në krim si vijon:

a) kryerjen e akteve të terrorizmit (neni 110, KPPK),
b) moslajmërimi i përgatitjes së veprave penale (neni 303, KPPK), moslajmërimi i veprave penale apo moslajmërimi i kryerësit të saj (neni 304, KPPK) dhe dhënia e ndihmës kryerësve (neni 305, KPPK) kur këto vepra kryhen në lidhje me terrorizmin (ndihma në kryerjen e veprave terroriste - neni 111, KPPK);
c) lehtësimi i kryerjes së terrorizimit (neni 112, KPPK), organizimi, përkrahja dhe pjesëmarrja në grupet terroriste (neni 113, KPPK)
d) gjenocidi (neni 116, KPPK);
e) krimet kundër njerëzimit (neni 117, KPPK);
f) krimet e luftës në kundërshtim të rëndë me konventat e Gjenevës (neni 118, KPPK), krimet e luftës si shkelje e rëndë e ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktin e armatosur ndërkombëtar (neni 119, KPPK), krimet e luftës për shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët me konventat e Gjenevës (neni 120, KPPK), krimet e luftës të cilat paraqesin shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë në karakterit ndërkombëtar (neni 121, KPPK);
g) sulmet në konfliktet e armatosura të një karakteri jo ndërkombëtar kundër instalimeve që përmbajnë forca të rrezikshme (neni 122, KPPK);
h) rekrutimi dhe regjistrimi i personave midis moshës pesëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet në konfliktin e armatosur (neni 123, KPPK);
i) përdorimi i mjeteve ose i metodave të ndaluara të luftimit (neni 124, KPPK);
j) organizimi i grupeve për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës (neni 128, KPPK);
k) rrezikimi i personave në mbrojtje ndërkombëtare (neni 141, KPPK);
l) përvetësimi i paligjshëm, shfrytëzimi, transferi dhe vendosja e materialeve nukleare (neni 144, KPPK);
m) kërcënimi për përdorimin ose kryerjen e vjedhjes a të plaçkitjes së materialit nuklear (neni 145, KPPK);
n) krimi i organizuar (neni 274, KPPK), kërcënimi gjatë procedurave penale për krim të organizuar (neni 310, KPPK);
o) veprat penale të paraqitura në nenin 10 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi Pengimin e larjes së parave dhe veprave të ngjashme penale.

5.2. Në pajtim me ligjin në fuqi para hyrjes në fuqi të KPPK-së, PSRK-ja gjithashtu do të ketë kompetencë të veçantë për hetimin dhe ndjekjen e krimeve, edhe të atyre në formë të tentimit, dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në krim si vijon:
a) terrorizmi (neni 125, KPRSFJ), krimet e përcaktuara sipas neneve 2, 3, 4, 5 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/12 mbi Ndalimin e terrorizmit dhe akteve tjera të ngjashme sipas përkufizimeve të paraqitura në nenin 1 të Rregullore së UNMIK-ut nr. 2001/12 dhe duke marrë parasysh dispozitat e nenit 6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/12;
b) të gjitha krimet e paraqitura në nenet 141-155 të KPRSFJ-së.

5.3. Para fillimi të gjykimit kryesor, PSRK-ja do të ketë kompetencë që t'i marrë

përsipër lëndët që janë në kompetencë të saj të veçantë dhe që janë hetuar a ndjekur penalisht nga organet kompetente në pajtim me ligjin në fuqi.

Neni 6
Ushtrimi i kompetencës së veçantë të PSRK-së

6.1. Të gjithë prokurorët që punojnë në Kosovë do të informojnë Kryeprokurorin e zyrës së tyre për ndonjë raport penal verbal ose me shkrim, apo për ndonjë lëndë që aktualisht është nën hetime a ndjekje, nga i cili është e arsyeshme që të besohet se krimi i paraqitur në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 5 të këtij ligji mund të jetë kryer.

6.2. Informata e paraparë sipas në paragrafit 1 të këtij neni do t'i përcjellët Kryeprokurorit përkatës sa me shpejtë që të jetë e mundur dhe në çdo rast brenda afatit të përgjithshëm që do të përcaktohet nga Kryeprokurori publik i Kosovës. Në raste urgjente, prokurorët do t'ia përcjellin informatën Kryeprokurorit brenda një afati me të shkurtër të përcaktuar po ashtu nga Kryeprokurori publik i Kosovës.

6.3. Kryeprokurori i zyrës do ta informojë Kryeprokurorin e PSRK-së dhe Kryeprokurorin publik të Kosovës sa më shpejtë që të jetë e mundur dhe në çdo rast brenda afatit të përgjithshëm që do të përcaktohet nga Kryeprokurori publik i Kosovës për çdo raport penal verbal a me shkrim apo për çdo lëndë për të cilën ai është njoftuar në përputhje me dispozitat e paraqitura në paragrafin 2 të këtij neni.

6.4. Në rast se Kryeprokurori i PSRK-së pajtohet që raporti penal ose lënda sipas paragrafit 3 të këtij neni në mënyrë të arsyeshme bie në kompetencë të veçantë të PSRK-së, atëherë Kryeprokurori publik do t'ia dërgojë raportin penal ose lëndën së bashku me të gjitha dokumentet dhe dosjet përkatëse Kryeprokurorit të PSRK-së.

6.5. Kryeprokurori do të sigurojë që të dhënat dhe informatat e ndjeshme të mos ju zbulohen personave të paautorizuar gjatë dorëzimit të raporteve penale, dosjeve të lëndës dhe të gjitha dokumenteve dhe dosjeve tjera përkatëse. Dorëzimi do të bëhet brenda afatit të përgjithshëm që do të përcaktohet nga Kryeprokurori publik i Kosovës nga koha kur Kryeprokurori i PSRK-së t'i këtë dhënë Kryeprokurorit të qarkut pëlqimin e tij në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni.

6.6. Prokurori përgjegjës për hetim që ka përcjellë informatën sipas paragrafit 1 të këtij neni do të jetë përgjegjës për çdo veprim procedural të nevojshëm për zhvillimin e shpejtë të hetimit a ndjekjes përderisa PSRK-ja të marrë përgjegjësinë për atë hetim a ndjekje.

6.7. Të gjitha vendimet e marra nga organet gjyqësore të cilat janë kompetente për të zhvilluar procedurën derisa PSRK-ja të marrë përgjegjësinë për hetim ose ndjekje do të mbesin të vlefshme dhe në fuqi.

6.8. Komandantët rajonal të policisë së Kosovës do t'ia dorëzojnë Kryeprokurorit të PSRK-së, sa me shpejtë që të jetë e mundur dhe në çdo rast brenda afatit të përgjithshëm që do të përcaktohet nga Ministria e Punëve të Brendshme, kopjen e raportit fillestar ose të njoftimit të krimit që agjencitë e zbatimit të ligjit që veprojnë nën kompetencat e tyre mund të kenë nxjerrë lidhur me sjelljet e supozuara kriminale që kanë ndodhur në territorin e kompetencës së tyre, për të

cilat janë njoftuar prokurorët përkatës dhe që mund të jenë në kompetencë të veçantë të PSRK-së. Komandantët rajonal mund të shtojnë vërejtje në shkresat e tyre dhe mund t'ua delegojnë detyrat e tyre komandantëve të stacioneve në Kosovë që janë nën autoritetin e tyre ashtu siç përcaktohet me anë të këtij neni.

Neni 7
Trasferimi i lëndëve nga PSRK-ja

Pasi që PSRK-ja të ketë marrë përgjegjësinë për një hetim a ndjekje penale në pajtim me dispozitat e paraqitura në paragrafin 3 të nenit 5 ose paragrafin 4 të nenit 6 të këtij ligji, dhe Kryeprokurori i PSRK-së beson se nuk ka, apo nuk ka arsye tjera që PSRK-ja të ushtrojë kompetencën e vet të veçantë, atëherë do të aplikohen mutatis mutandis dispozitat e paraqitura në paragrafët 1-11 të nenit 14 të këtij ligji.

Neni 8
Kompetenca e veçantë e PSRK-së për lëndët e deleguara nga gjykatat ndërkombëtare

PSRK-ja do të ketë kompetencë të veçantë për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet, duke përfshirë format e ndryshme të tentimeve dhe të bashkëpunimit në krime të cilat mund të referohen nga organet kompetente të gjykatave ndërkombëtare, siç janë Tribunali ndërkombëtar për krime në ish-Jugosllavi i themeluar me anë të Rezolutës nr. 827 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, tek autoritetet e Kosovës për hetim dhe/ose ndjekje në përputhje me procedurat e përcaktuara sipas ligjit në fuqi dhe me marrëveshjet ndërmjet organeve kompetente.

KREU III
KOMPETENCA PLOTËSUESE E PSRK-së

Neni 9
Kompetenca plotësuese e PSRK-së

9.1. PSRK-ja do të ketë kompetencë plotësuese, sipas modaliteteve të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet, edhe të atyre në formë të tentimit, dhe format e ndryshme të bashkëpunimin në krim si në vijon:
   a) sulm kundër rendit juridik të Kosovës (neni108, KPPK);
   b) nxitja e urrejtjes, e përçarjes ose e mos durimit kombëtar, racor, fetar a etnik (neni 115, KPPK);
   c) rrëmbimi i fluturakes (neni 132, KPPK);
   d) rrezikimi i sigurisë së aviacionit civil (neni 133, KPPK), rrezikimi i sigurisë së lundrimit detar (neni 134, KPPK), rrezikimi i sigurisë së platformave fikse të vendosur në pragun kontinental (neni 135, KPPK), piratëria (neni 136, KPPK);
   e) kontrabandimi me emigrantë (neni 138, KPPK);
   f) trafikimi me njerëz (neni 139, KPPK);
   g) rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to (neni 142, KPPK);

h) vrasja (neni 146, KPPK), vrasja e rëndë (neni 147, KPPK);
i) marrja e pengjeve (neni 143, KPPK);
j) shkelja e statusit të barabartë të banorëve të Kosovës (neni 158, KPPK);
k) rrëmbimi i personit (neni 159, KPPK);
l) tortura (neni 165, KPPK);
m) veprat penale kundër integritetit seksual të paraqitura në nenet 193-204 të KPPK-së çdoherë që ato janë të dënueshme me pesë ose më tepër vite burgim duke marrë parasysh maksimumin e sanksionimit të mundshëm të paraparë me ligj;
n) blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike (neni 229, KPPK), prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm dhe i substancave psikotropike (neni 230, KPPK);
o) shkaktimi i bankrotimit (neni 234, KPPK), dëmtimi i kreditorëve (neni 235 KPPK), keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi (neni 236, KPPK), lidhja e kontratave të dëmshme (neni 237, KPPK);
p) falsifikimi i parasë (neni 244, KPPPK);
q) organizimi i skemave piramidale dhe i bixhozit të paligjshëm (neni 243, KPPK), shmangia nga tatimi (neni 249, KPPK);
r) pranim i paarsyeshëm i dhuratave (neni 250, KPPK), dhënia e pa arsyetueshme e dhuratave (neni 251, KPPK);
s) rastet e rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes (neni 256, KPPK), Mashtrimi (neni 261);
t) shtrëngimi (neni 267, KPPK);
u) furnizimi, transporti, prodhimi ose shitja e paautorizuar e armëve (neni 327, KPPK);
v) pjesëmarrja në grup që kryen vepër penale (neni 320, KPPK);
w) shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit (neni 339, KPPK), pranimi i ryshfetit (neni 343, KPPK), dhënia e ryshfetit (neni 344, KPPK))
x) përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës (neni 340, KPPK), mashtrimi në detyrë (neni 341, KPPK).

9.2. Sipas modaliteteve të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji dhe në pajtim me ligjin në fuqi para hyrjes në fuqi të KPPK-së, ZSPK-ja gjithashtu do të ketë kompetencë plotësuese për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve, edhe të atyre në formë të tentimit, dhe format e ndryshme të bashkëpunimin në krim si në vijon:

a) vrasja (neni 30, LPK) dhe krimet tjera të paraqitura në nenet 31-34 të LPK-së;
b) trafikimi me njerëz (neni 2, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/4 mbi Ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë);
c) krimet e paraqitura në nenet 74-82 të LPK-së (veprat penale kundër dinjitetit të personalitetit dhe moralit) të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/1 mbi ndryshimin e Ligjit në fuqi për veprat penale që kanë të bëjnë me dhunën seksuale çdoherë që ato janë të dënueshme me burgim me pesë ose më tepër vite burgim duke marrë parasysh maksimumin e sanksionimit të mundshëm të paraparë me ligj;

d) prodhimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve (neni 245 KPRSFJ):
e) nxitja e urrejtjes kombëtare, racore a fetare, grindjes ose armiqësisë, (neni 134, KPRSFJ) dhe nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar dhe etnik (neni 1, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/4);
f) rrëmbimi i fluturakes (neni 240, KPRSFJ);
g) rrezikimi i sigurisë së fluturimit të fluturakes (neni 241, KPRSFJ).
h) rastet e rënda të vjedhjes grabitqare ose grabitjes (neni 138, LPK), plaçkitja (neni 141, LPK);
i) shtrëngimi (neni 149, LPK);
j) marrja e ryshfetit (neni 222, LPK), dhënia e ryshfetit (neni 223, LPK);
k) mashtrimi në detyrë (neni 215, LPK)
l) përvetësimi (neni 219, LPK));

9.3. Të gjithë prokurorët që punojnë në Kosovë do ta informojnë, me anë të telefonit apo mjeteve tjera, Kryeprokurorin e PSRK-së, sa më shpejtë që të jetë e mundur dhe jo më vonë se njëzetekatër orë pas kohës kur ata njoftohen lidhur me çdo raport penal verbal apo të shkruar që aktualisht është nën hetim a ndjekje penale dhe që bie në kategoritë e krimeve të përmendura në pikat e), f), n), p), t) dhe u) të paragrafit 1 të këtij neni dhe në pikat b), d) dhe i) të paragrafit 2 të këtij neni. Kryeprokurori i PSRK-së do të përcaktojë nëse ekzistojnë indikacione apo fakte relevante të rastit të krimit të organizuar, dhe në qoftë se ekziston dyshimi i bazuar se raporti verbal a me shkrim, lënda apo ndjekja penale përmban indikacione apo fakte relevante të rastit të krimit të organizuar, atëherë Kryeprokurori i PSRK-së mund të ushtrojë kompetencën e tij mbi lëndën apo ndjekjen penale në pajtim me pikën n), paragrafi 1 i nenit 5 dhe paragrafin 3 të nenit 5 të këtij ligji.

9.4. Të gjithë prokurorët që punojnë në Kosovë do të jenë të obliguar që të informojnë deri në afatin e përgjithshëm që do të përcaktohet nga Kryeprokurori publik i Kosovës, Kryeprokurorin e zyrës se tyre për çdo raport penal apo për lëndët që aktualisht janë nën hetime a ndjekje penale dhe që shpijnë tek dyshimi i bazuar se krimi i përshkruar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni mund të jetë kryer. Kryeprokurori përkatës do t'i raportojë Kryeprokurorit publik të Kosovës dhe Kryeprokurorit të PSRK-së, deri në afatin e përgjithshëm që do të përcaktohet nga Kryeprokurori publik i Kosovës, për të gjitha lëndët e mëhershme të lajmëruar në zyrat e tyre në pajtim me këtë nen.

9.5. Kryeprokurori i zyrës do t'ia paraqes, me kërkesë të tyre, Kryeprokurorit publik të Kosovës dhe Kryeprokurorit të PSRK-së të gjitha informatat përkatëse që kanë të bëjnë me lëndët e referuara në paragrafin 4 të këtij neni duke përfshirë edhe informatat që mundësojnë identifikimin e lëndëve individuale.

9.6. Brenda afatit të përgjithshëm që do të përcaktohet nga Kryeprokurori publik i Kosovës, Kryeprokurorët e zyrave të ndryshme do t'ia paraqesin Kryeprokurorit publik të Kosovës dhe Kryeprokurorit të PSRK-së një raport të mbyllur ku përshkruhet statusi aktual i lëndëve që janë raportuar më herët sipas paragrafit 4 të këtij neni të këtij ligji, dhe do të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar që të dhënat dhe informacionet të mos zbulohen tek personat e paautorizuar.

9.7. Pas kërkesës së Kryeprokurorit të PSRK-së, komandantët rajonal të policisë së

Kosovës do t'ia paraqesin Kryeprokurorit të PSRK-së një kopje të raportit fillestar ose të njoftimit të krimit të cilin e kanë nxjerrë agjencitë e zbatimit të ligjit lidhur me sjelljet e supozuara kriminale që kanë ndodhur në territorin e kompetencës së tyre, dhe për të cilat prokurorët janë njoftuar gjatë muajit të kaluar dhe të cilat mund të bien në kategoritë e përshkruara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni. Komandantët rajonal mund të shtojnë vërejtje në shkresat e tyre dhe mund t'ua delegojnë detyrat e tyre komandantëve të stacioneve në Kosovë që janë nën autoritetin e tyre ashtu siç përcaktohet me anë të këtij neni.

9.8. 9.8 Kur raporti fillestar apo njoftimi i krimit i referohet krimeve të përshkruara në pikat e), f), n), p), t) dhe u) të paragrafit 1 të këtij neni dhe në pikat b), d), dhe i) të paragrafit 2 të këtij neni, komandanti rajonal do t'ia përcjellë Kryeprokurorit të PSRK-së një kopje të dokumenteve relevante sa me shpejtë që të jetë e mundur dhe në çdo rast brenda njëzetekatër orëve. Kryeprokurori i PSRK-së përcakton nëse ekzistojnë indikacione apo fakte relevante të një rasti të krimit të organizuar, dhe në qoftë se ekziston dyshimi i bazuar se raporti verbal a me shkrim, lënda apo ndjekja penale përmban indikacione apo fakte relevante të rastit të krimit të organizuar, atëherë Kryeprokurori i PSRK-së mund të ushtrojë juridiksionin e tij mbi lëndën apo ndjekjen penale në pajtim me pikën n) paragrafi 1 i nenit 5 dhe paragrafin 3 të nenit 5 të këtij ligji.

Neni 10
Ushtrimi i kompetencës plotësuese nga PSRK-ja

10.1. Kur është në interes të hetimit a ndjekjes së duhur të krimeve, PSRK-ja do të ushtrojë kompetencën e vet plotësuese lidhur me veprat penale të paraqitura në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 9 të këtij ligji.

10.2. Për qëllimet e këtij ligji është në interes të hetimit a ndjekjes së duhur të krimeve të paraqitura në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 9 të këtij ligji që çdoherë njëra nga kriteret e mëposhtme të jetë plotësuar:

a) është e arsyeshme të besohet se sjellja e supozuar kriminale është pjesë e një fenomeni kriminal serioz që ndodhë ose ka ndodhur në vende të ndryshme të Kosovës dhe që mund të jetë në kompetencë territoriale të gjykatave të ndryshme sipas ligjit në fuqi, më qëllim që të garantohet një bashkërendim unik i hetimit a ndjekjes penale;
b) është e arsyeshme të besohet se sjellja e supozuar kriminale është pjesë e një aktiviteti kriminal më të gjerë tej kombëtar që bën të nevojshëm bashkëpunimin ndërkombëtar për të arritur një hetim a ndjekje tërësore të krimit;
c) ekziston dyshimi i bazuar lidhur më përpjekjet e paligjshme për të ndikuar në hetimin ose ndjekjen e sjelljes së supozuar kriminale;
d) sjellja e supozuar kriminale rrezikon ose ka rrezikuar funksionimin e stabilitetit të shtetit ose të organeve të tij, apo funksionimin e stabiliteti të institucioneve publike ose të organeve të tyre që veprojnë në Kosovë;
e) ekziston dyshimi i bazuar se PSRK-ja, për shkak të rrethanave të veçanta, ose të komplikimit, a të natyrës së sjelljes së supozuar kriminale, është organi i vetëm që mund të realizojë një hetim ose ndjekje tërësore të krimit.

10.3. Para se aktakuza të marrë formën e prerë, Kryeprokurori i qarkut do të propozojë me shkrim trasferimin tek PSRK-ja të hetimit a të ndjekjes penale të çdo krimi të përshkruar në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 9 të këtij ligji, nëse ekzistojnë fakte për të besuar që se paku njëri nga kriteret e paraqitura në paragrafin 2 të këtij neni është plotësuar lidhur më lëndën përkatëse. Propozimi lidhur me trasferimin e lëndës do t'i drejtohet Kryeprokurorit të PSRK-së.

10.4. Kryeprokurori i identifikuar sipas paragrafit 3 të këtij neni do ta informojë Kryeprokurorin publik të Kosovës lidhur me propozimin e tij. Me kërkesë të Kryeprokurorit të PSRK-së, Kryeprokurori do të kujdeset që t'ia dërgojë në mënyrë konfidenciale Kryeprokurorit të PSRK-së një kopje të të gjitha dokumenteve dhe informatave përkatëse për lëndën, së bashku më një raport duke nënvizuar arsyen për kërkesën dhe duke identifikuar qartazi së paku njërin nga kriteret e paraqitura në paragrafin 2 të këtij neni.

10.5. Dokumentet origjinale do të mbahen nga prokurori që është përgjegjës për të hetuar dhe ndjekur krimin sipas ligjit në fuqi. Vetëm në rast se PSRK-ja vendos që të marrë përgjegjësinë për lëndën, dokumentet dhe dosja origjinale do t'i dërgohen PSRK-së në përputhje me paragrafin 7 të këtij neni.

10.6. Kryeprokurori i PSRK-së do të marrë vendim lidhur me propozimin e Kryeprokurorit përkatës të referuar në paragrafin 3 të këtij neni brenda afatit të përgjithshëm që do të përcaktohet nga Kryeprokurori publik i Kosovës dhe që nga koha e pranimit të propozimit. Deri në kohën kur Kryeprokurori i PSRK-së të marrë përgjegjësinë për lëndën, prokurori që tashmë është përgjegjës për hetimin do t'i ushtrojë të gjitha detyrat e tij që kanë të bëjnë me ndjekjen dhe hetimin e sjelljes së supozuar kriminale.

10.7. Nëse Kryeprokurori i PSRK-së vendos që të marr përgjegjësinë për lëndën, ai do ta njoftojë Kryeprokurorin e identifikuar sipas paragrafit 3 të këtij neni lidhur me atë vendim. Kryeprokurori përkatës do t'ia dorëzojë PSRK-së të gjitha dosjet dhe materialin dhe do të jetë përgjegjës që të sigurojë që të dhënat dhe informatat e ndjeshme të mos zbulohen tek personat e paautorizuar gjatë fazës së dorëzimit.

Neni 11
Kundërshtimi i propozimit për të marrë përgjegjësi për lëndën nga ana e PSRK-së dhe procedura e rishqyrtimit

11.1. Kryeprokurori i PSRK-së do ta refuzojë propozimin e Kryeprokurorit të identifikuar sipas paragrafit 3 të nenit 10 të këtij ligji lidhur me trasferin e lëndës në çdo kohë që ai beson se vepra penale nuk është nga ato të paraqitura në paragrafët 1 ose 2 të nenit 9 të këtij ligji ose asnjëri nga kriteret e paraqitura në paragrafin 2 të nenit 10 të këtij ligji nuk është plotësuar.

11.2. Kryeprokurori i PSRK-së do ta informojë Kryeprokurorin përkatës dhe Kryeprokurorin publik të Kosovës lidhur me vendimin e tij për të refuzuar propozimin për transferim. Kryeprokurori i PSRK-së do t'ia dërgojë Kryeprokurorit përkatës një vendim me shkrim brenda afatit të përgjithshëm që do të përcaktohet nga Kryeprokurori publik i Kosovës dhe që do të fillojë nga koha kur propozimi është refuzuar. Vendimi me shkrim do të përfshijë arsyet për refuzim.

11.3. Brenda afatit të përgjithshëm që do të përcaktohet nga Kryeprokurori publik i Kosovës dhe që do të fillojë nga koha e dorëzimit të vendimit me shkrim ku kundërshtohet propozimi për transfer, Kryeprokurori i identifikuar sipas paragrafit 3 të nenit 10 të këtij ligji mund të kërkojë nga Kryeprokurori publik i Kosovës që të bëjë rishqyrtimin e vendimit të marrë nga Kryeprokurori i PSRK-së. Kryeprokurori i identifikuar sipas paragrafit 3 të nenit 10 të këtij ligji do t'ia bashkëngjis vendimin e Kryeprokurorit të PSRK-së dokumenteve të dërguara me kërkesën për rishqyrtim.

11.4. Nëse Kryeprokurori paraqet kërkesë për rishqyrtim, ai do t'ia dërgojë Kryeprokurorit publik të Kosovës një kopje të raporteve penale ose të lëndës së bashku më të gjitha dokumentet dhe dosjet përkatës. Në të njëjtën ditë që kërkesa për rishqyrtim është paraqitur, Kryeprokurori i qarkut ia dërgon një kopje të kërkesës Kryeprokurorit të PSRK-së.

11.5. Brenda afatit të përgjithshëm që do të përcaktohet nga Kryeprokurori publik i Kosovës dhe që do të fillojë nga koha e dorëzimit të kopjes së kërkesës për shqyrtim, Kryeprokurori i PSRK-së mund t'ia dërgojë vërejtjet e tij Kryeprokurorit publik të Kosovës ose mund të vendos që të mos dërgojë vërejtje. Një kopje e vërejtjeve lidhur me kërkesën për rishqyrtim ose e shkresës për mos ushtrimin e kësaj të drejte do t'i dërgohet Kryeprokurorit publik të Kosovës dhe Kryeprokurorit të identifikuar sipas paragrafit 3 të nenit 10 të këtij ligji.

11.6. Pas shqyrtimit të kërkesës për shqyrtim dhe të vërejtjeve të mundshme, Kryeprokurori publik i Kosovës do të vendos që ta konfirmojë vendimin ose të refuzojë atë. Kërkesa për rishqyrtim do të vendoset brenda afatit të përgjithshëm që do të përcaktohet nga Kryeprokurori publik i Kosovës dhe që do të fillojë nga koha e dorëzimit të saj me vërejtjet ose që nga koha e vendimin për të mos dërguar vërejte të paraparë në paragrafin 5 të këtij neni. Vendimi lidhur me kërkesën për rishqyrtim do të jetë i formës së prerë.

11.7. Kryeprokurori publik i Kosovës do t'ia dërgojë një kopje të vendimit lidhur me rishqyrtimin Kryeprokurorit përkatës dhe Kryeprokurorit të PSRK-së.

11.8. Në rast se Kryeprokurori publik i Kosovës refuzon vendimin e Kryeprokurorit të PSRK-së, PSRK-ja do të jetë përgjegjëse për të kryer hetimin a ndjekjen e rastit. Dispozitat e paraqitura në paragrafin 7 të nenit 10 të këtij ligji për dorëzimin e lëndës do të zbatohen mutatis mutandis.

11.9. Të gjitha detyrat që kanë të bëjnë me hetimin dhe ndjekjen e mundshme të veprave të supozuara penale i mbesin prokurorit kompetent përderisa PSRK-ja të marrë përgjegjësinë për lëndën ose Kryeprokurori publik i Kosovës të konfirmojë ose refuzojë vendimin e Kryeprokurorit të PSRK-së. Nëse Kryeprokurori publik i Kosovës konfirmon vendimin e Kryeprokurorit të PSRK-së për refuzimin e propozimit për transferim, prokurori kompetent do të vazhdojë të jetë përgjegjës për lëndën.

11.10. Të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra nga prokurori sipas paragrafit 9 të këtij neni para vendimit të Kryeprokurorit publik të Kosovës lidhur me kërkesën për rishqyrtim do të mbesin të vlefshme dhe në fuqi.

11.11. Të gjitha vendimet e marra nga organet gjyqësore të cilat janë kompetente që të vendosin për lëndën para vendimit të Kryeprokurorit publik të Kosovës lidhur me kërkesën për rishqyrtim do të mbesin të vlefshme dhe në fuqi.

11.12. Në çdo kohë gjatë procedurave por para se aktakuza të bëhet e formës së prerë, Kryeprokurori i zyrës kompetente mund ta ripërtërijë propozimin për transfer të së njëjtës lëndë tek Kryeprokurori i PSRK-së. Në këtë rast, propozim për transfer duhet të bazohet në ekzistimin e provave të reja ose të dëshmive të cilat nuk kanë qenë të njohura në kohën kur propozimi i mëhershëm i është paraqitur Kryeprokurorit të PSRK-së dhe pastaj është refuzuar. Mosrespektimi i dispozitës së paraqitur në këtë nen do të shpie në kundërshtimin e propozimit të ri.

Neni 12
Kompetenca e PSRK-së për lëndët e ndërlidhura me ato që janë në juridiksionin e saj

12.1. Çdoherë që PSRK-ja merr përgjegjësi për një lëndë që është në kompetencë të saj të veçantë a plotësuese, Kryeprokurori i PSRK-së mund t'i marrë përsipër hetimet a ndjekjet e veprave të supozuara penale që aktualisht zhvillohen nga prokurorët tjerë që punojnë në Kosovë nëse veprimet duken të jenë drejtpërsëdrejti të ndërlidhura dhe provat të përbashkëta.

12.2. Çdoherë që PSRK-ja ushtron kompetencën e vet plotësuese për një lëndë sipas pikës a), paragrafi 2 i nenit 10 të këtij ligji, Kryeprokurori i PSRK-së mund të marrë përsipër çdo hetim a ndjekje të veprave të supozuara penale që aktualisht zhvillohen nga prokurorët tjerë që jetojnë në Kosovë, nëse Kryeprokurori i PSRK-së beson se vepra e supozuar mund të jetë pjesë e një fenomeni kriminal serioz përfshirë edhe atë që ndodhë ose ka ndodhur në vende të ndryshme të Kosovës e që mund të jetë në kompetencë territoriale të gjykatave të ndryshme në përputhje me ligjin në fuqi.

12.3. PSRK-ja mund të marrë përsipër lëndët tjera në përputhje me dispozitat e paraqitura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni në çdo kohë gjatë procedurës. Në ushtrimin e kësaj të drejte, PSRK-ja nuk do të jetë e detyruar ndaj kufizimeve të parapara në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 5, në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 9 dhe paragrafin 3 të nenit 10 të këtij ligji.

12.4. Çdoherë që PSRK-ja merr përsipër hetimet a ndjekjet penale sipas dispozitave të paraqitur në paragrafët 1,2 dhe 3 të këtij neni, Kryeprokurori i PSRK-së do ta njoftojë për arsyet e marrjes së vendimeve të tij Kryeprokurorin përkatës të zyrës që ka juridiksion për lëndën si dhe Kryeprokurorin publik të Kosovës.

KREU IV
JURIDIKSIONI PËR LËNDËT E HETUARA OSE TË NDJEKURA PENALISHT NGA PSRK-ja DHE TRANSFERIMI I PËRGJITHSHËM I LËNDËVE

Neni 13
Juridiksioni për lëndët e marra përsipër nga PSRK-ja

13.1. Pasi që PSRK-ja të ketë marrë përgjegjësinë për një lëndë dhe për të gjitha fazat e procedurës pas ngritjes së aktakuzës dhe nëse PSRK-ja është përgjegjëse për hetimin a ndjekjen, atëherë do të identifikohet një gjykatë kompetente në pajtim me ligjin në fuqi.

13.2. Pasi që PSRK-ja të ketë marrë përgjegjësinë për lëndën, të gjitha veprimet procedurale dhe të gjitha vendimet tashmë të marra nga prokurorët ose gjykatësit kompetent për lëndën do të mbesin të vlefshme dhe në fuqi.

13.3. Nëse është e arsyeshme dhe për shkaqe të sigurisë, gjykata kompetente e identifikuar sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të caktohet në kolegj prej tre anëtarësh në vende të ndryshme brenda territorit të Kosovës në përputhje me autorizimin e kryetarit të gjykatës së instancës me të lartë pas kërkesës së gjyqtarit të procedurës paraprake apo të Kryetarit të kolegjit. Palët në procedurë do të njoftohen për vendin e ri të gjykimit pa vonesë.

Neni 14
Transferimi i lëndëve nga PSRK-ja gjatë procedurës gjyqësore dhe procedurës së rishqyrtimit

14.1. Nëse Kryeprokurori i PSRK-së beson se nuk ka arsye për PSRK-në që të ushtrojë kompetencën e vet të veçantë a plotësuese, në çdo kohë gjatë procedurës por para se aktakuza të marrë formën e prerë, Kryeprokurori i PSRK-së do t'ia kthejë Kryeprokurorit të zyrës që ka juridiksion për lëndën raportet penale ose lëndën së bashku me të gjitha dokumentet dhe dosjet përkatëse të pranuara sipas paragrafit 4 të nenit 6 ose paragrafit 7 të nenit 10 të këtij ligji, ose të marra sipas paragrafit 3 të nenit 5 ose paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 12 të këtij ligji. Kryeprokurori i PSRK-së gjithashtu do të përfshijë edhe dokumentet tjera të mbledhura gjatë hetimit të mundshëm të mëtutjeshëm të zhvilluar nga prokurorët special.

14.2. Kryeprokurori i PSRK-së do të përfshijë një vendim me shkrim në dokumente varësisht nga referimi së bashku me tërë materialin dhe provat e mbledhura gjatë zhvillimit të hetimit që arsyeton vendimin e tij.

14.3. Të gjitha veprimet procedurale dhe vendimet e ndërmarra nga prokurorët special dhe nga gjykata kompetente para referimit të lëndës sipas paragrafit 1 të këtij neni do të mbesin të vlefshme dhe në fuqi.

14.4. Në rastin e paraparë sipas paragrafit 1 të këtij neni, Kryeprokurori përkatës publik do t'ia ktheje raportet penale ose lëndën me të gjitha dokumentet dhe dosjet përkatëse prokurorit kompetent në pajtim me ligjin në fuqi, sa me shpejtë që të jetë e mundur, dhe në çdo rast brenda afatit të përgjithshëm që do të përcaktohet nga Kryeprokurori publik i Kosovës pasi që ato t'i janë dorëzuar atij.

14.5. Brenda afatit të përgjithshëm që do të përcaktohet nga Kryeprokurori publik i Kosovës dhe që do të fillojë nga koha e dorëzimit të raporteve penale ose të lëndës së bashku me të gjitha dokumentet dhe dosjet përkatëse në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, Kryeprokurori përkatës mund të kërkojë nga Kryeprokurori publik i Kosovës që të bëjë rishqyrtimin e vendimit të marrë nga Kryeprokurori i PSRK-së.

14.6. Nëse Kryeprokurori përkatës paraqet kërkesë për rishqyrtim, ai do t'ia dërgojë Kryeprokurorit publik të Kosovës një kopje të raporteve penale ose të lëndës së bashku me të gjitha dokumentet dhe dosjet përkatëse. Kryeprokurori që ka kërkuar rishqyrtimin do t'ia bashkëngjis dokumenteve të dërguara më qëllim të

rishqyrtimit një kopje të vendimit të Kryeprokurorit të PSRK-së. Në të njëjtën ditë që është paraqitur kërkesa për rishqyrtim, Kryeprokurori përkatës do t'ia dërgojë Kryeprokurorit të PSRK-së një kopje të kërkesës për shqyrtim. Paragrafët 5 dhe 6 të nenit 11 të këtij ligji do të zbatohen mutatis mutandis.

14.7. Kryeprokurori publik i Kosovës do t'ia dërgojë një kopje të vendimit lidhur me rishqyrtimin Kryeprokurorit përkatës dhe Kryeprokurorit të PSRK-së. Në rast se Kryeprokurori publik i Kosovës refuzon vendimin e Kryeprokurorit të PSRK-së, PSRK-ja do të jetë përgjegjëse për zhvillimin e hetimit a ndjekjes.

14.8. Prokurori kompetent i identifikuar nga Kryeprokurori përkatës sipas paragrafit 4 të këtij neni do të jetë përgjegjës për hetimin dhe ndjekjen e krimeve përderisa Kryeprokurori publik i Kosovës të vendos lidhur me kërkesën për rishqyrtim të Kryeprokurorit. I njëjti prokuror do të jetë përgjegjës për zhvillimin e procedurave penale nëse Kryeprokurori publik i Kosovës konfirmon vendimin e Kryeprokurorit të PSRK-së të marrë sipas paragrafit 1 të këtij neni.

14.9. Të gjitha vendimet e marra nga organet gjyqësore që janë kompetente për të vendosur për lëndën para vendimit të Kryeprokurorit publik të Kosovës lidhur me kërkesën për rishqyrtim do të mbesin të vlefshme dhe në fuqi.

14.10. Në çdo kohë gjatë procedurës por para se aktakuza të merr formën e prerë, lënda ose hetimi që PSRK-ja tashmë e ka kthyer sipas paragrafit 1 të këtij neni do t'i transferohet pas përsëri PSRK-së sipas dispozitave të paraqitura në këtë ligj nëse elementet e reja ose dispozitat e zbuluara rishtazi në mënyrë të arsyeshme na bëjnë të besojmë se ZSPK-ja ushtron kompetencën e saj të veçantë ose kompetencën plotësuese.

14.11. Kryetari i PSRK-së do t'ia transferohet pas Kryeprokurorit të zyrës që do të ketë juridiksion për lëndën, të njëjtën lëndë që më parë i është transferuar atij sipas dispozitave të paraqitura në paragrafin 1 të këtij neni, nëse elementet e reja ose faktet e zbuluara rishtazi në mënyrë të arsyeshme bëjnë të besohet se nuk ka arsye që PSRK-ja të ushtrojë kompetencën e vet të veçantë a kompetencën plotësuese. Në këtë rast, paragrafët 1-11 të këtij neni do të zbatohen mutatis mutandis.

KREU VI
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 15
Dispozitat kalimtare

15.1. Përveç asaj që është paraparë në dispozitën e paragrafit 1 të nenit 3 të këtij ligji, PSRK-ja do të përbëhet edhe nga pesë prokurorë të EULEX-it gjatë kohëzgjatjes së EULEX KOSOVË në Kosovë. Prokurorët e EULEX-it do të caktohen në PSRK sipas procedurave të përcaktuara nga EULEX KOSOVË. Për aq kohë sa procedura për caktimin e prokurorëve të EULEX-it nuk është përcaktuar, prokurorët e EULEX-it në PSRK do të caktohen nga Kryeprokurori i EULEX-it.

15.2. Numri i prokurorëve të EULEX-it të caktuar në PSRK i paraparë sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të ndryshohet sipas vendimit të organeve kompetente brenda EULEX KOSOVË.

15.3. Gjatë kohëzgjatjes së EULEX KOSOVË në Kosovë, Kryeprokuror i PSRK-së do të jetë një prokuror i EULEX-it, përderisa një vendim tjetër nuk merret nga organet kompetente brenda EULEX KOSOVË. Organet kompetente brenda EULEX KOSOVË do të përcaktojnë procedurat për emërimin e Kryeprokurorit të PSRK-së që do të jetë nga prokurorët e EULEX-it. Për aq kohë sa procedura për emërimin e Kryeprokurorit të PSRK-së është përcaktuar, Kryeprokurori i EULEX-it do ta caktojë Kryeprokurorin e PSRK-së.

15.4. Për aq kohë sa Kryeprokurori i PSRK-së është një prokuror i EULEX-it, Zëvendës kryeprokuror i PSRK-së do të përzgjidhet njëri nga prokurorët publik. Për aq kohë sa Kryeprokuror i PSRK-së të jetë një prokuror i EULEX-it, Kryeprokurori i PSRK-së do të jetë nën mbikëqyrjen e përgjithshme të Kryeprokurorit të EULEX-it, më përjashtim të dispozitës së paragrafit 2 të nenit 4 të këtij ligji. Për aq kohë sa Kryeprokurori i PSRK-së do të jetë një prokuror i EULEX-it, Kryeprokurori i EULEX-it do të jetë përgjegjës që të përcaktojë afatet e përmendura në paragrafin 9 të nenit 3, paragrafët 2,3,5 dhe 8 të nenit 6, paragrafët 4,6 dhe 8 të nenit 9, paragrafin 6 të nenit 10, paragrafët 2,3,5 dhe 6 të nenit 11 dhe paragrafët 4 dhe 5 të nenit 14 të këtij ligji.

15.5. Gjatë kohëzgjatjes së EULEX KOSOVË në Kosovë, të gjitha informatat që Kryeprokurori i zyrës përkatëse duhet t'ia përcjellë Kryeprokurorit të PSRK-së në përputhje me të gjitha dispozitat e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji, do t'i përcjellën Kryeprokurorit të PSRK-së nëpërmjet kryeprokurorëve të prokurorive të qarkut edhe për ato krime që janë në juridiksion të gjykatave komunale.

15.6. Gjatë kohëzgjatjes së EULEX KOSOVË në Kosovë, Kryeprokurori i PSRK-së do ta informojë Kryeprokurorin e EULEX-it për çdo informatë, vendim, kërkesë, raport apo të dhënë të pranuar në pajtim me paragrafët 3 dhe 8 të nenit 6, paragrafët 3,4,5,6,7 dhe 8 të nenit 9, paragrafin 4 të nenit 10, paragrafët 4 dhe 7 të nenit 11 dhe paragrafin 7 të nenit 14 të këtij ligji.

15.7. Gjatë kohëzgjatjes së EULEX KOSOVË në Kosovë, të gjitha informatat dhe dokumentet që duhet t'i përcjellën Kryeprokurorit të PSRK-së sipas paragrafëve 4,5,6 të nenit 9 dhe paragrafëve 4 dhe 7 të nenit 10 të këtij ligji, do t'ju përcjellën Kryeprokurorit të PSRK-së nëpërmjet kryeprokurorëve të prokurorive të qarkut me ndihmën e prokurorëve të EULEX-it të caktuar në rajone të ndryshme të Kosovës edhe për ato krime që janë në juridiksion të gjykatave komunale.

15.8. Gjatë kohëzgjatjes së EULEX KOSOVË në Kosovë, propozimet dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me transferimin e një lënde tek PSRK-ja të parapara sipas paragrafit 3 të nenit 10 të këtij ligji, kërkesa për rishqyrtim të vendimit mbi kundërshtimin e transferimit të një lënde sipas paragrafit 3 të nenit 11 të këtij ligji, ripërtrirja e propozimit për transferim të lëndës sipas paragrafit 12 të nenit 11 të këtij ligji dhe kërkesa për rishqyrtim të vendimit për kthim të lëndës sipas paragrafit 5 të nenit 14 të këtij ligji, gjithmonë do të jetë nën përgjegjësinë e Kryeprokurorit të qarkut të territorit ku gjendet gjykata kompetente për të vendosur për lëndën. Në qoftë se gjykata komunale është kompetente për të vendosur për lëndën, aktivitetet e lartpërmendura do të jenë gjithashtu nën përgjegjësinë e Kryeprokurorit të qarkut i cili do të veprojë sipas kërkesës së Kryeprokurorit komunal përkatës por vetëm në konsultim dhe vlerësim me

prokurorin e EULEX-it të caktuar në atë rajon.

15.9. Gjatë kohëzgjatjes së pjesëmarrjes së prokurorëve të EULEX-it në përbërjen e PSRK-së, informata që Kryeprokurori i PSRK-së do të jetë i obliguar të jap në pajtim me paragrafin 2 të nenit 11 të këtij ligji, vërejtjet e referuara në paragrafin 5 të nenit 11 të këtij ligji ose informata e referuar në paragrafin 4 të nenit 12 të këtij ligji gjithashtu do t'i dërgohen Kryeprokurorit të EULEX-it brenda afateve të njëjta të përcaktuara sipas neneve përkatëse të këtij ligji.

15.10. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të gjitha dosjet, informatat, arkivat dhe të dhënat në formë elektronikë dhe të shtypur lidhur me lëndët që aktualisht hetohen, ndiqen ose janë hequr nga procedura nga prokurorët ndërkombëtar të UNMIK-ut dhe të mbajtura nga Departamenti i Drejtësisë i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) do t'i dorëzohen Kryeprokurorit të EULEX-it në pajtim me modalitetet e përcaktuar me anë të marrëveshjeve ndërmjet UNMIK-ut dhe EULEX KOSOVË.

15.11. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Kryeprokurori i EULEX-it gjithashtu merr nga organet kompetente të gjitha dosjet, informatat, arkivat dhe të dhënat në formë elektronike dhe të shtypur që kanë të bëjnë me lëndët që aktualisht janë nën hetime a ndjekje ose që janë hequr nga procedura nga prokurorët ndërkombëtar të UNMIK-ut dhe nga ZPSK-ja e themeluar me herët në pajtim me Urdhëresën administrative nr. 2006/15.

15.12. Kryeprokurori i EULEX-it do të ketë kompetencë që të vendos se cilat nga lëndët e dorëzuara në pajtim me paragrafët 10 dhe 11 të këtij neni do të hetohen dhe ndiqen nga PSRK-ja e themeluar sipas këtij ligji, pavarësisht nga objekti i krimit të hetimit a ndjekjes dhe vendos se cilat lëndë do t'i referohen zyrës prokuroriale përkatëse të Kosovës.

15.13. Nëse Kryeprokurori i EULEX-it vendos që krimet nën hetim a ndjekje dhe të cilat janë dorëzuar në përputhje me paragrafët 10 dhe 11 të këtij neni do të vazhdojnë të hetohen a ndiqen nga PSRK-ja, atëherë PSRK-ja nuk do të jetë e detyruar nga kufizimet e parapara në paragrafët 1,2 dhe 3 të nenit 5, paragrafët 1 dhe 2 të nenit 9 dhe paragrafin 1 të nenit 10 të këtij ligji që rregullojnë ushtrimin e kompetencës së veçantë dhe plotësuese të PSRK-së.

15.14. Për lëndët që tashmë janë nën hetime a ndjekje dhe të cilat do mund t'i dorëzohen PSRK-së në pajtim me paragrafin 12 të këtij neni, gjykata kompetente dhe përbërja e kolegjit do të identifikohet në pajtim me ligjin në fuqi para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Kolegjet e caktuara për zbatimin e Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut 2000/64 do të vazhdojnë të ushtrojnë funksionet e tyre deri në përfundim të gjykimit apo të fazës përkatëse të procedurës që është në vazhdim në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligjin mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it.

15.15. Kryeprokurori i PSRK-së do të vendos se cilat udhëzime të brendshme të nxjerra në pajtim me paragrafin 6 të nenit 1 të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2006/15 mbesin të vlefshme dhe në fuqi në qeverisjen e PSRK-së të përcaktuara me anë të këtij ligji.

15.16. Gjatë kohëzgjatjes së pjesëmarrjes së prokurorëve të EULEX-it në përbërjen e PSRK-së, një kolegj i përbërë nga Kryeprokurori i EULEX-it, Kryeprokurori

publik i Kosovës dhe një anëtar tjetër i caktuar nga Kryeprokurori i EULEX-it do të jetë përgjegjës për përzgjedhjen e prokurorëve tjerë publik të Kosovës që kanë të drejtë të punojnë si prokurorë special, përveç nëse organet kompetente të EULEX KOSOVË përcaktojnë që një kolegj tjetër do të jetë përgjegjës për përzgjedhje dhe se do të ndiqet një procedurë tjetër.

15.17. Kur prokurorët e EULEX-it të mos marrin pjesë me tutje në përbërjen e PSRK-së, një kolegj i përbërë nga Kryeprokurori publik i Kosovës dhe dy anëtarë tjerë të caktuar nga ai, nga të cilët njëri do të jetë Kryeprokuror i qarkut i identifikuar në bazë të rotacionit, do të jetë përgjegjës për përzgjedhjen e prokurorëve tjerë publik të Kosovës të cilët do të punojnë si prokurorë special, përveç nëse përcaktohen dispozita të tjera sipas ligjit në fuqi.

15.18. Gjatë kohëzgjatjes së pjesëmarrjes së prokurorëve të EULEX-it në përbërjen e PSRK-së, raportet dhe informatat lidhur me aktivitetet e supozuara kriminale të kryera në Kosovë dhe të nxjerra nga Njësia ekzekutive për krime të organizuara e themeluar nga EULEX KOSOVË i drejtohen edhe Kryeprokurorit të PSRK-së përveç organeve tjera të identifikuara nga EULEX KOSOVË.

15.19. Gjatë kohëzgjatjes së EULEX KOSOVË në Kosovë, autorizimi lidhur me ndryshimin e vendit të gjykimit i përmendur në paragrafin 3 të nenit 13 këtij ligji do të jetë nën përgjegjësinë e Shefit të Komponentit të Drejtësisë, pas propozimit të Kryeprokurorit të misionit të EULEX-it apo të Kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX KOSOVË.

15.20. Në rast të riorganizimit substancial të sistemit të gjykatave apo të zyrave prokuroriale pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Kryeprokurori i zyrës që ka kompetencë për lëndën sipas legjislacionit të ri do të jetë autoritet kompetent që të ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë që i janë caktuar Kryeprokurorit të qarkut apo Kryeprokurorit komunal me anë të këtij ligji.

Neni 16
Hyrja në fuqi

16.1. Prokuroria Speciale e Kosovës e themeluar me anë të Urdhëresës Administrative nr. 2006/15 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/15 do të pushojë së ekzistuari në ditën e tranzicionit.

16.2. Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës
Me datën: 13.03.2008

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III / Nr. 27 / 03 QERSHOR 2008

LIGJI Nr. 03/L-225
PËR PROKURORIN E SHTETIT

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 955
Kreu II: Parimet themelore 956
Kreu III: Detyrat dhe kompetencat e prokurorit të shtetit 957
Kreu IV: Struktura organizative dhe juridiksioni i prokurorit të shtetit 958
Kreu V: Kualifikimet, kriteret dhe të drejtat për emërimin e prokurorëve të shtetit 961
Kreu VI: Dispozitat kalimtare 964
Kreu VII: Dispozitat përfundimtare 965

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR PROKURORIN E SHTETIT

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe fushëveprimi i ligjit

Ky ligj themelon dhe rregullon organizimin, juridiksionin, funksionimin, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **Prokurori i Shtetit** nënkupton institucionin e pavarur kompetent dhe përgjegjës për ndjekjen e personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale dhe veprave të tjera siç ceken me ligj dhe përfshinë si në vijim: prokuroritë themelore, Prokurorinë e Apelit, Prokurorinë Speciale, Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, dhe cilado njësi tjetër organizative që mund të krijohet për të ushtruar funksione prokuroriale.
   1.2. **Kryeprokurori i Shtetit** nënkupton Kryeprokurorin e Shtetit të Republikës së Kosovës si dhe menaxhmentin dhe kreun mbikëqyrës të Prokurorit të Shtetit.

1.3. **Kryeprokurori** nënkupton kreun e zyrës së prokurorit, duke përjashtuar Kryeprokurorin e Shteti dhe Kryeprokurorin Prokurorisë Speciale.
1.4. **Kushtetuta** nënkupton Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
1.5. **Prokuror Special** nënkupton prokurorin e shtetit që shërben në Prokurorinë Speciale siç ceket në Ligjin mbi Prokurorinë Speciale, Nr. 2008/03-L052.
1.6. **Këshill** nënkupton Këshillin Prokurorial të Kosovës, siç ceket në Ligjin mbi Këshillin Prokurorial të Kosovës.

KREU II
PARIMET THEMELORE

Neni 3
Pavarësia dhe paanshmëria e Prokurorit të Shtetit

1. Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur që ushtron funksionet e veta në mënyrë të paanshme.
2. Prokurori i Shtetit dhe secili prokuror para ligjit siguron trajtim të barabartë, objektiv dhe pa paragjykime për të gjithë personat pavarësisht gjinisë, racës, prejardhjes kombëtare apo sociale, shoqatave apo lidhjeve politike, besimeve fetare, gjendjes apo të metave shëndetësore, apo pozitës shoqërore.
3. Është e kundërligjshme dhe në kundërshtim me Kushtetutën për cilindo person fizik apo juridik që të ndërhyjë, pengojë, ndikojë apo të përpiqet të ndërhyjë, pengojë apo ndikojë te Prokurori i Shtetit gjatë kryerjes së funksioneve prokuroriale lidhur me cilindo hetim, procedurë apo lëndë individuale.

Neni 4
Ushtrimi i funksioneve prokuroriale

1. Në Republikën e Kosovës funksionet prokuroriale ushtrohen vetëm nga prokurorët e autorizuar dhe kompetentë të shtetit edhe prokurorët specialë siç ceket në Ligjin mbi Prokurorinë Speciale, të Republikës së Kosovës Nr. 2008/03L-052.
2. Një prokuror i shtetit i emëruar sipas rregullave është i autorizuar të iniciojë hetime penale, të paraqesë aktakuzën apo propozim akuzën, të zhvillojë ndjekjen penale apo të kryejë detyra apo funksione të tjera prokuroriale që janë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet e zbatueshme.

Neni 5
Shumëllojshmëria etnike e Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit pasqyron shumëllojshmërinë etnike në Republikën e Kosovës, në pajtueshmëri me nenet 109(4) dhe 110(3) të Kushtetutës dhe parimet e pranuara ndërkombëtarisht lidhur me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore.

Neni 6
Efikasiteti i Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit ushtron funksionet e veta në mënyrë efikase dhe efektive dhe në pajtueshmëri me Kushtetutën, ligjet e zbatueshme dhe parimet e pranuara ndërkombëtarisht për mos-diskriminimin, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.

KREU III
DETYRAT DHE KOMPETENCAT E PROKURORIT TË SHTETIT

Neni 7
Detyrat dhe kompetencat e prokurorëve

1. Detyrat dhe kompetencat e prokurorëve të shtetit përfshijnë:
   1.1. ushtrimin e funksioneve prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme dhe të sigurohen që të gjithë personat trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit;
   1.2. zbatimin e standardeve më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare;
   1.3. sjellje të ndershme dhe profesionale si në jetën personale ashtu edhe profesionale dhe bazuar në ligjin e zbatueshëm dhe kodin e etikës profesionale;
   1.4. ruajtjen e nderit dhe dinjitetit të Prokurorit të Shtetit;
   1.5. mbrojtjen e të drejtave ligjore të viktimave, dëshmitarëve, të dyshimtëve, të akuzuarve dhe personave të dënuar;
   1.6. ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme juridike për zbulimin e veprave penale dhe të autorëve të krimit si dhe hetimin dhe ndjekjen me kohë të veprave penale;
   1.7. marrjen e vendimeve mbi inicimin, vazhdimin apo ndërprerjen e procedurës penale ndaj personave të dyshuar apo të akuzuar për kryerjen e veprave penale;
   1.8. ngritjen e aktakuzave dhe përfaqësimin e tyre para gjykatës;
   1.9. ushtrimin e mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve gjyqësore;
   1.10. bashkëpunimin me policinë, gjykatat dhe institucionet e tjera;
   1.11. ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 8
Veprimtaritë parandaluese

Prokurori i Shtetit bashkëpunon me institucionet shtetërore dhe subjektet e tjera publike dhe private në aktivitete lidhur me edukimin e shoqërisë me qëllim të ngritjes së njohurisë për ligjin dhe parandalimit të veprave penale.

Neni 9
Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Kryeprokurori i Shtetit, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, do të përcaktojë protokole dhe procedura për të ngritur bashkëpunimin me autoritetet e shteteve të tjera sa i përket ndjekjeve penale, përmes shkëmbimit të informacionit dhe mënyrave të tjera në përputhje me ligjin e zbatueshëm dhe marrëveshjet ndërkombëtare lidhur mes Kosovës dhe vendeve të tjera.
2. Kryeprokurori i Shtetit bashkëpunon me autoritetet dhe subjektet ndërkombëtare të vendosura në Republikën e Kosovës.

Neni 10
Marrëdhëniet me publikun

1. Prokurori i Shtetit i ofron publikut rregullisht informacione lidhur me veprimtaritë e saj.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1. i këtij neni, Prokurori i Shtetit nuk ofron asnjë informatë qoftë drejtpërdrejtë apo tërthorazi që do të zbulonte sekretet zyrtare, do të rrezikonte një hetim apo procedurë penale në zhvillim e sipër, do të dëmtonte integritetin, dinjitetin, sigurinë dhe të drejtat mbi privatësinë e cilitdo person, apo që do të shkelte të drejtat e të miturve.

KREU IV
STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE JURIDIKSIONI I PROKURORIT TË SHTETIT

Neni 11
Kryeprokurori i Shtetit

1. Kryeprokurori i Shtetit ka juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
2. Kryeprokurori i Shtetit ka juridiksion ekskluziv mbi lëndët në shkallë të tretë pranë Gjykatës Supreme.
3. Kryeprokurori i Shtetit ka juridiksion ekskluziv mbi të gjitha lëndët që përfshijnë mjete të jashtëzakonshme juridike.
4. Kryeprokurori i Shtetit mund të marrë në kompetencë secilën lëndë me kërkesë apo pajtim të Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.
5. Kryeprokurori i Shtetit mund të marrë në kompetencë secilën lëndë në secilën prokurori të Republikës së Kosovës siç është përcaktuar me ligj.
6. Kryeprokurori i Shtetit është kreu i Prokurorit të Shtetit dhe ka përgjegjësi të gjithëmbarshme për menaxhimin e Prokurorit të Shtetit dhe mbikëqyrjen e të gjithë prokurorëve. Kryeprokurori i Shtetit mund të delegoj disa përgjegjësi të tij/saj.
7. Kryeprokurori i Shtetit nxjerr rregulla, instruksione, udhëzime dhe vendime për rregullimin e brendshëm të Prokurorit të Shtetit.
8. Selia e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit është në Prishtinë.

Neni 12
Roli administrativ i zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

1. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ofron përkrahje administrative Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe zyrave të prokurorit siç ceket në Ligjin mbi Këshillin Prokurorial të Kosovës.
2. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit do të kujdeset që të gjitha prokuroritë të kenë stafin adekuat administrativ dhe t'iu sigurojë të gjitha materialet e nevojshme brenda buxhetit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.
3. Kryeprokurori i Shtetit, apo cilido prokuror të cilit Kryeprokurori i Shtetit mund t'i delegojë autoritetin, mund të kërkojnë nga një prokuror vartës që të ofrojë raporte apo informata të tjera me shkrim lidhur me progresin, gjendjen apo zgjidhjen e lëndëve për të cilat është përgjegjës prokurori vartës.

Neni 13
Autoriteti i Kryeprokurorit

1. Secili Kryeprokuror është përgjegjës ndaj Kryeprokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial për ushtrimin efektiv, efikas dhe korrekt të funksioneve prokuroriale të prokurorisë dhe të prokurorëve në kuadër të saj.
2. Secili Kryeprokuror është kreu administrativ i prokurorisë në të cilën është emëruar. Kryeprokurori mund të delegojë disa kompetenca, varësisht prej pajtimit të Kryeprokurorit të Shtetit.
3. Secili Kryeprokuror mund të ndërmarrë funksionet e ndjekjes penale të cilat i janë caktuar një prokurori vartës të shtetit në atë prokurori dhe nga ai apo ajo mund të marrë përsipër zhvillimin e drejtpërdrejtë të hetimeve apo të procedurës penale, me pëlqimin paraprak të Kryeprokurorit të Shtetit.
4. Secili Kryeprokuror do të caktojë lëndët prokurorëve brenda prokurorisë, duke marrë parasysh natyrën e lëndës, përvojën dhe specializimin e prokurorit.

Neni 14
Organizimi i prokurorive

1. Prokurori i Shtetit në Republikën e Kosovës organizohet dhe funksionon në përputhje me këtë ligj si dhe me Ligjin mbi Prokurorinë Speciale, në raste kur mund të aplikohet.
2. Prokurori i Shtetit në Republikën e Kosovës organizohet në prokuroritë si në vijim:
   2.1. Prokuroria Themelore e përbërë nga Departamenti i Përgjithshëm, nga Departamenti për të Mitur dhe nga Departamenti për Krime të Rënda.
   2.2. Prokuroria e Apelit e përbërë nga Departamenti i Përgjithshëm dhe Departamenti për Krime të Rënda i Prokurorisë;
   2.3. Prokuroria Speciale; dhe
   2.4. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit
3. Lëndët që bien në kompetencë të Departamentit për Çështje Ekonomike ose Departamentit për Çështje Administrative pranë Gjykatës Themelore do të i caktohen prokurorëve pranë Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore.

Neni 15
Prokuroria Themelore

1. Prokuroria Themelore ka juridiksion mbi të gjitha lëndët e shkallës së parë, përveq nëse është paraparë ndryshe më ligj.
   1.1. Prokuroria Themelore themelohet me anë të këtij ligji me juridiksionin territorial të cekur si në vijim:
   1.2. Prokuroria Themelore në Prishtinë, për territorin e Gjykatës Themelore të Prishtinës siç ceket në Ligjin mbi Gjykatat;
   1.3. Prokuroria Themelore në Ferizaj, për territorin e Gjykatës Themelore të Ferizajit siç ceket në Ligjin mbi Gjykatat;
   1.4. Prokuroria Themelore në Gjakovë, për territorin e Gjykatës Themelore të Gjakovës siç ceket në Ligjin mbi Gjykatat;
   1.5. Prokuroria Themelore në Gjilan, për territorin e Gjykatës Themelore të Gjilanit siç ceket në Ligjin mbi Gjykatat;
   1.6. Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për territorin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës siç ceket në Ligjin mbi Gjykatat;
   1.7. Prokuroria Themelore në Pejë, për territorin e Gjykatës Themelore të Pejës siç ceket në Ligjin mbi Gjykatat;
   1.8. Prokuroria Themelore në Prizren, për territorin e Gjykatës Themelore të Prizrenit siç ceket në Ligjin mbi Gjykatat;

Neni 16
Prokuroria e Apelit

1. Prokuroria e Apelit themelohet për të vepruar para Gjykatës së Apelit.
2. Prokuroria e Apelit udhëhiqet nga Kryeprokurori i Prokurorisë i emëruar sipas Ligjit mbi Këshillin Prokurorial të Kosovës.
3. Prokuroria e Apelit ka juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
4. Selia e Prokurorisë së Apelit është në Prishtinë.
5. Prokurorët e emëruar në Prokurorinë e Apelit do të specializohen në përfaqësimin e ndjekjes penale para Gjykatës së Apelit. Kur një lëndë e prokurorisë prezantohet para Gjykatës së Apelit, prokurori i cili ka iniciuar apo zhvilluar ndjekjen penale, me miratimin e Kryeprokurorit të Shtetit, mund të shoqërojë dhe ndihmojë Prokurorin e Shtetit të Prokurorisë së Apelit në paraqitjen e ankesës apo mbrojtjen kundër ankesës.

Neni 17
Prokuroria Speciale

1. Juridiksioni territorial, fushëveprimi dhe kompetencat e Prokurorisë Speciale rregullohen ekskluzivisht me Ligjin mbi Prokurorinë Speciale, të Republikës së Kosovës Nr. 2008/03-L052.
2. Përbërja e Prokurorisë Speciale dhe emërimi i Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale bëhet në bazë të Ligjit mbi Prokurorinë Speciale, të Republikës së Kosovës Nr. 2008/03-L052.

Neni 18
Themelimi i zyrave tjera

1. Kryeprokurori i Shtetit mund t'i paraqet kërkesë Këshillit Prokurorial të Kosovës për themelimin e zyrave të tjera në kuadër në sistemit prokurorial.
2. Në rast së Këshilli miraton themelimin e një zyre tjetër, atëherë do t'i paraqesë Kuvendit të Kosovës një propozim për plotësim buxhetor.

KREU V
KUALIFIKIMET, KRITERET DHE TË DREJTAT PËR EMËRIMIN E PROKURORËVE TË SHTETIT

Neni 19
Kualifikimet dhe kriteret minimale për emërim

1. Kandidatët për emërim si prokurorë të shtetit duhet të përmbushin kualifikimet dhe kriteret minimale si më poshtë:
   1.1. të jenë shtetas dhe banorë të Kosovës;
   1.2. të kenë diplomë të Fakultetit Juridik, të pranuar nga ligjet e Kosovës;
   1.3. të kenë kaluar provimin e jurispodencës;
   1.4. të kenë kaluar provimin përgatitor për prokurorë dhe gjyqtarë;
   1.5. të kenë reputacion të lartë pozitiv profesional dhe integritet moral;
   1.6. të mos jenë të dënuar me vendim të plotfuqishëm për vepra penale, me përjashtim të kundërvajtjeve të përcaktuara me ligj;
   1.7. të kenë dhënë provimin për arsimim ligjor, përveç personave, që kanë së paku shtatë (7) vjet përvojë pune ligjore dhe avokatët, që e kanë ushtruar profesionin e avokatit së paku pesë (5) vjet.
   1.8. provimit përgatitor nuk i nënshtrohen kandidatët, të cilët e kanë ushtruar detyrën e gjyqtarit ose të prokurorit së paku tre (3) vjet, si dhe kandidatët, të cilët kanë së paku shtatë (7) vjet përvojë pune ligjore dhe e kanë dhënë provimin përgatitor gjatë procesit të emërimit dhe të riemërimit për gjyqtarë dhe prokurorë.

Neni 20
Kriteret e veçanta për prokurorë të caktuar të shtetit

1. Përveç kualifikimeve minimale, të gjithë kandidatët për emërim si prokurorë të shtetit, me qëllim të emërimit në prokurori të caktuara, duhet gjithashtu të kenë kualifikimet e mëposhtme:
   1.1. për ta ushtruar funksionin e prokurorit në Departamentin e Krimeve të Rënda në Prokurorinë Themelore, kandidati duhet të ketë së paku tre (3) vite përvojë juridike si prokuror apo gjyqtar;
   1.2. për ta ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Apelit, kandidati duhet të ketë së paku katër (4) vite përvojë juridike si prokuror apo gjyqtar;
   1.3. për ta ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë Speciale, kandidati duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë juridike në të drejtën penale, përfshirë së paku tre (3) vite përvojë si prokuror;

1.4. për ta ushtruar funksionin e prokurorit pranë Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, kandidati duhet të ketë së paku gjashtë (6) vite përvojë juridike në të drejtën penale, përfshirë së paku katër (4) vite përvojë si prokuror;
1.5. për ta ushtruar funksionin si Kryeprokuror kandidati duhet të ketë së paku tetë (8) vite përvojë juridike në të drejtën penale, përfshirë së paku gjashtë (6) vite përvojë si prokuror i shtetit.

Neni 21
Kompensimi i prokurorëve të shtetit

1. Gjatë periudhës së shërbimit, prokurorët e shtetit gëzojnë pagat bazë si në vijim:
1.1. kryeprokurori i Shtetit pranon pagë ekuivalente me atë të Kryetarit të Gjykatës Supreme.
1.2. prokurorët me mandat të përhershëm në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit pranojnë pagë ekuivalente në shkallë nëntëdhjetë për qind (90%) me pagën e Kryeprokurorit të Shtetit.
1.3. kryeprokurori i Prokurorisë Speciale pranon pagë ekuivalente në shkallë nëntëdhjetë e pesë (95) % me pagën e Kryeprokurorit të Shtetit.
1.4. prokurorët me mandat të përhershëm në Prokurorinë Speciale marrin pagë ekuivalente me pagën e prokurorëve në Zyrën e Kryeprokurorit te Shtetit;
1.5. kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit merr pagë ekuivalente me pagën e kryetarit të Gjykatës se Apelit;
1.6. prokurorët me mandat të përhershëm në Prokurorinë e Apelit pranojnë pagë ekuivalente në shkallë nëntëdhjetë për qind (90%) me pagën e Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit.
1.7. kryeprokurorët e prokurorive themelore marrin pagë ekuivalente me kryetarët e gjykatave themelore.
1.8. secili prokuror me mandat të përhershëm në Prokurorinë Themelore pranon pagë jo më pak se shtatedhjetë përqind (70%) e pagës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore. Këshilli do të nxjerr skemën për kompensime shtesë që pasqyron përgjegjësitë e veçanta të prokurorit që paraqitet para Departamentit të Krimeve të rënda pranë Gjykatës Themelore, por në asnjë rast shuma e pagës bazë dhe pagesës shtesë nuk do të kalojë nëntëdhjetë për qind (90%) të pagës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore.
1.9. përpos pagës së tyre bazë, secili prokuror gëzon të drejtën për kompensim shtesë për shërbime tjera siç ceket me ligj apo rregulla të nxjerra nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.
1.10. pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e ligjit, paga e prokurorëve të shtetit nuk do të zvogëlohet gjatë periudhës së shërbimit të tyre përpos nëse kjo caktohet si sanksion nga Këshilli Prokurorial apo Komisioni Disiplinor i Këshillit bazuar në përcaktimin se prokurori i shtetit ka kryer sjellje të pahijshme apo ndonjë vepër penale.
1.11. prokurorët e shtetit kanë të drejtë në pushim vjetor në masë të barabartë me shërbyesit civilë, por në asnjë rast më pak së njëzet (20) ditë pushimi vjetor me pagesë.

Neni 22
Mbrojtja

Prokurorët kanë të drejtë që nga Këshilli Prokurorial i Kosovës të kërkojnë masa të veçanta mbrojtëse për veten dhe për familjet e tyre atëherë kur kërcënimi për jetën e tij apo të një anëtari të familjes vjen si rezultat i ushtrimit të funksionit të tyre prokurorial apo buron nga ai.

Neni 23
Imuniteti

1. Prokurorët gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni për veprimet e ndërmarra, vendimet e marra, apo mendimet e shprehura që janë brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre.
2. Prokurorët nuk gëzojnë imunitet dhe mund të shkarkohen nga funksioni nëse kanë kryer shkelje të qëllimshme të ligjit.
3. Kur një prokuror akuzohet apo arrestohet, ai/ajo duhet ta njoftojë pa vonesë Kryeprokurorin e Shtetit.

Neni 24
Trajnimi i prokurorëve të shtetit

1. Prokurorët kanë të drejtë në trajnim profesional të duhur për t'iu mundësuar ushtrimin efektiv të funksioneve të tyre prokuroriale, siç është e përcaktuar nga Këshilli.
2. Kryeprokurori i Shtetit, së bashku me Këshillin, shqyrton programet trajnuese për prokurorët dhe bën përmirësime të nevojshme për të siguruar përshtatjen, efikasitetin dhe dobinë.

Neni 25
Veprimtaritë profesionale

1. Prokurorët kanë të drejtë të marrin pjesë në organizata profesionale të cilat promovojnë pavarësinë dhe mbrojtjen e interesave profesionale të prokurorëve.
2. Prokurorët mund të angazhohen në veprimtari të cilat janë në përputhje më Kodin e Etikës dhe Sjelljen Profesionale të Prokurorëve, siç është pjesëmarrja në takime shkencore, ligjërime apo trajnime dhe pjesëmarrje në përgatitjen e projekteve të ndryshme ligjore. Varësisht prej miratimit nga Kryeprokurori i Shtetit, prokurorët mund të marrin kompensim për veprimtaritë e tilla në përputhje me Kodin e Etikës dhe Sjelljen Profesionale të Prokurorëve në rast se nuk ekziston konflikt interesash dhe se nuk ka shkelje të ligjit, kodit të etikës apo akteve të tjera nën-ligjore.
3. Në pajtueshmëri me dispozitat e Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Prokurorëve, prokurorët e shtetit mund të angazhohen në shkrime profesionale dhe shkencore por nuk mund të botojnë përmbajtjen relevante të dosjeve prokuroriale gjatë apo pas përfundimit të funksionit prokurorial, përveç nëse kjo lejohet shprehimisht me ligj apo akt nën-ligjor të lëshuar nga Këshilli.

Neni 26
Sjellja e prokurorëve

1. Prokurorët nuk do të përdorin statusin si prokuror apo reputacionin e prokurorisë për të avancuar të drejtat apo interesat e tyre personale.
2. Prokurorët nuk do të kryejnë asnjë detyrë apo shërbim tjetër që mund të ndërhyjë në pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre apo që në ndonjë mënyrë tjetër mund të mos jetë në përputhje me ushtrimin e funksionit të prokurorit.
3. Prokurorët nuk do të angazhohen në çfarëdo funksioni apo veprimtarie politike, përfshirë anëtarësinë në parti politike ose kandidimin apo mbajtjen e pozite politike. Prokurorët inkurajohen të votojnë por nuk mund të marrin pjesë në zgjedhje apo veprimtari politike. Mbajtja e pozitës politike është në mospajtueshmëri me ushtrimin e funksionit të prokurorit.
4. Sjellja e prokurorit duhet të jetë në përputhje me dispozitat e parashtruara në Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Prokurorëve.

KREU VI
DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 27
Tranzicioni i Prokurorive

1. Ky ligj do të zbatohet sipas orarit në vijim:
   1.1. faza e planifikimit: nga data 1 janar 2011 deri më 31 dhjetor 2011, Këshilli do të përgatisë planin e zbatimit për të lehtësuar kalimin nga sistemi aktual prokurorial tek sistemi prokurorial i themeluar sipas këtij ligji. Deri më datë 1 dhjetor, 2011 Këshilli do të postojë në faqen e vet të internetit planin e zbatimit.
   1.2. faza e zbatimit: nga data 1 janar 2012 deri më 31 dhjetor 2012, Këshilli do të vazhdojë me planin e vet të zbatimit.

Neni 28
Përgjegjësitë e Këshillit Prokurorial gjatë fazës së planifikimit dhe zbatimit

1. Gjatë fazës së planifikimit Këshilli do të shpallë rregullore lidhur me çështjet kalimtare dhe operative të cilat paraqiten si të nevojshme sipas këtij ligji.
2. Gjatë fazës së planifikimit, Këshilli do të zhvillojë një plan të detajuar për zbatim që përfshinë, por që nuk kufizohet me sa vijon:
   2.1. caktimin, ri caktimin dhe transferimin e lëndëve tek prokuroritë përkatëse me juridiksion territorial apo material për ato lëndë;
   2.2. caktimin e personelit;
   2.3. transferimin e pajisjeve fizike në mes prokurorive;
   2.4. caktimin dhe transferimin e prokurorëve në zyrat dhe pozitat përkatëse siç është paraparë me këtë ligj, duke marrë parasysh dhe duke i dhënë rëndësinë e duhur emërimeve dhe vendimeve të marrura gjatë procesit gjithëpërfshirës të riemërimit dhe ngarkesës me lëndë për secilën prokurori; dhe

2.5. të gjitha çështjet e tjera që ndikojnë në kalimin e sistemit prokurorial në strukturën e themeluar me këtë ligj si dhe për funksionimin efikas në të ardhmen të prokurorive.

3. Këshilli do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për organizimin, planifikimin dhe zbatimin e plotë të dispozitave të këtij ligji dhe për të siguruar kalim të lehtë në strukturën e re prokuroriale.

Neni 29
Përfundimi i lëndëve të pazgjidhura

1. Të gjitha lëndët të cilat më datë 31 dhjetor 2012 janë lëndë të shkallës së tretë në cilëndo prokurori dhe të cilat nuk janë përfunduar me vendim të formës së prerë nga gjykata, më datë 1 janar 2013 do të trajtohen si lëndë të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.
2. Të gjitha lëndët të cilat më datë 31 dhjetor 2012 janë lëndë të shkallës së dytë në cilëndo prokurori dhe të cilat nuk janë përfunduar me vendim të formës së prerë nga gjykata,, më datë 1 janar 2013 do të trajtohen si lëndë të Prokurorisë së Apelit.
3. Të gjitha lëndët të cilat më datë 31 dhjetor 2012 janë lëndë të shkallës së parë në cilëndo prokurori dhe të cilat nuk janë përfunduar me vendim të formës së prerë nga gjykata,, më datë 1 janar 2013 do të trajtohen si lëndë të Prokurorisë Themelore përkatëse e cila ka juridiksionin mbi territorin përkatës.

Neni 30
Vlefshmëria e akteve të mëparshme

Të gjitha veprimet e mëparshme të autoriteteve prokuroriale lidhur me lëndët që në atë kohë ishin nën autoritetin e tyre të ligjshëm dhe që janë marrë para transferimit të kompetencave të cekura me këtë ligj, do të mbesin në fuqi përveç nëse këto shfuqizohen nga ndonjë vendim pasues i gjykatës apo nga ndonjë direktivë nga Kryeprkurori i Shtetit ose Këshilli sipas këtij ligji.

Neni 31
Buxheti

Për zbatimin e plotë të këtij ligji, Qeveria e Kosovës do të sigurojë fonde adekuate nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

KREU VII
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 32
Shfuqizimi i ligjeve tjera

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen ligjet në vijim:
   1.1. Ligji mbi Prokurorinë Publike të Krahinës Autonome të Kosovës
   1.2. Rregullorja e UNMIK-ut nr.1999/05, Për themelimin e Gjykatës ad hoc të instancës së fundit dhe të zyrës ad hoc të Prokurorisë Publike.

1.3. cilido ligj tjetër deri në masën që është në mospërputhshmëri me dispozitat e këtij ligji.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji cilido referim në cilindo ligj, rregullore, urdhëresë, rregull apo ndonjë akt tjetër juridik për "Shërbime Prokuroriale" apo "Prokuror Publik" do të interpretohen që të kenë kuptimin e "Prokurorit të Shtetit"
3. Asgjë në këtë ligj nuk do të interpretohet apo zbatohet për të ndryshuar, kufizuar, zgjeruar apo për të ndryshuar në ndonjë formë tjetër autoritetin, juridiksionin, pushtetin apo detyrat e caktuara të Prokurorisë Speciale të përcaktuara me Ligjin mbi Prokurorinë Speciale, Nr. 2008/03-L052.

Neni 33
Hyrja në fuqi

Nenet 21, 28 dhe 29 hyjnë në fuqi sipas nenit 80(6) të Kushtetutës. Pjesa tjetër e këtij ligji hyn në fuqi më 1 janar 2013.

Ligji Nr. 03/L-225
30 shtator 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-049-2010, datë 18.10.2010 nga u.d. Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 83 / 29 TETOR 2010

LIGJI Nr. 04/L-193
PËR AVOKATINË

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 967
Kreu II: Kushtet për ushtrimin e avokatisë 969
Kreu III: Të drejtat dhe detyrimet e avokatit 971
Kreu IV: Praktikantët 974
Kreu V: Zyra e avokatisë 975
Kreu VI: Format e ushtrimit të avokatisë 975
Kreu VII: Pezullimi, ndërprerja dhe humbja e të drejtës për ushtrimin e avokatisë 978
Kreu VIII: Ushtrimi i avokatisë nga avokatët e shteteve tjera në Republikën e Kosovës 979
Kreu IX: Oda e avokatëve 980
Kreu X: Specializimi i avokatit dhe shoqërive të avokatëve 982
Kreu XI: Përgjegjësia disiplinore e avokatëve, praktikantëve 982
Kreu XII: Dispozitat ndëshkuese 985
Kreu XIII: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 985

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR AVOKATINË

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Me këtë ligj rregullohen kushtet për ushtrimin e avokatisë, mënyrat dhe format e punës, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e avokatëve dhe praktikantëve, organizimi dhe puna e Odës së Avokatëve të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Oda), si dhe çështje tjera të rëndësishme për ushtrimin e avokatisë.

Neni 2
Zyra e Avokatit

Avokatët mund ta ushtrojnë avokatinë në zyrën individuale, në zyrën e përbashkët të avokatëve ose në shoqërinë të avokatëve, të regjistruar në regjistrin e Odës.

Neni 3
Avokatia

1. Avokatia është profesion i lirë dhe i pavarur që merret me dhënien e ndihmës juridike personave fizikë dhe juridikë për mbrojtjen e lirive, të drejtave dhe të interesave të tyre në pajtim me rendin juridik.
2. Pavarësia e avokatisë realizohet përmes:
   2.1. ushtrimit të pavarur të avokatisë;
   2.2. dhënies së ndihmës juridike;
   2.3. nxjerrjes së Statutit dhe akteve tjera të Odës;
   2.4. vendosjes për fitimin, ndërprerjen dhe pushimin e të drejtës në ushtrimin e avokatisë.

Neni 4
Ndihma juridike

1. Ndihma juridike përfshin:
   1.1. dhënien e këshillave dhe mendimeve juridike;
   1.2. hartimin e padive, kërkesave, propozimeve, lutjeve, mjeteve juridike dhe parashtresave tjera;
   1.3. hartimin e kontratave, marrëveshjeve, testamenteve, deklaratave, akteve të përgjithshme dhe të veçanta si dhe dokumenteve tjera;
   1.4. përfaqësimin dhe mbrojtjen e personave fizikë dhe juridikë, shoqëritë afariste dhe subjektet tjera juridike para gjykatave dhe organet tjera shtetërore;
   1.5. përfaqësimi i personave fizikë e juridikë në punët e tyre juridike, në zgjidhjen miqësore të kontesteve dhe raporteve kontestuese;
   1.6. kryerjen e punëve tjera të ndihmës juridike në emër dhe për llogari të personave fizikë e juridikë vendorë apo të huaj, në bazë të të cilave realizohen të drejtat dhe mbrohen liritë dhe interesat tjerë.

Neni 5
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **Avokatia** – profesion që merret me dhënien e ndihmës juridike;
   1.2. **Avokat** – person që është i regjistruar në Odë, që e ka dhënë betimin dhe merret me avokati;
   1.3. **Avokat vendor** – avokatin shtetas të Republikës së Kosovës;
   1.4. **Avokat i huaj** – avokati, i cili e ka fituar të drejtën për ushtrimin e profesionit të avokatit në shtetin amë, mund të ushtrojë profesionin e avokatit në Republikën e Kosovës në pajtim me kushtet e përcaktuara me këtë ligj dhe aktet tjera të Odës;
   1.5. **Kandidat** – personi që e ka dorëzuar kërkesën për regjistrim në regjistrin e avokatëve dhe e mban këtë status gjer në ditën e regjistrimit në listën e avokatëve dhe të dhënies së betimit;

1.6. **Kartela –** Kartela identifikuese e çdo avokati dhe praktikanti të regjistruar në Odë;
1.7. **Kodi** – Kodi i Etikës së Avokatëve;
1.8. **Oda** – Oda e Avokatëve të Kosovës;
1.9. **Pala** – person fizik apo juridik, i cili i drejtohet avokatit me kërkesë për ndihmë juridike dhe personi, të cilin avokati e përfaqëson apo e mbron;
1.10. **Përfaqësim** – përfaqësim apo mbrojtje në procedurë;
1.11. **Praktikant** – juristi i diplomuar, i cili është regjistruar në regjistrin e praktikantëve dhe është duke u aftësuar për profesionin e avokatit;
1.12. **Regjistri** – regjistri, në të cilin regjistrohen avokatët, praktikantët, zyrat e përbashkëta të avokatëve dhe shoqëritë e avokatëve;
1.13. **Regjistrimi** – Regjistrimi i Avokatëve, zyrave të përbashkëta të avokatëve, shoqërive të avokatëve dhe praktikanteve në regjistrin përkatës të odës.
1.14. **Shoqëria e avokatëve** – ortakëria e përgjithshme, shoqëria komandite dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuar siç është përkufizuar në Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
1.15. **Zyra e avokatisë** – lokali në të cilin ushtrohet avokatia.

KREU II
KUSHTET PËR USHTRIMIN E AVOKATISË

Neni 6
E drejta për ushtrimin e avokatisë

1. E drejta për ushtrimin e avokatisë fitohet me regjistrim në regjistrin e Odës.
2. Procedura për realizimin e të drejtës për ushtrimin e avokatisë iniciohet me parashtrimin e kërkesës së kandidatit për regjistrim në Odë.
3. Kundër vendimit lidhur me refuzimin e kërkesës për regjistrimin, pezullimin, ndërprerjen ose humbjen e të drejtës për ushtrimin e avokatisë lejohet ankesa.
4. Ankesa i dorëzohet Komisionit për Ankesa të Odës në afat prej tetë (8) ditësh prej ditës së pranimit.
5. Vendimi i Komisionit për Ankesa është përfundimtar.
6. Kundër vendimit të Komisionit të Odës për Ankesa, mund të iniciohet konflikti administrativ.

Neni 7

1. Kandidati për avokat është i detyruar të bëjë pagesën e shpenzimeve të parapara për regjistrim dhe të lidhë kontratën për sigurimin ndaj përgjegjësisë profesionale. para dhënies së betimit.
2. Me akt të veçantë të nxjerrë nga Oda përcaktohet lartësia e shpenzimeve për regjistrim. Lartësia e shpenzimeve për regjistrim nuk mund të jetë më e lartë se vlera e tri (3) pagave minimale në Kosovë.

Neni 8

1. Avokati, i cili është i regjistruar në regjistrin e avokatëve në pajtim me dispozitat e këtij ligji, pajiset për çdo vit me kartelën e identifikimit të avokatit.
2. Organi, para të cilit është duke u zhvilluar procedura, mund të kërkojë kartelën identifikuese nga çdo person që prezantohet në cilësinë e avokatit.

Neni 9

Avokati i cili e ka fituar të drejtën për ushtrimin e profesionit të avokatit në shtetin amë, mund të ushtrojë profesionin e avokatit në Republikën e Kosovës në pajtim me kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

Neni 10
Kushtet për regjistrim

1. Oda merr vendim të regjistrojë kandidatin, i cili i plotëson kushtet në vijim, përveç nëse nuk është përcaktuar ndryshe me këtë ligj:
   1.1. shtetësia e Republikës së Kosovës;
   1.2. diploma e fakultetit juridik në Kosovë apo diploma e fituar në fakultetin juridik të ndonjë shteti tjetër, e cila është pranuar në pajtim me ligjet që rregullojnë fushën e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës;
   1.3. zotësia e plotë e veprimit;
   1.4. provimi i dhënë i jurisprudencës në Republikën e Kosovës;
   1.5. të mos jetë në marrëdhënie të punës;
   1.6. që kundër tij mos të jetë në zhvillim e sipër procedurë penale apo të mos jetë gjykuar për vepër penale, për të cilën është paraparë dënimi me burg deri në një (1) vit, e cila kandidatin do ta kishte bërë të padenjë për të ushtruar avokatinë;
   1.7. të jetë i denjë për ushtrimin e avokatisë në pajtim me Kodin;
   1.8. të ketë siguruar zyrën e përshtatshme për ushtrimin e avokatisë dhe kushtet e nevojshme teknike në pajtim me aktet nënligjore të Odës;
   1.9. të ketë kaluar më së paku një (1) vit nga vendimi i plotfuqishëm për refuzimin e regjistrimit në Odë;
   1.10. të këtë dhënë provimin nga kodi i etikës profesionale të avokatëve sipas Rregullores së miratuar nga Oda.
2. Vetëm avokatët kanë të drejtë të japin ndihmë juridike, nëse me ligj nuk është paraparë ndryshe.
3. Profesorët ordinar dhe inordinar të lëndëve juridike në fakultetet e Republikës së Kosovës janë të autorizuar të ofrojnë këshilla dhe mendime juridike me pagesë, por jo edhe për forma të tjera të ndihmës juridike.
4. Shprehjet "këshillë juridike" dhe "mendim juridik" nga paragrafi 3. i këtij neni nuk nënkuptojnë përpilimin e shkresave (kontratave, testamenteve, deklaratave, etj.) e as të padive, kërkesave, lutjeve, mjeteve juridike të jashtëzakonshme dhe parashtresave tjera.
5. Personat nga paragrafi 2. i këtij neni janë të detyruar te njoftojnë Odën për

ushtrimin e veprimtarisë së tyre sipas këtij ligji me qëllim evidentim që ushtrojnë veprimtarinë e tyre ne pajtim me aktet e Odës.

6. Evidentimi i personave nga paragrafi 2. i këtij neni bëhet në pajtim me aktet e Odës.
7. Personat nga paragrafi 2. i këtij neni ofrojnë këshilla dhe mendime juridike në pajtim me dispozitat e ligjit, akteve të Odës dhe të Kodit të Etikës së Avokatëve.
8. Oda është e autorizuar dhe e detyruar të fillojë procedurën përkatëse ligjore për çdo rast të ofrimit të ndihmës juridike në mënyrë të paautorizuar, përveç nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 11
Betimi

1. Avokati, për të cilin është marrë vendimi për regjistrim në regjistrin e avokatëve, është i detyruar që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, prej ditës kur i dorëzohet njoftimi për lejimin e regjistrimit, të jep betimin solemn para organit kompetent të Odës. Në të kundërtën, konsiderohet se ka hequr dorë nga regjistrimi.
2. Teksti i betimit solemn është si vijon: „Betohem, se avokatinë do ta ushtroj me dinjitet, ndërgjegje, i pavarur dhe me nder, duke respektuar rendin juridik dhe kushtetues të Republikës së Kosovës”

KREU III
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E AVOKATIT

Neni 12
Detyrimet themelore të avokatit

1. Avokati është i detyruar:
   1.1. të ofrojë ndihmën juridike në mënyrë profesionale, të ndërgjegjshme, te denjë dhe në pajtim me këtë ligj, Statutin dhe Kodin;
   1.2. të ruaj fshehtësinë e të dhënave, fakteve dhe informatave që i janë dhënë gjatë përfaqësimit të klientëve.

Neni 13
Arsimi i vazhdueshëm ligjor

1. Avokati është i detyruar të arsimohet në mënyrë të vazhdueshme dhe të pasurojë njohuritë për ushtrimin e avokatisë në pajtim me aktet e përgjithshme të Odës.
2. Avokati është i detyruar që, praktikantit që kryen stazhin në zyrën e tij, t’i sigurojë kushte të përshtatshme për punë dhe trajnim në pajtim me programin e trajnimit të përcaktuar nga Oda si dhe të mbikëqyr punën e tij dhe ngritjen profesionale.

Neni 14
Liria dhe detyrimi i dhënies së ndihmës juridike

1. Avokati vendos në mënyrë të lirshme se a e pranon dhënien e ndihmës juridike, përveç rasteve të përcaktuara me këtë ligj.

2. Avokati nuk mund ta refuzojë ndihmën juridike, nëse gjykata, ndonjë organ tjetër shtetëror ose Oda e caktojnë si përfaqësues apo mbrojtës, në pajtim me ligjin, përveç nëse ekzistojnë arsyet e parapara me ligj, për shkak të të cilave avokati është i detyruara ta refuzojë ndihmën juridike.

Neni 15
Ndihma juridike pa pagesë

Oda është e detyruar të rregullojë ndihmën pa pagesë personave në gjendje sociale të vështirë në çështjet juridike, në të cilat, personat e tillë realizojnë të drejtat që janë në lidhje të drejtpërdrejtë me pozitën e tyre, si dhe me rastet tjera të parapara me aktet nënligjore të Odës.

Neni 16
Detyrimi i refuzimit të ndihmës juridike

1. Avokati është i detyruar t'ia refuzojë palës ndihmën juridike:
   1.1. nëse ai ose ndonjë avokat tjetër, i cili ka punuar në zyrën e njëjtë dhe ka qenë i angazhuar në çështjen e njëjtë apo në ndonjë çështje që ka pasur lidhje juridike me të parën duke përfaqësuar palën kundërshtare ose të dy palët, i ka dhënë këshillë juridike;
   1.2. nëse në çështjen e njëjtë apo në çështjen që ka lidhje juridike me të parën ka punuar si praktikant te avokati, i cili e ka përfaqësuar palën kundërshtare;
   1.3. nëse është anëtar, apo ka qenë anëtar i zyrës së përbashkët të avokatëve apo të shoqërisë së avokatëve, në të cilat, pala kundërshtare është duke u përfaqësuar apo ka qenë e përfaqësuar;
   1.4. nëse në çështjen e njëjtë apo në çështjen që ka lidhje juridike me të parën ka punuar si gjyqtar, prokuror apo person zyrtar në procedurë administrative apo ndonjë procedurë tjetër;
   1.5. në rastet tjera të parapara me ligj, statut dhe me kod.

Neni 17
Fshehtësia e avokatit

1. Avokati është i detyruar që, në pajtim me Statutin dhe Kodin të ruaj sekretin profesional dhe të kujdeset që, në mënyrë të njëjtë të veprojnë edhe të gjithë të punësuarit në zyrën tij.
2. Detyrimi i ruajtjes së fshehtësisë profesionale nuk është i kufizuar në kohë.

Neni 18
Refuzimi i prokurës

1. Avokati ka të drejtë ta refuzojë përfaqësimin (prokurën) në pajtim me këtë ligj.
2. Avokati është i detyruar ta informojë menjëherë organin kompetent, te i cili është duke u zhvilluar procedura.
3. Në rast të kërkesës së klientit, prokurën e të cilit e ka refuzuar, avokati është i detyruar të vazhdojë t'i jep ndihmë juridike të domosdoshme, por jo më shumë se

pesëmbëdhjetë (15) ditë prej ditës së dorëzimit të denoncimit rregullisht në organin, i cili është duke udhëhequr procedurën për denoncimin e prokurës.

Neni 19
Ruajtja dhe kthimi i shkresave të lëndës

1. Avokati është i detyruar t'ia kthejë palës të gjitha shkresat e lëndës pas përfundimit të përfaqësimit me kërkesën e tij.
2. Avokati është i detyruar t'i ruaj shkresat e lëndës në formë të shkresave apo të skanuara më së paku për pesë (5) vjet pas përfundimit të plotfuqishëm të procedurës, përveç nëse pala ka hequr dorë me shkrim nga një kërkesë e tillë.

Neni 20
Zëvendësimi i avokatit

1. Avokatin mund ta zëvendësojë praktikanti i punësuar në zyrën e tij ose ndonjë avokat tjetër në pajtim me këtë ligj.
2. Praktikantit të punësuar në zyrën e avokatit nuk i nevojitet autorizimi zëvendësuar për përfaqësim.
3. Praktikanti është i detyruar të veprojë sipas udhëzimeve të avokatit që e zëvendëson.
4. Për shkeljet e bëra nga praktikanti, përgjegjësinë materiale e bartë avokati, te i cili është i punësuar praktikanti.

Neni 21
Shpërblimi dhe kompensimi i shpenzimeve

1. Avokati ka të drejtë për pagesën e honorarit dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e tij në pajtim me Rregulloren për tarifën e avokatëve.
2. Për përfaqësim sipas detyrës zyrtare, lartësinë e shpërblimit dhe shpenzime të avokatëve e përcaktojnë Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Agjencia për ndihmë Juridike falas në bashkëpunim me organet e Odës.
3. Fatura e avokatit për shpërblim dhe shpenzime paraqet dokument autentik në procedurën e përmbarimit.

Neni 22
E drejta e pagesës dhe pengut

1. Honorarin dhe shpenzimet, avokati, zyra e përbashkët e avokatëve apo shoqëria e avokatëve janë të autorizuar t'i paguajnë nga të hollat e deponuara nga pala, apo nga të hollat që i janë paguar apo i ka pranuara në emër të klientit, nëse avokati dhe klienti nuk janë marrë vesh ndryshe.
2. Avokati është i detyruar t'ia jap palëve faturën për shërbimet e kryera dhe shpenzimet e paguara.
3. Nga mjetet financiare të pranuara në emër të palës, avokati ka të drejtën e pengut për pagesën e shpërblimit dhe shpenzimeve.

KREU IV
PRAKTIKANTËT

Neni 23
Kushtet për regjistrim në regjistrin e praktikantëve

1. Të drejtën për t'u regjistruar në regjistrin e praktikantëve e fiton personi, i cili i plotëson këto kushte:
   1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
   1.2. të posedojë diplomën e fakultetit juridik në Kosovë apo diplomën nga fakulteti juridik i ndonjë shteti tjetër, e cila është pranuar në pajtim me ligjet që rregullojnë lëmin e shkollimit të lartë në Republikën e Kosovës;
   1.3. të ketë zotësinë e plotë e veprimit;
   1.4. të mos jetë në marrëdhënie të punës;
   1.5. të mos jetë i dënuar për vepër penale, e cila do ta kishte bërë të padenjë për t'i besuar ushtrimin e avokatisë;
   1.6. të mos merret me ndonjë veprimtari tjetër të regjistruar;
   1.7. të jetë i denjë për ushtrimin e avokatisë në pajtim me kodin;
   1.8. të ketë lidhur kontratën e punës me avokatin, zyrën e përbashkët të avokatëve apo me shoqërinë e avokatëve.
2. Kohëzgjatja e praktikës në zyrën e avokatit është një (1) vit.
3. Dispozitat tjera materiale dhe procedurale që kanë të bëjnë me avokatët, në mënyrë të përshtatshme aplikohen edhe për praktikantët.

Neni 24
Të drejtat dhe detyrimet e praktikantit

1. Praktikanti është i detyruar të kryejë të gjitha punët që ia beson avokati dhe detyrohet t'u përmbahet udhëzimeve të tij.
2. Praktikantit i ndalohet kryerja e punëve juridike të avokatit pa lejen shprehimore të avokatit, te i cili është duke kryer praktikën.

Neni 25
Përgjegjësia e praktikantëve

1. Për dëmin që mund të shkaktojë praktikanti ndaj palës gjatë kryerjes së detyrës sipas autorizimit me shkrim të avokatit, në mënyrë të drejtpërdrejt përgjigjet avokati, Zyra e përbashkët e avokatëve dhe shoqëria e avokatëve.
2. Praktikanti përgjigjet personalisht për dëmin e shkaktuar gjatë ushtrimit të detyrës, nëse ky dëm është shkaktuar me dashje apo nga pakujdesia e rëndë.

KREU V
ZYRA E AVOKATISË

Neni 26

1. Avokati individual, zyrat e përbashkëta të avokatëve dhe shoqëritë e avokatëve mund të kenë vetëm një zyrë, e cila duhet të jetë në vendin, për të cilin ekziston vendimi i Odës.
2. Vendi, pajisja dhe rregullimi i zyrës duhet të jenë në harmoni me rëndësinë dhe prestigjin e avokatisë në kushtet e nevojshme për ruajtjen e sekretit profesional, në pajtim me kriteret e përcaktuara me aktet nënligjore të Odës.
3. Avokati mund të jep ndihmën juridike vetëm në zyrë, përveç rasteve kur përfaqëson në seanca, shqyrtime, shikime në vendin e ngjarjes, rekonstruktime, negociata ose në lidhjen e punëve juridike.
4. Përjashtimisht, për arsye të rrethanave të rastit dhe natyrës së ndihmës juridike, avokati mund të ofrojë ndihmë juridike edhe në banesë/shtëpi apo në selinë së palës.
5. Avokati është i detyruar që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh ta informojë me shkrim Odën për çdo ndërrim të selisë së zyrës së tij.
6. Themelimi, organizimi dhe funksionimi i zyrës së avokatit rregullohet me aktet e përgjithshme të Odës.

KREU VI
FORMAT E USHTRIMIT TË AVOKATISË

Neni 27

1. Avokatët mund ta ushtrojnë avokatinë:
   1.1. në zyrë individuale;
   1.2. në zyrën e përbashkët të avokatëve dhe
   1.3. në shoqërinë e avokatëve.

Neni 28
Zyra individuale

1. Avokati mund të ketë vetëm një (1) zyrë.
2. Avokati mund të veprojë si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
3. Selia e zyrës së avokatit duhet të jetë në vendin, në të cilin avokati e ka të lajmëruar në Odë dhe, për të cilin ekziston vendimi i Odës.
4. Vendi dhe rregullimi i zyrës së avokatit duhet të jenë në harmoni me rëndësinë dhe prestigjin e avokatisë në kushtet e nevojshme për ruajtjen e sekretit profesional, në pajtim me kriteret e përcaktuara me aktet e Odës.
5. Avokati mund të jep ndihmën juridike vetëm në zyrën e tij, përveç rasteve kur përfaqëson në seanca, shqyrtime, shikime në vendin e ngjarjes, rekonstruktime, negociata ose në lidhjen e punëve juridike.
6. Përjashtimisht, për arsye të rrethanave të rastit dhe natyrës së ndihmës juridike,

avokati mund të ofrojë ndihmë juridike edhe në banesë/shtëpi apo në zyrat e selisë së palës.

7. Avokati është i detyruar që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh ta informojë me shkrim Odën për çdo ndërrim të selisë së zyrës së tij.

Neni 29
Zyra e përbashkët e avokatëve

1. Disa avokatë mund të kenë zyrë të përbashkët dhe në atë rast, të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella i rregullojnë me kontratë.
2. Avokatët që kanë për qëllim themelimin e zyrës së përbashkët janë të detyruar ta informojnë Odën për lidhjen e kontratës nga paragrafi 1. i këtij neni.
3. Themelimi i zyrës së përbashkët të avokatëve regjistrohet në regjistrin përkatës të Odës pas marrjes së vendimit.
4. Oda është e detyruar që të bëjë regjistrimin nga paragrafi 2., 3. i këtij neni në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

Neni 30
Shoqëritë e avokatëve

1. Dy ose më shumë avokatë të regjistruar në Odë, mund të themelojnë shoqëri të avokatëve.
2. Vetëm avokati mund të jetë anëtar i shoqërisë së avokatëve.
3. Vetëm avokatët dhe praktikantët e shoqërisë së avokatëve mund të ofrojnë ndihmë juridike në shoqërinë e avokatëve.
4. Shoqëria e avokatëve mund të punësojë avokatë pa status të anëtarit të shoqërisë.
5. Me anë të akteve të përgjithshme të shoqërisë duhet të mbrohet pavarësia e avokatëve në kryerjen e profesioni.
6. Avokati që është i punësuar në shoqëri është i detyruar të ofrojë atë ndihmë juridike që ia cakton shoqëria, nëse me kontratë nuk është përcaktuar ndryshe.
7. Format e organizimit dhe të qeverisjes së shoqërive të avokatëve rregullohet me akte nënligjore të Odës dhe me Ligjin për shoqëritë tregtare.

Neni 31
Ndërlidhja e zyrave të avokatëve

1. Zyrat e avokatëve mund të ndërlidhen me zyra tjera vendore dhe të huaja për kryerjen e punëve të caktuara me interes të përbashkët dhe për bashkëpunim të ndërsjellë.
2. Ndërlidhja e zyrave të avokatëve bëhet me anë të kontratës me shkrim, e cila i dorëzohet Odës në kopje në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh prej ditës së nënshkrimit të saj.
3. Kushtet dhe mënyra e ndërlidhjes së zyrave nga paragrafi 1. i këtij neni rregullohet me akte të përgjithshme të Odës.

Neni 32
Pacenueshmëria e zyrës së avokatit

1. Zyra e avokatit, gjësendet dhe të dhënat që gjenden në të, mund t'i nënshtrohen kontrollimit vetëm në pajtim me këtë ligji.
2. Asnjë organ publik nuk mund të zbatojë masat e mbylljes ose të vulosjes ndaj zyrës së avokatit, gjatë procedurës penale, kundërvajtëse, administrative apo të ndonjë delikti ekonomik që është duke u zhvilluar kundër avokatit.

Neni 33
Heqja e lirisë e avokatit dhe bastisja e zyrës së tij

1. Avokati nuk mund të privohet nga liria për vepra penale lidhur me ushtrimin e shërbimet e tij në cilësinë e avokatit pa vendimin e gjykatës kompetente.
2. Për privimin e avokatit nga liria njoftohet Oda.
3. Zyra e avokatit mund të bastiset vetëm në bazë të vendimit të gjykatës kompetente edhe atë, lidhur me shkresa, dokumente apo lëndë të përcaktuara shprehimisht.
4. Zyra e avokatit mund të bastiset vetëm në prezencën e avokatit dhe të përfaqësuesit të autorizuar të Odës të caktuar nga Kryetari i Odës.
5. Sendet, shkresat ose dokumentet, përveç atyre nga paragrafi 3. i këtij neni, si dhe informatat që mund të mblidhen me rastin e bastisjes së zyrës së avokatit, nuk mund të shfrytëzohen për zhvillim të asnjë procedure kundër palëve të avokatit nga zyra e tij.
6. Gjykatat ose organet tjera shtetërore duhet menjëherë ta informojnë Odën për fillimin e procedurës kundër avokatit apo për vendimin e mbajtjes apo paraburgimit të tij.

Neni 34
E drejta e avokatit për sigurimin e informatave

Organet shtetërore, personat fizikë dhe juridikë me autorizime publike janë të detyruar që avokatit me kërkesën e tij në pajtim me ligjin ti ofroj të dhënat dhe informatat që i nevojiten për ushtrimin e avokatisë në rastet konkrete, nëse një gjë e tillë nuk është në kundërshtim me ruajtjen e fshehtësisë zyrtare dhe profesionale.

Neni 35
Sigurimi i detyrueshëm ndaj përgjegjësisë profesionale

1. Avokati është i detyruar të sigurohet ndaj përgjegjësisë profesionale në institucionin që është i regjistruar për këtë lloj të sigurimit.
2. Oda e përcakton shumën minimale të sigurimit për dëmin nga përgjegjësia profesionale.
3. Oda do t'ia refuzojë dhënien e kartelës avokatit, i cili nuk e ka lidhur kontratën e sigurimit ndaj përgjegjësisë profesionale.
4. Procedura për sigurimin e përgjegjësisë profesionale rregullohet me aktet e Odës.

Neni 36
Shënjimi i parashtresave dhe i dokumenteve

Avokati duhet të nënshkruaj dhe të vëj vulën e tij në çdo parashtresë dhe dokument. Në qoftë se avokati profesionin e avokatisë e ushtron në shoqërinë e avokatëve krahas vulës së shoqërisë së avokatëve duhet të vej edhe vulën e vetë.

KREU VII
PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE HUMBJA E TË DREJTËS PËR USHTRIMIN E AVOKATISË

Neni 37
Pezullimi i ushtrimit të avokatisë

1. Avokati ka të drejtë të kërkojë pezullimin e përkohshëm të ushtrimit të avokatisë:
   1.1. për shkak të ngritjes profesionale apo shkaqeve tjera të arsyeshme, për periudhën sa të zgjasin ato shkaqe;
   1.2. gjatë kohës së pengimit të përkohshëm për shkak të sëmundjes, pushimit të lehonisë, pushimit për kujdesin ndaj fëmijës dhe shkaqeve tjera shëndetësore;
   1.3. në rast të zgjedhjes apo emërimit në funksion publik për kohëzgjatjen e mandatit.
2. Vendimin për ndërprerjen, gjegjësisht pezullimin e ushtrimit të avokatisë e merr Oda.
3. Nëse ushtrimi i avokatisë është ndërprerë për shkak se kundër avokatit është në zhvillim e sipër procedura disiplinore, kohëzgjatja e ndërprerjes së ushtrimit të avokatisë llogaritet në kohëzgjatjen e masës së shqiptuar, sipas të cilës iu ka ndërprerë e drejta e ushtrimit të avokatisë.
4. Pas pushimit të ndërprerjes gjegjësisht pezullimit të shkaqeve, avokati fillon ushtrimin e profesionit të avokatisë.

Neni 38
Ndërprerja e ushtrimit të avokatisë

1. Ushtrimi i avokatisë ndërpritet, nëse:
   1.1. kundër avokatit është iniciuar procedurë penale për veprën penale, e cila e bën të padenjë për ushtrimin e avokatisë;
   1.2. kundër avokatit është iniciuar procedurë disiplinore për shkak të shkeljes së rëndë të detyrës së avokatit dhe prestigjit të avokatisë,
   1.3. avokati është dënuar për veprën penale, e cila e bën të padenjë për ushtrimin e avokatisë;
   1.4. në rastet nga paragrafi 1. i këtij neni dhe në rastet tjera, në të cilat avokati, për shkaqe të arsyeshme, nuk e ushtron avokatinë detyrohet ta informojë Odën.

Neni 39
Humbja e të drejtës për ushtrimin e avokatisë

1. Avokati e humb të drejtën për ushtrimin e avokatisë, nëse:
   1.1. humb shtetësinë e Republikës së Kosovës;
   1.2. humb zotësinë për të vepruar;
   1.3. për arsye shëndetësore e humb përgjithmonë aftësinë për ta ushtruar avokatinë;
   1.4. i është shqiptuar masa e sigurisë - ndalesa e ushtrimit të avokatisë;
   1.5. i është shqiptuar dënimi disiplinor i ndalesës së përhershme të ushtrimit të avokatisë;
   1.6. vullnetarisht heq dorë nga ushtrimi i avokatisë;
   1.7. më shumë se gjashtë (6) muaj pa shkaqe të arsyeshme nuk e ushtron avokatinë;
   1.8. themelon marrëdhënie pune, përveç në zyrë të avokatisë, zyrën e përbashkët apo shoqëri të avokatëve;
   1.9. është dënuar më shumë se një (1) vit pa kusht me burgim për vepra penale, të cilat e bëjnë të padenjë për ushtrimin e avokatisë;
   1.10. në periudhë prej një (1) viti nuk i përmbush detyrimet financiare ndaj Odës.

KREU VIII
USHTRIMI I AVOKATISË NGA AVOKATËT E SHTETEVE TJERA NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Neni 40

1. Avokatët nga shtetet e tjera mund të ushtrojnë profesionin e avokatit në territorin e Republikës së Kosovës nën kushtet e reciprocitetit.
2. Konfirmimin për ekzistimin e reciprocitetit e lëshon Ministria e Drejtësisë pas marrjes paraprake të mendimit të Odës së Avokatëve.
3. Me Statutin e Odës së Avokatëve rregullohen kushtet, mënyra dhe procedura sipas të cilëve avokatët nga shtetet e tjera mund të ushtrojnë profesionin e avokatisë në territorin e Republikës së Kosovës.
4. Avokatët nga shtetet anëtare të Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës mund të ushtrojnë profesionin e avokatit në territorin e Republikës së Kosovës.
5. Me rastin e regjistrimit në Regjistrin e veçantë të avokatëve në Odën e Avokatëve të Republikës së Kosovës, avokati nga paragrafi 1. dhe 4. i këtij neni, paraqet dokumentin e odës së avokatëve anëtarë i të cilës është për të dëshmuar se në shtetin amë ushtron profesionin e avokatit, si dhe dokumentet për plotësimin e kushteve nga paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3, 5, 6, 7, 8 dhe 9 të nenit 10 të këtij ligji.

KREU IX
ODA E AVOKATËVE

Neni 41
Organizimi dhe statusi i Odës

1. Oda është organizatë profesionale e pavarur e avokateve me cilësinë e personit juridik e themeluar në pajtim me ligjin dhe Statutin e Odes, e cila është kompetente për ushtrimin e autorizimeve publike dhe kryerjen e punëve me interes të përgjithshëm, në pajtim me këtë ligj dhe Statutin e Odes me autorizime publike me cilësi të personit juridik.
2. Selia e Odës është në Prishtinë.
3. Oda e avokatëve:
   3.1. vendos për fitimin dhe pushimin e drejtës së ushtrimit të veprimtarisë së avokaturës dhe shlyerjen në Regjistrin e avokatëve, zyrat e përbashkëta të avokatëve, dhe të shoqërive të avokatëve;
   3.2. vendos për kërkesat për pushimin e ushtrimit të përkohshëm të profesionit të avokatit;
   3.3. nxjerr Tarifën për shpërblimin dhe kompensimin e shpenzimeve të avokatëve;
   3.4. nxjerrë aktet e përgjithshme të Odës;
   3.5. nxjerr Kodin profesional të avokatëve;
   3.6. vendos për përgjegjësinë për shkeljen e detyrës së avokatëve dhe imazhin e avokaturës;
   3.7. kujdeset për aftësimin dhe ngritjen profesionale të bashkëpunëtorëve profesional të avokaturës dhe të praktikantëve të avokaturës;
   3.8. jep mendim për reciprocitet me kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë.
4. Organizimi i brendshëm i Odës rregullohet me Statut.
5. Oda i ka degët regjionale në Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Gjilan, Ferizaj dhe Mitrovicë. Me Statutin e Odes përcaktohen kompetencat e degëve regjionale.
6. Avokatët, zyrat e përbashkëta të avokatëve dhe shoqëritë e avokatëve detyrimisht anëtarësohen në Odë.

Neni 42
Organet e Odës

1. Organet e Odës janë: Konferenca e përgjithshme, Kuvendi, Kryetari, Këshilli Drejtues, Këshilli Mbikëqyrës, organet disiplinore, dhe organet e përcaktuara me Statutin e Odës.
2. Struktura, kompetenca, përbërja, mënyra e zgjedhjes, të drejtat dhe detyrimet e organeve të Odës rregullohen me aktet e Odës.
3. Kuvendi i Odës përbëhet nga përfaqësuesit e degëve regjionale, mbi parimin e sistemit të delegimit, të cilët zgjidhen në proporcion me numrin e anëtarëve të Degëve Regjionale.
4. Kuvendin e Odës e përbëjnë tetëdhjetë e pesë (85) delegatë.

Neni 43
Bashkëpunimi me institucionet

1. Oda e informon Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Qeverinë, përmes një raporti vjetor të shkruar, për ecuritë e punës, gjendjen dhe sfidat e avokatisë dhe masat që duhet ndërmarrë për qëllim të përparimit të avokatisë dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.
2. Oda bashkëpunon me institucionet shtetërore dhe me organet e vetëqeverisjes lokale në zgjedhjen e problemeve me rëndësi për realizimin e detyrave të avokatisë.
3. Oda vendos bashkëpunim me odat dhe asociacionet tjera ndërkombëtare me qëllim të zhvillimit të avokatisë.

Neni 44
Mbikëqyrja dhe përcjellja e punës së Odës dhe avokatisë

1. Qeveria e Kosovës mbikëqyr ligjshmërinë e akteve të përgjithshme të Odës së Avokatëve dhe ka të drejtë që gjer në vendimin e gjykatës kompetente, të ndaloj ekzekutimin e aktit i cili është në kundërshtim me ligjin. Kjo mbikëqyrje kufizohet në përfilljen e ligjit dhe të së drejtës, duke mos e cenuar autonominë administrative të Odës së Avokatëve.
2. Ministria e Drejtësisë përcjell punën e avokatisë dhe kushtet për punën e saj. Për këtë qëllim nga Oda mund të kërkojë informacione dhe të dhëna përkatëse duke pasur kujdes për pavarësinë e avokatisë.
3. Informacionet dhe të dhënat nga paragrafi 2. i këtij neni Oda është e detyruar t'ia dërgoj Ministrisë së Drejtësisë në afat prej tridhjetë (30) ditësh apo të njoftoj për arsyet për të cilat nuk mundet t'i dërgojë informacionet dhe të dhënat e kërkuara.

Neni 45
Evidenca dhe regjistrat e avokatëve

1. Oda e mban regjistrin e avokatëve, praktikantëve, zyrave të përbashkëta, të shoqërive të avokatëve dhe të avokatëve të huaj.
2. Evidencat, regjistrat dhe vërtetimet nga paragrafi 1. i këtij neni paraqesin dokumente publike.

Neni 46
Pagesa e anëtarësisë

Avokatët e regjistruar në regjistrin e avokatëve janë të detyruar të paguajnë anëtarësinë vjetore dhe të përmbushin të gjitha detyrimet tjera të parapara me Statut dhe aktet e përgjithshme të Odës.

Neni 47
Format e financimit të Odës

1. Oda e Avokateve të Kosovës financohet nga të hyrat:
   1.1. për licencim;
   1.2. për anëtarësi;
   1.3. nga pulla e Odës;
   1.4. nga dhuratat dhe grantet, si dhe
   1.5. të hyrat tjera në pajtim me ligjin dhe statutin.

KREU X
SPECIALIZIMI I AVOKATIT DHE SHOQËRIVE TË AVOKATËVE

Neni 48
Specializimi i avokatëve

1. Avokati mund të kërkojë t'i pranohet specializimin në ndonjë lëmi të së drejtës.
2. Për kërkesën për pranimin e specializimit vendos organi i Odës, i përcaktuar me Statut.
3. Kundër vendimit, me të cilin refuzohet kërkesa për pranimin e specializimit mund të ushtrohet ankesë.
4. Specializimi i pranuar i avokatit regjistrohet në regjistrin e avokatëve dhe mund të ceket në emërtimin e zyrës së avokatit.

Neni 49
Shoqëritë e specializuara të avokatëve

1. Shoqëritë e avokatëve, me rastin e regjistrimit mund të përcaktohen për ndihmë juridike në ndonjë lëmi të caktuar. Në atë rast, specializimi i shoqërisë së avokatëve detyrimisht ceket në emërtimin e saj.
2. Specializimi do t'i pranohet shoqërisë së avokatëve nëse vetëm njërit prej anëtarëve të saj i është pranuar specializimin sipas dispozitave të nenit paraprak.
3. Kushtet, procedura dhe lëmenjtë, në të cilët mund t'i pranohet specializimi avokatit dhe shoqërisë së avokatëve përcaktohet me aktet e Odës.

KREU XI
PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE E AVOKATËVE, PRAKTIKANTËVE

Neni 50
Shkeljet disiplinore

1. Avokatët dhe praktikantët përgjigjen për shkelje të lehta dhe të rënda të detyrës dhe prestigjit të avokatisë para organeve disiplinore të Odës, të përcaktuara me Statut.
2. Shkelje e rëndë konsiderohet posaçërisht prishja e prestigjit të avokatisë si funksion i mëvetësishëm dhe i pavarur.
3. Shkelje e rëndë konsiderohet edhe çdo shkelje e detyrës zyrtare, prestigjit dhe

Kodit të etikës së avokatëve, e cila ka peshë më të rëndë për shkak të rëndësisë së të mirave të rrezikuara, natyrën e detyrës zyrtare të shkelur, lartësia e dëmit material ose pasojat tjera dhe duke marrë parasysh rrethanat, në të cilat është kryer apo nuk është kryer veprimi.

4. Shkelje të lehtë paraqet shkelja e detyrës zyrtare, prestigjit dhe Kodit të etikës së avokatëve me peshë më të vogël.
5. Me Statutin e Odës përcaktohet se çka konsiderohet shkelje e rëndë e avokatisë, prestigjit dhe Kodit të etikës së avokatëve.

Neni 51
Masat disiplinore

1. Për shkelje të rëndë të detyrave dhe prestigjit të avokatisë, mund të shqiptohen këto masa:
   1.1. vërejtje;
   1.2. gjoba;
   1.3. humbja e të drejtës së ushtrimit të avokatisë prej gjashtë (6) muajsh gjer në pesë (5) vjet;
   1.4. humbja e të drejtës së ushtrimit të avokatisë prej pesë (5) gjer në dhjetë (10) vjet;
   1.5. humbja e përhershme e të drejtës së ushtrimit të avokatisë.
2. Për shkelje më të rënda të detyrës dhe prestigjit të avokatisë, praktikantit mund t'i shqiptohen këto masa:
   2.1. gjoba;
   2.2. çregjistrimi nga regjistri i praktikantëve prej gjashtë (6) muajsh;
   2.3. çregjistrimi i përhershëm nga regjistri.
3. Për shkelje të lehta të detyrës dhe prestigjit të avokatisë, avokatit mund t'i shqiptohet vërejtja, gjoba, kurse praktikantit vërejtja.
4. Lartësia dhe destinimi i gjobave sipas këtij neni, përcaktohet me Statutin e Odës. Gjobat e shqiptuara paguhen në favor të Odës së avokatëve.

Neni 52
Inicimi i procedurës disiplinore

1. Procedura disiplinore iniciohet nga organi disiplinor, i përcaktuar me Statut, sipas detyrës zyrtare ose me kërkesën e organit të përcaktuar me Statut.
2. Për kërkesën lidhur me inicimin e procedurës disiplinore kundër avokatëve nga shtetet tjera, që janë të regjistruar në regjistrin e avokatëve të huaj në pajtim me nenin 40 të këtij ligji, organi disiplinor do ta informojë organin gjegjës në shtetin amë të atij avokati.
3. Komisioni disiplinor hetimor është i detyruar t'i mundësoj përfaqësuesit të organit kompetent të shtetit amë të avokatit të huaj të merr pjesë në procedurë duke iu mundësuar të jep propozime për ndihmë të avokatit.
4. Dënimi disiplinor dhe masa disiplinore, me të cilën i kufizohet avokatit ushtrimi i avokatisë mund të zbatohet vetëm në territorin e Republikës së Kosovës.
5. Nëse organi kompetent i shtetit amë i avokatit ia ndalon përkohësisht apo

përgjithmonë ushtrimin e avokatisë, efekti i një vendimi të tillë të ndalesës së ushtrimit të avokatisë vlen edhe për territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 53
Zbatimi i përshtatshëm i ligjit

Në procedurën disiplinore kundër avokatit apo praktikantit në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat e legjislacionit penal dhe procedurës penale, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me Statut apo me ndonjë akt tjetër të përgjithshëm të Odës të aprovuar në pajtim me këtë ligj dhe me statutin.

Neni 54
Ekzekutimi i gjobave

Vendimet e plotfuqishme të organeve disiplinore të Odës me të cilat janë shqiptuar gjobat paraqesin dokumente ekzekutive dhe Oda është e autorizuar të kërkojë përmbarimin e tyre me dhunë në pajtim me dispozitat e Ligjit të Procedurës përmbarimore.

Neni 55
Apelimi në gjykatën kompetente

Kundër vendimit të shkallës së dytë përkatësisht përfundimtar, me të cilin është shqiptuar masa disiplinore – humbja e të drejtës për ushtrimin e avokatisë prej gjashtë (6) muajsh deri në pesë (5) vjet, humbjes së të drejtës së ushtrimit të avokatisë prej pesë (5) vjet gjer në dhjetë (10) vjet apo të humbjes së përhershme të së drejtës për ushtrim të avokatisë apo shlyerje nga regjistri i praktikantëve prej gjashtë (6) muajsh gjer në tre (3) vjet, si dhe shlyerja e përhershme nga regjistri i praktikantëve, mund të hapet konflikti administrativ në gjykatën kompetente.

Neni 56
Parashkrimi

1. Fillimi i procedurës disiplinore për shkelje të lehta parashkruhet gjashtë (6) muaj pas njoftimit për shkeljen e bërë dhe kryesin, kurse në çdo rast parashkruhet pas kalimit të afatit kohor prej një (1) viti prej ditës së kryerjes së shkeljes.
2. Fillimi i procedurës disiplinore për shkelje të rënda, parashkruhet një (1) vit pas njoftimit për shkeljen e bërë dhe për kryesin, kurse gjithsesi parashkruhet pas kalimit të afatit kohor prej dy (2) vjetësh prej ditës së kryerjes së shkeljes.
3. Ekzekutimi i masave disiplinore, të shqiptuara për shkelje të lehta, parashkruhet pas kalimit të afatit kohor prej gjashtë (6) muajve prej ditës së plotfuqishmërisë së vendimit.
4. Ekzekutimi i masave disiplinore, të shqiptuara për shkelje të rënda parashkruhet pas kalimit të afatit kohor prej një (1) viti prej ditës së plotfuqishmërisë së vendimit.
5. Nëse ndaj avokatit të paraqitur ka filluar procedura për përcaktimin e përgjegjësisë penale për të njëjtën vepër për të cilën ka filluar procedura disiplinore, afati i parashkrimit ndërpritet deri në përfundimin definitiv të procedurës penale para gjykatave të rregullta.

6. Pas përfundimit të procedurës penale, afati i parashkrimit për procedurën disiplinore, vazhdon të rrjedhë.

KREU XII
DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 57

1. Për ndihmën e dhënë juridike në kundërshtim me dispozitat e këtij Ligji neni 10 paragrafi 2., personi juridik do të dënohet për kundërvajtje me gjobë në lartësi prej katërmijë (4,000) Euro gjer në dyzetmijë (40,000) Euro.
2. Për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni do të dënohet personi përgjegjës në personin juridik me gjobë në lartësi prej pesëqind (500) Euro gjer në pesëmijë (5,000) Euro.
3. Për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni të përsëritur për herë të dytë, përveç dënimit me të holla, personit juridik do t'i shqiptohet masa e marrjes së lejes për ushtrimin e avokatisë në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, kurse për kundërvajtjen e përsëritur për herë të tretë, pos dënimit me të holla, do të shqiptohet masa e marrjes së përhershme të lejes për ushtrimit të avokatisë.

Neni 58

Për ndihmën e dhënë juridike të dhënë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, do të dënohet personi fizik me gjobë në lartësi prej njëmijë (1,000) Euro gjer në pesëmijë (5,000) Euro.

KREU XIII
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 59
Afati për harmonizimin e akteve të Odës

1. Oda është e detyruar të bëjë harmonizimin e akteve të përgjithshme me dispozitat e këtij Ligji në afat prej një (1) viti nga dita e hyrjes së këtij ligji në fuqi.
2. Deri në nxjerrjen e Statutit dhe të akteve tjera të përgjithshme të Odës së Avokatëve të Kosovës do të zbatohen Statuti dhe aktet e tjera të përgjithshme ekzistuese të cilat nuk janë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 60
Sigurimi për përgjegjësinë profesionale

Dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me sigurimin për përgjegjësinë profesionale zbatohen duke filluar prej 1 janarit 2014.

Neni 61
Procedurat në zhvillim e sipër

Procedurat në zhvillim e sipër në organet e Odës në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdohen sipas dispozitave që kanë qenë në fuqi në atë kohë.

Neni 62
Shfuqizimi i dispozitave

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Avokatinë nr. 03/L-117 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 49, datë 23.09.2009).

Neni 63
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji nr. 04/L-193
2 maj 2013

Shpallur me dekretin Nr. DL-025-2013, datë 21.05.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 20 / 31 MAJ 2013, PRISHTINË

LIGJI Nr. 02/L-25
PËR THEMELIMIN E INSTITUTIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

Kuvendi i Kosovës

Në mbështetje të Kreut 5.3 pika (d), (dh), 9.1.26. pika (a) dhe 11.2 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/09 datë 15 maj 2001),

Miraton:

LIGJIN PËR THEMELIMIN E INSTITUTIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

1.1. Themelohet Instituti Gjyqësor i Kosovës (në tekstin e mëtejmë IGJK), si organ i pavarur profesional i cili gëzon statusin e personit juridik.
1.2. Selia e Institutit Gjyqësor të Kosovës është në Prishtinë.
1.3. IGJK mund të lidhë marrëveshje pune, bashkëpunimi dhe veprimtarie shkencore, profesionale me institucionet tjera vendore dhe ndërkombëtare.
1.4. Organet e IGJK-së janë: Këshilli drejtues dhe drejtori i IGJK-së.
1.5. Bordi menaxhues e emëron drejtorin i IGJK-së më bashkërendim me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm pas shpalljes së konkursit.
1.6. Në rastet e arsyetuara, Bordi menaxhues e shkarkon drejtorin e IGJK-së në bashkërendim me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm.
1.7. IGJK-ja si institucion kryesor për aftësim brenda sistemit gjyqësor të Kosovës duhet të kryej funksionet e veta bazuar në parimet e ligjshmërisë, paanshmërisë dhe efikasitetit.
1.8. IGJK-ja është organ i pavarur i cili vepron në bashkëpunim me KGJPK-në ose Institucionet t cilat trashëgojnë p rgjegj sit e tij për koordinimin e nevojave për aftësimin profesional të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të Kosovës, për aftësimin e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë, si dhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me sistemin gjyqësor të Kosovës.
1.9. Strategjinë dhe programin e punës, IGJK-ja e harton në harmoni me parametrat e përgjithshme të përcaktuara nga Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës (në tekstin e mëtejmë KGJPK-ja) ose nga Institucionet t cilat trashëgojnë p rgjegj sit e tij, të cilët janë përgjegjës për çështjet gjyqësore dhe prokuroriale në Kosovë.

DISPOZITAT THEMELORE
Funksionet e IGJK-së

Neni 2

2.1. IGJK-ja është institucioni kryesor përgjegjës për:
   a) Aftësimin e bartësve dhe bartësve potencial të funksionit në gjyqësi (gjyqtarëve dhe prokurorëve);
   b) Vlerësimin dhe organizimin e provimit përgatitor për gjyqtarë dhe prokurorë;
   c) Kurset e posaçme të aftësimit për avancim të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
   d) Kurse për aftësimin bazë të gjyqtarëve porotë; dhe
   e) Kurse për aftësimin e profesionistëve të tjerë në lëmin gjyqësisë të identifikuara nga IGJK-ja.

2.2. Gjatë punës së vet IGJK-ja:
   a) Zhvillon plane aftësimi afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për një gjyqësi efikase, efektive dhe të paanshme;
   b) Kryen edhe veprimtari të tjera profesionale si institucion profesional-kërkimor për zhvillimin e gjyqësisë në Kosovë në pajtim me standardet evropiane.

Këshilli drejtues i IGJK-së

Neni 3

3.1. Këshilli drejtues përbëhet prej 13 (trembëdhjetë) anëtarëve.

3.2. Anëtarë mandator të Këshillit janë Kryetari i Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës ose Institucionet t cilat trashëgojnë p rgjegj sit e tij dhe Drejtori i Departamentit të Administratës Gjyqësore.

3.3. 9 (Nëntë) anëtarë emërohen nga Kuvendi i Kosovës, në bashkërendim me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm, me propozim të institucioneve vijuese:
   a) 1 (një) anëtar nga Qeveria e Kosovës;
   b) 2 (dy) anëtarë nga Gjykata Supreme e Kosovës;
   c) 1 (një) anëtar nga Prokuroria Publike e Kosovës;
   d) 1 (një) anëtar nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës;
   e) 1 (një) anëtarë nga Shoqata e Gjyqtarëve të Kosovës;
   f) 1 (një) anëtarë nga Shoqate e Prokurorëve të Kosovës;
   g) 1 (një) anëtarë nga Oda e Avokatëve të Kosovës;
   h) 1 (një) anëtar nga Shoqata e Juristeve të Kosovës.

3.4. Dy anëtarë me mandat dyvjeçarë emërohen nga institucionet vijuese:
   a) 1 (një) anëtar nga UNMIK-u
   b) 1 (një) anëtar nga OSBE-ja

3.5. Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit Drejtues së paku 2 (dy) anëtarë duhet të jenë nga radhët e minoriteteve.

3.6. Këshilli Drejtues është përgjegjës për:

a) Miratimin e Statutit të IGJK-së;
b) Miratimin e projektbuxhetit të IGJK-së dhe programin e trajnimeve;
c) Përcaktimin e strukturës dhe funksioneve të IGJK-së sipas këtij ligji.
d) Metodologjinë e aftësimit të bartësve dhe bartësve potencial të funksionit gjyqësor në Kosovë;
e) Dhënien e këshillave lidhur me financimin dhe kontraktimin me donatorët për përkrahjen e programeve të IGJK-së.

3.7. Anëtarët e Këshillit Drejtues zgjedhën me mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhje, por jo më shume se 2 (dy) mandate.
3.8. Këshilli Drejtues takohet sa herë që IGJK-ja e konsideron të nevojshme por jo më pak se një herë në tre muaj.
3.9. Mbledhjet e Këshilli Drejtues konvokohen në bazë të njoftimit të kryetarit të Këshillit Drejtues të IGJK-së.
3.10. Njoftimi duhet të dërgohet jo më vonë se 5 ditë pune para mbledhjes.
3.11. Mbledhjet e Këshillit Drejtues i kryeson Kryetari i Këshillit i cili zgjidhet nga anëtarët e Këshillit.
3.12. Drejtori i IGJK-së është i pranishëm në mbledhjet e Këshillit drejtues dhe ka të drejtë të bëjë propozime por pa të drejtë vote.

Përgjegjësitë e drejtorit të IGJK-së

Neni 4

4.1. Drejtori për punën e tij i përgjigjet Këshillit drejtues.
4.2. Drejtori i IGJK-së është përgjegjës për:
a) administrimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të IGJK-së dhe për garantimin e zbatimit të funksioneve që i janë besuar atij,
b) sigurimin e udhëzimeve të përshtatshme, të sakta e të paanshme dhe të këshillave profesionale të cilat do të jenë në funksion të IGJK-së,
c) menaxhimin me personelin dhe organizimin e IGJK-së,
d) nxjerrjen e vendimeve dhe udhëzimeve administrative për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me funksionet e tij,
e) menaxhimin efikas dhe të suksesshëm të burimeve financiare dhe donacioneve që i ndahen IGJK-së,
f) zbatimin e politikës jodiskriminuese të personelit brenda IGJK-së, përfshirë edhe përfaqësimin e paanshëm gjinor dhe etnik në Kosovë.

4.3. Koordinatori i programit emërohet nga komisioni i themeluar nga Bordi menaxhues pas shpalljes publike të konkursit, në pajtim me rregullat dhe procedurat e zbatueshme për shërbimin civil.

Kushtet për emërimin e drejtorit të IGJK-së

Neni 5

5.1. Drejtor i IGJK-së mund të emërohet personi i cili:
a) Është person i cili është regjistruar ose ka të drejtë të regjistrohet si banor i

përhershëm i Kosovës në Zyrën Qendrore të Regjistrimit Civil, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/13 të datës 17 mars 2000 mbi Zyrën Qendrore të Regjistrimit Civil.

b) është jurist i diplomuar me përvojë profesionale mbi 5 vite në gjyqësi;
c) e ka kryer provimin e jurisprudencës;
d) preferohet të ketë titull shkencor; dhe
e) njohja gjuhëve zyrtare në Kosovë konsiderohet përparësi.

5.2. Për emërimin e drejtorit, Këshilli drejtues e informon Kryeministrin dhe Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

Financimi i IGJK-së

Neni 6

6.1. IGJK-ja financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.
6.2. Sipas rastit, të hyrat e IGJK-së, mund të plotësohen nga donatorët dhe nga projektet hulumtuese të IGJK-së dhe entiteteve tjera vendore apo ndërkombëtare.
6.3. Të gjitha kontributet e dhuruara nga donatorët regjistrohen si mjete buxhetore të dedikuara për IGJK-në.

Provimi përgatitor dhe kursi i trajnimeve për kandidatët që pretendojnë të emërohen gjykatës apo prokuror

Neni 7

7.1. IGJK-ja u ofron kandidatëve të përzgjedhur për gjykatës dhe prokuror aftësim të mëtutjeshëm.
7.2. Kandidatët për postin e gjyqtarit apo prokurorit zgjedhën në bazë të konkurrimit publik dhe të hapur përmes të cilit ata i nënshtrohen provimit përgatitor për gjyqtarë dhe prokurorë. Personi mund të zgjedhet si kandidat për postin e gjyqtarit apo prokurorit vetëm nëse e kalon provimin përgatitor për gjyqtar dhe prokuror. Përvoja e punës dhe rezultati i provimit të jurisprudencës gjithashtu mund të merren parasysh në zgjedhjen e kandidatëve për postin e gjyqtarit apo prokurorit.
7.3. Vlerësimin e suksesit të arritur në provimin përgatitor dhe kursin aftësues e bën IGJK-ja në bazë të kritereve dhe rregullave të përcaktuara nga KGJPK-ja apo Institucionet t cilat trashëgojnë p rgjegj sit e tij.
7.4. Kandidatët që punojnë në gjykata apo prokurori në cilësinë e bashkëpunëtorit profesional, kurset mund ti ndjekin pa shkëputje nga marrëdhënia e punës.
7.5. Kandidatët e zgjedhur marrin një honorarë që paguhet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Kursi i aftësimit praktik për kandidatët që synojnë të emërohen gjyqtar apo prokuror

Neni 8

8.1. IGJK, në bashkëpunim me KGJPK-në apo Institucionet t cilat trashëgojnë p rgjegj sit e tij, do të jetë përgjegjës për:
   a) identifikimin e gjykatave dhe prokurorive publike të cilat mund t'i mbështesin trajnimet për kandidatët që synojnë të bëhen gjyqtarë apo prokurorë;
   b) caktimin e gjyqtarit-prokurorit i cili do ta mbikëqyrë kandidatin gjatë aftësimit.

8.2. Puna e kandidatit gjatë kursit të aftësimit do të vlerësohet nga gjyqtari apo prokurori mbikëqyrës në bazë të kritereve dhe rregullave të parapara nga KGJPK-ja apo Institucionet t cilat trashëgojnë p rgjegj sit e tij.

8.3. E drejta për honorar (mëditje), e paraparë në nenin 7.5 të këtij Ligji vlen edhe në këtë rast.

Kursi elementar i aftësimit për gjyqtarët porotë dhe profesionistët tjerë të emëruar

Neni 9

9.1. Me propozim të KGJPK-së, apo Institucionet t cilat trashëgojnë p rgjegj sit e tij, IGJK-ja do të organizojë kursin elementar të aftësimit për gjyqtar porotë.

9.2. Pas identifikimit të nevojave nga Këshilli drejtues, IGJK-ja do të organizojë kurse për trajnimin e profesionistëve të tjerë në fushën e drejtësisë.

Kurset e veçanta aftësuese për avancim në punë

Neni 10

10.1. IGJK-ja në konsultim me KGJPK-në apo Institucionet t cilat trashëgojnë p rgjegj sit e tij, do të organizojë kurse të veçanta aftësimi për gjyqtarë dhe prokurorë që janë apo do të avancohen brenda sistemit gjyqësor.

10.2. Gjyqtarët dhe prokurorët e posa emëruar kanë të drejtë dhe janë të obliguar të marrin pjesë në kurset e veçanta për aftësim dhe avancim, pa shkëputje nga marrëdhënia e punës, në pajtim më dispozitat në fuqi për shërbimin civil të Kosovës.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Hyrja në fuqi

Neni 11

11.1. Çështjet që kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin të IGJK-së e të cilat nuk janë rregulluar me këtë ligj mundë të rregullohen me statutin e IGJK-së dhe me akte tjera nënligjore.

11.2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushojnë të vlejnë dispozitat e ligjeve tjera që janë në kundërshtim me të.
11.3. Përgjegjësitë e përcaktuara më këtë ligj për KGJPK-në dhe DAGJ-in barten tek institucionet trashëguese të tyre ose institucionet që do t'i ushtrojnë kompetencat e tanishme të tyre.
11.4. Ky Ligj hyn në fuqi, pas miratimit në Kuvendin e Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

24.04 2006
UNMIK/REG/2006/23

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III / Nr. 23 / 01 PRILL 2008

LIGJI Nr. 04/L-017
PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 993
Kreu II: Dispozitat themelore 994
Kreu III: Shfrytëzuesit e ndihmës juridike falas 995
Kreu IV: Këshilli për ndihmë juridike falas 996
Kreu V: Themelimi, përbërja dhe organizimi i agjencisë 999
Kreu VI: Ofruesit e ndihmës juridike falas 1001
Kreu VII: Procedura për realizimin e ndihmës juridike falas 1002
Kreu VIII: Financimi dhe mbikëqyrja 1004

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të krijoj një sistem funksional për ndihmë juridike falas në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse, me anë të të cilit sigurohet qasje efektive në drejtësi për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare.

Neni 2
Fushëveprimi

Me këtë ligj përcaktohen, llojet, shtrirja, shfrytëzuesit dhe ofruesit e ndihmës juridike falas, themelimi i Këshillit dhe Agjencisë për ndihmë juridike falas, kompetencat, procedura dhe kushtet për realizimin e ndihmës juridike falas, dhe financimi i ndihmës juridike falas.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **Ndihmë juridike falas** - e drejtë në shërbime profesionale juridike falas për qytetarët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara me këtë ligj;
   1.2. **Kërkuesi** - personi i cili kërkon ndihmë juridike falas;
   1.3. **Përfituesi -** personi i cili e realizon të drejtën në ndihmë juridike falas në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë ligj;
   1.4. **Ofrues** - çdo person fizik apo juridik i cili në përputhje me këtë ligj ofron ndihmën juridike falas, si i punësuar apo i kontraktuar nga Agjencia ose në partneritet me të;
   1.5. **Avokat** - anëtar i Odës së Avokatëve të Republikës së Kosovës.
   1.6. **Lista e avokatëve** - nënkupton listën e avokatëve të përgatitur nga Oda e Avokatëve të Kosovës;
   1.7. **Të ardhura të përgjithshme familjare** - të ardhurat e kërkuesit dhe të gjithë anëtarëve të familjes së tij, duke përfshirë të ardhurat e realizuara nga puna dhe angazhimet tjera profitabile, shitja e pasurisë, trashëgimia, dhuratat dhe të gjitha të ardhurat apo përfitimet tjera të fituara në Kosovë ose jashtë saj, por duke përjashtuar pasurinë e cila sipas Ligjit mbi Procedurën Përmbarimore është e liruar nga përmbarimi i detyrueshëm apo tjetërsimi;
   1.8. **OJQ në partneritet** - organizatë jo-qeveritare që hynë në partneritet me Agjencinë.

KREU II
DISPOZITAT THEMELORE

Neni 4
Shtrirja dhe llojet e ndihmës juridike falas

1. Ndihma juridike falas ofrohet në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.
2. Ndihma juridike falas ofrohet në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse.
3. Ndihma juridike falas jepet për këto lloje:
   3.1. informatat dhe këshillat juridike lidhur me procedurat ligjore;
   3.2. përpilimin e shkresave dhe tërë asistencën tjetër teknike, që ka të bëjë me kompletimin e lëndës; dhe
   3.3. përfaqësimin në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse.

Neni 5
Shërbimet e autorizuara

1. Shërbimet e autorizuara të ndihmës juridike falas ofrohen në kuadër të ndihmës juridike primare dhe sekondare.
2. Ndihma juridike primare përfshin shërbimet vijuese:
   2.1. informatat dhe këshillat juridike lidhur me procedurat ligjore;

2.2. përpilimin e shkresave dhe tërë ndihmën tjetër teknike që ka të bëjë me kompletimin e lëndës;
2.3. përfaqësimin në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse;
2.4. mbrojtjen dhe përfaqësimin në të gjitha fazat e procedurës penale;
2.5. informatat dhe këshillat juridike lidhur me procedurat kundërvajtëse;
2.6. informatat, këshillat juridike dhe ndihma në procedurat e ndërmjetësimit, arbitrazhit ashtu siç është paraparë me ligjet në fuqi.

3. Ndihma juridike sekondare mbulon shërbimet të cilat janë paraparë në nën-paragrafin 2.2. dhe 2.3. të paragrafit 2. të këtij neni.

KREU III
SHFRYTËZUESIT E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Neni 6
Kriteret për dhënien e ndihmës juridike falas

1. Ndihma juridike falas i ofrohet të gjithë personave të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara si në vijim:
1.1. kriteri kualifikues;
1.2. kriteri financiar; dhe
1.3. kriteri juridik.

Neni 7
Kriteri kualifikues

1. Sipas kriterit kualifikues, në ofrimin e ndihmës juridike falas kanë të drejtë:
1.1. shtetasit e Republikës së Kosovës, të cilët janë me vendbanim në territorin e Republikës së Kosovës;
1.2. të gjithë personave me qëndrim të përkohshëm në Republikën e Kosovës;
1.3. personat e tjerë të përcaktuar me ligj, apo me rregullat e të drejtës ndërkombëtare, të cilat e obligojnë Republikën e Kosovës;
1.4. personat të cilëve ju ofrohet ndihma juridike falas në bazë të reciprocitetit.

Neni 8
Kriteri financiar

1. Sipas kriterit financiar, ofrohet ndihma juridike:
1.1. primare; dhe
1.2. sekondare.
2. Ndihma juridike primare u ofrohet të gjithë personave të cilët përfitojnë të drejtën nga ndihma sociale, ose janë në situatë të ngjashme me personat që përfitojnë të drejtën nga ndihma sociale.
3. Ndihma juridike sekondare u ofrohet të gjithë personave, të ardhurat e përgjithshme familjare të të cilëve janë më të vogla se sa të ardhurat mesatare familjare.

Neni 9
Kriteri juridik

1. Sipas kriterit juridik, ofrohet ndihma juridike duke vlerësuar bazueshmërinë e rastit si:
   1.1. vlerën reale të kërkesës;
   1.2. fuqia argumentuese e provave të prezantuara nga kërkuesi; dhe
   1.3. mundësia e suksesit të kërkesës.

Neni 10
Ndihma juridike falas e menjëhershme

Përjashtimisht në rastin urgjent, ndihma juridike falas e menjëhershme ofrohet për të gjithë personat e arrestuar apo të ndaluar, në polici, pavarësisht përmbushjes së kritereve të cilat kërkohen me këtë ligj.

KREU IV
KËSHILLI PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

Neni 11
Themelimi dhe përbërja e Këshillit për ndihmë juridike falas

1. Për sigurimin e ndihmës juridike falas, formohet Këshilli për ndihmë juridike falas (në tekstin e mëtejmë Këshilli), si institucion themelor i cili kryen funksionet e tij në mënyrë të pavarur nga institucionet e tjera publike dhe pa udhëzime dhe ndërhyrje nga asnjë person, si dhe ushtron mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Agjencisë.
2. Këshilli përbëhet nga shtatë anëtarë, të cilët janë profesionistë të kualifikuar, e që kanë njohuri për sistemin e drejtësisë.
3. Anëtarët e Këshillit zgjedhën nga Kuvendi i Republikës së Kosovës nga radhët e kandidatëve të propozuar nga institucionet e mëposhtme:
   3.1. Ministria e Drejtësisë;
   3.2. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
   3.3. Ministria për Kthim dhe Komunitete;
   3.4. Ministria e Financave;
   3.5. Oda e Avokatëve të Kosovës;
   3.6. Gjykata Supreme;
   3.7. Këshilli, bënë ftesë publike për anëtarët e OJQ-ve, ku nga të gjithë kandidatët i përzgjedh tre (3) prej tyre, të cilët i propozon para Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhje.
4. Secili institucion, i paraparë në nën-paragrafin 3.1. deri 3.6. të paragrafit 3. të këtij neni, duhet të propozojnë tre (3) kandidat ku njëri prej tyre do të zgjidhet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
5. Ministria për Kthim dhe Komunitete, duhet t'i propozojë kandidatet nga radhët e Komuniteteve në Kosovë.

Neni 12
Procedura e propozimit dhe zgjedhjes

1. Inicimin e procedurës për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit nga institucionet relevante e bënë Këshilli me kërkesë, jo më vonë se gjashtë (6) muaj para skadimit të mandatit të anëtarëve aktual të Këshillit.
2. Institucionet relevante i përgjigjen Këshillit me listën e kandidatëve të propozuar në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimit të kërkesës së Këshillit.
3. Këshilli ia dërgon listën me emrat e propozuar, komisionit përkatës të Kuvendit të Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e dorëzimit të listës së të propozuarve.
4. Procedura e emërimit të anëtarëve të Këshillit zbatohet konform rregullave të brendshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
5. Nëse mandati i anëtarit të Këshillit përfundon para skadimit të afatit për të cilin është zgjedhur, procedura e propozimit dhe emërimit të anëtarit të ri zbatohet konform dispozitave të këtij ligji.
6. Gjatë procedurës së propozimit dhe zgjedhjes së kandidatëve për anëtarë të Këshillit, duhet të sigurohet përfaqësimi etnik dhe gjinor. Këshilli duhet të ketë një kryesues.

Neni 13
Kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit

1. Kompetencat e Këshillit janë:
   1.1. hartimi i politikave dhe rregullave për ofrimin e ndihmës juridike falas, që sigurojnë sistem efektiv, efikas, gjithëpërfshirës, fleksibil dhe të qëndrueshëm;
   1.2. ushtrimi i mbikëqyrjes së punës së Agjencisë dhe funksionimit gjithëpërfshirës të sistemit të ndihmës juridike falas;
   1.3. identifikimi i prioriteteve në ofrimin e ndihmës juridike falas në varësi të burimeve dhe mjeteve financiare në dispozicion.
2. Këshilli sipas nevojës themelon komisione të veçanta për ushtrimin e kompetencave të parashtruara në paragrafin 1. të këtij neni.
3. Këshilli themelon, me vendim, Komisionin për ankesa, që vendos në shkallë të dytë për ankesat e ushtruara ndaj vendimeve të nxjerra nga zyrat rajonale**.**
4. Këshilli i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës një herë në vit për punën e Agjencisë dhe publikon Raportin në faqen zyrtare të Agjencionit.

Neni 14
Kushtet për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit

1. Anëtarët e Këshillit zgjedhën personat që i plotësojnë këto kushte:
   1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
   1.2. të ketë arsimim Universitar;
   1.3. të ketë karakter, ndershmëri dhe moral të lartë;
   1.4. të ketë përvojë dhe njohuri në sistemin e drejtësisë;

1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për vepër penale të dënueshme me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës;
1.6. të mos ushtroj funksion në ndonjë parti politike, deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës apo anëtarë i Kabinetit Qeveritar.

Neni 15
Mandati i Anëtarëve të Këshillit

1. Anëtarët e Këshillit zgjedhën për mandat tre (3) vjeçar pa të drejtë rizgjedhje.
2. Kryesuesi i Këshillit zgjidhet nga përbërja e Këshillit për një mandat një vit e gjysmë pa të drejtë rizgjedhjeje.
3. Kryesuesi i Këshillit përfaqëson Këshillin, thërret dhe udhëheq mbledhjet e këshillit dhe kryen përgjegjësi të tjera të përcaktuar me këtë ligj dhe me Rregulloren e punës që e nxjerr Këshilli.
4. Kryesuesi i Këshillit do të ketë zëvendësin, i cili caktohet nga radhët e Këshillit sipas sistemit të rotacionit me mandat një (1) vjeçar.

Neni 16
Përfundimi i ushtrimit të funksionit të anëtarit të Këshillit

1. Anëtari i Këshillit përfundon ushtrimin e funksionit kur:
   1.1. jep dorëheqje;
   1.2. përfundon mandatin;
   1.3. pushon anëtarësimin apo ndërpret marrëdhënien e punës me institucionin që e ka propozuar;
   1.4. me vdekje.

Neni 17
Shkarkimi i Anëtarit të Këshillit

1. Anëtari i Këshillit shkarkohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në rast të:
   1.1. Paraqitjes së paaftësisë mendore apo fizike e cila e pengon në ushtrimin e funksionit;
   1.2. Shqiptimit të dënimit për vepër penale me aktgjykim të plotfuqishëm;
   1.3. Sjellja personale në kundërshtim me ushtrimin e funksionit.
2. Procedura e shkarkimit të Anëtarëve të Këshillit zbatohet konform rregullave të brendshme të Kuvendit të Kosovës.

Neni 18
Pagesa e Anëtarëve të Këshillit

1. Anëtarët e Këshillit mbajnë mbledhje të rregullt sipas nevojës për të cilën gëzojnë të drejtë në mëditje.
2. Për mbledhjet tjera punuese, të Këshillit, anëtarët e saj nuk gëzojnë të drejtën në mëditje.
3. Anëtarët e Këshillit marrin mëditje për çdo mbledhje të mbajtur por jo më shumë se një herë në muaj.

KREU V
THEMELIMI, PËRBËRJA DHE ORGANIZIMI I AGJENCISË

Neni 19
Themelimi dhe Statusi i Agjencisë

1. Me këtë ligj themelohet Agjencia për ndihmë juridike falas (në tekstin e mëtejmë Agjencia).
2. Agjencia është institucion i pavarur publik i cili ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në pajtim me këtë ligj.
3. Agjencia është institucion i vetëm në territorin e Republikës së Kosovës përgjegjës për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas.
4. Organet e Agjencisë janë:
   4.1. drejtori Ekzekutiv;
   4.2. zyrat rajonale për ndihmë juridike falas (në tekstin e mëtejmë Zyrat rajonale), të cilat përcaktohen me vendim të veçantë të Këshillit.
5. Selia e Agjencisë është në Prishtinë.

Neni 20
Drejtori Ekzekutiv

1. Drejtori Ekzekutiv është organ i Agjencisë.
2. Kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv janë:
   2.1. koordinimi i punës të sistemit të ndihmës juridike falas;
   2.2. përgatitja e propozimit për buxhet vjetor të Agjencisë;
   2.3. propozimi i strukturës organizative të Agjencisë për miratim nga Këshilli;
   2.4. punësimin dhe mbikëqyrjen e punonjësve të Agjencisë;
   2.5. kontraktimi i mallrave dhe shërbimeve për funksionimin e sistemit të ndihmës juridike falas;
   2.6. organizimi i trajnimit për ofruesit e ndihmës juridike falas;
   2.7. udhëheqja e fushatave të vetëdijesimit për sistemin e ndihmës juridike falas;
   2.8. përgatitja e raporteve të rregullta vjetore dhe raporteve të tjera sipas kërkesës së Këshillit;
   2.9. mbajtja e regjistrave dhe ruajtja e dokumenteve dhe të dhënave lidhur me funksionimin e Agjencisë.
3. Drejtori ekzekutiv për punën e tij i përgjigjet Këshillit.

Neni 21
Zgjedhja e Drejtorit Ekzekutiv

1. Drejtori ekzekutiv i Agjencisë zgjidhet nga Këshilli, në përputhje me dispozitat e Ligjit në fuqi mbi Shërbimin Civil.
2. Kushtet për Drejtor Ekzekutiv të Agjencisë janë:
   2.1. të jetë Shtetas i Republikës së Kosovës;
   2.2. të jetë jurist i diplomuar me përvojë profesionale të paktën pesë (5) vite në lëmin e drejtësisë;

2.3. të ketë njohuri të gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës;
2.4. të ketë karakter, ndershmëri dhe moral të lartë;
2.5. të ketë eksperiencë dhe njohuri të dalluara në fushën e sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës;
2.6. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për vepër penale;
2.7. të mos jetë anëtar i asnjë partie politike, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës apo anëtar i kabinetit Qeveritar.

Neni 22
Zyrat rajonale për ndihmë juridike falas

1. Zyrat rajonale, mbulojnë dhënien e ndihmës juridike falas në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
2. Zyrat rajonale janë të obliguara që të ofrojnë ndihmë juridike falas në komunat të cilat i mbulon ajo zyrë rajonale, përmes zyrave mobile.
3. Kompetencat e Zyrës rajonale janë:
   3.1. pranimi i kërkesave për ndihmë juridike falas;
   3.2. angazhimi i ofruesve të ndihmës juridike falas;
   3.3. ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas në pajtim me autorizimet e përcaktuara me këtë ligj;
   3.4. mbajtja e evidencës për kërkuesit, përfituesit dhe shërbimet juridike të ofruara;
   3.5. koordinimi me institucionet lokale për ofrimin e ndihmës juridike efikase;
   3.6. organizimi i fushatave për vetëdijesimin juridik.
4. Kompetencat e përcaktuara nga paragrafi 3. i këtij neni kryhen nga zyrtarët, kualifikimi i të cilëve përcaktohet me akt nënligjor.
5. Zyrat rajonale për punën e vet i përgjigjen Drejtorit Ekzekutiv.

Neni 23
Personeli i Agjencisë

1. Personelin civil të Agjencisë e përbëjnë nëpunësit civil në pajtim me Ligjin për shërbyesit civil të Republikës së Kosovës.
2. Personelin Civil të Agjencisë, e zgjedh dhe e shkarkon Drejtori i Agjencisë në pajtim me Ligjin për shërbyesit civil të Republikës së Kosovës.

Neni 24
Parimet e Punës

Puna e Këshillit dhe Agjencisë, bazohet në parimet në të cilat bazohet puna e organeve të shërbimeve shtetërore si ligjshmërisë, transparencës, publicitetit, përgjegjësisë, efikasitetit, ekonomicitetit, dhe paanshmërisë profesionale.

Neni 25
Mosdiskriminimi dhe Konfidencialiteti

1. Përfituesi i ndihmës juridike falas ka të drejtë në ndihmën juridike të garantuar sipas këtij ligji, pa marrë parasysh origjinën e tij kombëtare, përkatësisht etninë, racën, ngjyrën, gjuhën, religjionin apo përkatësinë politike, identitetin gjinor, orientimin seksual, gjendjen shëndetësore, aftësinë e kufizuar, shtetësinë apo vendbanimin.
2. Zyrtarët e ndihmës juridike dhe ofruesit e ndihmës juridike falas nuk shprehin në opinion, mendimet e tyre për çështjet që kanë të bëjnë me rastin që është duke u trajtuar apo mbetet për t'u trajtuar para organit Gjyqësor apo Administrativ. Ata po ashtu përmbahen nga bërja e komenteve publike që mund të cenonte privatësinë e njërit apo tjetrit subjekt.

KREU VI
OFRUESIT E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Neni 26

1. Ofruesit e ndihmës juridike falas janë:
   1.1. zyrat Rajonale;
   1.2. zyrat Mobile për ndihmë Juridike Falas;
   1.3. avokatët;
   1.4. organizatat jo-qeveritare në rastet kur hyjnë në partneritet me Agjencinë.

Neni 27
Zyrat Rajonale

Zyrat rajonale janë organe që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar në nenin 22 të këtij ligji.

Neni 28
Zyrat mobile për ndihmë juridike falas

1. Zyrat mobile për ndihmë juridike falas themelohen nga Këshilli me propozimin e Drejtorit Ekzekutiv.
2. Zyrat mobile për ndihmë juridike falas si formë e organizimit të shërbimeve juridike, veprojnë në Komunat në të cilat zyrat e ndihmës juridike falas nuk janë themeluar.

Neni 29
Avokatët

1. Avokatët ofrojnë shërbime juridike të autorizuara në kuadër të ndihmës juridike primare dhe sekondare.
2. Oda e Avokatëve të Kosovës përgatitë dhe dorëzon tek Agjencia listën e avokatëve të cilët shprehin gatishmërinë për ofrimin e ndihmës juridike falas.

3. Agjencia lidhë kontratë individuale me avokatët e gatshëm për ofrimin e ndihmës juridike falas.
4. Avokatët ofrojnë shërbimet e autorizuara të ndihmës juridike falas sipas tarifës mbi kompensimet e përcaktuara nga Agjencia me akt nënligjor.
5. Zyrat rajonale për rastet të cilat duhet ti përfaqësojnë pranë gjykatave dhe organeve tjera, përfituesit e ndihmës juridike falas, caktojnë avokatin nga lista e azhurnuar prej Odës së Avokatëve.
6. Procedura për angazhimin e avokatëve rregullohet me akt nënligjor.
7. Shërbimet e autorizuara të përfaqësimit dhe të mbrojtjes në procedura gjyqësore ofrohen vetëm nga avokatët.

Neni 30
Organizatat Jo-Qeveritare

OJQ-të ofrojnë shërbime juridike të autorizuara në bazë të kritereve të përcaktuara nga Këshilli, me propozim të Drejtorit të Agjencisë.

KREU VII
PROCEDURA PËR REALIZIMIN E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Neni 31
Inicimi i Procedurës

1. Procedura për realizimin e ndihmës juridike falas iniciohet me paraqitjen e kërkesës në zyrën më të afërt për ndihmë juridike falas.
2. Forma dhe përmbajtja e formularit për paraqitjen e kërkesës për ndihmë juridike falas rregullohet me akt nënligjor.
3. Paraqitësi i kërkesës ka për obligim që të ofrojë dokumentacionin e kërkuar për të provuar bazueshmërinë e kërkesës për ndihmë juridike falas.
4. Në mungesë të dokumentacionit përkatës për kategorinë e viktimave të dhunës, si bazueshmëri e kërkesës merret deklarata me shkrim e mbrojtësit të viktimave.
5. Zyrtarët e zyrës për ndihmë juridike falas obligohen që të këshillojnë paraqitësin e kërkesës për të parashtruar kërkesën e ndihmës juridike falas.
6. Formulari i kërkesës plotësohet nga zyrtarët e zyrës për ndihmë juridike falas.
7. Në rast se kërkuesi i ndihmës juridike paraqet deklarata jo të vërteta, mbi bazën e të cilave bazohet ndihma juridike falas, zyrtarët e ndihmës juridike falas kanë të drejtë që të hulumtojnë gjendjen financiare të përfituesit, duke kërkuar pranë çdo organi publik dhënien e informacioneve mbi gjendjen financiare të tij.

Neni 32
Vendimi

1. Vendimi lidhur me kërkesën për ndihmë juridike falas merret në zyrën për ndihmë juridike falas në të cilën është parashtruar kërkesa.
2. Në rastin e marrjes së vendimit për ndihmë juridike falas, zyrtarët e ndihmës juridike falas vlerësojnë kriteret e parapara me këtë ligj.

3. Zyra për ndihmë juridike falas merr vendim për lejimin ose refuzimin e kërkesës për ndihmë juridike falas.
4. Vendimi për lejimin ose refuzimin e kërkesës merret brenda pesë (5) ditëve pune nga dita e dorëzimit të dokumentacionit të kompletuar.
5. Vendimi për lejimin e ndihmës juridike falas përcakton shërbimet e autorizuara për ndihmë juridike falas të cilët ofrohen në lidhje me kërkesën e aprovuar.
6. Shërbimet e autorizuara të përfaqësimit apo të mbrojtjes para gjykatës, referohen te avokati**.**
7. Përfituesi i ndihmës juridike falas obligohet që menjëherë të njoftojë zyrën për ndihmë juridike falas për ndryshimin e rrethanave të përcaktuara me këtë ligj, të cilat kanë ndikuar në marrjen e vendimit për lejimin e ndihmës juridike falas.
8. Nëse konstatohet që përfituesi i ndihmës juridike falas në mënyrë të kundërligjshme ka përfituar ose vazhdon të përfitojë nga ndihma juridike falas, zyra për ndihmë juridike falas me vendim ndërprenë menjëherë shërbimet e autorizuara të ndihmës juridike falas dhe obligon përfituesin që të kompensojë të gjitha shpenzimet e krijuara nga ofrimi i ndihmës juridike falas, ku të gjitha këto të hyra kalojnë në Buxhetin e Kosovës.

Neni 33
Aplikimi subsidiar

Në qoftë se me këtë ligj nuk është rregulluar në tërësi procedura e vendosjes sipas kërkesës për lejimin e ndihmës juridike falas, aplikohen dispozitat e Ligjit të procedurës administrative.

Neni 34
Ankesa kundër vendimit mbi refuzimin e ndihmës juridike falas

1. Kundër vendimit me të cilën refuzohet kërkesa për lejimin e ndihmës juridike falas, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë ankese, komisionit për ankesa (më tej Komisioni).
2. Ankesa i paraqitet Komisionit në afat prej tetë (8) ditëve nga dita e pranimit të vendimit mbi refuzimin e ndihmës juridike falas.
3. Komisioni vendos në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të ankesës për ndihmë juridike falas.
4. Vendimi i Komisionit është përfundimtar.
5. Komisioni duke vendosur për ankesën merr vendim si në vijim:
   5.1. hedhë ankesën si të palejuar;
   5.2. aprovon ankesën si të bazuar, prish vendimin me të cilin është refuzuar ndihma juridike falas dhe lejon ndihmën juridike falas, dhe
   5.3. refuzon ankesën si të pabazuar.

Neni 35
Ankesa kundër ofruesit të ndihmës juridike falas

1. Përfituesi i ndihmës juridike falas ka të drejtë ankese kundër shërbimeve juridike joprofesionale dhe jo etike të ofruara nga ofruesit e ndihmës juridike falas.

2. Procedura ankimore sipas këtij neni zhvillohet pranë Komisionit për ankesa të Këshillit ashtu siç është paraparë në nenin 13 paragrafi 3. i këtij ligji.
3. Komisioni vendosë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të ankesës në zyrën e pranimit të ankesave të ndihmës juridike falas.
4. Komisioni pas shqyrtimit të ankesës vendos si vijon:
   4.1. nëse ankesa e aprovuar është drejtuar kundër avokatit, Këshilli e njofton Odën e Avokatëve të Kosovës për ndërmarrjen e masave disiplinore në përputhje me rregulloret e brendshme të Odës së Avokateve;
   4.2. nëse ankesa e aprovuar është drejtuar kundër zyrtarit të zyrës për ndihmë juridike falas, Këshilli autorizon veprimet disiplinore të përcaktuara me akt nënligjor të Agjencisë;
   4.3. nëse ankesa e aprovuar është drejtuar kundër organizatës jo-qeveritare, Këshilli autorizon masat e përcaktuara me kontratën për shërbime me organizatën përkatëse si dhe të njoftojë Ministrinë e Administratës Publike.

KREU VIII
FINANCIMI DHE MBIKËQYRJA

Neni 36
Financimi nga Buxheti i Republikës së Kosovës

1. Agjencia financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës në pajtim më Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.
2. Agjencia menaxhon në mënyrë të pavarur me buxhetin e saj dhe i nënshtrohet auditimit të brendshëm dhe të jashtëm në përputhje me ligjin në fuqi.

Neni 37
Donacionet

Agjencia mund të pranojë donacione shtesë nga donacionet vendore dhe ndërkombëtare. Fondet e pranuara nga donacionet i raportohen Kuvendit të Republikës së Kosovës në baza vjetore, në përputhje me ligjin në fuqi.

Neni 38
Dispozitat Kalimtare

1. Brenda tre (3) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, zgjedhën anëtarët e Këshillit në pajtim me këtë ligj.
2. Brenda tre (3) muajve pas zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit, Këshilli zgjedh Drejtorin ekzekutiv.
3. Inicimin e procedurës për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit e bënë Komisioni për Ndihmë Juridike Falas, jo më vonë se një (1) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.
4. Brenda tre (3) muajve pas zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit, Këshilli nxjerr Rregulloren e brendshme të punës.
5. Brenda tre (3) muajve pas zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit, Këshilli nxjerr aktet nënligjore në pajtim me këtë ligj.

6. Komisioni për ndihmë juridike falas vazhdon punën me hyrjen në fuqi të këtij ligji, në pajtim me fushëveprimin e përcaktuar me këtë ligj, si Këshill për ndihmë juridike falas deri në emërimin e anëtarëve të Këshillit.
7. Pas themelimit të Këshillit për ndihmë juridike falas dhe gjithë nëpunësit e Komisionit për ndihmë juridike falas kalojnë në Agjencion, si dhe të drejtat, detyrimet, lëndët, pajisjet, mjetet për punë dhe arkiva e cila është e nevojshme për kryerjen e përgjegjësive nga fushëveprimi i tij.

Neni 39
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Rregullorja e UNMIK-ut nr.2006/36.

Neni 40
Hyrja në fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-017
2 shkurt 2012

Shpallur me dekretin Nr. DL-005-2012, datë 14.02.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 03 / 22 SHKURT 2012, PRISHTINË

LIGJI Nr. 03/L-101
LIGJ PËR FALJEN

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 1006
Kreu II: Procedurat për faljen 1008
Kreu III: Dispozitat përfundimtare 1009

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Në pajtim me paragrafin (29) të Nenit 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR FALJEN

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i Ligjit

Ky ligj i përcakton autorizimet ligjore të Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje të faljes individuale.

Neni 2
Përkufizimet

Për qëllimet e këtij ligji:
- **"Falje"** nënkupton pushtetin e jashtëzakonshëm ekzekutiv të Presidentit për t'i falur personat e dënuar për vepër penale, duke i liruar nga dënimi i përcaktuar nga gjykata;
- **"Person i Dënuar"** nënkupton personin e dënuar me anë të një vendimi përfundimtarë nga ndonjë gjykatë e Kosovës;
- **"Kërkesë"** nënkupton kërkesën për falje sipas këtij ligji;
- **"Ministria"** nënkupton Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës;
- **"Presidenti"** nënkupton Presidentin e Republikës së Kosovës;
- **"Rehabilitim"** nënkupton rikthimin e të gjitha të drejtave civile një personi të dënuar, duke përfshirë edhe rehabilitmin ligjor sipas nenit 87 të Kodit Penal të Kosovës.

Neni 3
Parimet për Falje

1. Falja është e drejtë e presidentit që ka për qëllim përdorimin e një mjeti jo të rregullt e të rrallë për t'i shpërblyer sjelljet dhe karakteret e jashtëzakonshme ose t'i adresojë shqetësimet e jashtëzakonshme humanitare.
2. Presidenti, me falje liron të dënuarin nga të gjitha dënimet që i janë ngarkuar me anë të një vendimi gjyqësor përfundimtarë.
3. Falja e liron të dënuarin nga vuajtja e dënimit, nga masat mbrojtëse, nga gjobat dhe nga çdo dënim tjetër të përfshirë në dënimin e shqiptuar nga gjykata.
4. Falja i ofron personit të dënuar rehabilitim të menjëhershëm.
5. Falja nuk ofron të drejtën për kompenzim financiar ndaj personit të falur.
6. Falja e personit të dënuar nuk ndikon tek të drejtat apo obligimet e personave tjerë të përcaktuara me të njëjtin vendim gjyqësor që është prekur nga Falja.
7. Kërkesa për falje nuk e ndërprenë ekzekutimin e dënimit.

Neni 4
E drejta për të kërkuar Falje

1. Vetëm personi i shpallur fajtor për vepër penale dhe i dënuar me vendim përfundimtarë nga ndonjë gjykatë e Kosovës gëzon të drejtën për tu falur nga Presidenti, përveç në rastet e parapara në këtë nen.
2. Personat e dënuar jashtë Kosovës, që janë duke e vuajtur dënimin në Kosovë, kanë të drejtë të bëjnë kërkesë për falje.
3. Personi i cili me qëllim i shmanget ekzekutimit të dënimit për veprën penale nuk ka të drejtë të kërkojë falje.
4. Personi i dënuar, kërkesa e të cilit është refuzuar nga Presidenti nuk ka të drejtë të kërkojë falje për veprën e njëjtë penale, përveç nëse mund të dëshmohet se janë paraqitur rrethana të reja që nga refuzimi i kërkesës së mëparshme.
5. Personi i dënuar në bazë të Kreut XIII apo Kreut XIV të Kodit Penal të Kosovës, për veprën penale kundër Kosovës apo qytetarëve të saj apo kundër të drejtës ndërkombëtare nuk ka të drejtë të kërkojë falje.

Neni 5
Kriteret për Falje

1. Kriteret të cilat shqyrtohen gjatë marrjes së vendimit mbi Faljen caktohen nga Presidenti në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin në fuqi.
2. Rrethanat që mund të shqyrtohen gjatë dhënies së faljes përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:
   2.1. pesha e krimit;
   2.2. rreziku i recidivizmit;
   2.3. pendimi i sinqertë;
   2.4. shfaqja e sjelljeve dhe karakterit të respektueshëm.

KREU II
PROCEDURAT PËR FALJEN

Neni 6
Paraqitja e kërkesës për Falje

1. Kërkesa për falje paraqitet me shkrim nga personi i dënuar. Në emër të personit të dënuar kërkesa mund të bëhet edhe nga bashkëshorti, bashkëshortja, fëmija, vëllai, motra ose nga ndonjë person tjetër i autorizuar nga personi i dënuar.
2. Kërkesa duhet t'i drejtohet Presidentit.
3. Kërkesa duhet të përmbajë një përshkrim të shkurtër të rastit, deklarimin e fakteve, rrethanat dhe arsyet në mbështetje të kërkesës për Falje, ndonjë informacion tjetër që mund të konsiderohet si i nevojshëm nga personi që paraqet kërkesën dhe çdo lloj informacioni tjetër që mund të jetë i nevojshëm.
4. Kërkesa mund të tërhiqet në çdo kohë si nga personi i dënuar ashtu edhe nga personi që ka bërë kërkesën në emër të të dënuarit.

Neni 7
Shqyrtimi i kërkesave për Falje

1. Me rastin e marrjes së kërkesës për Falje, Presidenti mund ta udhëzoj Ministrinë që të mbledh informatat e nevojshme.
2. Ministria, në bazë të kërkesës së Presidentit i mbledh të gjitha të dhënat personale në lidhje me personin e dënuar, të mbajtura nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, si dhe e njofton gjykatën që ka marrë vendim mbi çështjen e tillë, prokurorinë dhe palën e dëmtuar.
3. Nëse kërkohet nga Presidenti, Ministria mbledh informata shtesë nga burimet e saj apo nga burime tjera.
4. Pas mbledhjes së informatave të nevojshme, Ministria ia dërgon ato Presidentit.

Neni 8
Vendimi mbi kërkesën për Falje

1. Presidenti shpall Falje me anë të Dekretit i cili publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
2. Kur Presidenti shpall Falje, njoftohet personin që ka bërë kërkesën, personi që falet dhe Ministria.
3. Kur Presidenti refuzon kërkesën për Falje, pa vonesë njoftohet personi që ka bërë kërkesën, personi i dënuar dhe Ministria.
4. Dekreti i Presidentit për Falje hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit, përveç nëse parashihet ndryshe. Ministria duhet ta zbatojë Dekretin brenda dyzetetetë (48) orësh nga marrja e lajmërimit nga Presidenti.

KREU III
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 9
Zbatueshmëria

Ky ligj zbatohet vetëm për kërkesat për Falje të paraqitura pas hyrjes së këtij ligji në fuqi.

Neni 10
Hyrja në Fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-101
12 Dhjetor 2008

Shpallur me dekretin Nr. DL-076-2008, datë 30.12.2008 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI IV / Nr. 46 / 15 JANAR 2009

LIGJI Nr. 03/L-141
PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR OSE TË KONFISKUAR

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 1010
Kreu II: Dispozitat themelore 1011
Kreu III 1013
Kreu IV 1014

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR OSE TË KONFISKUAR

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Fushëveprimi dhe qëllimi i ligjit

1. Me këtë ligj themelohet Agjencia për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar si Agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë si dhe përcaktohen detyrat e përgjegjësit e tij.

Neni 2
Përkufizimet

Në kuptimin e këtij ligji:
- **"Agjencia"** do të thotë Agjenci për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar;
- **"Konfiskimi"** do të thotë marrje e përhershme e sendit në bazë të vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente, apo organit tjetër kompetent, në pajtim me ligjin në fuqi.
- **"Ministria"** nënkupton Ministrinë e Drejtësisë;
- **"Organ kompetent"** nënkupton çdo organ apo institucion që në të bazë të ligjit në fuqi është i autorizuar të bëjë sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë;

- **"Pasuri të Sekuestruara ose të Konfiskuara"** konsiderohen sendet e luajtshme, sendet e paluajtshme, paratë dhe letrat me vlerë të cilat janë në qarkullim juridik;
- **"Sekuestrim"** do të thotë marrja e përkohshme e sendit në bazë të vendimit të gjykatës apo organit kompetent, në pajtim me ligjin në fuqi.

KREU II
DISPOZITAT THEMELORE

Neni 3
Themelimi

1. Me qëllim të administrimit profesional të pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, Ministria themelon Agjencinë për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose konfiskuar.
2. Struktura funksionale dhe organizative e Agjencisë rregullohet me akt të veçantë nënligjor të cilin e nxjerr Ministria.

Neni 4
Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Agjencia:
   1.1. ruan dhe administron pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar në bashkëpunim me prokurorinë, gjykatën, apo organet tjera kompetente, në pajtim me ligjin në fuqi, me përjashtim të pasurisë së konfiskuar për realizimin dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore;
   1.2. ndihmon në ekzekutimin e vendimeve për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë, sipas kërkesës së organeve kompetente;
   1.3. mundëson shitjen e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, sipas autorizimit të organit kompetent;
   1.4. angazhon ekspert sipas nevojës për vlerësimin e vlerës së pasurisë dhe mënyrën e ruajtjes së sendit të sekuestruar ose të konfiskuar;
   1.5. administron të dhënat lidhur me pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar në një sistem të centralizuar kompjuterik;
   1.6. raporton tek Ministri lidhur me punën e Agjencisë dy (2) herë në vit, por sipas kërkesës së Ministrit edhe më shpesh.

Neni 5
Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore lidhur me pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar

1. Agjencia bashkëpunon dhe ndihmon gjykatën, prokurorinë, apo organet tjera kompetente për ekzekutimin e vendimeve të tyre në lidhje me pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar.
2. Me kërkesë të prokurorisë apo gjykatës, Agjencia siguron mbështetje logjistike për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë.

Neni 6
Administrimi i të dhënave

1. Agjencia mbledh, administron dhe procedon të dhënat, përfshirë vendimet e organeve kompetente dhe të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë.
2. Agjencia administron dhe ruan të dhënat lidhur me pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar dhjetë vite nga data kur Agjencia ka pranuar vendimin e formës së prerë për konfiskim nga gjykata apo organi tjetër kompetent.
3. Agjencia është i obliguar për ruajtjen e privatësisë së subjekteve të përfshirë në rastin konkret sipas ligjit në fuqi.
4. Të dhënat e organit kompetent përmbajnë informata të sakta në lidhje me pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar dhe për personat ndaj të cilëve është shqiptuar masa e tillë.
5. Agjencia mund të kërkoj informata shtesë nga organet kompetente, të cilat i vlerëson si të nevojshme për përmbushjen e përgjegjësive të tij.

Neni 7
Administrimi i Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar

1. Organi kompetent, i cili zhvillon procedurën për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë informon Agjencinë brenda dhjetë (10) ditësh lidhur me vendimin e nxjerrë.
2. Vendimi i gjykatës apo organit tjetër kompetent për sekuestrim ose konfiskim të pasurisë ekzekutohet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh dhe pasuria i dorëzohet Agjencisë.
3. Agjencia lëshon dëftesë për pranimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.
4. Agjencia ndërmerr veprime të nevojshme për ruajtjen adekuate dhe sigurimin e vlerës së pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.
5. Ruajtja e vlerës mund të sigurohet me mbajtjen apo shitjen e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar nga ana e Agjencisë, në mënyrë që të zëvendësohet me një kundërvlerë monetare.
6. Në rastet e veçanta Agjencia mund të kërkoj nga gjykata apo organi tjetër kompetent që pasuria e sekuestruar t'i lihet për ruajtje apo shfrytëzim personit të cilit i është sekuestruar sendi.
7. Përvetësimi apo shfrytëzimi i pa autorizuar i pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar është i denueshëm me Kodin Penal të Kosovës.
8. Brenda dhjetë ditësh pas pranimit të pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, Agjencia informon gjykatën apo organin tjetër kompetent i cili ka nxjerrë Vendimin për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë, duke përfshirë një kopje të regjistrimit të pasurisë. Agjencia po ashtu informon gjykatën, apo organin kompetent për lokacionin, kushtet e përgjithshme, specifikat dhe vlerën e pasurisë.

Neni 8
Shitja e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar

1. Me propozim të Agjencisë prokurori apo organi tjetër kompetent kërkon nga gjykata të vendos për shitjen e një pasurie që është e zëvendësueshme dhe mund ta humbë vlerën në rast të magazinimit ose shpenzimet e magazinimit janë joproporcionale me vlerën e pasurisë së sekuestruar.
2. Gjykata njofton palët në procedurë dhe Agjencinë lidhur me vendimin për shitjen e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.
3. Pas pranimit të vendimit të gjykatës kompetente lidhur me shitjen e pasurisë, Agjencia zhvillon procedurën për shitjen e pasurisë në pajtim me ligjet në fuqi.

Neni 9
Procedura pas shitjes

1. Pas shitjes së pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar shuma e fituar e zëvendëson vlerën e pasurisë së shitur. Gjykata e cila ka marrë vendimin për shitje informohet nga Agjencia për rezultatin e shitjes.
2. Agjencia ka për obligim të administroj çdo shumë e cila fitohet nga shitja e pasurisë së konfiskuar.
3. Të hyrat e realizuara nga shitja deponohen në xhirollogarinë bankare të Agjencisë në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.
4. Kur gjykata apo organi tjetër kompetent vendos t'ia kthej pasurinë palës në procedurë, Agjencia është i detyruar që në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh të ekzekutoj vendimin.
5. Mjetet nga shitja e pasurisë së konfiskuar, pas vendimit përfundimtar të gjykatës, derdhen në Buxhetin e Kosovës.

KREU III

Neni 10
Shkëmbimi i informatave

1. Çdo person fizik apo juridik, të cilit i është sekuestruar ose konfiskuar pasuria, ka të drejtë të kërkojë dhe të informohet nga agjencia për pasurinë e tij të sekuestruar ose të konfiskuar.
2. Personat e tretë fizikë apo juridikë, të cilët kanë interes juridik mund të kërkojnë informacione të nevojshme nga Agjencia lidhur me pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar.

Neni 11

Secili zyrtar i Agjencisë është i detyruar që t'i ruaj fshehtësitë për të gjitha të dhënat të cilat konsiderohen konfidenciale. Informatat e caktuara mund të zbulohen vetëm në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare.

KREU IV

Neni 12
Dispozitat kalimtare

1. Ky ligj zbatohet edhe në rastet për të cilat procedura gjyqësore për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë është në zhvillim e sipër në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Brenda gjashtë muajve, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministria duhet të nxjerrë akte nënligjore që burojnë prej tij.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2010.

Ligji Nr. 03/L-141
10 korrik 2009

Shpallur me dekretin Nr. DL-021-2009, datë 17.07.2009 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI IV / Nr. 58 / 10 GUSHT 2009

LIGJI Nr. 03/L-187
PËR MJEKËSINË LIGJORE

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat përgjithshme 1015
Kreu II: Kryerja e ekzaminimeve mjekoligjore 1015
Kreu III: Objektiviteti, fshehtësia profesionale dhe beneficionet 1017
Kreu IV: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 1020

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR MJEKËSINË LIGJORE

KREU I
DISPOZITAT PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

1. Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i procedurës për kryerjen e ekzaminimeve mjekoligjore nën autoritetin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore.
2. Ekspertët mjekoligjor kryejnë detyrat e tyre në mënyrë objektive, të pavarur, të paanshme dhe duhet t'u përmbahen parimeve të fshehtësisë profesionale lidhur me informatat e mbledhura, analizat dhe të gjeturat tjera për të cilat mësojnë gjatë kryerjes së detyrës së tyre zyrtare dhe duhet t'u përmbahen praktikave jo diskriminuese, në pajtim me ligjin.

KREU II
KRYERJA E EKZAMINIMEVE MJEKOLIGJORE

Neni 2
Ekspertët që kryejnë ekzaminimet mjekoligjore

1. Të gjitha ekzaminimet mjeko-ligjore kryhen nga specialisti (ekspert) i certifikuar mjekoligjor.
2. Ekzaminimet mjeko ligjore mund kryhen edhe nga specializanti i mjekësisë ligjore nën mbikëqyrjen e specialistit mjekoligjor.

Neni 3
Vendi i kryerjes së ekzaminimeve mjekoligjore

1. Të gjitha ekzaminimet mjekoligjore kryhen në lokalet e Departamentit të Mjekësisë Ligjore.
2. Në raste të jashtëzakonshme gjykata mund të urdhëroj kryerjen e ekzaminimeve mjekoligjore jashtë lokaleve të Departamentit të Mjekësisë Ligjore, pasi që të sigurohen kushte të përshtatshme për një gjë të tillë.

Neni 4

1. Autopsia mjekoligjore kryhet vetëm në bazë të urdhrit të lëshuar nga gjykata kompetente.
2. Autopsia mjekoligjore kryhet por nuk kufizohet vetëm në këto raste:
   2.1. vrasje apo vrasje të dyshuar;
   2.2. vdekje e papritur e befasishme;
   2.3. dyshimi për torturë apo çfarëdo forme tjetër të keqtrajtimit;
   2.4. vetëvrasje apo vetëvrasje e dyshuar;
   2.5. dyshimet gjatë mjekimit;
   2.6. aksidentet transportuese, profesionale apo shtëpiake;
   2.7. sëmundjet nga profesioni dhe rreziqet;
   2.8. fatkeqësitë teknologjike apo mjedisore;
   2.9. vdekja gjatë kohës së arrestimit, ndalimit, paraburgimit dhe burgimit;
   2.10. vdekja lidhur me veprimtarinë policore, apo ushtarake;
   2.11. trupat e paidentifikuara apo të skeletizuara;
   2.12. vdekjen gjatë operacionit, apo njëzetekatër (24) orë pas operacionit, anestezionit, apo ndonjë ndërhyrje tjetër mjekësore;
3. Procesverbali i autopsisë mjekoligjore duhet të jetë pjesë integrale e procedurave të autopsisë mjekoligjore.
4. Procesverbali i autopsisë mjekoligjore nënshkruhet nga specialisti apo anëtarët e panelit të ekspertëve mjekoligjor të cilët e kanë kryer autopsinë.

Neni 5
Afati për kryerjen ekzaminimeve mjekoligjore dhe autopsisë

1. Të gjitha ekzaminimet mjekoligjore duhet të kryhen pa vonesë.
2. Autopsia, mjekoligjore, nuk mund të kryhet më herët se gjashtë (6) orë nga momenti i konstatimit të vdekjes nga mjeku.
3. Të gjitha raportet e autopsisë mjekoligjore duhet të përfundohen dhe nënshkruhen dhjetë (10) ditë pas pranimit të rezultateve laboratorike. Kurse raporti përfundimtar i ekspertëve të mjekësisë ligjore duhet të përpilohet brenda tri (3) ditëve të punës pas ekzaminimit klinik mjekoligjor.
4. Në raste të veçanta kufizimi i afateve i përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni mund të zgjatet me miratimin me shkrim të drejtorit të Departamentit të Mjekësisë Ligjore. Miratimi me shkrim duhet të paraqet çartë arsyet e zgjatjes së afatit kohorë.

5. Të gjitha ekzaminimet mjekoligjore konsiderohen të përfunduara kur specialisti mjekoligjor përgatit dhe nënshkruan raportin përfundimtar.

Neni 6
Shpenzimet e Autopsisë

Shpenzimet e autopsisë bien në barrë të organit apo subjektit me urdhrin apo kërkesën e të cilit është kryer autopsia.

KREU III
OBJEKTIVITETI, FSHEHTËSIA PROFESIONALE DHE BENEFICIONET

Neni 7
Fshehtësia e informatave

1. Informatat e mësuara gjatë kryerjes së ekzaminimeve mjekoligjore janë të fshehta për opinionin.
2. Zbulimi i informatave të parapara me paragrafin 1. të këtij neni mund të bëhet pas urdhrit të lëshuar nga gjykata kompetente.
3. Të gjitha të dhënat e mbledhura nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore duhet të mbështetën në ligjin për mbrojtjen e të dhënave.

Neni 8
Obligimet e organeve hetimore dhe gjyqësore për autopsinë mjekoligjore

1. Organet hetimore dhe gjyqësore duhet menjëherë ta informojnë Departamentin e Mjekësisë Ligjore për rastet për të cilat kërkohet të bëhet ekzaminimi mjekoligjor
2. Autoritet hetuese duhet t'i ofrojnë Departamentit të Mjekësisë Ligjore çfarëdo fakti, mostre biologjike, dokument origjinal apo çfarëdo materiali tjetër e cila mund ti ndihmoj ekspertizës mjekoligjore.
3. Departamenti i Mjekësisë Ligjore duhet të merr në ruajtje trupin e vdekur, rrobat, mostrat biologjike dhe çfarëdo materiali tjetër lidhur me vendin e vdekjes, që mund të ndihmoj ekspertizën mjekoligjore.

Neni 9
Zhvarrosja

Zhvarrosja e trupit apo e pjesëve trupore duhet të bëhet nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore vetëm me urdhër të gjykatës.

Neni 10
Varrimi dhe lirimi i trupit dhe gjësendeve personale

1. Pasi që autopsia të kryhet, trupi i vdekur i identifikuar, pjesët e trupit dhe mbetjet mortore u kthehen anëtarëve të familjes ne rast se nuk ekziston nevoja për ekzaminime te mëtutjeshme mjeko ligjore.
2. Departamenti i Mjekësisë Ligjore duhet të kërkoj urdhër nga gjykata me kërkesën e të cilëve është bërë autopsia, për ta bërë varrimin ne rastet në vijim:

2.1. nëse trupi i vdekur apo pjesët e trupit të vdekur nuk janë identifikuar edhe pas shterjes së të gjitha mundësive brenda gjashtë (6) muajve;
2.2. nëse nuk ka anëtar të identifikuar të familjes që ta pranojnë trupin apo pjesët e trupit:
2.3. anëtarët e identifikuar refuzojnë ta marrin trupin e vdekur të identifikuar apo pjesët e trupit;
2.4. nëse për çfarëdo arsye nuk është e mundur ti kthehet anëtarëve te familjes trupi apo pjesët e trupit për varrim.

3. Departamenti i Mjekësisë Ligjore do ti dorëzoj Policisë çfarëdo gjësendi që xhindet në trupin e kufomës duke përfshirë rrobat dhe gjësendet personale, të cilat nuk janë mbledhur me parë nga policia në vendin e ngjarjes.

Neni 11
Ekzaminimi klinik mjekoligjor

1. Departamenti kryen të gjitha ekzaminimet klinike mjekoligjore të cilat përfshijnë por nuk kufizohen në:
1.1. përcaktimin e mjetit dhe shkallën e dëmtimeve trupore;
1.2. përcaktimin e shkallës së aftësisë për punë, gjendjen shëndetësore, moshën dhe identitetin;
1.3. përcaktimin e gjendjes seksuale dhe ekzaminimet mjekoligjore të personit që është viktimë e veprës penale kundër integritetit seksual;
1.4. përcaktimin e atësisë dhe amësisë;
1.5. dyshimet për abuzim të fëmijës;
1.6. lëndimet trupore;
1.7. traumat si pasojë e përdorimit të alkoolit dhe substancave narkotike psikotrope;
1.8. abortimet jo ligjor dhe të dyshimta;
1.9. lëndimet e dyshimta jo aksidentale;
1.10. transplantimet e dyshimta jo ligjore të organeve, indeve dhe qelizave.
2. Ekzaminimet mjekoligjore klinike duhet të kryhen në viktimën dhe kryesin e dyshuar.
3. Ekzaminimi klinik mjekoligjor duhet të kruhet vetëm pasi të informohet pacienti për natyrën e ekzaminimit që duhet të kryhet dhe pas marrjes së pëlqimit me shkrim nga pacienti. Në rast të refuzimit pa arsye vlejnë dispozitat e kodit të procedurës penale.
4. Kur pacienti është nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare apo nuk është në pozitë të jap pëlqimin, pëlqimi i paraparë në paragrafin 3. të këtij neni duhet të merret nga prindi apo përfaqësuesi ligjor i pacientit.
5. Ekzaminimet mjekoligjore klinike të parapara në paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni kryhen pas kërkesës me shkrim nga organet e hetuesisë apo gjyqësisë.

Neni 12
Ndihma

1. Nëse gjatë ekzaminimit *post mortum* mjeko ligjor nevojitet ndihma e specialistëve të fushave të tjera mjekësore, Departamenti i Mjekësisë Ligjore formon komisionin përkatës.

2. Përbërja e komisionit dhe rregullat e punës përcaktohen me rregullat e brendshme të Departamentit të Mjekësisë Ligjore.

Neni 13
Procedurat operative mjeko ligjore

1. Të gjitha ekzaminimet mjekoligjore kryhen në pajtim me ligjin dhe rregullat e brendshme të nxjerra nga Departamenti i Mjekësisë ligjore.
2. Të gjitha aktivitetet ndërlidhur me mjekësin ligjore përfshirë toksikologjinë mjekoligjore, histopatologjin, antropatologjinë, psikiatrinë, biologjinë dhe të gjitha fushat tjera rregullohen me rregullat e brendshme të Departamentit të Mjekësisë Ligjore.
3. Procedurat e ekzaminimeve mjekoligjore të përcaktuara në rregullat e brendshme të Departamentit të Mjekësisë Ligjore përfshijnë por nuk kufizohen në:
   3.1. praninë e ekspertit mjekoligjor në vendin e vdekjes apo të gjetjes së kufomës;
   3.2. mënyrën e ruajtjes së mbetjeve mortore dhe dëshmive të mbledhura në vendin e ngjarjes ku ka ndodhur vdekja;
   3.3. trajtimin apo riatdhesimin e mbetjeve mortore;
   3.4. autopsitë mjekoligjore;
   3.5. vlerësimin e vendndodhjeve, gërmimin dhe zhvarrosjen;
   3.6. mbledhjen, ruajtjen, analizimin dhe dhënien e indeve njerëzore për qëllime histopatologjike;
   3.7. analiza toksikologjike mjekoligjore;
   3.8. dokumentimin dhe certifikimin e ekzaminimeve;
   3.9. raportimet mjekoligjore;
   3.10. ruajtjen dhe analizimin e mbetjeve skeletore njerëzore;
   3.11. përbërjen e panelit të ekspertëve të mjekësisë ligjore;
   3.12. ekzaminimet klinike mjekoligjore të cilat kërkojnë shërbimet e infermiereve mjekoligjore;
   3.13. mbledhjen e lëngjeve trupore të pacientëve të gjallë;
   3.14. identifikimin;
   3.15. riatdhesimin, ruajtjen dhe analizimin e indeve njerëzore dhe mostrave në gjendje të lëngët;
   3.16. ekzaminimet dentale;
   3.17. procedimin, regjistrimin dhe ruajtjen e rezultateve personale;
   3.18. dërgimin e mostrave në laboratorët e forenzikës;
   3.19. identifikimin, procedimin dhe trajtimin e ngjarjeve fatale;
   3.20. menaxhimin e fatkeqësive (katastrofave) madhore dhe ndihmën ndaj shoqërisë civile;
   3.21. hulumtimet shkencore, arsimimin dhe trajnimin mjekoligjor;
   3.22. arsimimin dhe trajnimin në fushën e arkeologjisë dhe antropologjisë ligjore.

Neni 14
Orari i punës

1. Për shkak të kushteve specifike dhe rrezikshmërisë së lartë për shëndetin, personeli i Departamentit të Mjekësisë Ligjore nuk mund të kalojë më shumë se gjashtë (6) orë në procesin e autopsisë ose ekzaminimet e tjera.
2. Çështja e pagesës për personelin në gatishmëri e paraparë në paragrafin 1. të këtij neni rregullohet më akt të veçantë nënligjor, të cilin e nxjerr Qeveria.
3. Personelit të Departamentit të Mjekësisë Ligjore nga paragrafi 1. i këtij neni i paguhet një shtesë e të ardhurave personale.
4. Kategorizimi i nivelit të të ardhurave shtesë të parapara në paragrafin 2. të këtij neni rregullohet me akt të veçantë nënligjor të cilin e nxjerr Qeveria.

Neni 15
Puna jashtë orarit dhe pjesëmarrja në seanca gjyqësore

1. Puna e ekspertëve të mjekësisë ligjore jashtë orarit të tyre të punës kompensohet për secilin rast veç e veç, nga gjykata e cila ka kërkuar ekspertimin mjeko-ligjor, në pajtim me aktin e veçantë nënligjor të cilin e nxjerr Qeveria.
2. Për secilin rast të pjesëmarrjes në seancë gjyqësore, eksperti i mjekësisë ligjore do të kompensohet, në pajtim me aktin nënligjor të nxjerrë nga Qeveria.

Neni 16
Përgjegjësitë

Për shkeljen e këtij ligji ekspertët e mjekësisë ligjore i nënshtrohen masave disiplinore dhe sanksioneve penale sipas legjislacionit në fuqi.

KREU IV
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 17
Nxjerrja e akteve nënligjore

Aktet nënligjore për zbatim të këtij ligji do të nxirren brenda gjashtë (6) muajve prej ditës hyrjes në fuqi të
këtij ligji.

Neni 18
Shfuqizimi

Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohen të gjitha dispozitat juridike me të cilat është rregulluar çështja e mjekësisë ligjore.

Neni 19
Hyrja në Fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-187
25 shkurt 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-019-2010, datë 13.05.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 70 / 31 MAJ 2010

LIGJI Nr. 03/L-137
PËR DEPARTAMENTIN E MJEKËSISË LIGJORE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR DEPARTAMENTIN E MJEKËSISË LIGJORE

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i Ligjit

1. Ky ligj themelon Departamentin për Mjekësi Ligjore si organ publik kompetent, përgjegjës për të siguruar ekspertizë mjekoligjore, hetime mjekësore mbi vdekjen përfshirë edhe ekshumimin (zhvarrosjen) e mbetjeve mortore të shkaktuar si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë dhe kthimin e mbetjeve mortore tek familjet e tyre.
2. Me këtë ligj përcaktohet struktura organizative, kompetencat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Mjekësi Ligjore.

Neni 2
Përkufizimet

1. Për qëllimet e këtij ligji termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
   - "**Mjekësia Ligjore"** është degë e mjekësisë që zbaton njohuritë nga fusha e mjekësisë për çështjet dhe procedurat ligjore.
   - **Mjekësia Ligjore** përfshinë por nuk kufizohet në diciplinat si: mjekësia ligjore klinike, toksikologjia, histopatologjia, patologjia mjeko-ligjore, antropologjia mjeko-ligjore, arkeologjia mjeko-ligjore dhe odontologjia mjekoligjore.
   - **"Patologjia mjeko-ligjore"** është degë e mjekësisë që merret me përcaktimin e shkakut dhe raportimin e fakteve që lidhen me mënyrën e vdekjes së personit.
   - **"Autopsia"** është procedurë mjekësore që konsiston në ekzaminimin e tërësishëm të trupit apo mbetjeve mortore për të përcaktuar shkakun dhe kohën e vdekjes dhe të bëjë vlerësimin e ndonjë lëndimi që mund të jetë prezent, apo të përcaktoj natyrën e sëmundjes që ka shkaktuar vdekjen, si dhe studion patologjinë e sëmundjes.

- **"Ekzaminimet klinike mjekoligjore"** janë procedurë që konsiston në ekzaminimin e individëve të gjallë për të diagnostifikuar sëmundjen, studimin e lëndimeve, ose gjendjes shëndetësore për qëllime ligjore (të drejtësisë).
- **"Toksikologjia"** paraqet studimin e kundërefekteve të përbërjeve kimike në organizmat e gjallë".
- **"Histopatologjia"** nënkupton ekzaminimet mikroskopike të indeve me qëllim studimi manifestimin e sëmundjes.
- **"Hetues mjekësor për raste të vdekjeve"** nënkuptohen profesionistet e trajnuar që marrin pjesë në vendin ku ka ndodhur vdekja, dokumentojnë, mbledhin, ruajnë dhe bartin evidencat fizike për analiza, lidhur me trupin (kufomën) apo të mbeturat mortore dhe i dërgojnë deri në fund çështjet siç është e nevojshme për të kuptuar në tërësi rrethanat e papritura, vdekjet e shkaktuara me dhunë dhe nga pakujdesia.
- **"Persona të zhdukur"** janë personat vendndodhja e të cilëve është e panjohur.
- **"Antropologjia Mjekoligjore"** është disiplinë për aplikimin e teknikave standarde të shkencës së antropologjisë fizike (trupore) për të identifikuar mbetjet mortore dhe asistuar në hetimet mjekësore për proceset gjyqësore.
- **"Profili biologjiko-antropologjik"** është procedurë që konsiston në ekzaminimin e mbetjeve mortore, të kryer nga antropologu mjekoligjor me qëllim të dhënies së sugjerimeve mbi moshën, seksin(gjininë), origjinën, gjatësinë trupore dhe tiparet unike të të vdekurit bazuar në mbetjet mortore.
- **"Arkeologjia mjeko-ligjore"** nënkupton aplikimin e metodave arkeologjike për të ndihmuar lokalizimin, zhvarrosjen dhe regjistrimin e te mbeturave mortore, për të ndihmuar në hetimet mjekësore në proceset gjyqësore.
- **"Certifikata mjekësore mbi shkakun e vdekjes"**, nënkupton dokumentin formal që mund të përmbaj shkakun e vdekjes së trupit (kufomës) apo të mbetjeve mortore të lëshuar nga patologu mjekoligjor.
- **"Certifikata e identifikimit"**, nënkupton dokumentin formal që identifikon trupin apo të mbetura mortore.

Neni 3
Kompetencat

Departamenti i Mjekësisë Ligjore është përgjegjës për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemit mjekoligjor bazuar në standardet e njohura ndërkombëtare dhe praktikat më të mira Europiane për të siguruar shërbime mjeko ligjore, mësimdhënie dhe shërbime përkrahëse për familjet e personave të zhdukur.

Neni 4
Struktura Organizative e Departamentit për Mjekësi Ligjore

1. Departamenti i Mjekësisë Ligjore themelohet në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Instituti i Mjekësisë Ligjore i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore i Ministrisë së Drejtësisë do të shkrihen në Departamentin për Mjekësi Ligjore.

3. Departamenti përbëhet nga këto divizione:
   3.1. Divizioni për Mjekësi Ligjore;
   3.2. Divizioni për hulumtime dhe ndërtimin e kapiciteteve;
   3.3. Divizioni për Identifikim, Koordinim dhe Përkrahje;
4. Përbrenda Divizioneve që janë në kuadër të Departamentit për Mjekësi Ligjore do të themelohen sektorë dhe shërbime të veçanta si në vijim:
   4.1. Në kuadër të Divizionit për Mjekësi Ligjore do të themelohen sektoret punuese siç vijon:
      4.1.1. Sektori i autopsisë;
      4.1.2. Sektori për ekzaminime (këqyrje) klinike;
      4.1.3. Sektori për hetimin mjekësor të vdekjeve;
      4.1.4. Sektori për Antropologji dhe Arkeologji Mjeko-Ligjore;
      4.1.5. Laboratori për Toksikologji Mjeko-Ligjore;
      4.1.6. Laboratori për Histopatologji Mjeko-Ligjore;
      4.1.7. Sektori për Fotografi Mjekoligjore;
      4.1.8. Sektori për sigurimin e kualitetit;
      4.1.9. Sektori për dokumente Konfidenciale;
   4.2. Përbrenda Divizionit për Hulumtime dhe Ndërtimin e Kapaciteteve do të themelohen sektorët punues siç vijon:
      4.2.1. Sektori i Anatomisë Njerëzore dhe trajnimeve specializuese të Mjekësisë Ligjore;
      4.2.2. Sektori i trajnimeve të specializuara, për hetime në fushën e Mjekësisë Ligjore;
      4.2.3. Sektori për Akreditim dhe Certifikim;
      4.2.4. Sektori për hulumtime dhe statistikë;
   4.3. Përbrenda Divizionit për Koordinim, Identifikim dhe Përkrahje do të themelohen sektorët siç vijon:
      4.3.1. Sektori për hulumtimet në komunitet;
      4.3.2. Sektori për zhvarrosje, identifikim, koordinim dhe përkrahje;
      4.3.3. Projektet e Kujtesës/Projekt Psiko-Social;
      4.3.4. Sektori për mbështetjen/përkrahjen e familjeve;
      4.3.5. Sektori për ndërlidhje.
   4.4. Departamenti për Mjekësi Ligjore do të jetë i vendosur në Prishtinë.

Neni 5
Personali i Departamentit për Mjekësi Ligjore

I gjithë personeli i Departamentit të Mjekësisë Ligjore do të përzgjidhen dhe shkarkohen nga puna në pajtim me ligjin e zbatueshëm për shërbyes civil.

Neni 6
Kompetencat dhe përgjegjësitë e Divizionit

1. Kompetencat e Divizionit te Mjekësisë Ligjore përmbajnë por nuk kufizohen në:
   1.1. Mbajtjen e të drejtës për të siguruar ekspertizë mjekoligjore për organet publike;

1.2. Mbajtjen e të drejtës eksluzive për të udhëhequr hetimet mjekësore për vdekjen në vendin e ngjarjes;
1.3. Mbajtjen e të drejtës eksluzive për të kryer ekshumime (zhvarrosje) në pajtim me Kodin e Procedurës Penale;
1.4. Mbajtjen e të drejtës eksluzive për të kryer inspektime post-mortem(pas vdekjes) dhe autopsi në pajtim me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, si dhe ekzaminimin e viktimave që kanë pësuar nga veprat penale kundër jetës dhe trupit siç përcaktohet në Kodin Penal të Kosovës;
1.5. Mbajtjen e të drejtës eksluzive që të përcakton seksin (gjininë), racën, gjatësinë, moshën, dhe shkakun e vdekjes të mbetjeve mortore të një personi të pa identifikuar kurdoherë që është e mundur;
1.6. Kryerjen e autopsisë dhe/ose profilit antropologjiko biologjik dhe lëshon raport të autopsisë në raste të zbulimit të mbetjeve mortore në juridiksionet e huaja dhe të transportuara për në Republikën e Kosovës;
1.7. Mbajtjen e të drejtës eksluzive për koordiniminin dhe udhëheqjen e ekzaminimeve klinike për viktima, dëshmitar dhe autorët e mundshëm(supozuar) të krimit kundër integritetit seksual, mbështetur në Kapitullin XIX të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës;
1.8. Kërkimin e dokumenteve mjekësore që kanë të bëjnë me viktimën dhe/ose pandehurin për krimet kundër jetës dhe trupit, bazuar në Kodin Penal të Kosovës;
1.9. Mbledh ose ekzaminon dëshmitë e gjetura nga viktimat, dëshmitarët, apo të pandehurit e krimeve kundër integritetit seksual dhe veprave penale kundër jetës dhe trupit, bazuar në Kodin Penal të Kosovës.

2. Kompetencat e Divizionit për Hulumtime dhe Ndërtim të Kapaciteteve do të përfshijnë por nuk do të kufizohen në:
2.1. trajnimin dhe përgatitjen e praktikantëve të mjekësisë ligjore, infermiereve mjekoligjore, hetuesve mjekësor të vdekjeve, teknikëve te laboratorit të mjekësisë ligjore, fotografëve të mjekësisë ligjore, asistentëve teknik të mjekësisë ligjore, zyrtarëve mjekoligjor për identifikim, teknikëve të histopatologjisë dhe teknikëve të autopsisë;
2.2. mësimdhënien për studentët dhe studentët e diplomuar në fushën e anatomisë njerëzore dhe mjekësisë ligjore;
2.3. mbajtjen e dokumenteve për procedurat standarde operative, evidencën e inspektimit dhe mënyren e mbrojtjes.

3. Kompetencat e Divisionit për Koordinimin, Identifikimin dhe Përkrahjen e Familjeve do të përfshijnë por nuk do të kufizohen në:
3.1. mbledhjen dhe menaxhimin e informatave lidhur me vendndodhjen e personave të zhdukur dhe varrezave të mundshme;
3.2. kryerjen e vizitave tek familjet e personave të zhdukur për të mbledhur informacionet e nevojshme lidhur me personat e zhdukur;
3.3. përcaktimin e identititetit të personit të zhdukur në çdo mënyrë;
3.4. kthimin e mbetjeve mortore të identifikuara tek familjet e personave të zhdukur dhe/ose arranzhimin e rivarrimit, kur është e nevojshme;
3.5. koordinimin dhe komunikimin me familjet e personave të zhdukur duke i vënë në kontakt me organizatatat dhe institucionet vendore e ndërkombëtare;

3.6. sigurimin e informatave nga baza e të dhënave për Komisionin Funksional Parlamentar;
3.7. lëshon certifikata identifikimi;
3.8. bën kthimin e gjërave personale tek familjet së bashku me listën e plotë të nënshkruar.

Neni 7
Dispozitat Kalimtare

Personeli, buxheti i alokuar, prona, arkiva, të dhënat (evidencat) dhe pajisjet tjera të Institutit për Mjekësi Ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë do të bartet (transferohet) nga Ministria e Shëndetësisë në Ministrinë e Drejtësisë.

Neni 8
Dispozitat e EULEX-it

1. Gjatë kohëzgjatjes së Misionit të EULEX-it në Kosovë, ekspertët e EULEX-it në Departamentin e Mjekësisë Ligjore do të monitorojnë, udhëzojnë dhe këshilloj ekspertët vendor në Departament gjatë punës së tyre në ekipe të përziera.
2. Ekspertët e EULEX-it do të punojnë ngushtë me autoritetet vendor për të zhvilluar kapacitetet vendore dhe për të siguruar se Departamenti i Mjekësisë Ligjore të ketë ekspertë të mjaftueshëm, të trajnuar mirë dhe të aftë për kryerjen e ekspertizës mjeko ligjore që i plotëson standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira europiane:
   2.1. Ekspertët e EULEX-it do të kryejnë çdo lloj të ekzaminimit mjeko ligjor duke përfshirë autopsitë në ekipe të përziera me ekspertë mjeko ligjor vendor.
   2.2. Ekspertët e EULEX-it në Departamentin e Mjekësisë Ligjore do të marrin pjesë në çdo lloj të ekzaminimeve mjeko ligjore, duke përfshirë autopsitë në të gjitha rastet kur një prokuror i EULEX-it është caktuar në procedura penale në pajtim me nenin 8 të Ligjit për kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë dhe në të gjitha rastet kur një gjyqtar i EULEX-it është caktuar në procedura penale në pajtim me nenin 3 dhe 4 të Ligjit për kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.
3. Pjesëtarët e personelit të Misionit të EULEX-it do të bashkë-vendosen në objektet e Departamentit të Mjekësisë Ligjore.
   3.1. Misioni i EULEX-it në Kosovë do të caktojë një Bashkëkryesues të EULEX-it për Departamentin e Mjekësisë Ligjore i cili do të jetë përgjegjës që së bashku me Drejtorin vendor të Departamentit të Mjekësisë Ligjore të përcaktojë politikën udhëheqëse dhe zhvillimin e strategjisë në fushën e Mjekësisë Ligjore.
   3.2. Bashkëkryesuesi i EULEX-it i Departamentit të Mjekësisë Ligjore do të jetë përgjegjës për menaxhimin e personelit të EULEX-it të vendosur në Departamentin e Mjekësisë Ligjore.

3.3. Menaxhimi operacional, ndarja e punës dhe përbërja e ekipeve të përziera do të rregullohen me anë të një Marrëveshje ndërmjet Bashkëkryesuesit të EULEX-it të Departamentit të Mjekësisë Ligjore dhe Drejtorit vendor të Departamentit të Mjekësisë Ligjore.

Neni 9
Shfuqizimi

Ky ligj shfuqizon të gjitha dispozitat ligjore të cilat janë në kundërshtim me të.

Neni 10
Aktet nënligjore

Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji nxirren nga Ministria e Drejtësisë në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-137
25 qershor 2009

Shpallur me dekretin Nr. DL-019-2009, datë 17.07.2009 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI IV / Nr. 58 / 10 GUSHT 2009

LIGJI Nr. 04/L-157
PËR AVOKATURËN SHTETËRORE

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 1028
Kreu II: Statusi juridik, kompetenca dhe organizimi i avokaturës shtetërore 1030
Kreu III: Emërimi dhe pushimi nga funksioni 1032
Kreu IV: Të punësuarit në avokaturën shtetërore 1034
Kreu V: Pagat 1035
Kreu VI: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 1035

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR AVOKATURËN SHTETËRORE

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Fushëveprimi

Me këtë ligj rregullohet themelimi, organizimi dhe kompetencat e Avokaturës Shtetërore të Republikës së Kosovës, kushtet dhe procedura për emërimin dhe shkarkimin e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror dhe të avokatëve shtetëror, mjetet për punë, autorizimet e tyre, të drejtat dhe detyrimet, si dhe çështjet tjera me rëndësi për punën e saj.

Neni 2
Themelimi

Me këtë ligj themelohet Avokatura Shtetërore e Republikës së Kosovës (më tej: Avokatura Shtetërore), si mekanizëm i pavarur dhe i qëndrueshëm i përfaqësimit të pavarur ligjor të autoriteteve publike të Republikës së Kosovës në procedurat gjyqësore, të arbitrazhit dhe administrative.

Neni 3
Parimet e punës

1. Avokatura shtetërore kryen funksionin e vet në pajtim me Kushtetutën, me ligjet e zbatueshme dhe me aktet e përgjithshme nënligjore.
2. Askush nuk ka të drejtë që të ndikojë në çfarëdo mënyre në Avokaturën Shtetërore, në kryerjen e funksionit të saj.

Neni 4
Puna publike

1. Puna e Avokaturës Shtetërore është publike dhe secili person mund të ketë qasje në informacione në pajtim me ligjin.
2. Nëse Avokati i Përgjithshëm Shtetëror konsideron se kjo është e dobishme, mundet nëpërmjet mjeteve të informimit ta informojë publikun për shkallën e përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave të autoriteteve publike.

Neni 5
Gjuhët

Në punën e Avokaturës Shtetërore në përdorim janë gjuhët zyrtare të parapara me Kushtetutë dhe ligj.

Neni 6
Vula

1. Avokatura Shtetërore ka vulën e saj sipas formës dhe diametrit të përcaktuar me dispozitat për vulat.
2. Vula e Avokaturës Shtetërore ka formën rrethore, ashtu siç përcaktohet me Ligjin për vulat në institucionet e Republikës së Kosovës.
3. Madhësia e vulës së Avokaturës Shtetërore është me diametër dyzet (40) mm.
4. Teksti i vulës së Avokaturës Shtetërore shkruhet me shkronja të mëdha të shtypit në madhësi dhe formë të njëjtë në gjuhët zyrtare të Kosovës.
5. Vula e Avokaturës Shtetërore përmban këto të dhëna:
   5.1. në rrethin e parë të jashtëm shkruhet: Republika e Kosovës;
   5.2. në rrethin e dytë shkruhet: Qeveria e Republikës së Kosovës;
   5.3. në rrethin e tretë shkruhet: Ministria e Drejtësisë;
   5.4. në rrethin e katërt shkruhet: Avokatura Shtetërore; dhe
   5.5. në sipërfaqen e mbetur brenda rrethit më te vogël të vulës vendoset stema e Republikës së Kosovës.

KREU II
STATUSI JURIDIK, KOMPETENCA DHE ORGANIZIMI I AVOKATURËS SHTETËRORE

Neni 7
Statusi juridik

1. Avokatura Shtetërore është organ qendror i administratës në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Avokatura Shtetërore ka statusin e personit juridik me seli në Prishtinë.

Neni 8
Kompetenca

1. Avokatura shtetërore përfaqëson, jep këshilla dhe mbron autoritetet publike të Republikës se Kosovës, të përcaktuara me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, në procedurën gjyqësore, të arbitrazhit dhe në procedurën administrative në pajtim me ligjin.
2. Avokatura Shtetërore kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 9
Ushtrimi i funksionit

1. Funksionin e avokaturës shtetërore e ushtrojnë, Avokati i Përgjithshëm Shtetëror dhe avokatët shtetëror në Avokaturën Shtetërore.
2. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror dhe avokatët shtetëror në kryerjen e funksionit të tyre janë të pavarur. Avokati i Përgjithshëm për punën e vet i përgjigjet Ministrit të Drejtësisë.
3. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror e paraqet dhe përfaqëson Avokaturën Shtetërore, udhëheqë dhe ndërmerr veprime për të cilën është i autorizuar me këtë ligj, apo ligj tjetër.

Neni 10
Avokatët shtetëror

1. Avokatët shtetëror për punën e tyre i përgjigjen Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror.
2. Avokatët shtetëror e informojnë Avokatin e Përgjithshëm Shtetëror për gjendjen e përfaqësimit të lëndëve.
3. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror ua ndan detyrat avokatëve shtetërorë, dhe iu jep udhëzime të përgjithshme lidhur me kryerjen e detyrave në pajtim me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Avokaturës Shtetërore. Në kuptim të këtij ligji, udhëzimet për punën e avokatëve shtetërorë përfshijnë drejtimet e përgjithshme lidhur me kryerjen e detyrave dhe të aktiviteteve, si dhe orientimet për ndërmarrjen e procedurave dhe të masave në rastet konkrete.
4. Në kryerjen e punëve të përfaqësimit, Avokatura Shtetërore është e autorizuar që të

ndërmarr të gjitha veprimet të cilat i ndërmerr pala në procedurë, në pajtim me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës.

5. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror mund të autorizojë edhe personin e punësuar në Avokaturën Shtetërore me provim të dhënë të jurisprudencës, i cili punon në punët juridike që të përfaqësoj në gjykata dhe organe tjera në kontestet pasurore-juridike.
6. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror mund të autorizojë edhe personin e punësuar në organin e administratës shtetërore me provimin e dhënë të jurisprudencës, i cili punon në punët juridike, që të përfaqësojë në gjykata dhe organe të tjera në kontestet pasurore-juridike.

Neni 11
Përjashtimi

Rregullat e procedurës kontestimore për përjashtimin e gjyqtarëve, përshtatshmërisht zbatohen edhe për përjashtimin e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror dhe për avokatët shtetëror.

Neni 12
Shpenzimet e përfaqësimit

Shpenzimet e përfaqësimit nga ana e Avokatit të Përgjithshëm shtetëror dhe avokatëve shtetërorë i bart avokatura shtetërore.

Neni 13
Struktura e Avokaturës Shtetërore

1. Avokaturën shtetërore e udhëheq Avokati i përgjithshëm shtetëror.
2. Avokatura Shtetërore ka numër të caktuar të avokatëve shtetëror.
3. Numri i avokatëve shtetërorë dhe struktura organizative e Avokaturës shtetërore rregullohet me akt nënligjor, që e miraton Ministria e Drejtësisë.

Neni 14
Papajtueshmëria

Avokati Shtetëror nuk mund të ushtrojë funksione të tjera publike, ose private të cilat janë në kundërshtim me funksionet e tij të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 15
Konflikti i Interesit

Gjatë ushtrimit të funksioneve të tij publike, Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, si dhe cilido avokat tjetër shtetëror, nuk mund të përfaqësojë autoritetet publike nëse ka interes personal direkt ose indirekt në rastin që gjykohet.

KREU III
EMËRIMI DHE PUSHIMI NGA FUNKSIONI

Neni 16
Emërimi i Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror dhe i avokatëve shtetëror

1. Avokatin e Përgjithshëm Shtetëror me propozimin e Ministrit të Drejtësisë e emëron Qeveria e Republikës së Kosovës.
2. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror dhe avokatët shtetëror emërohen me konkurs publik sipas procedurës së paraparë me dispozitat për emërimin për pozitat e larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
3. Komisioni profesional vlerësues duhet të përbëhet nga përfaqësuesi i Ministrisë se Drejtësisë, një gjyqtar i Gjykatës se Apelit apo i Gjykatës Themelore, një prokuror i shtetit, një përfaqësues i shoqërisë civile dhe një profesor i Fakultetit të drejtësisë.
4. Avokatët shtetëror në Avokaturën Shtetërore emërohen me konkurs të hapur publik nga Ministria e Drejtësisë në pajtim me dispozitat për Shërbimin Civil për emërimin për pozitat e larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Për emërimin e avokatëve shtetëror përshtatshmërisht zbatohen dispozitat për emërimin e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror.

Neni 17
Kohëzgjatja e funksionit

1. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror emërohet për periudhën tre (3) vjeçare dhe mund të emërohet përsëri.
2. Avokatët shtetëror emërohen pa kufizim të kohëzgjatjes së funksionit.

Neni 18
Kushtet për emërim

1. Për Avokat të Përgjithshëm Shtetëror dhe për avokat shtetëror mund të emërohet çdo person i cili i plotëson këto kushte të përgjithshme:
   1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
   1.2. të jetë jurist i diplomuar;
   1.3. të ketë dhënë provimin e jurisprudencës;
   1.4. të jetë person me kualitete të larta morale, të ketë përvojën e nevojshme dhe aftësi profesionale në fushën e drejtësisë;
   1.5. të mos ketë qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për vepër penale;
   1.6. të mos jetë shkarkuar nga shërbimi civil, apo nga ndonjë funksion tjetër publik i Republikës së Kosovës për shkak të shkeljes së detyrës, apo paaftësisë për të kryer detyrën.
2. Personi mund të emërohet për Avokat të Përgjithshëm Shtetëror, nëse përveç kushteve të parapara me këtë ligj plotëson edhe kushtet e veçanta, të ketë së paku dhjetë (10) vite përvojë pune në punët juridike në ndonjë institucion të judikaturës, avokaturës apo në institucione tjera.
3. Personi mund të emërohet për avokat shtetëror nëse përveç kushteve të parapara

me këtë Ligj plotëson edhe kushtin e veçantë, të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune në punët juridike në ndonjë institucion të judikaturës, avokaturës apo në institucione tjera.

Neni 19
Marrja e detyrës

Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, përkatësisht Avokati shtetëror i emëruar, ia fillon detyrës menjëherë pas emërimit, e më së voni në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur është emëruar.

Neni 20
Pushimi i funksionit të Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror

1. Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror i pushon funksioni:
   1.1. me kërkesën e tij;
   1.2. kur i mbush gjashtëdhjetë e pesë (65) vjet për shkuarje të detyrueshme në pension;
   1.3. kur skadon afati për të cilin është emëruar;
   1.4. në rastin e shkarkimit të tij si rezultat i procedurës disiplinore;
   1.5. nëse në bazë të dokumentacionit medicinal të institucionit shëndetësor vërtetohet se përgjithmonë e ka humbur aftësinë punuese për ushtrimin e detyrës;
   1.6. nëse është dënuar për vepër penale, me burg efektiv, në kohëzgjatje së paku gjashtë (6) muaj.

Neni 21
Pushimi i funksionit të avokatit shtetëror

1. Funksioni i avokatit shtetëror pushon:
   1.1. me kërkesën e tij;
   1.2. kur mbush moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare për shkuarje të detyrueshme në pension;
   1.3. në rastin e shkarkimit të tij/saj si rezultat i procedurës disiplinore;
   1.4. nëse në bazë të dokumentacionit medicinal të institucionit shëndetësor vërtetohet se përherë e ka humbur aftësinë për ushtrimin e detyrës;
   1.5. nëse është dënuar për vepër penale, me burg efektiv, në kohëzgjatje së paku gjashtë (6) muaj.

Neni 22
Suspendimi

1. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, apo avokati shtetëror i cili gjendet në paraburgim suspendohet (suspendimi i detyrueshëm). Suspendimi zgjatë derisa personi gjendet në paraburgim.
2. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror dhe Avokati Shtetëror suspendohen (suspendimi diskrecional) nëse:

2.1. kundër tij ka filluar hetimi në procedurën penale;
2.2. kundër tij prokurori i shtetit ka ngritur aktakuzë për vepër penale;
2.3. kundër tij ka filluar procedura e shkarkimit;

3. kundër tij ka filluar procedura disiplinore, ndërsa organi disiplinor vërteton se, përgjegjësia disiplinore nuk mund të përcaktohet në mënyrë të drejtë nëse Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, apo avokati shtetëror përkohësisht nuk suspendohen gjatë procedurës;
4. kryerja e detyrave zyrtare në mënyrë të konsiderueshme është rënduar për shkak të gjendjes së tij mentale, emocionale dhe fizike.

Neni 23
Përgjegjësia e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror dhe avokatëve shtetëror

Dispozitat për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, lidhur me menaxhimin dhe përgjegjësinë e funksioneve për emërime të larta në mënyrë të përshtatshme vlejnë edhe për Avokatin e Përgjithshëm Shtetërorë dhe për avokatët shtetëror.

KREU IV
TË PUNËSUARIT NË AVOKATURËN SHTETËRORE

Neni 24
Personeli civil në Avokaturën Shtetërore

1. Avokatura Shtetërore ka numër të caktuar të nëpunësve civil për kryerjen e punëve profesionale dhe administrativo-teknike.
2. Avokatura Shtetërore mund të punësojë numër të caktuar të zyrtarëve profesional, të cilët iu ndihmojnë bartësve të funksioneve në kryerjen e punëve juridike.
3. Numri i nëpunësve civil në Avokaturën Shtetërore përcaktohet me aktin për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Avokaturës Shtetërore. Aktin për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës së Avokaturës Shtetërore, të cilin e përgatitë Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, e miraton Ministri i Drejtësisë.
4. Dispozitat për shërbimin civil në organet e administratës shtetërore, përshtatshmërisht zbatohen edhe për nëpunësit civil në Avokaturën Shtetërore, nëse me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe.

Neni 25
Aftësimi profesional

1. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, avokatët shtetëror dhe nëpunësit civil në Avokaturën Shtetërore, kanë të drejtë dhe detyrim në aftësim dhe arsimim profesional të përhershëm.
2. Për nevoja të aftësimit profesional sigurohen mjetet e nevojshme të cilat janë të parapara në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë dhe të ndara për Avokaturën Shtetërore.

Neni 26
Vlerësimi i punës profesionale

1. Në fund të çdo viti kalendarik, avokatët Shtetëror i nënshtrohen procedurës së vlerësimit të punës profesionale, e cila kryhet nga Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, i cili merr parasysh rezultatet e arritura gjatë procedurave gjyqësore dhe përfaqësimeve të kryera gjatë periudhës së vlerësimit.
2. Kriteret për vlerësim, rregullat dhe procedurat përcaktohen me Rregullore të brendshme të Punës së Avokaturës Shtetërore, të cilën e nxjerr Ministri i Drejtësisë.
3. Vlerësimi me të cilin konstatohet paaftësi profesionale përbën shkak për inicim të shkarkimit të një avokati shtetëror.

KREU V
PAGAT

Neni 27
Pagat e Avokatëve Shtetëror

1. Niveli i pagës së Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror dhe i avokatëve shtetëror, caktohet në pajtim me Ligjin për Pagat e nëpunësve civil dhe të akteve nënligjore përkatëse për zbatimin e dispozitave për pagat e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues.
2. Niveli i pagës së personelit tjetër të Avokaturës Shtetërore përcaktohet në pajtim me Ligjin për Pagat e nëpunësve civil.

KREU VI
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 28
Marrja e lëndëve

1. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, do ti marr lëndët nga kompetenca e vet, nga Divizioni për Përfaqësim në Ministrinë e Drejtësisë në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e plotësimit të vendeve të punës, e cila siguron funksionimin e Avokaturës Shtetërore.
2. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror duhet me shkrim ta informoj Ministrin e Drejtësisë për marrjen e lëndëve nga paragrafi 1. i këtij neni në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e kryerjes së pranim-dorëzimit.
3. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror dhe Udhëheqësi i Divizionit për Përfaqësim pranë Ministrisë së Drejtësisë nga paragrafi 1. i këtij neni përpilojnë regjistrin e lëndëve të marra, evidencën dhe arkivin e lëndëve.
4. Ditën e marrjes së lëndëve Divizioni për Përfaqësim pranë Ministrisë së Drejtësisë do të pushojë t'i kryej detyrat e përfaqësimit të autoriteteve publike.

Neni 29
Vazhdimi i punës së personelit civil

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të punësuarit në Divizionin për Përfaqësim në Ministrinë e Drejtësisë vazhdojnë të punojnë në Avokaturën Shtetërore në pajtim me dispozita e këtij ligji.
2. Të gjithë zyrtarët ligjorë në divizionin për përfaqësime që kanë ushtruar detyrat e përfaqësimit të institucioneve publike dhe që i plotësojnë kushtet sipas këtij ligji për t'u emëruar avokat shtetëror do ta kenë statusin e avokatit shtetëror.

Neni 30
Emërimi i Avokatit të përgjithshëm Shtetëror dhe i avokatëve shtetëror

Brenda tre (3) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji emërohet Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, ndërsa brenda tre (3) muajve pas emërimit të Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror emërohen avokatët shtetëror.

Neni 31
Aktet nënligjore

Brenda gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të nxirren aktet nënligjore të parapara me këtë ligj.

Neni 32
Shfuqizimi i legjislacionit të aplikueshëm

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet legjislacioni i aplikueshëm për avokaturën publike.

Neni 33
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-157
12 mars 2013

Shpallur me dekretin Nr. DL-008-2013, datë 26.03.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 8 / 8 PRILL 2013, PRISHTINË

LIGJI Nr. 04/L-141
PËR PROVIMIN E JURISPRUDENCËS

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 1037
Kreu II: Organizimi i provimit të jurisprudencës dhe përbërja e komisionit për dhënien e provimit 1038
Kreu III: Kushtet për paraqitjen e provimit të jurisprudencës 1039
Kreu IV: Procedura e provimit të jurisprudences 1040
Kreu V: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 1044

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR PROVIMIN E JURISPRUDENCËS

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Fushëveprimi dhe Qëllimi

1. Me këtë ligj rregullohen kushtet, kriteret, procedura dhe programi për dhënien e provimit të jurisprudencës.
2. Qëllimi i këtij ligji është të rregulloj organizimin e provimit, përbërjen dhe funksionimin e Komisionit për dhënien e provimit, si dhe verifikimin dhe vlerësimin e aftësive teorike dhe praktike të juristëve të diplomuar për ushtrimin e pavarur të detyrave, zbatimin e ligjeve, njohjen e etikës profesionale dhe të drejtave dhe liritë themelore të njeriut.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **Komisioni** - Komisioni për dhënien e provimit të jurisprudencës, është organ i pavarur profesional i cili organizon provime për kualifikimin e gjyqtarëve, prokurorëve, avokatve juristëve të diplomuar të tjerë për të cilët për ushtrimin e profesionit kërkohet të ketë dhënë provimin e jurisprudencës;

1.2. **Anëtari i komisionit** - personi i cili është emëruar nga Kuvendi Kosovës në Komisionin e jurisprudencës;
1.3. **Kandidati** - personi i cili mund t'i nënshtrohet provimit të jurisprudencës;
1.4. **Sekretari i Komisionit** - personi i cili merret me punët profesionale dhe administrative për nevojat e Komisionit për organizimin e provimit;
1.5. **Sistemi gjyqësor** – nënkupton gjykatat, prokurorinë shtetërore, organet rregullative gjyqësore dhe prokuroriale dhe institucionet e tjera gjyqësore.

KREU II
ORGANIZIMI I PROVIMIT TË JURISPRUDENCËS DHE PËRBËRJA E KOMISIONIT PËR DHËNIEN E PROVIMIT

Neni 3
Organizimi i provimit të jurisprudencës

1. Organizimi i provimit të jurisprudencës është kompetencë e Ministrisë së Drejtësisë.
2. Provimi i jurisprudencës mbahet nga komisioni për dhënien e provimit të jurisprudences.

Neni 4
Përbërja e komisionit

1. Komisioni për provimin e jurisprudencës përbëhet nga kryetari i komisionit, anëtarët e komisionit dhe zëvendësit e tyre.
2. Kryetarin, anëtarët e komisionit dhe zëvendësit e tyre i propozon ministri i drejtësisë dhe i emëron Kuvendi i Kosovës, me mandat dy (2) vjet, me mundësi riemërimi.
3. Komisioni emërohet nga radhët e juristë të diplomuar, të cilët e kanë dhënë provimin e jurisprudencës, që janë ekspertë të drejtësisë dhe që kanë së paku dymbëdhjetë (12) vjet përvojë punë në sistemin e drejtësisë.
4. Komisioni për punën e vet i raporton Kuvendit së paku një herë në vit.
5. Sekretari i komisionit për provimin e jurisprudencës caktohet nga ministri i drejtësisë. Kandidati që caktohet sekretar i këtij komisioni, duhet ta ketë të dhënë provimin e jurisprudencës.

Neni 5
Shpenzimet e dhënies së provimit

1. Shpenzimet e dhënies së provimit i paguan kandidati, përkatësisht organi gjyqësor, prokurorial, administrativ dhe institucioni tjetër i pavarur publik apo personi juridik tjetër në të cilin është i punësuar kandidati.
2. Kryetarit, anëtarëve përkatësisht zëvendësve dhe sekretarit të Komisionit u takon shpërblimi për punën në Komision.
3. Ministri nxjerr udhëzim administrativ për shpërblimin e punës së Komisionit.

KREU III
KUSHTET PËR PARAQITJEN E PROVIMIT TË JURISPRUDENCËS

Neni 6
Kushtet për dhënien e provimit

1. Kandidatët të cilët i nënshtrohen dhënies së provimit duhet t'i plotësojnë këto kushte:
   1.1. të jenë shtetas të Republikës së Kosovës.
   1.2. të jenë juristë të diplomuar sipas programit katër vjeçar ose t'i kenë përfunduar studimet master.
   1.3. të kenë punuar së paku një (1) vit në punët juridike në gjykata, në prokurori të shtetit apo në zyrën e avokatisë, ose të kenë punuar së paku dy (2) vite në punët profesionale juridike brenda ose jashtë vendit, në institucione publike, agjenci shtetërore dhe në administratën e institucioneve ndërkombëtare në Kosovë.
2. Provimin e jurisprudencës mund ta japin edhe personat të cilët nuk janë në marrëdhënie pune në organet e administratës, në shoqëritë tregëtare apo në personat e tjerë juridik nga paragrafi 1. i këtij neni, të cilët si jurist të diplomuar kanë kryer praktikën e nevojshme në gjykatë, prokurori të shtetit apo në zyrën e avokatisë me qëllim të aftësimit profesional dhe fitimin e kushteve për dhënjen të provimit të jurisprudencës (volonterët), ndërsa sipas kushteve në nënparagrafin 1.2. të këtij neni.
3. Kandidati i cili ka kryer Fakultetin Juridik në ndonjë universitet jashtë Kosovës, duhet të ketë nostrifikuar diplomën e Fakultetit Juridik, në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
4. Juristët e diplomuar të cilët kanë dhënë provimin profesional për punë në organet e administratës si dhe ata që kanë dhënë provimin profesional të gjyqtarit për kundërvajtje, provimin e jurisprudencës e japin si provim plotësues, sipas programit të shkurtuar, konform dispozitave paraprake, duke iu pranuar provimet e dhëna.

Neni 7
Lëndët e provimit të jurisprudencës

1. Provimi i jurisprudencës përbëhet nga pjesa e provimit me shkrim dhe pjesa e provimit me gojë.
2. Në pjesën e provimit me shkrim zgjidhen detyra praktike nga e Drejta penale materiale e procedurale, dhe nga e Drejta civile (materiale dhe procedurale), familjare, trashëgimore, e detyrimeve.
3. Pjesa e provimit me gojë përbëhet nga këto lëndë:
   3.1. E drejta civile (materiale dhe procedurale), familjare, trashëgimore dhe e detyrimeve;
   3.2. E drejta tregtare;
   3.3. E drejta penale (materiale dhe procedurale);
   3.4. E drejta e punës dhe e drejta administrative;
   3.5. E drejta kushtetuese, organizimi i sistemit gjyqësor të Kosovës, bazat e sistemit të Bashkimit Evropian dhe të drejtat e njeriut.

Neni 8
Vlerësimi i njohurive për dispozitat ligjore

Për suksesin e kandidatit, komisioni vlerëson njohurit për dispozitat pozitive ligjore dhe praktikën gjyqësore, njohuritë për institucionet juridike, shkathtësit, të shprehurit dhe të gjykuarit të drejtë.

Neni 9
Programi për provimin e jurisprudencës

Provimi jepet në kuadër të Programit për provimin e jurisprudencës i cili përmbanë lëndët, burimet juridike dhe literaturën për çdo lëndë nga neni 15 paragrafi 2. i këtij ligji.

KREU IV
PROCEDURA E PROVIMIT TË JURISPRUDENCES

Neni 10
Kërkesa për provim

1. Kërkesa për provimin e jurisprudencës paraqitet në Ministrinë e Drejtësisë.
2. Kandidatët në kërkesë deklarohen se në cilën gjuhë zyrtare dëshirojnë t'i nënshtrohen provimit dhe se a i janë nënshtruar provimit më parë.
3. Kandidati, kërkesës për provim ia bashkangjet dëshmitë se i plotëson kushtet nga neni 6 i këtij ligji për kryerjen e fakultetit juridik dhe përvojën e punës në punët juridike.
4. Personave nga neni 6 paragrafi 2. i këtij ligji, certifikatën për praktikën e kryer ia lëshon Kryetari i Gjykatës, Prokurori i Shtetit, Oda e Avokatëve te e cila personi është regjistruar në regjistrin si avokat praktikant.
5. Për dhënien e provimit sipas programit të shkurtuar kandidati është i obliguar që përveç dëshmive nga paragrafi paraprak të bashkëngjis dhe dëshminë për provimin e dhënë professional për punë në organe të administratës, përkatësisht dëshminë mbi dhënien e provimit të gjyqtarit për kundërvajtje.
6. Komisioni përkatës i Ministrisë me vendim përcakton se kandidati i plotëson kushtet për dhënien e provimit të jurisprudencës. Kundër vendimit të komisionit mund t'i paraqitet ankesë ministrit të drejtësisë, në afat prej tetë (8) ditësh. Ministri brenda pesë (5) ditëve vendos lidhur me ankesën e kandidatit. Vendimi i ministrit është përfundimtar.

Neni 11
Caktimi i kohës për dhënien e provimit

Ne bazë të vendimit më të cilin kandidatit i është lejuar dhënia e provimit, kryetari i komisionit e cakton kohën kur kandidati do ta jep provimin.

Neni 12
Dhënia e provimit

1. Provimi fillon me dhënien e pjesës së provimit me shkrim. Pjesën e provimit me shkrim kandidati e jep me zgjidhjen e rastit praktik nga fusha penalo-juridike dhe civilo-juridike.
2. Në ditën kur kandidati i nënshtrohet pjesës së provimit me shkrim, konsiderohet se ka filluar dhënien e provimit.
3. Dhënia e provimit organizohet në çdo tre (3) muaj, gjegjësisht katër (4) herë brenda një (1) viti kalendarik.
4. Lartësinë e pagesës për paraqitjen e provimit të jurisprudencës e cakton Ministri.
5. Në pjesën e provimit me shkrim merr pjesë anëtari i komisionit që pyet lëndën e cila jepet me shkrim dhe sekretari i komisionit.
6. Gjatë hartimit të detyrave me shkrim, kandidati mund të shërbehet vetëm me tekstet e dispozitave ligjore (pa komentar).
7. Pas kumtimit të detyrës, koha për punimin e detyrës me shkrim zgjatë pesë (5) orë.
8. Vendimin për suksesin e arritur në provim me shkrim e miraton Komisioni me shumicë votash, pas marrjes së mendimit nga anëtari i Komisionit i cili e ka kontrolluar punimin me shkrim.
9. Rezultati i punimit me shkrim vlerësohet para provimit me gojë. Kandidati duhet nga provimi me shkrim në lëmin civile dhe penale të arrij pikët konform nenit 13 paragrafi 3. të këtij ligji, për të vazhduar pjesën e provimit me gojë.

Neni 13
Maksimumi i pikëve të dhënies së provimit

1. Kandidati në provim mund të arrijë maksimumin tetëdhjetë (80) pikë.
2. Për detyrat me shkrim nga e drejta penale si dhe nga e drejta civile, kandidati mund të vlerësohet për secilin punim veç e veç, më së shumti me nga pesëmbëdhjetë (15) pikë.
3. Kandidati do të konsiderohet së e ka kaluar provimin me shkrim nëse arrin të grumbulloj, nga secila detyrë me shkrim, së paku nga nëntë (9) pikë.
4. Kandidati do të konsiderohet se e ka kaluar provimin nëse grumbullon dyzet e tetë (48) pikë.
5. Kandidati do të konsiderohet se e ka kaluar provimin me gojë nëse arrin të grumbulloj nga secila lëndë së paku nga gjashtë (6) pikë.

Neni 14
Dhënia e provimit me gojë

1. Kandidati i cili kalon pjesën me shkrim të provimit nga fusha penale dhe fusha civile, i lejohet t'i nënshtrohet pjesës së provimit me gojë.
2. Provimin me gojë kandidatët e japin publikisht para Komisionit në përbërje të plotë.
3. Provimi mbahet në praninë e të gjithë anëtarëve të Komisionit.
4. Kryetari i Komisionit menaxhon provimin me gojë, duke u kujdesur për mbarëvajtjen e procedurës së provimit.

5. Në provimin me gojë nuk mund të ftohen më shumë se një (1) kandidat në të njëjtën kohë.
6. Komisioni merr vendim me shumicë votash për suksesin e kandidatit, dhe asnjë anëtar i Komisionit nuk mund të abstenoj nga votimi.
7. Pas përfundimit të provimit me gojë, Komisioni vlerëson njohuritë e kandidatit në përputhje me dispozitat e nenit 15 të këtij ligji.
8. Me përfundimin e të gjitha provimeve do të përcaktohet numri i përgjithshëm i pikave të provimit dhe do të merret një vendim mbi rezultatin e provimit i cili i komunikohet kandidatit. Nëse kandidati nuk dëshiron t'i publikohet rezultati në prani të kandidatëve të tjerë, rezultati i komunikohet vetëm në prani të Komisionit.
9. Komisioni vlerëson rezultatin e kandidatit, në mënyrë kumulative me pikë të arritura (grumbulluara) në pjesën me shkrim dhe me gojë të provimit.
10. Procesverbali mbi provimin nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit dhe sekretari.
11. Kandidati i cili konsideron se suksesi i përgjithshëm ose suksesi nga njëra lëndë nuk i është vlerësuar në mënyrë të drejtë, mund t'i paraqes ankesë Komisionit, brenda tri (3) ditësh, nga komunikimi i rezultatit të provimit.
12. Komisioni është i detyruar që brenda pesë (5) ditësh ta shqyrtojë ankesën dhe lidhur me këtë ta njoftojë kandidatin.
13. Nëse ankesa e kandidatit aprovohet, Komisioni duhet ta përsëris provimin.

Neni 15
Pikët e nevojshëm për dhënien e provimit

1. Kandidati do të konsiderohet se e ka kaluar provimin, nëse arrin me i grumbulluar dyzet e tetë (48) pikë nga të gjitha lëndët.
2. Pjesët me gojë të provimit vlerësohen me pikë sipas grupeve të lëndëve dhe ate:
   2.1. E drejta civile (materiale dhe procedurale), familjare, trashëgimore dhe e detyrimeve;
   2.2. E drejta tregtare;
   2.3. E drejta penale (materiale dhe procedurale);
   2.4. E drejta e punës dhe e drejta administrative;
   2.5. E drejta kushtetuese, organizimi i sistemit gjyqësor të Kosovës, bazat e sistemit të Bashkimit Evropian dhe të drejtat e njeriut.
3. Suksesi i kandidatit vlerësohet me fjalët: **"kalon"** dhe **"nuk kalon".**

Neni 16
Kur konsiderohet se kandidati nuk e ka kaluar provimin

1. Komisioni konstaton se kandidati nuk e ka kaluar provimin nëse:
   1.1. nuk i ka plotësuar kushtet e parapara me nenin 13 paragrafi 5. të këtij ligji.
   1.2. nuk e dorëzon punimin me shkrim.
   1.3. lëshon pa arsye të justifikueshme, pjesën e provimit me gojë ose është larguar nga provimi me shkrim për shkak të mos respektimit të rregullave.
   1.4. është vlerësuar më pak se gjashtë (6) pikë nga cila do lëndë gjatë provimit me gojë; dhe
   1.5. nuk ka grumbulluar dyzet e tetë (48) pikë.

Neni 17
Shtyrja e provimit të filluar

1. Provimi i filluar mund të shtyhet me kërkesë me shkrim në qoftë se kandidati është sëmuar, ose për ndonjë rast të arsyeshme është penguar që të vazhdoj provimin.
2. Vendimin për shtyrjen dhe vazhdimin e provimit e merr Komisioni në afat prej pesë (5) ditësh.
3. Kërkesa për vazhdim duhet të dorëzohet brenda tetë (8) ditëve pas pushimit të shkaqeve të arsyeshme për shtyrjen e provimit, por jo më vonë se dy (2) muaj nga data kur kandidati duhet të hyn në provim.
4. Nëse kandidati nuk paraqetë kërkesë për shtyerjen e provimit me afate të përcaktuara në paragrafin 2. të këtij neni, ose në qoftë se kërkesa është refuzuar, konsiderohet se nuk ka kaluar provimin.
5. Kundër vendimit të Komisionit, nga paragrafi 2. të këtij neni, mund të parashtrohet ankesë në afat prej tre (3) ditësh Ministrit, i cili do të vendos në afat prej tetë (8) ditësh. Vendimi i Ministrit është përfundimtar.

Neni 18
Riprovimi

1. Kandidati i cili nuk tregon sukses të kënaqshëm në një ose dy lëndë mbetet në riprovim.
2. Kandidati mbetet në riprovim nëse nga dy lëndë të pjesës së provimit me gojë, nuk ka treguar rezultate të përcaktuara me dispozitën e nenit 15 paragrafi 2. të këtij ligj.
3. Kandidati i cili ka mbet në riprovim, pjesën e provimit të mbetur duhet ta paraqes për afatin e parë të radhës.
4. Nëse kandidati nuk i nënshtrohet riprovimit në afatin prej dy (2) deri në gjashtë (6) muaj ose gjatë riprovimit nuk tregon sukses të kënaqshëm do të konsiderohet se "nuk ka dhënë provimin".
5. Kandidati që mbetet në riprovim në pjesën me gojë nga e drejta penale dhe procedurës penale ose e drejta civile, e i cili më parë ka kaluar pjesën me shkrim të provimit, me rastin e riprovimit nuk do t'i nënshtrohen sërish pjesës me shkrim të provimit.
6. Kandidati i cili vlerësohet nga Komisioni provues se "nuk e ka dhënë provimin" mund ta përsërisë dhënien e provimit brenda afatit i cili nuk mund të jetë më shkurtër se gjashtë (6) muaj nga data kur i është komunikuar nga Komisioni se "nuk e ka dhënë provimin".
7. Kandidati i cili nuk e jep provimin për të dytën herë, mund ta përsërisë dhënien e provimit brenda afatit i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se dymbëdhjetë (12) muaj.

KREU V
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 19
Barazimi i provimit të dhënë sipas dispozitave të vlefshme deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji

1. Me provimin e jurisprudencës, në kuptim të këtij ligji, barazohet provimi i dhënë i jurisprudencës sipas dispozitave, të cilat kanë qenë të vlefshme deri me hyrjen në fuqi të këtij ligji.
2. Për njohjen e provimit të jurisprudencës të dhënë sipas dispozitave të vendeve tjera vendos Ministria e Drejtësisë, duke u udhëhequr sipas parimit të reciprocitetit.
3. Kandidati i cili dhënien e provimit të jurisprudencës e ka filluar sipas dispozitave të cilat kanë vlejtë para zbatimit të këtij ligji, ka të drejtë që dhënien e provimit të filluar të jurisprudencës ta përfundoj sipas dispozitave të cilat kanë vlejtë në kohën kur dhënien e ka filluar pas fillimit të zbatimit të këtij ligji.
4. Mandati i anëtarëve aktualë të Komisionit për provimin e jurisprudencës të emëruar në pajtim me ligjin do të vazhdojë sipas kushteve të caktuara me vendimin për emërimin e tyre.
5. Për lëndët që janë bashkuar sipas këtij ligji, provimin e mbajnë së bashku anëtaret e Komisionit aktual, sipas fushave për të cilat janë emëruar

Neni 20
Aktet nënligjore

Ministri nxjerr aktin nënligjor për dhënien e provimit të jurisprudencës me të cilin më për së afërmi rregullohet mënyra e paraqitjes së provimit, puna e Komisionit, përmbajtja e Programit të provimit, përmbajtja e procesverbalit, formulari i Certifikatës për dhënien e provimit, përmbajtja e Evidencës për provimin e dhënë të jurisprudencës, shumën të cilën kandidati paguan për provim si dhe shpërblimi për punën e Komisionit.

Neni 21
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Rregullorja e UNMIK-ut 2006/30 dhe Ligji mbi provimin e jurisprudencës Ligji Nr. 02/L-40, 20 janar 2006.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-141
25 prill 2013

Shpallur me dekretin Nr. DL-024-2013, datë 21.05.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 18 / 28 MAJ 2013, PRISHTINË

LIGJI Nr. 04/L-064
PËR AGJENCINË E KOSOVËS PËR FORENZIKË

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 1046
Kreu II: Organizimi dhe funksionet 1049
Kreu III: Kompetencat dhe përgjegjësitë e AKF-së 1051
Kreu IV: Të drejtat e personelit dhe disiplina 1052
Kreu V: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 1053

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR AGJENCINË E KOSOVËS PËR FORENZIKË

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj rregullon themelimin, misionin, organizimin, funksionet, detyrat, përgjegjësitë dhe financimin e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë.

Neni 2
Fushëveprimi

1. AKF-ja është institucioni përgjegjës për ofrimin e paanshëm, të analizave objektive shkencore forenzike.
2. AKF-ja i kryen veprimet me urdhër të gjykatës, prokurorisë apo me kërkesë të agjencive të zbatimit të ligjit.
3. AKF-ja ofron shërbime edhe për organet shtetërore sipas ligjit përkatës në fuqi.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **MPB -** Ministria e Punëve të Brendshme;

1.2. **Ministri –** Ministër i Punëve të Brendshme;
1.3. **AKF –** Agjencia e Kosovës për Forenzikë;
1.4. **Policia -** Policia e Kosovës;
1.5. **Agjencitë për zbatim të ligjit -** të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit të themeluara me ligj;
1.6. **Ekspert –** personeli i Agjencisë së Forenzikës që kryen hulumtim, hetim, gjurmim, vlerësim apo studim të provuar nga personeli i specializuar i AKF-së;
1.7. **Personel i specializuar shkencor -** punonjësi i specializuar teknik dhe menaxhues që kryejnë, udhëheqin apo verifikojnë ekspertimet kriminalistike, si dhe asistojnë në shikimin apo rikonstruimin e vendit të ngjarjes;
1.8. **Personel mbështetës -** punonjësi administrativ të personelit, logjistikës, prokurimit,
1.9. financave dhe mirëmbajtësve teknik;
1.10. **Personel me kohë të pjesshme dhe me kontratë –** personeli i jashtëm të kontraktuar nga AKF për konsulencë apo ekspertizë;
1.11. **Shkenca e Forenzikës -** aplikimi i shkencave (kimi, biologji, fizikë, matematikë, inxhinieri, makineri, kriminalistikë, etj.) për gjetjen, identifikimin, individualizimin, analizimin dhe vlerësimin e dëshmive fizike (provave materiale) për çështje ligjore penale dhe civile;
1.12. **Ekspertizë -** hulumtimi, hetimi, gjurmimi, vlerësimi apo studimi i provuar, përfshirë edhe raportet nga këto aktivitete, konstatimet dhe rezultatet që kërkojnë njohuri specifike dhe të cilat kryhen nga ekspertë për të vërtetuar dhe dhënë mendimin mbi faktet e caktuara;
1.13. **Urdhëresë për ekspertim -** urdhëresa e gjyqtarit apo prokurorit për kryerjen e ekspertizës;
1.14. **Kërkesë për ekspertim -** kërkesa e agjencive për zbatimin e ligjit apo institucioneve tjera shtetërore për kryerjen e shërbimeve;
1.15. **Formulari/kërkesa** –formulari i AKF-së për ekspertim;
1.16. **Dëshmi -** dokumenti, prova që dëshmon ndonjë fakt të caktuar;
1.17. **Provë** – vërtetimi i të dhënave që duam të njohim a ta studiojmë më thellë: eksperiment që bëhet për të marrë të dhëna për diçka, për të kontrolluar saktësinë e diçkaje, veprim paraprak që bëhet për të kontrolluar apo vërtetuar saktësinë e një lloji, një gjëje, a mase të diçkaje, duke u mbështetur në fakte a dëshmi. Prova është e dhënë që vërteton ose mohon diçka;
1.18. **Të dhënat relevante -** baza e të dhënave të cilat mbahen nga AKF-ja;
1.19. **Zinxhiri i ruajtjes -** zinxhiri i ruajtjes dhe evidentimit të dëshmisë fizike në rastin e pranim-dorëzimit të dëshmisë në AKF;
1.20. **Këshilli për cilësi, kualifikim dhe rikualifikim -** këshilli në nivel të AKF-së në përbërje të kryeshefit ekzekutiv, drejtorëve të departamenteve dhe menaxherit të cilësisë;
1.21. **Procedurat e brendshme teknike -** procedurat e brendshme shkencore të AKF-së.

Neni 4
Themelimi i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë

1. Agjencia e Kosovës për Forenzikë themelohet si agjenci e pavarur ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
2. Agjencia e Kosovës për Forenzikë është person juridik.
3. Agjencisë së Kosovës për Forenzikë i garantohet e drejta për veprimtari objektive dhe të paanshme.
4. Selia kryesore e AKF-së është në regjionin e Prishtinës.

Neni 5
Misioni

Misioni i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë është që përmes ushtrimit të veprimtarisë së saj, të ofroj shërbime forenzike cilësore në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet vendore dhe ndërkombëtare.

Neni 6
Parimet

1. Punonjësit e AKF-së duhet të respektojnë Kodin e etikës së AKF-së dhe parimet që parashihen me Kodin e mirësjelljes për nëpunësit civil.
2. Punonjësit e AKF-së, në përmbushje të detyrave të tyre, do të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 7
Simbolet

AKF ka stemën e cila propozohet nga Kryeshefi i AKF-së dhe miratohet nga ministri.

Neni 8
Kartela e identifikimit

1. Punonjësit e AKF-së janë të pajisur me kartelë identifikimi që shërben si autorizim për veprim në AKF-ë.
2. Forma, pajisja dhe mënyra e përdorimit të dokumentit të identifikimit rregullohet me një akt normativ që nxirret nga Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së.

Neni 9
Buxheti

AKF-ja është zë i veçantë buxhetor në kuadër të buxhetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Buxheti i AKF-së duhet të shqyrtohet dhe miratohet në procesin e rregullt buxhetor, në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Neni 10
Akreditimi

1. Laboratorët e AKF-së duhet të akreditohen dhe mirëmbahen sipas standardeve ndërkombëtare.
2. Procedurat për akreditim konform standardeve ndërkombëtare dhe afatet për akreditim do të rregullohen me udhëzim administrativ nga Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së.

Neni 11
Ministri

1. Kryeshefi i AKF-së i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt ministrit për administrimin dhe menaxhimin e AKF-së-së. Kryeshefi i AKF-së bashkëpunon me ministrin dhe i ofron atij informatat dhe raportet e nevojshme për administrimin dhe menaxhimin e AKF-së.
2. Në lidhshmëri me paragrafin 1. të këtij neni, informata qe ka të bëjë me çështje hetimore apo ndonjë ekspertizë, mund te ofrohet vetëm me urdhër te gjykatës kompetente apo prokurorisë.
3. Ministri mund të kërkoj raporte, informacione dhe dokumente të tjera, që lidhen me detyrat e AKF-së lidhur me administrimin dhe menaxhimin e AKF-së, duke mos ndërhyrë në veprimtarinë e AKF-së siç është paraparë ne paragrafin 2. të këtij neni.

KREU II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONET

Neni 12
Struktura organizative e AKF-së

Struktura e brendshme organizative e AKF-së propozohet nga Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së dhe miratohet nga ministri.

Neni 13
Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së

1. Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së është autoriteti ekzekutiv apolitik në kuadër të AKF-së dhe autoriteti më i lartë administrativ, teknik dhe operacional i AKF-së.
2. Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së është përgjegjës për:
   2.1. administrimin dhe menaxhimin e gjithmbarshëm te AKF-së;
   2.2. organizimin dhe punësimin e personelit, nxjerrjen e udhëzimeve administrative dhe marrjen e vendimeve për çështjet që i përkasin funksioneve të AKF-së;
   2.3. menaxhimin efektiv dhe efikas të resurseve që i janë besuar AKF-së.

Neni 14
Kriteret për emërim dhe përzgjedhja e Kryeshefit Ekzekutiv të AKF-së

1. Kriteret për emërim të Kryeshefit Ekzekutiv të AKF-së janë:
   1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
   1.2. të ketë diplomuar në një nga universitetet e pranuara dhe akredituara në fushat që kanë të bëjnë me shkencën e forenzikës;
   1.3. të ketë të paktën tri (3) vjet përvojë pune në pozitë menaxheriale në fushat që kanë të bëjnë me shkencën e forenzikës;
   1.4. të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale, me vendim të formës së prerë;
   1.5. të mos jetë ndëshkuar për shkelje të rënda disiplinore ekuivalente me shkeljet që përcaktohen në rregulloren e disiplinës së AKF-së, brenda dhjetë (10) viteve të fundit, gjatë të cilave ka punuar në institucione shtetërore;
   1.6. të mos ketë konflikt interesi me detyrën apo siç parashihet në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.
2. Ministri themelon një komision të veçantë për përzgjedhjen e Kryeshefit Ekzekutiv i cili duhet të jetë pesë (5) anëtarësh.
3. Komisioni nga paragrafi 2. i këtij neni, pas përzgjedhjes i propozon ministrit tre (3) kandidatë për Kryeshef Ekzekutiv të AKF-së. Ministri e emëron Kryeshefin Ekzekutiv bazuar në kandidaturat e propozuar nga komisioni.
4. Përbërja e komisionit si dhe procedura e përzgjedhjes rregullohet me akt nënligjor që nxirret nga ministri.

Neni 15
Mandati i Kryeshefit Ekzekutiv të AKF-së

1. Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së emërohet për një periudhë kohore prej pesë (5) vjetësh, me mundësi vazhdimi pas çdo pesë (5) vjetësh.
2. Nëse Kryeshefit Ekzekutiv të AKF-së i përfundon mandati në vitet kalendarike të zgjedhjeve të përgjithshme, atëherë qëndrimi i tij në detyrë do të zgjatet në mënyrë automatike për dy (2) vjet.

Neni 16
Lirimi dhe shkarkimi nga detyra i Kryeshefit Ekzekutiv të AKF-së

1. Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së lirohet apo shkarkohet nga detyra nga ministri për njërën nga arsyet e mëposhtme:
   1.1. është dënuar për vepër penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
   1.2. arrin moshën për pension;
   1.3. jep dorëheqje;
   1.4. për shkak të pamundësisë për ushtrimin e detyrës për një periudhë kohore më të gjatë se gjashtë (6) muaj;
2. Ministri i shqipton Kryeshefit Ekzekutiv të AKF-së, masat disiplinore vërejtje me shkrim apo shkarkim nga detyra, për njërën nga arsyet e mëposhtme:
   2.1. kryerja e një shkelje të rëndë të disiplinës, siç është e paraparë në rregulloren e disiplinës;

2.2. pas një vlerësimi negativ të dokumentuar të punës, për ndonjë shkelje të rregullave të integritetit apo mosrespektim i akteve nënligjore për disiplinën dhe personelin;
2.3. ka shfaqur mungesë të theksuar angazhimi, të argumentuar, në përmbushjen e objektivave strategjike dhe në kryerjen e detyrave sipas nenit 13 të këtij ligji.

3. Kur ekziston dyshim i arsyeshëm për të besuar se Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së, ka kryer vepër penale apo për ndonjërën nga arsyet e parapara në paragrafin 2. të këtij neni, ministri mund të suspendojë menjëherë Kryeshefin Ekzekutiv të AKF-së.
4. Në rastet e lirimit, shkarkimit apo suspendimit të Kryeshefit Ekzekutiv të AKF-së, ministri menjëherë emëron njërin nga drejtorët e departamenteve të AKF-së, si ushtrues detyrë të Kryeshefit Ekzekutiv deri në përzgjedhjen e Kryeshefit Ekzekutiv të AKF-së, jo më gjatë se gjashtë (6) muaj.

Neni 17
Gradat dhe funksionet e punonjësve të AKF-së

1. Personeli i AKF-së ndahet në tri (3) kategori të gradimit dhe funksioneve:
   1.1. personeli i specializuar- shkencor;
   1.2. personeli mbështetës;
   1.3. pozitat ekzekutive.
2. Procedurat dhe kushtet e gradimit do të rregullohen me një udhëzim administrativ që nxirret nga ministri me propozimin e Kryeshefit të AKF-së.

KREU III
KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E AKF-së

Neni 18
Veprimtaria e AKF-së

1. AKF kryen ekspertime të dëshmive, sipas kodit të procedurës penale dhe legjislacionit në fuqi.
2. AKF dëshmon në gjykatë apo prokurori ashtu siç është paraparë në Kodin e Procedurës Penale dhe legjislacionit në fuqi.
3. AKF-ja bazuar në kodin e procedurës penale del në vend të ngjarjes për asistencë në shikimin e vendit të ngjarjes.
4. AKF-ja bazuar në kodin e procedurës penale do të asistoj në rikonstruimin e vendit të ngjarjes.
5. AKF-ja përkrah ose ndihmon në hetimin e incidenteve në bazë të kërkesës së institucioneve shtetërore.
6. AKF në sisteme manuale apo sisteme të digjitalizuara, mban dhe mirëmban të dhëna relevante për qëllime krahasimore.
7. Administrimi i të dhënave relevante dhe shkëmbimi i tyre me agjenci apo institucione tjera brenda vendit si dhe aspekte tjera lidhur me të dhënat e personave do të rregullohen me udhëzim administrativ nga Kryeshefi i AKF-së, i cili duhet të jetë në përputhshmëri me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
8. Shkëmbimi i të dhënave të AKF-së me vendet tjera do të rregullohet përmes marrëveshjes ndërkombëtare në mes të MPB-së dhe autoriteteve të huaja

shtetërore, apo organizatave tjera të huaja.

9. AKF do të mbaj koleksion të armëve për qëllim të kryerjes së veprimtarisë së saj. Koleksioni i armëve do mbahet në përputhshmëri me Ligjin për Armët.
10. AKF përmes këshillit për cilësi, kualifikim dhe rikualifikim autorizon punonjësit shkencor për fillim dhe vazhdim të kryerjeve të ekspertimeve. Ky këshill merr vendime për cilësinë e shërbimeve shkencore në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e AKF-së.
11. Procedura dhe kushtet e funksionimit të këshillit për cilësi, kualifikim dhe rikualifikim do të rregullohen me një udhëzim administrativ që do të nxirret nga Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së.
12. AKF do të kryej hulumtime shkencore forenzike.
13. Procedurat dhe kushtet e hulumtimit, trajnimit dhe bashkëpunimit në fushën e forenzikës do të rregullohen me një udhëzim administrativ i cili do të nxirret nga Kryeshefi Ekzekutiv.

Neni 19
Administrimi i provave

1. Dëshmitë, respektivisht lëndët të cilat dërgohen për ekspertim në AKF, duhet të jenë të kompletuara. Lënda e kompletuar duhet të përmbaj urdhëresën për ekspertim, formularin/kërkesën e plotësuar të AKF-së për ekspertim, dëshmitë fizike që duhet ekzaminuar dhe zinxhirin e ruajtjes.
2. AKF është e obliguar që të kryej me kohë ekspertizën e dëshmisë dhe krahas dëshmisë, dosjes t'ia bashkëngjit raportin gjithëpërfshirës, në të cilin duhet të jepet mendimi profesional lidhur me ekspertizën e kryer.
3. AKF në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe agjencitë e tjera për zbatimin e ligjit do të përcaktojë procedurën për marrjen, dokumentimin, evidentimin, ruajtjen dhe transportimin e provave materiale.
4. Punonjësit e AKF-së janë të obliguar që ta ruajnë fshehtësinë dhe sekretin lidhur me ekspertizën e kryer. Personave të paautorizuar nuk u lejohet të nxjerrin në shesh, shpallin-publikojnë raportet, dokumentet apo veprimet tjera lidhur me ekspertimin e kryer, e as të japin deklarata për opinion pa lejen e autoriteteve kompetente.

KREU IV
TE DREJTAT E PERSONELIT DHE DISIPLINA

Neni 20
Të drejtat e punonjësve të AKF-së

1. Punonjësit e AKF-së kanë të drejtë për punësim të përhershëm deri në plotësimin e kushteve për pensionim, me përjashtim të individëve të cilët janë të punësuar në bazë të kontratës për shërbim për një periudhë fikse, si dhe atyre që shkarkohen me arsye, në bazë të legjislacionit në fuqi.
2. Paga bazë, rritjet në paga, shtesat dhe dobitë e tjera përfshirë edhe skemën e pensionit dhe sigurimin për punonjësit e AKF-së do të përcaktohen me udhëzim

administrativ nga ministri, ku do të përfshijnë shtesat por nuk kufizohen në pagesa për rrezikshmërinë në punë, pagesa për punë jashtë orarit dhe gjatë festave, pagesa për shujtë ditore, pagesa për veshmbathje, pagesa për detyrat speciale dhe shkathtësitë speciale.

3. Punonjësit e AKF-së të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i ndonjë veprimi disiplinor, përfitojnë si shpërblim 50% të pagës së rregullt mujore dhe atë vetëm një herë në vit.
4. Në rast të vdekjes në detyrë apo nëse një punonjës i AKF-së është vrarë për shkak të ushtrimit të detyrave të tij në kuadër të AKF-së, ministria do t'i paguajë familjes së punonjësit të ndjerë apo trashëgimtarit(ve) ligjor të tij pagën mujore të punonjësit të AKF-së, për një periudhë kohore prej një (1) viti nga vdekja e punonjësit te AKF-së.
5. Procedura, kushtet e punësimit dhe të punës për punonjësit e AKF-së rregullohen me udhëzim administrativ të nxjerrë nga Kryeshefi i AKF-se, që përfshin por nuk do të kufizohet në ngritjen në karrierë, trajnimin dhe konfliktin e interesit.
6. Punonjësit e AKF-së nuk kanë të drejtë greve apo çdo veprim tjetër që pengon apo ndërhyn në ushtrimin e veprimtarisë së AKF-së.
7. Punonjësit e AKF-së nuk duhet të shprehin qëndrime apo të ndërmarrin aktivitete që cenojnë natyrën e depolitizuar të AKF-së.

Neni 21
Pushimet e punës

Pushimet e punës të punonjësve të AKF-së rregullohen me një udhëzim administrativ që nxirret nga Kryeshefi Ekzekutiv.

Neni 22
Disiplina në AKF

Masat, shkeljet disiplinore, suspendimi si dhe procedura disiplinore për punonjësit e AKF-së, rregullohen me udhëzim administrativ nga ministri.

KREU V
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 23
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Për zbatimin e këtij ligji, ministri do të miraton aktet nënligjore për të përcaktuar:
   1.1. stemën identifikuese të AKF-së;
   1.2. strukturën organizative të AKF-së;
   1.3. procedurën e vlerësimit për punonjësit e AKF-së;
   1.4. përcaktimin e pagës bazë, rritjet në pagë, shtesat dhe dobitë tjera për punonjësit e AKF-së;
   1.5. procedurën dhe kushtet e punësimit dhe të punës për punonjësit e AKF-së;
   1.6. procedurën për shkeljet disiplinore, suspendimin si dhe procedurën disiplinore për punonjësit e AKF-së;

1.7. procedurat dhe kushtet e gradimit dhe pozitave në kuadër të AKF-së.
1.8. Për zbatimin e këtij ligji, Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së, do të miraton aktet nënligjore për:
1.9. formën, pajisjen dhe mënyrën e përdorimit të dokumentit të identifikimit;
1.10. procedurat shkencore për akreditim konform standardeve ndërkombëtare dhe afatet për akreditim;
1.11. procedurën për administrimin e të dhënave relevante dhe shkëmbimi i tyre me agjenci apo institucione tjera brenda vendit si dhe aspekte tjera lidhur me të dhënat relevante;
1.12. procedurën për sigurinë e të dhënave;
1.13. procedurën e funksionimit të këshillit për cilësi, kualifikim dhe rikualifikim;
1.14. procedurat dhe kushtet e hulumtimit, trajnimit dhe bashkëpunimit në fushën e forenzikës;
1.15. pushimet nga marrëdhënia e punës për punonjësit e AKF-së.

2. Punonjësit e ish-Laboratorit të Forenzikës –Policia e Kosovës që do të vazhdojnë të punojnë në AKF, gëzojnë të drejtën e stazhit të fituar në Policinë e Kosovës.
3. Punonjësit aktual të uniformuar dhe civil të ish-Laboratorit të Forenzikës-Policia e Kosovës kanë të drejtë që përmes një deklarimi vullnetarë të zgjedhin vazhdimin e punës në kuadër të AKF apo të kthehen në kuadër të strukturave të Policisë së Kosovës.
4. Punonjësit aktual të uniformuar të ish-Laboratorit të Forenzikës-Policia e Kosovës gëzojnë të drejtën e kthimit në gradën aktuale në kuadër të Policisë së Kosovës ashtu siç është paraparë në Ligjin për Policinë.
5. Për zbatimin e këtij ligji mund të nxirren edhe akte tjera nënligjore nga Ministri apo Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së.

Neni 24
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi te këtij ligji shfuqizohen të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me të.

Neni 25
Hyrja në fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-064
14 tetor 2011

Shpallur me dekretin Nr. DL-042-2011, datë 01.11.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 25 / 14 NËNTOR 2011, PRISHTINË

TË DREJTAT E NJERIUT

LIGJI Nr. 02/L-31
PËR LIRINË FETARE NË KOSOVË

Kuvendi i Kosovës,

Në mbështetje të Kreut 3.1, 3.2, 5.7 dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr 2001/09 datë 15 maj 2001), si dhe në standardet për të drejtat dhe liritë e njeriut të rregulluara me deklarata dhe konventa ndërkombëtare dhe rajonale, nën kompetencën e Këshillit të Evropës;

Duke u nisur nga fakti se liria e besimit është një prej të drejtave themelore të njeriut, dhe një prej parimeve dhe standardeve të pranuara ndërkombëtarisht mbi lirinë e të shprehurit, vetëdijes dhe përcaktimit fetar;

Duke e siguruar të drejtën e secilit, pa u diskriminuar në çfarëdo baze dhe me barazi të plotë para ligjit, për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit, pavarësisht nga bindja fetare apo vetëdija;

Duke u nisur nga tradita e jetës së përbashkët fetare në Kosovë;

Të vetëdijshëm për trashëgiminë tonë dhe vlerat tradicionale të tolerancës, jetës së përbashkët, dhe karakterit multikonfesional në Kosovë;

Duke u përpjekur të përkufizohen dispozita juridike unike të cilat do t'u siguronin bashkësive fetare të drejta dhe detyrime të barabarta, pa kurrfarë diskriminimi;

Duke e çmuar të rëndësishëm përparimin e mëtejmë të mirëkuptimit të ndërsjellë, të tolerancës dhe të respektimit të së drejtës për lirinë e shprehjes, ndërgjegjes dhe besimit fetarë,

Miraton:

LIGJIN PER LIRINË FETARE NË KOSOVË

Neni 1
Liria Fetare

1.1. Çdo njëri ka të drejtë të gëzojë lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetarë. Kjo e drejtë përfshinë lirinë për të pasur ose për të mos pasur fe, për të mbajtur apo për të ndërruar fenë ose besimin, dhe lirinë për të manifestuar fenë ose

besimin, qoftë si individ ose në bashkësi me të tjerët, publikisht ose privatisht, përmes adhurimit, predikimit, praktikimit dhe ceremonive.

1.2. E drejta për lirinë fetare dhe të besimit përfshinë, mes tjerash, edhe liritë në vijim:
   a) Lirinë e adhurimit ose tubimit në lidhje me një fe ose besim, dhe krijimin dhe mirëmbajtjen e vendeve për këto qëllime;
   b) Lirinë për të themeluar dhe qeverisur institucione humanitare dhe bamirëse;
   c) Lirinë për të prodhuar, siguruar dhe për të përdorur, gjësende dhe materiale të nevojshme për kryerjen e riteve ose zakoneve të fesë ose besimit;
   d) Lirinë e shkrimit, nxjerrjes dhe shpërndarjes së publikimeve relevante në këto lëmi;
   e) Lirinë për mësim të një feje apo besimi në vendet e destinuara për këto qëllime;
   f) Lirinë për të kërkuar dhe pranuar kontribute financiare dhe kontribute të tjera vullnetare nga individët dhe institucionet;
   g) Lirinë për t'u aftësuar, emëruar, zgjedhur ose caktuar pasardhës, sipas kushteve dhe standardeve të religjionit ose besimit përkatës;
   h) Lirinë e respektimit të ditëve të pushimit dhe festimit të festave dhe ceremonive sipas normave fetare të fesë ose besimit përkatës;
   i) Lirinë e krijimit dhe ruajtjes së komunikimit me individë dhe bashkësi për çështjet e fesë dhe besimit në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar.

1.3 Liria për të manifestuar fenë ose besimin duhet t'iu nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve që janë të parashkruara me ligj dhe janë të domosdoshme në shoqërinë demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit dhe moralit, dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të të tjerëve.

Neni 2
Mbrojtja nga Diskriminimi

2.1. Askush nuk duhet të jetë i diskriminuar ose i privilegjuar në çfarëdo mënyre në bazë të besimit fetarë, përkatësisë ose jopërkatësisë së një Bashkësie fetare, ose për kryerjen e ceremonive dhe ritualeve fetare.

2.2. Askush nuk duhet të pengohet ose të detyrohet të marrë pjesë në ceremonitë fetare, ose në forma të tjera të manifestimit të besimit fetar.

Neni 3
Barazia Fetare

Të gjithë personat, pavarësisht nga besimi ose bindja e tyre, pavarësisht nga përkatësia në ndonjë bashkësi fetare ose pjesëmarrja në ndonjë ceremoni fetare janë të barabartë para ligjit dhe gëzojnë të drejta të njejta në jetën civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Të gjithë personat juridik dhe fizik gëzojnë mbrojtje të njejtë para ligjit.

Neni 4
Mbrojtja me Kodin Penal

4.1. E drejta për të manifestuar fenë ose besimin nuk mund të abuzohet nëpërmjet nxitjes, ngacmimit, ose provokimit të jo tolerancës ose urrejtjes nacionale, fetare ose racore, duke kërcënuar të drejtën për të jetuar, të drejtën për shëndet fizik dhe mendor, të drejtat për fëmijë ose të drejtën për të respektuar integritetin privat dhe familjarë.
4.2. Sulmi ndaj çfarëdo zyrtari fetar, shkatërrimi ose dëmtimi i ndonjë vendi ose objekti fetarë, ose prone tjetër e ndonjë Bashkësie fetare, ashtu si edhe ndonjë akt ose aktivitet që ka për qëllim të shkaktojë, nxis, ose provokojë urrejtje fetare, është i ndëshkueshëm në bazë të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

Neni 5
Neutraliteti fetar

5.1. Nuk do të ketë asnjë fe zyrtare.
5.2. Bashkësitë fetare janë të ndara nga autoritetet publike.
5.3. Të gjitha autoritetet publike duhet të kenë parasysh tolerancën dhe respektin e ndërsjellë ndërmjet feve.
5.4. Të gjitha besimeve dhe bashkësive të tyre në Kosovë duke përfshirë Bashkësinë Islame të Kosovës, Kishën Ortodokse Serbe, Kishën Katolike, Bashkësinë e Besimit Hebrej, dhe Kishën Evangjeliste, do t'u ofrohet çdo lloj mbrojtjeje dhe mundësi për të gëzuar të drejtat dhe liritë e parashikuar me këtë Ligj.
5.5. Duke pasur parasysh kontributin specifik dhe identitetin e tyre në shoqëri, autoritetet publike duhet të mbajnë dialog të hapur, të rregullt dhe transparent me shoqatat fetare, Bashkësitë fetare për çështjet me interes të përbashkët.

Neni 6
Liria e bashkimit fetar

6.1. Liria e bashkimit për qëllime fetare është e garantuar në bazë të ligjit në fuqi të Kosovës.
6.2. Ndalohet formimi i një shoqate fetare e cila për nga emri ose statuti sugjeron që është zyrtarisht e lidhur ose e njohur nga një Bashkësi fetare, por që nuk e ka pëlqimin e së njëjtës.

Neni 7
Vetë përcaktimi dhe vetë rregullimi

7.1. Bashkësitë Fetare janë të lira që të përcaktojnë identitetin e tyre fetar.
7.2. Bashkësitë Fetare e rregullojnë dhe administrojnë në mënyrë të pavarur organizimin e tyre të brendshëm.
7.3. Bashkësitë fetare lirisht mund të themelojnë dhe komunikojnë me individë dhe komunitete në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, ashtu si edhe të formojnë shoqata me bashkësitë dhe grupe të tjera fetare në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në pajtim me ligjin në fuqi.

Neni 8
Vendet e Kultit

8.1. Ndërtesat dhe objektet që u takojnë bashkësive fetare, që janë të dedikuara për kryerjen e ceremonive fetare konsiderohen të pacenueshme për sa i përket ndërhyrjes së autoriteteve qeveritare, përveç nëse ndonjë urdhër gjyqësor është lëshuar si pasojë e aktiviteteve ilegale ose në rast të rrezikut të afërm për jetën ose shëndetin.
8.2. Qasja e lirë nga ana e pelegrinëve, mysafirëve dhe personave të cilët jetojnë përherë ose përkohësisht në institucionet ose objektet fetare duhet garantuar. Ky detyrim merret parasysh gjatë zbatimit të dispozitave që kanë të bëjnë me çështjet e qëndrimit dhe udhëtimit.
8.3. Mundësia që bashkësitë fetare të kufizojnë qasjen në vendet e tyre, në kuadër të kornizës për vetë administrim, është e garantuar sipas standardeve ndërkombëtare.

Neni 9
Arsimimi Fetar

9.1. Bashkësitë fetare kanë të drejtë të themelojnë institucione arsimore për nevojat e tyre në pajtim me ligjin në fuqi.
9.2. Ligji për Arsimin e Lartë rregullon çështjen e studimeve teologjike në universitete.
9.3. Shkollat e udhëhequra nga bashkësitë fetare qeverisën në bazë të aplikimit neutral të ligjit përkatës sikurse shkollat tjera private.
9.4. Çdo njëri ka të drejtë të zgjedhë ose të mos e zgjedh arsimin fetar sipas bindjeve dhe besimit personal. Prindërit ose kujdestarët e tjerë ligjorë janë të thirrur t'i përcaktojnë udhëzimet fetare dhe etike për fëmijët e tyre sipas bindjeve ose besimeve të tyre.
9.5. Arsimi fetar dhe edukimi i të miturve nuk guxon të dëmtojë zhvillimin ose shëndetin e tyre fizik ose mendor.

Neni 10
Liria për Informim

10.1. Bashkësitë fetare, dhe institucionet e tyre kanë të drejtë, në kuadër të Kushtetutës dhe ligjit, që të publikojnë informata duke përdorur të gjitha format e mediave.
10.2. Bashkësitë fetare detyrohen që qartë të shënojnë emrin e plotë të tyre në çfarëdo botimi, reviste dhe materiale të tjera fetare, si edhe në korrespondenca dhe shpallje publike të aktiviteteve të tyre.
10.3. Bashkësitë fetare gëzojnë qasje të barabartë në mediat publike.

Neni 11
Këshillimet Fetare

11.1. Me qëllim të realizimit të lirive fetare, autoritetet publike duhet të marrin masa që të garantojnë disponueshmërinë për këshillime fetare në spitale, në vendet për paraburgim ose burgje, si dhe në institute për kujdesje sociale.
11.2. Shërbyesit fetarë janë të liruar nga detyrimi për të dëshmuar në procedura para autoriteteve publike dhe gjykatave në lidhje me çfarëdo fakti ose rrethanash që ata kanë mësuar gjatë kryerjes së këshillimit të tyre fetarë.

Neni 12
Çështjet Financiare

12.1. Çështjet që kanë të bëjnë me detyrimet, tatimet dhe pagesat doganore, në lidhje me Bashkësitë fetare, qeverisen në bazë të ligjit në fuqi.

12.2. Institucionet e Bashkësive fetare lirohen nga tatimi ose kontributet e tjera të përgjithshme, për rastet si vijon:

a) vendet e kultit, pronat e tjera ose pjesët e pronës së Bashkësive fetare që kanë si qëllim të tyre të drejtpërdrejtë realizimin e bindjeve ose besimeve fetare, përfshirë qëllimet bamirëse dhe për mirëqenie;

b) aktivitetet që kanë si qëllim të posaçëm dhe të drejtpërdrejtë të tyre realizimin e bindjeve ose besimeve fetare, përfshirë qëllimet bamirëse dhe për mirëqenie; dhe

c) seminaret ose organizime të tjera për trajnimin e shërbyesve ose mësimdhënësve fetarë të arsimit fetar.

12.3. Bashkësitë fetare mbajnë të drejtën e pronësisë, posedimit, dhe gëzimit të institucioneve të tyre, donacioneve, objekteve të shenjta, dhe të fondeve që dedikohen për adhurim, mësim, dhe mirëqenie.

12.4. Bashkësitë fetare mund të pranojnë financim përmes të hyrave nga pronat e tyre, nga trashëgimia dhe dhuratat, nga kontributet bamirëse dhe të tjera vullnetare, si dhe nga kryerja e aktiviteteve të tjera të pajtim me ligjin në fuqi.

Neni 13
Përfitimet Sociale

13.1. Shërbyesit fetarë të bashkësive fetare i realizojnë të drejtat nga sigurimi pensional dhe sigurimi shëndetësor dhe të drejtat e tjera në bazë ligjit në fuqi.

13.2. Bashkësitë fetare, për realizimin e punëve të tyre fetare, mund të hyjnë në marrëdhënie juridike dhe të lidhin kontratë për punë me personel fetarë dhe me punëtorë të tjerë. Personeli fetar dhe punëtorët e tjerë, me të cilët bashkësia fetare ka lidhur kontratë për punë, i realizojnë të drejtat nga marrëdhënia e punës dhe në bazë të punës së kryer, sikurse edhe të punësuarit e tjerë.

13.3. Vijuesit e rregullt të shkollave fetare dhe të fakulteteve fetare për përgatitjen e personelit fetar i realizojnë të drejtat për mbrojtje shëndetësore, shtesat për fëmijë, sigurimin pensional dhe invalidor, të drejtat për asistencë sociale dhe të drejtat në trafik publik nën kushtet dhe në mënyrën e njëjtë siç i realizojnë vijuesit e shkollave dhe fakulteteve publike.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

24.08.2006
UNMIK/REG/2006/48

GAZETA ZYRTARE E INSTITUCIONEVE TË PËRKOHSHME TË VETË-QEVERISJES NË KOSOVË / PRISHTINË :VITI II / NR. 11 / 01 PRILL 2007

LIGJI Nr. 2004/3
KUNDËR DISKRIMINIMIT

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 1062
Kreu II: Procedura dhe sanksionet 1065
Kreu III: Organet për promovimin trajtimit të barabartë 1067
Kreu IV: Dispozitat kalimtare dhe të fundit 1067

Kuvendi i Kosovës

Duke u bazuar në Rregulloren nr. 2001/9, të datës 15 maj 2001, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, posaçërisht në dispozitat e Kreut 3.1, 3.2 dhe 5.7 dhe më tutje,

Duke patur parasysh rëndësinë e përkrahjes së bashkëjetesës, mbrojtjes të së drejtave të njeriut, përfaqësimit të drejtë të popullit të Kosovës në procesin e ngritjes dhe zhvillimit të institucioneve demokratike të vetëqeverisjes, sigurimin e trajtimit të barabartë dhe duke siguruar që nxjerrja e rregullave mbi këto çështje të jetë në përputhje me standardet dhe normat përkatëse Europiane dhe ndërkombëtare,

Miraton:

LIGJIN KUNDËR DISKRIMINIMIT

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, ngritja e shkallës së barazisë efektive dhe realizimi i parimit të trajtimit të barabartë të personave në Kosovë para Ligjit.

Neni 2
Parimet

Rregullimi i çështjeve që kanë të bëjnë me mosdiskriminimin mbështetet në këto parime:

a) Parimin e trajtimit të barabartë që nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë

diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj personit, në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paaftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religjionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale, racës, pronës, lindjes ose statuseve tjera;

b) Parimin e përfaqësimit të drejtë të të gjithë personave dhe të të gjithë anëtarëve të komuniteteve lidhur me punësim në kuadër të organeve publike në të gjitha nivelet.

c) Parimin e mirëkuptimit dhe tolerancës ndëretnike të personave në Kosovë.

Neni 3
Termet

Për qëllimet e nenit 2.a, termet në vijim kanë këto kuptime:

a) Diskriminimi i drejtpërdrejt nënkuptohet kur një person trajtohet, është trajtuar, ose do të trajtohet në mënyrë të pabarabartë në krahasim me tjetrin, duke u bazuar në një apo më shumë nga bazat e përshkruara nën 2 a;

b) Diskriminimi i tërthortë nënkuptohet kur nga bazat e përshkruara nën 2 a, një dispozitë, kriter apo praktikë e paanshme në shikim të parë e vënë personin në pozitë të pabarabartë krahasuar me të tjerë, duke u bazuar në një apo më shumë nga bazat që e ndalojnë diskriminimin, përveç në rastet kur dispozita e tillë, praktika apo kriteri mund të arsyetohet në pikëpamje objektive me një qëllim legjitim dhe me mjete legjitime, të domosdoshme për arritjen e qëllimit;

c) Ngacmimi konsiderohet diskriminim, brenda kuptimit të nenit 2 a, kur një sjellje kundër dëshirës (që përfshin por nuk kufizohet në sjellje të natyrës së padëshirueshme seksuale dhe/apo psikologjike) dhe që bazohet në një apo më shumë nga bazat e përshkruara nën nenin 2 a, e cila ka për qëllim apo ndikim në shkeljen e dinjitetit të personit dhe krijimin e ambientit frikësues, armiqësor, degradues, nënçmues dhe fyes, si është përcaktuar nga ai person;

d) Të udhëzuarit për të diskriminuar personat e tjerë, sipas bazave të përcaktuara në nenin 2 a, do të konsiderohet diskriminim në vështrim të nenit 2 a;

e) Viktimizimi konsiderohet diskriminim brenda kuptimit të nenit 2 a, dhe i cili konsiderohet se ndodhë kur personi përjeton trajtim të hidhur apo pasoja të hidhura si reagim ndaj ankimit apo procedurës, të vëna në lëvizje me qëllim të vënies në jetë të parimit të trajtimit të barabartë ashtu si është definuar nën 2.a, dhe / ose rastet kur personi i tillë ofron informacione, dëshmi apo ndihmë tjetër në lidhje me ankesën ose procedurën.

f) segragacioni do të konsiderohet diskriminim brenda kuptimit të nenit 2a, i cili ndodhë në rastet kur një ose disa persona veçohen nga tjerët përmes personave fizik, juridik, ose me kombinimin e dyjave, nga sektori publik, privat apo nga dy sektorët, dhe si i tillë bazohet në njërën ose në disa baza e përmendura nën 2 a, përveç në rastet kur veçimi i tillë është në baza të arsyeshme dhe objektive dhe mënyra për arritjen e atij qëllimi është i nevojshëm dhe proporcional.

Neni 4
Fusha e zbatimit të ligjit

Ky ligj zbatohet ndaj të gjitha veprimeve dhe mosveprimeve të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, përfshirë këtu edhe organet publike, të cilat cenojnë të drejtat e personit/ve fizik dhe juridik, në fushat si vijon:

a) kushteve për qasje në punësim, vetë punësim dhe të punësimin në profesion, përfshirë këtu kushtet e punësimit dhe kriteret e përzgjedhjes, pa marrë parasysh aktivitetin në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale dhe avansimimet;
b) qasje në të gjitha llojet dhe nivelet e udhëheqjes profesionale, trajnimeve profesionale, trajnimit të avancuar profesional dhe rikualifikimet përfshirë edhe përvojën e punës praktike;
c) kushtet e punësimit dhe kushtet e punës, përfshirë shkarkimin nga puna dhe pagesën;
d) anëtarësimin dhe përfshirjen në organizata të punëtorëve ose të punëdhënësve ose të çdo organizate tjetër anëtarët e së cilës ushtrojnë një profesion të caktuar, përfshirë edhe fitimet që mundësohen nga organizatat e tilla;
e) mbrojtja sociale, përfshirë skemën e ndihmës sociale, sigurimin social dhe mbrojtjen shëndetësore;
f) lehtësitë sociale, përfshirë ndër të tjera edhe ndihmën humanitare;
g) arsimin;
h) qasje në vendbanim dhe format e tjera të pronës (luajtshme dhe pa paluajtshme);
i) qasje në furnizim e të mirave materiale dhe shërbimeve të cilat janë në dispozicion të opinionit publik;
j) trajtimi i drejtë para Gjykatave dhe të gjitha organeve tjera që administrojnë drejtësinë;
k) sigurinë personale;
l) pjesëmarrjen në çështjet publike, përfshirë të drejtën për të zgjedhë dhe të drejtën për të qenë i zgjedhur;
m) qasja në vendet publike dhe
n) çfarëdo të drejte tjetër të paraparë me legjislacionin në fuqi;

Neni 5
Kërkesat reale dhe përcaktuese me rastin e punësimit

Pavarësisht nga nenet 2 a, 3a dhe 3 b, nuk konsiderohet diskriminim dallimi në trajtim i cili bazohet në dallimet e dhëna në bazat nën 2 a, mirëpo i cili si i tillë paraqet karakteristikën reale dhe përcaktuese me rastin e punësimit, qoftë për shkak të natyrës së aktiviteteve profesionale ose të vetë kontekstit në të cilin kryhen punët e caktuara profesionale, me kusht që qëllimi të jetë legjitim e kërkesat proporcionale me qëllimin.

Neni 6
Masa afirmative

6.1. Për sigurimin e barazisë së plotë në praktikë, masat për parandalimin apo kompensimin për disavantazhet e lidhura me bazat e dhëna nën 2 a, nuk konsiderohet diskriminim, me kusht që kjo të jetë në pajtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

6.2. Të gjithë personat që ushtrojnë funksione publike duhet të sigurojnë se palët të cilave u japin kontratën publike, huan, dhuratën, ose ndonjë përfitim tjetër përpilojnë një dokument i cili tregon se ato janë në pajtim me këtë ligj, dhe se të promovojnë dhe respektojnë politikën e mosdiskriminimit gjatë tërë kohës së ekzekutimit të detyrimeve.

6.3. Nëse pala e cila pranon kontratë publikë, hua, kontribut financiar ose përfitime tjera të përmendura në nenin 6.2, shkel cilëndo nga dispozitat e këtij ligji, kontrata publike, hua, kontribut financiar ose përfitimet tjera, shpallen të pavlefshme nga organi që i ka dhënë.

KREU II
PROCEDURA DHE SANKSIONET

Neni 7
Procedura

7.1. Çfarëdo ankese për diskriminim sipas këtij ligji do të vendoset apo gjykohet në pajtim me ligjin në fuqi nga organet administrative dhe gjykatat kompetente të cilat kanë juridiksion për çështjet konkrete të përfshira në ankesë.

7.2. Organet administrative dhe Gjykata veprojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji për të vendosur lidhur me një parashtresë.

7.3. Pas kompletimit të procedurës së ankesës për diskriminim sipas ligjit në fuqi mbi procedurat e përgjithshme administrative, ankuesi i pakënaqur mund të paraqesë ankesë në pajtim me Kapitullin e titulluar "Dispozita të veçanta" në ligjin mbi kontestet administrative në gjykatën e cila është kompetente sipas ligjit në fuqi.

7.4. Çdo procedurë e ndërmjetësimit ose pajtimit të cilat i parasheh legjislacioni në fuqi, mund të shfrytëzohen sipas zgjedhjes së parashtruesit/ve të kërkesës, për të adresuar shkeljet në bazë të këtij ligji.

7.5. Shfrytëzimi i procedurave të parapara nën 7.4, nuk e përjashton mundësinë e paraqitjes së kërkesës-ankesës para organit administrativ apo Gjykatës kompetente.

7.6. Shoqatat, organizatat apo subjektet tjerë juridik mund të inicojnë apo përkrahin procedura ligjore në emër të parashtruesit/ve, me marrjen e pëlqimit e tyre, për zhvillimin e procedurave administrative apo gjyqësore të parapara për zbatimin e obligimeve nga ky ligj.

Neni 8
Barra e provave

8.1. Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin faktet para organit administrativ apo Gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

8.2. Paragrafi 8.1 nuk ndalon zbatimin e rregullave të dëshmimit të cilat janë të favorshme për palën paditëse. Paditësi mund të mbrojë rastin e tij të diskriminimit edhe me metoda te tjera përfshirë edhe shfrytëzimin e dëshmive statistikore.

Neni 9
Sanksionet

9.1. Gjykata kompetente ose organi administrativ që ka konstatuar se është bërë shkelje e këtij ligji mund të shqiptojë sanksione varësisht nga natyra dhe lloji i shkeljes si dhe ndikimi i saj në viktimën apo viktimat.

9.2. Sanksionet e parapara me vendimin e organit kompetent ndaj personit fizik dhe juridik të cilët cenojnë dispozitat e këtij ligji përfshijnë:

a) Kompensimin për dëmin material dhe moral i shkaktuar nga cenimi i dispozitave të këtij ligji, përfshinë kthimin e të drejtave dhe masat e tjera të parapara me legjislacionin në fuqi, e të cilat organi kompetent i vlerëson si të përshtatshme.

b) Çdo personi fizik dhe juridik ose kombinim i tyre, i cili ka cenuar dispozitat e këtij ligji, i shqiptohet dënimi me gjobë në bazë të natyrës dhe shkalles së shkeljes, si në vijim:
   (i) personi fizik, prej 500 deri 1.000 euro;
   (ii) kontraktuesi i pavarur, prej 1.000 deri 5.000 euro;
   (iii) personat juridik, prej 1.000 deri 10.000 euro;
   (iv) personi fizik brenda personit juridik i cili është përgjegjës për shkelje prej 500 deri 2.000 euro;
   (v) personi i cili ushtron funksion publik i cili është përgjegjës për shkelje prej 500 deri 2.000 euro;

9.3. Gjykata mund të shqiptojë edhe urdhëresa të tjera sipas vlerësimit të saj.

9.4. Të gjitha mjetet e grumbulluara nga shqiptimi i dënimeve me gjobë nën 9.2 b, grumbullohen në një fond të veçantë, i cili do të dedikohet për ndihmën juridike falas personave fizik dhe juridik, të cilët ankohen se i është shkelë e drejta në trajtim të barabartë e paraparë me këtë ligj.

9.5. Mjetet e grumbulluara nga gjobat e parapara nën 9.2 b, do të administrohen nga një organ i caktuar administrativ apo Gjyqësor, deri në themelimin e Qendrës për Trajtim të Barabartë.

9.6. Shqiptimi i cilit do sanksion që parashihet me këtë ligj nuk përjashton shqiptimin e ndonjë ligji tjetër që është në fuqi në Kosovë.

KREU III
ORGANET PËR PROMOVIMIN TRAJTIMIT TË BARABARTË

Neni 10
Organi ekzistues

Organ i autorizuar për pranimin dhe hetimin e ankesave që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave në baza diskriminuese është Ombudspersoni i Kosovës, i cili do t'i shqyrtojë rastet në përputhje me autorizimet dhe përgjegjësitë që ka sipas legjislacionit në fuqi.

KREU IV
DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 11

11.1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushojnë të zbatohen të gjitha ligjet e mëparshme nga kjo fushë.
11.2. Dispozitat e legjislacionit që do të nxirren dhe dispozitat në fuqi lidhur me mbrojtjen e parimit të trajtimit të barabartë vlejnë dhe duhet të zbatohen edhe më tutje nëse janë më të favorshme se dispozitat e këtij ligji.

Neni 12
Zbatimi i Ligjit

12.1. Asnjë nga dispozitat e këtij ligji nuk mund të interpretohet sikur i jep Institucionit të Përkohshëm të Vetëqeverisjes në Kosovë, një grupimi apo një individi, çfarëdo të drejte që të ndërmarrë një veprimtari ose të kryejë një akt që ka për qëllim zhdukjen e të drejtave ose të lirive të njohura me legjislacionin në fuqi, ose kufizime më të gjëra të këtyre të drejtave se ato të parashikuara në legjislacionin në fuqi.
12.2. Kufizimet që në bazë të këtij ligji, u bëhen të drejtave dhe lirive të lartpërmendura mund të zbatohen vetëm për qëllimin për të cilin janë parashikuar.
12.3. Qeveria e Kosovës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji mund të nxjerr akte përkatëse nënligjore.

Neni 13
Hyrja në fuqi

13.1. Ky ligj hyn në fuqi 30 ditë pas miratimit nga Kuvendi dhe shpalljes nga PSSP-ja.
13.2. Menjëherë pas shpalljes së këtij Ligji nga PSSP-ja, Qeveria udhëheq një program për vetëdijesimin e publikut lidhur me këtë Ligj.

20.08.2004
UNMIK/REG/2004/32

LIGJI Nr. 03/L-215
PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 1068
Kreu II: Trajtimi i kërkesave 1069
Kreu III: Refuzimet e qasjes në dokumente 1072
Kreu IV: Dokumentet e publikuara me iniciativë të institucioneve publike 1074
Kreu V: Organi i pavarur për qasje në dokumente publike 1075
Kreu VI: Zbatimi 1075
Kreu VII: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 1077

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJI PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuara nga institucionet publike.

Neni 2
Fushëveprimi

1. Ky ligj zbatohet për të gjitha dokumentet që mbahen, hartohen apo pranohen nga institucionet publike.
2. E drejta për qasje në dokumente realizohet në pajtim me këtë ligj, pa paragjykuar dispozitat e ligjeve, si dhe të instrumenteve ligjore ndërkombëtare, të cilat njohin të drejta më të gjëra, për qasjen në dokumente publike.
3. Ky ligj nuk cenon të drejtën e qasjes në dokumente publike që mbahen nga institucionet, e të cilat mund të rrjedhin nga instrumentet ligjore ndërkombëtare apo aktet e institucioneve të cilat i zbatojnë ato.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. Institucionet publike - institucionet dhe organet e pushtetit shtetëror në vijim:
      1.1.1. Qeverinë dhe administratën në nivelin shtetëror, rajonal dhe lokal;
      1.1.2. institucionet ligjvënëse dhe gjyqësore, me kusht që kryejnë funksione administrative, sipas ligjeve të Republikës së Kosovës;
      1.1.3. personat fizik apo juridik, me kusht që të ushtrojnë autoritet administrativ, kryejnë detyra publike, apo operojnë me fonde publike sipas ligjeve të Republikës së Kosovës (bartësit privat të kompetencave publike);
      1.1.4. institucionet ligjvënëse lidhur me aktivitetet e tjera të tyre;
      1.1.5. institucionet gjyqësore lidhur me aktivitetet e tjera të tyre, dhe
      1.1.6. institucionet e pavarura të përcaktuara në ose të themeluara sipas Kapitullit XII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
   1.2. **Dokument publik** - çdo dokument zyrtar.
   1.3. **Dokument zyrtar -** duke përfshirë por duke mos u kufizuar, të gjitha informatat e regjistruara në çfarëdo forme, të hartuara apo pranuara dhe mbajtura nga institucionet publike. Dokument zyrtar është çdo shkresë zyrtare që shërben për të dëshmuar ose për të vërtetuar diçka, pa marrë parasysh formën e saj fizike apo karakteristikat, tekstin e shkruar apo të shtypur, hartat, skemat, fotografitë, vizatimet, skicat, materialet punuese, si dhe incizimet tingullore, të zëshme, magnetike apo elektronike, incizimet optike apo video incizimet në çfarëdolloj forme, si dhe pajisje bartëse për përpunim automatik të të dhënave me memorie të instaluara apo bartëse për arkivimin e të dhënave në formë digjitale (në tekstin e mëtejmë: dokument).
   1.4. **Kërkuesi i dokumentit -** çdo person fizik apo juridik, pa diskriminim në çfarëdo lloj baze, në mënyrë dhe nën kushte të përcaktuara me këtë ligj dhe ligj tjetër (në tekstin e mëtejmë: kërkuesi).
   1.5. **Avokati i Popullit -** institucionin e pavarur, të themeluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

KREU II
TRAJTIMI I KËRKESAVE

Neni 4
E drejta e qasjes në dokumente

1. Çdo kërkues i dokumentit, ka të drejtë në qasje të dokumenteve të institucioneve publike, duke iu përmbajtur parimeve, kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara me ligj.
2. Dokumentet janë të hapura për publikun në bazë të kërkesës së drejtpërdrejt, në bazë të kërkesës së bërë me shkrim ose në formë elektronike,me përjashtim të informacioneve të kufizuara me ligj.

3. Kërkesat e kërkuesit për qasje në dokumente publike, të parashtruara në cilëndo formë të lejuar me dispozitat e paragrafit paraprak të këtij neni, nga institucioni publik të cilit i drejtohet kërkuesi, trajtohen të barabarta dhe zyrtare.
4. Dokumentet publike të pranuara nga kërkuesi nuk mund të përdoren për qëllime denigrimi, propagandistike dhe komerciale.

Neni 5
Njësia/zyrtari përgjegjës për komunikim me qytetarë

1. Të gjitha institucionet publike janë të obliguara të caktojnë njësinë apo zyrtarin të cilët janë përgjegjës për pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente.
2. Të gjitha kërkesat për qasje në dokumente i drejtohen njësisë apo zyrtarit për komunikim me qytetarë të institucionit përkatës.
3. Njësia apo zyrtari për komunikim me qytetarë pas marrjes dhe shqyrtimit fillestar të kërkesës për qasje në dokumente zyrtare duhet të vlerësojnë se cila është njësia përkatëse brenda institucionit publik që duhet ta ketë dokumentin e kërkuar. Pas marrjes së dokumentit nga njësia përkatëse brenda institucionit publik, këtë dokument, në pajtim me legjislacionin në fuqi ia dërgojnë kërkuesit të dokumentit.
4. Njësia apo zyrtari për komunikim me qytetarë mbajnë evidencë të saktë për numrin e kërkesave për qasje në dokumente si dhe për numrin e lejuar apo refuzuar të këtyre kërkesave.
5. Njësia apo zyrtari për komunikim me qytetarë përgatisin raportet e rregullta dhe këto raporte ia dërgojnë njësisë përkatëse të Qeverisë së Kosovës/Zyrës së Kryeministrit e cila përgatit raportin gjithëpërfshirëse, të institucioneve publike, për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike.

Neni 6
Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

1. Kërkesat për qasje në dokumente parashtrohen në çfarëdo mënyrë e cila i mundëson institucionit publik të identifikojë dokumentin.
2. Kërkuesi i ndonjë dokumenti nuk është i obliguar që të japë arsye për të pasur qasje në dokumente.
3. Nëse kërkesa nuk është sa duhet e saktë, institucioni publik kërkon nga kërkuesi që ta qartësojë kërkesën dhe i ndihmon kërkuesit që ta bëjë këtë.
4. Kërkuesi i ndonjë dokumenti ka të drejtë për të mbetur anonim ndaj palëve të treta.
5. Institucionet publike i ofrojnë personave informata dhe ndihmë se si dhe ku mund të parashtrohen kërkesat për qasje në dokumente.
6. Formalitetet për kërkesa nuk tejkalojnë atë që është kyçe për të përpunuar kërkesën.

Neni 7
Përpunimi i kërkesave për qasje në dokumente zyrtare

1. Kërkesat për qasje në dokumente trajtohen nga cilido institucion publik që posedon dokumentin.

2. Nëse institucioni publik nuk posedon, nuk disponon ose nuk e mbikëqyrë informatën, e ka njohuri për organin gjegjës, resorin e tij ose institucionin tjetër, menjëherë ose më së voni pesë (5) ditë pune, nga dita e pranimit të kërkesës me shkrim të kërkuesit, është i detyruar që kërkesën t'ia përcjellë organit gjegjës ose sektorit të tij, i cili e posedon, disponon ose e mbikëqyrë informatën.
3. Për këto veprime institucioni përkatës publik, nga paragrafi 2. i këtij neni, është i detyruar që ta njoftojë kërkuesin.
4. Në rastet nga paragrafët e mësipërm të këtij neni, afatet e realizimit të së drejtës në qasje të informacionit, respektivisht dokumentit, llogariten nga dita kur institucioni publik, përkatësisht resori i tij e ka pranuar zyrtarisht kërkesën e bartur nga institucioni paraprak.
5. Institucioni publik ndihmon kërkuesin, aq sa është e mundshme në bazë të arsyeshmërisë, të identifikojë dokumentin e kërkuar.
6. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare trajtohen në mënyrë të barabartë.
7. Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare shqyrtohet dhe trajtohet me shpejtësi.
8. Institucioni publik obligohet që brenda shtatë (7) ditëve, prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerr vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të japë përgjigje me shkrim për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesërishëm dhe informon kërkuesin për të drejtën që ai ka për parashtrimin e një kërkese për rishqyrtim. Refuzimi i kërkesës bëhet me aktvendim me shkrim për refuzim të saj.
9. Në rast të refuzimit të plotë apo të pjesërishëm, kërkuesi mundet, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas marrjes së përgjigjes nga institucioni publik, të parashtrojë kërkesën për rishqyrtim e çështjes duke kërkuar nga institucioni që të rishqyrtojë vendimin.

Neni 8
Vazhdimi i afateve

1. Afatet për realizimin e të drejtës për qasje në informatë, respektivisht në dokumente publike, të përcaktuara me këtë ligj, mund të vazhdohen më së shumti deri pesëmbëdhjetë (15) ditë, në qoftë se:
   1.1. informata ose dokumenti duhet të kërkohet jashtë institucionit publik;
   1.2. me një kërkesë kërkohen disa informata ose dokumente publike, nga e njëjta palë;
2. Përkitazi me vazhdimin e afatit, institucioni publik ose sektori i tij, pa vonesë e më së voni brenda afatit prej tetë (8) ditësh të tjera pune, do ta njoftojë kërkuesin me ecurinë dhe arsyet që kanë shkaktuar shtyrjen e afatit.

Neni 9
Kërkesa për rishqyrtimin e çështjes

1. Kërkesa për rishqyrtimin e çështjes duhet të shqyrtohet brenda shtatë (7) ditësh prej kohës së regjistrimit të kërkesës për rishqyrtimin e çështjes.
2. Kërkesën për rishqyrtim e vendosë eprori i institucionit kompetent publik i Republikës së Kosovës.
3. Institucioni publik lejon qasje në dokumentin e kërkuar ose me një përgjigje me shkrim jep arsyet për refuzimin e plotë apo të pjesërishëm.

4. Në rast të refuzimit të plotë apo të pjesërishëm të kërkesës për rishqyrtimin e çështjes, institucioni publik informon parashtruesin me aktvendim me shkrim.

Neni 10
Mos përgjigjja e Institucionit publik

Refuzimi i kërkesës së kërkuesit, si dhe mos përgjigja e institucionit publik brenda afatit të caktuar konsiderohet si përgjigje negative dhe i jep të drejtë kërkuesit që të fillojë procedurën para Institucionit të Avokatit të Popullit, institucioneve të tjera publike, gjykatës kompetente, në përputhje me ligjin në fuqi.

Neni 11
Format e qasjes në dokumente

1. Kur të lejohet qasja në dokument kërkuesi ka të drejtë të zgjedhë nëse do të kontrollojë origjinalin apo kopjen, ose për të pranuar një kopje të dokumentit në çfarëdo forme apo formati në dispozicion sipas zgjedhjes së tij.
2. Nëse kufizimi vlen për disa nga informatat e një dokumenti, institucioni publik duhet të ofrojë qasje në pjesën tjetër të informatave të cilat i përmban dokumenti.
3. Nëse dokumenti i plotë ose i pjesshëm, është kërkuar një apo më shumë herë më parë, nga i njëjti kërkues, nëse institucioni ka dëshmi se informacioni publik ose dokumenti zyrtar është keqpërdorur më parë nga kërkuesi, nëse versioni i pjesshëm ose i tërë i dokumentit është çorientues apo i pakuptimtë për nga përmbajtja, atëherë institucioni publik, në procedurë ligjore, qasjen në informatë apo dokument mund ta kontestojë, respektivisht dhënien e tij, mund ta refuzojë në tërësi ose një pjesë përkatëse të tij.
4. Institucioni publik mund të ofroj qasje në ndonjë dokument duke drejtuar kërkuesin në burime alternative që mund të qasen më lehtë.
5. Nëse dokumenti është bërë publik, nga institucioni publik dhe kërkuesi ka qasje të lehtë në të, institucioni publik mund ta përmbush detyrimin e vet të lejimit të qasjes në dokumente duke e informuar kërkuesin se si ta marrë dokumentin e kërkuar.
6. Dokumentet ofrohen në versionin dhe formatin ekzistues (duke përfshirë formën elektronike ose në format alternative si p.sh në alfabetin e Brajit, të shtypur më shkronja të mëdha ose në shirit) duke respektuar plotësisht preferencën e parashtruesit.

KREU III
REFUZIMET E QASJES NË DOKUMENTE

Neni 12
Përjashtimet e së drejtës së qasjes në dokumente

1. Çdo kërkues ka të drejtë të ketë qasje në dokumente publike. Kufizimi i kësaj të drejte ushtrohet proporcionalisht dhe vetëm për qëllime të mbrojtjes së:
   1.1. sigurisë kombëtare, mbrojtjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare;

1.2. sigurisë publike;
1.3. parandalimit, hulumtimit dhe ndjekjes së aktiviteteve penale;
1.4. hulumtimeve disiplinore;
1.5. inspektimit, kontrollimit dhe mbikëqyrjes nga institucionet publike;
1.6. privatësisë dhe interesave të tjerë legjitim privat;
1.7. interesave komerciale dhe të tjera ekonomike;
1.8. politikave ekonomike, monetare dhe këmbimore të shtetit;
1.9. barazisë së palëve në procedura gjyqësore dhe administrimin efikas të drejtësisë;
1.10. mjedisit, apo,
1.11. diskutimeve brenda apo ndërmjet institucioneve publike lidhur me shqyrtimin e ndonjë çështjeje.

2. Qasja në informata të përmbajtura në një dokument mund të refuzohet nëse zbulimi i tyre dëmton apo ka mundësi të dëmtojë, cilindo nga interesat e përmendura në paragrafin 1. të këtij neni, përveç nëse nuk ekziston ndonjë interes publik më i lartë për të bërë zbulimin.
3. Nëse vetëm një pjesë e dokumenteve të kërkuara përfshihen nga ndonjë prej përjashtimeve të përmendura në paragrafin 1. të këtij neni, pjesët e mbetura të dokumentit bëhen publike.

Neni 13
Refuzimi i qasjes në dokumente zyrtare

1. Kërkesa për qasje në dokumente mund të refuzohet:
   1.1. nëse, pa marrë parasysh ndihmën nga institucioni publik, kërkesa mbetet tejet e paqartë për të mundësuar identifikimin e dokumentit; apo
   1.2. nëse janë plotësuar kushtet dhe kërkesat nga paragrafi 2. i nenit 11 të këtij ligji.
2. Institucioni publik i cili refuzon qasjen në dokumentin në tërësi, apo pjesërisht, duhet të japë arsye mbi refuzimin. Kërkuesi ka të drejtë, që pas parashtrimit të kërkesës, të marrë aktvendim të arsyetuar me shkrim, nga ai institucion publik, përkitazi me refuzimin.

Neni 14
Kërkesat për qasje në dokumente të klasifikuara

Kërkesat për qasje në dokumente të klasifikuara bëhen në pajtim me ligjin në fuqi për klasifikimin e informacioneve dhe rregullat e sigurisë.

Neni 15
Aplikimi i dispozitave të ligjit për procedurën administrative

Në procedurën e realizimit të të drejtave për qasje në informata, përkatësisht në dokumente publike, në mënyrë të përshtatshme, aplikohen dispozitat e ligjit për procedurën administrative të Republikës së Kosovës, nëse me dispozitat e këtij ligji nuk është përcaktuar ndryshe.

KREU IV
DOKUMENTET E PUBLIKUARA ME INICIATIVË TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE

Neni 16
Qasja e drejtpërdrejt në formë elektronike

1. Institucionet publike sipas këtij ligji janë të obliguara që në formë elektronike dhe përmes botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës ti publikojnë të gjitha dokumentet e publikueshme të cilat ato i hartojnë, konform Kushtetutës dhe Ligjit për Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
2. Ueb faqet e institucioneve publike duhet të përmbajnë, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në:
   2.1. misionin dhe funksionet e institucionit publik, duke përfshirë edhe ato të njësive në varësi;
   2.2. skemën organizative të institucionit publik, duke përfshirë edhe atë të njësive në varësi;
   2.3. legjislacionin bazë për organizimin, funksionimin dhe funksionet e institucionit përkatës;
   2.4. të dhënat e përditshme për veprimtarinë publike të institucionit, të dhënat për politika, akte ligjore e nënligjore;
   2.5. strategjitë dhe dokumentet e tjera të politikave, të miratuara, në fushën e veprimit dhe funksionet e institucionit publik;
   2.6. listën e hollësishme të shërbimeve që ofron institucioni për publikun, si: licenca, leje, autorizime, certifikata, vërtetime apo shërbime publike të tjera, ku do të përfshihen edhe:
      2.6.1. procedurat dhe kushtet e përfitimit të tyre;
      2.6.2. dokumentacioni i nevojshëm dhe kostoja për realizimin e shërbimit;
      2.6.3. formulari i aplikimit për çdo shërbim dhe udhëzuesi i plotësimit të tij;
      2.6.4. afati i detyrueshëm për të marrë përgjigje për shërbimin e kërkuar;
      2.6.5. afati dhe organi, ku bëhet Ankimi, në rast refuzimi të përgjigjes, apo të mos ofrimit të shërbimit në afatin e detyrueshëm ligjor;
3. Të gjitha institucionet publike përkatëse duhet të kenë një adresë e-maili, posaçërisht për komunikim me publikun dhe të ngarkojnë një person për të kontrolluar, rregullisht, të dhënat e pranuara. I njëjti mund të jetë përgjegjës për rifreskimin, sigurimin e qasjes dhe kredibilitetin e informatave në ueb faqet e institucioneve publike.
4. Ministria përkatëse për administratë publike, më së largu gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit, nxjerrë akt nënligjor për formën, dukjen dhe karakteristikat tjera që duhet të kenë ueb faqet e institucioneve publike.
5. Qeveria e Kosovës mund të caktojë, me vendim, përmbajtjen shtesë për ueb faqet e institucioneve publike.

KREU V
ORGANI I PAVARUR PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE

Neni 17
Institucioni i Avokatit të Popullit

1. Institucioni i Avokatit të Popullit është organ i pavarur, i cili ndihmon qytetarët për realizimin e së drejtës për qasje në dokumentet e nevojshme të cilat u janë refuzuar.
2. Detyrë e Institucionit të Avokatit të Popullit është që të kujdeset për realizimin e papengueshëm të së drejtës për qasje në dokumente publike, e sidomos:
   2.1. të ndërmerr masat e nevojshme për të promovuar dhe përkrahur të drejtat themelore për qasje në dokumente, dhe
   2.2. t'ia paraqesë Kuvendit raportet e rregullta për zbatimin e së drejtës për qasje në dokumente zyrtare, nga institucionet publike.
3. Institucioni i Avokatit të Popullit shërbimet për qytetarët i kryen pa pagesë.
4. Pala e pakënaqur në procedurën e realizimit të së drejtës në qasje në dokumente publike, mund ti drejtohet me ankesë edhe institucioneve të tjera publike.

KREU VI
ZBATIMI

Neni 18
Gjuhët

Qytetarët, ashtu siç është e përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, i ushtrojnë të drejtat e tyre të përcaktuara në këtë ligj, në gjuhën e tyre përkatëse.

Neni 19
Informimi i publikut mbi të drejtat e tij për qasje në dokumente

1. Institucionet publike duhet të informojnë publikun për të drejtat e tij për qasje në dokumente zyrtare dhe mënyrën në të cilën kjo e drejtë mund të ushtrohet. Gjithashtu duhet të ndërmarrin masat e nevojshme për të:
   1.1. përmbushur detyrat dhe obligimet e tyre lidhur me zbatimin e kësaj të drejte;
   1.2. ofruar informata mbi çështje apo aktivitetet për të cilat janë përgjegjëse;
   1.3. menaxhuar dokumentet e tyre, në mënyrë efikase, në mënyrë që të ketë qasje të lehtë;
   1.4. për ta informuar publikun për të drejtat të cilat rrjedhin nga ky ligj; si dhe
   1.5. për të caktuar njësinë apo zyrtarin përgjegjës për komunikim me qytetarë, të cilët janë përgjegjës për pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente.

Neni 20
Transparenca, raportimi dhe informimi i institucioneve publike

1. Për të siguruar transparencë të plotë institucionet në punën e tyre edhe sa i përket qasjes në dokumente publike, obligohen të jenë të përgjegjshme, efikase si dhe të raportojnë dhe informojnë opinionin publik, në mënyrë të rregullt periodike dhe vjetore.
2. Informimin nga paragrafi 1. i këtij neni, institucionet publike, të paktën një herë në vit, duhet ta bëjnë edhe përmes botimit të informatorëve gjithëpërfshirës, raporteve dhe formave tjera të përshtatshme kushtetuese dhe ligjore të informimit të plotë dhe transparent të qytetarëve.
3. Secili institucion publik harton raport vjetor për vitin paraprak, ku përfshihet numri i rasteve në të cilat institucioni publik ka lejuar qasjen, numri i rasteve në të cilat institucioni publik ka refuzuar qasjen në dokumente, si dhe arsyet e këtyre refuzimeve.
4. Secili institucion publik, raportin vjetor për vitin paraprak, ia dërgon njësisë përkatëse të Qeverisë së Kosovës/Zyrës së Kryeministrit, më së largu deri në fund të muajit janar të vitit përkatës.
5. Njësia përkatëse e Qeverisë së Kosovës/Zyrës së Kryeministrit, për zbatimin e këtij ligji:
   5.1. përgatit raportin gjithëpërfshirës për vitin paraprak, deri në fund të muajit mars të vitit përkatës;
   5.2. dorëzon një kopje të raportit gjithëpërfshirës në Kuvendin e Kosovës;
   5.3. bën rekomandime, duke përfshirë, nëse është nevoja, propozimet për rishikimin e këtij ligji; dhe
   5.4. përgatit një program veprimi për masat që duhen ndërmarrë nga institucionet.
6. Njësitë përkatëse të Zyrës së Kryeministrit, sipas nevojës edhe në bashkëpunim me institucionet tjera publike dhe shoqërinë civile, ndërmarrin masat e nevojshme për të promovuar dhe përkrahur të drejtat themelore për qasje në dokumente tek punonjësit e institucioneve publike.

Neni 21
Pagesat për qasje në dokumente zyrtare

1. Shikimi i dokumenteve zyrtare në objektet e institucionit publik është pa pagesë, duke mos ndaluar caktimin e tarifave për shërbimet e ndërlidhura të ofruara nga arkivat dhe muzetë.
2. Një tarifë mund t'i ngarkohet kërkuesit për kopje të dokumentit, e cila është e arsyeshme dhe nuk mund të tejkalojë shpenzimet e vërteta të riprodhimit dhe furnizimit të dokumentit.
3. Tarifat për shpenzimet e prodhimit dhe dërgimit të kopjes së dokumenteve rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga ministria përkatëse për financa dhe janë unike për të gjitha institucionet publike.
4. Tarifat e ngarkesave duhet të publikohen.

Neni 22
Mbajtja e evidencës zyrtare

1. Institucioni publik është i obliguar, që të udhëheq evidencën zyrtare dhe të rregullt, në formë të regjistrit ose ngjashëm, përkitazi me kërkesat, veprimet, procedurat dhe vendimet, lidhur me realizimin e të drejtave të personave fizik dhe juridik, në qasje në dokumente dhe informata zyrtare.
2. Mënyra e instituimit, përmbajtjes dhe elementeve të tjera relevante të udhëheqjes së evidencës, rregullohet më hollësisht me dispozita nënligjore nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

KREU VII
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 23
Mbrojtja e të dhënave personale

Deri në hyrjen në fuqi të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, institucionet mund të lëshojnë të dhëna të tilla vetëm në bazë të pëlqimit të mëparshëm dhe të qartë të personit në fjalë.

Neni 24
Riprodhimi i dokumenteve

Ky ligj nuk cenon rregullat ekzistuese mbi të drejtën e kopjes të cilat mund ta kufizojnë të drejtën e palës së tretë për riprodhimin ose shfrytëzimin e dokumenteve të lëshuara.

Neni 25
Zbatimi i ligjit për procedurën e përgjithshme administrative

Nëse me këtë ligj nuk përcaktohet ndryshe, për procedurën për qasje në dokumente publike, zbatohen dispozitat e ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.

Neni 26
Aktet nënligjore

1. Qeveria ka autoritetin të miratojë akte nënligjore me qëllim të zbatimit të këtij ligji.
2. Qeveria miraton akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji, tre (3) muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit.
3. Mos përgatitja e akteve nënligjore sipas paragrafit paraprak nuk i lejon institucionet të refuzojnë qasjen në dokumente publike.

Neni 27
Dispozitat ndëshkimore

1. Institucioni publik i cili në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, i pamundëson, pengon ose kufizon realizimin e të drejtave në qasje në dokumente publike dhe informata, dënohet me gjobë prej pesëmijë (5.000) deri dhjetëmijë (10.000) Euro.

2. Për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni, ndëshkohet edhe personi përgjegjës i institucionit publik, me gjobë në shumë prej pesëqind (500) deri njëmijë (1000) Euro.
3. Me gjobë prej pesëqind (500) deri dymijë (2000) Euro, ndëshkohet për kundërvajtje edhe personi fizik i cili e dëmton, e shkatërron, e fshehë ose në ndonjë tjetër mënyrë ose formë e bënë të paqartë informatën, rrjedhimisht dokumentin publik, me qëllim të pamundësimit të realizimit të së drejtës në qasje të dokumenteve publike, nga ana e kërkuesit të interesuar.
4. Për kundërvajtje nga paragrafi paraprak, me gjobë prej njëmijë (1.000) deri dymijë (2000) Euro, ndëshkohet personi përgjegjës i institucionit publik kompetent.

Neni 28
Shfuqizimi

1. Ky ligj shfuqizon:
   1.1. Ligjin nr. 2003/12 për qasje në dokumente zyrtare;
   1.2. Udhëzimin administrativ nr. 3/2006 për zbatimin e ligjit për qasje në dokumente zyrtare;
   1.3. Udhëzimin Administrativ nr. 05/2006 për organizimin dhe funksionimin e Zyrave për pranimin e ankesave dhe kërkesave-Tryeza e Komunikimit me qytetarë.
   1.4. Udhëzimin Administrativ nr. 07/2008-MSHP për forcimin e transparencës dhe standardizimit të faqeve të internetit në Institucionet e Republikës së Kosovës, dhe
   1.5. çdo dispozitë të legjislacionit që bie në kundërshtim me këtë ligj që ka të bëjë me të drejtën e qasjen në dokumente zyrtare.

Neni 29
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-215
7 tetor 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-063-2010, datë 01.11.2010 nga u.d. Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 88 / 25 NËNTOR 2010

LIGJI Nr. 2004/2
PËR BARAZI GJINORE

Kuvendi i Kosovës

Duke u bazuar në Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, nenet 3.1, 3.2 (a), (b), (c), (d), 5.1 (gj), 5.7, 9.1.26 (a) dhe 9.3.3,

Duke ndier nevojën e krijimit të kushteve ligjore për barazi gjinore në të gjitha fushat e jetës shoqërore në Kosovë, Kuvendi i Kosovës.

Miraton:

LIGJIN PËR BARAZI GJINORE TË KOSOVËS

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i Ligjit

1.1. Me këtë Ligj mbrohet, trajtohet dhe vendoset, barazia ndërmjet gjinive si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë së Kosovës, me mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve dhe për kontributin e tyre në zhvillimin politik, ekonomik, social, kulturor dhe në të gjitha fushat e jetës shoqërore.

1.2. Ky Ligj përcakton kushte dhe mundësi për barazi gjinore përmes politikave që mbështesin zhvillimin e gjithanshëm dhe përmirësimin, sidomos të pozitës së femrave, në mënyrë që ato të jenë të vlerësuara dhe të gëzojnë autoritet në familje dhe shoqëri.

1.3. Garantimi i të drejtave të barabarta është detyrë e tërë shoqërisë dhe nënkupton mënjanimin e pengesave në realizimin e barazisë gjinore.

1.4. Barazia gjinore bazohet në parimin e sjelljes së njëjtë dhe në parimin e mundësive të barabarta, ndërsa jetësohet me masat pozitive dhe me politikë të vetëdijësuar për barazi gjinore.

1.5. Ky Ligj përcakton masat e përgjithshme dhe të veçanta për garantimin e të drejtave të barabarta si dhe përcakton subjektet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre.

Neni 2
PËRKUFIZIMET TERMINOLOGJIKE

2.1. Barazi gjinore do të thotë pjesëmarrje e barabartë e femrave dhe meshkujve në të gjithat fushat e jetës, pozitë të barabartë, mundësi të barabarta për të gëzuar të gjithat të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në zhvillimin e shoqërisë si dhe të kenë përfitim të barabartë nga të arriturat e këtij zhvillimi.

2.2. Trajtim i barabartë gjinor do të thotë mënjanim i formave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të diskriminimit gjinor.

2.3. Diskriminim i drejtpërdrejtë gjinor do të thotë trajtim i pabarabartë i ndonjë individi në krahasim me një individ të gjinisë së kundërt në rrethana të njëjta apo të ngjashme.

2.4. Diskriminim i tërthortë gjinor do të thotë vënia e individit të njërës gjini në pozitë jo të barabartë me dispozitat asnjanëse, standardet apo trajtim të pabarabartë në rrethana të njëjta ose të ngjashme, përveç rasteve kur këto dispozita, standarde apo ky trajtim është i domosdoshëm dhe nëse mund të justifikohet me fakte objektive që nuk bazohen posaçërisht në ndonjërën gjini.

2.5. Nxitja e individit tjetër në diskriminim gjinor në kuptim të këtijë Ligji konsiderohet diskriminim gjinor.

2.6. Ngacmimi dhe ngacmimi seksual paraqesin diskriminim gjinor.

2.7. Ngacmimi përfshin çdo formë të sjelljes që ka për qëllim ose që paraqet cënim të dinjitetit personal.

2.8. Ngacmimi seksual përfshin çdo formë të sjelljes së padëshiruar seksuale verbale dhe joverbale, fizike ose simbolike, që në të njëjtën kohë ka për qëllim ose paraqet cënim të dinjitetit personal.

2.9. Masat ligjore janë masa të cilat kanë për qëllim arritjen e barazisë së plotë të femrave dhe meshkujve në shoqëri, të cilat japin përparësi specifike në mënyrë që pjesëtarëve të gjinisë së caktuar t'u mundësohet qasje e barabartë në të gjitha fushat e jetës shoqërore, të mënjanohet pabarazia gjinore ekzistuese, ose t'u sigurohen të drejta të cilat më herët nuk iu kanë takuar.

2.10. Masat e përgjithshme janë masa të natyrës normative, përmes të cilave diskriminimi gjinor parandalohet me anë të ligjeve të cilat i rregullojnë fushat e veçanta, sjelljet në rrethana të caktuara apo qasjen e duhur për garantimin e trajtimit të barabartë gjinor, siç janë ndëshkimet që duhet ndërmarrë ndaj individëve në rast të shkeljes së këtyre kufizimeve ose kërkesave.

2.11. Masat e veçanta janë masa të përkohshme të cilat kanë për qëllim garantimin e të drejtave të barabarta gjinore dhe promovimin e barazisë gjinore në fushat specifike të jetës shoqërore, në të cilat është identifikuar përfaqësimi i pabarabartë gjinor apo pozita e pabarabartë e personave që i përkasin njërës gjini.

2.12. Përfaqësimi i pabarabartë në kuptim të paragrafit 2.11, është atëherë kur përfaqësimi i njërës gjini, në një fushë të posaçme shoqërore apo në një segment të kësaj fushe, është më i ulët se 40%.

Neni 3
INSTITUCIONET DHE ORGANET UDHËHEQËSE

3.1. Me zbatimin e masave ligjore dhe afirmative vendoset pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve në organet e të gjitha niveleve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe institucionet publike, në mënyrë që pjesëmarrja në këto institucione të arrijë nivelin e pjesëmarjes së tyre te popullata e përgjithshme e Kosovës.

3.2. Pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve sipas nenit 3 pika 3.1 arrihet në rastet kur pjesëmarrja e një gjinie në institucione, organe apo në nivele të pushtetit është 40 %.

3.3. Gjatë emërimit në organet qendrore dhe në organet e qeverisjes lokale, si dhe te personat e tjerë juridik me pushtet publik, duhet të respektohet pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve në përputhje me paragrafin 3.2.

3.4. Organet kompetente gjatë emërimit të anëtarëve të këshillave, komisioneve dhe organeve përfaqësuese brenda dhe jashtë Kosovës duhet të përfillin përfaqësimin e barabartë të femrave dhe meshkujve në këta këshilla, komisione dhe organe përfaqësuese.

3.5. Gjatë emërtimit të institucioneve, ndërrmarjeve publike, rrugëve, të respektohet barazia gjinore.

SUBJEKTET PËRGJEGJËSE PËR ARRITJEN E BARAZISË GJINORE DHE KOMPETENCAT E TYRE

Neni 4
KUVENDI I KOSOVËS

4.1. Kuvendi i Kosovës respekton parimet e përfaqësimit të barabartë gjinor gjatë themelimit të organeve punuese dhe të delegacioneve në pajtim me rregulloren e tij të punës.

4.2. Kuvendi i Kosovës shqyrton dhe miraton Rezolutën për Programin e Kosovës për Barazi Gjinore.

4.3. Kuvendi i Kosovës shqyrton dhe miraton çdo dy vjet raportin e Qeverisë për realizimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore.

QEVERIA DHE MINISTRITË

4.4. Qeveria harton Programin e Kosovës për Barazi Gjinore. Për përmbushjen e këtij qëllimi, Qeveria emëron një grup të përbërë nga përfaqësues të ministrive, Zyrës për Barazi Gjinore të Kosovës, të komunave, të institucioneve publike, të shoqërisë civile dhe nga ekspertët.

4.5. Qeveria i paraqet Kuvendit të Kosovës projektrezolutën mbi Programin e Kosovës për Barazi Gjinore.

4.6. Çdo dy vjet Qeveria i paraqet raport Kuvendit të Kosovës për realizimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore.

4.7. Detyrë dhe përgjegjësi e Qeverisë dhe ministrive në fushën e barazisë gjinore është edhe promovimi dhe garantimi i të drejtave të barabarta gjinore.
4.8. Qeveria në kuadër të fushëveprimit të saj realizon qëllimet e këtij ligji duke ndërmarrë masat e përgjithshmë dhe të veçanta të përcaktuara me këtë ligj.
4.9. Qeveria formon Këshillin ndërministror, anëtarë të të cilit janë Zyrtarët për Barazi Gjinore të ministrive. Kompetencat dhe detyrat e këtij këshilli përcaktohen me rregullore të veçantë nga Qeveria.
4.10. Gjatë përgatitjes së rregulloreve dhe programeve të tyre, ministritë duhet të respektojnë dispozitat e këtij ligji.
4.11. Ministritë bashkëpunojnë me Zyrën për Barazi Gjinore të Kosovës për hartimin e projektligjeve, ndryshimin e ligjeve ekzistuese dhe shqyrtojnë rekomandimet e kësaj Zyre përkitazi me projektligjet dhe dokumentet e tjera në aspektin e barazisë gjinore, para se këto projektligje t'i dorëzohen Qeverisë për të marrë vendime.
4.12. Çdo ministri zgjedh zyrtar/zyrtare për barazi gjinore i cili/ e cila kryen detyrat e koordinatorit/koordinatores për çështje gjinore. Kompetencat e Zyrtarëve për Barazi Gjinore në ministritë përkatëse përcaktohen me rregullore të veçantë nga secila ministri, duke u mbështetur në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës.
4.13. Zyrtari/Zyrtarja për barazi gjinore siç parashihet në paragrafin 4.12 është përgjegjës për përmbushjen e detyrave nga aspekti i barazisë gjinore, në kuadër të kompetencave të ministrisë, duke u bazuar në këtë Ligj dhe në bashkëpunim me Zyrën për Barazi Gjinore të Kosovës.

ORGANET E QEVERISJES LOKALE

4.14. Organet e qeverisjes lokale, në pajtim me kompetencat e tyre, promovojnë dhe krijojnë mundësi të barabarta, hartojnë politikat e tyre duke u bazuar në barazinë gjinore dhe miratojnë masa dhe ndërmarrin aktivitete të nevojshme për krijimin e mundësive të barabarta për femra dhe meshkuj.
4.15. Organet e qeverisjes lokale themelojnë Zyrën për Barazi Gjinore dhe zgjedhin Zyrtarin/Zyrtaren për Barazi Gjinore në komunë. Kompetencat e Zyrtarëve për Barazi Gjinore në komuna përcaktohen me rregullore të veçantë, në bazë të këti ligji, nga Departamenti për Administrim Lokal i Ministrisë të Shërbimeve Publike dhe Rregullores për Shërbimin Civil të Kosovës.
4.16. Vendimet që marrin organet e qeverisjes lokale, para miratimit duhet të shqyrtohen në aspektin e barazisë gjinore edhe nga zyrtari/zyrtarja për Barazi Gjinore në komunën përkatëse.
4.17. Zyrtari/Zyrtarja për Barazi Gjinore në komunë bashkëpunon me Zyrën për Barazi Gjinore të Kosovës.

Neni 5
ZYRA PËR BARAZI GJINORE

5.1. Qeveria e Kosovës themelon Zyrën për Barazi Gjinore si institucion të veçantë qeveritar.

5.2. Zyra për Barazi Gjinore ka këto kompetenca:

a) zbaton dhe monitoron dispozitat e këtij Ligji dhe rregulloreve të miratuara në bazë të tij;
b) i propozon Qeverisë dhe ministrive hartimin, ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve dhe rregulloreve, si dhe miratimin e masave të tjera;
c) përpilon dhe propozon politikën për promovimin e barazisë gjinore dhe mbikëqyrë zbatimin e saj;
d) mbikëqyr zbatimin e marrëveshjeve dhe akteve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me barazinë gjinore;
e) përgatit raporte për Kosovën mbi përmbushjen e obligimeve ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore, të cilat miratohen nga Qeveria;
f) koordinon punën rreth përgatitjes së Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, dhe monitoron zbatimin e tij;
g) bashkëpunon me Zyrtarët për Barazi Gjinore në ministri dhe qeveritë lokale;
h) bashkëpunon me organizatat jo-qeveritare të cilat janë aktive në fushën e barazisë gjinore dhe siguron financimin e pjesshëm për projekte apo aktivitetet e tyre;
i) bashkëpunon me institucionet publike dhe siguron financim të pjesshëm për projekte apo aktivitetet e tyre;
j) propozon kushtet dhe kriteret për financim të pjesshëm të cilin e përcakton Qeveria;
k) koordinon aktivitetet e drejtuara në zbatimin e normave të përgjithshme të barazisë gjinore, duke përfshirë afrimin e ndihmës profesionale për zhvillimin e metodave dhe teknikave të përshtatshme;
l) propozon nisma për hulumtim dhe analiza në fushën e barazisë gjinore;
m) punon në ngritjen e vetëdijes së përgjithshme për barazinë gjinore;
n) i raporton çdo vit Qeverisë për veprimtarinë e Zyrës për vitin paraprak, e më së voni deri në fund të muajit mars.
o) Zyra për barazi gjinore gjatë kryerjes së detyrave të saj lidhur me çështjet gjinore të përmendura në nenin 5.2 (a) deri (n) i bashkërendon aktivitetete e saj me Zyrën këshillëdhënëse për qeverisje të mirë, për të drejtat e njeriut, për mundësi të barabarta dhe gjini të themeluar sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, shtojca I.

Neni 6
NJËSIA PËR BARAZI GJINORE

Çështjet e diskriminimit që lidhen drejtpërdrejt me gjininë trajtohen nga njësia për barazi gjinore në kuadër të institucionit të Ombudspersonit, të themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/38, e cila po ashtu, ka përgjegjësi të rishikojë projektligjet, të japë komente lidhur me zbatimin e këtij ligji dhe me legjislacionin ekzistues, kur ka të bëjë me çështjet gjinore. Zyra për barazi gjinore në kuadër të institucionit të Ombudspersonit financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Neni 7
FINANCIMI I ZYRËS PËR BARAZI GJINORE TË KOSOVËS

Zyra e Kosovës për barazi gjinore financohet nga Buxheti I Konsoliduar i Kosovës.

Neni 8
MBLEDHJA E INFORMATAVE DHE STATISTIKAT GJINORE

8.1. Të dhënat dhe informatat statistikore dhe jo - statistikore të cilat i mbledhin, i evidentojnë dhe i përpunojnë organet qëndrore dhe lokale, shërbimet dhe institucionet publike, ndërmarrjet publike dhe private si dhe subjektet e tjera paraqiten sipas struktures gjinore.

8.2. Programet, raportet, analizat dhe projektet të cilat i përgatisin organet qëndrore, lokale, institucionet publike, ndërrmarjet publike dhe private si dhe subjektet e tjera përfshijnë aspektin gjinor.

8.3. Institucionet e Kosovës, të cilat në bazë të ligjeve përkatëse janë kompetente të mbledhin, të evidentojnë, të përpunojnë dhe të bëjnë analizën e statistikave, përfshijnë treguesin gjinor në gjithë veprimtarinë e tyre, regjistrimin e popullsisë, anketimet demografike, dhe çdo lloj tjetër të anketimit.

8.4. Të dhënat dhe informatat statistikore dhe jo-statistikore që mblidhen, evidentohen dhe përpunohen në pajtim me paragrafin 9.1 janë pjesë përbërëse e evidences statistikore dhe lejohet qasje në to në pajtim me dispozitat me të cilat rregullohet mbrojtja e të dhënave personale të qytetarëve si dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare.

Neni 9
PARTITË POLITIKE

Partitë politike të regjistruara në regjistrin e partive politike, përcaktojnë metodat dhe masat për përfshirjen dhe përfaqësimin e femrave dhe meshkujve në pajtim me nenin 3.2.

Neni 10
SHOQËRIA CIVILE

10.1. Organizatat jo-qeveritare, shoqatat dhe fondacionet bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën e tyre në fushën e barazisë gjinore me institucionet qeveritare si dhe me institucione të tjera të përcaktuara me këtë Ligj.

10.2. Subjektet e shoqërisë civile kontribojnë në zbatimin e këtij Ligji.

Neni 11
EKONOMIA

11.1. Në legjislacionin ekonomik, financiar, të punësimit dhe mirëqënies sociale si dhe në programet makro dhe mikro - ekonomike, financiare, privatizim, përfshirë edhe të drejtën për trashëgimi dhe pronësi, kredi dhe burime natyrore duhet të mundësohet qasje e plotë dhe e barabartë për femra dhe meshkuj.

11.2. Organet përgjegjëse dhe personat juridik me autorizime publike si dhe institucionet financiare në kushte të barabarta u sigurojnë femrave dhe meshkujve qasje në mjete dhe shpërndarje të mjeteve të ndara për nxitjen e krijimit të biznesit dhe vetëpunësimit.

Neni 12
PUNA

12.1. Sektori publik, privat si dhe institucionet ligjvënëse dhe ekzekutive në sektorin e punës dhe të punësimit, sigurojnë të drejta dhe mundësi të barabarta për femra dhe meshkuj.

12.2. Vendi i lirë i punës hapet njësoj për femra dhe meshkuj.

12.3. Shpallja ose publikimi i vendit të lirë të punës nuk mund të përmbajë fjalë apo shprehje që diskriminojnë në baza gjinore. Kjo dispozitë nuk vlen nëse qëllimi i shpalljes dhe publikimit bëhet për të balancuar strukturën gjinore brenda një sektori profesional, dhe kjo duhet të vëhet në dukje në shpallje.

12.4. Kriteret dhe kushtet për zgjedhjen e kantidatëve për vende të punës në çdo degë veprimtarie, në të gjitha shkallët profesionale, në sektorin publik dhe privat, vendosen mbi bazat e barazisë gjinore.

12.5. Punëdhënësi/Punëdhënësja, është i/e detyruar të paguajë pagë të njëjtë për femra dhe meshkuj, për punën e njëjtë dhe për punën me vlerë të njëjtë, si dhe siguron kushtet e barabarta të punësimit dhe të punës dhe të gjitha të drejtat e barabarta të punës.

12.6. Punëdhënësi/Punëdhënësja siguron që femrat dhe meshkujt të kenë mundësi të barabarta për të vazhduar shkollimin dhe aftësimin profesional dhe të përcjellin trajnimet të cilat mbahen për të shtuar shkathtësitë profesionale ose të përgatiten për profesione të tjera.

12.7. Punëdhënësi/Punëdhënësja apo institucioni që bën aftësimin profesional dhe secili individ që merr pjesë në aftësimin profesional nuk u lejohet që të diskriminojnë asnjë individ në baza gjinore.

12.8. Punëdhënësi/Punëdhënësja, duhet të sigurojë trajtim të barabartë për femra dhe meshkuj në sektorin e punës, dhe të marrë masa në mënyrë që profesionet të mos jenë të kategorizuara si punë specifike vetëm për femra ose vetëm për meshkuj.

12.9. Punëdhënësit marrin masa të nevojshme për t'u mundësuar femrave dhe meshkujve të përshtasin detyrimet e tyre profesionale dhe familjare. Organizimi i punës dhe orarit, në pajtim me nevojat e tregut të punës dhe gjendjen familjare të të punësuarve, bëhet në mënyrë që të sigurojë kthimin në vendin e njëjtë të punës pas pushimit të lindjes, pushimit prindëror, pushimit të abortit, pushimit mjekësor ose pas kohës së kaluar jashtë vendit të punës për shkaqe urgjente familjare, apo aftësime profesionale.

12.10. Është e drejtë e çdo të punësuari femër apo meshkull të anëtarësohet dhe aktivizohet në sindikatat e punëtorëve apo të punëdhënësve apo në çdo organizatë tjetër profesionale, përfshirë edhe përfitimet që dalin nga kjo anëtarësi.

12.11. Ndalohet ngacmimi dhe ngacmimi seksual në vendin e punës.

12.12. Ndalohet përjashtimi nga puna i një të punësuari/punësuareje në rastin kur ai/ajo kërkon zbatimin e këtij ligji.
12.13. Ndalohet përjashtimi nga puna, pushimi i përkohshëm nga puna, padrejtësia lidhur me sigurinë në punë, kushtet e punës ose vlerësimin e punës së tij/saj si pasojë e ankesës së tij/saj për ngacmim seksual ose diskriminim në bazë të gjinisë.
12.14. Ndalohet diskriminimi mbi bazat gjinore në rast të zvogëlimeve dhe mbylljes së vendeve të punës.
12.15. Puna e papaguar e femrave dhe meshkujve vlerësohet kontribut në zhvillimin e familjes dhe shoqërisë në raste të:
a) kujdesit për mirëqenien familjare;
b) kujdesit për fëmijët;
c) kujdesit për anëtarë të tjerë të familjes;
d) punës në bujqësi dhe ekonomi familjare,etj;
Të drejtat që dalin nga ky paragraf realizohen me legjislacionin e sigurimit social, politikave dhe masave tjera.
12.16. Mbrojtja në punë, për femra dhe meshkuj dhe përfitimet e sigurimit social për punën me orar të shkurtuar, për punën e përkohshme dhe për punën që kryhet nga shtëpia sigurohet me ligjet në fuqi.

Neni 13
ARSIMI DHE EDUKIMI

13.1. Në të gjitha nivelet e arsimit dhe edukimit duhet të mundësohet arsimimi dhe edukimi i barabartë i femrave dhe meshkujve për pjesëmarrjen e tyre aktive në shoqëri, në jetën familjare dhe në tregun e punës.
13.2. Organi përgjegjës për arsim dhe institucionet në fushën e arsimit dhe të edukimit në të gjitha nivelet krijojnë, zbatojnë dhe mbikëqyrin politikat e veprimit për sigurimin e barazisë gjinore me qëllim të trajtimit të njëjtë të femrave dhe meshkujve, veçanërisht përsa i përket:
a) qasjes në arsim dhe edukim;
b) arsimit dhe edukimit lidhur me çështjet e barazisë gjinore;
c) përgatitjes, miratimit dhe zbatimit të programit arsimoro-edukativ;
d) hartimit të materialeve dhe teksteve shkollore dhe rishikimit të materialeve dhe teksteve shkollore ekzistuese;
e) hulumtimit të statusit të gjinive në shoqërinë kosovare, si një ndër mënyrë specifike në fushën e arsimit;
f) përfshirjes së femrave dhe meshkujve në trajnime të arsimimit profesional dhe të këshillimit për ato profesione të cilat deri tani janë konsideruar tradicionalisht si profesione vetëm për meshkuj ose vetëm për femra;
g) përfshirjes së barabartë të femrave dhe meshkujve në lëmenjtë e sportit dhe aktiviteteve të lira, gjatë orarit arsimor.
13.3. Në shkolla dhe institucione të tjera arsimore dhe pedagogjike ndalohet çdo lloj diskriminimi gjinor.

Neni 14
MEDIAT

14.1. Me anë të politikave programuese, të gjitha mediat (media të shtypura, media audio-vizuale, media elektronike) duhet të ndikojnë në kultivimin e vetëdijes së përgjithshme për barazinë e femrave dhe meshkujve:
   a) duke organizuar emisione edukativo-arsimore;
   b) duke siguruar mundësi për paraqitje dhe pjesëmarrje të barabartë të femrave dhe të meshkujve;
   c) duke promovuar rolin e barabartë të femrave dhe meshkujve në shoqëri;
   d) duke siguruar informacione të sakta dhe të plota mbi barazinë gjinore.

14.2. Ndalohet emetimi i programeve, botimi dhe publikimi i materialeve dhe informatave si dhe shpërndarja e informatave në formën elektronike mbi baza të diskriminimit gjinor.

14.3. Ndalohet shfaqja publike dhe paraqitja e çdo individi në mënyrë ofenduese, nënçmuese apo poshtëruese përsa i përket gjinisë dhe orientimit seksual.

Neni 15
BARAZIA GJINORE DHE TË DREJTAT CIVILE

15.1. Mosha madhore për të dy gjinitë në Kosovë është 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç.

15.2. Martesa njihet me ligj me aktin e kurorëzimit dhe sjell të drejta dhe detyrime sipas ligjit nëse me ligj të posaçëm nuk është përcaktuar ndryshe.

15.3. Kurorëzimi lejohet me arritjen e moshës madhore, nëse me ligj të veçantë nuk është paraparë ndryshe.

15.4. Femra ose mashkulli, nuk mund të ketë më tepër se një kurorëzim në të njëjtën kohë.

15.5. Martesat e kushtëzuara, të dhunshme dhe në kundërshtim me vullnetin e personave që do të lidhin martesë, denohen me ligj.

15.6. Pasuria e krijuar gjatë jetës në martesë regjistrohet në regjistrat publik, si pronë e përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve.

15.7. Institucioni që bën regjistrimin e pasurisë në regjistrat publik është i detyruar të veprojë në pajtim me paragrafin 16.6 të këtij Ligji.

15.8. Puna e përbashkët e bashkëshortëve me të cilën fitohet pasuria e përbashkët, konsiderohet kontribut i barabartë për krijimin e pasurisë së përbashkët.

15.9. Pasuria e përbashkët e regjistuar si pronë e përbashkët në pajtim me paragrafin 16.7, administrohet bashkarisht dhe nuk mund të tjetërsohet pa pëlqimin e bashkëshortëve.

15.10. Në rast të shkurorëzimit të bashkëshortëve pasuria e përbashkët ndahet në pjesë të barabarta.

15.11. Në rast vdekje të njërit prej bashkëshortëve, pasuria trashëgimore ndahet ndërmjet bashkëshortit/bashkëshortes dhe trashëgimtarëve të tjerë në pajtim me ligjin.

15.12. Fëmijët, femra dhe meshkuj trashëgojnë pasurinë në mënyrë të barabartë.

15.13. Trashëgimtarët, femra dhe meshkuj, mund të disponojnë me pjesën e tyre trashëgimore dhe ta tjetërsojnë, pas regjistrimit si pasuri e tyre trashëgimore.

15.14. Femrat dhe meshkujt kanë të drejtë për qasje të barabartë në sistemin e sigurisë dhe mirëqenies sociale gjatë tërë jetës.

Neni 16
DISPOZITAT NDËSHKUESE

16.1. Punëdhënësi/Punëdhënësja në rast të shkeljes së paragrafit 13.5 të këtij Ligji, dënohet me gjobë prej 1,000 deri në 5,000 Euro.Personi përgjegjës në rast të shkeljes së paragrafit 13.5 të këtij ligji, denohet me gjobë prej 500 deri në 1.500 Euro.

16.2. Punëdhënësi/Punëdhënësja në rast të shkeljes së paragrafit 13.12 dhe 13.13 të këtij Ligji, dënohet me gjobë prej 5,000 deri në 10,000 Euro.Personi përgjegjës në rast të shkeljes së paragrafit 13.12 dhe 13.13 të këtij ligji, dënohet me gjobë prej 1.000 deri 3.000 euro.

16.3. Personat juridik, në rast të shkeljes së paragrafit 15.2 të këtij Ligji, dënohen me gjobë prej 5,000 deri në 10,000 Euro.Personi përgjegjës në rast të shkeljes së paragrafit 15.2 të këtij ligji, denohet me gjobë prej 1.000 deri 3.000 Euro.

16.4. Institucioni i autorizuar dhe personi përgjegjës për regjistrimin e pasurisë në regjistrat publik, në rast të shkeljes së paragrafit 16.7 të këtij Ligji dënohet me gjobë prej 10,000 deri në 20,000 Euro.

16.5. Mjetet e mbledhura nga gjobat derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Neni 17
DISPOZITAT KALIMTARE

17.1. Në afat prej 6 (gjashtë) muajsh prej hyrjes në fuqi të këtij Ligji, Qeveria e Kosovës i paraqet Kuvendit të Kosovës, Rezolutën mbi Programin e Kosovës për Barazi Gjinore.

17.2. Në afat prej 3 (tre) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij Ligji, Qeveria e Kosovës shpall Rregulloren për themelimin e Zyrës për Barazi Gjinore.

17.3. Në afat prej 3 (tre) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij Ligji, Ministritë duhet të kenë zgjedhur Zyrtarët për Barazi Gjinore.

17.4. Në afat prej 3 (tre) muajsh qeveritë komunale zgjedhin Zyrtarin/ Zyrtaren për Barazi Gjinore në Komunë.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE
Neni 18

18.1. Garantohet mbrojtja gjyqësore e barazisë gjinore.

18.2. Ndalohet diskriminimi gjinor me ligj në të gjitha fushat e jetës shoqërore në Kosovë.

18.3. Me këtë Ligj nuk ndalohet zbatimi i ligjeve të tjera në fuqi me të cilat ndëshkohet shkelja e barazisë gjinore.

Neni 19
HYRJA NË FUQI E LIGJIT

Ky Ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe shpalljes së tij.

UNMIK/REG/2004/18
07.06.2004

GAZETA ZYRTARE E INSTITUCIONEVE TË PËRKOHSHME TË VETË-QEVERISJES NË KOSOVË / PRISHTINË :VITI II / NR. 14 / 01 KORRIK 2007

LIGJI Nr. 03/L-047
PËR MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE DHE PJESËTARËVE TË TYRE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Në mbështetje të Kapitullit IV neni 65 pika 1 të si dhe nenit 81 pika 1 paragrafi 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me qëllim të promovimit të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJIN PËR MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE DHE PJESËTARËVE TË TYRE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Neni 1
Dispozitat e përgjithshme

1.1. Republika e Kosovës garanton barazi të plotë dhe efektive për të gjithë popullin e Kosovës. Kosova e konsideron shumëllojshmërinë e saj kombëtare, etnike, gjuhësore dhe fetare si një burim force dhe pasurie për zhvillimin e mëtejshëm të një shoqërie demokratike që bazohet në sundimin e ligjit. Në zhvillimin e Republikës së Kosovës, inkurajohet dhe çmohet kontributi aktiv i të gjithë personave që iu përkasin komuniteteve.

1.2. Republika e Kosovës ndërmerr masat e veçanta për të siguruar barazi të plotë dhe efektive për komunitetet dhe pjesëtarët e tyre, duke marrë në konsideratë nevojat e tyre të veçanta. Këto masa nuk konsiderohen si akt diskriminimi.

1.3. Personat që iu përkasin komuniteteve në Republikën e Kosovës kanë të drejtë t'i gëzojnë individualisht apo së bashku me të tjerët, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut që janë përcaktuar në obligimet ligjore ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Kosovës. Këto të drejta dhe liri garantohen me kushtetutë, me ligje, rregullore dhe politika tjera shtetërore.

1.4. Për qëllimet e këtij ligji, komunitetet përkufizohen si grupe kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare tradicionalisht të pranishme në Republikën e Kosovës të cilat nuk janë shumicë. Këto grupe janë komuniteti serb, turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian, goran dhe komunitete të tjera. Pjesëtarët e komunitetit shumicë në Republikën e Kosovës, të cilët si tërësi nuk janë shumicë në një komunë të caktuar po ashtu i gëzojnë të drejtat e radhitura në këtë ligj.

1.5. Çdo person që i takon një komuniteti ka të drejtë që lirisht të zgjedhë të trajtohet apo të mos trajtohet si i tillë dhe asnjë dëm apo diskriminim nuk do të rezultojë nga zgjedhja e ushtrimit apo jo të të drejtave të cilat lidhen me këtë zgjedhje.

1.6. Gjatë ushtrimit të lirë nga ana e tyre të të drejtave dhe lirive të mbrojtura me këtë ligj, komunitetet dhe pjesëtarët e tyre i respektojnë të drejtat e të tjerëve.

1.7. Autoritetet në Republikën e Kosovës, përfshirë gjykatat, e interpretojnë këtë ligj në pajtim me garancitë e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre të përcaktuara në Kushtetutën e Kosovës, në obligimet e aplikueshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë dispozitat e Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.

Neni 2
Identiteti

2.1. Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë që lirisht të kultivojnë, shprehin dhe zhvillojnë kulturën dhe identitetin e tyre dhe të ruajnë e përmirësojnë elementët esencialë të identitetit të tyre, veçanërisht fenë, gjuhën, traditat dhe trashëgiminë e tyre kulturore. Përveç të drejtave të posaçme të numëruara në këtë ligj, të drejtat themelore të njeriut do të ushtrohen lirshëm dhe në mënyrë të barabartë, duke përfshirë lirinë e të menduarit, të shprehurit, të mediave, të shoqërimit dhe tubimit; të besimit dhe ushtrimit të fesë dhe të drejtën e manifestimit privatisht ose publikisht, individualisht apo në komunitet me të tjerë të atributeve kulturore të komunitetit përkatës.

2.2. Republika e Kosovës do të krijojë kushtet e duhura për t'iu mundësuar komuniteteve dhe personave që iu përkasin komuniteteve që lirshëm të kultivojnë, shprehin dhe zhvillojnë identitetet e tyre.

2.3. Ndalohen masat që synojnë ndryshimin e strukturës së popullatës, në zonat e banuara nga personat që iu përkasin komuniteteve e që janë në dëm të tyre. Republika e Kosova gjithashtu do t'i mbrojë personat që iu takojnë komuniteteve, nga politikat apo praktikat që kanë për qëllim ose kanë ndikim në asimilimin kundër dëshirës së tyre.

2.4. Personat që iu përkasin komuniteteve kanë të drejtë që t'iu njihen emrat e tyre personalë në formën e tyre origjinale, në formën e shkruar në gjuhën e tyre, si dhe t'i rikthejnë emrat e tyre origjinalë, nëse janë ndryshuar. Kjo përfshin të drejtën për të zgjedhur lirshëm emrat dhe mbiemrat e tyre, si dhe emrat e fëmijëve të tyre, dhe të drejtën për t'i regjistruar këta emra në regjistrat civil, në dokumentet e identifikimit dhe dokumentet e tjera zyrtare, në gjuhën dhe shkrimin e tyre, në përputhje me ligjin.

Neni 3
Barazia e plotë dhe efektive

3.1. Republika e Kosovës promovon frymën e paqes, tolerancës, dialogut ndërkulturor dhe ndër-fetar dhe mbështet pajtimin mes komuniteteve. Standardet e përcaktuara në këtë ligj, në Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe në instrumentet e tjera relevante

respektohen, në mënyrë që ta arrijë barazinë e plotë dhe efektive për të gjithë popullin e Republikës së Kosovës.

3.2. Republika e Kosovës ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur personat të cilët janë objekt i kërcënimit apo akteve të frikësimit, armiqësisë apo dhunës për shkak të identitetit të tyre kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar. Organet kompetente do të ndjekin penalisht, ashtu si përcaktohet me ligj, të gjithë ata që marrin pjesë në këto kërcënime apo në aktet e përshkruara në këtë paragraf.

3.3. Ndalohen të gjitha format e diskriminimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në bazë të identitetit kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar. Në pajtim me ligjin, Republika e Kosovës siguron që të gjithë pjesëtarët e komuniteteve t'i gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre themelore dhe ndërmerr masa të veçanta për të përmirësuar çdo situatë ku këta persona përjashtohen nga ushtrimi i barabartë i këtyre të drejtave.

3.4. Republika e Kosovës ndërmerr masa të tilla afirmative të cilat mund të jenë të nevojshme për promovimin e barazisë së plotë dhe efektive në të gjitha sferat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore, duke përfshirë arsimin, median, shëndetësinë dhe shërbime të tjera publike. Veprimet e tilla ofrohen në mënyrë të barabartë për të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre bazuar vetëm në nevoja.

3.5. Republika e Kosovës mbron lirinë e lëvizjes dhe sigurinë e pjesëtarëve të komuniteteve në mbarë vendin.

Neni 4
Gjuha

4.1. Gjuha shqipe dhe serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës dhe kanë status të njëjtë në institucionet e saj. Gjuhët turke, boshnjake dhe rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komunal apo kanë përdorim zyrtar në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

4.2. Personat që iu përkasin komuniteteve kanë të drejtë që lirshëm dhe pa ndërhyrje të përdorin gjuhën e komunitetit të tyre në jetën private dhe publike, në formë të folur dhe të shkruar.

4.3. Personat që iu përkasin komuniteteve kanë të drejtë në lirinë e shprehjes, duke përfshirë të drejtën për të marrë dhe dhënë informacion dhe ide në gjuhën e komunitetit të tyre përkatës.

4.4. Personat që iu përkasin komuniteteve, të cilët janë objekt i arrestimit apo ndalimit kanë të drejtë të informohen menjëherë në një gjuhë që e kuptojnë për arsyet e arrestimit dhe natyrën apo shkakun e ndonjë akuze kundër tyre.

4.5. Personat që iu përkasin komuniteteve kanë të drejtë të mbrojnë veten në gjyq në gjuhën e tyre; nëse është e nevojshme Qeveria do t'iu ofrojë atyre ndihmën pa pagesë të një përkthyesi.

4.6. Personat që iu përkasin komuniteteve kanë të drejtë të shfaqin në mënyrë të dukshme në publik shenja, mbishkrime dhe informacion tjetër të natyrës private në gjuhën e komunitetit të tyre.

4.7. Në fushat ku personat që iu përkasin komuniteteve përfaqësojnë një pjesë të

mjaftueshme të popullatës, emërtimet tradicionale lokale, emërtimet e qyteteve dhe treguesit e tjerë topografikë do të shfaqen edhe në gjuhën e komunitetit përkatës jo-shumicë. Kjo do të rregullohet nga Ligji mbi Përdorimin e Gjuhëve.

4.8. Përdorimi i gjuhës në marrëdhëniet mes personave që iu përkasin komuniteteve dhe autoriteteve administrative në nivel qendror dhe komunal, në marrëdhënie me gjykatat, mediat, dhe në arsim rregullohen në Ligjin mbi Përdorimin e Gjuhëve.

4.9. Republika e Kosovës ndërmerr masa afirmative për të siguruar që gjuhët e tjera përveç atyre zyrtare të ruhen, të kultivohen dhe të promovohen dhe do të orientojë sjelljen e saj sipas Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe të Minoriteteve.

Neni 5
Kultura

5.1. Komunitetet në Republikën e Kosovës dhe pjesëtarët e tyre gëzojnë të drejtën e shprehjes, kultivimit dhe zhvillimit të kulturës dhe traditave të tyre dhe të administrimit të çështjeve të veta kulturore.

5.2. Komunitetet kanë të drejtën e themelimit të shoqatave kulturore, artistike, shkencore dhe arsimore si dhe shoqatave të tjera për shprehjen, forcimin dhe zhvillimin e identitetit të tyre. Këto shoqata kanë të drejtën e regjistrimit të tyre si shoqata qytetare dhe regjistrimi i tillë nuk do t'iu mohohet apo revokohet përveç arsyeve të përcaktuara me ligj.

5.3. Komunitetet kanë të drejtë të themelojnë organizata përfaqësuese të komunitetit që mund të veprojnë si organizata ombrellë në lidhje me komunitetin përkatës dhe të kërkojnë përfaqësim në Këshillin Konsultativ për Komunitete. Përveç kërkesave të paragrafit 2 të këtij neni, këto shoqata duhet të jenë në pajtueshmëri me kodin e mirësjelljes për sa i përket përfaqësimit të tyre autentik të komunitetit përkatës, funksionimit demokratik, efikasitetit dhe transparencës financiare. Ky kod i mirësjelljes miratohet nga organizata përfaqësuese e komunitetit përmes Këshillit Konsultativ për Komunitete, i themeluar në përputhje me nenin 12 të këtij ligji.

5.4. Organizatat apo shoqatat e themeluara sipas paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni, kanë të drejtën për mbështetje dhe asistencë financiare, përfshirë edhe atë nga Qeveria, në pajtim me ligjin.

5.5. Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë të festojnë festat e tyre tradicionale dhe fetare në mënyrë të lirë dhe të hapur në pajtim me ligjin.

5.6. Komunitetet dhe organizatat e tyre përfaqësuese kanë të drejtën të përdorin dhe shfaqin simbolet e komunitetit të tyre në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.

5.7. Personat që iu përkasin komuniteteve, në mënyrë individuale apo nëpërmjet organizatave të tyre përfaqësuese kanë të drejtë të mbajnë kontakte mes tyre dhe me persona të tjerë që jetojnë në Republikën e Kosovës dhe të vendosin dhe mbajnë kontakte të lira dhe paqësore me personat e cilitdo Shtet, në veçanti ata me të cilët ndajnë të njëjtin identitet etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar, apo një trashëgimi të përbashkët kulturore në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.

5.8. Republika e Kosovës lidh marrëveshje dypalëshe, shumëpalëshe, rajonale dhe nën-rajonale me shtetet e tjera për të nxitur dhe forcuar bashkëpunimin kulturor, arsimor dhe forma të tjera të bashkëpunimit ndërkufitar.

5.9. Personat që iu përkasin komuniteteve dhe shoqatat e tyre kanë të drejtë që lirisht të marrin pjesë pa diskriminim në organizata lokale dhe ndërkombëtare dhe në aktivitetet e tyre.

5.10. Republika e Kosovës do ta ruajë trashëgiminë kulturore dhe fetare të të gjitha komuniteteve si pjesë përbërëse të trashëgimisë së Kosovës, dhe do të sigurojë mbrojtje efektive të vendeve dhe monumenteve të rëndësisë kulturore dhe fetare për komunitetet, në pajtim me ligjin.

5.11. Në bashkëpunim me Këshillin Konsultativ për Komunitete dhe organizatat përfaqësuese të komuniteteve, Republika e Kosovës zhvillon strategjinë për mbrojtjen efektive të vendeve dhe monumenteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare të komuniteteve.

5.12. Qeveria e Republikës së Kosovës mund t'ia delegojë detyrën e mirëmbajtjes së vendeve dhe monumenteve të caktuara me interes të veçantë për ta, organizatave dhe shoqatave që kanë dëshirën dhe kapacitetin për të përmbushur një funksion të tillë dhe t'iu ofrojë atyre financim në lidhje me atë synim, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.

Neni 6
Mediat

6.1. Komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre iu garantohet qasja në informacion pa diskriminim. Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë t'i krijojnë dhe përdorin mediat e tyre, përfshirë edhe për qëllimin e ofrimit të informatave në gjuhën e tyre, mes tjerash, nëpërmjet gazetave ditore dhe agjensioneve te lajmeve. Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë numër të rezervuar të frekuencave për mediat elektronike, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.

6.2. Komuniteteve iu garantohet qasje dhe përfaqësim i barabartë në mediat publike transmetuese. Programeve për komunitetet do t'i ndahet kohë në kanalet e transmetimit publik që të sigurohet se perspektiva e komuniteteve zë një vend të rëndësishëm në transmetimin e lajmeve vendore.

6.3. Komunitetet kanë të drejtën e programeve në gjuhën e tyre në mediat publike transmetuese, në pajtim me ligjin. Programet e tilla duhet të mbulojnë aktivitetet e komunitetit përkatës dhe përmbajtje të tjera që janë në interes të tij, duke përfshirë lajmet, kulturën, sportin dhe argëtimin. Personat që iu përkasin komuniteteve kanë rol udhëheqës në prodhimin dhe shfaqjen e programeve të tilla.

6.4. Mediat publike transmetuese sigurojnë, në nivel kombëtar dhe lokal, një numër adekuat të orëve të programit në gjuhën e komunitetit duke përfshirë oraret me shikim/dëgjim maksimal. Numri minimal i orëve të programeve të komuniteteve do të përcaktohet me ligj.

6.5. Qeveria e Republikës së Kosovës obligohet të ndërmarrë të gjitha masat, në kuadër të pushtetit të saj, për ta siguruar një plan të frekuencave ndërkombëtare që do t'i lejojë komunitetit serb të Kosovës qasje në një kanal të pavarur të

licencuar televiziv mbarë-kosovar në gjuhën serbe, i cili veprimtarinë e vet do ta zhvillojë në mënyrë efektive dhe pa diskriminim, në pajtim me ligjin.

6.6. Garantohet pranimi i lirë i valëve të transmetimeve ndërkufitare, qofshin ato të drejtpërdrejta apo nëpërmjet mjeteve të ritransmetimit.

6.7. Personat që iu përkasin komuniteteve përfaqësohen në mënyrë adekuate në organet rregullatore që kanë të bëjnë me mediat në Republikën e Kosovës. Përfaqësuesit e komuniteteve emërohen nga Komisioni i Pavarur i Mediave në konsultim me organizatat përfaqësuese të komuniteteve.

6.8. Rregulloret që kanë të bëjnë me ndalimin e nxitjes apo përhapjes së urrejtjes ose jo tolerancës racore, etnike apo fetare duhet të zbatohen edhe për mediat transmetuese që u përmenden më lart.

Neni 7
Feja

7.1. Republika e Kosovës nuk ka fe zyrtare dhe është neutrale për sa u përket çështjeve të besimeve fetare.

7.2. Personat që iu përkasin komuniteteve kanë të drejtë në lirinë e besimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejtë përfshinë lirinë për të pasur, mos pasur, mbajtur apo ndryshuar fenë apo besimin, dhe lirinë për të manifestuar, qoftë vetëm apo në komunitet me të tjerët, publikisht apo privatisht, fenë apo besimin, në adhurim, mësimdhënie, praktikë dhe vëzhgim. Kjo e drejtë do t'iu nënshtrohet vetëm kufizimeve që parashihen me ligj dhe standarde ndërkombëtare.

7.3. Republika e Kosovës nuk ndërhyn në lirinë fetare të komuniteteve dhe personave që iu përkasin atyre.

7.4. Praktikimi i riteve fetare, format tradicionale të jetesës fetare, duke përfshirë jetesën monastike dhe edukimin fetar mbrohen krahas pronës së kishës.

7.5. Republika e Kosovës promovon ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare të gjithë komuniteteve si pjesë përbërëse e trashëgimisë së Kosovës.

7.6. Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë i ofrohet mbrojtje dhe gëzim i të drejtave, privilegjeve dhe imuniteteve të saj në pajtim me Ligjin mbi Themelimin e Zonave të Veçanta të Mbrojtura.

7.7. Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë të themelojnë organizata dhe institucione fetare të komunitetit në pajtim me ligjin. Ushtrimi i kësaj të drejte do t'i nënshtrohet vetëm kërkesës ligjore për regjistrim. Kufizimet aplikohen vetëm ashtu si parashikohet në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 8
Arsimimi

8.1. Të gjithë personat që iu përkasin komuniteteve kanë të drejtë të marrin shkollim publik në të gjitha nivelet, në njërën nga gjuhët zyrtare të Kosovës që ata e zgjedhin. Personat që iu përkasin komuniteteve kanë të drejtë në shkollim publik parashkollor, fillor dhe të mesëm në gjuhën e tyre edhe nëse ajo nuk është gjuhë zyrtare. Qeveria vendos pragjet e arsyeshme dhe të zbatueshme për themelimin e klasave apo shkollave të veçanta që funksionojnë në gjuhët e komuniteteve.

Pragu minimal për klasa apo shkolla të tilla është më i ulët se pragjet e vendosura normalisht për institucionet dhe klasat shkollore. Pragjet maksimale do të korrespondojë me pragjet e vendosura normalisht për klasat shkollore. Kjo rregullohet me ligj.

8.2. Në komunat në të cilat, ka një numër të pamjaftueshëm nxënësish për të vënë në dispozicion shkollimin në një gjuhë jo-zyrtare të komunitetit, Qeveria e Republikës së Kosovës e ka për detyrim të ofrojë alternativa, duke përfshirë transportin e subvencionuar deri në zonat ku ofrohet shkollim i tillë, shkollimin në distancë, aranzhimet e ndryshme për mësimdhënie të lëvizshme, apo edhe ofertat për qëndrim në konvikt.

8.3. Republika e Kosovës garanton mundësitë ekzistuese për trajnim profesional dhe shkollim të lartë në nivel universitar, në gjuhët e komuniteteve. Në pajtim me nevojën e shprehur dhe mundësitë financiare, Qeveria e Republikës së Kosovës do të ofrojë shkollim të mëtutjeshëm të lartë dhe programe të trajnimit profesional në gjuhët e komuniteteve.

8.4. Komunitetet dhe pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë të themelojnë dhe menaxhojnë institucionet e tyre private për shkollim dhe trajnim, për të cilat mund të ofrohet ndihmë financiare publike, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare. Institucionet e tilla kanë të drejtë të aplikojnë për akreditim nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, nëse janë në përputhje me standardet e përgjithshme arsimore të plan programeve të Republikës së Kosovës, në pajtim me ligjin. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë monitoron cilësinë e mësimdhënies në pajtim me ligjin.

8.5. Shkollat që japin mësim në gjuhën serbe mund të aplikojnë plan-programe apo tekste mësimore të përgatitura nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë pas njoftimit të Ministrisë Kosovare të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në pajtim me procedurat e vendosura në Ligjin për Arsimin Lokal.

8.6. Universiteti i Mitrovicës Veriore është një institucion autonom publik i shkollimit të lartë. Komuna e Mitrovicës Veriore ka autoritet të ushtrojë përgjegjësi për këtë universitet në gjuhën serbe siç rregullohet me ligj.

8.7. Për të gjitha rastet përveç atyre të përmendura në paragrafin 5 të këtij neni, Qeveria e Republikës së Kosovës harton plan-programe të integruara në gjuhët e komuniteteve të cilat nuk janë gjuhë zyrtare si dhe standardet arsimore për të gjitha aspektet e shkollimit dhe monitoron dhe përforcon cilësinë e mësimdhënies në gjuhet e komuniteteve. Institucionet shkollore që veprimtarinë e tyre e zhvillojnë në gjuhën e një komuniteti që nuk është gjuhë zyrtare, mund të t'i dizajnojnë plan-programet shkollore të tyre në mënyrën e tyre, me kusht që ato të jenë në përputhje me kornizën e përgjithshme të plan-programit të integruar dhe që t'i përmbushin standardet e arritjes që përcaktohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Për më tepër, komunitetet kanë të drejtë që në bashkëpunim me Qeverinë, të përgatisin module shkollore që kanë të bëjnë me kulturën, historinë dhe traditat e tyre.

8.8. Qeveria e Republikës së Kosovës në përgatitjet e saj për trajnimin e mësuesve, siguron që të ketë kuadër të mjaftueshëm për t'i përmbushur obligimet e cekura ne paragrafin 6 të këtij neni. Trajnimi i mësuesve për ata që kërkojnë të japin mësim në gjuhët e komuniteteve zhvillohen në gjuhët përkatëse. Gjatë

përzgjedhjes së kandidatëve të përshtatshëm, autoritetet duhet të kenë parasysh nevojën që mësimdhënia në gjuhët e komuniteteve të ofrohet nga folësit e kualifikuar të gjuhës së dhënë, ku parapëlqehen folësit burimor.

8.9. Qeveria e Republikës së Kosovës siguron që drejtuesit dhe mësuesit e institucioneve të shkollimit publik që aktivitetin e tyre e zhvillojnë në gjuhët e komuniteteve janë kryesisht përfaqësues të këtyre komuniteteve dhe njohin në tërësi identitetin e komunitetit përkatës.

8.10. Në shkollat fillore dhe të mesme në të cilat gjuha e mësimit nuk është gjuhë zyrtare, nxënësit do të mësojnë një gjuhë zyrtare sipas zgjedhjes së tyre në pajtim me ligjin.

8.11. Qeveria e Republikës së Kosovës siguron qasje të barabartë të personave që iu përkasin komuniteteve në arsimin e lartë në nivelin universitar. Në këtë drejtim, Qeveria krijon masa të veçanta për të siguruar pranimin e kandidatëve që vijnë nga shkollat e komuniteteve në institucionet e arsimit të lartë dhe universitar.

8.12. Plan-programi shkollor kombëtar i Kosovës mbulon historinë, kulturën dhe atributet e tjera të komuniteteve tradicionalisht të pranishme në vend, me qëllim që të nxis frymën e respektit, mirëkuptimit dhe tolerancës midis të gjitha komuniteteve në Kosovë. Organizatat përfaqësuese të komuniteteve do të konsultohen gjatë hartimit të plan-programit të tillë.

Neni 9
Mundësitë Ekonomike dhe Shoqërore

9.1. Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë të gëzojnë pronën e tyre dhe mundësinë për të punuar me kompensim të drejtë dhe të barabartë, pa diskriminim.

9.2. Republika e Kosovës, krahas masave me synim të veçantë, zhvillon programe dhe iniciativa të tjera për punësim publik, që kanë synim të tejkalojnë diskriminimin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të personave që iu përkasin komuniteteve. Konsiderim i veçantë i kushtohet përmirësimit të gjendjes së komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

9.3. Planifikimi, zhvillimi, implementimi dhe vlerësimi i mekanizmave të veçantë për shtimin e mundësive për zhvillim ekonomik dhe punësim për grupet e cenueshme brenda shoqërisë bëhet me pjesëmarrjen dhe konsultimin e plotë të organizatave përfaqësuese të komuniteteve. Vëmendje e veçantë i kushtohet të varfërve, të moshuarve, fëmijëve, familjeve të reja dhe familjeve me një prind, vejushave dhe anëtarëve me aftësitë të kufizuara të komuniteteve.

9.4. Republika e Kosovës siguron barazi midis meshkujve dhe femrave në punësim, mundësi ekonomike dhe shoqërore si dhe monitoron rregullisht nëse femrat janë në rrezik të diskriminimit të dyfishtë, si rrjedhojë e gjinisë apo përkatësisë në ndonjë komunitet të veçantë. Qeveria miraton masa të veçanta kundër këtij diskriminimi.

9.5. Personat që u përkasin komuniteteve kanë të drejtë në përfaqësim të barabartë në punësim në të gjitha nivelet në ndërmarrjet publike, institucionet publike, përfshirë sektorin e sigurisë, gjyqësorin, shërbimin e prokurorisë, agjencitë qeveritare që kanë të bëjnë me administrimin e drejtësisë dhe shërbimet korrektuese, mbrojtjen, sigurinë dhe inteligjencën.

9.6. Nëse personat që iu përkasin komuniteteve hasin në vështirësi në përmbushjen e standardeve për pranim në postet e shërbimeve publike, veçanërisht përfshirë postet e larta, merren masa të posaçme.
9.7. Personat që iu përkasin komuniteteve do të kenë mundësi të barabarta në procedurat që kanë të bëjnë me prokurimin publik apo privatizimin e pronës publike.

Neni 10
Shëndetësia

10.1. Qeveria e Republikës së Kosovës ndërmerr masat e nevojshme për t'u siguruar se personat që iu përkasin komuniteteve kanë qasje të barabartë në kujdesin shëndetësor pa diskriminim.
10.2. Republika e Kosovës merr masa të veçanta për të siguruar ofrimin e shërbimeve shëndetësore të kënaqshme për personat që iu përkasin komuniteteve të rrezikuara në pikëpamje shoqërore dhe ekonomike.
10.3. Udhëzimet e kujdesit shëndetësor do të jenë në dispozicion në gjuhët përkatëse të komuniteteve.
10.4. Republika e Kosovës njeh kualifikimet mjekësore të përfituara jashtë vendit, në veçanti të kualifikimeve të personave që flasin gjuhë të komuniteteve, me kusht që këto kualifikime mjekësore të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të akreditimit bazuar në ligjin në fuqi.
10.5. Informacioni që ka të bëjë me edukimin e kujdesit shëndetësor, përfshirë informacionin për të drejtat dhe detyrimet e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre ekspozohen dhe ofrohen në gjuhët e komuniteteve përkatëse.
10.6. Republika e Kosovës vendos procedura efektive, transparente, me mundësi pjesëmarrjeje dhe qasje për të monitoruar qasjen në shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe ofrimin e këtyre shërbimeve për pjesëtarët e komuniteteve.

Neni 11
Pjesëmarrja politike

11.1. Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë pjesëmarrjeje efektive në vendimmarrje politike në të gjitha nivelet e qeverisë, përfshirë vendimet që janë me rëndësi të veçantë për ta ose për zonën në të cilën ata jetojnë. Një pjesëmarrje e tillë sigurohet përmes përfaqësimit në Kuvendin, Qeverinë, Gjyqësorin dhe organet e tjera të Republikës së Kosovës që parashihen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
11.2. Pjesëmarrja në qeverisjen lokale garantohet përmes ligjit për vetëqeverisjen lokale, përfshirë themelimin e zyrës së Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit Komunal për Komunitete dhe nënkryetarit të Komunës për Komunitete.
11.3. Personat që u përkasin komuniteteve kanë të drejtë të formojnë parti politike dhe të kandidohen për poste dhe pozita zyrtare në të gjitha nivelet e qeverisjes.
11.4. Partitë politike, përveç atyre të themeluara nga personat që ju përkasin komuniteteve, të cilat synojnë t'i përfaqësojnë ato komunitete, nuk mund ta përjashtojnë personat në bazë të përkatësisë së tyre në komunitete, dhe inkurajohen të jenë të hapura ndaj shumëllojshmërisë së shoqërisë së Kosovës.

11.5. Në përputhje me paragrafin 3 të nenit 5 të këtij ligji, organizatat përfaqësuese të komuniteteve inkurajohen të ndihmojnë komunitetet përkatëse në përfaqësimin e interesave të tyre në mënyrë të konsoliduar dhe të luajnë rolin e tyre në vetë menaxhimin e burimeve të vëna në dispozicion për avancimin e jetës së tyre kulturore.

Neni 12
Këshilli Konsultativ për Komunitete

12.1. Do të themelohet Këshilli Konsultativ për Komunitete, nën ombrellën e Presidentit të Republikës së Kosovës. Ky këshill do ketë mandatin si vijon:
   a) të ndihmojë në organizimin dhe artikulimin e pikëpamjeve të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në lidhje me legjislacionin, politikat dhe programet publike që kanë rëndësi të veçantë për to;
   b) të ofrojë një forum për konsultim dhe bashkërendim midis komuniteteve dhe të sigurojë funksionimin efikas të organizatave përfaqësuese të komuniteteve, në përputhje me kodin e mirësjelljes që do të miratohet nga Këshilli Konsultativ për Komunitete;
   c) të ofrojë një mekanizëm për shkëmbim të rregullt ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve shtetërore;
   d) të ju ofroj mundësinë komuniteteve që në faza të hershme, të marrin pjesë në nismat ligjore apo të politikave të cilat mund të përgatiten nga Qeveria ose Kuvendi, të sugjerojnë nisma të tilla dhe që mendimi i tyre të inkorporohet në projekte dhe programe përkatëse, përfshirë strategjinë dhe raportin vjetor, në bazë të nenit 13 të këtij ligji dhe në pajtim me ligjin;
   e) të plotësojë kërkesën për konsultime tjera të detyrueshme në relacion me akte të caktuara ligjore që janë paraparë në Kushtetutë dhe ligj;
   f) të ju mundësojë komuniteteve që të marrin pjesë në vlerësimin e nevojave, hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve që u kushtohen pjesëtarëve të tyre apo që kanë rëndësi të posaçme për ta;
   g) të jap rekomandime gjatë procesit të vendimmarrjes në lidhje me caktimin e fondeve, qofshin ato ndërkombëtare apo të ndara nga buxheti i Republikës së Kosovës, për projekte që u dedikohen komuniteteve apo interesave të tyre të veçanta;
   h) të kontribuojë në raportimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës që u drejtohet mekanizmave ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut; dhe
   i) të ngritë vetëdijen për brengat e komuniteteve brenda Republikës së Kosovës dhe t'u kontribuojë marrëdhënieve harmonike midis të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës.

12.2. Këshilli konsultativ për komunitete themelohet në bazë të një statuti që pasqyron dispozitat e këtij ligji. Ky statut i Këshillit do të miratohet pas konsultimit me komunitetet me anë të një dekreti presidencial brenda tre muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Këshilli fillon punën një muaj pas miratimit të këtij Statuti.

12.3. Këshilli konsultativ për komunitete takohet një herë në muaj. Këshilli mund të krijoj grupe punuese të specialisteve për çështje si arsimi, punësimi, ofrimi i ndihmës sociale, kulturës, gjuhen dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me to të cilët mund të takohen edhe më shpesh.

12.4. Këshill Konsultativ për Komunitete takohet dy herë në vit për ta bërë një shqyrtim të përgjithshëm të politikave dhe shqetësimeve të komuniteteve në Republikën e Kosovës, që do të kryesohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

12.5. Në takimet e rregullta të Këshillit konsultativ të komuniteteve, kryesimin do ta marrë një anëtar i Këshillit, i cili zgjidhet nga ky këshill për një periudhë njëvjeçare. Kryesuesi ndihmohet nga dy zëvendës kryesues të cilët emërohen nga dy komunitete të cilave nuk iu përket kryetari.

12.6. Këshilli Konsultativ për Komunitete do të përbëhet nga përfaqësues të të gjitha komuniteteve të Kosovës dhe të Qeverisë, Zyrës së Presidentit dhe agjencive të tjera relevante. Do të ketë nga dy (2) përfaqësues të komunitetit rom, egjiptian dhe atij ashkali, prej të cilëve nga një (1) mund të jenë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Do të ketë nga tre (3) përfaqësues të komunitetit boshnjak dhe turk, prej të cilëve nga një (1) mund të jenë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Do të ketë pesë (5) përfaqësues të komunitetit serb, prej të cilëve dy (2) mund të jenë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovë dhe do të ketë dy (2) anëtarë nga komuniteti goran, prej cilëve njëri mund të jetë deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Për secilin anëtar, mund të emërohet një zëvendës anëtar. Ata anëtarë të cilët nuk janë deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë zakonisht kryesues apo zëvendës kryesues apo të emëruar të tjerë të lartë të organizatave përfaqësuese të komuniteteve apo përfaqësues të shoqatave ose OJQ-ve që kanë të bëjnë me komunitetin e caktuar.

12.7. Përfaqësuesit e komunitetit të caktuar do të kandidohen nga ai komunitet, përmes organizatave përfaqësuese të komunitetit të tyre. Nëse nuk ka ndonjë organizatë të tillë, apo ka më shumë organizata që deklarojnë se i përfaqësojnë interesat e komunitetit në fjalë, Zyra e Presidentit do të kërkoj të mbështesë krijimin e një mekanizmi bashkërendues për komunitetin në fjalë dhe të ndërmjetësojë midis grupeve konkurrente nëse ka nevojë. Kur nuk është e mundur të arrihet pajtimi, Presidenti emëron përfaqësuesin përkatës në pajtim me kriteret e caktuara në statutin e Këshillit Konsultativ për Komunitete.

12.8. Presidenti emëron anëtarët e Këshillit Konsultativ për Komunitete për një mandat dyvjeçar, i cili mund të zgjatet një herë, në pajtim me nominimet që janë bërë nga organizatat përfaqësuese të komunitetit. Nëse Presidenti vendos të refuzoj emërimin e një apo më shumë të kandidatëve, ai/ajo duhet ta shpjegojë mendimin e tij për këtë vendim dhe të kërkojë nga shoqata e caktuar përfaqësuese e komunitetit që ta kandidoj dikë tjetër.

12.9. Zyra e Presidentit përfaqësohet nga një përfaqësues i lartë i saj. Mund të marrin pjesë edhe ministrat apo zëvendësministrat e ministrive dhe përfaqësuesit e agjencive shtetërore, fushëveprimi i të cilëve është me rëndësi të veçantë për komunitetet. Numri i përfaqësuesve të qeverisë që kanë të drejtë vote në Këshillin Konsultativ për Komunitete nuk duhet ta tejkalojë një të tretën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këtij këshilli. Kryesuesi i Këshillit Konsultativ për Komunitete mund të ftojë edhe organizata të shoqërisë civile, ekspertë individualë, përfaqësues shtesë qeveritarë ose përfaqësues të agjencive ndërkombëtare të marrin pjesë në takimet e këtij këshilli, pa të drejtë vote.

12.10. Këshilli Konsultativ për Komunitete do ta nxjerre Rregulloren e vet të punës dhe

do të bie dakord për një Plan vjetor të punës, në të cilin do të përcaktohen objektivat e qarta. Këshilli Konsultativ për Komunitete do t'i raportojë rregullisht, së paku një herë në vit, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës. Këshilli Konsultativ për Komunitete gjithashtu do ta njoftojë publikun e gjerë për aktivitetet dhe raportin e tij.

12.11. Këshilli Konsultativ për Komunitete mbështetet nga një Sekretariat, i cili do të vendoset në zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe të cilit do t'i ndahet buxheti që do t'i mundësojë funksionim efikas dhe mes të tjerash angazhim në zhvillimin e studimeve dhe hulumtimeve, të kërkojë këshilla nga ekspertë të jashtëm, t'i ngritë kapacitetet e anëtarëve të vet dhe t'i publikojë aktivitetet e veta.

12.12. Këshilli Konsultativ për Komunitete, jep rekomandime në bazë të mandatit të tij. Kur rekomandimet i drejtohen institucioneve publike, këto institucionet, brenda një (1) muaji duhet ta ofrojnë një përgjigje të arsyeshme, të cilat përfshijnë informata rreth veprimeve të institucioneve specifike që janë ndërmarrë apo do të ndërmerren. Kur Këshilli konsulton në lidhje me hartimin e ndonjë projektligji, Këshilli ka të drejtë të dëgjohet në fazën e shqyrtimit të projektligjit nga komisioni përkatës dhe të parashtrojë komente apo vërejtje përmbajtjesore me shkrim brenda një (1) muaji. Këshilli Konsultativ për Komunitete ka të drejtë të marrë një përgjigje të arsyetuar për rekomandimet e tij brenda një (1) muaji në rast se këshilla e tij nuk merret pjesërisht apo tërësisht në konsiderim.

12.13. Këshillit Konsultativ për Komunitete do t'i ndahet një buxhet për hartimin e programeve mbi çështjet e komuniteteve në Kosovë. Pjesë të këtij buxheti Këshilli do t'i ndajë për organizatat përfaqësuese të komuniteteve, OJQ-të dhe aktorët e tjerë që i mbështesin projektet që kanë për qëllim përmbushjen e interesave të komuniteteve. Këshilli po ashtu do ta aranzhojë ndërtimin e kapaciteteve brenda organizatave përkatëse përfaqësuese të komuniteteve, për të siguruar organizimin efektiv dhe artikulimin e interesave të komuniteteve.

12.14. Këshilli Konsultativ për Komunitete mund të ndërmerr aktivitete kulturore dhe shoqërore, të cilat i bashkojnë komunitetet e ndryshme dhe promovojnë mirëkuptimin dhe tolerancën e përbashkët ndërmjet komuniteteve, duke synuar ndërtimin e besimit dhe harmonisë ndërmjet komuniteteve.

Neni 13
Zbatimi

13.1. Në konsultim me Këshillin Konsultativ të Komuniteteve dhe palëve tjera me interes kombëtare dhe ndërkombëtare përkatëse, Qeveria përgatitë, miraton dhe publikon, një herë në vit, strategjinë gjithëpërfshirëse për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. Qeveria paraqet raportin vjetor gjithëpërfshirës Kuvendit të Republikës së Kosovës mbi zbatimin e strategjisë së saj.

13.2. Në këtë Strategji përcaktohen objektivat dhe masat e veçanta për luftimin e përjashtimit dhe margjinalizimit të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre nga jeta ekonomike, shoqërore dhe kulturore në Kosovë dhe për zbatimin e plotë të këtij ligji.

13.3. Raporti do të përfshijë informata të plota me të dhëna të detajuara mbi zbatimin

e strategjisë në bazë të paragrafit 2 të këtij neni, përfshirë të dhënat mbi aktivitetet, zhvillimet dhe konstatimet e kërkuara sipas ligjit.

13.4. Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë të:
   a) të mbrojnë të drejtat e tyre para të gjitha gjykatave në Republikën e Kosovës.
   b) të parashtrojnë ankesë në Zyrën e Ombudspersonit të Republikës së Kosovës dhe në organet e tjera të specializuara, përfshirë komisionin e pavarur të medieve, dhe komisionin e gjuhëve, dhe
   c) të informoj zëvendës kryetarin e kuvendit komunal për komunitete kur ata besojnë se të drejtat e tyre janë dhunuar.

13.5. Organizatat përfaqësuese të komuniteteve të themeluara sipas paragrafit 3 të nenit 5 të këtij ligji dhe Këshilli konsultativ për komunitete kanë të drejtë për të parashtruar kërkesë Presidentit, në lidhje me çështjet që janë me interes për ta, kanë të drejtë ligjore të paraqesin ankesa në lidhje me shkeljet e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në pajtim këtë ligj.

13.6. Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre, të cilat veprojnë nëpërmjet organizatave të tyre përfaqësuese dhe Këshillit konsultativ për komunitete, do të ftohen për ta ofruar kontributin e tyre në raportimin mbi pajtueshmërinë nga ana e Republikës së Kosovës me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe për të mbajtur kontakte me organet relevante ndërkombëtare.

Neni 14
Amendimi ose shfuqizimi

Ky Ligj mund të amendamentohet ose shfuqizohet vetëm në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës
Me datën: 13.03.2008

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III / Nr. 28 / 04 QERSHOR 2008

LIGJI Nr. 04/L-115
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË KANË TË BËJNË ME PËRFUNDIMIN E MBIKËQYRJES NDËRKOMBËTARE TË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË KANË TË BËJNË ME PËRFUNDIMIN E MBIKËQYRJES NDËRKOMBËTARE TË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Neni 1
Qëllimi

1. Ky ligj ka për qëllim të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve në vijim për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës:
   1.1. Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
   1.2. Ligjit Nr. 03/L-075 për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës;
   1.3. Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
   1.4. Ligjit Nr. 03/L-079 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale;
   1.5. Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
   1.6. Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04 L 101 për Fondet Pensionale të Kosovës;
   1.7. Kodit Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë;
   1.8. Ligji Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat;
   1.9. Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat;
   1.10. Ligji Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
   1.11. Ligji Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
   1.12. Ligji Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë;
   1.13. Ligji Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme;
   1.14. Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës;
   1.15. Ligji Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativ të Komunave;

1.16. Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës;
1.17. Ligji Nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës;
1.18. Ligji Nr. 03/L-237 për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave;
1.19. Ligji Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës;
1.20. Ligji Nr. 03/L-082 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës.
1.21. Ligji Nr. 03/L-033 për Statusin, imunitetet dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin e Kosovës dhe praninë ndërkombëtare ushtarake, si dhe personelin e saj.

Neni 2
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Ligji)

1. Neni 15 i ligjit bazik pas paragrafit 1. shtohet paragraf i ri 2. me tekstin si në vijim:
   2. Gjykatësit ndërkombëtarë, të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë ligj, vazhdojnë të marrin pagën e tyre të specifikuar sipas vendimit për emërim. Qeveria e Kosoves merr pjesë në pagesën e gjykatësve ndërkombëtarë, në periudhën e përcaktuar në vlerë të pagave të gjyqtarëve vendorë.
2. Neni 55 i ligjit bazik, paragrafi 1. dhe paragrafi 2 fshihen nga teksti i ligjit dhe shtohet një paragraf i ri me tekstin si në vijim:
   Mandati i gjykatësve ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim.

Neni 3
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-075 për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës (Ligji)

1. Neni 8 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 8

Auditori i përgjithshëm, i emëruar në përputhje me Kushtetutën dhe me këtë ligj, vazhdon të qëndrojë në post deri në përfundim të mandatit, me kompensimin e cekur në kushtet specifike të emërimit të tij. Qeveria e Kosovës siguron fonde në vlerën e përcaktuar me marrëveshjen në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Zyrës se Auditorit të përgjithshëm.

Neni 4
Ndryshimet dhe plotësimet Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji)

1. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1.12, që përkufizon Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar, fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Kuvendi pas propozimit nga qeveria zgjedh tre (3) anëtarë ndërkombëtarë drejtorë të bordit. Bordi, po ashtu, emëron një shtetas të Kosovës drejtor të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit, i cili nuk do të jetë anëtar i Bordit. Bordi, përveç kryesuesit, po ashtu, emëron zëvendëskryesues njërin prej anëtarëve të tij. Për emërimin, shkarkimin ose ndryshimin e kushteve të referimit të Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit kërkohet vota afirmative e shumicës së Bordit të Drejtorëve. Anëtarët ndërkombëtarë zgjedhën më mandat deri më 31 gusht 2014.

3. Neni 14 i ligjit bazik, paragrafët 7., dhe 9., vlejnë deri në përfundimin e mandatit të anëtarëve ndërkombëtarë të bordit.
4. Neni 31 i ligjit bazik, pas paragrafit 5. shtohet një paragraf i ri 6. me tekstin si në vijim:
   6. Nëse një anëtar ndërkombëtar i bordit i emëruar në pajtim me nenin 31 (5) jep dorëheqje nga Bordi dhe nëse kjo dorëheqje ose largim nga posti ndodh deri më 31 gusht 2014 atëherë ai/ajo do të zëvendësohet me një ndërkombëtar tjetër.

Neni 5
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-079 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale (Ligji)

1. Neni 4 i ligjit bazik që ndryshon nenin 5.2 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   5.2. Bordi mbikëqyrës përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve të cilët emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryeministri.
2. Neni 8 i ligjit bazik që ndryshon nenin 6.1 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   6.1. Sekretaria Ekzekutive ka drejtorin dhe zëvendësdrejtorin të cilët emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryeministri.
3. Neni 10 i ligjit bazik që ndryshon nenin 7.1 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   7.1. Komisioni përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të cilët emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.
4. Neni 13 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 13

Kuvendi, në konsultim me Komisionin, mund të themelojë panele shtesë të Komisionit, anëtarët e të cilëve do të emërohen në bazë të neneve 7.1 dhe 7.2.

5. Neni 16 i ligjit bazik që ndryshon nenin 12.8 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   12.8. Gjykata Supreme e Kosovës vendos lidhur me ankesat në trupin gjykues prej tre (3) gjyqtarëve të cilët emërohen nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës.
6. Pas nenit 27 të ligjit bazik, shtohet një nen i ri 27.A me tekstin si në vijim:

Neni 27.A

1. Mandati i tre (3) anëtarëve ndërkombëtarë të Bordit mbikëqyrës (përfshi edhe kryesuesin), i drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive, i dy (2) anëtarëve ndërkombëtarë të Komisionit (përfshi edhe kryesuesin), si dhe i dy gjykatësve ndërkombëtarë në panelet e ankimit të Gjykatës Supreme të cilët janë emëruar në pajtim me Kushtetutën do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim.
2. Anëtarët dhe gjykatësit ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë Ligj vazhdojnë të marrin pagën e tyre të specifikuar sipas kushteve të emërimit të tyre.
3. Qeveria e Kosoves do të sigurojë fonde për drejtorin e Sekretariatit Ekzekutive të barabartë me pagën e një anëtari vendor të Bordit Mbikëqyrës.
4. Nëse një anëtar ndërkombëtar i emëruar ne pajtim me Kushtetutën jep dorëheqje ose largohet nga pozita e tij/saj dhe nëse ky largim ose dorëheqja ndodh para datës 31 gusht 2014, atëherë ai/ajo do të zëvendësohet me një ndërkombëtar, të dominuar nga Kryeministri për pozitat e anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë së Pronës dhe drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive, si dhe të nominuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme për pozitën e anëtarëve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Anëtareve të Panelit të Ankesave të Gjykatës Supreme, pas konsultimeve me PSBE.

Neni 6
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.3. fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.7, riformulohet me tekstin si në vijim:
   1.7. **Gjykatës Ndërkombëtar** - çdo gjykatës i Misionit Evropian për Politika të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, i cili është emëruar në pajtim me këtë ligj.
3. Neni 11 i ligjit bazik, paragrafi 2. riformulohet me tekstin si në vijim:
   2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Dhoma e Posaçme do të vazhdojë të respektojë dhe zbatojë parimin e kompensimit në vend të kthimit fizik. Kur vendoset për mjetin juridik që do të jepet në një rast të caktuar, Dhoma e Posaçme do të marrë parasysh edhe dispozitat në fuqi të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, duke përfshirë qëllimet publike që përcaktohen në preambulën e atij ligji.

Neni 7
Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04 L-101 për fondet pensionale të Kosovës

1. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 4.6, riformulohet me tekstin si në vijim:
   4.6. Komisioni për përzgjedhje, i propozon kandidatët Kuvendit për vendet e lira në anëtarësim ose për riemërim të anëtarëve të Bordit Drejtues. Komisioni për Përzgjedhje do të përbëhet nga guvernatori i BQK-së - kryesues, Auditori i

Përgjithshëm dhe Ministri i Financave. Mandati i secilit anëtar të emëruar në Bordin Drejtues zgjat tre vjet, me mundësi të rizgjedhjes, nëse mandati i anëtarëve të Bordit skadon dhe asnjë anëtar i ri nuk është emëruar, atëherë anëtarët e Bordit ekzistues do të vazhdojnë mandatin për nëntëdhjetë (90) ditë.

Neni 8
Ndryshimet dhe plotësimet e Kodit Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë (Kodi)

1. Neni 309 i ligjit bazik që rregullon emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave me pëlqimin e PCN-së, fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 1 i Aneksit D, i Kodit, fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 1

Ky Aneks ofron përjashtimet e posaçme të përkufizuara në këtë Aneks që do t'i jepen bashkësive fetare sipas përkufizimit në legjislacionin e aplikueshëm, duke përfshirë edhe legjislacionin për liritë fetare në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Neni 9
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat (Ligji)

1. Neni 1 i ligjit bazik, paragrafi 1.32, që përkufizon PCN-në fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 8 i ligjit bazik paragrafi 2. në rreshtin e tretë fshihet fjala “dhe PCN”.
3. Neni 88 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 10
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-199 për gjykatat (ligji)

1. Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 11, riformulohet me tekstin si në vijim:
   11. Nëse në njërën nga komunat e reja dhe të themeluara mbi bazën e Ligjit për Kufijtë Administrativë Komunal nuk ka gjykatë themelore, komuna me vendim të Kuvendit Komunal mund ta parqet kërkesën para Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK) për të vendosur mbi themelimin e gjykatës themelore në territorin e saj, ose që një nga gjykatat ekzistuese themelore në territorin e komunës tjetër të ketë juridiksion mbi territorin e komunës së re. Të njëjtën të drejtë e ka edhe komuna ekzistuese, ku shumica e popullatës i takon komunitetit jo shumicë në Kosovës, dhe në të cilën nuk ka gjykatë themelore.
      11.1. KGjK do të aprovojë kërkesat e tilla, përveç nëse vlerësohet se ngarkesat e lëndëve për atë juridiksion është e pamjaftueshme për ta arsyetuar ekzistimin e gjykatës së ndarë.
      11.2. Kur KGjK e aprovon kërkesën për themelimin e gjykatës së re

themelore, autoritetet kompetente do t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se cilado gjykatë e re, është themeluar dhe funksionale brenda periudhës gjashtë mujore prej datës së vendimit.

11.3. Nëse KGjK nuk aprovon kërkesën për themelimin e gjykatës së re themelore, ose kur komuna i kërkon gjykatës ekzistuese që të ketë juridiksion për territorin e vet, autoritetet kompetente do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për përmirësimin e qasjes në drejtësi për komunitetet lokale, e cila është vështirësuar për shkak të izolimit gjeografik, mungesës së sigurisë, ose për shkak të faktorëve të tjerë relevant. Këto masa mund të përfshijnë krijimin në kuadër të territorit të komunës së re, të një departamenti të gjykatës themelore ekzistuese prej së cilës komuna e re ka kërkuar të ketë kompetencë për territorin e vet, ose që gjykata themelore të mundësojë mbajtjen e seancave në territorin e komunës së re.

2. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Përbërja e Gjykatës së Apelit pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Republikës së Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore. Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin përkatës në fuqi, si dhe për të siguruar pjesëmarrjen e komunitetit në gjyqësor, pesëmbëdhjetë (15) për qind e numrit të tërësishëm të ulëseve në Gjykatën e Apelit, por jo më pak se dhjetë ulëse, garantohen për gjyqtarët nga radha e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

Neni 11
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.2. fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 1.3, riformulohet me tekstin si në vijim:

1.3. Për të siguruar se gjykatat pasqyrojnë përbërjen etnike të zonës së tyre të juridiksionit në përputhje me nenin 104(3) të Kushtetutës dhe me legjislacionin përkatës në fuqi, Këshilli do të marrë parasysh që të plotësojë vendet e lira të punës ose të ulëseve të rezervuara me anëtarë të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

3. Neni 7 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 7
Mandati i anëtarëve të Këshillit

Anëtarët e Këshillit zgjidhen me mandat 5 (pesë) vjeçar, siç ceket në nenin 108 (6) të Kushtetutës dhe në këtë ligj. Një anëtar i këtij Këshilli mund të zgjidhet për një mandat shtesë jo-vijues pesë (5) vjeçar.

4. Neni 16 i ligjit bazik, paragrafi 3., riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Në përputhje me nenin 104(3) të Kushtetutës, Këshilli zbaton masa dhe veprimet tjera me qëllim rekrutimi, të cilat i konsideron të nevojshme dhe të përshtatshme për të siguruar se një gjykatë ose degë e gjykatës pasqyron përbërjen etnike në zonën e tyre të juridiksionit.

5. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 1., riformulohet si në vijim:
   1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ndërmerr masa të nevojshme për të rritur numrin e gjyqtarëve nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë, prej radhëve të atyre gjyqtarëve që shërbejnë në Kosovë. Për të përmbushur përgjegjësitë e veta, Këshilli, ndër të tjera, nga aplikantët njëlloj të kualifikuar për të shërbyer si gjyqtarë u jep përparësi anëtarëve nga komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovës, ashtu siç është paraparë me nenin 108 të Kushtetutës.
6. Neni 17 i ligjit bazik, pas paragrafit 5., shtohen tre paragraf të rinjë 6, 7 dhe 8, me tekstin si në vijim:
   6. Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të hartojë një rregullore të veçantë për të përshkruar procesin e emërimit dhe të riemërimit të gjykatësve nga komunitetet e nën-përfaqësuara në mesin e gjykatësve që shërbejnë në Kosovë.
   7. Dhënia e përparësisë për kandidatët me kualifikime të barabarta nga komunitetet e nën-përfaqësuara, do të zbatohet përderisa përqindja e gjyqtarëve pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë në Kosovë të jetë nën pesëmbëdhjetë përqind (15%) dhe / përderisa përqindja e gjyqtarëve të cilët janë pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, të jetë nën tetë (8%).
   8. Mandati i dy anëtarëve ndërkombëtarë të Këshillit të emëruar në pajtim me Kushtetutën do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim. Anëtarët ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë ligj vazhdojnë të marrin pagën e tyre.
   9. Neni 52 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 12
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.7, fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 1.3 riformulohet me tekstin si në vijim:
   1.3. Siguron se prokuroritë pasqyrojnë përbërjen etnike të zonës së tyre të juridiksionit në përputhje me nenin 109 (4) dhe 110(3) të Kushtetutës.
3. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Këshilli zbaton masa dhe veprime rekrutimi, si dhe masa të tjera të cilat i konsideron të nevojshme për të siguruar që një zyrë prokuroriale pasqyron përbërjen etnike të zonës së juridiksionit përkatës.
4. Neni 17 i ligjit bazik, pas paragrafit 3. shtohet një paragraf i ri 4. me tekstin si në vijim:
   4. Këshilli harton rregullore të veçantë për të përshkruar procesin e emërimit dhe të riemërimit të prokurorëve nga komunitetet e nën-përfaqësuara në mesin e prokurorëve që shërbejnë në Kosovë.
5. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 1., riformulohet me tekstin si në vijim:
   1. Këshilli ndërmerr masa të nevojshme për të rritur numrin e prokurorëve nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë. Kur ka aplikantë njëlloj të kualifikuar për të shërbyer si prokurorë, Këshilli u jep përparësi anëtarëve nga komunitetet që janë të nënpërfaqësuara në Kosovë siç është paraparë edhe me nenin 109 (4) dhe 110 (3) të Kushtetutës.

6. Neni 18 i ligjit bazik, pas paragrafit 5, shtohet paragrafi i ri 6, me tekstin si në vijim:
   6. Dhënia e përparësisë për kandidatët me kualifikime të barabarta nga komunitetet e nën-përfaqësuara, do të zbatohet përderisa përqindja e prokuroreve pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë në Kosovë të jetë nën pesëmbdhjetë përqind (15%) dhe / ose përderisa përqindja e prokurorëve të cilët janë pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, të jetë nën tetë përqind (8%).

Neni 13
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë (Ligji)

1. Pjesa e parë e preambulës se ligjit, riformulohet me tekstin si në vijim:
   Në bazë të nenit 65 (1) dhe ne pajtim me dispozitat kalimtare dhe përfundimtare nga kreu XIII dhe XIV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Pas nenit 7 të ligjit bazik shtohet një nen i ri 7.A me tekstin si në vijim:

Neni 7.A
Statusi i Kishës Ortodokse Serbe

1. Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë konsiderohet pjesë përbërëse e Kishës Ortodokse Serbe (KOS).
2. Emri dhe organizimi i brendshëm i Kishës Ortodokse Serbe, duke përfshirë edhe hierarkinë dhe veprimtaritë e saj, do të respektohen.
3. Nuk do të ketë ndalim arbitrar për hyrje në Kosovë ose qëndrim brenda Kosovës për priftërinjtë, kandidatët për prift, murgjve, murgeshave dhe vizitorëve.
4. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 7.3, fjalët "**themelojnë dhe**", fshihen nga teksti i ligjit.
5. Neni 8 i ligjit bazik, paragrafi 1, riformulohet me tekstin si në vijim:
   1. Ndërtesat dhe objektet që u takojnë bashkësive fetare, që janë të dedikuara për kryerjen e ceremonive fetare konsiderohen të pacenueshme për sa i përket ndërhyrjes së autoriteteve qeveritare dhe në to mund të hyhet vetëm me pëlqimin e institucionit përkatës fetar, përveç nëse është lëshuar ndonjë urdhër gjyqësor për shkak të aktiviteteve ilegale dhe në rast të rrezikut për jetën ose shëndetin.
6. Neni 12 i ligjit bazik, pas paragrafit 12.4 shtohet një paragraf i ri 12.5 me tekstin si në vijim:
   12.5. Përveç përjashtimeve të përmendura më lart, bashkësitë fetare gëzojnë privilegje doganore dhe tatimore për veprimtari ekonomike, që janë specifike për vetë-qëndrueshmërinë e tyre financiare, siç do të definohet me një akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e financave. Këto privilegje përfshijnë importimin dhe blerjen e produkteve qenësore për prodhim, të materialeve, pajisjeve dhe bagëtisë; dhe eksportimin e produkteve që dalin nga aktivitetet e lartpërmendura.

Neni 14
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1. përkufizimi "**Propozimin Gjithëpërfshirës**", fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Objekt i shpronësimit sipas këtij ligji mund të jenë të drejtat private pronësore dhe të drejtat tjera private për ose ndaj një prone të paluajtshme, me përjashtim të asaj prone të paluajtshme që bën pjesë në atë kategori të pronës, për të cilën Kushtetuta në mënyrë specifike thotë se nuk do të jetë objekt i shpronësimit.
3. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3, shtohet nën-paragraf i ri 3.1. me tekstin si në vijim:
   3.1 Prona e luajtshme dhe e paluajtshme, si dhe asetet tjera të Kishës Ortodokse Serbe do të jenë të pacenueshme dhe nuk do të jenë objekt i shpronësimit.

Neni 15
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (ligji)

1. Pas nenit 3 shtohet nen i ri 3.A me tekstin si në vijim:

Neni 3.A
Të drejtat e refugjatëve dhe personave të zhvendosur

1. Të gjithë refugjatët nga Kosova dhe personat e zhvendosur brenda vendit do të kenë të drejtën e kthimit dhe kërkimit të pronës së tyre dhe posedimeve personale, në pajtim me ligjet vendore dhe ndërkombëtare. Çdo person do të ketë të drejtë të marrë vendim të lirë dhe të jetë i informuar për vendin ku ai kthehet.
2. Institucionet e Republikës së Kosovës ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të krijuar kushte te favorshme për kthim të sigurt dhe të denjë të refugjatëve dhe personave të zhvendosur, bazuar në vendimet e tyre të lira dhe të bazuara në informata të sakta, përfshirë përpjekjet për të promovuar dhe mbrojtur lirinë e tyre të lëvizjes dhe mbrojtjen nga kërcënimi
3. Kushtet e kthimit të personave të zhvendosur dhe mekanizmat e bashkëpunimit me institucionet relevante ndërkombëtare do të përcaktohen nga institucionet e Republikës së Kosovës në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e aplikueshme."

Neni 16
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativë të Komunave (ligji)

1. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Bordi do të përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë, me nga pesë (5) përfaqësues të zgjedhur nga secila komunë dhe një (1) përfaqësues i zgjedhur nga Kryeministri.

2. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 4. riformulohet me tekstin si në vijim:
   4. Kryesuesi i Bordit përzgjidhet nga Kryeministri.
3. Neni 14 i ligjit bazik, fshihet termi **"dhe PCN do të ndërmarrin"** dhe zëvendësohet me termin: "**ndërrmer**".
4. Në Shtojcën 1 (Zonat Kadastrale) të ligjit bazik, emërtimi i komunës "**Hani i Elezit**" në gjuhën serbe dhe angleze ndryshohet në "**Elez Han**"

Neni 17
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës (ligji)

1. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi (c) riformulohet me tekstin si në vijim:
   (c) Një (1) anëtar, i përzgjedhur nga Kryeministri.
2. Neni 14 i ligjit bazik, paragrafi (b), nënparagrafi (iv) riformulohet me tekstin si në vijim:
   iv. Një (1) anëtar, i përzgjedhur nga Kryeministri.

Neni 18
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës (ligji)

1. Titulli i nenit 29 të ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 29
Regjistrimi dhe përcaktimi i shtetësisë

Neni 19
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-237 për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave (Ligji)

1. Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 4.12., riformulohet me tekstin si në vijim:
   4.12 Një (1) përfaqësues nga një prej Universiteteve publike, anëtar;

Neni 20
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës (ligji)

1. Neni 9 i ligjit bazik, paragrafi 3., riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Forca e Sigurisë së Kosovës është e strukturuar dhe e përgatitur për të përmbushur funksionet e sigurisë që nuk i përkasin policisë ose organizatave tjera për zbatim të ligjit.
2. Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 2., riformulohet me tekstin si në vijim:
   2. Forca e Sigurisë së Kosovës është e armatosur lehtë dhe nuk ka armë të rënda, siç janë tanket, artileria e rëndë ose kapacitete sulmuese ajrore. Një rishikim i plotë i këtyre kufizimeve, do të bëhet jo më herët se pesë vjet nga koha e hyrjes në fuqi e Ligjit Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Detyrat fillestare të Forcës së Sigurisë së Kosovës janë:

3. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 2, pika (e) fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 21
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-082 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës (ligji)

1. Neni 5 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 22
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-033 për Statusin, imunitetet dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin e Kosovës dhe praninë ndërkombëtare ushtarake, si dhe personelin e saj

1. Neni 3 i ligjit bazik paragrafi 2. pika (a) riformulohet me tekstin si në vijim:
   (a) Zyra Civile Ndërkombëtare dhe Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian.
2. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3.3. Individët e emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtarë, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, mandati i të cilëve nuk ka përfunduar para deklarimit të përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur gëzojnë statusin, privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara në ligjin bazik.
3. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 6., riformulohet me tekstin si në vijim:
   4.6. Ministri i Punëve të Jashtme nuk mund t'i shpallë PSBE-në ose një anëtar të personelit të tij, anëtarët e personelit të ICO-së, përfshirë individët e përcaktuar në nenin 3.3. të ligjit bazik ose anëtarët e misionit EULEX, si persona non grata.
4. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 7. fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 23

1. Të gjithë anëtarët ndërkombëtarë të emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, në pajtim me Kushtetutën e Republikës se Kosovës, me përjashtim të atyre të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Agjencisë Kosovare të Pronës gjyqtarët ndërkombëtarë të Panelit të Ankesave të Gjykatës Supreme, dhe dy gjyqtarë në Komisionin për Kërkesa Pronësore, nëse për çfarëdo arsye largohen nga pozita para datës 31 gusht 2014 ai/ajo do të zëvendësohet me një anëtar vendor.
2. Nëse në cilindo ligj të aplikueshëm në Republikën e Kosovës përdoren termet ICO ose PCN, të njëjtat shfuqizohen dhe zëvendësohen me institucionet vendore përkatëse.

II. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 24
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të amendamenteve kushtetuese për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë.

Ligji Nr. 04/L-115
31 gusht 2012

Shpallur me dekretin Nr.DL-036-2012, datë 04.09.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr.25 / 7 SHTATOR 2012, PRISHTINË

LIGJI Nr. 04/L-020
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-047 PËR MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE DHE PJESËTARËVE TË TYRE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-047 PËR MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE DHE PJESËTARËVE TË TYRE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Neni 1

Neni 1 i ligjit bazik paragrafi 1.4. riformulohet si vijon:

1.4. Për qëllimet e këtij ligji, komunitetet përkufizohen si grupe kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare tradicionalisht të pranishme në Republikën e Kosovës të cilat nuk janë shumicë. Këto grupe janë komuniteti serb, turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian, goran, malazez, kroat dhe komunitete të tjera. Pjesëtarët e komunitetit shumicë në Republikën e Kosovës, të cilët si tërësi nuk janë shumicë në një komunë të caktuar po ashtu i gëzojnë të drejtat e radhitura në këtë ligj.

Neni 2

Neni 12 i ligjit bazik paragrafi 12.6. riformulohet si vijon:

12.6. Këshilli Konsultativ për Komunitete do të përbëhet nga përfaqësues të të gjitha komuniteteve të Kosovës dhe përfaqësues të Qeverisë, Zyrës së Presidentit dhe agjencive të tjera relevante. Do të ketë nga dy (2) përfaqësues të komunitetit rom, egjiptian, goran, ashkali malazez dhe atij kroat, prej të cilëve nga një (1) mund të jenë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Do të ketë nga tre (3) përfaqësues të komunitetit boshnjak dhe turk, prej të cilëve nga një (1) mund të jenë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Do të ketë pesë (5) përfaqësues të komunitetit serb, prej të cilëve dy (2) mund të jenë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Për secilin anëtar, mund të emërohet një zëvendës anëtar. Ata anëtarë të cilët nuk janë deputet të Kuvendit të Republikës

së Kosovës, janë zakonisht kryesues apo zëvendës kryesues apo të emëruar të tjerë të lartë të organizatave përfaqësuese të komuniteteve apo përfaqësues të shoqatave ose OJQ-ve që kanë të bëjnë me komunitetin e caktuar.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-020
8 dhjetor 2011

Shpallur me dekretin Nr. DL-051-2011, datë 21.12.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 29 / 27 DHJETOR 2011, PRISHTINË

LIGJI Nr. 03/L-95
PËR TË DREJTAT E ISH TË DENUARVE DHE TË PËRNDJEKURVE POLITIKË

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 1117
Kreu II: Dispozitat themelore 1118
Kreu III: Procedura e realizimit të së drejtës 1121
Kreu IV: Komisioni qeveritar për njohjen e statusit të ish të dënuarve dhe të ish të përndjekurve politikë 1122
Kreu V: Instituti për ish të denuarit dhe për ish të përndjekurit politikë 1122
Kreu VI: Afatet për inicimin e procedurës dhe për realizimin e së drejtës 1123
Kreu VII: Dispozitat ndëshkimore 1123
Kreu VIII: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 1123

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR TË DREJTAT E ISH TË DENUARVE DHE TË PËRNDJEKURVE POLITIKË

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Me këtë ligj rregullohet statusi i ish të dënuarit politik, i ish të burgosurit politik dhe i ish të përndjekurit politik.
2. Të drejtat e tyre të veçanta nga sigurimi pensional dhe invalidor, të drejtat në kompensim për dëmtimin e shkaktuar si pasojë e burgimit, e dënimit ose e persekutimit dhe të drejtat e anëtarëve të familjes së ngushtë të tyre.
3. Themelimi i organit kompetent për njohjen e statusit.
4. Procedura për realizimin e të drejtave, që përcaktohen me këtë ligj.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **Ish i dënuar politik** - personi, qytetari i Kosovës, që me akt gjyqësor është

dënuar për vepra të inkriminuara politike – ideologjike të regjimit totalitar në ish Jugosllavi.

1.2. **Ish i burgosur politik** - personi i arrestuar, i mbajtur në vend të caktuar në izolim, në arrest shtëpiak dhe i burgosur për motive, për qëllime të pushtetit dhe për interesa politike, më tepër se shtatëdhjetedy (72) orë në objektet e veçanta të pushtetit.

1.3. **Ish i përndjekur politik** - personi, qytetari i Kosovës, i cili me akt juridik të organit kompetent, për motive politike është përndjekur nga organet e pushtetit.

1.4. **Statusi i ish të dënuarve, të burgosurve dhe të përndjekurve politikë** - pozita juridike e tyre sipas kushteve, kritereve dhe proceduarave të përcaktuara me këtë ligj.

1.5. **Anëtarë të familjes së personave të dënuar, të burgosur e të përndjekur politikë** - janë personat që përcaktohen me dispozitat e Ligjit për familjen.

1.6. **Komisioni Qeveritar për të drejtat e ish të burgosurve, të ish të dënuarve e të ish të përndjekurve Politikë** - komision i themeluar me akt te posaçëm në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

1.7. **Instituti për Integrimin e ish të burgosurve politikë** - institut i themeluar me akt te posaçëm në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

1.8. **Komisioni i Ankesave** komision qeveritar i themeluar me dispozitat e këtij ligji.

KREU II
DISPOZITAT THEMELORE

SHTRIRJA KOHORE DHE HAPËSINORE E ZBATIMIT TË LIGJIT

Neni 3
Statusi dhe kategoritë e ish të dënuarve dhe ish të përndjekurve politikë

1. Statusin e personave të përcaktuar me këtë nen e gëzojnë këto kategori:
   1.1. ish i dënuari politik;
   1.2. ish i burgosuri politik; dhe
   1.3. ish i përndjekuri politik.
2. Ish i dënuari politik, sipas këtij ligji konsiderohet qytetari i Kosovës, i cili me akt gjyqësor është dënuar me procedurë gjyqësore në gjykatë civile ose në gjykatë ushtarake për vepra të inkriminuara politike – ideologjike, atdhetare, gjatë regjimeve totalitare në ish Jugosllavi.
3. Ish i burgosur politik, sipas këtij ligji konsiderohet personi i arrestuar, i mbajtur në vend të caktuar në izolim dhe i burgosur për motive, për qëllime dhe për interesa politike, më tepër se shtatëdhjetedy (72) orë në lokalet e organeve të ndjekjes, përkatësisht në kampet e ndryshme të institucioneve zyrtare të sigurisë (të policisë, të ushtrisë, të shërbimit sekret).
4. Ish i përndjekur politik, sipas këtij ligji konsiderohet personi-qytetari i Kosovës, kundër të cilit me akt juridik të organit kompetent janë marrë masa ose veprime politike–juridike, që kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në masën e suspendimit ose të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, të shkollimit,

marrjen e lejes, respektivisht ndalesën për ushtrimin e veprimtarisë me mjete në pronësi personale, për shkak të bindjeve dhe të përcaktimit të tyre ose të lidhjeve të drejtpërdrejta ose të tërthorta me persona, të cilët janë dënuar dhe janë përndjekur në bazë të dyshimit të supozuar politik ose të inkriminimit politik.

5. Personat nga ky nen janë të dënuar dhe të përndjekur padrejtësisht dhe mbi këtë bazë janë të pafajshëm për efekte morale, politike, sociale dhe ekonomike.

Neni 4

Statusi dhe të drejtat e personave nga neni 3 i këtij ligji u njihen për periudhën e sundimit të regjimeve totalitare, që nga vendosja e tyre, përkatësisht nga data 1 mars 1913 deri më 12 qershor 1999, përkatësisht për të dënuarit, që kanë mbetur në burg deri në lirimin e tyre.

Neni 5

1. Qytetarët e Kosovës, që, për shkak të burgosjeve politike, të presioneve edhe pas daljes nga burgu, të frikësimeve, të kanosjes, të përndjekjes, të keqtrajtimit, të diskualifikimeve shoqërore ose të formave të tjera të veprimeve të rrezikshme për ta janë detyruar ta lëshojnë Kosovën a ndonjë vend tjetër të ish Jugosllavisë, madje nëse edhe në pjesët e tjera të ish Jugosllavisë ose në mërgim, jashtë ish Jugosllavisë, janë burgosur dhe persekutuar për motive politike, i gëzojnë të drejtat e parapara me këtë ligj.
2. Personat nga paragrafi 1. i këtij neni, të cilët janë privuar nga jeta në burg ose kanë vdekur si pasojë e burgosjes dhe e pasojave te konstatuara të burgosjes në Kosovë, në territorin e ish Jugosllavisë, ose në mërgim, i njihet statusi i dëshmorit dhe anëtarët - trashëgues të familjes i gëzojnë të gjitha të drejtat e përcaktuara me ligj.

Neni 6
Të drejtat dhe mënyra e realizimit

1. Personat nga neni 3 i këtij ligji kanë të drejtë në rehabilitim juridik, moral, shoqëror e politik për pasojat e burgosjes, të dënimit, dhe të trajtimit të padrejtë.
2. Të drejtat pasurore që lidhen me pronën e patundshme të konfiskuar dhe beneficionet që rrjedhin nga ky status, mund të bartën tek pasardhësit në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi të drejtat pronësore dhe Ligjit mbi trashëgiminë të Kosovës.

Neni 7
E drejta e kompensimit

1. Personat nga paragrafi 2. i nenit 3 të këtij ligji dhe në raste të veçanta edhe ata nga paragrafi 3. i nenit 3 të këtij ligji, kanë të drejtë në kompensim adekuat gradual dhe material.
2. Rast i veçantë, sipas këtij ligji përfshihet personi nga paragrafi 3. i nenit 3 të këtij ligji që e ka vuajtur dënimin me burgim më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë.

3. Kompensimi për një ditë të kaluar në burg bëhet sipas dispozitave në fuqi për kompensimin e personave të dënuar pa faj.
4. Kriteret, forma, afatet dhe modalitetet e tjera të kompensimit rregullohen me akt të veçantë.

Neni 8

Personat nga neni 3 i këtij ligji që kanë mbetur me pasoja te faktuara psikike, fizike ose psiko-fizike, si rezultat i veprimeve të dhunshme, frikësuese, të torturës, të traumave, të keqtrajtimeve dhe të keqpërdorimeve të tjera, gjatë dhe pas procedurës hetimore, kanë të drejtë për rehabilitim, për mbrojtje dhe për sigurim shëndetësor në përputhje me ligjin, duke përjashtuar ata që janë përfshirë në ndonjë kategori përfituese mbi këtë bazë.

Neni 9
E drejta për sigurim pensional e invalidor

1. Personat nga neni 3 i këtij ligji, kanë të drejtë për sigurim pensional, respektivisht sigurim invalidor, në proporcion me kohen e kaluar ne burg, respektivisht me shkallen e inavliditetit te shkaktuar ne burg.
2. E drejta për sigurimin pensional, invalidor dhe për stazh, rregullohen me akt të veçantë.
3. Personat nga paragrafët 1. dhe 2. të nenit 3 të këtij ligji, të cilëve u është shkaktuar invaliditet i përhershëm, marrin pension të veçantë nga buxheti Kosovës.

Neni 10
Njohja e stazhit te punës

Koha e kaluar në burg njihet si stazh i dyfishtë i punës për të burgosurit dhe të dënuarit politik.

Neni 11

Personat që në bazë të këtij ligji, pas përfundimit të procedurës gjegjëse, e fitojnë statusin benficues, do të marrin certifikatë për beneficionet që i gëzojnë.

Neni 12

1. Personat nga neni 3 i këtij ligji me gjendje të rëndë ekonomike dhe shëndetësore në kushte të njëjta kanë të drejtë edhe në këto forma përkatëse beneficimi:
   1.1. përparësi në punësim;
   1.2. përparësi për bursa dhe për vendosje të fëmijëve të tyre në konvikte;
   1.3. përparësi në shfrytëzimin e teksteve shkollore pa pagesë;
   1.4. lehtësi tatimore dhe doganore për mjetet dhe pajisjet e domosdoshme për rehabilitimin e tyre shëndetësor;
   1.5. lehtësi për shpenzimet e transportit me mjetet e transportit publik;

1.6. përparësi për ndihmë sociale e ekonomike;
1.7. për strehim;
1.8. kompensimin e shpenzimeve të varrimit.

2. Kushtet, kriteret dhe procedurat për realizimin e lehtësirave të lartpërmendura, rregullohen me akt të veçantë.

KREU III
PROCEDURA E REALIZIMIT TË SË DREJTËS

Neni 13

1. Të drejtat e parapara me këtë ligj, kërkohen, përfitohen dhe realizohen me procedurë përkatëse administrative, me kërkesë me shkrim dhe me dokumentacion të kompletuar.
2. Personat nga neni 3 i këtij ligji, kërkesën për njohjen e të drejtave, sipas këtij ligji, mund ta parashtrojnë pasi t'u njihet statusi i përcaktuar me ligj.
3. Për njohjen dhe realizimin e të drejtave sipas këtij ligji, personat duhet t'i parashtrojnë me shkrim kërkesën dhe provat e tjera të nevojshme.
4. Provë e nevojshme me shkrim është vërtetimi për vuajtjen e dënimit, aktgjykimi, përkatësisht aktvendimi gjyqësor nga institucioni kompetent, me të cilin vërtetohen: veprimi, pasoja, koha e qëndrimit në burg, dëshmia me shkrim e Shoqatës së të Burgosurve Politikë dhe e dëshmitarëve etj.

Neni 14

Institucionet dhe organet, që e kanë dokumentacionin e nevojshëm për dëshmimin e statusit të personave nga neni 3 i këtij ligji, që e mbikëqyrin dhe e ruajnë atë dokumentacion, janë të obliguar, që me kërkesë të palës së interesuar ta japin atë dokumentacion në afat më së largu prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Neni 15

Në qoftë se personi nga neni 3 i këtij ligji ka vdekur para datës së paraqitjes së kërkesës për njohje të së drejtës, kërkesën mund ta parashtrojë anëtari i familjes së tij.

Neni 16

Personit të cilit i është refuzuar kërkesa për njohjen e statusit të ish të burgosurit politik, ngase nuk ka mundur t'i sjellë dokumentet e kërkuara, sipas këtij ligji, mund të parashtrojë kërkesë të re duke bashkangjitur fakte e arsye të reja.

Neni 17

Lidhur me kushtet për përfitimin e së drejtës për pension, për lartësinë e pensionit, të procedurës së sendërtimit të së drejtës, të pagesës dhe të harmonizimit të pensionit, si

dhe të çështjeve të tjera, që nuk janë rregulluar me këtë ligj, në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat ligjore mbi sigurimin pensional dhe invalidor të punëtorëve.

Neni 18

Personat nga neni 3 i këtij ligji, që e përfitojnë statusin, respektivisht të drejtën përkatëse, të paraparë me këtë ligj, pa bazë ligjore, detyrohen, t'i kthejnë shumat që i kanë marrë padrejtësisht.

KREU IV
KOMISIONI QEVERITAR PËR NJOHJEN E STATUSIT TË ISH TË DËNUARVE DHE TË ISH TË PËRNDJEKURVE POLITIKË

Neni 19

1. Për njohjen e të drejtave të personave nga neni 3 i këtij ligji formohet një komision i posaçëm qeveritar.
2. Komisioni Qeveritar, emërohet nga Qeveria dhe përbëhet nga:
   2.1. një (1) përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë;
   2.2. një (1) përfaqësues i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale;
   2.3. një (1) përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë;
   2.4. një (1) deputet i Kuvendit të Kosovës nga komisioni përkatës;
   2.5. një (1) përfaqësues i Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës dhe
   2.6. një (1) përfaqësues nga shoqëria civile - përkatësisht nga Shoqata e Juristëve të Kosovës.
3. Kryetari i Komisionit zgjidhet me mandat një (1) vjeçar nga radhët e anëtarëve të Komisionit.
4. Komisioni Qeveritar për realizimin e të drejtave të ish të burgosurve politikë i përcakton kushtet, kriteret, llojin dhe mënyrën e zhdëmtimit (kompensimit) të personave në përputhje me nenin 3 të këtij ligji, me procedurë të caktuar me këtë ligj dhe me akte të tjera gjegjëse nënligjore.
5. Për ankesat lidhur me vendimet e Komisionit, sipas paragrafit 1. të këtij neni, vendos Komisioni i veçantë i shkallës së dytë i Qeverisë (Komisioni i Ankesave). Për punën, për organizimin dhe për funksionin e tij, Komisioni e nxjerr Rregulloren e punës, që e miraton Qeveria.

KREU V
INSTITUTI PËR ISH TË DENUARIT DHE PËR ISH TË PËRNDJEKURIT POLITIKË

Neni 20

1. Instituti themelohet për shqyrtimin, për hulumtimin dhe për publikimin e së vërtetës për ish të dënuarit, për ish të burgosurit dhe për ish të përndjekurit politikë, si dhe për integrimin e tyre në shoqëri.
2. Instituti nga paragrafi 1. të këtij neni, është institucion i posaçëm dhe i përhershëm shtetëror që veprimtarinë e vet e shtrin në tërë territorin e Kosovës.

3. Puna, fushëveprimi dhe aktivitetet e Institutit rregullohen me akt të veçantë.

KREU VI
AFATET PËR INICIMIN E PROCEDURËS DHE PËR REALIZIMIN E SË DREJTËS

Neni 21

Kërkesa për realizimin e së drejtës nga neni 3 i këtij ligji i paraqitet komisionit qeveritar të themeluar sipas këtij ligji në periudhën katër (4) vjeçare duke filluar gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi.

Neni 22

1. Mjetet financiare për përmbushjen e obligimeve, që krijohen me njohjen e të drejtave sipas këtij ligji, i siguron Qeveria nga Buxheti i Kosovës, pasuria e patundshme shoqërore, fondi i privatizimit, aksionet e privatizimit etj.
2. Mbarëvajtjen e punës, zbatimin e ligjit dhe transparencën e Komisionit Qeveritar, në përputhje me nenin 19 të këtij ligji, e përcjell dhe e mbikëqyr Kuvendi i Republikës së Kosovës.
3. Komisioni, nga neni 19 i këtij ligji, nëpërmjet Qeverisë, obligohet që rregullisht, të paktën një (1) here në vit, t'i raportojë me shkrim Kuvendit për ecurinë dhe efikasitetin e realizimit të të drejtave të rregulluara me këtë ligj.

KREU VII
DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 23

1. Moszbatimi i dispozitave të këtij ligji dënohet sipas ligjeve në fuqi.
2. Personat nga neni 3 i këtij ligji, që e kanë fituar statusin me dokumente të falsifikuara, kur kjo gjë vërtetohet ligjërisht, përveç kthimit të shumës së përfituar, ndiqen edhe penalisht në përputhje me ligjin në fuqi.
3. Në rastin kur personi nga neni 3 i këtij ligji, që është burgosur ose është dënuar rrejshëm nga shteti nuk i gëzon të drejtat në bazë të këtij ligji.

KREU VIII
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 24

1. Ky ligj nuk e përjashton të drejtën e anëtarëve të familjes së personave të cilëve i është njohur e drejta personale, që të përfitojnë nga Skema e Ndihmës Sociale.
2. Përfitimet familjare të përcaktuara me këtë ligj, e përjashtojnë të drejtën e përfitimit të po kësaj familjeje nga Skema e Ndihmës Sociale.
3. Përfituesit nga ligji për pensionet e personave me aftësi të kufizuara dhe/ose

përfituesit e pensioneve të pleqërisë mbi moshën gjashtëdhjetepesë (65) vjeçare, mund të jenë shfrytëzues të të drejtave në pajtim me këtë ligj.

Neni 25

Qeveria, përkatësisht ministritë përkatëse, obligohen në afat më së largu gjashtë (6) muaj nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji, ta formojnë komisionin nga nenit 19 si dhe Institutin nga neni 20 i këtij ligji dhe të nxjerrin akte të parapara nënligjore dhe akte të tjera administrative që e rregullojnë fushën e të drejtave të parapara me këtë ligj.

Neni 26
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-95
29 tetor 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-076-2010, datë 18.11.2010 nga u.d. Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 91 / 10 DHJETOR 2010

LIGJI Nr. 03/L-195
PËR AVOKATIN E POPULLIT

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 1125
Kreu II: Propozimi, zgjedhja dhe shkarkimi i avokatit të popullit dhe zëvendësve të tij 1127
Kreu III: Kompetencat dhe përgjegjësitë e avokatit të popullit 1130
Kreu IV: Procedurat e shqyrtimit të ankesave 1132
Kreu V: Zyra, objekti, personeli dhe buxheti i institucionit të avokatit të popullit 1135
Kreu VI: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 1137

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR AVOKATIN E POPULLIT

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim krijimin e mekanizmit ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik dhe juridik nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, të organeve të tjera dhe të organizatave që ushtrojnë autorizime publike për llogari të tyre.

Neni 2
Fushëveprimi i ligjit

Me këtë ligj rregullohet organizimi dhe funksionimi i Institucionit të Avokatit të Popullit, duke përcaktuar procedurat për emërim dhe shkarkim, kompetencat dhe mënyrën e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit si dhe rregullon procedurat për parashtrimin e ankesave dhe hetimin e tyre.

Neni 3
Parimet bazë të veprimtarisë së Avokatit të Popullit

1. Avokati i Popullit është institucion i pavarur që udhëhiqet nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit dhe profesionalizmit.
2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të të gjithë personave në Republikën e Kosovës dhe jashtë saj nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme të organeve të autoriteteve publike të Republikës së Kosovës.

Neni 4
Gjuha e punës

Gjuhë e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit janë gjuhët zyrtare të parapara me Kushtetutë dhe ligj.

Neni 5
Përbërja e Institucionit të Avokatit të Popullit

1. Institucioni i Avokatit të Popullit, përbëhet nga:
   1.1. Avokati i Popullit;
   1.2. pesë (5) zëvendës të Avokatit të Popullit;
   1.3. personeli profesional; dhe
   1.4. administrata.

Neni 6
Kushtet për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij

1. Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij zgjedhën personat që i plotësojnë këto kushte:
   1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
   1.2. të ketë arsimim të lartë;
   1.3. të ketë karakter, ndershmëri dhe moral të lartë;
   1.4. të ketë eksperiencë dhe njohuri të dalluara në fushën e të drejtave të njeriut;
   1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për vepër penale të dënueshme me legjislacionin e Republikës së Kosovës;
   1.6. të mos ushtrojë funksion në parti politike, deputet në legjislaturën e Kuvendit të Republikës së Kosovës që e zgjedhë atë apo anëtar i kabinetit qeveritar.

Neni 7
Papajtueshmëria

1. Avokati i Popullit dhe Zëvendësit e tij nuk duhet të jenë anëtarë të asnjë partie politike e as të ushtrojnë veprimtari politike, shtetërore a private profesionale.
2. Avokati i Popullit dhe Zëvendësit e tij nuk marrin pjesë në organizmat drejtues të organizatave civile, ekonomike dhe tregtare;

2.1. përveç ndalesave të përcaktuara në nën-paragrafin 1.6. të nenit 6 të këtij ligji dhe paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni, Avokati i popullit dhe zëvendësit e tij nuk kanë të drejtë të ushtrojnë ndonjë detyrë tjetër publike apo profesionale për të cilën shpërblehen me pagesë, përveç mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë.

3. Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij mund të merren me veprimtari shkencore, kulturore, akademike dhe veprimtari tjera, të cilat nuk bien në kundërshtim me funksionet e tyre dhe me legjislacionin në fuqi.

KREU II
PROPOZIMI, ZGJEDHJA DHE SHKARKIMI I AVOKATIT TË POPULLIT DHE ZËVENDËSVE TË TIJ

Neni 8
Procedura e propozimit

1. Procedura për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, dhe zëvendësve të tij fillon gjashtë (6) muaj para skadimit të mandatit të tyre.
2. Gjatë procedurës së zgjedhjes së kandidatëve për Avokat të Popullit dhe të zëvendësve të tij, duhet të sigurohet përfaqësimi etnik dhe gjinor.
3. Propozimin e Avokatit të Popullit e bënë Komisioni përkatës i Kuvendit të Republikës së Kosovës i cili pasqyron përbërjen politike, etnike dhe gjinore të Kuvendit në pajtim me rregulloren e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Kuvendi i Kosovës e shpall konkursin për zgjedhjen e Avokatit të Popullit në media të shkruara dhe elektronike.
5. Në konkurs caktohen kushtet për zgjedhjen e Avokatit të Popullit të paraparë me Kushtetutë dhe me këtë ligj. Afati për paraqitjen e propozimit për kandidatin nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) e as më i gjatë se njëzetë (20) ditë.
6. Pas skadimit të afatit të paraparë në paragrafin 5. të këtij neni, Komisioni, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, vlerëson nëse kandidatët i plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur Avokat i Popullit të paraparë me Kushtetutë dhe me këtë ligj, dhe hedhë poshtë kandidaturat që nuk plotësojnë këto kushte.
7. Komisioni zhvillon intervistë me secilin kandidat i cili plotëson kushtet për tu zgjedhur Avokat i Popullit dhe në bazë të të dhënave të paraqitura dhe rezultateve të intervistës, përgatitë listën e ngushtë të kandidatëve të kualifikuar për Avokat të Popullit.
8. Lista e ngushtë përmban tre (3) kandidatë.
9. Komisioni, bashkangjitur me listën e ngushtë, i dërgon Kuvendit të Republikës së Kosovës listën e të gjithë kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur Avokat i Popullit.
10. Propozimi i Komisioni përmban arsyetim përse Komisioni ju ka dhënë përparësi disa kandidatëve në krahasim me kandidatët tjerë.
11. Propozimin e zëvendësve e bën Avokati i Popullit në bazë të konkurrencës së hapur dhe transparente, sipas konkursit të shpallur nga Kuvendi i Kosovës.
12. Propozimi i Avokatit të Popullit e përmban arsyetimin për kandidatët e propozuar.

13. Të paktën njëri nga zëvendësit e Avokatit të Popullit duhet të jetë pjesëtar i komunitetit serb të Kosovës dhe së paku një (1) duhet të jetë prej njërit nga komunitetet tjera jo shumicë në Kosovë.
14. Procedura e zgjedhjes dhe e shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe Zëvendësve të Avokatit të Popullit, rregullohet me Rregullore të posaçme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Neni 9
Zgjedhja e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij

1. Avokatin e Popullit e zgjedh Kuvendi i Republikës së Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të tij, për një mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.
2. Avokati i Popullit duhet të zgjidhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e propozimit të kandidatëve. Nëse ky afat nuk është arritur, Kuvendi i Republikës së Kosovës voton për zgjedhjen e Avokatit të Popullit në secilën seancë plenare për tridhjetë (30) ditë të tjera. Nëse Avokati i Popullit nuk zgjidhet brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve, Komisioni përkatës i Kuvendit përsëri do të shpallë konkurs për Avokat të Popullit.
3. Zëvendësit e Avokatit të Popullit zgjidhen njëherazi nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë.
4. Nëse Kuvendi nuk i zgjedh zëvendësit në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditëve, Kuvendi shpall konkurs të ri.
5. Avokati i Popullit, njërin nga zëvendësit e zgjedhur e cakton zëvendës kryesor të tij me rotacion për një mandat një (1) vjeçar.

Neni 10
Marrja e detyrës dhe betimi

1. Avokati i Popullit merr detyrën pasi ta kenë dhënë betimin para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Teksti i betimit është si në vijim: "Unë betohem dhe premtoj solemnisht se do t'i kryej me besnikëri në mënyrë të pavarur dhe të paanshme detyrat dhe funksionet që më janë besuar me Kushtetutë dhe me ligj, se do t'i mbroj dhe avancoj të drejtat dhe liritë e njeriut në Republikën e Kosovës".

Neni 11
Imuniteti

1. Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimtari ose vendimet që janë brenda fushës së përgjegjësisë të Institucionit të Avokatit të Popullit.
2. Zyrat e Institucionit të Avokatit të Popullit janë të pacenueshme. Arkivat, lëndët, komunikimet, prona, fondet dhe pasuritë e Institucionit të Avokatit të Popullit, kudo që janë apo nga kushdo që mbahen, janë të pacenueshme dhe gëzojnë imunitet nga kontrolli, marrja, nga kërkimi zyrtar i tyre, nga konfiskimi, nga

shpronësimi apo nga çfarëdo ndërhyrje tjetër, qoftë përmes veprimit përmbarues, administrativ, gjyqësor apo legjislativ.

Neni 12
Shkarkimi nga funksioni i Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij

1. Avokati i Popullit, dhe zëvendësit e tij mund të shkarkohen për arsyet në vijim:
   1.1. paaftësia fizike apo mendore që shkakton pamundësinë e tij për kryerjen e funksioneve të tij.
   1.2. ka kryer vepër penale të dënueshme me legjislacionin e Republikës së Kosovës me gjashtë (6) ose më tepër muaj burgim në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë;
   1.3. për shkak të sjelljes së tij personale që është në kundërshtim me ushtrimin e funksionit të tij;
   1.4. nëse kryen veprime në kundërshtim me nën-paragrafin 1.6 të nenit 6 dhe paragrafi 2. të nenit 7 të këtij ligji.
2. Avokati i Popullit kërkon që Kuvendi i Republikës së Kosovës të shkarkojë nga detyra një apo më shumë zëvendës të tij, për shkak të një apo më shumë arsyeve të parapara në këtë ligj.

Neni 13
Përfundimi i funksionit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij

1. Funksioni i Avokatit të Popullit dhe i zëvendësve të tij mbaron:
   1.1. me vdekjen e tij;
   1.2. kur jep dorëheqje;
   1.3. kur mbaron afati 5 (pesë) vjeçar për Avokatin e Popullit, ndërsa 3 (tre) vjeçar për zëvendës të Avokatit të Popullit;
   1.4. kur shkarkohet.
2. Në rast mungese, vdekje, paaftësie të përhershme ose të përkohshme, Avokati i Popullit, zëvendësohet nga zëvendësi kryesor. Nëse zëvendësi kryesor nuk mund të kryejë funksionin, atëherë Avokati i Popullit zëvendësohet nga zëvendësi më i vjetër sipas moshës.
3. Në rast skadimi të mandatit, Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij do ta ushtrojnë funksionin e tyre deri në zgjedhjen e Avokatit të ri të Popullit dhe zëvendësve të tij.

Neni 14
Sigurimi i Punës pas përfundimit të mandatit

1. Pas përfundimit të mandatit, Avokati i Popullit mund të kthehet në funksionin e tij ose punën publike që kishte para zgjedhjes si Avokat i Popullit. Kur kjo nuk është e mundur, atëherë punëdhënësi i mëhershëm duhet t'i sigurojë një punë të përshtatshme, varësisht nga aftësitë dhe profesioni i tij.
2. Avokatit të Popullit, të cilit i përfundon mandati, ose që për shkaqe të arsyeshme nuk mund ta vazhdojë punën e mëparshëm ose nuk mund të gjejë punë tjetër

adekuate, e as që i ka plotësuar kushtet e përgjithshme të pensionimit, gëzon të drejtën e pagës në vlerën e njëjtë më atë që do të paguhej po të kishte punuar deri në pranimin në punë ose deri në plotësimin e kushteve të përgjithshme të pensionimit, por jo më gjatë se një (1) vit nga përfundimi i mandatit.

KREU III
KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E AVOKATIT TË POPULLIT

Neni 15
Kompetencat

1. Avokati i Popullit ka kompetenca për t'i hetuar ankesat e pranuara nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me standarde ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe konventave ndërkombëtare, veçanërisht me konventën evropiane për të drejtat e njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.
2. Kompetencat e Avokatit të Popullit shtrihen në mbarë territorin e Republikës së Kosovës. Në ushtrimin e funksioneve të tij lidhur me rastet që paraqiten brenda territorit të Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit mund t'u ofrojë shërbime të mira edhe qytetarëve të Republikës së Kosovës që përkohësisht ndodhen jashtë territorit të Republikës së Kosovës.
3. Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t'iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtresë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut.
4. Nëse Avokati i Popullit fillon procedurë me iniciativë të vetë ose ndonjë person tjetër në emër të të dëmtuarit i drejtohet me parashtresë Avokatit të Popullit për ngritjen e procedurës, është i nevojshëm pëlqimi nga personi, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut.
5. Kur Avokati i Popullit fillon procedurë me iniciativë të vetë lidhur me shkeljen e të drejtave dhe lirive të një numri më të madh të qytetarëve, të fëmijëve apo personave me aftësi të humbura veprimi, nuk është i nevojshëm pëlqimi nga paragrafi 4. i këtij neni.
6. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç në raste të zvarritjeve të paarsyeshme apo keqpërdorimit të dukshëm të pushtetit.
7. Avokati i Popullit mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese në pajtim me kushtetutën dhe ligjin për Gjykatë Kushtetuese;
8. Avokati i Popullit i ushtron kompetencat e veta edhe më anë të ndërmjetësimit dhe pajtimit.
9. Shërbimet e ofruara nga Institucioni i Avokatit të Popullit janë falas.

Neni 16
Përgjegjësitë

1. Avokati i Popullit ka këto përgjegjësi:
   1.1. të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe të angazhohet për zgjedhjen e tyre.
   1.2. të tërheqë vëmendjen për rastet kur institucionet e Republikës së Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla;
   1.3. të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave;
   1.4. të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut;
   1.5. t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta;
   1.6. të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës;
   1.7. të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Kosovë;
   1.8. të rekomandojë harmonizimin e legjislacionit të Kuvendit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv;
   1.9. të bashkëpunojë, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, me të gjitha organizatat dhe institucionet vendore dhe ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut;
   1.10. Avokati i Popullit, zëvendësit dhe personeli i tij duhet ruajtur fshehtësinë e të gjitha informatave dhe të të dhënave që i merr, duke i kushtuar kujdes të veçantë sigurisë së ankuesve, palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve, në pajtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave;
   1.11. obligimi për ruajtjen e fshehtësisë zyrtare vlen edhe pas përfundimit të mandatit ose marrëdhënies së punës.
2. Avokati i Popullit mund t'i ofrojë këshilla dhe t'i japë rekomandime çdo personi fizik dhe juridik lidhur me pajtueshmërinë e ligjeve dhe akteve nënligjore me standardet e pranuara ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut.
3. Avokati i Popullit mund t'i këshillojë dhe t'u rekomandojë institucioneve të Republikës së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës.
4. Avokati i Popullit i ndërmerr të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për t'i shqyrtuar ankesat e parashtruara sipas paragrafit 1. të nenit 15 të këtij ligji, duke përfshirë edhe intervenimin e drejtpërdrejtë tek autoritetet kompetente, nga të cilët do të kërkohet që të përgjigjen brenda kohës së arsyeshme të caktuar nga Avokati i Popullit. Nëse vazhdon dëmi i rëndë si pasojë e çështjes së ankesës sipas paragrafit 1. të nenit 15 të këtij ligji, nga autoritetet kompetente kërkohet të përgjigjen me nguti.

5. Nëse gjatë hetimeve, Avokati i Popullit konstaton se ekzekutimi i ndonjë vendimi administrativ mund të ketë pasoja të pariparueshme për personin fizik apo juridik, mund të rekomandojë që autoriteti kompetent ta pezullojë ekzekutimin e vendimit në fjalë deri në përfundimin e hetimeve lidhur me këtë çështje nga ana e Avokatit të Popullit.
6. Avokati i Popullit ka qasje në dosjet dhe në dokumentet e çdo institucioni të Republikës së Kosovës dhe mund t'i shqyrtojë ato lidhur me rastet që i ka në shqyrtim dhe sipas këtij ligji, mund të kërkojë nga çdo institucion i Republikës së Kosovës dhe nga personeli i tyre të bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit, duke siguruar informacione relevante, duke përfshirë edhe kopjen e plotë apo të pjesshme të dosjes dhe dokumenteve tjera sipas kërkesës së Avokatit të Popullit.
7. Zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit në çdo kohë dhe pa paralajmërim mund të hyjnë dhe të inspektojnë çdo vend ku personat janë privuar nga liria si dhe në institucionet tjera me liri të lëvizjes së kufizuar dhe mund të jenë të pranishëm në mbledhje ose seanca dëgjimore ku përfshihen personat e tillë. Zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit mund të mbajnë edhe takime me personat e tillë pa praninë e zyrtarëve të institucionit përkatës. Çdo lloj korrespondence e këtyre personave me Institucionin e Avokatit të Popullit nuk pengohet apo kontrollohet.
8. Avokati i Popullit ose përfaqësuesit e tij mund të hyjnë në hapësirat zyrtare të të gjitha organeve të autoriteteve publike, organeve tjera dhe organizatave që ushtrojnë autorizime publike për llogari të tyre.

KREU IV
PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

Neni 17
Fillimi i procedurës

Çdo person i cili pretendon se të drejtat apo liritë e tij janë shkelur me ndonjë ligj, veprim apo mosveprim, keqadministrim të organeve të autoriteteve publike, organeve tjera dhe organizatave që ushtrojnë autoritete publike për llogari të tyre, mund të kërkojë nga Institucioni i Avokatit të Popullit fillimin e procedurës.

Neni 18
Forma e paraqitjes së ankesës

1. Çdo ankesë që i parashtrohet Avokatit të Popullit duhet të jetë e nënshkruar dhe t'i ketë shënimet personale të paraqitësit të ankesës si dhe të përmbajë të gjitha rrethanat, faktet dhe dëshmitë në të cilat kjo ankesë bazohet. Paraqitësi i ankesës mund të deklarojë nëse mjetet juridike janë ushtruar apo jo, dhe nëse po cilat prej këtyre mjeteve janë zbatuar.
2. Çdo ankesë për fillimin e procedurës, si rregull paraqitet me shkrim. Kërkesa për fillimin e procedurës mund të paraqitet edhe gojarisht, në rast se nuk mund të bëhet me shkrim.

Neni 19
Procedura pas pranimit të ankesës

1. Pas pranimit të ankesës, Avokati i Popullit në afat prej tridhjetë (30) ditësh vendos për pranueshmërinë e çështjes si në vijim:
   1.1. të shqyrtojë në procedurë të përshpejtuar rastin;
   1.2. të fillojë hetimin e plotë;
   1.3. të hedh poshtë ankesën për shkak se:
      1.3.1. nuk është në kompetencën e Avokatit të Popullit sipas këtij ligji;
      1.3.2. ankesa është parashtruar pas afatit të paraparë me këtë ligj;
      1.3.3. ankesa është anonime;
      1.3.4. ankesa paraqet keqpërdorim të së drejtës për paraqitjen e ankesës;
      1.3.5. ankuesi ka dështuar të sigurojë informatat e kërkuara nga Avokati i Popullit.
   1.4. të refuzojë ankesën si të pabazuar.
   1.5. të ndërpretë hetimet kur konstaton se rasti është zgjidhur në ndonjë mënyrë tjetër në pajtim me kërkesën e ankuesit.
2. Në të gjitha rastet e mësipërme, Avokati i Popullit e njofton me shkrim palën brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të ankesës.
3. Vendimi i Avokatit të Popullit për të hedhur poshtë apo për të refuzuar ankesën është i formës së prerë.

Neni 20
Rastet e refuzimit të shqyrtimit të ankesës

1. Avokati i Popullit refuzon kërkesën për shkak të arsyeve si në vijim:
   1.1. kur nga shënimet e paraqitura dhe nga rrethanat e rastit del se të drejtat dhe liritë e njeriut nuk janë shkelur apo nuk është kryer kurrfarë keqadministrimi;
   1.2. kur kërkesa është jo e plotë dhe nuk është kompletuar edhe pas kërkesave të Avokatit të Popullit;
   1.3. kur procedurat për një lëndë janë duke u zhvilluar në organet gjyqësore ose në organet tjera kompetente, përveç në rastet e specifikuara me ketë ligj.
   1.4. kur të gjitha mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme nuk janë shterur, përpos nëse ai vlerëson se do të jetë e padobishme për paraqitësin e ankesës për të filluar apo vazhduar procedurën, apo nëse vlerëson se individët kanë pësuar dëm të madh apo mund të pësojnë dëm të madh dhe të pa kompenzueshëm në ndërkohë;.

Neni 21
Rastet e parashkrimit dhe përjashtimit

1. Avokati i Popullit nuk inicion procedurë për të hetuar shkeljen e të drejtave të njeriut nëse prej datës që pala e ka marrë vendimin e formës së prerë ose është njoftuar lidhur me të dhe deri në dorëzimin e ankesës në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë kaluar më shumë se gjashtë (6) muaj.

2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, Avokati i Popullit mund të iniciojë procedurë edhe pas kalimit të afatit prej gjashtë (6) muaj në rast se vlerëson se paraqitësi i ankesës ka qenë i penguar apo në rast se vlerëson se çështja është e rëndësisë së veçantë.

Neni 22
Procedura pas fillimit të hetimit

1. Kur Avokati i Popullit vendos t'i fillojë hetimet në pajtim me nenin 19 të këtij ligji, vendimin e vet do t'ua komunikojë paraqitësit të ankesës dhe organit kundër të cilit është paraqitur ankesa. Avokati i Popullit mund të kërkojë informata shtesë lidhur me rastin.
2. Avokati i Popullit cakton afatin brenda të cilit organi duhet t'ia dorëzojë të gjitha informatat e kërkuara në pajtim më paragrafin 1. të këtij neni. Afati nuk mund të jetë më i shkurtër se tetë (8) ditë dhe as më i gjatë se tridhjetë (30) ditë. Kur organi nuk arrin t'i dorëzojë në afatin e paraparë informatat e kërkuara nga Avokati i Popullit, ai pa vonesë duhet t'i paraqesë me shkrim arsyet e vonesës në ofrimin e informatës së kërkuar.
3. Në rast se Avokati i Popullit i vlerëson të pamjaftueshme përgjigjet ose masat e ndërmarra nga organi, ai ka të drejtë ta procedojë çështjen tek organi më i lartë kompetent, ose t'i paraqesë raport të veçantë Kuvendit, duke i propozuar edhe masa konkrete për vënien në vend të së drejtës së shkelur.
4. Refuzimi apo dështimi për t'iu përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit konsiderohet pengim i punës se Avokatit të Popullit. Kjo nuk e pengon Avokatin e Popullit për të nxjerrë konkludimet dhe rekomandimet e tij.
5. Avokati i Popullit mund të raportojë veprimet e parapara në paragrafin 4. të këtij neni në raportet e tij.

Neni 23
Detyrimi i bashkëpunimit dhe pasojat e refuzimit

1. Të gjitha organet e pushtetit shtetëror kanë për obligim ta ndihmojnë Avokatin e Popullit në zhvillimin e hetimeve, si dhe t'i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij.
2. Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil.

Neni 24
Thirrja e dëshmitarëve dhe ekspertëve

Avokati i Popullit mund t'i dërgojë thirrje çdo dëshmitari ose eksperti për ta intervistuar lidhur me rastin që e shqyrton. Personi i thirrur e që punon në institucionet publike është i obliguar t'i përgjigjet thirrjes.

Neni 25
Marrja e vendimit

Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë e tij, nxjerrë vendim në të cilin paraqiten konstatimet dhe rekomandimet e tij. Vendimi i tij i dërgohet parashtruesit të ankesës dhe autoriteteve publike përgjegjëse.

Neni 26
Përgjigjja në kërkesat e Avokatit të Popullit

Organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për masa disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Neni 27
Raporti i Avokatit të Popullit

1. Avokati i Popullit i paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës raportin vjetor.
2. Avokati i Popullit ia paraqet Kuvendit të Kosovës raportin për vitin paraprak deri më 31 mars të vitit vijues. Avokati i Popullit e paraqet raportin në seancë plenare, në të cilën diskutohet.

Neni 28
Publikimi i raporteve të veçanta

Avokati i Popullit mund të publikojë raporte të veçanta edhe përmes mediave për shkeljet e bëra nga organi, nëse ky i fundit, pas kërkesave të përsëritura nuk i është përgjigjur në mënyrë përkatëse propozimeve dhe rekomandimeve të tij.

KREU V
ZYRA, OBJEKTI, PERSONELI DHE BUXHETI I INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

Neni 29
Selia e Institucionit, paprekshmëria e selis dhe zyrave te Avokatit te Popullit

1. Selia e Institucionit të Avokatit të Popullit është në Prishtinë.
2. Institucionit të Avokatit të Popullit i sigurohen objekte të duhura për punë dhe pajisje të tjera në mënyrë që t'i mundësohet kryerja efektive e funksioneve dhe e përgjegjësive të tij.
3. Avokati i Popullit sipas nevojës mund të hapë zyra tjera brenda territorit të Republikës së Kosovës.
4. Në kuadër të Institucionit të Avokatit të Popullit do të funksionojnë njësi të veçanta për mbrojtjen e kategorive të posaçme te të drejtave të njeriut.

Neni 30
Personeli Profesional

Personeli i Institucionit të Avokatit të Popullit përzgjidhet nga radhët e qytetarëve të Republikës së Kosovës në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.

Neni 31
Rregullorja e Institucionit

1. Institucioni i Avokatit të Popullit nxjerrë Rregulloren e punës së tij.
2. Rregullorja e punës publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës" si dhe në web faqe të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Neni 32
Pagat

1. Niveli i pagës së Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij caktohet në pajtim me Ligjin për Pagat e zyrtarëve të Lartë Publik
2. Niveli i pagës së personelit tjetër të Avokatit të Popullit përcaktohet në pajtim me Ligjin për Pagat e nëpunësve civil.

Neni 33
Angazhimi i këshilltarëve dhe eksperteve të jashtëm

Avokati i Popullit, në marrëveshje me punëdhënësin mund të angazhojë, sipas nevojës, këshilltarë dhe ekspertë të jashtëm, për t'i shërbyer për një periudhë të caktuar.

Neni 34
Financimi

1. Institucioni i Avokatit të Popullit financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës.
2. Pavarësisht nga dispozitat e ligjeve të tjera, Institucioni i Avokatit të Popullit përgatit propozimin e buxhetit të tij vjetor dhe ia dërgon atë për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Institucioni i Avokatit të Popullit menaxhon në mënyrë të pavarur me buxhetin e tij dhe i nënshtrohet auditimit të brendshëm si dhe auditimit të jashtëm nga Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës.

Neni 35
Pranimi i donacioneve

Institucioni i Avokatit të Popullit mund të pranojë donacione shtesë nga donatorët vendorë dhe ndërkombëtarë, për të cilat njoftohet Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe të cilat nuk ndikojnë në pavarësinë financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe nuk janë në kundërshtim me ligjin dhe që nuk ndikojnë në pavarësinë e Institucionit të Avokatit të Popullit ose në të drejtat e tij prej Buxhetit të Republikës së Kosovës.

KREU VI
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 36

1. Brenda gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, zgjedhën zëvendësit e Avokatit të Popullit në pajtim me këtë ligj.
2. Mandati aktual i Avokatit të Popullit vazhdon deri në përfundimin e mandatit të tij.
3. Mandati aktual i zëvendësit të Avokatit të Popullit vazhdon deri në zgjedhjen e zëvendësve tjerë.
4. Avokati i Popullit ka kompetenca edhe për rastet që paraqiten para hyrjes në fuqi të këtij ligji kur nga faktet rezulton vazhdimi i shkeljes së një ose më shumë standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut ose përbëjnë keqpërdorim të vazhdueshëm të pushtetit.

Neni 37
Dispozitat Kalimtare

Brenda tre (3) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Institucioni i Avokatit të Popullit nxjerrë Rregulloren e punës.

Neni 38
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë të datës 30 qershor 2000, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/6 mbi Institucionin e Avokatit te Popullit të Kosovës e datës 16 shkurt 2006 dhe Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2007/15 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/6 mbi Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë të datës 19 mars 2007 si dhe të gjitha dispozitat tjera që bien në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 39
Hyrja në Fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-195
22 korrik 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-046-2010, datë 09.08.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 80 / 27 GUSHT 2010

MARRËDHËNIET ME JASHTË DHE HUMANITARE

LIGJI Nr. 03/L-044
PËR MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME DHE SHËRBIMIN DIPLOMATIK TË KOSOVËS

Në mbështetje të Kapitullit IV neni 65 pika 1 si dhe nenit 96 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me qëllim të rregullimit me ligj të autoritetit dhe kompetencave të institucioneve të Kosovës në ushtrimin e marrëdhënieve me shtetet dhe subjektet e tjera të së drejtës ndërkombëtare;

Me qëllim të promovimit të interesave politike dhe ekonomike të Kosovës ndërkombëtarisht, të mbrojtjes së të drejtave të shtetasve të Kosovës jashtë shtetit si dhe të zhvillimit të raporteve me shtetet e tjera.

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJIN PËR MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME DHE SHËRBIMIN DIPLOMATIK TË KOSOVËS

Neni 1
Fushëveprimtaria

Me këtë ligj themelohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Shërbimi Diplomatik i Kosovës si dhe përkufizohen kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre.

Neni 2
Përkufizimet

Për qëllim të këtij ligji, termat vijues kanë këto kuptime:
"Shtetas i Kosovës"- është personi fizik i cili mban shtetësinë e Kosovës ashtu siç definohet me ligjet në fuqi në Kosovë;
"Ministria"- është Ministria e Punëve të Jashtme;
"Mision diplomatik"- është ambasada ose ndonjë zyrë tjetër e cila përfaqëson Kosovën në një shtet tjetër ose në një organizatë ndërkombëtare ndërqeveritare në kuadër të kuptimit të Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike (1961) ose të Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore (1963);
"Shërbim diplomatik"- janë anëtarët e përhershëm të Ministrisë si dhe anëtarët e Ministrisë të caktuar në misione diplomatike në vende të tjera dhe në organizatat e tjera ndërkombëtare;

"Shef misioni"- është ambasadori ose ndonjë person tjetër i autorizuar nga institucionet përgjegjëse të Kosovës, për ta ushtruar atë detyrë;
"Marrëveshja e nivelit të shërbimit"- është Marrëveshja e Mirëkuptimit ose ndonjë marrëveshje tjetër me shkrim ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe një ministrie tjetër ose organi kompetent të shtetit të Kosovës e cila parasheh kushtet në bazë të së cilave mund të veprohet në emër të tjetrit ose në bazë të së cilës mundet dikush t'u bashkohet në shërbim zyrave të tjetrit.

Neni 3
Ministria e Punëve të Jashtme

3.1. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Shërbimi Diplomatik i Republikës së Kosovës të cilat përbëjnë Ministrinë dhe personelin e saj në ambasada jashtë, janë pjesë e Qeverisë së Kosovës.

3.2. Ministria e Punëve të Jashtme formulon dhe zbaton politikën e jashtme të Kosovës.

Në veçanti, Ministria:

a) zhvillon dhe bashkërendon politikat ndaj shteteve të tjera ndërsa në punët e jashtme, shpreh dhe mbron interesat e Kosovës në raport me vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare, në bashkërendim të plotë me ministritë e tjera, varësisht nga kompetencat e tyre të caktuara si dhe me Presidentin e Republikë së Kosovës;
b) përfaqëson Kosovën dhe institucionet e saj shtetërore në vendet e jashtme dhe në organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare, përmes ambasadave, misioneve ose zyrave përfaqësuese, të themeluara në pajtim me këtë ligj.
c) lidh traktate dhe marrëveshje të tjera detyruese ndërkombëtare me shtetet e tjera dhe me organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare;
d) vepron ne vendet e tjera dhe në organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare në emër të ministrive dhe organeve të tjera shtetërore. Aktivitetet e tilla mund të përfshijnë (por nuk kufizohen në) promovimin e tregtisë dhe investimeve të huaja në Kosovë dhe lëshimin e pasaportave ose dokumenteve të udhëtimit. Çdo funksion ekzekutiv i kryer në cilësinë e Ministrisë si bartës i organeve të tjera rregullohet me akte nënligjore dhe Marrëveshje të Nivelit të Shërbimit të dakorduara nga Ministria e Punëve të Jashtme si dhe ministritë ose organet shtetërore përkatëse;
e) ofron ndihmë konsullore shtetasve të Kosovës në vendet e tjera ashtu siç parashihet me akte nënligjore të Ministrisë si dhe mbron të drejtat e kosovarëve me banim të përkohshëm ose të përhershëm në vendet e tjera;
f) merr rol prijës dhe bashkërendues në raportet ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe misioneve diplomatike ose përfaqësuese të shteteve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare ndërqeveritare në Kosovë;
g) merr rol prijës në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës në ruajtjen dhe mbrojtjen e imuniteteve dhe privilegjeve në Kosovë të misioneve dhe personave të cilëve u takojnë imunitetet dhe privilegjet sipas konventave dhe zakoneve ndërkombëtare Ministria mund të merr masat e duhura në bazë të së drejtës ndërkombëtare të njohur përgjithësisht që të rregullon dhe

parandalon keqpërdorimin e statusit diplomatik, imuniteteve dhe privilegjeve;

h) i raporton rregullisht Presidentit të Republikës së Kosovës, si dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me çështjet me rëndësi në kuadër të përgjegjësive të Ministrisë, dhe bashkërendon me Presidentin dhe Kryeministrin lidhur me drejtimin strategjik të çështjeve të politikës së jashtme të Kosovës. Me kërkesë të Presidentit të Kosovës ose me iniciativën e Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministria mund të propozojë aktivitete ndërkombëtare që duhet të kryhen nga Presidenti;
i) i publikon një raport vjetor Kuvendit me të cilin parashtron qëllimet e Qeverisë për punët e jashtme dhe aktivitetet e Ministrisë gjatë vitit paraprak;
j) depoziton kopjet e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, të lidhura në emër të shtetit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës me autoritetet relevante; mban arkiv të atyre traktateve dhe marrëveshjeve dhe i publikon ato në faqen e internetit të Ministrisë; dhe mban dhe arkivon dokumentacionin përkatës të Ministrisë dhe të Shërbimit Diplomatik,
k) kryen detyra tjera të domosdoshme për zbatimin e pikave a) deri j) të këtij neni.

Neni 4
Ministri i Punëve të jashtme dhe kompetencat për të lidhur traktate

4.1. Ministri i punëve të jashtme, Presidenti dhe Kryeministri i Republikës së Kosovës, kanë autoritet për të nënshkruar traktate dhe konventa obligative ndërkombëtare në emër të Republikës së Kosovës dhe për të nënshkruar instrumente të aderimit në konventat ndërkombëtare të cilat veç janë në fuqi.

4.2. Ministri mund t'ua delegojë me shkrim këtë autoritet, përkitazi me traktatet dhe konventat e caktuara:
a) krerëve të ambasadave të Republikës së Kosovës ose misioneve diplomatike jashtë vendit;
b) ministrave tjerë brenda përgjegjësive të të cilëve mund të bie fushë veprimtaria e marrëveshjes ndërkombëtare.

4.3. Traktatet dhe konventat obligative ndërkombëtare nuk hyjnë në fuqi në Kosovë derisa të mos jenë ratifikuar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Instrumentet e pjesëmarrjes në konventat ndërkombëtare të cilat janë veç në fuqi dhe ratifikohen sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Këto ratifikime shpallen nga Presidenti dhe publikohen së bashku me tekstin e traktateve ose marrëveshjeve ndërkombëtare përkatëse në Gazetën Zyrtare.

Neni 5
Misionet diplomatike dhe zyrat e tjera përfaqësuese të Kosovës jashtë vendit

5.1. Presidenti, pas konsultimit me Kryeministrin, vendos të hap ambasada ose misione të tjera diplomatike të Kosovës në vendet e tjera ose organizatat ndërkombëtare, ose zyra përkatëse me qëllim të përfaqësimit të Republikës së Kosovës. Këto misione janë nën autoritetin dhe udhëzimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

5.2. Ambasadorët dhe shefat e misionit, si përfaqësues të Kosovës dhe institucioneve të saj si tërësi mund t'jua dërgojnë ato raporte ose rekomandime të politikave Ministrisë të cilat i konsiderojnë si të rëndësishme tek Presidenti, Kryeministri dhe ministrat tjerë në suaza të kompetencave të të cilëve është çështja e raporteve ose e rekomandimeve të politikave.

5.3. Konsullatat ose konsullatat e përgjithshme në vendet ku Kosova ka ambasador të akreditуar janë nën autoritetin e ose udhëzimet e atij ambasadori dhe konsiderohen zyra vartëse pjesë të misionit të tij.

5.4. Ambasadat ose misionet e tjera diplomatike jashtë munden, me lejen e Ministrisë, të punësojnë personel në funksione jo diplomatike të cilët janë banorë të vendit në të cilin gjendet misioni të cilët nuk është e thënë të jenë shtetas të Kosovës. Leja e Ministrisë jepet vetëm në atë raste kur punësimi i tillë është financiarisht më i leverdishëm për Kosovën se sa dërgimi i personelit nga Kosova në Mision me efekt të njëjtë të punës.

5.5. Personeli lokal i punësuar nuk konsiderohet pjesëtar i Shërbimit Diplomatik ose Shërbimit Civil të Kosovës as nuk i nënshtrohet të njëjtave kërkesa ose kushte të shërbimit. Kushtet kontraktuale të punësimit të tyre miratohen nga Ministria dhe mund të rregullohen me akte nënligjore të Ministrisë.

Neni 6
Kriteret për përzgjedhjen e ambasadorëve dhe shefave të tjerë të misioneve

Ambasadorët dhe konsujt e përgjithshëm si dhe shefat e tjerë të misioneve duhet të posedojnë:

a) aftësi relevante profesionale;
b) reputacion të lartë;
c) njohuri të marrëdhënieve ndërkombëtare;
d) njohuri të gjuhës angleze dhe zakonisht, në rastet e shteteve evropiane, të një gjuhe zyrtare të vendit përkatës.

Neni 7
Emërimi i Shefave të Misioneve

7.1. Postet vakante për ambasadorë dhe shefa të misioneve duhet të shpallen edhe në kuadër të Shërbimit Civil. Procedurat për intervistimin dhe ngushtimin e listës së aplikantëve përcaktohen me anë të akteve nënligjore të Ministrisë.

7.2. Ministri i Punëve të Jashtme, pas konsultimit me Presidentin dhe Kryeministrin, ia dërgon një listë të ngushtë prej së paku tre kandidatë për secilin post vakant, në besim, Komisionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare të Kuvendit të Kosovës. Komisioni mban seanca të mbyllura dëgjimore për këta kandidatë për të vërtetuar se a i plotësojnë kriteret e parapara me nenin 6 të këtij ligji. Pas kësaj ua raporton rezultatet e dëgjimeve të tij, në konfidencë, Presidentit, Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme. Raporti i Komisionit nuk përbën rekomandime lidhur me kandidatët të cilët plotësojnë kriteret nga neni 6 i këtij ligji.

7.3. Presidenti, pas konsultimit me Kryeministrin dhe Ministrin e Punëve të Jashtme

vendos pastaj nëse njëri nga kandidatët duhet të emërohet për në shtetin pranues ose organizatën ndërqeveritare ndërkombëtare. Pasi të jetë marrë pëlqimi nga shteti pranues, Presidenti akrediton kandidatin e suksesshëm.

7.4. Pa paragjykuar nenin 8 të këtij ligji, përzgjedhja për postet e ambasadorëve ose shefave të tjerë të misioneve nuk kufizohet për shërbyes civilë. Megjithatë, së paku pesëdhjetë përqind (50%) të emërimeve të reja të shefave të misioneve, nga data pesë vite pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të bëhet nga anëtarët në detyrë të Shërbimit Diplomatik të Kosovës.

7.5. Emërimi i personelit tjetër në ambasadë ose misione jashtë bëhet në përputhje me legjislacionin i cili rregullon Shërbimin Civil dhe aktet nënligjore të Ministrisë. Këto akte nënligjore mund të parashohin kohëzgjatjen normale ose maksimale të emërimeve në ambasada ose misione ose nderimeve të qëndrimit në detyrë në kuadër të selisë së Ministrisë.

Neni 8
Personeli

8.1. Anëtarët e Shërbimit Diplomatik të Kosovës, përveç të emëruarve politik, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe personeli i tij i nënshtrohet të njëjtave paga, kërkesa dhe kushte të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me ligje tjera ose akte nënligjore me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes efektive të punës së ambasadave dhe misioneve ose zyrave tjera jashtë Kosovës.

8.2. Rangjet diplomatike në përdorim ndërkombëtar të anëtarëve të Shërbimit Diplomatik të Kosovës përveç shefave të misioneve do të rregullohen me akte nënligjore të Ministrisë.

8.3. Ambasadorëve, konsujve të përgjithshëm dhe shefave të tjerë të misioneve u caktohen koeficient konform rëndësisë së detyrës së tyre. Në interes të raporteve të mira me shtetet e tjera, koeficientet e Shërbimit Civil të cilat u caktohen shefave të misioneve nuk publikohen.

Neni 9
Menaxhimi financiar dhe prokurimi

9.1. Pa paragjykuar dispozitat në ligjet tjera, ambasadat në vendet e tjera mund të kenë autoritet nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme që të:

a) hapin llogari bankare dhe të bëjnë pagesa nga to;
b) nënshkruajnë kontrata në emër të Ministrisë së Punëve të Jashtme;
c) pranojnë mallra dhe shërbime;
d) mbajnë nën llogaritë e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

9.2. Mënyrat sipas të cilave mund të ushtrohen këto kompetenca rregullohen me akte nënligjore të nxjerra nga Ministria e Punëve të Jashtme me pëlqimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë dhe (aty ku është e aplikueshme) të Autoritetit të Prokurimit Publik. Këto udhëzime administrative publikohen në web sajtin e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Ato duhet të synojnë të përcaktojnë, në nivelin që është e mundshme varësisht nga kufizimet e numrit të personelit të ambasadave, një shkallë të barabartë të ndarjes së detyrave, në prokurim dhe

menaxhim financiar, atyre institucioneve qeveritare në Kosovës të parapara me ligj, duke marrë parasysh faktin se ambasadat mund të mos kenë mundësi të kenë personel me orar të plotë për secilin aktivitet.

Neni 10
Caktimet në misione jashtë nga ministritë ose organet e tjera shtetërore

10.1. Personeli nga ministritë, agjencitë ose organet e tjera të shtetit mund të caktohen në detyra zyrtare në ambasada dhe misione të tjera të Kosovës jashtë, me pëlqimin e Ministrisë së Jashtme.
10.2. Detyrat dhe përgjegjësitë financiare të personelit të caktuar me detyra zyrtare në misione jashtë rregullohen me Marrëveshje të Shkallës së Shërbimit ndërmjet Ministrisë së Jashtme dhe organit që cakton zyrtarin.
10.3. Personeli i caktuar me detyrë zyrtare në mision konsiderohet i barabartë me anëtarët e tjerë të misionit të të njëjtit rang dhe vihet nën autoritetin e shefit te misionit në lidhje me përmbushjen e detyrave dhe sjelljen e tyre të përgjithshme.

Neni 11
Aktet nënligjore

Aktet nënligjore të Ministrisë, duke përfshirë ato të përmendura në pikat d) dhe e), paragrafi 2 i nenit 3, paragrafi 5 i nenit 5, paragrafët 1 dhe 4 të nenit 7, paragrafët 1 dhe 2 të nenit 8 dhe paragrafi 2 i nenit 9 të këtij ligji, publikohen në faqen elektronike të Ministrisë.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës
Me datën: 13.03.2008

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III / Nr. 26 / 02 QERSHOR 2008

LIGJI Nr. 03/L-207
LIGJIN PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-044 PËR MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME DHE SHËRBIMIN DIPLOMATIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJIN PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-044 PËR MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME DHE SHËRBIMIN DIPLOMATIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 1

Nenit 6 i ligjit në fuqi riformulohet si vijon:

Neni 6
Emërimi i ambasadorëve dhe shefave të misioneve

6.1. Ambasadorët, Konsujt e Përgjithshëm dhe Konsujt, si dhe shefat e tjerë të misioneve duhet të plotësojnë kërkesat si në vijim:
   a) kanë shtetësi të Kosovës;
   b) kanë zotësi të plotë për të vepruar;
   c) nuk janë dënuar për kryerje të veprës penale ose nuk janë nën hetime;
   d) nuk janë subjekt i masës disiplinore të largimit nga puna;
   e) janë në gjendje të mirë shëndetësore për të kryer detyrën.

6.2. Ambasadorët, Konsujt e Përgjithshëm, Konsujt, si dhe shefat e tjerë të misioneve duhet të plotësojnë edhe kërkesat si në vijim:
   a) kanë përgatitje të duhur profesionale;
   b) kanë reputacion të lartë;
   c) njohuri të marrëdhënieve ndërkombëtare;
   d) zotërojnë gjuhë të huaj të pranueshme dhe të përshtatshme për punën në shërbimin e jashtëm.

Neni 2

Neni 7 i ligjit në fuqi riformulohet si vijon:

7.1. Emërimi i Ambasadorëve dhe Shefave të Misioneve bëhet nga Presidenti i Republikës së Kosovës me dekret.
7.2. Ministri i Punëve të Jashtme, pas marrjes së pëlqimit nga Qeveria, ia dërgon emrin e kandidatit për Ambasador ose Shef Misioni, në besim, Komisioni për Punë të Jashtme i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Para se të kërkojë pëlqimin nga Qeveria, Ministria e Punëve të Jashtme sigurohet se kandidati i plotëson kriteret e përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 6.
7.3. Komisioni për Punë të Jashtme i Kuvendit të Republikës së Kosovës mban seanca të mbyllura dëgjimore për kandidatin e propozuar nga Qeveria, për të verifikuar plotësimin e kritereve të caktuara në paragrafin 2 të nenit 6. Pas seancës dëgjimore, Komisioni ia raporton rezultatet e dëgjimeve të tij, në besim, Presidentit, Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme.
7.4. Verifikimi i plotësimit të kritereve, të caktuara në paragrafin 2, të nenit 6 për kandidatët për Ambasadorë dhe Shefa të Misioneve, të cilët janë anëtarë në detyrë të Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës bëhet nga Ministria e Punëve të Jashtme.
7.5. Raporti i Komisionit është konsultativ dhe nuk e detyron Presidentin e Republikës së Kosovës.
7.6. Presidenti, pas marrjes së raportit Komisioni për Punë të Jashtme i Kuvendit të Republikës së Kosovës, vendos nëse kandidati duhet të emërohet për në shtetin pranues ose organizatën ndërqeveritare ndërkombëtare. Pasi të jetë marrë pëlqimi nga shteti pranues, Presidenti akreditonkandidatin e emëruar.
7.7. Së paku pesëdhjetë përqind (50 %) të emërimeve të Ambasadorëve dhe Shefave të Misioneve duhet të bëhet nga anëtarët në detyrë të Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës.
7.8. Të emëruarit në pozitën e Ambasadorit dhe Shefit të Misionit që nuk janë anëtarë në detyrë të Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës shërbejnë vetëm për një mandat, dhe pas përfundimit të këtij mandati, nuk konsiderohen pjesë e Shërbimit të Jashtëm.
7.9. Emërimi i personelit tjetër në Ambasadë ose Misione jashtë bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore të Ministrisë së Punëve të Jashtme.
7.10. Emërimi i Konsujve të Përgjithshëm bëhet me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës. Rekomandimi bëhet nga Ministri i Punëve të Jashtme.
7.11. Emërimi i Konsujve bëhet nga Ministri i Punëve të Jashtëm.

Neni 3
Hyrja në fuqi e Ligjit

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-207
8 korrik 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-037-2010, datë 28.07.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 76 / 10 GUSHT 2010

LIGJI Nr. 03/L-125
PËR SHËRBIMIN KONSULLOR TË MISIONEVE DIPLOMATIKE DHE KONSULLORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 1149
Kreu II: Dispozita të fundit 1155

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Duke ju referuar Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të vitit 1961, Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të vitit 1963, si dhe rregullave tjera përkatëse të së drejtës ndërkombëtare dhe të Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR SHËRBIMIN KONSULLOR TË MISIONEVE DIPLOMATIKE DHE KONSULLORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

NËNKREU I
VEPRIMTARIA KONSULLORE E MISIONIT DIPLOMATIK DHE KONSULLOR

Neni 1
Qëllimi

1. Misionet diplomatike dhe konsullore, në veprimtarinë e tyre konsullore, mbështesin bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shtetit pranues në fushën e shërbimit konsullor, ashtu siç përcaktohet në nenin 5 të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore, si dhe promovon forcimin e marrëdhënieve miqësore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shtetit pranues.
2. Misionet diplomatike dhe konsullore, në veprimtarinë e tyre konsullore, mbrojnë interesat e Republikës së Kosovës dhe të drejtat e shtetasve të Republikës së Kosovës në shtetin pranues në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore.

Neni 2
Përkufizimet

Për qëllim të këtij ligji, shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
”**Misioni konsullor”:** nënkupton përfaqësinë ose zyrën konsullore, pra sipas rastit, konsullatën e përgjithshme, konsullatën dhe shërbimin konsullor në misionet diplomatike të Republikës së Kosovës;
”**Drejtuesi i misionit konsullor”:** nënkupton personin përgjegjës, i cili është i autorizuar ta ushtrojë atë detyrë. Sipas rastit, drejtuesi i misionit konsullor mund të jetë konsulli i përgjithshëm, konsulli, nënkonsulli dhe drejtuesi i shërbimit konsullor, në përfaqësinë diplomatike të Republikës së Kosovës;
”**Zyrtari konsullor”:** nënkupton zyrtarin e lartë, duke e përfshirë drejtuesin e misionit konsullor, i cili është ngarkuar me ushtrimin e funksioneve konsullore;
”**Nëpunësi konsullor”:** nënkupton personin e punësuar në shërbimin administrativ ose teknik të misionit konsullor;
”**Shteti pranues”:** nënkupton shtetin ku është akreditуar drejtuesi i misionit konsullor;
”**Rrethi konsullor”:** nënkupton territorin në shtetin pranues, ku misioni konsullor është i akreditуar;
”Konsull nderi”: nënkupton shtetasin e Kosovës apo të huaj me qëndrim të përhershëm në shtetin pranues, i emëruar nga ministri i Punëve të Jashtme.

NËNKREU II
EMËRIMI DHE MARRJA E DETYRËS

Neni 3

1. Drejtuesi i misionit konsullor dhe nëpunësit e tjerë konsullorë emërohen në bazë të legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore të Ministrisë së Punëve të Jashtme.
2. Nënshkrimi i drejtuesit të misionit konsullor dhe nëpunësve konsullorë depozitohet pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe autoriteteve zyrtare përkatëse të shtetit pranues.

NËNKREU III
USHTRIMI I KOMPETENCAVE

Neni 4

Në veprimtarinë e tyre, drejtuesi i misionit konsullor, zyrtari konsullor dhe nëpunësit konsullorë, janë të detyruar të respektojnë rregullat ndërkombëtare, Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të vitit 1961, Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të vitit 1963, traktatet dhe marrëveshjet e Republikës së Kosovës me shtetin pranues, ligjet ekzistuese në rrethin konsullor dhe ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.

NËNKREU IV
KOMPETENCAT DHE DETYRAT KONSULLORE

Neni 5
Ushtrimi i funksioneve të shërbimit konsullor

1. Funksionet e shërbimeve konsullore në misionin konsullor i ushtron zyrtari konsullor i misionit konsullor.
2. Zyrtari konsullor i misionit konsullor i ushtron funksionet e shërbimeve konsullore në rrethin konsullor, i cili mund të përfshijë, të gjithë territorin e shtetit pranues ose një pjesë të tij.
3. Funksionet e shërbimeve konsullore, që ushtron zyrtari konsullor i misionit konsullor, rrjedhin nga kompetencat dhe përgjegjësitë me të cilat është pajisur misioni konsullor me këtë ligj.
4. Drejtuesi i misionit konsullor, mund t'ua delegojë kompetencat e tij zyrtarëve konsullorë, me kualifikimin e nevojshëm në misionin konsullor.
5. Në misionet diplomatike, aty ku është e nevojshme, funksionet e shërbimeve konsullore mund t'i ushtrojë një anëtar i shërbimit diplomatik.
6. Me pëlqimin e shtetit pranues, drejtuesi i misionit konsullor mund të ushtrojë funksionet e shërbimeve konsullore që i janë ngarkuar edhe jashtë rrethit konsullor.
7. Mbikëqyrjen gjatë ushtrimit të funksioneve të shërbimeve konsullore e ushtron shefi i misionit diplomatik kompetent për shtetin pranues.
8. Organizimi i misioneve konsullore, si dhe të drejtat dhe detyrat e zyrtarëve konsullorë përcaktohen me aktet nënligjore të Ministrisë së Punëve të Jashtme.
9. Në të gjitha rastet, rregulli përkatës vlen dhe për personat juridik të Kosovës, autoritetet apo institucionet e tjera të Kosovës, përveç në rastet kur kjo përjashtohet shprehimisht me legjislacionin në fuqi.

Neni 6
Dhënia e ndihmës shtetasve të Kosovës

1. Misioni konsullor mund të ofrojë ndihmën e nevojshme shtetasve të Kosovës, që gjenden në rrethin konsullor, pas kërkesës së ardhur nga shtetasi i Kosovës, në përputhje me rregullat ndërkombëtare, aktet normative në fuqi të shtetit pranues, si dhe ligjet dhe aktet nënligjore të Republikës së Kosovës.
2. Ofrimi i ndihmës, sipas paragrafit 1 të këtij neni, nuk vlen për shtetasit e Kosovës, të cilët njëkohësisht posedojnë shtetësinë e shtetit pranues. Ata nuk mund të përfitojnë nga kjo ndihmë, përveç në rastet konkrete kur rrethanat e mundësojnë dhënien e ndihmës.
3. Lloji, forma dhe masa e ndihmës përcaktohet nga drejtuesi i misionit konsullor, në pajtim me rregullat dhe ligjet përkatëse në shtetin pranues, nevojën për ndihmë nga shtetasi i Kosovës, si dhe duke marrë parasysh burimet e disponueshme buxhetore të Republikës së Kosovës.
4. Në raste të jashtëzakonshme, në pajtim me aktet nënligjore të Ministrisë së Punëve të Jashtme, mund të bëhet e mundur dhënia e ndihmës së domosdoshme financiare shtetasve të Kosovës për udhëtimin për në një vend tjetër ose për t'u riatdhesuar.

Në këto raste, rikthimi i shpenzimeve të kryera është i domosdoshëm. Ky detyrim shtrihet deri tek anëtarët e familjes ose prek trashëgiminë e personit që ka kërkuar ndihmë.

Neni 7
Dhënia e ndihmës shtetasve të Kosovës në raste të jashtëzakonshme

Në rastet kur në shtetin pranues ndodhin katastrofa natyrore, zhvillime politike, luftarake, revolucionare ose ngjarje të tilla të tjera që rrezikojnë ose dëmtojnë popullsinë në shtetin pranues apo pjesë të tij, drejtuesi i misionit konsullor mund të marrë masat e nevojshme për t'u ardhur në ndihmë dhe për të marrë në mbrojtje shtetasit e Kosovës të rrezikuar apo të dëmtuar. Me vendim të Qeverisë, kjo mund të vlejë edhe për anëtarët e familjes së shtetasve të Kosovës të cilët nuk janë shtetas të Kosovës.

Neni 8
Ndihma për të burgosurit dhe përfaqësimi i shtetasve të Kosovës në organet gjyqësore të shtetit pranues

1. Zyrtari konsullor, në përputhje me rregullat ndërkombëtare, legjislacionin në fuqi në shtetin pranues, këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, duke u bazuar në kërkesë paraprake ofron ndihmën e nevojshme dhe të përshtatshme për shtetasit e Kosovës, të cilët janë të burgosur, në hetime, ose të dënuar me heqje lirie në shtetin pranues.
2. Drejtuesi i misionit konsullor, duke vepruar në pajtim me rregullat dhe ligjet ndërkombëtare dhe legjislacionin në fuqi të shtetit pranues, mund t'u drejtohet autoriteteve përkatëse të shtetit pranues për të marrë informacion për arsyet e ndalimit ose të arrestimit të shtetasve të Kosovës në rrethin konsullor, veçanërisht për akuzat që janë ngritur ndaj tyre. Nëse është e nevojshme, drejtuesi i misionit konsullor, mund të vizitojë shtetasit e Kosovës të ndaluar ose të arrestuar në rrethin konsullor.
3. Drejtuesi i misionit konsullor merr masat e nevojshme dhe të lejueshme për lehtësimin e përfaqësimit të shtetasve të Kosovës para organeve gjyqësore ose autoriteteve të tjera të shtetit pranues në rrethin konsullor, në mënyrë që shtetasi i Kosovës të mund të realizojë të drejtat e tij/saj.

Neni 9
Riatdhesimi i shtetasve të Kosovës që kanë vdekur në shtetin pranues

1. Nëse nuk ekzistojnë mundësi të tjera, drejtuesi i misionit konsullor merr masat e nevojshme për kryerjen e identifikimit, nëse është e nevojshme, dhe për të lajmëruar anëtarët e familjes së shtetasve të Kosovës që kanë vdekur në shtetin pranues. Në qoftë se, në përputhje me dëshirën e të ndjerit/ndjerës apo dhe të anëtarëve të familjes do të kryhet transporti i trupit të shtetasve të Kosovës për në atdhe, drejtuesi i misionit konsullor ndihmon familjarët në vështirësitë e mundshme me dokumentacionin dhe planifikimin e transportit.

2. Kur familjarët e shtetasit të Kosovës ende nuk janë paraqitur dhe nuk ka mundësi të tjera, drejtuesi i misionit konsullor kërkon nga autoritetet lokale të shtetit pranues sigurimin e pasurisë ose sendeve të tjera që ka lënë shtetasi i vdekur i Kosovës në shtetin pranues.
3. Në qoftë se trashëgimtarët e të ndjerit/ndjerës nuk mund të gjenden dhe kur ka kaluar një periudhë kohore e gjatë pas sigurimit të pasurisë së lënë nga shtetasit e Kosovës, drejtuesi i misionit konsullor, mund të marrë masat e nevojshme që t'ua përcjellë këtë pasuri organeve përkatëse të Kosovës në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm në shtetin pranues.

NËNKREU V
DETYRA TË TJERA ADMINISTRATIVE

Neni 10
Përpunimi i dokumentacionit në çështjet e shtetësisë

Zyrtari konsullor i misionit konsullor përpunon dokumentacionin, në çështjet e shtetësisë, në pajtim me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 11
Pranimi i kërkesave për lëshimin e pasaportave dhe të vizave

1. Zyrtari konsullor i misionit konsullor pranon dokumentacionin, për pajisjen me pasaportat dhe dokumentet e tjera të nevojshme, me qëllim të lëvizjes në kufi të shtetasve të Kosovës.
2. Zyrtari konsullor i misionit konsullor pranon dokumentacionin, lidhur me vizat e llojeve të ndryshme, për lëvizjen e shtetasve të huaj në kufijtë e Republikës së Kosovës.
3. Lëshimi i vizave të llojeve të ndryshme për shtetasit e huaj, nga misionet konsullore, bëhet në pajtim me vendimet dhe aktet nënligjore të nxjerra në Republikën e Kosovës.

Neni 12
Regjistrimi i akteve të gjendjes civile

1. Në misionet konsullore të lejuara më parë me vendimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, drejtuesi i misionit konsullor, merr përsipër funksione të zyrtarëve të gjendjeve civile në mbajtjen dhe regjistrimin e akteve të gjendjes civile. Për të përmbushur këtë detyrë, ai mban regjistrat e lindjeve, vdekjeve dhe martesave.
2. Drejtuesi i misionit konsullor në bazë të paragrafit 1 të këtij neni:
   2.1. Lidhë martesa, nëse kjo është e lejuar me ligjet e shtetit pranues dhe nëse së paku njëri nga bashkëshortët është shtetas i Republikës së Kosovës, si dhe lëshon certifikata martesash. Lidhja e martesave nga drejtuesi i misionit konsullor regjistrohet në regjistrin për martesat dhe njoftohet Ministria e Punëve të Jashtme, për të kryer veprimet e mëtejshme;
   2.2. Regjistron në regjistrin e martesave edhe martesat e shtetasve të Republikës

së Kosovës, të lidhura nga autoritetet përkatëse të shtetit pranues, sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës dhe shtetit pranues, në bazë të certifikatave zyrtare;

2.3. Lëshon lejen e martesës për shtetasit e Kosovës, të përcaktuar me ligj përkatës të Republikës së Kosovës, nëse martesa lidhet në zyrat e gjendjes civile në rrethin konsullor të shtetit pranues, në rast se njëri nga bashkëshortët është i huaj.

3. Zyrtari konsullor, si në paragrafin 1 të këtij neni, bën regjistrimin e shtetasve të Republikës së Kosovës të lindur në rrethin konsullor në regjistrin e lindjeve, në bazë të certifikatave zyrtare të lëshuara nga autoritetet përkatëse vendëse.
4. Në afate të caktuara, aktet përkatëse të gjendjes civile të lindjeve, vdekjeve dhe martesave dërgohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme në mënyrë që të përcillen tek autoritetet kompetente të Kosovës.

Neni 13
Dokumentimi, lëshimi i vërtetimeve për vërtetësinë e dokumenteve, legalizimi i dokumenteve zyrtare, përkthimi i dokumenteve

Dokumentimi, lëshimi i vërtetimeve për vërtetësinë e dokumenteve, të lëshuara nga autoritetet e Republikës së Kosovës, legalizimi i dokumenteve zyrtare, të lëshuara nga autoritetet e Republikës së Kosovës dhe autoritetet e shtetit pranues, si dhe përkthimi i dokumenteve përcaktohen me akte nënligjore të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Neni 14
Dorëzimi i postës zyrtare

Në pajtim me marrëveshjen dy apo shumëpalëshe, zyrtari konsullor, merr masat për dorëzimin e dokumenteve dhe të postës zyrtare shtetasve të Republikës së Kosovës apo të huaj që qëndrojnë në rrethin konsullor, ose autoriteteve të shtetit pranues, po në rrethin konsullor, me kërkesën e gjykatave dhe autoriteteve zyrtare të Republikës së Kosovës. Në rast të mungesës së marrëveshjes, dy apo shumëpalëshe, dorëzimi i postës zyrtare realizohet përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme të shtetit pranues.

NËNKREU VI
KONSUJT E NDERIT

Neni 15
Emërimi, mbarimi i mandatit dhe kompetencat e konsullit të nderit

1. Për përfaqësimin sa më të mirë të interesave të Republikës së Kosovës, Ministri i Punëve të Jashtme emëron konsuj nderi.
2. Konsulli i nderit është pjesë përbërëse e strukturës së shërbimit konsullor të Republikës së Kosovës.
3. Kompetencat e konsullit të nderit përcaktohen me vendim të veçantë të Ministrit të Punëve të Jashtme.
4. Emërimi ka të bëjë me dhënien e titullit konsull nderi, shtetasit të Kosovës apo të

huaj, me qëndrim të përhershëm në shtetin pranues, me vendim të Ministrit të Punëve të Jashtme. Procedura e emërimit të konsullit të nderit përfshinë:

4.1. Argumentimin e hollësishëm të nevojës së përfaqësimit të interesave të Republikës së Kosovës me konsull nderi, në rrethin konsullor të propozuar;

4.2. Shqyrtimin e kujdesshëm të përshtatshmërisë së figurës së kandidatit për konsullin e nderit;

4.3. Marrjen e pëlqimit paraprak prej shtetit pranues për emërimin e kandidatit, që shqyrtohet për konsull nderi;

4.4. Pranimin e ekzekuaturës nga shteti pranues.

5. Konsulli i nderit merr përsipër përfaqësimin e interesave të Republikës së Kosovës, menjëherë pas dhënies së ekzekuaturës nga shteti pranues, për aq kohë sa është e nevojshme.
6. Me vendim të Ministrit të Punëve të Jashtme mund të kërkohet mbarimi i mandatit të konsullit të nderit, në rastin kur përfaqësimi i interesave të Republikës së Kosovës nuk konsiderohet të jetë i nevojshëm.
7. Konsulli i nderit mund të kërkojë në çdo kohë të heqë dorë nga titulli i tij.
8. Titulli konsull nderi nuk është i trashëgueshëm.
9. Në rast të pamundësisë për të ushtruar funksionin e përfaqësimit sa më të mirë, të interesave të Republikës së Kosovës, konsulli i nderit e njofton Ministrinë e Punëve të Jashtme nga momenti i paraqitjes së rrethanës që e pamundëson ushtrimin e këtij funksioni.
10. Konsulli i nderit e njofton Ministrinë e Punëve të Jashtme nëse punësohet në një shtet tjetër, përveç shtetit pranues, në një organizatë ndërkombëtare, ose kur ka bërë kërkesë për një nënshtetësi tjetër.
11. Për lejimin e fillimit të veprimtarisë së përfaqësimit të interesave të Republikës së Kosovës, konsulli i nderit pajiset nga Ministria e Punëve të Jashtme me ekzekuaturën përkatëse, pasi të ketë paraqitur vendimin për emërimin e tij.

NËNKREU VII
TAKSAT

Neni 16
Taksat konsullore

Në veprimtarinë e tij konsullore, drejtuesi i misionit konsullor ofron shërbimet konsullore kundrejt taksave në përputhje me aktet nënligjore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

KREU II
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ministria e Punëve të Jashtme ngarkohet të nxjerrë aktet nënligjore përkatëse në bazë të këtij ligji dhe për zbatim të tij.

2. Ministria e Punëve të Jashtme, brenda tre (3) muajve nga hyrja në fuqi të këtij ligji, miraton Rregulloren për Shërbimin Konsullor.

Neni 18
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-125
16 Dhjetor 2008

Shpallur me dekretin Nr. DL-073-2008, datë 30.12.2008 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI IV / Nr. 46 / 15 JANAR 2009

LIGJI Nr. 03/L-122
PËR SHËRBIMIN E JASHTËM TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Përmbajtja

Kreu I: Dispozita të përgjithshme 1157
Kreu II: Institucionet e shërbimit të jashtëm 1159
Kreu III: Nëpunësit e shërbimit të jashtëm 1163
Kreu IV: Të drejtat dhe detyrat e nëpunësit të shërbimit të jashtëm 1167
Kreu V: Trajtimi financiar i punonjësve të shërbimit të jashtëm 1168
Kreu VI: Nëpunësit administrativë dhe personeli ndihmës 1168
Kreu VII: Dispozita kalimtare 1169
Kreu VIII: Dispozita të fundit 1169

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Miraton

LIGJ PËR SHËRBIMIN E JASHTËM TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllim i këtij ligji është rregullimi i veprimtarisë së shërbimit të jashtëm, i organizimit, bashkërendimit dhe funksionimit të organeve që e përbëjnë shërbimin e jashtëm, dhe rregullimi i statusit të personelit të misionit diplomatik.

Neni 2
Përkufizimet

Për qëllim të këtij ligji, shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
"**Anëtarët e personelit të misionit"-** janë anëtarët e personelit diplomatik, të personelit administrativ dhe teknik, dhe të personelit shërbyes;
"Anëtarët e shërbimit të jashtëm"- janë anëtarët e përhershëm të Ministrisë si dhe anëtarët e Ministrisë të caktuar në misione diplomatike dhe konsullore në shtete të tjera dhe në organizata ndërkombëtare;
"Gradat Diplomatike dhe Konsullore"- janë titujt e dhënë ose të fituar të përfaqësuesve diplomatikë dhe konsujve, të renditur sipas përparësisë ose epërsisë hierarkike;

“Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës”- është komisioni i ngarkuar me dhënien, përveç gradës ambasador, të gradave diplomatike dhe konsullore për nëpunësit e shërbimit të jashtëm, si dhe propozimin e masave disiplinore ndaj nëpunësve të shërbimit të jashtëm dhe shqyrtimin e ankesave për masat disiplinore të marra ndaj tyre;
“Ministria”- është Ministria e Punëve të Jashtme të Qeverisë së Republikës së Kosovës;
“Ministri”- është Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Qeverisë së Republikës së Kosovës;
“Misioni diplomatik”- është ambasada ose çdo zyrë tjerë e cila përfaqëson Republikën e Kosovës në një shtet tjetër ose në një organizatë ndërkombëtare në kuptimin e Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike (1961) ose të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore (1963), ose e cila përfaqëson Republikën e Kosovës si pjesë të një misioni të dy ose më shteteve, dhe të cilës zyrë i janë dhënë të gjitha privilegjet dhe imunitetet që, sipas ligjit, i gëzojnë misionet diplomatike sipas Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike;
“Personeli administrativ dhe teknik”- janë anëtarët e personelit të misionit të punësuar në shërbimin administrativ dhe teknik të misionit;
“Personeli diplomatik”- janë anëtarët e personelit të misionit të rangut diplomatik;
“Personeli shërbyes”- janë anëtarët e personelit të misionit në shërbimin shtëpiak të misionit;
“Përfaqësuesi diplomatik”- është shefi i misionit ose një anëtar i personelit diplomatik të misionit;
“Shefi i misionit”- është ambasadori ose ndonjë person tjetër i autorizuar nga institucionet për ta ushtruar detyrën e tillë;
“Shtetas i Republikës së Kosovës”- është personi fizik i cili mban shtetësinë e Republikës së Kosovës ashtu siç përcaktohet në Ligjin për Shtetësinë e Kosovës.

Neni 3
Baza juridike e veprimtarisë së organeve të shërbimit të jashtëm

Presidenti i Republikës së Kosovës udhëheq politikën e jashtme të vendit në bazë të kompetencave që i jepen me Kushtetutë. Ministri i Punëve të Jashtme dhe strukturat e tjera në varësi të Ministrisë, e ushtrojnë veprimtarinë dhe funksionet e shërbimit të jashtëm në përputhje me Kushtetutën, me këtë ligj, me Ligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik, me aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, mbështetur në programin e Qeverisë dhe orientimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

KREU II
INSTITUCIONET E SHËRBIMIT TË JASHTËM

NËNKREU I
MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

Neni 4
Ministri

Ministri i Punëve të Jashtme drejton dhe përfaqëson shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës.

Neni 5
Drejtoria e Përgjithshme

Drejtoria e Përgjithshme bashkërendon komunikimin e përhershëm të Ministrisë me misionet e shërbimit të jashtëm, është përgjegjëse për hartimin dhe realizimin e synimeve në veprimtarinë e shërbimit me jashtë, si dhe udhëheqë Zyrat përkatëse brenda Ministrisë.

Neni 6
Struktura e Ministrisë

Strukturat përkatëse të Ministrisë themelohen me akte nënligjore të Ministrisë, që kanë për qëllim realizimin e veprimtarisë së shërbimit me jashtë.

Neni 7
Akademia Diplomatike

1. Me pëlqimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministri themelon Akademinë Diplomatike pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme, me qëllim të përgatitjes dhe formimit profesional të anëtarëve të personelit në shërbimin e jashtëm.
2. Funksionimi i Akademisë Diplomatike rregullohet me akt nënligjor të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

NËNKREU II
MISIONET DIPLOMATIKE

Neni 8
Llojet e misioneve

1. Misionet e Republikës së Kosovës jashtë vendit janë:
   1.1. misionet diplomatike;
   1.2. misionet konsullore;
2. Në misionet diplomatike bëjnë pjesë ambasadat dhe misionet e përhershme në organizatat ndërkombëtare.

3. Në misionet konsullore bëjnë pjesë konsullatat e përgjithshme, konsullatat, nënkonsullatat dhe zyrat konsullore.

Neni 9
Hapja, riorganizimi dhe mbyllja e misioneve diplomatike

1. Misionet diplomatike hapen, riorganizohen dhe mbyllen me vendim të Presidentit, pas konsultimit me Kryeministrin.
2. Misionet diplomatike veprojnë nën mbikqyrjen dhe në pajtim me udhëzimet e Ministrisë së Punëve te Jashtme.
3. Mënyra e funksionimit, struktura dhe numri i personelit të misioneve diplomatike përcaktohen nga Ministri i Punëve të Jashtme.

Neni 10
Funksionet e misionit diplomatik

1. Misioni diplomatik i Republikës së Kosovës ushtron funksionet në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të vitit 1961, me Ligjin për Ministrinë e Punëve te Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik, me këtë ligj dhe me akte të tjera nënligjore në zbatim të tij.
2. Misioni diplomatik ushtron këto funksione kryesore:
   2.1. përfaqëson Republikën e Kosovës në shtetin pranues ose në organizatat ndërkombëtare;
   2.2. mbron në shtetin pranues interesat e Republikës së Kosovës dhe të shtetasve ose personave juridikë të saj, në pajtim me të drejtën ndërkombëtare dhe me legjislacionin në fuqi të shtetit pranues;
   2.3. nxitë dhe fuqizon zhvillimin e marrëdhënieve politike, ekonomike, kulturore, arsimore, shkencore, teknologjike, të informacionit, diplomatike-konsullore dhe në çdo fushë tjetër ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shtetit pranues ose organizatës ndërkombëtare, në një frymë miqësore e bashkëpunimi;
   2.4. informon Ministrinë e Punëve të Jashtme për zhvillimet ekonomike, politike dhe sociale të shtetit pranues dhe për veprimtarinë e organizatave ndërkombëtare pranë të cilave është akredituar, në rastet kur preket interesi i Republikës së Kosovës;
   2.5. bashkëpunon me delegacionet e Republikës së Kosovës në bisedimet që zhvillohen në shtetin pranues dhe merr pjesë në bisedime me qeverinë e shtetit pranues në përgatitjen për nënshkrim të marrëveshjeve dy dhe shumëpalëshe si dhe në veprimtarinë e konferencave ndërkombëtare;
   2.6. promovon paqen dhe sigurinë rajonale dhe ndërkombëtare;
   2.7. promovon, mbron dhe fuqizon sigurinë dhe statusin ndërkombëtar të Republikës së Kosovës;
   2.8. kontribuon në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të njohura në nivel universal;
   2.9. mbron të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të shtetasve të Republikës së Kosovës brenda fushës së kompetencës së vet;

2.10. mbron sovranitetin dhe integritetin territorial, dhe interesat tjera të Republikës së Kosovës;
2.11. promovon veprimtarinë e organizatave publike, qendrave ose instituteve të Republikës së Kosovës jashtë.

3. Misioni diplomatik kryen edhe funksione ose veprimtari të tjera për të cilat autorizohet nga Ministri i Punëve të Jashtme në pajtim me këtë ligj, me Ligjin për Ministrinë e Punëve te Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik dhe akte të tjera nënligjore.
4. Misioni diplomatik kryen edhe funksione konsullore në shtetin pranues. Nëse ka misione konsullore të Republikës së Kosovës në të njëjtin shtet, misioni diplomatik kryen funksione konsullore në atë pjesë të territorit që nuk përfshihet në juridiksionin e misionit konsullor. Funksionet konsullore ushtrohen nga një diplomat i misionit diplomatik, i ngarkuar për veprimtarinë konsullore, me miratimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të vitit 1963, Ligjin për Shërbimin Konsullor dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 11
Misioni i posaçëm

1. Misioni i posaçëm është një mision i përkohshëm, që përfaqëson Republikën e Kosovës në një shtet tjetër ose organizatë ndërkombëtare, me pëlqimin e tyre, për të negociuar ose kryer detyra të posaçme, të cilat janë në interes të Republikës së Kosovës.
2. Themelimi, përbërja dhe funksionet e misionit të posaçëm përcaktohen me vendim të Presidentit, pas konsultimit me Kryeministrin.

Neni 12
Personeli i misioneve diplomatike

1. Personeli i misioneve diplomatike përbëhet nga personeli diplomatik, personeli administrativ dhe teknik, dhe personeli shërbyes.
2. Në personelin e misioneve diplomatike mund të përfshihen edhe nëpunës të caktuar në bazë të një marrëveshjeje të nivelit të shërbimit, mes Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe institucioneve tjera, për të kryer detyra në fushën ekonomike, kulturore, shkencore dhe të mbrojtjes dhe në çdo fushë tjetër për një kohë të caktuar. Gjatë kohës së shërbimit në misionin diplomatik, këta nëpunës gëzojnë të njëjtin status me anëtarët e personelit të misionit dhe pas përfundimit të këtij shërbimi rikthehen në pozicionin e mëparshëm, duke rifituar statusin që kanë pasur ose në një pozicion të barasvlershëm me të.

Neni 13
Emërimi dhe lirimi nga detyra i shefit të misionit

Emërimi dhe lirimi i shefit të misionit rregullohet me Ligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik dhe aktet nënligjore të Ministrisë së Punëve te Jashtme.

Neni 14
Funksionet e shefit të misionit diplomatik

1. Shefi i misionit diplomatik, në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të vitit 1961, ushtron këto funksione kryesore:
   1.1. përfaqëson dhe vepron në emër të Republikës së Kosovës në shtetin pranues ose organizatat ndërkombëtare;
   1.2. inicion dhe nënshkruan instrumente diplomatike;
   1.3. jep deklarata dhe mban qëndrime në emër të Republikës së Kosovës.
2. Shefi i misionit ka autoritet mbi të gjitha shërbimet civile dhe ushtarake që ushtrojnë veprimtarinë në misionin diplomatik. Ai drejton, udhëzon, kontrollon dhe vlerëson të gjithë veprimtarinë zyrtare të personelit të misionit diplomatik, si dhe kryen funksione të tjera, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore.
3. Shefi i misionit përgjigjet përpara Ministrit të Punëve të Jashtme për zbatimin e politikës së jashtme të Republikës së Kosovës në shtetin pranues dhe vepron në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e dhëna nga ky ligj, si dhe me udhëzimet e dhëna nga strukturat përkatëse në Ministrinë e Punëve të Jashtme.
4. Shefat e misioneve për çështje të interesit të veçantë mund të dërgojnë një raport ose rekomandim edhe te Presidenti, Kryeministri, dhe Ministrat e tjerë në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive të tyre.
5. Shefi i misionit bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e misioneve konsullore të Republikës së Kosovës në shtetin pranues.

Neni 15
Akreditimi në disa vende

1. Një shef misioni në një shtet mund të akreditohet edhe në një ose disa shtete të tjera, pavarësisht nëse ka mision diplomatik ose mision konsullor në këto shtete.
2. Shefi i misionit diplomatik dhe anëtarët e tjerë të personelit diplomatik, të akredituar në disa shtete në të njëjtën kohë, kryejnë në shtetet e tjera të njëjtat funksione që kryejnë në shtetin ku janë rezidentë.
3. Në shtetet ku nuk ka mision diplomatik, mund të emërohen si ambasadorë jorezidentë diplomatët me gradën ambasador. Ata kryejnë funksionet e njëjta të përfaqësimit si ambasadorët rezidentë.

Neni 16
I ngarkuari me punë

1. I ngarkuari me punë emërohet me dekret të Presidentit, pas propozimit të Qeverisë. Procedurat për akreditimin e të ngarkuarit me punë zbatohen nga Ministria e Punëve të Jashtme.
2. I ngarkuari me punë i përkohshëm emërohet nga Ministri i Punëve të Jashtme.
3. Në mungesë të shefit të misionit ose në rast pamundësie të shefit të misionit për të ushtruar funksionet e tij/saj, një i ngarkuar me punë i përkohshëm vepron përkohësisht si shef i misionit.

KREU III
NËPUNËSIT E SHËRBIMIT TË JASHTËM

NËNKREU I
STATUSI I PERSONELIT TË SHËRBIMIT TË JASHTËM

Neni 17
Ushtrimi i funksioneve diplomatike

1. Funksionet diplomatike në shërbimin e jashtëm ushtrohen nga anëtarët e personelit diplomatik në pajtim me dispozitat e këtij ligji.
2. Gjatë ushtrimit të funksioneve diplomatike, personeli diplomatik ndihmohet nga personeli administrativ dhe teknik, dhe personeli shërbyes.

Neni 18
Përfaqësuesit diplomatikë

Përfaqësuesi diplomatik ushtron funksione dhe kryen detyra në shërbimin diplomatik të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën, Ligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik, këtë ligj dhe me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 19
Kriteret për pranimin në shërbimin e jashtëm

1. Kriteret e përgjithshme për përzgjedhjen e ambasadorëve dhe konsujve si dhe shefave të tjerë të misioneve rregullohen me Ligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik dhe me aktet nënligjore në zbatim të tij.
2. Anëtarët e personelit të shërbimit të jashtëm i plotësojnë kërkesat si në vijim:
   2.1. kanë shtetësi të Kosovës;
   2.2. kanë zotësi të plotë për të vepruar;
   2.3. nuk janë dënuar për kryerje të veprës penale;
   2.4. nuk janë subjekt i masës disiplinore të largimit nga puna;
   2.5. janë në gjendje të mirë shëndetësore për të kryer detyrën;
   2.6. kanë përgatitje të duhur profesionale;
   2.7. zotërojnë gjuhë të huaj të pranueshme dhe të përshtatshme për punën në shërbimin e jashtëm;
   2.8. kanë kaluar provimin pranues të organizuar në bazë të proceduarve të përcaktuara me akt nënligjor të Ministrisë së Punëve të Jashtme.
3. Posedimi i shtetësisë së Kosovës nuk është i domosdoshëm për personelin administrativ dhe teknik, dhe personelin shërbyes.

Neni 20
Pranimi në shërbimin e jashtëm

Pranimi në shërbimin e jashtëm bëhet nëpërmjet konkursit të hapur, në pajtim me Ligjin për Ministrinë e Punëve te Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 21
Transferimi, lëvizja paralele, ngritja në detyrë

1. Transferimi, lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë e nëpunësit të shërbimit të jashtëm bëhet me vendim të Ministrit të Punëve të Jashtme, në bazë të propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm. Në çdo rast, propozimi shoqërohet dhe mbështetet në vlerësimin e punës të paraqitur nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit.
2. Procedurat e kryerjes së transferimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë përcaktohen në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm.

Neni 22
Kohëzgjatja në misionet diplomatike

Përfaqësuesit diplomatikë qëndrojnë në shërbim në të njëjtin mision diplomatik për një periudhe katër (4) vjeçare, ose ndryshe siç kërkohet për të përmbushur nevojat e Ministrisë dhe në diskrecion të Ministrit të Punëve të Jashtme.

Neni 23
Tërheqja e parakohshme nga misioni diplomatik

1. Presidenti i Republikës së Kosovës urdhëron tërheqjen e një ambasadori apo shefi të misionit nga misioni diplomatik përpara mbarimit të afatit të caktuar, për arsyet e mëposhtme:
   1.1. për nevoja pune në Ministrinë e Punëve të Jashtme;
   1.2. në bazë të kërkesës së vetë përfaqësuesit diplomatik;
   1.3. për arsye të vlerësimit negativ të punës së përfaqësuesit diplomatik;
   1.4. për shkelje të dispozitave të këtij ligji ose të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi;
   1.5. kur një gjë e tillë kërkohet nga shteti pranues.
2. Tërheqja e të gjithë përfaqësuesuesve të tjerë diplomatikë, duke mos e përfshirë shefin e misionit, për të njëjtat arsye të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, bëhet me urdhërin e Ministrit të Punëve të Jashtme.

Neni 24
Pezullimi nga Shërbimi i Jashtëm

1. Nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm mund të pezullohen nga ushtrimi i funksioneve të tij/saj:
   1.1. kur ndaj tij/saj fillon procedura për vepër penale, deri në marrjen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë;
   1.2. për periudha specializimi, më shumë se gjashtë (6) muaj, të ndërmarra me nismën e vetë nëpunësit, por me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm.
2. Gjatë periudhës së pezullimit, nëpunësi i shërbimit të jashtëm nuk paguhet, përveç në rastin e një vendimi të veçantë në pajtim me rregullat e Shërbimit Civil.
3. Në rastin e parashikuar në nënparagrafin 1.1 të këtij neni, kur çështja penale pushohet ose kur me vendim gjyqësor të formës së prerë deklarohet i pafajshëm,

nëpunësi rikthehet në shërbimin e jashtëm dhe, njëkohësisht, rifiton statusin, pagën dhe çdo të drejtë tjetër, që nga çasti i pezullimit.

4. Për rastin e parashikuar në nënparagrafin 1.1 të këtij neni, periudha e pezullimit merret në konsideratë për efekt të llogaritjes së afatit kohor, të nevojshëm për fitimin e gradave diplomatike.

Neni 25
Humbja e statusit në shërbimin e jashtëm

1. Përfaqësuesi diplomatik humb statusin në këtë shërbim kur:
   1.1. largohet në mënyrë vullnetare nga shërbimi i jashtëm;
   1.2. me humbjen e zotësisë për të vepruar;
   1.3. dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerje të veprës penale;
   1.4. kryen shkelje të rënda, të parashikuara në rregullat e Shërbimit Civil, si dhe në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm, për të cilat ndaj tij merret masa e largimit nga puna.

NËNKREU II
GRADAT

Neni 26
Gradat diplomatike dhe konsullore

1. Përfaqësuesit diplomatikë dhe konsujt, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në misionet diplomatike, marrin grada diplomatike ose konsullore.
2. Gradat diplomatike në shërbimin e jashtëm janë:
   2.1. ambasador;
   2.2. ministër
   2.3. ministër këshilltar;
   2.4. këshilltar;
   2.5. sekretar i parë;
   2.6. sekretar i dytë;
   2.7. sekretar i tretë;
   2.8. atashe.
3. Gradat konsullore në shërbimin e jashtëm janë:
   3.1. konsull i përgjithshëm;
   3.2. konsull;
   3.3. zëvendëskonsull;
   3.4. agjent konsullor.

Neni 27
Barasvlera e gradave

Përfaqësuesit diplomatikë mund të kalojnë nga një gradë diplomatike në një gradë konsullore, dhe konsujt mund të kalojnë nga një gradë konsullore në një gradë

diplomatike në përputhje me funksionet dhe detyrat e ngarkuara. Në çdo rast, kalimi bëhet duke respektuar barasvlerën e gradave si në vijim:

Konsulli përgjithshëm;	Ministër këshilltar ose këshilltar;
Konsull;	Sekretar i parë ose i dytë;
Zëvendëskonsull;	Sekretar i dytë ose i tretë;
Agjent konsullor.	Sekretar i tretë ose atashe.

Neni 28
Dhënia e gradave

1. Avancimi i nëpunësve të shërbimit të jashtëm bëhet duke u mbështetur në sistemin e gradimit. Elementet kryesorë në dhënien e një grade për anëtarin e shërbimit të jashtëm janë koha e shërbimit, kualifikimi dhe vlerësimi i rezultateve të punës.
2. Përveç gradës ambasador, gradat jepen nga Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës, mbi bazën e të dhënave që ndodhen në dosjen personale të çdo punonjësi dhe në bazë të vlerësimeve të bëra, sipas kritereve dhe rregullave të përcaktuara në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm.
3. Grada diplomatike ambasador miratohet nga Presidenti, me propozimin e Qeverisë.

Neni 29
Periudha për kalimin nga një gradë në tjetrën

1. Periudha minimale për kalimin nga një gradë në një tjetër përcaktohet me Rregulloren e Shërbimit të Jashtëm.
2. Kriteret për fitimin e gradës ministër këshilltar dhe ministër përcaktohen në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm.

Neni 30
Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës

1. Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës ka për detyrë:
   1.1. dhënien e gradave diplomatike dhe konsullore për nëpunësit e shërbimit të jashtëm në përputhje me këtë ligj dhe Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm;
   1.2. shqyrtimin e ankesave të nëpunësve të shërbimit të jashtëm ndaj të cilëve është marrë masë disiplinore nga eprori i tyre i drejtpërdrejt;
   1.3. shqyrtimin e rasteve të shkeljeve të rënda të kryera nga nëpunësit e shërbimit të jashtëm dhe propozimin te Ministri i Punëve të Jashtme i masave disiplinore për nëpunësit që kanë kryer këto shkelje.
2. Përbërja e Komisionit të Gradave dhe Disiplinës përcaktohet me Rregulloren e Shërbimit të Jashtëm.
3. Mënyra e funksionimit të Komisionit të Gradave dhe të Disiplinës përcaktohen në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm.
4. Llojet e shkeljeve dhe masat disiplinore përcaktohen në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm.

KREU IV
TË DREJTAT DHE DETYRAT E NËPUNËSIT TË SHËRBIMIT TË JASHTËM

Neni 31
Të drejtat e nëpunësit të shërbimit të jashtëm

1. Nëpunësi i shërbimit të jashtëm ka të drejtë:
   1.1. të gëzojë statusin e diplomatit, në shtetin apo shtetet ku ai/ajo është akredituar;
   1.2. të fitojë gradë në shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës, në bazë të kritereve të përcaktuara në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm;
   1.3. të mbajë funksione në Ministrinë e Punëve të Jashtme ose në misionet diplomatike, në përputhje me nivelin profesional dhe gradën që gëzon;
   1.4. të gëzojë imunitetet dhe lehtësitë që i jep statusi i diplomatit, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare gjatë periudhës kur ndodhet me shërbim jashtë shtetit;
   1.5. të përfitojë nga kualifikimet dhe trajnimet e ofruara nga Ministria e Punëve të Jashtme;
   1.6. të ketë trajtim financiar të posaçëm, në përputhje me statusin e tij dhe legjislacionin ne fuqi;
   1.7. të gëzojë të gjitha të drejtat e tjera të njohura në legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe të shtetit pranues.

Neni 32
Detyrat e nëpunësit të shërbimit të jashtëm

1. Nëpunësi i shërbimit të jashtëm ka për detyrë:
   1.1. të ushtrojë me ndershmëri dhe korrektësi funksionet dhe detyrat e ngarkuara, në përputhje me urdhrat, udhëzimet dhe rregulloret e Ministrisë së Punëve të Jashtme, aktet ndërkombëtare dhe me legjislacionin e Republikës së Kosovës;
   1.2. të mbajë përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e veprimeve gjatë kryerjes së detyrës;
   1.3. të mbrojë interesat e shtetit të Kosovës dhe të shtetasve dhe personave juridikë të Republikës së Kosovës në shtetin ose shtetet ku është akredituar dhe ushtron funksionet e tij;
   1.4. të zbatojë rregullat për informacionin e klasifikuar edhe pas largimit nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe të sigurojë ruajtjen e të dhënave dhe të informatave që i janë besuar;
   1.5. të pezullojë aktivitettin e tij në një parti, organizate ose shoqate politike gjatë periudhës në shërbimin e jashtëm;
   1.6. të mbajë, në të gjitha rrethanat, një qëndrim moral të denjë dhe profesional;
   1.7. të mos bëjë deklarata që bien në kundërshtim me qëndrimin e Republikës së Kosovës në marrëdhënie me shtetet e tjera ose organizatat ndërkombëtare;
   1.8. të respektojë ligjet dhe rregulloret e shtetit ose të shteteve ku është akredituar, dhe të mos përfshihet në veprimtari të cilat mund të vlerësohen si ndërhyrje në punët e brendshme të shtetit ose të shteteve ku zhvillon veprimtarinë;

1.9. të ushtrojë veprimtarinë e vet në përputhje me imunitetet dhe privilegjet që gëzon si anëtar i misionit diplomatik;
1.10. të mos ushtrojë në shtetin ose shtetet ku është akreditуar veprimtari tregtare ose çdo veprimtari tjetër fitimprurëse për llogari të tij ose të familjes së tij.
2. Shkelja e një detyrimi paraqet arsye për masë disiplinore.

KREU V
TRAJTIMI FINANCIAR I PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË JASHTËM

Neni 33
Pagat e punonjësve të shërbimit të jashtëm

Pagat e punonjësve të shërbimit të jashtëm caktohen në bazë të funksionit, gradave dhe përvojës në punë në pajtim me ligjet përkatëse në fuqi.

Neni 34
Trajtimi i familjeve të personelit të misioneve diplomatike

1. Bashkëshortit/es, i/e cili/a e shoqëron nëpunësin në misionin diplomatik, i njihet koha e qëndrimit jashtë shtetit për efekt të përvojës në punë dhe të pagesës së kontributeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës.
2. Bashkëshorti/ja, që në kohën e emërimit të përfaqësuesit diplomatik jashtë shtetit ka punuar në një institucion publik, ka të drejtë të kthehet në këtë vend pune pas kthimit të bashkëshortit/es në atdhe. Institucioni publik ku bashkëshorti/ja ka qenë i/e punësuar, ka detyrimin ta rimarrë në të njëjtin pozitë pune ose në një pozitë të barasvlershme.
3. Ministria e Punëve të Jashtme garanton arsimimin fillor dhe të mesëm të fëmijëve të të anëtarëve të personelit të misionit diplomatik dhe ku është e nevojshme, siguron financimin e këtij arsimimi. Mënyra, kriteret dhe kushtet e financimit përcaktohen me Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm.
4. Fëmijët, deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, të anëtarëve të personelit të misionit përfitojnë sigurimet shëndetësore sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

KREU VI
NËPUNËSIT ADMINISTRATIVË DHE PERSONELI NDIHMËS

Neni 35
Statusi i personelit administrativ, teknik dhe shërbyes

1. Nëpunës administrativë në shërbimin e jashtëm quhen nëpunësit të cilët kryejnë detyra në sektorët e buxhetit dhe të financës, në fushën e përpunimit të të dhënave dhe në çështje administrative. Për këta nëpunës zbatohen rregullat e Shërbimit Civil dhe aktet tjera nënligjore në zbatim të tij.
2. Personel teknik në shërbimin e jashtëm quhet ajo kategori punonjësish të cilët kryejnë detyra në sektorët ndihmës dhe të mirëmbajtjes.
3. Personel shërbyes në shërbimin e jashtëm quhet ajo kategori punonjësish të cilët kryejnë detyra në shërbimin shtëpiak të misionit.

Neni 36
Rekrutimi i stafit vendor

Misionet diplomatike mund të punësojnë shtetas të shtetit pranues, sipas procedurave të parashikuara në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm, për kryerjen e punëve administrative, teknike dhe shërbyese.

KREU VII
DISPOZITA KALIMTARE

Neni 37

1. Të gjithë të emëruarit si të ngarkuar me punë në kohën e hapjes së misioneve të para diplomatike të Republikës së Kosovës, kanë gradën ministër këshilltar.
2. Të gjithë të emëruarit tjerë në kohën e hapjes së misioneve të para diplomatike të Republikës së Kosovës, kanë atë gradë e cila u jepet në rastin e emërimit.
3. Periudha që nga emërimi i tyre numërohet për qëllim të fitimit të gradave diplomatike në shërbimin e jashtëm.

KREU VIII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 38
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ministria e Punëve të Jashtme ngarkohet të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.
2. Ministria e Punëve të Jashtme, brenda tre (3) muajve nga miratimi i këtij ligji, përgatit Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm. Rregullorja miratohet me vendim të Qeverisë.

Neni 39
Hyrja në fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-122
16 Dhjetor 2008

Shpallur me dekretin Nr. DL-071-2008, datë 30.12.2008 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI IV / Nr. 46 / 15 JANAR 2009

LIGJI Nr. 03/L-033
PËR STATUSIN, IMUNITETET DHE PRIVILEGJET E MISIONEVE DIPLOMATIKE, KONSULLORE DHE PERSONELIN E KOSOVËS DHE PRANINË NDËRKOMBËTARE USHTARAKE SI DHE PERSONELIN E SAJ

Në mbështetje të Kapitullit IV neni 65 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me qëllim të qartësimit të statusit, imunitetit dhe privilegjeve të misioneve diplomatike dhe konsullore, duke përfshirë edhe misionet e organizatave ndërkombëtare ndërqeveritare dhe personelin e tyre në Republikën e Kosovës, bashkë me personat tjerë të mbrojtur ndërkombëtarisht, në pajtim me të drejtën zakonore ndërkombëtare që është mishëruar në Konventën e Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike të datës 18 prill 1961, Konventën e Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore të datës 14 prill 1963, Konventën e përgjithshme mbi privilegjet dhe imunitetet e Kombeve të Bashkuara të datës 13 shkurt 1946, Konventën mbi privilegjet dhe imunitetin e Agjencive speciale të Kombeve të Bashkuara të datës 21 nëntor 1947 dhe me qëllim të sigurimit të marrëveshjeve kalimtare për misionet ekzistuese të ndërlidhjes në Republikën e Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Miraton:

LIGJIN PËR STATUSIN, IMUNITETET DHE PRIVILEGJET E MISIONEVE DIPLOMATIKE, KONSULLORE DHE PERSONELIN E KOSOVËS DHE PRANINË NDËRKOMBËTARE USHTARAKE SI DHE PERSONELIN E SAJ

Neni 1
Lënda e Rregullimit

Ky Ligj rregullon Statusin, Imunitetet dhe Privilegjet e Misioneve Diplomatike dhe Konsullore dhe personelin në Republikën e Kosovës dhe Praninë Ndërkombëtare Ushtarake si dhe personelin e saj.

Neni 2
Përkufizimet

- **"eksperti në mision" –** është eksperti i stërvitur për misionet e Kombeve të Bashkuara, agjencitë e saj të specializuara, OSBE-në ose organizata ndërqeveritare ndërkombëtare përkatëse të tjera përgjatë kohëzgjatjes së misionit të tyre.
- **"persona non grata"** është personi, prezenca e të cilit nuk është e dëshiruar në Republikën e Kosovës.

Neni 3
Misionet dhe personeli i tyre që kanë të drejtë për status diplomatik ose konsullor

3.1. Misionet e themeluara në Republikën e Kosovës me marrëveshje reciproke ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe shteteve të huaja me të cilat Republika e Kosovës ka marrëdhënie diplomatike ose konsullore, bashkë me personelin e tyre, do të gëzojnë statusin, privilegjet dhe imunitetet e parapara në këtë Ligj.

3.2. Zyrat dhe personeli, duke përfshirë edhe ekspertët në mision, të cilët gëzojnë statusin, privilegjet dhe imunitetet diplomatike janë:
   a) përfaqësuesit ndërkombëtar civil (PNC) dhe Përfaqësuesit special të Bashkimit Evropian (PSBE);
   b) misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX);
   c) kombet e Bashkuara, agjencitë speciale të Kombeve të Bashkuara;
   d) organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë (OSBE); dhe
   e) organizatat tjera ndërkombëtare ndërqeveritare si e sheh të arsyeshme Ministri i punëve të jashtme, gjithashtu do të gëzojnë këtë status, privilegj dhe imunitet.

3.3. Për qëllime të këtij Ligji, të emëruarit e PNC në ato pozita në institucionet e Republikës së Kosovës, të cilat janë specifikuar në zgjidhjen e statusit të Kosovës siç është paraparë në Propozimin Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, do të konsiderohen se janë personel i PNC.

Neni 4
Personeli i misioneve diplomatike ose konsullore

4.1. Ambasadorët do të akreditohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës ose nga Ministri i Punëve të Jashtme ndërsa për emërimet e të ngarkuarit me punë, (charges d'affaires), Udhëheqësit e Misioneve Konsullore dhe udhëheqësit e misionit do të kërkohet pëlqimi i Ministrit të Punëve të Jashtme.

4.2. Për arritjen e parë dhe largimin e përhershëm të personelit tjetër nga misionet, duke mos përfshirë personelin e rekrutuar në Republikën e Kosovës do të informohet Ministria e Punëve të Jashtme.

4.3. Emërimi i qytetarëve të Republikës së Kosovës ose i personelit që nuk janë qytetarë të shtetit dërgues, si personel diplomatik që i gëzon imunitetet dhe privilegjet në nenin 5 të këtij Ligji, do të kërkojë miratim paraprak të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

4.4. Ministri i Punëve të Jashtme mund ta njoftojë misionin që udhëheqësi i tij i misionit, ose një anëtar tjetër nga personeli i misionit, është persona non grata dhe nuk është i pranueshëm në Republikën e Kosovës.

4.5. Në rast se ky anëtar nuk do të revokohet brenda një periudhe të mjaftueshme kohore, që nuk do të jetë më pak se 48 orë edhe në rastet e urgjencës ekstreme, dhe jo më shumë sesa tridhjetë ditë, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk do ta njohë më atë anëtar si pjesë të Misionit dhe privilegjet dhe imunitetet diplomatike do të pushojnë në momentin e shpalljes së tij persona non grata.

4.6. Ministri i Punëve të Jashtme nuk mund t'i shpall PNC/PSBE-së ose një anëtar të personelit të tij, ose anëtarët e misionit EULEX, si persona non grata.

4.7. Ministri do ta ushtrojë fuqinë e paragrafit 4 të këtij neni vetëm sa i përket misioneve të shteteve ose organizatave ndërkombëtare që janë specifikuar në dokumentin e Zgjidhjes së Statusit që kanë rol në zbatimin apo mbikëqyrjen e zgjidhjes së statusit, pasi i ka dhënë njoftim paraprak Përfaqësuesit ndërkombëtar civil se ka për qëllim ta bëjë këtë, deri atëherë kur Përfaqësuesi ndërkombëtar civil e informon atë me shkrim që kjo kërkesë për njoftim paraprak nuk është më e nevojshme.

Neni 5
Privilegjet dhe imunitetet e misioneve diplomatike dhe konsullore dhe personelit të tyre

5.1. Objektet e një misioni diplomatik apo konsullor janë të paprekshme. Zyrtarët e shtetit të Republikës së Kosovës nuk do të hyjnë aty përveç me miratim të Udhëheqësit të misionit. Prona, pasuritë dhe mjetet e transportit të misionit dhe personelit të tij gëzojnë imunitet ndaj kontrollimit, rekuizimit, dhe konfiskimit.

5.2. Rezidencat private dhe prona e personelit të një misioni diplomatik apo konsullor, përveç personelit vendor të punësuar, janë po ashtu të paprekshme, përveç personelit vendor të punësuar.

5.3. Arkivat dhe dokumentet e misionit diplomatik apo konsullor dhe personelit të tij janë po ashtu të paprekshme. Kur komunikimi ndërmjet misionit diplomatik apo konsullor dhe Qeverisë së tij bëhen përmes korrierit, korrieri dhe çanta e mbyllur me dokumente janë të paprekshme.

5.4. Personeli i misioneve përveç personelit të punësuar vendor, bashkë me anëtarët e familjeve të tyre që i shoqërojnë ata, gëzojnë imunitet ndaj arrestimit apo paraburgimit. Bagazhi i tyre personal i nënshtrohet kontrollit vetëm nëse ka arsye serioze për të dyshuar që mund të përmbajë artikuj, importimi apo eksportimi i të cilëve ndalohet me ligjin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës. Kontrollimet e tilla bëhen vetëm në prani të zyrtarit diplomatik ose një përfaqësuesi të emëruar nga ai.

5.5. Personeli i misioneve përveç personelit të punësuar vendor, bashkë me anëtarët e familjeve të tyre që i shoqërojnë ata, gëzojnë imunitet nga juridiksioni penal në Republikën e Kosovës. Ata po ashtu gëzojnë imunitet ndaj gjithë juridiksionit civil apo administrativ në Republikën e Kosovës, përveç në rastet e ndonjë veprimi juridiko-civil që ka të bëjë me:

a) pronën private të patundshme në Republikën e Kosovës që e posedon zyrtari diplomatik në cilësi personale që nuk është e lidhur me funksionet e tij zyrtare;

b) trashëgiminë ku zyrtari diplomatik në të cilën ai përfshihet si ekzekutues, administrator ose trashëgimtar në cilësi personale jashtë funksioneve të veta zyrtare;

c) ndonjë aktivitet profesional apo ekonomik të ndërmarrë nga zyrtari diplomatik brenda Republikës së Kosovës në cilësi personale jashtë funksioneve të tij zyrtare;

5.6. Personeli i misioneve diplomatike apo konsullore, përveç personelit të punësuar në vend, nuk do të kërkohet të jetë dëshmitar në procedura penale apo civile.

5.7. Personeli i misionit diplomatik apo konsullor, përveç personelit të punësuar vendor, përjashtohet nga të gjitha taksat dhe tatimet, qofshin personale apo në pronë, dhe qofshin kombëtare apo komunale, përveç:

a) tatimeve indirekte që zakonisht përfshihen në çmimin e mallrave dhe shërbimeve në Republikën e Kosovës, përveç në rastin e specifikuar në paragrafin 8 të nenit 5 të këtij Ligji;
b) taksat dhe tatimet në pronën e paluajtshme private në Republikën e Kosovës që i mban një ndërmjetës diplomatik në cilësi private dhe që nuk lidhen me funksionin e tij zyrtar;
c) pronën e paluajtshme, trashëgiminë apo tatimet e trashëgimisë të pronës private të luajtshme të ndërmjetësit diplomatik apo një anëtari të tij të familjes, i cili vdes gjatë qëndrimit në Republikën e Kosovës dhe e cila pronë gjendet në Republikën e Kosovës si rezultat i pranisë zyrtare të ndjerit në Republikën e Kosovës;
d) të ardhurat private që e kanë burimin brenda Republikës së Kosovës ose tatimet kapitale në investimet e bëra në cilësi personale në Republikën e Kosovës;
e) taksat e ngarkuara për disa shërbime të kryera, duke përfshirë regjistrimin, taksat e gjykatës ose të regjistrimit të pronës së paluajtshme në Republikën e Kosovës.

5.8. Misionet diplomatike ose konsullore dhe personeli i tyre përveç personelit të punësuar vendor kanë të drejtë të importojnë mallra dhe shërbime, të liruar nga dogana dhe akciza ose tatimi në vlerë të shtuar, që janë për përdorim zyrtar dhe ekskluziv nga misioni ose për përdorim personal ekskluziv të personelit të misionit përveç personelit të punësuar në vend. Mund të mundësohet shfrytëzimi i depove të siguruara për importim të mallrave të tilla. Misionet diplomatike kanë të drejtë për zbritje të çmimit në tatimin në vlerë të shtuar për të gjitha shërbimet e blera në Republikën e Kosovës.

5.9. Ministri i Punëve të Jashtme po ashtu mund të vendos kufizime të konsiderueshme në sasinë e mallrave të blera pa tatim për shfrytëzim personal të personelit në misionet diplomatike apo konsullore, si dhe për rishitjen e këtyre mallrave në Republikën e Kosovës, me qëllim të pengimit të keqpërdorimit të privilegjeve diplomatike.

5.10. Ministria e Punëve të Jashtme do të pajisë me kartela të identitifikimit personelin e misioneve diplomatike apo konsullore. Automjetet e misioneve dhe personeli i tyre përveç personelit te punësuar vendor mund te marrin tabela të regjistrimit që i identifikojnë automjetet si diplomatike, ngase kjo është e përshtatshme për misionet dhe që ata të mund të realizojnë më mirë funksionet e veta.

Neni 6
Personeli vendor i punësuar

Personeli vendor në misionet diplomatike apo konsullore, duke përfshirë edhe qytetarët e shtetit dërgues të cilët janë banorë afatgjatë të Republikës së Kosovës dhe të cilët nuk

janë njoftuar dhe pranuar nga Ministria e punëve të jashtme si personel që gëzojnë imunitetet dhe privilegjet në nenin 5 të këtij Ligji, do të gëzojnë imunitet nga procedurat penale dhe civile për veprimet e kryera nga ata, dhe për fjalët e shkruara apo të shqiptuara, në cilësinë e tyre zyrtare.
Ky imunitet do të vazhdojë të jetë valid për veprimet e kryera ose fjalët e shqiptuara dhe të përdorura në cilësinë e tyre zyrtare gjatë kohës që janë të punësuar nga misioni, edhe nëse marrëdhënia e punës është ndërprerë.

Neni 7
Heqja e imuniteteve

Imunitetet në nenet 5 dhe 6 të këtij Ligji mund të hiqen vetëm nga Udhëheqësi i misionit, ose respektivisht me Udhëheqësit e Misionit, me marrëveshje të shpejtë me shkrim nga qeveria e shtetit përkatës dërgues ose baza e organizatës përkatëse ndërkombëtare ndërqeveritare.

Neni 8
Flamujt dhe emblemat

Misionet diplomatike apo konsullore dhe Udhëheqësit e misioneve të shteteve të akredituara në Republikën e Kosovës kanë të drejtë ta përdorin flamurin e tyre dhe emblemën kombëtare në objektin e Misionit, në rezidencën e shefit të misionit dhe në mjetet zyrtare të transportit.

Neni 9
Persona tjerë ndërkombëtarisht të mbrojtur

Udhëheqësit e shteteve të huaja, udhëheqësit e qeverive, dhe ministrat e punëve të jashtme, bashkë me familjet e tyre gëzojnë të njëjtat imunitete nga procedurat penale dhe civile si edhe ndërmjetësit tjerë diplomatikë gjatë kohës kur janë në Republikën e Kosovës.

Neni 10
Statusi, imunitetet dhe privilegjet e pranisë ndërkombëtare ushtarake (PNU)

10.1. Prania ndërkombëtare ushtarake (PNU) e vendosur në Republikën e Kosovës në bazë të Zgjidhjes së statusit, e vendosur me marrëveshje nga Këshilli i sigurimit i Kombeve të Bashkuara, dhe me çfarëdo emri që do ta ketë, gëzon imunitetet dhe privilegjet e mëposhtme. PNU përfshinë kontingjentet e veta kombëtare.
10.2. PNU, prona e vet, fondet dhe pasuritë gëzojnë imunitet ndaj të gjitha procedurave ligjore.
10.3. Personeli vendor i punësuar në KFOR gëzon imunitet ndaj procedurave juridiko-penale për sa i përket fjalëve të shqiptuara apo të shkruara dhe veprimeve të realizuara nga ata gjatë kryerjes së detyrave që ekskluzivisht lidhen me shërbimet e veta për KFOR-in.
10.4. Personeli i PNU përveç atyre të dhënë në paragrafin 3 të nenit 10 të këtij Ligji do të gëzoj imunitet ndaj:

a) juridiksionit para gjykatave në Republikën e Kosovës përkitazi me veprimet administrative, civile apo penale që i kryejnë në territorin e Republikën e Kosovës. Këta punëtorë do t'i nënshtrohen juridiksionit ekskluziv të shteteve përkatëse që i kanë dërguar; dhe
b) të gjitha formave të arrestit apo paraburgimit përveç nga personat që veprojnë në emër të shteteve përkatëse dërgues. Nëse mbahen gabimisht, atëherë menjëherë do t'i dorëzohen autoriteteve të PNU-së.

10.5. Të gjitha kërkesat për heqjen e imunitetit nga juridiksioni i Republikës së Kosovës ose për ushtrimin e juridiksionit të shtetit dërgues, do të bëhen nga Ministri i punëve të jashtme dhe do t'i dorëzohen Komandantit të PNU-së për veprim nga ana e autoriteteve që kontingjentit përkatës kombëtar.

10.6. Kontraktuesit e PNU-së, punëtorët dhe nënkontraktuesit e tyre nuk do t'i nënshtrohen ligjeve apo rregulloreve vendore për çështjet që lidhen me kushtet e kontratave të tyre me PNU-në apo me kontingjentet e veta kombëtare.

10.7. Kontraktuesit e PNU-së përveç kontraktuesve vendorë nuk do t'i nënshtrohen ligjeve apo rregulloreve vendore përkitazi me licencimin dhe regjistrimin e punëtorëve, bizneseve dhe korporatave.

10.8. Kontraktuesit e PNU-së, punëtorët dhe nënkontraktuesit e tyre gëzojnë imunitet ndaj procedurave ligjore në Republikën e Kosovës përkitazi me veprimet që i kryejnë ata brenda aktiviteteve të veta zyrtare sipas kushteve të kontratës ndërmjet tyre dhe PNU-së ose kontingjenteve të saj kombëtare.

10.9. Ankesat e palës së tretë për humbje apo dëmtim të pronës dhe për lëndime personale, sëmundje apo vdekje që shkaktohen apo drejtpërdrejt mund t'i atribuohen PNU-së apo personelit të saj dhe të cilat nuk shkaktohen nga nevojat e punës, do të zgjidhen nga komisionet për ankesa që i themelon PNU-ja, në mënyrën që e përcakton PNU.

10.10. Qeveria e Republikës së Kosovës do t'i shfrytëzojë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të vendosur në dispozicion të PNU-së dhe personelit të saj, pa pagesë, objektin publik dhe mjetet e nevojshme për realizimin e misionit të tyre.

10.11. Imuniteti i PNU-së, personelit dhe kontraktuesve të tij, i cili është i parashikuar, do të mbetet në fuqi, për veprat të cilat i kanë kryer, fjalët të cilat i kanë thënë, ose të cilat i kanë shkruar anëtarët e personelit deri sa kanë qenë në Republikën e Kosovës, ose gjatë ekzekutimit të kontratave të lidhura me PNU-në edhe pasi të ndërpritet marrëdhënia e punës së këtyre personave, gjegjësisht të përfundoj raporti i kontraktuar me kontraktuesit të PNU-së.

Neni 11
Dispozitat kalimtare
Marrëveshjet tranzitore për misionet ekzistuese të ndërlidhjes në Republikën e Kosovës

11.1. Misionet ndërlidhëse të themeluara në Republikën e Kosovës sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/42 dhe personeli përkatës do të gëzojnë statusin, privilegjet dhe imunitetet e parapara në këtë Ligj edhe në mungesë të akreditimit të Shtetit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

11.2. Ky ligj do te zëvendësoj te gjitha dispozitat e ligjit te aplikueshëm në fuqi, të cilat janë në papajtueshmëri me të.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës
Me datën: 20.02.2008

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III / Nr. 26 / 02 QERSHOR 2008

LIGJI Nr. 04/L-115
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË KANË TË BËJNË ME PËRFUNDIMIN E MBIKËQYRJES NDËRKOMBËTARE TË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË KANË TË BËJNË ME PËRFUNDIMIN E MBIKËQYRJES NDËRKOMBËTARE TË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Neni 1
Qëllimi

1. Ky ligj ka për qëllim të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve në vijim për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës:
   1.1. Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
   1.2. Ligjit Nr. 03/L-075 për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës;
   1.3. Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
   1.4. Ligjit Nr. 03/L-079 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale;
   1.5. Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
   1.6. Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04 L 101 për Fondet Pensionale të Kosovës;
   1.7. Kodit Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë;
   1.8. Ligji Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat;
   1.9. Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat;
   1.10. Ligji Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
   1.11. Ligji Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
   1.12. Ligji Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë;
   1.13. Ligji Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme;
   1.14. Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës;
   1.15. Ligji Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativ të Komunave;

1.16. Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës;
1.17. Ligji Nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës;
1.18. Ligji Nr. 03/L-237 për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave;
1.19. Ligji Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës;
1.20. Ligji Nr. 03/L-082 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës.
1.21. Ligji Nr. 03/L-033 për Statusin, imunitetet dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin e Kosovës dhe praninë ndërkombëtare ushtarake, si dhe personelin e saj.

Neni 2
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Ligji)

1. Neni 15 i ligjit bazik pas paragrafit 1. shtohet paragraf i ri 2. me tekstin si në vijim:
   2. Gjykatësit ndërkombëtarë, të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë ligj, vazhdojnë të marrin pagën e tyre të specifikuar sipas vendimit për emërim. Qeveria e Kosoves merr pjesë në pagesën e gjykatësve ndërkombëtarë, në periudhën e përcaktuar në vlerë të pagave të gjyqtarëve vendorë.
2. Neni 55 i ligjit bazik, paragrafi 1. dhe paragrafi 2 fshihen nga teksti i ligjit dhe shtohet një paragraf i ri me tekstin si në vijim:
   Mandati i gjykatësve ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim.

Neni 3
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-075 për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës (Ligji)

1. Neni 8 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 8

Auditori i përgjithshëm, i emëruar në përputhje me Kushtetutën dhe me këtë ligj, vazhdon të qëndrojë në post deri në përfundim të mandatit, me kompensimin e cekur në kushtet specifike të emërimit të tij. Qeveria e Kosovës siguron fonde në vlerën e përcaktuar me marrëveshjen në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Zyrës se Auditorit të përgjithshëm.

Neni 4
Ndryshimet dhe plotësimet Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji)

1. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1.12, që përkufizon Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar, fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Kuvendi pas propozimit nga qeveria zgjedh tre (3) anëtarë ndërkombëtarë drejtorë të bordit. Bordi, po ashtu, emëron një shtetas të Kosovës drejtor të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit, i cili nuk do të jetë anëtar i Bordit. Bordi, përveç kryesuesit, po ashtu, emëron zëvendëskryesues njërin prej anëtarëve të tij. Për emërimin, shkarkimin ose ndryshimin e kushteve të referimit të Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit kërkohet vota afirmative e shumicës së Bordit të Drejtorëve. Anëtarët ndërkombëtarë zgjedhën më mandat deri më 31 gusht 2014.

3. Neni 14 i ligjit bazik, paragrafët 7., dhe 9., vlejnë deri në përfundimin e mandatit të anëtarëve ndërkombëtarë të bordit.
4. Neni 31 i ligjit bazik, pas paragrafit 5. shtohet një paragraf i ri 6. me tekstin si në vijim:
   6. Nëse një anëtar ndërkombëtar i bordit i emëruar në pajtim me nenin 31 (5) jep dorëheqje nga Bordi dhe nëse kjo dorëheqje ose largim nga posti ndodh deri më 31 gusht 2014 atëherë ai/ajo do të zëvendësohet me një ndërkombëtar tjetër.

Neni 5
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-079 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale (Ligji)

1. Neni 4 i ligjit bazik që ndryshon nenin 5.2 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   5.2. Bordi mbikëqyrës përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve të cilët emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryeministri.
2. Neni 8 i ligjit bazik që ndryshon nenin 6.1 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   6.1. Sekretaria Ekzekutive ka drejtorin dhe zëvendësdrejtorin të cilët emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryeministri.
3. Neni 10 i ligjit bazik që ndryshon nenin 7.1 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   7.1. Komisioni përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të cilët emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.
4. Neni 13 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 13

Kuvendi, në konsultim me Komisionin, mund të themelojë panele shtesë të Komisionit, anëtarët e të cilëve do të emërohen në bazë të neneve 7.1 dhe 7.2.

5. Neni 16 i ligjit bazik që ndryshon nenin 12.8 të Rregullores, riformulohet me tekstin si në vijim:
   12.8. Gjykata Supreme e Kosovës vendos lidhur me ankesat në trupin gjykues prej tre (3) gjyqtarëve të cilët emërohen nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës.
6. Pas nenit 27 të ligjit bazik, shtohet një nen i ri 27.A me tekstin si në vijim:

Neni 27.A

1. Mandati i tre (3) anëtarëve ndërkombëtarë të Bordit mbikëqyrës (përfshi edhe kryesuesin), i drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive, i dy (2) anëtarëve ndërkombëtarë të Komisionit (përfshi edhe kryesuesin), si dhe i dy gjykatësve ndërkombëtarë në panelet e ankimit të Gjykatës Supreme të cilët janë emëruar në pajtim me Kushtetutën do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim.
2. Anëtarët dhe gjykatësit ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë Ligj vazhdojnë të marrin pagën e tyre të specifikuar sipas kushteve të emërimit të tyre.
3. Qeveria e Kosoves do të sigurojë fonde për drejtorin e Sekretariatit Ekzekutive të barabartë me pagën e një anëtari vendor të Bordit Mbikëqyrës.
4. Nëse një anëtar ndërkombëtar i emëruar ne pajtim me Kushtetutën jep dorëheqje ose largohet nga pozita e tij/saj dhe nëse ky largim ose dorëheqja ndodh para datës 31 gusht 2014, atëherë ai/ajo do të zëvendësohet me një ndërkombëtar, të dominuar nga Kryeministri për pozitat e anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë së Pronës dhe drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive, si dhe të nominuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme për pozitën e anëtarëve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Anëtareve të Panelit të Ankesave të Gjykatës Supreme, pas konsultimeve me PSBE.

Neni 6
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.3. fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.7, riformulohet me tekstin si në vijim:
   1.7. **Gjykatës Ndërkombëtar** - çdo gjykatës i Misionit Evropian për Politika të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, i cili është emëruar në pajtim me këtë ligj.
3. Neni 11 i ligjit bazik, paragrafi 2. riformulohet me tekstin si në vijim:
   2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Dhoma e Posaçme do të vazhdojë të respektojë dhe zbatojë parimin e kompensimit në vend të kthimit fizik. Kur vendoset për mjetin juridik që do të jepet në një rast të caktuar, Dhoma e Posaçme do të marrë parasysh edhe dispozitat në fuqi të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, duke përfshirë qëllimet publike që përcaktohen në preambulën e atij ligji.

Neni 7
Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04 L-101 për fondet pensionale të Kosovës

1. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 4.6, riformulohet me tekstin si në vijim:
   4.6. Komisioni për përzgjedhje, i propozon kandidatët Kuvendit për vendet e lira në anëtarësim ose për riemërim të anëtarëve të Bordit Drejtues. Komisioni për Përzgjedhje do të përbëhet nga guvernatori i BQK-së - kryesues, Auditori i

Përgjithshëm dhe Ministri i Financave. Mandati i secilit anëtar të emëruar në Bordin Drejtues zgjat tre vjet, me mundësi të rizgjedhjes, nëse mandati i anëtarëve të Bordit skadon dhe asnjë anëtar i ri nuk është emëruar, atëherë anëtarët e Bordit ekzistues do të vazhdojnë mandatin për nëntëdhjetë (90) ditë.

Neni 8
Ndryshimet dhe plotësimet e Kodit Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë (Kodi)

1. Neni 309 i ligjit bazik që rregullon emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave me pëlqimin e PCN-së, fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 1 i Aneksit D, i Kodit, fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 1

Ky Aneks ofron përjashtimet e posaçme të përkufizuara në këtë Aneks që do t'i jepen bashkësive fetare sipas përkufizimit në legjislacionin e aplikueshëm, duke përfshirë edhe legjislacionin për liritë fetare në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Neni 9
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat (Ligji)

1. Neni 1 i ligjit bazik, paragrafi 1.32, që përkufizon PCN-në fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 8 i ligjit bazik paragrafi 2. në rreshtin e tretë fshihet fjala “dhe PCN”.
3. Neni 88 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 10
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-199 për gjykatat (ligji)

1. Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 11, riformulohet me tekstin si në vijim:
   11. Nëse në njërën nga komunat e reja dhe të themeluara mbi bazën e Ligjit për Kufijtë Administrativë Komunal nuk ka gjykatë themelore, komuna me vendim të Kuvendit Komunal mund ta parqet kërkesën para Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK) për të vendosur mbi themelimin e gjykatës themelore në territorin e saj, ose që një nga gjykatat ekzistuese themelore në territorin e komunës tjetër të ketë juridiksion mbi territorin e komunës së re. Të njëjtën të drejtë e ka edhe komuna ekzistuese, ku shumica e popullatës i takon komunitetit jo shumicë në Kosovës, dhe në të cilën nuk ka gjykatë themelore.
      11.1. KGjK do të aprovojë kërkesat e tilla, përveç nëse vlerësohet se ngarkesat e lëndëve për atë juridiksion është e pamjaftueshme për ta arsyetuar ekzistimin e gjykatës së ndarë.
      11.2. Kur KGjK e aprovon kërkesën për themelimin e gjykatës së re

themelore, autoritetet kompetente do t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se cilado gjykatë e re, është themeluar dhe funksionale brenda periudhës gjashtë mujore prej datës së vendimit.

11.3. Nëse KGjK nuk aprovon kërkesën për themelimin e gjykatës së re themelore, ose kur komuna i kërkon gjykatës ekzistuese që të ketë juridiksion për territorin e vet, autoritetet kompetente do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për përmirësimin e qasjes në drejtësi për komunitetet lokale, e cila është vështirësuar për shkak të izolimit gjeografik, mungesës së sigurisë, ose për shkak të faktorëve të tjerë relevant. Këto masa mund të përfshijnë krijimin në kuadër të territorit të komunës së re, të një departamenti të gjykatës themelore ekzistuese prej së cilës komuna e re ka kërkuar të ketë kompetencë për territorin e vet, ose që gjykata themelore të mundësojë mbajtjen e seancave në territorin e komunës së re.

2. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Përbërja e Gjykatës së Apelit pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Republikës së Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore. Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin përkatës në fuqi, si dhe për të siguruar pjesëmarrjen e komunitetit në gjyqësor, pesëmbëdhjetë (15) për qind e numrit të tërësishëm të ulëseve në Gjykatën e Apelit, por jo më pak se dhjetë ulëse, garantohen për gjyqtarët nga radha e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

Neni 11
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.2. fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 1.3, riformulohet me tekstin si në vijim:

1.3. Për të siguruar se gjykatat pasqyrojnë përbërjen etnike të zonës së tyre të juridiksionit në përputhje me nenin 104(3) të Kushtetutës dhe me legjislacionin përkatës në fuqi, Këshilli do të marrë parasysh që të plotësojë vendet e lira të punës ose të ulëseve të rezervuara me anëtarë të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

3. Neni 7 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 7
Mandati i anëtarëve të Këshillit

Anëtarët e Këshillit zgjidhen me mandat 5 (pesë) vjeçar, siç ceket në nenin 108 (6) të Kushtetutës dhe në këtë ligj. Një anëtar i këtij Këshilli mund të zgjidhet për një mandat shtesë jo-vijues pesë (5) vjeçar.

4. Neni 16 i ligjit bazik, paragrafi 3., riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Në përputhje me nenin 104(3) të Kushtetutës, Këshilli zbaton masa dhe veprimet tjera me qëllim rekrutimi, të cilat i konsideron të nevojshme dhe të përshtatshme për të siguruar se një gjykatë ose degë e gjykatës pasqyron përbërjen etnike në zonën e tyre të juridiksionit.

5. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 1., riformulohet si në vijim:
   1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ndërmerr masa të nevojshme për të rritur numrin e gjyqtarëve nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë, prej radhëve të atyre gjyqtarëve që shërbejnë në Kosovë. Për të përmbushur përgjegjësitë e veta, Këshilli, ndër të tjera, nga aplikantët njëlloj të kualifikuar për të shërbyer si gjyqtarë u jep përparësi anëtarëve nga komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovës, ashtu siç është paraparë me nenin 108 të Kushtetutës.
6. Neni 17 i ligjit bazik, pas paragrafit 5., shtohen tre paragraf të rinjë 6, 7 dhe 8, me tekstin si në vijim:
   6. Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të hartojë një rregullore të veçantë për të përshkruar procesin e emërimit dhe të riemërimit të gjykatësve nga komunitetet e nën-përfaqësuara në mesin e gjykatësve që shërbejnë në Kosovë.
   7. Dhënia e përparësisë për kandidatët me kualifikime të barabarta nga komunitetet e nën-përfaqësuara, do të zbatohet përderisa përqindja e gjyqtarëve pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë në Kosovë të jetë nën pesëmbëdhjetë përqind (15%) dhe / përderisa përqindja e gjyqtarëve të cilët janë pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, të jetë nën tetë (8%).
   8. Mandati i dy anëtarëve ndërkombëtarë të Këshillit të emëruar në pajtim me Kushtetutën do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim. Anëtarët ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë ligj vazhdojnë të marrin pagën e tyre.
   9. Neni 52 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 12
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.7, fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 1.3 riformulohet me tekstin si në vijim:
   1.3. Siguron se prokuroritë pasqyrojnë përbërjen etnike të zonës së tyre të juridiksionit në përputhje me nenin 109 (4) dhe 110(3) të Kushtetutës.
3. Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Këshilli zbaton masa dhe veprime rekrutimi, si dhe masa të tjera të cilat i konsideron të nevojshme për të siguruar që një zyrë prokuroriale pasqyron përbërjen etnike të zonës së juridiksionit përkatës.
4. Neni 17 i ligjit bazik, pas paragrafit 3. shtohet një paragraf i ri 4. me tekstin si në vijim:
   4. Këshilli harton rregullore të veçantë për të përshkruar procesin e emërimit dhe të riemërimit të prokurorëve nga komunitetet e nën-përfaqësuara në mesin e prokurorëve që shërbejnë në Kosovë.
5. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 1., riformulohet me tekstin si në vijim:
   1. Këshilli ndërmerr masa të nevojshme për të rritur numrin e prokurorëve nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë. Kur ka aplikantë njëlloj të kualifikuar për të shërbyer si prokurorë, Këshilli u jep përparësi anëtarëve nga komunitetet që janë të nënpërfaqësuara në Kosovë siç është paraparë edhe me nenin 109 (4) dhe 110 (3) të Kushtetutës.

6. Neni 18 i ligjit bazik, pas paragrafit 5, shtohet paragrafi i ri 6, me tekstin si në vijim:
   6. Dhënia e përparësisë për kandidatët me kualifikime të barabarta nga komunitetet e nën-përfaqësuara, do të zbatohet përderisa përqindja e prokuroreve pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë në Kosovë të jetë nën pesëmbdhjetë përqind (15%) dhe / ose përderisa përqindja e prokurorëve të cilët janë pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, të jetë nën tetë përqind (8%).

Neni 13
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë (Ligji)

1. Pjesa e parë e preambulës se ligjit, riformulohet me tekstin si në vijim:
   Në bazë të nenit 65 (1) dhe ne pajtim me dispozitat kalimtare dhe përfundimtare nga kreu XIII dhe XIV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Pas nenit 7 të ligjit bazik shtohet një nen i ri 7.A me tekstin si në vijim:

Neni 7.A
Statusi i Kishës Ortodokse Serbe

1. Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë konsiderohet pjesë përbërëse e Kishës Ortodokse Serbe (KOS).
2. Emri dhe organizimi i brendshëm i Kishës Ortodokse Serbe, duke përfshirë edhe hierarkinë dhe veprimtaritë e saj, do të respektohen.
3. Nuk do të ketë ndalim arbitrar për hyrje në Kosovë ose qëndrim brenda Kosovës për priftërinjtë, kandidatët për prift, murgjve, murgeshave dhe vizitorëve.
4. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 7.3, fjalët "**themelojnë dhe**", fshihen nga teksti i ligjit.
5. Neni 8 i ligjit bazik, paragrafi 1, riformulohet me tekstin si në vijim:
   1. Ndërtesat dhe objektet që u takojnë bashkësive fetare, që janë të dedikuara për kryerjen e ceremonive fetare konsiderohen të pacenueshme për sa i përket ndërhyrjes së autoriteteve qeveritare dhe në to mund të hyhet vetëm me pëlqimin e institucionit përkatës fetar, përveç nëse është lëshuar ndonjë urdhër gjyqësor për shkak të aktiviteteve ilegale dhe në rast të rrezikut për jetën ose shëndetin.
6. Neni 12 i ligjit bazik, pas paragrafit 12.4 shtohet një paragraf i ri 12.5 me tekstin si në vijim:
   12.5. Përveç përjashtimeve të përmendura më lart, bashkësitë fetare gëzojnë privilegje doganore dhe tatimore për veprimtari ekonomike, që janë specifike për vetë-qëndrueshmërinë e tyre financiare, siç do të definohet me një akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e financave. Këto privilegje përfshijnë importimin dhe blerjen e produkteve qenësore për prodhim, të materialeve, pajisjeve dhe bagëtisë; dhe eksportimin e produkteve që dalin nga aktivitetet e lartpërmendura.

Neni 14
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (Ligji)

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1. përkufizimi "**Propozimin Gjithëpërfshirës**", fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Objekt i shpronësimit sipas këtij ligji mund të jenë të drejtat private pronësore dhe të drejtat tjera private për ose ndaj një prone të paluajtshme, me përjashtim të asaj prone të paluajtshme që bën pjesë në atë kategori të pronës, për të cilën Kushtetuta në mënyrë specifike thotë se nuk do të jetë objekt i shpronësimit.
3. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3, shtohet nën-paragraf i ri 3.1. me tekstin si në vijim:
   3.1 Prona e luajtshme dhe e paluajtshme, si dhe asetet tjera të Kishës Ortodokse Serbe do të jenë të pacenueshme dhe nuk do të jenë objekt i shpronësimit.

Neni 15
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (ligji)

1. Pas nenit 3 shtohet nen i ri 3.A me tekstin si në vijim:

Neni 3.A
Të drejtat e refugjatëve dhe personave të zhvendosur

1. Të gjithë refugjatët nga Kosova dhe personat e zhvendosur brenda vendit do të kenë të drejtën e kthimit dhe kërkimit të pronës së tyre dhe posedimeve personale, në pajtim me ligjet vendore dhe ndërkombëtare. Çdo person do të ketë të drejtë të marrë vendim të lirë dhe të jetë i informuar për vendin ku ai kthehet.
2. Institucionet e Republikës së Kosovës ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të krijuar kushte te favorshme për kthim të sigurt dhe të denjë të refugjatëve dhe personave të zhvendosur, bazuar në vendimet e tyre të lira dhe të bazuara në informata të sakta, përfshirë përpjekjet për të promovuar dhe mbrojtur lirinë e tyre të lëvizjes dhe mbrojtjen nga kërcënimi
3. Kushtet e kthimit të personave të zhvendosur dhe mekanizmat e bashkëpunimit me institucionet relevante ndërkombëtare do të përcaktohen nga institucionet e Republikës së Kosovës në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e aplikueshme."

Neni 16
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativë të Komunave (ligji)

1. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Bordi do të përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë, me nga pesë (5) përfaqësues të zgjedhur nga secila komunë dhe një (1) përfaqësues i zgjedhur nga Kryeministri.

2. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 4. riformulohet me tekstin si në vijim:
   4. Kryesuesi i Bordit përzgjidhet nga Kryeministri.
3. Neni 14 i ligjit bazik, fshihet termi **"dhe PCN do të ndërmarrin"** dhe zëvendësohet me termin: "**ndërrmer**".
4. Në Shtojcën 1 (Zonat Kadastrale) të ligjit bazik, emërtimi i komunës "**Hani i Elezit**" në gjuhën serbe dhe angleze ndryshohet në "**Elez Han**"

Neni 17
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës (ligji)

1. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi (c) riformulohet me tekstin si në vijim:
   (c) Një (1) anëtar, i përzgjedhur nga Kryeministri.
2. Neni 14 i ligjit bazik, paragrafi (b), nënparagrafi (iv) riformulohet me tekstin si në vijim:
   iv. Një (1) anëtar, i përzgjedhur nga Kryeministri.

Neni 18
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës (ligji)

1. Titulli i nenit 29 të ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 29
Regjistrimi dhe përcaktimi i shtetësisë

Neni 19
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-237 për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave (Ligji)

1. Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 4.12., riformulohet me tekstin si në vijim:
   4.12 Një (1) përfaqësues nga një prej Universiteteve publike, anëtar;

Neni 20
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës (ligji)

1. Neni 9 i ligjit bazik, paragrafi 3., riformulohet me tekstin si në vijim:
   3. Forca e Sigurisë së Kosovës është e strukturuar dhe e përgatitur për të përmbushur funksionet e sigurisë që nuk i përkasin policisë ose organizatave tjera për zbatim të ligjit.
2. Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 2., riformulohet me tekstin si në vijim:
   2. Forca e Sigurisë së Kosovës është e armatosur lehtë dhe nuk ka armë të rënda, siç janë tanket, artileria e rëndë ose kapacitete sulmuese ajrore. Një rishikim i plotë i këtyre kufizimeve, do të bëhet jo më herët se pesë vjet nga koha e hyrjes në fuqi e Ligjit Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Detyrat fillestare të Forcës së Sigurisë së Kosovës janë:

3. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 2, pika (e) fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 21
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-082 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës (ligji)

1. Neni 5 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 22
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-033 për Statusin, imunitetet dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin e Kosovës dhe praninë ndërkombëtare ushtarake, si dhe personelin e saj

1. Neni 3 i ligjit bazik paragrafi 2. pika (a) riformulohet me tekstin si në vijim:
   (a) Zyra Civile Ndërkombëtare dhe Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian.
2. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:
   3.3. Individët e emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtarë, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, mandati i të cilëve nuk ka përfunduar para deklarimit të përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur gëzojnë statusin, privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara në ligjin bazik.
3. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 6., riformulohet me tekstin si në vijim:
   4.6. Ministri i Punëve të Jashtme nuk mund t'i shpallë PSBE-në ose një anëtar të personelit të tij, anëtarët e personelit të ICO-së, përfshirë individët e përcaktuar në nenin 3.3. të ligjit bazik ose anëtarët e misionit EULEX, si persona non grata.
4. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 7. fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 23

1. Të gjithë anëtarët ndërkombëtarë të emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, në pajtim me Kushtetutën e Republikës se Kosovës, me përjashtim të atyre të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Agjencisë Kosovare të Pronës gjyqtarët ndërkombëtarë të Panelit të Ankesave të Gjykatës Supreme, dhe dy gjyqtarë në Komisionin për Kërkesa Pronësore, nëse për çfarëdo arsye largohen nga pozita para datës 31 gusht 2014 ai/ajo do të zëvendësohet me një anëtar vendor.
2. Nëse në cilindo ligj të aplikueshëm në Republikën e Kosovës përdoren termet ICO ose PCN, të njëjtat shfuqizohen dhe zëvendësohen me institucionet vendore përkatëse.

II. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 24
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të amendamenteve kushtetuese për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë.

Ligji Nr. 04/L-115
31 gusht 2012

Shpallur me dekretin Nr.DL-036-2012, datë 04.09.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr.25 / 7 SHTATOR 2012, PRISHTINË

LIGJI Nr. 04/L-052
PËR MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj përcakton procedurën e lidhjes, nënshkrimit, ratifikimit, rezervave dhe deklaratave, ndryshimit dhe plotësimit, tërheqjes nga marrëveshja, si dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës.

Neni 2
Pajtueshmëria me rregullat dhe parimet e të drejtës ndërkombëtare

Ky ligj është në pajtim me rregullat dhe parimet e pranuara universale të së drejtës ndërkombëtare, që rregullojnë lidhjen dhe ekzekutimin e traktateve ndërkombëtare, të kodifikuara në Konventën e Vjenës të 23 majit 1969 për të Drejtën e Traktateve, dhe Konventën e Vjenës të 21 marsit 1986 për të Drejtën e Traktateve ndërmjet Shteteve dhe Organizatave Ndërkombëtare ose ndërmjet Organizatave Ndërkombëtare.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **Aderim -** akt me të cilin Kuvendi ose Presidenti i Republikës së Kosovës jep miratimin që Republika e Kosovës të jetë palë në një traktat ose marrëveshje ndërkombëtare, e cila nuk është nënshkruar prej saj;
   1.2. **Agjencitë shtetërore** ose **agjencitë shtetërore përkatëse -** institucion fusha e kompetencave e të cilit mbulon fushëveprimin e marrëveshjes;
   1.3. **Autorizim -** dokument që lëshohet nga autoriteti kompetent përmes të cilit emëron një ose disa persona që përfaqësojnë atë në zhvillimin e bisedimeve ose nënshkrimin e marrëveshjes ndërkombëtare;
   1.4. **Deklaratë -** deklaratë e njëanshme, të bërë nga organi kompetent shtetëror, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, aderimit ose miratimit të një

marrëveshjeje me anën e së cilës shprehet një kuptim ose interpretim i marrëveshjes, që nuk synon të përjashtojë ose modifikojë efektet ligjore të dispozitave të caktuara;

1.5. **Marrëveshje ndërkombëtare -** një marrëveshje ndërkombëtare përkatësisht traktat i lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shteteve të huaja ose organizatave ndërkombëtare në formë të shkruar, e rregulluar me të drejtën ndërkombëtare pavarësisht nga emërtimi dhe nga përfshirja në një, dy apo më shumë instrumente të ndërlidhura.

1.6. **Marrëveshje për bashkëpunim ndër-institucional -** një marrëveshje ose memorandum e lidhur në emër të, dhe në bazë të kompetencave të ministrive apo agjencive shtetërore dhe institucioneve të tjera të Republikës së Kosovës me institucionet dhe organizatat përkatëse të shteteve të huaja, që nuk lidhet në emër të shtetit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe nuk është subjekt i ratifikimit. Ky lloj i marrëveshjes ka kryesisht karakter teknik;

1.7. **Parafim -** akt me të cilin personat e autorizuar vënë inicialet për të treguar se kanë rënë dakord për tekstin përfundimtar të marrëveshjes;

1.8. **Ratifikim -** akt me të cilin Republika e Kosovës në nivelin ndërkombëtar jep pëlqimin e vet të lidhë marrëveshje ndërkombëtare, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës;

1.9. **Rezervë -** deklaratë e njëanshme, të bërë nga organi kompetent shtetëror, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, aderimit ose miratimit të një marrëveshjeje me anën e së cilës synon të përjashtojë ose modifikojë efektet ligjore të dispozitave të caktuara;

1.10. **Tërheqja nga marrëveshja -** akt me të cilin Kuvendi, Presidenti ose Qeveria e Republikës së Kosovës shpreh heqjen dorë nga një traktat ose marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 4
E drejta e nismës për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare

1. Të drejtën e nismës për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare e kanë organet shtetërore të Republikës së Kosovës në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosoves dhe ligjin në fuqi.
2. Nismat për marrëveshjet ndërkombëtare që vijnë nga ministritë miratohen në parim nga Qeveria, pas rekomandimit nga Ministria e Punëve të Jashtme.

Neni 5
Procedura e shqyrtimit të projektmarrëveshjeve ndërkombëtare

1. Teksti i projektmarrëveshjes ndërkombëtare i hartuar nga një ministri ose agjenci shtetërore në gjuhët shqipe dhe serbe, si dhe në gjuhët e huaja përkatëse, i dërgohet ministrive ose agjencive shtetërore përkatëse për shqyrtim.
2. Projekti i tekstit të marrëveshjes ndërkombëtare i dërgohet Ministrisë së Punëve të Jashtme për shqyrtim vetëm pasi të jetë shqyrtuar dhe të jetë arritur pajtimi nga ministritë dhe agjencitë shtetërore përkatëse. Projekti i tekstit të marrëveshjes

ndërkombëtare i dërgohet Ministrisë së Punëve të Jashtme bashkë me kopjet e opinioneve të pranuara nga ministritë ose agjencitë shtetërore përkatëse gjatë procedurës së shqyrtimit.

3. Ministria ose agjencia shtetërore përkatëse siguron përkthimin e projektit të tekstit të marrëveshjes ndërkombëtare në gjuhën shqipe dhe serbe ose në gjuhën e huaj përkatëse.

Neni 6
Kompetenca për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare

1. Presidenti, Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme kanë të drejtën e kryerjes së të gjitha veprimeve të ndërlidhura me lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve.
2. Shefi i misionit diplomatik të Republikës së Kosovës ose përfaqësuesi i autorizuar i Republikës së Kosovës në një konferencë ndërkombëtare, organizatë ndërkombëtare ose një prej organeve të tyre ka të drejtën e negociimit të lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare të Republikës së Kosovës ose të miratojë tekstin me shtetin në të cilin është akredituar ose në konferencën ndërkombëtare, organizatën ndërkombëtare ose një prej organeve të tyre.
3. Personat tjerë, mund të kryejnë veprime drejt lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës vetëm me kusht që kanë fuqi të deleguara në bazë të ligjit në fuqi dhe procedurës së përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji.

Neni 7
Procedura për dhënien e autorizimit për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare

1. Kompetenca për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura me lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës që kanë të bëjnë me fushat e përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 10 të këtij ligji autorizohet nga Presidenti pas rekomandimit nga Qeveria.
2. Kompetenca për të kryer veprimet e ndërlidhura me lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, përveç atyre sipas paragrafit 1. të nenit 10 të këtij ligji, autorizohen nga Ministri i Punëve të Jashtme.
3. Kompetenca për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, të cilat hyjnë në fuqi në datën e nënshkrimit, autorizohen nga Presidenti pas rekomandimit të ministrisë ose agjencisë shtetërore, kompetencë e së cilës është hartimi i marrëveshjes ndërkombëtare, me kusht që Ministria e Punëve të Jashtme të ketë dhënë pëlqimin paraprak për marrëveshjen përkatëse.
4. Kërkesës drejtuar Qeverisë për dhënien e autorizimit nga Presidenti për të kryer veprime që kanë të bëjnë me lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare të referuara në paragrafin 1. të nenit 10 të këtij ligji, ministria ose agjencia shtetërore përkatëse i bashkëngjet dokumentet në vijim:
   4.1. projektin e tekstit të marrëveshjes ndërkombëtare në gjuhët shqipe dhe serbe dhe, sipas nevojës, në gjuhën e huaj përkatëse;
   4.2. opinionet e dorëzuara nga ministritë ose agjencitë shtetërore gjatë periudhës së shqyrtimit.

5. Vendimi nxirret nga Qeveria për të kërkuar dhënien e autorizimit nga Presidenti. Vendimi i Qeverisë specifikon nenet ose paragrafët përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të këtij ligji.
6. Kërkesës drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme për dhënien e autorizimit për të kryer veprime të ndërlidhura me lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, përveç atyre të referuara në paragrafin 1. të nenit 10 të këtij ligji, ministria ose agjencia shtetërore përkatëse i bashkëngjet dokumentet në vijim:
   6.1. projektin e tekstit të marrëveshjes ndërkombëtare në gjuhët shqipe dhe serbe dhe, sipas nevojës, në gjuhën e huaj përkatëse;
   6.2. opinionet e dorëzuara nga ministritë ose agjencitë shtetërore gjatë periudhës së shqyrtimit.
7. Kërkesës së drejtuar Presidentit të Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura me lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare, e cila hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit, ministria ose agjencia shtetërore i bashkëngjiten dokumentet në vijim:
   7.1. teksti i projekt marrëveshjes ndërkombëtare në gjuhët shqipe dhe serbe dhe, sipas nevojës, në gjuhën e huaj përkatëse;
   7.2. opinionet e dorëzuara nga ministritë ose agjencitë shtetërore gjatë periudhës së shqyrtimit;
   7.3. vendimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme për afatin kohor të lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare.
8. Presidenti dhe Ministria e Punëve të Jashtme japin autorizim, brenda afatit kohor prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pune nga data e pranimit të kërkesës nga Qeveria, respektivisht ministria ose agjencia shtetërore përkatëse. Autorizimet nënshkruhen nga Presidenti dhe Ministri i Punëve të Jashtme.
9. Informatat për autorizimet nga Presidenti dhe Ministri i Punëve të Jashtme ruhen dhe administrohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Neni 8
Negociatat për marrëveshje ndërkombëtare

1. Para fillimit të negociatave, ministria ose agjencia shtetërore përkatëse propozon përbërjen e delegacionit, kohën dhe vendin ku do të zhvillohen negociatat, pasi të jetë marrë më parë pëlqimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme.
2. Ministria e Punëve të Jashtme me rastin e dhënies së pëlqimit për fillimin e negociatave, jep pëlqimin edhe për përbërjen e delegacionit, kohën dhe vendin ku do të zhvillohen ato.
3. Pas çdo faze të negociatave të marrëveshjeve ndërkombëtare, ministria ose agjencia shtetërore përkatëse raporton rreth përparimit dhe rezultateve të negociatave tek Ministria e Punëve të Jashtme. Çdo korrespondencë me organizatat e huaja shtetërore dhe ndërkombëtare rreth marrëveshjeve ndërkombëtare shkëmbehet vetëm përmes kanaleve diplomatike.
4. Çdo propozim i bërë gjatë negociatave për bërjen e ndryshimeve dhe plotësimeve të mëdha në projektin e tekstit të marrëveshjes ndërkombëtare i nënshtrohet procedurës së shqyrtimit nga ministritë ose agjencitë shtetërore. Negociatat mund të vazhdojnë nëse ministritë ose agjencitë shtetërore përkatëse pajtohen për ndryshimet dhe propozimet e bëra gjatë procedurës së shqyrtimit.

5. Nëse ministritë ose agjencitë shtetërore përkatëse nuk pajtohen për ndryshimet ose plotësimet e propozuara në projektin e tekstit të marrëveshjes ndërkombëtare, atëherë me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme plotësimet dhe ndryshimet shqyrtohen dhe vendosen nga Qeveria.

Neni 9
Forma dhe Gjuha

1. Teksti i marrëveshjes dypalëshe ndërkombëtare shtypet në gjuhët e palëve që lidhin marrëveshje ose edhe në gjuhën tjetër sipas marrëveshjes së tyre:
   1.1. në alternatin dhe në letrën e vet;
   1.2. në alternatin dhe në letrën e palës tjetër.
2. Palët mund të merren vesh që për çdo kopje origjinale të përdoret edhe një gjuhë e huaj e pranuar bashkërisht.
3. Pas kësaj, shkëmbehen alternatet sipas nën-paragrafëve 1.1. dhe 1.2. të paragrafit 1. të këtij neni. Në këtë mënyrë secila palë ka dy kopje të ekzemplarit të vet në gjuhën e të dyja palëve.
4. Në raste të veçanta, marrëveshjet ndërkombëtare dypalëshe mund të hartohen edhe vetëm në një gjuhë të huaj të tretë, të pranuar bashkërisht nga të dyja palët. Në këtë rast, ministria ose agjencia shtetërore depoziton në Ministrinë e Punëve të Jashtme, krahas origjinalit të marrëveshjes, edhe përkthimin në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 10
Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje:
   1.1. territori, paqja, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;
   1.2. të drejtat dhe liritë fundamentale;
   1.3. anëtarësimi i Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare;
   1.4. marrja e obligimeve financiare nga Republika e Kosovës.
2. Marrëveshjet ndërkombëtare të referuara në paragrafin 1. të këtij neni ratifikohen me ligj të votuar nga dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës të referuara në paragrafin 1. të këtij neni i dorëzohen Kuvendit me iniciativë të vet ose pas propozimit nga Qeveria.
4. Marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, përveç atyre në paragrafin 1. të këtij neni, ratifikohen pas nënshkrimit nga Presidenti.
5. Paragrafi 4. i këtij neni nuk vlen për marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës të nënshkruara nga Presidenti.
6. Instrumentet e ratifikimit hartohen në bazë të ligjit, përkatësisht dekretit të paraparë në paragrafët 2. dhe 4. të këtij neni ose në bazë të paragrafit 5. të këtij neni.
7. Në rastet e nismës së procedurës së ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare të

referuara në paragrafin 1. të këtij neni, ministria ose agjencia përkatëse harton, nis procedurën e shqyrtimit në bazë të nenit 5 të këtij ligji dhe dorëzon në Qeveri, bashkë me tekstin e marrëveshjes ndërkombëtare dhe letrën shpjeguese për marrëveshjen ndërkombëtare, këto dokumente:

7.1. projektin e vendimit të Qeverisë përmes të cilit kërkohet nga Presidenti që t'i propozojë Kuvendit të Republikës së Kosovës ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare;

7.2. projektin e dekretit të Presidentit për marrëveshjen ndërkombëtare që i propozohet për ratifikim Kuvendit të Kosovës;

7.3. projektligjin e Republikës së Kosovës për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare.

8. Kërkesa për ratifikimin e marrëveshjeve, të cilat nuk janë të parapara në paragrafin 1. të këtij neni, dërgohet nga Ministria e Punëve të Jashtme te Presidenti.
9. Kërkesës për ratifikim i bashkëngjitet teksti i marrëveshjes ndërkombëtare dhe letra shpjeguese e marrëveshjes ndërkombëtare.
10. Dekreti i ratifikimit të marrëveshjes nga Presidenti i Republikës së Kosovës thirret në dispozitat përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në bazë të të cilave marrëveshja ndërkombëtare duhet të ratifikohet.

Neni 11
Rezervat dhe deklaratat

1. Në qoftë se ekzistojnë rezerva dhe/ose ka deklarata rreth marrëveshjes ndërkombëtare, ministria ose agjencia shtetërore përkatëse i raporton këto te ministritë dhe agjencitë qeveritare relevante gjatë procedurës së shqyrtimit në bazë të nenit 5 të këtij ligji.
2. Ministria ose agjencia shtetërore përkatëse përfshinë tekstin e rezervave dhe/ose deklaratave në projektligjin e Republikës së Kosovës rreth ratifikimit të marrëveshjes ndërkombëtare ose projektin e dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare dhe bën përkthimin e këtyre rezervave dhe/ose deklaratave në gjuhën e huaj përkatëse.
3. Tërheqja nga marrëveshja ose amendamentimi i rezervave dhe/ose deklaratave në lidhje me marrëveshjen ndërkombëtare duhet t'i nënshtrohet kërkesave të nenit 10 të këtij ligji.

Neni 12
Lidhja e marrëveshjeve për bashkëpunim ndërinstitucional

1. Ministritë dhe agjencitë shtetërore mund të lidhin, brenda fushës së tyre të kompetencave, marrëveshje apo memorandume me shtetet e huaja ose organizatat ndërkombëtare vetëm nëse marrëveshjet e tilla nuk përmbajnë obligime të detyrueshme për Qeverinë. Këto marrëveshje mund të lidhen me shkëmbim notash, pa zhvilluar bisedime me delegacione.
2. Këto marrëveshje mund të lidhen vetëm nëse nuk janë në kundërshtim me ligjet dhe aktet tjera ligjore të Republikës së Kosovës dhe zotimet e saja ndërkombëtare, dhe nëse zbatimi i marrëveshjeve të tilla nuk kërkon financim shtesë nga buxheti

shtetëror i Republikës së Kosovës.

3. Projekti i teksteve të marrëveshjeve të tilla i dërgohet Ministrisë së Punëve të Jashtme për shqyrtim.
4. Pasi Ministria e Punëve të Jashtme të japë pëlqimin me shkrim për lidhjen e marrëveshjes, marrëveshja nënshkruhet nga Ministri i ministrisë përkatëse, udhëheqësi i agjencisë shtetërore ose ndonjë institucioni tjetër shtetëror ose nga ndonjë person i autorizuar nga udhëheqësi i ministrisë, agjencisë shtetërore ose institucionit tjetër përkatës.
5. Një kopje e shtypur dhe një elektronike e tekstit të marrëveshjes i dorëzohen Ministrisë së Punëve të Jashtme, e cila ruan dhe administron marrëveshjet e tilla.

Neni 13
Projekti standard i tekstit të marrëveshjeve ndërkombëtare

1. Ministria ose agjencia shtetërore përkatëse mund të hartojë tekstin standard për marrëveshje ndërkombëtare. Projektet e teksteve të tilla për marrëveshje ndërkombëtare i dërgohen ministrive dhe Qeverisë ose agjencive shtetërore për shqyrtim në përputhje me nenin 5 të këtij ligji.
2. Ministria ose agjencia shtetërore përkatëse dorëzon në Ministrinë e Punëve të Jashtme projektin standard të tekstit të marrëveshjes ndërkombëtare në gjuhët shqipe dhe serbe si dhe projektin e vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e projektit të tekstit standard për marrëveshje ndërkombëtare.
   2.1. projekti standard i tekstit për marrëveshje ndërkombëtare miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
   2.2. projekti standard i tekstit për marrëveshje ndërkombëtare mund t'i dërgohet shteteve të huaja ose organizatave ndërkombëtare pa kaluar nëpër procedurën shtesë të shqyrtimit në bazë të nenit 5 të këtij ligji.

Neni 14
Kompetenca e Ministrisë së Punëve të Jashtme në procesin e hyrjes në fuqi të marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës

1. Aktet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me hyrjen në fuqi, vlefshmërinë dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, përfshirë përgatitjen dhe depozitimin e dokumenteve të nevojshme për hyrje në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare me depozitues, njoftimin për suspendim të zbatimit ose njoftimin për shfuqizimin, dhe raportimin për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare bëhen nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës.
2. Ministria e Punëve të Jashtme harton instrumentet për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, njoftimet për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore dhe instrumentet tjera të domosdoshme për hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare, depoziton këto dokumente dhe siguron dërgimin e këtyre dokumenteve në institucionet relevante ndërkombëtare e të huaja, si dhe shkëmbimin e këtyre instrumenteve.
3. Ministria e Punëve të Jashtme depoziton marrëveshjet ndërkombëtare tek një depozitues ose duhet të veprojë vet si depozitues, nëse ashtu është paraparë në marrëveshjen ndërkombëtare.

Neni 15
Karakteri detyrues i marrëveshjeve ndërkombëtare

1. Marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës që kanë hyrë në fuqi janë të detyrueshme në Republikën e Kosovës.
2. Nëse një marrëveshje ndërkombëtare në fuqi e Republikës së Kosovës vendos norma të tjera, përveç atyre të vendosura me ligje ose akte të tjera ligjore të Republikës së Kosovës që janë në fuqi në momentin e lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare ose të cilat kanë hyrë në fuqi pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare, atëherë dispozitat e marrëveshjes ndërkombëtare të Republikës së Kosovës mbizotërojnë.
3. Nëse një ligj ose ndonjë akt tjetër ligjor miratohet me qëllim të zbatimit të një marrëveshjeje ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, Qeveria dorëzon në Kuvend, në bazë të procedurës së paraparë, një projekt të ligjit adekuat ose duhet të miratojë një vendim të Qeverisë ose siguron miratimin e ndonjë akti tjetër ligjor në bazë të kompetencave përkatëse.

Neni 16
Zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës

1. Qeveria siguron zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.
2. Një marrëveshje ndërkombëtare e Republikës së Kosovës mund të përcaktojë gjithashtu rregulla të veçanta për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.

Neni 17
Ndryshimi dhe plotësimi i marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës

Një marrëveshje ndërkombëtare e Republikës së Kosovës mund të ndryshohet ose plotësohet në bazë të normave të së drejtës ndërkombëtare dhe në bazë të procedurës së përcaktuar në këtë ligj për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, përveç nëse parashihet ndryshe me marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 18
Tërheqja nga marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës ose suspendimi i zbatimit të tyre

1. Marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës mund të tërhiqen dhe zbatimi i tyre të suspendohet vetëm në bazë të dispozitave të marrëveshjeve ndërkombëtare, normave të së drejtës ndërkombëtare dhe në bazë të procedurës së vendosur përmes këtij ligji.
2. Vendimi në lidhje me tërheqjen nga një marrëveshje ndërkombëtare të Republikës së Kosovës ose suspendimin e zbatimit të saj në bazë të normave universale të së drejtës ndërkombëtare, të referuara në paragrafin 1. të nenit 10 të këtij ligji, merret nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me dy të tretat (2/3) e votave pas rekomandimit të Presidentit, me iniciativë të tij ose pas propozimit nga Qeveria.

3. Vendimi për tërheqjen nga një marrëveshje ndërkombëtare të Republikës së Kosovës ose për suspendimin e zbatimit të saj në bazë të normave universale të së drejtës ndërkombëtare, përveç atyre të parapara në paragrafin 1. të nenit 10 të këtij ligji, merret nga Presidenti, me iniciativë të tij ose me rekomandim të Qeverisë.

Neni 19
Informimi rreth marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës

1. Informacioni për të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare të cilat janë lidhur nga Republika e Kosovës ruhen dhe administrohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme, pavarësisht nga publikimi në Gazetën Zyrtare.
2. Kopja origjinale e marrëveshjes ndërkombëtare të nënshkruar përcillet brenda dhjetë (10) ditëve të punës, nga ministria përkatëse ose Qeveria ose agjencia shtetërore, te Ministria e Punëve të Jashtme për arkivim. Bashkë me marrëveshjen ndërkombëtare, ministria përkatëse ose Qeveria apo agjencia shtetërore dorëzon një dokument ku përshkruhet se kush, ku dhe kur e ka nënshkruar marrëveshjen ndërkombëtare si dhe versionin elektronik të marrëveshjes ndërkombëtare në gjuhët shqipe dhe serbe, si dhe në gjuhën e huaj relevante nëse është në dispozicion.
3. Ministria e Punëve të Jashtme certifikon vërtetësinë e origjinalit të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe i përcjell kopjet e origjinalit të marrëveshjeve te institucionet relevante shtetërore.

Neni 20
Publikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës

1. Marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës publikohen në Gazetën Zyrtare, pas dërgimit të tyre nga Zyra e Presidentit, respektivisht Kuvendi i Republikës së Kosovës.
2. Për të publikuar një marrëveshje ndërkombëtare, Ministria e Punëve të Jashtme dërgon një kopje të printuar dhe një elektronike të marrëveshjes ndërkombëtare në gjuhët shqipe dhe serbe në Gazetën Zyrtare të Republikë së Kosovës. Nëse marrëveshja ndërkombëtare është bërë vetëm në një gjuhë të huaj, atëherë Ministria e Punëve të Jashtme i dërgon Gazetës Zyrtare përkthimin në kopje të printuar dhe në version elektronik të marrëveshjes ndërkombëtare në gjuhët shqipe dhe serbe të bërë dhe verifikuar sipas kërkesave të paragrafit 3. të nenit 5 të këtij ligji.
3. Ministria e Punëve të Jashtme publikon, në Gazetën Zyrtare dhe faqen e saj elektronike, kumtesa informative për hyrjen në fuqi të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Neni 21
Regjistrimi i marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës në Sekretariatin e Kombeve të Bashkuara

Pas hyrjes në fuqi të marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, ato i dërgohen Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara për regjistrim nga Ministria e Punëve të Jashtme.

Neni 22

Qeveria e Kosovës sipas propozimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme nxjerr aktet e nevojshme nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 23
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-052
14 nëntor 2011

Ligji shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 28 / 16 DHJETOR 2011, PRISHTINË

LIGJI Nr. 03/L-183
PËR ZBATIMIN E SANKSIONEVE NDËRKOMBËTARE

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme 1199
Kreu II: Niveli i zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare 1202
Kreu III: Ndikimi i sanksioneve ndërkombëtare të zbatuara në Republikën e Kosovës mbi obligimet dhe transakcionet 1202
Kreu IV: Admninistrimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare 1203
Kreu V: Përgjegjësia për shkelje të sanksioneve ndërkombëtare 1205
Kreu VI: Dispozitat përfundimtare 1205

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR ZBATIMIN E SANKSIONEVE NDËRKOMBËTARE

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

1. Qëllimi i Ligjit për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare (në vijim:LZSN), është:
   1.1. sigurimi i implementimit të obligimeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës;
   1.2. krijimi i kushteve për Republikën e Kosovës për të kontribuuar me efikasitet dhe efektivitet në dhe për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare;
   1.3. luftimi i terrorizmit ndërkombëtarë;
   1.4. luftimi i shkeljeve të të drejtave dhe lirive të njeriut;
   1.5. zgjidhja paqësore e konflikteve territoriale ndërmjet shteteve të ndryshme si dhe;
   1.6. realizimi i interesave të sigurisë kombëtare të Republikës së Kosovës.
2. Ky ligj përcakton procedurën për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare jo-ushtarake në Republikën e Kosovës, të vendosura nga Kombet e Bashkuara ose nga organizata të tjera ndërkombëtare. Zbatimi i sanksioneve ndërkombëtare përfshinë vendosjen, ndryshimin dhe mbarimin e sanksioneve ndërkombëtare.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:
   1.1. **Entitet** - personi juridik-shteti, zona me status të veçantë, cila do organizatë e regjistruar dhe e licencuar për ushtrim të aktivitetit legal si dhe personi fizik
   1.2. **Sanksioni ndërkombëtarë** - kufizimi apo obligimi i caktuar me rezolutë, konventë, kovenantë, deklaratë apo ndonjë me akt të Organizatës së Kombeve të Bashkuara ose të organizatës ndërkombëtare të caktuar. Sanksionet ndërkombëtare mund të jenë të natyrës ekonomike, financiare, politike, të komunikimit, publike, si dhe që kanë për qëllim kufizime dhe obligime të tjera.
   1.3. **Sanksionet ekonomike** - kufizimet në import, eksport, ri-eksport dhe transit, duke përfshirë ndërmjetësimin e mallrave për nevoja të qytetarëve, artikuj me destinim të dyfishtë, pajisje ushtarake, shërbime dhe teknologji, kufizime në tregti me entitetet ndaj të cilave zbatohen sanksionet ndërkombëtare, kufizimet në aktivitete ekonomike të personave fizik apo juridik të Republikës së Kosovës në një shtet ose territor për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare; kufizime në aktivitetet ekonomike në territorin e Republikës së Kosovës të entiteteve ndaj cilave zbatohen sanksionet ndërkombëtare.
   1.4. **Sanksionet financiare** - kufizimet në të drejtat e entiteteve ndaj të cilave zbatohen sanksionet ndërkombëtare, për të menaxhuar, përdorur apo disponuar paratë e gatshme, sigurimet, mallrat, të drejtat e tjera të aseteve të pronës; kufizimet e pagesës për entitetet ndaj të cilave zbatohen sanksionet ndërkombëtare; kufizimet e tjera mbi aktivitetet financiare.
   1.5. **Sanksionet politike** - kufizimet e vizitave zyrtare, kufizimet për të hyrë brenda apo për të kaluar përmes një shteti a territori, përkitazi me ato vende ndaj të cilave zbatohen sanksione ndërkombëtare; kufizimet për të hyrë brenda apo për të kaluar përmes territorit të Republikës së Kosovës, për persona ndaj të cilëve zbatohen sanksionet ndërkombëtare; kufizimet në marrëdhëniet diplomatike, si dhe masa të tjera me ndikim politik dhe diplomatik.
   1.6. **Sanksionet në fushën e komunikacionit** - kufizimet në transport hekurudhor, rrugor, ujor, ajror, postar, elektronik dhe/ose komunikim tjetër me entitetet ndaj të cilave zbatohen sanksionet ndërkombëtare.
   1.7. **Sanksionet publike -** kufizimet në marrëdhëniet kulturore, shkencore, arsimore, sportive, si dhe marrëdhëniet tjera publike me entitetet ndaj të cilave zbatohen sanksionet ndërkombëtare.

Neni 3
Kushtet e përgjithshme të zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare

1. Zbatimi i sanksioneve ndërkombëtare specifikohet dhe ndryshohet me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me përjashtim të rastit që i referohet paragrafi 1 të nenit 8 të këtij ligji.

1.1. vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës përcaktojnë se cilat sanksione zbatohen, kufizimet kohore për zbatimin sanksioneve të tilla, kushtet, heqjen e mundshme dhe entitetet ndaj të cilave zbatohen sanksionet ndërkombëtare;

1.2. një datë e skadimit të sanksioneve ndërkombëtare caktohet duke llogaritur datën e skadimit të paraqitur me vendimet e organizatave ndërkombëtare që kanë vënë sanksionet ndërkombëtare;

1.3. afatet kohore për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare në Republikën e Kosovës nuk përcaktohen, nëse një organizatë ndërkombëtare, e cila ka vendosur afatet e tilla, e parasheh mundësinë për ripërtëritjen e zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare pas rishikimit i cili bëhet në rastin e skadimit të afateve kohore për zbatimin e sanksioneve të përmendura.

2. Nëse vendimet e organizatave ndërkombëtare vendosin që sanksionet ndërkombëtare të shfuqizohen ose zbatimi i tyre të mos zgjatet, zbatimi i sanksioneve ndërkombëtare në Republikën e Kosovës përfundon me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

3. Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare përcakton se çfarë lloj veprimesh personat fizik dhe juridik të Republikës së Kosovës duhet të bëjnë ose janë të ndaluar të bëjnë gjatë zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare.

4. Dispozitat e këtij ligji aplikohen ndaj personave fizik dhe juridik të Republikës së Kosovës në territoret e shteteve të huaja, pavarësisht faktit nëse shtetet e huaja zbatojnë apo jo sanksionet ndërkombëtare të cilat zbatohen nga Republika e Kosovës.

Neni 4
Përjashtimet nga zbatimi i sanksioneve ndërkombëtare

1. Nëse vendimet e organizatave ndërkombëtare të cilat kanë vënë sanksionet ndërkombëtare lejojnë përjashtime në zbatimin e tyre për qëllime humanitare, nevojat që lidhen me dispozitat e misioneve paqeruajtëse ose në rastet e tjera të veçanta, zbatimi i përjashtimeve nga sanksionet në Republikën e Kosovës vendoset me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me përjashtim të rastit të cilit i referohet paragrafi 1 i nenit 8 të këtij ligji.

2. Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e përjashtimeve të përcaktuara.

2.1. entitetet ndaj të cilëve zbatohen sanksionet ndërkombëtare ose personat fizik a juridik të Republikës së Kosovës, me përjashtim të institucioneve financiare, që kërkojnë të shfrytëzojnë mundësinë e përjashtimit aplikojnë tek një institucion që bën mbikëqyrjen e zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare, i cili është i paraqitur në nenin 12 të këtij ligji, dhe institucioni i lartpërmendur ose institucioni financiar aplikon në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës për sa i përket zbatimit të një përjashtimi në bazë të kriterit rast pas rasti dhe zbaton përjashtimin vetëm me pëlqimin e Ministrisë së lartpërmendur.

2.2. në ato raste kur Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës është institucioni i

cili bën mbikëqyrjen e sanksioneve ndërkombëtare, entitetet ose personat fizik apo juridik ndaj të cilëve zbatohen sanksionet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, me qëllim të shfrytëzimit të mundësisë së përjashtimeve, duhet të aplikojnë drejtpërsëdrejti në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës

KREU II
NIVELI I ZBATIMIT TË SANKSIONEVE NDËRKOMBËTARE

Neni 5
Niveli i zbatimit të sanksioneve të detyrueshme të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe vendimeve të organizatave të tjera ndërkombëtare

Sanksionet ndërkombëtare të përcaktuara në rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe vendimet e organizatave të tjera ndërkombëtare për sanksionet ndërkombëtare, të cilat janë të detyrueshme sipas obligimeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës zbatohen plotësisht në mënyrën e përcaktuar në nenin 3 të këtij ligji.

Neni 6
Niveli i zbatimit të vendimeve rekomanduese të organizatave ndërkombëtare

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, organizatave të tjera ndërkombëtare anëtare e të cilave është Republika e Kosovës ose në të cilat Republika e Kosovës është pjesëmarrëse, të cilat rekomandojnë vënien e sanksioneve ndërkombëtare për entitetet e veçanta, zbatohen nga Republika e Kosovës në mënyrën e përcaktuar në nenin 3 të këtij ligji.

Neni 7
Zbatimi i vendimeve të organizatave ndërkombëtare

Vendimet e organizatave ndërkombëtare në lidhje me vënien e sanksioneve ndërkombëtare kundrejt shteteve të huaja zbatohen me vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

KREU III
NDIKIMI I SANKSIONEVE NDËRKOMBËTARE TË ZBATUARA NË REPUBLIKËN E KOSOVËS MBI OBLIGIMET DHE TRANSAKCIONET

Neni 8
Përmbushja e obligimeve pas vendosjes së zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare

1. Ndalohet kryerja e veprimeve, përfundimi i të cilave është i ndaluar me sanksionet ndërkombëtare të zbatuara në Republikën e Kosovës. Veprimet, si përfundim përpara se të bëhet vendosja e zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare në

Republikën e Kosovës përfundojnë në mënyrë të njëanshme ose përmes marrëveshjes në mes të palëve. Ekzekutimi i tyre ndërpritet gjatë kohëzgjatjes së zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare.

2. Ndalohet kryerja e transaksioneve, ekzekutimi i të cilave është në kundërshtim me sanksionet ndërkombëtare të zbatuara në Republikën e Kosovës. Transaksionet e tilla të kryera pas vendosjes së zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare në Republikën e Kosovës në mënyrën e përcaktuar sipas këtij ligji konsiderohen të anuluara, të shfuqizuara dhe jo valide.
3. Përmbushja e obligimeve të cilat paraqiten përpara se të vendoset për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare në Republikën e Kosovës, përfundon ose pezullohet menjëherë gjatë kohëzgjatjes së zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare. Ndalohet të merren obligime të reja, përmbushja e të cilave është kundërshtim me sanksionet ndërkombëtare të zbatuara në Republikën e Kosovës.
4. Në kufizimin e vlefshmërisë së llogarive të entiteteve, ndaj të cilave zbatohen sanksionet ndërkombëtare, shpenzimet që ndërlidhen me mbajtjen rutinore të llogarive të tilla, mund t'u hiqet edhe interesi, si edhe pagesat e caktuara nën transaksione, të kryera para fillimit të zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare, mund të shtohen vetëm nëse çfarëdo ndalese ose shtese nuk duhet të vihet në dispozicion të entitetit, ndaj të cilit zbatohen sanksionet financiare.

Neni 9
Pasojat ligjore për mos përmbushjen e obligimeve

1. Përgjegjësia ligjore civile nuk aplikohet tek personat fizik ose juridik të Republikës së Kosovës për mos përmbushjen e obligimeve që ndërlidhen me zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare, ose personat e tillë lirohen nga përgjegjësia ligjore e lartpërmendur në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Shpenzimet e shkaktuara nga personat fizik dhe juridik gjatë zbatimit të këtij ligji nuk kompensohen.

KREU IV
ADMNINISTRIMI DHE MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË SANKSIONEVE NDËRKOMBËTARE

Neni 10
Administrimi i zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare

1. Ministria e Punëve të Jashtme bashkërendon zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare në Republikën e Kosovës dhe siguron personat fizik dhe juridik me informacione rreth çështjeve relevante për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare.
2. Ministria e lartë përmendur u siguron organizatave të tjera ndërkombëtare informacione për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara.

Neni 11
Institucionet e Republikës së Kosovës të cilat mbikëqyrin zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare

1. Brenda kufijve të kompetencave të tyre, institucionet përgjegjëse për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare janë:
   1.1. Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Ekonomisë dhe Financave;
   1.2. për mbikëqyrjen e zbatimit të sanksioneve financiare, institucione përgjegjëse janë; Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës nën koordinimin e Ministrisë së Brendshme dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave;
   1.3. për mbikëqyrjen e zbatimit të sanksioneve politike, institucione përgjegjëse janë; Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe të gjitha Ministritë tjera përgjegjëse sipas fushë veprimtarisë së tyre;
   1.4. për mbikëqyrjen e zbatimit te sanksioneve të komunikacionit, institucione përgjegjëse janë; Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Punëve të Jashtme, Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit, Autoriteti Rregullativ i Aviacionit Civil;
   1.5. për mbikëqyrjen e zbatimit të sanksioneve publike, institucione përgjegjëse janë: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, nën koordinimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.
2. Sipas nevojës, Qeveria me vendim cakton institucione të tjera, të cilat janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare të caktuara me vendim.

Neni 12
Mbikëqyrja e zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare

1. Procedura për mbikëqyrjen e zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare përkufizohet me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Personat fizik dhe juridik duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentet e nevojshme për të ushtruar mbikëqyrje te institucionet që kryejnë zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare.
2. Institucionet përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare, si dhe institucionet financiare sigurojnë informacione për Ministrinë e Punëve të Jashtme rreth zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare, shkeljet e tyre dhe rastet nën gjykim.
3. Dispozitat e informacionit të specifikuar në këtë ligj, ndaj institucioneve të referuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, nuk paraqesin zbulimin e informacionit zyrtar, industrial, komercial, sekret bankar ose informata konfidenciale. Të dhënat që përmbajnë ndonjë sekret shtetëror ose zyrtar do tu jepen institucioneve si dhe te grumbullohen edhe të ruhen në institucione në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligjet në fuqi.

KREU V
PËRGJEGJËSIA PËR SHKELJE TË SANKSIONEVE NDËRKOMBËTARE

Neni 13
Përgjegjësia për Shkelje të ligjit

Personat fizik dhe juridik mbajnë përgjegjësi për shkeljet e këtij ligji, në përputhshmëri me procedurat e përcaktuara me ligje të Republikës së Kosovës.

KREU VI
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 14
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-183
15 prill 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-018-2010, datë 04.05.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 69 / 20 MAJ 2010

LIGJI Nr. 04/L-122
PËR RATIFIKIMIN E KËMBIMIT TË NOTAVE DIPLOMATIKE PËR STATUSIN E FORCAVE TË HUAJA MES REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR RATIFIKIMIN E KËMBIMIT TË NOTAVE DIPLOMATIKE PËR STATUSIN E FORVCAVE TË HUAJA MES REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qellim ratifikimin e këmbimit të notave diplomatike më të cilat konstituohet marrëveshja për Statusin e forcave ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke përcaktuar privilegjet dhe imunitetet e personelit civil dhe ushtarak të forcave.

Neni 2
Fushëveprimi

Këmbimi i notave ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës është pjesë përbërëse e këtij ligji (shtojca 1) dhe zbatohet ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Neni 3
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-122
24 maj 2011

Shpallur me dekretin Nr. DL-026-2012, datë 08.06.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 15 / 13 QERSHOR 2012, PRISHTINË

012-0005

Ambasada e Shteteve të Bashkuara shpreh komplimentet e saja Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së dhe ka nderin t'i referohet diskutimeve të fundit ndërmjet përfaqësuesve të dy qeverive tona lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me personelin civil dhe ushtarak të Shteteve të Bashkuara (të përkufizuara si anëtarë të Forcave të Armatosura të Shteteve të Bashkuara dhe nëpunës civil të Departamentit të Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara, respektivisht, tani e tutje në tekst bashkërisht i referohen si personeli i Shteteve të Bashkuara) dhe me kontraktorët e Shteteve të Bashkuara (të përkufizuar si kompani dhe firma jo nga Republika e Kosovës, dhe nëpunësve të tyre të cilët nuk janë qytetarë të Republikës së Kosovës, në kuadër të kontratës me Departamentin e Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara) të cilët mund të jenë prezent përkohësisht në Republikën e Kosovës në lidhje me vizitat, trajnimet, ushtrimet zyrtare, aktivitetet humanitare, dhe aktivitetet tjera të dakorduara në mënyrë reciproke.

Si rezultat i këtyre diskutimeve, Ambasada propozon që personelit të Shteteve të Bashkuara t'i jepet statusi ekuivalent me atë të stafit administrativ dhe teknik të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara sipas Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike të 18 prillit 1961; kështu që personeli i Shteteve të Bashkuara të mund të hyjë dhe del nga Republika e Kosovës me identifikim të Shteteve të Bashkuara dhe me lëvizje kolektive apo me urdhra për udhëtim individual; kështu që Republika e Kosovës do t'i pranojë si të vlefshme të gjitha lejet profesionale të lëshuara nga Shtetet e Bashkuara, nën-divizionet politike të saj apo nga Shtetet për personelin e Shteteve të Bashkuara në ofrimin e shërbimeve për personelin e autorizuar; dhe se autoritetet e Republikës së Kosovës do t'i pranojnë si të vlefshme, pa ndonjë test të vozitjes apo tarifë, patentë shoferët apo lejet e lëshuara nga autoritetet përkatëse të Shteteve të Bashkuara për personelin e Shteteve të Bashkuara për operim të automjeteve. Ambasada më tej propozon që personeli i Shteteve të Bashkuara të autorizohet që të vesh uniforma gjatë kryerjes së detyrave zyrtare dhe që t'i bartin armët gjersa janë në detyrë nëse me urdhrat e tyre autorizohen të veprojnë ashtu.

Qeveria e Republikës së Kosovës e kupton rëndësinë e veçantë të kontrollit disiplinor nga autoritetet e Forcave të Armatosura të Shteteve të Bashkuara mbi personelin e Shteteve të Bashkuara dhe, prandaj, e autorizon Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të ushtrojë juridiksion penal mbi personelin e Shteteve të Bashkuara gjersa gjenden në Republikën e Kosovës.

Ambasada më tej propozon që Departamenti i Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara dhe personeli i Shteteve të Bashkuara nuk do të jenë të detyruar të paguajnë tatim apo ngarkesa tjera të ngjashme të vlerësuara në Republikën e Kosovës, dhe se Departamenti i Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara dhe personeli i Shteteve të Bashkuara mund të importojnë, eksportojnë, dhe shfrytëzojnë në Republikën e Kosovës çdo pasuri personale, pajisje, furnizim, material, teknologji, trajnim, apo shërbim në lidhje me aktivitetet në kuadër të kësaj Marrëveshje. Importimi, eksportimi, dhe shfrytëzimi i tillë do të përjashtohet nga çfarëdo inspektimi, licencimi, kufizimi tjetër, takse doganore, tatimi, apo ngarkese tjetër të ngjashme të vlerësuar në

Republikën e Kosovës. Qeveritë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Republikës së Kosovës do të bashkëpunojnë për t'i ndërmarr masat e tilla të cilat mund të jenë të nevojshme për të ofruar siguri dhe mbrojtje të personelit të Shteteve të Bashkuara, pasurisë, pajisjeve, të dhënave, dhe informatave zyrtare në Republikën e Kosovës.

Ambasada propozon që automjetet të cilat operojnë nga apo, në atë kohë, ekskluzivisht për Departamentin e Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara mund të hyjnë, dalin, dhe lëvizin lirshëm brenda territorit të Republikës së Kosovës, dhe se automjetet e tilla (qoftë duke i vozitur apo të tërhequra) nuk do t'i nënshtrohen pagesës së taksës së transitit në rrugë tokësore. Aeroplani në pronësi të dhe që operohet nga apo, në atë kohë, ekskluzivisht për Departamentin e Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara nuk do t'i nënshtrohet pagesës së navigimit, fluturimit, terminalit, aderimit, parkimit apo ngarkesave të tjera të ngjashme në territorin e Republikës së Kosovës. Departamenti i Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara do të paguajë ngarkesa të arsyeshme për shërbimet e kërkuara dhe të pranuara në situatat jo më pak të favorshme se sa ato të paguara nga forcat e sigurisë së Republikës së Kosovës. Aeroplani i Qeverisë së Shteteve të Bashkuara nuk i nënshtrohet procedurave të kontrollit dhe inspektimit.

Ambasada gjithashtu propozon që Departamenti i Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara mund të kontraktojë për çfarëdo materiali, furnizimi, pajisje, dhe shërbime (përfshirë ndërtimin) të furnizohet apo të merr përsipër në Republikën e Kosovës pa kufizime sipas zgjedhjes së kontraktorit, furnizuesit, apo personit i cili ofron material, furnizime, pajisje apo shërbime të tilla. Kontratat e tilla duhet të kërkohen, jepen dhe administrohen në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Blerja e artikujve dhe ofrimi i shërbimeve në Republikën e Kosovës nga apo në emër të Departamentit të Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara në lidhje me aktivitetet në kuadër të kësaj

Marrëveshje nuk do t'i nënshtrohen asnjë tatimi apo ngarkesave tjera të ngjashme në Republikën e Kosovës.

Ambasada më tej propozon që kontraktorët e Shteteve të Bashkuara nuk do të jenë të detyruar të paguajnë tatim apo ngarkesa tjera të ngjashme të vlerësuara në Republikën e Kosovës në lidhje me aktivitetet në kuadër të kësaj Marrëveshje dhe se kontraktorët e tillë mund të importojnë, eksportojnë, dhe shfrytëzojnë në Republikën e Kosovës çfarëdo pasurie personale, pajisje, furnizimi, materiali, teknologjie, trajnimi, apo shërbimi në plotësimin e kontratave me Departamentin e Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara në lidhje me aktivitetet në kuadër të kësaj Marrëveshje. Importimi, eksportimi, dhe shfrytëzimi i tillë do të përjashtohet nga çfarëdo licencimi, kufizimi tjetër, takse doganore, tatimi, apo ngarkese tjetër të ngjashme të vlerësuar në Republikën e Kosovës.

Ambasada propozon që kontraktorëve të Shteteve të Bashkuara t'u jepet trajtim i njëjtë me personelin e Shteteve të Bashkuara lidhur me lejet profesionale dhe patentë shoferët.

Ambasada propozon që personeli i Shteteve të Bashkuara duhet ta ketë lirinë e lëvizjes dhe qasjen në dhe shfrytëzimin e transportimit, deponimit, trajnimit reciprokisht të dakorduar, si dhe lehtësirat tjera të kërkuara në lidhje me aktivitetet në kuadër të kësaj Marrëveshje.

Qeveria e Republikës së Kosovës pranon se mund të jetë e nevojshme për Forcat e Armatosura të Shteteve të Bashkuara ta shfrytëzojnë radio spektrin. Departamenti i Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara duhet të lejohet t'i funksionalizojë sistemet e saj të telekomunikacionit (siç është përkufizuar telekomunikimi në Kushtetutën e vitit 1992 të Bashkimit Ndërkombëtarë të Telekomunikacionit). Kjo duhet ta përfshijë të drejtën për përdorim të mjeteve dhe shërbimeve të tilla siç kërkohen për të siguruar mundësi të plotë të operimit të sistemeve telekomunikuese, dhe të drejtën për ta shfrytëzuar të gjithë radio spektrin e nevojshëm për këtë qëllim. Shfrytëzimi i radio spektrit duhet të jetë pa pagesë për Qeverinë e Shteteve të Bashkuara.

Për me tepër, Ambasada propozon që Palët të heqin dorë nga çdo dhe të gjitha ankesat (përveç ankesave kontraktuale) kundër njëri-tjetrit për dëme, humbje, apo shkatërrime të pasurisë së tjetrit apo lëndim apo vdekje të personelit nga Pala e forcave të armatosura apo nga personeli i tyre civil që paraqiten gjatë kryerjes së detyrave të tyre zyrtare në lidhje me aktivitetet në kuadër të kësaj Marrëveshje. Ankesat nga palët e treta për dëmet apo humbjet e shkaktuara nga personeli i Shteteve të Bashkuara do të zgjidhen nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Shteteve të Bashkuara.

Përfundimisht, Ambasada më tej propozon që të dy qeveritë e tona, apo përfaqësuesit e tyre të caktuar, mund të hyjnë në aranzhime implementuese për t'i zbatuar dispozitat e kësaj Marrëveshje.

Në qoftë se këto që u përmendën më lartë janë të pranueshme për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Ambasada propozon që kjo Notë, bashkë me përgjigjen e Ministrisë për këtë qëllim, duhet ta përbëjë një marrëveshje ndërmjet dy qeverive, e cila do të hyjë në fuqi nga data e njoftimit përmes kanaleve diplomatike nga Qeveria e Republikës së Kosovës, duke njoftuar Qeverinë e Shteteve të Bashkuara për kompletimin e procedurave të brendshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës e shfrytëzon këtë mundësi për t'ia përsëritur Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës sigurinë e konsideratës së saj më të lartë.

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës,
Prishtinë, 18 shkurt 2012

LIGJI Nr. 04/L-148
PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE MES REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BASHKIMIT EVROPIAN MBI MISIONIN E BASHKIMIT EVROPIAN PËR SUNDIM TË LIGJIT NË KOSOVË

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Duke marrë parasysh përkushtimin e institucioneve të Republikës së Kosovës për avancimin e sundimit të ligjit në Kosovë, nevojën për ngritjen e kapaciteteve të tyre, gadishmërinë e tyre për të bashkëpunuar me Bashkimin Evropian në këtë drejtim dhe mbështetjen e vazhdueshme të Bashkimit Evropian nëpërmjet EULEX-it për të arritur këto qëllime,

Miraton

LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE MES REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BASHKIMIT EVROPIAN MBI MISIONIN E BASHKIMIT EVROPIAN PËR SUNDIM TË LIGJIT NË KOSOVË

Neni 1
Qëllimi

1. Ky ligj ratifikon marrëveshjen ndërkombëtare të arritur nëpërmjet shkëmbimit të instrumenteve mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë ("EULEX").
2. Ky ligj ratifikon marrëveshjen nderkombëtare në tërësi, duke përfshirë këtu, por pa u kufizuar nga:
   a) zgjatja e mandatit të EULEX-it në fushat e parapara në marrëveshje deri më 15 qershor 2014, dhe me përjashtim të Task Forcës Hulumtuese Speciale;
   b) delegimi i autoritetit për propozimin dhe emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, në përputhje me Kushtetutën, neni 20, dhe krijimi i një kuadri për formimin e një sistemi të regjistrimit për stafin e EULEX-it që i lejohet armë-mbajtja; dhe
   c) garantimi e imunitetit të stafit të zyrës dhe personelit të EULEX-it si dhe Përfaqësuesit Special të BE-së, ("EUSR"), në bazë të Ligjit Nr. 03/L-033 për Statusin, Imunitetet, dhe Privilegjet e Misioneve diplomatike, Konsullore dhe Personelin e Kosovës dhe Praninë Ndërkombëtare Ushtarake si dhe Personelin e Saj.

Neni 2
Fushëveprimi

Marrëveshja ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian do të jetë pjesë përbërëse e këtij ligji (shtojca 1) dhe zbatohet nga Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian.

Neni 3
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë pas shpalljes së tij nga Presidentja e Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-148
7 shtator 2012

Shpallur me dekretin Nr. DL-039-2012, datë 07.09.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 25 / 07 SHTATOR 2012, PRISHTINË

ANEKSI 1.

REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI

REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT

REPUBLIKA KOSOVA – PREDSEDNIK

Prishtinë, 4 shtator 2012

Sh.S.Zoj. Baronesha Catherine Ashton,
Përfaqësuese e Lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë

Shkëlqesia Juaj,

Dëshiroj t'ju shpreh juve falënderimet tona më të sinqerta për kontributin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian për stabilitetin dhe prosperitetin e Kosovës.

Në përputhje me nenet 17(5), 18(3) dhe 20(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe duke e pasur parasysh përfundimin e mbikëqyrjes së pavarësisë në Kosovës të paraparë në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, ne e miresëpresim praninë e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë ("EULEX KOSOVO"). Ne vazhdojmë ta mbështesim plotësisht mandatin e tij sipas përcaktimit nga Veprimi i Përbashkët 2008/124/PPJS, të miratuar nga Këshilli i Bashkimit Evropian, më 4 shkurt 2008, të ndryshuar në Aneksin IX, neni 2.3 i Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës; dhe letrat e kembyera të datës 17 shkurt 2008 dhe 9 gusht 2008.

Duke marrë parasysh qëllimin tonë për të fuqizuar edhe më tej sundimin e ligjit në Kosovë, ne e miresëpresim mbështetjen e vazhdueshme të EULEX-it në Kosovë për të ngritur autoritetet tona, dhe në veçanti sistemin tonë gjyqësor. Mbi këtë bazë, unë i bëj thirrje Shkëlqesisë Suaj, përmes kësaj letre dhe sipas autoritetit nga nenet 19 dhe 20 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që të përgjigjemi duke e shprehur gatishmërinë e BE-së që të vazhdojë të ofrojë prokurorë, gjyqtarë dhe polic me përvojë dhe dije që të shembëllejnë në Misionin EULEX në Kosovë.

së pavarësisë, EULEX-i mund të emërojë gjyqtarë dhe prokurorë të tij, të cilët do t'i zëvendësojnë ata të cilëve u skadon mandati. Këto emërime kryhen sipas mënyrës së përshkruar në vijim:

Sipas nenit 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, unë kam kompetencë të emëroj dhe shkarkoj prokurorët dhe gjyqtarët sipas propozimit të trupave nominues. Neni 20 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës i lejon Republikës që t'ia bëjë delegimin e kompetencave të caktuara organizatave ndërkombëtare për disa çështje specifike. Si President, e kam për detyrë të siguroj që këto delegime të kenë një rendësi të qartë. Prandaj, unë konfirmoj se, në bazë të nenit 20 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës EULEX-it në Kosovë do t'i delegohen kompetencat në vijim: (a) për propozimin dhe emërimin e gjyqtarëve sipas neneve 108 respektivisht 84 të Kushtetutës, pas njoftimit që i bëhet Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe zyrës sime me emrat dhe përvojat profesionale të këtyre gjyqtarëve dhe (b) të propozimit dhe emërimit të prokurorëve sipas neneve 110 respektivisht 84 të Kushtetutës, pas njoftimit që i bëhet Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe zyrës sime me emrat dhe përvojat profesionale të këtyre prokurorëve. Këta gjyqtarë dhe prokurorë të EULEX-it do të autorizohen sipas përshkrimit të dhënë në nenin 104 respektivisht 109 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe ligjeve tjera përkatëse.

Po ashtu, policët e EULEX-it do ta kenë autoritetin, pas njoftimit me emrat e tyre që i bëhet Ministrit për Punë të Brendshme, për të punuar në nivel qendror (duke përfshirë edhe nivelin e ministrisë), rajonal dhe atë lokal. Sipas nevojës, stafi i EULEX-it autorizohet që të mbajë armë. Ndërmjet Misionit dhe Ministrisë për Punë të brendshme do të arrihet një marrëveshje lidhur me sistemin e regjistrimit të armëve të cilat i mbajnë një numër i kufizuar i stafit të misionit, duke e pasur parasysh nevojën e balancimit të kërkesave për transparencë për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe për mbrojtjen e një numri të caktuar të gjesëtarëve të stafit për shkak të funksioneve të tyre.

Gjyqtarët, prokurorët dhe policët e EULEX-it do të vazhdojnë të shërbejnë në pajtim me ligjet e Kosovës, siç është kërkuar edhe më herët në Aneksin IX, nenë 2.3 i Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës. Kjo fiesë do ta mbështesë EULEX-in në mandatin aktual deri më 15 qershor 2014. Varësisht nga vlerësimi i përbashkët, kjo do të duhej të ishte data e pritshme e përfundimit të misionit EULEX në Kosovë.

Me anë të kësaj konfirmoj se TFHS me prokurorë dhe stafi mbështetës nga EULEX-i do ta vazhdojë punën deri në njoftimin e Kosovës nga Këshilli i Bashkimit Evropian për përmbylljen e hetimeve ose të procedurave që janë në rrjedhojë e tyre.

EULEX-it në Kosovë, zyrave dhe personelit të tij (duke i përfshirë ekspertët në misionin), njëherësh edhe Përfaqësuesit Special të BE-së (PSBE), zyrave dhe personelit i tij (duke i përfshirë edhe ekspertët në misionin), u jepen statusi, privilegjet dhe imunitetet i barasvlershëm me përmbajtjen nga Konventa e Vjenës, e datës 18 prill 1961, e zbatuar me anë të *Ligjit Nr. 03/L-033 për Statusin, Imunitetin dhe Privilegjet e Misioneve Diplomatike e Konsullore dhe të*

Personelit të tyre dhe të Prezencës Ushtarake Ndërkombëtare dhe të Personelit të tyre në Kosovë.

Me pranimin e kësaj fleteje nga ju, ne do të marrim përsipër, sipas nenit 18 dhe dispozitave tjera relevante të Kushtetutës dhe Ligjit të aplikueshëm në Kosovë, dhe në bashkëpunim të vazhdueshëm me Shefin e Misionit EULEX në Kosovë dhe/ose me PSBE, përmes Bordit të Përbashkët Bashkëerdukues për Sundimin e Ligjit (BPBSL), çfarëdo përkushtimi shtesë ose modaliteti të nevojshëm për ta lehtësuar funksionimin efektiv të misionit EULEX në Kosovë.

Dëshiroj edhe njëherë që ta përsëris përkushtimin tonë të plotë për sundimin e ligjit për të gjithë qytetarët tonë. Unë ju falënderoj për kontributin tuaj të vazhdueshëm për paqe dhe stabilitet në Kosovës dhe e mirëpres vazhdimin e bashkëpunimit tonë të ngushtë duke kontribuar për një Kosovë shumetnike, demokratike dhe të begatshme, si dhe ta sjellim Kosovën sa më afër integrimit të plotë në Bashkimin Evropian.

Sinqerisht,

Atifete Jahjaga
Presidente e Republikës së Kosovës

Zëvendës Presidente e Komisionit Evropian

Bruksel, 4 Shtator, 2012

Sh.S.Zuj. Atifete Jahjaga
Presidente e Kosovës

E nderuara zonja Presidente,

Unë e pasnoj fresën që e përmbaj letra juaj e datës 4 shtator 2012 për ta vazhduar përmbushjen e mandatit të misionit EULEX KOSOVË në fyrnën e bashkëpunimit të ndërsjellët.

Dëshiroj ta shfrytëzoj këtë rast që t'ju shpreh falënderimin tim të sinqertë për përkushtimin tuaj për t'ia ofruar tërë ndihmën e nevojshme misionit EULEX KOSOVË në kryerjen detyrave të tij në mënyrë efikase dhe efektive në tërë Kosovën.

EULEX-i do t'i kryejë detyrat e veta ashtu siç janë përcaktuar në Veprimin e Përbashkët 2008/124/CFSP për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë, EULEX KOSOVË, i miratuar dhe ndryshuar nga Këshilli i Bashkimit Evropian më 4 shkurt 2008.

EULEX-i do t'i ndihmojë institucionet, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në Kosovë në forcimin e mëtejmë të një sistemi gjyqësor të pavarur dhe shumetnik, si dhe të një shërbimi shumetnik policor dhe doganor në rrugën e tyre drejt përmbushjes së Standardeve Evropiane në fushat e tyre përkatëse.

Kosova ka perspektivë Evropiane sikurse i tërë rajoni i Ballkanit Perëndimor. Gjatë përmbushjes së mandatit të tij, EULEX-i do të kontribuojë në lehtësimin e përparimit të Kosovës drejt integrimeve të mëtejme në BE.

Në fund, pres që bashkëpunimi ynë i ngushtë të vazhdojë duke kontribuar kështu në forcimin e stabilitetit dhe prosperitetit në rajon.

Catherine Ashton

KONVENTAT NDËRKOMBËTARE

LIGJI Nr. 04/L-207
PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES KORNIZË NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BANKËS EVROPIANE PËR INVESTIME QË RREGULLON AKTIVITETET E BANKËS EVROPIANE PËR INVESTIME NË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES KORNIZË NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BANKËS EVROPIANE PËR INVESTIME QË RREGULLON AKTIVITETET E BANKËS EVROPIANE PËR INVESTIME NË KOSOVËS

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim që të ratifikojë marrëveshjen e nënshkruar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime që rregullon Aktivitetet e Bankës Evropiane për Investime në Kosovës.

Neni 2
Ratifikimi

Ratifikohet Marrëveshja e nënshkruar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime që rregullon Aktivitetet e Bankës Evropiane për Investime në Kosovës, e nënshkruar me 7 qershor 2013 në Prishtinë.

Neni 3
Dokumentet e bashkëngjitura

Në aneksin 1 të këtij ligji është bashkëngjitur Marrëveshja e nënshkruar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime që rregullon Aktivitetet e Bankës Evropiane për Investime në Kosovës, e nënshkruar me 7 qershor 2013 në Prishtinë.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-207
31 korrik 2013

Shpallur me dekretin Nr. DL-036-2013, datë 16.08.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 29 / 22 GUSHT 2013, PRISHTINË

MARRËVESHJE KORNIZË

mes

Qeverisë së Kosovës[**]

dhe

Bankës Evropiane për Investime

e cila drejton aktivitetet e BEI në Kosovë

Prishtina, 7 Qershor 2013

[*] ***Ky përcaktim nuk paragjykon qëndrimin ndaj statusit dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.***

E LIDHUR MES:

Qeverisë së Kosovës, me seli në Ndërtesën e re të Qeverisë, Rruga Nënë Tereza, 10000 Prishtina, përfaqësuar nga Z. Besim Beqaj, Ministër i Financave,

Më tutje referuar si "**Qeveria e Kosovës**",

në njërën anë, dhe

Bankës Evropiane për Investim, me seli në, boulevard Konrad Adenauer 100, L – 2950 Luxembourg – Kirchberg, Grand Duchy of Luxembourg, përfaqësuar nga Z. Anton Rop, Zëvendës President,

Më tutje referuar si "**Banka**",

në anën tjetër,

DUKE PASUR PARASYSH Vendimin Nr 1080/2011/EU e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, i datës 25 tetor 2011, për të dhënë një garanci të BE-së për Bankës Evropiane për Investime kundër humbjeve nga huat dhe nga garancitë për huat për projekte jashtë Bashkimit ("**Vendimi i BE për garanci**");

DUKE PASUR PARASYSH vendimin e Bordit të Guvernatorëve të Bankës, i datës 12 dhjetor 2011, mbi rishikimin e mandatit të jashtëm për periudhën 2007-2013 dhe rinovimin e garancisë së Bashkimit Evropian kundër humbjeve nga huat dhe nga garancitë për huat për projekte jashtë Bashkimit;

DUKE RIKUJTUAR që, në bazë të vendimeve sipërpërmendura, Kosova përfshihet dhe i përket listës së rajoneve të përshtatshme ku Banka është e autorizuar të financojë operacionet për projektet e investimeve;

DUKE VËNË RE se, në përputhje me nenin 10 (2) të Vendimit të BE-së për garanci, Kosova përfaqësohet ose nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë ose nga një administratë e përcaktuar në udhëzimet teknike operative rajonale mbi financimin e BEI sipas këtij Vendimi;

NDËRSA udhëzimet teknike operative rajonale, siç janë përcaktuar nga Komisioni Evropian dhe Banka në konsultim me Shërbimin Evropian për Veprim të Jashtëm më 7 nëntor 2012, deklarojnë se kjo administratë duhet të jetë Qeveria e Kosovës;

DUKE PASUR PARASYSH Banka ka dhënë hua fonde për investim për të mirën e projekteve në Kosovë deri në këtë datë sipas Marrëveshjes Kornizë të lidhur më 3 maj 2005 ndërmjet Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), duke vepruar për dhe në emër të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (IPVQ), dhe Bankës ("**Marrëveshja Kornizë 2005**");

DUKE DITUR se Qeveria e Kosovës i nënshtrohet Marrëveshjes Kornizë 2005 për qëllime të transaksioneve të lidhura në bazë të kësaj Marrëveshje Kornizë të vitit 2005 dhe duke pranuar edhe më tej se, bazuar në nenin 15 të Marrëveshjes Kornizë 2005, kryerja e obligimeve nën këtë marrëveshje, duke përfshirë, por jo kufizuar në, shlyerjen e obligimeve financiare, i takon IPVQ-ve dhe pasardhësve të tyre duke vepruar për Kosovën dhe në emër të saj;

DUKE PRANUAR se zhvillimi i Kosovës, dhe ekonomia e saj në veçanti, është në procesin e evolucionit si dhe të krijimit dhe konsolidimit të institucioneve të saj; dhe se Administrata e Kosovës po punon me synimin për të krijuar një rritje të qëndrueshme ekonomike të bazuar në zhvillimin e vazhdueshëm ekonomik në Kosovë, gjë që kërkon edhe fonde nga institucionet financiare ndërkombëtare në të mirë të zhvillimit të Kosovës;

DUKE DËSHIRUAR të lehtësojmë financimin, në kuadër të Vendimit dhe/ose vendimeve të organeve drejtuese të Bankës, me anë të huave, garancive dhe instrumenteve të tjera nga ana e Bankës për projektet e investimeve me interes për

Kosovën, dhe për këtë qëllim për ofrojmë mbrojtje të caktuar për projekte të tilla dhe të sigurojmë të drejta dhe privilegje të caktuara për Bankën;

DUKE RIAFIRMUAR se nënshkrimi i kësaj Marrëveshje Kornizë nuk përbën njohjen e Kosovës si një shtet i pavarur dhe kjo nuk paragjykon qëndrimin e shteteve anëtare për statusin e Kosovës, i cili do të vendoset në përputhje me praktikat e tyre kombëtare dhe të drejtën ndërkombëtare.

JANË PAJTUAR SI NË VIJIM:

Neni 1
Përkufizimet

Për qëllime të kësaj Marrëveshje Kornizë (më tutje referuar si Marrëveshja):
"**Përfitues**" (ose bashkërisht "**Përfituesit**") nënkupton vetë Kosovën, duke përfshirë çdo autoritet administrativ të saj, çdo person, qoftë një person fizik ose një person i themeluar sipas ligjit publik ose privat i cili përfiton:
(a) financimin me anë të një huaje, garancie, ekuiteti, kuazi ekuiteti, ose çdo mjeti tjetër financimi të ofruar nga Banka për çdo projekt, ose
(b) Asistencë Teknike,
duke përfshirë por jo kufizuar në një huamarrës nga Banka, një bashkë-debitor, një garantues, një huadhënës të garantuar nga Banka dhe huamarrësin, apo një pronar të një projekti;
"**Projekti**" (ose bashkërisht "**Projektet**") nënkupton çdo projekt investimi të cilin Banka e financon në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një ndërmjetësi me anë të një kredie, garancie, ekuiteti, kuazi ekuiteti, ose çdo mjeti tjetër financimi të ofruar nga Banka dhe/ose i cili përfiton Asistencë Teknike nga Banka dhe që përmbush kriteret e mëposhtme:
(i) ai gjendet në territorin e Kosovës, apo financimi i tij nga Banka kryhet në ose përmes territorit të Kosovës, dhe
(ii) Qeveria e Kosovës kërkon financimin e tij apo e pranon që financimi përfshihet në fushëveprimin e kësaj Marrëveshje, ku Banka bie dakord për financimin ose Asistencën Teknike në një datë pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, ose shprehimisht në pritje të zbatimit ose hyrjes në fuqi të saj;
"**Tatim**" nënkupton çdo tatim, detyrim, taksë doganore, mbledhje taksash, tatim i mbajtur në burim apo ngarkesë fiskale çfarëdo që të jetë i aplikuar në çdo nivel territorial, duke qenë i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë apo i ngarkuar nga apo brenda Kosovës;
"**Asistencë Teknike**" nënkupton çdo shërbim i asistencës teknike i ofruar drejtpërsëdrejti nga Banka ose nga palët e treta mbi bazën e një marrëveshjeje me Bankës dhe nën mbikëqyrjen e saj.
Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, "**Nenet**" dhe "**Preambula**" do të interpretohen si një referencë ndaj neneve dhe preambula përkatëse të kësaj Marrëveshje (përveç nëse specifikohet ndryshe). Titujt e neneve janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk ndikojnë në ndërtimin e kësaj Marrëveshje.

Neni 2
Fushëveprimi i Marrëveshjes

Përcaktimi mbi Kosovën nuk paragjykon qëndrimin e shteteve anëtare dhe/ose Bashkimit Evropian ndaj statusit të Kosovës dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 (1999) dhe Opinionin e GJND-së i datës 22 korrik 2010 mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Banka dhe Qeveria e Kosovës pajtohen se ajo çështje nuk përfshihet në fushëveprimin e aktiviteteve dhe funksioneve të Bankës dhe ka të bëjë ekskluzivisht me të drejtën e posaçme sovrane ose super-nacionale të secilit shtet anëtar dhe/apo Bashkimit Evropian. Megjithatë, kjo nuk do të ndikojë në asnjë mënyrë në vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshje sipas të drejtës ndërkombëtare.

Neni 3
Aktiviteti i Bankës

Banka mund të ushtrojë lirisht brenda territorit të Kosovës aktivitetet e parapara në Statutin e Bankës, edhe kur ai ndryshohet kohë pas kohe, duke përfshirë, por jo kufizuar në, financimin me anë të një kredie, garancie, ekuiteti, kuazi ekuiteti, ose çdo mjeti tjetër financimi të ofruar nga Banka për çdo projekt, duke ofruar Asistencë Teknike, duke investuar në tregjet e parave, duke blerë apo shitur letrat me vlerë dhe duke kryer ndonjë operacion tjetër financiar të ndërlidhur me aktivitetin e tillë, duke huazuar fonde bazuar në çdo ligj dhe rregullore përkatëse me anë të të gjitha instrumenteve të lejuara në këtë mënyrë, si dhe duke mbajtur, përdorur dhe disponuar këto fonde dhe operimin e llogarive në çdo valutë. Në veçanti, Banka mund të japë asistencë teknike dhe/ose, në bazë të vlerësimit të saj ndaj një projekti, të vendosë lirshëm nëse, dhe në cilat kushte dhe rregulla, do të bëjë financimin në mbështetje të tij.

Neni 4
Tatimi i Bankës

Interesi dhe të gjitha pagesat e tjera që i takojnë Bankës dhe që dalin nga aktivitetet e parashikuara në këtë Marrëveshje, duke përfshirë ofrimin e Asistencës Teknike, si dhe pasuritë dhe të ardhurat e Bankës të ndërlidhura me aktivitete të tilla, do të përjashtohen nga tatimi. Asnjë aktivitet i Bankës në territorin e Kosovës në lidhje me çdo çështje që mbulohet nga kjo Marrëveshje nuk do ta bëjnë, në vetvete, bankën ose pasuritë e saj subjekt tatimi.

Neni 5
Konvertimi i valutës dhe transferi i fondeve

Gjatë gjithë jetës së ndonjë operacioni financiar të konkluduar në pajtim me nenin 3 të kësaj Marrëveshje, Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë që:

(a) Përfituesit mund të konvertojnë në çdo valutë plotësisht të konvertueshme, me kursin e këmbimit që mbizotëron në tregun e valutës, shumat në valutën vendase të nevojshme për të gjitha pagesat në Bankë në lidhje me kreditë, garancitë, kuazi ekuitetin, apo çdo aksion në kapitalin e ndërmarrësisë, Asistencë teknike në lidhje

me ndonjë projekt apo e kundërta në Bankë, dhe (ii) se shumat e tilla do të jenë të transferueshme brenda ose jashtë territorit të Kosovës në mënyrë të lirshme, menjëhershme dhe efektive, sipas rastit, në mënyrë që përfituesit të mund të përmbushin obligimet e tyre ndaj Bankës në përputhje me kushtet e instrumentit përkatës të kontraktuar ose instrumenteve të tjera.

(b) Banka mund të konvertojë në çdo valutë plotësisht të konvertueshme, me kursin e këmbimit që mbizotëron në tregun e valutës, shumat në valutën vendase të pranuara nga Banka nga pagesat që dalin në lidhje me financimin përmes kredive, garancive, kuazi ekuiteteve, apo aksioneve në kapitalin e ndërmarrësisë, Asistencës teknike ose çdo aktivitet tjetër, dhe Banka mund të transferojë shumat e konvertuara në këtë mënyrë brenda ose jashtë territorit të Kosovës në mënyrë të lirshme, menjëhershme dhe efektive në ato llogari bankare që Banka mund të vendosë lirisht, ose, në opsion të Bankës, (ii) që mund të disponojë lirisht shuma të tilla brenda territorit të Kosovës;

(c) Banka mund të konvertojë në monedhën vendase, me kursin e këmbimit që mbizotëron në treg e valutës, çdo shumë në çdo lloj valute plotësisht të konvertueshme.

Neni 6
Trajtimi i projekteve/ aktiviteteve të Bankës

Pa cenuar kushtet e kësaj Marrëveshjeje, Qeveria e Kosovës do të:

(a) sigurojë që projektet dhe kontratat e dhëna për ekzekutimin e tyre, si dhe aktivitetet tjera bankare, përfitimet në lidhje me çështjet fiskale, doganore si dhe çështjet tjera, nga trajtimi jo më pak i favorshëm se ai që është akorduar për projekte ose kontrata apo aktivitete tjera të financuara dhe/ose të garantuara apo të siguruara nga ndonjë institucion tjetër ndërkombëtar financiar apo akorduar sipas një marrëveshje dypalëshe në lidhje me çështje të tilla ose sipas legjislacionit vendor, cilado që është më e favorshme; dhe

(b) ofrojë në mbrojtje dhe siguri të plotë dhe të vazhdueshme për çdo projekt kundër shpronësimit dhe të ruajë kapacitetin e projektit për të realizuar të ardhura që është në dispozicion për shërbimin e obligimeve në lidhje me financimin për projektin.

Neni 7
Tenderimi Publik

Banka mund të bëjë financimin e projekteve apo të ofrojë asistencë teknike të kushtëzuar me marrëveshje për pjesëmarrje në tenderë dhe procedura tjera konkurruese për dhënien e kontratave duke qenë në pajtim me Rregullat dhe Procedurat e Bankës në fuqi nga koha në kohë.

Neni 8
Statusi i Bankës dhe Trajtimi

(1) Banka do të gëzojë personalitet të plotë ligjor në territorin e Kosovës, në veçanti duke përfshirë kapacitetin për të kontraktuar, blerë dhe hequr nga përdorimi

pasurinë e tundshme dhe të patundshme si dhe të jetë palë në procedurë ligjore.

(2) Banka do të gëzojë trajtim të akorduar si institucion ndërkombëtar në lidhje me aktivitetet e saj në territorin e Kosovës i cili është mi i favorizuar në lidhje me çfarëdo aktiviteti të tillë, ose, nëse është më e favorshme, trajtim i akorduar sipas ndonjë marrëveshjeje ndërkombëtare e cila mbulon aktivitete të tilla. Në veçanti, Banka do të ketë qasje të lirë në tregun financiar në Kosovë. Obligimet e saj, letrat me vlerë dhe instrumentet tjera krahasuese financiare të trajtohen sipas kushteve, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në, kushte si trajtimi tatimor, të paktën po aq të favorshme sikur ato që u akordohen organeve publike në Kosovë, duke përfshirë Qeverinë si dhe institucionin më të favorizuar ndërkombëtar në këtë kuptim.

(3) Letrat me vlerë për borxhe të emetuara nga Banka dhe të shprehura në monedhë vendore do të jenë të pranueshme për operacionet e riblerjes me cilindo institucion që gëzon prerogativat e një banke qendrore në Kosovë sikur të ishin letra me vlerë për borxhe të emetuara nga Qeveria. Investitorët do të lejohen të blejnë letra të tilla me vlerë pa kufizime, dhe në veçanti nuk do të kufizohen për sa i përket përqindjes së letrave me vlerë të papaguara në një çështje të mbajtur nga ana e tyre.

(4) Gjatë kryerjes së aktiviteteve të saj sipas kësaj marrëveshjeje, Banka do të përjashtohet nga çfarëdo leje, licence apo ndonjë autorizim tjetër në çfarëdo forme që mund të jetë e nevojshme për aktivitete të ngjashme nën çfarëdo rregulli të aplikueshëm të ligjit vendor.

(5) Banka do të gëzojë statusin e preferuar të kreditorit në lidhje me aktivitetet e parapara me Statutin e bankës, duke përfshirë ato të përmendura në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9
Privilegjet dhe Imunitetet e Bankës dhe përfaqësuesve të saj

(1) Pasuritë e Bankës do të përjashtohen nga:
   (a) kërkimi dhe të gjitha format e shpronësimit; dhe
   (b) vjelja apo vënia e ndonjë mase tjetër të ekzekutimit apo sekuestrim para dhënies së një vendimi përfundimtar pa të drejtë ankese ndaj Bankës, të dhënë nga një Gjykatë kompetente.

(2) Përfaqësuesit e Bankës, derisa janë të angazhuar në aktivitete në lidhje me ose në implementim të kësaj marrëveshjeje, së paku do të gëzojnë imunitetet dhe privilegjet e më poshtme
   (a) imunitet nga procedurat ligjore dhe administrative, duke përfshirë por jo duke u kufizuar në, imunitet nga çfarëdo forme të arrestimit apo ndalimit në lidhje me veprimet e kryera nga ata në cilësinë e zyrtarit, përveç rasteve kur Banka e heq një imunitet të tillë;
   (b) privilegjet diplomatike dhe objektet në dispozicion në territorin e Kosovës, për komunikime zyrtare, bartjen e dokumenteve dhe udhëtimit.

(3) Qeveria e Kosovës të përjashtojë përfaqësuesit e Bankës, derisa ata janë të angazhuar në aktivitete të lidhura me ose në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, nga kufizimet e emigracionit dhe formalitetet e regjistrimit për të huaj.

(4) Në lidhje me të gjitha çështjet që nuk janë të parashikuara në mënyrë specifike më sipër, përfaqësuesit e Bankës do të gëzojnë nivelin e imuniteteve dhe privilegjeve

të cilat janë jo më pak të favorshme se ato në dispozicion të zyrtarëve të institucionit më të favorizuar ndërkombëtar në Kosovë.

Neni 10
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve mbi aktivitetet e Bankës

(1) Qeveria e Kosovës merr përsipër që, në lidhje me çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet Bankës dhe përfituesit ose çfarëdo pale të tretë lidhur me aktivitetet e Bankës të parapara me këtë Marrëveshje: (i) të sigurojë që gjykatat në Kosovë kanë autoritet të miratojnë një vendim përfundimtar të dalë nga një proces i rregullt i një gjykate ose gjykate kompetente, përfshirë edhe Gjykatën e Drejtësisë të Bashkimit Evropian apo ndonjë gjykate kombëtare të një shteti anëtar të BE-së apo ndonjë tribunal të arbitrazhit; dhe (ii) të sigurojë ekzekutimin e një vendimi të tillë, në përputhje me rregullat dhe procedurat e aplikueshme vendore.
(2) Qeveria e Kosovës me këtë rast heq dorë nga çdo lloj imuniteti ose nga e drejta për të kundërshtuar juridiksionin e gjykatës kompetente ose tribunalit, duke përfshirë edhe Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian, në lidhje me çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet Kosovës dhe Bankës në lidhje financimin e një projekti ose asistencës teknike.

Neni 11
Zëvendësimi

Të drejtat mbi Bankën nga kjo Marrëveshje mund të gëzohen dhe ushtrohen nga Banka në emër të vet dhe, deri në atë masë sa BE-ja ka bërë pagesën për Bankën në lidhje me çfarëdo garancie ose sigurimi për ndonjë kredi, kapital, kuazi-kapital, garanci apo ndonjë instrument tjetër financimi ose Asistencë Teknike të përmbyllur në bazë të kësaj Marrëveshjeje, nga (i) Banka si përfaqësuese e BE-së, ose (ii) siç mund të jetë rasti, vetë BE-ja në bazë të një të drejte të zëvendësimit.

Neni 12
Bashkëpunimi

(1) Qeveria e Kosovës pajtohet që të jap përgjigjen me shkrim brenda 30 ditëve ndaj kërkesave të bëra nga Banka për njohjen që financimi i projektit apo propozimi për Asistencë Teknike është në kuadër të fushëveprimit të kësaj Marrëveshjeje.
(2) Qeveria e Kosovës merr përsipër të informojë Bankën me kohë për ndonjë masë ose masë të propozuar nga ana e saj, apo edhe për ndonjë rrethanë tjetër, që në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojë materialisht në të drejtat dhe interesat e Bankës sipas kësaj Marrëveshje.
(3) Qeveria e Kosovës, duke vepruar përmes Ministrisë së Financave, menjëherë do ti dorëzojë Bankës letrën e saj të miratimit në lidhje me secilin projekt në Kosovë të miratuar nga Banka.

Neni 13
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

(1) Çdo polemikë, mosmarrëveshje, kundërshti apo pretendim që lind në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë, interpretimin, zbatimin ose përfundimin e kësaj Marrëveshjeje (së bashku referuar si "**Mosmarrëveshje**") për aq sa të jetë e mundur të zgjidhen me marrëveshje në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Bankës.
(2) Nëse mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet miqësisht nga Qeveria e Kosovës dhe Banka brenda 60 ditëve nga data e njoftimit të mosmarrëveshjes nga secila prej këtyre palëve, mosmarrëveshja do të dorëzohet nga cilado palë për një vendim përfundimtar dhe detyrues tek Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian.
(3) Qeveria e Kosovës me këtë rast heq dorë nga çdo imunitet ose e drejta për të kundërshtuar juridiksionin e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian në lidhje me çfarëdo mosmarrëveshje.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën pas datës në të cilën Banka i konfirmon Qeverisë së Kosovës pranimin e kopjes së vërtetuar të instrumentit të ratifikimit të kësaj të fundit ose instrument tjetër reciprokisht të rënë dakord ndërmjet Kosovës dhe Bankës, përfshirë edhe opinionin ligjor të pranueshëm për Bankën, si forcë ligjore të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 15
Marrëveshja Kornizë 2005 dhe Efektiviteti

Qeveria e Kosovës në mënyrë të pakushtëzuar dhe të parevokueshme pranon se të gjitha obligimet e kontraktuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në emër të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë në lidhje me të gjitha projektet, operacionet dhe aktivitetet e nënshkruara nga Banka sipas Marrëveshjes Kornizë 2005 do të vazhdojnë të jenë në fuqi dhe Qeveria e Kosovës në mënyrë të pakushtëzuar pranon dhe pajtohet t'i përmbahet obligimeve të tilla.

Neni 16
Skadimi

(1) Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohore.
(2) Banka mund, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Qeverisë së Kosovës të përfundojë këtë Marrëveshje ose të lirojë Qeverinë e Kosovës nga të gjitha ose ndonjërën nga obligimet e saja sipas kësaj Marrëveshjeje. Nëse nuk shprehet ndryshe, dhënia e një njoftimi të tillë nuk do të ndikojë në të drejtat dhe interesat e fituara nga Banka në lidhje me projektet dhe operacionet tjera financiare të pakryera, duke përfshirë Asistencën Teknike në datën e njoftimit.
(3) Qeveria e Kosovës mund me anë të një njoftimi paraprak 6-mujor me shkrim drejtuar Bankës të përfundojë këtë Marrëveshje. Dhënia e një njoftimi të tillë nuk

do të ndikojë në të drejtat dhe interesat e fituara nga Banka në lidhje me projektet dhe operacione tjera të pakryera financiare, duke përfshirë Asistencën Teknike në datën e hyrjes së njoftimit të tillë në fuqi në territorin e Kosovës.

Neni 17
Shpalosje

Qeveria e Kosovës pajtohet se shpalosja e kësaj Marrëveshjeje është e autorizuar dhe nuk shkelë asnjë rregullore të zbatueshme apo aktvendim të ndonjë organi kompetent qeverisës.

Neni 18
Adresa për komunikime

Palët bien dakord që çdo komunikim që del nga rrjedha e operimit të kësaj marrëveshjeje mund të adresohet në adresat e tyre përkatëse, të përcaktuara si më poshtë:

Për Qeverinë e Kosovës:	Ndërtesa e re e Qeverisë, rruga Nëna Terezë 10000 Prishtinë E-mail: zyraministrit@mfe-ks.org / Tel.: +3813820034101
Për Bankën:	100, boulevard Konrad Adenauer, L-2950 Luxembourg

NË DËSHMI TË KËSAJ, të poshtëshënuarit, e të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në gjuhën angleze, në katër (4) kopje origjinale, secila faqe është shënuar me iniciale nga të poshtëshënuarit ose përfaqësuesit e tyre në emër të Qeverisë së Kosovës dhe në emër të Bankës.

Prishtinë, 7 qershor 2013.

Nënshkruar në emër të QEVERISË SË KOSOVËS Ministri i Financave	Nënshkruar në emër të BANKA EVROPIANE E INVESTIMEVE Zëvendës President
Besim BEQAJ	Anton ROP

LIGJI Nr. 04/L-134
PËR NDËRTESAT E BANIMIT NË BASHKËPRONËSI

Përmbajtja

Kreu I: Dispozitat e përgjithshme....1231
Kreu II: Pronësia individuale dhe bashkëpronësia në ndërtesën në bashkëpronësi....1234
Kreu III: Krijimi, ndryshimi dhe shuarja e bashkëpronësisë....1236
Kreu IV: Shfrytëzimi i bashkëpronësisë dhe njësive në ndërtesë....1239
Kreu V: Organet vendimmarrëse në ndërtesat e banimit dhe ndarja e përgjegjësive....1241
Kreu VI: Administrimi dhe mirëmbajtja e bashkëpronësisë në ndërtesë....1249
Kreu VII: Mbikëqyrja....1252
Kreu VIII: Masat ndëshkimore....1253
Kreu IX: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare....1254

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR NDËRTESAT E BANIMIT NË BASHKËPRONËSI

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Me këtë ligj rregullohen të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e pronarëve të njësive të ndërtesës në lidhje me shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve, hapësirave dhe pajisjeve të përbashkëta të ndërtesës - bashkëpronësinë në ndërtesë.

Neni 2
Fushëveprimi

Ky ligj zbatohet për të gjitha ndërtesat për banim, ndërtesat për banim që kanë njësi afariste që janë në pronësi të më shumë së një pronari, si dhe për komplekse të njësive individuale të banimit dhe afariste të cilat kanë në pronësi të përbashkët një territor, në funksion dhe në përdorim, ekskluzivisht të pronarëve të njësive.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
   1.1. **Ndërtesë banimi në bashkëpronësi-** ndërtesë e pavarur me dy apo më shumë njësi të përshtatshme dhe e parashikuar për banim, respektivisht për banim dhe ushtrim të aktiviteteve afariste e që është në pronësi të më shumë së një pronari.
   1.2. **Njësitë individuale në ndërtesë -** njësitë e banimit, njësitë afariste, apo hapësirat tjera të pavarura në ndërtesë në pronësi individuale madhësia e të cilës është përcaktuar me anë të kufinjve horizontal dhe vertikal të saj, të evidentuara në Marrëveshjen në Bashkëpronësi.
   1.3. **Pronarë** - personi fizik dhe juridik i cili është bartës i të drejtës së pronësisë në njësinë e ndërtesës.
   1.4. **Krijuesi i bashkëpronësisë** - institucioni shtetëror, personi juridik, personi ose grup personash fizikë që veprojnë së bashku, të cilët investojnë për krijimin e pronës, në emër të të cilëve regjistrohet për herë të pare.
   1.5. **Marrëveshja e bashkëpronësisë -** dokumenti i nënshkruar nga të gjithë pronarët e njësive që regjistrohet në Kadastër e që shërben si Akt për themelimin e ndërtesës në bashkëpronësi. Dokumenti duhet të reflektoj çdo ndryshim në ndërtesë me amendamentim, duke përfshirë çdo amendamentim të atyre dokumenteve dhe planet e lokacionit e planimetrinë. Kjo Marrëveshje përshkruan të drejtat dhe përgjegjësitë, kufizimet dhe kushtet për mënyrën e shfrytëzimit të elementeve të përbashkëta dhe njësive. Kjo zakonisht përfshinë rregulloret e një ndërtese në bashkëpronësi. Marrëveshja është dokumenti kryesor për udhëheqjen e një ndërtese në bashkëpronësi
   1.6. **Plani i Lokacionit -** plani që përfshinë tërë ndërtesën në bashkëpronësi ose një pjesë të saj në dy dimensione që tregon lokacionin e ndërtesës në bashkëpronësi dhe hapësirave, pjesëve dhe elementeve të përbashkëta.
   1.7. **Planimetria** -përshkrimi grafik i njësive individuale dhe bashkëpronësisë në ndërtesë**.**
   1.8. **Kufinjtë Horizontal -** kufij të përcaktuar në marrëveshjen e bashkëpronësisë dhe nënkuptojnë hapësirën ndërmjet dy pllakave konstruktive respektivisht lartësinë e pastër dysheme-tavan të njësisë asisoj që prona e paluajtshme që është nën respektivisht mbi këto pllaka konstruktive nuk është pjesë e asaj njësie.
   1.9. **Kufinjtë Vertikal -** kufiri i përcaktuar të njësisë që nuk është një kufi horizontal i asaj njësie. Është definuar në marrëveshjen për bashkëpronësi e që nënkupton anët e brendshme të mureve që e kufizojnë njësinë.
   1.10. **Bashkëpronësia -** pjesë e pronës që nuk janë në pronësi individuale dhe nuk janë pronë publike, por në të cilat mbahet një interes i pandashëm nga pronarët e njësive.
   1.11. **Elementet e bashkëpronësisë -**pjesët, hapësirat dhe pajisjet e përbashkëta të ndërtesës në bashkëpronësi të cilat i shërbejnë njësive të ndërtesës dhe ndërtesës si tërësi, si dhe toka ndërtimore në të cilën është ndërtuar ndërtesa, zona e parkimit, objektet rekreative, e të ngjashme.
   1.12. **Elementet e bashkëpronësisë për përdorim të veçantë** - elementet për

përdorim ekskluziv të një ose më shumë njësive individuale por nuk u shërbejnë njësive tjera në ndërtesë e që zakonisht janë hapësira ose elemente të përbashkëta të një kati.

1.13. **Elementet e bashkëpronësisë për përdorim të përgjithshëm** -të gjitha elementet e bashkëpronësisë përveç elementeve e përbashkëta të veçanta.

1.14. **Shoqata e Pronarëve** - autoriteti ligjor që funksionon si organizatë joqeveritare ose person juridik ku obligohen të anëtarësohen të gjithë pronarët e njësive individuale të ndërtesës në bashkëpronësi

1.15. **Kryesia e Shoqatës** - grupi kryesues i pronarëve të njësive, të përfshirë në marrëveshje të bashkëpronësisë ose në rregulloren për funksionim dhe vepron në emër të Shoqatës**.**

1.16. **Rregulloret -** çfarëdo marrëveshje që është adoptuar nga Shoqata për funksionimin, rregullimin dhe menaxhimin e Shoqatës.

1.17. **Rendi Shtëpiak -** marrëveshja e adoptuar nga Shoqata për mënyrën e shfrytëzimit, administrimit dhe mirëmbajtjes së elementeve të bashkëpronësisë.

1.18. **Kuota e pjesëmarrjes në bashkëpronësi -** pjesa e pronësisë së pandashme në bashkëpronësinë në ndërtesë e cila shërben për përcaktimin e masës së pjesëmarrjes në shpenzimet e përbashkëta dhe në votim për pronarët e çdo njësie.

1.19. **Sipërfaqe e shfrytëzueshme -** sipërfaqja e përgjithshme e dyshemesë së njësisë në ndërtesë, duke mos përfshirë sipërfaqen që zënë nga muret e njësisë në ndërtesë.

1.20. **Administratori** - shoqëri tregtare e regjistruar pranë organit kompetent për regjistrimin e bizneseve që është e kontraktuar nga Shoqata e Pronarëve për ushtrimin e menaxhimit, mirëmbajtjes apo shërbimeve tjera për të mirën e ndërtesës në bashkëpronësi.

1.21. **Sipërfaqja e përgjithshme e shfrytëzueshme -** matje e sipërfaqes së shfrytëzueshme e të gjitha njësive, në metra katror.

1.22. **Administrimi** - zbatimi i vendimeve të marra nga Kryesia e Shoqatës bazuar në rregulloret e aprovuara nga Shoqata me qëllim të realizimit të administrimit duke përfshirë mirëmbajtjen dhe operimin e sigurte të ndërtesës në bashkëpronësi.

1.23. **Banor -** çdo person me qëndrim të përhershëm në ndërtesën në bashkëpronësi, dhe qiramarrësit me familjarët e tyre.

1.24. **Transaksion me konflikt interesi** - kontratë, transaksion ose marrëdhënie tjetër financiare ndërmjet: Shoqatës së Pronarëve dhe një anëtari të Kryesisë së Shoqatës; administratorit dhe një anëtari të Kryesisë së Shoqatës (përveç kontratës së Shoqatës së Pronarëve me Administratorin); Shoqatës së Pronarëve dhe një pale të lidhur me një anëtar të Kryesisë së Shoqatës; Administratorit dhe një pale të lidhur me një anëtar të Kryesisë së Shoqatës.

1.25. **Palë e lidhur** - bashkëshort, pasardhës, paraardhës, vëlla ose motër, bashkëshort /e i vëllait ose motrës, një pasuri apo trust në të cilën drejtori apo pala e lidhur me drejtorin ka interes përfitimi.

1.26. **Ministria** - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

KREU II
PRONËSIA INDIVIDUALE DHE BASHKËPRONËSIA NË NDËRTESËN NË BASHKËPRONËSI

Neni 4
E drejta e pronësisë në elemente të përbashkëta

1. Të gjithë pronarët e njësive kanë të drejtë të pandarë pronësie në elementet e bashkëpronësisë të ndërtesës në bashkëpronësi.
2. Kuota e pjesëmarrjes në bashkëpronësi e pronarit të njësisë individuale caktohet nga raporti i sipërfaqes së shfrytëzueshme të njësisë individuale ndaj sipërfaqes së përgjithshme të shfrytëzueshme.

Neni 5
Elementet e bashkëpronësisë në ndërtesë dhe njësitë individuale

1. Përveç siç është rregulluar në marrëveshjen për bashkëpronësi:
   1.1. pjesë të njësisë individuale konsiderohet edhe gjithë rrjeti përforcues, përforcuesit e murit, paneli i brendshëm, suvatimi, panelimi, pllakat, tapiceritë, ngjyra dhe dyshemeja e fundme dhe cilido material tjetër që përbën pjesë të sipërfaqes të fundme të njësisë, nëse muret, dyshemetë apo tavanet janë përcaktuar si kufijtë e një njësie;
   1.2. cila do pjesë e bashkëpronësisë që destinohet ti shërbej vetëm një njësie është element i bashkëpronësisë për përdorim të veçantë si: gypi, vrima,oxhaku, teli ose kanali që kalon përmes mureve, përmes shtyllave ose pjesërisht mbështetet jashtë kufijve të planifikuar të njësisë, ndërsa çfarëdo pjese që i shërben më shumë se një njësie, është një element i bashkëpronësisë për përdorim të përgjithshëm.
   1.3. pjesë të njësisë konsiderohen të gjitha hapësirat, pjesët e brendshme të ndërtesës si dhe renovimet dhe përmirësimet e bëra përbrenda kufijve të njësisë;
   1.4. grilat, roletet, kutitë e dritareve, shkallët e hyrjes, shtyllat, verandat, ballkonet dhe terasat si dhe dyert e jashtme dhe dritaret ose ndonjë pjesë aksesore që i shërben njësisë individuale, por që ndodhet jashtë kufijve të asaj njësie, janë elemente të bashkëpronësisë për përdorim të veçantë që përdoren ekskluzivisht për atë njësi.
2. Elementet e bashkëpronësisë të ndërtesës në bashkëpronësi janë të gjitha elementet përveç njësive individuale dhe përfshijnë:
   2.1. konstruksionin mbajtës të ndërtesës (themelet, muret masive, shtyllat, konstruksionin mes katesh, të kulmit kulmet e pjerrëta dhe të rrafshëta);
   2.2. mbulesën e kulmit (izolimin, tjegullat, dhe të ngjashme);
   2.3. kulmet e rrafshëta, të shfrytëzueshme dhe të pashfrytëzueshme;
   2.4. fasadat e ndërtesës, dera hyrëse dhe dritaret e hapësirave të përbashkëta;
   2.5. punimet e llamarinës së kulmit dhe punimet tjera;
   2.6. oxhaqet, kanalet e ventilimit, hidranti, pajisjet për fikjen e zjarrit, gypat e ujit, kanali për mbeturina dhe të ngjashme;

2.7. shkallët e përbashkëta, korridoret, rrethojat, daljet emergjente, ballkonet ose lozhat e përbashkëta dhe të ngjashme;
2.8. ashensorët për bartjen e banorëve dhe gjësendeve, me instalimet komplete të tyre;
2.9. instalimet elektrike prej siguresës kryesore deri te pllaka shpërndarëse e ndërtesës;
2.10. instalimet e ujësjellësit prej matësit kryesor të ujit deri te konsumatori si dhe sanimi pas intervenimeve;
2.11. Pajisjet sanitare të instalimit të ujësjellësit dhe kanalizimit në hapësirat e përbashkëta;
2.12. instalimet vertikale të kanalizimit nga gypat dalës të banesës deri te puset kryesore;
2.13. instalimet elektrike të ndriçimit të shkallëve: automatet, vendi i llambave dhe armaturave, pllaka shpërndarëse njehsori dhe ora e montuar;
2.14. pjesët e përbashkëta të instalimeve të ngrohjes qendrore nga lidhja me kallkan dhe trupat ngrohës në hapësirat e përbashkëta;
2.15. instalimi i telefonit deri te shpërndarësi në njësi të ndërtesës, instalimi i dyerve me dorëza elektrike, interfon zilja, instalimet e rrufepritësit dhe të ngjashme;
2.16. pajisjet për furnizim me ujë (hidrofori dhe hidroflekset);
2.17. hapësirat dhe instalimet për largimin e mbeturinave, hapësirat për larjen e rrobave, bodrumet dhe hapësirat e nën kulmit;
2.18. gropën septike të përbashkët,
2.19. çfarëdo pjese tjetër, hapësire, ose ndonjë ndërtesë dhe pajisje që nuk është pjesë e njësive individuale duke përfshirë tokën e parcelës në të cilën është ndërtuar ndërtesa.

3. Me përjashtim të elementeve të bashkëpronësisë për përdorim të veçantë të përcaktuara sipas nënparagrafit 1.2. dhe 1.4. të paragrafit 1. të këtij neni, marrëveshja duhet të specifikojë njësinë apo njësitë te cilave u dedikohen elementet e bashkëpronësisë për përdorim të veçantë.

Neni 6
Elementet e Bashkëpronësisë në ndërtesë të cilat u shërbejnë më shumë ndërtesave

1. Elementet e bashkëpronësisë në ndërtesë të cilat u shërbejnë pronarëve të disa ndërtesave janë bashkëpronësitë në ndërtesë të cilat janë ndërtuar për këtë qëllim dhe nëse për ndërtimin e tyre kanë kontribuar pronarët e më shumë ndërtesave.
2. Elementet e bashkëpronësisë në ndërtesë nga paragrafi 1. i këtij neni janë elemente të bashkëpronësisë për përdorim të përgjithshëm të të gjithë pronarëve të njësive në ato ndërtesa.
3. Për shfrytëzimin dhe administrimin e elementeve të bashkëpronësisë në ndërtesë proporcionalisht zbatohen dispozitat e këtij ligji.

Neni 7
Rregullore teknike

Ministria, për ndërtesat në bashkëpronësi, do të përcaktojë normat minimale teknike të ndërtesës në bashkëpronësi dhe normat minimale hapësinore për hapësirat në funksion të këtyre ndërtesave me Rregullore teknike.

KREU III
KRIJIMI, NDRYSHIMI DHE SHUARJA E BASHKËPRONËSISË

Neni 8
Krijimi i bashkëpronësisë

1. Bashkëpronësia në ndërtesë tek ndërtesat e vjetra krijohet me regjistrimin e marrëveshjes së bashkëpronësisë, të nënshkruar nga të gjithë pronarët e njësive e që përfshinë planin e lokacionit the planimetritë e ndërtesës në bashkëpronësi në Regjistrin e Pronësisë së paluajtshme dhe në Kadastër.
2. 2.Bashkëpronësia në ndërtesat e reja krijohet me regjistrimin e ndërtesës në Regjistrin e Pronësisë së paluajtshme dhe në Kadastër në emër të krijuesit i cili e kalon pronësinë e njësive individuale së bashku me kuotën e pjesëmarrjes në bashkëpronësi, të definuar sipas marrëveshjes së bashkëpronësisë, tek blerësit e ri-pronarët.

Neni 9
Emërtimi i ndërtesave në bashkëpronësi dhe njësive individuale në ndërtesë

Ndërtesat në bashkëpronësi dhe njësitë individuale emërtohen sipas dispozitave të Ligjit Nr.04/L-071 për Sistemin e Adresave.

Neni 10
Përmbajtja e marrëveshjes

1. Marrëveshja duhet të përmbajë:
   1.1. emrat e pronarëve të ndërtesës dhe të anëtarëve të shoqatës;
   1.2. ndërtesën ose ndërtesat e përfshira, emrin e rrugës si dhe numrin e ndërtesës, të definuara nga komuna;
   1.3. përshkrimin e përgjithshëm të ndërtesës, duke përfshirë madhësinë, llojin e ndërtimit dhe qëllimin e përgjithshëm;
   1.4. përshkrimin e secilës njësi, pozicionin e saj përbrenda ndërtesës, qëllimin e saj, madhësinë, numrin identifikues, dhe çfarëdo karakteristike tjetër;
   1.5. kuotën e pjesëmarrjes për çdonjërin pronarë;
   1.6. përshkrimin e qartë të të gjitha elementeve të përbashkëta të përgjithshme dhe për përdorim të veçantë, duke përfshirë pajisjet
   1.7. të drejtat dhe përgjegjësitë që i takojnë të gjithë pronarëve;
   1.8. çfarëdo kufizimi të përdorimit, posedimit dhe bartjes së pronësisë së njësive;
   1.9. përshkrim të mjaftueshëm ligjor të pronësisë në të cilën pronarët e njësisë

do të zotojnë vetëm një pjesë të patundshmërisë për disa vite, të quajtur si "pronë e afatizuar", nëse ka;

1.10. të gjitha skicat, planimetritë dhe certifikatat teknike që i takojnë ndërtesës në bashkëpronësi.

2. Marrëveshja mund të përmbaj çfarëdo çështje tjetër për të cilën nënshkruesit konsiderojnë se është e rëndësishme të përfshihem siç janë rregulloret në një ndërtesë në bashkëpronësi.
3. Marrëveshja mund të përmbaj edhe Planin e lokacionit dhe planimetrinë që mund të përmbaj informacione specifike që kërkohen të përfshihen në marrëveshje.
4. Marrëveshja mund të amendamentohet duke paraqitur ndryshimet në planin e lokacionit ose planimetritë për të përmirësuar gabimet tipografike ose teknike.
5. Marrëveshja mund të amendamentohet për të arritur pajtueshmërinë me kërkesat, standardet ose udhëzimet e ndonjë agjencion relevant qeveritar.
6. Në rastet kur krijohet ose shtohet njësi banimi në një ndërtesë në bashkëpronësi marrëveshja që amendamentohet duhet të përfshijë certifikatën nga arkitekti ose inxhinieri që dëshmon se:
   6.1. të gjitha komponentët strukturale të ndërtesës janë përfunduar tërësisht; dhe
   6.2. konstruksioni struktural i ndërtesës dhe infrastruktura është e mjaftueshme për krijimin e njësive të reja.
7. Përmbajtja e Planit të lokacionit dhe planimetrive përcaktohen me akt nënligjor.

Neni 11
Amendamentimi i marrëveshjes së bashkëpronësisë

1. Marrëveshja përfshinë planimetritë dhe mund të amendamentohet vetëm me një shumicë votash të njësive të pronarëve të cilët kanë më shumë se pesëdhjetë përqind (50%) të sipërfaqes së shfrytëzueshme të ndërtesës në bashkëpronësi.
2. Amendamentimi i marrëveshjes bëhet kur:
   2.1. bëhet ndryshim në madhësinë e ndërtesës, me rritjen e numrit të njësive, ose me ndryshimin e hapësirave të përbashkëta,
   2.2. bëhet ndryshimi i destinimit të njësisë,
3. Nëse nga amendamentet përfitojnë të gjitha njësitë, përgjegjësitë dhe shpenzimet mbulohen nga Shoqata e Pronarëve;
4. Pajtimi i pronarëve i përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni verifikohet nga autoritetet kompetente.
5. Amendamentet duhet të regjistrohen në Kadastër.
6. Amendamentimet duhet të pasqyrojnë ndryshimin në kuotën e pjesëmarrjes në elementet e përbashkëta të bashkëpronësisë dhe elementet e bashkëpronësisë për përdorim të veçantë.

Neni 12
Shuarja e bashkëpronësisë

1. Me përjashtim të rasteve kur të gjitha njësitë merren përmes shpronësimit, bashkëpronësia mund të shuhet me marrëveshjen e të gjithë pronarëve të njësive duke respektuar dispozitat e Ligji Nr. 03/L-154 mbi të drejtën pronësore dhe të drejtat tjera sendore.

2. Për më tepër marrëveshja për shuarje duhet të ekzekutohet në të njëjtën mënyrë sikurse kontrata për bartjen e pronësisë mbi pronën e paluajtshme, duke pasur parasysh numrin e njësive të pronarëve të paraparë me paragrafin 1. të këtij neni.
3. Shoqata e Pronarëve në emër të njësive të pronarëve, mund të kontraktoj për shitjen e pronës së paluajtshme të ndërtesës në bashkëpronësi përgjatë procesit të shuarjes, por kontrata nuk është e obligueshme për njësitë e pronarëve pa miratimin paraprak.
4. Nëse prona shitet gjatë fazës së shuarjes së bashkëpronësisë, titulli i pronës kalon tek Shoqata e Pronarëve si mbrojtës të interesave të njësive, e cila ka fuqinë e nevojshme për të lehtësuar shitjen.
5. Përderisa shitja të kryhet Shoqata e Pronarëve vazhdon të jetë në fuqi dhe ka të gjitha kompetencat sikurse para fillimit të procesit të shuarjes.
6. Vlera e shitjes duhet t'u shpërndahet të gjithë pronarëve të njësive dhe pengmarrësve si garant për pagesë pasi që interesat e tyre mund të shfaqen po ashtu, në pajtim me këtë nen, duke marrë parasysh vlerën e pronës që nuk shitet në pronësi ose të shpërndarë me qëllim të ruajtjes së balancit të interesave të secilës njësi në kuadër të gjithë pronës në mënyrë kumulative.
7. Marrëdhëniet pronësore për pronarët që nuk duan të shesin pronën e tyre rregullohen me Ligji Nr. 03/L-154 mbi të drejtën pronësore dhe të drejtat tjera sendore.
8. Pas shuarjes së bashkëpronësisë, procedurat për shitje, së bashku me asetet e Shoqatës së Pronarëve mbahen nga Shoqata e Pronarëve si peng për të siguruar kryerjen e obligimeve financiare të njësive;

Neni 13
Informatat e nevojshme për publikim

1. Shoqata e Pronarëve duhet t'i bëjë publike pronarëve të njësive informacionet në vijim:
   1.1. emrin e Shoqatës së Pronarëve;
   1.2. emrin e administratorit të caktuar nga Shoqata e Pronarëve nëse ka të tillë;
   1.3. adresën valide dhe një numër të telefonit si për Shoqatën e Pronarëve ashtu edhe për administratorin nëse ka;
   1.4. emrin e ndërtesës në bashkëpronësi;
   1.5. datën e regjistrimit të marrëveshjes së bashkëpronësisë; dhe
   1.6. numrin kadastral të regjistrimit të marrëveshjes së bashkëpronësisë.
2. Brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas përfundimit të çdo viti, Shoqata e Pronarëve duhet të vëjë në gatishmëri informacionet e mëposhtme:
   2.1. buxhetin për veprimtari për vitin e tanishëm fiskal;
   2.2. një listë të shpenzimeve sipas llojit duke përfshirë ndarjen e shpenzimeve të rregullta dhe shpenzimet e jashtëzakonshme;
   2.3. deklaratën financiare vjetore, duke përfshirë çfarëdo shumë që është rezervë gjatë vitit para se të shpallet;
   2.4. rezultatet e auditimit të raportit të fundit të Auditorit;
   2.5. listën e të gjitha polisave të sigurimit të Shoqatës së Pronarëve.
   2.6. marrëveshjen e bashkëpronësisë së Shoqatës së Pronarëve dhe çdo

amandament tjetër, rregulloret e funksionimit të shoqatës dhe rendin shtëpiak; dhe

2.7. procesverbalin e takimeve të anëtarëve;

3. Shoqata e Pronarëve mund të bëjë publike informacionet sipas paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni duke:
   3.1. postuar një njoftim në portalin e krijuar për këtë qëllim dhe duke i informuar të gjithë pronarët me adresën e portalit;
   3.2. i vënë në dispozicion në Zyrën e Shoqatës së Pronarëve; ose
   3.3. shpërndarë secilit pronarë personalisht;
4. Kosto e shpërndarjes e kërkuar sipas nënparagrafit 3.3. të paragrafit 3. të këtij neni, duhet të llogaritet si shpenzim i përbashkët.
5. Nëse adresa e Shoqatës së Pronarëve ose administratori ndryshojnë, Shoqata duhet të azhurnojë informacionet brenda nëntëdhjetë 90 ditësh pas realizimit dhe të njëjtat t'i ri publikoj.

KREU IV
SHFRYTËZIMI I BASHKËPRONËSISË DHE NJËSIVE NË NDËRTESË

Neni 14
Shfrytëzimi i Bashkëpronësisë

1. Pronari është i detyruar të shfrytëzoj bashkëpronësinë në pajtim me destinimin dhe në masë e cila i përgjigjet të drejtave të pronarëve të tjerë.
2. Pronarët vendosin për të gjitha punët në bashkëpronësi të cilat kanë për qëllim përmirësimin e kushteve për përdorimin e saj.

Neni 15
Kryerja e Veprimtarive të lejuara në bashkëpronësinë në ndërtesë

1. Ndërtesa e banimit mund të ndërroj etazhitetin ose pjesët e përbashkëta të ndërtesës mund të ri-destinohen vetëm kur është në harmoni me planin rregullues urban dhe kërkesat themelore të ndërtimit.
2. Relacioni në mes përfituesit të së drejtës për ri-destinim të bashkëpronësisë dhe pronarëve të ndërtesës në bashkëpronësi rregullohet përmes marrëveshjes.
3. Pëlqimi i pronarëve duhet të jetë i verifikuar tek organet kompetente.
4. Përfituesi i të drejtës sipas paragrafit 2. të këtij neni është i detyruar që të marrë pëlqimin e të gjithë pronarëve tjerë dhe t'i kompensoj për vlerën e sipërfaqes së ridestinuar në bashkëpronësi nëse me marrëveshje nuk vendoset ndryshe.

Neni 16
Shfrytëzimi i njësive në ndërtesë

Çdo pronarë të drejtën e vet pronësore në njësitë e ndërtesës e realizon në atë mënyrë që mos t'i pengojë pronarët tjerë në shfrytëzimin e njësive në pronësi të tyre, respektivisht shfrytëzimin dhe përdorimin e pjesëve dhe pajisjeve të përbashkëta në ndërtesë.

Neni 17
Kryerja e Veprimtarive të lejuara në njësitë e ndërtesës

1. Si subjekt i dispozitave të marrëveshjes së bashkëpronësisë dhe dispozitave ligjore, një pronar i njësisë mund:
   1.1. të realizojë ndonjë përmirësim ose ndryshim të njësisë së tij nëse nuk ndikon në integritetin struktural, sistemin elektrik, sistemin mekanik,si dhe në zvogëlimin e kuotës së pjesëmarrjes së pronarëve tjerë në elementet e përbashkëta pa lejen e Shoqatës së Pronarëve;
   1.2. të eliminoj ose ndryshoj ndonjë pjesë ose të krijoj dalje, nëse ndarja në tërësi ose pjesërisht është element i përbashkët, nëse këto veprime nuk ndikojnë në integritetin struktural, sistemin elektrik ose sistemin mekanik ose nuk ndikojnë në zvogëlimin e stabilitetit të ndërtesës pas blerjes së një njësie fqinje ose të një pjese të njësisë fqinje,
2. Në pajtim me dispozitat e këtij ligji, pronari mund t'ia ndërrojë destinimin e njësisë së ndërtesës nëse i plotëson kushtet dhe procedurat e specifikuara me legjislacionin në fuqi.
3. Në pajtim me paragrafin 2. të këtij neni, për ndryshimin e destinimit të njësisë së ndërtesës pronari duhet të siguroj paraprakisht pëlqimin e pronarëve të tjerë, ku shuma e sipërfaqes së shfrytëzueshme të njësive të tyre të veçanta, përbënë mbi pesëdhjetë përqind (50%) të sipërfaqes së përgjithshme të shfrytëzueshme të ndërtesës.
4. Pëlqimi i pronarëve duhet të jetë i verifikuar tek organet kompetente.

Neni 18
Ndërprerja e punimeve

Kryesia e Shoqatës, administratori, ose cilido pronarë tjetër mund të kërkojë që të ndërpriten punimet rreth ndryshimeve, nëse ndryshimet në njësinë e ndërtesës apo në bashkëpronësi janë duke u kryer pa pajtimin e Shoqatës së Pronarëve ose kanë devijuar nga marrëveshja me shoqatën e Pronarëve.

Neni 19
Përgjegjësitë për dëmet

1. Pronari është përgjegjës për dëmin i cili është shkaktuar gjatë shfrytëzimit të njësisë së tij, dhe ndikon në njësitë tjera të ndërtesës ose në bashkëpronësinë në ndërtesë, në pajtim me dispozitat e përgjithshme ligjore.
2. Pronari, respektivisht qiramarrësi i njësisë së ndërtesës, është përgjegjës solidar me shkaktuesin e dëmit në njësi të ndërtesës, gjegjësisht në bashkëpronësi të ndërtesë kur atë e shkakton personi i tretë, si vizitor i ftuar i pronarit/qiramarrësit. Nëse dëmi shkaktohet nga kushtet e papërshtatshme ose mungesa e sigurisë së elementeve të përbashkëta, atëherë përgjegjëse është Shoqata.

Neni 20
Raportet e Qiramarrësit ndaj Bashkëpronësisë në ndërtesë

1. Pronarët bartin të drejtën dhe përgjegjësinë ndaj ndërtesës në bashkëpronësi të siguruar nga marrëveshja e bashkëpronësisë dhe rregulloret e aplikueshme, edhe nëse njësitë janë dhënë me qera ose jo tek një palë e tretë. Një pronar njësie është përgjegjës për pagesën e të gjitha obligimeve financiare duke përfshirë tatimin në pronë.
2. Pronari duhet të siguroj se cilido qiramarrës i njësisë i respekton rregulloret, deklaratën dhe rendin shtëpiak të ndërtesës në bashkëpronësi.
3. Pronarët mund të japin me qëra njësitë e tyre një pale të tretë subjekt me marrëveshjen, rregulloret dhe rendin shtëpiak të një ndërtese në bashkëpronësi.
4. Qiramarrësit kanë të drejtën e përdorimit dhe shfrytëzimit të njësisë dhe të elementeve të përbashkëta sikurse përcaktohen nga kontrata e qiradhënies.
5. Në varësi të marrëveshjes së bashkëpronësisë, akteve nënligjore dhe rendit shtëpiak të një ndërtese në bashkëpronësi, pronari që e lëshon me qera një njësi tek një palë e tretë duhet të ofroj menjëherë njoftimin për dhënie me qera tek Kryesia e Shoqatës ose administratori, si agjent i Kryesisë së Shoqatës. Njoftimi duhet të përfshijë informacionet kontaktuese për të dyja palët pronarin dhe qiramarrësin.

KREU V
ORGANET VENDIMMARRËSE NË NDËRTESAT E BANIMIT DHE NDARJA E PËRGJEGJËSIVE

Neni 21
Organet e vendimmarrjes

Organet përgjegjëse për marrjen e vendimeve dhe administrim në ndërtesën në bashkëpronësi janë Shoqata e Pronarëve, Kryesia e Shoqatës që kanë fuqinë të delegojnë funksionet tek një administrator.

Neni 22
Shoqata e Pronarëve

1. Për ndërtesat e reja në bashkëpronësi, Shoqata e Pronarëve të ndërtesës në bashkëpronësi duhet të organizohet jo më vonë se dita kur njësia e parë e bashkëpronësisë i dorëzohet blerësit.
2. Për ndërtesat ekzistuese, që kanë më shumë se dy (2) pronar njësish që janë themelues të bashkëpronësisë, pronarët e njësive duhet të formojnë Shoqatën e Pronarëve të ndërtesës në bashkëpronësi në kohën kur marrëveshja për bashkëpronësi nënshkruhet e që shërben si akt themelues i ndërtesës në bashkëpronësi.
3. Në kohën kur themelohet Shoqata e Pronarëve, pronarët e njësive duhet të nxjerrin rregulloret e aplikueshme nëse nuk janë përfshirë në Marrëveshjen e Bashkëpronësisë
4. Anëtarësia përbëhet ekskluzivisht nga të gjithë pronarët e njësive.

5. Nëse bashkëpronësia shuhet sipas nenit 12 të këtij ligji, Shoqata e Pronarëve duhet të përbëhet nga të gjithë pronarët e mëparshëm të njësive që janë titullar të ekzekutimit të procedurave të bartjes së pronës.

Neni 23
Rregulloret e shoqatës së pronarëve

1. Mënyra e funksionimit të Shoqatës së Pronarëve definohet me rregullore.
2. Në pajtim me këtë ligj, rregulloret e nxjerra nga Shoqata e Pronarëve duhet të përfshijnë:
   2.1. numrin e anëtarëve të Kryesisë së Shoqatës dhe titujt e zyrtarëve të Shoqatës së Pronarëve;
   2.2. zgjedhjet e Kryesisë së Shoqatës, të presidentit, zyrtarit të thesarit, sekretarit dhe të gjithë zyrtarëve të tjerë të Shoqatës së Pronarëve që specifikohen përmes rregulloreve;
   2.3. kualifikimet, kompetencat, detyrat dhe kushtet për pranimin e titullit, mënyrën e zgjedhjes dhe largimit nga detyra, anëtarët e Kryesisë së Shoqatës dhe zyrtarët si dhe mënyrën e plotësimit të vendit vakant;
   2.4. kompetencat e Kryesisë së Shoqatës ose zyrtarëve, që mund të delegohen tek personat të tjerë ose tek Administratori, nëse ka të tillë;
   2.5. zyrtarët që mund të përgatisin, ekzekutojnë, certifikojnë, regjistrojnë dhe amendamentojnë Marrëveshjen e Bashkëpronësisë në emër të Shoqatës së Pronarëve; dhe
   2.6. metodën për amendamentimin e rregulloreve.
3. Subjekt të dispozitave të marrëveshjes së bashkëpronësisë dhe rregulloreve mund të jenë çfarëdo çështje tjetër që Shoqata e Pronarëve e konsideron të arsyeshme dhe të nevojshme.

Neni 24
Statusi ligjor dhe regjistrimi i Shoqatës së Pronarëve

1. Shoqata e Pronarëve vendos nëse do të jetë Organizatë Joprofitabile (këtu e tutje OJQ), që fiton statusin e tillë juridik me rastin e regjistrimit në Ministrinë përkatëse për Administratën Publike ose personit juridik i regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.
2. Çdo ndryshim në anëtarësi duhet të përfshihet në statutin e Shoqatës së pronarëve dhe t'i përcillet organit kompetent për regjistrim.

Neni 25
Emërtimi i Shoqatës së Pronarëve

Emri i Shoqatës së Pronarëve si OJQ ose person juridik duhet të përmbajë fjalët "shoqatë e pronarëve", së cilës i bashkëngjitet edhe adresa e ndërtesës në bashkëpronësi.

Neni 26
Të drejtat ligjore të Shoqatës së Pronareve

1. Në pajtim me paragrafët 2. dhe 3. të këtij neni, dhe bazuar në Marrëveshjen për Bashkëpronësi, Shoqata e Pronarëve, pa autorizim specifik në marrëveshje mund të:
   1.1. adaptoj dhe amendamentoj rregulloret;
   1.2. adaptoj dhe amendamentoj të ardhurat, shpenzimet, rezervat dhe pagesën e obligimeve financiare si pjesë e shpenzimeve të përbashkëta të pronarëve të njësive;
   1.3. punësoi dhe largoi nga puna administratorin, punonjësit tjerë, nëpunësit dhe kontraktorët tjerë të pavarur;
   1.4. mbroj dhe marr pjesë në procedurat gjyqësore ose administrative si përfaqësues të një, dy a më shumë pronarëve të njësive në ndonjë çështje që ndërlidhet me bashkëpronësinë;
   1.5. hyjë në marrëdhënie kontraktuese dhe marrë përsipër detyrime;
   1.6. rregulloj përdorimin, mirëmbajtjen, riparimin, ndërrimin e vendit dhe ndryshimin e elementeve të përbashkëta;
   1.7. bëjë përmirësimet shtesë të elementeve të përbashkëta;
   1.8. marrë, mbajë, siguroj dhe bartë të drejtën e pronësisë ose interesit, të pronësisë së luajtshme ose paluajtshme në emër të vetë duke u bazuar në nenin 10 nënparagrafin 1.8. të këtij ligji;
   1.9. ndajë shpenzimet e përbashkëta, të ardhurave të qerasë, licencave dhe koncesionimeve në lidhje me elementet e përbashkëta;
   1.10. inkasojë dhe pranoj pagesa dhe tarifa për përdorimin, qiradhënien dhe shfrytëzimin e elementeve të përbashkëta të përshkruara në nenin 5 të këtij ligji;
   1.11. inkasojë tarifa shtesë për kryerjen me vonesë të obligimeve financiare të pronarëve, mbulimin e arsyeshëm të shpenzimeve për angazhimin e avokatit dhe shpenzimeve të tjera ligjore për mbledhjen e pagesave dhe kryerjen e veprimeve të tjera për të realizuar kompetencat e Shoqatës së Pronarëve pa marrë parasysh nëse padia është ngritur ose jo, dhe pas kumtimit të njoftimit dhe ofrimit të mundësisë që pala të dëgjohet, shqiptimi i dënimit për shkelje të marrëveshjes së bashkëpronësisë, rregulloreve dhe rregullave të Shoqatës së Pronarëve;
   1.12. inkasojë tarifa të arsyeshme për përgatitjen dhe regjistrimin e amendamenteve të marrëveshjes së bashkëpronësisë ose raportit për obligimet financiare që nuk janë kryer nga ana e pronarëve;
   1.13. sigurojë dëmshpërblimin për zyrtarët e vetë dhe Kryesinë e Shoqatës dhe për pagesën e polisës së sigurimit të ndërtesës nëse është e mundur;
   1.14. përcaktojë të drejtën për të pasur të hyra në të ardhmen, duke përfshirë të drejtën për të inkasuar pagesën e shpenzimeve të përbashkëta, por vetëm në atë shkallë që në mënyrë ekspresive e mundëson marrëveshja e bashkëpronësisë;
   1.15. ushtrojë kompetenca të tjera konform marrëveshjes së bashkëpronësisë ose rregulloreve;

1.16. ushtrojë kompetenca të tjera që mund të ushtrohen në Kosovë nga OJQ-të ose personat juridik të llojit të njëjtë sikurse Shoqata e Pronarëve; dhe
1.17. ushtroj kompetenca të nevojshme dhe në pajtim me udhëheqjen dhe funksionimin e Shoqatës së Pronarëve;

2. Shoqata e Pronarëve mund të ushtroj kompetencat e veta në mënyrë të drejtë, të arsyeshme dhe jodiskriminuese, dhe marrëveshja e bashkëpronësisë nuk duhet të kërkoj ndryshe;
3. Administratori, punonjësi, kontraktori i pavarur ose ndonjë person që përfaqëson Shoqatën e Pronarëve duhet të jetë subjekt i këtij neni njësoj sikurse do të ishte e tërë Shoqata e Pronarëve;

Neni 27
Takimet

1. Takimet e pronarëve të njësive si anëtar të Shoqatës së Pronarëve, duhet të mbahen së paku një herë në vit.
2. Pronarët mund të marrin pjesë personalisht apo të autorizojnë një përfaqësues të autorizuar sipas nenit 28 të këtij ligji.
3. Takimet e jashtëzakonshme thirren nga Kryetari, shumica e anëtarëve të Kryesisë së Shoqatës, ose nga pronarët e njësive që kanë një të pestën (1/5) e votave të Shoqatës së Pronarëve.
4. Kryesia e Shoqatës ose Administratori mund të ofroj një njoftim së paku dy (2) javë para mbajtjes së mbledhjes dhe njoftimi duhet t'u dorëzohet pronarëve të njësive personalisht, ose nëse pronari nuk jeton në bashkëpronësi, duke ja dërguar ftesën përmes postës, faksimilit, ose emalit në adresën e pronarit. Njoftimi po ashtu duhet të postohet në një vend të dukshëm në ndërtesë.
5. Njoftimi duhet të përmbajë kohën dhe vendin e takimit dhe pikat e agjendës, duke përfshirë arsyen e takimit për çfarëdo amendamentimi të marrëveshjes ose rregulloreve, propozim-ndryshimin e buxhetit, dhe propozimet për largimin nga detyra të zyrtarëve ose anëtarëve të kryesisë së shoqatës.
6. Të gjitha takimet e rregullta dhe jashtëzakonshme të Shoqatës së Pronarëve janë të hapura për diskutim për anëtarët e Shoqatës së Pronarëve ose përfaqësuesit e tyre. Agjenda e takimit duhet të jetë në dispozicion për ndryshime.
7. Marrëveshja e Bashkëpronësisë nuk mund të kufizoj të drejtat e pronarëve të njësive për t'u njoftuar dhe për të marrë pjesë në takime.
8. Mbledhjet e Shoqatës së Pronarëve udhëhiqen nga Kryesia e Shoqatës.
9. Përveç siç ceket në nenin 15, paragrafi 4 të këtij ligji, çështjet që hidhen në votim nga Shoqata e Pronarëve kalojnë nëse për to vendos shumica e pronarëve që përbën më shumë se pesëdhjetë (50) përqind të votave.
10. Përderisa rregulloret nuk e parashohin ndryshe, kuorumi konsiderohet se është arritur për mbajtjen e mbledhjes së Shoqatës së Pronarëve, nëse pesëdhjetë (50%) përqind e pjesëmarrësve janë të pranishëm personalisht ose të përfaqësuar nga i autorizuari në fillim të takimit.
11. Përderisa rregulloret nuk e parashohin ndryshe, kuorumi konsiderohet se është arritur për mbajtjen e mbledhjes së Kryesisë së Shoqatës, nëse pesëdhjetë (50%) përqind e pjesëmarrësve janë të pranishëm personalisht ose të përfaqësuar nga i autorizuari në fillim të takimit.

12. Në rast se ka mungesë të kuorumit Kryesia e Shoqatës ose Administratori do të caktojnë një mbledhje të re.
13. Në takimin e Shoqatës së Pronarëve, çështjet që mund të hedhen në votim janë ato pika që janë prezantuar në agjendë për të cilat është shpërndarë edhe njoftimi për mbajtjen e mbledhjes.
14. Në takimin e Shoqatës së Pronarëve, sekretari i Kryesisë së Shoqatës ose administratori do të regjistrojnë dhe evidentojnë të gjitha vendimet e marra në mbledhje. Kopja e procesverbalit do t'u shpërndahet të gjithë pronarëve.
15. Pavarësisht nga paragrafi 6. i këtij neni, anëtarët e Kryesisë së Shoqatës mund të mbajnë takim me dyer të mbyllura gjatë një mbledhje të rregullt ose të jashtëzakonshme.
16. Shoqata e Pronarëve definon në rregullore kur mbahen takimet me dyer të mbyllura.
17. Nëse mbahet një takim me dyer të mbyllura, procesverbali duhet të njoftoj se takimi me dyer të mbyllura është mbajtur dhe të ofroj në përgjithësi informacione rreth çështjes së diskutuar me dyer të mbyllura.

Neni 28
Votimi dhe delegimi i së drejtës së votës

1. Fuqia e votës përcaktohet me kuotën e pjesëmarrjes.
2. Pronarët e njësive mund të delegojnë të drejtën e votës.
3. Një pronar njësie nuk mund të anulojë një delegim të së drejtës së votës të dhënë sipas këtij Neni përveç me njoftim faktik për revokim bërë personit që kryeson takimin e Shoqatës së Pronarëve. Delegimi i të drejtës së votës është i pavlefshëm nëse nuk është i datuar ose ka qëllim të jetë i revokueshëm pa paralajmërim. Delegimi i të drejtës së votës përfundon pas njëmbëdhjetë (11) muajve pas datës së tij, përveç nëse parashihet ndryshe në të.
4. Mënyra e votimit dhe detajet tjera të funksionimit dhe vendimmarrjes gjatë takimeve rregullohet në rregulloret e Shoqatës së Pronarëve.
5. Çdo veprim i Shoqatës së Pronarëve i bazuar në pranimin ose refuzimin e një vote, pëlqimi, fletëvotimi me shkrim, heqje dorë, emërimin e të deleguarit, ose revokimin të emërimit të të deleguarit është i vlefshëm përveç nëse një gjykatë e jurisdiksionit kompetent vendos ndryshe.

Neni 29
Kryesia e Shoqatës

1. Kryesia e Shoqatës është organi kryesor udhëheqës i Shoqatës së Pronarëve.
2. Kryesia e Shoqatës ngarkohet me administrimin e ndërtesës në bashkëpronësi përveç nëse shumica e pronarëve të njësive votojnë për të punësuar një Administrator.
3. Përveç siç parashihet në marrëveshjen për bashkëpronësi, rregullore, ose cilëndo dispozitë tjetër të këtij neni, Kryesia e Shoqatës mund të veprojë në të gjitha instancat në emër të Shoqatës së Pronarëve.
4. Përgjegjësitë e Kryesisë së Shoqatës më detajisht rregullohen me rregullore.

Neni 30
Administratori

1. Shoqata e Pronarëve mund të punësojë një administrator për të administruar funksionet e përditshme të ndërtesës në bashkëpronësi.
2. Çdo administrator i punësuar duhet të ofrojë:
   2.1. dëshmi për sigurimin e mirëbesimit ose bono sigurimi me shkrim për të mbrojtur dhe rimbursuar shoqatën në rast të veprimit ilegal të administratorit;
   2.2. certifikatë që dëshmon përfundimin e trajnimit të së paku një anëtari të Administratorit siç përcaktohet me Udhëzim Administrativ nga Ministria; dhe
   2.3. certifikatën e biznesit nga organi kompetent për biznes.
3. Detyrat e administratorit do të përcaktohen në kontratën ndërmjet administratorit dhe Shoqatës së Pronarëve.
   3.1. kontrata nuk do ti jep administratorit ndonjë kompetencë më të madhe se ato të Kryesisë së Shoqatës dhe mund të përfshijë ato çështje të përcaktuara në nenet 29 dhe 30 të këtij ligji.
   3.2. kontrata do të përfshijë:
      3.2.1. emrin e ndërtesës në bashkëpronësi;
      3.2.2. emrat dhe informatat kontaktuese të të dy palëve dhe pikave kryesore të kontaktit të tyre, përfshirë edhe jashtë orarit në rast të ndonjë emergjence në ndërtesën në bashkëpronësi;
      3.2.3. kompetencat dhe përgjegjësitë specifike të administratorit;
      3.2.4. shumën dhe kushtet e kompensimit;
      3.2.5. shumën e sigurimit të mirëbesimit apo garancionit; dhe
      3.2.6. periudhën e kontratës.
4. Kontrata mund të lidhet nga Kryesia e Shoqatës por duhet të miratohet me shumicë votash nga Shoqata e Pronarëve në takimin vjetor të radhës ose në një takim të veçantë të thirrur me qëllim të ratifikimit të kontratës së administratorit.
5. Administratori është përgjegjës për raportim në Kryesinë e Shoqatës çdo muaj, përfshirë edhe ofrimin e një kontabiliteti të plotë të të gjitha mjeteve të mbledhura dhe shpenzimeve. Administratori gjithashtu do të ndihmojë Kryesinë e Shoqatës për të raportuar në takimin vjetor me Shoqatën e Pronarëve.
6. Administratori duhet të mbajë të dhëna të sakta dhe të hollësishme lidhur me financat dhe administrimin e ndërtesës në bashkëpronësi dhe duhet ti bëjë këto të dhëna të disponueshme për çdo pronar të njësisë në rast kërkese.
7. Kontrata me administratorin mund të ndërpritet me vullnet të cilësdo palë.
8. Pas përfundimit të kontratës me skadim apo me ndërprerje, administratori do ti kthejë menjëherë Kryesisë së Shoqatës të gjithë dokumentacionin në lidhje me ndërtesën në bashkëpronësi.

Neni 31
Konflikti i Interesit

1. Përveç transaksioneve të përkufizuara me konflikt interesi, Shoqata e Pronarëve nuk mund t'i japë hua ndonjë anëtari të Kryesisë së Shoqatës ose Administratorit.

Çdo anëtar i Kryesisë së Shoqatës ose administrator që aprovon ose merr pjesë në dhënien e një huaje të tillë do t'i detyrohet Shoqatës së Pronarëve shumën e huas së tillë deri në shlyerjen e saj.

2. Një transaksion me konflikt interesi nuk ndalohet nëse:
   2.1. faktet materiale sa i përket marrëdhënies ose transaksionit me interes të anëtarit apo administratorit i shpalosen plotësisht Kryesisë së Shoqatës;
   2.2. kryesia e Shoqatës në mirëbesim aprovon transaksionin me konflikt interesi me shumicën e votave së anëtarëve të Kryesisë;

Neni 32
Përgjegjësia ligjore

1. Krijuesi i bashkëpronësisë është përgjegjës për realizimin e plotë të marrëveshjes me pronarët e njësive të ndërtesës në bashkëpronësi dhe hapësirave në funksion të tyre, si dhe për pasojat e veprimit ose mosveprimit në cilëndo pjesë të bashkëpronësisë.
2. Çdo akt që pretendon një veprim ose mosveprim nga shoqata duhet të ngritët ndaj shoqatës dhe jo ndaj ndonjë pronari njësie.
3. Kurdo që krijuesi i detyrohet shoqatës sipas këtij neni, ai gjithashtu është përgjegjës për shpenzimet e procesit gjyqësor, përfshirë tarifat e arsyeshme të avokatit, që i dalin shoqatës.
4. Krijuesi i bashkëpronësisë i detyrohet shoqatës për të gjitha fondet e shoqatës të mbledhura gjatë periudhës së kontrollit nga ai e të cilat nuk janë shpenzuar si duhet.

Neni 33
Sigurimi

1. Shoqata e pronarëve duhet të mbajë në dispozicion, në masë të arsyeshme:
   1.1. sigurim të pronës në elementet e përbashkëta për të mbuluar humbjen nga shkaqe të ndryshme në shumën e riparimit të pronës së siguruar;
   1.2. sigurim të përgjegjësisë së përgjithshme komerciale që del në lidhje me administrimin e elementeve të përbashkëta, në një shumë të specifikuar nga rregulloret e Shoqatës së Pronarëve.
2. Nëse sigurimi i përshkruar në paragrafin 1. të këtij neni nuk është në dispozicion ose nëse ndonjë polisë e sigurimit të tillë anulohet ose nuk rinovohet pa u marrë polisa zëvendësuese, shoqata do të njoftojë menjëherë pronarët e njësive.
3. Me marrëveshjen e bashkëpronësisë përcaktohen çfarëdo lloj sigurimi tjetër që pronarët e njësive e konsiderojnë të duhur për të mbrojtur ndërtesën në bashkëpronësi dhe organet administruese.
4. Kostoja për sigurim është shpenzim i përbashkët i shoqatës ku çdo pronar njësie është i obliguar të mbulojë shpenzimet në masë të kuotës së tij të pjesëmarrjes.
5. Kostoja e riparimit ose zëvendësimit që i tejkalon të ardhurat nga sigurimi dhe rezervave është shpenzim i përbashkët.
6. Çdo administrator i kontraktuar nga një shoqatë për administrimin e tridhjetë (30) apo më shumë njësive të një ndërtese në bashkëpronësi duhet të marrë dhe mbajë

sigurimin në një shumë jo më të vogël se shuma e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve për dy (2) muajt e fundit, plus rezervat, sipas kalkulimeve nga buxheti aktual i shoqatës.

7. Secili pronar njësie duhet të bëjë sigurimin e njësisë së banimit.

Neni 34
Autorizimet e Administratorit

1. Administratori krahas autorizimeve të caktuara me ligjet në fuqi ka edhe autorizime tjera si vijon:
   1.1. harton planin e mirëmbajtjes së ndërtesës, kohën e realizimit dhe ekzekutimin e këtij plani;
   1.2. mban llogarinë e shpenzimeve të administrimit;
   1.3. informon pronarët për punën e tij/saj dhe ua cakton llogaritë mujore dhe vjetore;
   1.4. përgatit faturat e pronarëve në bazë të llogarisë mujore dhe paguan detyrimet për kontratat me personat e tretë;
   1.5. paraqet raportin vjetor për administrimin e objektit;
   1.6. përfaqëson pronarët para organeve përkatëse për dhënien e lejeve dhe shfrytëzimin e shërbimeve komunale;
   1.7. Administratori kryen edhe punë tjera të përcaktuara me këtë ligj, me ligjet tjera në fuqi ose me marrëveshjen e pronarëve.

Neni 35
E drejta e administratorit për zgjedhjen e personit të tretë

1. Administratori për kryerjen e detyrave të veçanta, të cilat janë pjesë e kornizës së menaxhimit, mund të autorizojë një person të tretë për të kryer të gjithë punën ose një pjesë të saj. Administratori mbetet përgjegjës për të gjithë punën e kryer nga pala e tretë.
2. Administratori duhet të këshillojë dhe t'i përgjigjet Kryesisë së Shoqatës në lidhje me çdo kontratë të bërë me palët e treta.
3. Procedura e përzgjedhjes së personave të tretë për kryerjen e punëve të veçanta do të definohet nga pronarët në Marrëveshjen e bashkëpronësisë ose rregullore.

Neni 36
Përgjegjësitë e komunës ndaj ndërtesave në bashkëpronësi

1. Komuna me anë të planeve rregulluese urbane përcakton tokën e përbashkët dhe hapësirat publike në funksion të ndërtesave në bashkëpronësi, instalimet e përbashkëta elektrike, ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe ngrohjes qendrore duke respektuar normat minimale për hapësirat në funksion të ndërtesës në bashkëpronësi
2. Nëse ndërtesa në bashkëpronësi, parcela në të cilën është ndërtuar është pjesërisht ose tërësisht pronë komunale, Komuna duhet të pajtohet, gjatë procesit të regjistrimit të bashkëpronësisë, në dhënien e titullit pronarëve të njësive ndaj

hapësirave të përbashkëta në funksion të ndërtesës të rregulluara sipas paragrafit 1. të këtij neni.

3. Komuna, përkatësisht Organi kompetent komunal e mban regjistrin e ndërtesave në bashkëpronësi dhe administratorëve që ushtrojnë këtë veprimtari në territorin që ajo e administron.
4. Forma, përmbajtja dhe mënyra e mbajtjes së regjistrit sipas paragrafit 2. të këtij neni përcaktohet me akt nënligjor nga Ministria.
5. Komuna inicion krijimin e Shoqatës të Pronarëve me anë të projekteve varësisht prej mundësive buxhetore
6. Ministria në bashkëpunim me Komunën do të siguron edukim dhe trajnim pronarëve të ndërtesave dhe Kryesinë e Shoqatës rreth qeverisjes dhe funksionimit të ndërtesës në bashkëpronësi.

KREU VI
ADMINISTRIMI DHE MIRËMBAJTJA E BASHKËPRONËSISË NË NDËRTESË

Neni 37
Shpenzimet e përbashkëta

1. Derisa Shoqata e Pronarëve të bëjë një vlerësim të shpenzimeve të përbashkëta, krijuesi do të paguajë të gjitha shpenzimet e përbashkëta. Pasi të jetë bërë një vlerësim nga Shoqata e Pronarëve, vlerësimet do të bëhen së paku një (1) herë në vit, buxheti miratohet po ashtu së paku një (1) herë në vit nga Shoqata e Pronarëve.
2. Përveç për vlerësimet sipas paragrafëve 3. dhe 4. të këtij neni, të gjitha shpenzimet e përbashkëta do të taksohen ndaj të gjitha njësive në pajtim me kuotën e pjesëmarrjes të definuar në marrëveshjen e bashkëpronësisë në pajtim me nenin 10 të këtij ligji. Çdo shpenzim i përbashkët i vendosur nga Shoqata e Pronarëve do të bartë interes në normën e përcaktuar nga shoqata që nuk tejkalon normën e lejueshme me ligj.
3. Ashtu siç është përcaktuar me marrëveshje:
   3.1. çdo shpenzim i përbashkët lidhur me mirëmbajtjen, riparimin, ose zëvendësimin e një elementi të bashkëpronësisë për përdorim të veçantë do të taksohet ndaj njësive të cilave ai element i përbashkët i shërben, në mënyrë të barabartë, ose në çfarëdo proporcioni tjetër të cilin e parasheh marrëveshja;
   3.2. çdo shpenzim i përbashkët ose pjesë e tij që përfiton më pak se të gjitha njësitë do të taksohet ekskluzivisht ndaj njësive të përfituara; dhe
   3.3. kostot e shërbimeve komunale do të taksohen në bazë të politikave të definuara nga operatorët.
4. Nëse ndonjë shpenzim i përbashkët është shkaktuar nga sjellja e ndonjërit nga pronarët e njësive, shoqata mund të taksojë atë shpenzim ekskluzivisht ndaj njësisë së atij pronari.
5. Çdo pronar njësie është përgjegjës për taksimet e bëra ndaj njësisë së tij.
   5.1. pronarët e njësive do të paguajnë taksën pavarësisht nëse kanë shfrytëzuar ose jo elementet e përbashkëta ose kanë përdorur njësinë ndaj së cilës janë bërë taksimet.

5.2. pronarët e njësive duhet të paguajnë taksat për të mbuluar kostot që janë aprovuar nga shoqata, pavarësisht nëse pronari i njësisë ka votuar kundër ose në favor të vendimit të aprovuar.

Neni 38
Menaxhimi i të hyrave të mbledhura nga Shoqata e Pronarëve

1. Kryesia e Shoqatës dhe administratori, nëse ka, do të sigurojnë se të gjitha fondet e Shoqatës së Pronarëve mbahen në një llogari bankare të veçantë.
2. Nëse administratori menaxhon më shumë ndërtesa, fondet e secilës ndërtesë në bashkëpronësi duhet të mbahen në llogari të veçanta.
3. Përveç kur parashihet ndryshe në marrëveshjen e bashkëpronësisë, të gjitha fondet tepricë të shoqatës që mbesin pas pagesës ose ndarjes mënjanë të parave për shpenzime të përbashkëta dhe parapagimin ose ndarjes mënjanë të fondeve rezervë do t'iu kreditohen pronarëve të njësive proporcionalisht me kuotën e pjesëmarrjes për të ulur vlerësimet e e tyre të ardhshme për shpenzime të përbashkëta.

Neni 39
Shfrytëzimi i të hyrave të Shoqatës së Pronarëve

1. Të hyrat e mbledhura nga Shoqata e Pronarëve përmes taksave ose burimeve tjera mund të përdoren vetëm për të mbuluar shpenzimet për:
   1.1. kthimin e huave, përfshirë kapitalin dhe interesin;
   1.2. riparimet emergjente të bashkëpronësisë;
   1.3. riparimet e nevojshme të bashkëpronësisë;
   1.4. punët e administrimit të rregullt të bashkëpronësisë;
   1.5. sigurimin e ndërtesave nga një kompani e sigurimit;
   1.6. mbrojtjen nga zjarri.

Neni 40
Administrimi i rregullt

1. Punë të administrimit të rregullt, të cilat janë me interes të të gjithë pronarëve të një njësie të ndërtesës janë:
   1.1. mbajtja e higjienës në sipërfaqen e hapësirës së përbashkët;
   1.2. mirëmbajtja e rregullt e instalimeve elektrike në pjesët e përbashkëta të ndërtesës;
   1.3. mirëmbajtja e ndriçimit dhe pajisjeve tjera elektrike brenda dhe jashtë ndërtesës
   1.4. pagesa e shpenzimeve të energjisë elektrike në pjesët e përbashkëta dhe pajisjet e ndërtesës;
   1.5. ngjyrosja e mureve brenda dhe jashtë ndërtesës;
   1.6. servisimi i rregullt i ashensorit;
   1.7. servisimi i rregullt i instalimeve kundër zjarrit dhe aparatet kundër zjarrit në ndërtesë;
   1.8. servisimi i rregullt i instalimit të ujësjellësit, kanalizimit, instalimeve elektrike dhe instalimeve të makinerisë;

1.9. dezinsektimi dhe deratizimi i hapësirës së përbashkët të ndërtesës dhe pjesëve të veçanta në tërë ndërtesën;
1.10. pastrimi i ulluqeve, horizontale dhe vertikal, të ujit, si dhe rrjetave ujëmbledhësve;
1.11. pastrimi i gropës septike;
1.12. mirëmbajtja dhe pastrimi i oxhaqeve;
1.13. riparimet e nevojshme si:
1.13.1. riparimi i kulmeve, mureve mbajtëse, shtyllave, konstruksioneve mes-katshe dhe themeleve;
1.13.2. riparimi i oxhaqeve dhe kanaleve të ventilimit të dëmtuara;
1.13.3. riparimi i fasadës së ndërtesës së dëmtuar;
1.13.4. izolimi i mureve, dyshemeve dhe themelet të ndërtesave;
1.14. të gjitha punë tjera të nevojshme për të mbajtur ndërtesën në gjendje të rregullt dhe për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e banorëve në ndërtesë për të cilat vendoset nga Shoqata e Pronarëve.

Neni 41
Riparimet emergjente të ndërtesës në bashkëpronësi

1. Riparime emergjente konsiderohen punët e ndërmarra në bashkëpronësi me rastin e:
1.1. dëmtimit në sistemin e ngrohjes qendrore;
1.2. çarjeve, dëmtimeve dhe bllokimin në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit, për të parandaluar efektet negative të mëtejshme;
1.3. problemeve të paraqitura në instalime elektrike;
1.4. dëmeve të mëdha në oxhaqe dhe kanalet e ventilimit;
1.5. depërtimit të ujit të shiut në ndërtesë, rehabilitimit të pasojave dhe dëmtimeve të mëdha në çati;
1.6. kërcënimit të stabilitetit statik të ndërtesës ose të pjesëve të caktuara të ndërtesës;
1.7. dëmtimeve në ashensorë;
1.8. rënies së pjesëve të fasadës;
1.9. rehabilitimit të pasojave nga zjarri,
1.10. çdo ndërtimi tjetër, riparimi apo rehabilitimi urgjentisht i nevojshëm për të mbrojtur ndërtesën në bashkëpronësi ose përdoruesit e saj nga dëmi i afërt ose dëmtimet shtesë.

Neni 42
Mirëmbajtja e rregullt të ndërtesave

1. Kryesia e Shoqatës, ose drejtpërdrejt përmes administratorit ose shoqatës së pronarëve, do të përgatisë një plan për mirëmbajtjen e rregullt të ndërtesave. Plani do të zgjasë së paku një (1) vit.
2. Në planin e mirëmbajtjes, Kryesia e Shoqatës do të përcaktojë elementet që do të mirëmbahen ose riparohen dhe do ti përfshijë në buxhetin e kërkuar nga neni 37 i këtij ligji.

3. Nëse ndonjë pronar beson se plani i mirëmbajtjes nuk siguron ruajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi, ai mund të sfidojë planin dhe buxhetin duke dorëzuar një kundërshtim te Kryesia e Shoqatës. Nëse Kryesia e Shoqatës refuzon këtë kundërshtim, pronari i njësisë mund të ndërmerr hapa në dispozicion në bazë të këtij ligji, duke përfshirë thirrjen e një takimi të jashtëzakonshëm të Shoqatës së Pronarëve.
4. Në rastet kur ndonjë apo më shumë pronarë nuk respektojnë planin e mirëmbajtjes, secili pronar tjetër mund të lajmëroj inspektorin komunal që të marrë vendim ndaj tyre që të zbatojnë planin e mirëmbajtjes.

Neni 43
Shpenzimet tjera

1. Shpenzime tjera mund të aprovohen nga shumica e pronarëve ose siç përcaktohet ndryshe nga ky ligj.
2. Shpenzimet tjera janë shpenzimet që tejkalojnë kostot e menaxhimit të rregullt përfshijnë ndryshimet në pronësinë e përbashkët, ndryshimin e shfrytëzimit në ndërtesë dhe përmirësimet që nuk përfshihen në mirëmbajtjen e rregullt të ndërtesës, angazhimi i profesionistëve siç janë avokatët apo kontabilistët dhe aktivitetet për përmirësimin e shoqërisë dhe komunitetit.
3. Nëse një Shoqatë e Pronarëve nuk e aprovon një shpenzim të propozuar, cilido pronar njësie apo një kombinim i pronarëve të njësive mund të financojnë shpenzimin vetë, nëse aktiviteti ose shërbimi që rrit shpenzimet është në përputhje me Marrëveshjen e Bashkëpronësisë, rregulloret, rendit shtëpiak me këtë ligj dhe ka marrë aprovimin e nevojshëm të pronarit, nëse aprovimi i tij/saj është i/e nevojshëm.
4. Pronarët, të cilët e kanë më shumë se gjysmën e pjesëve në bashkëpronësi në ndërtesë, aprovojnë rendin shtëpiak, në të cilin vendosen rregullat themelore të mirëkuptimit fqinjësor në ndërtesë.

KREU VII
MBIKËQYRJA

Neni 44
Mbikëqyrja administrative

1. Përgjegjës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë të këtij ligji është Ministria përkatëse për mjedisin dhe planifikimin hapësinor.
2. Mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së administratës komunale rreth zbatimit të dispozitave të këtij ligji e bënë Ministria përkatëse për mjedisin dhe planifikimin hapësinor.

Neni 45
Mbikëqyrja inspektuese

1. Mbikëqyrjen inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë të këtij ligji, e kryen inspektori komunal i autorizuar për banim në kuadër të organit kompetent për inspektim.
2. Në territoret që janë nën kompetencën e Ministrisë, mbikëqyrjen inspektuese e bënë Inspektorati i Ministrisë.
3. Gjatë kryerjes së punës inspektuese, inspektorët nga paragrafi 1. i këtij neni kanë të drejtë të kryejnë mbikëqyrje në të gjitha ndërtesat për banim dhe ndërtesat për banim që kanë njësi afariste që janë në pronësi të më shumë së një pronari, si dhe, në komplekse të njësive individuale të banimit dhe afariste të cilat kanë në pronësi të përbashkët një territor, në funksion dhe në përdorim, ekskluzivisht, të pronarëve të njësive nëse administrimi i të njëjtave kryhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore në bazë të këtij ligji.
4. Shoqata e pronarëve ose Administratori si dhe pronarët e njësive individuale në ndërtesën në bashkëpronësi ose përfaqësuesve të tyre janë të detyruar t'i mundësojnë inspektorëve qasje në dokumentet e nevojshme lidhur me administrimin e ndërtesës në bashkëpronësi.
5. Për gjendjen e konstatuar inspektori mban procesverbal në bazë të cilit nxjerr aktvendim dhe në bazë të cilit konkluzion lejohet ekzekutimi.
6. Kundër aktvendimit të inspektorit të autorizuar për banim mund të bëhet ankesë në Ministri.
7. Ankesa kundër aktvendimit nuk e shtynë ekzekutimin.

KREU VIII
MASAT NDËSHKIMORE

Neni 46

1. Shoqata e Pronarëve mund të regjistrojë një barrë pagese ndaj një njësie për çdo pagesë të vonuar ndaj saj ose gjoba të vendosura ndaj pronarit të asaj njësie.
2. Shuma e barrës së pagesës rritet varësisht me vonesën e pagesës.
3. Barra e pagesës do të mbetet mbi njësinë dhe duhet të përmbushet para se njësia të mund të shitet, transferohet ose bartet në ndonjë mënyrë tjetër.
4. Një barrë pagese sipas këtij neni është me përparësi ndaj të gjitha barrë pagesave tjera mbi një njësi, përveç:
   4.1. barrës së pagesave të regjistruara para regjistrimit të marrëveshjes së bashkëpronësisë;
   4.2. interesit të sigurimit në njësinë që ka prioritet ndaj të gjitha interesave tjera të sigurimit dhe që është regjistruar para datës në të cilën evidentohet se taksa e kërkuar nuk është paguar; dhe
   4.3. barrës tatimore për patundshmëri dhe taksat apo ngarkesat tjera qeveritare ndaj njësisë.
5. Barra e pagesës regjistrohet në marrëveshjen e bashkëpronësisë dhe përbën njoftim dhe për kryerje të saj.

6. Shoqata do t'i ofrojë pronarit të njësisë apo përfaqësuesit të caktuar të pronarit të njësisë një njoftim me shkrim për natyrën dhe shumën e papaguar të taksave, gjobave ose shumave tjera që aktualisht ngarkohen ndaj njësisë së pronarit. Nëse nuk jepet njoftim, shoqata nuk do të ketë të drejtë të shpall barrë pagese mbi njësinë.
7. Barra e pagesës e shoqatës mund të ekzekutohet në mënyrë të njëjtë si hipoteka në patundshmëri.
8. Shoqata do të ketë të drejtë në shpenzimet dhe tarifat e arsyeshme të avokatit që i dalin shoqatës për të zbatuar barrën e pagesës.
9. Anëtarët e Kryesisë së Shoqatës ose Administratorët i nënshtrohen detyrimeve ligjore ndaj Shoqatës së Pronarëve siç parashihet me këtë ligj dhe gjithashtu mund të ballafaqohen me ndjekje penale nëse përfshihen në veprimtari kriminale gjatë kryerjes së përgjegjësive të tyre.

KREU IX
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 47

1. Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj i nxjerr Ministria në afat prej gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji Nr. 03/L-091 për Shfrytëzimin, administrimin, mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi.
3. Bashkësitë e pronarëve të organizuar sipas Ligjit Nr. 03/L-091 për Shfrytëzimin, administrimin, mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi, brenda gjashtë (6) muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të organizohen në përputhje me këtë ligj.

Neni 48
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-134
29 korrik 2013

Shpallur me dekretin Nr. DL-033-2013, datë 16.08.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 29 / 22 GUSHT 2013, PRISHTINË

LIGJI Nr. 04/L-199
PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË PARË NDËRKOMBËTARE TË PARIMEVE QË RREGULLOJNË NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE MES REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE REPUBLIKËS SË SERBISË

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË PARË NDËRKOMBËTARE TË PARIMEVE QË RREGULLOJNË NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE MES REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE REPUBLIKËS SË SERBISË

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ratifikon Marrëveshjen e parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, parafuar më 19 prill 2013 nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri i Republikës së Serbisë, miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 22 prill 2013, Vendimi Nr. 01/126, dhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 22 prill 2013, Rezoluta Nr. 04-R-10.

Neni 2
Fushëveprimi

Fushëveprimi i këtij ligji është Marrëveshja e parë ndërkombëtare e parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, dhe kjo Marrëveshje është pjesë përbërëse e këtij ligji. Ky ligj do të zbatohet nga Republika e Kosovës, me ndihmën e Bashkimit Evropian, (BE), Forcave të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut në Kosovë, (KFOR), dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

Neni 3
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë pas shpalljes së tij nga Presidentja e Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-199
27 qershor 2013

Shpallur me dekretin Nr. DL-050-2013, datë 12.09.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 38 / 17 SHTATOR 2013, PRISHTINË

Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve

1. Do të krijohet një Asociacion/Bashkësi e komunave me shumicë serbe në Kosovë. Anëtarësimi do të jetë i hapur për çdo komunë tjetër me kusht që anëtarët janë në pajtim.
2. Bashkësia/Asociacioni do të krijohet përmes statutit. Shpërbërja e Bashkësisë/ Asociacionit mund të bëhet vetëm me vendim të komunave pjesëmarrëse. Do të ofrohen garanci ligjore përmes ligjit të zbatueshëm dhe të drejtës kushtetuese (përfshirë rregullën për shumicën prej 2/3).
3. Struktura e Asociacionit/Bashkësisë do të themelohet mbi të njëjtën bazë sikurse statuti ekzistues i Asociacionit të komunave të Kosovës, p.sh. Kryetari, Nënkryetari, Kuvendi, Këshilli.
4. Në përputhje me kompetencat e parapara me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjin e Kosovës komunat pjesëmarrëse do të kenë të drejtë të bashkëpunojnë në ushtrimin e kompetencave të tyre përmes Asociacionit/ Bashkësisë në mënyrë kolektive. Asociacioni/Bashkësia do të ketë mbikëqyrje të plotë mbi fushat e zhvillimit ekonomik, arsimin, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural.
5. Asociacioni/Bashkësia do të ushtroj kompetenca të tjera shtesë siç mund të delegohen nga autoritetet qendrore.
6. Bashkësia/Asociacioni do të ketë rol përfaqësues te autoritetet qendrore dhe do të ketë një ulëse në Këshillin Konsultativ të Komuniteteve për këtë qëllim. Në përmbushje të këtij roli është paraparë funksioni monitorues.
7. Në Kosovë do të ketë një forcë policore, e quajtur Policia e Kosovës. E tërë policia në Kosovën veriore do të integrohen në kornizën e Policisë së Kosovës. Pagat do të jenë vetëm nga PK-ja.
8. Pjesëtarëve të strukturave tjera serbe të sigurisë do t'u ofrohet vend në strukturat ekuivalente të Kosovës.
9. Do të ketë një Komandant Rajonal të Policisë për katër komunat veriore me shumicë serbe (Mitrovica Veriore, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi). Komandanti i këtij rajoni do të jetë një serb i Kosovës i nominuar nga Ministria e Punëve të Brendshme nga lista e ofruar nga katër kryetarët e komunave në emër të Bashkësisë/Asociacionit. Përbërja e PK-së në veri do të reflektojë përbërjen etnike të popullatës së katër komunave. (Do të ketë Komandant tjetër rajonal për komunat e Mitrovicës Jugore, Skënderajit dhe Vushtrrisë). Komandanti rajonal i katër komunave veriore do të bashkëpunojë me komandantë tjerë rajonal.
10. Autoritetet gjyqësore do të integrohen dhe do të veprojnë në kuadër të kornizës ligjore të Kosovës. Gjykata e Apelit në Prishtinë do të themeloj një panel i përbërë nga një shumicë e gjykatësve serb të Kosovës për t'u marrë me të gjitha komunat e Kosovës me shumicë serbe.

    Një divizion i kësaj Gjykate të Apelit, i përbërë nga staf administrativ dhe gjyqtarë, do të vendoset në mënyrë të përhershme në Mitrovicën veriore (në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës).

Secili panel i divizionit të mësipërm do të përbëhet nga një shumicë e gjyqtarëve serb të Kosovës. Gjyqtarët përkatës do të vendosen varësisht nga natyra e rastit në fjalë.

11. Zgjedhjet lokale në komunat e veriut do të organizohen në vitin 2013, me lehtësimin e OSBE-së, në përputhje me ligjin e Kosovës, dhe me standardet ndërkombëtare.
12. Një plan zbatimi, përfshirë afatin kohor, do të nxirret deri më 26 Prill. Parimi i financimit transparent do të adresohet në zbatimin e kësaj marrëveshjeje.
13. Diskutimet lidhur me Energjinë dhe Telekomin do të intensifikohen nga të dy palët, dhe do të përfundojnë deri më 15 qershor.
14. Është arritur pajtimi që asnjëra palë nuk do të bllokojë, apo inkurajojë të tjerët të bllokojnë, progresin e palës tjetër në rrugët përkatëse drejt BE-së.
15. Do të themelohet një komision zbatimi nga të dy palët, me lehtësimin e BE-së.